

BIBLËN MUND TA KUPTOSH DHE TI!

***Ungjilli sipas Pjetrit:
Marku dhe I & II Pjetrit***

BOB UTLEY
PROFESOR I HERMENEUTIKËS
(INTERPRETIMIT BIBLIK)

PËRKTHEU: FLORENC MENE

***SERIA E KOMENTARËVE STUDIMORË UDHËZUES
DHIATA E RE, VËLL. 02***

BIBLE LESSONS INTERNATIONAL, MARSHALL, TEKSAS
2011

PËRMBAJTJE

Një fjalë nga autori: si mund të të ndihmojë ky komentari?.....	9
Udhëzues për leximin e mirë biblik: kërkim personal për të vërtetën e verifikueshme	11
Komentari:	
Biografi e Pjetrit	18
Hyrje për Markun	20
Marku 1	25
Marku 2	55
Marku 3	66
Marku 4	81
Marku 5	95
Marku 6	103
Marku 7	114
Marku 8	126
Marku 9	138
Marku 10	153
Marku 11	177
Marku 12	186
Marku 13	208
Marku 14	232
Marku 15	256
Marku 16	272
Hyrje për 1 Pjetrin	278

1 Pjetrit 1	283
1 Pjetrit 2	305
1 Pjetrit 3	320
1 Pjetrit 4	337
1 Pjetrit 5	349
Hyrje për 2 Pjetrin	359
2 Pjetrit 1	363
2 Pjetrit 2	382
2 Pjetrit 3	398
Shtojcat:	
Përcaktime të shkurtra të termave gramatikore greqisht	411
Kritika e tekstit	420
Shpallje doktrimore	423

TEMAT E VEÇANTA: PËRMBAJTJE

<i>Arché</i> (Special Topic: <i>Arché</i>), Marku 1:1	26
Pendimi në Dhiatën e Vjetër (Special Topic: Repentance in the Old Testament), Marku 1:4	29
Rrëfimi (Special Topic: Confession), Marku 1:5	31
Adopsionizmi (Special Topic: Adoptionism), Marku 1:10	34
Gnosticizmi (Special Topic: Gnosticism), Marku 1:10.....	34
Trinia (Special Topic: The Trinity), Marku 1:11	35
Numrat simbolikë në Bibël (Special Topic: Symbolic Numbers in Scripture), Marku 1:13.....	37
Fjalët greqisht për “vënien në provë” dhe ngjyrimet e tyre kuptimore (Special Topic: Greek Terms for Testing and their Connotations), Marku 1:13	38
Satani (Special Topic: Satan), Marku 1:13.....	39
Familja e Herodit të Madh (Special Topic: The Family of Herod the Great), Marku 1:14.....	41
Mbretëria e Perëndisë (Special Topic: The Kingdom of God), Marku 1:15	43
Besim, Besoj, ose Kam Besim (<i>Pistis</i> [emër], <i>Pisteuo</i> [folje], <i>Pistos</i> [mbiemër] (Special Topic: Faith (<i>pistis</i>) [noun], <i>pisteuo</i> [verb], <i>pistos</i> [adjective]), Marku 1:15.....	44
Shabati (Special Topic: Sabbath), Marku 1:21.....	46
Skribët (Special Topic: Scribes), Marku 1:22	47
Demoniake (Frymë e Ndyrë) (Special Topic: The Demonic [Unclean Spirits]), Marku 1:23	47
I Shenjti (Special Topic: The Holy One), Marku 1:24	49
Dëbimi i demonëve (Special Topic: Exorcism), Marku 1:25.....	50
Zemra (Special Topic: The Heart), Marku 2:6.....	57
Farisenjtë (Special Topic: Pharisees), Marku 2:16.....	60
Agjërimi (Special Topic: Fasting), Marku 2:18	62
Herodianët (Special Topic: Herodians), Marku 3:6	68

Shkatërrimi (<i>apollumi</i>) (Special Topic: Destruction [<i>apollumi</i>]), Marku 3:6	68
Biri i Perëndisë (Special Topic: The Son of God), Marku 3:11	70
Numri dymbëdhjetë (Special Topic: The Number Twelve), Marku 3:14	71
Grafiku me emrat e apostujve (Special Topic: Chart of Apostles' Names), Marku 3:16.....	73
Amen (Special Topic: Amen), Marku 3:28.....	76
Personaliteti i Frymës (Special Topic: The Personhood of the Spirit), Marku 3:29	77
I përjetshëm [<i>aiōnios</i>] (Special Topic: Eternal [<i>aiōnios</i>]), Marku 3:29.....	78
Procedura eksegjetike për interpretimin e “mëkatit të pafalshëm” (Special Topic: Exegetical Procedures for Interpreting “the Unpardonable Sin”), Marku 3:29.....	79
Interpretimi i shëmbëlltyrave (Special Topic: Interpreting Parables), Mësime kontekstuale, Marku 4.....	83
Misteri në ungjijtë (Special Topic: Mystery in the Gospels), Marku 4:11	87
Nevoja për qëndresë (Special Topic: The Need to Persevere), Marku 4:17.....	89
Shpëtimi [kohët e foljeve greqisht] (Special Topic: Salvation [Greek Verb Tenses]), Marku 4:27-29	91
Vajosja në Bibël [BDB 603] (Special Topic: Anointing in the Bible [BDB 603]), Marku 6:13.....	107
Hipokritët (Special Topic: Hypocrites), Marku 7:6.....	117
Gjuha njerëzore (Special Topic: Human Speech), Marku 7:20.....	119
Vënia e duarve në Bibël (Special Topic: Laying on of Hands in the Bible), Marku 7:32.....	123
Ringjallja (Special Topic: The Resurrection), Marku 8:31	133
Dërgoj [<i>apostellō</i>] (Special Topic: Send [<i>apostellō</i>]), Marku 9:37.....	146
Ku janë të vdekurit (Special Topic: Where Are the Dead?), Marku 9:43	149
<i>Ktisis</i> (Special Topic: <i>Ktisis</i>), Marku 10:6	156
Dhjetë urdhërimet [shih Eks. 20:1-17; LiP. 5:6-21] (Special Topic: The Ten Commandments [cf. Exod. 20:1-17; Deut. 5:6-21]), Marku 10:19	160
Pasuria (Special Topic: Wealth), Marku 10:23	163
Lavdi [<i>Doksa</i>] (Special Topic: Glory [<i>Doxa</i>]), Marku 10:37.....	169

Shpengoj/Çliroj (Special Topic: Ransom/Redeem), Marku 10:45.....	171
Jezusi Nazareas (Special Topic: Jesus the Nazarene), Marku 10:47.....	174
Përjetë [idiomë greke] (Special Topic: Forever [Greek Idiom]), Marku 11:14.....	181
Lutja e efektshme (Special Topic: Effective Prayer), Marku 11:23-24.....	183
“Gur” [BDB 6, KB 7] dhe “Gur Themeli” [819, KB 944] (Special Topic: “Stone” [BDB 6, KB 7] and “Cornerstone” [819, KB 944]), Marku 12:10.....	189
Sinedri (Special Topic: Sanhedrin), Marku 12:13.....	191
Saducenjtë (Special Topic: Sadducees), Maru 12:18	194
Autorësia e Pentatukut nga Moisiu (Special Topic: Moses’ Authorship of the Pentateuch), Marku 12:26... 196	
Emrat e Perëndisë (Special Topic: Names for Deity), Marku 12:36.....	201
Shkallët e shpërblimeve dhe ndëshkimeve (Special Topic: Degrees of Rewards and Punishment), Marku 12:40 204	
Monedhat që përdorehin në Palestinë në kohën e Jezusit (Special Topic: Coins in Use in Palestine in Jesus’ Day), Marku 12:42	206
Parashikimet e Dhiatës së Vjetër për të ardhmen kundrejt parashikimeve të Dhiatës së Re [“Hyrje e rëndësishme për Zbulesën”] (Special Topic: Old Testament Predictions of the Future vs. New Testament Predictions [Crucial Introduction to Revelation]), Mësime kontekstuale, Marku 13.....	209
Literatura apokaliptike (Special Topic: Apocalyptic Literature), Mësime kontekstuale, Marku 13	214
Përgjigjet për dy pyetjet e dishepujve në lidhje me kthimin e Krishtit në Mateu 24:3 (Special Topic: Answers to the Disciples’ Two Questions in Matthew 24:3), Marku 13:4	216
Kjo epokë dhe epoka e ardhshme (Special Topic: This Age and the Age to Come), Marku 13:8.....	218
Neveria e shkatërrimit (Special Topic: The Abomination of Desolation), Marku 13:14.....	220
Zgjedhja/paracaktimi dhe nevoja për një drejtpeshim teologjik (Special Topic: Election/Predestination and the Need for a Theological Balance), Marku 13:20	222
Zgjedhja/paracaktimi dhe nevoja për një drejtpeshim teologjik (Special Topic: Election/Predestination and the Need for a Theological Balance), 1 Pje. 1:2 [disi ndryshe nga tema e mësipërme]	285
Lutja ndërmjetësuese (Special Topic: Intercessory Prayer), Marku 13:20.....	222

Dyzet e dy muajt (Special Topic: Forty-Two Months), Marku 13:20.....	225
Ardhja në re (Special Topic: Coming in the Clouds), Marku 13:26	226
Ati (Special Topic: Father), Marku 13:32	229
Lëmosha (Special Topic: Almsgiving), Marku 14:5	236
Rendi i shërbesës së Pashkës në judaizmin e shekullit të parë (Special Topic: Passover (Order of Service), Marku 14:22	241
Darka e Zotit në Gjoni 6 (Special Topic: The Lord’s Supper in John 6), Marku 14:22.....	241
Besëlidhja (Special Topic: Covenant), Marku 14:24	242
“Derdhet” (Special Topic: Poured Out), Marku 14:24.....	243
Ora (Special Topic: The Hour), Marku 14:35	246
Mallkimi [<i>Anathema</i>] (Special Topic: Curse [<i>Anathema</i>]), Marku 14:71	253
Ponc Pilati (Special Topic: Pontius Pilate), Marku 15:1	258
Gratë në Bibël (Special Topic: Women in the Bible), Marku 15:40	267
Gratë që ndiqnin Jezusin (Special Topic: Women Who Followed Jesus), Marku 16:1	274
Erëzat e varrimit (Special Topic: Burial Spices), Marku 16:1	275
Trashëgimia e besimtarëve (Special Topic: Believers’ Inheritance), 1 Pjetrit 1:4	288
Jezusi dhe Fryma (Special Topic: Jesus and the Spirit), 1 Pjetrit 1:11.....	293
<i>Kerigma</i> e kishës së hershme (Special Topic: The <i>Kerygma</i> of the Early Church), 1 Pjetrit 1:11.....	294
Pikëpamjet e Palit për ligjin e Moisiut (Special Topic: Paul’s Views of the Mosaic Law), 1 Pje. 1:12 ..	295
Shenjtëria/shenjtërimi në Dhiatën e Re (Special Topic: New Testament Holiness/Sanctification), 1 Pje. 1:15	297
I shenjtë (Special Topic: Holy), 1 Pjetrit 1:16.....	298
Ndërtoj (Special Topic: Edify), 1 Pjetrit 2:5	307
Krishterimi është kolektiv (Special Topic: Christianity Is Corporate), 1 Pjetrit 2:5	307
Nënshtrim [<i>hupotassō</i>] (Special Topic: Submission [<i>hupotassō</i>]), 1 Pjetrit 2:13	312

Qeveria njerëzore (Special Topic: Human Government), 1 Pjetrit 2:13	312
Vullneti (<i>thelēma</i>) i Perëndisë (Special Topic: The Will (<i>thelēma</i>) of God), 1 Pjetrit 2:15.....	314
Porositë e Palit për skllevërit (Special Topic: Paul’s Admonitions to Slaves), 1 Pjetrit 2:18	316
Drejtesia (Special Topic: Righteousness), 1 Pjetrit 3:14	326
Shpresa (Special Topic: Hope), 1 Pjetrit 3:15	329
Veset dhe virtytet në DHR (Special Topic: Vices and Virtues in the NT), 1 Pjetrit 4:3	338
Qëndrimet biblike për alkoolin dhe alkoolizmin (Special Topic: Biblical Attitudes toward Alcohol and Alcoholism), 1 Pjetrit 4:3	339
Pse vuajnë të krishterët? (Special Topic: Why Do Christians Suffer?), 1 Pjetrit 4:12	345
Koinonia (Special Topic: <i>Koinonia</i>), 1 Pjetrit 4:13.....	346
Ligësia si person (Special Topic: Personal Evil), 1 Pjetrit 5:8.....	352
Qëndresa (Special Topic: Perseverance), 1 Pjetrit 5:9	354
Sila/Silvani (Special Topic: Silas/Silvanus), 1 Pjetrit 5:12	356
Rritja e krishterë (Special Topic: Christian Growth), 2 Pjetrit 1:5.....	369
Siguria e shpëtimit (Special Topic: Assurance), 2 Pjetrit 1:10.....	371
I thirrur (Special Topic: Called), 2 Pjetrit 1:10	373
Femohimi [<i>afistemī</i>] (Special Topic: Apostasy [<i>aphistemī</i>]), 2 Pjetrit 1:10.....	373
“E vërteta” (si koncept) në shkrimet e Gjonit (Special Topic: “Truth” (the Concept) in John’s Writings), 2 Pjetrit 1:12	376
“I vërtetë” (si term) në shkrimet e Gjonit (Special Topic: “True” (the Term) in John’s Writings), 2 Pje. 1:12	376
Ardhja e dytë (Special Topic: The Second Coming), 2 Pjetrit 1:16.....	378
“Bijtë e Perëndisë” në Zanafilla 6 (Special Topic: “The Sons of God” in Genesis 6), 2 Pjetrit 2:4	387
Shkatërroj, rrënoj, shprish (<i>ftheirō</i>) (Special Topic: Destroy, Ruin, Corrupt [<i>ftheirō</i>]), 2 Pjetrit 2:12	393
Zjarri (Special Topic: Fire), 2 Pjetrit 3:7	401
Plani i përjetshëm shpëngues i JHVH (Special Topic: JHWH’s Eternal Redemptive Plan), 2 Pje. 3:9....	404

NJË FJALË NGA AUTORI

SI MUND TË TË NDIHMOJË KY KOMENTAR?

Interpretimi biblik është një proces arsyetues dhe shpirtëror që përpiket të kuptojë një shkrimtar të lashtë të frymëzuar, në mënyrë të tillë që mesazhi i dhënë nga Perëndia të mund të kuptohet dhe të zbatohet në kohën tonë.

Procesi shpirtëror është kyç, por i vështirë për t'u përcaktuar. Ai kërkon qëndrim të dorëzuar dhe të hapur ndaj Perëndisë. Duhet të kesh uri (1) për Perëndinë, (2) për ta njohur atë dhe (3) për t'i shërbyer. Ky proces përfshin lutjen, rrëfimin dhe gatishmërinë për të ndryshuar mënyrën e jetesës. Fryma është kyç në procesin interpretues, por mbetet mister pse të krishterët e sinqertë dhe të perëndishëm e kuptojnë Biblën ndryshe nga njëri-tjetri.

Procesi arsyetues është më i lehtë për t'u shpjeguar. Duhet të jemi konsekuentë dhe të ndershëm me tekstin, dhe të mos ndikohemi nga anësitë tona personale apo denominacionale. Të gjithë jemi të kushtëzuar historikisht. Askush prej nesh s'është interpretues objektiv dhe asnjans. Ky komentuar ofron një proces të kujdesshëm arsyetues që përmban tri parime interpretuese, që janë strukturuar për të na ndihmuar të tejkalojmë anësitë tona.

Parimi i parë

Parimi i parë është të vërejmë sfondin historik ku u shkrua libri biblik, si dhe shkasit e veçantë historik për autorësinë e tij. Autori fillestar donte të përçonte një synim, një mesazh. Teksti nuk mund të ketë për ne një kuptim që nuk e pati kurrë për autorin fillestar, të lashtë e të frymëzuar. Çelësi është synimi i autorit, jo nevoja jonë historike, emocionale, kulturore, personale, apo denominacionale. Zbatimi është partner i pandashëm i interpretimit, por interpretimi i drejtë duhet t'i paraprijë gjithmonë zbatimit. Duhet ritheksuar se çdo tekst biblik ka një kuptim të vetëm dhe jo më tepër. Ky kuptim është ai që synonte t'i përçonte kohës së vet autori biblik fillestar përmes udhëheqjes së Frymës. Ky kuptim i vetëm mund të ketë shumë zbatime të mundshme për kultura dhe situata të ndryshme. Këto zbatime duhen lidhur me të vërtetën qendrore të autorit fillestar. Për këtë arsye, ky komentuar studimi udhëzues synon që të sigurojë një hyrje për secilin libër të Biblës.

Parimi i dytë

Parimi i dytë është të identifikojmë njësitë letrare. Secili libër biblik përbën një dokument të unifikuar. Interpretuesit nuk kanë të drejtë të izolojnë njërin aspekt të së vërtetës duke përjashtuar të tjerët. Prandaj, duhet të rrekemi të kuptojmë synimin e gjithë librit biblik përpara se të interpretojmë njësitë e veçanta letrare të tij. Pjesët e veçanta (kapitujt, paragrafët, apo vargjet) nuk mund të kenë një kuptim ndryshe nga ai i gjithë njësisë në tërësi. Interpretimi duhet të zhvendoset nga qasja deduktive ndaj tërësisë drejt qasjes induktive ndaj pjesëve. Për këtë arsye, ky komentuar studimi udhëzues synon të ndihmojë studiuesin që të analizojë strukturën e secilës njësi letrare sipas paragrafëve. Ndarjet sipas paragrafëve apo kapitujve nuk janë të frymëzuara, por na ndihmojnë që të identifikojmë njësitë e mendimit.

Interpretimi në nivelin e paragrafit (jo në nivelin e periudhës, fjalisë, frazës apo fjalës) është çelësi për të ndjekur kuptimin e synuar të autorit biblik. Paragrafët bazohen në një tematikë të unifikuar, shpesh e quajtur tema, ose fjalia temë. Çdo fjalë, frazë, fjali dhe periudhë e paragrafit lidhet në njëfarë mënyre me këtë temë të unifikuar. Ato e kufizojnë, zgjerojnë, shpjegojnë dhe/ose e vënë në pikëpyetje. Një çelës i vërtetë për interpretimin e saktë është të ndjekim mendimin e autorit fillestar paragraf për paragraf përmes njësisë të veçanta letrare që përbëjnë librin biblik. Ky komentuar studimi udhëzues synon të ndihmojë studiuesin që ta bëjë këtë duke krahasuar përkthimet e sotme në gjuhën angleze. Këto përkthime janë përzgjedhur për shkak se përdorin teori të ndryshme përkthimi:

1. Teksti greqisht i United Bible Society (Shoqëria e Bashkuar Biblike) është botimi i katërt i rishikuar (UBS⁴). Ky tekst është ndarë në paragrafë nga studiues të sotëm teksti.
2. Versioni New King James (NKJV) është një përkthim i fjalëpërfjalshëm i bazuar në traditën e dorëshkrimeve greqisht të njohur si *Textus Receptus*. Ndarjet e paragrafëve të tij janë më të gjata se

në përkthimet e tjera. Këto njësi më të gjata e ndihmojnë studiuesin që të shohë temat e unifikuara. [Kur autori i komentarit citon nga NKJV, përkthyesit në shqip citojnë nga versioni LIM, i cili i përket të njëjtës familje tekstuale si NKJV. Shënim i përkthyesit.]

3. Versioni New Revised Standard (NRSV) është një përkthim i fjalëpërfjalshëm, por i modifikuar. Ai përbën një pikë të ndërmjetme mes dy versioneve të mëposhtme moderne. Ndarjet e tij të paragrafëve janë tejet të dobishme për identifikimin e temave.
4. Versioni Today's English (TEV) është një përkthim ekuivalent dinamik i botuar nga Shoqëria e Bashkuar Biblike. Ai përpiket ta përkthejë Biblën në mënyrë të tillë që çdo lexues ose folës modern i anglishtes të mund të rrokë kuptimin e tekstit greqisht. Shpesh, sidomos në ungjijtë, ai i ndan paragrafët sipas folësve, jo sipas temës, në të njëjtën mënyrë si NIV. Për synimet e interpretuesit, kjo nuk është e dobishme. Është interesante të vërejmë se, si UBS⁴, ashtu dhe TEV, janë botuar nga e njëjta organizatë, e megjithatë ndarja e paragrafëve të tyre ndryshon.
5. Bibla e New Jerusalem (NJB) është një përkthim ekuivalent dinamik i bazuar në përkthimin katolik francez. Është shumë i dobishëm për krahasimin e ndarjes së paragrafëve nga pikëvështrimi evropian.
6. Teksti i shtypur është ai i New American Standard Bible (NASB), i përditësuar në vitin 1995, i cili është një përkthim i fjalëpërfjalshëm. Paragrafët e tij ndiqen nga komentet e mia varg për varg. [Në shqip, përkthyesi ka përkthyer drejtpërdrejt NASB-në sa herë që përdoret në komantar. Shënim i përkthyesit.]

Parimi i tretë

Parimi i tretë është ta lexojmë Biblën në përkthime të ndryshme me qëllim që të kapim gamën më të gjerë të mundshme kuptimore (fusha semantike) që mund të kenë fjalët ose frazat biblike. Shpesh, fraza ose fjala greqisht mund të kuptohet në një sërë mënyrash. Këto përkthime të ndryshme i nxjerrin në pah këto alternativa dhe ndihmojnë në identifikimin dhe shpjegimin e varianteve në dorëshkrimet greqisht. Këto nuk ndikojnë në doktrinë, por, gjithsesi, na ndihmojnë në përpjekjen për t'u kthyer te teksti origjinal i shkruar nga shkrintari i frymëzuar në lashtësi.

Ky komantar ofron një mënyrë të shpejtë që studiuesi të kontrollojë interpretimet e veta. Ai nuk synon që të thotë fjalën e fundit, por të jetë informues dhe të nxisë mendimin. Shpesh, interpretimet e tjera të mundshme na ndihmojnë që të mos bëhemi tepër të provincialë, dogmatikë dhe denominacionalë. Interpretuesve u nevojitet një gamë më e gjerë alternativash interpretuese për të kuptuar sesa i vagullt mund të jetë teksti i lashtë. Është tronditëse sesa pak konsensus ekziston mes të krishterëve që pretendojnë se burimi i tyre i së vërtetës është Bibla.

Këto parime më kanë ndihmuar të tejkaloj një pjesë të mirë të kushtëzimit tim historik, pasi më kanë detyruar të "përleshem" me tekstin e lashtë. Shpresoj se kjo gjë do të jetë bekim edhe për ty.

Bob Utley
East Texas Baptist University
27 qershor 1996

UDHËZUES PËR LEXIMIN E MIRË BIBLIK: KËRKIM PERSONAL PËR TË VËRTETËN E VERIFIKUESHME

A mund ta njohim të vërtetën? Ku gjendet? E verifikojmë dot logjikisht? A ekziston autoriteti absolut? A ka vlera absolute që mund të na udhëheqin jetën dhe botën tonë? A ka kuptim jeta? Pse jemi këtu? Ku po shkojmë? Këto pyetje (pyetje që përsiasin të gjithë njerëzit e logjikshëm) e kanë përndjekur mendjen njerëzore që nga agui kohës (Pred. 1:13-18; 3:9-11). Më kujtohet kërkimi im vetjak për një qendër integruese në jetën time. Unë u bëra besimtar në Krishtin në moshë të re, kryesisht në bazë të dëshmisë së disa personave të rëndësishëm në familjen time. Me rritjen drejt pjekurisë, m'u rritën edhe pyetjet për veten dhe botën time. Klishtë e thjeshta kulturore dhe fetare nuk u jepnin kuptim përjetimeve për të cilat lexoja dhe me të cilat ndeshesha. Ishte një kohë pësjtjellimi, kërkimi, përmallimi dhe, shpesh, e një mungese shprese përballë botës së pandjeshme dhe të ashpër ku jetoja.

Shumë pretendonin se kishin përgjigje për këto pyetje absolute, por, pas hulumtimeve dhe përsiatjeve, vëreja se përgjigjet e tyre bazoheshin në (1) filozofi personale, (2) mite të lashta, (3) përjetime personale, ose (4) projeksione psikologjike. Kisha nevojë për njëfarë mase verifikimi, njëfarë lloj prove, një logjikë mbi të cilën të bazoja botëkuptimin tim, qendrën time integruese, arsyen për të jetuar.

Këto i gjeta në studimin e Biblës. Fillova të shqyrtoja për prova për vërtetësinë e saj, të cilat i gjeta në (1) besueshmërinë historike të Biblës, e vërtetuar nga arkeologjia, (2) saktësinë e profecive të Dhiatës së Vjetër, (3) unitetin e mesazhit të Biblës gjatë një mijë e gjashtëqind viteve të prodhimit të saj, dhe (4) dëshmitë personale të njerëzve të cilëve iu ndryshoi jeta një herë e përgjithmonë nga kontakti me Biblën. Krishterimi, si sistem i unifikuar besimi dhe bindjesh, ka aftësinë që të trajtojë pyetjet e koklavitura të jetës njerëzore. Kjo jo vetëm që më siguroi një kornizë logjike, por aspekti përjetues i besimit biblik më solli edhe gëzim e qëndrueshmëri emocionale.

Mendova se e gjeta qendrën integruese për jetën time: Krishtin, siç kuptohet përmes Shkrimeve. Ishte një përjetim ngazëllues, një çlirim emocional. Megjithatë, ende më kujtohet tronditja dhe dhimbja që pata kur fillova të kuptoja se sa shumë interpretime të ndryshme të këtij libri propagandoheshin, nganjëherë edhe brenda të njëjtave kisha dhe shkolla mendimi. Pohimi i frymëzimit dhe vërtetësisë së Biblës nuk ishte fundi, por vetëm fillimi. Si t'i vërtetoj ose mohoj interpretimet e larmishme dhe të kundërta të pasazheve të shumta e të vështira në Bibël, që ofroheshin nga ata që besonin në autoritetin dhe vërtetësinë e saj?

Kjo detyrë u bë synimi i jetës sime dhe shtegtimi i besimit tim. E dija se besimi në Krishtin (1) më kishte sjellë paqe dhe gëzim të madh. Mendja ime kërkonte me ngulm disa vlera absolute në mes të relativitetit të kulturës sime (postmodernizmit); (2) dogmatizmi i sistemeve të kundërta fetare (feve botërore); dhe (3) arroganca denominacionale. Në kërkimin tim për qasje të vlefshme për interpretimin e literaturës së lashtë, u habita kur zbulova dhe vetë anësitë e mia historike, kulturore, denominacionale dhe përjetuese. Shpesh, Biblën e kisha lexuar për të përforcuar pikëpamjet e mia. E përdorja si burim dogme për të sulmuar të tjerët dhe për të ripërkrahur vetë pasiguritë dhe mangësitë e mia. Sa të dhimbshëm e pata këtë ndërgjegjësim!

Ndonëse nuk mund të jem kurrë plotësisht objektiv, mund të bëhem lexues më i mirë i Biblës. Mund t'i kufizoj anësitë e mia duke i identifikuar dhe duke pranuar praninë e tyre. Ende nuk jam i çliruar prej tyre, por jam përballur me dobësitë e mia. Shpesh, interpretuesi është armiku më i keq i leximit të mirë biblik!

Më lejo të rendis disa nga presupozimet që sjell në studimin tim të Biblës në mënyrë që ti, si lexues, t'i shqyrtosh bashkë me mua:

I. Presupozime


1. Unë besoj se Bibla është e vetmja vetëzbulesë e frymëzuar e të vetmit Perëndi të vërtetë. Si rrjedhojë, duhet interpretuar në dritën e synimit të autorit fillestar hyjnor (Frymës) përmes shkrimtarit njerëzor në një sfond të veçantë historik.
2. Unë besoj se Bibla është shkruar për njeriun e zakonshëm – për të gjithë njerëzit! Perëndia na u përshtat për të na folur qartazi brenda një konteksti historik dhe kulturor. Perëndia nuk e fsheh të vërtetën – ai dëshiron të kuptojmë! Si rrjedhojë, Bibla duhet interpretuar në dritën e kohës së vet, jo sonës. Për ne, Bibla nuk duhet të ketë kurrë një kuptim të ndryshëm nga ajo që kuptuan ata që e lexuan dhe dëgjuan për herë të parë. Ajo është e kuptueshme nga mendja e zakonshme njerëzore dhe përdor forma e teknika normale të komunikimit njerëzor.

3. Unë besoj se Bibla ka një mesazh dhe synim të unifikuar. Ajo nuk bie në kundërshti me veten, ndonëse vërtet përmban pasazhe të vështira dhe paradoksale. Kështu, interpretuesi më i mirë i Biblës është vetë Bibla.
4. Unë besoj se çdo pasazh (përjashto profecitë) ka vetëm një kuptim, i bazuar në synimin e autorit të frymëzuar fillestar. Ndonëse s'mund të jemi kurrë absolutisht të sigurt se e njohim synimin e autorit fillestar, shumë tregues na dëftojnë në drejtimin e tij:
 - (a) Gjinia (lloji letrar) e zgjedhur për të shprehur mesazhin
 - (b) Sfondi historik dhe/ose shkasi i veçantë që solli në ekzistencë shkrimin
 - (c) Konteksti letrar i gjithë librit, si dhe i çdo njësie letrare
 - (d) Modeli (përvijimi) tekstual i njësisë letrare në mënyrën si lidhen me gjithë mesazhin
 - (e) Tiparet e veçanta gramatikore që janë përdorur për të komunikuar mesazhin
 - (f) Fjalët e zgjedhura për të paraqitur mesazhin
 - (g) Pasazhet paralele


Studimi i secilës prej këtyre zonave bëhet objekti i studimit tonë të pasazhit. Përpara se të shpjegoj metodologjinë time për leximin e mirë të Biblës, më lejoni të përvijoj disa nga metodat e papërshtatshme që po përdoren sot, të cilat kanë shkaktuar kaq shumë larmi interpretimesh dhe që, si rrjedhojë, duhen shmangur:

II. Metoda të papërshtatshme

1. Anashkalimi i kontekstit letrar të librave të Biblës dhe përdorimi i çdo periudhe, fjalie, madje dhe fjalësh të veçanta si pohime të së vërtetës pa lidhje me synimin e autorit ose kontekstin më të gjerë. Shpesh, ky quhet “përdorim i teksteve si provë”.
2. Anashkalimi i sfondit historik të librave duke e zëvendësuar me një sfond të hamendësuar historik që ka pak ose aspak mbështetje nga vetë teksti.
3. Anashkalimi i sfondit historik të librave dhe leximi i tyre si gazetën lokale të mëngjesit, të shkruar kryesisht për të krishterët e sotëm si individë.
4. Anashkalimi i sfondit historik të librave duke alegorizuar tekstin në një mesazh teologjiko-filozofik tërësisht pa lidhje me dëgjuesit e parë apo me synimin e autorit fillestar.
5. Anashkalimi i mesazhit fillestar duke e zëvendësuar me sistemin tonë të teologjisë, ndonjë doktrinë që e kemi për zemër, apo me ndonjë çështje bashkëkohore pa lidhje me synimin dhe mesazhin e shprehur të autorit fillestar. Shpesh, ky fenomen vijon pas leximit fillestar të Biblës si mënyrë për të mbështetur autoritetin e folësit. Rëndom, ky quhet “reagim i lexuesit” (interpretim i llojit “çfarë më thotë teksti mua?”). Në çdo komunikim njerëzor me shkrim mund të gjenden tre përbërës të lidhur me njëri-tjetrin:



Në të shkuarën, teknikat e ndryshme të leximit janë fokusuar në njërin nga këta tre përbërës. Por, për të pohuar vërtet frymëzimin unik të Biblës, do të ishte më i përshtatshëm një diagram i ndryshuar:



Në të vërtetë, në procesin interpretues duhen përfshirë të tre këta përbërës. Për qëllime vërtetimi, interpretimi im fokusohet në dy përbërësit e parë: autori fillestar dhe teksti. Ndoshta, po reagoj ndaj keqpërdorimeve që kam përmendur: (1) alegorizimi ose shpirtërizimi i teksteve dhe (2) interpretimi i “reagimit të lexuesit” (ç’kuptim ka teksti për mua). Keqpërdorimi mund të ndodhë në secilën fazë. Duhet t’i kontrollojmë gjithmonë motivet, anësitë, teknikat dhe zbatimet tona. Por si t’i kontrollojmë nëse nuk ka asnjë kufi, cak, apo kritere për interpretimet? Pikërisht këtu, synimi autorial dhe struktura e tekstit më sigurojnë disa kritere për t’ua kufizuar gamën interpretimeve të vlefshme të mundshme.

Në dritën e këtyre teknikave të përshtatshme leximore, cilat janë disa qasje të mundshme për leximin dhe interpretimin e mirë të Biblës, të cilat na ofrojnë një shkallë vërtetimi dhe konsistence?

III. Qasje të mundshme për leximin e mirë të Biblës

Në këtë pikë, nuk po diskutoj për teknikat unike të interpretimit të gjinive të veçanta, por për parimet e përgjithshme hermeneutike që janë të vlefshme për të gjitha llojet e teksteve biblike. Një libër i mirë për qasjet sipas gjinive të ndryshme është *How To Read the Bible For All Its Worth (Si ta lexosh Biblën për gjithë vlerën që ka)*, nga Gordon Fee dhe Douglas Stuart, botuar nga Zondervan.

Metodologjia ime fokusohet fillimisht te fakti se lexuesi duhet t’i lejojë Frymës së Shenjtë që të hedhë dritë mbi Biblën përmes katër ciklesh personale leximi. Kjo i jep Frymës, tekstit dhe lexuesit vend parësor, jo dytësor. Po kështu, kjo e mbron lexuesin që të mos ndikohet në mënyrë të panevojshme nga komentuesit. Kam dëgjuar se dikush ka thënë: “Bibla hedh shumë dritë mbi komentaret”. Ky nuk synohet si koment zhvlerësues për ndihmat studimore, por si thirrje për përdorimin e tyre në kohën e duhur.

Duhet të jemi në gjendje që interpretimet t’i mbështesim me vetë tekstin. Gjashtë zona sigurojnë të paktën një vërtetim të kufizuar:

- (1) Sfondi historik
- (2) Konteksti letrar
- (3) Strukturat gramatikore (sintaksa)
- (4) Përdorimi i fjalëve në kohën kur u shkruan
- (5) Pasazhet e përshtatshme paralele
- (6) Gjinia letrare

Duhet të jemi në gjendje të japim arsyet dhe logjikën e interpretimeve tona. Bibla është burimi ynë i vetëm për besimin dhe praktikën. Mjerisht, shpesh, të krishterët nuk bien dakord për ato që mëson ose pohon ajo. Është vetëkundërshtuese që ne besimtarët të pohojmë frymëzimin e Biblës dhe, pastaj, të mos jemi në gjendje të biem dakord se çfarë na mëson dhe kërkon ajo!

Katër ciklet e leximit synojnë të na sigurojnë të dhënat interpretuese të mëposhtme:

A. Cikli i parë i leximit

1. Lexo gjithë librin njëherësh. Lexoje sërish me një përkthim tjetër, ndoshta me një teori të ndryshme përkthimi
 - a. fjalë për fjalë (NKJV, NASB, NRSV)
 - b. ekuivalencë dinamike (TEV, JB)
 - c. parafrazim (Living Bible, Amplified Bible)
2. Kërko qëllimin qendror të gjithë shkrimit. Identifiko idenë e tij kryesore.
3. Izolo (nëse është e mundur) një njësi letrare, kapitull, paragraf, apo fjali që shpreh qartë qëllimin ose idenë e tij qendrore.
4. Identifiko gjininë mbizotëruese letrare
 - a. Dhiata e Vjetër
 - (1) Narrativa hebraike
 - (2) Poezia hebraike (letërsi urtësie, psalm)
 - (3) Profecia hebraike (prozë, poezi)
 - (4) Kodet e ligjit
 - b. Dhiata e Re
 - (1) Narrativa (ungjijtë, Veprat)

- (2) Shëmbëlltyra (ungjijtë)
 - (3) Letra
 - (4) Letërsia apokaliptike
- B. Cikli i dytë i leximit
1. Lexo sërish gjithë librin, duke u përpjekur të identifikosh temat ose subjektet kryesore.
 2. Përvijoj temat madhore dhe shpreh shkurtimisht përmbajtjen e tyre me një pohim të thjeshtë.
 3. Kontrolllo pohimin e synimit dhe përvijimin tënd të përgjithshëm me anë të ndihmave studimore.
- C. Cikli i tretë i leximit
1. Lexo sërish gjithë librin, duke u përpjekur të identifikosh sfondin historik dhe shkasin e veçantë për shkrimin e tij, duke u bazuar në të dhënat e vetë këtij libri biblik.
 2. Rendit elementet historike që përmenden në librin biblik
 - a. Autori
 - b. Data
 - c. Marrësit
 - d. Arsyeja e veçantë për shkrimin e tij
 - e. Aspekte të sfondit kulturor që lidhen me qëllimin e shkrimit
 - f. Përmendje të njerëzve dhe ngjarjeve historike
 3. Zgjeroje përvijimin tënd në nivel paragrafi për atë pjesë të librit biblik që po interpreton. Gjithmonë identifikoj dhe përvijoj njësinë letrare. Kjo mund të përbëhet nga një sërë kapitujsh ose paragrafesh. Kjo gjë të mundëson të ndjekësh logjikën dhe modelin tekstual të autorit fillestar.
 4. Kontrolllo sfondin historik duke përdorur ndihma studimore.
- D. Cikli i katërt i leximit
1. Lexo sërish njësinë e veçantë letrare në disa përkthime
 - a. Fjalë për fjalë (NKJV, NASB, NRSV)
 - b. Ekuivalencë dinamike (TEV, JB)
 - c. Parafrazim (Living Bible, Amplified Bible)
 2. Gjej strukturat letrare ose gramatikore
 - a. Fraza të përsëritura, Efe. 1:6, 12, 14
 - b. Struktura të përsëritura gramatikore, Rom. 8:31
 - c. Koncepte të kundërta
 3. Rendit elementet e mëposhtme
 - a. Terma të rëndësishëm
 - b. Terma të pazakontë
 - c. Struktura të rëndësishme gramatikore
 - d. Fjalë, fjali dhe periudha tejet të vështira
 4. Gjej pasazhet e duhura paralele
 - a. Gjej pasazhin më të qartë mësimor për temën tënde duke përdorur
 - (1) Libra “të teologjisë sistematike”
 - (2) Bibla me referenca
 - (3) Përkues biblikë
 - b. Gjej një çift të mundshëm paradoksal brenda temës tënde. Shumë të vërteta biblike paraqiten në çifte dialektike; shumë konflikte denominacionale vijnë nga mbështetja e njëanshme të gjysma e një tensioni biblik. Gjithë Bibla është e frymëzuar, ndaj duhet të përpiqemi të gjejmë mesazhin e saj të plotë në mënyrë që t’i sigurojmë një drejtpeshim biblik interpretimit tonë.
 - c. Kërko për paralele brenda të njëjtit libër, të njëjtit autor, ose të njëjtës gjini letrare; Bibla është interpretuesja më e mirë e vetes, pasi ajo ka një autor të vetëm, Frymën.
 5. Përdor ndihmat studimore për të kontrolluar vëzhgimet e tua për sfondin dhe shkasin historik
 - a. Bibla studimore
 - b. Enciklopedi, manualë dhe fjalorë biblikë
 - c. Hyrje biblike
 - d. Komentarë biblikë (në këtë pikë në studimin tënd, lejo komunitetin besimtar, të kaluar dhe të tashëm, që të të ndihmojë në studimin tënd personal dhe të ta korrigjojë).

IV. Zbatimi i interpretimit të Biblës

Në këtë pikë, i kthehemi zbatimit. Ke kaluar kohë për të kuptuar tekstin në sfondin e vet fillestar; tani, duhet ta zbatosh në jetën dhe kulturën tënde. Unë e përcaktoj autoritetin biblik si “të kuptuarit e asaj që po i thoshte autori fillestar biblik kohës së vet dhe zbatimin e asaj të vërtete në kohën tonë”.

Zbatimi duhet të ndjekë interpretimin e synimit të autorit fillestar si nga ana kohore, ashtu dhe ajo logjike. Nuk mund ta zbatojmë pasazhin biblik në kohën tonë pa kuptuar se çfarë po thoshte ai në kohën e vet! Pasazhi biblik nuk duhet të ketë një kuptim që nuk e pati kurrë vetë!

Si udhërrëfyes do të kesh përvijimin tënd të detajuar në nivelin e paragrafit (cikli i tretë i leximit). Zbatimi duhet bërë në nivelin e paragrafit, jo fjalës. Fjalët kanë kuptim vetëm në kontekst; fjalitë kanë kuptim vetëm në kontekst; periudhat kanë kuptim vetëm në kontekst. I vetmi person i frymëzuar, që është i përfshirë në procesin interpretues, është autori fillestar. Ne ndjekim vetëm udhëheqjen e tij me anë të përndritjes së Frymës së Shenjtë. Por përndritja nuk është frymëzim. Për të thënë, “kështu thotë Zoti”, duhet t’i qëndrojmë besnikë synimit të autorit fillestar. Zbatimi duhet të ketë lidhje të veçantë me synimin e përgjithshëm të gjithë shkrimit, me njësinë e veçantë letrare dhe me zhvillimin e mendimit në nivelin e paragrafit.

Mos lejo që problematikat e kohës sonë të interpretojnë Biblën; lër Biblën të flasë vetë! Kjo mund të na kërkojë që t’i nxjerrim parimet nga teksti. Kjo është e vlefshme nëse teksti mbështet një parim të caktuar. Fatkeqësisht, shumë herë, parimet tona janë thjesht të tilla, parime “tonat” – jo parime të tekstit.

Në zbatimin e Biblës, është e rëndësishme të kujtojmë se (përveçse në rastin e profecisë) vetëm një kuptim i vetëm është i vlefshëm për një tekst të caktuar biblik. Ai kuptim lidhet me synimin e autorit fillestar teksa trajtonte një krizë apo nevojës të kohës. Nga ky kuptim i vetëm mund të nxirren shumë zbatime të mundshme. Zbatimi do të bazohet në nevojat e marrësve, por duhet të ketë lidhje me kuptimin e autorit fillestar.

V. Aspekti shpirtëror i interpretimit

Deri tani, kam diskutuar për procesin logjik dhe tekstual që ka të bëjë me interpretimin dhe zbatimin. Tani, më lejoni të diskutoj shkurtimisht për aspektin shpirtëror të interpretimit. Lista e mëposhtme më ka rezultuar e dobishme:

- A. Lutu për ndihmën e Frymës (shih 1 Kor. 1:26-2:16).
- B. Lutu për falje dhe pastrim personal nga mëkatet e njohura (shih 1 Gjonit 1:9).
- C. Lutu për një dëshirë më të madhe për të njohur Perëndinë (shih Psa. 19:7-14; 42:1 e më tej; 119:1 e më tej).
- D. Çdo mësim të ri zbatohet menjëherë në jetë.
- E. Vazhdo të jesh i përlulur dhe i mësuësishëm.

Është shumë e vështirë të ruash ekuilibrin mes procesit logjik dhe udhëheqjes shpirtërore të Frymës së Shenjtë. Citimet e mëposhtme më kanë ndihmuar t’i ekuilibroj këto të dyja:

- A. nga James W. Sire, *Scripture Twisting (Shtrembërimi i Shkrimit)*, f. 17-18:

“Përndritja i vjen në mendje popullit të Perëndisë – jo vetëm elitës shpirtërore. Nuk ka asnjë klasë *guru*-sh në krishterimin biblik, asnjë *iluminati*, as njerëz përmes të cilëve duhet të vijë çdo interpretim i saktë. Prandaj, ndonëse Fryma e Shenjtë jep dhunti të veçanta urtësie, njohurie dhe mprehtësie shpirtërore, ai nuk i cakton këta të krishterë të dhuntishëm që të jenë të vetmit interpretues të autoritetshëm të Fjalës së tij. Është në dorën e secilit individ të popullit të tij që të mësojë, të gjykojë dhe të dallojë në lidhje me Biblën, e cila qëndron si autoritet edhe mbi ata të cilëve Perëndia u ka dhënë aftësi të veçanta. Si përmbledhje, supozimi që shpreh në gjithë këtë libër është se Bibla është zbulues e vërtetë e Perëndisë për gjithë njerëzimin, se ajo është autoriteti ynë absolut për të gjitha çështjet për të cilat flet, dhe se ajo nuk është mister i plotë, por mund të kuptohet mjaftueshëm nga njerëzit e zakonshëm në çdo kulturë”.

- B. për Kirkegardin, gjetur në Bernard Ramm, *Protestant Biblical Interpretation (Interpretimi biblik protestant)*, f. 75:

Sipas Kirkegardit, studimi gramatikor, leksikor dhe historik i Biblës është hap i nevojshëm, por paraprak, drejt leximit të vërtetë të Biblës. “Për ta lexuar Biblën *si fjalë të Perëndisë*, njeriu duhet ta lexojë me emocion të madh, në majtë gishtave, me pritshmëri të madhe, në kuvendim me Perëndinë. Nëse Biblën e lexon shkel e shko, pa kujdes, apo në mënyrë akademike, apo profesionale, nuk po e lexon si Fjalë të Perëndisë. Kur njeriu e lexon Biblën siç lexon një letër dashurie, atëherë po e lexon si Fjalë të Perëndisë”.

- C. H. H. Rowley në *The Relevance of the Bible (Natyra aktuale e Biblës)*, f. 19:
 “Asnjë kuptim thjesht mendor i Biblës, sado i plotë, s’ mund t’ia zotërojë dot të gjitha thesaret asaj. Ajo nuk e përçmon këtë lloj kuptimi, sepse ai është thelbësor për të shkuar drejt të kuptuarit të plotë. Por kjo duhet të të çojë në një të kuptuar shpirtëror të thesareve shpirtërore të këtij libri, në mënyrë që të plotësohet. Dhe, për këtë të kuptuar shpirtëror, është e nevojshme diçka më tepër sesa vigjilenca mendore. Gjërat shpirtërore dallohen shpirtërisht, ndaj studiuesit të Biblës i nevojitet një qëndrim shpirtëror pranues, një zell për të gjetur Perëndinë që t’i dorëzohet atij, në mënyrë që të kalojë, përtej studimit të tij shkencor, në trashëgiminë më të pasur të librit më madhështor në botë”.

VI. Metoda e këtij komentuari

Komentari studimor udhëzues synon të të ndihmojë në procedurat interpretuese në mënyrat vijuese

- A. Një përvijim i shkurtër historik shërben si hyrje e çdo libri. Pasi të kesh kryer “ciklin tre të leximit”, kontrollo këtë informacion.
- B. Mësimet kontekstuale gjenden në fillim të secilit kapitull. Kjo do të të ndihmojë të kuptosh sesi është strukturuar njësia letrare.
- C. Në fillim të çdo kapitulli ose njësie letrare kryesore, kam dhënë ndarjet e paragrafëve dhe titujt e tyre përshkruar nga një sërë përkthimesh moderne:
1. Teksti greqisht i United Bible Society, botimi i katërt i rishikuar (UBS⁴)
 2. The New American Standard Bible, përditësimi i vitit 1995 (NASB)
 3. The New King James Version (NKJV)
 4. The New Revised Standard Version (NRSV)
 5. Today’s English Version (TEV)
 6. The Jerusalem Bible (JB)
- Ndarjet sipas paragrafëve nuk janë të frymëzuara. Ato duhen vërtetuar nga konteksti. Duke krahasuar disa përkthime moderne që nisen nga teori të ndryshme përkthimi dhe pikëvështrime të ndryshme teologjike, jemi në gjendje të analizojmë strukturën e hamendësuar të mendimit të autorit fillestar. Secili paragraf përmban nga një të vërtetë kryesore. Kjo është quajtur “fjalja temë”, ose “ideja qendrore e tekstit”. Ky mendim unifikues është çelësi për interpretimin e duhur historik dhe gramatikor. S’duhet kurrë të interpretojmë, të predikojmë, ose të japim mësim nga më pak se një paragraf! Gjithmonë kujto se çdo paragraf ka lidhje me paragrafët rrethues. Ja pse është kaq e rëndësishme të bësh një përvijim të të gjithë librit në nivelin e paragrafëve. Duhet të jemi në gjendje të ndjekim rrjedhën logjike të temës që po trajtohet nga autori i frymëzuar fillestar.
- D. Shënimet e Bobit ndjekin një qasje interpretimi “varg për varg”. Kjo na shtrëngon të ndjekim mendimin e autorit fillestar. Shënimet sigurojnë informacion për pikat e mëposhtme:
1. kontekstin letrar
 2. të dhënat historike dhe kulturore
 3. informacione gramatikore
 4. studime fjalësh
 5. pasazhe paralele të rëndësishme
- E. Në pika të ndryshme gjatë këtij komentari, tekstit të shtypur të New American Standard Version (përditësimi i vitit 1995) do t’i shtojmë edhe përkthimet e një sërë versionesh të tjera moderne:
1. The New King James Version (NKJV), i cili ndjek dorëshkrimet tekstuale të “Textus Receptus”.
 2. The New Revised Standard Version (NRSV), i cili është një rishikim “fjalë për fjalë” i Revised Standard Version, i kryer nga Këshilli Kombëtar i Kishave (National Council of Churches).
 3. The Today’s English Version (TEV), i cili është një përkthim ekuivalent dinamik i Shoqërisë Biblike Amerikane.
 4. The Jerusalem Bible (JB), i cili është një përkthim anglisht i bazuar në një përkthim ekuivalent dinamik nga ana e katolikëve francezë.
- F. Për ata që s’lexojnë greqisht, krahasimi i përkthimeve anglisht mund t’i ndihmojë në identifikimin e problemeve në tekst:
1. variantet në dorëshkrime
 2. kuptimet e ndryshme të fjalëve
 3. tekstet dhe strukturat që janë të vështira nga ana gramatikore
 4. tekstet e paqarta

Ndonëse përkthimet anglisht nuk i zgjidhin dot këto probleme, gjithsesi i shigjetojnë si pjesë që kanë nevojë për një studim më të thellë dhe më tërësor.

- G. Në përmbyllje të çdo kapitulli, jepen pyetje të vlefshme diskutimi, të cilat përqipen të shigjetojnë çështjet kryesore interpretuese të atij kapitulli.

BIOGRAFI E PJETRIT

FAMILJA

- A. Familja e Pjetrit jetonte në Galilenë e johebrenjve, në qytetin e Betsaidës, në bregun verior të Detit të Galilesë (ose Detit të Tiberiadës, shih Gjoni 1:44), por, me sa duket, në një moment të caktuar, u transferuan në Kapernaum (shih Marku 1:21, 29).
- B. I ati i Pjetrit quhej Jona (shih Mat. 16:17), ose Gjon (shih Gjoni 1:42; 21:15-17).
- C. Emrin e parë e kishte Simon (shih Marku 1:16, 29, 30, 36), që ishte i përhapur në Palestinën e shekullit të parë. Kjo ishte forma judaike e emrit Simeon (shih Veprat 15:14; 2 Pje. 1:1), që ishte emri i njërit prej dymbëdhjetë fiseve të Izraelit (shih Zan. 29:33; Eks. 1:1).
Jezusi i vuri emrin Pjetër (*Petros*, që do të thotë “shkëmb,” që synonte të përshkruante qëndrueshmërinë dhe forcën e tij të mëvonshme në Mat 16:18; Marku 3:16; Luka 6:14; Gjoni 1:42). Forma aramaike është *Kefa* (shih Gjoni 1:42; 1 Kor. 1:12; 3:22; 9:5; 15:5; Gal. 1:18; 2:9, 11, 14). Shpesh, në DHR, këta dy emra jepen së bashku (Mat. 16:16; Luka 5:8; Gjoni 1:40; 6:8,68; 13:6,9,24,36; 18:10,15,25; 20:2,6; 21:2-3,7,11,15).
- D. Vëllai i Pjetrit quhej Andrea (shih Marku 1:16). Ai ishte dishepull i Gjon Pagëzorit (shih Gjoni 1:35, 40) dhe, më vonë, u bë besimtar dhe ndjekës i Jezusit (shih Gjoni 1:36-37). Ai e solli Simonin te Jezusi (shih Gjoni 1:41). Muaj më vonë, Jezusi i takoi përbri Detit të Galilesë dhe i thirri të bëheshin zyrtarisht dishepuj të tij me kohë të plotë (shih Mat. 4:18-20; Marku 1:16-18; dhe Luka 5:1-11).
- E. Ishte i martuar (shih Marku 1:30; 1 Kor. 9:5), por nuk përmendet të ketë patur fëmijë.

PROFESIONI

- A. Familja e Pjetrit zotëronte disa barka peshkimi, madje punësonte dhe mëditës.
- B. Familja e tij mund të ketë qenë partnere biznesi me Jakobin, Gjonin dhe babain e tyre, Zebedeun (shih Luka 5:10).
- C. Pjetri iu rikthye shkurtimisht peshkimit pas vdekjes së Jezusit (shih Gjoni 21).

PERSONALITETI

- A. Pikat e forta të Pjetrit
 1. Ishte ndjekës i përkushtuar, por tejet i nxituar (shih Marku 9:5; Gjoni 13:4-11).
 2. Ndërmori të kryente vepra besimi, por shpesh dështoi (p.sh., ecja mbi ujë, shih Mat. 14:28-31).
 3. Ishte trim dhe i gatshëm të vdiste (shih Mat. 26:51-52; Marku 14:47; Luka 22:49-51; Gjoni 18:10-11).
 4. Pas ringjalljes, Jezusi iu drejtua personalisht si drejtuesit të turpëruar të të dymbëdhjetëve (Gjoni 21) dhe i dha mundësinë të pendohej dhe të rimerrte udhëheqjen.
- B. Dobësitë e Pjetrit
 1. Në fillim, kishte prirje legaliste judaike
 - a. të ngrënit me johebrenjtë (Gal. 2:11-21)
 - b. ligjet për ushqimin (Veprat 10:9-16)
 2. Si gjithë apostujt, Pjetri nuk i kuptonte plotësisht mësimet rrënjësisht të reja të Jezusit, si dhe rrjedhojat e tyre
 - a. Marku 9:5-6
 - b. Gjoni 13:6-11; 18:10-11
 3. Jezusi e qortoi personalisht dhe rëndë (Mark 8:33; Mat. 16:23)

4. U gjet në gjumë, në vend që të ishte duke u lutur në orën e rëndësishme kur Jezusi kishte nevojë në Gjetseman (Marku 14:32-42; Mat. 26:36-46; Luka 22:40-60)
5. Mohoi në mënyrë të përsëritur se njihte Jezusin (Marku 14:66-72; Mat. 26:69-75; Luka 22:56-62; Gjoni 18:16-18, 25-27)

DREJTIMI I GRUPIT APOSTOLIK NGA PJETRI

- A. Ka katër lista apostujsh (shih Mat. 10:2-4; Marku 3:16-19; Luka 6:14-16; Veprat 1:13). Pjetri renditet gjithmonë i pari. Të Dymbëdhjetët ndaheshin në tre grupe katërshe. Besoj se kjo u lejonte të shkonin me radhë në shtëpi për të vizituar familjen.
- B. Shpesh, Pjetri shërben si folës për grupin e apostujve (shih Mat. 16:13-20; Marku 8:27-30; Luka 9:18-21). Këto pasazhe janë përdorur edhe për të theksuar autoritetin e Pjetrit brenda grupit (shih Mat 16:18). Megjithatë, brenda të njëjtit konteksti, ai edhe qortohet nga Jezusi si mjet i Satanit (shih Mat. 16:23; Marku 8:33).

Po kështu, kur dishepujt po debatonin se kush ishte më i madhi, nuk e morën si fakt të kryer se këtë pozicion e mbante Pjetri (shih Mat. 20:20-28, sidomos v. 24; Marku 9:33-37; 10:35-45).

- C. Pjetri nuk ishte drejtuesi i kishës së Jerusalemit. Kjo detyrë iu caktua Jakobit, gjysmëvëllait të Jezusit (shih Veprat 12:17; 15:13; 21:18; 1 Kor. 15:7; Gal. 1:19; 2:9, 12)..

SHËRBESA E TIJ PAS RINGJALLJES SË JEZUSIT

- A. Roli udhëheqës i Pjetrit shihet qartë në kapitujt e parë të Veprave
 1. Kryesoi në zgjedhjen e zëvendësuesit të Judës (shih Veprat 1:15-26).
 2. Bëri predikimin e parë në ditën e Rrëshajëve (shih Veprat 2).
 3. Shëroi një ulok dhe bëri predikimin e dytë të regjistruar në Veprat (shih Veprat 3:1-10; 3:11-26).
 4. Foli guximshëm para Sinedrit në Veprat 4.
 5. Luajti rol kryesues në disiplinimin kishtar të Ananias dhe Safirës te Veprat 5.
 6. Foli para këshillit të Jerusalemit në Veprat 15:7-11.
 7. Veprat e Apostujve i atribuojnë një sërë ngjarjesh dhe mrekullish të tjera.
- B. Gjithsesi, Pjetri nuk i mishëroi gjithmonë parimet e ungjillit
 1. Mbajti mendësinë e Dhiatës së Vjetër (shih Gal. 2:11-14).
 2. U desh të merrte zbulës të veçantë që të përfshinte Kornelin (Veprat 10) dhe johebrenjtë e tjerë.

VITET E HESHTJES

- A. Për Pjetrin ka pak, ose aspak, të dhëna pas Këshillit të Jerusalemit (Veprat 15)
 1. Galatasve 1:18
 2. Galatasve 2:7-21
 3. 1 Korintasve 1:12; 3:22; 9:5; 15:5
- B. Tradita e kishës së hershme
 1. Martirizimi i Pjetrit në Romë përmendet në letrën e Klementit të Romës drejtuar kishës në Korint më 95 pas K.
 2. Edhe Tertuliani (rreth 150-222 pas K.) e përmend martirizimin e Pjetrit në Romë nën Neronin (54-68 pas K.).
 3. Klementi i Aleksandrisë (200 pas K.) thotë se Pjetri u vra në Romë.
 4. Origeni (252 pas K.) thotë se Pjetri u martirizua i kryqëzuar kokëposhtë në Romë.

HYRJE PËR MARKUN

SHËNIME HYRËSE

- A. Kisha e hershme, zakonisht, e anashkalonte kopjimin, studimin dhe mësimdhënien e Markut, sepse preferonte Mateun dhe Lukën, ndërsa Markun e shihte si version “të shkurtuar” (ungjill të shkurtuar); këtë pikëpamje e tha shprehimisht më vonë dhe Augustini.
- B. Marku nuk citohet shpesh, as nga etërit të hershëm greqishtfolës të kishës, as nga apologët (mbrojtësit e besimit) e shekullit të dytë.
- C. Që nga shfaqja e qasjes moderne historiko-gramatikore në lidhje me interpretimin biblik, ungjilli i Markut ka marrë sërish rëndësi për shkak se konsiderohet si ungjilli i parë që u shkrua. Si Mateu, ashtu dhe Luka, përdorën skematikën e Markut në prezantimin që i bënë jetës dhe rëndësisë së Jezusit. Në këtë mënyrë, Marku është shndërruar në dokumentin themelor të kishës, pasi është rrëfimi i parë zyrtar me shkrim i jetës së Jezusit.

GJINIA LETRARE

- A. Ungjijtë nuk janë biografi ose histori moderne. Ato janë shkrime teologjike përzgjedhëse, që përdorshin për t’ua prezantuar Jezusin dëgjuesve të ndryshëm për t’i sjellë në besim tek ai. Ungjijtë janë “lajm i mirë”, rrëfime për jetën e Jezusit me qëllim ungjillizimin (shih Gjoni 20:30-31).
- B. Marku trajton katër kontekste të veçanta historike dhe katër qëllime teologjike:
 - 1. Jeta dhe mësimet e Jezusit
 - 2. Jeta dhe shërbesa e Pjetrit
 - 3. Nevojat e kishës së hershme
 - 4. Qëllimi ungjillizues i Gjon Markut
- C. Katër ungjijtë janë unikë në literaturën e Lindjes së Afërt dhe atë greko-romake. Autorët e frymëzuar kishin detyrën, që me udhëheqjen e Frymës, të përzgjidhnin ato mësimet dhe veprime të Jezusit që zbulonin qartë karakterin dhe/ose qëllimin e tij.

Ata i renditën këto fjalë dhe vepra në mënyra të ndryshme. Një shembull është kur krahasojmë Predikimin në Mal të Mateut (Mat. 5-7) me Predikimin në Fushë të Lukës (shih Luka 6:20-49). Shihet qartë se Mateu prirë për t’i mbledhur të gjitha mësimet e Jezusit në një predikim të gjatë, ndërsa Luka i përhapte këto mësimet gjatë gjithë ungjillit të vet. E njëjta gjë mund të thuhet dhe për mrekullitë të Jezusit: Mateu i mbledh së bashku, ndërsa Luka i përhap gjatë gjithë ungjillit.

Kjo nënkupton aftësinë e ungjilltarëve, jo vetëm që të përzgjidhnin dhe rendisnin mësimet e Jezusit, por edhe t’i përshtasin për synimet e tyre teologjike (lexo librin *How to Read the Bible for All Its Worth*, f. 113-114). Gjatë leximit të ungjijve, lexuesi duhet të bëjë vazhdimisht pyetjen se ç’ide po përpiqen të përçojnë ungjilltarët. Pse e kanë përfshirë këtë ngjarje, mrekulli, apo mësim të veçantë në këtë pikë të paraqitjes së Jezusit nga ana e tyre?
- D. Ungjilli i Markut është shembull i mirë i greqishtes *koine* si gjuhë e dytë e popujve në botën mesdhetare. Gjuha amtare e Markut ishte aramaishtja (kjo vlente dhe për Jezusin dhe gjithë judenjtë në Palestinën e shekullit të parë). Kjo shije semitike del shpesh në pah në ungjillin e Markut.

AUTORËSIA

- A. Tradita kishtarë e lidh Gjon Markun me apostullin Pjetrin për shkrimin e këtij ungjilli. Vetë ky libër (si gjithë ungjijtë e tjerë) është pa autor.
- B. Një tjetër dëshmi për rrëfimin okular të Pjetrit është fakti se Marku nuk përmend tri ngjarje të veçanta ku Pjetri mori pjesë personalisht.

1. Ecja e Pjetrit në ujë (shih Mat. 14:28-33)
2. Rasti ku Pjetri shërbeu si zëdhënës i besimit të Dymbëdhjetëve në Cezare të Filipisë (shih Mat. 16:13-20). Marku (8:27-30) lë pa përmendur pasazhet “mbi këtë shkëmb” dhe “çelësat e mbretërisë”.
3. Rasti kur Pjetri pagoi taksën e tempullit për vete dhe për Jezusin (shih Mat. 17:24-27). Ndoshta, modestia s’ia lejonte Pjetrit që t’i theksonte këto ngjarje në predikimet e veta në Romë.

C. Tradita e kishës së hershme

1. *I Klementi*, i shkruar në Romë rreth 95 pas K., aludon për Markun (si dhe *Bariu i Hermës*).
2. *Papia*, peshkopi i Hierapolit (rreth 130 pas K.), shkroi librin *Interpretimi i Thënive të Zotit*, që citohet nga Euzebi (275-339 pas K.) në librin e vet *Historia Kishtare* 3:39:15. Ai thekson se Marku ishte përkthyesi i Pjetrit dhe mbajti shënime të sakta, por jo kronologjike, për kujtimet e Pjetrit për Jezusin. Me sa duket, Marku mori dhe përshtati predikimet e Pjetrit, si dhe i organizoi në formën e ungjillit. *Papia* thotë se këtë informacion e kishte marrë nga “plaku”, që ndoshta ishte apostulli Gjon.
3. Justin Martiri (150 p.K.), kur citon Markun 3:17, shton se ky ishte kujtim i Pjetrit.
4. Prologu Anti-Markionit për Markun, i shkruar rreth 180 p.K., e identifikon Pjetrin si dëshmitar in okular të ungjillit të Markut. Po kështu, ky prolog thotë se Marku e shkroi ungjillin nga Italia pas vdekjes së Pjetrit (sipas traditës, në Romë rreth 65 p.K.).
5. Ireneu, që shkroi rreth 180 p.K., e përmend Gjon Markun si përkthyesin e Pjetrit dhe përpiluesin e kujtimeve të tij pas vdekjes (shih *Kundër Herezive* 3:1:2).
6. Klementi i Aleksandrisë (195 p.K.) thotë se ata që dëgjuan predikimet e Pjetrit në Romë i kërkuan Markut që t’i mbante shënim këto predikime.
7. Fragmenti Muratorian (një listë e librave të pranuar nga të krishterët), i shkruar rreth 200 p.K. në Romë, ndonëse me tekst të paplotë, duket se pohon se Gjon Marku mbajti shënim predikimet e Pjetrit.
8. Tertuliani (200 p.K.), në *Kundër Markionit* (4:5), thotë se Marku botoi kujtimet e Pjetrit.
9. Në *The Expositor’s Bible Commentary*, vëll. 8, f. 606, Walter Wessel bën komentin interesant se traditat e mësipërme të kishës së hershme vijnë nga qendra kishtare të larmishme nga ana gjeografike:
 - a. *Papia*, në Azinë e Vogël
 - b. Prologu Anti-Markionit dhe Fragmenti Muratorian, që të dy në Romë
 - c. Ireneu (shih *Adv. Haer.* 3:1:1), në Lion të Francës. Tradita e Ireneut gjendet edhe te Tertuliani (shih *Adv. Marc.* 4:5) në Afrikën e veriut, si dhe te Klementi i Aleksandrisë në Egjipt (shih *Hypotyposesis* 6, cituar nga Euzebi, *Eccl. His.* 2:15:1-2; 3:24:5-8; 6:14:6-7). Kjo larmi gjeografike i jep besueshmëri kësaj tradite, pasi ishte e pranuar gjerësisht në krishterimin e hershëm.
10. Sipas Euzebit (*Eccl. His.* 4:25), Origeni (230 p.K.; *Komentari i Mateut*; nuk njihet asnjë komentari i Markut deri në shekullin e pestë) thotë se Marku e shkroi ungjillin siç ia kishte shpjeguar Pjetri.
11. Vetë Euzebi diskuton për ungjillin e Markut në *Eccl. His.* 2:15, dhe thotë se Marku i shkroi predikimet e Pjetrit pas kërkesës së atyre që i kishin dëgjuar vetë, në mënyrë që t’i lexonin në të gjitha kishat. Euzebi e bazon këtë traditë në shkrimet e Klementit të Aleksandrisë.

D. Çfarë dimë për Gjon Markun:

1. Nëna e tij ishte besimtare e mirënjohur në Jerusalem; në shtëpinë e saj mblidhej kisha (ndoshta, ishte dhe vendi ku u krye Darka e Fundit, shih Marku 14:14-15; Veprat 1:13-14; Veprat 12:12). Ndoshta, Marku ishte djali i paemër që u arratis “i zhveshur” nga Gjetsemani (Marku 14:51-52).
2. Ai shoqëroi xhaxhain e vet, Barnabën (shih Kol. 4:10), dhe Palin kur u kthyen sërish nga Jerusalem në Antioki (Veprat 12:25).
3. Ishte shoqëruar me Barnabën dhe Palin në udhëtimin e parë misionar (Veprat 13:5), por u kthye papritmas në shtëpi (Veprat 13:13).

4. Më vonë, Barnaba donte që ta merrnin prapë Markun për një udhëtim të dytë misionar, por kjo shkaktoi mosmarrëveshje të rëndë mes Barnabës dhe Palit (Veprat 15:37-40).
 5. Më vonë, Marku u ribashkua me Palin dhe u bë mik dhe bashkëpunëtor i tij (Kol. 4:10; 2 Tim. 4:11; Filemoni 24).
 6. Ishte shoqëruar dhe bashkëpunëtor i Pjetrit (1 Pje. 5:13), me gjasë në Romë.
- E. Njohuria personale e Markut për jetën e Jezusit duke se vërtetohet nga Makru 14:51-52, ku një djalë largohet me vrap i zhveshur nga kopshti i Gjetsemanit menjëherë pas arrestimit të Jezusit. Kjo hollësi e pazakontë dhe plotësisht e papritur duket se pasqyron përjetimin personal të Markut.

DATA

- A. Ky ungjill është rrëfim dhe interpretim prej dëshmitari okular i jetës, veprave dhe mësimëve të Jezusit, me sa duket i marrë nga predikimet e Pjetrit. Këto predikime u përpiluan dhe u shpërndanë pas vdekjes së tij, sipas Prologut Anti-Markionit dhe Ireneut (i cili shton, edhe pas vdekjes së Palit). Pali dhe Pjetri u martirizuan nën Neronin (54-68 p.K.) në Romë (sipas traditës së kishës). Datat e sakta janë të panjohura, por nëse kjo është e vërtetë, atëherë datimi i Markut është diku në mesin e viteve gjashtëdhjetë.
- B. Ka mundësi që Prologu Anti-Markionit dhe Ireneu të mos e kenë patur fjalën për vdekjen e Pjetrit, por për largimin e tij (pra, daljen) nga Roma. Ka disa të dhëna tradicionale (p.sh., Justini dhe Hipoliti) se Pjetri e vizitoi Romën gjatë mbretërimit të Klaudit (41-54 p.K.). (Euzebi, *Eccl. His.* 2:14:6).
- C. Duket se Luka e përmyll librin e Veprave me Palin ende në burg në fillim të viteve '60. Nëse është e vërtetë se Luka e përdori Markun për të shkruar ungjillin e vet, atëherë Marku duhet të jetë shkruar përpara Veprave dhe, si rrjedhojë, më herët sesa fillimi i viteve '60.
- D. Autorësia dhe data e Markut nuk ndikojnë asesi në të vërtetat historike/teologjike/ungjillizuese të këtij ungjilli (apo të çdo ungjilli tjetër). Personazhi kryesor është Jezusi, jo autori njerëzor!
- E. Është e habitshme se asnjëri nga ungjijtë (madje, as Gjoni, i shkruar 95-96 p.K) nuk e përmend drejtpërdrejt, apo tërthorazi, shkatërrimin e Jerusalemit (shih Mat. 24; Marku 13; Luka 21) në 70 p.K. nga gjenerali romak dhe, më vonë, perandori Titi. Marku mund të jetë shkruar përpara kësaj ngjarjeje. Madje, ka gjasa që Mateu dhe Luka të jenë shkruar përpara këtij gjykimi të rëndë të judaizmit. Thjesht duhet pranuar se datat e sakta të shkrimit të ungjijve sinoptikë janë të paqarta deri më sot (si dhe marrëdhënia letrare mes tyre).

MARRËSIT

- A. Një sërë shkrimtarësh të kishës së hershme e lidhin Markun me Romën:
 1. 1 Pjetrit 5:13
 2. Prologu Anti-Markionit (Itali)
 3. Ireneu (Romë, shih *Adv. Haer.* 3:1:2)
 4. Klementi i Aleksandrisë (Romë, shih Euzebi, *Eccl. Hist.* 4:14:6-7; 6:14:5-7)
- B. Marku nuk i shpreh shkoqur qëllimet pse e shkroi ungjillin. Ka patur një sërë teorish për këtë.
 1. Është trakt ungjillizues (shih Marku 1:1) i shkruar posaçërisht për romakët (shih Marku 1:15; 10:45)
 - a. Elementet judaike interpretohen (shih Marku 7:3-4; 14:12; 15:42)
 - b. Fjalët aramaisht përkthehen (shih Marku 3:17; 5:41; 7:1, 34; 10:46; 14:36; 15:22, 34)
 - c. Përdor shumë fjalë latinisht (p.sh., ekzekutor, Marku 6:27; sekstan, Marku 7:4; census, Marku 12:14; kuadrant, Marku 12:42; pretorium, Marku 15:16; centurion, Marku 15:39; flagellare [kamxhikoj] Marku 15:42)
 - d. Gjuhë përfshirëse në lidhje me Jezusin

- (1) Gjuhë përfshirëse në lidhje me ata në Palestinë (shih Marku 1:5, 28, 33, 39; 2:13; 4:1; 6:33, 39, 41, 55)
- (2) Gjuhë përfshirëse në lidhje me të gjithë njerëzit (shih Marku 13:10)
2. Përndjekja pas zjarrit që ra në Romë më 64 pK, për të cilin Neroni ua hodhi fajin të krishterëve, shkaktoi një valë të tmerrshme persekutimi ndaj besimtarëve. Marku e përmend shpesh përndjekjen (p.sh., vuajtjet e Jezusit, 8:31; 9:39; 10:33-34, 46; dhe vuajtjen e ndjekësve të tij 8:34-38; 10:21, 30, 35-44).
3. Vonesa e Ardhjes së Dytë
4. Vdekja e dëshmitarëve okularë që kishin qenë me Jezusin, veçanërisht vdekja e apostujve
5. Shfaqja e herezive brenda kishave të shpërndara gjerësisht
 - a. Judaistët (Galatasve)
 - b. Gnostikët (1 Gjonit)
 - c. Kombinimi i a. dhe b. (pra, Kolosianët dhe Efesianët; 2 Pje. 2)

PËRVIJIMI STRUKTOROR

- A. Marku është strukturuar në mënyrë të tillë që java e fundit e jetës së Jezusit përbën fokusin e mbi një të tretës së librit. Rëndësia teologjike e Javës së Mundimit është e qartë.
- B. Meqë, sipas traditës së kishës së hershme, ungjilli i Markut është përpiluar nga predikimet e Pjetrit (pra, ndoshta në Romë), është e qartë përse nuk përfshin asnjë rrëfim të lindjes së Jezusit. Marku fillon aty ku nis dhe historia e Pjetrit, pra kur Jezusi ishte i rritur, dhe lidhet teologjikisht me mesazhin e Gjon Pagëzorit për pendim dhe besim si përgatitje për punën e Mesisë.
 Predikimet e Pjetrit duhet të kenë përdorur konceptet e “Birit të Njeriut” dhe “Birit të Perëndisë”. Ky ungjill reflekton vetë teologjinë e Pjetrit për Jezusin si person. Së pari, ai ishte mësues dhe shërues i madh, por më vonë u bë e qartë se ishte Mesia! Ky Mesi nuk ishte gjenerali pushtues që pritej, por një Shërbëtor i Përvuajtur (shih Isaia 53).
- C. Përvijimi thelbësor i strukturës gjeografike të Markut është huazuar dhe nga ungjijtë e tjerë sinoptikë (pra, Mateu dhe Luka)
 1. Shërbesa në Galile (Marku 1:14-6:13)
 2. Shërbesa jashtë Galilesë (Marku 6:14-8:30)
 3. Udhëtimi për në Jerusalem (Marku 8:31-10:52)
 4. Java e fundit në zonën e Jerusalemit (Marku 11:1-16:8)
- D. Ka mundësi që struktura e Markut imiton modelin bazë të predikimit të hershëm apostolik (p.sh., Veprat 10:37-53; shih librin e C. H. Dodd, *New Testament Studies*, f. 1-11). Nëse është e vërtetë, atëherë ungjijtë e shkruar janë pika kulmore e një periudhe traditash gojore (pra, *kerigma*). Judaizmi e konsideronte mësimin gojor si më të vlefshëm sesa tekstet e shkruara.
- E. Marku karakterizohet nga një stil i shpejtë rrëfimi (p.sh., “menjëherë”, shih Marku 1:10) i jetës së Jezusit. Marku nuk përmban seanca të gjata mësimdhënieje, por kalon shpejt nga njëra ngjarje në tjetrën (p.sh., përdorimi i përsëritur i fjalës “menjëherë”). Ungjilli i Markut e zbulon Jezusin me anë të veprimeve të tij. Megjithatë, ky rrëfim me ritëm të shpejtë është i mbushur me hollësi të gjalla prej dëshmitari okular (pra, prej Pjetrit).

CIKLI NJË I LEXIMIT (nga “Udhëzues për leximin e mirë biblik”)

Ky është një komentari studimor udhëzues, që do të thotë se ti je vetë përgjegjës për interpretimin e Biblës. Secili prej nesh duhet të ecë sipas dritës që ka. Ti, Bibla dhe Fryma e Shenjtë keni përparësi në interpretim. Nuk duhet t’ia dorëzosh këtë të drejtë komentuesit.

Lexo gjithë librin biblik njëherësh. Shprehe idenë qendrore të librit me fjalët e tua.

1. Ideja e gjithë librit.
2. Lloji i letërsisë (gjinia letrare)

CIKLI DY I LEXIMIT (nga “Udhëzues për leximin e mirë biblik”)

Ky është një komentuar studimor udhëzues, që do të thotë se ti je vetë përgjegjës për interpretimin e Biblës. Secili prej nesh duhet të ecë sipas dritës që ka. Ti, Bibla dhe Fryma e Shenjtë keni përparësi në interpretim. Nuk duhet t’ia dorëzosh këtë të drejtë komentuesit.

Lexo gjithë librin biblik njëherësh për herë të dytë. Përvijto temat kryesore dhe shprehe temën me një fjali.

1. Tema e njësisë së parë letrare.
2. Tema e njësisë së dytë letrare.
3. Tema e njësisë së tretë letrare.
4. Tema e njësisë së katërt letrare
5. Etj.

MARKU 1

NDARJET NË PARAGRAFË TË PËRKTHIMEVE MODERNE*

UBS ⁴	NKJV	NRSV	TEV	NJB
Predikimi i Gjon Pagëzorit	Gjon Pagëzori përgatit udhën	Veprimtaria e Gjon Pagëzorit	Predikimi i Gjon Pagëzorit	Shpallja e Gjon Pagëzorit
1:1-8	1:1-8	1:1-3 1:4-5 1:5-8	1:1-8	1:1-8
Pagëzimi i Jezusit	Gjoni pagëzon Jezusin	Pagëzimi i Jezusit	Pagëzimi dhe tundimi i Jezusit	Jezusi pagëzohet
1:9-11	1:9-11	1:9-11	1:9-11	1:9-11
Tundimi i Jezusit	Satani tundon Jezusin	Tundimi i Jezusit		Sprovimi në shkretëtirë
1:12-13	1:12-13	1:12-13	1:12-13	1:12-13
Fillimi i shërbesës galilease	Jezusi fillon shërbesën galilease	Fillimi i veprimtarisë së Jezusit në Galile	Jezusi thërret katër peshkatarë	Jezusi fillon të shpallë mesazhin
1:14-15	1:14-15	1:14-15	1:14-15	1:14-15
Thirrja e katër peshkatarëve	Katër peshkatarë thirren për t'u bërë dishepuj			Thirren katër dishepujt e parë
1:16-20	1:16-20	1:16-20	1:16-18 1:19-20	1:16-18 1:19-20
Burri me frymën e ndyrë	Jezusi dëbon një frymë të ndyrë		Burri me frymën e ligë	Jezusi mëson në Kapernaum dhe shëron një demoniak
1:21-28	1:21-28	1:21-28	1:21-22 1:23-24 1:25 1:26-27 1:28	1:21-22 1:23-28
Shërimi i shumë njerëzve	Shërimi i vjehrrës së Pjetrit		Jezusi shëron shumë njerëz	Shërimi i vjehrrës së Simonit
1:29-34	1:29-31 Shumë shërohen pas perëndimit të diellit në shabat	1:29-31	1:29-31	1:29-31 Një sërë shërimesh
	1:32-34	1:32-34	1:32-34	1:32-34
Turneu predikues	Predikimi në Galile		Jezusi predikon në Galile	Jezusi lë pa zhurmë

* Ndonëse nuk janë të frymëzuara, ndarjet në paragrafë janë kyçe për të kuptuar dhe ndjekur synimin e autorit fillestar. Secili përkthim modern i ka ndarë dhe përmbledhur paragrafët. Secili paragraf ka një temë, të vërtetë, ose mendim qendror. Secili version e përmbledh atë temë në mënyrën e vet të veçantë. Kur të lexosh tekstin, pyet veten se cili përkthim i përshtatet logjikës tënde për temën dhe për ndarjet në vargje.

Në çdo kapitull, së pari duhet të lexojmë Biblën dhe të përpiqemi të identifikojmë temat e saj (paragrafët), pastaj ta krahasojmë njohurinë tonë me versionet moderne. Biblën mund ta kuptojmë vërtet vetëm pasi kuptojmë synimin e autorit fillestar duke dalluar logjikën dhe prezantimin e tij. Vetëm autori fillestar është i frymëzuar; lexuesit nuk kanë të drejtë t'ia ndryshojnë ose modifikojnë mesazhin. Lexuesit e Biblës kanë vërtet përgjegjësinë që ta zbatojnë të vërtetën e frymëzuar në kohën dhe jetën e tyre.

Vini re se të gjithë termat teknike dhe shkurtime shpjegohen plotësisht në këto dokumente: Përcaktime të termave gramatikore greqisht, Kritika e tekstit, dhe Fjalorth.

1:35-39	1:35-39	1:35-39	1:35-37 1:38 1:39	Kapernaumin dhe udhëton nëpër Galile 1:35-39
Pastrimi i lebrozit	Jezusi pastron lebrozin		Jezusi shëron një burrë	Shërimi i burrit me sëmundje të rëndë lëkure
1:40-45	1:40-45	1:40-45	1:40 1:41-44 1:45	1:40-45

CIKLI TRE I LEXIMIT (shih f. v)

NDJEKJA E SYNIMIT TË AUTORIT FILLESTAR NË NIVELIN E PARAGRAFËVE

Ky është një komentuar studimor udhëzues, që do të thotë se ti je vetë përgjegjës për interpretimin e Biblës. Secili prej nesh duhet të ecë sipas dritës që ka. Ti, Bibla dhe Fryma e Shenjtë keni përparësi në interpretim. Nuk duhet t'ia dorëzosh këtë të drejtë komentuesit.

Lexo gjithë kapitullin njëherësh. Identifiko temat. Krahaso ndarjet e tua tematike me pesë përkthimet moderne. Ndarja në paragrafë nuk është e frymëzuar, por është çelësi për të ndjekur synimin e autorit fillestar, gjë që është thelbi i interpretimit. Secili paragraf ka vetëm një temë të vetme.

1. Paragrafi i parë
2. Paragrafi i dytë
3. Paragrafi i tretë
4. Etj.

STUDIMI I FJALËVE DHE FRAZAVE

TEKSTI I NASB (I PËRDITËSUAR): MARKU 1:1

¹Fillimi i ungjillit të Jezu Krishtit, Birit të Perëndisë.

1:1 “Fillimi” Për çfarë bën fjalë kjo frazë hyrëse?

1. Filleza e parë, si te Zan. 1:1 dhe Gjoni 1:1
2. Fillimi i mishërimit të Jezusit, si te 1 Gjonit 1:1
3. Fillimi i shërbesës publike të Jezusit (pra, ngjarjet që Pjetri përjetoj personalisht)

Paragrafi i parë i referohet në mënyrë të veçantë profecisë së Isaias në DHV për Mesinë. Historia e ungjillit nis me traditën profetike të Izraelit. Citimi te Marku 1:2 dhe 3 është kombinim i Mal. 3:1 me Isa. 40:3.

TEMË E VEÇANTË: ARCHË (SPECIAL TOPIC: ARCHË)

Termi “zotërim” është fjala greke *archē*, që do të thotë “fillimi” ose “origjina” e diçkaje.

1. fillimi i rendit të krijuar (shih Gjoni 1:1; 1 Gjonit 1:1; Heb. 1:10)
2. fillimi i ungjillit (shih Marku 1:1; Fil. 4:15; 2 Thes. 2:13; Heb. 2:3)
3. dëshmitarët e parë (shih Luka 1:2)
4. shenjat e fillimit (mrekullitë, shih Gjoni 2:11)
5. parimet fillestare (shih Heb. 5:12)
6. siguria fillestare, bazuar në të vërtetat e ungjillit (shih Heb. 3:14)
7. fillimi (Kol. 1:18; Zbu. 3:14)

Më vonë, u përdor për “sundimin”, ose “autoritetin”

1. për zyrtarët qeveritarë njerëzorë
 - a. Luka 12:11
 - b. Luka 20:20
 - c. Romakëve 13:3; Titi 3:1

2. për autoritetet engjëjlore
 - a. Romakëve 8:38
 - b. 1 Kor. 15:24
 - c. Efe. 1:21; 3:10; 6:12
 - d. Kol. 1:16; 2:10, 15
 - e. Juda 6

Këta mësues të rremë përçmojnë çdo autoritet, tokësor dhe qiellorëqoftë. Ata janë njerëz të shturur antinomianë. Vendosin veten dhe dëshirat e tyre përpara Perëndisë, engjëjve, autoriteteve civile dhe drejtuesve të kishave.

■ **“i ungjillit”** Meqë, ndoshta, Marku është ungjilli i parë i shkruar, ky është përdorimi i parë i fjalës *euangelion* (shih Marku 1:14, 15; 8:35; 10:29; 13:10; 14:9) nga shkruesi i një ungjilli (përdorimi i kësaj fjale nga Pali te Gal. 2:2 dhe 1 Thes. 2:9 është më i hershëm nga ana kronologjike). Fjalë për fjalë do të thotë “lajmi i mirë” ose “mesazhi i mirë”. Qartazi, reflekton Isa. 61:1 dhe, ndoshta, 40:9 dhe 52:7. *Komentari Biblik i Jeromit* thotë: “Përdorimi që i bëu Marku fjalës ‘ungjill’ ngjason me atë të Palit, ku nënkupton ose aktin e shpalljes, ose përmbajtjen e shpalljes” (f. 24).

■ **“Jezu Krishtit, Birit të Perëndisë”** Forma gramatikore e kësaj fraze mund të kuptohet si (1) mesazhi i dhënë nga Jezusi, ose (2) mesazhi për Jezusin. Numri 2 është ndoshta kuptimi i synuar nga autori. Megjithatë, *The Dictionary of Jesus and the Gospels*, i botuar nga IVP, thotë: “Gjinorja (“i”) është, ndoshta, edhe kryefjalore, edhe kundrinore: Jezusi shpall ungjillin, dhe ungjilli shpall historinë e vet” (f. 285).

Vargu 1 nuk është fjali e plotë. Ndoshta, përbën titullin e librit. Dorëshkrimet e lashta uncialle greke, Sinaitiku, A, B, D, L dhe W shtojnë frazën “Biri i Perëndisë,” që ndiqet nga NKJV, si dhe NRSV, TEV dhe NIV, por mungon në (1) tekstin origjinal të Sinaitikut; (2) në versionin Siriak të Palestinës; (3) në një dorëshkrim koptik; (4) në versionin gjeorgjian; si dhe në (5) përkthimin armenisht dhe (6) në një citim të këtij teksti nga komentari i Origenit për Gjonin. UBS4 i jep përfshirjes së kësaj fraze vlerësimin “C” (pra, “vështirë për t’u vendosur”). Shih Temën e Veçantë “Biri i Perëndisë”, te Marku 3:11.

Të krishterët e sotëm, që e duan dhe besojnë Biblën, e kanë të vështirë ta pranojnë nga ana mendore se dorëshkrimet greke përmbajnë variante tekstuale, por sado e vështirë të na duket kjo për supozimet tona në lidhje me frymëzimin dhe ruajtjen e vetëzbulesës së Perëndisë, ato janë realitet. Kjo shtesë madje duket e qëllimshme, jo rastësore. Kopjuesit e hershëm ortodoksë ishin të vetëdijshëm për pikëpamjet e hershme heretike për Jezusin, si adopsionizmi, që thoshte se Jezusi u bë Biri i Perëndisë. Këta kopjues të hershëm, shpesh, i modifikonin tekstet greqisht që kopjonin, në mënyrë që t’i bënin më tepër ortodokse nga ana teologjike (shih 1 Gjonit 5:7-8). Për të lexuar më tepër për këtë ndryshim të qëllimshëm të dorëshkrimeve greqisht nga skribët ortodoksë, shih Bart D. Ehrman, *The Orthodox Corruption of Scripture*. Ai diskuton në veçanti për Markun 1:1 në faqet 72-75.

■ **“Jezus”** Zakonisht, në judaizmin e shekullit të parë, emrin fëmijës ia vendoste babai. Në këtë rast, Ati qiellor, nëpërmjet një engjëlli, i vuri emrin fëmijës Jezus. Shpesh, emrat judaikë përmbanin kuptime simbolike; ky s’bënte përjashtim. Jezusi është kombinim i dy emrave hebraisht: (1) JHVH dhe (2) shpëtim. Domethënia e tij përmbledhet te Mat. 1:21. Jezusi është përkthimi greqisht i emrit hebre “Jozue”. Ai provoi se ishte Moisiu i ri, Jozueu i ri, dhe Kryepriifti i ri.

■ **“Krishti”** Ky është përkthimi grek i fjalës hebraisht “Mesia”, që do të thotë “i vajosuri”. Në DHV, vajosja e udhëheqësve (pra, profetëve, priftërinjve dhe mbretërve) nga Perëndia simbolizonte thirrjen hyjnore dhe pajisjen e tyre për një detyrë të caktuar.

Fjala “Mesi” nuk përdoret shpesh në DHV (shih Dan. 9:25, 26, ku nënkupton mbretin eskatologjik), por koncepti është pa dyshim i pranishëm. Është paralel me Mat. 1:1, “biri i Davidit”, që nënkupton një pasardhës mbretëror të mbretit ideal të Izraelit, “Davidit”. Perëndia i premtoi Davidit në 2 Samueli 7 se një nga pasardhësit e tij do të mbretëronte gjithmonë në Izrael. Ky premtim u duk sikur u thye nga shkatërimi i Jerusalemit prej babilonasve dhe nga deportimi i banorëve të tij (pra, 586 para K.). Megjithatë, profetët filluan të shihnin një farë të ardhshme të Davidit (Isaia, Mikea, Malakia). Jezusi është i premtuari “Bir i Davidit”, “Biri i njeriut” (shih Dan. 7:13), dhe “Biri i Perëndisë” (i përdorur 5 herë te Marku).

Është interesant fakti se e vetmja herë kur në këtë ungjill përdoret termi “Jezu Krisht” është në vargun e parë (vetëm dy herë te Mateu dhe te Gjoni, dhe asnjëherë te Luka). Normalisht, Marku përdor termin “Jezus”. Ky

përdorim përputhet me theksin teologjik të Markut te ana njerëzore e Jezusit, ndërsa natyra e tij hyjnore është e fshehur (pra, sekreti mesianik) deri në plotësimin e misionit të tij mesianik (pra, Shërbëtori i Përvuajtur). Vetëm në librin e Veprave “Jezu Krishti” bëhet titull i përsëritur.

TEKSTI I NASB (I PËRDITËSUAR): MARKU 1:2-8

²Siç është shkruar në profetin Isaia: “Ja, po e dërgoj lajmëtarin tim përpara teje, i cili do të të përgatitë udhën; ³Zëri i njërit që bërtet në shkretëtirë: ‘Përgatitsni udhën e Zotit, bëjani shtigjet të drejta.’” ⁴Gjon Pagëzori u shfaq në shkretëtirë duke predikuar një pagëzim pendimi për faljen e mëkateve. ⁵Dhe gjithë vendi i Judesë shkante tek ai, si dhe gjithë populli i Jerusalemit; dhe pagëzoheshin prej tij në lumin Jordan, duke rrëfyer mëkatet. ⁶Gjoni vishej me lesh deveje dhe me një rrip lëkure rreth brezit; dieta e tij ishin karkalecat dhe mjalti i egër. ⁷Ai predikonte dhe thoshte: “Pas meje po vjen Njëri, që është më i fuqishëm se unë, dhe unë s’jam i denjë as të ulem dhe t’ia zgjidh rripat e sandaleve. ⁸Unë ju pagëzova me ujë; por ai do t’ju pagëzojë me Frymën e Shenjtë”.

1:1 “Siç është shkruar” Fjala “shkruar” është në kohën e kryer; përbënte një idiomë judaike që përdorej për të nënkuptuar zbuluesën e përjetshme të Perëndisë (pra, Shkrimin).

■ **“në profetin Isaia”** Ky citim është kombinim i Mal. 3:1 dhe Isa. 40:3. Nuk është marrë nga teksti masoretik hebraisht, as nga Septuaginta greqisht e Isa. 40:3. Për shkak të kësaj, disa kopjues e ndryshuan tekstin në “shkruar në profetët” (pra, në pjesën e profetëve në kanonin e DHV). Forma njëjës gjendet në dorëshkrimet uncialle greke, Sinaitiku, B, L dhe D; ndërsa shumësi gjendet në dorëshkrimet A dhe W.

Isaia 40-66 përmban dy thekse të rëndësishme eskatologjike: (1) Shërbëtori i Përvuajtur (veçanërisht Isa. 52:13-53:12) dhe (2) epoka e re e Frymës (veçanërisht Isaia 56-66). Në hyrjen e tij të shkurtër, Marku përmban një sërë aludimesh të mundshme për librin e Isaisë.

■ **“po e dërgoj lajmëtarin tim përpara teje”** Fjala “lajmëtar” mund t’i referohet edhe një engjëlli (shih Eks. 23:20a; në këtë rast, kjo fjalë do të përbënte aludim ndaj Eksodit), por këtu bëhet fjalë për “një lajmëtar” (shih Mal. 3:1). Ndoshta, është lojë fjale me termin ungjill (pra, lajmi i mirë). Kjo është një nga citimet e rralla nga DHV te Marku, që u shkrua pikësisht për romakët. Bën fjalë për shërbesën e Gjon Pagëzorit (shih Marku 1:4). Tregon se tradita profetike e DHV po përmbushet (kjo pasqyrohet edhe në shërimet dhe dëbimet e demonëve nga Jezusi, që janë profeci mesianike në librin e Isaias). Shërbesa e Gjon Pagëzorit përmendet në të katërt ungjijtë.

1:3 “Zëri i njërit që bërtet në shkretëtirë” Është citim i Isa. 40:3 nga një burim i panjohur. Fjala “shkretëtirë” nënkupton një tokë kullote të pabanuar, jo një shkretëtirë të thatë, ranore, plot erë.

■ **“Përgatitsni udhën e Zotit”** Kjo është një urdhërore aoriste veprorë, që nënkupton një veprim urgjent. Në tekstin masoret, lexohet fjala Zot (pra, *adon*), por në vetë tekstin hebraisht gjendet fjala JHVH (ZOT). Në fillim, kjo frazë përdorej për përgatitjen fizike për vizitën e mbretit (shih Isa. 57:14; 62:10). Më vonë, u përdor metaforikisht për shërbesën e Gjon Pagëzorit, sepse ai përgatiti shpirtërisht rrugën për ardhjen e Jezus Mesisë, i cili quhet edhe “Zot” (pra, *kurios*).

■ **“Bëjani shtigjet të drejta”** MT dhe LXX kanë tekstin “bëjini të drejta shtigjet e Perëndisë sonë”. Marku (ose Pjetri) e modifikoi tekstin (ose citon nga një formë e panjohur tekstuale) që të bënte fjalë për Jezusin, jo JHVH-në.

1:4 “Gjon Pagëzori” Pse pagëzoi me ujë Gjoni?

1. Precedenti gjendet në DHV, ku nënkuptonte inaugurimin e një “besëlidhjeje të re” (Eks. 19:10, 14; Isa. 1:16; Jer. 31:34; Ezek. 36:25)
2. Akt pastrues nga ndotja ceremoniale (Lev. 15).
3. Metaforë profetike eskatologjike për ujin jetedhënës që vjen nga Perëndia (Isa. 12:2-3; Jer. 2:13; 17:13; Ezek. 47:1; Zak. 13:1; 14:8; Zbu. 22:1)
4. Imiton pagëzimin e prozelitëve si rit pranimit për t’u bërë pjesë e popullit të Perëndisë

5. Është mënyrë rabinike e përgatitjes së shtegtarëve për t’iu afruar JHVH-së në tempullin e tij (ndoshta, me kredhje; shih traktatin Mikvaot në *Mishna*). Kjo banjë rituale praktikohet ende nga myslimanët përpara se të bëjnë lutjet e detyruara.

■ **“u shfaq”** Ndoshta, në këtë mënyrë Marku aludon për profecinë e shfaqjes së papritur të Elisë përpara “shfaqjes së papritur” të Mesisë (shih Mal. 3:1).

■ **“duke predikuar”** Ky është termi “shpall” (*kirisso*), që do të thotë “shpall kudo ose publikisht një lajm” (shih Marku 1:4, 7, 14, 38, 39, 45). Marku nuk e përdor foljen ungjillizoj (*euangelizo*).

Gjoni erdhi duke predikuar një pagëzim për pendim (shih Temën e Veçantë më poshtë). I njëjti mesazh u përçua dhe nga Jezusi, por duke theksuar “besimin” (shih Temën e Veçantë në Marku 1:15). Këto dy elemente të nevojshme të besëlidhjes—pendimi dhe besimi—,që tregohen me anë të pagëzimit, bëhen dhe elementet e predikimeve apostolike në Veprat (pra, *kerigma*).

1. Pjetri
 - a. predikimi i parë i kishës (Veprat 2:37-39)
 - (1) pendohuni
 - (2) pagëzohuni
 - b. predikimi i dytë i kishës (Veprat 3:16, 19)
 - (1) besimi
 - (2) pendimi
2. Filipi (Veprat 8:12)
 - a. besoni
 - b. pagëzohuni
3. Pali
 - a. gardiani filipian (Veprat 16:31, 33)
 - (1) besoni
 - (2) pagëzohuni
 - b. lamtumira me pleqtë efesianë (Veprat 20:21)
 - (1) pendim para Perëndisë
 - (2) besim në Krishtin
 - c. dëshmia para Agripës (Veprat 26:18)
 - (1) kthim nga errësira (Satani), pra, pendohuni
 - (2) në dritë (Perëndia)

Për mua, kërkesat e Besëlidhjes së Re janë:

1. pendohuni
2. pagëzohuni
3. binduni
4. bëni qëndresë

Synimi i Besëlidhjes së Re është ngjashmëria me Krishtin tani, në mënyrë që të tjerët ta shohin ndryshimin dhe të dëshirojnë të besojnë dhe vetë në Krishtin!

■ **“një pagëzim pendimi”** Pagëzimi nuk është mekanizmi i faljes, por përbën mundësinë që besimtari të rrëfejë publikisht besimin. Nuk është akt sakramental, por një qëndrim i ri ndaj mëkatit dhe një marrëdhënie e re me Perëndinë. Është shenjë e jashtme e ndryshimit të brendshëm.

TEMË E VEÇANTË: PENDIMI NË DHIATËN E VJETËR (SPECIAL TOPIC: REPENTANCE IN THE OLD TESTAMENT)

Ky koncept është thelbësor, por i vështirë për t’u përcaktuar. Shumica prej nesh e kanë një përcaktim, që vjen nga denominacioni ynë i caktuar. Megjithatë, zakonisht disa fjalëve hebraisht (ose greqisht) u imponohet një përcaktim “i caktuar” teologjik, ndonëse ato nuk e nënkuptojnë në mënyrë të veçantë këtë lloj përcaktimi. Duhet të mos harrojmë se autorët e DHV (me përjashtim të Lukës) ishin autorë hebrenj që përdornin fjalë të greqishtes koine; prandaj, vendi nga duhet t’ia nisim janë vetë fjalët hebraisht, të cilat janë veçanërisht dy.

1. *nakham* (BDB 636, KB 688)

2. *shuv* (BDB 996, KB 1427)

E para, *nakham*, që në fillim mund të ketë patur kuptimin “marr frymë thellë”, përdoret në disa kuptime.

- a. “pushim” ose “rehat” (p.sh., Zan 5:29; 24:67; 27:42; 37:35; 38:12; 50:21; shpesh përdoret në emra, shih 2 Mbre. 15:14; 1 Kro. 4:19; Neh. 1:1; 7:7; Nahumi 1:1)
- b. “vajtoi” (p.sh. Zan. 6:6, 7)
- c. “ndryshim mendjeje” (p.sh., Eks. 13:17; 32:12, 14; Num. 23:19; Jobi 42:5-6)
- d. “mëshirë” (p.sh., LiP. 32:36)

Vini re se të gjitha këto nënkuptojnë ndjenja të forta! Ideja kyçe është kjo: ndjenja të forta që çojnë në veprim. Ky ndryshim veprimi, shpesh, drejtohet te personat e tjerë, por edhe te Perëndia. Pikërisht ky ndryshim qëndrimi dhe veprimi drejt Perëndia e mbush këtë fjalë me rëndësi të madhe teologjike. Por, këtu, duhet patur kujdes. Perëndia thuhet se “pendohet” (shih Zan. 6:6, 7; Eks. 32:14; Gjyq. 2:18; 1 Sam. 15:11, 35; Psa. 106:45), por kjo nuk vjen nga keqardhja e tij për ndonjë mëkat apo gabim, por përbën një mënyrë letrare për të treguar dhembshurinë dhe përkujdesjen e Perëndisë (shih Num. 23:19; 1 Sam. 15:29; Psa. 110:4; Jer. 4:27-28; Ezek. 24:14). Ndëshkimi i duhur për mëkatën dhe rebelimin falet nëse mëkatari ia kthen vërtet shpinën mëkatit dhe drejtohet te Perëndia. Kjo nënkupton riorientim të jetës.

Fjala e dytë, *shuv*, do të thotë “kthehem” (i kthej shpinën, kthehem pas, kthehem drejt). FOLJA *shuv* (BDB 996, KB 1427) do të thotë “kthehem pas” ose “kthehem”. Mund të përdoret në këto kuptime:

1. i kthej shpinën Perëndisë (Num. 14:43; Joz. 22:16,18,23,29; Gjyq. 2:19; 8:33; 1 Sam. 15:11; 1 Mbre. 9:6; Jer. 3:19; 8:4).
2. kthehem te Perëndia (1 Mbre. 8:33,48; 2 Kro. 7:14; 15:4; 30:9; Psa. 51:13; 116:7; Isa. 6:10; 10:21,22; 31:6; Jer. 3:7,12,14,22; 4:1; 5:3; Ose. 3:5; 5:4; 6:1; 7:10,16; 11:5; 14:1,2; Amosi 4:6,8-11; vini re veçanërisht Jeremia 7 dhe Amosi 4)
3. Kur JHVH i thotë fillimisht Isaisë se Juda nuk do të/mund të pendohet (shih Isa. 6:10), por jo për herë të parë në këtë libër, ai u bën thirrje që të kthehen tek ai.

Më shumë sesa ndjenjë, pendimi është qëndrim ndaj Perëndisë. Është riorientim i jetës nga vetja njerëzore drejt tij. Nënkupton gatishmërinë për të ndryshuar dhe për t’u ndryshuar. Nuk nënkupton ndalimin e plotë të mëkatit, por ndalimin e përditshëm nga rebelimi i vetëdijshëm! Pendimi përbën përmbysjen e rrjedhëve egoiste të Rënies (Zan. 3). Tregon se shëmbëllimi dhe ngjasimi i Perëndisë (Zan. 1:26-27), ndonëse i dëmtuar, tani rikthehet! Bashkësia e njerëzve të rënë me Perëndinë bëhet sërish e mundshme.

Në DHV, pendim do të thotë kryesisht “ndryshim veprimi”, ndërsa në DHV nënkupton kryesisht “ndryshimin e mendjes” (shih Tema e Veçantë: Pendimi [DHR]). Të dyja këto janë të domosdoshme për të patur pendimin e vërtetë biblik. Po kështu, duhet të kuptojmë se pendimi është, edhe akt fillestar, por edhe proces i vazhduar. Veprimi fillestar mund të shihet te Marku 1:15; Veprat 3:16 dhe 19; 20:21, ndërsa procesi i vazhduar mund të shihet te 1 Gjonit 1:9; Zbulesa 2 dhe 3. Pendimi nuk është fakultativ (shih Luka 13:3, 5)!

Nëse është e vërtetë se dy kërkesat e besëlidhjes janë “pendimi” dhe “besimi” (p.sh., Mat. 3:2; 4:17; Marku 1:4,15; 2:17; Luke 3:3,8; 5:32; 13:3,5; 15:7; 17:3), atëherë *nakham* bën fjalë për ndjenjat e forta që shkaktohen kur njeriu pranon mëkatën dhe i kthen shpinën, ndërsa *shuv* bën fjalë për kthimin nga mëkati dhe, pastaj, për kthimin drejt Perëndisë (një shembull i këtyre dy veprimeve shpirtërore është Amosi 4:6-11, “ju nuk u kthyet tek unë” [pesë herë] dhe Amosi 5:4, 6, 14, “më kërkoni... kërkoni Zotin... kërkoni të mirën dhe jo të keqen”).

Shembulli i parë madhështor i fuqisë së pendimit është mëkati i Davidit me Batshebën (shih 2 Sam. 12; Psa. 32, 51). Ndonëse kjo pati pasoja të mëvonshme për Davidin, familjen e tij dhe Izraelin, Davidi vetë u rikthye në bashkësi me Perëndinë! Edhe Manasi i lig mund të pendohet dhe të marrë falje (shih 2 Kro. 33:12-13).

Të dyja këto fjalë përdoren në mënyrë paralele te Psa. 90:13. Njeriu duhet ta pranojë mëkatën dhe t’i kthejë

shpinën në mënyrë personale dhe të qëllimshme; duhet të ketë dhe dëshirën për të kërkuar Perëndinë dhe drejtësinë e tij (shih Isa. 1:16-20). Pendimi ka një aspekt njohës, një aspekt personal dhe një aspekt moral. Të tre janë të domosdoshëm për të filluar një marrëdhënie të re me Perëndinë dhe për ta ushqyer këtë marrëdhënie të re. Ndjenja e thellë e pendesës kthehet në një përkushtim të vazhdueshëm ndaj Perëndisë dhe për Perëndinë!

■ **“për faljen e mëkateve”** Fjala “falje” do të thotë “flak tej”. Përbën një nga fjalët e ndryshme biblike për faljen. Ka lidhje metaforike me Ditën e Shlyerjes në DHV (Lev. 16), ku një nga dy cjepët e veçantë të asaj dite dëbohet nga kampi i Izraelit, duke mbartuar dhe larguar në mënyrë simbolike mëkatin (Lev. 16:21-22; Heb. 9:28; 1 Pje. 2:24).

Fraza “e mëkateve” është gjinore objektive.

1:5 “gjithë vendi i Judesë shkante tek ai, si dhe gjithë populli i Jerusalemit” Ky është një teprim (hiperbolë) oriental, por tregon ndikimin e jashtëzakonshëm të predikimit të Gjonit. Ai ishte zëri i parë profetik që nga Malakia, 400 vite më herët. Folja këtu është në kohën e pakryer, që nënkupton se populli po vinte vazhdimisht për shkak se e pranonte Gjonin si profet.

■ **“pagëzoheshin”** Edhe kjo është në kohën e pakryer, që nënkupton një veprim të vazhdueshëm në të shkuarën. Shumë judenj po shquanin një ditë të re në veprimtarinë e Perëndisë dhe po përgatiteshin për të.

■ **“duke rrëfyer mëkatet”** Është pjesore e tashme mesore, që fjalë për fjalë do të thotë “them të njëjtën gjë”. Rrëfimi ishte shpallja publike e nevojës për falje shpirtërore.

Kjo nënkupton se, nëse judenjtë pendoheshin dhe ndryshonin mënyrën e jetesës, JHVH do t’ua falte plotësisht mëkatet (shih Marku 1:4; Mat. 3:6; Luka 3:3). Ky është padyshim modeli i DHV. Ai nënkuptonte faljen e plotë nëpërmjet pendimit, besimit, ndryshimit të jetesës, dhe tani pagëzimi shndërrohet në simbolin e jashtëm të pendimit! Ky model i DHV modifikohet nga shërbesa mesianike e Jezusit. Të njëjtët elementë janë ende të vlefshëm, por tani rolin qendror e merr besimi personal në Jezusin si Krishti (shih Veprat 2:38; 3:16, 19; 20:21). Katër ungjijtë përbëjnë periudhën kalimtare. Marku 1:14-15 flet për periudhën e Gjon Pagëzorit, por teologjikisht i paraprin mesazhit të përfunduar të ungjillit (pra, pendohu, beso, dhe bëj një jetë të re). Thelbi është se kush është Jezusi! Ai është përfaqësuesi i JHVH-së, zbuluesi dhe kryesi i shpengimit dhe gjykimit. Kjo është arsyeja për “sekretin mesianik” të Marku. Jezusi është plotësisht Perëndi, që nga fillimi (pra, nga ngjizja e virgjër), por kjo zbulohet plotësisht vetëm pas ringjalljes dhe ngritjes së tij në qiell.

TEMË E VEÇANTË: RRËFIMI (SPECIAL TOPIC: CONFESSION)

- A. Ka dy forma të së njëjtës rrënjë greqisht që përdoren për “rrëfimin e fajit” ose “rrëfimin e besimit”, *homologeo/eksomologo*. Kjo fjalë e përbërë vjen nga *homo*, “e njëjtë”; dhe *lego*, “flas”; ose *eks*, “prej”. Kuptimi bazë është “them të njëjtën gjë, bie dakord me” dikë. PARAFJALA greke, *eks*, shtohet për të nënkuptuar një shpallje publike.
- B. Përkthimet e fjalëve në këtë grup janë:
1. lavdëroj
 2. bie dakord
 3. shpall (Mat. 7:23)
 4. rrëfej besimin
 5. rrëfej fajin (Heb. 4:14; 10:23)
- C. Ky grup fjalësh kishte dy përdorime në dukje të kundërta:
1. Lavdëroj (Perëndinë)
 2. Pranoj mëkatin
- Këto mund të jenë zhvilluar nga fakti se njerëzimi e kupton shenjtërinë e Perëndisë dhe mëkatin e vet. Të pranosh njërin të vërtetë, do të thotë t’i pranosh të dyja.
- D. Përdorimet e këtij grupi fjalësh në DHR janë:

1. premtoj (Mat. 14:7; Veprat 7:17)
2. bie dakord për diçka (Gjoni 1:20; Luka 22:6; Veprat 24:14; Heb. 11:13)
3. lavdëroj (Mat. 11:25; Luka 10:21; Rom. 14:11; 15:9; Heb. 13:15)
4. pranoj
 - a. një person (Mat. 10:32; Luka 12:8; Gjoni 9:22; 12:42; Rom. 10:9; Fil. 2:11; 1 Gjonit 2:23; Zbu. 3:5)
 - b. një të vërtetë (shih Veprat 23:8; 1 Gjonit 4:2)
5. bëj shpallje publike të diçkaje (kuptimi ligjor u shndërrua në pranim fetar; shih Veprat 24:14; 1 Tim. 6:13)
 - a. pa pranim faji (shih 1 Tim. 6:12; Heb. 10:23)
 - b. me pranim faji (shih Mat. 3:6; Veprat 19:18; Heb. 4:14; Jakobi 5:16; 1 Gjonit 1:9)

1:6 “Gjoni vishej me lesh deveje” Kjo ishte veshja e tij e përditshme (pra, pjesore e mesme e kryer). Nuk ishte lëkurë deveje, por rrobë e thurur me leshin e devesë (shih 2 Mbre. 1:8; Mat. 3:4). Ai ishte njeri i shkretëtirë dhe profet (shih Zak. 13:4). Gjoni vishej si Elia, për të cilin Mal. 3:1 dhe 4:5 kishin thënë se do të vinte si pararendës i Mesisë.

▣ **“karkaleca dhe mjaltë të egër”** Ky ishte ushqimi normal i banorëve të shkretëtirës. Karkalecat ishin ushqim i pastër dhe i pranueshëm nga ana levitike (shih Lev. 11:22). Gjoni hante ato gjëra që ishin natyrshëm të disponueshëm.

1:7 Ky varg dhe Marku 1:8 tregojnë motivin përgatitor të mesazhit të Gjonit. Ai e pranonte rolin dhe pozicionin e vet në lidhje me Atë që do të vinte nga Perëndia (shih Gjoni 3:30). Ai e konsideronte veten shërbëtor, skllav (vetëm skllavërit ua hiqnin këpucët të tjerëve). Përujja e Gjonit regjistrohet në të katër ungjijtë (shih Mat. 3:11; Luka 3:16; Gjoni 1:27; si dhe predikimi i Palit te Veprat 13:25). Ndoshta, ungjilltarët e përfshinë këtë pjesë për shkak të ndonjë grupimi heretik që u zhvllua me vonë rreth figurës së Gjon Pagëzorit (Veprat 18:24-19:7).

1:8 “Unë ju pagëzova me ujë” Mos harroni: pagëzimi i Gjonit ishte përgatitor. Nuk bëhet fjalë për pagëzimin e krishterë. Gjoni ishte profeti i fundit i DHV (Luka 16:16), predikues i periudhës kalimtare, jo predikuesi i parë i ungjillit (Luka 16:16; Veprat 19:17). Ai, siç thonë citimet e Isaisë, lidh besëlidhjen e vjetër me atë të re.

▣ **“ai do t’ju pagëzojë me Frymën e Shenjtë”** Kjo është në ndryshim nga pagëzimi i Gjonit. Mesia do të inaugurojë epokën e re të Frymës. Pagëzimi i tij do të jetë me (ose “me anë të” ose “në”) Frymën. Ka patur shumë debate mes denominacioneve për atë se cilës ngjarjeje në përjetimin e krishterë i referohet kjo shprehje. Disa mendojnë se bëhet fjalë për një përjetim fuqizues pas shpëtimit, një lloj bekimi të dytë. Personalisht, mendoj se bëhet fjalë për çastin kur njeriu bëhet i krishterë (shih 1 Kor. 12:13). Nuk i mohoj mbushjet ose pajisjet e mëvonshme me Frymë, por besoj se ka vetëm një pagëzim fillestar shpirtëror në Krishtin, ku besimtarët identifikohen me vdekjen dhe ringjalljen e Jezusit (Rom 6:3-4; Efe. 4:5; Kol. 2:12). Kjo vepër pranuese e Frymës përvijohet te Gjoni 16:8-11. Veprat e Frymës së Shenjtë janë këto:

1. bindja për mëkat
2. zbulimi i së vërtetës për Krishtin
3. e drejton njeriun të pranojë ungjillin
4. pagëzon në Krishtin
5. e qorton besimtarin për mëkatet e vazhdueshme
6. formon në besimtarin karakterin e Krishtit

TEKSTI I NASB (I PËRDITËSUAR): MARKU 1:9-11

⁹Ato ditë, Jezusi erdhi nga Nazareti i Galileesë dhe u pagëzua nga Gjoni në Jordan. ¹⁰Menjëherë, ndërsa po dilte nga uji, pa qiejt të hapeshin dhe Frymën duke zbritur mbi të si pëllumb; ¹¹dhe një zë erdhi nga qiejt: “Ti je Biri im i dashur; në ty jam i kënaqur”.

1:9 “Jezusi erdhi nga Nazareti i Galileesë” Jezusi lindi në Betlehem të Judesë, jetoi disa vjet në Egjipt dhe, pastaj, u zhvendos në Nazaret, qyteti i lindjes së Jozefit dhe Marisë, që ishte një ngulim i vogël dhe i ri me judenj

në veri. Shërbesa e hershme e Jezusit u krye në këtë zonë veriore rreth Detit të Galileës, që përmbush profecinë e Isa. 9:1.

■ **“Jezusi... u pagëzua”** Ungjijtë ndryshojnë përsa i përket kronologjive të hershme të shërbesave të Jezusit në Galileë dhe Jude. Duket se pati një shërbesë të hershme në Jude dhe një të mëvonët, por të katërt kronologjitë e ungjijve duhet të harmonizohen për ta shquar këtë vizitë të hershme në Jude (p.sh., Gjoni 2:13-4:3).

Arsyeja pse u pagëzua Jezusi ka qenë gjithmonë preokupim për besimtarët, pasi pagëzimi i Gjoni ishte pagëzim pendese. Jezusi nuk kishte nevojë të pendohej sepse ishte i pamëkat (shih 2 Kor. 5:21; Heb. 4:15; 7:26; 1 Pje. 2:22; 1 Gjonit 3:5).

Teoritë kanë qenë si më poshtë:

1. Ky ishte një shembull që duhet ta ndiqnin besimtarët
2. Ishte shenjë e identifikimit të tij me nevojat e besimtarëve
3. Ishte shugurimi dhe pajisja e tij për shërbesë
4. Ishte simbol i detyrës së tij shpenguese
5. Ishte miratimi i tij për shërbesën dhe mesazhin e Gjon Pagëzorit
6. Ishte shenjë paraprake profetike e vdekjes, varrosjes dhe ringjalljes së tij (shih Rom. 6:4; Kol. 2:12).

Cilado qoftë arsyeja, ky ishte një çast përcaktues në jetën e Jezusit. Ndonëse kjo nuk nënkupton se Jezusi u bë Mesi në këtë pikë (siç thotë herezia e hershme e adopsionizmit [shih *The Orthodox Corruption of Scripture*, nga Bart D. Ehrman, f. 47-118]), ky çast pati rëndësi të madhe për të.

1:10

NASB, NKJV “menjëherë”

NRSV “sapo”

TEV “porsa”

NJB “sakaq”

Kjo fjalë shfaqet shumë shpesh te Marku. Karakterizon ungjillin e tij. Këtu, *euthis* përkthehet “menjëherë” ose “sakaq” (shih Marku 1:10,12,18,20,21,20,28,42; 2:2,8,12; 3:6; 4:5,15,16,17,29; 5:5,29,42; 6:25,27,45, 50,54; 7:35; 8:10; 9:15,20,24; 10:52; 11:3; 14:43,45; 15:1).

Kjo është fjala që i jep ungjillit të Markut ritmin e tij të shpejtë e të mbushur me veprim, gjë që duhet t’u ketë lënë mbresa romakëve. Ky grup fjalësh përdoret rreth 47 herë te Marku (shih *A Translator’s Handbook on the Gospel of Mark*, nga Robert Bratcher dhe Eugene Nida, f. 29).

■ **“ndërsa po dilte nga uji”** Ndoshta është aludim për Isa. 63:11, ku bënte fjalë për Detin e Kuq (pra, për një Dalje të re në Jezusin, i cili së shpejti do të tundohej për dyzet ditë, njësoj si Izraeli për dyzet vjet). Ky varg nuk mund të përdoret si pasazh provë për pagëzimin me kredhje. Në kontekstin e vet, mund të nënkuptojë daljen nga lumi, jo detyrimisht daljen nga poshtë ujit.

■ **“pa”** Ndoshta, kjo nënkupton se vetëm Jezusi e pa dhe e dëgjoi këtë miratim mesianik. Nëse është kështu, kjo përputhet me motivin e përsëritur të Sekretit Mesianik të Markut. Megjithatë, edhe ungjijtë e tjerë e regjistrojnë këtë ngjarje në mënyrë të ngjashme (shih Mat. 3:13-17; Luka 3:21-22).

■ **“qiejt të hapeshin”** Ndoshta, është aludim për Isa. 64:1. Kjo fjalë do të thotë “shqyiej”, që ishte metaforë për shqyerjen e kupës qiellore mbi tokë (shih Zan. 1:6).

■ **“Frymën... si pëllumb”** Kjo metaforë mund ta ketë filluesën tek

1. Fryma që rrinte pezull mbi ujin në Zan. 1:2
2. Zogjtë që Noeu nxori nga Arka në Zan. 8:6-12
3. Përdorimi që i bënin rabinët pëllumbit si simbol i kombit të Izraelit (shih Psa. 68:13; 74:19)
4. Pëllumbi si simbol i butësisë dhe paqes (shih Mat. 10:16)

Një arsye pse jam kaq fort i përkushtuar ndaj metodës historiko-gramatikore të interpretimit biblik (e cila përqendrohet te synimi i autorit siç na shprehet në kontekstin letrar) është mënyra deformuese ose e zgjuar sesi interpretuesit e lashtë (si dhe shumë interpretues modernë) e manipulonin tekstin për t’ia përshtatur strukturës së tyre të paracaktuar teologjike. Nëse e mbledh vlerën numerike të shkronjave në fjalën greke “pëllumb”

(*peristera*), që është baraz me 810, përftohet e njëjta vlerë numerike me fjalët greke *alfa* (baraza me 1) dhe *omega* (baraz me 800); pra, gjoja pëllumbi është baraz me Frymën e përjetshme të Krishtit. Kjo është metodë e zgjuar dhe isegjetike, por jo ekzegjetike!

■ “**mbi të**” Kjo është parafjala *eis*, që do të thotë “brenda”. Nuk synon të thotë se Jezusi s’ e kishte më parë Frymën e Shenjtë, por kjo ishte shenjë e dukshme dhe e veçantë e fuqizimit që po i jepte Fryma për detyrën mesianike që i ishte caktuar. Ndoshta, kjo përbën dhe aludim ndaj profecisë së përmbushur (shih Isa. 63:11).

Marku përdor parafjalën “brenda” (*eis*), ndërsa Mateu dhe Luka përdorin parafjalën “mbi” (*epi*). Kjo ndodh për shkak se ungjilli i Markut, që nuk përmban fare rrëfimet e lindjes ose vizitave pas lindjes, e fillon shërbesën e Jezusit me ngjarjen e pagëzimit. Kjo shkurtësi u përdor nga grupet heretike, adopsionistët dhe gnostikët, për të thënë se Jezusi, që ishte thjesht njeri, u fuqizua në mënyrë të mbinatyrshme me “Frymën-Krisht” në këtë moment dhe, më tej, ishte në gjendje të bënte mrekulli. Për këtë arsye, disa kopjues të mëvonshëm e ndryshuan parafjalën në “tek” (*pros*).

TEMË E VEÇANTË: ADOPTIONIZMI (SPECIAL TOPIC: ADOPTIONISM)

Ishte një nga pikëpamjet e hershme për marrëdhënien e Jezusit me hyjninë. Në thelb, pohonte se Jezusi ishte njeri normal në të gjitha mënyrat dhe se u birësua në mënyrë të veçantë nga Perëndia në çastin e pagëzimit (shih Mat. 3:17; Marku 1:11), ose në ringjalljen e tij (Rom. 1:4). Jezusi bëri një jetë kaq shembullore sa që Perëndia, në një pikë të caktuar, (në pagëzim, ose në ringjallje) e adoptoi si “birin” e vet (shih Rom. 1:4; Fil. 2:9). Kjo ishte një pikëpamje pakice në kishën e hershme në shekullin e tetë. Në vend që Perëndia të bëhet njeri (Mishërimi), kjo pikëpamje e përmbys radhën dhe, tani, njeriu bëhet Perëndi!

Ajo është tejet simbolike dhe imagjinare, me shumë terma kriptikë. Shpesh, të vërtetën e shpreh me ngjyra, numra, vegime, ëndrra, ndërmjetësime engjëjsh, fjalë të fshehta e të koduara dhe, shpesh, me një dualizëm të fortë mes mirësisë dhe ligësisë.

TEMË E VEÇANTË: GNOSTICIZMI [nga fjala greke *gnosis*, që do të thotë njohuri, shih 1 Tim. 6:20] (SPECIAL TOPIC: GNOSTICISM)

- I. Konteksti i shekullit të parë
Bota romake e shekullit të parë ishte një kohë eklektizmi mes feve lindore dhe atyre perëndimore. Perënditë e panteoneve greke dhe romake kishin fituar emër të keq. Fetë e mistershme ishin shumë popullore për shkak se theksonin marrëdhënien personale me hyjninë si dhe një njohuri të fshehtë. Filozofia sekulare greke ishte popullore dhe po shkrihej me botëkuptime të tjera. Në këtë botë feje eklektike erdhi dhe ekskluziviteti i besimit të krishterë (Jezusi është e vetmja udhë për te Perëndia, shih Gjoni 14:6). Cilido qoftë sfondi i saktë i kësaj herezie, ajo ishte një përpjekje për ta bërë natyrën përjashtuese të krishterimit (pra, Gjoni 14:6; 1 Gjonit 5:12) të pranueshme dhe të pëlqyeshme nga ana mendore për dëgjuesit greko-romakë në përgjithësi. Ka gjasa që mendimi gnostik të ketë dalë prej sekteve të skajshme judaike (një shembull: sekti i Pergamenave të Detit të Vdekur). Kjo ndoshta shpjegon dhe disa prej elementeve judaike të librave të DHR në lidhje me gnosticizmin.
- II. Disa nga parimet bazë të kësaj herezie sipas të dhënave të brendshme të 1 Gjonit.
 - A. Mohimi i mishërimit të Jezu Krishtit
 - B. Mohimi i rolit qendror të Jezu Krishtit në shpëtim
 - C. Mungesa e një stili të përshtatshëm jetese si të krishterë
 - D. Theksimi i njohurisë (shpesh, e fshehtë)
 - E. Prirja drejt ekskluzivimit dhe elitizmit
- III. Shenjat e gnosticizmit në shekullin e parë
 - A. Mësimet bazë të proto-gnosticizmit të shekullit të parë duket se ishin theksimi i dualizmit ontologjik (të përjetshëm) mes shpirtit dhe materies. Shpirti (perëndia i lartë) konsiderohej i mirë, ndërsa materia ishte qenësisht e keqe. Kjo dikotomi i ngjan

1. Platonizmit: idealja kundër fizikes
 2. Qiellorja përkundër tokësore
 3. E padukshmja përkundër të dukshmes. Kishte dhe një mbitheksim të rëndësishëm të njohurisë së fshehtë (fjalët kyçe ose kodet sekrete i lejonin shpirtit të kalonte përmes sferave engjëjlore [*aeona*] deri te perëndia i lartë), që ishte e domosdoshme për shpëtim.
 4. Ndoshta ka ndikime nga zoroastrianizmi
- B. Nga sfondi i 1 Gjonit mund të dallojmë dy forma të proto-gnosticizmit
1. Gnosticizmi docetik, që mohonte natyrën e vërtetë njerëzore të Jezusit për shkak se materia është e keqe
 2. Gnosticizmi i Kerintit, që e identifikonte Krishtin me një nga *aeon*-at ose nivelet e shumta engjëjlore midis perëndisë së lartë dhe materies së ligë. Ky “Shpirt Krishti” banoi në njeriun Jezus që nga çasti i pagëzimit dhe e braktisi para kryqëzimit.
 3. Nga këto dy grupe, disa praktikonin asketizmin (nëse trupi do diçka, ajo është gjë e ligë), ndërsa disa të tjerë, antinomianizmin (nëse trupi do diçka, jepja).
- C. Nuk ka të dhëna me shkrim për ndonjë sistem të zhvilluar të gnosticizmit në shekullin e parë. Vetëm nga mesi i shekullit të dytë ekzistojnë të dhëna të dokumentuara (shih Tekstet e Nag Hamadit). Për informacione të mëtejshme për “gnosticizmin”, shih
1. *The Gnostic Religion* nga Hans Jonas, botuar nga Beacon Press
 2. *The Gnostic Gospels* nga Elaine Pagels, botuar nga Random House
 3. *The Nag Hammadi Gnostic Texts and the Bible* nga Andrew Helmbold

IV. Herezia sot

- A. Fryma e kësaj herezie është e pranishme dhe sot, kur njerëzit përpiqen ta kombinojnë të vërtetën e krishterë me sisteme të tjera mendimi.
- B. Fryma e kësaj herezie është e pranishme dhe sot, kur njerëzit theksojnë doktrinën “e saktë” në veçim nga marrëdhënia personale dhe besimi si stil jetese.
- C. Fryma e kësaj herezie është e pranishme dhe sot, kur njerëzit e kthejnë krishterimin në një grupi elitare dhe përjashtues nga ana intelektuale.
- D. Fryma e kësaj herezie është e pranishme dhe sot, kur njerëzit fetarë bienin për e asketizmit ose antinomianizmit si mënyra më e mirë për të gjetur hiri të Perëndia.

1:11 “një zë erdhi nga qiejt” Rabinët e quanin zërin hyjnor *Bath Kol* (shih Marku 9:7); kjo ishte metoda sesi pohohej vullneti i Perëndisë gjatë periudhës ndërbiblike kur s’kishte më profetë. Për ata që e njihnin judaizmin rabinik, ky duhet të ketë qenë një miratim i fuqishëm hyjnor.

■ **“Ti je Biri im”** Këta dy tituj bashkojnë aspektin mbretëror të Mesisë (Psa. 2:7) me Shërbëtorin e Përvuajtur të Isaisë (Isa. 42:1). Fjala “bir” në DHV mund të nënkuptojë (1) kombin e Izraelit; (2) mbretin e Izraelit; ose (3) Mbretin e ardhshëm davidik dhe mesianik. Shih Temën e Veçantë në Marku 3:16.

Vini re tre personat e Trinisë në Marku 1:11; Fryma, zëri nga qielli, dhe Biri, që ishte marrësi i të dyjave.

TEMË E VEÇANTË: TRINIA (SPECIAL TOPIC: THE TRINITY)

Vini re veprimtarinë e të tre Personave të Trinisë në kontekste të bashkuara. Termi “trini”, i shpikur së pari nga Tertuliani, nuk është fjalë biblike, por koncepti i saj shfaqet kudo.

- A. Ungjijtë
 1. Mat. 3:16-17; 28:19 (dhe paralelet e saj)
 2. Gjoni 14:26
- B. Veprat – Veprat 2:32-33 38-39
- C. Pali
 1. Rom. 1:4-5; 5:1,5; 8:1-4,8-10
 2. 1 Kor. 2:8-10; 12:4-6
 3. 2 Kor. 1:21-22; 13:14
 4. Gal. 4:4-6

5. Efe. 1:3-14,17; 2:18; 3:14-17; 4:4-6

6. 1 Thes. 1:2-5

7. 2 Thes. 2:13

8. Titi 3:4-6

D. 1 Pjet. 1:2

E. Juda – v. 20-21

Në DhV, aludohet për një shumësi personash në Perëndinë.

A. Përdorimi i SHUMËSIT për Perëndinë

1. Emri *Elohim* është SHUMËS, por kur përdoret për Perëndinë ka gjithmonë një FOLJE në NJËJËS

2. “Ne” te Zanafilla 1:26-27; 3:22; 11:7

B. Engjëlli i Zotit ishte përfaqësues i dukshëm i Hyjnisë

1. Zanafilla 16:7-13; 22:11-15; 31:11,13; 48:15-16

2. Eksodi 3:2,4; 13:21; 14:19

3. Gjyqtarët 2:1; 6:22-23; 13:3-22

4. Zakaria 3:1-2

C. Perëndia dhe Fryma e tij janë të pandashëm, Zan. 1:1-2; Ps. 104:30; Isa. 63:9-11; Ezek. 37:13-14

D. Perëndia (JHVH) dhe Mesia (*Adon*) janë të veçantë, Psa. 45:6-7; 110:1; Zak. 2:8-11; 10:9-12

E. Mesia dhe Fryma janë të veçantë, Zak. 12:10

F. Të tre përmenden te Isa. 48:16; 61:1

Natyra hyjnore e Jezusit dhe personaliteti i Frymës shkaktonin probleme për besimtarët e hershëm që ishin monoteistë të rreptë.

1. Tertuliani – ia nënshtroi Birin Atit

2. Origeni – nënshtroi esencën hyjnore të Birit dhe të Frymës

3. Ari – mohoi natyrën hyjnore të Birit dhe të Frymës

4. Monarkianizmi – besonte në shfaqjen e njëpasnjëshme të të njëjtit Perëndi si Atë, si Bir dhe, pastaj, si Frymë

Trinia është një formulim i zhvilluar nga ana historike, por i informuar nga materiali biblike

1. Natyra e plotë hyjnore e Jezusit, i barabartë me Atin, gjë që u pohua në 325 pas K. nga Këshilli i Nikesë

2. Personaliteti dhe natyra e plotë hyjnore e Frymës, i barabartë me Atin dhe me Birin, u pohua nga Këshilli i Kostandinopojës (381 pas K.)

3. Doktrina e Trinisë shprehet në mënyrë të plotë në veprën e Augustinit *De Trinitate*

Këtu kemi vërtet një mister. Por DhR duket se pohon një esencë të vetme hyjnore me tre shfaqje të përvetshme personale.

☐ **“i dashur”** Kjo frazë është ose (1) titull për Mesinë, siç përkthehet në NRSV, NJB dhe Williams, ose (2) frazë përshkruese, si në NASB, NKJV dhe TEV. Në përkthimin grek të DHV (pra, Septuaginta), kjo fjalë kishte kuptimin “i parapëlqyer”, ose “i vetëm”, i ngjashëm me Gjonin 3:16.

☐ **“në ty jam i kënaqur”** Kjo frazë përshkruese ka paralelet e veta në Mat. 3:17 dhe 17:5 (Shndërrimi në mal). Megjithatë, kjo frazë përshkruese mungon në Marku 9:7 dhe Luka 9:35.

TEKSTI I NASB (I PËRDITËSUAR): MARKU 1:12-13

¹²Menjëherë, Fryma e shtyu të dilte në shkretëtirë. ¹³Dhe ishte në shkretëtirë për dyzet ditë, duke u tunduar nga Satani; dhe ishte me kafshët e egra, ndërsa engjëjt i shërbenin.

1:12-13 Ky rrëfim i tundimit të Jezusit është tejet i shkurtër krahasuar me Mat. 4:1-11 dhe Luka 4:1-13. Në këto dy rrëfime të fundit, synimi i tundimit është i qartë: Si do t’i përdorte Jezusi fuqitë e tij mesianike për të përmbushur detyrën e tij shpenguese (shih James Stewart, *The Life and Teaching of Jesus Christ*, f. 39-46)?

Por cila mund të ketë qenë domethënia e rrëfimit të shkurtër të Marku? Ndoshta, Pjetri e shihte këtë ngjarje si simbol të triumfit të Jezusit mbi të Ligun (pra, me anë të fuqizimit të Frymës), një parashije e Javës së Mundimit. Por ky është vetëm hamendësim. Vetë teksti nuk na jep asnjë të dhënë tjetër përveç kohës së ngjarjes—menjëherë pasi Jezusi (1) mori Frymën dhe (2) miratimin e Atit, por përpara shërbesës së tij publike.

Kjo është një nga tre ngjarjet që përmenden përpara shërbesës publike të Jezusit ([1] shërbesa e Gjonit; [2] pagëzimi i Gjonit; dhe [3] tundimi nga Satani).

1:12 “Menjëherë” Shih shënimin te Marku 1:10.

■ **“Fryma e shtyu të dilte në shkretëtirë”** Fjala “shtyu” është një folje me kuptimin e fortë “dëboj” (shpesh, përdorej për dëbimet e demonëve, shih Marku 1:34, 39; 3:15, 22, 23; 6:13; 7:26; 9:18, 28, 38). Tundimi i Birit u krye me anë të veprimit të të ligut, por u nxit nga Fryma (shih Mat. 4:1-11; Luka 4:1-13). Ishte vullneti i Perëndisë që Jezusi të vihej në sprovë! Do t’ju rekomandoj atë lexonit dy libra të dobishëm për këtë temë: *The Life and Teaching of Jesus*, nga James S. Stewart, dhe *Between God and Satan*, nga Helmut Thielicke.

Në DHV, shkretëtira ishte një kohë sprove për Izraelin, por edhe një kohë bashkësie të ngushtë me Perëndinë. Rabinët e quanin periudhën e endjes në shkretëtirë si muajin e mjaltit mes JHVH-së dhe Izraelit. Elia dhe Gjon Pagëzori u rritën në shkretëtirë. Ajo ishte një vend veçimi për edukim, meditim dhe përgatitje për shërbesë aktive. Kjo periudhë ishte kyçe për përgatitjen e Jezusit (shih Heb. 5:8).

1:13 “dyzet ditë” Ky numër përdoret edhe në mënyrë të fjalëpërfjalshme, edhe në mënyrë të figurshme, në Bibël. Nënkupton një periudhë të gjatë dhe të papërcaktuar kohore (pra, me të gjatë se cikli hënor, por më të shkurtër se një ndryshim stinor).

TEMË E VEÇANTË: NUMRAT SIMBOLIKË NË BIBËL (SPECIAL TOPIC: SYMBOLIC NUMBERS IN SCRIPTURE)

- A. Disa numra funksiononin edhe si shifra, edhe si simbole.
1. Një – Perëndia (p.sh. LiP. 6:4; Efe. 4:4-6)
 2. Katër – gjithë toka (pra, katër cepat, katër erërat; p.sh., Isa. 11:12; Jer. 49:36; Dan. 7:2; 11:4; Zak. 2:6; Mat. 24:31; Marku 13:27; Zbu. 7:1)
 3. Gjashtë – mospërsosmëria njerëzore (një më pak se 7; p.sh., Zbu. 13:18)
 4. Shtatë – përsosmëria hyjnore (shtatë ditët e krijimit). Vini re përdorimet simbolike që i bëhen këtij numri në Zbulesë:
 - a. Shtatë shandanët: Zbu. 1:12, 20; 2:1
 - b. Shtatë yjet: Zbu. 1:16, 20; 2:1
 - c. Shtatë kishat: Zbu. 1:20
 - d. Shtatë shpirtrat e Perëndisë: Zbu. 3:1; 4:5; 5:6
 - e. Shtatë llambat: Zbu. 4:5
 - f. Shtatë vulat: Zbu. 5:1, 5
 - g. Shtatë brirët dhe shtatë sytë: Zbu. 5:6
 - h. Shtatë engjëjt: Zbu. 8:2, 6; 15:1, 6, 7, 8; 16:1; 17:1
 - i. Shtatë trumbetat: Zbu. 8:2, 6
 - j. Shtatë bubullimat: Zbu. 10:3, 4
 - k. Shtatë mijë: Zbu. 11:13
 - l. Shtatë kokat: Zbu. 13:1; 17:3, 7, 9
 - m. Shtatë murtajat: Zbu. 15:1, 6, 8; 21:9
 - n. Shtatë kupat: Zbu. 15:7; 21:9
 - o. Shtatë mbretërit: Zbu. 17:10
 5. Dhjetë – plotësia
 - a. Përdorimi në ungjijtë:
 - (1) Mat. 20:24; 25:1, 28
 - (2) Marku 10:41
 - (3) Luka 14:31; 15:8; 17:12,17; 19:13,16,17,24,25
 - b. Përdorimi në librin e Zbulesës:
 - (1) Zbu. 2:10; dhjetë ditë e mundimit
 - (2) Zbu. 12:3; 17:3, 7, 12, 16; dhjetë brirët
 - (3) Zbu. 13:1; dhjetë kurorat
 - c. Shumëfishat e numrit 10 në Zbulesë:

- (1) $144,000 = 12 \times 12 \times 1000$; shih Zbu. 7:4; 14:1, 3
 (2) $1,000 = 10 \times 10 \times 10$; Zbu. 20:2, 3, 6
6. Dymbëdhjetë – organizimi njerëzor:
- Dymbëdhjetë bijtë e Jakobit (pra, dymbëdhjetë fiset e Izraelit, Zan. 35:22; 49:28)
 - Dymbëdhjetë shtyllat; Eks. 24:4
 - Dymbëdhjetë gurët e çmuar në gjoksoren e Kryepriftit; Eks. 28:21; 39:14
 - Dymbëdhjetë bukët për tryezën e Shenjtërores (simbol se Perëndia siguron për dymbëdhjetë fiset); Lev. 24:5; Eks. 25:30
 - Dymbëdhjetë gjurmuesit; LiP. 1:23;
 - Dymbëdhjetë mbartësit e gurëve; Joz. 4:2, 3, 4, 8, 9, 20
 - Dymbëdhjetë apostujt; Mat. 10:1
 - Përdorimi në Zbulesë:
 - Dymbëdhjetë mijë të vulosur; Zbu. 7:5-8
 - Dymbëdhjetë yjet; Zbu. 12:1
 - Dymbëdhjetë portat, dymbëdhjetë engjëjt, dymbëdhjetë fiset; Zbu. 21:12
 - Dymbëdhjetë gurët e themelit, emrat e 12 apostujve; Zbu. 21:14
 - Jerusalemi i Ri ishte dymbëdhjetë mijë stade në të gjitha anët; Zbu. 21:16
 - Dymbëdhjetë portat e bëra me dymbëdhjetë gurë të çmuar; Zbu. 21:21
 - Pema e jetës me dymbëdhjetë lloj frytësh; Zbu. 22:2
7. Dyzet – numri për kohën:
- Nganjëherë i fjalëpërfjalshëm (eksodi dhe endja në shkretëtirë; p.sh., Eks. 16:35); LiP. 2:7; 8:2
 - Mund të jetë i fjalëpërfjalshëm ose simbolik:
 - Përmbytja; Zan. 7:4, 17; 8:6
 - Moisiu në malin Sinai; Eks. 24:18; 34:28; LiP. 9:9, 11, 18, 25
 - Periudhat e jetës së Moisiut:
 - 40 vjet në Egjipt
 - 40 vjet në shkretëtirë
 - 40 vjet në krye të Izraelit
 - Jezusi agjëroi dyzet ditë; Mat. 4:2; Marku 1:13; Luka 4:2
 - Vini re (me anë të një Përkuesi Biblik) numrin e herëve që kjo shifër shfaqet për të përcaktuar kohën në Bibël!
8. Shtatëdhjetë – numri i plotë për njerëzit
- Izraeli; Eks. 1:5
 - Shtatëdhjetë pleqtë; Eks. 24:1, 9
 - Eskatologjik; Dan. 9:2, 24
 - Ekipi misionar; Luka 10:1, 17
 - Falja (70x7), Mat. 18:22

B. Referenca të dobishme

- John J. Davis, *Biblical Numerology*
- D. Brent Sandy, *Plowshares and Pruning Hooks*

■ **“duke u tunduar”** Kjo është një formë perifrastike pësore e pakryer, e lidhur me foljen “jam” të pakryer veprorë. Fjala “tundoj” (*peirazo*) ka dhe ngjyrimin kuptimor “sprovuj me qëllim që ta shkatërroj”. Nga fjalitë kushtore të klasit të parë te Mat. 4 (shih Marku 4:3, 6) mësojmë se qëllimi i këtij tundimi ishte sesi do ta përdorte Jezusi fuqinë e vet mesianike për të përmbushur vullnetin shpengues të Perëndisë.

TEMË E VEÇANTË: FJALËT GREQISHT PËR “VËNIEN NË PROVË” DHE NGJYRIMET E TYRE KUPTIMORE (SPECIAL TOPIC: GREEK TERMS FOR TESTING AND THEIR CONNOTATIONS)

Ka dy fjalë greke që përçojnë idenë e vënies diku në provë për një qëllim të caktuar.

- Dokimazō, Dokimion, Dokimasia*

Kjo fjalë është term metalurgjik për vënien në provë të autenticitetit të diçkaje (pra, metaforikisht, të dikujt) me anë të zjarrit. Zjarri zbulon metalin e vërtetë dhe djeg (pra, pastron) skoriet. Ky proces fizik u shndërrua në zhargon të fuqishëm teologjik ku Perëndia, dhe/ose Satani, dhe/ose njerëzit vënë në sprovë të tjerët. Kjo fjalë përdoret vetëm në kuptimin pozitiv të sprovimit me synim që dikush të miratohet.

Në DHR përdoret për të vënë në sprovë

- a. qetë – Luka 14:19
- b. vetveten – 1 Kor. 11:28
- c. besimin tonë – Jakobi 1:3
- d. madje dhe Perëndinë – Heb. 3:9

Rezultatet e këtyre sprovave merren si pozitive (shih Rom. 2:18; 14:22; 16:10; 2 Kor. 10:18; 13:3; Fil. 2:27; 1 Pje. 1:7), prandaj, ky term përçon idenë e shqyrtimit dhe miratimit të dikujt si

- a. i vlefshëm
- b. i mirë
- c. i vërtetë
- d. i vyer
- e. i nderuar

2. *Peirazō, Peirasmos*

Shpesh, ky term ka ngjyrimin e shqyrtimit me qëllim gjetjen e të metave, ose refuzimin. Shpesh, përdoret në lidhje me tundimin e Jezusit në shkretëtirë.

- a. Përçon përpjekjen për ta shtënë Jezusin në kurth (shih. Mat. . 4:1; 16:1; 19:3; 22:18, 35; Marku 1:13; Luka 4:2; Heb. 2:18).
- b. Kjo fjalë (*peirazōn*) përdoret edhe si titull i Satanit në Mat. 4:3; 1 Thes. 3:5.
- c. Përdorimi

(1) Përdorej nga Jezusi për të na paralajmëruar që të mos e vëmë Perëndinë në sprovë (shih Mat. 14:7; Luka 4:12) [ose Krishtin, shih 1 Kor. 10:9].

(2) Po kështu, ajo nënkupton përpjekjen për të bërë diçka që ka dështuar (shih Heb. 11:29).

(3) Përdoret në lidhje me tundimin dhe sprovat e besimtarëve (shih 1 Kor. 7:5; 10:9, 13; Gal. 6:1; 1 Thes. 3:5; Heb. 2:18; Jakobi 1:2, 13, 14; 1 Pje. 4:12; 2 Pje. 2:9).

▣ “nga Satani” Bibla flet vazhdimisht për një forcë personale dhe të mbinatyrshme ligësie.

TEMË E VEÇANTË: SATANI (SPECIAL TOPIC: SATAN)

Kjo është temë shumë e vështirë për disa arsye.

1. DHV nuk na paraqet një kryearmik të së mirës, por një shërbëtor të JHVH (shih A. B. Davidson, *OT Theology*, f. 300-306), i cili i ofron njerëzimit një alternativë, si dhe e akuzon njerëzimin për padrejtësi. Ka vetëm një Perëndi (shih Temën e Veçantë: Monoteizmi), një fuqi dhe një shkak të vetëm në DHV—JHVH (shih Isa. 45:7; Amosi 3:6).
2. Koncepti i kryearmikut personal të Perëndisë u zhvillua në literaturën ndërthjatore (jokanonike) nën ndikimin e feve dualiste perse (zoroastrianizmi). Nga ana e vet, kjo gjë ndikoi së tepërmi në judaizmin rabinik dhe në komunitetin esen (p.sh., Pergamenat e Detit të Vdekur).
3. DHR i zhvillon motivet e DHV në kategori çuditërisht të thekta, por dhe të përzgjedhura.

Nëse studimin e ligësisë e shohim nga pikëvështrimi i teologjisë biblike (ku secili libër, autor, ose gjini letrare studiohet dhe përvijohet veçmas), atëherë na zbulohen pikëpamje shumë të ndryshme për ligësinë.

Nga ana tjetër, nëse i qasemi studimit të ligësisë nga përjasja jobiblike ose jashtëbiblike e feve botërore ose feve lindore, atëherë një pjesë e mirë e zhvillimeve të DHR paraprihen nga dualizmi persian dhe spiritizmi greko-romak.

Nëse dikush (si unë!) është i përkushtuar paraprakisht ndaj autoritetit hyjnor të Shkrimit, atëherë zhvillimi i DHV duhet parë si zbuluesë e përshkallëzuar. Të krishterët duhet të mos lejojnë që folklori judaik apo literatura perëndimore (Dantja, Milioni) të ndikojnë më tej në këtë koncept. Ka pa dyshim mister dhe paqartësi

në këtë pjesë të zbulësës. Perëndia ka zgjedhur që të mos na i zbulojë të gjitha aspektet e ligësisë, apo origjinën (shih Temën e Veçantë: Luciferi), zhvillimin, apo synimin e saj, por na ka zbuluar disfatën e ligësisë!

Në DHV, termi “satan” ose “akuzues” (BDB 966, KB 1317) mund të përdoret për tre grupe të ndryshme.

1. Akuzuesit njerëzorë (shih 1 Sam. 29:4; 2 Sam. 19:22; 1 Mbre. 11:14, 23, 25; Psa. 109:6)
2. Akuzuesit engjëj (shih Num. 22:22-23; Jobi 1-2; Zak. 3:1)
3. Akuzuesit demoniakë (shih 1 Kro. 21:1; 1 Mbre. 22:21; Zak. 13:2)

Vetëm më vonë, në periudhën ndërthjatore, gjarpri i Zanafillës 3 identifikohet me Satanin (shih *Libri i Urtësisë* 2.23-24; 2 *Enoku* 31:3), dhe, më vonë, kjo shndërrohet në koncept rabinik (shih *Sot* 9b dhe *Sanh.* 29a). “Bijtë e Perëndisë” në Zanafilla 6 bëhen engjëj në 1 *Enoku* 54:6. E përmend këtë, jo për të thënë se ky libër është teologjikisht i saktë, por për të treguar zhvillimin e termit. Në DHR, këto veprimtari të DHV i atribuohen ligësisë së personifikuar engjëjlore (shih 2 Kor. 11:3; Zbu. 12:9).

Origjina e ligësisë së personifikuar është e vështirë ose e pamundur (varet nga pikëpamja e secilit) për t’u përcaktuar nga DHV. Një arsye për këtë është monoteizmi i rreptë i Izraelit (shih Temën e Veçantë: Monoteizmi; si dhe vini re 1 Mbre. 22:20-22; Pred. 7:14; Isa. 45:7; Amosi 3:6). Çdo shkakësi (shih Isa. 45:7; Amosi 3:6) i atribuohet JHVH-së për të treguar natyrën unike dhe parësinë e tij (shih Isa. 43:11; 44:6, 8, 24; 45:5-6, 14, 18, 21, 22).

Burime të mundshme informacioni janë: (1) Jobi 1-2, ku Satani është një nga “bijtë e Perëndisë” (pra, engjëjt), ose (2) Isaia 14 dhe Ezekieli 28, ku mbretërit kryelartë të Lindjes së Afërt (Babilonia dhe Tiri) ndoshta përdoren për të ilustruar krenarinë e Satanit (shih 1 Tim. 3:6). Unë kam dyshimet e mia për këtë qasje. Ezekieli përdor metafora nga Kopshti i Edenit, jo vetëm për mbretin e Tirit si Satan (shih Ezek. 28:12-16), por edhe për mbretin e Egjiptit si Pema e Njohurisë së të Mirës dhe së Ligës (Ezek. 31). Mirëpo Isaia 14, sidomos v. 12-14, duket se përshkruan një kryengritje engjëjlore për shkak të krenarisë. Nëse Perëndia ka dashur të na e zbulojë natyrën dhe origjinën e saktë të Satanit, e ka bërë në një mënyrë dhe vend shumë të tërthortë. Duhet t’i shmangemi prirjes së teologjisë sistematike, e cila merr pjesë të vogla dhe të paqarta nga Dhiatat, autorët, librat dhe gjinitë e ndryshme dhe i kombinon për të formuar një “pazëll” të vetëm hyjnor.

Unë jam dakord me Alfred Edersheim (*The Life and Times of Jesus the Messiah*, vëll. 2, shtojcat XIII [f. 748-763]) dhe XVI [f. 770-776]) se judaizmi rabinik është ndikuar së tepërmi nga dualizmi pers dhe nga hamendësimet perse për demonët. Rabinët nuk janë burim i saktë për të vërtetën në këtë pikë. Jezusi ndryshon rrënjësisht nga mësimet e Sinagogës në këtë fushë. Unë mendoj se koncepti i një armiku kryeengjëllor të JHVH-së u zhvillua nga dy perënditë e larta të dualizmit iranian, *Ahkiman* dhe *Ormaza*, dhe më tej u zhvillua nga rabinët për t’u shndërruar në dualizmin biblik të JHVH-së dhe Satanit.

Pa dyshim, DHR përmban zbulësë të përshkallëzuar në lidhje me personifikimin e ligësisë, por mësimet e saj nuk janë aq të detajuara sa ato të rabinëve. Një shembull i qartë i këtij dallimi është “lufta në qiell”. Rënia e Satanit është një domosdoshmëri logjike, por nuk na jepen hollësi (shih Temën e Veçantë: Rënia e Satanit dhe engjëjve të tij). Edhe shpjegimet që na jepen fshihen në gjuhë e gjinisë letrare apokaliptike (shih Zbu. 12:4, 7, 12-13). Ndonëse Satani është mposhtur në Jezusin dhe është dëbuar në tokë, ai ende funksionon si shërbëtor i JHVH-së (shih Mat. 4:1; Luka 22:31-32; 1 Kor. 5:5; 1 Tim. 1:20).

Duhet t’i vëmë fre kureshtjes në këtë pikë. Ekziston një forcë personale tundimi dhe ligësie, por gjithsesi ka vetëm një Perëndi dhe ne jemi përgjegjës për zgjedhjet që bëjmë. Ekziston një betejë shpirtërore, si përpara, ashtu dhe pas, shpëtimit. Fitorja mund të vijë dhe të qëndrojë vetëm në Perëndinë Triun dhe nëpërmjet tij. Ligësia është mposhtur dhe do të asgjësohet (shih Zbu. 20:10)!

■ **“kafshët e egra”** Ndoshta, bëhet thjesht fjalë për një zonë të pabanuar. Megjithatë, për shkak se bishat përdoren si metafora, ose si emra, për demonët në DHV (shih NEB), mund të bëhet fjalë edhe për një vend me veprimtari demoniake (shih Psa. 22:12-13, 16, 21; Isa. 13:21-22; 34:11-15).

Këto bisha mund të jenë edhe aludim i vazhdueshëm për eksodin e ri, një epokë të re ku do të ripërtërihet miqësia mes njerëzimit dhe kafshëve (shih Isa. 11:6-9; 65:25; Os. 2:18). Shpesh, Bibla e përshkruan epokën e re

si rikthim të Kopshtit të Edenit (shih Zan. 2; Zbu. 21-22). Shëmbëllimi i parë i Perëndisë në njerëzimin (shih Zan. 1:26-27) ripërtërihet përmes vdekjes flijuese të Jezusit. Bashkësia e plotë, që ekzistonte përpara Rënies (shih Zanafilla 3), bëhet sërish e mundshme.

■ **“engjëjt i shërbenin”** Kjo është në kohën e pakryer, që nënkupton (1) një veprim të vazhdueshëm në të shkuarën, ose (2) fillimin e një veprimi në të shkuarën. Engjëjt i kishin shërbyer edhe (1) Elisë në shkretëtirë në të njëjtën mënyrë (duke i siguruar ushqim; shih 1 Mbre. 18:7-8). Ndoshta, kjo nënkupton se Jezusi ishte zëri i ri profetik (shih LiP. 18:18-22); edhe (2) Izraelit në shkretëtirë. Pra, tani po i shërbenin dhe Jezusit në shkretëtirë. Ndoshta, kjo nënkuptonte se Jezusi ishte Moisiu i ri, duke nxjerrë paralele mes tyre në pagëzimin dhe sprovimin e tij (shih 1 Kor. 10:1-13).

TEKSTI I NASB (I PËRDITËSUAR): MARKU 1:14-15

¹⁴Dhe, mbasi Gjonin e burgosën, Jezusi erdhi në Galile duke predikuar ungjillin e Perëndisë ¹⁴dhe duke thënë: “Koha u përmbush dhe mbretëria e Perëndisë është afër; pendohuni dhe besoni në ungjillin”.

1:14-15 Këto dy vargje janë shprehje përmbledhëse. Marku e përdor shpesh këtë teknikë (shih Marku 1:14-15, 21-22, 39; 2:13; 3:7b-9; 6:7, 12-13). Këto përmbledhje përçojnë një sërë të vërtetash teologjike:

1. Jezusi ishte popullor dhe shumë erdhën që ta dëgjonin tek predikonte/jepte mësim
2. Jezusi ishte i fuqishëm; dëbonte demonët dhe shëronte njerëzit
3. Fuqinë e vet ua transferonte dhe dishepujve (p.sh., udhëtimet misionare të të Dymbëdhjetëve ose të shtatëdhjetëve)
4. Synimi i shpalljes së Jezusit ishte pendimi dhe besimi

1:14 “Gjoni e burgosën” Gjoni e burgosi (pra, *paradidomi*, që përdoret njëzet herë te Marku në kuptimin “dorëzoi te autoritetet”) Herod Antipa, sepse vazhdonte ta dënonte publikisht martesën e Herodit me ish-gruan e të vëllait (shih Marku 6:16-17).

TEMË E VEÇANTË: FAMILJA E HERODIT TË MADH (SPECIAL TOPIC: THE FAMILY OF HEROD THE GREAT)

A. Herodi i Madh

1. Mbret i Judesë (37-4 para K.), idumeas (nga Edomi), i cili, përmes manovrimeve politike dhe mbështetjes së Mark Antonit, ia doli të caktohej sundimtar i një pjesë të madhe të Palestinës (Kanaanit) nga senati romak më 40 para K.
2. Përmendet në Mat. 2:1-19 dhe Luka 1:5
3. Bijtë e tij
 - a. Herod Filipi (biri i Marianës së Simonit)
 - (1) Burri i Herodiadës (4 para K. – 34 pas K.)
 - (2) Përmendet në Mat. 14:3; Marku 6:17
 - b. Herod Filipi I (biri i Kleopatrës)
 - (1) Tetrark i zonës në veri dhe perëndim të Detit të Galilesë (4 para K. – 34 pas K.)
 - (2) Përmendet në Luka 3:1
 - c. Herod Antipa
 - (1) Tetrark i Galilesë dhe Peresë (4 para K. – 39 pas K.)
 - (2) Përmendet në Mat. 14:1-12; Marku 6:14,29; Luka 3:1,19; 9:7-9; 13:31; 23:6-12,15; Acts 4:27; 13:1
 - d. Arkelau, Herod Etnarku
 - (1) Sundimtar i judesë, Samarisë dhe Idumesë (4 para K. – 6 pas K.)
 - (2) Përmendet në Mat. 2:22
 - e. Aristobuli (biri i Marianës)
 - (1) Përmendet si babai i Herod Agripës I, i cili ishte
 - (a) Mbreti i Judesë (37-44 pas K.)

- (b) Përmendet në Veprat 12:1-24; 23:35
 - (i) Biri i tij ishte Herod Agripa II
 - Tetrark i territorit verior (50-70 pas K.)
 - (ii) E bija e tij ishte Bernika
 - Bashkëshortja e vëllait
 - Përmendet në Veprat 25:13-26:32
 - (iii) E bija e tij ishte Drusila
 - Gruaja e Feliksit
 - Përmendet në Veprat 24:24

B. Referencat biblike për Herodët

1. Herod tetrarku, i përmendur te Mateu 14:1 e më tej; Luka 3:1; 9:7; 13:31 dhe 23:7, ishte i biri i Herodit të Madh. Me vdekjen e Herodit të Madh, mbretëria e tij u nda mes bijve të vet. Fjala “tetrark” do të thotë “udhëheqës i një të katërtës”. Ky Herod njihej edhe si Herod Antipa, një formë e shkurtuar e emrit Antipater. Ai kishte nën vete Galilenë dhe Perënë. Kjo do të thoshte se një pjesë e mirë e shërbesës së Jezusit u krye në territorin e këtij sundimtari idumeas të brezit të dytë.
2. Herodiada ishte e bija e vëllait të Herod Antipës, Aristobulit. Ajo kishte qenë e martuar më parë me Filipin, gjysmëvëllain e Herod Antipës. Ky nuk ishte Filip tetrarku, që sundonte në rajonin në veri të Galilisë, por vëllai tjetër Filip, që jetonte në Romë. Herodiada kishte një vajzë me Filipin. Kur Herod Antipa vizitoi Romën, u takuan dhe Herodiada e joshi, sepse kërkonte të ngjiste shkallët e karrierës politike. Si rrjedhojë, Herod Antipa e ndau të shoqen, që ishte princesë nabatese, ndërsa Herodiada u divorcua nga Filipi që të martohej me Herodin. Ajo ishte dhe motra e Herod Agripës I (shih Veprat 12).
3. Emrin e të bijës së Herodiadës, Salome, e mësojmë nga Flavius Jozefus në librin e tij, *Lashtësitë e Judenjve* 8:5:4. Ajo duhet të ketë qenë 12 deri 17 vjeç në atë kohë. Duket se e ëma e kontrollonte dhe e manipulonte. Më vonë, u martua me Filip tetrarkun, por shumë shpejt mbeti e ve.
4. Rreth dhjetë vjet pas prerjes së kokës së Gjon Pagëzorit, Herod Antipa shkoi në Romë me nxitjen e së shoqes, Herodiadës, për të kërkuar titullin “mbret”, sepse atë titull e kishte marrë i vëllai i saj, Agripa I. Por Agripa I i shkroi Romës dhe e akuzoi Antipën për bashkëpunim me partët, armiq të urryer të Romës nga Gjysmëhëna Pjellore (Mesopotamia). Perandori, me sa duket, i besoi Agripës I dhe e syrgjynosi Herod Antipën, bashkë me të shoqen, Herodiadën, në Spanjë.
5. Për ta patur më të lehtë që t’i mbajmë mend këta Herodë të ndryshëm që shfaqen në Dhiatën e Re, mund të kujtojmë se Herodi i Madh vrau fëmijët në Betlehem; Herod Antipa vrau Gjon Pagëzorin; Herod Agripa I vrau apostullin Jakob; ndërsa Herod Agripa II dëgjoi apelin e Palit (që gjendet në librin e Veprave).

C. Për të dhëna për sfondin e familjes së Herodit të Madh, shqyrtoni treguesin në fund të librit *Lashtësitë e judenjve* të Flavius Jozefusit.

■ **“Jezusi erdhi në Galileë”** Ungjilli e vendos shërbesën e Jezusit gjeografikisht në Galileë, në Judeë, në Galileë dhe sërish në Judeë. Jezusi u largua nga Palestina e jugut kur Gjonin e arrestuan (shih Mat. 4:12; Luka 4:14-15; Gjoni 1:43). Shërbesa në Palestinën veriore, ku mbizotëronin johebrenjtë, ishte përbushje e profecisë së Isa. 9. Askush nuk priste që nga ky rajon të fillonte ndonjë gjë e rëndësishme nga ana shpirtërore; rajoni ndodhej larg Tempullit (shih Gjoni 1:46) dhe ishte i pari që ishte pushtuar dhe çuar në robëri nga fuqitë mesopotamase (pra, Asiria dhe neo-Babilonia).

■ **“duke predikuar ungjillin e Perëndisë”** Përdorimi i fjalës “ungjill” duhet cilësuar. Në fillim, mesazhi i Jezusit ngjasonte me atë të Gjonit. Ungjilli i plotë i Jezusit plotësohet vetëm pas jetës, vdekjes, varrosjes, ringjalljes dhe ngritjes së tij në qiell. Vargu 15 jep përmbajtjen e predikimit të hershëm të Jezusit. Ajo që predikonte Gjoni u mishërua personalisht në Jezusin e Nazaretit (shih Gjoni 14:6).

1:15 “koha është përmbushur” Kjo frazë prezantohet me lidhëzën *hoti*, që zakonisht tregon një citim dhe përdoret shpesh nga Marku. Pra, këto fjalë pasqyrojnë ato që mban mend Pjetri nga fjalët e Jezusit. Është në formën e kryer pësore dëftore, që tregon fjalë më domethënie profetike/mesianike (shih Efe. 1:10; Gal. 4:4; 1 Tim. 2:6; Titi 1:3). Diateza pësore pasqyron veprimtarinë e Perëndisë në kohë dhe histori, si dhe kontrollin e tij mbi këto të dyja.

■ **“mbretëria e Perëndisë”** Bëhet fjalë për mbretërimin e Perëndisë. Është edhe realitet i tanishëm, edhe përmbushje në të ardhmen. Në ungjillin e Mateut, kjo quhet zakonisht “mbretëria e qiejve”. Këto fraza janë sinonimike (krahaso Mat. 13:11 me Markun 4:11 dhe Lukën 8:10). Mbretëria mbërriti kur lindi Jezusi. Ajo përshkruhet dhe mishërohet në jetën dhe mësimet e Jezusit. Do të përmbushet në kthimin e tij. Mbretëria ishte tema e predikimeve dhe shëmbëlltyrave të Jezusit. Ishte motivi qendror i mesazheve të tij.

TEMË E VEÇANTË: MBRETËRIA E PERËNDISË (SPECIAL TOPIC: THE KINGDOM OF GOD)

Në DhV, JHVH mendohej si Mbreti i Izraelit (shih 1 Sam. 8:7; Psa. 10:16; 24:7-9; 29:10; 44:4; 89:18; 95:3; Isa. 43:15; 44:6), ndërsa Mesia si mbreti ideal (shih Psa. 2:6; Isa. 9:6-7; 11:1-5). Me lindjen e Jezusit në Betlehem (6-4 para K.), mbretëria e Perëndisë hyri furishëm në historinë njerëzore me fuqi të re dhe me shpengim (besëlidhja e re, shih Jer. 31:31-34; Ezek. 36:27-36).

1. Gjon Pagëzori shpalli afërsinë e mbretërisë (shih Mat. 3:2; Marku 1:15).
2. Jezusi mësoi qartë se mbretëria ishte e pranishme në atë vetë dhe në mësimet e tij (shih Mat. 4:17, 23; 9:35; 10:7; 11:11-12; 12:28; 16:19; Marku 12:34; Luka 10:9, 11; 11:20; 12:31-32; 16:16; 17:21). Mirëpo mbretëria është edhe e ardhshme (shih Mat. 16:28; 24:14; 26:29; Marku 9:1; Luka 21:31; 22:16, 18).

Në paralelet sinoptike të Marku dhe Luka gjejmë frazën “mbretëria e Perëndisë”. Kjo temë e zakonshme e mësimet të Jezusit kishte të bënte me mbretërimin e tanishëm të Perëndisë në zemrat e njerëzve, që, një ditë, do të përmbushet mbi gjithë tokën. Kjo pasqyrohet në lutjen e Jezusit të Mat. 6:10. I shkruar për judenjët, ungjilli i Mateut preferonte frazën që nuk përdorte emrin e Perëndisë (Mbretëria e qiejve), ndërsa Marku dhe Luka, që iu shkruan johebrenjve, përdorën termin e zakonshëm, duke përdorur emrin e hyjnisë.

Kjo është një frazë shumë kyçe në ungjijtë sinoptikë. Predikimi i parë dhe i fundit i Jezusit, si dhe shumica e shëmbëlltyrave të tij, trajtuan këtë temë. Ajo flet për mbretërimin e Perëndisë në zemrat e njerëzve tani! Është e habitshme që Gjoni e përdor këtë frazë vetëm dy herë (dhe asnjëherë në shëmbëlltyrat e Jezusit). Në ungjillin e Gjoni, metaforë kyçe është “jeta e përjetshme”.

Tensioni në këtë frazë shkaktohet nga dy ardhjet e Krishtit. DhV përqendrohej vetëm te një ardhje e Mesisë së Perëndisë – një ardhje ushtarake, gjykuese dhe e lavdishme – por DhR tregon se, herën e parë, ai erdhi si Shërbëtori i Përvuajtur i Isaisë 53 dhe si mbreti i përlulur i Zak. 9:9. Dy epokat judaike, epoka e ligësisë dhe epoka e re e drejtësisë, mbivendosen. Tani, Jezusi mbretëron në zemrat e besimtarëve, por, një ditë, do të mbretërojë mbi gjithë krijimin. Ai do të vijë siç paratha DhV! Besimtarët jetojnë në periudhën “tashmë, por ende jo” të mbretërisë së Perëndisë (shih Gordon D. Fee dhe Douglas Stuart, *How to Read the Bible for All Its Worth*, f. 131-134).

NASB, NKJV “është afër”
NRSV “është afruar”
TEV “është pranë”
NJB “është shumë pranë”

Kjo folje është dëftore e kryer veprorë, që nënkupton se mbretëria ishte realitet i shkuar (shih Marku 1:1-3), por edhe realitet i tanishëm (shih Mat. 12:28; Luka 11:20; 17:21). Faza “koha është përmbushur” është paralele me këtë frazë dhe thekson realitetin e fjalës profetike të Perëndisë që tani po bëhet ngjarje historike. “Epoka e Re e Drejtësisë” u inaugurua me lindjen e Jezusit, por u njoh plotësisht vetëm pas ngjarjeve të Javës së Mundimeve dhe u fuqizua plotësisht vetëm pas ditës së Rrëshajëve.

Ndonëse mbretëria ka ardhur vërtet, ka dhe pasazhe të DHV që nënkuptojnë se shfaqja e saj e plotë është në të ardhmen (shih Marku 9:1; 14:25; Mat. 26:29; Luka 22:18; Veprat 1:11; 1 Thes. 4:13-18). Qëndrimi ynë ndaj Krishtit tani përcakton shpresën tonë eskatologjike (shih Marku 8:38).

■ “pendohuni” Shih Temën e Veçantë për Pendimin në Marku 1:4.

■ “dhe besoni në ungjillin” Paralelet me Mat. 4:17 dhe Luka 4:14-15 nuk kanë të njëjtën përmbledhje.

TEMË E VEÇANTË: BESIM, BESOJ, OSE KAM BESIM (*Pistis* [EMËR], *Pisteuo* [FOLJE], *Pistos* [MBIEMËR]) (SPECIAL TOPIC: FAITH (*PISTIS* [noun], *PISTEUO* [verb], *PISTOS* [adjective]))

- A. Ky është një term shumë i rëndësishëm në Bibël (shih Heb. 11:1, 6). Është tema e predikimit të hershëm të Jezusit (shih Marku 1:15). Ekzistojnë të paktën dy kërkesa për besëlidhjen e re: pendimi dhe besimi (Marku 1:15; Veprat 3:16, 19; 20:21).
- B. Etimologjia e tij
1. Termi “besim” në DhV donte të thoshte besnikëri ose besueshmëri dhe ishte përshkrim i natyrës së Perëndisë, jo sonës
 2. Vinte nga një term hebraisht (*emun, emunah*), që donte të thoshte “të jesh i sigurt, ose i qëndrueshëm”. Besimi shpëtues është pranim mendor (grup të vërtetash), jetesë morale (stil jetese) dhe, pikë së pari, një përkushtim në marrëdhënie (mirëseardhja e një personi) dhe i vullnetshëm (një vendim) ndaj atij personi.
- C. Përdorimi i saj në DhV
- Duhet theksuar se besimi i Abrahamit nuk ishte në një Mesi të ardhshëm, por në premtimin e Perëndisë se do të kishte një fëmijë dhe pasardhës (shih Zanafilla 12:2; 15:2-5; 17:4-8; 18:14). Abrahami iu përgjigj këtij premtimi duke besuar në Perëndinë. Ai ende kishte dyshime dhe probleme për këtë premtim, për të cilin u deshën trembëdhjetë vjet për t’u përbushur. Megjithatë, Perëndia ia pranoi besimin e tij të papërsosur. Perëndia është i gatshëm të punojë me qenie njerëzore me të meta, të cilët i përgjigjen atij dhe premtimeve të tij me besim, edhe nëse ky besim ka madhësinë e një fare sinapi (shih Mat. 17:20).
- D. Përdorimi i saj në DhR
- Termi “besoi” vjen nga fjala greke (*pisteuō*), që mund të përkthehet edhe “besoj”, “besim”, ose “siguri në diçka”. Për shembull, ky EMËR nuk shfaqet në ungjillin e Gjonit, por si FOLJE përdoret shpesh. Në Gjoni 2:23-25 ka pasiguri për vërtetësinë e përkushtimit të turmës ndaj Jezusit të Nazaretit si Mesi. Shembuj të tjerë të këtij përdorimi sipërfaqësor të termit “besoj” gjenden në Gjoni 8:31-59 dhe Veprat 8:13, 18-24. Besimi i vërtetë biblik është më tepër sesa reagim fillestar. Ai duhet pasuar nga procesi i dishepullizimit (shih Mat. 13:20-22, 31-32).
- E. Përdorimi i saj me PARAFJALË
1. *eis* do të thotë “në”. Ky konstrukt unik thekson faktin se besimtarët e vënë besimin në Jezusin
 - a. në emrin e tij (Gjoni 1:12; 2:23; 3:18; 1 Gjonit 5:13)
 - b. në të (Gjoni 2:11; 3:15,18; 4:39; 6:40; 7:5,31,39,48; 8:30; 9:36; 10:42; 11:45,48; 12:37,42; Mat. 18:6; Veprat 10:43; Fil. 1:29; 1 Pje. 1:8)
 - c. në mua (Gjoni 6:35; 7:38; 11:25,26; 12:44,46; 14:1,12; 16:9; 17:20)
 - d. në Birin (Gjoni 3:36; 9:35; 1 Gjonit 5:10)
 - e. në Jezusin (Gjoni 12:11; Veprat 19:4; Gal. 2:16)
 - f. në Dritën (Gjoni 12:36)
 - g. në Perëndinë (Gjoni 14:1)
 2. *en* do të thotë “në”, si te Gjoni 3:15; Marku 1:15; Veprat 5:14
 3. *epi* do të thotë “në” ose mbi, si te Mat. 27:42; Veprat 9:42; 11:17; 16:31; 22:19; Rom. 4:5,24; 9:33; 10:11; 1 Tim. 1:16; 1 Pjet. 2:6
 4. RASA DHANORE pa asnjë PARAFJALË, si te Gal. 3:6; Veprat 18:8; 27:25; 1 Gjonit 3:23; 5:10
 5. *hoti*, që do të thotë “besoj se”, jep përmbajtjen e asaj që duhet besuar
 - a. Jezusi është i Shenjti i Perëndisë (Gjoni 6:69)
 - b. Jezusi është Unë Jami (Gjoni 8:24)
 - c. Jezusi është në Atin dhe Ati është në të (Gjoni 10:38)
 - d. Jezusi është Mesia (Gjoni 11:27; 20:31)
 - e. Jezusi është Biri i Perëndisë (Gjoni 11:27; 20:31)
 - f. Jezusi u dërgua nga Ati (Gjoni 11:42; 17:8, 21)
 - g. Jezusi është një me Atin (Gjoni 14:10-11)
 - h. Jezusi erdhi nga Ati (Gjoni 16:27, 30)

- i. Jezusi e identifikoi veten me emrin e besëlidhjes së Atit, “Unë Jam” (Gjoni 8:24; 13:19)
- j. Ne do të jetojmë me të (Rom. 6:8)
- k. Jezusi vdiq dhe u ringjall (1 Thes. 4:14)

TEKSTI I NASB (I PËRDITËSUAR): MARKU 1:16-20

¹⁶Teksa po ecte përgjatë Detit të Galilesë, pa Simonin dhe Andrean, vëllain e Simonit, që po hidhnin rrjetën në det; sepse ishin peshkatarë. ¹⁷Dhe Jezusi u tha: “Më ndiqni, dhe unë do t’ju bëj peshkatarë njerëzish”. ¹⁸Menjëherë, lanë rrjetën dhe e ndoqën. ¹⁹Si shkoi disi më tej, pa Jakobin, birin e Zebedeut, dhe Gjonin të vëllanë; edhe ata ishin në barkë duke rregulluar rrjetat. ²⁰Menjëherë, i thirri; dhe ata lanë të atin, Zebedeun, në barkë me mëditësit, dhe u larguan të ndiqnin Jezusin.

1:16 “Detit të Galilesë” Ky liqën njihet me disa emra në Bibël.

1. Deti i Kineretit (shih Num. 34:11; Joz. 12:3; 13:27)
2. Liqeni i Genesaretit (shih Luka 5:1)
3. Deti i Tiberiadës (shih Gjoni 6:1; 21:1)
4. Deti i Galilesë (termi më i përdorur; shih Marku 1:16; 7:31; Mat. 4:18; 15:29; Gjoni 6:1)

▣ **“Simonin dhe Andrean... po hidhnin rrjetën”** Vini re se Pjetri është zyrtarisht i pari që thirret nga Jezusi sipas Markut, ndërsa te Gjoni 1:35-42 i pari është Andrea. Deti i Galilesë furnizonte gjithë Palestinën me peshk. Kjo ishte një nga ato rrjetat e duarve, që kishin përmasa 3 x 4.5 metra. Peshku ishte ushqimi kryesor i dietës së judenjve.

1:17 “Më ndiqni” Kjo është ndajfolje që vepron si urdhërore aoriste. Ky s’duhet të ketë qenë takimi i parë i Jezusit me këta peshkatarë (shih Gjoni 1:35 e më tej). Kjo është thirrje që tani të bëhen zyrtarisht dhe përfundimisht ndjekës të një rabini (shih Marku 1:17 dhe 20).

▣ **“do t’ju bëj peshkatarë njerëzish”** Kjo është lojë fjalësh me profesionin e tyre. Peshkimi në DHV, shpesh, përdorej si metaforë gjykimi (shih Jer. 16:16; Ezek. 29:4-5; 38:4; Amosi 4:2; Hab. 1:14-17). Këtu, përdoret si metaforë shpëtimi.

1:18 Kjo përsëritet edhe te Mat. 4:18-22, por te Luka 5:1-11 jepet një rrëfim paksa i ndryshëm.

1:19-20 “barkë” Këto ishin barka të mëdha peshkimi. Jakobi dhe Gjoni, bijtë e Zebedeut, ishin peshkatarë të suksesshëm të shtresës së mesme (p.sh., kishin mëditës). Me sa duket, Gjoni kishte kontrata tregtie për t’u shitur rregullisht peshk familjeve priftërore në Jerusalem (p.sh., ata e njihnin Gjonin; shih Gjoni 18:15-16).

TEKSTI I NASB (I PËRDITËSUAR): MARKU 1:21-28

²¹Hynë në Kapernaum; dhe, menjëherë, ditën e shabatit, hyri në sinagogë dhe filloi t’i mësonte njerëzit. ²²Ata mahnitëshin nga mësimi i tij; sepse i mësonte si dikush me autoritet, jo si skribët. ²³Në atë çast, ishte një burrë në sinagogën e tyre, që kishte një frymë të ndyrë; dhe ai bërtiti ²⁴duke thënë: “Ç’punë kemi ne me njëri-tjetrin, o Jezus i Nazaretit? Ke ardhur të na shkatërrosh? E di kush je ti, i Shenjti i Perëndisë!” ²⁵Dhe Jezusi e qortoi dhe i tha: “Hesht, dhe dil prej tij!” ²⁶Dhe mbasi e sfiliti, fryma e ndyrë bërtiti me zë të fortë dhe doli prej tij. ²⁷Ata u mahnitën të gjithë, kështu që po debatnin me njëri-tjetrin duke thënë: “Ç’është kjo? Një mësim i ri me autoritet! Ai urdhëron dhe frymërat e ndyra dhe ato i binden”. ²⁸Menjëherë, lajmi për të u përhap kudo, në të gjithë rajonin e Galilesë përreth.

1:21 “Kapernaum” Për shkak të mungesës së besimit të Nazaretit (shih Luka 4:16-30), dhe si përmbushje profecie (shih Mat. 4:13-16), Jezusi e bëri Kapernaumin bazë të vet (shih Marku 2:1). Shërbesa në qytetin e Kapernaumit (shih Marku 1:21-3:6) përdoret për të përshkruar veprimtarinë normale të Jezusit. Këto ngjarje zbulojnë qartë autoritetin, pushtetin dhe natyrën mesianike të tij. Është si të shohësh pak jetën dhe aktivitetin e përditshëm të Jezusit gjatë gjithë kësaj periudhe të shërbesës së tij publike.

▣ **“menjëherë”** Shih shënimin në Marku 1:10.

■ “shabatit” Shih Temën e Veçantë më poshtë.

TEMË E VEÇANTË: SHABATI (SPECIAL TOPIC: SABBATH)

Shabat vjen nga një fjalë hebraisht (BDB 992, KB 1409) që do të thotë “pushim” ose “ndalim”. Lidhet me ditën e shtatë të krijimit (shih John H. Walton, *The Lost World of Genesis One*), ku Perëndia pushoi nga puna e vet pasi përfundoi krijimin e parë (shih Zan. 2:1-3). Perëndia nuk pushoi për shkak se ishte i lodhur, por për shkak se (1) krijimi ishte përfunduar dhe ishte i mirë (shih Zan. 1:31), dhe (2) për t’i dhënë njerëzimit një model të rregullt adhurimi dhe pushimi. Përdorimi si ditë adhurimi nis me Zan. 2:2-3, ku JHVH e përdor pushimin e vet si model për kafshët (shih Eks. 23:12) dhe njerëzimin (njerëzit kanë nevojë për një orar të rregullt pune, pushimi dhe adhurimi). Si gjithë ditët e tjera të Zan. 1, shabati fillon në muzg; prandaj, periudha zyrtare e shabatit ishte nga muzgu i së premtes deri në muzgun e së shtunës. Të gjitha hollësitë për kremtimin e shabatit jepen në librin e Eksodit (sidomos kapitujt 16, 20, 31 dhe 35) dhe atë të Levitikut (sidomos kapitujt 23-26). Përdorimi i parë i specializuar i kësaj dite nga Izraeli gjendet në Eks. 16:25-26 në mbledhjen e manës. Më tej, bëhet pjesë e “Dhjetë Fjalëve” (shih Eks. 20:8-11; LiP. 5:12-15). Ky është një shembull ku Dhjetë Urdhërimet në Eksodi 20 janë disi të ndryshme nga Dhjetë Urdhërimet në Ligji i Përtërirë 5. Ligji i Përtërirë po e përgatit Izraelin për jetën e nguluar bujqësore në Kanaan.

Farisenjtë i kishin marrë këto rregulla dhe, me anë të diskutimeve të tyre gojore, i kishin interpretuar për të përfshirë shumë rregulula të tjera. Jezusi kreu shpesh mrekulli, duke shkelur me dashje rregullat e tyre pedante në mënyrë që të hynte në dialog teologjik me ta (p.sh., Mateu 12). Jezusi nuk hodhi poshtë apo përcmoi shabatit, por legalizmin arrogant dhe mungesën e dashurisë nga ana e tyre (shih Marku 2:27-28).

Kisha e hershme adhuronte edhe ditën e shabatit, edhe ditën e parë të javës (pra, të dielën, ditën e ringjalljes; shih Gjoni 20:1, 19; Veprat 20:7; 1 Kor. 16:2). Sinagoga iu kundërvu lëvizjes së krishterë në rritje duke iu kërkuar anëtarëve të vet që ta hidhnin poshtë Jezusin si Mesi (pra, *Tetëmbëdhjetë Bekimet*). Në këtë pikë (pra, 70 pas K.), të krishterët nisën të mblidheshin vetëm të dielën.

Shabat vjen nga një fjalë hebraisht që do të thotë “pushim” ose “ndalim”. Lidhet me ditën e shtatë të krijimit, ku Perëndia pushoi nga puna e vet pasi përfundoi krijimin e parë (shih Zan. 2:1-3). Perëndia nuk pushoi për shkak se ishte i lodhur, por për shkak se (1) krijimi ishte përfunduar dhe ishte i mirë (shih Zan. 1:31), dhe (2) për t’i dhënë njerëzimit një model të rregullt adhurimi dhe pushimi. Si gjithë ditët e tjera të Zan. 1, shabati fillon në muzg; prandaj, periudha zyrtare e shabatit ishte nga muzgu i së premtes deri në muzgun e së shtunës. Të gjitha hollësitë për kremtimin e shabatit jepen në librin e Eksodit (sidomos kapitujt 16, 20, 31 dhe 35) dhe atë të Levitikut (sidomos kapitujt 23-26). Farisenjtë i kishin marrë këto rregulla dhe, me anë të diskutimeve të tyre gojore, i kishin interpretuar për të përfshirë shumë rregulula të tjera. Jezusi kreu shpesh mrekulli, duke shkelur me dashje rregullat e tyre pedante në mënyrë që të hynte në debat me ta. Jezusi nuk hodhi poshtë apo përcmoi shabatit, por legalizmin arrogant dhe mungesën e dashurisë nga ana e tyre.

■ “sinagogë” Vjen nga një fjalë e përbërë greqisht, që fjalë për fjalë, do të thotë “mblidhemi së bashku”. Jezusi e kishte zakon që të merrte pjesë rregullisht në adhurim. Sinagoga u zhvillua si koncept në Mesopotami gjatë robërisë babilonase. Ishte vend adhurimi, arsimit dhe i mbrojtjes së kulturës judaike. Ishte shprehje lokale e besimit judaik, ashtu si tempulli ishte shprehja kombëtare e tij. Kishte të paktën një sinagogë në çdo qytet ku kishte të paktën dhjetë burra judenj.

■ “filloi t’i mësonte” Zakoni e donte që dikush nga bashkësia, ose një mik i shquar, të ftohetj për të udhëhequr pjesën e mësimin gjatë shërbesës së adhurimit. Zakonisht, lexohej një pasazh nga Torahu (pra, Zanafilla-Ligji i Përtërirë) dhe një pasazh nga Profetët (pra, Jozueu-Mbretërit dhe Isaia-Malakia).

1:22, 27 “mahniteshin” Fjalë për fjalë, ka kuptimin “u shtangën për të kushtuar vëmendje”. Stili dhe përmbajtja e mësimin të Jezusit ishin rrënjësisht të ndryshme nga ato të rabinëve. Ata citonin njëri-tjetrin si autoritete, kurse ai fliste me autoritetin e Perëndisë (shih Mat. 5:17-48). Mësimet dhe veprat e Jezusit shkaktonin mahnitje, shtangje, madje dhe frikë (shih Marku 1:22,27; 2:12; 5:42; 6:2,51; 7:37; 9:6,15; 10:26,32; 11:18; 14:33).

1:22 “jo si skribët” Jezusi nuk citonte traditat gojore (pra, Talmudin). Judenjtë kishin frikë mos shkelnin ndonjë urdhërim të Perëndisë, kështu që çdo varg i Torahut (shkrimet e Moisiut, Zanafilla-Ligji i Përtërirë) interpretohej me anë të diskutimeve rabinike. Më vonë, këto u zhvilluan në shkolla të ndryshme, njëra liberale (pra, Hileli), ndërsa tjetra konservatore (pra, Shamai). Rabinët kryesues të këtyre dy shkollave të lashta, shpesh, citoreshin si autoritete. Skribët ishin mësues profesionistë të judaizmit; ata e interpretonin traditën gojore për t’ua përshtatur situatave dhe nevojve të vendit dhe momentit. Shumica e skribëve në kohën e Jezusit ishin farisenj.

TEMË E VEÇANTË: SKRIBËT (SPECIAL TOPIC: SCRIBES)

Ky titull vjen nga një EMËR hebraisht (BDB 706, KB 767), që do të thotë “mesazh i folur”, “dokument/dekret i shkruar” (KB 766). Përkthimi grek *grammateus* (LXX), zakonisht, bën fjalë për një mesazh të shkruar. Mund të ketë kuptimin

1. Edukues (Nehemia 8)
2. Zyrtar qeveritar (2 Mbre. 22:3-13)
3. Shkrues/sekretar (1 Kr. 24:6; 2 Kro. 34:13; Jer. 36:22)
4. Oficer ushtarak (Gjyq. 5:14)
5. Drejtues fetar (p.sh., Ezra, te Ezra 7:6; Neh. 12:12-13)

Në DHR, skribët shoqërohen shpesh me farisenjtë (shih Tema e Veçantë: Farisenjtë). Në njëfarë kuptimi, ata ishin njerëz të arsimuar në DHV dhe në Traditat Gojore (p.sh., Talmudi). Ata ndihmonin në interpretimin dhe zbatimin e traditave judaike në jetën e përditshme (shih *Siraku* 39:6). Me sa duket, skribët quheshin edhe “juristë” (shih Marku 12:28; Luka 7:30; 10:25; 11:45; 14:3). Sidoqoftë, drejtësia e tyre (pra, legalizmi dhe rituali judaik) nuk mund të sillte paqe me Perëndinë (shih Mat. 5:20; Rom. 3:19-20; 9:1-5, 30-32; 10:1-6; Kol. 2:20-22).

Në ungjijtë sinoptikë, skribët përshkruhen shpesh (Gjoni s’i përmend asnjëherë; Gjoni 8:3 nuk është origjinal) si kundërshtarë të Jezusit; me sa duket, ata vinin si zyrtarë nga Jerusalemi (shih Marku 3:22; 7:1). Mirëpo disa prej tyre e pranuan (shih Mat. 8:19).

1. Konflikti për ngrënien me mëkatarët dhe me tagrambledhësit (Marku 2:16; Mat. 9:9-13)
2. Konflikti për burimin e autoritetit të Jezusit në dëbimet e demonëve (Marku 3:22)
3. Konflikti për faktin se Jezusi falte mëkatet (Mat. 9:3; Luka 5:21)
4. Kërkesa për një shenjë të jashtëzakonshme (Mat. 12:38)
5. Konflikti për larjen e duarve (pra, për larjet ceremoniale); Mat. 15:1-2; Marku 7:1-5
6. Konflikti për miratimin e turmave në hyrjen e tij ngadhënjyese në Jerusalem (Mat. 21:15)
7. Akuza që iu bëri Jezusi për motivet e tyre (pra, që kërkonin nderim dhe vend të parë); Marku 12:38-40
8. Akuza që iu bëri Jezusi ngaqë ishin hipokritë dhe udhërrëfyes të verbër që uleshin në ndenjësën e Moisiut (Mat. 23:1-36)

Për shkak se e njihnin Shkrimin, skribët duhet të ishin të parët që ta pranonin dhe ta përqaфонin Jezusin, por traditat e tyre (shih Isa. 29:13; 6:9-10) i patën verbuar! Kur drita bëhet errësirë, sa e madhe është errësira!

1:23 “një burrë...[me] një frymë të ndyrë” Ky ishte një rast pushtimi demoniak (shih Marku 1:34). Vini re se ai ende merrte pjesë në adhurim, sa për sy e faqe. DHR bën dallimin mes sëmundjes fizike dhe pushtimit demoniak, ndonëse, shpesh, këto të dyja mund të kenë të njëjtat simptoma. Në këto raste, demoni e vë nën kontroll personin, dhe ky i fundit e humbet vullnetin e vet. Botëkuptimi judaik pranonte praninë e qenive shpirtërore, të mira (Marku 1:13; Mat. 18:10; Veprat 12:15; 2 Mbre. 6:17) dhe të këqija (Marku 1:23,26,27; 3:11,20; 5:2,8,13; 6:7; 7:25), që ndikonin në jetën e njerëzve.

TEMË E VEÇANTË: DEMONIAKE (FRYMË E NDYRË) (SPECIAL TOPIC: THE DEMONIC [UNCLEAN SPIRITS])

- A. Popujt e lashtë ishin animistë. Ata u vishnin personalitet njerëzor forcave të natyrës, kafshëve dhe objekteve natyrore. Jeta shpjegohej përmes ndërveprimit të këtyre qenieve shpirtërore me njerëzimin.
- B. Ky personifikim u shndërrua në politeizëm (shumë perëndi). Zakonisht, demonët (*genii, xhindet*)

ishin perëndi më të ulëta ose gjysmëperëndi (të mirë ose të këqinj) që ndikonin në jetën e njeriut si individ.

1. Mesopotami, kaos dhe konflikt
2. Egjipt, rend dhe funksion
3. Kanaan, shih W. F. Albright, *Archaeology and the Religion of Israel* [Arkeologjia dhe feja e Izraelit], botimi i pestë, f. 67-92

C. DhV nuk flet shumë (dhe as zhvillon) për temën e perëndive më të ulëta, engjëjve, ose demonëve, ndoshta për shkak të monoteizmit të saj të rreptë (shih Eks. 8:10; 9:14; 15:11; LiP. 4:35,39; 6:4; 33:26; Psa. 35:10; 71:19; 86:8; Isa. 46:9; Jer. 10:6-7; Mik. 7:18). Gjithsesi, ajo përmend perënditë e rreme të kombeve pagane (*Shedim*, shih LiP. 32:17; Psa. 106:37), madje jep dhe emra për disa prej tyre.

1. *Se'im* (satirët ose demonët leshatakë, shih Lev. 17:7; 2 Kro. 11:15)
2. *Lilith* (demon femër, ose joshës, shih Isa. 34:14)
3. *Mavet* (fjalë hebraisht për vdekjen, që përdorej për perëndinë kanaanite të nënbotës, *Mot*, shih Isa. 28:15, 18; Jer. 9:21; dhe ndoshta LiP. 28:22)
4. *Reshef* (fatkeqësi, shih LiP. 32:24; Psa. 78:48; Hab. 3:5)
5. *Dever* (murtajë, shih Psa. 91:5-6; Hab. 3:5)
6. *Az'azel* (emri i paqartë, por, ndoshta, demon shkretëtire ose emër vendi, shih Lev. 16:8, 10, 26) (Këta shembuj janë marrë nga *Encyclopaedia Judaica*, vëll. 5, f. 1523.)

Gjithsesi nuk ka dualizëm apo pavarësi engjëllore nga JHVH në DhV. Satani është shërbëtor i JHVH-së (shih Jobi 1-2; Zakaria 3), jo një armik i pavarur, që e drejton vetë veten (shih A. B. Davidson, *A Theology of the Old Testament* [Teologji e Dhiatës së Vjetër], f. 300-306).

D. Judaizmi u zhvillua gjatë robërisë babilonase (586-538 para K.). Teologjikisht, u ndikua nga dualizmi i personifikuar persian i zoroastrianizmit, me një perëndi të mirë e të lartë, të quajtur *Mazda* ose *Ormazd*, dhe një kundërshtar të lig, të quajtur *Ahriman*. Kjo lejoi brenda judaizmit të pasrobërisë dualizmin e personifikuar mes JHVH-së e engjëjve të tij dhe Satanit e engjëjve (ose demonëve) të tij.

Teologjia e ligësisë së personifikuar në judaizëm shpjegohet dhe dokumentohet më së miri nga Alfred Edersheim, *The Life and Times of Jesus the Messiah* [Jeta dhe koha e Jezus Mesisë], vëll. 2, shtojca XIII (f. 749-863) dhe XVI (f. 770-776). Judaizmi e personifikonte ligësinë në tre mënyra.

1. Satani, ose Sammaeli
2. Synimi i lig (*jecer hara*) brenda njerëzimit.
3. Engjëlli i Vdekjes

Edersheim i karakterizon këta si (1) Akuzuesi; (2) Tunduesi; dhe (3) Ndëshkuesi (vëll. 2, f. 756). Ka një dallim të madh teologjik mes judaizmit pas robërisë dhe prezantimit e shpjegimit që i bën DhR ligësisë.

E. DhR, veçanërisht në ungjijtë, pohon ekzistencën dhe kundërshtimin e qenieve të këqija shpirtërore ndaj njerëzimit dhe JHVH-së (në judaizëm, Satani ishte armik i njerëzimit, por jo i Perëndisë). Ata i kundërvihen vullnetit, sundimit dhe mbretërisë së Perëndisë.

Jezusi i kundërshtoi dhe i dëboi nga njerëzit këto qenie demoniake, të quajtura edhe (1) frymë të liga (shih Luka 4:36; 6:18), ose (20 frymë të liga (shih Luka 7:21; 8:2). Jezusi bëri qartazi dallimin mes sëmundjes (fizike dhe mendore) dhe pushtimit demoniak. Ai e demonstroi fuqinë dhe njohurinë e vet shpirtërore duke dalluar dhe dëbuar këto frymë të liga. Shpesh, ata e njihnin dhe përpiqeshin t'i drejtoheshin atij, por Jezusi ua hidhte poshtë dëshminë e tyre, kërkonte që të heshtnin dhe i dëbonte. Dëbimet janë shenjë e disfatës së mbretërisë së Satanit.

Ka një mungesë të habitshme informacioni në letrat apostolike të DhR për këtë temë.

Dëbimi i demonëve nuk renditet kurrë si dhunti shpirtërore, dhe as nuk na jepet një metodologji apo procedurë për brezat e ardhshëm të predikuesve ose besimtarëve.

F. Ligësia është reale; ligësia është personale; ligësia është e pranishme. As origjina, as synimi i saj nuk na zbulohen. Bibla pohon realitetin e saj dhe kundërshton me forcë ndikimin e saj. Perëndia ka plotësisht situatën nën kontroll; ligësia mposhtet, gjykohet dhe do të shfaroset nga njerëzimi.

G. Populli i Perëndisë duhet ta kundërshtojë ligësinë (shih Jakobi 4:7). Ata nuk mund të kontrollohen prej saj (shih 1 Gjonit 5:18), por mund të tundohen dhe kjo mund t'u dëmtojë dëshminë dhe

ndikimin (shih Efe. 6:10-18). Ligësia është pjesë e zbuluar e pikëpamjes së të krishterit. Të krishterët e sotëm nuk kanë të drejtën të ripërcaktojnë ligësinë (çmitologjizimi i Rudolf Bultmann), të çpersonalizojnë ligësinë (strukturat shoqërore të Paul Tillich), apo të përpiqen ta shpjegojnë plotësisht me terma psikologjikë (Zigmund Frojd). Ndikimi i ligësisë është i gjerë, por ajo është mposhtur. Besimtarët duhet të ecin në fitoren e Krishtit!

1:24

NASB “Ç’punë kemi ne me njëri-tjetrin”

NKJV “Ç’lidhje kemi ne me ty”

NRSV “Ç’lidhje ke ti me ne”

TEV, NJB “Çfarë do prej nesh”

Fjalë për fjalë, kjo shprehje thotë: “çfarë mes nesh dhe ty”. Në *A Translator’s Handbook on the Gospel of Mark*, Bratcher dhe Nida vërejnë se: “në greqishten klasike, kjo frazë donte të thoshte ‘ç’kemi ne të përbashkët?’. Mirëpo, këtu ajo përkon me shprehjen hebraike ‘Pse fut hundët në punët e mia?’” (f. 49). Kjo idiomë ilustron në Gjyqtarët 11:12; 2 Sam. 16:10; 19:22; 1 Mbre. 17:18; 2 Kro. 35:12.

▣ **“Jezusi i Nazaretit”** Shih shënimin në Marku 10:47.

▣ **“Ke ardhur të na shkatërrosh”** Gramatikisht, kjo mund të jetë ose pyetje, ose pohim. Ishte shprehje armiqësie në DhV (shih Gjyq 11:12; 2 Sam. 16:10; 19:22; 1 Mbre. 17:18; 2 Mbre. 3:13; 2 Kro. 35:21). Ligësia e di se, një ditë, do të gjykohe!

▣ **“I Shenjti i Perëndisë”** Ky ishte titull mesianik nga DhV. Nuk ishte rrëfim i vullnetshëm, por përpjekje e përlllogaritur që t’i shkaktonin telashe Jezusit. Më vonë, Jezusi u akuzua se merrte pushtet nga Satani (shih Mat. 9:34; 12:24; Marku 3:22; Luka 11:15).

TEMË E VEÇANTË: I SHENJTI (SPECIAL TOPIC: THE HOLY ONE)

I. “I shenjti i Izraelit” është titull i preferuar i Hyjnisë në Isaia (shih Isa. 1:4; 5:19; 10:17,20; 12:6; 17:7; 29:19,23; 30:11,12,15; 31:1; 37:23; 40:25; 41:14,16,20; 43:3,14,15; 45:11; 47:4; 48:17; 49:7; 54:5; 55:5; 60:9,14). Për shkak se ai është “i shenjtë”, edhe populli i tij duhet të jetë i shenjtë (shih Lev. 19:2; Mat. 5:48; 1 Pje. 1:16).

Ky titull, në një farë kuptimi, shpreh tensionin e pamundur që një popull mëkatar dhe i rënë të zbatojë një standard të shenjtë. Besëlidhja e Moisiut ishte e pamundur të zbatohet (shih Joz. 24:19; Veprat 15; Gal. 3; Hebrejve). Besëlidhja e vjetër ishte një mënyrë për të treguar pamundësinë që njerëzit të përputhen me standardin e Perëndisë (Gal 3); gjithsesi ai ishte me ta, i mbronte dhe po i përgatiste për përgjigjen e tij për gjendjen e tyre të rënë (pra, “Besëlidhja e Re në Jezusin”). Ai nuk e ul standardin, por e siguron përmes Mesisë. Besëlidhja e re (shih Jer. 31:31-34; Ezek. 36:22-38) është besëlidhje besimi dhe pendimi, jo përpjekjeje njerëzore, ndonëse çon në ngjashmëri me Krishtin (shih Jakobi 2:14-26). Perëndia dëshiron një popull që pasqyron karakterin e tij para kombeve (shih Mat. 5:48).

II. “I Shenjti” mund t’i referohet

1. Perëndisë Atë (shih pasazhet e shumta në DhV për “të Shenjtin e Izraelit”)

2. Perëndisë Bir (shih Marku 1:24; Luka 4:34; Gjoni 6:69; Veprat 3:14)

3. Perëndisë Frymë (titulli i tij, “Fryma e Shenjtë”, shih Gjoni 1:33; 14:26; 20:22)

Veprat 10:38 është një varg ku të tre personat e Hyjnisë përfshihen në vajosje. Jezusi ishte i vajosur (shih Luka 4:18; Veprat 4:27; 10:38). Këtu, ky koncept zgjerohet për të përfshirë gjithë besimtarët (shih 1 Gjoni 2:27). I Vajosuri është shndërruar në të vajosurit! Kjo mund të jetë paralele me Antikrishtin dhe antikrishtët (shih 1 Gjoni 2:18). Akti simbolik i vajosjes fizike me vaj në DhV (shih Eks. 29:7; 30:25; 37:29) kryhej tek ata që ishin thirrur dhe pajisur nga Perëndia për një detyrë të veçantë (d.m.th., profetët, priftërinjtë dhe mbretërit). Fjala “Krisht” është përkthim i fjalës hebraishte “i vajosuri”, ose Mesia.

1:25 “Jezusi e qortoi” Marku e përdor këtë fjalë shpesh: (1) nganjëherë, për demonët (shih Marku 1:25; 3:2; 9:25); (2) për erën dhe detin (shih Marku 4:39); dhe (3) për vetë dishepujt e Jezusit (shih Marku 8:30, 33; 10:13).

▣ **“Hesht”** Kjo është urdhërore aoriste pësore, që do të thotë “Mbylle gojën me gojëz!” (shih Marku 4:39). Dy urdhrat që Jezusi i dha demonit janë fjalë të forta me ngjyrim negative.

▣ **“dil prej tij”** Kjo është urdhërore aoriste veprare.

TEMË E VEÇANTË: DËBIMI I DEMONËVE (SPECIAL TOPIC: EXORCISM)

Dëbimi i demonëve ishte i përhapur në kohën e Jezusit, por metodat e tij ishin rrënjësisht të ndryshme prej të tjerëve (shih Mat. 8:16; Marku 1:27). Dëbimet që iu bënte ai demonëve ishin shenjë e Epokës së Re (shih Luka 9:1). Rabinët (shih Mat. 12:27; Veprat 19:13) përdornin formula magjike (shih Alfred Edersheim, *The Life and Times of Jesus the Messiah*, vëll. 2, Shtojca XIII, f. 748-763; XVI, f. 770-776), kurse Jezusi përdorte autoritetin e vet. Sot, qarkullojnë shumë të dhëna pështjelluese dhe të gabuara në lidhje me dëbimin e demonëve dhe natyrën demoniake. Pjesë e këtij problemi është fakti se DHR nuk diskuton për këto çështje. Si pastor, do të doja të kisha më tepër informacion për këtë temë. Më poshtë, ju rendis disa libra të besueshëm.

1. *Christian Counseling and the Occult*, Kurt E. Koch
2. *Demons in the World Today*, Merrill F. Unger
3. *Biblical Demonology*, Merrill F. Unger
4. *Principalities and Powers*, John Warwick Montgomery
5. *Christ and the Powers*, Hendrik Berkhof
6. *Three Crucial Questions About Spiritual Warfare*, Clinton Anton

Habitem që dëbimi i demonëve nuk renditet si një nga dhuntitë shpirtërore në letrat e apostujve, madje kjo temë as nuk diskutohet fare. Unë besoj në botëkuptimin biblik, i cili thotë se bota shpirtërore (pra, e mira dhe e liga) është e pranishme dhe vepruese në botën fizike (shih Jobi 1-2; Danieli 10; Efe. 6:10-18). Sidoqoftë, Perëndia ka zgjedhur që të mos na i zbulojë hollësitë e kësaj çështjeje. Si besimtarë, kemi gjithë informacionet e nevojshme për të jetuar në mënyrë të perëndishme dhe të frytshme për të! Por disa tema nuk na zbulohen apo zhvillohen plotësisht. Besimtarët duhet të mos harrojnë se dëbimi i demonëve është provë e dukshme e fitores së Jezusit mbi ligësinë (shih Luka 10:17-20). DHV bën dallimin e qartë mes dëbimit të demonëve dhe shërimit (shih Mat. 8:16; Marku 1:32; Luka 4:40-41).

Shih Temat e Veçanta:

1. Tema e Veçantë: Satani
2. Tema e Veçantë: Ligësia personale
3. Tema e Veçantë: Demoniakja në DHV
4. Tema e Veçantë Demoniakja në DHR

1:26 Ungjijtë na tregojnë për një sërë shfaqjesh fizike të frymëve të liga kur largoheshin nga njeriu (shih Marku 1:26; 9:26; Luka 9:39). Ndoshta, kjo ishte një mënyrë si vërtetohej se fryma largohej vërtet.

Kjo shenjë e parë fuqie tregon qartë pretendimet mesianike të Jezusit. Titulli i DHV (shih Psa. 16:10) me të cilin demonët e pranojnë Jezusin dhe fuqinë e tij për t'i bërë zap dhe për t'i gjykuar reflekton qartë autoritetin shpirtëror të Jezusit të Nazaretit (shih Marku 1:27c). Ky rrëfim gjendet edhe te Luka 4:31-37.

1:27 “Ç’është kjo? Një mësim i ri me autoritet” Fjala greke “i ri” (pra, *kainos*) do të thotë “i ri në kuptimin e cilësisë”, jo “i ri në kuptimin kohor”. Frazja “me autoritet” ndoshta ka parasysh mësimin e Jezusit (shih Mat. 7:29; NASB, NRSV, NJB), ose urdhrin e Jezusit (shih Luka 4:36; NKJB, TEV). Meqë Luka 4:36 përbën një paralel të drejtpërdrejtë me këtë varg, mundësia e dyte duket si më e pranueshme.

Burimi i autoritetit të Jezusit do të bëhej problem kryesor mes Jezusit dhe drejtuesve judenj (shih Marku 11:28; Mat. 21:23; Luka 20:2). Ata s’ia mohonin dot fuqinë, kështu që ia vunë në dyshimin burimin. Ky ishte mëkati i pafalshëm!

1:12 “Menjëherë” Shih shënimin në Marku 1:10.

▣ **“lajmi për të u përhap kudo”** Ky lloj dëbimi demonësh duhet të jetë treguar e ritreguar vazhdimisht.

TEKSTI I NASB (I PËRDITËSUAR): MARKU 1:29-31

²⁹Dhe menjëherë pasi dolën nga sinagoga, hynë në shtëpinë e Simonit dhe Andreas, bashkë me Jakobin dhe Gjonin. ³⁰Dhe vjehrra e Simonit dergjej e sëmurë me ethe; dhe, menjëherë, ata i folën Jezusit për të. ³¹Dhe ai shkoi tek ajo, e ngriti duke e marrë për dorë, dhe ethet e lanë dhe po iu shërbente.

1:30 “vjehrra e Simonit” Kjo tregon se Pjetri ishte i martuar. Gruaja e tij nuk përmendet kurrë në DHR. Ndoshta, mund t’i kishte vdekur, por 1 Kor. 9:5 nënkupton se ajo udhëtonte me Pjetrin. Kjo ndodhi gjendet edhe te Luka 4:31-37 dhe Mat. 8:14-17.

▣ **“dergjej e sëmurë”** Kjo është në kohën e pakryer, që tregon veprim të vazhduar në të shkuarën. Kishte disa kohë që ishte sëmurur.

▣ **“me ethe”** Fjala për fjalë, “e goditur nga ethet”. Kjo është në kohën e tashme, që nënkupton një problem të vazhdueshëm. Vini re se kjo sëmundje nuk lidhet me pushtimin demoniak (shih Marku 1:32). Fuqia e Jezusit mbi sëmundjen është një tjetër shenjë e natyrës dhe misionit të tij mesianik. Siç ndodh shpesh në ungjijtë, mrekullitë e Jezusit vlenin jo vetëm për atë që shërohej, por edhe për dishepujt, Jezusi po e zbulon qartazi veten para apostujve të tij të sapozgjedhur. Këtu, ai vepron me dhembshuri ditën e shtunë. Kjo duhet të ketë qenë tronditëse për këta burra judenj.

TEKSTI I NASB (I PËRDITËSUAR): MARKU 1:32-34

³²Kur erdhi darka, pas perëndimit të diellit, filluan t’i sillnin atij të gjithë ata që ishin të sëmurë dhe ata që ishin të pushtuar nga demonët. ³³Dhe gjithë qyteti iu mblodh te dera. ³⁴Dhe ai shëroi shumë që ishin të sëmurë nga lëngata të ndryshme, dhe dëboi shumë demonë; dhe nuk i lejonte demonët të flisnin, sepse e dinin kush ishte.

1:32 “Kur erdhi darka” Me sa duket, kjo ndodhi pas muzgut, kështu që shabati kishte përfunduar zyrtarisht dhe, tani, shërimet fizike ishin të lejuara nga ana rabinike.

▣ **“filluan t’i sillnin”** Kjo është në kohën e pakryer, që do të thotë “po mbartnin vazhdimisht” të sëmurë. Jezusi nuk donte ta njihnin si mrekullibërës, por si shpallës të së vërtetës (shih Luka 4:43), mirëpo fjala u përhap gjithsesi (shih Marku 1:28).

▣ **“të sëmurë”** Vargu 32 nënkupton se “të gjithë” ata që ishin të sëmurë ose të pushtuar nga demonët në gjithë qytetin u sollën të Jezusi. Vargu 34 thotë se ai shëroi ose çliroi “shumë” prej tyre, por jo të gjithë. Është interesante se fjalët “të gjithë” dhe “shumë” shpesh përdoren në mënyrë sinonimike në Bibël (shih Isaia 53:6 në krahasim 53:11,12 dhe Rom. 5:18, në krahasim me v. 19). Është e paqartë nëse Jezusi i shëroi të gjithë ata që i sollën, apo shumë prej tyre. Në pellgun e Betezdës në Jerusalem, thuhet se Jezusi shëroi vetëm njërin nga të sëmurët e shumtë. Jezusi nuk kërkonte medoemos çdo rast për të shëruar njerëzit, por nëse përballej me situatën e duhur (p.sh., kur donte t’iu mësonte diçka dishepujve dhe të tregonte dhembshuri ndaj të lënduarve dhe nevojtarëve), ai vepronte me fuqi. Jezusi bënte gjithçka për hir të ungjillizimit (p.sh., gruaja samaritane, shih Gjoni 4, sidomos Marku 1:4). Shërimi ishte shenjë, kurse ungjillizimi ishte synimi dhe fokusi i shërbesës së tij.

Ka njëfarë përshtjellimi në lidhje me metodologjinë e Jezusit për shërimin; nganjëherë, shërimi varet nga përgjigjja me besim e të sëmurit; herë të tjera, nga besimi i njerit prej miqve ose të dashurve të tij; shpesh, shërimi ndodh me qëllim që Jezusi të tregojë pushtetin e vet, pavarësisht besimit nga ana e marrësit. Shpëtimi nuk shoqëron automatikisht çlirimin ose shërimin fizik.

▣ **“ata që ishin të pushtuar nga demonët”** Vini re dallimin mes sëmundjes dhe pushtimit demoniak.

1:33 Këta banorë ishin kureshtarë, ndërsa disa ishin të dëshpëruar për shërim fizik dhe plotësim shpirtëror.

1:34 “ai shëroi shumë” Ky varg është i pari i shumë të tillëve në Marku (shih Marku 1:34, 43-44; 3:12; 4:11; 5:43; 7:24, 36; 8:26, 30; 9:9), që shpesh janë quajtur “sekreti mesianik i Markut”. Jezusi u thotë dishepujve dhe atyre që shëron që të mos flasin për veprat e tij shëruese. Jezusi nuk donte që ta njihnin thjesht si shërues ose mrekullibërës. Këto ishin vetëm shenja që tregonin për natyrën e tij mesianike, gjë që, në këtë pikë të jetës së tij, nuk ishte zbuluar ende plotësisht. Jezusi erdhi (1) për të zbuluar Atin; (2) për ta ofruar veten si flijim për mëkatin; dhe (3) për t’u dhënë besimtarëve një shembull që ta ndjekin. Shërimet dhe çlirimet ishin vetëm shenja të dhembshurisë së tij për të dobëtit, të sëmurët dhe të përjashtuarit. Kjo ishte dhe një shenjë e parashikuar në DHV për shërbesën e Mesisë (shih Isa. 61:1).

▣ **“nuk i lejonte demonët të flisnin”** Kjo është në kohën e pakryer, që nënkupton një sërë dëbimesh demoniake (shih Marku 1:24). Shih Temën e Veçantë “Demoniake” në Marku 1:24.

TEKSTI I NASB (I PËRDITËSUAR): MARKU 1:35-39

³⁵Në mëngjes herët, ndërsa ishte ende errësirë, Jezusi u ngrit, doli nga shtëpia dhe shkoi në një vend të veçuar, dhe po lutej aty. ³⁶Simoni dhe shokët po e kërkonin; ³⁷e gjetën dhe i thanë: “Të gjithë po të kërkojnë”. ³⁸Ai iu tha: “Le të shkojmë diku tjetër në qytetet këtu pranë, që të predikoj dhe aty; sepse për këtë erdha”. ³⁹Dhe hynte në sinagogat e tyre anekënd Galileës, duke predikuar dhe duke dëbuar demonët.

1:35 “Në mëngjes herët, ndërsa ishte ende errësirë” Bëhet fjalë për rojen e fundit të natës, dikur mes 3:00 dhe 6:00 të mëngjesit.

▣ **“po lutej aty”** Kjo është në kohën e pakryer; pra, tregon jetën e rregullt shpirtërore të Jezusit. Në ungjillin e Lukës, ky theks përsëritet shpesh. Në Marku ka vetëm tre shembuj ku Jezusi lutet: këtu, në ushqyerjen e pesë mijëve (shih Marku 8:6) dhe në Gjetseman (shih Marku 14:32-42).

1:37-39 Njerëzi po e kërkonin Jezusin sepse ai i shëronte, jo për shkak të mësimin të tij (shih Luka 4:43). Jezusi është vazhdimisht në lëvizje sepse (1) donte që të gjithë ta dëgjonin mesazhin e tij dhe (2) për shkak se ia keqkuptonin misionin.

1:38

NASB “sepse për këtë erdha”
NKJV “sepse për këtë qëllim kam ardhur”
NRSV “sepse këtë erdha të bëj”
TEV, NJB “sepse për këtë shkak erdha”

Jezusi e kuptonte plotësisht se ishte dërguar (shih Luka 4:43) për të shpallur ungjillin e Perëndisë (shih Marku 1:14-15). E dinte se nuk ishte dërguar si mrekullibërës ose shërues, por si themeluesi i një dite të re, një marrëdhënieje të re me Atin, për inaugurimin e mbretërisë së Perëndisë! Rëndësia qendrore e personalitetit të tij, përmbajtja e mesazhit të tij, veprat e tij shpenguese dhe ringjallja dhe ngritja e tij e lavdishme në qiell ishin fokusi i mesazhit të Jezusit. Sekreti Mesianik i Markut është një mënyrë letrare për të theksuar se këto gjëra do të kuptoheshin ose zbuloheshin plotësisht vetëm vite më vonë.

1:39 Në Marku 1:39 gjendet një variant tekstual. Disa dorëshkrime të lashta greke lexojnë “hynte” (p.sh., Sinaitiku, B, L, versioni siriak dhe përkthimet koptike, si dhe NASB, NRSV, TEV, NJB), ndërsa disa dorëshkrimet unciale greke, A, C, D, W, përkthimet e Vulgatës dhe Peshitës, si dhe teksti greqisht i përdorur nga Augustini lexojnë “ishte” (NKJV). *The Textual Commentary on the Greek New Testament*, nga Bruce Metzger, f. 75-76, thotë se një kopjues e ndryshoi “hynte” për ta përshtatur me Lukën 4:44. Ky është shembull i faktit se shumica e ndryshimeve në dorëshkrimet greqisht nuk bëjnë asnjë dallim të rëndësishëm teologjik ose historik për kuptimin e plotë të pasazhit.

TEKSTI I NASB (I PËRDITËSUAR): MARKU 1:40-45

⁴⁰Dhe një i lebrosur erdhi te Jezusi, duke iu përgjëruar dhe duke rënë në gjunjë para tij, dhe duke i thënë: “Nëse ke dëshirë, ti mund të më pastrosh”. ⁴¹I mbushur me dhembshuri, Jezusi shtriu dorën, e preku dhe i tha: “Dua; pastrohu”. ⁴²Menjëherë, lebroza e la dhe ai u pastrua. ⁴³Dhe Jezusi e

paralajmëroi rreptësisht dhe e largoi menjëherë, ⁴⁴dhe i tha: “Mos i trego asgjë askujt; por shko, paraqitu te prifti dhe ofro për pastrimin tënd atë që urdhëroi Moisiu, si dëshmi për ta”. ⁴⁵Por ai doli dhe filloi ta shpallte lirisht dhe ta përhapte lajmin kudo, deri në atë masë sa që Jezusi nuk mund të hynte më hapur në qytete, por qëndronte në zona të pabanuara; dhe ata i vinin nga të gjitha anët.

1:40 “i lebrosur” Kjo histori gjendet dhe te Mat. 8:2-4 dhe Luka 5:12-16. Judaizmi e konsideronte lebrozën sëmundje që e dërgonte Perëndia (shih 2 Kro. 26:16-21). Kontakti me lebrozin të bënte ceremonialisht të ndotur. Kjo sëmundje nënkuptonte izolim të plotë nga shoqëria! Është e habitshme nga ana kulturore që ky njeri i përjashtuar nga shoqëria iu afrua Jezusit dhe që Jezusi e preku (shih Marku 1:41). Sëmundja e DHV e quajtur lebrozë, e diskutuar në Lev. 13-14, përshkruan shumë lloj sëmundje lëkure, ku të gjitha e përjashtonin njeriun nga adhurimi.

▣ **“në gjunjë”** Në Luka 5:12, thuhet se ai u shtri përpara Jezusit. Jezusi nuk ishte si rabinët e tjerë. Ai donte t’ia dinte për të përjashtuarit dhe të izoluarit nga shoqëria.

▣ **“Nëse ke dëshirë, mund të më pastrosh”** Kjo është fjali kushtore e klasit të tretë, që nënkupton veprim të mundshëm. Ai nuk e vë në dyshim fuqinë e Jezusit (p.sh., lebrozi e quan Jezusin “Zot” në Mat. 8:2), por dëshirën e tij për të vepruar.

1:41 “I mbushur me dhembshuri” Jezusi ka dhembshuri për njerëzimin e krijuar në shëmbëllimin e Perëndisë. Teksti perëndimor, dorëshkrimi D, lexon “me zemërim”, por dorëshkrimet Sinaïtiku, A, B, dhe C lexojnë “me dhembshuri”. Këto fjalë gjenden edhe në armaisht. Ndonëse dorëshkrimet më të vjetra dhe më të mira lexojnë “dhembshuri”, leximi më i pazakontë do të kishte qenë “me zemërim” ose “i zemëruar”. Shih Shtojcën Dy “Kritika e Tekstit”. Ka disa pasazhe te Marku ku zemërimi i Jezusit përmendet në kontekste të papritura (shih Marku 1:43; 3:5 dhe 10:14; dhe një herë te Gjoni 11:33, 38). Zemërimi i tij drejtohej ndaj sëmundjes, ose ndaj ligësisë së kësaj epoke.

Marku e portretizon Jezusin si plotësisht njerëzor; si njeri që ndien dhe shpreh gjithë gamën e ndjenjave njerëzore, për vete si dhe për të tjerët.

1. Dhembshuri ose zemërim (Marku 1:41; 3:5)
2. Uri fizike (Marku 2:25)
3. Psherëtimë e thellë (Marku 7:34; 8:12)
4. Indinjatë/rreptësi (Marku 10:14)
5. Dashuri (Marku 10:21)
6. Trishtim/shqetësim (Marku 10:33-34)
7. Braktisje (Marku 15:34)
8. Etje (Marku 15:36)

▣ **“e preku”** Ky veprim ishte rreptësisht i ndaluar nga ana ceremoniale! Jezusi që prek njerëzit është një ndodhi që shfaqet shpesh në ungjijtë (p.sh., Marku 7:33; 8:22; 10:13; si dhe shumë herë kur njerëzit e preknin Jezusin; Marku 30:10; 5:22-28, 30, 31; 6:56) si gjest përkujdesjeje dhe preokupimi personal.

▣ **“ji i pastruar”** Kjo është urdhërore aoriste pësore. Jezusi shëron me të njëjtin autoritet personal me të cilin dëbon dhe demonët.

1:43 “e paralajmëroi rreptësisht” Fjalë për fjalë, “shfryu”, që nënkupton një psherëtimë pa zë. Kjo pasqyron Sekretin Mesianik të Markut. Ungjilli nuk ishte përfunduar ende, dhe mesazhi ishte ende i paplotë. Jezusi nuk donte që ta njihnin si mrekullibërës.

▣ **“e largoi menjëherë”** Kjo është e njëjta fjalë e fortë që u përdor kur Fryma e shtyu Jezusin në shkretëtirë (shih Marku 1:12).

1:44 “ofro për pastrimin tënd atë që urdhëroi Moisiu” Kjo kërkesë kishte të bënte me shërimin e dikujt nga lebroza (shih Lev. 13, 14; LiP. 24:8). Jezusi nuk e hidhte poshtë DHV (shih Mat. 5:17-19), por traditat gojore që ishin zhvilluar brenda judaizmit (shih Mat. 5:21-48). Ndoshta, kjo do të shërbente si dëshmi edhe për priftërinjtë.

1:45 “ta shpallte” Kjo është paskajore e tashme. Tregon mosbindje të drejtpërdrejtë ndaj urdhrit të prerë të Jezusit (shih Marku 1:43-44).

■ **“qëndronte në zona të pabanuara”** Bëhet fjalë për kullotat e pabanuara si te Marku 1:3.

PYETJE PËR DISKUTIM

Ky është një komentari studimor udhëzues, që do të thotë se ti je vetë përgjegjës për interpretimin e Biblës. Secili prej nesh duhet të ecë sipas dritës që ka. Ti, Bibla dhe Fryma e Shenjtë keni përparësi në interpretim. Nuk duhet t’ia dorëzosh këtë të drejtë komentuesit.

Këto pyetje për diskutim t’i kam dhënë për të të ndihmuar që të analizosh çështjet kryesore të kësaj pjese të librit. Ato synojnë të të nxisin mendimin, jo të kenë natyrë shteruese.

1. Pse Marku nis me shërbesën e Gjon Pagëzorit? Kë përfaqëson Gjoni?
2. A jep pagëzimi falje, apo vetëm e simbolizon?
3. Pse u pagëzua Jezusi? A ishte mëkatar që të kishte nevojë për pendim?
4. Ku nënkuptohen në këtë pjesë të dhëna për Trininë?
5. Pse u tundua Jezusi? Në ç’zona të jetës i erdhi tundimi?
6. A është këtu mbretëria e Perëndisë, apo do të vijë në të ardhmen?
7. A përshkruan Marku 1 takimin e parë mes Jezusit dhe peshkatarëve?
8. Pse u habitën kaq shumë njerëzit në sinagogën e Kapernaumit me mësimet e Jezusit?
9. Çfarë është pushtimi demoniak: realitet, apo besëtytni kulturore?
10. Pse e zbuluan demonët se kush ishte Jezusi në të vërtetë?
11. Pse është kaq domethënës pastrimi të lebrosurit?
12. Pse e urdhëroi Jezusi të lebrosurin që të mos i tregonte askujt se çfarë i kishte ndodhur?

MARKU 2

NDARJET NË PARAGRAFË TË PËRKTHIMEVE MODERNE

UBS ⁴	NKJV	NRSV	TEV	NJB
Shërimi i të paralizuarit 2:1-12	Jezusi fal dhe shëron të paralizuarin 2:1-12	Shërimi i të paralizuarit 2:1-12	Jezusi shëron burrin e paralizuar 2:1-5 2:6-7 2:8-11 2:12	Shërimi i të paralizuarit 2:1-12
Thirrja e Levit 2:13-17	Tagrambledhësi Mate 2:13-17	Thirrja e Levit 2:13-14 2:15-17	Jezusi thërret Levin 2:13-14 2:15-16 2:15-17	Thirrja e Levit 2:13-14 Ngrënia me mëkatarët 2:15-17
Pyetjet për agjërimin 2:18-20 2:21-22	Jezusin e pyesin për agjërimin 2:18-22	Agjërimi 2:18-20 2:21-22	Pyetja për agjërimin 2:18 2:19-20 2:21-22	Diskutimi për agjërimin 2:18-22
Këputja e kallinjve të grurit në shabat 2:23-28	Jezusi është Zoti i shabatit 2:23-28	Jezusi dhe ligjet e shabatit 2:23-28	Pyetja për shabatit 2:23-24 2:25-26 2:27-28	Këputja e kallinjve në shabat 2:23-26 2:27-28

CIKLI TRE I LEXIMIT (shih f. v)

NDJEKJA E SYNIMIT TË AUTORIT FILLESTAR NË NIVELIN E PARAGRAFËVE

Ky është një komentari studimor udhëzues, që do të thotë se ti je vetë përgjegjës për interpretimin e Biblës. Secili prej nesh duhet të ecë sipas dritës që ka. Ti, Bibla dhe Fryma e Shenjtë keni përparësi në interpretim. Nuk duhet t'ia dorëzosh këtë të drejtë komentuesit.

Lexo gjithë kapitullin njëherësh. Identifiko temat. Krahaso ndarjet e tua tematike me pesë përkthimet moderne. Ndarja në paragrafë nuk është e frymëzuar, por është çelësi për të ndjekur synimin e autorit fillestar, gjë që është thelbi i interpretimit. Secili paragraf ka vetëm një temë të vetme.

1. Paragrafi i parë
2. Paragrafi i dytë
3. Paragrafi i tretë
4. Etj.

MËSIMET KONTEKSTUALE

- A. Marku 2:1-3:6 tregon katër ndodhi gjatë turneut predikues që përmendet në Marku 1:38-39.
 1. një shërim (Marku 2:1-12)
 2. afrimi i një grupi të përjashtuar nga populli (Marku 2:13-17)
 3. një pyetje për agjërimin (Marku 2:18-20)

4. një polemikë për traditën gojore (Marku 2:23-38)

B. Marku 2:1-3:6 është një njësi letrare. Nxjerr në pah kundërshtimin gjithnjë e më të madh të Jezusit nga institucionet që ruanin statukuonë fetare. Vetë Jezusi veprimi në kundërshtim me traditën gojore Pra, Talmudin) me qëllim që të niste një dialog teologjik me krerët fetarë. Vini re përsëritjen e fjalës “pse” (Marku 2:7, 16, 18, 24).

C. Paralelet:

1. Marku 2:1-12 – Mat. 9:1-8; Luka 5:12-26
2. Marku 2:13-17 – Mat. 9:9-13; Luka 5:27-31
3. Marku 2:18-22 – Mat. 9:14-17; Luka 5:33-39
4. Marku 2:23-25 – Mat. 12:1-8; Luka 6:1-5

D. Jezusi erdhi për të zbuluar Atin. Judaizmi e kishte fshehur atë pas ritualesh dhe rregullash. Jezusi demaskon anësinë dhe axhendën e krerëve fetarë në konfliktet që pati me ta në ungjillin e Markut. Këto çështje përcaktojnë deallimet mes judaizmit rabinik dhe lirisë së besëlidhjes së re, si dhe fesë së vërtetë, në Jezusin.

1. Autoriteti i Jezusit për të falur mëkatet (Marku 2:1-12)
2. domosdoshmëria e agjërimit (Marku 2:18-22)
3. domosdoshmëria e zbatimit të rregullave të shabatit (Marku 2:23-28)
4. domosdoshmëria e ligjeve ceremoniale (Marku 7:1-8)
5. çështja e divorcit (Marku 10:2-9)
6. pagimi i taksave për Romën (Marku 12:13-17)
7. natyra e ringjalljes (Marku 12:18-27)
8. urdhërimi më i madh (Marku 12:28-34)

STUDIMI I FJALËVE DHE FRAZAVE

TEKSTI I NASB (I PËRDITËSUAR): MARKU 2:1-12

¹Kur u kthye në Kapernaum pas disa ditësh, dëgjuan se ishte në shtëpi. ²Dhe shumë u mblodhën, aq sa s’kishte më vend, madje as pranë derës; dhe ai u predikonte fjalën. ³Dhe erdhën e i sollën një të paralizuar, që e mbanin katër burra. ⁴Meqë s’arrinin dot tek ai për shkak të turmës, ata hoqën çatinë mbi të; dhe, pasi hapën një vrimë, lëshuan vigun në të cilin dergjej i paralizuari. ⁵Kur pa besimin e tyre, Jezusi i tha të paralizuarit: “Bir, mëkatet të janë falur”. ⁶Por disa nga skribët ishin ulur dhe po arsyetonin në zemrën e tyre: ⁷Pse flet kështu ky njeri? Ai po blasfemon: kush mund t’i falë mëkatet përveç Perëndisë?” ⁸Menjëherë, Jezusi, i vetëdijshëm në frymë se ata po arsyetonin ashtu brenda vetes, u tha: “Pse po arsyetoni për këto gjëra në zemrën tuaj? ⁹Çfarë është më e lehtë: t’i thuash të paralizuarit, ‘mëkatet të janë falur’, apo t’i thuash, ‘Ngrihu, merr vigun dhe ec’?” ¹⁰Por, që ta dini se Biri i Njeriut ka autoritet në tokë për të falur mëkatet”—dhe i tha të paralizuarit, ¹¹“Unë po të them, ngrihu, merr vigun dhe shko në shtëpi”. ¹²Dhe ai u ngrit dhe menjëherë mori vigun dhe doli në sytë e të gjithë, aq sa të gjithë u mrekulluan dhe po lavdëronin Perëndinë duke thënë: “Kurrë s’kishim parë diçka të tillë”.

2:1 “Kapernaum” Ky emër do të thotë “fshati i Nahumit”. Për shkak të mungesës së besimit të Nazaretit, Jezusi e bëri këtë qytet në Galile bazë të vet (shih Marku 4:13). Ndodhej në një rrugë kryesore karavanësh nga Damasku në Egjipt. Për diskutime të mëtejshme, shih *Cities of the Biblical World*, nga Moine F. DeVries, f. 269-275.

▣ **“dëgjuan”** Nami i Jezusit bënte që shumë njerëz të vinin dhe ta takonin (p.sh., të sëmuret, kureshtarët, kërkuesit e vërtetë dhe krerët fetarë). Fjalët e Jezusit, shpesh, u drejtoheshin grupeve të ndryshëm të dëgjuesve, por zakonisht nuk na thuhet se për cilin grup bëhet fjalë.

▣ **“ishte në shtëpi”** Është e paqartë nëse kjo ishte shtëpia e Pjetrit, apo e Marisë.

2:2 “shumë u mblodhën” Në shoqëritë lindore, dera e hapur nënkuptonte “hyni brenda”; dhe ashtu bënë njerëzit.

■ **“sa s’kishte më vend, madje as pranë derës”** Shtëpia mund të ketë patur një oborr të vogël, por gjithsesi, nuk mbante dot shumë njerëz.

■ **“ai u predikonte fjalën”** Kjo është dëftore e pakryer veprorë, që mund të kuptohet si (1) fillimi i një veprimi, ose (2) si përsëritja e një veprimi. “Fjala” ishte mesazhi i përsëritur i Jezusit, i shprehur te Marku 1:14-15. Shenjat dhe veprimet e tij ndryshonin; por thelbi qendror i mesazhit mbetej i njëjti.

2:3 “i paralizuar” Kjo fjalë e përbërë është formuar nga “zgjidh” dhe “përbri”. Ndoshta, ai ishte viktimë e ndonjë goditjeje në tru, i paralizuar nga njëra anë. Veprimet e Jezusit kishin synim të dyfishtë: (1) të përmbushnin profecinë mesianike të Isa. 61:6 dhe (2) të shpallnin natyrën dhe autoritetin e tij hyjnor duke falur mëkatet. Për ata që kishin sy shpirtërorë, kjo ishte shenjë e qartë dhe e pagabueshme!

2:4 “hoqën çatinë” Fjalë për fjalë, “shqitën çatinë”. Në çati mund të hipje nga rruga dhe, shpesh, përdorëshin si vende festash shoqërore. Zakonisht, ishin të sheshta, të bëra me baltë, degë dhe bar. Luka 5:19 thotë “tjegulla”, që mund të nënkuptojë një oborr. E përfytyroni dot Jezusin duke u përpjekur të jepte mësim, ndërsa mbi kokën e të gjithëve binin copëza çatie?

■ **“vigun”** Ky ishte një rrogëz i vogël prej kashte, që përdorej për të fjetur.

2:6 “besimin e tyre” Jezusi pa besimin e shokëve, si dhe atë të të paralizuarit, dhe iu përgjigj atij besimi.

■ **“mëkatet të janë falur”** Ndoshta, ky mund të ketë qenë provokim i qëllimshëm drejtuar krerëve fetarë që ishin të pranishëm. Por Jezusi edhe po inkurajonte besimin e atij burri. Judenjtë besonin se kishte një lidhje mes mëkatit dhe sëmundjes (shih Jobi; Gjoni 9:2; Jakobi 5:15-16). Ky njeri ndoshta ishte i shqetësuar se paraliza e tij lidhej me ndonjë mëkat.

Teksti i UBS4 ka formën dëftore të tashme pësore. Disa dorëshkrime greke kanë dëftoren e kryer pësore (shih P88, Sinaitiku, A, C, D, L, W), njësoj si Luka 5:20. Mirëpo Mat. 9:2 dhe dorëshkrimi B kanë dëftoren e tashme pësore. Është e vështirë të vendosësh se cila prej këtyre dy mundësive është origjinalja.

2:6 “skribët” Këta ishin ekspertë në ligjin gojor dhe të shkruar. Ata ishin ose (1) delegacion zyrtar nga Jerusalemi, të dërguar për të vëzhguar Jezusin, ose (2) interpretues lokalë të traditave judaike për popullin e qyteteve të tyre. Duhet të kenë shkruar herët që të arrinin të futeshin në shtëpi, ose ndoshta prisnin që të tjrëet t’u hapnin vend të uleshin përpara, për shkak të statusit të tyre shoqëror. Shih Tema e Veçantë: Skribët, Marku 1:22.

NASB, NKJV “po arsyetonin në zemrën e tyre”

NRSV “po dyshonin në zemrën e tyre”

TEV, NJB “po thoshin me vete”

Pyetja teologjike është kjo: a ua lexoi Jezusi mendimet, duke dhënë kështu një tjetër provë të natyrës së tij hyjnore (shih 1 Sam. 16:7; Psa. 7:9; 139:1-4; Fja. 16:2; 21:2; 24:12; Jer. 11:20; 17:10; 20:12; Luka 16:15; Acts 15:8; Heb. 4:12), apo ua dinte traditat dhe ua shihte shprehjen që kishin në fytyrë?

Vetë kjo (shih Marku 2:8) mund të ketë qenë një tjetër shenjë. Rabinët e interpretonin Isa. 11:3 duke thënë se Mesia do të ishte në gjendje që të dallonte mendimet e njerëzve.

TEMË E VEÇANTË: ZEMRA (SPECIAL TOPIC: THE HEART)

Fjala greke *kardia* përdoret në Septuagintë dhe në DhR për të pasqyruar fjalën hebraisht *lēb* (BDB 523). Ajo përdoret në disa mënyra (shih Bauer, Arndt, Gingrich dhe Danker, *A Greek-English Lexicon [Leksik greqisht-anglisht]*, f. 403-404).

1. qendra e jetës fizike, një metaforë për individin (shih Veprat 14:17; 2 Kor. 3:2-3; Jakobi 5:5)
2. qendra e jetës shpirtërore (pra, morale)
 - a. Perëndia njeh zemrën (shih Luka 16:15; Rom. 8:27; 1 Kor. 14:25; 1 Thes. 2:4; Zbu. 2:23)
 - b. përdoret për jetën shpirtërore të njerëzimit (shih Mat. 15:18-19; 18:35; Rom. 6:17; 1 Tim. 1:5; 2 Tim. 2:22; 1 Pjet. 1:22)
3. qendra e jetës mendore (pra, intelekti, shih Mat. 13:15; 24:48; Veprat 7:23; 16:14; 28:27; Rom.

1:21; 10:6; 16:18; 2 Kor. 4:6; Efe. 1:18; 4:18; Jakobi 1:26; 2 Pjet. 1:19; Zub. 18:7; zemra është sinonime me mendjen te 2 Kor. 3:14-15 dhe Fil. 4:7)

4. qendra e vullnetit (shih Veprat 5:4; 11:23; 1 Kor. 4:5; 7:37; 2 Kor. 9:7)
5. qendra e ndjenjave (shih Mat. 5:28; Veprat 2:26,37; 7:54; 21:13; Rom. 1:24; 2 Kor. 2:4; 7:3; Efe. 6:22; Fil. 1:7)
6. vendi unik i veprimtarisë së Frymës (shih Rom. 5:5; 2 Kor. 1:22; Gal. 4:6 [pra, Krishti në zemrat tona, Efe. 3:17])
7. Zemra është mënyrë metaforike për të nënkuptuar gjithë njeriun (shih Mat. 22:37, që citon LiP. 6:5). Mendimet, qëllimet dhe veprimet që i atribuohen zemrës zbulojnë llojin e individit. DhV ka disa përdorime goditëse të këtyre termave
 - a. Zan. 6:6; 8:21, “Perëndia u trishtua në zemër”, shih dhe Osea 11:8-9
 - b. LiP. 4:29; 6:5, “me gjithë zemër dhe me gjithë shpirt”
 - c. LiP. 10:16, “zemër e parrethprerë” dhe Rom. 2:29
 - d. Ezek. 18:31-32, “një zemër të re”
 - e. Ezek. 36:26, “një zemër të re” në dallim nga “një zemër guri”

2:7 “Ai po blasfemon” Dënimi për blasfemi ishte vdekja me gurë (shih Lev. 24:16). Jezusi ishte fajtor për këtë akuzë nëse nuk ishte vërtet hyjni. Edhe pretendimi i Jezusit se falte mëkatet ishte një pohim aspak i tërthortë për faktin se ishte hyjnor, ose të paktën se ishte përfaqësues i pushtetit dhe autoritetit hyjnor.

■ **“kush mund t’i falë mëkatet përveç Perëndisë”** Mesazhi i Jezusit për pendim dhe besim (shih Marku 1:14-15) bazohet te presupozimi se të gjithë njerëzit janë mëkatarë (madje dhe populli i besëlidhjes së DHV, shih Rom. 3:9-18). Mëkati është gjë e rëndë dhe ka, jo vetëm një aspekt që ndikon në marrëdhënien e përkohshme me Perëndinë, por edhe një aspekt të përjetshëm eskatologjik. Mëkati, si dhe fuqia dhe pasojat e tij, është arsyeja pse erdhi Jezusi (shih Marku 10:45; 2 Kor. 5:21).

Vetëm Perëndia mund t’i falë mëkatet, pasi mëkati drejtohet pikësisht kundër tij (shih Zan. 20:6; 39:9; 2 Sam. 12:13; Psa. 41:4; 51:4). Meqë libri i Isaisë përbën një referencë (ose aludim) të vazhdueshëm në ungjillin e Markut, ja dis avargje nga Isaia që trajtojnë epokën e re dhe faljen: Isa. 1:18; 33:24; 38:17; 43:25; 44:22. Edhe kjo ishte një tjetër shenjë mesianike.

2:8, 12 “Menjëherë” Shih shënimin në Marku 1:10.

■ **“Jezusi, i vetëdijshëm”** Shih shënimin në Marku 2:7.

■ **“në frymë”** Dorëshkrimet uncialle greke të DHR nuk kanë

1. hapësirën mes fjalëve
2. shenjat e pikësimit
3. shkronjat e mëdha (të gjitha shkronjat ishin të mëdha)
4. ndarjet në vargje dhe kapituj

Prandaj, vetëm konteksti mund ta përcaktojë nevojën për shkronjat e mëdha. Zakonisht, shkronjat e mëdha përdoren për

1. emrat e Perëndisë
2. emrat e vendeve
3. emrat personale

Fjala “frymë” mund të bëjë fjalë për:

1. Frymën e Shenjtë (shih Marku 1:5)
2. aspektin e vetëdijshëm personale të njeriut (shih Marku 8:12; 14:38)
3. ndonjë qenie të botës shpirtërore (p.sh., frymërat e liga, shih Marku 1:23).

Në këtë kontekst, “fryma” bën fjalë për Jezusin si person.

Unë personalisht nuk e pranoj konceptin teologjik se njerëzit kanë tre aspekte (trup, shpirt dhe frymë, në bazë të 1 Thes. 5:23). Zakonisht, ata që pranojnë këtë koncept e kthejnë këtë supozim teologjik në një strukturë teologjike me të cilën interpretohen të gjitha pasazhet biblike. Këto kategori shndërrohen në forma hermetike me të cilat Perëndia komunikon me njerëzit. Jo; njerëzit janë unitet (shih Zan. 2:7). Për një përmbledhje të dobishme të teorive për natyrën njerëzore si të trefishtë, të dyfishtë, apo si unitet, shih Frank Stagg, *Polarities of Man’s*

Existence in a Biblical Perspective, dhe librin e Millard J. Erickson, *Christian T Theology* (botimi i dytë), f. 538-557.

2:9, 11 “Ngrihu, merr vigun dhe ec” Këto janë dy urdhërore aoriste, të ndjekura nga një urdhërore e tashme. Ky ishte një shërim i menjëhershëm dhe i pakthyesëm. U bë për tre arsye.

1. për shkak se Jezusi donte t’ia dinte për nevojtarin, dhe shpërbleu besimin e tij dhe të miqve
2. që të vazhdonte t’u mësonte dishepujve ungjillin në lidhje me natyrën dhe misionin e Jezusit
3. që të vazhdonte të përballej dhe të dialogonte me krerët fetarë

Këta krerë fetarë kanë vetëm dy mundësi: të besojnë në të, ose të gjejnë justifikime për t’ia mohuar fuqinë dhe autoritetin.

2:10 “Biri i Njeriut” Kjo ishte një frazë mbiemërore nga DHV. Te Ezek. 2:1 dhe Psa. 8:4 ishte përdorur në kuptimin e vet të vërtetë etimologjik: “qenie njerëzore”. Mirëpo, te Dan. 7:13 kjo shprehje përdoret në një kontekst unik, ku nënkuptonte natyrën njerëzore dhe hyjnore të personit që thirret me këtë titull të ri mbretëror dhe eskatologjik (shih Marku 8:38; 9:9; 13:26; 14:26). Meqë ky titull nuk përdorej nga judaizmi rabinik dhe, si rrjedhojë, nuk kishte asnjë ngjirim nacionalist, përjashtues, apo militarist. Jezusi e zgjodhi si titullin e përkryer për të fshehur dhe zbuluar natyrën e vet të dyfishtë: plotësisht njeri dhe plotësisht Perëndi (shih 1 Gjonit 4:1-3). Ky ishte vetëpërcaktimi i tij i parapëlqyer.

Ai përdoret trembëdhjetë herë te Marku (shpesh, në lidhje me vuajtjet e ndryshme të Jezusit, shih Marku 8:31; 9:12, 31; 10:33, 45; 14:21, 41).

■ **“ka autoritet në tokë për të falur mëkatet”** Jezusi e kreu këtë mrekulli me qëllim që t’u dëshmonte këtyre skribëve. Çështja e autoritetit (pra, *eksusia*) do të shndërrohet në problem qëndror. Ata s’mund t’ia mohojnë fuqinë, kështu që do të thonë se fuqia dhe autoriteti i tij kanë natyrë demoniake ose satanike (shih Mat. 10:25; 12:24-29; Luka 11:14-22).

2:12 “të gjithë u mrekulluan” Kjo nuk ndodhi për shkak të shërimit; ata e kishin parë ta bënte më parë këtë gjë; por u habitën nga falja e mëkateve! Ata (skribët dhe farisenjtë) e morën shenjën që kërkonin. Jezusi e tregoi qartë fuqinë dhe autoritetin e vet. Kushedi, ndoshta dhe këta krerë “po lavdëronin Perëndinë” në këtë rast, bashkë me të tjerët.

TEKSTI I NASB (I PËRDITËSUAR): MARKU 2:13-14

¹³Dhe doli sërish në breg të detit; dhe të gjithë njerëzit shkonin tek ai, dhe ai i mësonte. ¹⁴Teksa po kalonte, pa Levin, birin e Alfeut, të ulur në kabinën e taksave, dhe i tha: “Më ndiq!” Dhe ai u ngrit dhe e ndoqi.

2:13 “të gjithë njerëzit shkonin tek ai, dhe ai i mësonte” Këto janë dy folje të pakryera. Jezusi gjente gjithmonë kohë për t’u mësuar njerëzve ungjillin dhe për t’u përkuajdesur për ta. Prandaj dhe populli e donte kaq shumë. Ai ishte shumë ndryshe nga krerët e tyre fetarë gjykues dhe përjashtues.

2:14 “Levin” Në hebraisht, ky emër do të thotë “shok”. Ishte emri i fisit priftëror të Izraelit; Ndoshta, ishte Jezusi ai që ia ndryshoi emrin në “Mate”, që do të thotë “dhuratë e JHVH” (shih Marku 3:18; 9:9), ose, si Pali, edhe Levit prindërit i kishin dhënë dy emra që në lindje.

■ **“të ulur në kabinën e taksave”** Mbledhja e taksave ishte një profesion që popullata judaike e përçmonte, pasi paguhej nga autoritetet romake. Tagrambledhësit duhet që të mblidhnin për Romën një taksë të caktuar për çdo mall. Një pjesë të taksave të mbledhura shkonin te Herod Antipa. Çdo gjë mbi shumën e caktuar shkonte në xhepat e tyre si rrogë. Mbledhja e taksave njihej për nivelin e lartë të mashtrimit. Levi, ndoshta, po mblidhte taksa për eksportin e peshkut.

■ **“Më ndiq”** Kjo është urdhërore e tashme veprorë. Ishte thirrje zyrtare për dishepullizim (shih Marku 1:17, 20). Duhet të kemi parasysh se rabinët iu bënë thirrje dishepujve që të lidheshin me Ligjin, ndërsa Jezusi iu bënte thirrje që të lidheshin me të. Rruga e shpëtimit ishte Jezusi, jo kryerja njerëzore e rregullave të Moisiut (pra, Talmudi). Pendimi nuk është kthim te Ligji i Moisiut, por kthim te Jezusit, Mesia i JHVH. Jezusi nuk e hodhi

poshtë ligjin, por e vendosi veten në vendin tradicional të ligjit, duke thënë se ai ishte interpretimi i vërtetë i ligjit (shih Mat. 5:17-48). Shpëtimi është person, jo thjesht kredo, ose zbatim i një grupi rregullash. Kjo çështje është, në thelb, arsyeja pse Jezusi hyri në konflikt të qëllimshëm me krerët fetarë. Në librin e vet, *The Method and Message of Jesus' Teachings*, Robert H. Stein thotë me të drejtë për këtë pohim:

“Ndonëse fjala ‘totalitare’ ka shumë ngjyime negative, Archibald M. Hunter e përdor këtë term në mënyrë të saktë kur përshkruan përkushtimin e plotë (total) që Jezusi kërkonte nga ndjekësit e vet. Në gojën e kujtdo tjetër, pohimet e Jezusit do të dukeshin provë e një egomanie të tmerrshme, pasi Jezusi nënkupton qartë se gjithë bota rrotullohet rreth tij dhe se fati i gjithë njerëzve varet nga pranimi ose refuzimi i tij.... Sipas Jezusit, fati i njeriut rrotullohet rreth tij. Pika qëndrore e historisë dhe shpëtimit, pohon Jezusi, është ai vetë. Bindja ndaj tij është urtësi dhe shpëtim nga gjykimi, por refuzimi i fjalëve të tij është marrësi dhe humbje, sepse fjalët e tij janë themeli i vetëm i sigurt mbi të cilin mund të ndërtojmë (Mat. 7:24-27)” (f. 118).

TEKSTI I NASB (I PËRDITËSUAR): MARKU 2:15-17

¹⁵Dhe ndodhi që ai ishte shtrirë në tryezë në shtëpinë e Levit, dhe shumë tagrambledhës dhe mëkatarë po darkonin me Jezusin dhe dishepujt; sepse kishte shumë prej tyre, dhe ata e ndiqnin. ¹⁶Kur skribët e farisenjve panë se ai po hante me mëkatarët dhe tagrambledhësit, iu thanë dishepujve: “Pse po ha dhe pi me tagrambledhësit dhe mëkatarët?” ¹⁷Kur dëgjoi këtë, Jezusi u tha: “Nuk janë të shëndetshmit ata që kanë nevojë për mjek, por të sëmurët; unë nuk erdha që të thërras të drejtët, por mëkatarët”.

2:15 “Ai ishte shtrirë në tryezë” Kjo ishte shtëpia e Levit (shih Luka 5:29). Jezusi hante me të përjashturit nga ana shoqërore dhe fetare për të hyrë në dialog fetar me ta. Të shumtë ishin ata që shkonin tek ai, sepse Jezusi vepronte plotësisht ndryshe nga krerët arrogantë të judenjve. Ngrënia ishte eveniment i veçantë në Lindjen e Afërt të lashtë, sepse shprehet miqësi dhe pranim. Ata mbështeteshin mbi bërrylin e majtë rreth një tryeze të ulët, në formë patkoi, me këmbët pas vetes (kjo është sfiduar nga J. Jeremias në librin e vet *The Eucharistic Words of Jesus*, f. 20-21. Ai thotë se judenjtë nuk e ndiqnin shpesh zakonet mesdhetar të mbështetjes, përveçse gjatë ditëve të festave). Në Lindjen e Afërt, edhe ata që s’ishin ftuar në darkë mund të hynin në sallën e ngrënies dhe të qëndronin në këmbë ngjitur me murin, ose të dera apo dritaret, dhe të dëgjonin bisedat.

Pyetja është sa simbolizëm eskatologjik duhet të nxjerrim nga ky kontekst. A është kjo gosti një parashije e gostisë mesianike, e cila do të përfshijë dhe të përjashtuarit (shih Mat. 8:11; Luka 13:29 ndoshta reflektojnë Isa. 59:15b-21)? Nëse po, atëherë këtu shohim mësimin teologjik se shoqërimi tokësor me Jezusin pasqyron miqësinë e mbretërisë eskatologjike. Mëkatarët pajtohen tani dhe në përjetësi! Të gjithë mëkatarët janë të mirëpritur (dhe të gjithë janë mëkatarë, madje dhe populli i besëlidhjes së DHV, shih Rom. 3:9-18).

▣ **“mëkatarët”** Bëhet fjalë për ata që nuk zbatonin të gjitha detajet e Traditave Gojore (pra, Talmudit). Shpesh, thirreshin në mënyrë përçmuese “populli i vendit”. Nuk ishin plotësisht të mirëpritur në sinagogë.

▣ **“dhe dishepujt”** Këta burra të përzgjedhur shihnin gjithçka që bënte dhe thoshte Jezusi. Madje, në radhë të parë, veprimet e tij kishin si synim kryesor vetë ata. Dishepujt do të mbanin shënim veprimet e Jezusit dhe do t’ia shpjegonin botës.

▣ **“sepse kishte shumë prej tyre, dhe ata e ndiqnin”** Forma gramatikore këtu është e paqartë, por duket se bëhet fjalë për “mëkatarët”, jo për dishepujt.

2:16 “skribët e farisenjve” Skribët nuk ishin pjesë vetëm e një pale fetare/politike, ndonëse shumica e tyre në kohën e Jezusit ishin farisenj. Farisenjtë ishin një sekt i veçantë teologjik i judaizmit, që u zhvillua gjatë periudhë makabease. Ata ishin fetarë shumë të përkushtuar dhe të sinqertë, të cilët ndiqnin në mënyrë të rreptë traditat gojore (pra, Talmudin).

TEMË E VEÇANTË: FARISENJTË (SPECIAL TOPIC: PHARISEES)

I. Ky term kishte një nga fillesat e mundshme, si më poshtë:

- A. “jam i veçar”. Ky grupim u zhvillua gjatë periudhës makabease. (Kjo është pikëpamja e pranuar më gjerësisht).
- B. “ndaj”. Ky është një tjetër kuptim nga e njëjta rrënjë në hebraisht. Disa thonë se nënkuptonte “interpretues” (shih 2 Tim. 2:15).
- C. “persian”. Ky është një tjetër kuptim nga e njëjta rrënjë në aramaisht. Disa prej doktrinave të farisenjve kanë shumë të përbashkëta me dualizmin zoroastrian persian.

II. Ka patur disa teori se nga kush përbëheshin farisenjtë.

- A. Sekt teologjik i judaizmit të hershëm (sipas Jozefusit)
- B. Grup politik nga periudhat hasmonease dhe herodiane
- C. Grup studiuesish dhe interpretuesish të Moisiut, që ndihmonin njerëzit e zakonshëm të kuptonin Besëlidhjen e Moisiut dhe traditat gojore rreth saj
- D. Lëvizje laike skribësh, si Ezra dhe Sinagoga e Madhe, në konkurrencë me udhëheqjen priftërore të tempullit

Ata u formuan nga konflikti me

- 1. Sunduesit jojudaikë (sidomos Antioku IV)
- 2. Aristokracia kundrejt popullit
- 3. Ata që ishin të përkushtuar ndaj besëlidhjes në dallim nga judeu i zakonshëm në Palestinë

III. Informacioni ynë për ta vjen nga

- A. Jozefusi, që ishte farise
 - 1. *Lashtësitë e Judenjve*
 - 2. *Luftrat e Judenjve*
- B. Dhiata e Re
- C. Burime të mëvonshme judaike

IV. Doktrinat e tyre kryesore.

- A. Besimi në ardhjen e një Mesie, i cili ndikohej nga letërsia judaike apokaliptike në periudhën ndërthjatore, si 1 Enoku.
- B. Perëndia është veprues në jetën e përditshme. Kjo ishte drejtpërdrejt në kundërshtim me saducenjtë. Shumë doktrina fariseike ishin në kundërshtime teologjike me doktrinat e saducenjve.
- C. Një jetë tjetër, e orientuar nga ana fizike, e bazuar në jetën tokësore, e cila përfshinte shpërblime dhe ndëshkime (shih Dan. 12:2).
- D. Besimi në autoritetin e DhV dhe Traditave Gojore (*Talmudi*). Ata ishin të vetëdijshëm se po u bindeshin porositjeve të Perëndisë në DhV, siç interpretoheshin dhe zbatoheshin nga shkollat e studiuesve rabinikë (konservatori Shamai dhe liberali Hilel). Interpretimi rabinik bazohej në një dialog mes rabinëve të dy filozofive të ndryshme, njëri konservator e tjetri liberal. Në fund, këto diskutime gojore për kuptimin e Shkrimit u shkruan në dy forma: Talmudi babilonas dhe Talmudi i paplotë palestinas. Ata besonin se Moisiu i kishte marrë këto interpretime gojore në malin Sinai. Fillea historike e këtyre diskutimeve nisi me Ezrën dhe me burrat e “Sinagogës së Madhe” (më vonë, të quajtur Sinedër).
- E. Besimi në një angjelologji tejet të zhvilluar. Këtu futeshin edhe qenie shpirtërore të mira, edhe të këqija. Kjo u zhvillua nga dualizmi persian dhe nga letërsia judaike ndërthjatore.
- F. Besimi në sovranitetin e Perëndisë, por dhe ushtrimin e vullnetit të lirë njerëzor (*jezer*).

V. Pikat e forta të lëvizjes fariseike.

- A. E donin, respektonin dhe besonin në zbuluesin e Perëndisë (pra, gjithë zbuluesin, Ligji, Profetët, Shkrimet dhe Traditat Gojore).
- B. Ishin të përkushtuar për t’u bërë ndjekës të drejtë (pra, besim dhe jetë e përditshme me besim) të zbuluesit të Perëndisë. Donin “një Izrael të drejtë” që të përmbushte premtimet profetike të epokës së re dhe të begatë.
- C. Përkrahnin barazinë në shoqërinë judaiste, që përfshinte çdo nivel njeriu. Në një kuptim, hidhnin poshtë udhëheqjen dhe teologjinë priftërore (pra, saducease) (shih Veprat 23:8).
- D. Mbronin elementin e vlefshëm njerëzor në besëlidhjen e Moisiut. Pohonin plotësisht sovranitetin

e Perëndisë, por përkrahnin dhe nevojën për ushtrimin e vullnetit të lirë njerëzor (pra, dy *jecer*).
E. DHR përmend një sërë farisenjsh të respektuar (pra, Nikodemi, sundimtari i ri dhe Jozefi i Arimateas).

VI. Ishin i vetmi sekt i judaizmit të shekullit të parë që i mbijetoi shkatërrimit të Jerusalemit dhe tempullit nga romakët më 70 pas K. Ata u bënë judaizmi modern.

2:16 “po hante me mëkatarët” Ky mund të ketë qenë një veprim i shpeshtë, jo thjesht një përjashtim (shih Luka 5:29; 7:34; 15:1-2). Ishte shumë trodintëse për elitën kryelartë fetare!

2:17 “të sëmurët” Ata kishin një ndjesi nevoje, që ishte thelbësore për të patur besim (shih Mat. 5:3-4) dhe Jezusi ishte shëruesi dhe mik i tyre (shih Luka 7:34; 19:10).

■ **“unë nuk erdha që të thërras të drejtët, por mëkatarët”** Ky ishte një pohim ironik, ndoshta dhe sarkastik, si te 7:19. Kjo thënie nuk nënkuptonte se krerët fetarë ishin të drejtë (shih Mat. 5:20) kështu që s’kishin nevojë të pendoheshin, por se mesazhi i Jezusit (shih Marku 1:14-15) tërhoqte më shumë ata që e kuptonin nevojën e tyre shpirtërore. Jezusi përdor shpesh thënie proverbiale në mësimet e tij (shih Marku 2:17,21,22,27; 3:27; 4:21,22,25; 7:15; 8:35,36,37; 9:40,50; 10:25,27,31,43-44). S’ka më të verbër se të verbrit që mendojnë se shohin!

Tekstus Receptus shton “në pendim” në fund të këtij vargu, duke ndjekur vargun paralel te Luka (shih Marku 5:32) dhe tekstin bizantin, por ky variant as nuk përfshihet si mundësi nga aparati kritik i UBS4.

TEKSTI I NASB (I PËRDITËSUAR): MARKU 2:18-20

¹⁸Dishepujt e Gjonit dhe farisenjtë po agjëronin; dhe ata erdhën dhe i thanë: “Pse dishepujt e Gjonit dhe dishepujt e farisenjve agjërojnë, kurse dishepujt e tu nuk agjërojnë?” ¹⁹Dhe Jezusi ua ktheu: “Për sa kohë që dhëndri është me ta, shoqëruesit e dhëndrit nuk mund të agjërojnë, apo jo? Për sa kohë që dhëndrin e kanë mes tyre, nuk mund të agjërojnë. ²⁰Por do të vijnë ditët kur dhëndri do të merret prej tyre, dhe atëherë, në atë ditë, do të agjërojnë”.

2:18-20 “agjëronin” Farisenjtë dhe nxënësit e Gjonit, nga kultura e tyre, ishin të kushtëzuar të agjëronin dy herë në javë, të hënave dhe të enjteve (shih Luka 18:12). Ligji i Moisiut përmendte vetëm një ditë agjërimi në vit: Dita e Shlyerjes (shih Levitiku 16). Këto agjërimet dy herë në javë janë shembull i qartë i tradicionalizmit të zhvilluar (shih Zak. 7-8). Agjërimi e humb vlerën shpirtërore kur bëhet i detyrueshëm dhe e përqendron vëmendjen te vetja (shih Mat. 6:16-18).

TEMË E VEÇANTË: AGJËRIMI (SPECIAL TOPIC: FASTING)

Ndonëse nuk urdhërohet kurrë në DHR, agjërimi pritej që, në kohën e duhur, të bëhej nga dishepujt e Jezusit (shih Mat. 6:16, 17; 9:15; Marku 2:19; Luka 5:35). Agjërimi i duhur përkrahëhet në Isaia 58. Jezusi e vendosi vetë këtë precedent (shih Mat. 4:2). Kisha e hershme agjëronte (shih Veprat 13:2-3; 14:23; 2 Kor. 6:5; 11:27). Qëllimi dhe mënyra e agjëritit janë thelbësore; ndërsa koha, kohëzgjatja dhe shpeshtësia janë fakultative. Agjërimi i DHV nuk është detyrim për besimtarët e DHR (shih Veprat 15:19-29). Agjërimi nuk është mënyrë për t’u mburrur që je njeri shpirtëror (shih Isaia 58; Mat. 6:16-18), por është një mënyrë sesi mund të afroresh më tepër me Perëndinë dhe të kërkosh drejtimin e tij (p.sh., Jezusi, Mat. 4:2). Agjërimi mund të jetë i dobishëm nga ana shpirtërore.

Prirja e kishës së hershme drejt asketizmit bëri që disa kopjues të fusnin fjalën “agjërim” në disa pasazhe (shih Mat. 17:21; Marku 9:29; Veprat 10:30; 1 Kor. 7:5). Për të dhëna të mëtejshme për këto pjesë të dyshimta, shih librin e Bruce Metzger, *A Textual Commentary on the Greek New Testament*, botuar nga United Bible Societies.

NASB, NKJV “ata erdhën”
NRSV “njerëz erdhën”
TEV, NJB “disa njerëz erdhën”

Vargu 18 nis duke vërejtur se dishepujt e Gjonit dhe farisenjtë po agjëronin në një rast të caktuar. Disa të tjerë e vunë re këtë dhe erdhën dhe e pyetën Jezusin përse dishepujt e tij nuk po agjëronin me këtë rast.

2:19 Gramatikisht, kjo pyetje pret përgjigjen “jo”.

■ **“dhëndri”** Koncepti i “dhëndrit” përmbledh brenda vetes një metaforë të fuqishme nga DHV. Në DHV, JHVH është dhëndri ose burri i Izraelit. Në këtë kontekst, Jezusi është dhëndri dhe kisha është nusja (shih Efe. 5:23-32). Në Marku 2:20, “dhëndri merret” bën fjalë për një kohë kur do të ndodhë një ndarje.

Si interpretues, kemi dy mundësi zgjedhjeje. Së pari, mund ta shohim këtë si metaforë kulturore për një kohë gëzimi që lidhej me dasmat. Askush nuk agjëron gjatë dasmës! Së dyti, mund ta shohim si shëmbëlltyrë të kohës së Jezusit në tokë dhe të kryqëzimit të tij të ardhshëm. Marku (interpretuesi i Pjetrit) duhet ta ketë ditur vlerën e plotë të këtyre fjalëve të mbushura me metaforë (në judaizëm, dhëndri ishte metaforë, jo e Mesisë, por e mbretërisë së ardhshme të Perëndisë). A është ky parashikim i vdekjes së Jezusit? Ai e ka zbuluar qartazi natyrën e vet mesianike dhe hyjnore përmes fjalëve dhe veprave (pra, dëbimeve të demonëve, shërimeve, faljes së mëkateve). Sidoqoftë, Sekretet Mesianik të Markut të bën të vrasësh mendjen! Por gjuha shëmbëlltyrore dhe domethënia e saj për Markun 2:21-22 më kanë bërë ta shoh gjithë këtë ndodhi në një kontekst zëvendësues dhe eskatologjik (pra, dhëndri vdes, por Biri i njeriut kthehet dhe qëndron). Mes vdekejs dhe kthimit të tij (pra, gostia mesianike), ndjekësit e Jezusit do të agjërojnë në mënyrë dhe kohë të përshtatshme.

2:20 “merret prej tyre” Ndoshta, është aludim për Isa. 53:8 në Septuagintë. Pas kryqëzimit, ringjalljes dhe ngritjes së Jezusit në qiell, Pjetri e kuptoi plotësisht domethënien e Isaisë 53.

■ **“do të agjërojnë”** Kjo është e ardhme dëftore veprare (pohim fakti), jo urdhërore (urdhërim).

TEKSTI I NASB (I PËRDITËSUAR): MARKU 2:21-22

²¹“Askush nuk qep një arnë të një cope të patkurrur në një rrobë të vjetër; përndryshe arna do të shkëputet prej saj, pra, e reja nga e vjetra, dhe do të ndodhë një shqyerje më e keqe. ²²Askush nuk vendos verë të re në kacekë të vjetër; përndryshe, vera do t’i shqyejë kacekët, dhe do të humbasë vera bashkë me kacekët; por vera e re vihet në kacekë të rinj”.

2:21 Kjo pasqyron një të vërtetë kulturore, të kthyer në proverb.

2:22 “kacekë” Dhinë rripeshin në mënyrë të tillë që lëkura e tyre të përdorej si enë për lëngje. Këto lëkura të saporegjura kishin cilësi elastike. Kur vjetëroheshin, procesi i fermentimit dhe zgjerimit të verës së re i bënte të shqydheshin. Judaizmi s’ ishte në gjendje t’i pranonte mësimet dhe korigjimet e Jezusit, kështu që pas pak do të anulohesh. Besëlidhja e re (shih Jer. 31:31-34; Ezek. 36:22-38) kishte ardhur në Jezusin! Asgjë s’ mund të jetë më njësoj.

Ky varg përmban një sërë variantesh në greqisht. Disa vijnë nga vargjet paralele të Mat. 9:17 dhe Luka 5:37-38. Mënyra e përmbledhur sesi Marku i përmend këto ngjarje bëri që disa kopjues të mëvonshëm të përpiqeshin ta sqaronin këtë thënie.

Vini re titujt metaforikë të Jezusit në këtë kontekst: (1) mjeku, Marku 2:17; (2) dhëndri, Marku 2:19; (3) vera e re, Marku 2:21-22; dhe (4) Zoti i shabatit, Marku 2:28.

■ **“do të humbasë”** Shih Temën e Veçantë: *Apollumi* të Marku 3:6.

TEKSTI I NASB (I PËRDITËSUAR): MARKU 2:21-22

²³Dhe ndodhi që, teksa po kalonte përmes fushave me drithë ditën e shabatit, dishepujt e tij, duke kaluar, nisën të këpusnin kallinj. ²⁴Farisenjtë i thanë: “Ja, pse po bëjnë atë që nuk lejohet në shabat?” ²⁵Dhe ai u tha: “S’e keni lexuar ndonjëherë çfarë bëri Davidi kur kishte nevojë dhe bashkë me shokët pati uri? ²⁶Sesi hyri në shtëpinë e Perëndisë në kohën e kryepriftit Abiatar dhe hëngri bukë të shenjtëruar, që s’i lejohej askujt ta hante përveç priftërinjve, dhe madje u dha dhe atyre që ishin me të?” ²⁷Jezusi u tha: “Shabati u bë për njeriun, jo njeriu për shabatit. ²⁸Kështu, Biri i Njeriut është Zot edhe i shabatit”.

2:23 “teksa po kalonte përmes fushave me drithë ditën e shabatit” Bëhet fjalë për shtigjet përmes fushave me drithë, që rrethonin fshatrat dhe qytetet. Këto “fusha me drithë” mund të bëjnë fjalë për çdo lloj drithi (pra, elb, apo grurë).

2:24 “pse po bëjnë atë që nuk lejohet në shabat?” Farisenjtë e konsideronin veprimin e dishepujve si (1) korrije; (2) shoshitje; dhe (3) përgatitje ushqimi ditën e shabatit, gjë që ishte e palejueshme sipas traditave të tyre gojore të bazuara në Eks. 34:21. Dishepujt e Jezusit nuk po bënë asgjë të paligjshme sipas ligjeve të mbledhjes së kallizave në DHV (shih LiP. 23;25); problemi ishte dita kur e bënë këtë gjë (shih Zan. 2:1-3; Eks. 20:8-11; 23:12; 31:15; LiP. 5:12-15)! Duket se shkruesit e ungjijve i mbajtën shënim veprimet e Jezusit ditën e shabatit për të treguar (1) polemikat që shkaktuan ato, ose (2) se Jezusi i bëri këto lloj gjërash çdo ditë; shabati nuk bënte përjashtim.

2:25-28 Kjo thënie e famshme (shih Marku 2:27) e Jezusit është unike për Markun. Shpreh autoritetin e tij për të riinterpretuar botëkuptimin dhe udhëzimet tradicionale të DHV (shih Mat. 5:17-48). Në të vërtetë, kjo ishte një shenjë tjetër se Jezusi po thoshte se ishte Mesia i Perëndisë.

2:25 Gramatikisht, kjo pyetje pret përgjigje pohuese. Bën fjalë për një ndodhi nga jeta e Davidit, e shënuar në 1 Samueli 21. Shpesh, Jezusi përdorte DHV për të ilustruar mësimet e tij (shih Marku 2:25-26; 4:12; 10:6-8,19; 12:26,29-30,36).

2:26 “shtëpinë e Perëndisë” Ndoshta, bën fjalë për tabernakullin e lëvizshëm, që ndodhej në Nod.

▣ **“Abiatar”** Ka një problem historik kur 1 Sam. 21:1 e më tej krahasohet me 2 Sam. 8:17 dhe 1 Kro. 18:16 në lidhje me emrin Abiatar apo Abimelek: (1) edhe babai, edhe i biri, quhen kryepriftërinj dhe (2) Jezusi përdori parafjalën *epi* me një fjalë në rasë gjinore në kuptimin e “në ditët e” që do të thoshte “gjatë kohës së tij” (shih Veprat 11:28; Heb. 1:2). E dimë se, pak kohë pas kësaj ngjarjeje, mbreti Saul e vrau Abimelekun dhe Abiatarin u arratis te Davidi (shih 1 Sam. 22:11-23) dhe u bë një nga dy kryepriftërinjtë e pranuar (pra, Abiatar dhe Cadoku).

Ky është një shembull i disa lloj problemesh që nuk mund të shpjegohen lehtësisht. Këtu s’bëhet fjalë për ndonjë ndryshim fjalësh në dorëshkrimet greqisht. Ose duhet të supozojmë se ky ishte një gabim i hershëm kopjimi që ndodhi përpara se dorëshkrimet në papirus të ishin shkruar me dorë (gjë që përbën një hamendësim). Gjithë mësuesit e Biblës shqetësohen se përse Jezusi duket sikur e keqçiton një pjesë të historisë së DHV, sidomos për faktin se, në këtë kontekst, Jezusi po qorton farisenjtë se përse nuk e lexonin Shkrimin.

Ka disa libra që trajtojnë mendimet konservatore në lidhje me interpretimin e pasazheve të vështira:

1. *Hard Sayings of the Bible*, Walter C Kaiser, Jr., Peter H. Davids, F. F. Bruce dhe Manfred T. Branch.
2. *Encyclopedia of Bible Difficulties*, nga Gleason L. Archer.
3. *Answers to Questions*, nga F. F. Bruce.

▣ **“bukë të shenjtëruar”** Çyrekët e bukës peshonin nga 2.7 kilogram secili! Aty vendoseshin 12 çyrekë buke, që zëvendësoheshin përjavë, ndërsa çyrekët njëjavësh që simbolizonin furnizimin e JHVH-së për dymbëdhjetë fiset e Izraelit duhet të haheshin vetëm nga priftërinjtë (shih Eks. 25:23-28; Lev. 24:5-9). Perëndia bëri një përjashtim për rregullin në këtë rast. Jezusi po pohon se ka të njëjtin autoritet si Kryepriifti dhe të njëjtën të drejtë si ai që do të bëhej pas pak mbret, pra, Davidi!

2:27 Rregullat e shabatit ishin bërë parësore në atë kohë. Këto tradita ishin bërë çështje fetare, jo çështje dashurie për njerëzit e krijuar në shëmbëllimin e Perëndisë. Përparësia e rregullave kishte zëvendësuar përparësinë e marrëdhënieve. Merita kishte zëvendësuar dashurinë. Traditat fetare (pra, ligji gojor) kishin zëvendësuar synimin e Perëndisë (shih Isa. 29:13; Kol. 2:16-23). Si mund ta kënaqim Perëndinë? Një analogji e dobishme në DHV ishte flijimi. Perëndia donte që flijimi të ishte mënyrë sesi njerëzimi mëkatar dhe nevojtar të vinte tek ai që të rikthehej në marrëdhënien e duhur me të. Mirëpo flijimi ishte kthyer në një ritual, në procedurë liturgjike. Kështu kishte ndodhur dhe me ligjin e shabatit! Njerëzimi ishte bërë shërbëtor, në vend që të ishte objekti i shabatit (pra, arsyeja për ligjet).

Tre thënie të Markut 2:27-28 janë, në njëfarë kuptimi, paralele (pra, të gjitha përdorin terma të përgjithshme për njerëzimin). Fjala “bir i njeriut” në Marku 2:28 është idiomë semite që kishte kuptimin “genie njerëzore” (shih Psa. 8:4; Ezek. 2:1). Ai ishte termi i preferuar i Jezusit për veten. Njeriu Jezus na zbulon

dinjitetin dhe përparësinë absolute të njerëzimit! Perëndia u bë njëri prej nesh, për hirin tonë! Nevoja njerëzore e tejkalon traditën fetare. Perëndia vepron për ne, në mënyrë individuale dhe kolektive.

2:28 “Biri i Njeriut” Shih shënimin në Marku 2:10.

PYETJE PËR DISKUTIM

Ky është një komentari studimor udhëzues, që do të thotë se ti je vetë përgjegjës për interpretimin e Biblës. Secili prej nesh duhet të ecë sipas dritës që ka. Ti, Bibla dhe Fryma e Shenjtë keni përparësi në interpretim. Nuk duhet t’ia dorëzosh këtë të drejtë komentuesit.

Këto pyetje për diskutim t’i kam dhënë për të të ndihmuar që të analizosh çështjet kryesore të kësaj pjese të librit. Ato synojnë të të nxisin mendimin, jo të kenë natyrë shteruese.

1. Rendit metaforat që përdori Jezusi për të përshkruar veten në vargjet 17, 19, 21-22, 28.
2. Pse ishin kaq armiqësorë krerët fetarë ndaj mësimin të Jezusit?
3. Pse thirri Jezusi një njeri kaq të urryer dhe të përjashtuar sa Levi për të qenë dishepull i tij?
4. Ç’lidhje kanë mësimet e Jezusit me traditën gojore të judenjve?
5. Pse nuk përbën agjërimi një pjesë të vazhdueshme të adhurimit tonë për Perëndinë?
6. Cila ishte e vërteta qendrore e shëmbëlltyrës së Jezusit në Marku 2:19-22?
7. S’donte t’ia dinte Jezusit për ligjin ceremonial, apo ka ndonjë mundësi tjetër për veprimet e tij në Marku 2:23-28?
8. Ç’mendim ke për “gabimin” historik në Marku 2:26?
9. Ç’lidhje ka Marku 2:27 me sot?

MARKU 3

NDARJET NË PARAGRAFË TË PËRKTHIMEVE MODERNE

UBS ⁴	NKJV	NRSV	TEV	NJB
Burri me dorë të tharë 3:1-6	Shërimi në shabat 3:1-6	Jezusi dhe ligjet e shabatit (2:23-3:6)	Burri me dorën e paralizuar 3:1-4a 3:4b-6	Shërimi i burrit me dorën e tharë 3:1-6
Turma në anë të detit 3:7-12	Një turmë e madhe ndjek Jezusin 3:7-12	Vepra e shërimit 3:7-12	Turma përbri liqenit 3:7-11 3:12	Turmat ndjekin Jezusin 3:7-12
Zgjedhja e të dymbëdhjetëve 3:13-19	Dymbëdhjetë apostujt 3:13-19	Dymbëdhjetë të zgjedhurit 3:13-19a	Jezusi zgjedh dymbëdhjetë apostujt 3:13-15 3:16-19	Caktimi i të dymbëdhjetëve 3:13-19
Jezusi dhe Beelzebuli 3:20-30	Shtëpia e përçarë nuk qëndron dot 3:20-27 Mëkati i pafalshëm 3:28-30	Pyetje për fuqinë e Jezusit 3:19b-27 3:28-30	Jezusi dhe Beelzebuli 3:20-21 3:22 3:23-26 3:27 3:28-30	Familja shqetësohet për Jezusin 3:20-21 Akuzat e skribëve 3:22-27
Nëna dhe vëllezërit e Jezusit 3:31-35	Nëna dhe vëllezërit kërkojnë Jezusin 3:31-35	3:31-35	Nëna dhe vëllezërit e Jezusit 3:31-32 3:33-35	Familja e vërtetë e Jezusit 3:31-35

CIKLI TRE I LEXIMIT (shih f. v)

NDJEKJA E SYNIMIT TË AUTORIT FILLESTAR NË NIVELIN E PARAGRAFËVE

Ky është një komentuar studimor udhëzues, që do të thotë se ti je vetë përgjegjës për interpretimin e Biblës. Secili prej nesh duhet të ecë sipas dritës që ka. Ti, Bibla dhe Fryma e Shenjtë keni përparësi në interpretim. Nuk duhet t'ia dorëzosh këtë të drejtë komentuesit.

Lexo gjithë kapitullin njëherësh. Identifiko temat. Krahaso ndarjet e tua tematike me pesë përkthimet moderne. Ndarja në paragrafë nuk është e frymëzuar, por është çelësi për të ndjekur synimin e autorit fillestar, gjë që është thelbi i interpretimit. Secili paragraf ka vetëm një temë të vetme.

1. Paragrafi i parë
2. Paragrafi i dytë
3. Paragrafi i tretë
4. Etj.

TEKSTI I NASB (I PËRDITËSUAR): MARKU 3:1-6

¹Hyri sërish në një sinagogë; dhe aty ishte një burrë me dorë të tharë. ²Ata po e vëzhgonin nëse do ta shëronte në shabat, që ta akuzonin. ³Ai i tha burrit me dorë të tharë: “Ngrihu dhe dil përpara!” ⁴Dhe u tha atyre: “A është e ligjshme që të bësh mirë apo të bësh keq në shabat; të shpëtosh një jetë apo të vrasësh?” Por ata heshtnin. ⁵Pasi i vështroi përreth i zemëruar, u trishtua nga ngurtësia e zemrës së tyre. I tha burrit: “Shtrije dorën”. Dhe ai e shtriu dhe dora iu shërua. ⁶Farisenjtë dolën dhe menjëherë filluan të thurnin plane me herodianët kundër tij, sesi ta vrisnin.

3:1 “në një sinagogë” Kjo ngjarje jepet edhe te Mat. 12:9-14 dhe Luka 6:6-11. Sinagogat u zhvilluan gjatë robërisë babilonase. Ishin vend ku kryheshin arsimi i fëmijëve, lutjet, adhurimi dhe bashkësia. Sinagoga ishte shprehje lokale e judaizmit, ashtu si tempulli ishte pika qendrore për judenjtë si komb.

Jezusi shkonte rregullisht në sinagogë. Ai duhet ta ketë mësuar Biblën dhe traditat judaike në shkollën e sinagogës në Nazaret. Merrte pjesë plotësisht në adhurimin judaik të shekullit të parë.

Po kështu, është interesante se Jezusi, me sa duket qëllimisht, vepronte në mënyra provokuese në shabat dhe në sinagogë. Ai i shkelte qëllimisht traditat gojore (pra, Talmudin) të pleqve në mënyrë që të hynte në përballje/diskutim teologjik me krerët fetarë (si ata lokalë, ashtu dhe ata kombëtarë; si me farisenjtë, ashtu dhe me saducenjtë). Diskutimi më i zgjatur i tij teologjik, sidomos për faktin se ndryshon nga normat tradicionale, është Predikimi në Mal (shih Mateu 5-7, sidomos 5:17-48).

▣ **“me dorë të tharë”** Kjo është pjesore e kryer pësore. Luka 6:6 thotë se i ishte tharë dora e djathtë, që duhet t’i ketë krijuar probleme në aftësinë për punë.

3:2 “Ata po e vëzhgonin” Kjo është në kohën e pakryer. Bën fjalë për praninë e vazhdueshme të krerëve fetarë.

▣ **“që ta akuzonin”** Kjo është një fjali qëllimore, e paraprirë nga *hina*. Ata nuk donin t’ia dinin për të paralizuarin. Donin vetëm ta kapnin Jezusin në shkelje teknike që ta turpëronin dhe ta mohonin. Jezusi vepron nga dhembshuria për burrin e paralizuar, në mënyrë që t’u jepte mësim dishepujve dhe që të përballej me krerët fetarë, të cilët drejtoheshin nga rregullat, traditat dhe vetëdrejtësia e tyre.

3:3

NASB “Ngrihu dhe dil përpara!”

NKJV “Dil përpara”

NRSV “Eja përpara”

TEV “Dil këtu përpara”

NJB “Ngrihu dhe qëndro në mes”

Fjalë për fjalë, përkthehet “Ngrihu në mes [të një vendi]”. Është urdhërore e tashme veprorë. Jezusi donte që të gjithë ta shihnin.

3:4 Rabinët kishin një traditë tejet të zhvilluar gojore (Talmudi), që interpretonte ligjin e Moisiut (shih Marku 2:24). Ata jepnin shpjegime të ngurta për atë që mund, ose nuk mund, të bëhej ligjërisht ditën e shabatit. Lejohej të stabilizojë një njeri të dëmtuar në rast urgjence, por nuk lejohej t’ia përmirësoje gjendjen. Pyetja e Jezusit zbuloi problemin e përparësisë së traditave të tyre ndaj nevojve njerëzore. Kështu ndodh gjithmonë me legalistët!

▣ **“të shpëtosh”** Kjo është fjala greke *sōzō*. Përdoret në dy kuptime të ndryshme në DHR: (1) në kuptimin e DHV, pra çlirim nga problemet fizike; ose (2) për shpëtimin shpirtëror. Në ungjijtë, zakonisht ka kuptimin e parë (shih Marku 3:4; 8:35a; 15:30-31; madje, dhe “shëroj”, shih Marku 5:32, 28, 34; 6:56; 10:52), por në Marku 8:35b; 10:26; 13:13 mund të ketë kuptimin e dytë. Ky kuptim i dyfishtë gjendet edhe te Jakobi (#1 në Marku 5:15, 20, por #2 në Marku 1:21; 2:14; 4:12).

▣ **“jetë”** kjo është fjala greke *psuhi*. Është e vështirë ta përcaktosh. Mund të ketë kuptimin

1. Jeta tokësore fizike (shih Marku 3:4; 8:35; 10:45)

2. Ndjenjat ose vetëdija (shih Marku 12:30; 14:34)
3. Vetëdija shpirtërore dhe e përrjetshme e njeriut (shih Marku 8:36, 37)

Vështirësia për përkthimin e kësaj fjale vjen nga përdorimi i saj në filozofinë greke, sipas së cilës njerëzit kanë shpirt, dhe jo nga koncepti hebre i faktit se njerëzit janë shpirt (shih Zan. 2:7).

3:5 “Pasi i vështroi përreth i zemëruar” Ungjilli i Markut i përmend më haptazi se të tjerët ndjenjat e Jezusit (shih Marku 1:40-42, 43; 3:1-5; 10:13-16, 17-22; 14:33-34; 15:34). Heshtja e t merrshme dhe superioriteti moral i krerëve krenarë fetarë e zemëroi Jezusin! Kjo ngjarje vijon të qartësojë 2:27-28.

▣ **“u trishtua nga ngurtësia e zemrës së tyre”** Kjo është një formë e përforcuar e fjalës *hidhërim* (*lupē*) me ndajfoljen *sun*. Përdoret vetëm këtu në gjithë DHR. Jezusi ndjeu keqardhje për problemin dhe nevojën e këtij burri, por edhe reagoi negativisht ndaj ngurtësisë së krerëve fetarë. Ata s’ donin ta shihnin të vërtetën për shkak se ishin të përkushtuar ndaj traditave (shih Isa. 29:13; Kol. 2:16-23). Sa shpesh na ndodh dhe neve kjo?

Fjala “ngurtësi” do të thotë kalcifikim (shih Rom. 11:25; Efe. 4:18). Shih Temën e Veçantë: Zemra në Marku 2:6.

▣ **“shërua”** Kjo fjalë (pra, kthej në gjendjen fillestare) nënkupton se dora e tharë ishte diçka e mëvonshme, jo një difekt nga lindja. *Ungjilli i Hebrenjve*, një libër jokanonik, tregon një traditë se ky burrë ishte murator dhe kishte ardhur t’i lutje Jezusit t’ia shëronte dorën që të kthehej prapë në punë.

3:6 “Farisenjtë dolën” Luka 6:11 thotë “të tërbuar”. Fjalë për fjalë, do të thotë “të çmendur” (shih 2 Tim. 3:9). Shih shënimin për Farisenjtë në Marku 2:16.

▣ **“menjëherë”** Shih shënimin në Marku 1:10.

▣ **“filluan të thurnin plane”** Kjo është dëftore e pakryer veprorë, e përdorur në kuptimin e fillimit të një veprimi në kohën e shkuar. Në Marku 3:11, tre forma të pakryera përdoren për të treguar një veprim të përsëritur në kohën e shkuar. Këto dy përdorime janë funksioni kryesor gjuhësor i kësaj kohe.

▣ **“me herodianët”** Normalisht, farisenjtë tejet konservatorë dhe nacionalistë nuk pranonin të kishin fare lidhje me herodianët e orientuar politikisht, të cilët mbështesnin sundimin e Herodit dhe pushtimin romak.

TEMË E VEÇANTË: HERODIANËT (SPECIAL TOPIC: HERODIANS)

Herodianët ishin një grup i veçantë në Palestinën e shekullit të parë, që ishte krijuar nga lidhjet e tyre me familjen mbretërore të Herodit (shih Jozefusin, *Lasht.* 14.15.6).

Herodët ishin familje sundimtarësh idumeas (nga Edomi); gjithçka nisi me Herodin e Madh. Pas vdekjes së tij, disa nga djemtë e vet e ndanë mbretërinë e të atit mes njëri-tjetrit. Të gjithë Herodët ishin mbështetës të qeverisë romake. Ndjekësit e tyre donin të ruanin gjendjen e pandryshuar politike. Ata donin që sundimi i Herodëve të drejtonte punët romake në Izrael. Ky grup ishte rreptësisht politik. Ata nuk identifikoheshin zyrtarisht, as me teologjinë e farisenjve, as të saducenjve.

▣ **“sesi ta vrisnin”** Këta krerë u fyen nga shërimi në shabat, por nuk iu duk fare problem që po planifikonin vrasjen e dikujt! Ndoshta, këtë vendim e bazonin te Eks. 31:13-17. Sa gjëra të çuditshme janë justifikuar në emër të Perëndisë! Kjo është padyshim një parathënie e vdekjes së Jezusit nga krerët judenj.

TEMË E VEÇANTË: SHKATËRRIMI (APOLLUMI) (SPECIAL TOPIC: DESTRUCTION [APOLLUMI])

Ky term ka një fushë të gjerë semantike, gjë që ka shkaktuar pështjellim të madh në lidhje me konceptet teologjike të gjykimit të përrjetshëm përkundër asgjësimit. Kuptimi bazë i fjalëpërfjalshëm është “nga” *apo plus ollumi*, “shkatërroj, rrënoj”.

Problemi vjen nga përdorimet e figurshme të këtij termi. Kjo mund të shihet qartë në Louë dhe Nida,

Greek-English Lexicon of the Neë Testament, Based on Semantic Domains [Leksik greqisht-anglisht i Dhiatës së Re, bazuar në domenet semantike], vëll. 2, f. 30. Ata rendisin disa kuptime të këtij termi

1. shkatërroj (p.sh. Mat. 10:28; Luka 5:37; Gjoni 10:10; 17:12; Veprat 5:37; Rom. 9:22 nga vëll. 1, f. 232)
2. s'arrij të përftoj (p.sh., Mat. 10:42; vëll. 1, f. 566)
3. humbas (p.sh., Luka 15:8, vëll. 1, f. 566)
4. i pavetëdijshëm për vendndodhjen (p.sh., Luka 15:4; vëll. 1, f. 330)
5. vdes (p.sh., Mat. 10:39, vëll. 1, f. 266)

Gerhard Kittel, *Theological Dictionary of the Neë Testament [Fjalor teologjik i Dhiatës së Re]* përpiqet të përvijojë përdorimet e ndryshme duke renditur katër kuptime:

1. shkatërroj, ose vras (p.sh. Mat. 2:13; 27:20; Marku 3:6; 9:22; Luka 6:9; 1 Kor. 1:19)
2. humbas ose pësoj humbje nga (p.sh., Marku 9:41; Luka 15:4, 8)
3. humbas (p.sh. Mat. 26:52; Marku 4:38; Luka 11:51; 13:3,5,33; 15:17; Gjoni 6:12,27; 1 Kor. 10:9-10)
4. të jesh i humbur (p.sh., Mat. 5:29-30; Marku 2:22; Luka 15:4, 6, 24, 32; 21:18; Veprat 27:34)

Më tej, Kittel thotë: “në përgjithësi, mund të themi se #2 dhe #4 gjenden në thëniet që lidhen me këtë botë, si te ungjijtë sinoptikë, ndërsa #1 dhe #3 gjenden në ato thënie që lidhen me botën tjetër, si te Pali dhe Gjoni” (f. 394).

Këtu qëndron dhe pështjellimi. Ky term ka një përdorim kaq të gjerë semantik sa që autorë të ndryshëm të DhR e përdorin në një larmi mënyrash. Mua më pëlqen Robert B. Girdlestone, *Synonyms of the Old Testament [Sinonime të Dhiatës së Vjetër]*, f. 275-277. Ai e lidh këtë term me ata njerëz që janë të shkatërruar moralisht dhe presin ndarjen e përjetshme nga Perëndia, në dallim nga ata njerëz që njohin Krishtin dhe kanë jetë të përjetshme në të. Grupi i dytë është “i shpëtuar”, ndërsa i pari shkatërrohet.

Robert B. Girdlestone, *Synonyms of the Old Testament*, f. 276, vë në dukje se ka disa vende ku ky term nuk mund të përkthehet “asgjësim”, por “një dëmtim të tillë që e bën objektin praktikisht të padobishëm për qëllimin e vet fillestar”.

1. Shkapërderdhja e vajit (Mat. 26:8)
2. Prishja e calikëve të vjetër (Mat. 9:17)
3. Prishja e flokëve (Luka 21:18)
4. Prishja e ushqimit (Gjoni 6:27)
5. Prishja e floririt (1 Pje. 1:7)
6. Shkatërrimi i botës (2 Pje. 3:6)
7. Prishja e trupit fizik (Mat. 2:13; 8:25; 12:14; 21:41; 22:7; 26:52; 27:20; Rom. 2:12; 14:15; dhe 1 Kor. 8:11)

Ky term nuk bën kurrë fjalë për asgjësimin e personit, por për fundin e ekzistencës trupore. Përdoret rëndom dhe në kuptimin moral. “Gjithë njerëzit konsiderohen si të shkatërruar moralisht, pra, kanë dështuar në zbatimin e synimit për të cilin u krijua raca njerëzore” (f. 276). Përgjigja e Perëndisë për këtë problem mëkati është Jezu Krishti (shih Gjoni 3:15-16 dhe 2 Pje. 3:9). Ata që refuzojnë ungjillin tani i nënshtrohen një shkatërrimi të mëtejshëm, që përfshin edhe trupin edhe shpirtin (shih 1 Kor. 1:18; 2 Kor. 2:15; 4:3; 2 Thes. 2:10). Për mendimin e kundërt, shih Fudge, *The Fire that Consumes*.

Personalisht (shih Girdlestone, *Synonyms of the Old Testament*, 276), nuk mendoj se ky term nënkupton asgjësim (shih E. Fudge, *The Fire That Consumes [Zjarri që shkrumbon]*). Fjala “e përjetshme” përdoret si për ndëshkimin e përjetshëm, ashtu dhe për jetën e përjetshme, në Mat. 25:46. Nëse zhvlerëson njërën, zhvlerëson dhe tjetrën!

3:7-8 Popullariteti në rritje i Jezusit ishte një tjetër arsye pse i kundërviheshin krerët fetarë (shih Mat. 12:15-16; Luka 6:17-19).

3:8 “**Idumea**” Bëhet fjalë për tokat kombëtare të Edomit të lashtë, që ishte zona e prejardhjes së Herodit.

■ **“përtej Jordanit”** Bëhet fjalë për zonën e quajtur Perea, në rajonin e përtej Jordanit. Ishte një nga tre rajonet që konsideroheshin nën ligjin e Moisiut (pra, Judea, Galilea dhe toka në anën tjetër të Jordanit [pra, Perea, shih *Baba Bathra* 3:2]). Zyrtarisht, përcaktohej si toka midis lumenjve Jabok dhe Arnon (në DhV, Amon dhe Moab).

■ **“rrethinat e Tirit dhe Sidonit”** Bëhet fjalë për mbretërinë e lashtë të Fenikisë.

■ **“një numër i madh njerëzish”** Me sa duket, ishin një grup i përzier judenjsh dhe johebrenjsh.

3:9 “barkë” Bëhet fjalë për një barkë të vogël me rrema.

■ **“t’i bëhej gati gjithë kohës”** Kjo barkë ishte gjithmonë në dispozicion, që turma të mos e shtypte dhe ta hidhte në detit (shih Marku 1:45).

3:10 “ngjisheshin rreth tij” Fjalë për fjalë, “shtyheshin kundër” tij. Çdo i sëmurë donte ta prekte (shih Marku 5:25-34). Turma dukej si sallë pritjeje në urgjencën e spitalit.

3:11 Ky varg përmban një grup prej tre foljesh të pakryera, gjë që tregon përballjen e vazhdueshme të Jezusit me demonët. Shih Temën e Veçantë: Dëbimi i demonëve në Marku 1:25.

■ **“Biri i Perëndisë”** Këta demonë nuk dëshmonin për të mirën e Jezusit, por për të theksuar pritjet e gabuara të turmës. Kjo çoi në akuzën (Marku 3:22) se fuqia e Jezusit vinte nga Satani (shih Mat. 9:34; 10:25; 11:18). Krerët judenj nuk ia sfidonin dot fuqinë Jezusit, kështu që hodhën akuza të rreme për burimin e autoritetit të tij.

TEMË E VEÇANTË: BIRI I PERËNDISË (SPECIAL TOPIC: THE SON OF GOD)

Ky është një nga titujt kryesorë në DhR për Jezusin. Pa dyshim që ka ngjyrimë hyjnore. Ajo e përfshinte Jezusin si “Biri”, ose si “Biri im”, dhe Perëndisë i drejtohet me termin “Atë”. Në DhR shfaqet mbi 124 herë. Edhe vetëpërcaktimi si “Bir i Njeriut” ka ngjyrim hyjnor nga Dan. 7:13-14.

Në DhV, termi “bir” mund t’u referohet katër grupeve të veçanta.

- A. engjëjve (zakonisht, në SHUMËS, shih Zan. 6:2; Jobi 1:6; 2:1)
- B. Mbreti i Izraelit (shih 2 Sam. 7:14; Psa. 2:7; 89:26-27)
- C. kombi i Izraelit në tërësi (shih Eks. 4:22-23; LiP. 14:1; Os. 11:1; Mal. 2:10)
- D. gjykatësit e Izraelit (shih Psa. 82:6)

Ajo që lidhet me Jezusin është faza e dytë. Në këtë mënyrë, “biri i Davidit” dhe “biri i Perëndisë” lidhen me 2 Samuelin 7; Psalmi 2 dhe 89. Në DhV, “biri i Perëndisë” nuk përdoret kurrë në mënyrë të veçantë për Mesinë, përveç si mbreti eskatologjik, si një nga “ofiqtet e vajosura” të Izraelit. Sidoqoftë, në Pergamenat e Detit të Vdekur, ky titull me ngjyrimë mesianike është i zakonshëm (shih referencat e veçanta në *Dictionary of Jesus and the Gospels [Fjalori i Jezusit dhe i ungjijve]*, f. 770). Po kështu, “Biri i Perëndisë” është titull mesianik në dy vepra judaike apokaliptike në periudhën ndërthjatore (shih 2 Esdra 7:28; 13:32, 37, 52; 14:9 dhe 1 Enokut 105:2).

Sfondi i saj në DhR, kur përdoret për Jezusin, përmbledhet më së miri nga një sërë kategorish.

- 1. paraekzistenca e tij (shih Gjoni 1:1-18)
- 2. lindja e tij unike (e virgjër) (shih Mat. 1:23; Luka 1:31-35)
- 3. pagëzimi i tij (shih Mat. 3:17; Marku 1:11; Luka 3:22. Zëri i Perëndisë nga qielli bashkon mbretin mbretëror të Psalmi 2 me shërbëtorin e përvuajtur të Isaisë 53).
- 4. tundimi i tij mesianik (shih Mat. 4:1-11; Marku 1:12, 13; Luka 4:1-13). Ai tundohet për të vënë në dyshim natyrën e tij birnore, ose të paktën, që ta arrinte synimin e saj me mjete të ndryshme nga kryqi).
- 5. pranimi i tij nga rrëfyet të papranueshëm
 - a. demonët (shih Marku 1:23-25; Luka 4:31-37, 41; Marku 3:11-12, 5:7)
 - b. jobesimtarët (shih Mat. 27:43; Marku 14:61; Gjoni 19:7)
- 6. pranimi i tij nga dishepujt

- a. Mat. 14:33; 16:16
- b. Gjoni 1:34, 49; 6:69; 11:27
- 7. rrëfimi që ai dha për veten
 - a. Mateu 11:25-27
 - b. Gjoni 10:36
- 8. përdorimi nga ana e tij e metaforës familjare të Perëndisë si Atë
 - a. përdorimi i fjalës “abba” për Perëndinë
 - 1) Marku 14:36
 - 2) Romakëve 8:15
 - 3) Galatasve 4:6
 - b. përdorimi i përsëritur i fjalës Atë (*patër*) për të përshkruar marrëdhënien e tij me Perëndinë

Si përmbledhje, titulli “Bir i Perëndisë” kishte kuptim të madh teologjik për ata që e njihnin DhV dhe premtimet e kategoritë e saj, por shkruesit e DhR ishin nervozë për ta përdorur këtë term me johebrenjtë, për shkak të sfondit të tyre pagan ku “perënditë” merrnin gra dhe fëmijët që lindnin prej tyre qheshin “titanë” ose “gjigantë”.

3:12 Ky është theksi i vazhdueshëm i Markut te “sekreti mesianik”. Me fjalë dhe me vepra, Jezusi zbulohet plotësisht se është Mesia që në krye të Markut, por për shkak të keqkuptimit (1) të krerëve judenj (pra, se Mesia do të ishte hero kombëtar, që do ta ngrinte Izraelin në pozitat e dominimit botëror) dhe (2) të turmës (pra, se Mesia ishte mrekullibërës), Jezusi qorton një sërë njerëzish që të mos e trumbetojnë njohurinë e tyre për të. Ungjilli përfundon vetëm pas jetës, vdekjes, ringjalljes dhe ngritjes së tij në qiell.

TEKSTI I NASB (I PËRDITËSUAR): MARKU 3:13-19

¹³Pastaj u ngjit në mal dhe thirri ata që donte vetë, dhe erdhën tek ai. ¹⁴Dhe caktoi dymbëdhjetë, që të ishin me të dhe që t’i dërgonte për të predikuar, ¹⁵si dhe që të kishin autoritet për të dëbuar demonët. ¹⁶Dhe caktoi dymbëdhjetë: Simonin (që i vuri emrin Pjetër), ¹⁷dhe Jakobin, birin e Zebedeut, dhe Gjjonin vëllain e Jakobit (atyre iu dha emrin Boanerges, që do të thotë “Bijtë e Bubullimës”); ¹⁸dhe Andrean, dhe Filipin, dhe Bartolomeun, dhe Mateun, dhe Thomain, dhe Jakobin birin e Alfeut, dhe Tadeun, dhe Simon Zelotin, ¹⁹dhe Judë Iskariotin, që e tradhtoi.

3:13 “u ngjit në mal” Kjo mund të kuptohet në dy mënyra: (1) Jezusi e la zonën përbri detit të Galilesë dhe u ngjit në zonën kodrinore, ose (2) kjo është hyrje për kontekstin e Predikimit në Mal (shih Mat. 5-7), gjë që Marku nuk e përmend.

3:14 “caktoi dymbëdhjetë” Kjo gjendet dhe në Predikimin në Fushë, te Luka 6:12-16. Marku nuk e përmend Predikimin në Mal të Mateut (shih Mat. 5-7).

TEMË E VEÇANTË: NUMRI DYMBËDHJETË (SPECIAL TOPIC: THE NUMBER TWELVE)

Dymbëdhjeta ka qenë gjithmonë numër simbolik organizimi

- A. Jashtë Biblës
 - 1. dymbëdhjetë shenjat e Zodiakut
 - 2. dymbëdhjetë muajt e vitit
- B. Në DhV (BDB 1040, plus 797)
 - 1. bijtë e Jakobit (fiset judaike)
 - 2. reflektohet në
 - a. dymbëdhjetë shtyllat e altarit, te Eks. 24:4
 - b. dymbëdhjetë gurët e çmuar në gjoksoren e kryepriftit (që nënkupton dymbëdhjetë fiset) në Eks. 28:21
 - c. dymbëdhjetë çyrekët e bukës në vendin e shenjtë të tabernakullit, Lev. 24:5

- d. dymbëdhjetë spiunët e dërguar në Kanaan, në Num. 13 (një nga secili fis)
 - e. dymbëdhjetë shufrat (flamujt fisnorë) në rebelimin e Korës, Num. 17:2
 - f. dymbëdhjetë gurët e Jozueut, Joz. 4:3, 9, 20
 - g. dymbëdhjetë ndarjet administrative në administrimin e Solomonit, 1 Mbret. 4:7
 - h. dymbëdhjetë gurët e altarit të Elisë për JHVH-në, 1 Mbret. 18:31
- C. Në DhR
- 1. dymbëdhjetë apostujt e zgjedhur
 - 2. dymbëdhjetë shportat me bukë (një për secilin apostull) në Mat. 14:20
 - 3. dymbëdhjetë frone, ku do të ulen dishepujt e DhR (që i referohet 12 fiseve të Izraelit), në mat. 19:28
 - 4. dymbëdhjetë legjionet me engjëj për të shpëtuar Jezusin, Mat. 26:53
 - 5. simbolizmi i Zbulesës
 - a. 24 pleqtë në 24 frone, 4:4
 - b. 144,000 (12x12,000), në 7:4; 14:1, 3
 - c. dymbëdhjetë yje në kurorën e gruas, 12:1
 - d. dymbëdhjetë porta, dymbëdhjetë engjëj që reflektojnë dymbëdhjetë fiset në 21:12
 - e. dymbëdhjetë gurët e themelit të Jerusalemit të ri dhe, mbi ta, emrat e dymbëdhjetë apostujve, 21:14
 - f. dymbëdhjetë mijë stade, te 21:16 (madhësia e qytetit të ri, Jerusalemit të Ri)
 - g. muri është 144 kubitë, te 21:17
 - h. dymbëdhjetë portat me perla, te 21:21
 - i. pemët në Jerusalemin e ri me dymbëdhjetë lloje frutash (një për çdo muaj), 22:2

3:14 Këtij vargu i shtohet dhe një frazë tjetër në dorëshkrimet e lashta unciale greke Sinaitikus, Vatikanus dhe, me pak ndryshime, në kodikun e Efraemit. Faza e shtuar është “të cilët dhe i quajti apostuj” (shih shënimin në NRSV). Shumë kritikë të tekstit mendojnë se kjo shtesë është asimilim me vargun 6:13 te Luka.

▣ **“që të ishin me të”** Jezusi u përfshi ngushtësisht me trajnimin e të Dymbëdhjetëve. Robert Coleman ka shkruar dy libra të dobishëm për metodat e Jezusit: *The Master Plan of Evangelism* dhe *The Master Plan of Discipleship*. Të dy trajtojnë temën e rritjes së kishës së hershme duke përdorur të njëjtat parime si Jezusi.

▣ **“që t’i dërgonte për të predikuar”** Jezusi erdhi për të predikuar lajmin e mirë të mbretërisë. Ai i trajnoi dhe dishepujt që të bënin të njëjtën gjë: (1) të dymbëdhjetët (shih Marku 6:7-13; Mat. 10:1, 9-14; Luka 9:1-6) dhe (2) më vonë, shtatëdhjetë dishepujt (shih Luka 10:1-20).

3:15 “demonët” Ndoshta, bëhet fjalë për engjëjt e rënë, që vepronin në emër të Satanit. Mirëpo Bibla është e heshtur për origjinën e botës demoniake. Autoriteti i Jezusit mbi ta vërteton fuqinë dhe misionin e tij mesianik. Shih Temën e Veçantë në Marku 1:24.

3:16 “caktoi dymbëdhjetë” Të dymbëdhjetët përmenden katër herë në DHR (shih Mat. 10:2-4; Marku 3:16-19; Luka 6:14-16; dhe Veprat 1:13 [identik me Mat. 10:2-4]). Lista shfaqet gjithmonë në katër grupe me tre veta. Shpesh, rendi brenda grupeve ndryshon (por Pjetri është gjithmonë i pari dhe Judë Iskarioti është gjithmonë i fundit). Ka mundësi që këto grupime të reflektojnë mënyrën e rotacionit, që u lejonte këtyre burrave të ktheheshin në shtëpi herë pas here për të kryer përgjegjësitë e tyre familjare.

Është e habitshme sa pak dimë për shumicën e apostujve të hershëm. Shpesh, na mbetet të mbështetemi vetëm në traditën e kishës së hershme.

TEMË E VEÇANTË: GRAFIKU ME EMRAT E APOSTUJVE (SPECIAL TOPIC: CHART OF APOSTLES' NAMES)

	Mateu 10:2-4	Marku 3:16-19	Luka 6:14-16	Veprat 1:12-18
Grupi i parë	Simoni (Pjetri) Andrea (vëllai i Pjetrit) Jakobi (biri i Zebedeut) Gjoni (vëllai i Jakobit)	Simoni (Pjetri) Jakobi (biri i Zebedeut) Gjoni (vëllai i Jakobit) Andrea	Simoni (Pjetri) Andrea (vëllai i Pjetrit) Jakobi (biri i Zebedeut) Gjoni (vëllai i Jakobit)	Pjetri Gjoni Jakobi Andrea
Grupi i dytë	Filipi Bartolomeu Thomai Mateu (tagrambledhësi)	Filipi Bartolomeu Mateu Thomai	Filipi Bartolomeu Mateu Thomai	Filipi Thomai Bartolomeu Mateu
Grupi i tretë	Jakobi (biri i Alfeut) Tadeu Simoni (kanaaniti) Juda (Iskarioti)	Jakobi (biri i Alfeut) Tadeu Simoni (kanaaniti) Juda (Iskarioti)	Jakobi (biri i Alfeut) Simoni (zeloti) Juda (biri i Jakobit) Juda (Iskarioti)	Jakobi (biri i Alfeut) Simoni (zeloti) Juda (biri i Jakobit)

■ **“Simonin (që i vuri emrin Pjetër)”** Shumica e judenjve në Galile kishin një emër jude (p.sh., Simon, ose Simeon, që do të thotë “dëgjim”) dhe një emër grek (që nuk jepet asnjëherë). Jezusi e quan Simonin “shkëmb”. Në greqisht, është fjala *petros*, ndërsa në aramaisht është *kefa* (shih Gjoni 1:42; Mat. 16:16).

Pjetri është dëshmitari okular, burimi apostolik pas ungjillit të Markut. Shih Hyrjen për shënime të hollësishme.

3:17 “Boanerges... Bijtë e Bubullimës” Marku e përkthen këtë emër aramaik për lexuesit johebrenj (ndoshta, romakë). Këta vëllezër (pra, Jakobi dhe Gjoni) i mishërojnë vërtet këtë emërtim të Luka 9:54.

3:18 “Andrean” Në greqisht, do të thotë “burrëror”. Nga Gjoni 1:29-42, mësojmë se Andrea ishte dishepull i Gjon Pagëzorit dhe se ishte ai që e prezantoi vëllain e vet, Pjetrin, me Jezusin.

■ **“Filipin”** Në greqisht, do të thotë “ai që do kuajt”. Thirrja e tij jepet me hollësi në Gjoni 1:43-51.

■ **“Bartolomeun”** Kjo fjalë do të thotë “bir i Ptolemeut”. Ndoshta, ky është Nataneli i ungjillit të Gjonit (shih Gjoni 1:45-49; 21:20).

■ **“Mateun”** Në hebraisht, do të thotë “dhuratë e JHVH”. Bëhet fjalë për Levin (shih Marku 2:13-17).

■ **“Thomain”** Në hebraisht, do të thotë “binjak”, ose Didimus (në greqisht) (shih Gjoni 11:16; 20:24; 21:2).

■ **“Jakobin”** Është emër hebraisht. Në listën e të Dymbëdhjetëve ka dy burra që quhen Jakob. Njëri është vëllai i Gjonit (shih Marku 3:17) dhe ishte pjesë e rrethit të brendshëm (pra, Pjetri, Jakobi dhe Gjoni). Kurse ky njihet si Jakobi i vogël.

■ **“Tadeun”** Ai quhet edhe “Lebeu” (shih Mat. 10:3), ose “Juda” (shih Gjoni 14:22). Të dy emrat, edhe Tadeu dhe Lebeu, kanë kuptimin “fëmijë i dashur”.

NASB, NJB **“Simon Zelotin”**
 NKJV **“Simon Kananitin”**
 NRSV **“Simon Kananeasin”**
 TEV **“Simon Patriotin”**

Teksti greqisht i Markut shkruan “kananeasin” (shih dhe Mat. 10:4). Marku, ungjilli i të cilit u shkrua për romakët, ndoshta nuk donte që të përdorte fjalën politkisht problematike “zelot”, që bënte fjalë për një lëvizje

guerrilase judaike kundër Romës. Gjithsesi, Luka këtë term përdor për Simonin (shih Luka 6:15 dhe Veprat 1:13). Fjala “kananeas” mund të ketë disa kuptime.

1. Bën fjalë për zonën e Galileës që njihej si Kana
2. Vjen nga përdorimi i DHV i fjalës “kananeas” në kuptimin “tregtar”
3. Është emërtim i përgjithshëm i banorëve të Kananit (që quhej dhe Palestinë)

Nëse përcaktimi i Lukës është i saktë, atëherë “zelot” vjen nga fjala aramaisht që do të thotë “entuziast” (shih Luka 6:15; Veprat 1:17). Dymbëdhjetë dishepujt e zgjedhur nga Jezusi vinin nga grupe të ndryshme dhe konkurruese. Simoni ishte anëtar i një grupi nacionalist që përkrahte mposhtjen e dhunshme të autoritetit romak. Normalisht, ky Simon dhe Levi (pra, tagrambledhësi Mate) nuk do të kishin ndenjur në të njëjtën dhomë me njëritjetrin.

3:19 “Judë Iskariotin” Ka dy Simonë, dy Jakobë dhe dy Juda. “Iskariot” ka dy kuptime të mundshme: (1) banor i Keriotit në Jude (shih Joz. 15:23), ose (2) “burrë i thikës”, ose vrasës, që ndoshta do të thotë se edhe ai ishte zelot, si Simoni.

▣ **“që e tradhtoi”** Kjo folje e ka marrë ngjyrimin kuptimor nga përshkrimi që i bën Gjoni në ungjillin e vet Judës (shih Gjoni 6:71; 12:4; 13:2, 26-27; 18:2-5). Në thelb, ka thjesht kuptimin “dorëzoi në duart e autoriteteve” (shih Marku 1:14). Motivi psikologjik dhe/ose teologjik pse Juda e tradhtoi Jezusin është mister.

TEKSTI I NASB (I PËRDITËSUAR): MARKU 3:20-27

²⁰Dhe ai erdhi në shtëpi, dhe turma u mbledh sërish, madje aq sa nuk ishin dot në gjendje të hanin. ²¹Kur e dëgjuan këtë familjarët e tij, shkuan që ta merrnin me vete; sepse thoshin “e ka lënë mendja”. ²²Skribët, që kishin zbritur nga Jerusalemi, thoshin: “E ka pushtuar Beelzebuli”, dhe “Ai i dëbon demonët me anë të princit të demonëve”. ²³Dhe ai i thirri pranë vetes dhe filloi t’u fliste me shëmbëlltira: “Si mund ta dëbojë Satani Satanin? ²⁴Nëse mbretëria përçahet kundër vetes, ajo mbretëri nuk mund të qëndrojë. ²⁵Nëse shtëpia përçahet kundër vetes, ajo shtëpi nuk qëndron dot. ²⁶Nëse Satani është ngritur kundër vetes dhe është i përçarë, nuk mund të mbahet dot, por i ka ardhur fundi! ²⁷Por askush nuk mund t’i hyjë në shtëpi të fortit dhe t’ia plaçkisë pasurinë pa e lidhur më parë të fortin; pastaj, ia plaçkit shtëpinë.

3:20 “erdhi në shtëpi” Duhet të bëhet fjalë për të njëjtën shtëpi si te Marku 2:1 dhe, ndoshta, Marku 7:17; 9:38.

▣ **“turma”** Kjo ishte si rezultat i shërbesës shëruese dhe çliruese të Jezusit (shih Marku 1:45; 2:2, 13; 3:7, 20).

▣ **“aq sa nuk ishin dot në gjendje të hanin”** Kjo e shqetësoi së tepërmi familjen e tij. Jezusi kishte gjithmonë kohë për nevojtarët. U përkushtohej me mish e shpirt.

3:21

NASB, NKJV **“familjarët e tij”**

NRSV, TEV **“familja e tij”**

NJB **“të afërmit”**

Fjalë për fjalë, “ata që ishin nga ana e tij”. KJV e përkthen “miqtë”, por me sa duket bëhej fjalë për nënën dhe vëllezërit e Jezusit.

NASB **“që ta merrnin me vete”**

NKJV **“ta kapnin”**

NRSV **“ta vinin nën kontroll”**

TEV, NJB **“ta merrnin përsipër”**

Kjo është fjalë e fortë te Mateu (shih Mat. 14:3; 18:28), por zakonisht nuk përdoret në kuptimin e dhunshëm te Marku. Shpesh, përdoret për ndihmën që u jepet të sëmurëve që të ngrihen duke i kapur për dore. Familja e Jezusit u përpoq ta merrte forcërisht në shtëpi sepse mendonin se po vepronte në mënyrë të paarsyeshme (shih Marku 3:31-35).

NASB “e ka lënë mendja”
NKJV, NJB “e ka lënë truri”
NRSV “e ka humbur toruan”
TEV “është çmendur”

Teksti greqisht është i paqartë se kush i thoshte këto fjalë. I thoshte familja e tij (sipas NASB, NKJV, NJB, NIV), apo këto i thoshin të tjerët, por familja e tij i kishte dëgjuar (sipas NRSV, TEV)?

Në këtë kontekst, kjo fjalë do të thotë “i ndarë nga ekuilibri mendor” (shih 2 Kor. 5:13). Marku e përdor shpesh në kuptimin “i mahnitur” (shih Marku 2:12; 5:42).

Kjo tregon se, ndonëse Jezusi ishte popullor me turmat, keqkuptohej nga (1) vetë dishepujt e tij; (2) krerët fetarë; (3) familja e tij; dhe (4) vetë turmat.

3:22 “Skribët, që kishin zbritur nga Jerusalemi” Ndoshta, bëhet fjalë për ata që përmenden në Marku 2:6, 16, që, me sa duket, ishin delegatë zyrtarë të Sinedrit, të dërguar për të mbledhur të dhëna për mësimet dhe veprimet e Jezusit.

■ **“E ka pushtuar”** Ata po thoshin se Jezusi ishte pushtuar nga një demon dhe se fuqinë e merrte prej Satanit (shih Mat. 9:34; Gjoni 7:20; 8:48-52; 10:20). Të njëjtën gjë kishin thënë dhe për Gjon Pagëzorin (shih Mat. 11:18). Ata s’ia mohonin dot mrekullitë Jezusit, kështu që vinin në dyshim burimin e fuqisë dhe autoritetit të tij.

■ **“Beelzebuli”** Ky emër i palakueshëm shqiptohet “Beelzebub” në KJV dhe “Beelzebul” në shumicën e përkthimeve moderne. “Beel” vjen nga fjala semite *ba’al*, që do të thotë “zot”, “pronar”, “zotëri”, ose “bashkëshort”. Ishte emri i perëndisë së furtunës dhe pjellorisë në Kanaan.

“Zebul” mund të ketë kuptimin (1) lartësi (pra, mal ose qiell); (2) princ (pra, Zabul); ose (3) pleh. Shpesh, judenjtë i ndryshonin shkronjat e perëndive të huaja për të formuar një lojë tallëse fjalësh.

Nëse është “zebub”, mund të bëhet fjalë për

1. Baalin e Ekronit (shih 2 Mbre. 1:2, 3, 6)
2. Një perëndi të filistejve, Zebaba
3. Një lojë fjalësh aramaisht që do të thotë “zoti i armiqësisë” (pra, *be’el debaba*)
4. “Zoti i mizave” (aramaisht, “mizë” *dibaba*)

Shqiptimi *Beelzebub* është i panjohur në judaizmin rabinik.

Për informacione të mëtejshme për emrat që përdoren për ligësinë e personifikuar shih *The New International Dictionary of New Testament Theology*, vëll. 3, f. 468-473.

■ **“princit të demonëve”** Emri *Beelzebul* nuk ishte emër i njohur i Satanit në judaizëm. Jezusi e përdor si sinonimik me Satanin në Marku 3:23.

3:23-26 Jezusi tregoi absurditetin logjik të akuzës se ai e merrte pushtetin mbi demonët nga Satani. Është absurde të mendosh se kreu mund t’iu kundërvihet shërbëtorëve të vet!

3:23 “i thirri pranë vetes” Këtë e bëri që t’u tregonte (pra, skribëve të Markut 3:22) se ishte në gjendje t’ua lexonte mendimet (shih shënimin në Marku 2:6b). Po kështu, ky ishte një tjetër rast përta që të dëgjonin qartë mesazhin e tij.

■ **“shëmbëlltyra”** Kuptimi i fjalëpërfjalshëm i kësaj fjale (*paraboli*, që përdoret 13 herë te Marku) është “hedh përbri”. Në këtë rast, për të ilustruar një të vërtetë shpirtërore përdoret një ngjarje e zakonshme nga jeta.

3:24 “nëse” Kjo është fjali kushtore e klasit të tretë, që nënkupton veprim të mundshëm.

3:27 “pa e lidhur më parë të fortin” Kjo është referencë e fshehtë mesianike nga Isa. 49:24-25. Kjo tregonte dhe vetëdijen e Jezusit se ishte më i fortë se Satani.

Akti i dëbimit të demonëve ishte i përhapur në judaizëm (shih Marku 9:38; Veprat 19:14). Ajo që ishte e pazakontë ishte pushteti dhe autoriteti që ushtronte Jezusi në dallim nga pijet dhe formulat magjike që përdornin rabinët. Jezusi tregon qartazi se, me ardhjen e tij, Satani është mposhtur tashmë! Augustini madje e citonte Markun 3:24 si provë se mijëvjeçari i premtuar ishte i pranishëm tashmë (pra, amilenializmi).

Sot, ky varg përdoret shpesh si provë biblike se Satani “duhet lidhur” në takimet e krishtera. Por ky pasazh nuk mund të shërbejë si precedent që të krishterët të luten kundër Satanit. Besimtarët nuk udhëzohen kurrë që t’i drejtohen Satait. Ky varg është kthyer në një mantra besëtyte që s’ka lidhje fare me DHR.

TEKSTI I NASB (I PËRDITËSUAR): MARKU 3:28-30

²⁸”Me të vërtetë ju them: të gjitha mëkatet do t’u falen bijve të njerëzve, si dhe çfarëdo blasfemi që të thonë; ²⁹por kushdo që blasfemon kundër Frymës së Shenjtë nuk ka kurrë falje, por është fajtor për mëkat të përjetshëm” – ³⁰sepse po thoshin: “ka frymë të ndyrë”.

3:28 “Me të vërtetë” Fjalë për fjalë, “amen”. Përdorimi hyrës që i bën Jezusi fjalës “me të vërtetë” është unik. Zakonisht, i paraprin një thënieje të rëndësishme.

TEMË E VEÇANTË: AMEN (SPECIAL TOPIC: AMEN)

I. DHIATA E VJETËR

- A. Termi “Amen” vjen nga një fjalë hebraike që do të thotë
 - 1. “e vërtetë” (*emeth*, BDB 49)
 - 2. “vërtetësi” (*emun, emunah*, BDB 53)
 - 3. “besim” ose “besnikëri”
 - 4. “besim te dikush” (*dmn*, BDB 52)
- B. Etimologjia e saj vjen nga qëndrimi fizik i qëndrueshëm i dikujt. E kundërta do të ishte një njeri që është i paqëndrueshëm, që rrëshqet (shih Psalmi 40:2; 73:18; Jeremia 23:12), ose që pengohet (shih Psa. 73:2). Nga ky përdorim i fjalëpërfjalshëm u zhvillua zgjerimi metaforik i kuptimit “besnik, i besueshëm, i besës dhe me integritet” (shih Zan. 15:6; Hab. 2:4).
- C. Përdorimet e veçanta
 - 1. Shtyllë, 2 Mbret. 18:16 (1 Tim. 3:15)
 - 2. Siguri, Eks. 17:12
 - 3. Palëvizshmëri, Eks. 17:12
 - 4. Qëndrueshmëri, Isa. 33:6
 - 5. I vërtetë, 1 Mbret. 10:6; 17:24; 22:16; Fja. 12:22
 - 6. I patundur, 2 Kro. 20:20; Isa. 7:9
 - 7. I besueshëm (Torahu), Psa. 119:43, 142, 151, 160
- D. Në DhR përdoren dhe ty fjalë të tjera hebraisht për besimin veprues.
 - 1. *bathakh* (BDB, 105), besim
 - 2. *jëra* (BDB 431), frikë, respekt, adhurim (shih Zan. 22:12)
- E. Nga kuptimi i besimit ose besueshmërisë u zhvillua dhe një përdorim liturgjik që u përdor për të mbështetur një pohim besnik ose të vërtetë të një tjetri (shih LiP. 27:15-26; Neh. 8:6; Psa. 41:13; 72:19; 89:52; 106:48).
- F. Çelësi teologjik për këtë term nuk është besnikëria e njerëzimit, por ajo e JHVH-së (shih Eks. 34:6; LiP. 32:4; Psa. 108:4; 115:1; 117:2; 138:2). Shpresa e vetme e njerëzimit të rënë është besnikëria besnike dhe e mëshirshme e JHVH-së ndaj besëlidhjes dhe premtimet e tij. Ata që njohin JHVH-në duhet të jenë si ai (shih Hab. 2:4). Bibla është historia që dokumenton ripërtëritjen që i bën Perëndia shëmbëllimit të vet (shih Zan. 1:26-27) në njerëzimin. Shpëtimi i rikthen njerëzimit aftësinë për të patur bashkësi të ngushtë me Perëndinë. Kjo është arsyeja pse jemi krijuar.

II. DHIATA E RE

- A. Përdorimi i fjalës “amen” si pohim përmbyllës liturgjik i besueshmërisë së një pohimi të caktuar është i zakonshëm në DhR (shih 1 Kor. 14:16; 2 Kor. 1:20; Zbu. 1:7; 5:14; 7:12).
- B. Përdorimi i këtij termi në përmbyllje të lutjeve është i zakonshëm në DhR (shih Rom. 1:25; 9:5; 11:36; 16:27; Gal. 1:5; 6:18; Efe. 3:21; Fil. 4:20; 2 Thes. 3:18; 1 Tim. 1:17; 6:16; 2 Tim. 4:18).
- C. Jezusi është i vetmi që përdori këtë term (shpesh, i dyfishuar te Gjoni) për të prezantuar pohime të rëndësishme (shih Luka 4:24; 12:37; 18:17, 29; 21:32; 23:43)
- D. Përdoret si titull për Jezusin te Zbu. 3:14 (ndoshta, titull i JHVH-së nga Isa. 65:16).

E. Koncepti i besueshmërisë, besimit, besnikërisë, ose besimit në dikë shprehet me termin greqisht *pistos* ose *pistis*, që në anglisht përkthehet “besim te dikush”, “besim në dikë”, “besoj”.

■ **“të gjitha mëkatet do t’u falen bijve të njerëve, si dhe çdo blasfemi që do të thonë”** Kjo tregon diapazonin e hirit të Perëndisë në Krishtin. Fraza “bijve të njerëzve” është një term i zakonshëm semit që nënkupton qeniet njerëzore (shih Psa. 8:4; Ezek. 2:1).

3:29 “por kushdo që blasfemon kundër Frymës së Shenjtë” Kjo duhet kuptuar në kontekstin e vet historik para ditës së Rrëshajëve. Nënkupton refuzimi e së vërtetës së Perëndisë. Mësimet e këtij vargu, shpeshherë, janë quajtur “mëkati i pafalshëm”. Por kjo duhet interpretuar në dritën e kriterëve të mëposhtme:

1. Dallimi në DHV mes mëkateve “të qëllimshme” dhe “të paqëllimshme” (shih Num. 15:27-31)
2. Mosbesimi i familjes së Jezusit në dallim me mosbesimin e farisenjve në këtë kontekst
3. Thëniet për faljen në Marku 3:28
4. Dallimet mes paraleleve të ungjijve, sidomos ndryshimi i “birit të njeriut” (shih Mat. 12:32; Luka 12:10) në “bijtë e njerëzve” (shih Mat. 12:31; Marku 3:28).

Në dritën e sa thamë më sipër, ky mëkat kryhet prej atyre që, në praninë një drite dhe njohurie të madhe, gjithsesi e hedhin poshtë Jezusin si mjetin hyjnor të zbulësës dhe shpëtimit. Ata e kthejnë dritën e ungjillit në errësirën e Satanit (shih Marku 3:30). E refuzojnë tërheqjen dhe bindjen e Frymës (shih Gjoni 6:44, 65). Mëkati i pafalshëm nuk është refuzim nga Perëndia për shkak të një veprimi ose fjale të caktuar, por për shkak të refuzimi të vazhdueshëm të Perëndisë në Krishtin me anë të një mosbesimi të qëllimshëm (si në rastin e skribve dhe farisenjve).

Ky mëkat mund të kryhet vetëm prej atyre që e kanë dëgjuar ungjillin. Ata që kanë dëgjuar qartë mesazhin për Jezusin janë më të përgjegjshmit për refuzimin e tij. Kjo është veçanërisht e vërtetë për kulturat moderne që e dëgjojnë vazhdimisht ungjillin, por e refuzojnë Jezusin (p.sh., Amerika, kultura perëndimore).

Për faktin se Fryma e Shenjtë është Personi i tretë i Trinisë, shih Temën e Veçanë më poshtë.

TEMË E VEÇANTË: PERSONALITETI I FRYMËS (SPECIAL TOPIC: THE PERSONHOOD OF THE SPIRIT)

Në DhV, “Fryma e Perëndisë” (pra, *ruakh*) ishte një forcë që përmbushte synimin e JHVH-së, por nuk na aludohet se ai ishte person (pra, në monoteizmin e DhV). Mirëpo, në DhR, dokumentohet personaliteti i plotë i Frymës.

1. Ai mund të shahet (shih Mat. 12:31; Marku 3:29)
2. Mëson të tjerët (shih Luka 12:12; Gjoni 14:26)
3. Dëshmon (shih Gjoni 15:26)
4. Bind, drejton (shih Gjoni 16:7-15)
5. Quhet “dikush” (pra, *hos*, Efe. 1:14)
6. Mund të brengoset (shih Efe. 4:30)
7. Mund të shuhet (shih 1 Thes. 5:19)
8. Mund të kundërshtohet (shih Veprat 7:51)
9. Mbron besimtarët si avokat (shih Gjoni 14:26; 15:26; 16:7)
10. Përlëvdon Birin (shih Gjoni 16:14)

Edhe pasazhet trinitare flasin për tre persona.

1. Mat. 28:19
2. 2 Kor. 13:14
3. 1 Pjet. 1:2

Ndonëse në greqish fjala “frymë” (*pneuma*) është në gjininë ASNJANËSE, kur bëhet fjalë për Frymën, DHR shpesh përdor PERËMRIN VETOR MASHKULLOR (shih Gjoni 16:8, 13-14).

Fryma lidhet me veprimtarinë njerëzore.

1. Veprat 15:28

2. Rom. 8:26
3. 1 Kor. 12:1
4. Efe. 4:30

Roli i Frymës theksohet që në fillim të Veprave (njësoj si në ungjillin e Gjonit). Dita e Rrëshajave nuk ishte fillimi i punës së Frymës, por një kapitull i ri. Jezusi kishte gjithmonë Frymën. Pagëzimi i tij nuk ishte fillimi i punës së Frymës, por një kapitull i ri. Luka e përgatit kishën për një kapitull të ri shërbese të efektshme. Jezusi është ende fokusi, fryma është ende mjeti i efektshëm dhe synimi është dashuria, falja e Atit dhe rimëkëmbja e gjithë njerëzve të krijuar në shëmbëllimin e tij (shih Temën e Veçantë: Plani i përjetshëm shpengues i JHVH)!

▣ **“nuk ka kurrë falje”** Kjo thënie duhet interpretuar në bazë të Markut 3:28.

▣ **“por është fajtor për mëkat të përjetshëm”** Ky ishte refuzimi i qëllimshëm i ungjillit (pra, i personalitetit dhe veprave të Jezusit) në prani të një drite të fortë!

Ka shumë variante në lidhje me frazën “mëkat të përjetshëm”. Disa dorëshkrime të lashta greke

1. E kanë ndryshuar në frazë gjinore (pra, *hamartias*) – C*, D, W
2. Kanë shtuar fjalën “të gjykimit” (pra, *kriseos*) – A dhe C² (shih KJV)
3. Kanë shtuar “të ndëshkimit” (pra, *kolaseosi*), dorëshkrimi minuskul 1234

Për disa kopjues të hershëm, ishte tronditëse të bëhej fjalë për “mëkat të përjetshëm”.

UBS4 i jep termit “mëkat të përjetshëm” vlerësin B (pra, pothuajse e sigurt që është në tekstin original).

TEMË E VEÇANTË: I PËRJETSHËM (*aiōnios*) (SPECIAL TOPIC: ETERNAL [*aiōnios*])

Robert B. Girdlestone, në librin e vet *Synonyms of the Old Testament*, ka një koment interesant për fjalën “i përjetshëm”:

“Mbiemri *aiōnios* përdoret më tepër se dyzet herë në DHV në lidhje me jetën e përjetshme, e cila konsiderohet pjesërisht si dhuratë e tanishme, dhe pjesërisht si premtim për të ardhmen. Po kështu, përdoret edhe për ekzistencën e pafundme të Perëndisë në Rom. 16:26; për efikasitetin e pafundmë të shlyerjes së Krishtit në Heb. 9:12; 13:20; si dhe për epokat e shkuara në Rom. 16:25; 2 Tim. 1:9; Titi 1:2.

Kjo fjalët përdoret edhe për ferrin e përjetshëm (Mat. 18:8; 25:41; Juda 1:7), ndëshkimin e përjetshëm (Mat. 25:46), gjykimin ose dënimin e përjetshëm (Marku 3:29; Heb. 6:2) dhe shkatërrimin e përjetshëm (2 Thes. 1:9). Kjo fjalë në këto pasazhe nënkupton fund pa kthim dhe, me sa duket, nënkupton se, kur të zbatohen këto gjykime, koha e provës, ndryshimit, ose mundësisë për të ndryshuar jetën, do të kenë marrë fund absolutisht dhe një herë e përgjithmonë. Në kuptojmë shumë pak gjëra për të ardhmen, për lidhjen e jetës njerëzore me pjesën tjetër të ekzistencës, die dhe për peshën morale të mosbesimit, kur i shohim në dritën e përjetësisë. Nëse, nga njëra anë, është gabim t’i shtosh fjalës së Perëndisë, nga ana tjetër, është gabim t’i heqim diçka asaj; dhe nëse e kemi vështirë të kuptojmë doktrinën e ndëshkimit të përjetshëm që na shpaloset në Bibël, duhet të kënaqemi që të presim, të mbahemi fort pas ungjillit të dashurisë së Perëndisë në Krishtin, dhe të pranojmë se ekziton një sfond i mistershëm që s’jemi në gjendje ta kuptojmë” (f. 318-319).

TEMË E VEÇANTË: PROCEDURA EKSEGJETIKE PËR INTERPRETIMIN E “MËKATIT TË PAFALSHËM” (SPECIAL TOPIC: EXEGETICAL PROCEDURES FOR INTERPRETING “THE UNPARDONABLE SIN”)

- A. Mos harroni se ungjijtë reflektojnë një kontekst judaik
 1. Dy lloje mëkatesh (shih Lev. 4:2, 22, 27; 5:15, 17-19; Num. 15:27-31; LiP. 1:43; 17:12-13)
 - a. të paqëllimshëm
 - b. të qëllimshëm
 2. Konteksti judaik para Rrëshajave (pra, përmbushja e ungjillit dhe Frymës nuk janë shfaqur ende)
- B. Vini re kontekstin letrar të Markut 3:22-30

1. Mosbesimi i vetë familjes së Jezusit (shih 3:31-32)
 2. Mosbesimi i farisenjve (shih 2:24; 3:1, 6, 22)
- C. Krahasoni paralelet ku titulli “Bir i Njeriut” ndryshon në “bij njerëzish”
1. Mat. 12:22-37 (pra, 12:32, “një fjalë kundër Birit të Njeriut”)
 2. Luka 11:14-26; 12:8-12 (pra, 12:10, “një fjalë kundër Birit të Njeriut”)
 3. Marku 3:28 (pra, “Të gjitha mëkatet do t’u falen bijve të njerëzve”)

Mëkati i pafalshëm është refuzimi i vazhdueshëm i Jezusit në prani të dritës së madhe hyjnore. Farisenjtë e kuptuan qartë, por s’pranuan të besonin. Në këtë kuptim, kjo lidhet me “mëkatin që çon në vdekje” në 1 Gjonit (shih Temën e Veçantë: Mëkati në vdekje).

TEKSTI I NASB (I PËRDITËSUAR): MARKU 3:31-35

³¹Pastaj, mbërriti nëna dhe vëllezërit e tij; qëndruan jashtë dhe i dërguan fjalë dhe e thirrën. ³²Rreth tij ishte ulur një turmë dhe i thanë: “Ja, nëna dhe vëllezërit e tu janë jashtë dhe po të kërkojnë”. ³³Duke iu përgjigjur, u tha: “Kush janë nëna ime dhe vëllezërit e mi?” ³⁴Si pa rreth e rrotull ata që ishin ulur rreth tij, tha: “Ja, nëna ime dhe vëllezërit e mi! ³⁵Sepse kushdo që kryen vullnetin e Perëndisë, është vëllai, motra dhe nëna ime”.

3:31-35 Këto vargjet lidhen me Markun 3:21. Ka një kontrast të qartë mes mosbesimit të paditur, por të dhimbsur, të familjes së Jezusit (shih Gjoni 7:5) dhe mosbesimit të qëllimshëm dhe armiqtësor të krerëve fetarë. Jezusi thotë qartë se vullneti i Perëndisë është besimi në të (shih Gjoni 6:40; 14:6).

3:33 “Kush janë nëna ime dhe vëllezërit e mi?” Kjo pyetje tronditëse tregon botëkuptimin e Jezusit dhe natyrën radikale të besimit biblike, që mund të përshkruhet vetëm me fjalët e një lindjeje të re, e një familjeje të re. Jeta familjare ishte aspekt tejet i rëndësishëm i jetës judaike; prandaj, përdorimi i termave familjare për bashkëbesimtarët është shumë domethënës. Besimtarët lidhen me Hyjninë si pjesëtarë të familjes; Perëndia është Ati, Jezusi është Biri i pashoq dhe Shpëtitari, kurse ne jemi fëmijë të Perëndisë.

3:35 “Sepse kushdo që kryen vullnetin e Perëndisë” Besimi në Krishtin është vullneti i Perëndisë për gjithë njerëzit (shih Gjoni 1:12; 3:16; 6:40; 14:6; 1 Gjonit 5:12, 13). Shih Temën e Veçantë: Vullneti i Perëndisë në 1 Pje. 2:15. Vini re ftesën përfshirëse dhe mbarëbotërore që njerëzit t’i përgjigjen me besim Jezusit dhe mesazhit të tij.

PYETJE PËR DISKUTIM

Ky është një komentuar studimor udhëzues, që do të thotë se ti je vetë përgjegjës për interpretimin e Biblës. Secili prej nesh duhet të ecë sipas dritës që ka. Ti, Bibla dhe Fryma e Shenjtë keni përparësi në interpretim. Nuk duhet t’ia dorëzosh këtë të drejtë komentuesit.

Këto pyetje për diskutim t’i kam dhënë për të të ndihmuar që të analizosh çështjet kryesore të kësaj pjese të librit. Ato synojnë të të nxisin mendimin, jo të kenë natyrë shteruese.

1. Pse konteksti i Lukës ndryshon nga ai i Markut? (Marku 3:22-30)
Çfarë i shton rrëfimi i Mateut atij të Markut?
2. Pse hodhën krerët fetarë këto akuza kundër Jezusit në këtë kapitull? A nuk e dinin si ishte e vërteta?
3. Pse përpiqet të arsyetojë me ta Jezusi?
4. Çfarë është “mëkati i pafalshëm”?
5. Në ç’kontekst mund të kryhet mëkati i pafalshëm sot? A mund ta dijë ai/ajo që e ka kryer?
6. A lidhet ky pasazh për mëkatin e pafalshëm me 1 Gjonin 5:16 ose me Heb. 6 dhe 10?

7. Si lidhet ky mëkat me shpëtimin? Si lidhet ky mëkat me mosbesimin e familjes së Jezusit?
8. A është blasfemia kundër Jezusit e falshme, kurse ajo kundër Frymës së Shenjtë e pafalshme? Cili është dallimi mes tyre (krahaso Mat. 12:31-32 me Lukën 12:10 dhe Markun 3:28)?

MARKU 4

NDARJET NË PARAGRAFË TË PËRKTHIMEVE MODERNE

UBS ⁴	NKJV	NRSV	TEV	NJB
Shëmbëlltyra e mbjellësit 4:1-9	Shëmbëlltyra e mbjellësit 4:1-9	Mësimi me shëmbëlltyra 4:1-9	Shëmbëlltyra e mbjellësit 4:1-2 4:3-8 4:9	Shëmbëlltyra e mbjellësit 4:1-9
Qëllimi i shëmbëlltyrave 4:10-12	Qëllimi i shëmbëlltyrave 4:10-12	4:10-12	Qëllimi i shëmbëlltyrave 4:10-12	Pse fliste Jezusi me shëmbëlltyra 4:10-12
Shpjegimi i shëmbëlltyrës së mbjellësit 4:13-20	Shpjegimi i shëmbëlltyrës së mbjellësit 4:13-20	4:13-20	Jezusi shpjegon shëmbëlltyrën e mbjellësit 4:13-20	Shpjegimi i shëmbëlltyrës së mbjellësit 4:13-20
Drita nën magje 4:21-23	Drita nën shportë 4:21-25	4:21-25	Drita nën babune 4:21-23	Pranimi dhe trajtimi i mësimin të Jezusit 4:21-23
4:24-25			4:24-25	Shëmbëlltyra e masës 4:24-25
Shëmbëlltyra e rritjes së farës 4:26-29	Shëmbëlltyra e rritjes së farës 4:26-29	Fara që rritet fshehtazi 4:26-29	Shëmbëlltyra e rritjes së farës 4:26-29	Shëmbëlltyra e farës që rritet vetvetiu 4:26-29
Shëmbëlltyra e farës së sinapit 4:30-32	Shëmbëlltyra e farës së sinapit 4:30-32	Fara e sinapit 4:30-32	Shëmbëlltyra e farës së sinapit 4:30-32	Shëmbëlltyra e farës së sinapit 4:30-32
Përdorimi i shëmbëlltyrave 4:33-34	Përdorimi i shëmbëlltyrave nga Jezusi 4:33-34	4:33-34	4:33-34	Përdorimi i shëmbëlltyrave 4:33-34
Fashitja e stuhisë 4:35-41	Era dhe valët binden 4:35-41	Era dhe deti fashiten 4:35-41	Jezusi fashit stuhinë 4:35-38 4:39-40 4:41	Fashitja e stuhisë 4:35-41

CIKLI TRE I LEXIMIT (shih f. v)

NDJEKJA E SYNIMIT TË AUTORIT FILLESTAR NË NIVELIN E PARAGRAFËVE

Ky është një komentuar studimor udhëzues, që do të thotë se ti je vetë përgjegjës për interpretimin e Biblës. Secili prej nesh duhet të ecë sipas dritës që ka. Ti, Bibla dhe Fryma e Shenjtë keni përparësi në interpretim. Nuk duhet t'ia dorëzosh këtë të drejtë komentuesit.

Lexo gjithë kapitullin njëherësh. Identifiko temat. Krahaso ndarjet e tua tematike me pesë përkthimet moderne. Ndarja në paragrafë nuk është e frymëzuar, por është çelësi për të ndjekur synimin e autorit fillestar, gjë që është thelbi i interpretimit. Secili paragraf ka vetëm një temë të vetme.

1. Paragrafi i parë
2. Paragrafi i dytë
3. Paragrafi i tretë

4. Etj.

MËSIMET KONTEKSTUALE

- A. Disa nga kapitujt vijues të Markut reflektojnë kundërshtimin në rritje të krerëve fetarë. Marku ia kundërve popullaritetin e Jezusit në popull mospopullaritetit të tij në krerët fetarë.
- B. Jezusi ka kaluar nga predikimet në sinagoga te takimet në natyrë. Kjo ishte një mënyrë për ta ulur ndikimin e krerëve fetarë dhe për t'i dhënë më shumë mundësi popullatës në tërësi që të dëgjonte fjalët e tij.
- C. Të kuptuarit e shëmbëlltyrave lidhej (dhe ende lidhet) me besimin paraprak. As apostujt nuk i kuptuan në fillim mësimet shëmbëlltyrore të Jezusit. Në disa mënyra, të kuptuarit varet nga
1. zgjedhja
 2. fuqia përndritëse e Frymës
 3. gatishmëria për t'u penduar dhe besuar
- D. “Shëmbëlltyra” është fjalë e përbërë në greqisht, që do të thotë “hedh përbri”. Ngjarje të përditshme përdorehin për të ilustruar të vërteta shpirtërore. Megjithatë, duhet mos harruar se, për shkruarit e ungjillit, kjo fjalë greke reflektonte fjalën hebraisht *mashal* (BDB 605), që donte të thoshte “gjëzë” ose “fjalë e urtë”, fjalë urtësie. Dëgjuesi duhet të jetë i gatshëm t'i rimendojë çështjet dhe rezultatet e pritura në dritën e natyrës së mahnitshme të mbretërisë së Perëndisë, që tani është e pranishme në Jezusin. Për disa dëgjues, shëmbëlltyrat e fshehin të vërtetën (shih Marku 4:10-12).
- E. Shëmbëlltyrat në Marku 4 përmenden dhe te Mateu e Luka

Marku

Mateu

Luka

Katër llojet e dheut

4:3-20

Llamba e fshehur

13:3-23

8:5-15

4:21-25

Fara e sinapit

4:30-32

13:31-32

Përdorimi i shëmbëlltyrave

4:33-34

13:33-35

(shih Marku 4:10-12)

- F. Shëmbëlltyra e Llojit të Dheut, ose Shëmbëlltyra e Mbjellësit, që gjendet në të tre ungjijtë sinoptikë, përbën çelësin interpretues për gjithë shëmbëlltyrat e tjera. Jezusi u siguroi që t'ua shpjegonte veçmas dishepujve. Deri në atë çast, ata nuk kuptonin; po atëherë si mund të kuptonin të tjerët? Kjo shëmbëlltyrë ka disa aspekte tipologjike dhe/ose alegorike që duhen identifikuar, përndryshe s'kemi për ta rrokur kuptimin e vërtetë të saj.
- G. Marku 4:21-25 përsëritet te Mateu në kontekste të tjera:
- Marku 4:21 – Mateu 5:15
 - Marku 4:22 – Mateu 10:26
 - Marku 2:24 – Mateu 7:2
 - Marku 4:25 – Mateu 13:12; 25:29

Ka të paktën dy shpjegime:

1. Jezusi i përsëriti dhe i rizatoi mësimet dhe ilustrimet e tij për grupe të ndryshme dhe në kohë të ndryshme.

2. Shkruesit e ungjijve përzgjedhin, rendisin dhe përshtasin fjalët e Jezusit për qëllimet e tyre letrare dhe teologjike (shih *How to Read the Bible for All Its Worth*, nga Gordon Fee dhe Doug Stuart, f. 113-134).

H. Marku përmend një sërë mrekullish që zbulojnë fuqinë dhe autoritetin e Jezusit në Marku 4:35-8:26. Këto mrekulli synonin të provonin vërtetësinë e mësimëve të reja dhe radikale të Jezusit. Krishti e ktheu veten në thelbin e çështjes!

TEMË E VEÇANTË: INTERPRETIMI I SHËMBËLLTYRAVE (SPECIAL TOPIC: INTERPRETING PARABLES)

Ungjijtë sinoptikë u shkruan shumë vjet pas jetës së Jezusit. Ungjilltarët (me ndihmën e Frymës) ishin mësuar nga ana kulturore me traditat gojore. Rabinët mësonin duke e paraqitur mësimin gojarisht. Edhe Jezusi e imitoi këtë qasje gojore në lidhje me mësimdhënien. Me aq sa dimë, nuk shkroi asnjë nga mësimet ose predikimet e veta. Si ndihmë për kujtesën, ai i përsëriste, përmblydhte dhe ilustronte prezantimet e mësimëve të tij. Edhe ungjilltarët i ruajtën këto ndihma kujtese. Shëmbëlltyrat, që janë të vështira për t'u përcaktuar, janë një nga këto teknika.

“Shëmbëlltyrat përcaktohen më saktë si ndodhi me dy nivele kuptimore; niveli i ndodhisë siguron një pasqyrë me të cilën perceptohet dhe kuptohet realiteti”. *Dictionary of Jesus and His Gospels* (f. 594).

“Shëmbëlltyra është një thënie ose ndodhi, që përpiqet të përçojë një ide që folësi dëshiron ta theksojë duke e ilustruar me një situatë të njohur nga jeta e përditshme”. *The Zondervan Pictorial Bible Encyclopedia* (f. 590).

Është e vështirë të përcaktohet saktësisht se ç' nënkuptonte fjala “shëmbëlltyrë” në kohën e Jezusit.

1. Disa thonë se ajo reflekton termin hebraisht *mashal*, që ishte një lloj gjëagjëze (Marku 3:23), fjalë e urtë (Fjalët e Urta, Luka 4:23), thënie e shkurtër (Marku 7:15), apo thënie e mistershme (“thënie e errët”).
2. Disa të tjerë përkrahin përcaktimin më të kufizuar të ndodhisë së shkurtër.

Në varësi të mënyrës si e përcaktojmë këtë term. Mbi një e treta e mësimëve të Jezusit, që na janë transmetuar me shkrim, kanë formë shëmbëlltyre. Ajo ishte një gjini kryesore letrare në DHR. Shëmbëlltyrat janë, pa dyshim, thënie që Jezusi i tha vërtet. Nëse pranojmë përcaktimin e dytë, ka gjithsesi lloje të ndryshme ndodhish të shkurtra:

1. Ndodhi të thjeshta (Luka 13:6-9)
2. Ndodhi të ndërlikuara (Luka 15:11-32)
3. Ndodhi të kundërta (Luka 16:1-8; 18:1-8)
4. Tipologjike/alegorike (Mat. 13:24-30, 47-50; Luka 8:4-8, 11-15; 10:25-37; 14:16-24; 20:9-19; Gjoni 10; 15:1-8)

Në trajtimin e kësaj llojshmërie materiali shëmbëlltyrash, këto thënie duhen interpretuar në një sërë nivelesh. Niveli i parë janë parimet e përgjithshme hermeneutike, që vlejnë për të gjitha gjinitë biblike. Disa udhëzime:

1. identifikoj qëllimin e gjithë librit ose, të paktën, e njësisë më të plotë letrare
2. identifikoj audiencën e parë. Është e rëndësishme kur, shpesh, e njëjta shëmbëlltyra iu thuhet grupeve të ndryshme, si për shembull:
 - a. delet e humbura, te Luka 15, iu drejtohet mëkatarëve
 - b. delja e humbur, te Mat. 18, iu drejtohet dishepujve
3. sigurohu që të vësh re kontekstin e atypëratyshëm të shëmbëlltyrës. Shpesh, Jezusi ose shkruesi i ungjillit e thotë vetë idenë kryesore (zakonisht, në fund të shëmbëlltyrës, ose menjëherë pas saj)
4. shprehe synimin(et) qëndror të shëmbëlltyrës me një fjali të vetme dëftore. Shpesh, shëmbëlltyrat kanë dy ose tre protagonistë. Zakonisht, jepet nga një e vërtetë, synim, ose ide e nënkuptuar për çdo personazh (Luka 15:11-22 ka 3 personazhe, kurse shëmbëlltyra e Samaritanit të Mirë, jo; Luka

10:25-37)

5. Shqyrto pasazhet paralele në ungjijtë e tjerë, pastaj në librat e tjerë të DHR ose të DHV

Niveli i dytë i parimeve interpretuese janë ato që lidhen në mënyrë të veçantë me materialet e shëmbëlltyrave:

1. Lexoje (dëgjoje, nëse është e mundur) disa herë shëmbëlltyrën. Ato jepeshin për të patur ndikim gojor, jo për t'u analizuar me shkrim.
2. Shumica e shëmbëlltyrave kanë vetëm një të vërtetë qendrore, që lidhet me kontekstet historike dhe letrare të Jezusit dhe/ose ungjilltarit.
3. Kujdes kur interpreton hollësitë. Shpesh, ato janë thjesht pjesë e peizazhit të ndodhisë.
4. Mos harro se shëmbëlltyrat nuk janë realitet. Ato janë analogji të marra nga jeta, por shpesh janë teprime që synojnë të përçojnë një ide (të vërtetë) të caktuar.
5. Identifiko pikat kryesore të ndodhisë, siç do t'i kishin kuptuar dëgjuesit judenj të shekullit të parë (Kenneth E. Bailey, *Jesus Through Middle Eastern Eyes*). Pasta, gjej kthesën e ndodhisë, ose pikën e surprizës. Zakonisht, ajo vjen në fund të ndodhisë (shih A. Berkeley Mickelsen, *Interpreting the Bible*, f. 221-224).
6. Të gjitha shëmbëlltyrat jepeshin për të ngjallur një reagim te dëgjuesi. Ai reagim, zakonisht, lidhet me konceptin e "Mbretërisë së Perëndisë". Jezusi ishte inauguruesi i Mbretërisë së re Mesianike (Mat. 21:31; Luka 17:21). Ata që e dëgjonin Jezusin, duhet t'i përgjigjeshin në çast! Mbretëria ishte edhe e ardhme (Mat. 25). E ardhmja e njeriut varej nga mënyra si do t'i përgjigjej Jezusit në atë çast. Shëmbëlltyrat e mbretërisë përshkruanin mbretërinë e re që kishte ardhur në Jezusin. Ato përshkruanin kërkesat etike dhe rrënjësore të kësaj mbretërie për dishepullizimin. Asgjë s'mund të jetë më si më parë. Gjithçka është rrënjësisht e re dhe e përqendruar në Jezusin!
7. Shpesh, shëmbëlltyrat nuk e shprehin shkoqur idenë ose të vërtetën e tyre qendrore. Interpretuesi duhet të kërkojë çelsat kontekstuale që zbulojnë të vërtetat qendrore, të cilat asokohe ishin të qarta nga ana kulturore për dëgjuesit e parë, por që tani janë të paqarta për ne.

Një nivel i tretë, që zakonisht është i debatueshëm, është ai natyrës së fshehur të së vërtetës shëmbëlltyrore. Jezusi fliste shpesh për natyrën e fshehur të shëmbëlltyrave (shih Mat. 13:9-15; Marku 4:9-13; Luka 8:8-10; Gjoni 10:6; 16:25). Kjo lidhet me profecinë e Isa. 6:9-10. Zemra e dëgjuesit përcakton nivelin e kuptueshmërisë (shih Mat. 11:15; 13:9,15,16,43; Marku 4:9,23,33-34; 7:16; 8:18; Luka 8:8; 9:44; 14:35).

Megjithatë, duhet thënë gjithashtu se, shpesh, turma (Mat. 15:10; Marku 7:14) dhe farisenjtë (Mat. 21:45; Marku 12:12; Luka 20:19) e kuptonin plotësisht ku e kishte fjalën Jezusi, por nuk pranonin t'i përgjigjeshin si duhet me besim dhe pendesë. Në njëfarë kuptimi, kjo është e vërteta e Shëmbëlltyrës së Ilojeve të dheut (Mat. 13; Marku 4; Luka 8). Shëmbëlltyrat ishin mjet për ta fshehur ose zbuluar të vërtetën (Mat. 13:16-17; 16:12; 17:13; Luka 8:10; 10:23-24).

Grant Osborne, në *Hermeneutical Spiral*, f. 239, hedh idenë se "shëmbëlltyrat janë 'mekanizëm përballjeje' dhe funksionojnë ndryshe në varësi të dëgjuesve.... Secili grup (krerët, turma, dishepujt) përballen ndryshe nga shëmbëlltyrat". Shpesh, edhe dishepujt nuk ia kuptonin shëmbëlltyrat ose mësimet Jezusit (shih Mat. 15:16; Marku 6:52; 8:17-18,21; 9:32; Luka 9:45; 18:34; Gjoni 12:16).

Edhe niveli i katërt ka shkaktuar polemika. Ka të bëjë me të vërtetën qendrore të shëmbëlltyrave. Shumica e interpretuesve modernë kanë reaguar (dhe me të drejtë) kundër interpretimit alegorik të shëmbëlltyrave. Alegoria i kthente hollësitë në sisteme të detajuara të së vërtetës. Kjo metodë interpretimi nuk përqendrohej te konteksti historik, konteksti letrar, apo te synimi i autorit, por paraqiste mendimin e interpretuesit, jo të pasazhit.

Megjithatë, duhet pranuar se shëmbëlltyrat që Jezusi i interpretoi vetë janë shumë pranë interpretimit alegorik, ose të paktën, tipologjik. Jezusi i përdorte hollësitë për të përçuar disa të vërteta (Mbjellësi, Mateu 13; Marku 4; Luka 8 dhe Rojtarët e Ligj të Vreshtit, Mat. 21; Marku 12; Luka 20).

Ka dhe shëmbëlltyra që përmbajnë disa të vërteta kryesore. Një shembull i tillë është shëmbëlltyra e

Birit Plangprishës (Luka 15:11-32). Thelbësor për të rrokur kuptimin e plotë të kësaj shëmbëlltyre është jo vetëm dashuria e Atit dhe sjellja rebele e djalit të vogël, por edhe qëndrimi i djalit të madh.

Një citim i dobishëm nga *Linguistics and Biblical Interpretation* i Peter Cotterell dhe Max Turner thotë:

“Më shumë se çdo tjetër, ishte Adul Julicher ai që e drejtoi mendimin e studiuesve të Dhiatës së Re drejt një përpjekjeje vendimtare për të kuptuar rolin e shëmbëlltyrave në mësimet e Jezusit. Alegorizimi rrënjësor i shëmbëlltyrave u braktis dhe, kështu, nisi kërkimi për të gjetur çelësin që do të na mundësonte depërtimin në kuptimin e vërtetë të shëmbëlltyrave. Por, siç e bëri të qartë dhe Jeremias, ‘Përpjekjet për t’i çliruar shëmbëlltyrat nga interpretimet e çuditshme dhe arbitrare të çdo detaji bënë që dhe Julicher vetë të binte në një gabim fatal’. Gabimi ishte se ai nuk këmbëntulte thjesht që shëmbëlltyra duhet kuptuar sikur përçon një ide të vetme, por se ajo ide duhet të ishte sa më e përgjithshme që të ishte e mundur” (f. 308).

Një tjetër citim i dobishëm vjen nga *The Hermeneutical Spiral*, e Grant Osborne:

“Mirëpo unë kam parë shumë tregues se shëmbëlltyra janë vërtet alegori, ndonëse të kontrolluara nga synimi i autorit. Blomberg (1990), madje, argumenton se shëmbëlltyrat kanë po aq ide qendrore sa dhe protagonistë, dhe se janë vërtet alegori. Ndonëse kjo është disi e tepruar, është më pranë së vërtetës sesa qëndrimi i llojit ‘një shëmbëlltyrë ka një ide të vetme’” (f. 240).

A duhen përdorur shëmbëlltyrat për të mësuar të vërteta doktrino, apo për të ilustruar të vërteta doktrino? Shumica e interpreesve është ndikuar nga abuzimi i metodës alegorike të interpretimit të shëmbëlltyrave, gjë që u lejonte interpretuesve t’i përdornin për të mbështetur doktrina që s’kishin fare lidhje me synimin origjinal të Jezusit, apo të shkruesit të ungjillit. Kuptimi duhet lidhur me synimin e autorit. Jezusi dhe shkruesit e ungjijve ishin të frymëzuar, ndërsa interpretuesit e tyre, jo.

Sado të jetë abuzuar me shëmbëlltyrat, ato funksionojnë gjithsesi si mjete për të mësuar të vërtetën, madje dhe të vërtetat doktrino. Dëgjoni se ç’thotë Bernard Ramm në këtë pikë:

“Shëmbëlltyrat na mësojnë vërtet doktrinën; madje, pretendimi se nuk mund të përdoren kurrsesi në shkrimet doktrino është i pavend. Ne duhet t’i kontrollojmë rezultatet tona duke i krahasuar me mësimet e qarta dhe të dukshme të Zotit tonë, si dhe me pjesën tjetër të Dhiatës së Re. Nëse tregojmë kujdesin e duhur, shëmbëlltyrat mund t’i përdorim për të ilustruar doktrinën, për të ndriçuar përjetimin e krishterë dhe për të dhënë mësim praktikë”. *Protestant Biblical Interpretation* (f. 285).

Në mbyllje, më lejoni t’ju jap tre citime që pasqyrojnë disa paralajmërime për interpretimin që iu bëjmë shëmbëlltyrave:

1. Marrë nga *How to Read the Bible for All Its Worth*, Gordon Fee dhe Doug Stuart:

“Për nga fati i keqinterpretimit në kishë, shëmbëlltyrat i kalon vetëm Zbulesa” (f. 135).

2. Marrë nga *Understanding and Applying the Bible*, J. Robertson McQuilkin:

“Shëmbëlltyrat kanë qenë burim i jashtëzakonshëm bekimi për ndriçimin e popullit të Perëndisë në lidhje me të vërtetat shpirtërore. Në të njëjtën kohë, shëmbëlltyrat kanë qenë dhe burim i paparë përshtjellimi për doktrinën dhe praktikën e kishës” (f. 164).

3. Marrë nga *The Hermeneutical Spiral*, Grant Osborne:

“Shëmbëlltyrat kanë qenë ndër ato pjesë të Shkrimit për të cilat është shkruar më tepër, por që janë abuzuar nga ana hermeneutike.... Janë gjinia letrare biblike më dinamike, por edhe më e vështira për t’u kuptuar. Potenciali i shëmbëlltyrës për komunikimin është i jashtëzakonshëm, pasi krijon një krahasim ose ndodhi në bazë të jetës së përditshme. Megjithatë, vetë kjo ndodhi mund të përfshijë shumë kuptime, dhe lexuesi i sotëm mund ta ketë po aq të vështirë ta interpretojë, sa dhe dëgjuesit e lashtë” (f. 235).

TEKSTI I NASB (I PËRDITËSUAR): MARKU 4:1-9

¹Filloi t'i mësonte sërish në anë të detit. Dhe rreth tij u mbledh një turmë kaq e madhe saqë hipi në një barkë në det dhe u ul; dhe gjithë turma rrinte në tokë në anë të detit. ²Dhe po i mësonte shumë gjëra me shëmbëlltyra dhe po u thoshte në mësimin e tij: ³“Dëgjoni! Ja, mbjellësi doli të mbjellë; ⁴teksa po mbillte, një pjesë e farës ra përbri rrugës, dhe erdhën zogjtë dhe e hëngrën. ⁴Një pjesë tjetër ra në gurishte, ku nuk kishte shumë dhë; dhe mbiu menjëherë sepse s'kishte thellësi dheu. ⁶Por, pasi doli dielli, u dogj; dhe ngaqë skishte rrënjë, u tha. ⁷Një pjesë tjetër ra mes ferrave, dhe ferrat u rritën, e mbytën dhe nuk dha fryt. ⁸Një pjesë tjetër ra në tokë të mirë, dhe kur u rritën e u shtuan, dhanë fryt dhe prodhuan tridhjetë, gjashtëdhjetë dhe njëqind fish. ⁹Dhe po u thoshte: “Kush ka veshë, le të dëgjojë”.

4:1 “Filloi t'i mësonte sërish në anë të detit” Kjo s'ishte plotësisht e re (shih Marku 2:13; 3:7), por tani sinagoga po bëhej gjithnjë e më e mbyllur ndaj tij, kështu që Jezusi i vijoi shërbesat e tij mësimore në natyrë. Donte që njeriu i zakonshëm të ishte në kontakt me të dhe me mësimet e tij.

■ **“u mbledh një turmë kaq e madhe”** Turma ishte e madhe, por shëmbëlltyra të lë të kuptosh se pak prej tyre u përgjigjen me besim. Prania e turmave të mëdha është temë e përsëritur në Marku (shih Marku 2:13; 3:9; 4:1, 36; 5:31; 7:33; 8:, 1, 2; 9:14, 17; 14:43; 15:8).

■ **“barkë”** Kjo fjalë greke nënkupton një barkë të vogël lundrimi. Në Marku 3:9, Jezusi kërkoi një barkë me rrema, që të ishte në pritje, në rast se shtypja e turmës do të bëhej tepër e madhe. Në atë rast, barka do t'i shërbente si platformë për të folur. Çdo i sëmurë donte ta prekte. Kjo duhet të ketë shkaktuar një shtypje të madhe.

■ **“u ul”** Ndoshta ulja e Jezusit (në krahasim me qëndrimin në këmbë) pasqyron zakonet kulturor të mësuesve judaikë (pra, rabinët uleshin kur jepnin mësim), ose ndoshta këtë e bëri për shkak të lëkundjes së barkës.

■ **“në tokë”** Ndoshta, Jezusi përdori amplifikimin e natyrshëm të zërit (që vjen kur dikush flet nga uji në drejtim të tokës) për t'i folur një turme kaq të madhe.

4:2 “po i mësonte” Kjo është dëftore e pakryer veprorë, që nënkupton se ai po i mësonte vazhdimisht (pra, “shumë gjëra”).

■ **“shëmbëlltyra”** Shih Temën e Veçantë: Interpretimi i shëmbëlltyrave, te hyrja e Markut 4.

4:3 “Dëgjoni” Kjo është urdhërore e tashme veprorë. Mos harroni se shëmbëlltyrat u thanë gojarisht. Rabinët jepnin mësim, pastaj e përmbledhnin, pastaj jepnin shembuj. Këtë model ndoqi dhe Jezusi (shih William L. Blevin, *Birth of the New Testament*, f. 1-13).

■ **“mbjellësi”** Kjo ishte pamje shumë e zakonshme në Galile. Kjo shëmbëlltyrë bëhet shumë e kuptueshme kur kupton sesi e plugonin këta bujq tokën rreth fshatit. Ata punonin tokën rreth shtigjeve, vendeve me barishte, etj. Pastaj, e mbillnin gjithë arën me dorë. Jezusi e përdori këtë praktikë të zakonshme për të ilustruar nivelin e pranimit shpirtëror (pra, katër llojet e dheut).

4:4 “përbri rrugës” Bëhet fjalë për shtigjet publike nëpër arat e përbashkëta të fshatit. Kur arat plugoheshin, shtigjet zhdukeshin për pak kohë, por pastaj rishfaqeshin shpejt.

4:5 “gurishte” Bëhet fjalë për një formacion shkëmbor nën disa centimetra tokë, dhe jo për gurë të mëdhenj në fushë. Cektësia e këtij dheu nuk dukej dot me sy.

4:7 “mes ferrave” Bëhet fjalë për ferrishet që kishin zënë rrënjë mirë; edhe ato nuk dukeshin pasi plugohej toka.

4:8 “dhanë fryt dhe prodhuan tridhjetë, gjashtëdhjetë dhe njëqindfish” Llojet e ndryshme të dheut dhe venndodhja bënin të mundur sasi të ndryshme prodhimi. Ekzistojnë disa variante në dorëshkrimet greqisht në lidhje me parafjalën *en*. Gjithsesi, këto variante të ndryshme nuk ia ndryshojnë kuptimin pasazhit. Ndoshta në të tria rastet duhet parafjala *en*, që tregon ndikimin e gjuhës aramaike.

4:9, 23 “Kush ka veshë, le të dëgjojë” Kjo është shprehje semite. Vë në dukje nevojën që njeriu të mendohet me kujdes dhe t’i zbatojë gjërat personalisht (shih Mat. 11:15; 13:9,43; Luka 8:8; 14:35; Zbu. 2:7,11,17,29; 3:6,13,22; 13:9). Ndoshta, kjo reflekton dhe lutjen hebraisht *Shema* (pra, LiP. 6:4), që do të thotë “dëgjo në mënyrë që ta zbatosh [urdhërimin]”. Dëgjimi duhet të përkthehet në veprim (shih Jakobi 2:14-26).

TEKSTI I NASB (I PËRDITËSUAR): MARKU 4:10-12

¹⁰Sapo mbeti vetëm, ndjekësit e tij, bashkë me të dymbëdhjetët, filluan ta pyesnin për shëmbëlltyrat. ¹¹Dhe po u thoshte: “Juve ju është dhënë misteri i mbretërisë së Perëndisë, por ata që janë jashtë e marrin gjithçka me shëmbëlltyra, ¹²që, duke parë, të shohin e të mos kuptojnë, dhe duke dëgjuar, të dëgjojnë dhe të mos marrin vesh, përndryshe mund të kthehen dhe të falen”.

4:10 “Sapo mbeti vetëm” Pra, vetëm me dishepujt. Me sa duket, atyre u vinte turp t’i bënin pyetje në publik. Është e qartë se nuk e kishin kuptuar shëmbëlltyrën.

4:11 “Juve ju është dhënë” Kjo është dëftore e kryer pësore. Ne jemi administratorë dhe përgjegjës për të vërtetat shpirtërore që zotërojmë. “Kujt i jepet shumë, shumë do t’i kërkohet” (shih Luka 12:48).

Ky mësim veçmas, që duket se ndodhte rregullisht, mund të shpjegojë ndryshimet mes ungjijve sinoptikë dhe ungjillit të Gjonit. Jezusi flet shumë ndryshe te Gjoni. Ka mundësi që mësimet me shëmbëlltyra, që shfaqen kaq shpesh në ungjijtë sinoptikë, të jenë dhënë përpara turmave, ndërsa stili tejet i ndryshëm (pra pohimet “unë jam”) mund të ketë ndodhur veçmas me dishepujt dhe pikërisht këtë përmend ungjilli i Gjonit.

Ndoshta gjithë kjo çështje e mësimit të veçantë për të dymbëdhjetët mund të ketë funksionuar në kishën e hershme si mënyrë për të theksuar dhe autoritetin e apostujve. Ata, dhe vetëm ata, e dinin interpretimin “e vërtetë” të fjalëve të Jezusit. Çdo zbuluesë vjen përmes këtyre dishepujve të zgjedhur dhe të frymëzuar.

■ **“misteri”** Kjo është fjala greke *musterion*. Në DHR përdoret në disa kuptime. Në këtë kontekst, nënkupton të vërtetën e zbuluar, të cilën krerët dhe turma s’ishin në gjendje ta kuptonin (shih Isa. 6:9-10).

TEMË E VEÇANTË: MISTERI NË UNGJIJTË (SPECIAL TOPIC: MYSTERY IN THE GOSPELS)

- A. Në ungjijtë sinoptikë, “misteri” përdoret për mësimet shpirtërore që nxirren nga shëmbëlltyrat e Jezusit.
1. Marku 4:11
 2. Mateu 13:11
 3. Luka 8:10
- B. Pali e përdori në disa mënyra të ndryshme:
1. Ngurtësimi i pjesës së Izraelit në mënyrë që të mundësohej përfshirja e johebrenjve. Ky vërshim johebrenjsh do të funksionojë si mekanizëm që judenjtë të pranojnë Jezusin si Krishtin e profecisë (shih Rom. 11:25-32).
 2. Ungjilli iu bë i njohur kombeve, duke iu thënë se të gjithë janë të përfshirë në Krishtin dhe nëpërmjet tij (shih Rom. 16:25-27; Kol. 2:2).
 3. Trupat e rinj të besimtarëve në Ardhjen e Dytë (shih 1 Kor. 15:5-57; 1 Thes. 4:13-18).
 4. Përmbledhja e të gjitha gjërave në Krishtin (shih Efe. 1:8-11)
 5. Johebrenjtë dhe judenjtë si bashkëtrashëgimtarë (shih Efe. 2:11-3:13).
 6. Ngushtësia e marrëdhënies së Krishtit me Kishën përshkruhet me metaforën e martesës (shih Efe. 5:22-33).
 7. Johebrenjtë përfshihen si popull i besëlidhjes dhe brenndabanohen nga Fryma e Krishtit në mënyrë që në ta të prodhohet pjekuria e Krishtit, pra, të ripërtërihet shëmbëllimi i përçuduar i

Perëndisë në njeriun (shih Zan. 1:26-27; 5:1; 6:5, 11-13; 8:21; 9:6; Kol. 1:26-28).

8. Antikrishti i kohëve të fundit (shih 2 Thes. 2:1-11).

9. Një himn i kishës së hershme për misterin e ungjillit gjendet në 1 Tim. 3:16.

C. Në Zbulesën e Gjonit, misteri përdoret në lidhje me kuptimin e simboleve apokaliptike të Gjonit.

1. 1:20

2. 10:7

3. 17:5, 6

D. Këto janë të vërteta që njerëzit nuk i zbulojnë dot; duhen zbuluar nga Perëndia. Këto mësimet janë thelbësore për ta kuptuar vërtetë planin e përjetshëm të Perëndisë për shpengimin e gjithë njerëzve (shih Zan. 3:15). Shih Temën e Veçantë: Plani i përjetshëm shpëngues i JHVH.

■ **“i mbretërisë së Perëndisë”** Shih shënimin në Marku 1:15.

■ **“por ata që janë jashtë”** Fryma e Shenjtë dhe dëgjueshmëria personal janë të domosdoshme për të kuptuar të vërtetat përfundimtare. Ata që mohojnë Frymën kryejnë mëkatin e Markut 3:29. Shëmbëlltyrat kishin synimin e dyfishtë të fshehtë të së vërtetës (shih Mat. 11:25-27) dhe të zbulimit qartazi të së vërtetës (shih Luka 10:29 dhe shëmbëlltyra që vijon). Çelësi është zemra e dëgjuesit.

4:12 Ky citim vjen nga Targumi aramaisht i Isa. 6:9. Vargu paralel te Mateu, që është marrë nga Septuaginta, citon edhe Isa 6:9 edhe 6:10. Predikimi i Isaisë u refuzua nga izraelitët kokëfortë të cilëve iu drejtua në shekullin e tetë para Krishtit. Edhe dëgjuesit e Jezusit në shekullin e parë i mohuan mësimet e tij. Ky citim mbizotërohet nga folje në lidhore, gjë që tregon kushtin e vullnetit nga ana e dëgjuesve.

Ndonëse Marku po u shkruan johebrenjve (ndoshta, atyre romakë), aludon shpesh për pasazhet nga DHV (shih Marku 1:2-3; 2:25-26; 4:12; 10:6-8,19; 12:26,29-31,36).

■ **“mund të kthehen”** Kjo është fjala e DHV (pra, *shuv*, BDB 996) që do të thotë “pendim”.

TEKSTI I NASB (I PËRDITËSUAR): MARKU 4:13-20

¹³Dhe ai u tha: **“Nuk e kuptoni këtë shëmbëlltyrë? Si do t’i kuptoni gjithë shëmbëlltyrat?”**
¹⁴Mbjellësi mbjell farën. ¹⁵Këta janë ata që janë përbri rrugës ku mbillet fjala: kur dëgjojnë, Satani vjen menjëherë dhe ua rrëmben fjalën që ishte mbjellur në ta. ¹⁶Po kështu, ata të cilët fara mbillet në gurishte janë ata që, kur e dëgjojnë fjalën, e pranojnë menjëherë me gëzim; ¹⁷dhe nuk kanë rrënjë të qëndrueshme në vetvete, por janë të përkohshëm; pastaj, kur vjen mundimi ose përndjekja për shkak të fjalës, menjëherë largohen. ¹⁸Ndërsa ata të cilët fara mbillet mes ferrave janë ata që e kanë dëgjuar fjalën, ¹⁹por shqetësimet e botës dhe mashtrimi i pasurive dhe dëshirat për gjërat e tjera hyjnë dhe e mbysin fjalën, dhe ajo bëhet e pafrytshme. ²⁰Kurse ata të cilët fara mbillet në tokë të mirë janë ata që e dëgjojnë fjalën, e pranojnë dhe prodhojnë fryt tridhjetë, gjashtëdhjetë dhe njëqindfish”.

4:13 “Nuk e kuptoni këtë shëmbëlltyrë? Si do t’i kuptoni gjithë shëmbëlltyrat?” Kjo shprehje jepet vetëm nga Marku, por tregon se Jezusi priste që dishepujt të kuptonin. Familja e tij nuk kuptonte, as turmat nuk kuptonin, as krerët fetarë; por as dishepujt nuk mund të kuptonin pa vëmendje dhe shpjegim të veçantë.

Kjo shëmbëlltyrë është model për të tjerat. Ja disa parime kyçe për interpretimin e shëmbëlltyrave:

1. Ki parasysh kontekstet historike dhe letrare
2. Identifiko të vërtetën qendrore
3. Mos u përqendro më shumë se ç’duhet te detajet
4. Kontrolllo pasazhet e tjera paralele në ungjijtë
5. Identifiko të kthesën e papritur, ose thënien e papritur nga ana kulturore, që përbën thirrje për veprim për shkak të etikës së re të mbretërisë së Perëndisë

4:14 Fara bën fjalë për shpalljen e ungjillit. Pasazhi paralel te Mateu (shih Mat. 13:19) e quan “fjala e Mbretërisë”.

4:15 “Satani” Ky rrëmbim i së vërtetës shprehet qartë në 2 Kor. 4:4. Pasazhi paralel te Mateu (Mat. 13:19) shton: “ata nuk e kuptojnë”, pastaj Satani ua heq nga mendja dhe nga zemra që as të mos mendojnë më për të. Shih Temën e Veçantë në Marku 1:13.

▣ **“ua rrëmben”** Kjo fjalë greke (*airō*) mund të ketë kuptimin (1) shkatërroj (shih Gjoni 11:48), ose (2) ia marr jetën dikujt (shih Luka 23:18; Veprat 12:19); pa fjalë s’ka jetë!

4:16 “kur e dëgjojnë fjalën, e pranojnë menjëherë me gëzim” Pranimi fillestar i së vërtetës nuk është i vetmi kriter (shih Marku 4:17 dhe 19). Besimi biblik nuk bazohet në një vendi emocional në të kaluarën, por në një marrëdhënie që sa vjen e rritet me Zotin. Shpëtimi nuk është siguracion kundër zjarrit, as biletë për në qiell, por nënkupton ripërtëritjen e “shëmbëllimit të Perëndisë”, që lejon bashkësinë e përditshme dhe të ngushtë me Perëndinë. Mbirja e gëzueshme nuk e zëvendëson marrëdhënien e frytshme (shih Marku 4:20).

4:17 “nuk kanë rrënjë të qëndrueshme në vetvete” Kjo është paralele me fjalën “besoj” te Gjoni në Gjoni 8:30 e më tej.

▣ **“kur vjen mundimi ose përndjekja”** Qëndresa është provë e besimit të vërtetë.

TEMË E VEÇANTË: NEVOJA PËR QËNDRESË (SPECIAL TOPIC: THE NEED TO PERSEVERE)

Doktrinat biblike që lidhen me jetën e krishterë janë të vështira të shpjegohen, pasi paraqiten në dyshe dialektike, që janë tipike për botën lindore. Këto dyshe duken kontradiktore, por janë të dyja biblike. Të krishterët perëndimorë janë prirur që të zgjedhin njëren të vërtetë dhe të anashkalojnë ose zhvlerësojnë të vërtetën e kundërt. Më lejoni t’ju jap disa shembuj.

- A. A është besimi një vendim fillestar për të besuar në Krishtin, apo një përkushtim dishepullizimi gjithë jetën?
- B. A është shpëtimi një zgjedhje që bën Perëndia sovran me anë të hirit, apo është një përgjigje e njerëzimit me besim dhe me pendim ndaj ofertës hyjnore?
- C. Pasi merret shpëtimi, a është i pamundur të humbet, apo ekziston nevoja për zell të vazhdueshëm? Çështja e qëndresës ka qenë polemike gjatë gjithë historisë së kishës. Problemi fillon me disa pasazhe në DhR që duket sikur janë në kundërshti me njëra-tjetrën:

- A. pasazhet për sigurinë e shpëtimit
 1. thëniet e Jezusit (Gjoni 6:37; 10:28-29)
 2. thëniet e Palit (Rom. 8:35-39; Efe. 1:13; 2:5,8-9; Fil. 1:6; 2:13; 2 Thes. 3:3; 2 Tim. 1:12; 4:18)
 3. thëniet e Pjetrit (1 Pjet. 1:4-5)
- B. pasazhet për nevojën për qëndresë
 1. thëniet e Jezusit (Mat. 10:22; 13:1-9,24-30; 24:13; Marku 13:13; Gjoni 8:31; 15:4-10; Zbu. 2:7,17,26; 3:5,12,21)
 2. thëniet e autorit të Hebrenjve (2:1; 3:6, 14; 4:14; 6:11)
 3. thëniet e Gjonit (1 Gjonit 2:6; 2 Gjonit 9)
 4. thëniet e Atit (Zbu. 21:7)

Shpëtimi biblik rrjedh nga dashuria, mëshira dhe hiri i Perëndisë Triun dhe sovran. Asnjë njeri nuk mund të shpëtohet pa nismën e Frymës (shih Gjoni 6:44, 65). Perëndia vjen në fillim dhe përcakton rendin, por kërkon që njerëzit të përgjigjen me besim dhe pendim, si në fillim, ashtu dhe në vazhdim. Perëndia punon me njerëzimin në një marrëdhënie besëlidhjeje. Ka edhe privilegje, edhe përgjegjësi!

Shpëtimi u ofrohet gjithë njerëzve. Vdekja e Jezusit i dha fund problemit të mëkatit në krijimin e rënë. Perëndia ka siguruar një rrugë dhe kërkon që gjithë ata që janë krijuar në shëmbëllimin e tij t’i përgjigjen dashurisë dhe asaj që na ka siguruar ai në Jezusin.

Nëse dëshiron të lexosh më tepër për këtë temë nga një pikëvështrim jokalvinist, shih

1. Dale Moody, *The Word of Truth [Fjala e së vërtetës]*, Eerdmans, 1981 (f. 348-365)
2. Howard Marshall, *Kept by the Power of God [I ruajtur me anë të fuqisë së Perëndisë]*, Bethany Fellowship, 1969
3. Robert Shank, *Life in the Son [Jeta në Birin]*, Westcott, 1961

Bibla trajton dy probleme të ndryshme në këtë pikë: (1) të mos e marrim sigurinë e shpëtimit si leje për të bërë jetë të pafrytshme dhe egoiste; dhe (2) të inkurajojë ata që kanë vështirësi në shërbesë apo me mëkatën personal. Problemi është se grupet e gabuara po marrin mesazhin e gabuar dhe po ndërtojnë sisteme teologjike mbi pasazhe të kufizuara biblike. Disa të krishterë kanë nevojë të dëshpëruar për mesazhin e sigurisë së shpëtimit, ndërsa disa të tjerë kanë nevojë për paralajmërime të rrepta! Në cilin grup bën pjesë ti?

■ **“për shkak të fjalës”** Vini re se përndjekja lidhet me ungjillin (shih Mat. 5:10-12; 1 Pje. 2:11-12, 21; 3:14-17; 4:12-16). Biri i Perëndisë, fjala e Perëndisë dhe populli i Perëndisë janë shënjestra në këtë botë të rënë.

4:18 Lloji i tretë i dheut janë ata që dëgjojnë fjalën, por problemet e jashtme (shih Marku 4:19) e bëjnë farën (pra, fjalën) të vdesë. Vini re dallimin e qartë mes mbirjes dhe dhënies së fryteve! Gara nuk fitohet nga fillimi i mbarë, por nga përfundimi i mbarë (shih Gjoni 15; Hebrenjve 11).

4:19 “shqetësimet e botës dhe mashtrimi i pasurive” Bëhet fjalë për tundimet e kësaj botë (epoke) të rënë.

4:20 “tridhjetë, gjashtëdhjetë dhe njëqindfish” Sasia nuk është aq e rëndësishme sa dhënia e fryteve!

TEKSTI I NASB (I PËRDITËSUAR): MARKU 4:21-25

²¹Dhe po u thoshte: “Llamba nuk merret që të vihet nën babune ose nën shtrat, apo jo? A nuk merret që të vihet mbi dritëmbajtëse? ²²Sepse asgjë e fshehtë nuk do të rrijë pa u zbuluar; dhe asgjë sekrete nuk do të rrijë pa dalë në dritë. ²³Kush ka veshë për të dëgjuar, le të dëgjojë”. ²⁴Dhe po u thoshte: “Kujdes se çfarë dëgjoni. Me standardin e masës suaj do t’ju masin; madje, do t’ju jepet edhe më tepër. ²⁵Sepse kujtdo që ka, do t’i jepet edhe më tepër; dhe kujtdo që nuk ka, do t’i merret edhe ajo që ka”.

4:21 “Llamba” Dy pyetjet e para të Markut 4:21 presin gramatiksht përgjigjen “jo”. Drita është bërë për të ndriçuar. Besimi duhet të sjellë fryt. Ky paragraf shpjegon përse shumë njerëz nuk i kuptonin shëmbëlltyrat e Jezusit. Shëmbëlltyrat duhet t’u hapin sytë njerëzve, por zemrat dhe motivet e tyre të liga e bllokojnë dritën. Perëndia dëshiron të komunikojë (shih Marku 4:22).

Në dritën e kontekstit të atypëratyshëm, Jezusi po flet, pa dyshim, për shpalljen e ardhshme të ungjillit të plotë pas ringjalljes dhe ngritjes së tij në qiell. Sekretin Mesianik, që shfaqet shpesh te Marku, e vërteta që fshihet me anë të përdorimit të shëmbëlltyrave, si dhe moskuptimi nga ana e rrethit të ngushtë të dishepujve kërkon që kjo të shihet në kontekstin e ardhshëm (pra, pas ditës së Rrëshajëve).

■ **“babune”** Kjo ishte një enë, që mbante një ose dy masa drithi të thatë. Është huazim nga latinishtja, që ndoshta konfirmon faktin se ungjilli i Markut u shkrua për romakët.

■ **“shtrat”** Fjalë për fjalë, “vig”. Përdorej, jo vetëm për të fjetur (shih Marku 7:30), por edhe si jastëk shpine kur njerëzit hanin në pozicion të shtrirë dhe të mbështetur nga pas.

■ **“dritëmbajtëse”** Mund të bëhet fjalë për disa mënyra të ndryshme sesi dritat pozicionoheshin që të jepnin ndriçimin maksimal: (1) një pjesë e dalë në mur; (2) një varëse në mur; ose (3) një lloj pedestalali.

4:23 “Kush ka” Kjo është fjali kushtore e rendit të parë. Jezusi e merr si fakt të kryer se disa (më në fund) do ta kuptojnë natyrën, misionin dhe premtimet e tij.

4:24-25 Kjo shpreh një parim shpirtëror. Mesazhi i ungjillit përhapet gjatë e gjerë; çelësi i rritjes është lloji i dheut ku bie fara e tij. Është tejet e rëndësishme që njeriu të tregohet i hapur ndaj së vërtetës shpirtërore. Kjo nuk vlen vetëm për përgjigjen fillestare ndaj ungjillit, por edhe për përgjigjen e vazhdueshme ndaj tij. Përgjigjja e cekët dhe emocionale do të refuzohet.

4:24 “Kujdes se çfarë dëgjoni” Bën fjalë për pranimin ose refuzimin personal të Jezusit. Rabinët besonin se mendja ishte si kopsht i pluguar, i gatshëm për hedhjen e farës. Ajo që lejojmë të shohim me sy dhe të dëgjojmë

me veshë (shih Marku 4:9, 23) do të zërë rrënjë. Njeriu shndërrohet në gjërat që mediton, fokusohet dhe që i bën përparësi!

■ **“Me standardin e masës suaj do t’ju masin”** Ky varg s’ka të bëjë aspak me dhënien e ofertave financiare, por me dallueshmërinë shpirtërore. Kjo e vërtetë shprehet edhe në Mat. 5:7; 6:14-15; 18:21-35; Marku 11:25; Luka 6:36-37; Jakobi 2:13; 5:9. Nuk bëhet fjalë për drejtësi me anë të veprave, por për faktin se zemra e njeriut zbulohet me anë të veprave të tij. Besimtarët kanë zemër të re dhe familje të re.

4:25 Ungjilli u jep vazhdimisht bekime atyre që i janë përgjigjur pozitivisht, kurse atyre që e refuzojnë nuk u lë asgjë! Jezusi po përdor një fjalë të urtë në formë paradoksi (shih Marku 4:22, 25; 6:4; 8:35; 10:43-44). Kjo ishte tipike për mësuesit e Lindjes së Afërt.

Ky pasazh përdor një formë PËSORE, që është ndoshta mënyrë e tërthortë për të folur për Perëndinë. Perëndia është vepruesi i pashprehur i veprimit.

TEKSTI I NASB (I PËRDITËSUAR): MARKU 4:26-29

²⁶Dhe po thoshte: “Mbretëria e Perëndisë është si njeriu që hedh farën në dhé; ²⁶Shkon në shtrat natën, ngrihet ditën dhe fara mbin dhe rritet—sesi, ai vetë nuk e di. ²⁸Dheu prodhon vetë të korra; në fillim kërcellin, pastaj kallirin, dhe pastaj kokrrat e pjekura në kalli. ²⁹Dhe kur të korrrat piqen, ai i vë menjëherë draprin sepse të korrrat janë gati”.

4:26 “farën” Kjo shëmbëlltë e shfaqet vetëm te Marku. Për shkak të vargut 14, e dimë se bën fjalë për mesazhin e ungjillit. Rritja është rezultat i farës së mirë dhe dheut të duhur. Këto janë aspektet hyjnore dhe njerëzore të besëlidhjes.

4:27-29 Këto vargje ndoshta flasin për shpëtimin si proces (shih 1 Kor. 1:18; 15:2; 2 Kor. 2:15; 2 Pje. 3:18). Kjo shëmbëlltë e përshkruan rritjen e misterhme dhe të mahnitshme të shpëtimit në jetën e fëmijëve të rënë të Adamit. Synimi përfundimtar është fryti!

TEMË E VEÇANTË: SHPËTIMI (KOHËT E FOLJEVE GREQISHT) (SPECIAL TOPIC: SALVATION [GREEK VERB TENSES])

Shpëtimi nuk është produkt, por marrëdhënie. Nuk përfundon kur njeriu beson në Krishtin; sapo ka filluar! Nuk është policë sigurimi kundër zjarrit, as biletë për në qiell, por një jetë ku njeriu sa vjen e bëhet si Krishti. Në Amerikë ekziston një proverb që thotë se, sa më tepër të jetojë çifti së bashku, aq më tepër i ngjasin njëri-tjetrit. Ky është synimi i shpëtimit!

SHPËTIMI SI VEPRIM I PLOTËSUAR (AORIST)

- Veprat 15:11
- Romakëve 8:24
- 2 Timoteut 1:9
- Titit 3:5
- Romakëve 13:11 (kombinon AORISTIN me një orientim TË ARDHSHËM)

SHPËTIMI SI GJENDJE EKZISTENCE (E KRYERA)

- Efesianët 2:5, 8

SHPËTIMI SI PROCES I VAZHDUAR (E TASHMJA)

- 1 Korintasve 1:18; 15:2
- 2 Korintasve 2:15
- 1 Pjetrit 3:21

SHPËTIMI SI PËRMBUSHJE E ARDHSHME (KOHJA E ARDHME në FOLJE, ose konteksti)

- Romakëve 5:9, 10; 10:9, 13
- 1 Korintasve 3:15; 5:5
- Filipianëve 1:28
- 1 Thesalonikasve 5:8-9
- Hebrenjve 1:14; 9:28

- 1 Pjetrit 1:5, 9

Si rrjedhojë, shpëtimi fillon me një vendim fillestar besimi (shih Gjoni 1:12; 3:16; Rom. 10:9-13), por kjo duhet të rezultojë në një proces besimi në stilin e jetesës (shih Rom. 8:29; Gal. 2:19-20; Efe. 1:4; 2:10), që, një ditë, do të përmbushet me shikim (shih 1 Gjonit 3:2). Kjo gjendje përfundimtar quhet përlëvdim. Kjo mund të ilustruhet si

1. Shpëtimi fillestar – shfajësimi (shpëtuar nga ndëshkimi i mëkatit)
2. Shpëtimi përparues – shenjtërimi (shpëtuar nga fuqia e mëkatit)
3. Shpëtimi përfundimtar – përlëvdimi (shpëtuar nga prania e mëkatit)

4:29 “i vë menjëherë draprin” Kjo është metaforë për korrijen në kohët e fundit. Bën fjalë për ditën e gjykimit (shih Joeli 3:13; Mat. 3:12; 13:30).

TEKSTI I NASB (I PËRDITËSUAR): MARKU 4:30-32

³⁰Dhe u tha: “Si ta përshkruajmë mbretërinë e Perëndisë, ose me ç’shëmbëlltore ta paraqesim? ³¹Ajo është si fara e sinapit që, kur mbillet në tokë, ndonëse është më e vogël se çdo farë mbi dhë, ³²pasi mbillet, rritet dhe bëhet më e madhe se çdo bimë kopshti dhe lëshon degë aq të mëdha saqë nën hijen e saj bëjnë fole zogjtë e qiellit”.

4:30 Ky pasazh gjendet edhe në Mat. 13:31-32.

4:31 “fara e sinapit” Rabinët thoshin se ishte fara më e vogël. Mirëpo shkurrja e saj arrinte deri në katër metra lartësi. Kjo shëmbëlltore është paralele me atë më sipër. Rritja shpirtërore mund të nisë e vogël, por rezultatet janë të stërmëdha! Ashtu si fara e ungjillit rritet në zemrën e njeriut për ta shndërruar në ngjashmëri me Krishtin, kështu dhe mbretëria e Perëndisë rritet derisa të bëhet mbretëri mbarëbotërore (shih Mat. 13:33).

4:32 Fundi i këtij vargu ndoshta aludon për pemët e stërmëdha në pasazhet e DHV të Ezek. 17:22-24 dhe Dan. 4:11-12, që gjithashtu janë metafora mbretërie.

TEKSTI I NASB (I PËRDITËSUAR): MARKU 4:33-34

³³Me shumë shëmbëlltura të tilla, ai u fliste fjalën, me aq sa ishin në gjendje që ta dëgjonin; ³⁴dhe nuk u fliste pa shëmbëlltura; por ua shpjegonte gjithçka veçmas dishepujve.

4:33 “Me shumë shëmbëlltura të tilla, ai u fliste fjalën” Ne kemi me shkrim vetëm një pjesë të vogël të shërbesës së Jezusit (shih Gjoni 21:25). Të gjithë do të donim të kishim më shumë mësim dhe vepra të Jezusit me shkrim (Gjoni 20:30), por duhet të kuptojmë se kemi gjithçka që na nevojitet të dimë për Perëndinë, mëkatin, jetën, vdekjen, etj (shih Gjoni 20:31). Veçse duhet të veprojmë në bazë të zbulësës që na është dhënë. Këto dy vargje gjenden edhe te Mat. 13:33-35.

▣ **“me aq sa ishin në gjendje që ta dëgjonin”** Bëhet fjalë për aftësinë e tyre shpirtërore për ta pranuar ungjillin (shih Marku 4:9, 23). Besimtarët sot kanë ndihmën e Frymës së shenjtë brendabanues që na ndihmon t’i kuptojmë fjalët e Jezusit.

4:34 Ky varg reflekton dhe thëniet e mëparshme në Marku 4:10-12 dhe 13.

TEKSTI I NASB (I PËRDITËSUAR): MARKU 4:35-41

³⁵Atë ditë, kur ra nata, u tha: “Le të kalojmë në bregun tjetër”. ³⁶Si lanë turmën, dishepujt e morën me vete në barkë, ashtu siç ishte; kishte dhe barka të tjera me të. ³⁷Dhe shpërtheu një furtunë kaq e fortë saqë dallgët po përplaseshin kaq shumë mbi barkë saqë ajo filloi menjëherë të mbushej. ³⁸Jezusi vetë ishte në kishë, dhe flinte mbi një jastëk; ata e zgjuan dhe i thanë: “Mësues, nuk do t’ia dish që po marrim fund?” ³⁹Ai u ngrit, e qortoi erën dhe i tha detit: “Pusho, qetësohu”. Dhe era pushoi dhe u bë qetësi e plotë. ⁴⁰Dhe ai u tha: “Pse keni frikë? Si ka mundësi që s’keni besim?” ⁴¹Ata u frikësuan shumë dhe i thoshin njëri-tjetrit: “Kush është ky, që i binden dhe era dhe deti?”

4:35-41 Këtu nis një kontekst i zgjeruar mrekullish, Marku 4:35-8:26. Jezusi e vërtetoi mesazhin e vet duke shfaqur fuqinë që zotëronte. Kjo ngjarje përmendet edhe në Mat. 8:18, 23-27 dhe Luka 8:22-25.

4:36 Ky varg ka një sërë tiparësh të veçanta, që nuk gjenden në pasazhet e tjera paralele.

1. Ç’do të thotë “ashtu siç ishte”? TEV e përkthen: “dishepujt hipën në barkën ku ishte ulur tashmë Jezusi”. Kjo duket se është mundësia më e mirë.
2. Për kë bën fjalë fraza “kishte dhe barka të tjera me të”? Mos, ndoshta, grupi i apostujve ishte i shpërndarë në disa barka të vogla, apo furtuna zuri dhe barka të tjera që ishin aty pari?

Është e qartë se këto janë detaje prej dëshmitari okular (pra, të Pjetrit), por qëllimi dhe domethënia e tyre nuk është e qartë.

4:37 “Dhe shpërtheu një furtunë kaq e fortë” Furtunat e papritura janë diçka e zakonshme në Detin e Galilesë, për shkak të kodrave që e rrethojnë, dhe për faktin se liqeni është nën nivelin e detit. Kjo duhet të ketë qenë furtunë tejet e fortë, pasi dhe peshkatarët me përvojë ndër dishepujt u frikësuan.

4:38 Qartazi, kjo ngjarje përdoret për të përshkruar qetësinë e Jezusit dhe frikën e dishepujve nga rrethanat e çastit. Pyetja për “merakosjen” e Jezusit është universale. Nëse Perëndia është i dashur dhe i gjithfuqishëm, pse përballen besimtarët me sprova që u kërcënojnë jetën?

▣ **“po marrim fund”** Shih Temën e Veçantë: *apollumi* në Marku 3:6.

4:39 Kjo gjë tregoi qartë fuqinë dhe autoritetin e Jezusit – edhe forcat jofrymore të natyrës i binden.

▣ **“Pusho, qetësohu”** Kjo është urdhërore e tashme veprare, e ndjekur nga një folje urdhërore e kryer pësore. Jezusi, si vepruesi i Perëndisë Atë në krijim (shih Gjoni 1:3, 10; 1 Kor. 8:6; Kol. 1:16; Heb. 1:2), kishte (dhe ende ka) fuqi mbi krijimin (shih Psa. 33:7; 65:2; 147:18).

4:40 Kjo pyetje vlen për gjithë besimtarët, në çdo situatë. Jezusi po u jep mësim dishepujve, jo vetëm me fjalë, por edhe me vepra.

4:41 Ky varg shfaq qartë papjekurinë teologjike të apostujve. Konteksti këtu vë përballë disa lloje të ndryshme mosbesimi: (1) mosbesimi i familjes së Jezusit; (2) i krerëve fetarë; dhe (3) i dishepujve. Grupi i parë dhe i tretë po rriten nga ana shpirtërore. Mosbesimi i tyre bazohet në padije, kurse ai i krerëve fetarë është i qëllimshëm. Atyre u jepen shenja pas shenjash, të vërteta pas të vërtetash; megjithatë, për shkak të anësive të tyre paraprake, krerët fetarë jo vetëm që nuk pranojnë të besojnë, por madje, mësimet dhe veprimet e Jezusit ia veshin fuqisë së Satanit! Ky është mëkati i pafalshëm!

PYETJE PËR DISKUTIM

Ky është një komentari studimor udhëzues, që do të thotë se ti je vetë përgjegjës për interpretimin e Biblës. Secili prej nesh duhet të ecë sipas dritës që ka. Ti, Bibla dhe Fryma e Shenjtë keni përparësi në interpretim. Nuk duhet t’ia dorëzosh këtë të drejtë komentuesit.

Këto pyetje për diskutim t’i kam dhënë për të të ndihmuar që të analizosh çështjet kryesore të kësaj pjese të librit. Ato synojnë të të nxisin mendimin, jo të kenë natyrë shteruese.

1. Pse është kaq e rëndësishme kjo shëmbëlltëri (Marku 4:3-5) për interpretimin e gjithë të tjerave?
2. Si e trajton ky pasazh marrëdhënien mes sovranitetit të Perëndisë dhe vullnetit të lirë njerëzor?
3. Jep të vërtetën qendrore të këtyre pasazheve:
 - a. Marku 4:21-23

- b. Marku 4:24-25
 - c. Marku 4:28-29
 - d. Marku 4:30-32
4. Cila është e vërteta bazë e gjithë këtyre shëmbëlltyrave? (Mos harro kontekstin)
 5. Rendit, brenda këtij konteksti, tre grupet që nuk besojnë.

MARKU 5

NDARJET NË PARAGRAFË TË PËRKTHIMEVE MODERNE

UBS ⁴	NKJV	NRSV	TEV	NJB
Shërimi i demoniakut gerasenas 5:1-10	Shërimi i burrit të pushtuar nga demonët 5:1-20	Demoniakut gerasenas 5:1-13	Jezusi shëron burrin me frymë të ligë 5:1-5 5:6-8 5:9a 5:9b-10 5:11-13	Demoniakut gerasenas 5:1-20
5:11-20		5:14-20	5:14-16 5:17 5:18 5:19 5:20	
Bija e Jairit dhe gruaja që preku rrobën e Jezusit 5:21-24a	Rikthimi në jetë i një vajze dhe shërimi i një gruaje 5:21-43	Ringjallja e bijës së Jairit 5:21-24a	Bija e Jairit dhe gruaja që preku mantelin e Jezusit 5:21-23 5:24	Shërimi i gruas me hemoragji – Rikthimi në jetë i bijës së Jairit 5:21-24
5:24b-34		5:24b-34	5:25-28 5:29-30 5:31 5:32-34	5:25-34
5:35-43		5:35-43	5:35 5:36-39 5:40-41 5:42-43	5:35-43

CIKLI TRE I LEXIMIT (shih f. v)

NDJEKJA E SYNIMIT TË AUTORIT FILLESTAR NË NIVELIN E PARAGRAFËVE

Ky është një komentuar studimor udhëzues, që do të thotë se ti je vetë përgjegjës për interpretimin e Biblës. Secili prej nesh duhet të ecë sipas dritës që ka. Ti, Bibla dhe Fryma e Shenjtë keni përparësi në interpretim. Nuk duhet t'ia dorëzosh këtë të drejtë komentuesit.

Lexo gjithë kapitullin njëherësh. Identifiko temat. Krahaso ndarjet e tua tematike me pesë përkthimet moderne. Ndarja në paragrafë nuk është e frymëzuar, por është çelësi për të ndjekur synimin e autorit fillestar, gjë që është thelbi i interpretimit. Secili paragraf ka vetëm një temë të vetme.

1. Paragrafi i parë
2. Paragrafi i dytë
3. Paragrafi i tretë
4. Etj.

MËSIMET KONTEKSTUALE NGA 5:1-43

Ky kapitull synon të tregojë një ditë të zakonshme në jetën e Jezusit gjatë periudhës publike të shërbesës. Fuqia dhe autoriteti i Jezusit tregohen në këto tre rastë:

- A. Demoniaku gerasenas (pasazhe paralele, Mat. 8:28-34; Luka 8:26-39)
Vargjet 1-20 (tregon pushtetin e Jezusit mbi botën shpirtërore)
- B. Bija e Jairit (pasazhe paralele: Mat. 9:18-19, 23-26; Luka 8:40-42, 49-56)
Vargjet 21-24, 35-43 (tregon pushtetin e Jezusit mbi vdekjen)
- C. Gruaja me hemoragji (pasazhe paralele: Mat. 9:20-22; Luka 8:43-48)
Vargjet 25-34 (tregon pushtetin e Jezusit mbi sëmundjen)

STUDIMI I FJALËVE DHE FRAZAVE

TEKSTI I NASB (I PËRDITËSUAR): MARKU 5:1-13

¹Arritën në anën tjetër të detit, në krahinën e gerasenasve. ²Kur Jezusi doli nga barka, menjëherë i doli përpara nga varrezat një burrë me një frymë të ndyrë, ³i cili banonte në varreza. Dhe askush s'ishite më në gjendje ta lidhte, madje as me zinxhirë. ⁴Sepse e kishin lidhur shpesh me pranga e zinxhirë, por i kishte thyer zinxhirët dhe i kishte këputur prangat, dhe askush s'ishite aq i fortë sa ta bënte zap. ⁵Vazhdimisht, ditë e natë, ai ulërinte në varreza dhe nëpër male dhe e çante veten me gurë. ⁶Kur e pa Jezusin nga larg, u turr dhe u përkul para tij; ⁷dhe duke bërtitur me zë të lartë, i tha: “Ç’punë kemi ne me njëri-tjetrin, o Jezus, Biri i Perëndisë shumë të lartë? Të përgjerohem, për Zotin, mos më torturo!” ⁸Sepse ai i kishte thënë: “Dil nga ky burrë, o frymë e ndyrë!” ⁹Dhe po e pyeste: “Si të quajnë?” Dhe burri i tha: “Më quajnë Legjion; sepse jemi shumë”. ¹⁰Dhe nisi t’i përgjerohej me të madhe që të mos i dëbonte nga ajo krahinë. ¹¹Dhe aty ishte një tufë e madhe derrash, që po kullosnin aty pranë në mal. ¹²Demonët iu përgjeronin dhe i thanë: “Na dërgo në derrat që të hyjmë në ta”. ¹³Jezusi u dha leje. Dhe, pasi dolën, frymërat e ndyra hynë në derrat; dhe tufa u turr teposhtë brinjës së thepisur dhe ra në det, rreth dy mijë krerë; dhe u mbytën në det.

5:1 “Arritën në anën tjetër të detit” Ndoshta, ishte ende natë (shih Marku 4:35). Dishepujve duhet t’u jetë dashur të rremojnë pasi Jezusi e kishte bërë erën të pushonte plotësisht.

■ **“në krahinën e gerasenasve”** Kjo ishte në cepin verilindor të detit të Galilesë, dhe quhej Dekapolis. Ky rajon ishte kryesisht johebre dhe shumë i helenizuar. Ungjijtë sinoptikë kanë shumë dallime në lidhje me shqiptimin e emrit të vendit: Gerasa (dorëshkrimet Sinaitikus*, B, D dhe Luka 8:26), Gergesa (dorëshkrimet Sinaitikus, 2, L), Gergusta (dorëshkrimi W), ose Gadara (dorëshkrimet A, C, dhe Mat. 8:28). Të gjitha këto ishin qytete të zonës.

5:2 “Kur Jezusi doli nga barka” Ndoshta dishepujt e dëgjuan ulërimën (Marku 5:5) dhe iu erdhi mirë që Jezusi doli i pari nga barka!

■ **“menjëherë”** Shih shënimin në Marku 1:10.

■ **“një burrë”** Mat. 8:28 e më tej flet për dy burra. Edhe Mateu flet për dy të verbër jashtë Jerikos (shih Mat. 20:29; Marku 10:46; Luka 18:35). Ky është tipar karakteristik i ungjillit të Mateut. Marku dhe Luka bëjnë fjalë për vetëm një të demonizuar (shih Luka 8:26 e më tej). Për një diskutim të mëtejshëm, shih *Hard Sayings of the Bible* (f. 321-322).

■ **“i doli përpara nga varrezat një burrë me një frymë të ndyrë”** Qartazi, bëhet fjalë për një rast pushtimi demoniak. DHR nuk diskuton për origjinën e demonëve dhe nuk jep procedura të hollësishme si të përballemi me ta. Dëbimi i demonëve nuk renditet askund si dhunti e Frymës. Shih Temat e Veçanta: Demonike dhe Dëbimi i Demonëve në Marku 1:25.

5:3 “i cili banonte në varreza” Ata kishin zbritur pranë varrezës së fshatit. Njerëzit e atyshëm e kishin dëbuar të çmendurin e demonizuar që të jetonte në këtë zonë të veçuar. Tani ajo ishte shtëpia e tij.

■ **“askush s’ ishte më në gjendje ta lidhte”** Ai kishte forcë të mbinatyrshme.

5:4 “e kishin lidhur shpesh me pranga e zinxhirë” Kjo jepet në formën paskajore të kryer pësore. Me sa duket, banorët e vendit ishin përpjekur ta lidhnin më zinxhirë. Ishte aq njeri problematik sa e njihnin mirë.

■ **“i kishte thyer”** Kjo tregon forcën e tij të mbinatyrshme.

5:5 “ulërinte... çante veten me gurë” Kjo sjellje lidhej ndoshta me vetëplagosjen, ose me rituale adhurimi pagan që shihen dhe në DHV (shih 1 Mbre. 18:28). Përshkrimi i gjallë që i bëhet sjelljes së vazhdueshme të këtij njeriu duhet të ketë ardhur nga fshatarët.

5:6 “u turr dhe u përkul para tij” Folja e parë nënkupton armiqësi. E dyta nënkupton respekt dhe pranim të pozitës dhe autoritetit të Jezusit (shih Marku 5:4b).

5:7 “duke bërëtitur me zë të lartë, i tha: ‘Ç’punë kemi ne me njëri-tjetrin, o Jezus, Biri i Perëndisë shumë të lartë?’” Një nga demonët i drejtohet Jezusit. E dinin kush ishte (shih Marku 1:23; Jakobi 2:19). Madje dhe i drejtohen me një frazë mesianike. Në këtë rast, motivi i tyre ishte frika (nëdallim nga 1:23).

■ **“Të përgjërohem, për Zotin”** Kjo ishte shprehje hebraike, që donte të thoshte: “betohem para Zotit”.

■ **“mos më torturo”** Gramatikisht, kjo formë foljore është ose lidhore aoriste veprorë për ndalim veprimi, ose lidhore aoriste veprorë që vepron si urdhërore aoriste veprorë, me kuptimin “kurrë mos fillo një veprim” (shih Barbara dhe Timothy Friberg, *Analytical Greek New Testament*, f. 120). Demonët e dinin se gjykimi po vinte (shih Marku 1:23-24; Mat. 25:41; Zbu. 12:9; 20:10). Edhe pasazhet paralele te Mat. 8:29 dhe Luka 8:28, 31 nënkuptojnë gjykimin eskatologjik. Me sa duket, këta demonë nuk e dinin që Mesia do të vinte dy herë. Edhe “frymërat” mund të vuajnë!

5:8, 9 “i tha” Është në kohën e pakryer në greqisht (pra, “po i thoshte”). Kjo kohë përdoret kryesisht në dy mënyra: (1) një veprim i përsëritur në të shkuarën, ose (2) fillimi i një veprimi në të shkuarën. Në këtë kontekst, vetëm alternativa (2) duket e vlefshme. Gjithsesi, nëse rendi i fjalëve që Jezusi i tha demoniakut janë jashtë rendit kronologjik, atëherë vlen dhe alternativa (1). Marku ndoshta po e përdor kohën e pakryer në mënyrë bisedore, pasi kjo kohë përdoret edhe në Marku 5:10.

5:9 “Si të quajnë?” Kjo pyetje mund të jetë idiomë hebraike, pra, kërkon të dijë karakteristikat e tyre.

■ **“Legjion”** Në ushtrinë romake, legjioni përbëhej nga 6,000 ushtarë. Kjo është një nga fjalët e shumta latine që përdoren nga Marku. Ndoshta, ishte metaforë e faktit se ata e kishin vënë përposhtë plotësisht këtë njeri. Megjithatë, për shkak të Markut 5:13, që përshkruan faktin se demonët shkaktuan vdekjen e 2,000 derrave, ndoshta është shifër e fjalëpërfjalshme.

5:10 “nga ajo krahinë” Mund të bëhet fjalë për (1) zonën e varrezave; (2) krahinën e Dekapolit; ose (3) ndoshta për Humnerën e Ferrit, që përmendet në shëmbëlltyrën e Lukës 8:31. Vargu paralel te Mateu thotë “përpara kohës së caktuar” (shih Mat. 8:29).

25:11 Tufa e derrave tregon se kjo ishte zonë ku jetonin johebrenj.

5:12 “Na dërgo në derrat” Vini re se demonët i bënë një kërkesë Jezusit. Teksti nuk na thotë përse i lejoi Jezusi këta demonë që të hynin në derrat, as pse donin që ta bënin këtë. Ndoshta, largimi i demonëve nga burri dhe hyrja në derrat ishte mënyrë e dukshme për ta inkurajuar atë burrë që të besonte se ishte çliruar vërtet (pra, ishte ndihmë pamore, e ngjashme me vendosjen e pështymës dhe baltës në sytë e të verbrit). Demonët mund ta kenë bërë këtë kërkesë për shkak (1) se preferonin më mirë derrat sesa Humnerën, ose (2) ky veprim do t’i bënte banorët e vendit që t’i kërkonin Jezusit të largohej. Demonët nuk bëjnë gjëra që ta ndihmojnë Jezusin!

5:13 “u mbytën” Është folje dëftore e pakryer pësore. Ata u turrën nga shkëmbi në det njëri pas tjetrit!

TEKSTI I NASB (I PËRDITËSUAR): MARKU 5:14-20

¹⁴Kullotësit e derrave ikën me vrap dhe e treguan këtë që ndodhi në qytet dhe në fshat. Dhe njerëzit erdhën të shihnin se çfarë kishte ndodhur. ¹⁵Erdhën te Jezusi dhe vunë re se burri, që kishte qenë i pushtuar nga demonët, ishte i ulur, i veshur dhe me mendje në rregull; pikërisht ai burrë që kishte patur “legjionin”; dhe kishin frikë. ¹⁶Ata që e kishin parë ngjarjen u përshkruan atyre se çfarë i kishte ndodhur të demonizuarit, si dhe për derrat. ¹⁷Dhe ata filluan t’i përgjëroheshin që të largohej nga rajoni i tyre. ¹⁸Teksa po Jezusi po hipte në barkë, burri që kishte qenë i demonizuar po i përgjërohej që ta shoqëronte. ¹⁹Ai nuk e lejoi, por i tha: “Kthehu në shtëpi te njerëzit e tu, dhe tregoju çfarë gjërash të mëdha ka bërë Zoti për ty, dhe sesi pati mëshirë për ty”. ²⁰Dhe ai shkoi dhe filloi të shpallte në Dekapol çfarë gjërash të mëdha kishte bërë Jezusi për të; dhe të gjithë mahniteshin.

5:14 “Dhe njerëzit erdhën të shihnin se çfarë kishte ndodhur” Kureshtja dhe frika i nxit njerëzit e qytetit që të vijnë edhe natën.

5:15 “i ulur” Ky është përshkrimi i parë i një sërë gjërash që përshkruajnë paqen dhe vetëpërbajtjen e sapogjetur të këtij burri.

■ **“i veshur”** Pushtimi demoniak shfaqet në shumë mënyra te njeriu:

1. nuk flet dot (Marku 9:17, 25; Mat. 9:32)
2. s’flet ose nuk shikon (Mat. 12:22)
3. atak epileptik (Mat. 17:15, 18)
4. forcë e jashtëzakonshme (Marku 5:3-4)
5. përpëlitje (Marku 1:26; 9:20)
6. paralizë (Veprat 8:17)

Gjithsesi, jo të gjitha problemet fizike kanë origjinë demoniake. Në ungjijtë bëhet shpesh dallimi mes sëmundjes dhe pushtimit demoniak (shih Marku 1:32,34; 6:13; Mat. 4:24; 10:8; Luka 4:40-41; 9:1; 13:32).

5:17 “filluan t’i përgjëroheshin që të largohej nga rajoni i tyre” Këto dy folje janë dëftore aoriste mësores dhe paskajore e tashme veprorë. Ky refuzim ishte një arsye e mundshme pse demonët donin që të hynin në derrat! Banorët e vendit donin që të largohej Ai që qetësoi atë burrë që askush prej tyre s’e kishte qetësuar dot. Sa dallim ka kjo nga ai fshati në Gjoni 4. Me sa duket, shqetësimet e tyre ekonomike ishin më të rëndësishme se shërimi i këtij burri.

5:19 “Kthehu në shtëpi te njerëzit e tu” Kjo është urdhërore e tashme veprorë. Jezusi po i thoshte të kthehej në familje. E dinte se prania e një ndjekësi me sa duket johebre mund të përbënte problem për disa judenj. Po kështu, nëse burri qëndronte në atë rajon, Jezusi do të kishte një dëshmitar në këtë zonë me johebrenj. Pavarësisht reagimit të tyre, Jezusi donte t’ia dinte për këta njerëz materialistë!

■ **“dhe tregoju”** Kjo është urdhërore aoriste veprorë. Pra, tregoju njerëzve të tu se çfarë ka bërë për ty Perëndia. Me sa duket, ai e kreu më së miri këtë detyrë (shih Marku 5:20). Kjo tregon dhembshurinë e Jezusit për johebrenjtë.

5:20 “Dekapol” Kjo fjalë greke do të thotë “dhjetë qytete”. Ato ishin një konfederatë që nga koha e Aleksandrit të Madh. Ky rajon ishte në veri te Peresë dhe në lindje të Detit të Galilesë. Ishte strehë e kulturës heleniste.

TEKSTI I NASB (I PËRDITËSUAR): MARKU 5:21-24

²¹Pasi Jezusi kaloi sërish me barkë në bregun tjetër, një turmë e madhe u mblodh rreth tij; prandaj qëndroi në breg të detit. ²²Një nga krerët e sinagogës, i quajtur Jair, erdhi dhe, kur e pa, i ra para këmbëve ²³dhe iu përgjërua fort duke i thënë: “Bija ime e vogël është në prag të vdekjes; të lutem, eja dhe vendosi duart mbi të që të bëhet mirë dhe të jetojë!” ²⁴Dhe Jezusi u nis me të; dhe një turmë e madhe po e ndiqte dhe po shtyhej rreth tij.

5:22 “Një nga krerët e sinagogës, i quajtur Jair” Emri i tij do të thotë “JHVH më ka përndritur”. Ai ishte personi përgjegjës për detyrat administruese, si mirëmbajtja e godinës së sinagogës. Duhet të ketë qenë njeri me njëfarë pozite fetare në komunitet.

■ **“i ra para këmbëve”** Ky ishte veprim nderimi dhe adhurimi (shih Marku 5:6 ,22, 33, ku përdoren fjalë të tjera, por bëhet fjalë për të njëjtin veprim). Pamja e një kreu oriental, i shtrirë përmbys në rrugë përpara një rabini jozyrtar, duhet të ketë qenë tejet e papritur!

■ **“Bija ime e vogël është në prag të vdekjes”** Mateu 9:18 thotë se ajo kishte vdekur. Ky burrë besonte se prania dhe prekja e Jezusit do t’ia shëronte/rikthente të bijën.

5:23

NASB, TEV “të bëhet mirë”
NKJV “të shërohet”
NRSV “të të bëhet mirë”
NJB “të shpëtojë”

Kjo është formë lidhore aoriste pësore e foljes *sōzō*; këtu, përdoret në kuptimin e DHV, pra të çlirimit fizik (shih Jakobi 5:15). Në DHR, kjo folje merr kuptimin e shpëtimit shpirtëror. Është e paqartë teologjikisht nëse gjithë ata që shëronte Jezusi shpëtoheshin edhe shpirtërisht. Veprimet e tij ndoshta nisnin një proces që pikën kulmore e arrinte më vonë në jetën shpirtërore të individit në fjalë, por që nuk na thuhet në Bibël.

Për shembull, shihnin në këtë kapitull pikën kur besimi i të demonizuarit shihet, jo para, por pas shërimit të vet. Vajza e vogël ndihmohet për shkak të besimit të të atit, dhe gruaja me problemin e gjakrrjedhjes ishte e gatshme ta ndoste Jezusin nga ana ceremoniale duke prekur një rabin në mënyrë egoiste (dhe, ndoshta, besëtyte). Ku përfundon interesi dhe ku fillon besimi?

5:24 “po shtyhej rreth tij” Luka 8:42 shton se shtypja e turmës ishte kaq e madhe sa që ishte pothuajse e pamundur të merrje frymë.

TEKSTI I NASB (I PËRDITËSUAR): MARKU 5:25-34

²⁵Një grua që kishte gjakrrjedhje prej dymbëdhjetë vitesh, ²⁶dhe që kishte vuajtur shumë në duart e shumë mjekëve dhe kishte shpenzuar gjithçka që kishte por pa asnjë dobi, madje ishte përkeqësuar, ²⁷kur dëgjoi për Jezusin, hyri në turmë pas tij dhe ia preku rrobat. ²⁸Sepse thoshte me vete: “Nëse vetëm ia prek rrobat, do të shërohem”. ²⁹Menjëherë, gjakrrjedhja i pushoi; dhe ndjeu në trup se ishte shëruar nga sëmundja. ³⁰Menjëherë, Jezusi, duke kuptuar në vete se forca e vet kishte dalë prej tij, u kthye mes turmës dhe tha: “Kush m’i preku rrobat?” ³¹Dhe dishepujt i thanë: “Ti e sheh që turma po shtyhet rreth teje, dhe thua ‘Kush më preku?’” ³²Por ai po vështronte përreth që të shihte gruan që e kishte bërë këtë. ³³Por gruaja, duke u frikësuar dhe duke u dridhur, e vetëdijshme se çfarë i kishte ndodhur, erdhi dhe ra përpara tij dhe i tregoi gjithë të vërtetën. ³⁴Dhe ai i tha: “Bijë, besimi yt të ka shëruar; shko në paqe dhe jji e shëruar nga sëmundja jote!”.

5:25 “gjakrrjedhje prej dymbëdhjetë vjetësh” Kjo duhet ta ketë bërë këtë grua të papastër nga ana ceremoniale (shih Lev. 15:25-27) dhe, si rrjedhojë, e kishte përjashtuar nga çdo formë adhurimi jude (pra, nga sinagoga dhe tempulli).

5:26 “dhe kishte vuajtur shumë në duart e shumë mjekëve” Luka, që ishte mjek, nuk e përmend këtë pjesë të Luka 8:43 e më tej.

■ **“kishte shpenzuar gjithçka që kishte por pa asnjë dobi”** Kurat judaike që renditeshin për këtë problem në Talmud ishin: (1) mbajtja e hirit të një veze struci në një leckë liri rreth qafës në verë dhe në një leckë pambuku në dimër; ose (2) mbajtja e kokrave të elbit nga bajgat e gomarcës së bardhë (shih Shab. 110 A & B).

5:27 “ia preku rrobën” Ndoshta, i preku shallin e lutjes, që burrat e përdornin për të mbuluar kokën gjatë adhurimit. Quhej *talit* (shih Num. 15:38-40; LiP. 22:12). Për një grua të papastër nga ana ceremoniale, prekja e një rabini ishte veprim i pahijshëm. Por ajo ishte e dëshpëruar!

5:30 “Menjëherë” Shih shëniin në Marku 1:10.

▣ **“Jezus, duke kuptuar në vete se forca”** Natyra e saktë e kësaj force është e paqartë. Pa dyshim që vinte nga Perëndia (shih Luka 5:17). Jezusi ia ndiente ndikimin. Ishte në gjendje t’ua jepte të tjerëve, si për shembull, në misionin e të Dymbëdhjetëve dhe të Shtatëdhjetëve.

▣ **“e vet kishte dalë prej tij”** Mateu 8:17 citon Isa. 53:4 se Mesia do të na shërojë për shkak se mbarti dobësitë tona.

▣ **“Kush m’i preku rrobat”** Turma ishte e madhe (shih Marku 5:31). Mateu 9:20 lexon “xhufkat”. Shalli i lutjes kishte trembëdhjetë xhufka blu, që përkujtonin ligjin e Moisiut.

5:32 “ai po vështronte përreth” Koha e pakryer tregon se Jezusi nisi të këqyrte turmën. Në këtë rast, nuk kishte dijeni të mbinatyrsme se kush ishte personi në fjalë, apo çfarë kishte ndodhur. Ndoshta, kjo pyetje synohej për gruan (pra, si mundësi që të shprehte besimin e saj).

5:33 “duke u frikësuar dhe duke u dridhur” Gratë ishin vend shumë të ulët në shoqëri. Ajo ngurronte të fliste në publik. Po kështu, e dinte se, meqë ishte e papastër nga ana ceremoniale, nuk i lejohej të prekte rabinin.

5:34 “Bijë” Mësimet e Jezusit zbulojnë të vërtetën e mahnitshme se qeniet njerëzore, përmes besimit në Jezusin, mund të bëhen anëtarë të familjes së Perëndisë. Shpëtimi përshkruhet me terma të lindjes ose ligjore, që tregojnë marrëdhënie familjare. Sa metafora të fuqishme që janë këto për përjetimin e krishterë!

▣ **“besimi yt të ka shëruar”** Çelësi ishte, jo prekja e Jezusit, por veprimi në bazë të besimit në të. Po kështu, thelbi nuk ishte besimi, por objekti i besimit të saj (pra, Jezusi). Kjo që ndodhi s’ishte aspak magjike, as nuk ndodhi nga forca e endimit pozitiv, por ndodhi nga forca e Jezusit. Ky është një tjetër përdorim i fjalës *sozo* në kuptimin e DHV (shih Marku 5:23). Këtu, jepet si dëftore e kryer pësore, që tregonte se ajo u shërua dhe mbeti e shëruar nga problemi i vet fizik.

▣ **“shko në paqe dhe ji e shëruar nga sëmundja jote”** Këto folje janë të dyja në formën urdhërore të tashme veprare. Fjala paqe (*irini*) ka kuptimin e plotësisë dhe mirëqenies, jo thjesht të mungesës së problemeve. Fjala “sëmundje” vjen nga rrënja “godas e kamxhik”.

TEKSTI I NASB (I PËRDITËSUAR): MARKU 5:35-43

³⁵Ndërsa ende po fliste, erdhën disa nga shtëpia e kreut të sinagogës duke thënë: “Jot bijë vdiq; pse e shqetëson akoma Mësuesin?” ³⁶Por Jezusi, që ia zuri veshi këto fjalë, i tha kreut të sinagogës: “Mos ki më frikë, vetëm beso”. ³⁷Dhe nuk lejoi askënd që ta shoqëronte, përveç Pjetrit, Jakobit dhe Gjonit, vëllait të Jakobit. ³⁸Erdhën në shtëpinë e kreut të sinagogës; dhe Jezusi pa një pështjellim, dhe njerëz që qanin dhe vajtonin me zë të lartë. ³⁹Si hyri brenda, u tha: “Pse bëni zhurmë dhe vajtoni? Fëmija nuk ka vdekur, por po fle”. ⁴⁰Ata nisën ta përqeshnin. Por, si i nxori të gjithë jashtë, mori me vete babain dhe nënën e fëmijës, bashkë me shoqëruesit e vet, dhe hyri në dhomën ku ishte fëmija. ⁴¹Si e kapi fëmijën për dore, i tha: “Talitha kum!” (që, e përkthyer, do të thotë: “Vogëlushe, po të them, çohu!”). ⁴²Menjëherë, vajza u ngrit dhe nisi të ecte, sepse ishte dymbëdhjetë vjeç. Dhe, menjëherë, ata u mahnitën plotësisht. ⁴³Dhe ai i urdhëroi prerazi që askush të mos dinte për këtë, dhe u tha që t’i jepnin vajzës diçka për të ngrënë.

5:35 “vdiq” Kjo është dëftore aoriste veprare. Jam i sigurt se Jairo ishte shumë i paduruar! Duket se kjo ishte një sprovë për besimin e tij, ose një tjetër shembull i fuqisë dhe autoritetit të Jezusit.

5:36

NASB “ia zuri veshi këto fjalë”
NKJV “sapo Jezusi dëgjoi fjalët që u thanë”
NRSV, NJB “ia zuri veshi ato që thanë”
TEV “Jezusi nuk ua vari fjalëve të tyre”
NIV “pa ua varur fjalëve të tyre”

Rrënja greqisht e kësaj fjale do të thotë “dëgjoj pa kujdes”. Mund të përkthehet, “s’kushtoj vëmendje” ose “dëgjoj rastësisht”. Kjo fjalë është kaq e vagullt saqë, shumë herët, kopjuesit e ndryshuan në fjalën “dëgjoj” (shih dorëshkrimet Sinaitikus, A, C, D dhe K), që gjenden në vargun paralel te Luka 8:50.

■ **“Mos ki më frikë”** Kjo është urdhërore e tashme me një pjesore mohore, që zakonisht, nënkupton ndalimin e një veprimi që po kryhet. E kundërta e frikës është besimi!

■ **“vetëm beso”** Kjo është një tjetër urdhërore e tashme veprare. Një thënie e thjeshtë, por kyçe (shih Veprat 16:31).

5:37 “nuk lejoi askënd që ta shoqëronte” Është e paqartë pse Jezusi kishte një grup të ngushtë dishepujsh (shih Marku 1:29; 5:37; 9:2; 13:3; 14:33). Ungjilli i Markut është dëshmia okulare e Pjetrit. Ky rreth i ngushtë nuk kishte ndonjë privilegj të veçantë, pasi Jakobi u vra herët.

Jezusi nuk donte të përhapej fama e tij si shërues, apo si dikush që ngjallte të vdekurit. Kjo është një nga ato llojet e ndyrshme të shprehjeve të Markut, që teologët i quajnë “sekreti mesianik” (shih Marku 5:43). Jezusi kishte tashmë probleme të madhe logjistike me turmat e mëdha, kështu që s’kishte nevojë për më tepër telashe.

■ **“Pjetrit, Jakobit dhe Gjonit”** Ky ishte rrethi i ngushtë i dishepujve të Jezusit (shih Marku 9:2; 14:33; Mat. 17:1; 26:37; Luka 9:28).

5:38 “dhe njerëz që qanin dhe vajtonin me zë të lartë” Këto ishin rituale të njohura, madje dhe të pritshme, në funeralet judaike. Kjo tregon se familja e priste vdekjen e bijës së Jairit, dhe kishte bërë tashmë përgatitje për këtë gjë.

5:39 “Fëmija nuk ka vdekur, por po fle” “Gjumi” ishte eufemizëm i DHV për vdekjen. Jezusi e përdor për Lazarin te Gjoni 11:11. Këtu, vihet si kontrast me vdekjen. Vras mendjen se, nëse Marku 5:37 konsiderohet si “sekreti mesianik”, atëherë pse ia tha këto fjalë turmës, përveçse nëse po përpiquej që të reduktonte ndikimin (pra, thashethemet e mëvonshme) e ringjalljes së saj?

5:40 “nisën të përqeshnin” Kjo është në kohën e pakryer, që nënkupton se dëgjuesit vazhduan ta tallnin për një kohë të gjatë, ose se filluan të qeshnin në atë pikë.

■ **“bashkë me shoqëruesit e vet”** Bëhet fjalë për Pjetrin, Jakobin dhe Gjonin. Në shumë mënyra, mrekullitë e Jezusit synonin jo vetëm edukimin dhe besimin e njerëzve, por edhe atë të dishepujve!

5:41 “Talitha, kum” Kjo është frazë në aramaisht. Judenjtë në kohën e Jezusit flisnin aramaisht, jo hebraisht. Kjo duhet të ketë qenë dhe gjuha amtare e Jezusit. Në ungjijtë përmenden një sërë frazash aramaisht (p.sh., *sabbata*, Marku 3:4; *Boanerges*, Marku 3:17; Satani, Marku 3:23, 26; 8:33; *Talitha kumi*, Marku 5:41; *Effata*, Marku 7:35; *Gehena*, Marku 9:43, 45, 47; *paska*, Marku 14:14; *Aba*, Marku 14:36; *Eloi, Eloi, lama sabaktani*, Marku 15:34). Fakti se Marku e përkthen, tregon se po iu drejtohet lexuesve johebrenj.

5:42” Menjëherë... menjëherë” Shih shënimin në Marku 1:10.

■ **“ishte dymbëdhjetë vjeç”** Kjo moshë tregon se ajo ishte përgjegjëse për zbatimin e ligjit (pra, *bat micva*) dhe ishte në moshë të pjekur për martesë. Djemtë ishin përgjegjës para ligjit, pra në moshë madhore, kur mbushnin trembëdhjetë vjeç (pra, *bar micva*). Jetëgjatësia normale ishte shumë më e shkurtër se sot, dhe brenda një familjeje jetonin së bashku disa breza; për këtë arsye, martoheshin shumë më të rinj se sot.

5:43 “i urdhëroi prerazi që askush të mos dinte për këtë” Jezusi nuk donte që të njihej si shërues, ose si mrekullibërës. Këto gjëra i bënte për të zbuluar dhembshurinë e Perëndisë dhe për ta përforcuar mesazhin dhe autoritetin e vet (Marku 1:44; 3:12; 5:43; 7:36;8:26,30; 9:30; Matt. 8:4; 9:30; 12:16; 17:9).

▣ **“u tha që t’i jepnin vajzës diçka për të ngrënë”** Kjo është një tjetër hollësi prej dëshmitari okular. Jezusi tregon përkujdesje për vogëlushen. Kjo provon gjithashtu se ajo ishte rikthyer fizikisht në jetë.

PYETJE PËR DISKUTIM

Ky është një komentari studimor udhëzues, që do të thotë se ti je vetë përgjegjës për interpretimin e Biblës. Secili prej nesh duhet të ecë sipas dritës që ka. Ti, Bibla dhe Fryma e Shenjtë keni përparësi në interpretim. Nuk duhet t’ia dorëzosh këtë të drejtë komentuesit.

Këto pyetje për diskutim t’i kam dhënë për të të ndihmuar që të analizosh çështjet kryesore të kësaj pjese të librit. Ato synojnë të të nxisin mendimin, jo të kenë natyrë shteruese.

1. Çfarë është pushtimi nga demonët? A mund të ndodhë sot? A mund t’i prekë dhe të krishterët?
2. Pse lejoi Jezusi që të mbyteshin derrat?
3. Pse e përzunë Jezusin banorët e vendit?
4. Pse duhet që ish i demonizuar të qëndronte aty?
5. Ç’kuptim ka: “i doli forca”?”
6. Pse thotë Jezusi për fëmijën e vdekur që “po fle”?
7. Pse kërkon Jezusi që të mbetet e fshehtë ringjallja e bijës së Jairit?
8. Pse kishte Jezusi një rreth të ngushtë dishepujsh?

MARKU 6

NDARJET NË PARAGRAFË TË PËRKTHIMEVE MODERNE

UBS ⁴	NKJV	NRSV	TEV	NJB
Refuzimi i Jezusit në Nazaret 6:1-6a	Jezusi refuzohet në Nazaret 6:1-6	Refuzimi në qytetin e vet 6:1-6a	Jezusi refuzohet në Nazaret 6:1-3 6:4 6:5-6a	Vizita në Nazaret 6:1-6a
Misioni i të Dymbëdhjetëve 6:6b-13	Dërgimi i të Dymbëdhjetëve 6:7-13	Autorizimi dhe udhëzimet për të Dymbëdhjetët 6:6b-13	Jezusi dërgon dymbëdhjetë dishepujt 6:6b-11 6:7-13	Misioni i të Dymbëdhjetëve 6:6b-13
Vdekja e Gjon Pagëzorit 6:14-29	Gjon Pagëzorit i pritet koka 6:14-29	Vdekja e Gjonit 6:14-16 6:17-29	Vdekja e Gjon Pagëzorit 6:14 6:15a 6:15b 6:16-18 6:19-20 6:21-23 6:24a 6:24b 6:25 6:26-29	Herodi dhe Jezusi 6:14-16 Gjon Pagëzorit i pritet koka 6:17-20
Ushqyerja e pesë mijë vetëve 6:30-44	Ushqyerja e pesë mijë vetëve 6:30-44	Ushqyerja e pesë mijë vetëve 6:30-44	Jezusi ushqen pesë mijë vetë 6:30-32 6:33-36 6:37a 6:37b 6:38a 6:38b 6:39-44	Mrekullia e parë e bukëve 6:30-44
Ecja në ujë 6:45-52	Jezusi ecën në det 6:45-52	Jezusi ecën në ujë 6:45-46 6:47-52	Jezusi ecën në ujë 6:45-50a 6:50b-52	Jezusi ecën në ujë 6:45-52
Shërimi i të sëmurëve në Genesaret 6:53-56	Shumë vetë prekin Jezusin dhe shërohen 6:53-56	Besimi në fuqinë e Jezusit për shërim 6:53-56	Jezusi shëron të sëmurët në Genesaret 6:53-56	Shërimet në Genesaret 6:53-56

CIKLI TRE I LEXIMIT (shih f. v)

NDJEKJA E SYNIMIT TË AUTORIT FILLESTAR NË NIVELIN E PARAGRAFËVE

Ky është një komentuar studimor udhëzues, që do të thotë se ti je vetë përgjegjës për interpretimin e Biblës. Secili prej nesh duhet të ecë sipas dritës që ka. Ti, Bibla dhe Fryma e Shenjtë keni përparësi në interpretim. Nuk duhet t'ia dorëzosh këtë të drejtë komentuesit.

Lexo gjithë kapitullin njëherësh. Identifiko temat. Krahaso ndarjet e tua tematike me pesë përkthimet moderne. Ndarja në paragrafë nuk është e frymëzuar, por është çelësi për të ndjekur synimin e autorit fillestar, gjë që është thelbi i interpretimit. Secili paragraf ka vetëm një temë të vetme.

1. Paragrafi i parë
2. Paragrafi i dytë
3. Paragrafi i tretë
4. Etj.

PASAZHET PARALELE NË UNGJIJTË SINOPTIKË

- A. Vargjet 1-6a gjenden edhe te Mat. 13:54-58.
- B. Vargjet 6b-13 gjenden edhe te Mat. 9:35-11:1 dhe Luka 9:1-6.
- C. Vargjet 14-29 gjenden te Mat. 14:1-2, Marku 6:14-16 dhe Luka 9:7-9.
- D. Vargjet 30-44, pra, ushqyerja e pesë mijë vetëve, gjenden në të katërt ungjijtë (Marku 6:30-44; Mat. 14:13-21; Luka 9:10-17; Gjoni 6:1-13).
- E. Vargjet 45-52 gjenden te Mat. 14:22-23 dhe Gjoni 6:14-21.
- F. Vargjet 53-56 gjenden te Mat. 14:34-36.

STUDIMI I FJALËVE DHE FRAZAVE

TEKSTI I NASB (I PËRDITËSUAR): MARKU 6:1-6a

¹Jezusi doli prej andej dhe hyri në vendlindjen e tij; dhe dishepujt e ndiqnin. ²Kur erdhi shabati, nisi t'i mësonte në sinagogë; dhe shumë prej dëgjuesve u mahnitën dhe po thoshin: “Ku i gjeti ky njeri këto gjëra, dhe ç'është kjo urtësi që i është dhënë atij, dhe këto lloj mrekullish që kryhen nga duart e tij?” ³A nuk është ky zdrukhtari, biri i Marisë, dhe vëllai i Jakobit, Joseut, Judës dhe Simonit? A nuk janë motrat e tij këtu me ne?” Dhe fyheshin prej tij. ⁴Jezusi u tha: “Profeti nuk është pa nderim përveçse në vendlindjen e tij, ndër të afërmit e tij dhe në shtëpinë e tij”. ⁵Dhe nuk mundi të kryente aty asnjë mrekulli përveçse vuri duart mbi ca të sëmurë dhe i shëroi. ⁶Dhe çuditej nga mosbesimi i tyre.

6:1 “Jezusi doli prej andej” Bëhet fjalë për Kapernaumin, që ishte kthyer në selinë galilease të Jezusit.

■ **“hyri në vendlindjen e vet”** Fjalë për fjalë, “vendi i tij i lindjes”; bëhet fjalë për Nazaretin (shih Marku 1:9, 24), ku Jezusi ishte rritur. Ndodhej 32 km në juglindje të Kapernaumit. Me sa dihet, ishte ngulim i ri i judeasve.

■ **“dhe dishepujt e tij e ndiqnin”** Jezusi i trajnonte dishepujt duke i marrë me vete gjithë kohës (shih Robert Coleman, *The Master Plan of Evangelism*). Shumë prej mësimeve dhe mrekullive të Jezusit kishin si shënjestër dhe dishepujt.

6:2 “t'i mësonte në sinagogë” Jezusi shkonte rregullisht në sinagogë. Shpesh, e ftonin të fliste si mësues i ftuar, një praktikë e përhapur për kohën.

▣ **“shumë prej dëgjuesve u mahnitën”** Ata nuk binin ia kundërshtonin mësimet, por ia vinin në dyshim kualifikimet dhe shkollimin. Kjo ngjason dhe me farisenjtë, që ia vinin në dyshim autoritetin.

▣ **“Ku i gjeti ky njeri këto gjëra?”** Urtësia, fuqia dhe autoriteti i Jezusit habisnin çdo njeri. Në vegjëli, Jezusi kishte qenë njësoj si fëmijët e tjerë të fshatit. Grupe të ndryshme bënë vazhdimisht pyetjen: nga i erdhën këto cilësi? Të gjithë e kishin të qartë se Jezusi zotëronte urtësi dhe autoritet të madh!

▣ **“këto lloj mrekullish që kryhen nga duart e tij”** Kapernaumi ishte vetëm 32 kilometra nga Nazareti, kështu që ishte përhapur fjala për mrekullitë e tij.

6:3 “A nuk është ky zdrucktari?” Fjala “zdruckhtar” do të thotë edhe “zanatçi”, që mund të nënkuptonte një punues druri, metali, ose guri. Justini tha se përdorej për atë që bënte parmendat dhe zgjedhët (*Dial.* 88:8). Me sa duket, Jezusi ishte bërë zdrucktari i qytetit pas vdekjes së parakohshme të Jozefit.

▣ **“biri i Marisë”** Ashtu si fraza “ky njeri” te Marku 6:2, edhe kjo ndoshta ishte përpjekje për të treguar përçmim. Banorët e qytetit duhet ta kenë ditur për shtatzëninë e Marisë. Origeni thotë se, në origjinal, thuhej: “biri i zdruckhtarit dhe Marisë”, pasi ishte tejet e pazakontë që të përmendej nëna. Për shkak të Gjonit 8:41, disa mendojnë se kjo lidhet me thashethemin e përhapur gjerësisht se Jezusi ishte fëmija i jashtëligjshëm i një ushtari romak. Shumica e ndryshimeve në dorëshkrime vijnë nga anësia teologjike e kopjuesve, të cilët ndoshta kishin frikë se mos doktrina e lindjes së virgjër komprometohej nga fraza paralele te Mateu: “biri i zdruckhtarit dhe Marisë” (shih Mat. 13:55).

▣ **“vëllai i”** Kjo tregon fëmijërinë normale të Jezusit (shih Luka 2:40, 52). Po kështu, tregon se Maria kishte dhe fëmijë të tjerë. Nga kjo listë e vëllezërve dhe motrave (shih Mat. 13:55-56), dy prej tyre, Jakobi dhe Juda, janë autorë të DHR.

NASB “fyheshin prej tij”

NKJV “fyheshin prej tij”

NRSV “fyheshin prej tij”

TEV “e refuzuan”

NJB “nuk e pranuan”

Kjo është fjala *skandalon*, që do të thotë “shkop me karrem që përdorej si kurth”. Fjalën “skandal” e kemi marrë pikërisht nga ky term.

Ky koncept kishte vlerë të madhe mesianike në DHV (shih Psa. 118:22; Isa. 8:14; 28:16). Ashtu si krerët fetarë, edhe banorët e Nazaretit nuk e tejkalonin dot anësinë e tyre (shih Marku 6:4).

6:4 “Profeti” Vargu 4 ishte fjalë e urtë dhe e njohur në kohën e Jezusit. Jezusi ishte patjetër më tepër se profet, por ky ishte një nga titujt që Moisiu përdori për të Ardhurin e veçantë të Perëndisë (shih LiP. 18:15, 18).

6:4 “nuk mundi të kryente aty asnjë mrekulli” Kjo nuk nënkupton dobësi nga ana e Jezusit, por kufizimin e vetëdijshëm që ai i bëri shërbesës së vet. Vargu paralel te Mat. 13:58 shkruan “nuk kreu”, jo “nuk mundi të kryente”. Jezusi nuk shihte vlerën e personit; nuk bënte preferenca. Luka 7:11-14 tregon se Jezusi nuk kërkonte gjithmonë një reagim me besim, por gjithsesi kjo ishte ajo që pritej normalisht. Besimi në Perëndinë dhe në Jezusin i hap derën sferës shpirtërore. Nuk ka rëndësi sasia e besimit, por Personi të cilit i drejtohet ai!

▣ **“Vuri duart mbi ca të sëmurë”** Shih Temën e Veçantë në Marku 7:32.

6:6a

NASB “çuditej nga mosbesimi i tyre”

NKJV “habitej për shkak të mosbesimit të tyre”

NRSV “shtangej nga mosbesimi i tyre”

TEV “ishte shumë i habitur, ngaqë njerëzit nuk kishin besim”

NJB “habitej nga mungesa e besimit të tyre”

Kjo është dëftore e pakryer veprorë, që nënkupton veprim të përsëritur. Jezusi habitej nga verbëria dhe zemërgurtësia e njerëzve (Jezusi u refuzua dy herë në Nazaret, shih Luka 4:16-31). Ndonëse ishin në praninë e një të vërtete madhështore, dhe ndonëse shihnin shenja të mrekullueshme (shih Marku 6:2), ata s'pranonin të besonin (shih Isa. 6:9-10).

TEKSTI I NASB (I PËRDITËSUAR): MARKU 6:6b-13

⁶Dhe ai shkante nëpër fshatra dhe i mësonte. ⁷Dhe i thirri të dymbëdhjetët dhe filloi t'i dërgonte dy nga dy, dhe u dha autoritet mbi frymërat e ndyra; ⁸dhe i porositi që të mos merrnin asgjë me vete udhës, përveç një shkopi—as bukë, as trastë, as para në brez—⁹dhe sandaleve; dhe shtoi: “Mos vishni dy tunika”. ¹⁰Dhe u tha: “Kudo që të hyni në shtëpi, qëndroni aty derisa të largoheni nga qyteti. ¹¹Nëse ndonjë vend nuk ju pranon ose nuk ju dëgjon, kur të dilni prej atyre, shkundni pluhurin nga thembrat e këmbëve si dëshmi kundër tyre”. ¹²Ata dolën dhe predikuan që njerëzit të pendoheshin. ¹³Dhe dëbonin shumë demonë dhe vajosnin me vaj shumë të sëmurë dhe i shëronin.

6:7 “filloi t'i dërgonte dy nga dy” Kjo ndoshta nënkupton një mision të veçantë, dhe jo një autorizim universal.

■ **“dy nga dy”** Ndoshta, për shkak se nevojiteshin dy dëshmitarë për të vërtetuar një çështje (shih LiP. 19:15). Ndoshta, kjo ishte edhe për shkak të aspektit sociologjik të inkurajimit të njëri-tjetrit. Këta dy dëshmitarë përballeshin me një botë armiqësore nga ana shpirtërore dhe kulturore.

■ **“dhe u dha autoritet mbi frymërat e ndyra”** Vargu paralel te Luka 9:1 shton: “dhe që të shëronin sëmundje”. Vargu paralel te Mat. 10:8 shton: “të shëronin të sëmurët, të ringjallnin të vdekurit, të pastronin lebrozët dhe të dëbonin demonët”. Të gjitha këto veprime ishin shenja mesianike nga DHV, shenja të përkujdesjes së Perëndisë, shenja të fuqisë së Perëndisë dhe mbretërisë së tij të ardhshme. Shih Temën e Veçantë te Marku 1:25.

Fuqia dhe autoriteti i Jezusit mund t'u delegohej ndjekësve të tij. Pa dyshim, disa aspekte të autorizimit të të Dymbëdhjetëve nga Jezusi nuk mund të përsëritet, por fuqia e Perëndisë është e disponueshme edhe për kishën e tij. Ku është kjo fuqi në kohën tonë? Me sa duket, këto fuqi-shenja përdoren për të vërtetuar mesazhin e ungjillit dhe për t'i dhënë besueshmëri predikuesit të ungjillit. Kjo vlen dhe sot. Megjithatë, në ato kultura ku mesazhi i ungjillit ka zënë rrënjë, besimtarët duhet të ecin me anë të besimit, jo shikimit; beso në Perëndinë, mos kërko mrekulli (shih Gjoni 4:48)!. Mrekullitë nuk janë përgjigje për problemet e besimit! Po kështu, ka mundësi që gjykimi i Perëndisë për kishën e vakët është imazhi i suksesit, por realiteti i pafrytshmërisë.

Shenjat dhe mrekullitë, si dhe veprimtaria demonike dhe engjëllorë, ishin shtuar së tepërmi në kohën e Jezusit dhe apostujve. Kjo veprimtari shpirtërore është, pa dyshim, e pranishme në çdo epokë, por u përforcua gjatë ardhjes së parë të Jezusit dhe do të përforcohet sërish kur koha e ardhjes së dytë të tij të afrohet.

Unë gëzohem nga shfaqjet e shenjave të dashurisë dhe fuqisë së Perëndisë (pra, dhuntitë janë ende vepruese), por besoj në të vërtetat e ungjillit, jo në praninë ose mungesën e shfaqjeve fizike. Mrekullitë dhe shenjat mund të jenë të rreme (shih Mat. 24:24; 2 Thes. 2:9; Zbu. 13:13; 16:14; 19:20). Besimtarët nuk duhet të kërkojnë konfirmim! Besimi prej fëmije është më i lartë shpirtërisht sesa shenjat dhe mrekullitë e mbinatyrshme.

6:8 “i porositi që të mos merrnin asgjë me vete udhës, përveç një shkopi” Të gjithë ungjijtë sinoptikë e përmendin këtë, por në mënyra disi të ndryshme. Mateu 10:9-11 nënkupton shprehjen “mos bli tjetër shkop për rrugën”. Luka 9:3 ngjason me Mat. 10:10, por heq frazën “mos bli” të Mat. 10:9. Të gjithë udhëtarët merrnin me vete shkop për t'u mbrojtur. Ideja e këtyre thënieve është se këta misionarë duhet të mbështeteshin plotësisht nga furnizimin e Perëndisë (fizikisht dhe shpirtërisht), jo në forcat e tyre.

Për një diskutim të plotë të dallimeve mes Mateut, Markut dhe Lukës në lidhje me atë që duhet të merrnin (ose të mos merrnin) dishepujt me vete në udhëtimin e tyre misionar, shih *Hard Sayings of the Bible*, shih 422-24.

■ **“trastë”** Ndoshta, ishte një çantë shpine.

■ **“para në brez”** Ndoshta, bëhej fjalë për brezin ku mbaheshin paratë.

6:9 “Mos vishni dy tunika” Bëhet fjalë për një rrobë të jashtme, që përdorej edhe si mbulesë për gjumë. Kjo do të thotë: mos merrni rroba të tjera me vete (pra, mos u përpiqni të jeni gati për çdo të papritur).

6:10 “qëndroni aty derisa të largoheni” Ata s’duhet të kërkonin akomodim më të mirë. Vendi i parë ku njerëzit, nga besimi, ua hapnin derën e shtëpisë dishepujve, ishte dhe vendi ku duhet të qëndronin.

6:11 “Nëse ndonjë vend nuk ju pranon ose nuk ju dëgjon” “Ndonjë vend” bëhet fjalë për qytetet ose sinagogat. Ndonëse fjalë për fjalë është “pranon”, kuptimi është “mirëpret”.

▣ **“shkundni pluhurin nga thembrat e këmbëve si dëshmi kundër tyre”** Kjo duhej bërë me anë të një veprimi që simbolizonte gjykimin dhe ndarjen e ardhshme (shih Veprat 13:51; dhe një veprim i ngjashëm në Marku 18:6). Ky ishte zakoni i përhapur judaik kur njerëzit dilnin nga Samaria dhe hynin në rajonin e Judesë.

▣ Marku 6:11 (NKJV) përmban një fjali shtesë: “Me të vërtetë po ju them: do të jetë më e lehtë për Sodomën dhe Gomorrën në ditën e gjykimit sesa për atë qytet”. Kjo gjendet në dorëshkrimin A dhe në shumë dorëshkrime të mëvonshme minuskule greke. Nuk e shkroi Marku, por duket se është kopjuar nga Mat. 10:15 dhe është futur nga kopjuesit në tekstin e Markut.

6:12 “ata... predikuan që njerëzit të pendoheshin” Pendimi është kyç për të patur një marrëdhënie besimi me Perëndinë (shih Mat. 3:2; 4:17; Marku 1:15; 6:12; Luka 13:3, 5; Veprat 2:38; 3:19; 20:21). Në hebraisht, kjo fjalë nënkuptonte ndryshim veprimi, ndërsa në greqisht nënkuptonte ndryshimin e mendjes. Pendimi është gatishmëria për të hequr dorë nga ekzistenca egoiste dhe për të bërë një jetë të informuar dhe të drejtuar nga Perëndia. Kjo kërkon që t’i kthesh shpinën përparësisë së vetes dhe robërimit ndaj vetes. Në thelb, kërkon një qëndrim të ri, një botëkuptim të ri, një zotëri të ri. Pendimi është vullneti i Perëndisë për çdo qenie njerëzore të krijuar në shëmbëllimin e tij (shih Ezek. 18:21, 23, 32; Luka 13:1-5; dhe 2 Pje. 3:9).

Pasazhi i DHR, që reflekton më së miri termat e ndryshëm greqisht për pendimin, është 2 Kor. 7:8-12:

1. *Lupe*, “hidhërim” ose “trishtim”: Marku 6:8 (dy herë), 9 (tri herë), 10 (dy herë), 11
2. *Metamelomai*, “preokupim më vonë”: Marku 6:8 (dy herë), 9
3. *Metanoeo*, “pendim”, “pasmendje”: Marku 6:9, 10

Kontrasti është midis pendimit të rremë [*metamelomai*], (p.sh.: Juda (Mat 27:3) dhe Esau (Heb. 12:16-17)) dhe pendimi të vërtetë [*metanoeo*].

Pendimi i vërtetë lidhet teologjikisht me:

1. predikimin e Jezusit për kushtet e Besëlidhjes së Re (shih Mat. 4:17; Marku 1:15; Luka 13:3, 5)
2. predikimet e apostujve në Veprat (pra, *kerigma*, shih Veprat 3:16, 19; 20:21)
3. dhuntinë sovranë të Perëndisë (shih Veprat 5:31; 11:18 dhe 2 Tim. 2:25)
4. humbjen e përjetshme (shih 2 Pje. 3:9). Pendimi nuk është diçka fakultative!

Shih Temën e Veçantë: Pendimi në Dhiatën e Vjetër (Marku 1:4d).

6:13 “dëbonin shumë demonë dhe vajosnin me vaj shumë të sëmurë dhe i shëronin” Vini re se DHR bën dallimin mes sëmundjes dhe pushtimit demoniak. Shih shënimin në Marku 1:25c.

▣ **“i vajosnin me vaj”** Vaji përdorej në disa kuptime: (1) si ilaç (shih Jakobi 5:14); (2) si simbol i Frymës së Shenjtë, sidomos në DHV për mbretërit, priftërinjtë dhe profetët; dhe (3) si ndihmë psikologjike për të kuptuar praninë e Perëndisë. Jezusi përdorte lloje të ndryshme shenjash të jashtme në shërim.

TEMË E VEÇANTË: VAJOSJA NË BIBËL (BDB 603) (SPECIAL TOPIC: ANOINTING IN THE BIBLE [BDB 603])

- A. Përdorej për zbulim (shih LiP. 28:40; Ruthi 3:3; 2 Sam. 12:20; 14:2; 2 Kro. 28:15; Dan. 10:3; Amosi 6:6; Mik. 6:15)
- B. Përdorej për mysafirët (shih Psa. 23:5; Luka 7:38, 46; Gjoni 11:2)
- C. Përdorej për shërim (shih Isa. 61:1; Jer. 51:8; Marku 6:13; Luka 10:34; Jakobi 5:14) [u përdor në kuptimin higjienik të Ezek. 16:9]
- D. Përdorej për përgatitjen për varrim (shih Zan. 50:2; 2 Kro. 16:14; Marku 16:1; Gjoni 12:3,7; 19:39-40)
- E. Përdorej në kuptimin fetar (për një objekt, shih Zan. 28:18; 31:13 [shtyllë]; Eks. 29:36 [altari]; Eks. 30:26; 40:9-16; Lev. 8:10-13; Num. 7:1 [tabernakulli])

F. Përdorej për shugurimin e drejtuesve

1. Priftërinjtë
 - a. Aaroni (Eks. 28:41; 29:7; 30:30)
 - b. Bijtë e Aaronit (Eks. 40:15; Lev. 7:36)
 - c. Frazë ose titull standard (Num. 3:3; Lev. 16:32)
2. Mbretërit
 - a. nga Perëndia (shih 1 Sam. 2:10; 2 Sam. 12:7; 2 Mbret. 9:3,6,12; Ps. 45:7; 89:20)
 - b. nga profetët (shih 1 Sam. 9:16; 10:1; 15:1,17; 16:3,12-13; 1 Mbret. 1:45; 19:15-16)
 - c. nga priftërinjtë (shih 1 Mbret. 1:34, 39; 2 Mbret. 11:12)
 - d. nga pleqtë (shih Gjyq. 9:8,15; 2 Sam. 2:7; 5:3; 2 Mbret. 23:30)
 - e. për Jezusin si mbret mesianik (shih Ps. 2:2; Luka 4:18 [Isa. 61:1]; Veprat 4:27; 10:38; Heb. 1:9 [Ps. 45:7])
 - f. ndjekësit e Jezusit (shih 2 Kor. 1:21; 1 Gjonit 2:20, 27 [krizma])
3. ndoshta për profetët (shih Isa. 61:1)
4. instrumentet mosbesuese të çlirimit hyjnor
 - a. Kiri (shih Isa. 45:1)
 - b. Mbreti i Tirit (shih Ezek. 28:14, ku ai përdor metaforat e Edomit)
5. termi ose titulli “Mesia” do të thotë “i Vajosuri” (BDB 603)

Veprat 10:38 është një varg ku në vajosje përfshihen të tre personat e hyjnisë. Edhe Jezusi u vajos (shih Luka 4:18; Veprat 4:27; 10:38). Ky koncept zgjerohet për të përfshirë gjithë besimtarët (shih 1 Gjonit 2:27). I Vajosuri është bërë çdo i vajosur besimtar! Kjo ndoshta është si paralelizmi mes Antikrishtit dhe antikrishtërvë (shih 1 Gjonit 2:18). Veprimi simbolik në DHV i vajosjes fizike me vaj (shih Eks. 29:7; 30:25; 37:29) bëhej për ata që thirreshin dhe pajiseshin nga Perëndia për një detyrë të veçantë (pra, profetët, priftërinjtë dhe mbretërit). Fjala “Krisht” është përkthim i fjalës hebraisht “i vajosuri”, ose Mesia.

TEKSTI I NASB (I PËRDITËSUAR): MARKU 6:14-16

¹⁴Dhe mbreti Herod dëgjoi për këtë, sepse emri i tij ishte bërë shumë i famshëm; dhe njerëzit thoshin: “Gjon Pagëzori është ringjallur nga vdekja; prandaj po veprojnë këto fuqi të mrekullueshme prej tij”. ¹⁵Por të tjerë thoshin: “Ai është Elija”. Ndërsa të tjerë thoshin: “Ai është profet, si ata të dikurshmit”. ¹⁶Por, kur dëgjoi Herodi për këto, thoshte vazhdimisht: “Gjoni, të cilit ia preva kokën, është ringjallur!”

6:14 “mbreti Herod” “Mbret” nuk ishte titulli zyrtar i Herod Antipës. Ai quhej Tetrark, që kishte kuptimin “sundim prej katër vetësh”. Ishte i biri i Herodit të Madh nga një grua samaritane. Sundoi në Perea dhe Galile me viteve 4 para Krishtit dhe 39 pasa Krishtit. Në atë vit e syrgjynosën pasi i kërkoi Cezarit që ta bënte mbret.

Shih Temën e Veçantë: Familja e Herodit të Madh, te Marku 1:14.

■ **“njerëzit thoshin: ‘Gjon Pagëzori është ringjallur nga vdekja’”** Kjo shprehje reflekton besimin e farisenjve në ringjalljen fizike (shih Veprat 23:6; 24:21; Heb. 6:2). Ishte një përpjekje tjetër për t’i dhënë shpjegim të gabuar fuqisë dhe autoritetit të Jezusit (pra, krerët fetarë ia atribuonin Satanit ose demonëve; banorët e vendlindjes së tij e mohojnë për shkak se e njihnin Jezusin që fëmijë; kurse këta njerëz ia atribuojnë Gjon Pagëzorit, ose ndonjë tjetri profeti të DHV).

6:15 “Elija” Kjo tregon domethënien mesianike të shërbesës së Jezusit. Lidhet me disa profeci të veçanta te Mal. 3:1-2 dhe 4:5-6.

■ **“Ai është profet, si ata të dikurshmit”** Kjo tregon se populli shquante një autoritet të ri te mësimet e Jezusit, që nuk kishte qenë i pranishëm në Izrael për qindra vjet, që nga koha e Malakisë (ose autorit të Kronikave). Kjo shprehje reflekton dhe profecinë mesianike që bëri Moisiu për Mesinë në LiP. 18:15 e më tej, ku foli për ardhjen e një profeti si Moisiu.

6:16 “të cilit ia preva kokën” Kjo tregon ndërgjegjen e fajshme të Herodit (shih Mat. 14:10; Luka 9:9) dhe mungesën e informacionit për lidhjen e Gjonit me Jezusin.

TEKSTI I NASB (I PËRDITËSUAR): MARKU 6:17-29

¹⁷Sepse vetë Herodi kishte dhënë urdhër, e kishte arrestuar dhe mbajtur Gjonin të lidhur në burg për shkak të Herodiadës, gruas së vëllait të tij, Filipit, sepse e kishte patur grua. ¹⁸Sepse Gjoni i thoshte Herodit: “Nuk është e ligjshme që të kesh gruan e vëllait tënd”. ¹⁹Herodiada e mbante inat dhe donte ta vriste por s’po ia dilte dot; ²⁰sepse Herodi ia kishte frikën Gjonit, sepse e dinte që ishte njeri i drejtë e i shenjtë, dhe e mbronte. Dhe kur e dëgjonte, pështjellohej shumë; por i pëlqente ta dëgjonte. ²¹Dita e volitshme erdhi kur, për ditëlindjen e vet Herodi shtroi një gosti për të mëdhenjtë e tij, për komandantët e ushtrisë dhe për parinë e Galileës; ²²dhe, kur hyri vetë vajza e Herodiadës dhe vallëzoi, i pëlqeu Herodit dhe të ftuarve në gosti; dhe mbreti i tha vajzës: “Më kërkoi çfarë të duash dhe do të ta jap”. ²³Dhe iu betua: “Çfarëdo të më kërkosh, do të ta jap; deri në gjysmën e mbretërisë”. ²⁴Ajo doli jashtë dhe i tha të ëmës: “Çfarë të kërkosh?” Dhe ajo i tha: “Kokën e Gjon Pagëzorit”. ²⁵Ajo hyri me shpejtësi te mbreti dhe i tha: “Dua të më japësh menjëherë në pjatë kokën e Gjon Pagëzorit”. ²⁶Dhe ndonëse mbreti u trishtua shumë, për shkak të betimit dhe për shkak të të ftuarve në gosti, nuk ishte në gjendje ta refuzonte. ²⁷Menjëherë, mbreti dërgoi ekzekutuesin dhe e urdhëroi që t’i sillte kokën e Gjonit. Dhe ai doli dhe ia preu kokën në burg, ²⁸dhe ia solli kokën në pjatë dhe ia dha vajzës; dhe vajza ia dha nënës. ²⁹Kur dishepujt e Gjonit dëgjuan për këtë, erdhën, ia morën trupin dhe ia vendosën në një varr.

6:17-29 Kjo është jashtë radhës kronologjike. U vendos këtu për të shpjeguar Markun 6:14.

6:17 “Herodiadës” Kishte qenë gruaja e Filipit, vëllait të Herod Antipës (shih Mat. 14:3). Kishin jetuar në Romë. Ishte dhe mbesë e Antipës me anë të Aristobulit. Antipa e kishte joshur, e kishte ndarë nga Filipi, dhe ishte martuar me të.

Sipas Jozefusit (pra, *Lashtësitë e judenjve* 18.5.4), Herodiada ishte martuar me Herodin, të birin e Herodit të Madh (nëna e të cilit ishte Mariana, e bija e kryepriutit). Po kështu, Jozefusi thotë se e bija e Herodiadës, Salomeja, më vonë u martua me Filipin. Ka gjasa që Herodi të jetë njohur is Herod Filipi.

6:18 Kjo marrëdhënie shkelte Levitikun 18:16; 20:21.

6:19 “Herodiada e mbante inat” Kjo është në kohën e pakryer. Si duket, ajo ia përmendte vazhdimisht këtë temë Herod Antipës. Herodi e ruante (koha e pakryer) Gjonin prej saj (Marku 6:20).

6:29 “Herodi ia kishte frikën Gjonit” Kjo frikë vinte për shkak se Gjoni ishte njeri i shenjtë. Mateu 14:4 thotë se Herodi i druhej popullaritetit të Gjonit në popull. Herodi ishte njeri frikacak. Ia kishte frikën Gjonit, Herodiadës, madje dhe të ftuarve të vet—sa keq që vetëm Perëndisë s’ia kishte frikën!

6:21 Ka tre grupe të ftuarish: (1) autoritetet civile; (2) autoritetet ushtarake; dhe (3) paria e kamur dhe e famshme e vendit.

▣ **“kur e dëgjonte”** Herodi urdhëronte t’ia sillnin Gjonin, ose shkonte te qelia e tij në Makaerus (pra, në anën lindore të Detit të Vdekur; shih *Lashtësitë e judenjve* 18.5.2).

▣ **“pështjellohej shumë; por i pëlqente ta dëgjonte”** Kjo tregon paradoksin e atij që i bën përshtypje e vërteta, por e refuzon dritën (shih Gjoni 3:19-21).

▣ Herodiada priti deri në çastin e duhur—një tubim publik, një gosti plot dehje, një vallëzim epshndjellës dhe një premtim të palogjikshëm—që ta detyronte Herodin t’ia plotësonte dëshirën.

6:22 “e bija e Herodiadës” Quhej Salome sipas Jozefusit; ishte e bija e Filipit.

▣ **“vallëzoi”** Nuk ishte normale që një femër e shtresës së saj shoqërore të vallëzonte në këtë lloj gostie. Këto vallëzime epshndjellëse, zakonisht, kryheshin nga prostitutat ose nga valltaret profesioniste.

■ **“Më kërko çfarë të duash dhe do të ta jap”** Herodi e tha këtë në prani të zyrtarëve të lartë, kështu që nuk e merrte dot mbrapsht (shih Marku 6:21, 26).

6:23 “iu betua” Përdori emrin e Perëndisë për t’ia vërtetuar premtimin.

6:24 Ky varg vërteton qëllimet e fshehta dhe komplotin e nënës së saj (shih Marku 6:28b).

6:26 Nevoja për t’u lënë përshtypje miqve dhe familjarëve ia mposhti frikën Herodit (*perilupos*, që nënkupton trishtim të madh, Mat. 26:38; Marku 14:34).

6:27 “ekzekutuesin” Është fjalë latinisht, që nënkupton një trupojë të veçantë. Në fillim përdorej për spiunin, por më vonë përdorej edhe për ekzekutuesin (p.sh., nga Seneka). Marku përmban më shumë fjalë dhe fraza latine se çdo ungjill tjetër. Ndoshta, u shkrua posaçërisht për romakët.

■ **“në burg”** Në *Lashtësitë* (18.5.2), Jozefusi na thotë se kjo ishte në fortesën e Herodit, që quhej Makaerus dhe ndodhej pranë Detit të Vdekur në Moab.

6:29 Pa dyshim, Gjon Pagëzori po i bindej vullnetit të Perëndisë. Por shërbesa e tij zgjati vetëm rreth tetëmbëdhjetë muaj. Ndonëse shkaku real i vdekjes së tij ishte intriga e një gruaje të ligë, Perëndia e ka nën kontroll historinë dhe e përdor për qëllimet e tij. Ky varg tregon dhe preokupimin e judenjve për t’i dhënë të vdekurit një varrim të denjë.

TEKSTI I NASB (I PËRDITËSUAR): MARKU 6:30-44

³⁰Apostujt u mblodhën së bashku me Jezusin, dhe i raportuan për të gjitha ato që kishin bërë dhe mësuar. ³¹Dhe ai u tha: “Ejani veçmas në një vend të vetmuar dhe pushoni pak”. (Sepse shkonin e vinin shumë njerëz, dhe s’kishin as kohë për të ngrënë.) ³²U nisën veçmas me një barkë në një vend të vetmuar. ³³Njerëzit i panë duke ikur, dhe shumë i njohën dhe vrapuan aty së bashku në këmbë nga të gjitha qytetet, dhe arritën aty përpara tyre. ³⁴Kur Jezusi doli në breg, pa një turmë të madhe dhe ndjeu dhembshuri për ta pasi ishin si dele pa bari; dhe nisi t’u mësonte shumë gjëra. ³⁵Kur u bë tashmë shumë vonë, dishepujt erdhën tek ai dhe i thanë: “Ky vend është i shkretë dhe tashmë është shumë vonë; ³⁶thua ju të largohen që të shkojnë në fushat dhe fshatrat përreth dhe të blejnë diçka për të ngrënë”. ³⁷Por ai iu përgjigj: “Jepuni ju diçka për të ngrënë!” Por ata i thanë: “Të shkojmë dhe të shpenzojmë dyqind dinarë për bukë dhe t’u japim diçka për të ngrënë?” ³⁸Dhe ai iu tha: “Sa bukë keni? Shkoni, shihni!” Dhe pasi e mësuan, i thanë: “Pesë bukë dhe dy peshq”. ³⁹Ai i urdhëroi të gjithë të ulëshin me grupe në barin e gjelbër. ⁴⁰U ulën në grupe qindëshe dhe pesëdhjetëshe. ⁴¹Dhe ai i mori pesë bukët e dy peshqit dhe, pasi ngriti sytë drejt qiellit, e bekoji ushqimin, i theu bukët dhe ua jepte vazhdimisht dishepujve që t’ua shtronin përpara të tjerëve; dhe dy peshqit ua ndau të gjithëve. ⁴²Hëngrën të gjithë dhe u ngopën, ⁴³dhe mblodhën dymbëdhjetë shporta plot me copat e bukës dhe peshqve. ⁴⁴Ishin pesë mijë burra që hëngrën bukët.

■ **“Apostujt”** Ky është i vetmi përdorim i këtij termi në ungjillin e Markut. Zakonisht, ai i quan “dishepuj”. “Apostull” vjen nga fjala greke “dërgoj” (*apostellō*). Jezusi zgjodhi dymbëdhjetë prej dishepujve që të ishin me të në mënyrë të veçantë dhe i quajti “apostuj” (shih Luka 6:13). Kjo fjalë përdoret shpesh në kontekstin që Jezusi dërgohet nga Ati (shih Mat. 10:40; 15:24; Marku 9:37; Luka 9:48; Gjoni 4:34; 5:24,30,36,37,38; 6:29, 38, 39, 40, 57; 7:29; 8:42; 10:36; 11:42; 17:3,8,18,21,23,25; 20:21). Në burimet judaike, ky term përdorej për atë që dërgohej si përfaqësues zyrtar i një tjetri, i ngjashëm me termin “ambasador”. Në këtë udhëtim misionar, ata vepruan si mëkëmbës të Jezusit. Kishin pushtet dhe autoritet të deleguar.

■ **“i raportuan”** Kjo ishte pjesë e trajnimit të Jezusit. Ai i mësonte, u tregonte si të vepronin, i dërgonte dhe, pastaj, kërkonte raportim. Kështu mësuan ata. Shih librin e Robert Coleman, *The Master Plan of Evangelism*, që dokumenton dhe zbaton trajnimin që Jezusi u dha dishepujve/apostujve.

6:31 Ashtu si Jezusi kishte nevojë t'i largohej shtypjes së turmës (shih Marku 3:20), edhe dishepujt kishin nevojë për të njëjtën gjë. Njerëzit po vinin për të marrë ndihmën e tyre 24 orë ditën. Por trajnimi i dishepujve s'kishte përfunduar. Kishin nevojë për njëfarë kohë veçmas!

6:32 “barkë” Zakonisht, kjo fjalë përdorej për një peshkarexhë të madhe, që mbante deri në 13 burra (shih Mat. 4:21-22; 8:23; Veprat 21:2-3), por përdorej dhe për barkat më të vogla (shih Luka 5:2).

6:33 “vrapuan aty së bashku me këmbë nga të gjitha qytetet” A përfytyron dot një turmë të madhe me të sëmurë, ulokë dhe kureshtarë, duke u turrur përgjatë bregut? Këta njerëz ishin të dëshpëruar.

6:34 “ndjeu dhembshuri për ta” Jezusi kishte gjithmonë kohë për nevojtarët (shih Mat. 9:36).

▣ **“si dele pa bari”** Kjo metaforë bazohet në DHV (shih Num. 27:17; Ezek. 34:5; Zak. 13). Ndoshta, është aludim i fshehur për fjalët e Jezusit në Gjoni 10.

▣ **“nisi t'u mësonte”** Përgjigja e Jezusit për nevojat e turmës ishin mësimet e tij. Ata kishin nevojë për plotësi shpirtërore, jo thjesht për shërim fizik. Jezusi ua përmbushi të dyja këto nevoja (shih Mat. 14:14).

6:35 “Ky vend është i shkretë” Ky është vendi “i veçuar” i Markut 6:31.

6:37 “Jepuni ju diça për të ngrënë” Jezusi po sprovonte besimin e dishepujve. Pra, problemin e vlerësuar drejt; zgjidheni tani!

▣ **“dyqind dinarë”** Dinari ishte sa rroga e një dite për punëtorin e rëndomtë (shih Mat. 20:2), ose për ushtarin.

6:38 “Pesë bukë dhe dy peshq” Ata s'kishin mjaft as për vete. Jezusi po e përdorte këtë mundësi për t'u treguar dishepujve se ajo që kishin mjaftonte, madjte dhe tepronte, nëse ia jepnin atij dhe nëse kishin besim në të!

6:39 “të uleshin në grupe” Kjo shprehje (fjalë për fjalë, *sumpinō, sumpinō*; kompani me kompani) kishte kuptimin: “bëhuni gati të hani!” Jezusi duket se po i urdhëron dishepujt që ta organizojnë turmën për shpërndarjen e ushqimit me anë të një formacioni normal.

▣ **“në barin e gjelbër”** Kjo është dëshmi okulare e Pjetrit. Po kështu, nënkupton se po afronte koha e festës së Pashkës në pranverë.

6:41 “ngriti sytë drejt qiellit” Pozicioni i zakonshëm fizik për lutjet e judenjve ishte qëndrimi në këmbë me duart dhe kokën e ngritur dhe sytë e hapur. Jezusi po tregonte se burimi i autoritetit të tij ishte Ati qiellor.

▣ **“theu... ua jepte vazhdimisht”** Folja e parë është aoriste, ndërsa e dyta, e pakryer. Mrekullia e shumëfishimit ndodhi në duart e Jezusit.

Pasazhi paralel te Gjoni 6 i shpreh shkoqur pritshmëritë teologjike të kësaj turme. Judenjët e kohës së Jezusit prisnin që Mesia t'u siguronte ushqim, siç kishte bërë Moisiu gjatë endjes në shkretëtirë (shih Gjoni 6:30-40). Jezusi po u jep pikërisht shenjën që kërkonin, por ata nuk mund (ose nuk donin) ta kuptonin.

6:42 Kjo shprehje vjen nga Septuaginta (pra, përkthimi greqisht i DHV); u përdor kur populli i Perëndisë në DHV u ngop me mana dhe shkurta (shih Psa. 78:29; 105:40). Ky motiv i DHV zhvillohet më tej te Gjoni 6:30-40, ku Jezusi përmbush pritshmëritë rabinike duke siguruar ushqim, njësoj si Moisiu dikur. Jezusi është Moisiu i ri; çlirimi i tij është eksodi i ri; dhe ai sjell epokën e re të begatisë (shih Psa. 132:15; Isa. 49:10).

6:43 “dymbëdhjetë shpora plot me copat e bukës dhe peshqve” Kjo tregon se Jezusi nuk kryente përditë mrekulli për ushqimin e tyre. Atë që mbetej duhet ta ruanin për vaktet e mëvonshme.

Disa komentues (William Barclay) e mohojnë elementin e mrekullueshëm dhe thonë se ai djali i vogël e ndau ushqimin e vet me të tjerët (shih Gjoni 6:9) dhe, kur të tjerët në turmë e panë, ndanë ushqimet e tyre me

njëri-tjetrin. Nëse është kështu, nga erdhën dymbëdhjetë shportat me ushqimin e mbetur? Paragjykimet na e ndikojnë interpretimin e këtij pasazhi njësoj siç ndikuan paragjykimet edhe te njerëzit në kohën e Jezusit!

6:44 “pesë mijë burra” Kishte qenë distancë e gjatë e bërë me vrap (shih Marku 6:33) dhe ky ishte vend i shkretë (shih Marku 6:32). Ndoshta, në turmë s’kishte shumë gra dhe fëmijë. Nuk e dimë saktë madhësinë e kësaj turme. Por ishte e stërmadhe!

TEKSTI I NASB (I PËRDITËSUAR): MARKU 6:45-46

⁴⁵Menjëherë, Jezusi i detyroi dishepujt e vet të hypnin në barkë dhe t’i paraprinin në bregun tjetër, në Betsaidë, ndërsa ai vetë po niste turmën. ⁴⁶Pasi u përshëndet me ta, u nis për në mal që të lutej.

6:45 “Betsaidë” Emri i këtij qyteti do të thotë “shtëpia e dritës”. Ishte në anën perëndimore të liqenit.

■ **“ai vetë po niste turmën”** Pasazhi paralel në Gjoni 6 na jep shumë më tepër të dhëna për reagimin e kësaj turme. Marku përqendrohet te trajnimi i dishepujve dhe te dhembshuria e Jezusit, ndërsa Gjoni tregon sesi Jezusi i përmbushi pritshmëritë e judenjve për mesinë duke i ushqyer ata njësoj siç kishte bërë Moisiu (pra, me mana). Ata u përpoqën ta bënin mbret. Kjo tregon se e kishin keqkuptuar misionin e Jezusit (njësoj si dishepujt, familja e tij dhe krerët fetarë).

6:46 “u nis për në mal që të lutej” Jezusi kishte një kohë të rregullt lutjeje. Kjo është e qartë veçanërisht në ungjillin e Lukës. Jezusi e dinte që kjo mrekulli do të keqkuptohej. Ashtu siç nuk donte që ta konsideronin thjesht si shërues, nuk donte as ta konsideronin si ushqyes (shih Gjoni 6:15). Ai erdhi t’u zbulonte Atin, por turma nuk mundej ose nuk donte ta kuptonte. Në njëfarë kuptimi, kjo ishte përmbushje e tundimit të Satanit në shkretëtirë, që i tundonte njerëzit me bukë (pra, ushqyerjet e mrekullueshme, Mat. 4:3-4).

TEKSTI I NASB (I PËRDITËSUAR): MARKU 6:47-52

⁴⁷Kur u bë natë, barka ishte në mes të detit, ndërsa ai po ecte i vetëm në tokë. ⁴⁸Kur pa se po mundoheshin me rremat, sepse e kishin erën kundër, rreth rojës së katërt të natës shkoi drejt tyre, duke ecur në det; dhe donte t’i kalonte. ⁴⁹Por kur ata e panë se po ecte në det, menduan se ishte fantazmë dhe bërtitën; ⁵⁰sepse të gjithë e panë dhe u tmerruan. Por, menjëherë, ai u foli dhe u tha: “Merrni zemër; jam unë, mos kini frikë”. ⁵¹Pastaj, hipi në barkë me ta dhe era pushoi; dhe ata u mahnitën plotësisht, ⁵²sepse nuk e kishin kuptuar fare ngjarjen e bukëve, por e kishin zemërn të ngurtësuar.

6:48 “Kur pa” Është e paqartë nëse i pa (1) fizikisht, apo (2) me anë të ndonjë njohurie të mbinatyrshme.

■ **“mundoheshin me rremat”** Vjen nga fjala greke “torturohem”. Është e vështirë të rremosh kundër erës.

■ **“rreth rojës së katërt të natës”** Në kohën romake, kjo ishte mes orës 3:00-6:00 të mëngjesit.

■ **“shkoi drejt tyre, duke ecur në det”** Kjo ishte një tjetër mrekulli e Jezusit për natyrën me qëlim që t’u forconte besimin dishepujve. Ata e shihnin fuqinë dhe autoritetin e tij në shumë mënyra të ndryshme. Por, prapëseprapë, nuk e kuptonin; kishin ende frikë (shih Marku 6:49-50) dhe habiteshin (shih Marku 6:51).

Ka mundësi që kjo mrekulli të ketë synuar të përmbushte Jobin 9:8; 38:16; Psa. 77:19; dhe Isa. 43:16. Jezusi po kryente aktet hyjnore që përshkruhen në DHV (shih Marku 6:52).

■ **“donte t’i kalonte”** Kjo duket sikur nuk përputhet me kontekstin, përveç nëse e lidhim me Jobin 9:8 dhe 11! Në TEV, shënimi në fund të faqes shkruan “të bashkohej me ta”. Kjo folje e ka vërtet këtë ngjyrim kuptimo në Luka 12:32 dhe 17:7.

6:49 “fantazmë” Kjo gjendet edhe te Mat. 14:26 si fjalë Është një fjalë e fortë që përdorej për “acarimin dhe pësjtjellimin mendor dhe shpirtëror” (shih *The Greek-English Lexicon*, nga Bauer, Arndt, Gingrich, dhe Danker, f. 805).

6:50 “Merrni zemër” Kjo është urdhërore e tashme veprare, që Jezusi e përdorte shpesh (shih Mat. 9:2, 22; 14:27; Marku 6:50; 10:49; Gjoni 16:33; Veprat 23:11).

▣ **“mos kini frikë”** Kjo është urdhërore e tashme mesore (deponente), që Jezusi e përdorte shpesh (shih Mat. 14:27; 17:7; 28:10; Marku 6:50; Luka 5:10; 12:32; Gjoni 6:20; Zbu. 1:17). Ndoshta, kjo sërish e lidh Jezusin me Moisiun (shih Eks. 14:13; 20:20). Jezusi ishte Moisiu i ri, ose zëdhënësi i ri i Perëndisë (shih Zan. 15:1; Joz. 8:1).

6:51 Këtu mungon rrëfimi i Pjetrit që ecën (dhe fundoset) në ujë (shih Mat. 14:28-31). Libri i A. T. Robertson, *Word Pictures in the New Testament*, vëll. 1, f. 319, thotë: “Ndoshta, Pjetri nuk e kishte për zemër ta tregonte këtë histori”.

6:52 “sepse nuk e kishin kuptuar fare” Mezi i mësonin gjërat. Jezusi kishte durim me ta. Kjo është shumë inkurajuese për mua!

▣ **“e kishin zemrën të ngurtësuar”** Kjo është pjesore e kryer pësore. Ky është koncept i vështirë teologjik. Mos, ndoshta, kjo nënkupton (për shkak të formës pësore) se Perëndia ose Fryma ua kishte mbyllur mendjen? Ndoshta, kjo tregon se paragjykimet dhe traditat e tyre judaike i kishin verbuar që të mos shihnin të vërtetat e qarta në veprat dhe fjalët e Jezusit (shih Marku 8:17-18). Ky “njeri” nuk përputhej me asnjë kategori që njihnin (shih Marku 4:13, 40; 7:18). Ky është motiv i përsëritur te Marku. Shih Temën e Veçantë: Zemra, në Marku 2:6.

TEKSTI I NASB (I PËRDITËSUAR): MARKU 6:53-56

⁵³Kur kaluan në anën tjetër, zbritën në Genesaret dhe e lidhën barkën në breg. ⁵⁴Kur zbritën nga barka, menjëherë njerëzit e njohën, ⁵⁵dhe vrapuan në mbarë atë krahinë dhe filluan të sillnin në çdo vend të sëmur mbi vigje, kudo që dëgjonin se ndodhej ai. ⁵⁶Kudo që hynte, në fshatra, ose qytete, ose në fusha, ata vendosnin të sëmuret në sheshe dhe i përgjëroheshin që të paktën t’i preknin cepin e rrobës; dhe gjithë ata që e preknin, shëroheshin.

6:55 Kjo tregon nevojën, kaosin dhe dhembshurinë e fuqinë e Jezusit. Ky ishte mësim edhe për përparësinë e njerëzve. Jezusi kishte gjithmonë kohë për ta.

6:56 “cepin e rrobës” Bëhet fjalë për shallin e tij të lutjes (shih Num. 15:38-40; LiP. 22:12). Këta njerëz ishin të dëshpëruar, besëtytë dhe egoistë.

PYETJE PËR DISKUTIM

Ky është një komentari studimor udhëzues, që do të thotë se ti je vetë përgjegjës për interpretimin e Biblës. Secili prej nesh duhet të ecë sipas dritës që ka. Ti, Bibla dhe Fryma e Shenjtë kenë përparësi në interpretim. Nuk duhet t’ia dorëzosh këtë të drejtë komentuesit.

Këto pyetje për diskutim t’i kam dhënë për të të ndihmuar që të analizosh çështjet kryesore të kësaj pjese të librit. Ato synojnë të të nxisin mendimin, jo të kenë natyrë shteruese.

1. Si i pajton kontradiktat mes ungjijve të ndryshëm?
2. Pse kishte kaq larmi mendimesh për atë se kush ishte Jezusi?
3. A ishte ringjallja koncept i pazakontë në kohën e Jezusit?
4. Pse i lejoi Perëndia një gruaje të urryer dhe të ligë që t’i shkaktonte vdekjen një njeriu kaq të madh sa Gjoni?
5. Pse tërhoqi Jezusi një turmë kaq të madhe?
6. Pse ushqeu 5,000 vetë Jezusi?
7. Ç’lidhje ka shërbesa mësimdhënëse e Jezusit me shërimet që kryente?

MARKU 7

NDARJET NË PARAGRAFË TË PËRKTHIMEVE MODERNE

UBS ⁴	NKJV	NRSV	TEV	NJB
Tradita e pleqve 7:1-13	Ndotja vjen nga brenda 7:1-23	Tradita e pleqve 7:1-8	Mësimet e paraardhësve 7:1-2 7:3-4 7:5 7:6-7 7:8 7:9-13	Traditat e farisenjve 7:1-13
7:14-23		7:14-16 7:17-23	Gjërat që e ndotin njeriun 7:14-16 7:17-19 7:20-23	Për pastërtinë dhe ndotjen 7:14-16 7:17-23
Gruaja sirofenikase 7:24-30	Një pagane tregon besimin e saj 7:24-30	Gruaja sirofenikase 7:24-30	Besimi i gruas 7:24-27 7:28 7:29 7:30	E bija e gruas sirofenikase shërohet 7:24-30
Shërimi i shurdhmemecit 7:31-37	Jezusi shëron shurdhmemecin 7:31-37	Shërimet 7:31-37	Jezusi shëron shurdhmemecin 7:31-34 7:35-37	Shërimi i të shurdhërit 7:31-37

CIKLI TRE I LEXIMIT (shih f. v)

NDJEKJA E SYNIMIT TË AUTORIT FILLESTAR NË NIVELIN E PARAGRAFËVE

Ky është një komentuar studimor udhëzues, që do të thotë se ti je vetë përgjegjës për interpretimin e Biblës. Secili prej nesh duhet të ecë sipas dritës që ka. Ti, Bibla dhe Fryma e Shenjtë keni përparësi në interpretim. Nuk duhet t'ia dorëzosh këtë të drejtë komentuesit.

Lexo gjithë kapitullin njëherësh. Identifiko temat. Krahaso ndarjet e tua tematike me pesë përkthimet moderne. Ndarja në paragrafë nuk është e frymëzuar, por është çelësi për të ndjekur synimin e autorit fillestar, gjë që është thelbi i interpretimit. Secili paragraf ka vetëm një temë të vetme.

1. Paragrafi i parë
2. Paragrafi i dytë
3. Paragrafi i tretë
4. Etj.

PASAZHET PARALELE NË UNGJIJTË SINOPTIKË

- A. Marku 7:1-23 gjendet edhe te Mat. 15:1-20
- B. Marku 7:24-30 gjendet edhe te Mat. 15:21-28

STUDIMI I FJALËVE DHE FRAZAVE

TEKSTI I NASB (I PËRDITËSUAR): MARKU 7:1-8

¹Farisenjtë dhe disa nga skribët u mblodhën rreth tij pasi erdhën nga Jerusalemi, ²dhe panë se disa nga dishepujt e tij e hanin bukën me duar të papastra, pra, të palara. ³(Sepse farisenjtë dhe gjithë judenjtë nuk hanë pa pastruar duart me kujdes, duke zbatuar kështu traditat e pleqve; ⁴madje, dhe kur kthehen nga tregu, nuk hanë pa u pastruar më parë; ka dhe shumë gjëra të tjera që duhet t'i kryejnë për shkak të traditës, si larja e kupave, brokave dhe enëve prej bakri). ⁵Farisenjtë dhe skribët e pyesnin: “Pse nuk ecin dishepujt e tu sipas traditave të pleqve, por e hanë bukën me duar të papastra?” ⁶Dhe ai iu tha: “Me të drejtë profetizoi Isaia për ju, hipokritë, siç është shkruar:

‘Ky popull më nderon me buzë,

Por zemra e tij është larg meje.

⁷‘Por më kot më adhurojnë,

Duke mësuar si doktrina urdhërimet e njerëzve’.

⁸Duke anashkaluar urdhërimin e Perëndisë, ju zbatoni traditën e njerëzve”.

7:1 “Farisenjtë” Këta ishin fetarët më të sinqertë të kohës. Nga ana kulturore, ishin më të mirët. Bisedat e Jezusit me ta përmenden shpesh në ungjill (shih Marku 7:5-8; 11:27-33; 12:13-17). Shih shënimin më të plotë te Marku 2:6.

▣ **“disa nga skribët... pasi erdhën nga Jerusalemi”** Krerët fetarë e ndiqnin gjithmonë Jezusin për ta kapur në gabime (shih Marku 3:22; Gjoni 1:19). Me sa duket, këta ishin pjesë e një komiteti zyrtar faktgjetes, i dërguar nga Sinedri (shih Temën e Veçantë te Marku 12:13) në Jerusalemi. Sinedri përbëhej nga 70 persona që vinin nga

1. Familjet drejtuese priftërore (saducenjtë; shih Temën e Veçantë në Marku 12:18)
2. Krerët fetarë lokalë (farisenjtë)
3. Pronarët e pasur të tokave

7:2 “me duar të papastra, pra, të palara” Këtu bëhet fjalë për papastërti fetare, jo higjenike (shih Marku 7:4). Pastërtia ceremoniale ishte diçka shumë serioze për farisenjtë (shih Luka 11:38; Mat. 15:2). Sqarohet në mënyrë shumë të hollësishme në Talmud. Debati bëhej për traditat gojore, që interpretonin pasazhet e DHV.

▣ **“të papastra”** Në greqisht përdoret fjala *koinos*, që do të thotë “e rëndomtë”, ose “e disponueshme për të gjithë”. Këtë titull e përdorim dhe sot për greqishten popullore që flitej në gjuhën e Jezusit. Fjala latine “vullgatë” ka të njëjtin ngjyrim kuptimor (pra, diçka e disponueshme për të gjithë). Në këtë kontekst, bëhet fjalë për ndotjen ceremoniale për shkak të kontaktit të njeriut me gjëra të papastra.

7:3

NASB	“pa pastruar duart me kujdes”
NKJV	“pa larë duart në mënyrë të veçantë”
NRSV	“pa larë plotësisht duart”
TEV	“pa larë duart si duhet”
NJB	“pa larë krahët deri te bërrylat”

Ka ndryshime në dorëshkrimet greke për këtë frazë. Leximi më i pazakontë është *pugme*, që do të thotë “grusht”, dhe gjendet në dorëshkrimet e lashta unciale A, B dhe L, ndërsa *pukna*, që do të thotë “shpesh”, gjendet në Sinaitikus, W dhe në Vullgatë dhe Peshita. Disa tekste të lashta e heqin fare parantezën e Markut 7:3-4 (dorëshkrimi i shekullit të nëntë 037, i njohur me shkronjën greke delta, dhe disa përkthime kopte dhe siriake, si dhe Diatesaroni). UBS4 i jep alternativeë së parë vlerësimin “A” (pra, e sigurt që është origjinal).

Ndoshta, kjo fjalë e vështirë greke reflekton përkthimin në greqisht të një fraze aramaike: “pa larë duart në një qyp (të veçantë)” (shih *Theological Dictionary of the New Testament*, redaktuar nga Gerhard Friedrich dhe Geoffrey W. Broomiley, vëll. 6, f. 916). Farisenjtë e morën porosinë e DHV për priftërinjtë që kishin turnin në tempull dhe e aplikuan për gjithë judenjtë “e vërtetë” përditë. Ata po i shtonin elemente ligjit të Moisiut.

Një tjetër mundësi është ta marrim si metodë rabinike të larjes së duarve dhe krahëve me grusht të mbyllur, por kjo nuk mbështetet nga asnjë traditë e shkruar rabinike, përveçse nëse bëhet fjalë për konceptin e kapjes së ujit të hedhur mbi bërryla (me duart poshtë) me dorë të hapur dhe të mbledhur si kupë, në mënyrë që ta fërkosh prapë te bërryli.

Fjala “laj” (*niptō*, shih Mat. 15:2) zakonisht përdorej për larjen e një pjese të trupit, jo për banjën e plotë (shih *louō*, Gjoni 13:10).

■ **“duke zbatuar kështu traditat e pleqve”** Këto tradita (shih Gal. 1:14) u kodifikuan në Talmud (pra, në Mishna). Këto tradita rabinike jepen në dy botime. Më i ploti është Talmudi Babilonas, ndërsa ai i papërfunduari vjen nga Palestina. Studimi i sotëm i kësaj literature është penguar nga fakti se askush s’është i sigurt se kur u thanë apo u shkruan këto diskutime. Më vonë, u zhvilluan dy shkolla interpretimi rabinik, njëra konservatore (pra, *Shamai*) dhe tjetra liberale (pra, *Hileli*). Të gjitha çështjet debatohen në bazë të këtyre diskutimeve rabinike. Rabinët i citonin paraardhësit e tyre si të autoritetshëm.

7:4 “pa u pastruar më parë” Judenjtë i zgjeruan ligjet që vlenin për priftin që hynte në tabernakull dhe ia zbatuan gjithë judenjve (shih Eks. 30:19). Këto rregulla lidhen me ndotjen ceremoniale. Ishin zhvilluar gjatë një periudhe të gjatë ekohore me anë të aludimeve dhe hamendësimeve në bazë të rregullave levitike.

Në këtë frazë gjendet një variant në dorëshkrimet greke. Disa tekste greqisht kanë:

1. formën lidhore aoriste mesore të fjalës *baptizō* (pra, dorëshkrimet A, D, W dhe përkthimet e Vullgatës dhe siriake)
2. formën dëftore të tashme veprorë të *baptizō* (pra, dorëshkrimet F, L)
3. formën lidhore aoriste mesore të *rantizō* “spërkas” (pra, dorëshkrimet Sinaitikus, B dhe përkthimi kopt). Shumica e përkthimeve moderne zgjedhin alternativën 1. Disa kopjues të hershëm mund ta kenë futur leximin 3 për shkak se *baptizō* ishte bërë term teknik për pagëzimin e krishterë.

UBS4 i jep alternativës 1 vlerëimin “B” (pothuajse e sigurt se është origjinal).

NASB “edhe enëve prej bakri”
NKJV “enëve prej bakri dhe divanëve”
NRSV “ibrikëve prej bronxi”
TEV “tasave prej bakri dhe shtretëve”
NJB “pjatave prej bronxi”

Kjo fjalë, “enë/tasa” vjen nga latinishtja. Marku përdor më shumë fjalë latinisht se çdo libër tjetër i DHR. Kjo, ndoshta, tregon se u shkrua në Romë për romakët.

Ekziston një variant në tekstet greqisht, që shton fjalën *klinōn* (pra, shtretërit ose divanët) në dorëshkrimet A, D dhe W, ndërsa P46, Sinaitiku, B dhe L nuk e përmbajnë. Ndoshta disa kopjues, duke njohur Levitikun 15, shtuan dhe këtë fjalë; ose disa kopjues të mëvonshëm, që nuk e njihnin DHV, mendonin se ishte fjalë e pavend dhe e hoqën nga teksti. Hamendësimi për këtë gjë është interesant, por i parëndësishëm nga ana teologjike.

7:5 “e pyesnin” Është në kohën e pakryer, që nënkupton se po e pyesnin vazhdimisht, ose nënkupton se filluan ta pyesnin.

■ **“nuk ecin dishepujt e tu sipas traditave të pleqve”** Kjo ishte çështje e rëndë nga ana fetare për ta. Madje, në literaturën judaike, jepet një rast kur një rabin u përjashtua për shkak se nuk i lau siç duhet duart. Talmudi, që përmbante diskutimet e tyre rabinike si të kuptonin dhe zbatonin pasazhet e DHV, ishte bërë “autoriteti” i tyre.

7:6 “Me të drejtë profetizoi Isaia për ju” Jezusi besonte se disa pasazhe nga Isaia, që vlenin historikisht për kohën e këtij profeti, vlenin edhe për këtë brez farisenjsh shtatëqind vjet më vonë. Kjo tregon vlerën aktuale të Shkrimit për çdo brez. Të vërtetat e Perëndisë ndikohen nga kultura, por gjithsesi e tejkalojnë kulturën dhe kohën! Jezusi citon Isa. 29:13.

■ **“hipokritë”** Kjo fjalë përbëhet nga dy fjalë të tjera: “nën” dhe “gjykoj”. Ishte një fjalë që përdorej për të përshkruar aktorët kur luanin rolet me maskë para fytyrës. Jezusi i akuzon se janë shumë të zellshëm për disa gjëra, por zhvlerësojnë plotësisht disa të tjera (shih Isa. 29:13; Kol. 2:16-23). Nuk është rastësore që “hipokritët” dhe larja e duarve shfaqen së bashku në Psa. 26:4 dhe 6!

TEMË E VEÇANTË: HIPOKRITËT (te Mateu) (SPECIAL TOPIC: HYPOCRITES [in Matthew])

Kjo fjalë e përbërë (*hypokritēs*) përkthehet fjalë për fjalë “gjykoj nën”. Mund të kishte kuptimin: (1) aludim për një fjalë teatrale, ku aktorët flisnin pas një maske (pra, luanin rolin), ose (2) përdorimi i mëparshëm i kësaj fjale, pra “interpretuj mbi”.

Farisenjtë luanin rolin duke kryer ritet dhe ritualet fetare (shpesh, në publik) me qëllim që njerëzit t'i lavdëronin, dhe jo me qëllim që të kënaqnin Perëndinë (ndonëse jam i sigurt se dhe kjo ishte një nga motivet e tyre të shumta):

1. jepnin lëmoshë, jo vetëm për të ndihmuar të varfrit, por për t'u lavdëruar nga njerëzit (Mat. 6:2)
2. luteshin në sinagogë dhe në publik që t'i shihnin të tjerët (Mat. 6:5)
3. kur agjëronin, kishin pamje të çrregullt, që të tjerët të habiteshin nga niveli i tyre shpirtëror (Mat. 6:16)
4. thoshin diçka, por bënë diçka tjetër (shih Mat. 15:7-9; Marku 7:1-7; Isa. 29:13)
5. përpiqeshin ta kapnin Jezusin në kurth me pyetje hileqare, në vend që të kërkonin urtësinë e vërtetë (Mat. 22:15-22)
6. i pengonin të tjerët që të mos hynin në Mbretëri (Mat. 23:13-15)
7. jepnin të dhjetat e ushqimeve të kuzhinës, por dilnin mangët në punët me peshë të ligjit (Mat. 23:23)
8. pastronin të jashtmen e gotës, por jo të brendshmen e tyre (Mat. 23:25)
9. ishin si varre të lyera me gëlqere, por brenda plot me papastërti (Mat. 23:27-28) (shih *Dictionary of Biblical Imagery*, f. 415)
10. besonin te drejtësia e tyre (Mat. 23:29-30)
11. kanë një vend të veçantë në ferr (Mat. 24:51)

■ **“siç është shkruar”** Kjo është në kohën e kryer, dhe do të thotë “qëndron e shkruar”. Ishte shprehje standarde judaike dhe nënkuptonte Shkrimin e frymëzuar (shih Maru 9:12-13; 11:17; Mat. 4:4, 7, 10). Citimi vjen nga Septuaginta e Isa. 29:13, që përshkruan vetëdrejtësinë njerëzore. Jezusi jep një shembull të kësaj në Marku 7:9-12 dhe në pasazhin paralel te Mat. 15:4-6.

■ **“zemra”** Për judenjtë, zemra ishte qendra e veprimtarisë fizike, pra, baza e veprimeve. Ata e përdornin ritualin fetar si mjet për t'u pranuar nga Perëndia. Traditat e tyre ishin bërë autoriteti absolut! Ky është gjithmonë rreziku për njerëzit fetare. Shih Temën e Veçantë në Marku 2:6.

■ **“është larg”** Do të thotë “mbaj larg”. Praktikant fetare, shpesh, përdoren për të anashkaluar përkushtimin e plotë ndaj Perëndisë. Shpesh, feja bëhet pengesë, jo urë te Perëndia.

7:7 Ç' dënim i tmerrshëm i hipokrizisë dhe formalizmit fetar!

7:8 “Duke anashkaluar” Do të thotë “dëboj” (pra, urdhërimin e Perëndisë), dhe është në kontrast me fjalën “mbaj”, që do të thotë “rrok”, “mbaj fort”, ose “kapem fort pas” traditave.

■ **“urdhërimin e Perëndisë, ju zbatoni traditën e njerëzve”** Çështja është zbulesa (DHV) apo tradita (Talmudi)? Kjo pyetje vlen për çdo njeri në çdo kulturë (ose denominacion). Autoriteti fetar është çështje jetike!

TEKSTI I NASB (I PËRDITËSUAR): MARKU 7:9-13

⁹Ai po iu thoshte dhe kështu: **“Ju jeni ekspertë për të anashkaluar urdhërimin e Perëndisë që të mbani traditën tuaj.** ¹⁰Sepse Moisiu tha: **“Ndero babain dhe nënën”;** dhe **“ai që flet keq për babain ose nënën, të dënohet me vdekje”;** ¹¹kurse ju thoni: **“Nëse dikush i thotë babait ose nënës, ‘Gjithçka që kam për të të ndihmuar është Kurban (pra, i është dhënë Perëndisë)’,** ¹²ju nuk e lejoni me që të bëjë diçka për babanë dhe nënën e vet; ¹³kështu, ju e zhvlerësoni fjalën e Perëndisë me anë të traditës tuaj, që keni trashëguar; dhe bëni shumë gjëra të tjera si kjo”.

7:9	
NASB	“jeni ekspertë për të anashkaluar”
NKJV	“E refuzoni me mjeshtëri”
NRSV	“E refuzoni bukur”
TEV	“e refuzoni me dinakëri”
NJB	“Sa me zgjuarsi e shmangni”

Kjo është sarkazëm therrëse, njësoj si Gjoni 3:10.

7:10 “Moisiu tha” Vargu paralel i Mat. 15:4 thotë: “Perëndia tha”. Kjo tregon se pas fjalëve të Moisiut qëndronte frymëzimi i Perëndisë.

▣ **“Ndero”** Është citim nga Dhjetë Urdhërimet, i shkruar te Eks. 20:12 dhe i përsëritur te LiP. 5:16. Vjen nga një fjalë tregtare hebraisht “i jap peshën e duhur diçkaje” (BDB 457), që do të thotë: kuptoj vlerën e diçkaje.

7:11 “nëse” Kjo është fjali kushtore e rendit të tretë, që bën fjalë për veprim të mundsëm. Jezusi po flet për mënyrat e kohës sesi anashkalohej ligji i Perëndisë (shih Marku 7:12).

▣ **“babain dhe nënën”** Kjo tregon respektin që duhet t’u japim të dy prindërve.

▣ **“ai që flet keq për babain ose nënën”** Ky është citim nga Eksodi 21:17. Çnderimi merrte ndëshkim të rëndë. Rabinët e kishin anashkaluar këtë varg me anë të traditave të tyre.

▣ **“Kurban”** Ky është transliterim greqisht i fjalës hebraisht (jo aramaisht) “dhoratë”, pra diçka që i jepej Perëndisë si dhoratë (tempullit, shih NKJV). Jezusi po jep një shembull sesi fetarët judaikë të kohës së tij iu bënin bisht synimit dhe ligjeve të shprehura të DHV duke i zëvendësuar me traditat e tyre gojore. Ata kishin shpikur shumë “vrime” ligjore në traditat gojore (shih Mat. 5:33-34; 23:16-22).

TEKSTI I NASB (I PËRDITËSUAR): MARKU 7:14-16

¹⁴Pasi e thirri sërish turmën të vetja, filloi t’u thoshte: “Më dëgjoni, të gjithë, dhe kuptoni: ¹⁵nuk ka asgjë jashtë njeriut që mund ta ndotë nëse hyn në të; por gjërat që dalin nga njeriu janë ato që e ndotin njeriun. ¹⁶[Nëse dikush ka veshë të dëgjojë, le të dëgjojë].”

▣ **“e thirri sërish turmën të vetja”** Jezusi e denoncoi publikisht hipokrizinë e skribëve dhe traditave të tyre. NKJV përmban fjalën *panta* (të gjithë) në vend të *palin* (sërish).

▣ **“Dëgjoni... kuptoni”** Këto janë të dyja urdhërore aoriste veprare. Kjo frazë shërben si hyrje e një shembulli të rëndësishëm dhe tronditës.

7:15 Ky është shembull klasik i riinterpretimit që Jezusi i bën DHV (shih Mat. 5:17-48). Ai po anulon ligjin e ushqimit (Lev. 11). Kjo është mënyrë e fuqishme për të pohuar autoritetin e tij (pra, ai është në gjendje ta ndryshojë ose anulojë DHV, por jo ata). Kjo duhet të jetë fjalë paralajmëruese për ata që e bëjnë ushqimin thjesht çështje ushqimi dhe pije (shih rom. 14:13-23; 1 Kor. 8:1-13; 10:23-33). Fjalët e Jezusit zbulojnë lirinë e qartë të Besëlidhjes së Re (shih Rom. 14:1-15:13; 1 Kor. 8-10).

7:16 Ky varg përfshihet në shumë dorëshkrime unciale greke (A, D, K, W, θ), në Diatesaron, si dhe në tekstin greqisht që përdorte Augustini (shih NKJV dhe NJB). Mirëpo disa dorëshkrime të tjera (Sinaitiku, B dhe L) nuk e përfshijnë si varg. Ndoshta, është shtesë e ndonjë kopjuesi, e huazuar nga Marku 4:9 ose 23. NASB (përditësimi i 1995) e përfshin në kllapa për të treguar se ka dyshim për origjinalitetin e këtij vargu. USB4 i jep mospërfshirjes së këtij vargu vlerësimin “A” (e sigurt).

TEKSTI I NASB (I PËRDITËSUAR): MARKU 7:17-23

¹⁷Pasi la turmën dhe hyri në shtëpi, dishepujt e pyetën për shëmbëlltyrën. ¹⁸Dhe ai u tha: “Edhe ju jeni kaq të pamend? A nuk e kuptoni se gjithçka që hyn në njeriun nga jashtë nuk e ndot atë, ¹⁹sepse nuk

i hyn në zemër, por në stomak, dhe pastaj jashtëqitet?” (Kështu, i shpalli të gjitha ushqimet të pastra.)²⁰Dhe po thoshte: “Ajo që del nga njeriu e ndot njeriun. ²¹Sepse nga brenda, nga zemra e njerëzve, dalin mendimet e liga, kurorëshkeljet, vjedhjet, vrasjet, kuërvëritë, ²²veprat e lakmisë dhe ligësisë, si dhe mashtrimi, epshi, smira, sharjet, krenaria dhe marrëzia. ²³Të gjitha këto gjëra të liga dalin nga brenda dhe e ndotin njeriun”.

7:17 “dishepujt e pyetën” Mateu 15:15 thotë se e pyeti Pjetri. Fjalët e Jezusit ishin shumë tronditëse për këta judenj të shekullit të parë! Jezusi po anulonte Moisiun! Kush mendonte se ishte ky rabin i pazyrtauruar?

7:18 “Edhe ju jeni kaq të pamend?” Jezusi u habit nga ngathtësia e dishepujve për ta kuptuar. Mesazhi i tij ishte shumë ndryshe nga ato që kishin dëgjuar ata gjithë jetën (pra, teologjinë fariseike). Tradita nuk korrigjohet lehtë (shih Marku 4:13, 40; 6:52; 8:21). Besimi në Jezusin si Mesia i premtuar kërkonte ndarjen e plotë nga traditat e tyre të vyera dhe nga pritshmëritë e tyre kulturore. “Fjala e Gjallë” e tejkalon “fjalën e shkruar”! Besimtarët adhurojnë Jezusin, jo Biblën.

Zakonisht, komentuesit thonë se Jezusi refuzoi traditën gojore të judenjve, por ligjet e DHV i përkrahu gjithmonë. Mirë ky refuzim i ligjeve të ushqimit, si dhe refuzimi që Jezusi bëri mësimit të Moisiut për divorcin në Mat. 5:31-32 (shih Marku 10:2-12) tregojnë qartë se Jezusi e shihte veten si interpretuesin e saktë dhe, madje, Zotin e DHV (shih Mat. 5:38-39). Ai është zbuluesi absolute i Perëndisë. Askush prej nesh, që e do Biblën, nuk ndihet rehat nga kjo. Ne e shohim Biblën si të autoritetshme dhe aktuale. Mirëpo, sa vargje të tjera nga DHV i konsideroi Jezusi si zbulues jo të qartë të qëllimeve të Atit? Kjo jo vetëm që i tronditi skribët, por, në njëfarë mase, më trondit dhe mua! Më kujton faktin se DHV nuk është i detyrueshëm për besimtarët e DHR (shih Veprat 15; Galatasve 3). Padyshim që DHV është Bibël dhe pa dyshim që na zbulon Perëndinë, por unë nuk jam i detyruar nga ritualet ose procedurat e saj (shih Veprat 15:6-11, 19). Unë jam i shtrenguar nga botëkuptimi i saj, nga zbuluesia e Perëndisë, dhe nga synimet e premtimit e tij (shih Mat. 5:17-20)!

7:19

NASB, NRSV “(Kështu, i shpalli të gjitha ushqimet të pastra)”

NKJV “duke i pastruar, kështu, të gjitha ushqimet”

TEV “(... Jezusi shpalli se të gjitha ushqimet mund të hahen)”

NJB “(Kështu e shpalli çdo ushqim të pastër)”

Kllapat pasqyrojnë pikëpamjen e përkthyesve se ky është koment redaktorial (ndoshta nga përvoja e Pjetrit në Veprat 10). Është një e vërtetë e rëndësishme e DHR (shih Rom. 14:13-23; 1 Kor. 8:1-13; 10:23-33). Njerëzit nuk janë në rregull me Perëndinë për shkak të gjërave që hanë ose jo! Besëlidhja e re nuk bazohet në rregullat e DHV (p.sh., Levitiku 11; Veprat 15). Perëndia shikon zemrën, jo barkun!

7:20 Rabinët e DHV thoshin se mendja është një tokë pjellore dhe e përgatitur për t’u mbjellë, ndërsa sytë dhe veshët janë dritarja e shpirtit. Gjithçka që njeriu lejon të hyjë brenda, zë rrënjë. Mëkati nis brenda mendimeve dhe zhvillohet me anë të veprimeve. Gjuha zbulon zemrën e njeriut!

TEMË E VEÇANTË: GJUHA NJERËZORE (SPECIAL TOPIC: HUMAN SPEECH)

I. MENDIME FILLESTARE PËR FJALËT E URTA

- A. Gjuha është pjesë e shëmbëllimit të Perëndisë të njeriu (pra, krijimi u krijua me fjalën e Perëndisë, dhe Perëndia i flet krijimit të vet njerëzor). Ajo është pjesë jetike e personalitetit tonë.
- B. Gjuha njerëzore na mundëson të komunikojmë me të tjerët për ato që mendojmë për jetën. Prandaj, na zbulon se kush jemi në të vërtetë (Fja. 18:2; 4:23, 20-27). Të folurit është testi acid i personit (Fja. 23:7).
- C. Ne jemi qenie shoqërore. Kërkojmë praninë dhe miratim. E kërkojmë nga Perëndia dhe nga njerëzit e tjerë. Fjalët kanë fuqinë që të na i plotësojnë këto nevoja, në mënyra pozitive (Fja. 17:10), ose negative (Fja. 12:18).
- D. Gjuha njerëzore ka fuqi të jashtëzakonshme (Fja. 18:20-21)—fuqi për bekim dhe shërim (Fja. 10:11, 21), dhe fuqi për mallkim dhe shkatërrim (Fja. 11:9).

E. Ne korrim atë që mbjellim në këtë drejtim (Fja. 12:14).

II. PARIME NGA FJALËT E URTA

A. Potenciali negativ dhe shkatërrues i gjuhës njerëzore

1. fjalët e të ligjve (1:11-19; 10:6; 11:9,11; 12:2-6)
2. fjalët e kurorëshkelëses (5:2-5; 6:24-35; 7:5ff; 9:13-18; 22:14)
3. fjalët e gënjeshtarit (6:12-15,19; 10:18; 12:17-19,22; 14:5,25; 17:4; 19:5,9,28; 21:28; 24:28; 25:18; 26:23-28)
4. fjalët e budallait (10:10,14; 14:3; 15:14; 18:6-8)
5. fjalët e dëshmitarëve të rremë (6:19; 12:17; 19:5,9,28; 21:28; 24:28; 25:18)
6. fjalët e thashethemaxhiut (6:14,19; 11:13; 16:27-28; 20:19; 25:23; 26:20)
7. fjalët që thuhën nga nxitimi (6:1-5; 12:18; 20:25; 29:20)
8. fjalët lajkatare (29:5)
9. fjalët me tepri (10:14,19,23; 11:13; 13:3,16; 14:23; 15:2; 17:27-28; 18:2; 21:23; 29:20)
10. fjalët e shturura (17:20; 19:1)

B. potenciali pozitiv, shërues dhe ndërtues i gjuhës njerëzore

1. fjalët e të drejtëve (10:11,20-21,31-32; 12:14; 13:2; 15:23; 16:13; 18:20)
2. fjalët e të zgjuarve (10:13; 11:12)
3. fjalët e njohurisë (15:1, 4, 7, 8; 20:15)
4. fjalët e shërimit (15:4)
5. fjalët e përgjigjes së butë (15:1, 4, 18, 23; 16:1; 25:15)
6. fjalët e përgjigjes së këndshme (12:25; 15:26, 30; 16:24)
7. fjalët e ligjit (22:17-21)

III. MODELI I DHV VAZHDON EDHE NË DHR

- A. Gjuha njerëzore na mundëson të komunikojmë me të tjerët për ato që mendojmë për jetën. Prandaj, na zbulon se kush jemi në të vërtetë (Mat. 12:33-37; 15:1-20; Marku 7:2-23).
- B. Ne jemi qenie shoqërore. Kërkojmë praninë dhe miratim. E kërkojmë nga Perëndia dhe nga njerëzit e tjerë. Fjalët kanë fuqinë që të na i plotësojnë këto nevoja, në mënyra pozitive (2 Tim. 3:15-17), ose negative (Jak. 3:2-12).
- C. Gjuha njerëzore ka fuqi të jashtëzakonshme; fuqi për bekim dhe shërim (Efe. 4:29, dhe fuqi për mallkim dhe shkatërrim (Jak. 3:9). Jemi përgjegjës për ato që themi (Mat. 12:36-37; Jak. 3:2-12).
- D. Do të gjykohe mi nga fjalët (Mat. 12:33-37; Luka 6:39-45) dhe nga veprat (Mat. 25:31-46). Korrim atë që mbjellim (Gal. 6:7).

7:21 “nga zemra e njerëzve” Jezusi rendit një sërë sjelljesh dhe veprimesh të mëkatshme. Këto lloj mëkatesh dënoheshin dhe nga stoikët. Edhe Pali ka disa lista me mëkate si kjo (shih Rom. 1:29-31; 1 Kor. 5:11; 6:9; 2 Kor. 12:20; Gal. 5:19-21; Efe. 4:31; 5:3-4; Kol. 3:5-9; 2 Tim. 3:2-5). Shih Temën e Veçantë: Veset dhe Virtytet në 1 Pjetrit 4:2.

■ **“kurorëshkeljet”** Fjala “pornografi” vjen nga e njëjta rrënjë si kjo fjalë greqisht. Nënkuptonte çdo veprim të pahijshëm seksual: seksi paramartesor, homoseksualiteti, seksi me kafshët, madje dhe refuzimi i përgjegjësive të leviratit (pra, kur vëllai nuk pranonte lidhje martesore dhe seksuale me vejushën e të vëllait të vdekur me qëllim që t’i siguronte trashëgimtar).

Në DHV bëhej dallimi mes tradhtisë bashkëshortore (kurorëshkeljes) dhe shturjes paramartesorë (kurvëria). Mirëpo, në periudhën e DHR, ky dallim s’ekzistonte më.

■ **“vrasjet... veprat e lakmisë... mashtrimi... krenaria”** Këto fjalë përshkruajnë dhe botën pagane në Rom. 1:29-31. Tregojnë një zemër të dalë nga shinat, një zemër që priret “të marrë sa më shumë për vete me çdo çmim”.

■ **“kurvëritë”** Kjo është fjala *moicheia*, që nënkupton marrëdhënies seksuale jashtëmartesore (shih 1 Kor. 6:9-10). Në mënyrë metaforike, përdorej edhe për idhujtarinë. Në DHV, JHVH është bashkëshorti, ndërsa Izraeli është nusja; prandaj, të shkosh pas perëndive të tjerë është formë tradhtie bashkëshortore.

■ **“epshi”** Në Rom. 13:13 kjo përdoret për të treguar se besimtarët s’duhet të jetojnë kështu. Në *Greek-English Lexicon of the New Testament Based on Semantic Domains*, vëll. 1, f. 771, Louw dhe Nida e përcaktojnë këtë fjalë si “një sjellje së cilës i mungon plotësisht vetëpërbajtja morale; zakonisht, nënkupton shturje seksuale”. Vini re se shumë prej këtyre termave nënkuptojnë një seksualitet të pakontrolluar, diçka karakteristike për kulturën pagane të shekullit të parë.

7:22 Rendi i kësaj liste mëkatesh ndryshon nga njëri përkthim në tjetrin. Si përmbledhje, jeta pa Perëndinë është e pafre! Lista e Palit në Gal. 5:19-21 përshkruan ligësinë, ndërsa lista në Gal. 5:22-23 përshkruan të perëndishmen.

NASB, NRSV,
NJB “smira”
NKJV “epoka e ligë”
TEV “xhelozia”

Fjalë për fjalë, “syri i lig” (shih shënimin anësor te NASB). Në Lindjen e Afërt, njerëzit mendonin se dikush mund t’u shtinte syrin e keq (pra, t’ju bënte dëm nga ana shpirtërore). Në hebraisht, kjo fjalë ka ngjyrimin kuptimor “xhelozia egoiste” (shih LiP. 15:9; Fja. 23:6).

NASB, NRSV,
TEV, NJB “sharjet”
NKJV “blasfemia”

Fjalë për fjalë, do të thotë “blasfemi”, që nënkuptonte të thuash diçka të pavërtetë për dikë tjetër. Mund të përdoret për sharjet ose gënjeshtat ndaj Perëndisë ose ndaj njerëzve (shih Veprat 6:11; Rom. 2:24).

■ **“krenaria”** Bën fjalë për njeriun kryelartë, përçmues, ose krenar (shih Luka 1:51; Rom. 1:30; 2 Tim. 3:2; Jakobi 4:6; 1 Pje. 5:5).

7:23 Vargu paralel në Mat. 15:20 e përmbledh gjithë argumentin (shih 1 Sam. 16:7).

TEKSTI I NASB (I PËRDITËSUAR): MARKU 7:24-30

²⁴Jezusi u ngrit dhe, që andej, shkoi në krahinën e Tirit. Dhe, pasi hyri në një shtëpi, donte që të mos e dinte askush, por nuk mundi të qëndronte i fshehur. ²⁵Por, pasi dëgjoi për Jezusin, një grua, vajza e vogël e së cilës kishte një frymë të ndyrë, erdhi menjëherë dhe u hodh para këmbëve të tij. ²⁶Kjo grua ishte johebrijeje, me prejardhje sirofenikase. Dhe iu përgjyrua vazhdimisht që ta dëbonte demonin nga e bija. ²⁷Por ai i thoshte: “Le të ngopen njëherë fëmijët, sepse nuk është mirë të merret buka e fëmijëve dhe t’u hidhet qenve”. ²⁸Por ajo iu përgjigj dhe i tha: “Po, Zot, por edhe qentë poshtë tavolinës ushqehen me thërrimet e fëmijëve”. ²⁹Dhe ai i tha: “Për shkak të kësaj përgjigjeje, shko; demoni ka dalë nga vajza jote”. ³⁰Dhe, kur ajo u kthye në shtëpi, e gjeti fëmijën të shtrirë në shtrat, dhe demoni i kishte dalë.

7:24 “Tirit” Tiri ndodhej në veriperëndim të detit të Galiliesë, jashtë kufirit të Tokës së Premtuar në DHV. Ishte, kryesisht, zonë johebrenjsh. Fraza “dhe Sidonit” mungon në disa dorëshkrime të lashta greke, si D, L dhe W, por gjendet te Mat. 15:21 dhe Marku 7:31, si dhe në dorëshkrimet Sinaitikus, A dhe B, si dhe në Vullgatë dhe në Peshita.

■ **“por nuk mundi të qëndronte i fshehur”** Kjo ishte për shkak të mrekullive të tij (shih Marku 3:8). Edhe në një zonë ku mbizotëronin johebrenjtë, s’mund të gjente dot qetësi dhe kohë personale me dishepujt.

7:25 “vajza e vogël e së cilës kishte një frymë të ndyrë” Sesi demonizoheshin fëmijët, nuk na thuhet as këtu, as në rrëfimin e Markut 9:17-29. Në asnjë rast nuk duket se bëhet fjalë për frymën familjare (pra, demoni që kalon brez pas brezi brenda familjes). Shih Temën e Veçantë: Dëbimi i Demonëve në Marku 1:25.

▣ **“u hodh përpara këmbëve të tij”** Kjo ishte shenjë kulturore (1) përulësie dhe (2) kërkese ndaj më të madhit. Ndoshta ajo duhet të ketë dëgjuar për mrekullitë e Jezusit dhe, e dëshpëruar, iu afrua këtij rabini jude me frikë!

7:26 “johebreje, me prejardhje sirofenikase” Kini parasysh se Jezusi ndihmoi dhe johebrenj të tjerë (shih Marku 5:1; 11:17; Mat. 8:5-13; Gjoni 4), por brenda kufijve gjeografikë të Tokës së Premtuar. Po të kishte filluar një shërbesë shërimi në një vend pagan, Jezusi do të refuzohej nga popullsia judaike për shkak të paragjyqimeve që kishin.

Ekziston një ngjashmëri interesante mes shërbimit të Jezusit ndaj kësaj gruaje fenikase dhe shërbesës së Elisë në lidhje me gruan fenikase në 1 Mbret. 17. Në të dyja rastet, dashuria, dhembshuria dhe ndihma e Perëndisë janë të disponueshme për paganët e urryer. Kjo duhet të ketë qenë një provë e fshehtë e natyrës së tij mesianike.

Në ç’gjuhë u krye kjo bisedë mes gruas dhe Jezusit? Është e qartë se duhet të jetë bërë në greqisht. Meqë ishte rritur në Palestinën veriore, Jezusi duhet të ketë qenë trigjuhësh. Në Luka 4:16-20, Jezusi lexon nga një pergamenë hebraisht e Isaisë. Duhet ta ketë mësuar hebraishten në shkollën e sinagogës. Normalisht, fliste dhe aramaisht. Mund të ketë folur dhe greqishten *koine* (p.sh., në bisedën private me Pilatin).

▣ **“iu përgjërua vazhdimisht”** Kjo është në kohën e pakryer. Ajo iu lut papushim!

▣ **“që ta dëbonte demonin”** Kjo është aoriste lidhore veprorë. Ajo ende kishte disa dyshime për aftësinë ose gatishmërinë e Jezusit që të vepronte, gjë që shprehet në mënyrën lidhore.

7:27 “fëmijët” Kjo fjalë familjare bën fjalë për Izraelin (shih Mat. 15:24).

7:27-28

NASB, NRSV,
TEV, “qentë”
NKJV, NJB “këlyshët”

Kjo është e vetmja herë që kjo fjalë përdoret në DHR. Ashpërsia e saj zbutet nga fakti se është në formën e zvogëluar (pra, *kunarion*), “këlysha” (NJB e përkthen “qentë e shtëpisë”). Judenjtë i quanin paganët “qen”, si term poshtërues. Ky dialog synonte t’i ndihmonte dishepujt që ta mposhtnin paragjykimin që kishin ndaj johebrenjve (shih Mat. 15:23). Jezusi e pranoi dhe e shpalli publikisht që ajo kishte besim të madh (shih Mat. 15:28).

7:28 “Zot” Ndoshta, këtë e përdori në kuptimin kulturor të fjalës “zotëri”, si te Gjoni 4:11. Për çudi, ky është i vetmi shembull i përdorimit të fjalës *zot* për t’iu drejtuar Jezusit në ungjillin e Markut.

▣ **“fëmijëve”** Fjalë për fjalë, “vogëlushëve” (*paidion*). Në këtë kontekst përdoren një sërë fjalësh zvogeluese. Në *Word Pictures in the New Testament*, vëll. 1, f. 326, A. T. Robertson thotë: “fëmijët e vegjël hidhnin qëllimisht thërrime ushqimi për qenin”. Sa do të doja që ungjilli të na tregonte tonin e zërit, shprehjet e fytyrës dhe gjuhën e trupit të Jezusit! Mendoj se kjo bisedë ishte shumë më pozitive nga ç’na e transmetojnë fjalët.

▣ **“thërrimet e fëmijëve”** Të pasurit e përdornin bukën për të fshirë duart pasi hanin, pra, si shami.

7:29 “për shkak të kësaj përgjigjeje” Jezusi i la mbresa qëndrimi këmbëngulës dhe besimi i kësaj nëne (shih Mat. 15:28). Disa herë, Jezusi i shëroi/çliroi njerëzit në bazë të besimit të dikujt tjetër (shih Marku 2:3-12; 9:14-29; Mat. 8:5-13).

▣ **“shko; demoni doli nga vajza jote”** Gruaja pati besim se Jezusi mund t’i dëbonte demonët edhe nga largësia, pa rituale apo magji.

7:29, 30 “ka dalë” Në Marku 7:29, kjo është në formën dëftore të kryer veprorë, kurse te Marku 7:30 është pjesore e kryer veprorë, që përqendrohet në veprimin e vazhdueshëm të një veprimi në të shkuarën. Demoni ishte larguar dhe s’do të kthehej më te vajza e saj.

7:30 “të shtrirë në shtrat” Kjo është pjesore e kryer pësore, që mund të kuptohet në dy mënyra: (1) demoni kishte dalë dhunshëm (shih Marku 1:26; 9:26) dhe e kishte hedhur vajzën e vogël në shtrat, ose (2) gjendja e demonizimit e kishte bërë të dergjej në shtrat.

TEKSTI I NASB (I PËRDITËSUAR): MARKU 7:31-37

³¹Sërish, doli nga krahina e Tirit dhe kaloi përmes Sidonit në Detin e Galilesë, brenda krahinës së Dekapolit. ³²I sollën një të shurdhër që mezi fliste, dhe iu përgjëruan që të vinte dorën mbi të. ³³Jezusi e mori mënjanë turmës, më vete, ia vuri gishtat në veshë dhe, pasi pështyu, ia preku gjuhën me pështymë; ³⁴dhe, pasi vështrroi drejt qiellit me psherëtimë të thellë, i tha: “Effata!” që do të thotë, “Hapu!” ³⁵Dhe iu hapën veshët, iu largua pengesa e gjuhës dhe nisi të fliste qartë. ³⁶Dhe Jezusi i urdhëroi të mos ia tregonin askujt; por sa më tepër i urdhëronte, aq më gjerë vazhduan ta shpallnin lajmin. ³⁷Ishin shumë të habitur dhe thoshin: “Ai e ka bërë gjithçka mirë; madje, bën që të shurdhët të dëgjojnë dhe memecët të flasin!”

7:31 Ky përshkrim gjeografik është i pazakontë. Sidoni ishte në veri të Tirit në bregdet, ndërsa Dekapoli ishte në jug dhe në lindje të Detit të Galilesë. NKJV e përkthen “u largua nga rajoni i Tirit dhe Sidonit”, por ky përkthim nuk mbështetet nga P46, A, W dhe Peshita. Shumica e kritikëve të tekstit mbështesin tekstin më të vështirë, i cili e çon Jezusin në veri dhe në lindje përpara se të shkonte në jug.

▣ **“Detin e Galilesë”** Ky quhet edhe (1) Kineret në DHV; (2) Deti i Genesaretit në Luka 5:1; dhe (3) Deti i Tiberiadës gjatë periudhës romake të shekullit të parë në Gjoni 6:1; 21:1.

▣ **“krahinës së Dekapolit”** Kjo ishte zona e demoniakut gadarenas (shih Marku 5:1-20). Ishte zonë johebrenjsh në lindje dhe në jug të Detit të Galilesë. Shërbesa e Jezusit në këto rajone tregon dashurinë e tij për johebrenjtë.

7:32 “të shurdhët që mezi fliste” Ky term përdoret vetëm këtu në DHR dhe në Septuagint te Isa. 35:6. Vargu 37 mund të ketë lidhje me Isa. 35:5-6, që përshkruan shërbesën e ardhshme shëruese të Mesisë.

▣ **“të vinte dorën mbi të”** Shih Temën e Veçantë më poshtë.

TEMË E VEÇANTË: VËNIA E DUARVE NË BIBËL (SPECIAL TOPIC: LAYING ON OF HANDS IN THE BIBLE)

Ky gjest përfshirjeje personale përdoret në mënyra të ndryshme në Bibël.

1. në betim (pra, dora nën kofshë; shih Zan. 24:2, 9; 47:29)
2. kur i kalohet drejtimi i familjes dikujt tjetër (shih Zan. 48:14, 17, 18)
3. identifikimi me vdekjen e një kafshe flijuese si zëvendësues
 - a. priftërinjtë (Eks. 29:10,15,19; Lev. 16:21; Num. 8:12)
 - b. personat laikë (shih Lev. 1:4; 3:2,8; 4:4,15,24; 2 Chr. 29:23)
4. kur veçohej dikush për t’i shërbyer Perëndisë për një detyrë ose shërbesë të veçantë (shih Num. 8:10; 27:18,23; LiP. 34:9; Veprat 6:6; 13:3; 1 Tim. 4:14; 5:22; 2 Tim. 1:6)
5. pjesëmarrja në dënimin me vdekje me gurë të një mëkatari (shih Lev. 24:14)
6. dora para gojës tregon heshtje, ose pranim (shih Gjyq. 18:19; Jobi 21:5; 29:9; 40:4; Mikea 7:16)
7. duart në kokë tregojnë trishtim/brengosje (2 Sam. 13:19)
8. marrja e bekimit për shëndet, lumturi dhe perëndishmëri (shih Mat. 19:13, 15; Marku 10:16)
9. lidhet me shërimin fizik (Mat. 8:3; 9:18,20; Marku 5:23; 6:5; 7:32; 8:23; 16:18; Luka 4:40; 13:13; Veprat 9:17; 28:8).
10. marrja e Frymës së Shenjtë (shih Veprat 8:17-19; 9:17; 19:6; vini re dhe LiP. 34:9)

Çuditërisht, ka një mungesë uniformitetit në pasazhet që janë përdorur historikisht për të mbështetur caktimin kishtar të drejtuesve (pra, shugurimi, shih Tema e Veçantë: Shugurimi).

1. Në Veprat 6:6, apostujt vënë duart mbi shtatë të zgjedhurit për shërbesën lokale.
2. Në Veprat 13:3, profetët dhe mësuesit vënë duart mbi Barnabën dhe Palin për shërbesë misionare.
3. Në 1 Tim. 4:14, pleqtë lokalë përfshihen në thirrjen fillestare dhe shugurimin e Timoteut.
4. Në 2 Tim. 1:6, Pali vë duart mbi Timoteun.

Kjo larmi dhe paqartësi tregon mungesën e organizimit në kishën e shekullit të parë. Kisha e hershme ishte shumë më dinamike, dhe i përdorte rregullisht dhuntitë shpirtërore të besimtarëve (shih 1 Kor. 12, 14). DHR nuk është shkruar për të mbrojtur apo përcaktuar një model qeverisës (shih larminë në Veprat 15), apo një procedurë të caktuar shugurimi. Traditat organizuese të kishës janë të domosdoshme, por jo biblike. Perëndishmëria e grupit drejtues është shumë më e rëndësishme se forma (pra, politika) e drejtimit.

7:33 “e mori mënjanë turmës” E bëri që të mos tregonin për këtë shërim, si dhe që ta bënte burrin të ndihej i qetë (shih Marku 8:23).

▣ **“ia vuri gishtat në veshë”** Jezusi po i tregonte atij se çfarë do të bënte me veprime fizike të pranuar nga ana kulturore (pra, gishti në vesh dhe pështyma në gjuhë).

▣ **“ia preku gjuhën me pështymë”** Pështyma përdorej rëndom si ilaç në botën mesdhetare të shekullit të parë. Jezusi donte që t’ia rriste besimin këtij njeriu.

7:34 “dhe, pasi vështroi drejt qiellit” Ky ishte qëndrimi standard fizik kur judenjtë luteshin në kohën e Jezusit (pra, qëndrimi në këmbë, sytë e hapur, koka dhe duart e ngritura).

▣ **“me psherëtimë të thellë”** bëhet fjalë për një tingull të thellë që shpreh ndjenjë të fortë (shih Rom. 4; 8:22-23; 2 Kor. 5:12). Konteksti letrar e tregon nëse ky tingull është pozitiv (shih Marku 7:34; Rom. 8:26) apo negativ (shih Veprat 7:34; Jakobi 5:9). Ndoshta, ky veprim tregonte dhimbjen e Jezusit për mëkatin dhe sëmundjen në këtë botë të rrënuar nga rebelimi njerëzor. Forma e përbërë e kësaj fjale përdoret edhe te Marku 8:12.

▣ **“Effata!”** Kjo është urdhërore aoriste pësore; është fjala aramaisht që ka kuptimin “hapu!” (dhe iu hapën veshët, shih Marku 7:35). Pjetrit iu kujtuan dhe vetë fjalët aramaisht që tha Jezusi, ndaj Marku i përktheu në greqisht për lexuesit johebrenj (pra, romakë). Shih shënimin në Marku 5:41.

7:36 “i urdhëroi të mos ia tregonin askujt” Arsyeja për këtë ishte se ungjilli nuk ishte përmbushur ende. Jezusi nuk donte që ta njihnin si mrekullibërës. Shtypja e turmave përbënte problem tashmë. Ky “sekret mesianik” është tipik për Markun. Mirëpo është e habitshme se, në ungjillin e Markut, Jezusi kryen shumë vepra dhe thotë shumë gjëra që zbulojnë natyrën e tij. Jezusi e zbulon qartë veten se është Mesia, madje përmbush dhe pritshmëritë judaike të kohës për ata që kishin sy shpirtërorë për të parë!

7:37 Shërimi i të shurdhërit ishte shenjë e qartë mesianike (shih Isa. 35:5-6).

▣ **“Ai e ka bërë gjithçka mirë”** Kjo është dëftore e kryer veprorë. Ç’përmbledhje e mahnitshme nga ana e banorëve të Palestinës veriore!

PYETJE PËR DISKUTIM

Ky është një komentuar studimor udhëzues, që do të thotë se ti je vetë përgjegjës për interpretimin e Biblës. Secili prej nesh duhet të ecë sipas dritës që ka. Ti, Bibla dhe Fryma e Shenjtë keni përparësi në interpretim. Nuk duhet t’ia dorëzosh këtë të drejtë komentuesit.

Këto pyetje për diskutim t’i kam dhënë për të të ndihmuar që të analizosh çështjet kryesore të kësaj pjese të librit. Ato synojnë të të nxisin mendimin, jo të kenë natyrë shteruese.

1. Si duhet ta trajtojmë traditën? Përcakto çfarë është tradita.
2. A po e anashkalon Jezusi Dhiatën e Vjetër? Nëse po, si mund ta trajtojmë DHV si të frymëzuar nga Perëndia? (Marku 7:19)

3. Shpjego ndryshimet mes pikëpamjes së Jezusit për fenë dhe pikëpamjes së farisenjve.
4. Pse shkoi Jezusi në një krahinë ku mbizotëronin johebrenjtë? (Marku 7:24)
5. Si pushtoheshin fëmijët nga demonët? A ndodh kjo dhe sot? (Marku 7:25)
6. Pse u tha Jezusi që të mos i tregonin askujt për shërimin e atij burrit? (Marku 7:36)

MARKU 8

NDARJET NË PARAGRAFË TË PËRKTHIMEVE MODERNE

UBS ⁴	NKJV	NRSV	TEV	NJB
Ushqyerja e katër mijë vetëve 8:1-10	Ushqyerja e katër mijë vetëve 8:1-10	Katër mijë vetë ushqehen 8:1-10	Jezusi ushqen katër mijë vetë 8:1-3 8:4 8:5 8:6-10	Mrekullia e dytë e bukëve 8:1-10
Kërkesa për shenjën 8:11-13	Farisenjtë kërkojnë shenjë 8:11-12 Ruhuni nga majaja e farisenjve dhe Herodit 8:13-21	Thëniet për shenjat 8:11-13	Farisenjtë kërkojnë mrekulli 8:11-12 8:13	Farisenjtë kërkojnë shenjë nga qielli 8:11-13
Majaja e farisenjve dhe Herodit 8:14-21		Majaja e farisenjve 8:14-21	Majaja e farisenjve dhe Herodit 8:14-15 8:16 8:17-19 8:20 8:21	Majaja e farisenjve dhe Herodit 8:14-21
Shërimi i të verbrit në Betsaidë 8:22-26	I paralizuari i verbër shërohet në Betsaidë 8:22-26	I verbri shërohet 8:22-26	Jezusi shëron një të verbër në Betsaidë 8:22-23 8:24 8:25-26	Shërimi i të verbrit në Betsaidë 8:22-26
Shpallja e Pjetrit për Jezusin 8:27-30	Pjetri rrëfen Jezusin si Krisht 8:27-30	Rrëfimi i Pjetrit 8:27-30	Shpallja e Pjetrit për Jezusin 8:27 8:28 8:29a 8:29b 8:30	Rrëfimi i besimit të Pjetrit 8:27-30
Jezusi parathotë vdekjen dhe ringjalljen e vet 8:31:9:1	Jezusi parashikon vdekjen dhe ringjalljen e vet 8:31-33 Merr kryqin dhe ndiq Jezusin 8:34:9-1	8:31-33 Për dishepullizimin 8:34:9-1	Jezusi flet për vuajtjet dhe vdekjen e vet 8:31-33 8:34:9-1	Profecia e parë për Mundimin 8:31-33 Kushti për të ndjekur Jezusin 8:34:9-1

CIKLI TRE I LEXIMIT (shih f. v)

NDJEKJA E SYNIMIT TË AUTORIT FILLESTAR NË NIVELIN E PARAGRAFËVE

Ky është një komentuar studimor udhëzues, që do të thotë se ti je vetë përgjegjës për interpretimin e Biblës. Secili prej nesh duhet të ecë sipas dritës që ka. Ti, Bibla dhe Fryma e Shenjtë keni përparësi në interpretim. Nuk duhet t'ia dorëzosh këtë të drejtë komentuesit.

Lexo gjithë kapitullin njëherësh. Identifiko temat. Krahaso ndarjet e tua tematike me pesë përkthimet moderne. Ndarja në paragrafë nuk është e frymëzuar, por është çelësi për të ndjekur synimin e autorit fillestar, gjë që është thelbi i interpretimit. Secili paragraf ka vetëm një temë të vetme.

1. Paragrafi i parë
2. Paragrafi i dytë
3. Paragrafi i tretë
4. Etj.

PASAZHET PARALELE NË UNGJIJTË SINOPTIKË

- A. Nuk e dimë nëse Jezusi i ushqente turmat shpesh, ose, për ndonjë arsye që interpretuesit e sotëm përëndimorë nuk e dinë, kjo ngjarje përsëritet (shih 6:34-44 dhe 8:1-10).
- B. Marku 8:10-12 gjendet edhe te Mat. 15:39-16:4.
- C. Marku 8:13-26 gjendet edhe te Mat. 16:5-12.
- D. Marku 8:27-30 gjendet edhe te Mat. 16:13-20; Luka 9:18-21.
- E. Marku 8:31-37 gjendet edhe te Mat. 16:21-26; Luka 9:22-25.
- F. Marku 8:38-9:1 gjendet edhe te Mat. 16:27-28; Luka 9:26-27.

STUDIMI I FJALËVE DHE FRAZAVE

TEKSTI I NASB (I PËRDITËSUAR): MARKU 8:1-10

¹Në ato ditë, kur kishte sërish një turmë të madhe dhe s'kishin asgjë për të ngrënë, Jezusi thirri dishepujt dhe u tha: ²“Ndiej dhembshuri për popullin sepse kanë qëndruar me mua prej tri ditësh dhe s'kanë ç'të hanë. ³Po t'i dërgoj të uritur në shtëpi, do t'u bjerë të fikët rrugës; dhe disa prej tyre kanë ardhur prej shumë larg”. ⁴Dhe dishepujt iu përgjigjën: “Ku mund të gjendet mjaftueshëm bukë këtu, në këtë vend të shkretë, që t'i ngopë këta njerëz?” ⁵Dhe ai po u thoshte: “Sa bukë keni?” I thanë: “Shtatë”. ⁶Dhe ai i porositi njerëzit të uleshin përtokë; dhe, si mori shtatë bukë, falenderoi dhe i theu, dhe filloi t'ua jepte dishepujve që t'ua shërbenin, dhe ata ia shërbenin popullit. ⁷Kishin dhe disa peshq të vegjël; dhe, pasi i bekoi, porositi që t'i shërbenin dhe peshqit. ⁸Dhe hëngrën e u ngopën; dhe mbledhën shtatë shporta të mëdha plot me copëzat e mbetura të ushqimit. ⁹Aty ishin rreth katër mijë vetë; dhe ai i nisi për në shtëpi. ¹⁰Dhe, menjëherë, hyri në barkë me dishepujt dhe erdhi në krahinën e Dalmanuthës.

8:1 “Në ato ditë” Kjo ngjarje ndodhi në rajonin e Dekapolit, që ishte kryesisht johebre (shih Marku 7:31).

■ **“kishte sërish një turmë të madhe”** Kjo karakterizonte shërbesën e Jezusit gjatë kësaj periudhe.

8:2 “Ndiej dhembshuri për popullin” Fjala “dhembshuri” vjen nga një fjalë greqisht, që përdoret për organet e poshtme të trupit (mëlçia, veshkat, të përbrendshmet). Në DHV, judenjtë mendonin se vatra e ndjenjave ishin të përbrendshmet e trupit.

Jezusit i do njerëzit (shih 1:41; 6:34; 8:2; 9:22; Mat. 9:36; 14:41; 15:32; 18:27; 20:34; Luka 7:13; 10:33). Këta njerëz ishin refuzuar nga rabinët gjithë jetën. Ndaj mbledheshin si turmë për të marrë përkujdesjen e Jezusit.

■ **“kanë qëndruar me mua prej tri ditësh”** Kishte qenë kohë e gjatë mësimdhënieje. Judenjtë i llogarisnin ditët nga darka e sotme në darkën e nesërme. Çdo pjesë e ditës llogaritej; prandaj kjo shprehje nuk nënkupton medoemos tre ditë të plota 24 orëshe. Ata s’ishin larguar dot as për të blerë ushqime. Tani, kishin ngrënë gjithçka që kishin sjellë me vete.

8:3 “Po t’i dërgoj” Kjo është fjali kushtore e rendit të parë, që bën fjalë për një veprim të mundshëm. Jezusi nuk po thotë se ata janë të gjithë në pikën e këputjes fizike, por se disa janë të dobët dhe të sëmurë, dhe mund t’u bjerë të fikët.

■ **“do t’u bjerë të fikët rrugës”** Kjo gjendje do t’u shkactohej nga mungesa e ushqimit. Shih Gjyq. 8:15 dhe Vaj. 2:19 në Septuagintë. Ata i kishin mbaruar të gjitha ushqimet që kishin me vete dhe po agjëronin.

■ **“disa prej tyre kanë ardhur prej shumë larg”** Kjo tregon sesi ishte përhapur fama e Jezusit si mrekullibërës. Njerëzit e dëshpëruar shkojnë kudo dhe bëjnë çdo përpjekje për të gjetur ndihmë!

8:4: “Ku mund të gjendet bukë mjaftueshëm këtu” Edhe sikur të kishin para, s’kishte vend ku mund të blinin ushqime. Jezusi po sprovon besimin e dishepujve për furnizimin e tij! Ata dështuan sërish (shih Marku 6:34-44).

8:6 “të uleshin” Bëhet fjalë për pozicionin e mbështetur, që tregonte përgatitje për të ngrënë ushqim.

8:6-8 “bukët... peshqit” Kjo ishte dieta normale e përditshme për popullin e Palestinës. Kjo është shumë e ngjashme me 6:34-44.

■ **“falënderoi”** Kjo lutje bekimi për ushqimin pranon përkujdesjen dhe furnizimin e përditshëm të Perëndisë (shih Mat. 6:11). Judenjtë luteshin gjithmonë para ngrënies.

■ **“theu... shërbenin”** Kjo është aoriste e ndjekur nga koha e pakryer. Mrekulli e shumëfishimit ndodhi kur Jezusi theu bukën, njësoj si te Marku 6:41.

8:8 “shtatë shporta të mëdha plot me copëzat e mbetura” Kjo është fjalë e ndryshme nga ajo që u përdor për shportat te 6:43. Këto shporta ishin shumë të mëdha (shih Veprat 9:25). Këto copëza të mbetura u mbledhën për t’u përdorur më vonë. Megjithatë, nga Marku 8:14 mësojmë se dishepujt i harruan dhe i lanë aty copëzat e ushqimit.

8:9 “rreth katër mijë” Mateu 15:83 shton “burra”, që do të thotë se turma ishte më e madhe. Ndoshta, në këtë zonë të izoluar kishte një numër jo të madh grash dhe fëmijësh, por gjithsesi edhe ata kishin ardhur.

8:10 “menjëherë” Shih shënimin te Marku 1:10.

■ **“krahinën e Dalmanuthës”** Ka disa variante për këtë grazë. Problemi është se nuk njihet asnjë vend me këtë emër në Palestinën e kohës së Jezusit. Prandaj kopjuesit e ndryshuan emrin e vendit për ta përputhur me “Magadanin” e Mateut (NKJV, “Magdala”).

TEKSTI I NASB (I PËRDITËSUAR): MARKU 8:11-13

¹¹Farisenjtë erdhën dhe filluan të debatonin me të, duke kërkuar prej tij një shenjë nga qielli, që ta vinin në provë. ¹²Duke psherëtirë thellë në shpirt, ai u tha: “Pse kërkon shenjë ky brez? Me të vërtetë ju them, asnjë shenjë nuk do t’i jepet këtij brezi”. ¹³Pasi i la, hipi sërish në barkë dhe u largua në bregun tjetër.

8:11 “Farisenjtë... filluan të debatonin me të” Kjo ishte diçka që ndodhte rëndom. Ata nuk ia mohonin dot autoritetin, fuqinë, apo popullaritetin, kështu që përpiqeshin ta zinin me fjalë duke i kërkuar t’u përgjigjej disa pyetjeve që do ta bënin një pjesë të dëgjuesve që ta braktisnin Jezusin. Shih Temën e Veçantë: Farisenjtë në Marku 2:16.

■ **“shenjë nga qielli”** Në ungjillin e Gjonit, fjala “shenjë” ka kuptim të veçantë, kurse këtu përdoret për kërkesën e farisenjve që të shihnin një provë për autoritetin e tij, ndoshta (1) një profeci (shih LiP. 13:2-5; 18:18-22); (2) një shenjë qiellore (shih Isa. 7:11; 38:7-8); ose (3) një shenjë apokaliptike (fitore ushtarake kundër armiqve).

■ **“ta vinin në sprovë”** Fjala *peirazō* ka ngjyrimin kuptimor: sprovë, vë në provë, ose tundoj “me qëlim që ta shkatërroj” dikë. Ndoshta, është aludim për mosbesimin e Izraelit gjatë endjes në shkretëtirë (shih Eks. 17:7; Num. 14:11-12, 22; LiP. 33:8). Shih Temën e Veçantë për fjalët greqisht për “sprovimin” në Marku 1:13.

8:12 “Duke psherëtirë thellë” Kjo është fjalë e përbërë, pra, formë e përforcuar e termit “psherëti” (shih Marku 7:34). Jezusi ua kishte treguar tashmë autoritetin e vet me anë të veprave dhe fjalëve, por ata kishin mbetur gjithsesi në verbëri shpirtërore.

■ **“në shpirt”** Bëhet fjalë për personalitetin e Jezusit (shih Marku 2:8). Ka të njëjtin ngjyrim kuptimor si te Marku 14:38 në lidhje me qeniet njerëzore. Fjala “shpirt” përdoret te Marku për

1. Frymën e Shenjtë (Marku 1:10, 12)
2. Frymërat e ndyra (pra, demonët, Marku 1:23,26,27; 3:11,30; 5:2,8,13; 6:7; 7:25; 9:17,20,25)
3. Shpirtin njerëzor (Marku 2:8; 8:12; 14:38)

■ **“ky brez”** Edhe kjo fjalë ka ngjyrim kuptimor nga DHV në lidhje me periudhën e endjes në shkretëtirë (shih Num. 32:13; LiP. 1:35; 32:5, 20).

■ **“Me të vërtetë”** Fjalë për fjalë, “amen”. Shih Temën e Veçantë, “Amen” në Marku 3:28.

■ **“ju them, asnjë shenjë nuk do t’i jepet këtij brezi”** Kjo është shprehje hebraishte e fortë mohore (jo fjali kushtore greqisht) që nënkuptonte një betim të nënkuptuar, por të pashprehur. Kur krahasohet me Mat. 16:4, kuptojmë se Jezusi po thoshte: s’ka më shenja të tjera. Jezusi u kishte dhënë shumë shenja (pra, profeci të DHV të përbushura në veprat dhe fjalët e tij), por ata nuk donin t’i pranonin shenjat ose Jezusin, sepse ai sfidonte traditat, pozitën kulturore dhe popullaritetin e tyre.

8:12 Jezusi udhëtoi së tepërmi në Palestinën veriore për shkak se donte që të gjithë ta dëgjonin mesazhin e tij, por edhe për shkak të shtypjes së turmave.

TEKSTI I NASB (I PËRDITËSUAR): MARKU 8:14-21

¹⁴Dhe ata kishin harruar të merrnin bukë me vete, dhe kishin vetëm një bukë në barkë. ¹⁵Dhe ai i urdhëronte duke u thënë: “Kujdes! Ruhuni nga majaja e farisenjve dhe nga majaja e Herodit”. ¹⁶Ata filluan të diskutonin me njëri-tjetrin për faktin se nuk kishin marrë bukë. ¹⁷Dhe Jezusi, i vetëdijshëm për këtë, u tha: “Pse po diskutoni se nuk keni marrë bukë? Ende nuk shihni dhe kuptoni? Keni zemër të ngurtësuar? ¹⁸Keni sy po nuk shihni? Keni veshë dhe nuk dëgjoni? A nuk ju kujtohet ¹⁹kur theva pesë bukët për pesë mijë veta, sa shporta me copëzat e mbetura mblodhët?” Ata i thanë: “Dymbëdhjetë”. ²⁰“Kur theva shtatë bukë për katër mijë vetë, sa shporta të mëdha plot me copëza të mbetura mblodhët?” Dhe ata i thanë: “Shtatë”. ²¹Dhe ai u thoshte: “Ende nuk po kuptoni?”

8:14 Qartazi, kjo është hollësi prej dëshmitari okular nga Pjetri.

8:15 “Ai i urdhëronte” Kjo është dëftore e pakryer mesore, që përdor një fjalë të fortë: “urdhëroj me autoritet” (shih Marku 5:43; 7:36; 8:15; 9:9). Kjo fjalë është tipike për Markun (pra, lidhet shpesh me “Sekretin Mesianik”).

NASB, NRSV “Kujdes”

NKJV “Bëni kujdes”

TEV “Kujdesuni”

NJB “Mbajini sytë hapur”

Fjalë për fjalë, “shikoni” (pra, *horao*). Është urdhërore e tashme veprare, që nënkupton zell të vazhdueshëm për të patur vigjilencën e duhur.

NASB, NKJV,
NRSV “Ruhuni”
TEV “ruhuni nga”
NJB “jini vigjilentë”

Edhe kjo është urdhërore e tashme veprare. Të dyja këto urdhëra të rrepta vijnë nga fjalë të ndryshme greqisht që kanë kuptimin “shikoj” (pra, *horao* dhe *blepo*); kjo nënkupton se besimtarët duhet të jenë vazhdimisht vigjilentë (shih Marku 4:24; 12:38; 13:5, 9, 23, 33) kundër legalizmit dhe institucionalizmit kryelartë.

■ **“e Herodit”** Kopjuesit e hershëm prireshin t’i standardizonin thëniet e Jezusit. Në Marku 3:6 dhe 12:13, Jezusi thotë “herodianëve”; prandaj dorëshkrimet greke P46, G dhe W, si dhe disa versione të Vullgatës, dhe përkthimet kopte, e ndryshuan këtë formë gjinore. Forma në shumicën e dorëshkrimeve greke është ajo gjinore (shih dorëshkrimet Sinaitikus, A, B, C, D dhe L). Shih Temën e Veçantë për familjen e Herodit në Marku 1:14.

■ **“majaja”** Zakonisht, ajo ishte simbol i shprishjes, siç ndodh dhe në këtë pasazh (shih 1 Kor. 5:6-8; Gal. 5:9). Ndoshta është lojë fjalësh në aramaisht, sepse fjalët “maja” dhe “fjalë” janë shumë të ngjashme. Problemi i dishepujve ishte njësoj si ai i farisenjve, pra, plogështia dhe verbëria shpirtërore. Ata duhet të jenë vazhdimisht vigjilentë kundër këtij fenomeni. Herodët përfaqësonin problemin e kundërt: dashurinë për botën dhe gjendjen e statukuosë me çdo çmim!

8:16 “filluan të diskutonin me njëri-tjetrin për faktin se nuk kishin marrë bukë me vete” Kjo është në kohën e pakryer. Dishepujt nuk e kishin marrë ende mësimin. Jezusi do t’ua përmbushë çdo nevojë! Ai po flet për ndikimet shprishëse, kurse ata mendojnë se ai po flet për ushqimin!

NKJV shton fjalën “duke u thënë” në këtë fjali të shkurtuar (siç bëjnë dhe shumë dorëshkrime të mëvonshme greqisht), në përputhje me Mat. 16:7. NASB e përmbushi këtë qëllim duke i shtuar këto fjalë me shkronja të pjerrëta (pra, “filluan” dhe “faktin”).

8:17 “Jezusi, i vetëdijshëm për këtë” Nuk është gjithmonë e qartë sesi i dinte Jezusi gjërat. Nganjëherë, kjo vinte nga njohuria e tij e mbinatyrshme, ndërsa herë të tjera, për shkak se ai e njihte sjelljen dhe karakteristikat e njerëzve.

■ **“Pse po diskutoni se nuk keni marrë bukë”** Kjo është e para nga një grup prej gjashtë ose shtatë pyetjesh, ku Jezusi shpreh zhgënjimin se as dishepujt e tij nuk i kuptonin ende gjërat! Gjithë ky kontekst i Markut na zbulon sa e vështirë është që “miqtë dhe armiqtë” ta kuptonin mesazhin rrënjësisht të ri të Jezusit. As dishepujt e tij, as familja, as njerëzit e qytetit të vet, as turmat dhe as krerët fetarë nuk kishin sy ose veshë shpirtërorë!

■ **“Ende nuk shihni dhe kuptoni”** Ky është motiv i përsëritur (shih Marku 8:21; 6:52). Familja, njerëzit e vendlindjes, dishepujt, njerëzit e qytetit dhe krerët fetarë nuk e kuptonin. Ndoshta, kjo tregon klimën shpirtërore përpara plotësisë së Frymës që erdhi në ditën e Rrëshajëve (ose “Sekreti Mesianik” zbulohet në Zotin e kryqëzuar dhe të ringjallur).

■ **“Keni zemër të ngurtësuar”** Kjo është pjesore e kryer pësore, që nënkupton një gjendje të vazhdueshme shpirtërore, e shkaktuar nga një veprues i jashtëm (shih Marku 4:13, 40; 6:52; 7:18; 8:17, 21, 33; 9:10, 32). Kjo është pikërisht ajo që do t’i ndodhë dhe Juda Iskariotit. (shih Temën e Veçantë: Zemra, te Marku 2:6.

8:18 Ky është citim i DHV nga Ezekieli 12:2 (shih Jer. 5:21), që teologjikisht është paralel i Isa. 6:9-10 (shih Marku 4:12). Profetët e DHV flisnin fjalën e Perëndisë, por keqkuptoheshin për shkak të gjendjes shpirtërore të dëgjuesve. Këto citime nga DHV janë në një formë gramatikore që pret përgjigjen “po”.

■ **“A nuk ju kujtohet”** Jezusi po i qorton për mungesë kuptueshmërie shpirtërore në lidhje me ushqyerjet e mrekullueshme (shih Marku 8:17-21). Kjo frazë ka dhe një orientim nga DHV (shih LiP. 4:9-10; 8:11, 19). Populli i Perëndisë duhet t’i ruajë të vërtetat e Perëndisë dhe duhet t’i zbatojë.

8:19 “shporta” Ky term është i ndryshëm nga 8:8. Përdoret te Marku 6:43 (pra, shportat e vogla). Ai po u kujton ushqyerjen e mëparshme të mrekullueshme. Ata nuk e kishin bërë lidhjen (shih Marku 8:32-33; 9:32-34; 10:35-37).

8:20 Vargu 19 bën fjalë për ushqyerjen në Markun 6, por vargu 20 bën fjalë për ushqyerjen e tanishme, te Marku 8.

TEKSTI I NASB (I PËRDITËSUAR): MARKU 8:22-26

²²Dhe erdhën në Betsaida. Dhe i sollën Jezusit një të verbër dhe iu përgjyruan që ta prekte. ²³Si e mori të verbrin për dore, Jezusi e nxori jashtë fshatit; dhe pasi i pështyu në sy dhe vuri duart mbi të, e pyeti: “Shikon gjë?” ²⁴Dhe ai ngriti sytë dhe tha: “Shoh njerëz, sepse i shoh si pemë, duke ecur lart e poshtë”. ²⁵Pastaj, sërish, Jezusi ia vuri duart mbi sy; dhe ai vështroi ngultas dhe iu kthye shikimi dhe filloi të shihte gjithçka qartë. ²⁶Dhe Jezusi e dërgoi në shtëpi duke i thënë: “As mos hyr në fshat”.

8:22 “një të verbër” Një nga profecitë e Isaisë për Mesinë ishte se do t’u kthente shikimin të verbërve (shih Isa. 29:18-35:5; 42:7, 16, 18, 19).

Verbëria fizike është metaforë e DHV për verbërinë shpirtërore (shih Isa. 56:10; 59:10). Po kjo lojë fjalësh me verbërinë fizike dhe atë shpirtërore shihet grafikisht në Gjoni 9. Kjo lidhet qartazi me verbërinë e dishepujve në Marku 8:15, 18.

8:23 “e nxori jashtë fshatit” Kjo ishte me qëllim që i verbri të qetësohej, por edhe që ta mbante të fshehtë shërimin (shih Marku 7:33; 8:26).

■ **“i pështyu në sy dhe vuri duart mbi të”** Këto ishin të dyja mënyra kulturore shërimi, njëra fizike tjetra shpirtërore. Synimi ishte që t’ia forconte besimin të verbrit. Shih Temën e Veçantë: Vënia e Duarve në Marku 7:32.

8:24 “Shoh njerëz, sepse i shoh si pemë” Jezusi nuk kishte fuqi të kufizuar, por po punonte për besimin e këtij njeriu. Ky është i vetmi shërim i pjesshëm, ose shërim me disa faza, që përmendet në ungjijtë.

8:25 Ky varg fillon me vënien e duarve të Jezusit në sytë e të verbrit. Pastaj, skena zhvendoset te burri (shih NJB). Ai duhet të përqendrohet dhe të shohë ngultas (shih Mat. 7:5). Kur bashkëpunon, i kthehet menjëherë shikimi.

8:26 Kjo është një nga ato rastet e përsëritura te Marku kur Jezusi urdhëron prerazi njerëzit që ka shruar që të mos tregojnë për shërimin e tyre. Tekstus Receptus (pra, KJV ose NKJV) madje shton një frazë për ta bërë më të qartë këtë. Jezusi nuk donte që të njihej si shërues. Ai e përdorte shërimin për të treguar mëshirën e Perëndisë, për t’ua forcuar besimin dishepujve dhe për të vërtetuar shërbesën e tij shëruese.

TEKSTI I NASB (I PËRDITËSUAR): MARKU 8:27-30

²⁷Jezusi doli, bashkë me dishepujt, në fshatrat e Cezare Filipisë; dhe gjatë rrugës, i pyeti dishepujt duke u thënë: “Kush thonë njerëzit se jam?” ²⁸Ata ia treguan dhe i thanë: “Gjon Pagëzori; disa të tjerë thonë, Elija; por disa të tjerë, se je një nga profetët”. ²⁹Dhe ai vazhdoi duke i pyetur: “Po ju, kush thoni se jam?” Pjetri iu përgjigj dhe i tha: “Ti je Krishti”. ³⁰Dhe ai i paralajmëroi që të mos i tregonin askujt për të.

8:27-30 Kjo ngjarje është fazë kyçe në ungjillin e Markut. Historitë e mrekullive, që vërtetojnë fuqinë, autoritetin dhe natyrën hyjnore të Jezusit pushojnë. Nga kjo pikë e më tej, theksi është te kryqëzimi. Ungjilli i Markut ndryshon nga përqendrimi te natyra e Jezusit tek vepra e tij madhështore e shpengimit (pra, tek ajo që kreu).

8:27 “në fsharat” Mateu 16:13 thotë “në rajonin e”. Jezusi donte të bënte dy gjëra: (1) të largohej prej turmave, dhe (2) të predikonte në të gjitha fshatrat. Në këtë rast, arsyeja #1 është mbizotëruese.

■ **“Cezare Filipisë”** Ky qytet ishte 34 km në veri të Detit të Galilesë në një zonë kryesisht pagane. Ishte nën kontrollin e Herod Filipit, jo Herod Antipës.

■ **“gjatë rrugës, i pyeti”** Teksa dishepujt po ecnin, Jezusi nisi (koha e pakryer) të bisedonte me ta.

■ **“Kush thonë njerëzit se jam?”** Mateu 16:13 thotë: “Biri i Njeriut”, që ishte titulli që Jezusi kishte zgjedhur për veten. Kjo është një pyetje fetare qendrore.

8:28 “Gjon Pagëzori” Ky ishte mendimi i Herod Antipës, si dhe i disa të tjerëve (shih Marku 6:14, 16; Luka 9:19).

■ **“Elija”** Kjo nënkuptonte se Jezusi mendohej se ishte pararendësi i Mesisë (shih Mal. 4:5).

■ **“një nga profetët”** Mateu 16:14 thotë “Jeremia”. Të gjitha këto mendime kërkonin ringjalljen trupore dhe ishin tituj nderues, por jo vetëm për Mesinë.

8:29 “Po ju, kush thoni se jam?” Kjo është në shumës dhe i drejtohej të gjithë dishepujve. “Ju” ka vlerë theksuese në greqisht, sepse ky përemër vendoset i pari në fjali.

■ **“Ti je Krishti”** Pjetri, më energjiku i grupit, përgjigjet i pari. Kjo fjalë është tejskronjzim i fjalës hebraisht “Mesia” (BDB 603), që do të thotë “i Vajosuri”. Jezusi ngurronte që ta pranonte publikisht këtë titull për shkak të interpretimeve të rreme politike, ushtarake dhe nacionalise të judenjve. Në këtë kontekst privat, ai e pranon, madje dhe e kërkon këtë titull. Vargu paralel te Mat. 16:16 ka titullin e plotë: “Krishti, Biri i Perëndisë së Gjallë”. Marku (që mban shënim predikimet e Pjetrit) nuk e përmend lavdërimin e Jezusit për Pjetrin (shih Mat. 16:17, 19).

8:30 “i paralajmëroi që të mos i tregonin askujt për këtë” Ky është një shembull tjetër i Sekretit Mesianik, që është shumë i përmendur te Marku (shih Marku 1:33-34,43; 3:12; 4:11; 5:43; 7:24,36; 8:26,30). Ata ia njihnin titullin, por jo misionin!

TEKSTI I NASB (I PËRDITËSUAR): MARKU 8:31-33

³¹Dhe ai filloi t’i mësonte se Biri i Njeriut duhet të vuajë shumë gjëra, se do të refuzohet nga pleqtë, kryepiftërinjtë dhe skribët, do të vritet, dhe pas tre ditësh do të ringjallet. ³²Dhe Jezusi po e thoshte qartë këtë. Dhe Pjetri e mori mënjane dhe filloi ta qortonte. ³³Por, duke u kthyer dhe duke parë dishepujt, Jezusi e qortoi Pjetrin dhe i tha: “Ik pas meje, Satan; sepse ti nuk e ke mendjen te interesat e Perëndisë, por tek ato të njeriut”.

8:31 “ai filloi t’i mësonte” Koha e pakryer mund të nënkuptojë (1) fillimin e një veprimi, ose (2) vazhdimin e një veprimi në të shkuarën. Këtu, #1 nënkuptohet nga konteksti, por Marku 8:32 ka një tjetër formë të pakryer që nënkupton #2. Kjo është profecia e parë e Jezusit për vuajtjet dhe vdekjen e tij, por ka dhe të tjera (shih Maru 9:12, 31; 10:33-34).

■ **“Biri i Njeriut duhet”** Kjo tregon se Jezusi e kuptonte qartë misionin e tij dhe çmimin e kësaj (shih Marku 10:45). Kjo ishte pikërisht ajo lloj shenje profetizuese që farisenjtë ia kishin kërkuar te Marku 8:12 për të vërtetuar se ishte profet i vërtetë (shih LiP. 13:2-5; 18:18-22).

■ **“do të vuajë shumë gjëra”** Ky ishte ai aspekt i shërbesës mesianike që judenjët e anashkalonin (shih Zan. 3:15; Psalmi 22; Isa. 52:13-53:12; Zak. 9-14). Në mendimin judaik, Mesia shihej si pasardhës i Davidit, dalëzotësi ushtarak i Izraelit. Por ai do të ishte dhe profet, si te Psalmi 110 dhe Zakaria 3-4. Kjo natyrë e dyfishtë pasqyrohet dhe në pritshmërinë e komunitetit të Pergamenave të Detit të Vdekurt për dy Mesi, njëri mbretëror (nga Juda) dhe tjetri piftëror (nga Levi). Kjo pritshmëri e një roli dinamik si udhëheqës dukej tejet e ndryshme nga Mesia si njeri i vuajtur që vdes.

Jezusi u përpoq disa herë që t’i informonte dishepujt për vuajtjet e profetizuara për të (shih Marku 8:31; 9:12, 30-31; 10:33-34), por ata nuk e kuptonin dot (shih Marku 8:32-33; 9:32-34; 10:35-37).

■ **“do të refuzohet”** Kjo do të thotë “mohohet”, sepse Jezusi nuk përmbushte paragjykimet e krerëve judenj për Mesinë. Nuk puqej me pritshmëritë e tyre.

■ **“nga pleqtë, kryepriiftërinjtë dhe skribët”** Bëhet fjalë për Sinedrin, këshillin prej shtatëdhjetë krerësh nga Jerusalemi, që ishte si një lloj gjykate e lartë. Shih Temën e Veçantë të Marku 12:13.

■ **“do të vritet... do të ringjallet”** Ky është thelbi i mesazhit të ungjillit: një fljijim zëvendësues dhe vërtetimi i lavdishëm hyjnor i pranimit të saj.

TEMË E VEÇANTË: RINGJALLJA (SPECIAL TOPIC: RESURRECTION)

Në Bibël, kthimi nga vdekja ka tre kuptime:

- Ata që nuk vdiqën, por shkuan te Perëndia (pra, Enoku, shih Zan. 5:24; Elia, shih 2 Mbre. 2:11), që quhet “u mor lart”.
- Nga fuqia e Perëndisë, disa kthehen nga pragu i vdekjes dhe shërohen fizikisht. Ky quhet “reanimacion”. Në të ardhmen, këta njerëz do të vdesin.
- Ka patur vetëm një ringjallje (pra, Jezusi). Ai vdiq, por u ringjall nga vdekja (pra, *hadesi*) dhe iu dha një trup i ri, i përgatitur për jetën e përjetshme me Perëndinë. Ai është fryti i parë i të vdekurve (shih 1 Kor. 15:20, 23; “i parëlinduri i të vdekurve”, shih Kol. 1:15, 17). Për shkak të tij, besimtarët do të ringjallen në Ardhjen e Dytë (shih Psa. 49:15; 73:24; Isa. 26:19; Dan. 12:2; Mat. 22:31-32; Marku 12:26-27; Gjoni 5:25,28-29; 6:39-40,44,54; Rom. 8:11; 1 Kor. 15; 1 Thes. 4:13-18; 1 Gjonit 3:2).

Prova për ringjalljen:

- Pesëdhjetë (5) ditë më vonë, në ditën e Rrëshajëve, ringjallja u bë pika qendrore e predikimit të Pjetrit (shih Veprat 2). Mijra vetë që jetonin në atë zonë, ku ndodhi kjo gjë, besuan!
- Jeta e dishepujve ndryshoi rrënjësisht, nga dekurajimi (nuk e prisnin ringjalljen e Jezusit) te guximi, madje dhe martirizimi.
- Pali rendit shumë besimtarët në 1 Kor. 15:5-8, përfshi dhe veten (shih Veprat 9).

Vlera e ringjalljes:

- Tregon se Jezusi është vërtetë ai që tha (shih Mat. 12:38-40; parashikimi i vdekjes dhe ringjalljes së tij)
- Perëndia miratoi jetën, mësimet dhe vdekjen zëvendësuese të Jezusit! (shih Rom. 4:25)
- Na tregon premtimin për gjithë të krishterët (pra, trupin e ringjalljes, shih 1 Kor. 15)

Thënie të Jezusit se do të ringjallej nga vdekja:

- Mat. 12:38-40; 16:21; 17:9,22, 23; 20:18-19; 26:32; 27:63
- Marku 8:31; 9:1-10,31; 14:28,58
- Luka 9:22-27
- Gjoni 2:19-22; 12:34; kapitujt 14-16

Pjetri dhe Pali pohojnë se Psalmi 16 bën fjalë për Jezus Mesinë

- Pjetri, Veprat 2:24-32
- Pali, Veprat 13:32-37

Për studim të mëtejshëm:

- Evidence that Demands a Verdict*, nga Josh McDoell
- Ëho Moved the Stone?* Nga Frank Morrison
- The Zondervan Pictorial Encyclopedia of the Bible*, “Resurrection”, “Resurrection of Jesus Christ”

■ **“pas tre ditësh do të ringjallet”** Kjo frazë mund të bëjë fjalë për Os. 6:1-2. Interpretohet në mënyrë të ngjashme dhe në Targumin aramaisht të këtij vargu. Gjithsesi, Jezusi duket se po aludon për Jona 1:17 (shih Mat. 12:39; 16:4). Kjo lloj shenje profetike ishte pikërisht ajo që po kërkonin farisenjtë në Marku 8:12 (shih Mat. 16:4). Kjo lloj profecie ishte baza për përcaktimin e profetit të vërtetë sipas LiP. 13:2-5; 18:18-22. Jezusi u dha shenjë pas shenje, por ata nuk donin (dhe nuk mund) të kuptonin!

8:32

NASB “po e thoshte qartë këtë”
NKJV “po e thoshtë hapur këtë fjalë”
NRSV, NJB “e tha gjithë këtë haptazi”
TEV “ua bëri shumë të qartë këtë”

Kjo është një tjetër kohë e pakryer si te Marku 8:31. Aty kishte kuptimin “filloi”, kurse këtu mund të bëjë fjalë për një veprim të përsëritur (pra, Jezusi u foli disa herë për vuajtjet dhe vdekjen e vet). Ai u foli haptazi—pa shëmbëlltyra, pa simbole, pa metafora (shih Gjoni 10:24; 11:14; 16:25, 29; 18:20).

■ **“Pjetri e mori mënjane”** Këtë e bëri me sinqeritet, por në mënyrë të pamend. Pjetri po vepron si zëdhënës i Satanit për mënyrën sesi Jezusi duhet ta përdorte ofiqin e tij mesiaik për të ungjillizuar dhe shpëtuar njerëzit (shih Marku 1:12-13; Mat. 4:1-11).

■ **“dhe filloi ta qortonte”** Kjo është fjalë e fortë greke (shih LXX e Zan. 37:10; Luka 4:41; 2 Tim. 4:2). Përdoret për Jezusin në Marku 1:25; 3:12; 4:39 dhe 9:25. Në këtë kontekst, Pjetri “e qortoi rëndë”, “e censuroi” Jezusin për fjalët që tha. Padyshim, motivi i tij ishte ta mbronte Jezusin, jo ta dënonte. Pjetri nuk e kuptonte natyrën zëvendësuese dhe profetike të vuajtjeve të Jezusit.

Jezusi e qorton Pjetrin në Marku 8:33 për mungesë njohurie shpirtërore dhe për plogështi në të kuptuar.

8:33 “duke parë dishepujt” Jezusi ia tha Pjetrit këtë fjalë, por, në njëfarë kuptimi, po u drejtohej të gjithë dishepujve.

■ **“Ik pas meje, Satan”** Kjo është urdhërore e tashme veprare. Jezusi e urdhëron Pjetrin që t’i hiqej sysh Jezusit. Kjo ka ngjyrimë kuptimore të refuzimit në DHV (pra, “hidh pas shpine”, shih 1 Mbre. 14:9; Ezek. 23:35). Pa e kuptuar, Pjetri po e tundonte Jezusin njësoj siç kishte bërë dhe Satani në shkretëtirë (shih Marku 1:12-13; Mat. 4:1-11). Satani u përpoq ta bënte Jezusin që ta fitonte besnikërinë e njerëzve në çdo mënyrë tjetër përveç Kalvarit (pra, t’i ushqente, t’u tregonte mrekulli, ta komprometonte mesazhin e vet). Pjetri nuk e kuptonte se vuajtja dhe vdekja e Jezusit ishte plani i Perëndisë (shih Marku 10:45; Veprat 2:23; 3:18; 4:28; 13:29; 2 Kor. 5:21). Shih Temën e Veçantë: Satani, në Marku 1:13.

Shpesh, tundimet më të dhimbshme dhe më dinake në vijnë nga miqtë dhe nga familja! Përparësia më e lartë është mbretëria e Perëndisë, jo preferencat, privilegjet apo qëllimet personale (shih Marku 8:34-38).

TEKSTI I NASB (I PËRDITËSUAR): MARKU 8:34-9:1

³⁴Dhe ai e thirri turmën dhe dishepujt dhe u tha: “Nëse dikush dëshiron të vijë pas meje, duhet ta mohojë veten, të marrë kryqin e vet dhe të më ndjekë. ³⁵Sepse, kushdo që dëshiron ta shpëtojë jetën e vet, do ta humbasë, por kushdo që e humbet jetën e vet për hirin tim dhe për hir të ungjillit, do ta shpëtojë. ³⁶Sepse ç’dobi i bën njeriut nëse fiton gjithë botën, por humbet shpirtin e vet? ³⁷Sepse çfarë do të japë njeriu si shkëmbim për shpirtin e vet? ³⁸Sepse kushdo që turpërohet prej meje dhe prej fjalëve të mia në këtë brez kurorëshkelës dhe mëkatar, edhe Birit të Njeriut do t’i vijë turp prej tij kur të vijë në lavdinë e Atit me engjëjt e shenjtë. ^{9:1}Dhe Jezusi u thoshte: “Me të vërtetë ju them: ka disa që po qëndrojnë këtu, që nuk do ta shijojnë vdekjen derisa të shohin mbretërinë e Perëndisë pasi të vijë me fuqi”.

8:34 “e thirri turmën dhe dishepujt” Marku është i vetmi ungjill që përmend praninë e turmës në Cezarenë e Filipisë. Zakonisht, kjo ngjarje ishte një kohë mësimi veçmas, por qartazi, aty ishin të pranishëm dhe të tjerë. Kjo turmë duhet të ketë përfshirë dhe shumë johebrenj por, ndoshta, s’kishte farisenj ose krerë fetarë, sepse këtu ishin jashtë tokës së premtuar në një zonë pagane. Pikërisht kësaj turme, Jezusi i zbulon çmimin e vërtetë të dishepullizimit: dorëzimin radikal dhe të plotë që nevojitej për ta ndjekur Jezusin. Ai u bën thirrje ta ndjekin, por ua shpreh qartë çmimin!

■ **“Nëse”** Kjo është fjali kushtore e rendit të parë, që kuptohet si e vërtetë nga këndvështrimi i autorit, ose për qëllimet e tij letrare.

■ **“dikush dëshiron të vijë pas meje”** Vini re ftesën universale për të qenë dishepuj të Jezusit. Por ka një çmim (pra, shpëtimi është falas, por dishepullizimi është i domosdoshëm, por ka çmim të madh nga ana personale). Është interesante se vetë fjalët e Jezusit për Pjetrin në Marku 8:33 (*hupage opisō mou*) përdoren sërish tani (*opisō mou*), por në kuptimin “ejani pas meje” (pra, dishepullizimi). Ka ndjekje të pavend (Pjetri, si zëvendësues i Satanit) dhe ndjekje të duhur (pra, shërbesa altruiste). Pikërisht ajo gjë për të cilën Pjetri e qortoi Jezusin tani shprehet si qëllim për të gjithë: “merrni kryqin tuaj”!

■ **“duhet ta mohojë veten”** Kjo është forma urdhërore aoriste mesore e një fjale që do të thotë “mohoj”, “hedh poshtë”, “refuzoj”, ose “injoroj” (shih Mat. 16:24; 20:35, 75; Marku 8:34; 14:30, 32, 72; Luka 9:23; 12:9; 23:34, 61; Gjoni 13:38).

Rënia (shih Zanafilla 3) e ka kthyer në qëllim të jetës pavarësinë dhe egoizmin e njerëzimit, por tani besimtarët duhet të kthehen te varësia altruiste te Perëndia. Shpëtimi është rikthimi i shëmbëllimit të Perëndisë në njerëzimin; ky shëmbëllim është dëmtuar nga Rënia. Kjo na lejon të kemi bashkësi të ngushtë me Atin, që është synimi i krijimit.

■ **“të marrë kryqin e vet”** Kjo është urdhërore aoriste veprorë. Kjo frazë, “merr kryqin tënd” përdorej në rastin kur një kriminel i dënuar ishte i detyruar ta mbante trarin horizontal të kryqit deri në vendin e kryqëzimit. Kjo ishte metaforë kulturore për vdekjen e dhimbshme dhe të turpshme. Në këtë kontekst, bën fjalë për “vdekjen ndaj natyrës sonë të vjetër mëkatore”. Ungjilli është thirrje radikale për ndjekje pa kthim, pra, për dishepullizim (shih Mat. 10:38; 16:24; Luka 9:23; 14:27; 17:33; Gjoni 12:25). Ashtu si Jezusi dha jetën për të tjerët, edhe ne duhet të ndjekim shembullin e tij (shih 2 Kor. 5:14-15; Gal. 2:20; 1 Gjonit 3:16). Kjo tregon qartazi se rezultatet e rënies ishin hequr.

■ **“dhe të më ndjekë”** Kjo është urdhërore e tashme veprorë. Kjo është gjuha e dishepullizimit rabinik. Krishterimi është zgjedhje vendimtare, e ndjekur nga dishepullizimi i vazhdueshëm (shih Mat. 28:19-20; Efe. 2:8-10).

8:35-37 “të shpëtojë jetën e vet... do ta humbasë” Kjo është lojë fjalësh me fjalën greqisht “vete”, *psuche*. Në këtë kontekst, shohim një kontrast mes jetës shpirtërore (me fokus te mbretëria) dhe jetës egoiste (tokësore, të përqendruar te vetja). Përkthimi i Williams për DHR e përkthen “jetën më të lartë... jetën më të ulët”. Nëse jetojmë për Krishtin, do të jetojmë përjetësisht; nëse jetojmë për veten, jemi shpirtërisht të vdekur (shih Zan. 3; Isa. 59:2; Rom. 5:18-19; 7:10-11; 8:1-8; Efe 2:1, 5; Kol. 2:13; Jakobi 1:15). Kjo e vërtetë ngjason me shëmbëlltyrën e “budallait të pasur” (shih Luka 12:16-20).

8:35 “ungjillit” Kjo është fjalë e përbërë: *eu* (i mirë) dhe *angelos* (mesazh). Në fillim kishte kuptimin “shpall lajme të mira”, por më vonë u përdor për mesazhin rreth Jezusit si Mesia që sjell shpëtimin (dhe doktrinat që lidhen me të). Nënkupton të vërtetat e krishterimit dhe shpalljen e këtyre të vërtetave. Ungjilli i Markut mund të ketë qenë i pari që e përdor në këtë kuptim (shih Marku 1:1, 14-15; 8:35; 10:29; 14:9).

8:36 “nëse fiton gjithë botën” Edhe kjo ishte një nga tundimet e Satanit për Jezusin (shih Mat. 4:8-9).

■ **“por humbet shpirtin e vet”** Kjo është paskajore aoriste pësore e një termi që përdorej për të përshkruar humbjen e diçkaje që e kishte më parë në zotërim (shih Mat. 16:26; Veprat 27:10).

8:37 Kjo është pyetje e fuqishme. Ku është përparësia: te jeta e tanishme, apo te jeta e përjetshme? Jeta egoiste ia heq njeriut gëzimin e jetës dhe dhuratën e jetës! Kjo jetë është, edhe dhuratë, edhe kujdestari.

8:38 “kushdo që turpërohet prej meje dhe prej fjalëve të mia” Bëhet fjalë për kohën kur çdo njeri përballet me ungjillin. Kjo e vërtetë shprehet në mënyrë të ndryshme në Mat. 10:32-33 dhe Luka 12:8-9. Vendimi që njeriu merr sot për ungjillin ia përcakton dhe të ardhmen. Jezusi është ungjilli!

Kjo frazë është fjali kushtore e rendit të tretë, pra, nënkupton kushtëzim (shih TEV dhe NJB).

■ **“në këtë brez kurorëshkelës dhe mëkatar”** Judenjët e periudhës ndërhyjëto zhvilluan teologjinë e dy epokave. Epoka e tanishme mbizotërohet nga mëkati, egoja dhe padrejtësia. Shih Temën e Veçantë: Dy Epokat

Judaïke në Marku 13:8. Megjithatë, Perëndia do të dërgonte Mesinë dhe do të themelonte një epokë të re drejtësie. Jezusi po thotë se ai vetë po e inauguronte këtë ditë dhe se kjo drejtësi e re varet (pra, bazohet, Gjoni 1:12; 3:16) nga besimi dhe bindja personale në të, jo në përpjekjet njerëzore (shih Jer. 31:31-34; Mat. 5:20).

■ **“Birit të Njeriut”** Ky është titulli i Jezusit për veten; nuk kishte domethënie nacionaliste, ushtarake, apo përjashtuese në judaizmin e parë të shekullit të parë. Ky term vjen nga përdorimi tipik që i bëhet në Ezek. 2:1 dhe Psa. 8:4, ku ka kuptimin “qenie njerëzore”, dhe në Dan. 7:13, ku nënkupton Mesinë hyjnor (pra, duke ecur në retë e qiellit, duke iu afruar Perëndisë dhe duke marrë mbretërinë e përjetshme). Ky term kombinon dy aspektet e personalitetit të Jezusit, plotësisht Perëndi dhe plotësisht njeri (shih 1 Gjonit 4:1-3).

■ **“kur të vijë”** DHV zbulon qartë një ardhje të Mesisë. Mirëpo jeta tokësore e Jezusit tregoi se Zan. 3:15; Psalmi 22; Isaia 53; dhe Zakaria 9-14 përmendin dhe një vuajtje të Mesisë. Ardhja e dytë dhe e lavdishme e Mesisë si Zot dhe gjykatës i kozmosit do të jetë pikërisht ashtu siç e prisnin judenjtë të vinte për herë të parë. Mendjengushtësia dhe dogmatizmi i tyre teologjik i bëri që ta mohonin Jezusin.

Ardhja e Dytë është një e vërtetë madhore dhe e përsëritur shpesh në DHR (shih Mat. 10:23; 16:27-28; 24:3,27,30,37; 26:64; Marku 8:38-39; 13:26; Luka 21:27; Gjoni 21:22; Veprat 1:11; 1 Kor. 1:7; 15:23; Fil. 3:20; 1 Thes. 1:10; 2:19; 3:13; 4:16; 2 Thes. 1:7,10; 2:1,8; Jakobi 5:7-8; 2 Pje. 1:16; 3:4,12; 1 Gjonit 2:28; Zbu. 1:7).

■ **“në lavdinë e Atit me engjëjt e shenjtë”** Kjo është profeci e DHV nga Dan. 7:10 (shih Mat. 16:27; Marku 13:20; Luka 9:26; 2 Thes. 1:7). Këtu bëhet fjalë për ardhjen e dytë. Me fjalë të tjera, tregon natyrën hyjnore të Jezusit. Disa herë në Mateu, engjëjt janë mbledhës dhe ndarës eskatologjikë të njerëzimit (shih Maru 13:39-41, 49; 24:31).

■ **“lavdinë”** Në DHV fjala më e zakonshme hebraisht “lavdi” (*kabod*) ishte, fillimisht, term tregtar (nënkuptonte peshoren) që kishte kuptimin “jam i rëndë”. Ajo që ishte e rëndë ishte e vlefshme, ose kishte vlerë të qenësishme. Shpesh, koncepti i shkëlqimit i shtohet kësaj fjale për të shprehur madhështinë e Perëndisë (shih Eks. 15:16; 24:17; Isa. 60:1-2). Vetëm ai është i denjë dhe i nderuar. Është tepër i shkëlqyer që të shihet me sy nga njerëzimi (shih Eks. 33:17-23; Isa. 6:5). Perëndia mund të njihet vërtet vetëm nëpërmjet Krishtit (shih Jer. 1:14; Mat. 17:2; Gjoni 14:8-9; Heb. 1:3; Jakobi 2:1).

Fjala “lavdi” është disi e vagullt.

1. Mund të jetë paralel i termit “drejtësia e Perëndisë”
2. Mund t’i referohet “shenjtërisë” ose “përsosmërisë” së Perëndisë
3. Mund t’i referohet shëmbëllimit të Perëndisë, në të cilin u krijua njerëzimi (shih Zan. 1:26-27; 5:1; 9:6), por që, më vonë, u njoillo për shkak të rebelimit (shih Zan. 3:1-22)

Përdoret për herë të parë për praninë e Perëndisë mes popullit të tij në renë e lavdisë gjatë periudhës së endjes në shkretëtirë (shih Eks. 16:7, 10; Lev. 9:23; Num. 14:10).

9:1 Ka patur shumë teori që shpjegojnë këtë thënie të Jezusit. Mund të bëhet fjalë për këto:

1. Ngjitja e Jezusit në qiell
2. Mbretëria tashmë e pranishme në Jezusin
3. Ardhja e Frymës ditën e Rrëshajëve
4. Shkatërrimi i Jerusalemit në 70 pas K.
5. Pritja e kthimit të afërt të Jezusit
6. Përhapja e shpejtë e krishterimit
7. Shndërrimi në mal.

Këto teori përqendrohen në fraza të ndryshme të këtij vargu: (1) “disa prej atyre që po qëndrojnë këtu”; (2) “mbretërinë e Perëndisë”; ose (3) “të vijë me fuqi”. Hamendësimi më i mirë është #7 për shkak të kontekstit të atypëratyshëm të Markut 9:2-13 dhe 2 Pje. 1:16-18. Po kështu, asnjë teori tjetër nuk i shpjegon të tria aspektet e vargut. Gjithsesi, kjo vlen vetëm për Pjetrin, Jakobin dhe Gjonin.

■ **“Me të vërtetë”** Fjalë për fjalë, “amen”. Shih Temën e Veçantë të Marku 3:28.

■ **“nuk do ta shijojnë vdekjen”** Kjo është fjali e dyfishtë mohore, që përdoret si frazë metaforikë (pra, përjetimi i fundit të jetës).

▣ “mbretërinë e Perëndisë” Shih shënimin në 1:15.

▣ “pasi të vijë me fuqi” Kjo është pjesore e kryer veprore, që nënkupton ardhejn e plotë dhe përfundimtare të mbretërisë. Kjo është në kontrast me faktin se mbretëria, në një kuptim të vërtetë, u inaugurua me ardhjen e Jezusit (pra, mishërimin e tij), por pritet ende një ngjarje e ardhshme (pra, Ardhja e Dytë).

PYETJE PËR DISKUTIM

Ky është një komentuar studimor udhëzues, që do të thotë se ti je vetë përgjegjës për interpretimin e Biblës. Secili prej nesh duhet të ecë sipas dritës që ka. Ti, Bibla dhe Fryma e Shenjtë keni përparësi në interpretim. Nuk duhet t’ia dorëzosh këtë të drejtë komentuesit.

Këto pyetje për diskutim t’i kam dhënë për të të ndihmuar që të analizosh çështjet kryesore të kësaj pjese të librit. Ato synojnë të të nxisin mendimin, jo të kenë natyrë shteruese.

1. A ushqeu Jezusi dy turma të mëdha, apo kemi të bëjmë me një ushqyerje, por nga dy këndvështrime?
2. Çfarë lloj “shenje” donin farisenjtë?
3. Pse i qortoi Jezusi dishepujt?
4. Pse e shëroi Jezusi vetëm pjesërisht të verbrin herën e parë?
5. Pse ndodhia te Mateu është më e plotë se ndodhia te Marku për rrëfimin e Pjetrit?
6. Çfarë saktësisht nënkuptonte rrëfimi i Pjetrit për Jezusin?
7. Pse u tronditën dishepujt nga mësimi i Jezusit për vdekjen e vet në Jerusalem?
8. Shpjego me fjalët e tua kuptimin e vargjeve 34-38.

MARKU 9

NDARJET NË PARAGRAFË TË PËRKTHIMEVE MODERNE

UBS ⁴	NKJV	NRSV	TEV	NJB
Shpërftyrimi i Jezusit	Jezusi shpërftyrohet në mal	Shpërftyrimi	Shpërftyrimi	Shpërftyrimi
9:2-8	9:2-13	9:2-8 Profecitë për Elijan	9:2-6 9:7-8	9:2-8 Pyetja për Elijan
9:9-13		9:9-13	9:9 9:10-11 9:12-13	9:9-13
Shërimi i djalit me frymën e ndyrë	Shërimi i djalit	Shërimi i djalit epileptik	Jezusi shëron një djalë me një frymë të ndyrë	Demoniaku epileptik
9:14-29	9:14-29	9:14-29	9:14-16 9:17-18 9:19-20a 9:20b-21a 9:21b-22 9:23 9:24 9:25 9:26-27 9:28 9:29	9:14-29
Jezusi parathotë sërish vdekjen dhe ringjalljen e tij	Jezusi parathotë sërish vdekjen dhe ringjalljen e tij	Profetizimi i Mundimit	Jezusi flet sërish për vdekjen e vet	Profecia e dytë për Mundimin
9:30-32	9:30-32	9:30-32	9:30-31 9:32	9:30-32
Kush është më i madhi?	Kush është më i madhi?	Madhështia e vërtetë	Kush është më i madhi?	Kush është më i madhi?
9:33-37	9:33-37	9:33-37	9:33 9:34-37	9:33-37
Kush nuk është kundër nesh, është me ne	Jezusi ndalon sektarizmin	Dëbuesi i panjohur i demonëve	Kush nuk është kundër nesh, është me ne	Përdorimi i emrit të Jezusit
9:38-41	9:38-41	9:38-41	9:38 9:39-41	9:38-40 Bujaria ndaj dishepujve të Krishtit 9:41
Tundimet për mëkat	Jezusi paralajmëron për shkeljet	Paralajmërimet për ferrin	Tundimet për mëkat	Nxjerrja e të tjerëve nga rruga e duhur
9:42-50	9:42-48 Kripa pa shije s'ka vlerë 9:49-50	9:42-48 Dishepujt e kripur 9:49-50	9:42-48 9:49 9:50a 9:50b	9:42-50

CIKLI TRE I LEXIMIT (shih f. v)

NDJEKJA E SYNIMIT TË AUTORIT FILLESTAR NË NIVELIN E PARAGRAFËVE

Ky është një komentuar studimor udhëzues, që do të thotë se ti je vetë përgjegjës për interpretimin e Biblës. Secili prej nesh duhet të ecë sipas dritës që ka. Ti, Bibla dhe Fryma e Shenjtë keni përparësi në interpretim. Nuk duhet t'ia dorëzosh këtë të drejtë komentuesit.

Lexo gjithë kapitullin njëherësh. Identifiko temat. Krahaso ndarjet e tua tematike me pesë përkthimet moderne. Ndarja në paragrafë nuk është e frymëzuar, por është çelësi për të ndjekur synimin e autorit fillestar, gjë që është thelbi i interpretimit. Secili paragraf ka vetëm një temë të vetme.

1. Paragrafi i parë
2. Paragrafi i dytë
3. Paragrafi i tretë
4. Etj.

PASAZHET PARALELE NË UNGJIJTË SINOPTIKË

- A. Marku 9:2-8 gjendet edhe te Mat. 17:1-8 dhe Luka 9:28-36.
- B. Marku 9:9-13 gjendet edhe te Mat. 17:9-13 dhe Luka 9:36.
- C. Marku 9:14-29 gjendet edhe te Mat. 17:14-20 dhe Luka 9:37-43.
- D. Marku 9:30-32 gjendet edhe te Mat. 17:22-23 dhe Luka 9:43-45.
- E. Marku 9:33-37 gjendet edhe te Mat. 18:1-5 dhe Luka 9:46-48.
- F. Marku 9:38-50 gjendet edhe te Mat. 18:6-14 dhe Luka 9:49-50.

STUDIMI I FJALËVE DHE FRAZAVE

TEKSTI I NASB (I PËRDITËSUAR): MARKU 9:2-8

²Pas gjashtë ditësh, Jezusi mori me vete Pjetrin, Jakobin dhe Gjonin, dhe i çoi të vetëm në një mal të lartë. Dhe u shpërfytyrua para tyre; ³dhe rrobat e tij u bënë të shndritshme dhe borë të bardha, aq sa nuk i zbardh dot asnjë rrobalarës në botë. ⁴Atyre iu paraqit Elija, bashkë me Moisiun, që po flisnin me Jezusin. ⁵Pjetri i tha Jezusit: “Rabin, është mirë që jemi këtu; le të bëjmë tre çadra, një për ty, një për Moisiun dhe një për Elijan”. ⁶Sepse nuk e dinte si të përgjigjej; sepse ishin të tmerruar. ⁷Atëherë, u formua një re, që i mbuloi nën hijen e vet, dhe nga reja doli një zë: “Ky është Biri im i dashur, dëgjojeni!” ⁸Dhe, menjëherë, vështruan rreth e qark dhe s’panë më askënd me ta, përveç Jezusit.

9:2 “gjashtë ditësh” Luka 9:28, thotë “tetë ditësh”. Ky përcaktim i qartë kohor është tejet i pazakontë për ungjillin e Markut.

■ **“Pjetrin, Jakobin dhe Gjonin”** Ky është rrethi i brendshëm i dishepujve që ishin gjithmonë të pranishëm në ngjarjet kryesore (shih Marku 5:37). Kjo ngjarje vlente, sa për Jezusin, aq dhe për ta.

■ **“në një mal të lartë”** Tradita (pra, ungjilli jokanonik i Hebrenjve) thotë se ky ishte mali Tabor, por, ndoshta, ishte një nga kodrat përreth malit Hermon.

Ndoshta kjo ngjarje ishte mënyrë tipologjike për pasqyrimin e përjetimit të Moisiut në malin Sinai.

1. Një mal i lartë
2. Reja
3. Fytyrat e lavdishme (Eks. 34:29)
4. Periudha gjashtëditëshe (shih Eks. 24:16)

Ky motiv nga Eksodi (pra, Jezusi si Moisiu i ri, që jep një besëlidhje të re, dhe nxjerr popullin e vet nga skllavëria e mëkatit) është aludim i përsëritur te Marku. Në ungjillin e Lukës, thuhet se Jezusi, Moisiu dhe Elija po diskutonin për eksodin (pra, daljen) e Jezusit.

▣ **“të vetëm”** Luka 9:25 thotë se qëllimi ishte që “të luteshin”. Jezusi donte të largohej nga turmat dhe t’i mësonte dishepujt në vetmi. Në këtë rast, bëhet fjalë për rrethin e ngushtë të drejtuesve.

▣ **“u shpërfytyrua para tyre”** Kjo është dëftore aoriste pësore e fjalës së përbërë *meta* (pas) dhe *morfoo* (formoj), me kuptimin “ndryshoj pamjen”. Nga kjo fjalë greke kemi marrë dhe fjalën “metamorfozë”. Lavdia e shndritshme paraekzistuese e Jezusit shfaqet përmes trupit të tij njerëzor. Shndritja e vetes së tij të vërtetë hyjnore u pa qartë nga dishepujt (shih 2 Pje. 1:16-18). Fjala *morfi* (pra, Fil. 2:6-7) tregon thelbin e pandryshuar të diçkaje ose të dikujt (e kundërta e fjalës *skema*, pra, Fil. 2:8, ndryshimi i formës së jashtme).

Ky shpërfytyrim është i mundshëm dhe për ndjekësit e tij (shih Rom. 12:2; 2 Kor. 3:18). Në këtë kuptim, bën fjalë për rimëkëmbjen e shëmbëllimit hyjnor në njerëzimin, i dëmtuar nga Rënia e Zanafillës 3. Jezusi na bën të mundur të bëhemi vërtet njerëzorë, vërtet si Krishti.

9:3

NASB “rrobat e tij u bënë të shndritshme dhe borë të bardha”

NKJV “rrobat iu bënë të shndritshme, krejt të bardha”

NRSV “rrobat iu bënë të bardha verbuese”

TEV “rrobat iu bënë të shndritshme dhe të bardha”

NJB “rrobat iu bënë të bardha sa shkëlqenin”

Mateu 17:2 shton se “fytyra e tij shkëlqente si dielli”. Pa dyshim, ky është një aspekt i lavdisë së Jezusit që, shpesh, karakterizohet dhe nga vezullimi (shih shënimet më të plota te Marku 8:38).

NASB, NKJV “nuk i zbardh dot asnjë rrobalarës në botë”

NRSV “aq sa nuk i zbardhon dot asnjë në tokë”

TEV “më të bardha nga ç’mund t’i lajë dot askush në botë”

NJB “më të bardha nga ç’mund t’i bëjë asnjë zbardhues në botë”

Bën fjalë për rrobalarësit që pastronin cohat.

Pikërisht për vargje të tilla, librat e historisë janë shumë të dobishëm. Më lejoni të përmend disa që më kanë ndihmuar të kuptoj kulturën e Lindjes së Afërt në lashtësi.

1. Roland de Vaux, *Ancient Israel*, dy vëll.
2. Fred H. Wright, *Manners and Customs of Bible Lands*
3. James M. Freeman, *Manners and Customs of the Bible*
4. Jack Finegan, *Light from the Ancient Past*, 2 vëll.
5. James S. Jeffers, *The Greco-Roman World of the New Testament Era*
6. K. A. Kitchen, *Ancient Orient and the Old Testament*
7. Edwin M. Yamauchi, *The Stones and the Scriptures*

9:4 “Elija... Moisiu... Jezusi” Kjo tregon zbuluesën e vazhdueshme të Perëndisë. Vini re se, me sa duket, ata kishin tashmë trupa të ringjallur, që është e habitshme kur ke parasysh 1 Thes. 4:13-18. Këta ishin dy personalitete të Dhiatës së Vjetër, që kishin një aspekt profetik eskatologjik (pra, Elija përpara Mesisë dhe Moisiu si profet si Jezusi).

▣ **“paraqit”** Kjo fjalë përdoret për shfaqjet engjëlllore në Luka 1:11 dhe 22:43, dhe për Jezusin në Luka 24:34.

▣ **“po flisnin me Jezusin”** Kjo është e pakryer perifrastike, që nënkupton një bisedë të gjatë. Luka 9:31 thotë se ata po diskutonin për largimin (pra, eksodin) e Jezusit nga Jerusalemi. Këtu kemi një ngjasim të fortë mes këtij pasazhi dhe Eks. 24:12-18.

1. Elementi kohor i “gjashtë ditëve” (Marku 9:2)
2. Vendi, “në një mal të lartë” (Marku 9:2)
3. Prania e resë dhe Perëndia që flet prej saj (Marku 9:7)

4. Përmendja e lavdisë në fytyrën e Moisiut dhe në fytyrën e Jezusit këtu (Luka 9:29; Eks. 34:29-30)

9:5 “Pjetri i tha Jezusit” Luka 9:32 thotë se tre dishepujt ishin në gjumë pas ditës së gjatë dhe ngjites së vështirë; dhe Pjetri u zgjua pikërisht kur Elija dhe Moisiu po largoheshin.

▣ **“Rabin”** Te Mateu, thuhet “Zot”, ndërsa te Luka thuhet “Mjeshtër”.

▣ **“është mirë ë jemi këtu”** Kjo duhet të ketë qenë një përvojë e mahnitshme shpirtërore dhe fizike; vërtetim i mahnitshëm i personalitetit të Jezusit si Mesia i premtuar në DHV.

▣ **“çadra”** Kjo duhet të ketë qenë e ngjashme me kasollet e përkohshme prej kashte që përdorehin gjatë festës së Çadrave. Pjetri, pra, po thoshte se, nëse vizitorët e lavdishëm të DHV do të qëndronin për njëfarë kohe, edhe ata mund të qëndronin më gjatë!

9:6 Sa herë që Pjetri s’dinte ç’ të bënte, fliste!

9:7 “re” Ky ishte simboli i pranisë së JHVH-së gjatë eksodit (shih Eks. 13-14). Rabinët e quanin “reja e lavdisë *Shekina*”, pra, JHVH banonte dukshëm dhe vazhdimisht mes Izraelit.

▣ **“i mbuloi nën hijen e vet”** Kjo fjalë pasqyron kuptimin (në DHV) e resë së veçantë të pranisë së JHVH, që i siguronte hije (pra, mbrojtje) dhe udhëheqje popullit të Perëndisë gjatë periudhës së endjes në shkretëtirë (për 38 vjet). Kjo re rishfaqet tri herë në lidhje me Jezusin.

1. Në ngjizjen e tij, Maria mbulohet nga Fryma (shih Luka 1:35)
2. Në pagëzimin e tij, Jezusit i flet një zë nga qielli (reja vetë nuk përmendet shkoqur, shih Mat. 3:17)
3. Në Shpërhyrimin në mal, dëgjohej një zë (shih Mat. 17:5; Luka 9:34)

Kjo fjalë përdoret dy herë në DHR, një herë në lidhje me hijen e Pjetrit që bie mbi njerëzit dhe i shëron (shih Veprat 5:15) dhe një herë në formën e përbërë të kësaj fjale (Heb. 9:5), ku bëhet fjalë për kerubinët që i bëjnë hije Kapakut të Mëshirës mbi Arkën e besëlidhjes.

▣ **“një zë”** Ky është, ose (1) JHVH që flet nga reja në shkretëtirë, ose (2) një *Bath Kol* (zë nga qielli), me të cilën Perëndia zbulonte vullnetin e JHVH-së gjatë periudhës ndërhytore kur s’kishte më profetë (Marku 1:11).

▣ **“Biri im i dashur”** Fjala “bir në këtë frazë nga DHV përdoret për (1) Izraelin në tërësi; (2) për mbretin e Izraelit si përfaqësues i JHVH-së; dhe (3) për Mesinë e premtuar, që do të vinte në të ardhmen (shih Psa. 2:7). Kjo është hera e dytë që Ati i drejtohet Birit në këtë mënyrë të veçantë, me anë të këtij titulli të veçantë (shih Mat. 3:17; 17:5). Shih shënimin e plotë në Marku 1:11 dhe Temën e Veçantë në Marku 3:11.

▣ **“dëgjojeni”** Kjo është urdhërore e tashme veprorë, që pasqyron profecinë e LiP. 18:15. Zbulesa përfundimtare e Atit duhet pranuar dhe duhet të ketë bindjen e njerëzve (shih Luka 6:46).

9:8 Ky varg nënkupton, se (1) ky përjetim ishte vegim, ose (2) një ndryshim i shpejtë në botën e dukshme.

TEKSTI I NASB (I PËRDITËSUAR): MARKU 9:9-13

⁹Teksa po zbrisnin nga mali, ai i urdhëroi që të mos ia tregonin askujt ato që kishin parë, derisa Biri i Njeriut të ringjallej nga vdekja. ¹⁰Ata u kapën pas asaj fjale dhe po diskutonin me njëri-tjetrin se ç’donte të thoshte ringjallja nga vdekja. ¹¹E pyetën Jezusin duke thënë: “Pse thonë skribët se duhet të vijë së pari Elija?” ¹²Dhe ai u tha: “Elija vjen vërtet më parë dhe rivendos gjithçka. Por, megjithatë, pse shkruhet për Birin e Njeriut se duhet të vuajë shumë gjëra dhe do të trajtohet me përçmim? ¹³Por unë ju them se Elija ka ardhur vërtet, dhe ata bënë me të si deshën, ashtu siç është shkruar për të”.

9:9 “ai i urdhëroi që të mos ia tregonin askujt ato që kishin parë, derisa Biri i Njeriut të ringjallej nga vdekja” Kjo ishte e vemja herë kur faktori kohor lidhet me paralajmërimet e përsëritura të Jezusit që të mos flisnin (shih Marku 5:43; 7:36; 8:30). Ky ndalim lidhet me faktin se ungjilli nuk ishte përmbushur ende. Në të

ardhmen, kujtimet e kësaj ngjarjeje do të kuptoheshin qartë në dritën e gjithë ngjarjeve të tjera në lidhje me ungjillin (shih 2 Pje. 1:16-18).

9:10 “po diskutonin me njëri-tjetrin se ç’donte të thoshte ringjallja nga vdekja” Dishepujt nuk e kuptonin dallimin mes “Ardhjes së Dytë” (8:38) dhe “Ringjalljes” (9:9). Judenjtë e kohës së Jezusit prisnin vetëm një ardhje të Mesisë në histori, dhe kjo ngjarje lidhej me fitoren ushtarake dhe epërsinë e Izraelit si komb në nivelin botëror. Shih Temën e Veçantë: Ringjallja, në Marku 8:31.

9:11 “skribët” Këta ishin interpretuesit e respektuar kulturorë të DHV, që shpjegonin DHV dhe mënyrën si duhej zbatuar në atë kohë. Në këtë periudhë, shumica e skribëve ishin farisenj. Shih Temën e Veçantë në Marku 2:6.

9:12-13 “Elija vjen vërtet më parë... Elija ka ardhur vërtet” Jezusi pohon se Gjon Pagëzori ka përmbushur rolin profetik të Elijas (Mal. 3:1 dhe 4:5). Ka patur shumë debate për përgjigjen që dha Jezusi. Ai u shpreh qartë se Elija kishte ardhur vërtet në shërbesën e Gjon Pagëzorit (shih Mat. 11:10, 14; Makru 9:11-13; Luka 1:17). Megjithatë, kur farisenjtë e pyetën vetë Gjon Pagëzorin në ungjillin e Gjonit (Gjoni 1:20-25) nëse ishte Elija, ai e mohoi hapur. Kjo mospërputhje në dukje mund të sqarohet nga fakti se Gjoni mohoi se ishte Elija i ringjallur, ndërsa Jezusi pohoi se, në mënyrë simbolike, Gjoni përmbushi shërbesën përgatitëse të Elijas. Edhe Elija edhe Gjoni visheshin njësoj dhe vepronin në mënyra të ngjashme, kështu që identifikimi mes tyre ishte i qartë në mendjen e judenjve që e dinin historinë e Elijas dhe që dëgjonin dhe kishin parë Gjon Pagëzorin (Luka 1:17).

9:12 “do të vuajë shumë gjëra dhe do të trajtohet me përcëpim” Kjo ishte shumë tronditëse për judenjtë e kohës së Jezusit, që prisnin një çlirimtar të fuqishëm si gjyqtarët e DHV dhe që nuk prisnin një shpëtimtar të përvuatur. Ata nuk kuptonin një sërë mësimesh nga DHV (pra, Zan. 3:15; Psalmi 22; Isa. 52:13-52:12; Zak. 9-14). Dymbëdhjetë dishepujve iu deshën vite që ta kuptonin vërtet situatën; as ata nuk i kutuan gjërat plotësisht derisa erdhi shërbesa e veçantë e Frymës së Shenjtë ditën e Rrëshajëve (shih Gjoni 16:13-14), që ua zbuloi.

Vini re se Jezusi po përpiqet t’i përfshijë dymbëdhjetë dishepujt në arsytim teologjik. Po i detyron të shohin marrëdhënien mes dy profecive të ndryshme. Ata nuk ishin zyrtarisht “skribë”, por, pas pak, duhet të funksiononin si të tillë.

Jezusi i habiti me një përmbushje të papritur, që nuk ishte e fjalëpërfjalshme, por tipologjike (pra, Gjon Pagëzori funksionoi si përmbushje e ardhjes së Elisë dhe përgatitjes së rrugës për Mesinë).

Jezusi shfrytëzonte çdo çast vetmie që t’i mësonte dishepujt. Madje, dhe gjatë zbritjes nga mali, ai përmend një çështje të rëndësishme (pra, profecinë e Malakisë për Elijan). Ky shfrytëzim i çdo mundësie për trajnim fetar reflektohet te LiP. 6:7 dhe 11:19.

9:13 “siç është shkruar për të” Elija ishte përndjekur nga Jezebela (shih 1 Mbre. 19:2, 10, 14), ndërsa Gjoni ishte përndjekur nga Herodiada.

TEKSTI I NASB (I PËRDITËSUAR): MARKU 9:14-29

¹⁴Kur u kthyen te dishepujt, panë një turmë të madhe rreth tyre, dhe disa skribë po debatonin me ta. ¹⁵Menjëherë, kur gjithë turma e pa Jezusi, u mahnitën dhe nisën të vraponin që ta përshëndesnin. ¹⁶Dhe ai i pyeti: “Për çfarë po diskutoni me ta?” ¹⁷Dhe një nga turma iu përgjigj: “Mësues, unë solla tim bir, i pushtuar nga një frymë që e bën memec; ¹⁸dhe sa herë që e kap, e përplas përtokë, shkumon nga goja, kërcëllet dhëmbët dhe i ngrin trupi. Iu kërkova dishepujve të tu që ta dëbonin, por nuk e bënë dot”. ¹⁹Ai u përgjigj dhe i tha: “O brez mosbesues, edhe për sa kohë do të jem me ju? Për sa kohë do më duhet t’ju duroj? Ma sillni!” ²⁰Dhe ia sollën djalin Jezusit. Kur e pa Jezusin, menjëherë fryma e ndyrë e bëri djalin të dridhej dhe, si u rrëzua përtokë, filloi të rrokullisej duke shkumuar në gojë. ²¹Dhe Jezusi e pyeti të atin: “Sa kohë ka që i ndodh kjo?” Ai i tha: “Që nga fëmijëria. ²²Shpesh, e ka hedhur në zjarr dhe në ujë, që ta vrasë. Por, nëse mund të bësh diçka, ki mëshirë për ne dhe na ndihmo!” ²³Dhe Jezusi i tha: “Nëse mundesh?” Gjithçka është e mundur për atë që beson”. ²⁴Menjëherë, i ati i djalit bërtiti dhe i tha: “Besoj; ndihmoma mosbesimin tim”. ²⁵Kur Jezusi pa se rreth tyre po mblidhej shpejt një turmë, e qortoi frymën e ndyrë dhe i tha: “Frymë shurdhmemece, unë të urdhëroj: dil prej tij dhe mos hyr më kurrë më në të”. ²⁶Pasi bërtiti dhe e shkundi në mënyrë të tmerrshme, doli prej tij; dhe djali u bë si kufomë, aq sa shumica prej tyre tha: “Vdiq!” ²⁷Por Jezusi e mori për dore dhe e ngriti; dhe djali u çua. ²⁸Kur Jezusi

hyri në shtëpi, dishepujt nisën të pyesnin veçmas: “Pse nuk ia dolëm dot që ta dëbonim?”²⁹ Dhe ai u tha: “Ky lloj del vetëm me anë të lutjes”.

9:14 “Kur u kthyen te dishepujt” Jezusi e kishte lënë pjesën tjetër të dishepujve në këmbë të malit. Luka 9:37 na thotë se u kthyen të nesërmen.

▣ **“një turmë e madhe... skribët po debatonin”** Të dyja këto aspekte karakterizojnë shërbesën e Jezusit dhe, tani, dishepujt, po përjetonin parashijën e situatës ekzistenciale të Jezusit si dhe të shërbesës së tyre të ardhshme. Këto ishin jo vetëm probleme, por edhe mundësi të vazhdueshme.

9:15 “menjëherë” Shih shënimin në Marku 1:10.

▣ **“u mahnitën”** Disa e shohin këtë mahnitje si të lidhur me faktin se fytyra e Jezusit ende po shndriste (si në Eks. 34:29-30), por këtu konteksti duket se bën fjalë për faktin se Jezusi u kthye në momentin e duhur për shërbesë dhe mësimdhënie.

NASB **“nisën të vraponin që ta përshëndesnin”**

NKJV **“duke vrapuar drejt tij, e përshëndetën”**

NRSV **“i dolën me vrap përpara që ta përshëndesnin”**

TEV **“vrapuan tek ai dhe e përshëndetën”**

NJB **“vrapuan që ta përshëndesnin”**

Kjo është në kohën e pakryer që nënkupton (1) fillimin e një veprimi (pra, NASB), ose (2) një veprim të përsëritur në të shkuarën. Kjo turmë ishte e ngazëllyer kur pa Jezusin dhe të gjithë vrapuan që ta përshëndesnin.

9:16 “Për çfarë po diskutonin me ta” Jezusi ia drejton këtë pyetje turmës. Skribët nuk donin t’ia dinin për djalin e vogël, por për aspektin teologjik të paaftësisë së dishepujve që ta shëronin.

9:17 “i pushtuar nga një frymë” Ungjijtë bëjnë dallimin e qartë mes pushtimit demoniak dhe sëmundjes fizike. Në këtë rast të veçantë, duket se kemi një paqartësi mes këtyre të dyjave. Simptomat që përshkruan i ati dhe domethënia e disa fjalëve greqisht në këtë pasazh nënkuptojnë epilepsinë, veçanërisht sulmet e forta të epilepsisë. Ky element fizik përkeqësohej ose nxitej nga pushtimi demoniak. Shih Temën e Veçantë; Demoniaku në Marku 1:23.

9:18 “i ngrin trupi” Ky është përshkrim i sulmeve të epilepsisë.

▣ **“Tu kërkova dishepujve të tu që ta dëbonin, por nuk e bënë dot”** Edhe vetë dishepujt u habitën. Jezusi u kishte dhënë fuqi mbi demonët në Marku 6:7, 13, por, në këtë rast, përpjekjet e tyre dështuan!

9:19 Jezusi përdor dy pyetje retorike në Marku 9:19 për të shprehur zhgënjimin për mungesën e besimit të dishepujve, turmës dhe skribëve.

9:20 “Kur e pa Jezusin, menjëherë fryma e ndyrë e bëri djalin të dridhej” Ky ishte pushtim demoniak, që shfaqej si epilepsi.

9:21 Në ungjijtë gjenden një sërë ndodhish pushtimi demoniak të fëmijëve. Si dhe pse ndodhte kjo, nuk na shprehet kurrë.

9:22 Natyra shkatërrimtare e botës demoniake shihet qartë në përshkrimin që i bën i ati jetës së djalit të tij.

▣ **“vrasë”** Shih Temën e Veçantë *Apollumi* në Marku 3:6.

▣ **“nëse”** Kjo është fjali kushtore e rendit të parë, që merret si e vërtetë nga pikëvështrimi i autorit ose për qëllimet e tij letrare. Babai po shprehet besimin në aftësinë shëruese të Jezusit.

■ **“ki mëshirë për ne dhe na ndihmo”** Ky baba kishte besim në Jezusin edhe kur dishepujt nuk arritën t’ia çlironin të birin nga demoni.

Në *Word Studies in the New Testament*, vëll. 1, f. 113, M. R. Vincent shprehet se ky baba u identifikua plotësisht me problemet e të birit, ashtu si gruaja sirofenikase me problemin e së bijës (shih Mat. 15:22).

9:23 “Nëse mundesh?” Kjo është përsëritje e pohimit të babait të djalit në Marku 9:22. Është një tjetër fjali kushtore e rendit të parë. Ky burrë pohoi aftësinë e Jezusit; tani, Jezusi ia vë besimin në sprovë.

■ **“Gjithçka është e mundur për atë që beson”** Kjo nuk është leje që njerëzimi, madje dhe ata që besojnë, të manipulojnë Perëndinë, por është premtime se Perëndia do ta kryejë vullnetin e vet nëpërmjet besimit (shih Gordon Fee, *The Disease of the Health and Wealth Gospels*). Ka dy kushte: (1) vullneti i Perëndisë dhe (2) besimi! Shih Temën e Veçantë: Lutja e efektshme te Marku 11:23.

9:24 “Besoj; ndihmoma mosbesimin tim” Kjo është urdhërore e tashme veprare. Mos harro se gjëja jetike është besimi, jo sasia e besimit (shih Mat. 17:20; Luka 17:6). Vini re se Jezusi u mor me dyshimet e këtij burri; të njëjtën gjë bën dhe me ne.

Jezusi merret me besimin e të atit, jo të djalit, sepse djali ishte pushtuar nga demoni që në fëmijëri. S’dihet nëse një nga arsytet pse dishepujt nuk e çliruan dot djalin ishte për shkak të mungesës së besimit të babait të tij në dishepujt. Jezusi përqendrohej shpesh në besimin e prindit ose miqve për të kryer shërimet dhe çlirimet nga demonët. Fjalët e këtij babai rrëfejnë nevojën e tij, ndaj ai i përgjërohet Jezusit që t’ia përforcojë besimin. Këtë lutje duhet ta bëjmë të gjithë!

Tekstus Receptus shton *kurie* (pra, formën thirrrore të fjalës “Zot”), që mund të jetë një shtesë e kopjuesve për të treguar besimin e babait duke iu drejtuar Jezusi si Zot, por kjo shtesë nuk gjendet në asnjë përkthim anglisht të Biblës përveçse në KJV dhe në NKJV.

9:25 “po mblidhej shpejt një turmë” Është e paqartë sesi lidhet kjo me dëbimin demoniak. Është e kundërta e “sekretit mesianik” që gjendet shpesh në Marku. Jezusi e shfaq fuqinë dhe autoritetin e vet në një situatë që dishepujt nuk e përballonin dot. Shtypja dhe kureshtja e turmës përbënte gjithmonë problem, por edhe mundësi ungjillizimi. Kjo mund të ketë qenë e njëjta turmë si ajo te Marku 9:14-15, ose mund të ketë qenë një grup njerëzish që sapo kishin mbërritur.

■ **“Frymë shurdhmemecë”** Me sa duket, ky ishte thjesht një tjetër aspekt i problemeve fizike të atij djalit (shih Marku 9:17), që lidhet me pushtimin demoniak.

■ **“dil prej tij dhe mos hyr më në të”** Këtu kemi një folje urdhërore aoriste veprare dhe dhe një folje lidhore aoriste veprare, që ka kuptimin “dil jashtë dhe mos fillo më kurrë të kthehesh tek ai”.

9:26 Shfaqjet fizike që shoqëruan largimin e demonit ishin të zakonshme në rastet e dëbimeve të demonëve në DHR.

■ **“djali u bë si kufomë”** Kjo ishte një tjetër simptomë e konvulsionit të fortë.

9:27 “Jezusi e mori për dore dhe e ngriti” Kjo gjë tregon preokupimin dhe dhembshurinë e Jezusit (shih Marku 1:31; 5:41). Ai nuk kishte frikë t’i prekte të sëmurët dhe të pushtuarit nga demonët!

9:28 “Pse nuk ia dolëm dot që ta dëbonim?” Ata u habitën! Më herët, ia kishin dalë të dëbonin demonët; pse jo tani? Mateu 17:20 thotë se kjo ndodhi për shkak se kishin besim të pakët.

9:29 “Ky lloj del vetëm me anë të lutjes” Shumë dorëshkrime të tjera greke shtojnë “dhe me anë të agjërimit”. Mirëpo kjo nuk gjendet në dorëshkrimet Sinaitikus ose Vatikanus, as në dorëshkrimin greqisht që përdorte Klementi. Shtesa e kësaj fraze është shumë e lashtë dhe e përhapur, ndoshta për shkak të prirjes së kishës së hershme që të huazonte nga judaizmi në këtë pikë. Përfshihet në dorëshkrimet P46, Sinaitikus (dora e dytë), A, C,

D, K, L, W, X dhe në Diatesaron. Shih Temën e Veçantë për Agjërimin në Marku 2:18-20. UBS4 i jep leximit të shkurtër vlerësimin “A” (i sigurt).

Teologjikisht, kjo ndodhi nënkupton se ka disa lloj demonësh që kërkojnë teknika të ndryshme. Shih Temën e Veçantë të Marku 1:25.

TEKSTI I NASB (I PËRDITËSUAR): MARKU 9:30-32

³⁰Prej aty, dolën dhe nisën të përshkonin Galilenë, dhe Jezusi nuk donte që ta merrte vesh njeri. ³¹Sepse po i mësonte dishepujt dhe po u thoshte: “Biri i Njeriut duhet të dorëzohet në duart e njerëzve, dhe ata do ta vrasin; dhe pasi të vritet, do të ngrihet pas tri ditësh”. ³²Por ata nuk e kuptonin këtë thënie, dhe kishin frikë ta pyesnin.

9:30 “nisën të përshkonin Galilenë” Kjo është ende skena e largimit nga mali i shpërfytyrimit dhe lëvizja në jug përmes Galileesë. Jezusi donte të fliste personalisht me sa më shumë njerëz të mundej.

■ **“nuk donte që ta merrte vesh njeri”** Ky është një tjetër aspekt i dëshirës së Jezusit që të mos njihet si shërues apo mrekullibërës, për shkak se shtypja e turmave që kërkonin ndihmë fizike ia bënte të pamundur që të jepte mësim dhe të predikonte.

9:31 “Biri i Njeriut” Shih shënimin në Marku 8:38c.

■ **“duhet të dorëzohet”** Kjo është dëftore e tashme pësore. Kjo fjalë ka kuptimin “dorëzohet tek autoritetet”. Kjo ishte hera e tretë që Jezusi ua zbulon qartë dishepujve se ç’do të ndodhë në Jerusalem (shih Marku 8:31; 9:12).

■ **“do të ngrihet”** Shih Temën e Veçantë në Marku 8:31.

■ **“tri ditësh”** Sipas llogaritjes judaike të kohës, kjo ishte rreth 30-38 orë (pra, një kohë e shkurtër të premtën para darkës, gjithë ditën e shtunë, dhe një pjesë të së dielës përpara agimit). Kjo periudhë kohore lidhet disa herë me ngjarjen e Jonës (shih Mat. 12:39-40; 16:3; Luka 11:29-32).

9:32 “nuk e kuptonin” Ky është motiv i përsëritur në ungjijtë sinoptikë. Ungjilli i Lukës e zbulon qartë këtë situatë.

1. Dishepujt nuk kuptuan (Luka 2:50; 9:45; 18:34)
2. Duhet ta kishin kuptuar pasi Jezusi ua kishte interpretuar këto fjalë (Luka 8:10)
3. Jezusi ua hapi mendjen dishepujve (Luka 24:45)

Ata ishin po aq të verbër sa turma derisa fjalët e Jezusit dhe frymëzimi i Frymës ua hapi mendjen dhe zemrën e mbyllur për të parë të vërtetën e besëlidhjes së re. Mendja e rënë njerëzore nuk kupton dot përveçse me anë të ndihmës së Frymës; madje, dhe në këtë rast ky është një proces i ngadaltë rritjeje nga shpëtimi në shenjtërim.

TEKSTI I NASB (I PËRDITËSUAR): MARKU 9:33-37

³³Erdhën në Kapernaum; dhe, kur hyri në shtëpi, nisi t’i pyeste: “Për çfarë po diskutoni rrugës?” ³⁴Por ata heshtën, sepse gjatë rrugës kishin diskutuar me njëri-tjetrin se kush ishte më i madhi. ³⁵Pasi u ul, i thirri të dymbëdhjetët dhe u tha: “Nëse dikush dëshiron të jetë i pari, do të jetë i fundit i të gjithëve dhe shërbëtori i të gjithëve”. ³⁶Pasi mori një fëmijë, e vendosi para tyre, e mori në krahë dhe u tha: ³⁷“Kushdo që e pranon një fëmijë si ky në emrin tim, më pranon mua; dhe kushdo që më pranon mua, nuk më pranon mua, por atë që ma dërgoi”.

9:33 “Kapernaum” Ky qytet, vendlindja e Pjetrit dhe Andreasë, u bë selia e Jezusit pas mosbesimit të Nazaretit.

■ **“kur hyri në shtëpi”** Kjo ishte, ndoshta, shtëpia e Pjetrit (shih Marku 1:29), ose një shtëpi me qira, që e përdorte Jezusi.

■ **“Për çfarë po diskutoni rrugës?”** Ata po debatonin, jo thjesht po diskutonin. Ai u kishte folur për vdekjen e vet (tri herë), dhe dishepujt donin të dinin se cili prej tyre do t’ia zinte vendin si udhëheqës (sih Mat. 18:1-18; Luka 9:46-48; 22:24).

9:34 “më i madhi” Kjo tregon smirën e grupeve të tjera të dishepujve jashtë rrethi të brendshëm të Pjetrit, Jakobit dhe Gjonit. Ndoshta, pasqyron konceptin e tyre si judenj për mbretërinë nacionaliste tokësore.

9:34 “Pasi u ul” Kjo tregon se një sesion mësimdhënieje (shih Marku 4:1; 9:35; Mat. 5:1; Luka 4:20)

■ **“Nëse dikush dëshiron të jetë i pari”** Kjo është fjali kushtore e rendit të parë, që merret si e vërtetë nga pikëvështrimi i autorit. Jezusi nuk e dënoi ambicien e tyre, por e përcaktoi në bazë të etikës së re të Mbretërisë së Perëndisë. Madhështia lidhet me shërbesën (shih Marku 10:31, 45; Mat. 20:26; 19:30; Gjoni 13:5), jo me kontrollin apo me pushtetin! Mbretëria e Perëndisë ndryshon së tepërmi nga shoqëritë njerëzore.

Këto fjale janë shembull i qartë i mënyrës sesi Jezusi i përsëriste mësimet e tij në kontekste të ndryshme dhe në kohë të ndryshme (shih Marku 10:43-44; Mat. 23:11; Luka 22:24-25).

■ **“shërbëtor”** Jezusi fliste aramaisht. Kjo thënie (pra, Marku 9:35-37) mund të jetë lojë fjalësh me termin aramaisht *talja*, që do të thotë, edhe “fëmijë”, edhe “shërbëtor”.

9:36 “Pasi mori një fëmijë” Mateu 18:1-18, Luka 9:46-49, dhe ky pasazh, tregojnë qartë se Jezusi po flet për besimtarët e rinj, jo për fëmijët.

■ **“e mori në krahë”** Kjo është një tjetër hollësi prej dëshmitari okular nga Pjetri. Ndoshta, kjo ishte shtëpia e Pjetrit dhe fëmija i tij!

9:37 “Kushdo që e pranon një fëmijë si ky në emrin tim” “Në emrin tim” do të thotë “në karakterin e Jezusit”. Nuk ka asgjë magjike në përsëritjen e disa fjalëve. Fuqia vjen nga njohja e Jezusit dhe nga imitimi i veprimeve të tij. Përgjigjja jonë me dashuri ndaj të tjerëve, për shkak se jemi ndjekës të Jezusit, është mënyrë për të shprehur dashurinë për të (shih Mat. 25:31-45).

Nga Veprat 19:13-16, dimë se dëbuesit judenj të demonëve e përdornin emrin e Jezusit, por me rezultate të habitshme. Nga Mat. 7:21-23 e dimë se jetike është marrëdhënia personale me Krishtin, jo thjesht përmendja e pavend apo e përsëritur e emrit të tij.

■ **“dhe kushdo që më pranon mua, nuk më pranon mua, por atë që ma dërgoi”** Në mënyrë karakteristike, Jezusi pohon pozitën e lartësuar të Atit. Kjo përmendet në mënyrë të përsëritur në ungjillin sipas Gjonit. Ky nënshtrim ndaj Atit nuk vjen për shkak të pabarazisë, por për shkak të funksioneve, brenda Trinisë.

TEMË E VEÇANTË: DËRGOJ (APOSTELLŌ) (SPECIAL TOPIC: SEND [APOSTELLŌ])

Kjo është fjale e zakonshme greqisht që do të thotë “dërgoj” (pra, *apostellō*). Ky term ka një sërë përdorimesh teologjike.

1. rabinët e përdornin në kuptimin e dikujt që thirret dhe dërgohet si përfaqësues zyrtar i një tjetri, pak a shumë si fjala jonë “ambasador” (shih 2 Kor. 5:20)
2. shpesh, ungjijtë e përdorin këtë term për dërgimin e Jezusit nga Ati. Te Gjoni, ky term merr ngjyrimë mesianike (Mat. 10:40; 15:24; Marku 9:37; Luka 9:48 dhe veçanërisht Gjoni 5:36,38; 6:29,57; 7:29; 8:42; 10:36; 11:42; 17:3, 8, 18, 21, 23, 25; 20:21). Përdoret për dërgimin e besimtarëve nga Jezusi (shih Gjoni 17:18; 20:21 [në v. 21 përmendet, si *apostellō*, ashtu dhe sinonimi i tij *pempō*).
3. DhR e përdori për dishepujt
 - a. rrethi i brendshëm fillestar i dymbëdhjetë dishepujve (p.sh., Marku 6:30; Luka 6:13; Veprat 1:2, 26)
 - b. një grup i veçantë ndihmësish dhe bashkëpunëtorësh apostolikë
 - (1) Barnaba (shih Veprat 14:4, 14)
 - (2) Androniku dhe Juniasi (KJV, Junia, shih Rom. 16:7)

- (3) Apollo (shih 1 Kor. 4:6-9)
- (4) Jakobi, vëllai i Zotit (Gal. 1:19)
- (5) Silvani dhe Timoteu (1 Thes. 2:6)
- (6) ndoshta Titi (2 Kor. 8:23)
- (7) ndoshta Epafroditi (Fil. 2:25)

- c. një dhunti e vazhdueshme në kishë (shih 1 Kor. 12:28-29; Efe. 4:11)
- 4. Pali e përdor këtë titull për vete në shumicën e letrave të tij si mënyrë për të pohuar autoritetin hyjnor të tij si përfaqësues i Krishtit (shih Rom. 1:1; 1 Kor. 1:1; 2 Kor. 1:1; Gal. 1:1; Efe. 1:1; Kol. 1:1; 1 Tim. 1:1; 2 Tim. 1:1; Titi 1:1).
- 5. Problemi me të cilin përballemi ne sot si besimtarë është se DHR për çfarë bën fjalë kjo dhunti e vazhdueshme, apo si identifikohet te besimtarët. Qartazi, duhet bërë dallimi mes të Dymbëdhjetëve të parë (#3a) dhe përdorimit të mëvonshëm të kësaj fjale (#3b). Shih Temën e Veçantë: Frymëzimi, dhe Temën e Veçantë: Përndritja. Nëse “apostujt” e sotëm nuk janë të frymëzuar që të shkruajnë Bibël shtesë (pra, kanoni është i mbyllur; Juda v. 3; shih Temën e Veçantë: Kanoni), atëherë çfarë bëjnë ata që është e ndryshme nga profetët e DHR ose ungjilltarët (shih Efe. 4:11)? Ja mundësitë e mia:
 - a. Mbjellës misionarë kishash të reja në vende të paungjillizuara (kështu përdoret në *Didake*)
 - b. Udhëheqës pastorësh në një zonë ose denominacion të caktuar
 - c. ?
 Mua më pëlqen alternativa #1.

TEKSTI I NASB (I PËRDITËSUAR): MARKU 9:38-41

³⁸Gjoni i tha: “Mësues, pamë dikë që po dëbonte demonë në emrin tënd, dhe u përpoqëm ta ndalonim sepse ai nuk po na ndjek”. ³⁹Por Jezusi i tha: “Mos e ndaloni, sepse askush që kryen një mrekulli në emrin tim nuk do të jetë në gjendje, që menjëherë pas kësaj, të flasë keq për mua. ⁴⁰Sepse ai që nuk është kundër nesh, është me ne. ⁴¹Sepse kushdo që ju jep një gotë ujë për të pirë për shkak të emrit tuaj si ndjekës të Krishtit, me të vërtetë ju them, nuk do ta humbasë shpërblimin e vet”.

9:38 “dhe u përpoqëm ta ndalonim sepse ai nuk po na ndjek” Ka disa variante në dorëshkrimet greqisht. Ky varg është i vështirë për t’u interpretuar. Kjo bëri që kopjuesit e lashtë ta ndryshonin disi. Leximi që pranohet nga shumica e versioneve të Biblës anglisht sot (sipas UBS4) gjendet në dorëshkrimet Sinaïtikus dhe Vatikanus, si dhe në traditën e përkthimit siriak.

9:39 “Mos e ndaloni” Kjo është urdhërore e tashme me pjesore mohore që, zakonisht, nënkupton ndalimin e një veprimi në kryerje e sipër.

9:40 “Sepse ai që nuk është kundër nesh, është me ne” Shpesh, Jezusi përdorte proverba kulturore në mësimet e tij (shih Marku 2:17,21,22; 3:27; 4:21,22,25; 7:15; 8:35,36,37; 9:40,50; 10:25,27,31,43-44). Krahasoje këtë me Mat. 12:30 dhe Luka 11:23.

Në librin *Hard Sayings of the Bible*, botuar nga IVP, f. 466-467, gjendet një diskutim interesant për kontradiktën (në dukje) mes Markut 9:40 dhe Luka 11:23. Ky libër është burim i dobishëm, i shkruar nga studiues të mirënjohur ungjillorë. Ata shprehën se konteksti i këtyre referencave e zgjidh kontradiktën në dukje mes tyre.

9:41 Shikoni paralelet interesante në Mat. 10:42; 25:40. Ka një kontrast të fortë mes Markut 9:38-41 dhe Marku 9:42-48. Ata që nuk janë të lidhur zyrtarisht me Jezusin përkrahen për veprat e tyre të mira, kurse ata që e njohin Jezusin paralajmërohen me metafora të forta për përgjegjësinë e tyre ndaj besimtarëve të rinj. Ky paradoks tronditës ilustron të vërtetën e Markut 9:33-37.

Po kështu, ky varg përmend shpërblimet e mbretërisë për ata që shërbejnë me besnikëri (shih Marku 9:41; 10:21, 28-31, dhe disa herë në predikimin e Jezusit në mal te Mat. 5:12, 46; 6:5-6, 16-18, 19-21). Është e vështirë ta drejtpeshosh shpëtimin falas nga puna e përfunduar e Krishtit me përgjegjësitë e besimtarëve për ta zbatuar besimin në praktikë.

Gjithashtu, është e vështirë ta drejtpeshosh konceptin e DHR për shkallët e shpërblimeve dhe ndëshkimit (shih Mat. 10:45; 11:22; 18:6; 25:21, 23; Marku 12:40; Luka 12:47-48; 20:47). Shih Temën e Veçantë në Marku 12:40.

TEKSTI I NASB (I PËRDITËSUAR): MARKU 9:42-48

⁴²“Kushdo që bën të pengohet një nga këta të vegjlit që besojnë, do të ishte më mirë për të nëse do t’i vendosej një gur i rëndë mulliri rreth qafës dhe do të hidhej në det. ⁴³Nëse dora të bën të pengohesh, prite; është më mirë për ty të hysh në jetë i gjymtuar sesa të kesh dy duar dhe të shkosh në ferr, në zjarrin e pashueshëm, ⁴⁴[ku krimbi i tyre nuk vdes, dhe zjarri nuk shuhet.] ⁴⁵Nëse këmba të bën të pengohesh, prite; është më mirë për ty të hysh në jetë i çalë sesa të kesh dy këmbë dhe të flakesh në ferr, ⁴⁶[ku krimbi i tyre nuk vdes, dhe zjarri nuk shuhet.] ⁴⁷Nëse syri të bën të pengohesh, flake tej; është më mirë të hysh në mbretërinë e Perëndisë me një sy sesa të kesh dy sy dhe të flakesh në ferr, ⁴⁸ku krimbi i tyre nuk vdes, dhe zjarri nuk shuhet”.

9:42 “Kushdo që bën të pengohet një nga këta të vegjlit” Teologjikisht, bëhet fjalë për besimtarët e rinj. Megjithatë, mund të ketë lidhje kontekstuale me mësimin që sapo u nxor nga djali i pushtuar nga demoni. Perëndia i do fëmijët dhe nuk dëshiron që t’i shfrytëzojë askush.

■ **“që besojnë”** Kjo është pjesore e tashme veprare, që thekson besimin e vazhdueshëm. Disa dorëshkrime të lashta greke shtojnë “në mua” (shih dorëshkrimet A, B, C2, L, W dhe përkthimet Vullgata, Siriake dhe Koptike). Duket se kjo është shtuar nga një kopjues në bazë të vargut paralel në Mat. 18:6 pasi këto fjalë mungojnë nga dorëshkrimet Sinaitikus dhe C. Shih Temën e Veçantë në Marku 1:15.

■ **“të pengohet”** Fjalë për fjalë, nënkupton çarkun me ushqim, që përdorej për të zënë kafshët.

■ **“nëse”** Kjo është fjali kushtore e rendit të parë. Është paralajmërim i fortë për drejtuesit e krishterë. Bariu i Madh përkujdeset për të gjitha delet, por sidomos për të rejat dhe të dobëtat; edhe drejtuesit duhet të kujdesen për ta!

Kjo është hiperbolë (shih Mat. 5:29, 30, 38-46; 6:2-4; 7:3-5; 23:23-24; 10:24-25). Jezusi po flet me gjuhë metaforike për gjykimin e përjetshëm. Këto teprime orientale i kanë pështjelluar besimtarët perëndimorë për breza të tërë. Dashuria për Biblën dhe dëshira për të ndjekur Jezusin i kanë bërë besimtarët perëndimorë të mos rrokin gjinitë letrare lindore dhe metaforat e Biblës.

■ **“gur i rëndë mulliri”** Bën fjalë për pjesën e lartë dhe të rumbullakët të një guri të stërmadh mulliri, i cili tërhiqej nga kafshët. Ky është një tjetër teprim oriental, që përdoret për të theksuar mesazhin e Jezusit.

■ **“të hidhej në det”** Kjo është dëftore e kryer pjesore, që nënkupton një gjendje të vazhdueshme. Kjo ishte metaforë e fuqishme për gjykimin. Si njerëz të shkretëtirës, judenjtë kishin frikë nga uji.

9:43-47 Kjo është gjuhë metaforike (pra, hiperbolike), por tregon përkushtimin radikal që kërkon Jezusi (shih Robert H. Stein, *The Method and Message of Jesus’ Teachings*, f. 8-11).

Këto vargje janë shembull i paralelizmit poetik dhe sinonimik hebraik, që është shumë i përhapur në DHV (shih Marku 2:21-22; 3:4,24-25,28; 4:22,30; 8:17,18; 9:43-47; 10:38,43-44; 13:24-25). Disa shembuj paralelizmi antitetik në Makru janë Marku 2:19-20; 3:18-29; 4:25; 7:8, 15; 8:35 (shih Stein, f. 27-29).

9:43 “Nëse” Kjo është fjali kushtore e rendit të tretë, që bën fjalë për një veprim të mundshëm.

■ **“të hysh në jetë”** Në DHV përdoren dy fjalë për jetën: (1) *bios* (pra, jeta tokësore) dhe (2) *zoi* (pra, jeta shpirtërore). Jezusi po flet për hyrjen në sferën shpirtërore (pra, në jetën e përjetshme). Kjo paralelizohet nga fraza “Mbretëria e Perëndisë” në Marku 9:47. Besimtarët mund të hyjnë në mbretëri tani dhe, në njëfarë kuptimi, mund ta përjetojnë qiellin tani (shih Efe. 2:5-6).

Ka disa mënyra sesi përshkruhet kjo në DHR.

1. bota e ardhshme, jeta e përjetshme (Marku 10:17, 30)
2. shpëtimi... humbja e jetës (Marku 8:35; Mat. 10:39; Luka 17:33)
3. hyrja në jetë (Marku 9:43; Mat. 25:46)
4. hyrja në gëzimin e Zotit (Mat. 25:21, 23)

■ **“ferr”** Kjo është *Gehena* (shih Jer. 7:31). Ishte vendi i adhurimit të perëndisë fenikase të zjarrit dhe pjellorisë, Molekut, në luginën e bijve të Hinomit, në jug të Jerusalemit. Kutu, fëmijët e parëlindur i flijoheshin perëndisë kananite të pjellorisë (shih Lev. 18:21; 20:2-5; LiP. 12:31; 18:10; 2 Mbre. 21:6; 2 Kro. 28:3; 33:6; Jer. 2:23; 7:32; 32:35). Judenjtë kishin kaq turp nga idhujtaria e paraardhësve të tyre sa që këtë zonë e kishin kthyer në vendin ku grumbulloheshin plehrat e Jerusalemit. Metaforat e Jezusit për ndarjen e përjetshme nga dashuria e Atit (zjarri, krimbat, era e qelbur) janë marrë pikërisht nga ky vend plehrash.

Jezusi e përdor shumë herë këtë fjalë, por ajo përdoret vetëm një herë nga një autor tjetër në DHR (Jakobi 3:6). Ferri është po aq realitet biblik sa dhe qielli (shih Mat. 25:46). Shih Temën e Veçantë më poshtë, II., B.

TEMË E VEÇANTË: KU JANË TË VDEKURIT? (SPECIAL TOPIC: WHERE ARE THE DEAD?)

I. Dhiata e Vjetër

- A. Të gjithë njerëzit shkojnë në *Sheol* (etimologjia e paqartë, BDB 1066), që nënkupton vdekjen ose varrin, kryesisht në letërsinë e urtësisë dhe në librin e Isaisë. Në DhV, kjo ishte një ekzistencë e errët, e vetëdijshme, por pa gëzim (shih Jobi 10:21-22; 38:17).
- B. Karakteri i *Sheolit*
 1. shoqërohet me gjykimin (zjarrin) e Perëndisë, LiP. 32:22
 2. burg me porta (Jobi 38:17; Psa. 9:13; 107:18)
 3. tokë pa kthim (Jobi 7:9; titull akadian për vdekjen)
 4. tokë/sferë e errët (Jobi 10:21-22; 17:13; 18:18)
 5. vend heshtjeje (Psa. 28:1; 31:17; 94:17; 115:17; Isa. 47:5)
 6. shoqërohet me ndëshkimin edhe përpara Ditës së Gjykimit, Psa. 18:4-5
 7. shoqërohet me *abaddon*-in (shkatërrimin), ku është i pranishëm dhe Perëndia, Jobi 26:6; Psa. 139:8; Amosi 9:2
 8. shoqërohet me “Gropën” (varrin), Psa. 16:10; 88:3-4; Isa. 14:15; Ezek. 31:15-17
 9. të ligjtë zbresin të gjallë në *Sheol*, Num. 16:30, 33; Jobi 7:9; Psa. 55:15
 10. shpesh, personifikohet si kafshë me gojë të madhe, Num. 16:30; Fja. 1:12; Isa. 5:14; Hab. 2:5
 11. njerëzit aty thirren *Refa'im* (pra, shpirtrat e të vdekurve), Jobi 26:5; Fja. 2:18; 21:16; 26:14; Isa. 14:9-11
 12. megjithatë, JHVH është i pranishëm edhe aty (Jobi 26:6; Psa. 139:8; Fja. 15:11)

II. Dhiata e Re

- A. Fjala hebraisht *Sheol* përkthehet në greqisht si *Hades* (bota e padukshme)
- B. Karakterizimi i *Hadesit*
 1. i referohet vdekjes, Mat. 16:18
 2. lidhet me vdekjen, Zbu. 1:18; 6:8; 20:13-14
 3. shpesh nënkupton vendin e ndëshkimit të përhershëm (*Gehenna*), Mat. 11:23 (citim i DhV); Luka 10:15; 16:23-24
 4. shpesh nënkupton varrin, Luka 16:23
- C. Ndoshta i ndarë (rabinët)
 1. pjesa e të drejtëve quhet parajsë (në fakt, ky është një tjetër emër i qiellit, shih 2 Kor. 12:4; Zbu. 2:7), Luka 23:43
 2. pjesa e të ligjve quhet *Tartar*, 2 Pjetrit 2:4, ku është vendi që mbahen engjëjt e ligj (shih Zan. 6; 1 Enokut). Shoqërohet me “Humnerën”, Luka 8:31; Rom. 10:7; Zbu. 9:1-2, 11; 11:7; 17:18; 20:1, 3
- D. *Gehenna*
 1. Reflekton frazën e DhV, “lugina e bijve të Hinomit” (në jug të Jerusalemit). Ishte vendi ku perëndia fenikas i zjarrit, *Moleku* (BDB 574), adhurohej me flijime foshnjash (shih 2

- Mbret. 16:3; 21:6; 2 Kro. 28:3; 33:6), gjë që ndalohej nga Lev. 18:21; 20:2-5.
2. Jeremia e ndryshoi, nga vend adhurimi pagan, në një vend të ndëshkimit të JHVH-së (shih Jer. 7:32; 19:6-7). Kështu, ky u bë vendi i gjykimit të flaktë e të përjetshëm në 1 Enokut 90:26-27 dhe Sib. 1:103.
 3. Judenjtë e kohës së Jezusit ndienin kaq shumë neveri prej pjesëmarrjes së paraardhësve të tyre në adhurimin pagan me flijime foshnjash, saqë këtë zonë e shndërruan në vendgrumbullimi plehrash për Jerusalem. Shumë prej metaforave të Jezusit për gjykimin e përjetshëm vinin nga ky vendgrumbullim (zjarri, tymi, krimbat, era e qelbur, shih Marku 9:44, 46). Fjala *Gehenna* përdoret vetëm nga Jezusi (përveçse te Jakobi 3:6).
 4. Përdorimi i *Gehenna*-s nga Jezusi
 - a. zjarr, Mat. 5:22; 18:9; Marku 9:43
 - b. i përhershëm, Marku 9:48 (Mat. 25:46)
 - c. vend shkatërrimi (i trupit dhe shpirtit), Mat. 10:28
 - d. paralel me *Sheolin*, Mat. 5:29-30; 18:9
 - e. karakterizon të ligjtë si “bij të ferrit”, Mat. 23:15
 - f. rezultat i dënimit të gjyqit hyjnor, Mat. 23:33; Luka 12:5
 - g. koncepti i *Gehenna*-s është paralel me vdekjen e dytë (shih Zbu. 2:11; 20:6, 14), ose me liqenin e zjarrtë (shih Mat. 13:42, 50; Zbu. 19:20; 20:10, 14-15; 21:8). Ka gjasa që liqeni i zjarrtë të bëhet vendbanimi i përhershëm i njerëzve (nga *Sheoli*) dhe i engjëjve të ligj (nga *Tartari*, 2 Pjet. 2:4; Juda v. 6, ose humnera, shih Luka 8:31; Zbu. 9:1-11; 20:1, 3).
 - h. nuk u krijua për njerëzit, por për Satanin dhe për engjëjt e tij, Mat. 25:41
 - E. Ka gjasa që, për shkak të mbivendosjes së *Sheolit* me *Hadesin* dhe *Gehenna*-n,
 1. në fillim, të gjithë njerëzit shkonin në *Sheol/Hades*
 2. përvoja e tyre atje (e mirë/e keqe) përkeqësohet pas Ditës së Gjykimit, por vendi i të ligjve mbetet i njëjtë (ja pse KJV e përktheu fjalën *hades* (varr) si *gehanna* (ferr))
 3. I vetmi pasazh në DhR që përmend torturën përpara Gjykimit është shëmbëlltyra e Lukës 16:19-31 (Lazari dhe i Pasuri). *Sheoli* përshkruhet edhe si vend ndëshkimi tani (shih LiP. 32:22; Psa. 18:1-5). Megjithatë, s’mund të krijojmë një doktrinë në bazë të një shëmbëlltyre.

III. Gjendja e ndërmjetme midis vdekjes dhe ringjalljes

- A. DhR nuk mëson “pavdekshmërinë e shpirtit”, që është një prej disa pikëpamjeve të lashta për jetën pas vdekjes.
 1. shpirti njerëzor ekziston përpara jetës së vet fizike
 2. shpirti njerëzor është i përjetshëm përpara dhe pas vdekjes fizike
 3. shpesh, trupi fizik shihet si burg, ndërsa vdekja si çlirim për t’u kthyer në gjendjen paraekzistuese
- B. DhR aludon për një gjendje të patrupëzuar midis vdekjes dhe ringjalljes
 1. Jezusi flet për ndarjen e shpirtit dhe trupit, Mat. 10:28
 2. Abrahami mund të ketë një trup tani, Marku 12:26-27; Luka 16:23
 3. Moisiu dhe Elija kanë një trup fizik në çastin e shndërrimit në mal, Matu 17
 4. Pali pohon se, në Ardhjen e Dytë, shpirtat me Krishtin do të marrin të parët trupa të rinj, 1 Thes. 4:13-18
 5. Pali pohon se besimtarët do të marrin trupa të rinj shpirtërorë në Ditën e Ringjalljes, 1 Kor. 15:23, 52
 6. Pali pohon se besimtarët nuk shkojnë në *Hades*, por, pas vdekjes, janë me Jezusin, 2 Kor. 5:6, 8; Fil. 1:23. Jezusi mposhti vdekjen dhe i mori të drejtët në qiell me të (1 Pjet. 3:18-22).

IV. Qielli

- A. Kjo fjalë përdoret në tre kuptime në Bibël.
 1. atmosfera mbi tokë, Zan. 1:1, 8; Isa. 42:5; 45:18
 2. qiejt me yje, Zan. 1:14; LiP. 10:14; Psa. 148:4; Heb. 4:14; 7:26

3. vendi i fronit të Perëndisë, LiP. 10:14; 1 Mbret. 8:27; Psa. 148:4; Efe. 4:10; Heb. 9:24 (qielli i tretë, 2 Kor. 12:2)

B. Bibla nuk na zbulon shumë gjëra për jetën pas vdekjes, ndoshta për shkak se njerëzit e rënë nuk kanë kapacitetin që të kuptojnë (shih 1 Kor. 2:9).

C. Qielli është edhe vend (shih Gjoni 14:2-3), edhe person (shih 2 Kor. 5:6-8). Qielli mund të jetë Kopshti i ripërtërirë i Edenit (Zanafilla 1-2; Zbulesa 21-22). Toka do të pastrohet dhe rimëkëmbët (shih Veprat 3:21; Rom. 8:21; 2 Pjet. 3:10). Shëmbëllimi i Perëndisë (Zan. 1:26-27) ripërtërihet në Krishtin. Tani, bashkësia e ngushtë e Kopshtit të Edenit bëhet sërish e mundshme.

Gjithsesi, kjo mund të jetë metaforike (qielli si qytet i stërmadh në formë kubi, i Zbu. 21:9-27), dhe jo e fjalëpërfjalshme. 1 Korintasve 15 përshkruan dallimin mes trupit fizik dhe trupit shpirtëror si dallimi mes farës dhe bimës së rritur. Sërish, 1 Kor. 2:9 (citim i Isa. 64:4 dhe 65:17) është një shpresë dhe premtim madhështor! Unë e di se, kur të shohim atë, do të jemi si ai (shih 1 Gjonit 3:2).

V. Burime të dobishme

A. William Hendriksen, *The Bible on the Life Hereafter* [Bibla për jetën pas vdekjes]

B. Maurice Rawlings, *Beyond Death's Door* [Përtej derës së vdekjes]

9:44, 46 Vargjet 44 dhe 46 janë njësoj si Marku 9:48. Asnjëra prej të dyjave nuk gjendet në dorëshkrimet e lashta uncialle greke (Sinaitikus, B, C, L, ose W). Duket se një kopjues i lashtë i mori këto fjalë nga Marku 9:48 dhe i futi në Marku 9:44 dhe 46.

9:48 “ku krimbi i tyre nuk vdes, dhe zjarri nuk shuhet” Ky është citim nga Isa. 66:24. Judenjtë ishin kaq të tronditur nga fakti që paraardhësit e tyre digjnin fëmijët (2 Mbre. 21:6) saqë këtë vend e kthyen në grumbullimin e plehrave të Jerusalemit. Pikërisht nga ky vend e merr Jezusi gjuhën e vet metaforike për ndarjen e përjetshme nga Perëndia: Ferri. E njëjta fjalë, “e përjetshme”, që përdoret për qiellin në Mat. 25:46, përdoret në të njëjtin varg edhe për gjykimin.

TEKSTI I NASB (I PËRDITËSUAR): MARKU 9:49-50

⁴⁹“Sepse çdokush do të kripet me zjarr. ⁵⁰Kripa është e mirë; por nëse kripa e humbet shijen, me çfarë mund ta bësh prapë të kripur? Kini kripë në vetvete, dhe jini në paqe me njëri-tjetrin”.

9:49 “kripet me zjarr” Kripa ishte mjet shërimi, pastrimi dhe konservimi. Përdorej edhe për të vulosur besëlidhjet (shih Num. 18:19). Ishte përbërës tejet i rëndësishëm për jetën e popujve të shkretëtirës. Fjalët “zjarr” dhe “kripë” janë sinonimike në këtë kontekst dhe përdoren për pastrimin. Vargu 49 ka shumë variante në dorëshkrime. Ndoshta, kjo vjen për shkak të pasigurisë se (1) si lidhet ky varg me Markun 9:49, ose (2) ç’kuptim kishte vetë ky varg. Ndoshta, një kopjues dalloi këtu aludimin për Lev. 2:13 dhe e futi në cep të tekstit. Shpesh, Jezusi e përdori kripën si analogji për të komunikuar disa të vërteta shpirtërore (shih Mat. 5:13; Luka 14:34-35).

9:50 Ky vargu, ashtu si Marku 9:49, duket se është disi i palidhur me kontekstin e mëparshëm. Ashtu si Marku 9:49 u përfshi për shkak të fjalës “zjarr”, edhe ky vargu u shtua për shkak të termit “kripë”. Ndoshta, ka parasysh Markun 9:35. Mënyra si jetojnë të krishterët ka rëndësi!

PYETJE PËR DISKUTIM

Ky është një komentari studimor udhëzues, që do të thotë se ti je vetë përgjegjës për interpretimin e Biblës. Secili prej nesh duhet të ecë sipas dritës që ka. Ti, Bibla dhe Fryma e Shenjtë keni përparësi në interpretim. Nuk duhet t’ia dorëzosh këtë të drejtë komentuesit.

Këto pyetje për diskutim t’i kam dhënë për të të ndihmuar që të analizosh çështjet kryesore të kësaj pjese të librit. Ato synojnë të të nxisin mendimin, jo të kenë natyrë shteruese.

1. Pse u “shpërfytyrua” Jezusi?
2. Si lidhet kjo ngjarjet me DHV?
3. Pse ishin të pështjelluar dishepujt për Elijan?
4. Pse nuk e kuptonin dishepujt vdekjen dhe ringjalljen e Jezusit?
5. A është e gabuar që i krishteri të jetë ambicioz? Si e përcaktoi Jezusi madhësinë?
6. A po flet për fëmijët Jezusi në Marku 9:35-37, 42, apo po i përdor si shembull për të rriturit?
7. A ka shkallë të ndryshme gjykimi?
8. A duhet marrë në mënyrë të fjalëpërfjalshme Marku 9:43-47?
9. Çfarë simbolizon kripa?

MARKU 10

NDARJET NË PARAGRAFË TË PËRKTHIMEVE MODERNE

UBS ⁴	NKJV	NRSV	TEV	NJB
Mësimi për divorcin 10:1-12	Martesa dhe divorci 10:1-12	Për martesën dhe divorcin 10:1 10:2-9 10:10-12	Jezusi mëson për divorcin 10:1 10:2 10:3 10:4 10:5-9 10:10-12	Pyetja për divorcin 10:1-12
Bekimi i fëmijëve të vegjël 10:13-16	Jezusi bekon fëmijët e vegjël 10:13-16	Bekimi i fëmijëve 10:13-16	Jezusi bekon fëmijët e vegjël 10:13-16	Jezusi dhe fëmijët 10:13-16
I pasuri 10:17-22	Jezusi këshillon të riun e pasur 10:17-22	I pasuri 10:17-22	I pasuri 10:17 10:18-19 10:20 10:21-22	I riu i pasur 10:17-22 Rreziku i pasurive
10:23-31	Gjithçka është e mundur për Perëndinë 10:23-31	10:23-27 10:28-31	10:23 10:24-25 10:26 10:27 10:28 10:29-31	10:23-27 Shpërblimi i mohimit 10:28-31
Jezusi parathotë për herë të tretë vdekjen dhe ringjalljen e vet 10:32-34	Jezusi parathotë për herë të tretë vdekjen dhe ringjalljen e vet 10:32-34	Mundimi profetizohet për herë të tretë 10:32-34	Jezusi flet për herë të tretë për vdekjen e vet 10:32-34	Profecia e tretë e Mundimit 10:32-34
Kërkesa e Jakobit dhe Gjonit 10:35-45	Më i madhi shërben 10:35-45	Jakobi dhe Gjoni kërkojnë nderim 10:35-40 10:41-45	Kërkesa e Jakobit dhe Gjonit 10:35 10:36 10:37 10:38 10:39-40 10:41-45	Bijtë e Zebedeut bëjnë një kërkesë 10:35-40 Udhëheqja me shërbesë 10:41-45
Shërimi i Bartimeut të verbër 10:46-52	Jezusi shëron Bartimeun e verbër 10:46-52	Bartimeu i verbër 10:46-52	Jezusi shëron Bartimeun e verbër 10:46-47 10:48 10:49	I verbri i Jerikos 10:46-52

10:50
10:51a
10:51b
10:52

CIKLI TRE I LEXIMIT (shih f. v)

NDJEKJA E SYNIMIT TË AUTORIT FILLESTAR NË NIVELIN E PARAGRAFËVE

Ky është një komentuar studimor udhëzues, që do të thotë se ti je vetë përgjegjës për interpretimin e Biblës. Secili prej nesh duhet të ecë sipas dritës që ka. Ti, Bibla dhe Fryma e Shenjtë keni përparësi në interpretim. Nuk duhet t'ia dorëzosh këtë të drejtë komentuesit.

Lexo gjithë kapitullin njëherësh. Identifiko temat. Krahaso ndarjet e tua tematike me pesë përkthimet moderne. Ndarja në paragrafë nuk është e frymëzuar, por është çelësi për të ndjekur synimin e autorit fillestar, gjë që është thelbi i interpretimit. Secili paragraf ka vetëm një temë të vetme.

1. Paragrafi i parë
2. Paragrafi i dytë
3. Paragrafi i tretë
4. Etj.

PASAZHET PARALELE NË UNGJIJTË SINOPTIKË

- A. Divorci, Marku 10:2-12 (paralel me Mateun 19:1-12)
- B. Bekimi i fëmijëve, Marku 10:13-16 (paralel me Mateun 19:13-15; Luka 18:15-17)
- C. I riu pasanik, Marku 10:17-31 (paralel me Mateun 19:16-20:16; Luka 18:18-30)
- D. Profetizimi i kryqëzimit, Marku 10:32-34 (paralel me Mateun 20:17-20; Luka 18:31-34)
- E. Bijtë e Zebedeut, Marku 10:35-45 (paralel me Mateun 20:21-28)
- F. Bartimeu i verbër, Marku 10:46-52 (paralel me Mateun 20:29-34; Luka 18:35-43)

STUDIMI I FJALËVE DHE FRAZAVE

TEKSTI I NASB (I PËRDITËSUAR): MARKU 10:1

¹Si u ngrit, Jezusi shkoi prej andej në rajonin e Judesë dhe përtej Jordanit; turmat u mblohdën sërish rreth tij dhe, siç e kishte zakon, filloi sërish t'i mësonte.

10:1 “shkoi prej andej në rajonin e Judesë dhe përtej Jordanit” RSV dhe ASV e përkthejnë kështu: “erdhi në territoret e Judesë dhe përtej-Jordanit”. Konteksti nënkupton se Jezusi ishte në rrugëtimin e fundit drejt Jerusalemit. Me sa duket, shkoi në veri përmes Samarisë, kaloi në Galile dhe iu bashkua turmave të shtegtarëve që udhëtonin drejt Jerusalemit. Shumica e judenjve nuk pranonin të kalonin përmes Samarisë në rrugën për në Jerusalem, kështu që kalonin në anën lindore të Jordanit (pra, përmes Peresë) dhe, pastaj, futeshin sërish në anën perëndimore në Jeriko. Nëse ka ndodhur kështu, kjo shpjegon pse ky varg na duket i vështirë (shih A. T. Robertson, *Word Pictures in the New Testament*, vëll. 1, f. 348, thotë se mbi një e treta e ungjillit të Lukës ndodh mes Markut 9 dhe 10 [pra, 9:57-18:14]; si dhe Mat. 18 dhe Gjoni 7-11).

■ **“turmat u mblohdën sërish rreth tij”** Ndoshta, bëhet fjalë për (1) shtegtarët në rrugën për në Jerusalem për festën, ose (2) të sëmuret, kureshtarët, krerët e judenjve dhe dishepujt. Jezusi i tërhiqte gjithmonë turmat.

■ **“siç e kishte zakon”** Sa herë që Jezusi i jepej mundësia të jepte mësim, e bënte (shih Marku 1:21; 2:13; 4:2; 6:2, 6, 34; 12:35; 14:49). Përmbajtja e mesazhit të tij ishte:

1. Pendohuni dhe besoni (si mesazhi i Gjon Pagëzorit)
2. Në Mbretërinë e Perëndisë hyhet me besim në Jezusin
3. Mbretëria e Perëndisë ta ndryshon rrënjësisht mënyrën si mendon dhe jeton.

TEKSTI I NASB (I PËRDITËSUAR): MARKU 10:2-9

²Disa farisenj erdhën te Jezusi për ta vënë në provë dhe nisën ta pyesnin nëse është e ligjshme që burri ta ndajë gruan. ³Dhe ai u përgjigj dhe u tha: “Çfarë ju urdhëroi Moisiu?” ⁴Ata i thanë: “Moisiu e lejoi burrin që të shkruante një letër divorci dhe e ndante gruan”. ⁵Por Jezusi u tha: “Për shkak të ngurtësisë së zemrës suaj e dha ai këtë urdhër. ⁶Por, që nga fillimi i krijimit, Perëndia i bëri mashkull dhe femër. ⁷Për këtë arsye, burri do ta lërë atin dhe nënën, ⁸dhe do të bëhen të dy një mish; kështu, ata nuk janë më dy, por një mish. ⁹Prandaj, ata që e ka bashkuar Perëndia, asnjë njeri të mos e ndajë”.

10:2 “farisenj” Shih Temën e Veçantë: Farisenjtë, në Marku 2:16.

■ **“për ta vënë në provë”** Fjala *peirazo* ka ngjyrimin kuptimor “sprovuj me qëllim që ta shkatërroj dikë” (shih Marku 8:11; 10:2; 12:15; Tema e Veçantë për fjalët “sprovuj” në Marku 1:13). Kjo pyetje synonte që (1) ta përçante popullin dhe rabinët në lidhje me mendimet e dy shkollave rabinik të Shamait (konservatore) dhe Hilelit (liberale), ose (2) të nxiste zemërimin e Herod Antipës.

■ **“nëse është e ligjshme që burri ta ndajë gruan”** Vini re se pyetja e farisenjve vlen për divorcin, jo për rimartesën. Po kështu, vini re se Jezusi po i përgjigjet një pyetjeje të veçantë. Nuk po diskuton për këtë temë në një kontekst neutral. Këta farisenj po përpiqen ta shtien në kurth në mënyrë që ai të armiqësohet me (1) ndjekësit e Hilelit, që kishin qëndrim liberal kundrejt divorcit. Mateu 19:3 e zgjeron këtë pyetje duke përfshirë arsyen e divorcit, ose (2) me Herod Antipën, i cili ishte divorcuar (shih Marku 6:17-20).

Fjala “e ligjshme” mund të bëjë fjalë për ligjin e Moisiut ose për traditat rabinike (pra, për Talmudin). Si përgjigje, Jezusi u citon një pasazh nga Ligji i Përtërirë.

10:4 “të shkruante një letër divorci” Ky citim vjen nga LiP. 24:1-4. Moisiu nisi një procedurë ligjore për ta mbrojtur gruan (shih Eks. 21:1-11). Kjo procedurë ligjore kishte disa kërkesa.

1. kërkonte një periudhë kohore
2. duhet ta shkruante një prift, ose një levit
3. mund të kërkonte kthimin e pajës

Shpresa ishte që këto procedura t’i jepnin çiftit mundësinë e pajtimit.

Po kështu, duhet thënë se LiP. 24 nënkuptonte të drejtën e rimartesës, si për burrin, ashtu dhe për gruan. Mirëpo, ky pasazh i Ligjit të Përtërirë, në kontekstin e vet, nuk trajtonte çështjen kulturore të divorcit, por më tepër (1) siguronte virgjërinë dhe besnikërinë e nuses dhe (2) rendiste procedurat dhe caqet e qarta për rimartesën.

Problemi i vërtetë kishte të bënte me interpretimin liberal të këtij pasazhi nga shkolla rabinike e Hilelit (p.sh., *The Christ of the Gospels*, nga J. W. Shepherd, f. 451-457). Kjo shkollë përqendrohej te fjala “diçka e turpshme” dhe ia zgjeronte gamën kohore dhe kuptimore. Farisenjtë po e citonin Moisiun vetëm për ta shtënë Jezusin në kurth. Nuk po kërkonin njohuri.

Jezusi ripohoi qëllimin e Perëndisë: martesë mes një burri dhe një gruaje përjetë. Gjithçka tjetër nuk është ideale. Problemi është sesi t’i drejtpeshojmë fjalët e Jezusit në këtë kontekst me fjalët e tij për faljen në kontekste të tjera. Standardi për ndjekësit e Mbretërisë është i lartë, por, po kaq i lartë është dhe hiri i Perëndisë! Në këtë epikë, qasja “rast pas rasti” është më mirë sesa rregullat e ngurta ligjore.

Në DHV, JHVH e përdorte divorcin për të përshkruar veprimet e tij ndaj Izraelit për shkak të idhujtarisë së tyre (shih Isa. 50:1; Jer. 3:1-8; Os. 2:2). Ka shembuj në DHV ku divorci është i detyrueshëm (shih Zan. 21:8-14; Eks. 21:10-11; LiP. 21:10-14; Ezra 9-10). Revista shkencore *Journal of the Evangelical Theological Society*, vëll. 40#4, ka një artikull të shkëlqyer dhe mendimnxitës me titull “Old Testament Perspectives on Divorce and Remarriage” [“Pikëvështrime të Dhiatës së Vjetër për divorcin dhe rimartesën”], nga Joe M. Sprinkle.

10:5 “Për shkak të ngurtësisë së zemrës suaj” Jezusi i përshkruan izraelitët si “zemërgurtë” (shih Ezek. 2:4; 3:7). Fjala “qafëfortë” është metaforë sinonimike (shih Eks. 32:9; 33:3, 5, 9; LiP. 9:6, 13). Ata donin gjithmonë t’i

bënin gjërat sipas dëshirës së tyre. Kjo është gjithmonë prirja e njerëzimit të rënë! Ky qëndrim ishte i pranishëm dhe në dishepujt e Jezusit (shih Marku 3:5; dhe 6:52).

Tema e divorcit është shembull i qartë i problemit të përdorimit të pasazheve biblike si provë për doktrinën tonë. Duhet ta lejojmë gjithë Biblën që të flasë për çdo temë. Ky nuk është i vetmi pasazh biblik për divorcin dhe rimartesën.

Kjo thënie e Jezusit më shqetëson. Nga ta dija unë se LiP. 24:1-4 nuk ishte fjala e fundit e JHVH-së për këtë temë? Ajo gjendet në Bibël. Nëse Jezusin nuk do ta kishin pyetur për këtë çështje, ndoshta, s'do ta kishte ditur kurrë se ky pasazh kishte vlerë të kufizuar. Problemi është ky: sa pasazhe të tjera në DHV janë dhënë për shkak të “ngurtësisë së zemrës” dhe sa prej tyre janë vullneti i Perëndisë për njerëzimin? I vetmi ngushëllim vjen nga qasja vërtet sistematike ndaj temave teologjike, duke patur parasysh të dyja dhiatat dhe situatat historike (psh., Marku 7:14-16, 17-23). Të krishterët ungjillorë sot nxitohen kur “provojnë” disa të vërteta absolute në bazë të pasazheve të izoluara dhe të veçuara biblike.

Teologjikisht, refuzimi që i bëri Jezusi Moisiut është i habitshëm. Me këtë mënyrë të fuqishme, ai theksoi autoritetin e vet. Këta dishepuj judenj duhet të jenë shtangur që Jezusi e dinte pse Moisiu bëri diçka, dhe që Jezusi kishte fuqinë dhe autoritetin nga JHVH-ja që ta anulonte. Kjo pjesë e Markut është teologjikisht paralele e Mat. 5:17-48.

10:6 “nga fillimi i krijimit” Shih Temën e Veçantë: *Ktisis*, më poshtë.

TEMË E VEÇANTË: *KTISIS*

Kjo fjalë, *ktisis*, përdoret në një larmi kuptimesh në DHR. Leksiku i Louw dhe Nida rendit mundësitë e mëposhtme:

1. krijimi (vepra e krijimit, shih Marku 13:19; Rom. 1:20-22; Efe. 3:9)
2. krijesa (ajo që krijohet e gjallë, shih Marku 10:6; Rom. 1:25; 8:39; Kol. 1:15;23)
3. universi (gjithçka që u krijua, shih Marku 13:19; Rom. 8:20; Heb. 9:11)
4. institucioni (shih 1 Pje. 2:13 [#42.39])
5. autoriteti (shih 1 Pje. 2:13, [#37.47])

Edhe Pali e personifikon krijimin në Rom. 8:18-25. Ai e karakterizon krijimin e ri të Perëndisë si epokë të re, epoka e Fryma në 2 Kor 5:17 dhe Gal. 6:15. Besimtarët duhet të jetojnë si qytetarë të epokës së re (shih Rom. 6:4).

■ **“Perëndia i bëri mashkull dhe femër”** Martesa ishte në planin origjinal të Perëndisë për krijimin (shih Zan. 1:27). Seksi ishte/është dhuratë nga Perëndia për të përbushur synimin e tij për mbushjen e tokës (shih Zan. 1:28).

10:7 “burri do ta lërë atin dhe nënë” Ky është një tjetër citim nga Zanafilla (shih Marku 2:24). Tregon statusin e lartë të martesës, madje dhe mbi autoritetin prindëror. Ndoshte një ndarje e nevojshme mendore nga prindërit, edhe sikur kjo të mos ndodhte në mënyrë fizike (pra, disa breza jetonin së bashku).

10:8 “dhe do të bëhen të dy një mish” Edhe ky citim vjen nga Zan. 2:24. Në martesë, të dy bëhen një: fizikisht, emocionalisht, dhe në çdo mënyrë tjetër. Kjo tregon vazhdimësinë e martesës në planin e Perëndisë. Mosiu jetoi shumë vite larg ngjarjeve të regjistruara në Zanafillë. Në pjesën e krijimit të Zanafillës, ai e zhvendos çështjen e mevonshme të përparësisë së martesës duke e lexuar në kontekstin e çiftit të parë.

10:9 “që e ka bashkuar Perëndia” Fjalë për fjalë, “ka futur nën të njëjtën zgjedhë”. Divorci është një nga mënyrat sesi njerëzimi i rënë ndan atë që Perëndia ka caktuar si normë shoqërore (pra, martesa është shtyllë për një shoqëri të qëndrueshme, LiP. 5:16, 33; 4:40; 32:47, “që ditët e tua të zgjaten dhe të të ecë mbarë në tokën që po të jep Zoti, Perëndia yt). Ky është një shembull i qartë sesi bestimtarët i besëlidhjes preferon vullnetin e vet në dallim nga vullneti i Perëndisë.

■ **“asnjë njeri të mos e ndajë”** Kjo është urdhërore e tashme veprare me pjesëz mohore, që zakonisht nënkupton ndalimin e një veprimi në kryerje e sipër. Për një diskutim të dobishëm për martesën, familjen dhe divorcin, shih Frank Staff, *New Testament Theology*, f. 296-302.

TEKSTI I NASB (I PËRDITËSUAR): MARKU 10:10-12

¹⁰Në shtëpi, dishepujt filluan ta pyesnin sërish për këtë. ¹¹Dhe ai u tha: “Kushdo që e ndan gruan dhe martohet me grua tjetër, kryen kurorëshkelje ndaj saj; ¹²dhe, nëse ajo vetë ndahet nga i shoqi dhe martohet me burrë tjetër, kryen kurorëshkelje”.

10:10 “dishepujt filluan ta pyesnin sërish për këtë” Mateu 19:10 përmend habinë e dishepujve. Ata ishin kureshtarë për ato që kishin mësuar gjithnjë për divorcin dhe rimartesën. Kjo frazë tregon modelin e mësimit publik të Jezusit dhe interpretimin më vete. Ky model tregon sesa e lehtë ishte që të keqkuptoheshin fjalët e Jezusit. Këto sesione private ishin një mundësi që Jezusi të edukonte të Dymbëdhjetët për ta kuptuar qartë pikëvështrimin e ri dhe rrënjësor të Mbretërisë së Perëndisë. Jezusi e fokusoi autoritetin absolut te vetja, jo te DHV (shih Mat. 5:17-19), ndonëse ai e nderonte dhe, zakonisht, e miratonte DHV.

10:11-12 “kryen kurorëshkelje... kryen kurorëshkelje” Të dyja janë folje të tashme dëftore. Forma (morfologjia) e fjalës “kurorëshkelje” në greqishten *koine* mund të jetë mesore, ose pësore. Mateu 5:32, që trajton të njëjtën temë, përmban një folje paskajore aoriste pësore. Kjo nënkupton se të gjitha format janë pësore. Nëse kjo është e vërtetë, atëherë kurorëshkelje nuk ishte divori dhe rimartesa, por veprimi ligjor i ndarjes së gruas, që nga ana kulturore e stigmatizonte atë si kurorëshkelëse. Fjalë për fjalë, “asaj i shkaktohet të kryejë kurorëshkelje”. Ky nuk është ndalim total biblik i rimartesës, por ka lidhje me një aspekt teologjik të interpretimi judaik (pra, Hileli kundër Shamait).

Megjithatë, shkrirja e besëlidhjes martesore mes besimtarëve (pra, ata që betohen në emër të Krishtit se do të qëndrojnë të martuar) nuk ishte, dhe kurë nuk është idealja e Perëndisë. Besimtarët janë përgjegjës për një standard më të lartë mbretërie. Divorci është, shpesh, e keqja më e vogël; nuk është mëkati i pafalshëm! Shih shënimin e plotë në Marku 10:4.

10:12 “nëse ajo vetë ndahet nga i shoqi dhe martohet me burrë tjetër, kryen kurorëshkelje” Ky përkthim ndjek tekstin e dorëshkrimeve aleksandriane greke. Teksti “përdimor” lexon “nëse ajo ndahet nga i shoqi, por nuk divorcohet dhe martohet me dikë tjetër, kryen kurorëshkelje”. Pasazhi paralel te Mat. 19:1-12 nuk e përmend këtë varg, ndoshta për shkak se Mateu, që u shkruan judenjve, s’kishte nevojë ta përfshinte. Në judaizëm, gratë nuk kishin të drejtën që ta ndanin burrin. Marku, që u shkruan johebrenjve, e përmend këtë rast për të treguar aspektin universal të mësimit të Jezusit. Kjo përqendrohet në barazinë ligjore mes burit dhe gruas, që reflektohet në ligjin romak. Kjo është një tjetër provë se Marku u shkrua për romakët. Jezusi është pro familjes (shih Marku 10:13-16)!

▣ “nëse” Kjo është fjali kushtore e rendit të tretë, që nënkupton veprim të mundshëm.

TEKSTI I NASB (I PËRDITËSUAR): MARKU 10:13-16

¹³Dhe po i sillnin fëmijë që ai t’i prekte; por dishepujt i qortuan. ¹⁴Por, kur Jezusi e pa këtë, u zemërua dhe u tha: “Lërin fëmijët të vijnë tek unë; mos i pengoni; sepse mbretëria e Perëndisë u përket të tillëve. ¹⁵Me të vërtetë ju them: kushdo që nuk e pranon mbretërinë e Perëndisë si fëmijë nuk do të hyjë aspak në të. ¹⁶Dhe i mori në krahë dhe nisi t’i bekonte, duke vendosur duart mbi ta.

10:13 “po i sillnin” Kjo është në kohën e pakryer. Prindërit i sillnin vazhdimisht fëmijët te Jezusi që t’i bekonte në mënyrën tradicionale rabinike. Kjo s’kishte të bënte aspak me shpëtimin e këtyre fëmijëve. Ata konsideroheshin tashmë pjesë e Izraelit me anë të rrethprerjes dhe po prisnin kalimin në moshën e pjekurisë së besëlidhjes, që ishte 12 vjeç për vajzat dhe 13 vjeç për djemtë.

▣ “fëmijë” Luka 18:15 thotë “foshnja”. Në qarqet judaike, vajzat nën 12 dhe djemtë nën 13 vjeç konsideroheshin fëmijë.

▣ “prekte” Mateu 19:13 thotë “të vinte duart mbi ta” (shih Marku 10:16). Në kohën e Jezusit, ishte normale që prindërit t’u kërkonin rabinëve që t’ua bekonin fëmijët. Ky veprim shihet dhe në Zan. 48:8 e më tej. Zakonisht, kjo kryhej në ditëlindjen e fëmijës në fjalë. Ky bekim bëhej më tepër për qetësinë mendore të prindit sesa për statusin “e shpëtimin” të fëmijës!

■ **“dishepujt i qortuan”** Disa kopjues të hershë shtuan “ata që i sollën” (shih NKJV). Mirëpo kjo nuk gjendet në dorëshkrimet e lashta greke të Sinaitikut, B dhe C, por përfshihet në A, D dhe W. Leximi më i shkurtër gjendet edhe në Mat. 19:13 dhe Luka 18:15. Fëmijët në Lindjen e Afërt nuk kanë statusin e privilegjuar që kanë në perëndim. Dishepujt mund të kenë menduar se po e mbronin Jezusin nga një veprim problematik dhe riautlist. Mirëpo, për Jezusin, njerëzit kishin gjithmonë përparësi.

10:14

NASB, NKJV

NJB

NKJV

TEV

“u zemërua”

“u indinjua së tepërmi”

“u zemërua”

Kjo është një fjalë e fortë, që përdoret në Marku 10:41 për zemërimin e dishepujve kundër Jakobit dhe Gjonit kur këta të dy kërkuan poste drejtuese, dhe në Marku 14:4 për mërinë e Judës ndaj vajosjes së Jezusit. Edhe Mateu e përdor disa herë këtë term (shih Marku 20:24; 21:15; 26:8).

Ungjilli i Markut zbulon natyrën njerëzore të Jezusit duke na treguar ndjenjat e tij (shih *Jesus and the Rise of Early Christianity*, nga Paul Barnett, f. 156).

1. dhembshuria për lebrozin (Marku 1:40-42)
2. zemërimi për ashpërsinë e zemrës së farisenjve (Marku 3:1-5)
3. indinjimi ndaj dishepujve (Marku 10:13-16)
4. dashuria për të riun e pasur (Marku 10:17-22)
5. shqetësimi i thellë në Gjetseman (Marku 14:33-34)
6. braktisja në kryq (Marku 15:34)

Jezusi shprehet shpesh acarimin me dishepujt (Marku 6:52; 8:17; 9:19). Fëmijët i shihte si krijesa të rëndësishme të Perëndisë, ndaj i donte. I përdoret shpesh fëmijët si shembuj për besimin dhe dishepullizimin e vërtetë.

■ **“Lërimi fëmijët të vijnë tek unë”** Kjo është urdhërore aoriste veprorë, që shpreh urgjencë ose thellësi ndjenje.

■ **“mos i pengoni”** Kjo është urdhërore e tashme me pjesore mohore, që zakonisht nënkuptonte ndalimin e një veprimi në kryerje e sipër.

■ **“mbretëria e Perëndisë”** Kjo frazë e përhapur në ungjijtë bënte fjalë për mbretërimin e Perëndisë në zemrat njerëzore tani, që një ditë do të përmbushej për gjithë tokën, ashtu siç ndodh në qiell. Shih Temën e Veçantë në Marku 1:15.

10:15 “Me të vërtetë” Shih Temën e Veçantë: Amen, në Marku 3:28.

■ **“kushdo që nuk e pranon”** Bëhet fjalë për të rriturit. Shpesh, Jezusi i përdorte fëmijët si shembuj shpirtërorë (shih Mat. 18). DHR është zbulues për të rriturit. Nuk diskuton për statusin shpirtëror të fëmijëve!

Kjo fjalë greke, *dekhomai*, në fillim kishte kuptimin “rrok di,ka”. Në këtë kuptim, është paralele me *lambano*. Më vonë, u përdor në kuptimin “pranoj”, ose “besoj”, ose “mirëpres”. Mund të ketë një dallim të vogël nëkuptimin se *dekhomai* thekson dhënësin, kurse *lambano* reflekton pjesëmarrjen aktive të marrësit (shih *Greek-English Lexion of the New Testament Based on Semantic Domains*, nga Louw dhe Nida, vëll. 1, f. 572, shënimi 31).

Thelbi teologjik është se njerëzit duhet të “pranojnë”, “besojnë” dhe “mirëpresin” Jezusin. Shpëtimi nënkupton mirëpritjen e një personi, besimin e të vërtetave për atë person (pra, ungjillin), dhe jetën që imiton atë person. Shpëtimi ka një aspekt të vullnetshëm fillestar dhe të vazhdueshëm.

■ **“nuk do të hyjë aspak”** Kjo është formë e fortë dhe e dyfishtë mohore, që do të thotë “kurrën e kurrës”. Në njëfarë kuptimi, Jezusi po e identifikon mbretërinë e Perëndisë me besimin fëmijëror tek ai dhe tek mësimet e tij. Kjo mund të tingëllojë jotolerante sot, por është mësim i qartë i DHR. Shpesh, quhet “skandali i natyrës përjashtuese të ungjillit”. Mirëpo është i vërtetë. Besimi në Jezusin është e vetmja rrugë për tek Ati (shih Gjoni 14:6)! Kjo duhet të shkaktojë lutje, dëshmi dhe përlësi, jo arrogancë, gjykim dhe krenari!

10:16 “i mori në krahë” Kjo është një tjetër dëshmi okulare e Pjetrit, si 9:36.

▣ **“nisi t’i bekonte, duke vendosur duart mbi ta”** Jezusi kaloi kohë me secilin prej fëmijëve. Prandaj, mund t’ia besojmë pa frikë fëmijët dashurisë së Perëndisë, që shfaqet kaq qartë në Jezusin. Jezusi ua rriti statusin dhe vlerën shoqërore jo vetëm grave, por edhe fëmijëve. Shih Temën e Veçantë: Vendosja e duarve, në Marku 7:32.

TEKSTI I NASB (I PËRDITËSUAR): MARKU 10:17-22

¹⁷Ndërsa Jezusi po nisej për një udhëtim, një burrë vrapoi drejt tij, u gjunjëzua para tij dhe e pyeti: “Mësues i mirë, çfarë duhet të bëj që të trashëgoj jetën e përjetshme?” ¹⁸Dhe Jezusi i tha: “Pse më quan të mirë? Askush nuk është i mirë përveç Perëndisë. ¹⁹Ti i njeh urdhërimet: ‘Mos vrit, mos bëj kurorëshkelje, mos vidh, mos bëj dëshmi të rreme, mos mashtro, ndero atin dhe nënën tënde’”. ²⁰Dhe ai i tha: “Mësues, të gjitha këto i kam zbatuar që nga rinia”. ²¹Jezusi e pa, ndjeu dashuri për të dhe i tha: “Një gjë të mungon: shko, shit gjithçka që zotëron, jepua të varfërve dhe do të kesh një thesar në qiell; pastaj, eja dhe më ndiq”. ²²Por, nga këto fjalë, ai u trishtua dhe iku i mërzitur, sepse kishte shumë pasuri.

10:17 “Ndërsa Jezusi po nisej për një udhëtim” Ungjilli i Markut karakterizohet nga udhëtimet e Jezusit. Kjo ishte teknika letrare e Markut për strukturimin e paraqitjes së kujtimeve (ose predikimeve) të Pjetrit.

▣ **“një burrë”** Mateu 19:20 shton mbiemrin “i ri”; Mat. 19:22 shton: “Ai kishte shumë prona (pra, ishte i pasur)”; ndërsa Luka 18:18 e quan “sundimtar”. Ky burrë, me sa duket, ishte i pasur, moral, dhe drejtues i rëndësishëm qytetar dhe fetar. Termi “sundimtar” nënkupton se ishte drejtues i sinagogës lokale. Shih Temën e Veçantë: Drejtësia, në 1 Pjetrit 3:14.

▣ **“vrapoi... dhe u gjunjëzua”** Ky ishte veprim tejet i pazakontë në publik për një burrë të kamur oriental. Me sa duket, e kishte me sigurtitet pyetjen dhe dëshirën për të mësuar. Nuk po përpiquej ta vinte në provë, apo ta mashtronte, Jezusin.

▣ **“Mësues i mirë”** Kjo frazë i hapi mundësinë Jezusit që të shqyrtonte botëkuptimin shpirtëror të këtij burri (shih Marku 10:18). Fjala “i mirë” (pra, *agathos*) mund të kuptohet në mënyra të ndryshme (i mirë, i dobishëm, bujar, dobipurës, i drejtë, ose i virtytshëm). Ky njeri e përdori në mënyrën e vet, kurse Jezusi e përdori në kuptimin absolut të fjalës.

▣ **“çfarë duhet të bëj”** Mënyra si i kuptonte ai çështjet shpirtërore përqendrohej në veprimet e tij. Ky njeri ishte mburjtur me traditën rabinike të veprave njerëzore (shih Mat. 19:16).

▣ **“që të trashëgoj”** Kjo fjalë familjare nënkupton marrëdhënien personale me Perëndinë. Në DHV, priftërinjtë thuhet se ishin trashëgimia e Perëndisë dhe ai ishte i tyre, për shkak se ata nuk morën asnjë copë toke siç bënë fiset e tjera. Vetë kjo pyetje nënkupton se ky njeri besonte se ishte plotësisht i pranuar nga Perëndia, por thjesht donte të sigurohej për këtë gjë.

▣ **“jetën e përjetshme”** Koncepti i jetës së përtejme (ose mbretërisë eskatologjike) vinte nga pasazhe të tilla si Dan. 12:2 ose Jobi 14:14; 19:25-27. Farisenjtë besonin në një jetë të përtejme, e cila do të ishte fizike. Ishin të bindur se JHVH do t’u jepte jetë të përjetshme për shkak të (1) identitetit të tyre racial (pra, si fëmijë të Abrahamit) dhe (2) për shkak të zbatimit nga ana e tyre e traditave gojore (pra, Talmudit).

10:18 “i mirë” Përdoret për të treguar se i vetmi standard i vërtetë për krahasim është drejtësia e Perëndisë. Fjala “i drejtë” vjen nga një fjalë e DHV (pra, kallam lumi), që përdorej si etalon ose si metër.

▣ **“Askush nuk është i mirë përveç Perëndisë”** Jezusi nuk po flet për mirësinë e vet, por donte që t’ia trondiste këtij njeriu mendimin e cekët që kishte për Perëndinë dhe për mirësinë e tij (shih Mat. 5:48). Kjo mund të jetë aludim i DHV për 1 Kro. 16:34; 2 Kro. 5:13; 7:3; Psa. 25:8; 86:5; 100:5; 106:1; 107:1; 118:1; Ezra 3:11.

Pasazhi paralel te Mateu e ndryshon pyetjen e sundimtarit: “Mësues, çfarë gjëje të mirë duhet të bëj që të fitoj jetën e përjetshme?” (Mat. 19:16). Ky ndryshim na jep idenë që kishte ky njeri për mirësinë dhe për arritjen e asaj mirësie nga ana e tij (shih Marku 19:20).

10:19 “Ti i di urdhërimet” Kjo është përmbledhje e gjysmës së dytë të Dhjetë Urdhërimeve, që flasin për mënyrën sesi partnerët e besëlidhjes duhet ta trajtojnë njëri-tjetrin.

■ **“mos mashtro”** Mund të bëhet fjalë për lakminë. Ky urdhërim, nga mënyra si shprehet, nuk ishte pjesë e Dhjetë Urdhërimeve, as nuk gjendet në këtë formë gjetkë në DHV. Po kështu, vargjet paralele në Mat. 19:18-19 dhe Luka 18:20 nuk e përmbajnë këtë frazë. Megjithatë, për të qenë të ndershëm, të tre ungjijtë sinoptikë kanë ndryshime në mënyrën si i citon Jezusi urdhërimet. Sërish, ky është problem i zakonshëm me dëshmitë okulare. Kjo gjë nuk ndikon aspak në frymëzimin ose vërtetësinë e historive të ungjijve!

TEMË E VEÇANTË: DHJETË URDHËRIMET (shih Eks. 20:1-17; LiP. 5:6-21) (SPECIAL TOPIC: THE TEN COMMANDMENTS [see Ex. 34:28; Deut. 4:13; 10:4])

I. Termat

- A. Fjalë për fjalë, “Dhjetë Fjalët” (shih Eks. 34:28; LiP. 4:13; 10:4).
- B. Klementi i Aleksandrisë e quajti “Dekalog” (*Deka Logous*), dhe pastaj etërit e hershëm e quajtën njësoj.
- C. Në Bibël quhet edhe:
 - 1. “Besëlidhje” (pra, hebraisht *berith*, shih Eks. 34:28; LiP. 4:13; 9:9; shih Temën e Veçantë: Besëlidhje)
 - a. nga akadishtja, *barah* – ha (pra, një vakt të përbashkët)
 - b. nga akadishtja, *biru* – lidh, ose prangos (pra, lidhje mes njerëzve)
 - c. nga akadishtja, *biru* – midis (pra, marrëveshjes mes dy palëve)
 - d. *baru* – shije (pra, detyrim)
 - 2. “Dëshmi” – Eks. 16:34; 25:16 (pra, dy pllakat)

II. Qëllimi

- A. Ato zbulojnë karakterin e Perëndisë (shih Temën e Veçantë: Tiparet e Perëndisë së Izraelit [DHV])
 - 1. Unike dhe të autoritetshme (pra, monoteiste; shih Temën e Veçantë: Monoteizmi)
 - 2. Etike, si ndaj shoqërisë, ashtu dhe ndaj individit
- B. Vlejnë për
 - 1. gjithë njerëzit, sepse zbulojnë vullnetin e Perëndisë për njerëzimin, dhe gjithë njerëzit janë krijuar në shëmbëllimin e Perëndisë.
 - 2. vetëm për besimarët e besëlidhjes, pasi është e pamundur t’i kuptosh dhe të bindesh pa ndihmën e Perëndisë
 - 3. C. S. Ljuis – këtu reflektohet ndjesia e brendshme morale, që ekziston dhe në fiset më primitive (Rom. 1:19-20; 2:14-15).
- C. Si gjithë kodet e lashta ligjore, edhe këto urdhërimet synonin
 - 1. të rregullonin dhe mbanin në kontroll marrëdhëniet ndërpersonale
 - 2. të ruanin stabilitetin e shoqërisë
- D. Ato e lidhin grupin heterogjen të skllëvërve dhe të përjashtuarve nga Egjipti në një komunitet besimi dhe ligji. B. S. Childs, *Old Testament Library, Exodus*: “të të aspektet negative tregojnë caqet e jashtme të kufirit të besëlidhjes. Çdo shkelje thyen vetë natyrën e kësaj marrëdhënieje njeri-Perëndi. Dy aspektet pozitive tregojnë përcaktimin e jetës brenda besëlidhjes. Dekalogu sheh dhe brenda, dhe jashtë; të ruan nga udha e vdekjes dhe të dëfton udhën e jetës” (f. 398).

III. Paralele

- A. Biblike
 - 1. Dhjetë Fjalët janë shkruar dy herë, në Eksodi 20 dhe Ligji i Përtërirë 5. Dallimi i vetëm dhe i vogël në urdhërimet 4,5 dhe 10 tregon përshtatjen e këtyre parimeve të përgjithshme ndaj situatave të ndryshme.

2. Gjithsesi, uniformiteti i tyre tregon për saktësinë me të cilën janë transmetuar.
3. Ndoshta, lexoheshin dhe ripohoheshin në mënyrë periodike, siç tregon Jozueu 24.

B. Kulturore

1. Kode të tjera ligjore nga Lindja e Afërt e lashtë
 - a. *Ur-Nammu* (sumer, 2050 para K.) nga qyteti i Urit
 - b. *Lipit-Ishtar* (sumer, 1900 para K.), nga qyteti i Isinit
 - c. *Eshnunna* (akadian, 1875 para K.), nga qyteti i Eshunës
 - d. Kodi i Hamurabit (babilonas, 1690 para K.) nga Babilonia, por kjo shtyllë u gjet në Suza
2. Forma e ligjeve në Eksodi 20:18-23:37 ka shumë të përbashkëta me kodet e tjera ligjore të Lindjes së Afërt. Megjithatë, Dhjetë Fjalët kanë një formë unike, që nënkupton autoritetin e tyre (urdhërimet në vetën e dytë njëjës—apodiktike).
3. Lidhja më e dukshme kulturore është ajo me Traktatet hitite të Sovranitetit (1450-1200 para K.). Disa shembuj të përshtatshëm të kësaj ngjashmërie gjenden në
 - a. Dhjetë Fjalët
 - b. Libri i Ligjit të Përtërirë
 - c. Jozueu 24
 Elementet e këtyre traktateve janë
 - a. Identifikimi i Mbretit
 - b. Rrëfimi i bëmave të tij madhështore
 - c. Detyrimet e Besëlidhjes
 - d. Udhëzime për ruajtjen e traktatit në faltore për lexim publik
 - e. Perënditë e palëve thirren si dëshmitarë
 - f. Bekime për besnikërinë dhe mallkime për shkeljen e traktatit
4. Disa burime të dobishme për këtë temë:
 - a. George Mendenhall, *Law and Covenant in Israel and the Ancient Near East*
 - b. Dewey Beegle, *Moses: The Servant of Yahweh*
 - c. W. Bezzel, *Origin and History*
 - d. D. J. McCarthy, *Treaty and Covenant*

IV. Struktura e brendshme

- A. Në librin e tij, *The Origins of Israelite Law*, Alt ishte i pari që bëri dallimin mes apodiktikes dhe kazuistikes.
 1. Kazuistikja ishte ajo formë e ligjeve të Lindjes së Afërt që përmbante kushtin—“nëse” = “atëherë”
 2. Apodiktikja ishte ajo formë e rrallë që shpreh një urdhër të drejtpërdrejtë, “Nuk duhet të...” ose “Duhet të...”
 3. Roland de Vaux, në *Ancient Israel: Social Institutions*, vëll. 1, f. 146, thotë se kazuistikja përdorej kryesisht në sferën laike, ndërsa apodiktikja në sferën e së shenjtës.
- B. Dhjetë Fjalët janë kryesisht negative në mënyrë e të shprehurit – 8 nga 10 të tilla. Forma është VETA E DYTË NJËJËS. Këto urdhërime i drejtohen gjithë komunitetit të besëlidhjes, çdo anëtar si individ, ose të dyve së bashku!
- C. Dy pllakat prej guri (Eks. 24:12; 31:18), shpesh, interpretohen si shprehje të aspekteve vertikale dhe horizontale të Dhjetë Fjalëve. Marrëdhënia e njeriut me JHVH-në shprehet në katër urdhërime, ndërsa marrëdhënia e njerëzve me njëri-tjetrin shprehet në 6 urdhërimet e tjera. Megjithatë, duke patur parasysh traktatet hitite të sovranitetit, këto pllaka mund të jenë dy kopje të gjithë listës së urdhërimeve.
- D. Numërimi historik i Dhjetë Fjalëve
 1. Është e qartë se kemi të bëjmë me dhjetë rregulla. Megjithatë, nuk na jepet dallimi i saktë mes tyre.
 2. Lista e sotme judaike rendit si urdhërim të parë Eks. 20:2. Për ta ruajtur numrin 10, judenjtë e llogarisin Eks. 24:3-6 si urdhërimin e dytë.
 3. Kishat katolike dhe luterane, duke ndjekur Augustinin, e bëjnë Eks. 20:3-6 si urdhërimin e parë dhe, për ta mbajtur numrin në dhjetë, e ndajnë vargun 17 në dy urdhërime të ndryshme.
 4. Kishat e reformuara, duke ndjekur Origenin dhe kishat e hershme lindore dhe perëndimore,

thonë se Eks. 20:3 është urdhërimi i paarë. Kjo ishte dhe pikëpamja e lashtë judaike, që përfaqësohet nga Filoja dhe Jozefusi.

- V. Si duhet t'i trajtojnë të krishterët Dhjetë Fjalët?
- A. Respekti absolut i Jezusit për Shkrimet na jepet në Predikimin në Mal (Mat. 5-7), veçanërisht në Mat. 5:17-48, që na tregon sa serioze është kjo temë. Predikimi i tij duket sikur është i bazuar në Dhjetë Fjalët dhe në zbatimin e tyre të saktë.
- B. Teoritë e marrëdhënies së 10 urdhërimeve me të krishterën
1. Për besimtarët
 - a. Roy Honeycutt, *These Ten Words*
 - (1) “Dhjetë Urdhërimet nuk bëhen kurrë të panevojshme, pasi as Perëndia nuk bëhet kurrë i tillë” (f. 7).
 - (2) “Gjithsesi, për shkak se Urdhërimet janë dëshmitarë të Perëndisë, në njëfarë kuptimi aktualiteti i tyre dhe aktualiteti i Perëndisë janë kaq të ndërthurur me njëri-tjetrin saqë janë pothuajse të pandashëm. Si rrjedhojë, nëse Perëndia është aktual për jetën tënde, edhe Urdhërimet do të jenë thellësisht aktuale pasi janë shkruar për karakterin e Perëndisë dhe kërkesat e tij” (f. 8).
 - b. Personalisht, këto urdhërime duhet t'i shohim si urdhërime që rrjedhin nga një marrëdhënie besimi që është krijuar tashmë. T'i ndash nga besimi dhe përkushtimi i Perëndisë do të thotë t'i shkatërrosh. Prandaj, për mua, ato janë universale vetëm në kuptimin që Perëndia dëshiron që gjithë njerëzit ta njohin. Po kështu, lidhen dhe me dëshminë e brendshme të Perëndisë me gjithë krijimin e tij njerëzor. Pali e shpreh këtë në Romakëve 1:19-20; 2:14-15. Në këtë kuptim, Urdhërimet pasqyrojnë një dritë udhërrëfyese që ka aktualitet të qenësishëm për gjithë njerëzimin.
 2. Për gjithë njerëzit, në çdo shoqëri, në çdo kohë
 - a. Elton Trueblood, *Foundations for Reconstruction*. “Teza e këtij libërthi është se rikthimi i ligjit moral, siç paraqitet në Dekalogun hebre, është një nga mënyrat si mund të gjejmë antihelmin për rrënimin e mundshëm moral” (f. 6).
 - b. George Rawlinson, *Pulpit Commentary*, “Exodus”:
 - c. Ato përbëjnë, për gjithë kohën, një përmbledhje të koncize të detyrës njerëzore, që në fytyrën e vet mbart natyrën hyjnore, që është e përshtatshme për çdo formë të shoqërisë njerëzore dhe që, për sa kohë të ekzistojë bota, nuk mund të bëhet e dalëmode. Ruajtja e Dekalogut nga komunitetet e krishtera si përmbledhja më e mirë e ligjit moral është e justifikuar për këto arsye, dhe na siguron dëshminë e fortë për natyrën e shkëlqyer të këtyre urdhërimeve” (f. 130).
 3. Si mjet shpëtimi ato nuk janë, dhe kurrë nuk kanë qenë, mjete të Perëndisë për shpengimin shpirtëror të njeriut të rënë. Pali e shpreh qartë këtë në Gal. 2:15-4:31 dhe Rom. 3:21-6:23. Dhjetë Urdhërimet shërbejnë si udhëzues për njeriun në shoqëri. Ato na i drejtojnë sytë të Perëndia dhe, pastaj, te njerëzit e tjerë. Nëse s'kapim elementin e parë, s'kapim asnjë element të tyre! Ligjet morale, pa një zemër të ndryshuar dhe të shpëtuar, janë thjesht pasqyrë e natyrës së rënë dhe të pashpresë të njeriut! Dhjetë Urdhërimet janë të vlefshme, por vetëm si përgatitje për t'u takuar me Perëndinë në mes të gjendjes sonë të paaftë. Nëse veçohet nga shpengimi, Dekalogu bëhet udhëzues pa udhërrëfyese!

10:20 “Të gjitha këto i kam zbatuar” Ky njeri i kishte kryer të gjitha detyrimet fetare të kulturës së tij. Edhe apostulli Pal mendonte se i kishte përmbushur kërkesat fetare (shih Veprat 23:1-2; Fil. 3:6). Ky njeri nuk po gënjente. Besonte se ishte i pafajshëm përpara Perëndisë.

■ **“nga rinia”** Bëhet fjalë për ceremoninë e *Bar Micva* në moshën 13-vjeçare, kur djali bëhej burrë dhe konsiderohej përgjegjës për zbatimin e Ligjit.

10:21 “Jezusi e pa, ndjeu dashuri për të” Kjo gjendet vetëm te Marku. Mirëpo dashuria e Jezusit nuk i uli standardet e mbretërisë së Perëndisë. Këtu kemi pardoksin e dashurisë së pakushtëzuar që kërkon një përgjigje të duhur besimi.

■ **“Një gjë të mungon”** Ky koment ngjason me Markun 12:34. Jezusi e kuptonte se njerëzit janë në shkallë të ndryshme, më afër ose më larg mbretërisë së vërtetë, gjë që nuk kushtëzohet nga kryerja e ligjeve të Moisiut, apo nga identiteti racor (shih Gjoni 8:33), por nga besimi personal në Jezusin. Ky drejtues fetar erdhi me qëndrimin e duhur, te personi i duhur, bëri pyetjen e duhur, por, me sa duket, nuk ishte në gjendje të bënte zgjedhjen vendimtare! Jezusi nuk e uli standardin! Burri iku i trishtuar! Kaq afër, por edhe kaq larg!

■ **“shit gjithçka që zotëron, jepua të varfërve... pastaj, eja dhe më ndiq”** Kjo tregon natyrën radikale të besimit të DHR (shih Luka 14:33). Jezusi e dinte ç’përparësi kishte ky burrë. Për t’u bërë i krishterë, njeriu duhet të heqë dorë nga të gjitha përparësitë e tjera. Në njëfarë kuptimi, kjo e bën krishterimin vërtet shumë të vështirë! Në këtë thënie, Jezusi po fokusohet në gjysmën e parë të Dhjetë Urdhërimeve në lidhje me përkushtimin parësor të njeriut ndaj Perëndisë dhe vetëm ndaj Perëndisë (shih Mat. 5:20).

Ky pasazh nuk mund të kthehet në ligj për gjithë besimtarët (pra, varfëria është gjëja më e lartë për Perëndinë). Duhet parë në kontekst. Marrëdhënia shpirtërore mes Perëndisë dhe njerëzimit duhet të ketë përparësi ndaj marrëdhënieve fizike (pra, pasuria, fama, puna, familja, zotërimet, madje dhe vetë jeta). Nëse zotërimet janë të këqija në vetvete, atëherë pse duhet t’ua japim të varfërve?

Dhe diçka e fundit. Ne fokusohemi gjithmonë në kërkesën e Jezusit, por a e dije që Jezusi i dha këtij njeriu dhe një motivim të paprecedent? E ftoi që t’i bashkohej grupit të dishepujve të tij! Mundësia e tij ishte shumë më e madhe sesa kostoja!

■ **“do të kesh një thesar në qiell”** Për shkak të rebelimit të njerëzimit, bekimet e Perëndisë rezervohen për jetën e përtejme (shih Marku 10:30; Mat. 5-7). Njerëzit duhet të jenë të gatshëm që të heqin dorë nga pasuritë tokësore si provë për kthimin në besim, por jo si bazë për këtë kthim në besim.

10:22 “u trishtua” Kjo fjalë mund të kuptohet në dy mënyra: (1) tronditje ose habi, ose (2) trishtim i shprehur me një fytyrë të mërziut. Të dyja këto alternativa janë të logjikshme në këtë kontekst.

TEKSTI I NASB (I PËRDITËSUAR): MARKU 10:23-27

²³Dhe Jezusi, duke vështruar rreth e rrotull, u tha dishepujve: “Sa e vështirë do të jetë për të pasurit që të hyjnë në mbretërinë e Perëndisë!” ²⁴Dishepujt u habitën nga fjalët e tij. Por Jezusi u përgjigj sërish dhe u tha: “Fëmijë, sa e vështirë është të hysh në mbretërinë e Perëndisë! ²⁵Është më e lehtë që të hyjë deveja në vrimën e gjilpërës sesa të hyjë i pasuri në mbretërinë e Perëndisë”. ²⁶Ata u habitën edhe më shumë dhe i thanë: “Atëherë, kush mund të shpëtohet?” ²⁷Duke i vështruar, Jezusi tha: “Për njerëzit është e pamundur, por jo për Perëndinë; sepse të gjitha gjërat janë të mundura për Perëndinë”.

10:23 “Dhe Jezusi, duke vështruar rreth e rralë” Kjo shprehje përdoret disa herë për të treguar se Jezusi e vërente sesi mësimet e tij preknin të tjerët (shih Marku 3:5, 34; 5:32; 10:23; 11:11). Vetëm Luka 6:10 përbën një varg paralel. Ky është kujtim vetëm i Pjetrit.

■ **“Sa e vështirë do të jetë për të pasurit që të hyjnë në mbretërinë e Perëndisë”** Kjo duhet të ketë qenë e habitshme për dishepujt (shih Marku 10:24). Pikëpamja tradicionale e DHV, e bazuar në LiP. 27-28, ishte se pasuria dhe shëndeti lidheshin me zbatimin e besëlidhjes dhe me bekimin e Perëndisë. Pikërisht këtë çështje trajtuan Jobi dhe Psalmi 73. Të pasurit prirën të besojnë në burimet e tyre, jo në Perëndinë.

TEMË E VEÇANTË: PASURIA (SPECIAL TOPIC: WEALTH)

- I. Këndvështrimi i Dhiatës së Vjetër në tërësi
 - A. Perëndia është zotëruesi i gjithçkaje
 1. Zanafilla 1-2
 2. 1 Kronikave 29:11
 3. Psalmi 24:1; 50:12; 89:11
 4. Isaia 66:2

- B. Njerëzit janë administrues të pasurisë për synimet e Perëndisë
 - 1. Ligji i Përtërirë 8:11-20
 - 2. Levitiku 19:9-18
 - 3. Jobi 31:16-33
 - 4. Isaia 58:6-10
- C. Pasuria është pjesë e adhurimit
 - 1. Dy të dhjetat
 - a. Numrat 18:21-29; LiP. 12:6-7; 14:22-27
 - b. Fjalët e Urta 3:9
- D. Pasuria shihet si dhuratë nga Perëndia për besnikërinë ndaj besëlidhjes
 - 1. Ligji i Përtërirë 27-28
 - 2. Fjalët e Urta 3:10; 8:20-21; 10:22; 15:6
- E. Paralajmërimi për pasurinë në kurriz të të tjerëve
 - 1. Fjalët e Urta 21:6
 - 2. Jeremia 5:26-29
 - 3. Osea 12:6-8
 - 4. Mikea 6:9-12
- F. Pasuria nuk është e mëkatshme në vetvete, ndonëse përbën përparësi
 - 1. Psalmi 52:7; 62:10; 73:3-9
 - 2. Fjalët e Urta 11:28; 23:4-5; 27:24; 28:20-22
 - 3. Jobi 31:24-28

II. Këndvështrimi unik i Fjalëve të Urta

- A. Pasuria vendoset në zonën e përpjekjeve personale
 - 1. përtacia dhe dembelizmi dënohen – Fja. 6:6-11; 10:4-5,26; 12:24,27; 13:4; 15:19; 18:9; 19:15,24; 20:4, 13; 21:25; 22:13; 24:30-34; 26:13-1
 - 2. puna e palodhur mbrohet – Fja. 12:11, 14; 13:11
- B. Varfëria kundrejt pasurisë përdoret për të ilustruar drejtësinë kundrejt ligësisë – Fja. 10:1 e më tej; 11:27-28; 13:7; 15:16-17; 28:6,19-20
- C. Urtësia (njohja e Perëndisë dhe Fjalës së tij, dhe jetësimi i kësaj njohurie) është më e mirë se pasuritë: Fja. 3:13-15; 8:9-11,18-21; 13:18
- D. Paralajmërimet dhe porosi
 - 1. Paralajmërimet
 - a. mos dil garant për kredinë e të afërmit: Fja. 6:1-5; 11:15; 17:18; 20:16; 22:26-27; 27:13
 - b. ruhu nga pasurimi me mjete të padrejta: Fja. 1:19; 10:2,15; 11:1; 13:11; 16:11; 20:10,23; 21:6; 22:16,22; 28:8
 - c. mos merr borxh: Fja. 22:7
 - d. ruhu nga natyra e përkohshme e pasurisë: Fja. 23:4-5
 - e. pasuria nuk do të të ndihmojë në ditën e gjykimit: Fja. 11:4
 - f. pasuria bën shumë “miq”: Fja. 14:20; 19:4
 - 2. Porosi
 - a. nxitet bujaria: Fja. 11:24-26; 14:31; 17:5; 19:17; 22:9,22-23; 23:10-11; 28:27
 - b. drejtësia, më e mirë se pasuria: Fja. 16:8; 28:6, 8, 20-22
 - c. lutje për përmbushjen e nevojave, jo për pasuri të madh: Fja. 30:7-9
 - d. kur i jep të varfrit, i ke dhënë Perëndisë: Fja. 14:31

III. Këndvështrimi i DHR

- A. Jezusi
 - 1. pasuria të shtyn në tundimin e veçantë që të besosh te vetja dhe te burimet e tua, dhe jo te Perëndia dhe burimet e tij
 - a. Mateu 6:24; 13:22; 19:23
 - b. Marku 10:23-31
 - c. Luka 12:15-21, 33-34

- d. Zbulesa 3:17-19
 - 2. Perëndia do të të sigurojë për nevojta fizike
 - a. Mateu 6:19-34
 - b. Luka 12:29-32
 - 3. mbjellja lidhet me korrjen (fizike, por edhe shpirtërore)
 - a. Marku 4:24
 - b. Luka 6:36-38
 - c. Mateu 6:14; 18:35
 - 4. pendimi ndikon në pasuri
 - a. Luka 19:2-10
 - b. Levitiku 5:16
 - 5. shfrytëzimi ekonomik dënohet
 - a. Mateu 23:25
 - b. Marku 12:38-40
 - 6. gjykimi i ditëve të fundit lidhet me përdorimin që i bëjmë pasurisë: Mateu 25:31-46
- B. Pali
- 1. pikëpamje praktike si Fjalët e Urta (puna)
 - a. Efesianëve 4:28
 - b. 1 Thesalonikasve 4:11-12
 - c. 2 Thesalonikasve 3:8, 11-12
 - d. 1 Timoteut 5:8
 - 2. pikëpamje shpirtërore si Jezusi (gjërat janë të përkohshme, prandaj ji i kënaqur)
 - a. 1 Timoteut 6:6-10 (kënaqja)
 - b. Filipianëve 4:11-12 (kënaqja)
 - c. Hebrenjve 13:5 (kënaqja)
 - d. 1 Timoteut 6:17-19 (bujaria dhe besimi në Perëndinë; jo pasuritë)
 - e. 1 Korintasve 7:30-31 (transformimi i gjërave)

IV. Përfundime

- A. Nuk ka teologji sistematike në Bibël për pasurinë.
- B. Nuk ka pasazhe absolute për këtë temë; prandaj, mësimet mund të nxirren nga pasazhet e ndryshme. Kujdes që të mos i detyrosh pasazhet e izoluara që t'i përshtaten pikëpamjeve të tua.
- C. Fjalët e Urta, që u shkruan nga njerëz të mençur (të urtët), ka këndvështrim të ndryshëm nga llojet e tjera të gjinive letrare biblike. Fjalët e Urta është libër praktik dhe i përqendruar te individi. Ai drejtpeshon dhe duhet drejtpeshuar me Shkrimet e tjera (shih Jer. 18:18).
- D. Koha jonë duhet t'i analizojë pikëpamjet dhe praktikatat e veta në lidhje me pasurinë në dritën e Biblës. Kemi përparësi të gabuara nëse udhërrëfyes të vetëm kemi kapitalizmin, ose komunizmin. Pse dhe si mund të arrihet suksesi janë pyetje më të rëndësishme sesa vlera e pasurisë që akumulon njeriu.
- E. Akumulimi i pasurisë duhet drejtpeshuar me adhurimin e vërtetë dhe me kujdestarinë e përgjegjshme (shih 2 Korintasve 8-9)

10:24 “Fëmijë” Jezusi i thirri dishepujt me një fjalë që kishte përdorur në sesionin e mëparshëm të mësimin (shih Marku 10:13-16). Kjo përforcon idenë se “fëmijët” nënkupton besimtarët e rritur.

■ **“sa e vështirë është të hysh në mbretërinë e Perëndisë”** Kjo është thënie tronditëse. Shpëtimi është dhuratë falas për shkak të veprës së përfunduar të Krishtit, që vlen për këdo që përgjigjet me pendim dhe besim. Problemi vjen kur, në njëfarë mënyre, mendojmë se e meritojmë! Shpëtimi është i vështirë për njerëzimin krenar, të pavarur dhe të rënë. Do të na pëlqente më tepër nëse marrëdhënia jonë me Perëndinë do të ishte e vështirë; kështu do të krenoheshim kur ta arrinin. Mirëpo rruga e Perëndisë, pendimi dhe besimi, është përlënëse për njerëzimin e rënë, sidomos për të pasurit, të arsimuarit dhe të privilegjuarit.

Për shkak se ky varg është caq i fortë, disa kopjues të lashtë u përpoqën t'ia kufizonin gamën duke futur një frazë cilësuese (shih Bruce M. Metzger, *A Textual Commentary on the Greek New Testament*):

1. “për ata që besojnë në pasuritë” gjendet në dorëshkrimet A, C, D dhe Textus Receptus
2. “i pasuri” në dorëshkrimin W
3. “ata që kanë pasuri” në dorëshkrimin 1241

10:25 “të hyjë deveja në vrimën e gjilpërës” Ashtu si Mat 23:24, kjo frazë është ekzagjerim oriental. Disa kopjues, dhe shumë komentues, janë përpjekur ta shpjegojnë këtë shprehje si (1) lojë fjalësh mes “devesë” (*kamelos*) dhe “litarit” (*kamilus*), që vjen nga shekulli i pestë, ose (2) duke e interpretuar “syrin e gjilpërës” sikur bën fjalë për një portë të vogël në një nga portat e mëdha të Jerusalemit, por për asnjërën prej tyre nuk ka të dhëna historike (shih Fee dhe Stuart, *How to Read the Bible for All Its Worth*). Këto përpjekje nuk e rrokin idenë e hiperbolës (shih Mat. 19:24; Luka 18:25).

10:26 “habitur” Marku, shpesh, e përdor këtë fjalë (*ekplessomai*) për të përshkruar sesi reagonin njerëzit ndaj mësimëve dhe veprimeve të Jezusit (shih Marku 1:22; 6:2; 7:37; 10:26; 11:18; dhe sinonimi *thambeo* në Marku 10:24). Mesazhi i Jezusit është shumë i ndryshëm nga ai i rabinëve, si në formë (pra, autoriteti i tij), ashtu dhe në mesazh (pra, natyra e mbretërisë së tij).

NASB	“i thanë”
NKJV	“thanë me njëri-tjetrin”
NRSV	“i thanë njëri-tjetrit”
TEV	“pyetën njëri-tjetrin”
NJB	“duke i thënë njëri-tjetrit”

Këto përkthime të ndryshme kanë të bëjnë me disa variante në dorëshkrimet greqisht.

1. NKJV; dorëshkrimet A, D, W dhe Textus Receptus
2. NRSV, TEV, NJB; dorëshkrimet M* dhe përkthimi Peshita
3. NASB, dorëshkrimet Sinaitikus, B dhe C
4. një dorëshkrim minuskul (569) dhe disa përkthimet kopte nuk e përmbajnë këtë frazë, siç ndodh dhe te Mateu 19:25 dhe Luka 18:26

10:27 Theksimi që i bën ky varg hirit të Perëndisë është drejtpeshim i mirëpritur i natyrës radikale të dishepullizimit në DHR. Njerëzit nuk janë në gjendje t'ia afrohen Perëndisë së shenjtë, por e vërteta e mahnitshme dhe e mrekullueshme është se ai na afrohet vetë!

Kjo thënie mund të jetë aludim për Zan. 18:14, ose Jer. 32:17, 24. Shpresa e vetme e njerëzimit është në karakterin, premtimet dhe veprimet e Perëndisë së vetëm të vërtetë!

TEKSTI I NASB (I PËRDITËSUAR): MARKU 10:28-31

²⁸Pjetri filloi t'ia thoshte: “Ja, ne kemi lënë gjithçka dhe të ndoqëm”. ²⁹Jezusi i tha: “Me të vërtetë ju them; nuk ka njeri që të ketë lënë shtëpinë, vëllezërit, motrat, nënën, babain, fëmijët, apo tokat, për hirin tim dhe për hir të ungjillit, ³⁰që të mos marrë njëqindfish tani në kohën e tanishme, shtëpi, vëllezër, motra, nëna, fëmijë dhe toka, bashkë me përndjekje; ndërsa, në epokën e ardhshme, jetën e përjetshme. ³¹Por shumë që janë të parët do të jenë të fundit, ndërsa të fundit, të parët”.

10:28 “ne kemi lënë... dhe të ndoqëm” Kjo është dëftore aoriste veprorë (pra, lamë një herë e përgjithmonë), e ndjekur nga një dëftore e kryer veprorë (pra, vazhdojmë të jemi dishepuj). Në njëfarë kuptimi, Pjetri po tregon vendimin e dishepujve që të bëhen ndjekës të Jezusit. Ndoshta, Pjetri po përpiqet ta krahasojë përkushtimin e tyre me kërkesën që Jezusi i bëri të riut të pasur.

10:29 Ky varg rendit disa nga aspektet normale të shoqërisë judaike, ku bënin pjesë dhe ndjekësit e Jezusit. Ai e lidh qartë përkushtimin e tyre me vetë Jezusin personalisht (pra, “për hirin tim”) dhe me të vërtetat e tij (pra, “për hir të ungjillit”).

Kisha e hershme ndikohej nga asketizmi grek, sidomos nga mosmartesa. Është interesante se gratë nuk përmenden në këto lista. Ndoshta, kjo nënkupton se martesa nuk ishte diçka prej së cilës a duhettë hiqnin dorë.

Megjithatë, përfshirja e “fëmijëve” mund të nënkuptojë se gratë përfshihen në frazën “lanë shtëpinë”. Përkushtimi paraprak i besimtarit ndaj Jezusit duhet t’ia tejkalojë dhe familjes (shih 1 Tim. 5:8). Kjo nuk nënkupton mosmartesën, por besnikërinë absolute të besimtarit ndaj Jezusit.

10:30 Jezusi e përshkruan mbretërinë e Perëndisë (1) në mënyra shumë tokësore, që paralelizojnë gjërat që dishepujt “nuk morën dot” në këtë jetë, dhe (2) në lidhje me këtë rend të tanishëm botëror. Disa nga bekimet e njëqindfishta shijohen tani duke u bërë pjesë e popullit të Perëndisë.

Këto terma normale familjare, në thelb, na sigurojnë se jeta familjare e prekur nga dishepullizimi rimëkëmbet përmes familjes më të madhe—familjes së Perëndisë. Nuk besoj se kjo frazë synon të na premtojë bollëk të mirash materiale në këtë jetë, njësoj si LiP. 27-28. Nëse i vendos bekimet në një strukturë të tipit “shpërbllim për shërbimin”, atëherë pse na duhet hiri? Bekimet materiale nuk janë përjetimi i gjithë besimtarëve të perëndishëm, por gëzimi dhe mbushullia e familjes më të madhe të krishterë janë të tilla!

■ **“bashkë me përndjekje”** Ky është përjashtim tronditës, që gjendet vetëm në Makru. Të krishterët do të përndiqen në këtë epokë të rënë (shih Mat. 5:10-12; Rom. 8:17; 2 Kor. 1:5, 7; Fil. 3:10; 2 Tim. 2:9-12; 1 Pje. 4:12-16). Kjo përndjekje shërben për një sërë synimesh të perëndishme: (1) është provë se jemi të shpëtuar; (2) mjeti i Perëndisë për shndërrimin tonë në ngjashmëri me Krishtin; dhe (3) provë se bota do të gjykohej.

■ **“në epokën e ardhshme”** Judaizmi ndërthjator (rabinët dhe shkruarit e Pergamenave të Detit të Vdekur) e ndante historinë në dy epoka. Epoka e tanishme e ligë, e dominuar nga rebelimi engjëllor dhe njerëzor, dhe epoka kur Perëndia do të shpërthejë në histori përmes Mesisë dhe do të vendosë epokën e re, një epokë drejtësie dhe paqe. Nganjëherë, kjo përshkruhet me terma bollëku tokësor, sipas LiP. 27-28 (shih Amosi 9:13-15); herë të tjera si “qielli i ri dhe toka e re” (shih Isaia 56-66). Nga DHR, është e qartë se epoka e re (pra, Mbretëria e Perëndisë) u themelua në momentin e mishërimit të Krishtit në Betlehem, por nuk u përmbush plotësisht atëherë. DHR zbulon qartë dy ardhje të Mesisë, hera e parë si Shërbëtori i Përvuajtur i Isaisë 53, dhe hera e dytë si Mbret i Mbretërve. Të krishterët jetojnë në periudhën “tani, por ende jo”, pra në mbivendosjen e këtyre dy epokave judaike. Si ndjekës të Krishtit, ne jemi shpirtërisht të bekuar në të dyja epokat (shih Efe. 2:5-6). Shih Temën e Veçantë: Kjo Epokë dhe Epoka e Ardhshme në Marku 13:8.

■ **“jetën e përjetshme”** Për këtë gjë e pyeti Jezusin i riu pasanik: për jetën me Perëndinë, llojin e jetës sipas Perëndisë. Marku përdor mbiemrin *aiônios* (pra, i përjetshëm) për mëkatin e përjetshëm në Marku 3:29, dhe për jetën e përjetshme këtu. Kjo vlen për jetën (pra, *zoi*) e epokës së re, jetën e Mbretërisë së Perëndisë. Kjo është e tashme në Krishtin, por do të përmbushet plotësisht në kthimin e tij (pra, *parousia* = prani).

Kjo frazë përshkruese është shumë e rrallë në ungjijtë sinoptikë, por tejet e përdorur te Gjoni. Është frazë kyçe në gjithë shkrimet e Gjoni (shih Gjoni 3:15; 4:36; 5:39; 6:54,68; 10:28; 12:25; 17:2,3; 1 Gjoni 1:2; 2:25; 3:15; 5:11,13,20). Shih Temën e Veçantë: E përjetshme në Marku 3:29.

10:31 “të parët do të jenë të fundit” Kjo është e vërtetë goditëse shpirtërore (shih Mat. 19:30; 20:16). Pasuria dhe pozita e vërtetë nuk kanë aspak lidhje me standardet tokësore (shih Isa. 55:8-9). Kjo përmbysje rolesh ishte në kundërshtim me mendësinë e dishepujve, që bazohej në drejtësinë sipas veprave (shih Mat. 19:30; Luka 13:30). Shih Gordon Fee, *The Disease of the Health and Wealth Gospel*.

Ndoshta kjo i drejtohej reagimit të Pjetrit se ata kishin bërë sakrificë për t’u bërë dishepuj (shih Marku 10:28). Ky pasazh përgatiti skenën teologjike për 10:41-45. Jezusi, Mbreti eskatologjik i Mbretërve, bëhet Shërbëtori i Përvuajtur i Isa. 52:13-53:12! Besimtarët duhet të imitojnë jetën/vdekjen/shërbesën e tij (shih 1 Gjoni 3:16). Ungjilli është shërbesë, jo pushtet; dashuri, jo forcë!

TEKSTI I NASB (I PËRDITËSUAR): MARKU 10:32-34

³²Ata ishin në rrugë, duke u ngjitur për në Jerusalem, dhe Jezusi po ecte përpara tyre; ata ishin të mahnitur, dhe ata që i ndiqnin kishin frikë. Dhe, sërish, ai i mori të dymbëdhjetët veçmas dhe filloi t’u tregonte se çfarë do t’i ndodhte atij, ³³duke u thënë: “Ja, po ngjitemi në Jerusalem, dhe Biri i Njeriut do të dorëzohet te krerët e priftërinjve dhe te skribët; dhe ata do ta dënojnë me vdekje dhe do t’ia dorëzojnë paganëve. ³⁴Ata do ta tallin dhe do ta pështynë, do ta rrahin me kamxhik dhe do ta vrasin, por pas tri ditësh ai do të ringjallet”.

10:32 “në rrugë” Në DHV, metafora e rrugës, ose shtegut, përdoret për të përshkruar jetën e perëndishme (shih Psa. 23:3; 32:8; 50:23; 119:1; 139:3; Fja. 2:12-15; 4:18; 12:28; 15:24). Ajo përshkruan dhe shërbesën e Gjon Pagëzorit, që përgatiti “rrugën e Zotit” (shih Isaia 40). Në Veprat, titulli më i hershëm për kishën ishte “Udha” (shih Marku 9:2; 19:9, 23; 22:4, 14, 22).

Marku duket se e strukturon ungjillin e vet në bazë të kësaj metafore biblike për besimin si mënyrë jetese (shih Marku 1:2, 3; 8:27; 9:33, 34; 10:32, 52). Jezusi ishte në shtegtim drejt kryqit (shih Marku 10:45).

▣ **“Jezusi po ecte përpara tyre”** Ndoshta, bëhet fjalë për grupin e apostujve, ose për një grup shtegtarësh që ishin nisur për festën në Jerusalem.

▣ **“ata ishin të mahnitur, dhe ata që i ndiqnin kishin frikë”** Kjo frazë duhet lidhur me tre profecitë e mëparshme të Jezusit për vuajtjen dhe vdekjen e tij në Jerusalem në duart e krerëve judenj dhe romakë. Jezusi e dinte se çfarë e priste aty, por, gjithsesi, ecte drejt atij fundi me shpejtësi dhe patundshmëri. Ata duhet të jenë shqetësuar: Ç’pasoja do të kishte për ta vuajtja dhe vdekja e tij?

▣ **“i mori të dymbëdhjetët veçmas”** Kjo është profecia e katërt për vuajtjen dhe vdekjen e Jezusit (shih Marku 8:31; 9:12, 31). Kjo është profecia më e hollësishme e Jezusit. Ai e dinte plotësisht se ç’ e priste (shih Marku 10:45). Dishepujt ende nuk ia kuptonin qëllimin dhe domosdoshmërinë kësaj profecie (shih Marku 9:32; Luka 9:45; 18:34).

▣ **“filloi t’u tregonte se çfarë do t’i ndodhte atij”** Shumica e foljeve në Marku 10:32 janë të pakryera, që nënkupton veprim të përsëritur. Mendoj se kjo vlen dhe për profecinë e përsëritur të Jezusit për vuajtjen e tij; prandaj, “filloi” është përkthim i gabuar i kësaj forme të pakryer (shih TEV).

Në njëfarë kuptimi, Jezusi po zbulonte pushtetin dhe autoritetin e vet duke e njohur të ardhmen dhe duke patur kontroll mbi vdekjen dhe ringjalljen e tij (shih Gjoni 10:17-18).

10:33 “Biri i Njeriut” Shih Shënimin në Marku 8:38c.

▣ **“do të dorëzohet te krerët e prifërinjve dhe te skribët”** Kjo ishte fazë përshkruese për Sinedrin (shih Marku 14:43 e më tej), që ishte gjykata e lartë e judenjve, ndonëse në shekullin e parë kishte vetëm autoritet të kufizuar. Shih Temën e Veçantë në Marku 12:13.

Jezusi e paratha reagimin e Sinedrit. Hyrja e tij triumfale në Jerusalem dhe pastrimi i tempullit ia vulosën fatin. Veprimi i parë tërboi farisenjtë, ndërsa veprimi i dytë tërboi saducenjtë.

▣ **“do t’ia dorëzojnë paganëve”** bëhet fjalë për ushtrinë pushtuese romake (shih Marku 15:1). Sinedri nuk kishte autoritet për të dënuar njerëzit me vdekje; vetëm qeveria romake e kishte këtë të drejtë.

10:34 “ata do ta dënojnë me vdekje” Kjo u përmbush nga ushtarët romakë në Marku 15:16-20. Marku nuk e përmend gjyqin e Jezusit përpara Herod Antipës (shih Luka 23).

▣ **“do ta pështyjnë”** Kjo ishte shenjë përçmimi në DHV (shih Num. 12:14; LiP. 25:9; Jobi 17:6; 30:10; Isa. 50:6). Ushtarët romakë e shfrynë mbi Jezusin gjithë urrejtjen e tyre për judenjtë dhe për zakonet e tyre të çuditshme (shih Marku 14:65).

▣ **“kamxhik”** Rrahja me kamxhik ishte praktikë e zakonshme përpara kryqëzimit (shih Marku 15:15). Të dënuarit ia lidhnin duart te një tra i ulët. Ushtari përdorte një kamxhik të bërë me copa guri, hekuri, ose kocke, të lidhura në disa shirita lëkure rreth 60 cm të gjata, dhe e godiste të burgosurin në kurriz. Goditja e kamxhikut e shqyente mishin e spinës dhe ia shkulte dhëmbët, madje dhe sytë. Shumë të burgosur vdisnin vetëm nga rrahja me kamxhik. Ishte tejet e dhunshme (shih Isa. 52:14).

▣ **“por pas tri ditësh”** Ky është përkthimi i fjalëpërfjalshëm i kësaj fraze. Kjo periudhë kohore, ndoshta lidhet me përjetimin e Jonës (shih Mat. 12:39-41; 16:4, 21; Luka 11:39, 32). Përmendet dhe nga Pali në përmbledhjen që i bëri ungjillit në 1 Kor. 15:4.

Jezusi e përdori këtë profeci për “ditën e tretë” në lidhje me dy ngjarje: (1) ringjallja e tij nga Hadesi (shih Marku 8:31; 9:31; 10:34), por edhe për (2) ndërtimin që do t’i bënte ai një tempulli të ri (shih Marku 14:58; 15:29; Gjoni 2:19; Veprat 6:14).

Kjo frazë përmban një variant tekstual në dorëshkrimet greke. Në vargjet paralele (Mat. 20:19 dhe Luka 18:33) përmbajnë frazën “ditën e tretë”. Kjo gjendet edhe këtu në Marku në dorëshkrimet A dhe W. Mirëpo fraza karakteristike e Markut, që gjendet në Marku 8:31 dhe 9:31, është “pas tri ditësh”, që gjendet në dorëshkrimet Sinaitikus, B, C, D dhe L.

■ **“do të ringjallet”** Kjo është dëftore e ardhme mesore. Fokusohej në faktin se Jezusi do të ringjallet vetë (shih Gjoni 10:17-18). Shumica e pasazheve për ringjalljen e Krishtit janë në diatezën pësore; përqendrohen në Perëndinë Atë si ai që kryen ringjalljen, duke treguar se e ka pranuar flijimin e Jezusit. Në njëfarë kuptimi, gjithë Trinia përfshihet në ringjalljen e Jezusit (p.sh., Fryma në Rom. 8:11). Shih Temën e Veçantë: Ringjallja në Marku 8:31.

TEKSTI I NASB (I PËRDITËSUAR): MARKU 10:35-40

³⁵Jakobi dhe Gjoni, dy bijtë e Zebedeut, erdhën te Jezusi dhe i thanë: “Mësues, duam që të bësh për ne çfarëdo që të të kërkojmë”. ³⁶Dhe ai u tha: “Çfarë doni të bëj për ju?” ³⁷Ata i thanë: “Bëj që të mund të ulemi, njëri në të djathtë dhe tjetri në të majtë, në lavdinë tënde”. ³⁸Por Jezusi u tha: “Ju nuk e dini se çfarë po kërkon. A jeni në gjendje të pini nga kupa që pi unë, apo të pagëzoheni me pagëzimin që pagëzohem unë?” ³⁹Ata i thanë: “Po, jemi”. Dhe Jezusi u tha: “Kupën që pi unë, do ta pini; dhe do të pagëzoheni me pagëzimin që pagëzohem unë. ⁴⁰Por që të uleni në të djathtë apo në të majtë time, këtë s’e jap unë; por kjo do t’u jepet atyre për të cilët është përgatitur”.

10:35 “dy bijtë e Zebedeut” Mateu 20:20 thotë se këtë pyetje ua bëri nëna e tyre.

■ **“duam që të bësh për ne çfarëdo që të të kërkojmë”** Sa herë që Jezusi paratha vuajtjet dhe vdekjen e tij, dishepujt fillonin të planifikonin se kush do t’ia zinte vendin si udhëheqës! Pikëvështrimi i tyre ishte ende një mbretëri tokësore, dhe kush do të ishte drejtuesi i saj. Dishepujt nuk i kuptuan dot gjërat deri në ditën e Rrëshajëve!

Në njëfarë kuptimi, kjo ngjarje përmendet për të treguar sesa pak kuptonin dishepujt (shih Luka 18:34). Kjo është ironi therrëse!

10:37 “në të majtë... në të djathtë” Ata donin vendet e nderit dhe autoritetit. Kjo ngjarje tregon se Pjetri nuk pranohej si drejtuesi i qartë i grupit të apostujve. Personaliteti që kishte e bënte të fliste gjithmonë i pari, por ata nuk e shihnin si drejtues.

■ **“në lavdinë tënde”** Mateu 20:21 thotë, “në mbretërinë tënde”. Në ungjillin e Markut, bën fjalë për shfaqjen e dukshme të mbretërisë eskatologjike të Perëndisë (Marku 8:38; 10:37; 13:36).

TEMË E VEÇANTË: LAVDI (Doksa)

Koncepti biblik i “lavdisë” është i vështirë për t’u shpjeguar. LXX e përdor fjalën *doxa* për të përkthyer mbi njëzet fjalë hebraisht. Përdoret shumë herë, në gjithë DHR, në një larmi mënyrash. Përdoret për Perëndinë, Jezusin, njerëzit dhe mbretërinë mesianike.

Në DhV, fjala më e zakonshme hebraisht për termin “lavdi” (*kabod*, BDB 458, KB 455-458) në fillim ishte term tregtar (që i referohej peshores), fjalë për fjalë, “rëndoj” (KB 455). Ajo që rëndonte ishte e vlefshme, ose kishte vlerë të qenësishme. Shpesh, koncepti i shkëlqimit i shtohet kësaj fjale për të shprehur madhështinë e Perëndisë (shih Eks. 13:21-22; 24:17; Isa. 4:5; 60:1-2). Vetëm ai është i denjë dhe i nderuar (shih Psa. 24:7-10; 66:2; 79:9). Ai është tepër i shkëlqyer që ta kundrojë njerëzimi i rënë, ndaj e vesh veten me re, dorë, ose tym (shih Eks. 16:7, 10; 33:17-23; Isa. 6:5). JHVH mund të njihet vërtet vetëm nëpërmjet Krishtit (shih Gjoni 1:18; 6:46; 12:45; 14:8-11; Kol. 1:15; 1 Tim. 6:16; Heb. 1:3; 1 Gjonit 4:12)

Për një diskutim të plotë të fjalës *kabod*, shih Temën e Veçantë: Lavdi (DhV). Lavdia e besimtarëve është se kuptojnë ungjillin dhe lavdinë e Perëndisë, jo se kanë lavdi në vetvete (shih 1 Kor. 1:29-31; Jer. 9:23-

■ **“Ju nuk e dini se çfarë po kërkon!”** “Kërkon” është në diatezën mesore, që përqendrohet te kryefjala, “ju vetë”. Edhe fraza tjetër, “jeni në gjendje” është në diatezën mesore.

■ **“kupën”** Në DHV, kupa përdoret për të nënkuptuar fatin e dikujt, zakonisht në mënyrë negative (shih Psa. 75:8; Isa. 51:17-23; Jer. 25:15-28; 49:12; 51:7; Vaj. 4:21-22; Ezek. 32:34; Hab. 2:16; Zak. 12:2). Kjo është pikërisht metafora që përdori dhe Jezusi në Gjetseman (shih Marku 14:36) për kryqëzimin e vet.

■ **“pagëzimin që pagëzohem unë”** Kjo është metaforë për vuajtjen, madje dhe vdekjen (shih Luka 12:50). Lavdia e tij ishte e përzier me dhimbje (shih Heb. 2:18; 5:8).

10:39 Këta drejtues do të vuanin nga e njëjta përndjekje dhe nga të njëjtat keqkuptime si Jezusi (shih Jakobi në Veprat 12:2 dhe Gjoni në Zbu. 1:9).

10:40 “do t’u jepet atyre për të cilët është përgatitur” Ky është një tjetër shembull i nënshtimit të Jezusit ndaj planit dhe qëllimit të Atit. Ka një plan hyjnor (shih Veprat 2:3; 3:18; 4:28; 13:29). Teksti i lashtë aleksandrian (dorëshkrimi A*) shton “nga Ati im”, që gjendet edhe te Mat. 20:23.

Dorëshkrimet e lashta unciale greke u shkruan me shkronja të mëdha pa hapësirë mes fjalëve, pa pikësim dhe pa paragrafë. Nganjëherë, është e vështirë të vendosësh si ta ndash fjalinë në fjalë. Kjo fjali mund të ndahet në dy mënyra (shih *Interpreting the New Testament*, nga Hans Conzelmann dhe Andreas Lindemann, përkthyer nga Siegfried S. Schotzmann, f. 22)

1. “për të cilët është caktuar”
2. “është përcaktuar për të tjerë” (shih përkthimet siriake).

TEKSTI I NASB (I PËRDITËSUAR): MARKU 10:41-45

⁴¹Kur e dëgjuan këtë, të dhjetët filluan të ndiheshin të zemëruar me Jakobin dhe Gjonin. ⁴²Si i thirri te vetja, Jezusi u tha: “Ju e dini se ata që njihen si sundimtarë të paganëve, i urdhërojnë; dhe të mëdhenjtë e tyre ushtrojnë autoritet mbi ta. ⁴³Por nuk është kështu mes jush, por kushdo që dëshiron të bëhet i madh ndër ju do të jetë shërbëtori juaj; ⁴⁴dhe kushdo që dëshiron të jetë i pari ndër ju do të jetë skllavi i të gjithëve. ⁴⁵Sepse dhe Biri i Njeriut nuk erdhi që t’i shërbejnë, por për të shërbyer dhe për ta dhënë jetën si shpengim për shumë vetë”.

10:41 “Kur e dëgjuan këtë” Kjo tregoi se Jakobi dhe Gjoni pritën derisa mbetën vetëm për vetëm me Jezusin. Kjo tregon dhe natyrën njerëzore të apostujve. Këta nuk ishin “super shenjtorë”, por thjesht burra të thirrur, të pajisur dhe të përdorur nga Perëndia. Të tjerët u zemëruan, jo për shkak se kërkesa e Jakobit dhe Gjonit ishte e pavend, por për faktin se ishin të parët që ia bënë Jezusit këtë kërkesë. Këta apostuj të zgjedhur shfaqnin ende egoizëm dhe mëkat.

10:42 Jezusi i përgjigjet sërish ambicies dhe keqkuptimit të Mbretërisë nga ana e tyre.

10:43

NASB “Por nuk është kështu mes jush”

NKJV “Por nuk do të jetë kështu mes jush”

NRSV “Por nuk është kështu ndër ju”

TEV “Mirëpo nuk është kjo mënyra mes jush”

NJB “Mes jush, kjo nuk duhet të ndodhë”

Këto përkthime reflektojnë një variant në dorëshkrimet greke. Në disa dorëshkrime (Sinaitikus, B, C*, D, L, W) përdoret koha e tashme (shih NASB, NRSV, TEV), që gjendet dhe në pasazhin paralel të Mat. 20:26. Mirëpo, në disadorëshkrime të tjera (A dhe C3) përdoret koha e ardhme (shih NKJV; dhe nënkuptohet në NJB).

■ **“kushdo që dëshiron të bëhet i madh”** Jezusi nuk e dekurajon madhështinë ose ambicien, por e përcakton madhështinë e vërtetë si shërbesë dhe përlësi (shih Mat. 20:26; Marku 9:35).

■ **“shërbëtori”** Kjo është fjala *diakonos*, që më vonë bëhet funksioni/ofiqi i dhjakut. Të gjithë besimtarët janë të thirrur për të shërbyer (shih Efe. 4:11-12).

10:44 Kjo ndihmon për të shpjeguar Markun 10:31.

■ **“skllavi”** Kjo është fjala *doulos*, që nënkuptonte shërbëtorin e shtëpisë.

10:45 “Biri i Njeriut” Shih shënimin në Marku 8:38c.

■ **“nuk erdhi që t’i shërbejn, por për të shërbyer”** Ky është përcaktimi i vërtetë i madhësisë. Jezusi na jep modelin e jetës së Mbretërisë që duhet ta imitojmë (shih 1 Pje. 2:21). Kjo e vërtetë u dha simbolikisht në çastin kur Jezusi u lau këmbët dishepujve në Dhomën e Sipërme natën që u tradhtua (shih Gjoni 13:14-15).

Kjo e vërtetë ka qenë gjithmonë e vështirë për drejtuesit e kishës. Por, pa të, nuk ka kishë shërbëtoare.

■ **“për ta dhënë jetën”** Ky është vargu përmbledhës i gjithë ungjillit të Markut. Jezusi e përmend gjithmonë vdekjen e vet si dhuratë ose lavdi të tij. Bëhet fjalë për shlyerjen zëvendësuese (pra, ofertën për mëkatin, 2 Kor. 5:21) të Krishtit (shih Zan. 3:15; Isa. 52:13-53:12).

■ **“shpengim”** Fjalë për fjalë, “blej sërish” ose “paguaj një çmim” (shih Mat. 20:28; Titi 2:14; 1 Pje. 1:18). Kjo pasqyron fjalën e DHV që përdoret për skllëvërit dhe të burgosurit e luftës kur shpengoheshin, shpesh nga një i afërm (*go’el*). Jezusi bashkon në vetvete dashurinë dhe drejtësinë e Perëndisë Atë. Mëkati kushton një jetë—dhe këtë jetë e siguroi vetë Perëndia!

TEMË E VEÇANTË: SHPENGOJ/ÇLIROJ (SPECIAL TOPIC: RANSOM/REDEEM)

I. DHIATA E VJETËR

A. Kryesisht, ka dy terma ligjorë hebraisht që e përçojnë këtë koncept.

1. *Ga’al* (BDB 145 I, KB 169 I), që në thelb do të thotë “çliroj [dikë] me anë të pagimit të një çmimi”. Forma e fjalës *go’el* i shton këtij koncepti ndërmjetësin personal; zakonisht ky ndërmjetës është një anëtar i familjes (pra, shpenguesi i fisit). Ky aspekt kulturor i së drejtës për të shpenguar objekte, kafshë, tokë (shih Lev. 25, 27), ose të afërm (shih Ruthi 4:14; Isa. 29:22) i transferohet teologjikisht çlirimit që i bën JHVH Izraelit nga Egjipti (shih Eks. 6:6; 15:13; Psa. 74:2; 77:15; Jer. 31:11). Ai bëhet “Shpenguesi” (shih (Jobi 19:25; Ps. 19:14; 78:35; Fja. 23:11; Isa. 41:14; 43:14; 44:6,24; 47:4; 48:17; 49:7,26; 54:5,8; 59:20; 60:16; 63:16; Jer. 50:34).

2. *Padah* (BDB 804, KB 911), që në thelb do të thotë “çliroj” ose “shpëtoj”.

- a. shpengimi i të parëlindurve (Eks. 13:13-15; Num. 18:15-17)
- b. shpengimi fizik krahasohet me shpengimin shpirtëror (Psa. 49:7, 8, 15)
- c. JHVH shpëton Izraelin nga mëkati dhe rebelimi (Psa. 130:7-8)

B. Ky koncept teologjik përfshin një sërë elementesh të lidhura.

1. Ekziston nevoja, skllavërimi, falimentimi, burgosja.
 - a. Fizike
 - b. Shoqërore
 - c. Shpirtërore (shih Psa. 130:8)
2. Duhet paguar një çmim për lirinë, lirim dhe rimëkëmbjen.
 - a. E kombit të Izraelit (shih LiP. 7:8)
 - b. E individit (shih Jobi 19:25-27; 33:28; Isaia 53)
3. Dikush duhet të veprojë si ndërmjetës dhe bamirës. Në rastin e *ga’al*-it, ky ishte zakonisht një anëtar i familjes, ose farefis (shih *go’el*, BDB 145).
4. Shpesh, JHVH e përshkruan vetën me terma familjarë.

- a. Atë
- b. Bashkëshort
- c. Shpengues/Shpagues Faferisno. Shpengimi kryhet më anë të veprimit personal të JHVH; paguhet një çmim dhe arrihet shpengimi!

II. DHIATA E RE

A. Ka disa terma që përdoren për përcimin e këtij koncepti teologjik.

1. *Agorazō* (shih 1 Kor. 6:20; 7:23; 2 Pje. 2:1; Zbu. 5:9; 14:3-4). Ky është term tregtar, që pasqyron pagimin e një çmimi për diçka. Ne jemi një popull i blerë me gjak, i cili nuk e ka jetën e vet në dorë. Ne i përkasim Krishtit.
2. *Eksagorazō* (shih Gal. 3:13; 4:5; Efe. 5:16; Kol. 4:5). Edhe ky është term tregtar. Pasqyron vdekjen zëvendësuese të Jezusit për hirin tonë. Jezusi mbarti “mallkimin” e ligjit, që bazohej te veprat (pra, ligjit të Moisiut, shih Efe. 2:14-16; Kol. 2:14), të cilin njerëzit mëkatarë nuk e përmbushin dot. Ai mbajti mbi vete mallkimin (shih LiP. 21:23) për të gjithë ne (shih Marku 10:45; 2 Kor. 5:21)! Në Jezusin, drejtësia dhe dashuria e Perëndisë u shkruanë në një për të mundësuar faljen, pranimin dhe komunikimin e plotë me Perëndinë!
3. *Luō* “çliroj”
 - a. *Lutron*, “çmim i shlyer” (shih Mat. 20:28; Marku 10:45). Këto janë fjalë të fuqishme nga goj e vetë Jezusit në lidhje me qëllimin e ardhjes së tij: pra, për të qenë Shpëtimtar i botës duke shlyer një borxh mëkati që nuk e kishte ai vetë (shih Gjoni 1:29).
 - b. *Lutroō*, “çliroj”
 - (1) Çliroj/shpengoj Izraelin (Luka 24:21)
 - (2) Jezusi dhe veten për të shpenguar dhe pastruar popullin e vet (Titit 2:14)
 - (3) Jezusi ishte zëvendësues i pamëkatë (1 Pje. 1:18-19)
 - c. *Lutrōsis*, “çlirim”, “shpengim”, ose “lirim”
 - (1) Profecia e Zakarisë për Jezusin, Luka 1:68
 - (2) Lavdet e Hanës për Perëndinë për Jezusin, Luka 2:38
 - (3) Flijimi më i mirë, i kryer një herë e përgjithmonë, nga Jezusi, Heb. 9:12
4. *Apolytrōsis*
 - a. Shpengim në Ardhjen e Dytë (shih Veprat 3:19-21)
 - (1) Luka 21:28
 - (2) Romakëve 8:23
 - (3) Efesianëve 1:14; 4:30
 - (4) Hebrenjve 9:15
 - b. Shpengimi në vdekjen e Krishtit
 - (1) Romakëve 3:24
 - (2) 1 Korintasve 1:30
 - (3) Efesianëve 1:7
 - (4) Kolosianëve 1:14
5. *Antilytron* (shih 1 Tim. 2:6). Ky është pasazh kyç (si dhe Titit 2:14), sepse e lidh çlirimin me vdekjen zëvendësuese të Jezusit në kryq. Ai është flijimi i vetëm i pranueshëm, ai që vdiq për të gjithë (shih Gjoni 1:29; 3:16-17; 4:42; 1 Tim. 2:4; 4:10; Titit 2:11; 2 Pje. 3:9; 1 Gjonit 2:2; 4:14).

B. Koncepti teologjik në DHR.

1. Njerëzimi është i skllavëruar ndaj mëkatit (shih Gjoni 8:34; Rom. 3:10-18, 23; 6:23).
2. Robërimi i njerëzimit ndaj mëkatit është zbuluar me anë të ligjit të Moisiut në DHV (shih Gal. 3) dhe me anë të Predikimit në Mal të Jezusit (shih Matu 5-7). Përpjekja njerëzore është kthyer në dënim me vdekje (shih Kol. 2:14).
3. Jezusi, qengji i pamëkatë i Perëndisë, ka ardhur dhe ka vdekur në vendin tonë (shih Marku 10:45; Gjonit 1:29; 2 Kor. 5:21). Ne jemi çliruar nga mëkati që t'i shërbejmë Perëndisë (shih Rom. 6).

4. Si rrjedhojë, JHVH dhe Jezusi janë “të afërm” që veprojnë në vendin tonë. Kjo vazhdon dhe metaforat e familjes (pra, ati, burri, biri, vëllai, i afërmi).
5. Shpengimi nuk është çmim që i paguhet Satanit (pra, siç thotë teologjia e mesjetës), por është pajtimi i fjalës dhe drejtësisë së Perëndisë me dashurinë e Perëndisë dhe shlyerjen e plotë në Krishtin. Në kryq u kthye paqja, rebelimi njerëzor u fal, dhe shëmbëllimi i Perëndisë në njerëzimint tani është plotësisht funksional për të patur bashkësi të ngushtë me të!
6. Shpengimi ka dhe një aspekt në të ardhmen (shih Rom. 8:23; Efe. 1:14; 4:30), që ka të bëjë me trupin tonë të ringjalljes dhe me marrëdhënien e ngushtë dhe personale me Perëndinë Triun (shih Temën e Veçantë: Trinia). Trupi ynë i ringjalljes do të jetë si ai i Krishtit (shih 1 Gjonit 3:2). Ai kishte trup fizik, por me një aspekt shtesë nga ana dimensionale. Është e vështirë ta përcaktosh paradoksin e 1 Kor. 15:12-19 me 1 Kor. 15:35-58. Siç shihet, ka trup fizik dhe tokësor, por ka dhe trup qiellor dhe shpirtëror. Jezusi i ka të dy!

■ **“sepse”** Kjo është parafjala greqisht *anti*. Nganjëherë, bashkohet me emrin “shpengim” (*lutron = antilutron*, p.sh., 1 Tim. 2:6). Mund të ketë kuptimin “në vend të”, “në emër të”, “në vendin e”. Marrëdhënia mes parafjalëve *anti* dhe *hyper* duhet përcaktuar nga konteksti (shih 2 Kor. 5:14; Heb. 10:12; 1 Pje. 2:21; 3 :18; 1 Gjonit 3:16). Të gjitha këto kanë ngjyrimin kuptimor të shlyerjes zëvendësuese të Jezusit. Ai vdiq në vendin tonë, mbarti mëkatin tonë (shih Isa. 53:4-6).

■ **“shumë”** Fjala që kanë zgjedhur disa komentues për ta kufizuar shlyerjen e Jezusit është fjala “të zgjedhurit”. Fjalët “shumë” dhe “të gjithë” janë sinonimike në dy pasazhe kyçe që trajtojnë temën e shpengimit. Krahaso Isa. 53:11-12, “shumë” me Isa. 53:6 “të gjithë”. Ky paralelizëm shihet qartë në Rom. 5:18, “të gjithë”, dhe Rom. 5:18, “shumë”. Jezusi pagoi çmimin për të gjithë, por vetëm ata që përgjigjen me pendim dhe besim ndaj ftesës së Frymës shpengohen.

Marku 10:45 është zemra teologjike e këtij ungjilli. U dha si përgjigje ndaj ambicies personale. Ambicia njerëzore duhet t’i kthehet Perëndisë si dhruatë (shih Rom. 12:1-2). Të krishterët duhet të imitojnë vetofrimin e Krishtit (shih 1 Gjonit 3:16).

TEKSTI I NASB (I PËRDITËSUAR): MARKU 10:46-52

⁴⁶Pastaj erdhën në Jeriko. Dhe teksa po largohej nga Jerikoja me dishepujt dhe me një turmë të madhe, një lypsar i verbër, i quajtur Bartime, biri i Timeut, ishte ulur përmbri rrugës. ⁴⁷Kur dëgjoji se ishte Jezusi Nazareas, nisi të bërtasë dhe të thotë: “Jezus, Bir i Davidit, ki mëshirë për mua!” ⁴⁸Shumë po i thoshin rreptë që të heshte, por ai vazhdoi të bërtiste akoma më shumë: “Bir i Davidit, ki mëshirë për mua!” ⁴⁹Dhe Jezusi ndaloi dhe tha: “Thirrreni këtu”. Kështu që e thirrën të verbrin dhe i thanë: “Merr zemër, ngrihu! Ai po të thërret”. ⁵⁰Si flaku mënjanë rrobën, ai kërcëu në këmbë dhe shkoi te Jezusi. ⁵¹Dhe, duke iu përgjigjur, Jezusi i tha: “Çfarë dëshiron që të bëj për ty?” Dhe i verbri i tha: “Rabboni, dua që të rifitoj shikimin!” ⁵²Dhe Jezusi i tha: “Shko; besimi yt të ka shëruar”. Menjëherë, ai rifitoi shikimin dhe filloi ta ndiqte në rrugë.

10:46 “Jeriko” Është një nga qytetet më të lashta në botë dhe, shpesh, quhet “Qyteti i Palmave”. Emri i tij do të thotë “i parfumosur”. Ishte zonë shumë pjellore dhe e bukur. Në kohën e Jezusit, kishte dy Jeriko: qyteti i vjetër dhe një qytet romak rreth 1.5 km larg. Ishte rreth 34 km në verilindje të Jerusalemit në vaun e lumit Jordan.

■ **“teksa po largohej”** Mateu 20:29 thotë “po dilte”; Luka 8:35 thotë “po afrohej”. Ky përshtjellim është shenjë e dëshmimeve okulare. Mos harroni se kishte dy Jeriko në kohën e Jezusit. Ndoshta, ai po dilte nga njëra dhe po i afrohej tjetrës.

■ **“një turmë e madhe”** Këta ishin shtegtarë në rrugën për Jerusalem për festën e Pashkës, së bashku me banorë kureshtarë të qytetit. Shumë nga priftërinjtë e tempullit jetonin në Jeriko. Rruga nga Jeriko në Jerusalem ishte shumë e rrezikshme për shkak të kusarëve (kujtoni shëmbëlltyrën e Samaritanit të Mirë); prandaj, njerëzit udhëtonin në grupe të mëdha.

☐ **“një lypsar i verbër... ishte ulur përbri rrugës”** Ka një variant në dorëshkrimet greke në këtë frazë. Emri “lypsar” është term i rrallë (shih Gjoni 9:8). Zakonisht, ky koncept shprehet me anë të një pjesoreje (dorëshkrimet A, K, W, Sinaitikus dhe Textus Receptus, shih NKJV). Mirëpo emri (pra, *prosaiteo*) gjendet në dorëshkrimet Sinaitikus, B, L (shih NASB, NRSV, TEV dhe NJB). Dorëshkrimi D ka një sinonim (pra, *epaiteo*, të dyja të formuara nga rrënja “pyes”), që gjendet në vargun paralel të Lukës 18:35. Këto variante tekstuale nuk kanë asnjë lloj ndikimi në interpretimin e pasazhit.

☐ **“Bartime”** Kjo fjalë ka kuptimin “biri i Timeut”. Është tejet e pazakontë që Marku të përmendë emrat e atyre që Jezusi shëronte ose prej të cilëve dëbonte demonët. Në mënyrë interesante, Mateu përmend dy të verbër (shih Mat. 20:30). Arsyeja pse ndodh kjo është e paqartë, por ka dallime të vazhdueshme mes Mateut dhe Mark/Lukës.

☐ **“biri i Timeut”** Në aramaisht, kjo fjalë do të thotë “i papastër”. Ishte përpjekje për t’ua shpjeguar emrin “Bartime” lexuesve johebrenj.

☐ **“ishte ulur përbri rrugës”** Ndoshta, aty, lypsa i verbër ulej përditë duke shpresuar për lëmoshë (pra, kërkonte ofertat judaike për të varfrit).

10:47 “Jezusi Nazareas” Në mënyrë unike, Marku përmend titullin *nazarenos* (shih Marku 1:24; 10:47; 14:67; 16:6). Ungjilli i Mateut thotë: “Ai do të quhet nazareas” (shih Mat. 2:23).

Fshati ku u rrit Jezusi quhej Nazaret. Nuk përmendet në DHV, në Talmud, apo nga Jozefusi. Me sa duket, u banua vetëm në kohën e Gjon Hirkanit (që ishte hasmoneas), i cili sundoi nga 134-104 para K. Prania e Jozefit dhe Marisë nga ky fshat nënkupton se aty kishte zënë vend një fis i prejardhjes së Davidit.

Mund të ketë një lidhje etimologjike mes emrit “Nazaret” dhe titullit mesianik “Dega”, që është *necer* në hebraisht (shih Isa. 11:1; Jer. 23:5; 33:15; Zak. 3:8; 6:12; Zbu. 5:5; 22:16).

Me sa duket, ishte fjalë përçmuese, për shak të vendndodhjes së Nazaretit larg nga Jerusalemi në një zonë pagane (shih Gjoni 1:46; dhe Veprat 24:5; ndonëse dhe kjo është profeci, Isa. 9:1). Kjo mund të jetë arsyeja pse u përfshi në akuzën e vendosur mbi kokën e Jezusit në kryq.

TEMË E VEÇANTË: JEZUSI NAZAREAS (SPECIAL TOPIC: JESUS THE NAZARENE)

Ka një sërë termash të ndryshëm greqisht që përdor DhR për të folur për Jezusin.

A. Termat e DhR

1. Nazareti – qyteti në Galile (shih Luka 1:26; 2:4, 39, 51; 4:16; Veprat 10:38). Ky qytet nuk përmendet në burimet e kohës, por është gjetur në mbishkrime të mëvonshme.
S’ishte kompliment që Jezusi ishte nga Nazareti (shih Gjoni 1:46). Shenja mbi kryqin e Jezusit, që përfshiu dhe emrin e këtij vendi, ishte shenjë e përçmimit të judenjve.
2. *Nazarēnos* – duket se i referohet edhe një vendndodhjeje gjeografike (shih Luka 4:34; 24:19).
3. *Nazōraios* – mund t’i referohet një qyteti, por mund të jetë edhe lojë fjalësh me termin mesianik hebre “Dega” (*necer*, shih Isa 4:2; 11:1; 53:2; Jer. 23:5; 33:15; Zak. 3:8; 6:12; në DhR, Zbu. 22:16). Luka e përdor për Jezusin në 18:37 dhe në Veprat 2:22; 3:6; 4:10; 6:14; 22:8; 24:5; 26:9.
4. Lidhet me #3, *nāzīr*, që do të thotë “i shenjtëruar me anë të një betimi”.

B. Përdorimet historike jashtë DhR.

1. Përcaktonte një grup heretik jude (para krishterimit) (në aramaisht, *nāsōrayyā*).
2. U përdor në qarqet judaike për të përshkruar besimtarët në Krishtin (shih Veprat 24:5, 14; 28:22, *nori*).
3. U bë fjala e zakonshme për të përcaktuar besimtarët në kishat siriane (aramaike). “I krishterë” përdorej në kishat greke për të përcaktuar këta besimtarë.
4. Diku pas rënies së Jerusalemit, farisenjtë u riorganizuan në Javne dhe nisën ndarjen formale mes sinagogës dhe kishës. Një shembull i llojit të formulave të mallkimit kundër të krishterëve gjendet në “Tetëmbëdhjetë Bekimet” nga *Berakoth* 28b-29a, ku besimtarët quhen “nazareas”
“Nazareasit dhe heretikët u zhdukshin në një çast; ata do të fshihen nga libri i jetës dhe nuk do të shkruhen me besnikët”.
5. U përdor nga Justin Martiri, *Dial.* 126:1, i cili përdori termin *necer* të Isaisë për Jezusin.

C. Mendimi i autorit

Habitem nga kaq shumë shqiptime që ka ky term, ndonëse e di se nuk është e padëgjuar në DhV, ku “Jozueu” shfaqet në një sërë shqiptimesh të ndryshme në hebraisht. Pikat e mëposhtme më bëjnë të mbetem i pasigurt për kuptimin e saktë të kësaj fjale:

1. shoqërimi i ngushtë me termin mesianik “Dega” (*necer*), ose termin e ngjashëm *nāzir* (dikush që shenjtërohet me anë të një betimi)
2. ngjyrimi negativ që e lidhte me Galilenë
3. dokumentimi i pakët, ose i munguar, i kohës për qytetin e Nazaretit në Galile
4. fakti se vjen nga goja e një demoni në kuptimin eskatologjik (pra, “Ke ardhur të na shkatërrosh?”).

Për një bibliografi të plotë të studimeve për këtë grup fjalësh, shih Colin Broën (red.), *New International Dictionary of New Testament Theology*, vëll. 2, f. 346, ose Raymond E. Broën, *Birth*, f. 209-213, 223-225.

☐ **“Bir i Davidit”** Ky ishte titull mesianik (shih 2 Sam. 7), që kishte domethënie nacionaliste. Ky titull është shumë i rrallë në Marku (shih Marku 10:47, 48; 12:35).

☐ **“ki mëshirë për mua”** Kjo është urdhërore aoriste veprorë, që nënkupton veprim të theksuar. Ishte lutje e zakonshme në Psalmet (shih Marku 51:1).

10:48 “Shumë po i thoshin rreptë që të heshtte” Kjo është në kohën e pakryer. Ai po bërtiste vazhdimisht dhe disa nga turma po e qortonin vazhdimisht (shih Luka 18:39).

10:49 “Jezusi ndaloi” Ndonëse ishte në rrugën drejt kryqit, Jezusi kishte kohë dhe për një lypsar të verbër! Kjo është një tjetër shenjë profetike nga Isaia për ata që kanë sy shpirtërorë për të parë!

☐ **“Merr zemër, ngrihu! Ai po të thërret”** Zakonisht, në greqishten *koine*, çdo frazë lidhet me frazën paraprirëse me anë të një lidhëze ose një përemri që i referohet diçkaje në kontekstin paraprirës. Kur këto lidhëza mungojnë (si në këtë rast), na e përqendrojnë vëmendjen te thëniet e personit në fjalë. Këto janë thënie të theksuara dhe të veçuara. E para dhe e dyta janë urdhërore të tashme veprorë, ndërsa e fundit është dëftore e tashme veprorë.

10:50 “Si flaku mënjanë rrobën” Kjo rrobë përdorej (1) si mbulojë për të fjetur, dhe (2) për të mbledhur ushqimet dhe lëmoshat. Në njëfarë kuptimi, ky ishte simbol i besimit të Bartimeut se do të shërohej.

☐ **“kërceu në këmbë”** Këto janë hollësi prej dëshmitari okular, që i kujton Pjetri.

10:51 “Çfarë dëshiron të bëj për ty?” Jezusi po e detyronte që ta shprehte kërkesën e besimit të tij.

☐ **“Dua të rifitoj shikimin”** Shërimi i të verbërve kishte domethënie mesianike (shih Isa. 35:4-5; 42:7, 16; 61:1). Kjo ishte një nga shenjat-prova që kishin kërkuar farisenjtë.

10:52 “besimi yt të ka shëruar” Fjalë për fjalë, “shpëtuar” (pra, *sozo*) në formën dëftore të kryer veprorë. Kjo fjalë përdoret në kuptimin e saj të DHV, pra për çlirimin fizik (shih Jakobi 5:15).

☐ **“filloi ta ndiqte”** Luka 18:45 shton, “duke përlëvduar Perëndinë”.

PYETJE PËR DISKUTIM

Ky është një komentari studimor udhëzues, që do të thotë se ti je vetë përgjegjës për interpretimin e Biblës. Secili prej nesh duhet të ecë sipas dritës që ka. Ti, Bibla dhe Fryma e Shenjtë keni përparësi në interpretim. Nuk duhet t’ia dorëzosh këtë të drejtë komentuesit.

Këto pyetje për diskutim t’i kam dhënë për të të ndihmuar që të analizosh çështjet kryesore të kësaj pjese të librit. Ato synojnë të të nxisin mendimin, jo të kenë natyrë shteruese.

1. Pse donin prindërit që Jezusi të vinte duart mbi fëmijët e tyre?
2. Pse u përpoqën dishepujt që t'i ndalonin?
3. Pse u zemërua kaq shumë Jezusi me dishepujt?
4. Ç'lidhje kanë fëmijët me Mbretërinë e Perëndisë?
5. Çfarë cilësi prej fëmije kërkon Jezusi te dishepujt?
6. Pse u flet kaq shpesh Jezusi dishepujve për vdekjen e tij të afërt?
7. Përcakto madhësitinë e vërtetë.

MARKU 11

NDARJET NË PARAGRAFË TË PËRKTHIMEVE MODERNE

UBS ⁴	NKJV	NRSV	TEV	NJB
Hyrja ngadhënjimtare në Jerusalem 11:1-11	Hyrja ngadhënjimtare 11:1-11	E Diela e Palmave 11:1-10 11:11	Hyrja ngadhënjimtare në Jerusalem 11:1-3 11:4-5 11:6-10 11:11	Mesia hyn në Jerusalem 11:1-11
Mallkimi i fikut 11:12-14	Tharja e fikut 11:12-14	Mallkimi i fikut 11:12-14	Jezusi mallkon fikon 11:12-14a 11:14b	Figu i pafryt 11:12-14
Pastrimi i tempullit 11:15-19	Jezusi pastron tempullin 11:15-19	Pastrimi i tempullit 11:15-19	Jezusi shkon në tempull 11:15-17 11:18 11:19	Dëbimi i tregtarëve nga tempulli 11:15-19
Mësimi nga fiku i tharë 11:20-25	Mësimi nga fiku i tharë 11:20-24 Falja dhe lutja 11:25-26	Kuptimi i fikut të tharë 11:20-24 11:25	Mësimi nga fiku 11:20-21 11:22-25	Fiku i tharë, besimi dhe lutja 11:20-25
S'e përmban Markun 11:26		S'e përmban Markun 11:26	S'e përmban Markun 11:26	S'e përmban Markun 11:26
Autoriteti i Jezusit vihet në dyshim 11:27-33	Autoriteti i Jezusit vihet në dyshim 11:27-33	Autoriteti i Jezusit 11:27-33	Pyetja për autoritetin e Jezusit 11:27-28 11:29-30 11:31-33a 11:33b	Autoriteti i Jezusit vihet në dyshim 11:27-33

CIKLI TRE I LEXIMIT (shih f. v)

NDJEKJA E SYNIMIT TË AUTORIT FILLESTAR NË NIVELIN E PARAGRAFËVE

Ky është një komentari studimor udhëzues, që do të thotë se ti je vetë përgjegjës për interpretimin e Biblës. Secili prej nesh duhet të ecë sipas dritës që ka. Ti, Bibla dhe Fryma e Shenjtë keni përparësi në interpretim. Nuk duhet t'ia dorëzosh këtë të drejtë komentuesit.

Lexo gjithë kapitullin njëherësh. Identifiko temat. Krahaso ndarjet e tua tematike me pesë përkthimet moderne. Ndarja në paragrafë nuk është e frymëzuar, por është çelësi për të ndjekur synimin e autorit fillestar, gjë që është thelbi i interpretimit. Secili paragraf ka vetëm një temë të vetme.

1. Paragrafi i parë
2. Paragrafi i dytë
3. Paragrafi i tretë
4. Etj.

MËSIMET KONTEKSTUALE:

- A. Hyrja Ngadhënjimtare ishte shenjë e rëndësishme profetike: Jezu i u shpall Mesia i premtuar. Vargjet paralele gjendet në Mat. 21:1-11, Luka 19:29-44, dhe Gjoni 12:12-19.
- B. Hyrja Ngadhënjimtare ka një aspekt paradoksal. Qartazi, Jezusi po përmbushte profecinë e Zak. 9:9, dhe bërtitjet e turmës (pra, liturgjia e Psalmeve) ishin miratim i natyrës së tij mesianike. Megjithatë, mos harrojmë se këto psalme (që quhen “Halel”) përdoren për të mirëpritur shtegtarët çdo vit, sa herë që vinin për Pashkë. Fakti se ata po i zbatonin një personi të veçantë tregon natyrën unike të kësaj ngjarjeje. Kjo shihet qartë në zemërimin e madh të krerëve fetarë.
- C. Pastrimi i tempullit, i përmendur në Marku 11:15-19, me sa duket, ishte pastrimi i dytë që i bëri Jezusi këtij vendi. I pari ndodhi në Gjoni 2:15. Unë nuk i pranoj parimet e kritikës letrare, të cilat i shkrijnë këto dy ngjarje në një të vetme. Ndonëse është e vështirë ta bashkohësh kronologjinë e unifikimit sinoptikë me atë të unifikimit të Gjoni, mua më duket gjithsesi më mirë, për shkak të dallimeve mes këtyre dy ngjarjeve, që të themi se bëhet fjalë për dy pastrime; i pari ndodhi herët në shërbesën e Jezusit, ndërsa i dyti, nga fundi i kësaj shërbese. Kjo mund të shpjegojë dhe armiqësinë e hershme dhe gjithnjë e më të madhe nga ana e krerëve fetarë të Jerusalemit. Ky pastrim gjendet edhe në Mat. 21:12-16 dhe Luka 19:45-47.
- D. Mallkimi i fikut është, qartazi, aludim për judaizmin. Vargjet paralele gjenden në Mat. 21:18-19 dhe Luka 19:45-48.
- E. Fiku i tharë (Marku 11:20-25) gjendet edhe te Mat. 21:19-22 dhe Luka 21:37-38.
- F. Autoriteti i Jezusit vihet në dyshim (Marku 11:27-12:12). Autoriteti i tij është çështja kyçe teologjike! Pasazhet paralele gjenden në Mat. 21:23-46 dhe Luka 20:1-19.

STUDIMI I FJALËVE DHE FRAZAVE

TEKSTI I NASB (I PËRDITËSUAR): MARKU 11:1-10

¹Teksa po i afroheshin Jerusalemit, në Betfage dhe Betani, pranë malit të Ullinjve, ai dërgoi dy prej dishepujve ²dhe u tha: “Shkoni në fshatin përballë dhe, menjëherë, sapo të hyni në të, do të gjeni aty një kërraç mbi të cilin nuk është ulur askush; zgjidheni dhe silleni këtu. ³Nëse dikush ju thotë, ‘Pse po e bëni këtë?’, i thoni: ‘Zoti ka nevojë për të’; dhe, menjëherë, ai do ta dërgojë këtu”. ⁴Ata ikën dhe gjetën një kërraç të lidhura te dera, jashtë në rrugë; dhe e zgjidhën. ⁵Disa nga njerëzit që ishin aty u thanë: “Ç’po bëni që po zgjidhni kërraçin?” ⁶Ata u thanë ashtu siç u kishte thënë Jezusi, dhe u dhanë leje. ⁷E sollën kërraçin te Jezusi dhe vendosën mantelet e tyre mbi të; dhe ai u ul mbi të. ⁸Dhe shumë i shtrinë rrobat e tyre në rrugë, ndërsa të tjerë shtronin degë me gjethe që i kishin marrë nga fushat. ⁹Ata që ecnin përpara dhe ata që vinin nga pas bërtisnin: “Hozana! I bekuar qoftë ai që vjen në emër të Zotit; ¹⁰E bekuar është mbretëria e ardhme e atit tonë, Davidit; Hozana në lartësi!”

11:1 “Betfage” Ky emër do të thotë “shtëpia e fiqve”, ose “vendi i fiqve të papjekur”. Ndodhej në kreshtën përballë Jerusalemit, e quajtur mali i Ullinjve. Në literaturën rabinike, ajo është lagje periferike e Jerusalemit. Ishte pranë rrugës kryesore që vinte nga Jeriko, dhe të cilën e përdornin shtegtarët.

■ **“Betani”** Ky emër do të thotë “shtëpia e hurmave”. Gjoni 11:18 thotë se ishte 3 kilometra në juglindje të Jerusalemit, në rrugën për në Jeriko, dhe ishte vendlindja e Marisë, Martës dhe Lazarit. Gjatë tre ditëve kryesore të festës së përvitshme (shih Lev. 23) të gjithë ata që banonin përreth Jerusalemit mbanin në shtëpinë e tyre shtegtarë. Jezusi qëndronte aty kur ishte në Jerusalem (shih Marku 11:11; Mat. 21:17).

■ **“pranë malit të Ullinjve”** Këto dy fshatra të vogla ndodheshin mbi të njëjtën kreshtë (rreth 5 km e gjatë) që njihej si “mali i Ullinjve”.

■ **“dërgoi dy prej dishepujve”** Ndoshta, njëri prej tyre ishte Pjetri, dhe këtë ngjarje ia përmendi më vonë Gjon Markut.

11:2 “menjëherë” Shih shënimin në Marku 1:10.

■ **“kërriç”** Kjo ngjarje është përmbushje profecie (shih Zan. 49:11; Zak. 9:9). Gomerët përdorshin rëndom nga mbretërit judenj (kjo përmendet dhe në Pllakat e Marit dhe në Epikën sumere të Gilgameshit). Ky kërriç do të përmbushte profecitë mesianike (vetëm mbreti i hipte gomarit të tij; dhe ky kërriç nuk ishte ngarë nga askush tjetër më parë), por edhe do të përçonte faktin se Jezusi erdhi në paqe. Në Ardhjen e Dytë, Zoti do të shfaqet si kalorës i bardhë, si Mbret i Mbretërve dhe si Gjykatës i universit (shih Zbu. 19:11-16). Rabinët i njihnin këto profeci mesianike dhe thoshin se, nëse Izraeli do të ishte i denjë, qoftë dhe për një ditë të vetme, Mesia do të vinte në retë e qiellit; përndryshe, Mesia do të vinte një ditë mbi gomar.

■ **“nuk është ulur askush”** Gomarit mbretëror s’i hipte askush tjetër përveç mbretit. Një shembull i këtij simboli të fuqishëm shihet në momentin kur Solomoni nget gomarin e Davidit (shih 1 Mbre. 1:33).

11:3 “nëse” Kjo është fjali kushtore e rendit të tretë, që nënkupton veprim të mundshëm.

■ **“Zoti ka nevojë për të”** Shpesh, është e vështirë të kuptosh nga ndodhitë e ungjijve nëse Jezusi po përdor njohurinë e tij profetike, apo thjesht i kishte rregulluar më parë disa ngjarje (shih Marku 14:12-16).

Ky është përdorim i rrallë nga Marku i fjalës *kurios* si titull që i vihej Jezusit (shih Marku 7:28; 11:3). Meqë kjo fjalë mund të ketë kuptimin “zotëri”, ose “padron”, ndoshta bën fjalë për të zotin e kërriçit. Megjithatë, konteksti të lë të kuptosh se bëhet fjalë për Jezusin. Domethënia teologjike e këtij termi është se kjo përbën mënyrën sesi DHV fliste për JHVH-n (shih Marku 11:9) me anë të emrit *Adon*, që do të thotë “pronar”, “zotëri”, “zot”, ose “burrë/bashkëshort” në hebraisht.

■ **“dhe, menjëherë, ai do ta dërgojë këtu”** Është e paqartë nëse ky është koment i dishepujve për kërriçin, apo është pjesë e fjalisë së Jezusit. Ka disa variante tekstuale në dorëshkrimet greke për shkak të paqartësisë së kësaj fraze.

11:5 “disa nga njerëzit që ishin aty” Vargu paralel te Luka 19:33 thotë: “pronarët”.

11:7 “vendosën mantelet e tyre mbi të” Mantelet shërbenin si jastëk, ose si shtrojë-samar. Ngjyrat e tyre mund t’u kenë dhënë pamje festive ose parade (pra, për marshimin mbretëror).

11:8 “shumë i shtrinë rrobat e tyre në rrugë” Kë nënkupton fjala “shumë”? Nëse bëhet fjalë për dishepujt, atëherë ky është gjest që tregonte natyrën mbretërore të Jezusit (shih 2 Mbre. 9:13). Nëse bëhet fjalë për banorët e Jreusalemit, do të ishte habi po ta bënin këtë gjë çdo vit për shkak të dëmit që i shkaktonte ecja e gomarit rrobave të tyre në rrugën e prishur. Ndoshta, ata kishin dëgjuar për Jezusin dhe e dinin që ishte njeri unik.

■ **“të tjerë shtronin degë me gjethe”** Gjoni 12:13 thotë se këto ishin gjethe palme, që rriteshin në malin e Ullinjve (shih Jozefusin). Me sa duket, ishin shenjë fitoreje ose triumfi (shih Zbu. 7:9). Ky ritual kryhej çdo vit nga banorët e Jerusalemit në festat e Çadrave dhe Pashkëve për turmat e shtegtarëve që i afroreshin qytetit. Këtë vit, domethënia e Mbretit që afrohej u përmbush.

Ndonëse ky akt simbolik kryhej vazhdimisht gjatë Festës së Çadrave (shih Lev. 23:13-20), ato gjethe ishin shumë më të mëdha se këto. Gjethet që përdoren këtu ishin më të vogla dhe i ngjajonë zakonit të sotëm kur njerëzit shpërndajnë petale trëndafilash përpara nuses, kur ajo ecen drejt altarit. Këto tre veprime—(1) mantelet mbi kafshët, (2) mantelet e shtrira në rrugë, dhe (3) degët e përhapura në rrugë—tregonë se ata po e nderonin Jezusin si Mesia i premtuar mbretëror (Psalmi 2) dhe Davidik (shih 2 Samuelit 7).

11:9 “Ata... bërtisnin” Me sa duket, liturgjia e Markut 11:9-10 ishte pjesë e festave të përvitshme. Kishin domethënie të rëndësishme kombëtare (pra, ndoshta kjo ishte mënyra aramaike për të thënë “pushteti mbretëror i takon [filanit]”). Megjithatë, meqë këto përsëriteshin çdo vit, romakët nuk ndiheshin të kërcënuar. Këtë vit, ato gjetën përmbushjen e tyre të plotë në Jezusin e Nazaretit. Ajo që më parë kishte qenë liturgji, tani ishte zbulesë!

■ **“Hozana”** Në hebraisht, do të thotë: “mirëpriteni!” Ishte pjesë e Psalmi të Halelit 118:25, që citohej për vitin sa herë që shtegtarët mbërrinin në Jerusalem. Fjalë për fjalë, do të thoshte “shpëtona tani” (shih 2 Sam. 14:4; 2 Mbret. 6:16), që ishte bërë përsëritje standarde.

■ **“I bekuar qoftë ai që vjen në emër të Zotit”** Ky është citim nga Psa. 118:26. Ky ishte një nga Psalmet e Halelit (113-118) që citohej në festën e Pashkës. Psalmi 118 kishte domethënie të fortë mesianike (shih Marku 11:22). Vargu paralel në Luka 19:38 thotë: “I bekuar është Mbreti, që vjen në emër të Zotit”. Kjo liturgji rituale e përvitshme u bë profeci e përmbushur!

11:10 “mbretëria e ardhme e atit tonë, Davidit” Kjo kishte domethënie nacionaliste (shih 2 Sam. 7; Os. 3:5). Nuk e dimë nëse kjo ishte litani e përvitshme, apo nëse u shtua për t’iu referuar posaçërisht Jezusit. Ndoshta është aludim për Zak. 9:9. Mateu 21:5 e shpreh drejtpërdrejt këtë profeci. Vargu paralel në Luka 19:39 tregon zemërimin e fortë të farisenjve kur këto fraza iu atribuuan drejtpërdrejt Jezusit.

■ **“Hozana në lartësi”** Kjo shprehje mund të ketë kuptimin: (1) lavdi Perëndisë në qiell, ose (2) Perëndia në qiell e shpëtoftë (pra, Jezusin).

TEKSTI I NASB (I PËRDITËSUAR): MARKU 11:11

¹¹Jezusi hyri në Jerusalem dhe u fut në tempull; dhe, pasi vështroi rreth e rrotull gjithçka, u largua për në Betani me të dymbëdhjetët, meqë ishte vonë tashmë.

11:11 “tempull” Kjo fjalë (*hieron*) nënkuptonte gjithë zonën e tempullit, jo vetëm pjesën qendrore (Shenjtërorja e Shenjtërore dhe Vendi i Shenjtë).

■ **“ishte vonë tashmë”** Kishin ecur tashmë mbi 30 km nga Jeriko. Zona e tempullit mund të ketë qenë pothuajse e boshatisur në atë orë. Jezusi donte që të gjithë ta shihnin veprimin simbolik të pastrimit dhe rikthimit të tempullit në qëllimin fillestar që i kishte caktuar Perëndia.

TEKSTI I NASB (I PËRDITËSUAR): MARKU 11:12-14

¹²Të nesërmen, pasi lanë Betaninë, Jezusin e zuri uria. ¹³Duke parë nga larg një pemë fiku në gjethe, donte të shihte se mos, ndoshta, gjente diçka në të; dhe kur erdhi te pema, gjeti vetëm gjethe, sepse nuk ishte stina e fiqve. ¹⁴Ai i tha: “Askush mos hëngërt më kurrë nga fryti yt!” Dhe dishepujt po e dëgjonin.

11:12 Jezusi përdori një nevojë të zakonshme (pra, ushqimin) si mundësi për t’u dhënë dishepujve një mësim të fuqishëm për gjykimin dhe refuzimin.

11:13 “pemë fiku” Ju kujtoj se emri i qytetit të Betfages donte të thoshte “shtëpia e fiqve”. Me sa duket, kishte shumë pemë të tilla fiku në këtë zonë.

■ **“në gjethe”** Ka patur shumë diskutime mes komentuesve për këtë pemë fiku dhe pse shkoi aty Jezusi.

1. ndodhej në një zonë të mbrojtur nga era dhe i kishin dalë shpejt gjethet, kështu që mund të kishte fiq të vegjel.
2. gjethet premtinin fryt, por nuk dhanë përmbushje, njësoj si Izraeli
3. Jezusi nuk po kërkonte fiq, por sythat përpara fiqve, që ndonjëherë haheshin (shih F. F. Bruce, *Answers to Questions*, f. 56 ose *Hard Sayings of the Bible*, f. 441-442).

Mendoj se ishte veprim simbolik gjykimi (shih Luka 13:6-9), njësoj si pastrimi i tempullit, kundër judaizmit të kohës së Jezusit, që e kishte qendrën në Jerusalem. Parathoshte shkatërrimin (më 70 pas K.) nga gjenerali romak (më vonë, perandori) Titus dhe gjykimin eskatologjik për shkak se nuk i besuan Jezusit (shih v. 14).

■ **“nuk ishte stina e fiqve”** Ishte stina e Pashkës dhe, zakonisht, në atë kohë nuk kishin dalë ende as gjethet e plota. Kjo frazë tregon natyrën simbolike të kësaj ndodhie. Vini re, gjithashtu, se Jezusi foli me zë të lartë që ta dëgjonin dishepujt. Shpesh, Izraeli simbolizohej si pemë fiku (gjithsesi, zakonisht, përfaqësohej nga vreshtat, shih

Jer. 29:17; Os. 9:10; Joeli 1:7; Mik. 7:1-6). Fakti se pema kishte shumë gjethe tregonte se duhet të kishte prodhuar fryte. Por Izraeli nuk kishte prodhuar fryte! Kjo ndodhi e fikut ndahet në dy pjesë, pasi në mes të saj jepet ngjarja e pastrimit të tempullit; kjo gjë simbolizon gjykimin e Perëndisë kundër sistemit fetar judaik të shekullit të parë dhe krerëve të këtij sistemi (njësoj si ngjarja e pastrimit të tempullit). Është e paqartë nëse në këtë mënyrë u dënua gjithë Izraeli, apo vetëm krerët e paligjshëm (pra, ata saducenj që i kishin blerë postet e tyre nga romakët). Ky gjykim i Izraelit theksohet në Luka 13:6-9 dhe Marku 12:1-12.

11:14 Ky është gjykim i fortë dhe i vazhdueshëm!

TEMË E VEÇANTË: PËRJETË (IDIOMË GREKE) (SPECIAL TOPIC: FOREVER [GREEK IDIOM])

Një frazë idiomatike greke është “në epoka/në jetë të jetëve” (shih Luka 1:33; Rom. 1:25; 11:36; 16:27; Gal. 1:5; 1 Tim. 1:17), që ndoshta reflekton fjalën hebraisht ‘*olam*. Shih Robert B. Girdlestone, *Synonyms of the Old Testament*, f. 319-321, dhe Temën e Veçantë: Përjetë (‘*Olam*).

Fraza të ngjashme janë “përjetësisht” (shih Mat. 21:19; Marku 11:14; Luka 1:55; Gjonit 6:58; 8:35; 12:34; 13:8; 14:16; 2 Kor. 9:9), dhe “në jetë të jetëve” (shih Efe. 3:21). Duket se nuk ka asnjë dallim mes këtyre idiomave greke, që kanë kuptimin “përjetë”. Fjala “epoka” mund të jetë në SHUMËS në kuptimin e firugshëm të një konstrukti gramatikor të rabinëve, që quhej “SHUMËSI MBRETËROR”, ose ndoshta ka parasysh konceptin e disa “epokave” në kuptimin judaik të “epokës së ligësisë”, “epokës së ardhshme”, ose “epokës së drejtësisë” (shih Temën e Veçantë: Kjo Epoka dhe Epoka e Ardhshme).

TEKSTI I NASB (I PËRDITËSUAR): MARKU 11:15-18

¹⁵Pastaj erdhën në Jerusalem. Dhe ai hyri në tempull dhe filloi t’i dëbonte ata që po shisnin e blinin në tempull, dhe ua përmbysi tryezat këmbysesve të parave dhe ndenjëset atyre që po shisnin pëllumba; ¹⁶dhe nuk i lejonte askujt që të mbartte mallra përmes tempullit. ¹⁷Dhe nisi t’i mësonte dhe t’u thoshte: “A nuk është shkruar: ‘Shtëpia ime do të quhet shtëpi lutjeje për të gjitha kombet’? Por ju e keni kthyer në fole kusarësh”. ¹⁸Krerët e priftërinjve dhe skribët e dëgjuan këtë dhe filluan të përpiqeshin sesi ta shkatërronin; sepse ia kishin frikën, ngaqë gjithë turma mahnitej nga mësimet e tij.

11:15 “hyri në tempull” Bëhet fjalë për oborrin e johebrenjve, ku tregtarët kishin stendat e tyre (ato stenda ishin pronë e familjes së kryepriftërinjve). Ungjilli i Gjonit shënon një tjetër rast pastrimi (shih Gjoni 2:13 e më tej). Jezusi nuk ishte gjithmonë ai njeriu i butë që mendojmë!

Ky veprim ua sfidoi autoritetin saducenjve, ashtu si veprimet dhe fjalët e shtegtarëve në hyrjen ngadhënjimtare i sfiduan farisenjtë. Këto veprime e dënuan Jezusin me vdekje (shih Marku 11:18).

■ **“filloi t’i dëbonte ata që po shisnin dhe blinin”** Ky mund të jetë aludim për Zak. 14:21: “atë ditë, nuk do të ketë më asnjë kanaanit (pra, tregtar) në shtëpinë e Zotit të ushtrive”.

■ **“ata që shisnin dhe blinin”** Këta tregtarë përfaqësonin familjen e kryepriftit, i cili e kishte blerë priftërinë dhe të drejtat e dhënies me qira nga Roma (të paktën që nga viti 30 e më tej. Unë mendoj se Jezusi u kryqëzua në vitin 34 pas K.).

■ **“këmbyesit e parave”** Taksa e tempullit kushtonte ½ shekel (shih Eks. 30:13). Në kohën e Jezusit, i vetmi shekel ishte ai i Tirit. Shtegtarët faturoheshin 1/24 e shekelit kur këmbenin monedhat.

■ **“atyre që po shisnin pëllumba”** Një pëllumb ishte flijimi që jepnin të varfrit, lebrozët dhe gratë. Çmimi normal i tij trefishohej kur blihej në këto stenda. Madje dhe kur shtegtarët i sillnin vetë nga shtëpia kafshët e flijimit, zakonisht prifti gjente ndonjë të metë te to dhe i urdhëronte të blinin një kafshë tjetër.

11:16 “nuk i lejonte askujt të mbartte mallra përmes tempullit” Kjo frazë është unike për Markun. Oborri i johebrenjve ishte kthyer në rrugë shkurt mes qytetit dhe malit të Ullinjve. E kishte humbur qëllimin e vet të veçantë fetar si vend ku kombet do të vinin te JHVH.

11:17 “Shtëpia ime do të quhet shtëpi lutjeje për të gjitha kombet” Ky është citim nga Isa. 56:7. Tregon dashurinë universale të Perëndisë. Mateu, që u shkruan judenjve, e lë pa përmendur këtë frazë të fundit.

■ **“fole kusarësh”** Ky është citim nga predikimi i famshëm i Jeremisë në tempull, që u mor me ritualin pa besim dhe me besëtytninë fetare (shih Jer. 7:11). Në emër të fesë, siguroheshin fitime më të mëdha, në vend që tempulli të ishte vend qetësie dhe lutjeje për johebrenjtë. Fjala “kusarë” mund të ketë dhe kuptimin “rebelë”.

11:18 “Krerët e priftërinjve dhe skribët” Familjet e pasura kontrollonin postin e kryepriftit. Ky nuk ishte më post familjar që lidhej me Aaronin, por ishte post që romakët ia shisnin atij që ofronte shumën më të lartë.

■ **“skribët”** Kjo kategori drejtuesish nisi në kohën e Ezrës. Në kohën e Jezusit shumica prej tyre ishin farisenj. Ata interpretonin aspektet praktike të ligjit për popullin e zakonshëm, sidomos në bazë të traditës gojore (pra, Talmudit). Ky grup është i ngjashëm në funksion me rabinin e sotëm. Shih Temën e Veçantë në Marku 2:6.

■ **“filluan të përpiqeshin sesi ta shkatërronin”** Kjo është në kohën e pakryer. Mund të ketë kuptimin “filluan” (shih NASB, TEV), por mund të ketë edhe një tjetër kuptim: ata u përpoqën vazhdimisht, që nga ky çast, që ta vrisnin Jezusin (shih NRSV). Të gjitha foljet në Marku 11:18 janë në kohën e pakryer; bëjnë fjalë për veprime të filluara dhe të vazhduara gjatë kësaj jave të fundit të jetës së Jezusit. Nisin të shfaqen motive të përsëritura. Hyrja Ngadhënjimtare dhe pastrimi i tempullit ia vulosën fatin Jezusit; dhe ai e dinte këtë.

TEKSTI I NASB (I PËRDITËSUAR): MARKU 11:19

¹⁹Kur binte nata, ata dilnin nga qyteti.

11:19 Ky varg, ndoshta, duhet lidhur me paragrafin e Markut 11:15-18. Kjo është një tjetër hollësi prej dëshmitari okular nga ana e Pjetrit. Kjo frazë e shkurtër përmendet ndryshe në disa dorëshkrime greqisht (disa kanë formën shumë, disa kanë njëjës).

TEKSTI I NASB (I PËRDITËSUAR): MARKU 11:20-26

²⁰Teksa kalonin aty pari në mëngjes, panë pemën e fikut, e tharë deri në rrënjë. ²¹Pjetrit iu kujtua dhe i tha Jezusit: “Rabin, shiko, pema e fikut që mallkove është tharë”. ²²Dhe Jezusi u përgjigj dhe u tha: “Kini besim në Perëndinë. ²³Me të vërtetë ju them: kushdo që i thotë këtij mali, ‘Ngrihu dhe hidhu në det’, dhe nuk dyshon në zemër, por beson se ajo që thotë do të ndodhë, do t’i jepet. ²⁴Prandaj, ju them: gjithçka për të cilën luteni dhe kërkonti, besoni se do ta keni marrë, dhe do t’ju jepet. ²⁵Kurdoherë që qëndroni në këmbë dhe luteni, falni nëse keni diçka kundër dikujt, në mënyrë që edhe Ati juaj, që është në qiell, t’ju falë shkeljet”. ²⁶[Por, nëse nuk falni, as Ati juaj, që është në qiell, nuk do t’juaj falë shkeljet].]

11:20 “Teksa po kalonin aty pari” Ndoqën të njëjtën rrugë nga Betania në Jerusalem.

■ **“e tharë deri në rrënjë”** Kjo ishte shenja e refuzimit të plotë të Izraelit (shih Marku 12:1-12), ose të paktën e krerëve të tij të atëhershëm.

11:21 “Pjetrit iu kujtua” Pjetrit i kujtohet shumë mirë ndodhia!

11:22 “Jezus u përgjigj dhe u tha” Pjetri veproi sërish si folës i mendimeve të të gjithë dishepujve.

■ **“Kini besim në Perëndinë”** Kjo është urdhërore e tashme veprare. Është motiv i përhapur në ungjill. Besimi (pra, emri, *pistis*; folja *pisteuo*; shih Temën e Veçantë në Marku 1:15) në JHVH (dhe në Mesinë e tij) është shpresa e vetme e njerëzimit të rënë. Ky sistem i tanishëm botëror, bashkë me strukturat e pushtetit të tij, nuk duhet të na e shpërqendrojë vëmendjen. Perëndia është me ne dhe na ndihmon. Shihni drejt tij, vetëm drejt tij!

Ky akt simbolik gjykimi dhe mohimi preku gjithë sistemin e tyre tradicional të besimit. Kushedi sa radikale ishin mësimet dhe pikëvështrimet e reja të Jezusit për këta burra judenj tradicionalë të shekullit të parë!

Jezusi e refuzoi fuqishëm dhe qartazi tempullin (në formën që funksiononte atëherë) dhe krerët e popullit, si saducenjtë ashtu dhe farisenjtë (pra, si liberalët, Hilelin, ashtu dhe konservatorët, Shamain).

Ekziston një variant tekstual në dorëshkrimt greke, që shton pjesëzën kushtore greke *ei* (pra, “nëse”), posaçërisht në Sinaitikus dhe në D. Kjo do ta kthente në një fjali kushtore të rendit të parë. Sidoqoftë, prania e kësaj pjesëze mund të jetë një idiomë hebraike që nënkupton citim të drejtpërdrejtë. Nuk përfshihet në dorëshkrimet A, B, C, L dhe W, dhe nuk përkthehet e tillë në asnjë version anglisht të Biblës së përdorur në këtë komentat. Ndoshta, këtë shtesë e bënë disa skribë që donin ta bënin të dukej plotësisht si Luka 17:6, ose si Mat. 21:21 (që ka *ean*, në vend të *ei* [te Luka]).

11:23 “Me të vërtetë” Fjalë për fjalë, “amen”. Shih Temën e Veçantë në Marku 3:28.

▣ **“këtij mali”** Ndoshta, (1) bëhej fjalë për vetë malin e Ullinjve (shih Zak. 14:4), ose (2) përdoret si figurë letrare në Zak. 4:7. Kjo frazë ishte metaforë e njohur rabinike për largimin e vështirësive.

Në DHV, kjo lloj gjuhe “rrafshuese” përdorej shpesh për të përshkruar ardhjen e JHVH-së (shih Mik. 1:3-40; Hab. 3:6). Ai do të ishte i disponueshëm për gjithë tokën kur të rrafshoheshin malet (shih Zak. 14:4) dhe luginat do të mbusheshin, lumenjtë dhe detet do të thaheshin, në mënyrë që të gjithë të shkonin tek ai në Jerusalem. Kjo gjuhë metaforike nga natyra zëvendësohet në DHV nga nevojtarët, që shkojnë te Jezusi, jo në Jerusalem. Në DHR, “Jerusalemi” në Palestinë bëhet “Jerusalemi i ri”, qyteti i shenjtë që zbret nga qielli. DHR i ka universalizuar profecitë e DHV që jepeshin vetëm për Jerusalem dhe Palestinën gjeografike.

▣ **“në det”** Ndoshta, bëhet fjalë për Detin e Vdekur, që është i dukshëm nga mali i Ullinjve.

▣ **“nuk dyshon”** Besimi është faktor kyç në lutje (shih Jakobi 1:6-8).

▣ **“zemër”** Shih Temën e Veçantë në Marku 2:6.

11:23-24 “do t’i jepet” Kjo thënie duhet drejtpeshuar me thëniet e tjera biblike për lutjen. Ky është shembull i mirë i arsyes pse nuk duhet ta përdorim një varg të vetëm si tekst-provë dhe të themi: “Kështu thotë Bibla; kjo e mbyll debatin”. Bibla thotë shumë gjëra të tjera për lutjen. Gjëja më e keqe që Perëndia mund t’u bënte shumicës së të krishterëve është t’u përgjigjej pozitivisht të gjitha lutjeve të tyre! Zakonisht, lutemi për gjëra të gabuara. Të lutem, lexo dhe medito për Temën e Veçantë më poshtë për “Lutjen e Efektshme”.

TEMË E VEÇANTË: LUTJA E EFEKTSHME (SPECIAL TOPIC: EFFECTIVE PRAYER)

A. Në lidhje me marrëdhënien personale të njeriut me Perëndinë triun

1. Lidhur me vullnetin e Atit
 - a. Mat. 6:10
 - b. 1 Gjonit 3:22
 - c. 1 Gjonit 5:14-15
2. Banimi në Jezusin
Gjoni 5:17
3. Lutja në emrin e Jezusit
 - a. Gjoni 14:13, 14
 - b. Gjoni 15:16
 - c. Gjoni 16:23-24
4. Lutja në Frymë
 - a. Efe. 6:18
 - b. Juda 20

B. Në lidhje me motivet personale

1. Pa u lëkundur
 - a. Mat. 21:22
 - b. Jakobi 1:6-7
2. Kur lutesh gabim

Jakobi 4:3

3. Lutja pa egoizëm
Jakobi 4:2-3

C. Në lidhje me zgjedhjet personale

1. Qëndresa
 - a. Luka 18:1-8
 - b. Kolosianëve 4:2
 - c. Jakobi 5:16
2. Mosmarrëveshjet në familje
1 Pjetrit 3:7
3. Mëkati
 - a. Psalmi 66:18
 - b. Isaia 59:1-2
 - c. Isaia 64:7

Të gjitha lutjet marrin përgjigje, por jo çdo lutje është e efektshme. Lutja është marrëdhënie me dy kahe. Gjëja më e keqe që mund të bënte Perëndia do të ishte t'u përgjigjej lutjeve të papërshtatshme të besimtarëve. Shih Temën e Veçantë: Lutja Ndërmjetësuese në Kol. 4:3. Shih Temën e Veçantë: Lutja Ndërmjetësuese në 1 Gjonit 5:14. Skicën e gjeni te www.freebiblecommentary.org.

11:24 “do ta keni marrë” Ka një variant tekstual në lidhje me kohën e foljes *lambano*. Aoristja, që reflekton një fjalë hebraishte që përdorej për përmbushjen e pritshme, gjendet në dorëshkrimet Sinaitikus, B, C, L dhe W. Me sa duket, disa kopjues e ndryshuan këtë (1) në kohën e ardhme që të përputhet me Mat. 21:22 (shih dorëshkrimet D dhe Vullgatën), ose (2) në kohën e tashme (dorëshkrimi A dhe përkthimi armenisht).

11:25 “Kurdoherë që qëndroni në këmbë dhe luteni” Qëndrimi normal për lutje ishte qëndrimi në këmbë me sy hapur dhe me kokën dhe krahët e ngritura. Judenjtë luteshin si të bisedonin me Perëndinë.

■ **“falni nëse keni diçka kundër dikujt”** Falja e të tjerëve është prova, jo baza, e faljes sonë (shih Mat. 5:7; 6:14-15; 7:1-2; 18:21-35; Luke 6:36-37; Efe. 4:32; Col. 3:13; Jakobi 2:13; 5:9). Njeriu që s'fal nuk e ka takuar kurrë Perëndinë!

■ **“nëse”** Kjo është fjali kushtore e rendit të parë. Shpesh, besimtarët mbajnë inate. Njohja e Perëndisë në Krishtin duhet t'i ndryshojë këto qëndrime. Neve na është falur kaq shumë; si mund t'i trajtojmë të tjerët, që janë në shëmbëllimin e Perëndisë, me përcimim dhe me zemërim të vazhdueshëm?

■ **“Ati juaj, që është në qiell”** Jeusi fliste aramaisht, që do të thotë se shumë vende ku në greqisht përdoret fjala “Atë”, *Pater*, fjala aramaisht e përdorur ishte *Abba* (shih Marku 14:36). Kjo fjalë familjare, “Babi”, ose “Baba”, pasqyron marrëdhënien e ngushtë të Jezusit me Atin; fakti se ai ua zbulon këtë gjë dhe ndjekësve të vet, na nxit që të kërkojmë dhe ne këtë lloj marrëdhënie të ngushtë me Atin. Fjala “Atë” përdorej vetëm për JHVH-në në DHV, por Jezusi e përdor shpesh dhe vazdimisht. Kjo është zbuluesë e rëndësishme e marrëdhënies sonë të re me Perëndinë përmes Krishtit.

11:26 Ky varg mungon në dorëshkrimet uncial greke Sinaitikus, B, L dhe W. Përfshihet me disa ndryshime në dorëshkrimet A, D, K, X dhe në përkthimin Peshitta dhe në Diatessaron (pra, katër ungjijtë e shkrirë në një). Me sa duket, një kopjues i lashtë e shtoi këtë frazë nga Mat. 6:15.

TEKSTI I NASB (I PËRDITËSUAR): MARKU 11:27-33

²⁷Erdhën sërish në Jerusalemin. Dhe, teksa Jezusi po ecte në tempull, kryepriëtorinjtë, skribët dhe pleqtë erdhën tek ai, ²⁸dhe filluan t'i thoshin: “Me ç' autoritet po i bën këto gjëra, ose kush ta dha këtë autoritet që t'i bësh këto gjëra?” ²⁹Dhe Jezusi u tha: “Do t'ju bëj një pyetje, m'u përgjigjini dhe pastaj, do t'ju them me ç' autoritet i bëj këto gjëra. ³⁰A ishte pagëzimi i Gjonit nga qielli, apo nga njerëzit? M'u përgjigjini”. ³¹Ata nisën të arsyetonin me njëri-tjetrin duke thënë: “Nëse themi, ‘nga qielli’, ai do të thotë:

‘Atëherë pse nuk e besuat?’³²Por a do të themi, ‘nga njerëzit?’ – ata kishin frikë nga populli, sepse të gjithë mendonin se Gjoni kishte qenë profet i vërtetë.³³Iu përgjigjën Jezusit dhe i thanë: “Nuk e dimë”. Dhe Jezusi u tha: “As unë nuk do t’jua them me ç’autoritet i bëj këto gjëra”.

11:27 “Erdhën sërisht në Jerusalem” Kjo duket se nënkupton që ata ishin largoheshin nga Jerusalemi për t’i kaluar netët në Betani, ndoshta në shtëpinë e Lazarit, Marisë dhe Martës.

▣ **“po ecte në tempull”** E përfytyroni dot si po e vështrojnë tregtarët! Jezusi nuk i fshihej përballjes, dhe as nuk e shmange. Ky ishte çasti i ndikimit të tij mbi Jerusalemin.

▣ **“kryepriiftërinjtë, skribët dhe pleqtë”** Kjo ishte përbërja e gjithë Sinedrit. Ai ishte një grup zyrtar sundues prej shtatëdhjetë anëtarësh në Jerusalem; u zhvillua nga Sinagoga e Madhe e kohës së Ezrës. Përbëhej nga Kryepriifti dhe familja e tij, skribët vendas, si dhe pleqtë e pasur dhe me ndikim në zonën e Jerusalemit. Shih Temën e Veçantë në Marku 12:13.

11:28 “Me ç’autoritet po i bën këto gjëra” Kjo ka qenë dhe mbetet pyetja kyçe në lidhje me Jezusin. Nga e mori pushtetin dhe autoritetin për të folur dhe vepruar? Jezusi nuk përputhej me kallëpin e tyre për atë që do të thoshte dhe bënte Mesia!

11:29 Jezusi e përdorte shpesh këtë teknikë (pra, përgjigjen e pyetjes me pyetje) kur fliste me ata që përpiqeshin ta mashtronin ose ta fusnin në kurth (shih Marku 2:6-9, 19, 25-26; 3:23-24; 10:3, 37-39; 12:14-16). Ai do të tregojë i hapur me ta nëse ata do të tregoheshin të hapur me të (shih Marku 11:33).

11:30 “A ishte pagëzimi i Gjonit nga qielli?” Jezusi iu përgjigj pyetjes së tyre me një pyetje për refuzimin që ata i bënë Gjon Pagëzorit. Ata nuk po kërkonin realisht të vërtetën (shih Marku 11:31-33). Ishin më shumë të preokupuar për reputacionin dhe ruajtjen e pushtetit të tyre (shih Marku 11:32).

11:31 “nëse” Kjo është fjali kushtore e rendit të tretë, që nënkupton veprim të mundshëm.

11:33 Jezusi u përgjigjet me shëmbëlltyrën e Markut 12:1-12, që është një nga dënimet më të rënda të Izraelit dhe krerëve të tij në gjithë DHR.

PYETJE PËR DISKUTIM

Ky është një komentuar studimor udhëzues, që do të thotë se ti je vetë përgjegjës për interpretimin e Biblës. Secili prej nesh duhet të ecë sipas dritës që ka. Ti, Bibla dhe Fryma e Shenjtë keni përparësi në interpretim. Nuk duhet t’ia dorëzosh këtë të drejtë komentuesit.

Këto pyetje për diskutim t’i kam dhënë për të të ndihmuar që të analizosh çështjet kryesore të kësaj pjese të librit. Ato synojnë të të nxisin mendimin, jo të kenë natyrë shteruese.

1. Çfarë na zbulon ky kapitull për Jezusin?
2. Pse e pranoi Jezusi titullin “Biri i Davidit”?
3. Ç’lidhje ka besimi me shërimin?
4. Pse është kaq e rëndësishme Hyrja Ngadhënjimtare?
5. Ç’kuptim kishin bëritjet e turmës?
6. Pse e mallkoi Jezusi pemën e fikut?
7. Pse i dëboi Jezusi tregtarët? A ishte hera e parë kjo?
8. Pse nuk e ndaloi Jezusin policia e tempullit?
9. A mund t’i kërkojmë gjithçka Perëndisë? Ç’lidhje ka besimi ynë me lutjen që merr përgjigje?
10. Pse është kaq pyetje kyçe Marku 11:28?

MARKU 12

NDARJET NË PARAGRAFË TË PËRKTHIMEVE MODERNE

UBS ⁴	NKJV	NRSV	TEV	NJB
Shëmbëlltyra e vreshtit dhe vreshtarëve 12:1-11	Shëmbëlltyra e vreshtarëve të këqinj 12:1-12	Shëmbëlltyra e vreshtit 12:1-11	Shëmbëlltyra e vreshtarëve të vreshtit 12:1-8 12:9-11	Shëmbëlltyra e vreshtarëve të këqinj 12:1-11
12:12		12:12	12:12	12:12
Paguaja taksat Cezarit 12:13-17	Farisenjtë: a është e ligjshme t'i paguajmë taksa Cezarit? 12:13-17	Paguaja taksat Cezarit 12:13-17	Pyetja për pagesën e taksave 12:13-14 12:15 12:16a 12:16b 12:17a 12:17b	Për taksat për Cezarin 12:13-17
Pyetja për ringjalljen 12:18-27	Saducenjtë: Po ringjallja? 12:18-27	Pyetjet për ringjalljen 12:18-23 12:24-27	Pyetja për ngritjen nga vdekja 12:18-23 12:24-27	Ringjallja e të vdekurve 12:18-23 12:24-27
Urdhërimi i madh 12:28-34	Skribët: Cili është urdhërimi më i lartë? 12:28-34	Urdhërimi i madh 12:28-34	Urdhërimi i madh 12:28 12:29-31 12:32-33 12:34	Urdhërimi më i madh nga të gjithë 12:28-34
Pyetja për Birin e Davidit 12:35-37	Jezusi: Si mund ta quajë Davidi pasardhësin e vet Zot? 12:35-37	Biri i Davidit 12:35-37	Pyetja për Mesinë 12:35-37a	Jezus, jo vetëm Bir, por edhe Zot i Davidit 12:35-37
Demaskimi i skribëve 12:38-40	Ruhuni nga skribët 12:38-40	Thëniet për krenarinë dhe përuljen 12:38-40	Jezusi paralajmëron në lidhje me mësuesit e ligji 12:37b-40	Skribët dënohen nga Jezusi 12:38-40
Oferta e vejushës 12:41-44	Dy monedhat e vejushës 12:41-44	Oferta e vejushës 12:41-44	Oferta e vejushës 12:41-44	Monedha e vejushës 12:41-44

CIKLI TRE I LEXIMIT (shih f. v)

NDJEKJA E SYNIMIT TË AUTORIT FILLESTAR NË NIVELIN E PARAGRAFËVE

Ky është një komentuar studimor udhëzues, që do të thotë se ti je vetë përgjegjës për interpretimin e Biblës. Secili prej nesh duhet të ecë sipas dritës që ka. Ti, Bibla dhe Fryma e Shenjtë keni përparësi në interpretim. Nuk duhet t'ia dorëzosh këtë të drejtë komentuesit.

Lexo gjithë kapitullin njëherësh. Identifiko temat. Krahaso ndarjet e tua tematike me pesë përkthimet moderne. Ndarja në paragrafë nuk është e frymëzuar, por është çelësi për të ndjekur synimin e autorit fillestar, gjë që është thelbi i interpretimit. Secili paragraf ka vetëm një temë të vetme.

1. Paragrafi i parë
2. Paragrafi i dytë
3. Paragrafi i tretë
4. Etj.

PASAZHET PARALELE NË UNGJIJTË SINOPTIKË:

- A. Përfaqësuesit e Sinedrit bëjnë pyetje (shih Marku 11:27-12:12) dhe Jezusi u përgjigjet me një shëmbëlltëri (Marku 12:1-12). Pasazhet paralele gjenden në Mat. 21:33-46 dhe Luka 20:1-19.
- B. Farisenjtë dhe herodianët pyesin për taksat që duhet t'ia paguajnë Cezarit (Marku 12:13-17); pasazhet paralele gjenden në Mat. 22:15-22 dhe Luka 20:20-26.
- C. Saducenjtë bëjnë një pyetje për ringjalljen (Marku 12:18-27); pasazhet paralele gjenden në Mat. 22:23-33 dhe Luka 20:27-40.
- D. Një skrib pyet për urdhërimin më të madh (Marku 12:28-34); pasazhi paralel gjendet në Mat. 22:34-40.
- E. Jezusi u bën krerëve judenj një pyetje për marrëdhënien e Mesisë me Davidin (Marku 12:35-37); pasazhi paralel gjendet në Mat. 22:41-46 dhe Luka 20:41-44.
- F. Jezusi demaskon skribët (Marku 12:38-40); paralelet janë në Mat. 23:1-39 dhe Luka 20:45-47.
- G. Oferta sakrifikuase e vejushës (Marku 12:41-44) gjendet dhe në Luka 21:1-4.

STUDIMI I FJALËVE DHE FRAZAVE

TEKSTI I NASB (I PËRDITËSUAR): MARKU 12:1-11

¹Dhe ai filloi t'u fliste me shëmbëlltëra: "Një burrë kishte një vresht dhe e rrethoi me një mur, gërmoi një vend për shtrydhjen e rrushit, ndërtoi një kullë dhe ua dha me qira vreshtarëve dhe iku në një udhëtim. ²Në kohën e të vjelave dërgoi një skllav të vreshtarët, me qëllim që të merrte disa nga prodhimet e vreshtit prej vreshtarëve. ³Ata e kapën, e rrahën dhe e kthyen duarbosh. ⁴Sërish, ai u dërgoi një tjetër skllav; ata e plagosën në kokë dhe e trajtuan turpshëm. ⁵Pastaj u dërgoi një tjetër dhe atë e vranë; dhe kështu bënë me shumë të tjerë. Disa i rrahën, disa i vranë. ⁶I mbeti dhe një për të dërguar, të birin e tij të dashur; e dërgoi të fundit fare, dhe tha: "Tim bir do ta respektojnë". ⁷Por ata vreshtarët i thanë njëri-tjetrit: "Ky është trashëgimtari; ejani, ta vrasim dhe trashëgimia të na mbetet neve!" ⁸E morën të birin, e vranë dhe e flakën jashtë vreshtit. ⁹Çfarë do të bëjë i zoti i vreshtit? Do të vijë, do t'i shkatërrojë vreshtarët dhe vreshtin do t'u japë të tjerëve. ¹⁰As nuk e keni lexuar këtë shkrim: 'Guri, që ndërtohet e hodhën poshtë, u bë guri i qoshes; ¹¹Kjo ndodhi nga Zoti, dhe është e mrekullueshme për sytë tanë?'"

■ "t'u fliste me shëmbëlltëra" "t'u fliste" bën fjalë drejtpërdrejt për përfaqësuesit e Sinedrit (shih Marku 11:27), dhe tërthorazi turmës së madhe.

Gjithë ky kapitull përmban një sërë pyetjesh nga krerët fetarë:

1. nga Sinedri (Marku 11:27-12:12)
2. nga farisenjtë dhe herodianët (Marku 12:13-17)
3. nga saducenjtë (Marku 12:18-27)
4. nga një skrib (Marku 12:28-34)
5. nga Jezusi (Marku 11:29-33; 12:9, 35-37)

■ **“mbolli një vresht dhe e rrethoi me një mur, gërmoi një vend për shtrydhjen e rrushit, ndërtoi një kullë”** Ky është citim nga Septuaginta e Isa. 5:1-2. Hardhia ishte një nga simbolet e kombit të Izraelit (si pema e fikut në Marku 11:12-14, 20-25). Isaia 5 përdor një këngë popullore për vreshtin për t’iu drejtuar Izraelit. Mateu përfshin disa shëmbëlltyra të tjera, që i drejtohen sërish kombit të Izraelit (shih Mat. 22:1-14). Është e vështirë të përcaktosh nëse Perëndia hodhi poshtë

1. krerët e paligjshëm jo-aaronikë të Izraelit
2. legalimin e tyre egoist dhe gjykues
3. mosbesimin e kombit në tërësi. Edhe Izraeli, me gjithë privilegjet e tij nga besëlidhja (shih Rom. 9:4-5), ishte përgjegjës për detyrat e besëlidhjes së Moisiut (shih Ligji i Përtërirë 27-28).

Është e habitshme sa thellësisht ndryshon procedura e Isaisë 5 (për dashurinë falas dhe të disponueshme të Perëndisë për gjithë ata që shkojnë tek ai) nga dhuna e këtyre vreshtarëve në këtë shëmbëlltyrë.

12:2 “Në kohën e të vjelave” Zakonisht, duheshin të paktën pesë vjet që vreshat të fillonin të jepnin prodhime në nivelin fitimprurës. Pronari duhet të merrte pjesën e vet nga ky investim.

12:2, 4, 5, 6 “dërgoi” Perëndia u përpoq të komunikonte duke u dërguar një sërë përfaqësuesish, madje dhe birin e vet. Kjo tregon durimin e Perëndisë dhe dëshirën e tij që të krijonte një marrëdhënie besëlidhjeje.

12:2, 4, 5 “një skllav” Këta skllavër simbolizojnë profetët e DHV. Mateu, siç e ka zakon, përmend dy skllavër (shih Mat. 21:34). Ky pasazh tregon qartë sesi Mateu e kombinon rrëfimin e Markut për disa skllavër me radhë në një moment të vetëm.

12:3 “e rrahën” Bëhet fjalë për rrahje të rëndë. Fjalë për fjalë, do të thotë “rrjep lëkurën” (shih Marku 13:9).

12:4 “e plagosën në kokë” Bëhet fjalë për goditje të vazhdueshme në kokë. Tregon dhunën që pësuan ata që përfaqësonin Perëndinë dhe i folën në emër të tij (pra, profetët e DHV) popullit rebel të besëlidhjes.

■ **“e trajtuan turpshëm”** Kjo është forma foljore e emrit “Timote”, që do të thotë “nder” ose “vlerë” me alfa mohore. Do të thotë “trajtoj me përçmim”, ose “me mungesë të plotë respekti” (shih Jakobi 2:6).

12:5 Pse u dërgoi Perëndia shërbëtor pas shërbëtorit? Perëndia e krijoi njerëzimin me një qëllim: të kishte bashkësi me të. Ai dëshiron të krijojë një popull për vete, por ata nuk duan. Megjithatë, Perëndia përpique vazhdimisht që të na afrohet! Ai ka “një dashuri që nuk heq dorë” nga krijimi i tij.

12:6 “I mbeti dhe një për të dërguar” Qartazi, bëhet fjalë për Jezusin. Kjo frazë përdoret dhe nga Ati në pagëzimin e Jezusit (Mat. 1:11; 3:17) dhe në shndërrimin në mal (9:7; Mat. 17:5). Kjo e vërtet shihet dhe në Gjoni 3:16 dhe Heb. 1:1-2. Është kombinim i një Psalmi mbretëror (Psa. 2:7) me pasazhin për Shërbëtorin e Përvuajtur (Isa. 42:1).

12:7 “dhe trashëgimia do të na mbetet neve” Bëhet fjalë ligjërish për ligjin judaik të “pronës pa pronar”, që mund ta merrte dikush tjetër për shkak të zotërimit të saj. Kjo pasqyron qëndrimin mëkatar të njerëzimit që të ketë “gjithnjë e më tepër pa asnjë çmim”. Njerëzimi dëshiron të bëhet perëndia i vetes (shih Zan. 3).

12:8 “e flakën jashtë vreshtit” Mosvarrosja e duhur tregon përçmimin e plotë të vreshtarëve ndaj pronarit dhe të birit!

Pasazhet paralele në dy ungjijtë e tjerë përshkruajnë radhën si ndodhi kjo: e flakën të birin jashtë vreshtit dhe, pastaj, e vranë (shih Mat. 21:39; Luak 19:15). Ndoshta, këtë e bënë që ta tregonin edhe më qartë vdekjen e Jezusit jashtë mureve të qytetit të Jerusalemit.

12:9 Ky varg tregon përgjigjen e Perëndisë ndaj atyre që vranë Birin e tij të vetëm. Në ungjillin e Markut, Jezusi i bën turmës një pyetje. Kjo reflekton Isa. 5:3-4, ku profeti bën një pyetje. Dëgjuesit dënohen nga vetë goja e tyre (shih Mat. 21:41). Perëndia do t’i kërkojë llogari gjithë krijesës së tij të vetëdijshme për dhuratën e jetës. Ata do të korrin atë që kanë mbjellë (shih Marku 4:21-25; Mat. 13:12; 25:14-30; Gal. 6:7).

■ **“vreshtin do t’ua japë të tjerëve”** “Të tjerët” mund të bëjë fjalë për kishën, që përbëhet nga judenjtë dhe johebrenjtë besimtarë (shih Efe. 2:11-3:13).

12:10 “As nuk e keni lexuar këtë shkrim?” Kjo është hyrja e Jezusit për një varg që përdorej çdo vit në procesionet e tyre kur mirëprisnin shtegtarët në Jerusalem (shih Psa. 118:22-23). Kjo pyetje është motiv i përsëritur në DHR (shih Mat. 21:42; Luka 20:17; Veprat 4:11; Rom. 9:32-33; 1 Pje. 2:7). Ajo shpjegon problemin sesi Izraeli mund ta humbasë Mesinë e vet (shih Rom. 9-11). Kjo thënie është shuplakë në fytyrën e pikërisht atyre që pretendonin se e njihnin Shkrimin!

■ **“guri”** Ky është citim i Psa. 118:22-23 nga Septuaginta. Në shkrimet rabinike, ky gur bënte fjalë për Abrahamin, Davidin, ose Mesinë (shih Dan. 2:34-35). Po ky psalm citohej edhe si pjesë e Psalmeve halel, që përdorehin për t’i mirëpritur shtegtarët që vinin në Jerusalem për Pashkë.

■ **“ndërtuesit”** Në shkrimet rabinike kjo fjalë përdorej për skribët. Komentet që shtoi Jezusi përmenden në Mat. 21:43-44. Vini re këtu se ndërtuesit dënohen ngaqë nuk rrokën të vërtetën më të rëndësishme: Jezusi është Mesia i premtuar.

■ **“guri i qoshes”** Metafora e Mesisë si gur vjen nga një sërë prodërimesh të DHV.

1. forca dhe qëndrueshmëria e JHVH-së (shih Psa. 18:1-2).
2. Vegimi i Danielit në kapitullin 2 (shih Dan. 2:34-35, 48)
3. Përbërësi i ndërtesës që
 - a. Nis ndërtesën (pra, guri i themelit)
 - b. Mban peshën e ndërtesës (pra, guri i qendrës, ose guri kryesor i harkut)
 - c. Përfundon ndërtesën (pra, guri i majës, ose i kreut)

Ndërtesa nënkupton metaforikisht popullin e Perëndisë, tempullin e vërtetë (shih 1 Kor. 3:16-17; 2 Kor. 6:16; Efe. 2:19-22).

TEMË E VEÇANTË: “GUR” (BDB 6, KB 7) dhe “GUR THEMELI” (BDB 819, KB 944) (SPECIAL TOPIC: CORNERSTONE)

- I. Përdorimet në DHV
 - A. Koncepti i gurit si material i fortë dhe i durueshëm, që përbën lëndë të shkëlqyer për themel, përdorej për të përshkruar JHVH-në (shih Jobi 38:6; Psa. 18:2 përdor dy fjalë që kanë kuptimin “shkëmb”, BDB 700, 849).
 - B. Më tej, u zhvillua si titull mesianik (shih Zan. 49:24; Psa. 118:22; Isa. 28:16).
 - C. Fjala “gur” ose “shkëmb” më vonë u përdor për të nënkuptuar gjykimin që do të vijë nga JHVH me anë të Mesisë (shih Isa. 8:16 [BDB 6 “Construct”, BDB 103]; Dan. 2:34-35, 44-45 [BDB 1078]).
 - D. Më vonë, u zhvillua si metaforë ndërtimi (sidomos Isa. 28:16).
 1. Guri i themelit, që vendosej i pari, ishte i sigurt dhe përcaktonte këndet për gjithë godinën. Quhet dhe “guri i qoshes”
 2. Mund të ketë edhe kuptimin e gurit të fundit që vendosej në ndërtesë, sepse mbante muret të lidhur me njëri-tjetrin (shih Zak. 4:7; Efe. 2:20, 21). Quhet “guri i kreut”, nga hebraishaj *rosh* (pra, krye, kokë)
 3. Mund të ketë dhe kuptimin “guri kyç”, që vihej në qendër të harkut mbi portën, sepse mbante peshën e gjithë murit
- II. Përdorimet në DHR
 - A. Jezusi e citoi disa herë Psalmin 118 për t’iu referuar vetes (shih Mat. 21:41-46; Marku 12:10-11; Luka 20:17)
 - B. Pali e përdor Psalmin 118 në lidhje me refuzimin që i bëri JHVH Izraelit të pabesë dhe rebel (shih Rom. 9:33)
 - C. Pali e përdor konceptin e “gurit të qoshes” në Efe. 2:20-22 në lidhje me Krishtin

D. Pjetri e përdor këtë koncept për Jezusin në 1 Pje. 2:1-10. Jezusi është guri i qoshes, ndërsa besimtarët janë gurë të gjallë (pra, janë tempull, shih 1 Kor. 6:19), të ndërtuar mbi të (pra, Jezusi është Tempulli i ri, shih Marku 14:58; Mat. 12:6; Gjoni 2:19-20). Judenjtë e hodhën poshtë themelin e shpresës së tyre kur refuzuan Jezusin si Mesi.

III. Thënie teologjike

- A. JHVH e lejoi Davidin/Solomonin që t'i ndërtonte një tempull. Iu tha se, nëse do ta respektonin besëlidhjen, do t'i bekonte dhe do të ishte me ta (shih 2 Sam. 7), por nëse nuk bindeshin, tempulli do të rrënohej (shih 1 Mbre. 9:1-9)!
- B. Judaizmi rabinik fokusohej te forma dhe ritualet, por anashkalonte aspektin personal të besimit (shih Jer. 31:31-34; Ezek. 36:22-38). Perëndia kërkon një marrëdhënie të përditshme, personal dhe të perëndishme me ata që ka krijuar në shëmbëllimin e vet (shih Zan. 1:26-27). Luka 20:17-18 përmban fjalë të frikshme gjykimi (si dhe Mat. 5:2), që i drejtohen judaizmit.
- C. Jezusi e përdori konceptin e tempullit për të trupin e vet fizik (shih Gjoni 2:19-22). Kjo vazhdon dhe zgjerohet më tej konceptin e besimit personal në Jezusin si Mesi; ky është çelësi për të patur marrëdhënie me JHVH-në (pra, Gjoni 14:6; 1 Gjonit 5:10-12).
- D. Shpëtimi synon të rimëkëmbë shëmbëllimin e dëmtuar të Perëndisë në qeniet njerëzore (Zan. 1:26-27 dhe Zan. 3), që të bëhet e mundur bashkësia me Perëndinë. Synimi i krishterimit është ngjashmëria me Krishtin tani. Besimtarët duhet të jetojnë si gurë të gjallë (pra, tempuj të vegjël të ndërtuar sipas modelit të Krishtit).
- E. Jezusi është guri i themelit dhe guri i kreut të besimit tonë (pra, Alfa dhe Omega). Mirëpo ai është dhe guri i pengimit dhe i skandalit (Isa. 28:16). Po s'pranove atë, ke për të humbur gjithçka. S'mund të ketë terren të ndërmjetëm në këtë gjë!

12:11 Ky varg nënkupton se gjithçk që ndodhi në refuzimin dhe vdekjen e Jezusit ishte e paraditur dhe e profetizuar (shih Isa. 53:10; Luka 22:22; Veprat 2:23; 3:18; 4:28; 1 Pje. 1:20).

TEKSTI I NASB (I PËRDITËSUAR): MARKU 12:12

¹²Dhe ata po përpiqeshin që ta kapnin, por i druheshin popullit, sepse e kuptonin që këtë shëmbëlltë e kishte thënë kundër tyre. Kështu, e lanë dhe u larguan.

12:12 “po përpiqeshin që ta kapnin” Krerët e judenjve e kuptuan se shëmbëlltëra bënte fjalë për ta dhe vepruan në mënyrën e parashikuar (pra, u përpoqën që ta vrisnin).

☐ **“i druheshin popullit”** Këta krerë mendonin për opinionin e momentit (shih Marku 11:18, 32; Mat. 21:26, 46; Luka 19:48), jo për fjalën e Perëndisë, që të vendosnin për veprimet e tyre.

☐ **“e kuptonin që këtë shëmbëlltë e kishte thënë kundër tyre”** Përemri i nënkuptuar “ata” mund të kuptohet në dy mënyra: (1) krerët i druheshin popullaritetit të Jezusit në turmën e popullit (shih Mat. 21:45) ose, (2) edhe turma e kuptonte se këtë shëmbëlltë e kishte për krerët fetarë.

TEKSTI I NASB (I PËRDITËSUAR): MARKU 12:13-17

¹³Pastaj, dërguan tek ai disa nga farisenjtë dhe herodianët që ta fusnin në kurth me fjalë. ¹⁴Erdhën dhe i thanë: “Mësues, e dimë se ti je i vërtetë dhe nuk pyet njeri; sepse ti nuk je i anshëm ndaj askujt, por mëson udhën e Perëndisë me të vërtetë. A është e ligjshme t'ia paguajmë taksën Cezarit, apo jo? ¹⁵T'ia paguajmë apo jo?” Por ai, duke e ditur hipokrizinë e tyre, u tha: “Pse po më vini në provë? Më sillni një dinar që ta shoh”. ¹⁶Ata ia sollën një. Dhe ai u tha: “Fytyra dhe mbishkrimi i kujt është këtu?” Dhe ata i thanë: “e Cezarit”. ¹⁷Dhe Jezusi u tha: “Jepni Cezarit gjërat që janë të Cezarit, dhe Perëndisë, gjërat që janë të Perëndisë”. Dhe ata u mahnitën prej tij.

12:13 “dërguan” Bëhet fjalë për Sinedrin, që ishte autoriteti fetar për judenjtë (shih Marku 11:27).

TEMË E VEÇANTË: SINEDRI (SPECIAL TOPIC: SANHEDRIN)

I. Burime informacioni

A. Vetë Dhiata e Re

B. *Lashtësitë e judenjve*, e Flavius Jozefus

C. Pjesa e Mishnas në Talmud (p.sh., Traktati “Sinedri”)

Fatkeqësisht, DhR dhe Jozefusi nuk përputhen me shkrimet rabinike, të cilat duket se flasin për dy Sinedra në Jerusalem, njëri priftëror (pra, saduceas), i kontrolluar nga Kryepriifti, që trajtonte çështje të drejtësisë civile dhe penale, dhe i dyti, i kontrolluar nga farisenjtë dhe skribët, që trajtonte çështje fetare dhe tradicionale. Megjithatë, shkrimet rabinike datojnë nga viti 200 pas K. dhe pasqyrojnë situatën kulturore pas rënies së Jerusalemit në duart e gjeneralit romak Titi, më 70 pas K. Judenjtë e rithemeluan jetën e tyre fetare në një qytet të quajtur Javne dhe, më pas (pra, 188 pas K.), u transferuan në Galile.

II. Terminologjia

Problemi me identifikimin e këtij trupi gjyqësor lidhet me emra e ndryshëm me të cilët njihet. Ka një sërë fjalësh që përdoren për të përshkruar grupet gjyqësore brenda komunitetit judaik të Jerusalemit.

A. *Gerousia* – “senati” ose “këshilli”. Ky është termi më i vjetër, i cili u përdor nga fundi i periudhës perse (shih *Lashtësitë* e Jozefusit, 12.3.3 dhe *2 Makabejve* 11:27). Ai përdoret nga Luka në Veprat 5:21, së bashku me “Sinedrin”. Mund të ketë qenë mënyrë për t’ua shpjeguar këtë term lexuesve greqishtfolës (shih *1 Mak.* 12:35).

B. *Synedrion* – “Sinedri”. Kjo është një fjalë e përbërë nga *syn* (së bashku me) dhe *hedra* (ndenjësë). Për habi, ky term përdoret në aramaisht, por reflekton një fjalë greqisht. Nga fundi i periudhës makabease, ky ishte bërë termi i pranuar për të përcaktuar gjykatën e lartë të judenjve në Jerusalem (shih Mat. 26:59; Marku 15:1; Luka 22:66; Gjoni 11:47; Veprat 5:27). Problemi del kur e njëjta terminologji përdoret edhe për këshillat gjyqësore lokale jashtë Jerusalemit (shih Mat. 5:22; 10:17).

C. *Presbyterion* – “këshilli i pleqve” (shih Luka 22:66). Ky është një përcaktim i DhV për krerët e fiseve. Gjithsesi, më vonë u përdor për gjykatën e lartë në Jerusalem (shih Veprat 22:5).

D. *Boulē* – Ky term, “këshill”, u përdor nga Jozefusi (p.sh., *Luftërat* 2.16.2; 5.4.2, por jo në DhR) për të përshkruar një sërë entesh gjyqësore:

1. Senati në Romë;
2. gjykatat lokale romake;
3. gjykata e lartë judaike në Jerusalem; dhe
4. gjykatat lokale judaike.

Jozefi i Arimatesë përshkruhet si anëtar i Sinedrit me anë të një forme të këtij termi (pra, *bouleutēs*, që do të thotë “këshilltar”, shih Marku 15:43; Luka 23:50).

III. Zhvillimi historik

Thuhet se, në fillim, Esdra formoi Sinagogën e Madhe (shih Targumi, te Kënga e Këngëve 6:1) në periudhën pas kthimit nga robëria, që duket se u shndërrua në Sinedrin në kohën e Jezusit.

A. Mishna (pra, Talmudi) bën të ditur se kishte dy gjykata madhore në Jerusalem (shih Sanh. 7:1).

1. Njëra përbëhej nga 70 (ose 71) anëtarë (*Sand.* 1:6 madje pohon se Sinedrin e parë e formoi Moisiu te Num. 11, shih Num. 11:16-25).
2. Tjetra përbëhej nga 23 anëtarë (por kjo mund t’u referohet gjykatave të sinagogave lokale).
3. Disa studiues judaikë besojnë se në Jerusalem kishte tre Sinedre me nga 23 anëtarë. Kur këta të tre mblidheshin si një grup, së bashku me dy krerët, përbënin “Sinedrin e Madh” me 71 anëtarë (p.sh., *Nasi* dhe *Av Bet Din*).
 - a. njëri priftëror (pra, saducenjtë)
 - b. tjetri ligjor (pra, farisenjtë)
 - c. tjetri aristokratik (pra, pleqtë)

B. Në periudhën pas kthimit nga robëria, pasardhja e kthyer davidike ishte Zerubabeli ndërsa pasardhja e kthyer aronike ishte Jozueu. Pas vdekjes së Zerubabelit, nuk vazhdoi më pasardhja

davidike, kështu që manteli gjyqësor iu kaloi në mënyrë unike priftërinjve (shih *1 Mak.* 12:6) dhe pleqve lokalë (shih *Neh.* 2:16; 5:7).

- C. Ky rol priftëror në vendimet gjyqësore dokumentohet nga Diodori (40:3:4-5) gjatë periudhës helenistike.
- D. Ky rol priftëror në qeverisje vazhdoi edhe gjatë periudhës seleukase. Jozefusi citon Antiokun “e Madh” II (223-187 para K.) në *Lashtësitë* 12.138-142.
- E. Ky pushtet priftëror vazhdoi edhe gjatë periudhës makabease sipas Jozefusit, *Lashtësitë* 13.10.5-6; 13.15.5.
- F. Gjatë periudhës romake, guvernatori i Sirisë (pra, Gabini, 57-55 para K.) themeloi pesë “Sinedra” rajonale (shih Jozefusi, *Lashtësitë* 14.5.4; dhe *Luftërat* 1.8.5), por kjo u anulua më vonë nga Roma (pra, 47 para K.).
- G. Sinedri pati një përballje politike me Herodin (shih, *Lashtësitë* 14.9.3-5), i cili, më 37 para K., u hakmor dhe vrau shumicën e anëtarëve të gjykatës së lartë (shih, Jozefusi, *Lashtësitë* 14.9.4; 15.1.2).
- H. Nën prokuratorët romakët (pra, 6-66 pas K.), Jozefusi na thotë (shih *Lashtësitë* 20.200.251) se Sinedri fitoi sërish pushtet dhe ndikim të konsiderueshëm (shih Marku 14:55). Në DhR regjistrohen tre gjyqe, ku Sinedri, nën udhëheqjen e familjes së Kryepriftit, ekzekuton drejtësinë.
 - 1. Gjyqi i Jezusit (shih Marku 14:53-15:1; Gjoni 18:12-23, 28-32)
 - 2. Pjetri dhe Gjoni (shih Veprat 4:3-6)
 - 3. Pali (shih veprat 22:25-30)
- I. Kur judenjtë bënë kryengritje më 66 pas K., romakët shkatërruan shoqërinë judaike dhe Jerusalemin më 70 pas K. Sinedri u shkri një herë e përgjithmonë, ndonëse farisenjtë në Javne u përpoqën të rikthenin një gjykatë të lartë juridike (pra, *Beth Din*) në jetën fetare (por jo civile, apo politike) të judenjve.

IV. Anëtarësia

- A. Përmendja e parë biblike e një gjykate të lartë në Jerusalem është 2 Kro. 19:8-11. Ajo përbëhej nga
 - 1. levitët;
 - 2. priftërinjtë; dhe
 - 3. krerët e familjeve (pra, pleqtë, shih 1 Mak. 14:20; 2 Mak. 4:44).
- B. Gjatë periudhës makabease, ajo dominohej nga (1) familjet priftërore të saducenjve dhe (2) aristokracia lokale (shih 1 Mak. 7:33; 11:23; 14:2). Më vonë, në këtë periudhë, “skribët” (juristët e Moisiut, zakonisht farisenj) iu shtuan Sinedrit, me sa duket nga gruaja e Aleksandër Janeut, Salomeja (76-67 para K.). Thuhet se ajo i bëri farisenjtë grupin mbizotërues (shih Jozefusi, *Luftërat e judenjve* 1.5.2).
- C. Në kohën e Jezusit, kjo gjykatë përbëhej nga
 - 1. familjet e kryepriftërinjve
 - 2. burra lokalë të familjeve të pasura
 - 3. skribët (shih Luka 19:47)

V. Burimet e konsultuara

- A. *Dictionary of Jesus and the Gospels* [Fjalori i Jezusit dhe ungjijve], IVP, f. 728-732.
- B. *The Zondervan Pictorial Encyclopedia of the Bible* [Enciklopedia e Pikturuara e Biblës e Zondervan], vëll. 5, f. 268-273.
- C. *The New Schaff-Herzog Encyclopedia of Religious Knowledge* [Enciklopedia e re e njohurisë fetare e Schaff-Herzog], vëll. 10, f. 203-204.
- D. *The Interpreter's Dictionary of the Bible* [Fjalori i interpretuesit të Biblës], vëll. 4, f. 214-218.
- E. *Encyclopedia Judaica* [Enciklopedia judaike], vëll. 14, f. 836-839.

■ **“farisenjtë”** Ky ishte grupi fetar që u formua gjatë periudhës makabease. Ishin shumë të përkushtuar ndaj traditave gojore (pra, Talmudit). Shih Temën e Veçantë: Farisenjtë, në Marku 2:16.

■ **“herodianët”** Ky ishte një grup politik që mbështeste sundimin e Herodëve idumeas. Edhe ata ishin në favor të statukuosë romake. Normalisht, farisenjtë dhe herodianët ishin armiq me njëri-tjetrin. Fakti se po bashkëpunonin tregon se sa të rënda i konsideronin mësimet e Jezusit. Shih Temën e Veçantë: Herodianët, në Marku 1:14.

■ **“që ta fusnin në kurth”** Fjalë për fjalë, “kap”. Përdorej për kapjen me kurth të kafshëve të egra. Ishte bërë metaforë e marrjes së informacionit me qëllim që të vësh në dukje dobësitë ose gabimin e dikujt (shih Luka 11:54). Ata mendonin se, duke i bërë këtë pyetje Jezusit, do ta kapnin si në kurth mes dy grupeve kundërshtarë: autoriteteve romake dhe popullit jude.

12:14 “Mësues, e dimë se ti je i vërtetë dhe nuk pyet njeri; sepse ti nuk je i anshëm ndaj askujt, por mëson udhën e Perëndisë me të vërtetë” Këta krerë po e lajkatonin Jezusin me qëllim që t’i gjenin ndonjë faj, por, në të vërtetë, po thoshin diçka të vërtetë për të. Jezusi e trajtonte të vërtetën njësoj si JHVH. Kjo është dhe ironia më e fortë! Thëniet e tyre masthruese, në të vërtetë, përbënin komplimentin më të madh për të.

■ **“nuk je i anshëm”** Fjalë për fjalë, kjo idiomë hebraishte do të thotë: “sepse nuk vështron fytyrën e njerëzve”. Historikisht, përdorej për gjykatësit e Izraelit. Gjatë gjyqit, i pandehuri e mbante kokën ulur që të mos e njihnin kush ishte. Nëse gjykatësi ia vinte dorën te mjekra dhe ia ngrinte fytyrën që ta shihte kush ishte, mundësia për të treguar anshmëri rritej. Prandaj drejtësia duhet të ishte e verbër!

■ **“A është e ligjshme t’ia paguajmë”** Kjo është pyetje ligjore që lidhje me ligjin e Moisiut, por edhe me pushtimin e atëhershëm të Izraelit nga Roma. Me këtë lloj pyetjeje skribët merreshin përditë. Kishte dy mënyra si t’i përgjigjeshe kësaj pyetjeje: në bazë të pasazheve nga Moisiu, apo në bazë të realitetit të ligjit dhe pushtimit romak. Këta krerë donin baza ligjore për ta futur qeverisjen romake brenda dilemës së tyre fetare (shih Luka 20:20). Po t’i përgjigjej “po”, Jezusi do të fyente zelotët; po t’i përgjigjej “jo”, do të arrestohej gna qeverisja romake.

■ **“taksa”** Është tejskronjzim i fjalës latinisht “census”. Ishte takë për kokë, që Roma ia vendoste gjithë popujve të pushtuar. Kjo taksë për gjithë perandorinë (rreth 6-20 pas K.) për meshkujt 14-65 vjeç dhe për gratë 12-65 vjeç, që jetonin në provincat perandorake, i shkonte drejtpërdrejt perandorit. Kjo ishte arsyeja pse Jozefi u detyrua të linte Nazaretin dhe të shkonte në Betlehem me Marinë shtatzënë (shih Luka 2:1-6).

12:15 “Por ai, duke e ditur hipokrizinë e tyre... pse po më vini në provë” Fjala hipokrizi (*hupokrisis*), në fillim, bënte fjalë për aktorët që, kur aktronin, vinin në fytyrë një maskë. Bënin sikurin dikush tjetër (shih Mat. 23:28; Luka 12:1; 20:20; 1 Tim. 4:2; 1 Pje. 2:1). Më vonë, u përdor për njerëzit mashtrues, që përpiqeshin t’i bënin të tjerët që të mendonin diçka që s’ishte e vërtetë. Gjithçka që këta krerë ia thanë (me ironi) Jezusit në Marku 12:14 kundërshtohet nga veprimet e tyre në Marku 12:15. Fjala “vë në provë” (*peirazo*) kishte dhe ngjyrimin kuptimor të vënies në provë me qëllim shkatërrimin ose dështimin e dikujt. Shih Temën e Veçantë: Fjalët për vëniën në provë, Marku 1:13.

■ **“dinar”** Kjo monedhë argjendi ishte e vetnja mënyrë si mund të paguhej taksa në fjalë. Ishte sa rroga e një dite për një punëtor ose ushtar të zakonshëm. Ishte simbol i kontrollit të Romës. Shih Temën e Veçantë në Marku 12:42.

12:16 “Fytyra dhe mbishkrimi i kuj është këtu” Tiberi (14-37 pas K.) ishte perandori i atëhershëm. Në këtë monedhë ishte një mbishkrim që pretendonte se perandori ishte hyjnor. Në pjesën e përparme të monedhës shkruhej: “Tiber Cezar Augusti, i biri i Augustit Hyjnor”. Në pjesën e pasme të monedhës ishte pamja e Tiberit, i hipur në fron dhe me mbishkrimin “Priifti më i Lartë”.

12:17 “Jepni Cezarit gjërat që janë të Cezarit” Besimtarët duhet t’u binden autoriteteve civile për shkak se kështu ka urdhëruar Perëndia (shih Rom. 13:1-7; Titit 3:1; 1 Pje. 2:13-14). Fjala greqisht “jepni” mund të ketë kuptimin “ktheji dikujt atë që i takon”.

■ **“dhe Perëndisë, gjërat që janë të Perëndisë”** Ndonëse shteti ka vulën hyjnore, nuk ka status hyjnor. Nëse shteti pretendon autoritet absolut, duhet refuzuar nga ndjekësit e Perëndisë së vetëm të vërtetë. Shumë janë

përpjekur që të përkrahin dhe mbështesin doktrinën e sotme politike të ndarjes së shtetit nga kisha në bazë të këtij vargu. Në një kuptim shumë të kufizuar, ky varg i drejtohet vërtet kësaj çështjeje, por sigurisht që nuk përbën mbështetje biblike për këtë teori politike moderne. Kjo teori është një e vërtetë që shihet nga historia, por jo pikësisht nga Bibla.

TEKSTI I NASB (I PËRDITËSUAR): MARKU 12:18-27

¹⁸Disa saducenj (që thonë se nuk ka ringjallje) erdhën te Jezusi dhe filluan ta pyesnin duek i thënë: ¹⁹“Mësues, Moisiu shkroi për ne se, nëse vëllai i një burri vdes dhe lë pas një grua dhe s’ka fëmijë, vëllai i tij duhet të martohet me atë grua dhe të lindë fëmijë për vëllain e tij. ²⁰Ishin shtatë vëllezër; i pari mori një grua dhe vdiq pa lënë fëmijë. ²¹I dyti u martua me të dhe vdiq pa lënë fëmijë; kështu dhe i treti; ²²kështu, të shtatë nuk lanë fëmijë pas. Në fund, vdiq dhe gruaja. ²³Në ringjallje, kur të ngrihen sërish, gruaja e kujt do të jetë ajo? Sepse të shtatë ishin martuar me të”. ²⁴Jezusi ua ktheu: “A nuk është kjo arsyeja pse e keni gabim, pra, se nuk e kuptoni Shkrimin dhe fuqinë e Perëndisë? ²⁵Sepse kur të ringjallen nga vdekja, as nuk do të martohen, as nuk do të jepen për martesë, por do të jenë si engjëjt në qiell. ²⁶Por në lidhje me faktin se të vdekurit ngjallen sërish, a nuk e keni lexuar në librin e Moisiut, në pasazhin për shkurren që digjej, sesi i foli Perëndia dhe i tha: ‘Unë jam Perëndia i Abrahamit, Perëndia i Isakut dhe Perëndia i Jakobit’? ²⁷Ai nuk është Perëndi i të vdekurve, por i të gjallëve; e keni plotësisht gabim”.

12:18 “saducenj” Ky ishte një sekt aristokrat dhe priftëror i judaizmit, që kishte në dorë kryepriftërinë dhe Sinedrin. Ishte një grup i pasur, i fuqishëm politikisht dhe kishin çdo gjë në dorë. Ishin shumë konservatorë dhe pranonin si të autoritetshme vetëm shkrimet e Moisiut (pra, Zanafilla—Ligji i Përtërirë); pra, e refuzonin traditën gojore.

TEMË E VEÇANTË: SADUCENJTË (SPECIAL TOPIC: SADDUCEES)

I. Origjina e grupit

- A. Shumicë e studiuesve mendojnë se ky emër vjen nga Cadoku, një nga kryepriftërinjtë e Davidit (shih 2 Sam. 8:17; 15:24). Më vonë, Solomoni e dëboi Abiatarin ngaqë kishte mbështetur kryengritjen e Adonijahut (shih 1 Mbret. 2:26-27) dhe caktoi si kryepriftin e vetëm Cadokun (shih 1 Mbret. 2:35). Pas robërisë në Babiloni, vija e tij priftërore u rivendos në personin e Jozueut (shih Hag. 1:1). Kjo familje levite u zgjodh për të administruar tempullin. Më vonë, ata që rridhnin nga kjo traditë priftërore, si dhe mbështetësit e tyre, u quajtën cadokë, ose saducenj.
- B. Një traditë rabinike e shekullit të nëntë (*Aboti* i Rabin Natanit) thotë se Cadoku ishte dishepull i Antigoni të Sokos (shekulli i dytë para K.). Cadoku e keqkuptoi thënien e famshme të mësuesit të vet, “shpërblimet pas vdekjes”, dhe zhvilloi një teologji që e mohonte jetën pas vdekjes dhe, si rrjedhojë, mohonte dhe ringjalljen e trupit.
- C. Më vonë, brenda judaizmit, saducenjtë u identifikuan me betusianët. Edhe Betusi ishte dishepull i Antigoni të Sokos. Ai zhvilloi një teologji të ngjashme me Cadokun, që mohonte jetën pas vdekjes.
- D. Emri “saduce” përmendet vetëm që nga koha e Gjon Hirkanit (135-104 para K.), ku citohet nga Jozefusi (shih *Lashtësitë* 13.10.5-6). Në *Lashtësitë* 13.5.9, Jozefusi thotë se ekzistonin “tre shkolla mendimi”: farisenjtë, saducenjtë dhe esenët.
- E. Sipas një teorie tjetër, saducenjtë e kanë origjinën në kohën e përpjekjeve të sundimtarëve seleukë për të helenizuar priftërinë në kohën e Antiokut IV, Epifanit (175-163 para K.). Gjatë kryengritjes makabaese, Simon Makabeu (142-135 para K.) dhe pasardhësit e tij (shih 1 Mak. 14:41) nisën një priftëri të re. Këta kryepriftërinj të rinj hasmoneas ishin, ndoshta, fillimi i grupimit të saducenjve aristokratë. Farisenjtë u zhvilluan gjatë po kësaj kohe nga hasidimët (pra, “të veçuarit”, shih 1 Mak. 2:42; 7:5-23).
- F. Sipas një teorie moderne (nga T. W. Manson), “saduce” është transliterim i fjalës greke *sundikoi*. Kjo fjalë u referohej autoriteteve lokale, që kishin lidhje me autoritetin romak.

Kjo, ndoshta, shpjegon faktin pse disa saducenj nuk ishin priftërinj aristokratë, por anëtarë të Sinedrit.

II. Bindjet e tyre të veçanta

- A. Ata ishin grupimi priftëror konservator (pranonin si të frymëzuar vetëm Torahun) nga sektet e besimit judaik gjatë periudhave hasmonease dhe romake.
- B. Në veçanti, përqendroheshin te procedurat, protokollit, ritualet dhe liturgjia e Tempullit.
- C. Besonin në Torahun e shkruar (pra, Zanafilla – Ligji i Përtërirë) si libër i autoritetshëm, por hidhnin poshtë traditën gojore (pra, Talmudin).
- D. Kështu, hidhnin poshtë shumë doktrina të zhvilluara, që farisenjtë i kishin për zemër
 1. ringjallja e trupit (shih Mat. 22:23; Marku 12:18; Luka 20:27; Veprat 4:1-2; 23:8)
 2. pavdekshmëria e shpirtit (shih *Lashtësitë* 18.1.3-4; *Luftërat* 2.8.14)
 3. ekzistenca e një hierarkie të detajuar engjëllore (shih Veprat 23:8)
 4. E merrnin në mënyrë të fjalëpërfjalshme ligjin “sy për sy” (pra, *leks talionis*) dhe mbështesnin ndëshkimin fizik dhe dënimin me vdekjes (në vend të marrëveshjes monetare)
- E. Një tjetër pikë e debatueshme nga ana teologjike është debati mes paracaktimit dhe vullnetit të lirë. Nga tre grupet e përmendura nga Jozefusi
 1. Esenët besonin në një lloj determinizmi
 2. Saducenjtë theksonin vullnetin e lirë njerëzor (shih *Lashtësitë* 13.5.9; *Luftërat* 2.8.14)
 3. Farisenjtë kishin një pozicion disi të drejtpeshuar mes të dyve
- F. Në njëfarë kuptimi, konfliktet mes këtyre dy grupeve (saducenjtë dhe farisenjtë) pasqyronin tensionin mes priftërinjve dhe profetëve në DHV.

Një tjetër tension shkaktohej nga fakti se saducenjtë përfaqësonin fisnikërinë dhe pronarët e tokave. Ata ishin aristokratë (shih *Lashtësitë* e Jozefusit, 13.10.6; 18.1.4-5; 20.9.1), ndërsa farisenjtë dhe skribët ishin studiues dhe të përshpirtshmit, që vinin nga populli. Ky tension ishte, si të thuash, mes tempullit të Jerusalemit dhe sinagogave lokale të vendit.

Një tension tjetër shkaktohej nga refuzimi që i bënin saducenjtë ndikimit të zoroastrianizmit në teologjinë e farisenjve. Shembuj të kësaj teologjie farisaike janë: (1) angjelologjia shumë e zhvilluar; (3) dualizmi mes JHVH-së dhe Satanit; dhe (3) pikëpamja e zhvilluar për jetën e përtejme me terma të hollësishëm fizikë. Disa teprime të esenëve dhe farisenjve shkaktojnë reagimin teologjik të saducenjve. Ata iu kthyen pozicionit konservator të një teologjie që pranonte vetëm Moisiun, në mënyrë që të hidhnin poshtë hamendësimet e grupimeve të tjera judaike.

III. Burime informacioni

- A. Jozefusi është burimi kryesor për të dhënat për saducenjtë. Ai është i anshëm kundër saducenjve për shkak të animit të tij drejt farisenjve, si dhe për shkak të interesit të vet që t’u përshkruajë romakëve një imazh pozitiv të jetës së judenjve.
- B. Burimi tjetër i informacionit është literatura rabinike. Mirëpo, edhe këtu është e qartë anësia e fortë e këtij materiali. Saducenjtë e mohonin aktualitetin dhe autoritetin e traditës gojore të Pleqve (pra, Talmudin). Qartazi, pra, këto shkrime fariseike i përshkruajnë kundërshtarët e tyre në mënyrë ndoshta të tepruar (pra, përdorin taktika me “armiqtë të rremë”).
- C. Nga vetë saducenjtë nuk ka mbijetuar asnjë shkrim. Me shkatërrimin e Jerusalemit dhe të Tempullit më 70 pas K., humbën të gjitha dokumentet dhe ndikimi i kësaj elite priftërore.

Ata donin të ruanin paqen në rajon, dhe e vetmja mënyrë për ta bërë këtë gjë në shekullin e parë ishte të bashkëpunojë me romakët (shih Gjoni 11:48-50).

12:19 “Moisiu shkroi për ne” Bëhet fjalë për diskutimin e Moisiut për martesën levirate, që gjendet në LiP. 25:5-10.

■ **“nëse vëllai i një burri vdes”** Ky ligj judaik njihej me termin “martesë levirate”. Vjen nga latinishtja, që do të thotë “vëllai i burrit”. Të drejtat e trashëgimisë ishin shumë të rëndësishme në Izrael, pasi Perëndia ua kishte dhënë tokën e premtuar fiseve me anë të hedhjes së shortit (shih Jozueu 12-19). Prandaj, nëse një burrë vdiste pa lënë trashëgimtarë meshkuj, vëllai i tij duhet të martohej me vejushën dhe t’i lindte fëmijë vejushës; pastaj, ky fëmijë bëhej trashëgimtari i gjithë pronës së vëllait të vdekur.

12:23 Ky është dhe synimi i pyetjes: që të vinin në lojë konceptin e ringjalljes trupore në një jetë të pëtejme fizike.

12:24 Pyetja therëse e Jezusit përqendrohet në faktin se saducenjve iu mungonte njohuria e Shkrimeve dhe Perëndisë. Forma gramatikore e kësaj pyetjeje pret përgjigjen “po”.

12:25 “por do të jenë si engjëjt në qiell” Kjo fjali e shkurtër ka ngjallur shumë hamendësime. Engjëjt në DHV, zakonisht, janë mashkullore (përveç Zak. 5:9). Për çfarë bën fjalë ky koment i shkurtër i Jezusit: për seksualitetin e tyre, apo për marrëdhëniet seksuale? Si ndikon kjo në mënyrën si kuptojmë Zan. 6:1-2? Ndoshta, po përpiqemi të nxjerrim më shumë teologji se ç’duhet nga kjo bisedë me saducenjët. Qielli është një përjetim plotësisht i ndryshëm nga ana e marrëdhënieve sesa toka. Por është e paqartë sesi funksionon kjo sferë e re ndërpersonale, e përjetshme dhe shpirtërore. Bibla ka zgjedhur që të mos na zbulojë më tepër informacione për jetën e pëtejme. Saducenjët e morën këtë mungesë informacioni si justifikim për ta mohuar realitetin e jetës së pëtejme. Është më mirë që ta pohojmë këtë realitet në bazë të premtimeve të Perëndisë dhe Krishtit, por të jemi të gatshëm që të mbetemi të painformuar derisa të vdesim. Bibla u siguron besimtarëve gjithçka që u nevojitet të dinë!

Jezusi tha se ekzistenca në qiell nuk përmban asnjë aspekt seksual (pra, riprodhues). Ka shumë pyetje që do të donim të bënim për këtë gjë, por DHR nuk na jep asnjë qartësim të mëtejshëm. Ndoshta, mund të bëhet thjesht fjalë për faktin se engjëjt janë krijuar nga Perëndia, jo nga marrëdhëniet seksuale.

12:25-26 “engjëjt... Por në lidhje me faktin se të vdekurit ngjallen sërish” Saducenjët e mohonin ekzistencën e engjëjve dhe ringjalljes. Farisenjtë i pohonin të dyja.

12:26 “Por në lidhje me faktin se të vdekurit ngjallen sërish” Ka disa pasazhe në DHV që e pohojnë këtë të vërtetë (shih Job 14:14-15; 19:25-27; Ps. 23:6; Isa. 25:6-9; 26:14-19; Dan. 12:2). Por jeta e pëtejme në DHV është realitet i fshehur. Zbulesa e përshkallëzuar në DHR e qartëson dhe e përcakton realitet, por, gjithsesi, këtë gjë e bën me gjuhë metaforike dhe të fshehur. Qielli është një premtim dhe e vërtetë e sigurt, por natyra e saktë e tij është mister.

■ **“në librin e Moisiut”** Jezusi pohon se burimi i Ligji të Përtërirë është Moisiu. Edhe kjo pyetje pret përgjigjen “po”.

TEMË E VEÇANTË: AUTORËSIA E PENTATUKUT NGA MOISIU (SPECIAL TOPIC: MOSES’ AUTHORSHIP OF THE PENTATEUCH)

- A. Bibla vetë nuk e përmend autorin (siç ndodh për shumë libra të tjera të DHV). Zanafilla nuk përmban pjesë ku autori shkruan në vetën e parë, si te Ezra, Nehemia, apo pjesët “ne” te Veprat.
- B. Tradita judaike
 1. Shkrimtarët e lashtë judenj thonë se e shkroi Moisiu
 - a. *Ekleziasti* i Ben Sirahut, 24:23, i shkruar rreth 185 para K.
 - b. *Baba Bathra* 14b, pjesë e Talmudit që flet për autorësinë tradicionale të librave në DHV
 - c. Filoja i Aleksandrisë, në Egjpit; filozof jude, që jetoi rreth 20 para K. deri në 42 pas K.
 - d. Flav Jozefi, historian jude, që jetoi mes 37-70 pas K.
 2. JHVH ia zbulon të vërtetën Moisiut
 - a. Thuhet se Moisiu shkroi për popullin
(1) Eksodi 17:14

- (2) Eksodi 24:4, 7
- (3) Eksodi 34:27, 28
- (4) Numrat 33:2
- (5) Ligji i Përtërirë 31:9, 22, 24-26
- b. Thuhet se Perëndia i foli popullit me anë të Moisiut
 - (1) Ligji i Përtërirë 5:4-5, 22
 - (2) Ligji i Përtërirë 6:1
 - (3) Ligji i Përtërirë 10:1
- c. Thuhet se Moisiu ia tha popullit fjalët e Torahut
 - (1) Ligji i Përtërirë 1:1,3
 - (2) Ligji i Përtërirë 5:1
 - (3) Ligji i Përtërirë 27:1
 - (4) Ligji i Përtërirë 29:2
 - (5) Ligji i Përtërirë 31:1, 30
 - (6) Ligji i Përtërirë 32:44
 - (7) Ligji i Përtërirë 33:1
- 3. Autorët e DHV ia atribuojnë Pentatukun Moisiut
 - a. Jozueu 8:31
 - b. 2 Mbretërve 14:6
 - c. Ezra 6:18
 - d. Nehemia 8:1; 13:1-2
 - e. 2 Kronikave 25:4; 34:12; 35:12
 - f. Danieli 9:11
 - g. Malakia 4:4
- C. Tradita e krishterë
 - 1. Jezusi ia atribuon Moisiut autorësinë e Torahut
 - a. Mateu 8:4; 19:8
 - b. Marku 1:44; 7:10; 10:5; 12:26
 - c. Luka 5:14; 16:31; 20:37; 24:27, 44
 - d. Gjoni 5:46-47; 7:19, 23
 - 2. Autorë të tjerë të DHR ia atribuojnë Moisiut autorësinë e citimeve nga Torahu
 - a. Luka 2:22
 - b. Veprat 3:22; 13:39; 15:1, 15-21; 26:22; 28:23
 - c. Romakëve 10:5, 19
 - d. 1 Korintasve 9:9
 - e. 2 Korintasve 3:15
 - f. Hebrenjve 10:28
 - g. Zbulesa 15:3
 - 3. Shumica e Etërve të Kishës e pranuan autorësinë e Moisiut. Mirëpo, Ireneu, Klementi i Aleksandrisë, Origeni dhe Tertuliani kishin dyshime për lidhjen e Moisiut me formën e tanishme kanonike të Zanafillës(shih D. 2).
- D. Studiuesit e sotëm
 - 1. Qartazi, Torahut i janë bërë disa shtesa redaktoriale (ndoshta, për ta bërë këtë vepër të lashtë më të kuptueshme për lexuesit e kohës, diçka karakteristike për kopjuesit nga Egjipti):
 - a. Zanafilla 12:6; 13:7; 14:14; 21:34; 32:32; 36:31; 47:11
 - b. Eksodi 11:3; 16:36
 - c. Numrat 12:3; 13:22; 15:22-23; 21:14-15; 32:33 e më tej
 - d. Ligji i Përtërirë 3:14; 34:6
 - 2. Kopjuesit e lashtë ishin të mirëtrajnuar dhe të arsimuar. Gjithsesi, teknikat e tyre ndryshonin nga njëri vend në tjetrin:
 - a. Në Mesopotami, ata kujdeseshin që të mos ndryshonin asgjë; madje, e kontrollonin punën për saktësi. Ja një shënim në fund të faqes i një kopjuesi të lashtë sumer, rreth vitit 1400 para K.: “kjo vepër është e plotë nga fillimi në fund; është kopjuar,

- rishikuar, krahasuar dhe verifikuar shenjë për shenjë [d.m.th., germë për germë]”.
- b. Në Egjipt, kopjuesit i redaktonin lirisht tekstet e lashta që t’i përditësonin për lexuesit e kohës. Edhe kopjuesit në Kumran (pra, Pergamenat e Detit të Vdekur) e ndoqën këtë kqasje.
 3. Studiuesit e shekullit të nëntëmbëdhjetë përkrahën teorinë se Torahu është dokument i përbërë, i formuar nga shumë burime gjatë një periudhe të gjatë kohore (Graff-Uellhausen). Kjo teori bazohet në:
 - a. emrat e ndryshëm që përdoren për Perëndinë
 - b. dubletat (historitë që, në dukje, përsëriten dy herë) në tekst
 - c. forma letrare e ndodhive
 - d. teologjia e ndodhive
 4. Burimet dhe datat e mundshme
 - a. Burimi “J” (përdorimi i emrit JHVH nga Izraeli jugor) – 950 para K.
 - b. Burimi “E” (përdorimi i emrit “Elohim” nga Izraeli verior) – 850 para K.
 - c. Kombinimi i “J-E” – 750 para K.
 - d. Burimi “D” – 621 para K. (Libri i Ligjit; 2 Mbre. 22:8, i zbuluar gjatë reformës së Josias kur po riparohet Tempulli, ishte, me sa duket, libri i Ligjit të Përtërirë, i shkruar nga një prift i panjohur në kohën e Josias për ta mbështetur reformën e tij.)
 - e. Burimi “P” (rishkrimi priftëror i DHV, sidomos i ritualeve dhe procedurave) – 400 para K.
 5. Qartazi, Torahu ka disa shtesa redaktoriale. Judenjtë thonë se këto i bëri
 - a. Kryepriifti (ose ndonjë tjetër nga familja e tij) gjatë kohës së shkrimit
 - b. Profeti Jeremia
 - c. Skribi Ezra – IV Ezra thotë se ai e rishkroi Torahun për shkak se origjinalet ishin djegur kur ra Jerusalemi më 586 para K.
 6. Megjithatë, teoria e J.E.D.P. nxjerr në pah më tepër teoritë dhe kategoritë tona letrare moderne sesa i përgjigjet fakteve që gjenden në Torah (R. K. Harrison, *Introduction to the Old Testament*, f. 495-541 dhe *Tyndale’s Commentaries*, “Leviticus”, f. 15-25).
 7. Tiparet e literaturës hebraike
 - a. Dubletat, si p.sh., Zanafilla 1 & 2, janë fenomen i zakonshëm në hebraisht. Zakonisht, jepet një përshkrim i përgjithshëm, i ndjekur nga një ndodhi e veçantë. Ndoshta, kjo përdorej për të theksuar të vërtetat ose për të ndihmuar kujtesën gojore.
 - b. Rabinët e lashtë thoshin se dy emrat më të përdorur për Perëndinë kanë domethënie teologjike:
 - (1) JHVH – emri i besëlidhjes i Perëndisë, që tregon marrëdhënien e tij me Izraelin si Shpëtimtar dhe Shpengues (shih Psa. 19:7-14; 103).
 - (2) Elohim – Perëndia si Krijues, Sigurues dhe Ruajtës i gjithë jetës në tokë (shih Psa. 19:1-6; 104).
 - c. Në literaturën jobiblike të Lindjes së Afërt ndodh rëndom që në vepra të bashkuara letrare të ketë një larmi stiles dhe fjalori (shih R. K. Harrison, f. 522-526).
 8. Sipas një teorie të re, skribë (në pjesë të ndryshme të Izraelit) po punonin me pjesë të ndryshme të Pentatukut në të njëjtën kohën nën drejtimin e Samuelit (shih 1 Sam. 10:25). Kjo teori u propozua për herë të parë nga E. Robertson në *The Old Testament Problem*.
 - E. Të dhënat nga literatura e Lindjes së Afërt të lënë të mendosh se Moisiu përdori dokumente të shkruara kuneiforme, ose traditat gojore të stilit (patriarkal) mesopotamas, kur shkroi Zanafillën. Kjo nuk ia ul në asnjë mënyrë frymëzimin Zanafillës, por është një përpjekje për të shpjeguar fenomenin letrar të librit të Zanafillës (shih P. J. Wiseman, *New Discoveries in Babylonia about Genesis*). Duke nisur nga Zanafilla 37, ndikimi i fortë egjiptian në stilin, formën dhe fjalorin e librit duket se tregon se Moisiu përdori, ose prodhime letrare, ose tradita gojore, nga koha e izraelitëve në Egjipt dhe në Mesopotami. Arsimin zyrtar Moisiu e mori plotësisht në Egjipt! Formimi i saktë letrar i Pentatukut është i pqartë. Unë besoj se Moisiu është përpiluesi dhe autori i pjesës dërrmuese të Pentatukut, ndonëse mund të ketë përdorur kopjues dhe/ose tradita të shkruara ose gojore (patriarkale). Shkrmet e tij janë

përshtatur nga kopjues të mëvonshëm. Natyra historike dhe besueshmëria e këtyre pesë librave të parë të DHV është provuar nga arkeologjia moderne.

■ **“Unë jam Perëndia i Abrahamit”** Kjo përmendje e Eks. 3:2-6 është lojë fjalësh me kohën e foljes hebraisht “jam”. Forma e kësaj foljeje (pra, shkakore) bëhet emri i besëlidhjes së Perëndisë së Izraelit, JHVH (shih Eks. 3:14). Ky titull nënkupton se Perëndia është i vetmi që jeton, madje që jeton përjetë. Për shkak se ai jeton, edhe populli i tij jeton (shih Marku 12:27; Psa. 103:15-17; Isa. 40:6-8; 1 Pje. 1:24-25). Vini re se Jezusi pohon realitetin e jetës së përtejme në bazë të shkrimeve të Moisiut, që ishte e vetmja pjesë në kanonin hebre që pranohej nga saducenjtë si e autoritetshme për doktrinë.

TEKSTI I NASB (I PËRDITËSUAR): MARKU 12:28-34

²⁸Një nga skribët erdhi, i dëgjo duke debatuar dhe, kur kuptoi se Jezusi u ishte përgjigjur drejt, e pyeti: “Cili është i pari i të gjitha urdhërimeve?” ²⁹Jezusi iu përgjigj: “I pari fare është: ‘Dëgjo, o Izrael! Zot, Perëndia ynë, është një Zot; ³⁰dhe ti do ta duash Zotin, Perëndinë tënd, me gjithë zemër, me gjithë shpirt, me gjithë mendje dhe me gjithë forcën tënde’. ³¹I dyti është ky: ‘Do ta duash të afërmin si vetveten’. Nuk ka urdhërim tjetër më të madh se këto”. ³²Skribi i tha: “E drejtë, Mësues; me të drejtë ke thënë se ai është një, dhe se nuk ka tjetër veç tij; ³³dhe ta duash atë me gjithë zemër, me gjithë mendje dhe me gjithë forcë, dhe ta duash të afërmin si vetveten është shumë më e lartë se çdo ofrim i djegur dhe flijim”. ³⁴Kur Jezusi pa se skribi iu përgjigj me mend, i tha: “Nuk je larg nga mbretëria e Perëndisë”. Pas kësaj, askush nuk guxoi që t’i bënte pyetje të tjera.

12:28 “skribët” Zakonisht, këta ishin jopriftërorë (pra, jo levitë), që ishin bërë ekspertë të traditave gojore (pra, Talmudit) të judenjve. Në DHV, levitët lokalë ia interpretonin popullit shkrimet e shenjta (shih Neh. 8). Pasi sinagogat lokale u zhvilluan gjatë robërisë në Babiloni, rolit të mësuesve dhe interpretuesve lokalë iu rrit vlera. Në kohën e Jezusit, shumica e këtyre skribëve ishin farisenj. Historikisht (pra, pas shkatërrimit të tempullit), ata u zhvilluan në judaizmin rabinik. Shih Temën e Veçantë në Marku 2:6.

■ **“i dëgjo duke debatuar”** Vargu paralel në Mat. 22:34-35 duket se nënkupton motive të fshehta, por ungjilli i Markut na lë të kuptojmë se ky skrib ishte vërtet i interesuar për këtë pyetje teologjike.

12:29 “dëgjo” Jezusi citon nga LiP. 6:4-5, veçse jo nga teksti mazoret, por nga Septuaginta (paraleli në Mat. 22:37 është më afër TM, por jo plotësisht i njëjtë me të). Citimi i Jezusit i shton një frazë, edhe tekstit mazoret edhe atij grek të Septuagintës. Ky citim nuk gjendet plotësisht në asnjë pasazh të DHV. Septuaginta e ndryshon fjalën hebraisht “zemër” në “mendje”, ose “arsye”. Por ky citim ia shton dhe frazën “me gjithë mendje” frazës së trefishtë (pra, zemër, shpirt, forcë) në MT dhe në LXX. NJB e tregon këtë kur e shtyp këtë frazë sikur nuk është pjesë e citimit nga DHV (pra, e vendos në shkronja të pjerrëta). Është interesante se dorëshkrimi uncial greke D (pra, Beza), që u kopjua në shekullin e pestë, nuk e përmend fare frazën “me gjithë mendje”. Ndoshta, kjo reflekton tekstin origjinal, pasi mungesa e kësaj fraze përputhet me përgjigjen e skribëve në Marku 12:33.

Në vargun paralel te Mateu (pra, 22:32), Mateu e citon kështu Jezusin: “me gjithë zemër, me gjithë shpirt dhe me gjithë mendje”. Këtu, fraza hebraisht “me gjithë forcë” nuk përmendet. Është shumë e habitshme që Marku dhe Mateu nuk bien dakord me njëri-tjetrin, dhe as me MT ose LXX. Ky është një shembull i qartë i citimeve jo të ngurta të DHV në DHR (madje, dhe në ato raste që i atribuohen Jezusit). Këtu, precizioni është i pamundur. Të gjitha këto citime (pra, LXX, Mateu dhe Marku) reflektojnë përdorimin e përgjithshëm të këtij citimi të Moisiut.

Ky pasazh nga DHV (pra, LiP. 6:4-5) quhet *Shema*, që në hebraisht do të thotë “dëgjo”. Pra, dëgjo që të vepros. Ai është kthyer në shprehjen bazë judaike të monoteizmit. Judenjtë besimtarë e përmendin përditë në lutje, dhe në çdo shabat. Ka dhe pasazhe të tjera për natyrën unike të Perëndisë në librave e profetëve, por ky pasazh gjendet në shkrimet e Moisiut (pra, Zan – LiP.) dhe, si rrjedhojë, pranohej nga gjithë dëgjuesit e Jezusit (pra, saducenjtë dhe farisenjtë).

12:30 Përgjigjja e Jezusit tregon se urdhërimi parësor i Perëndisë përmban dy aspekte: (1) uniteti dhe natyra unika e Perëndisë dhe, (2) përkushtimi ynë i plotë ndaj tij dhe vetëm ndaj tij!

▣ **“zemër”** Shih Temën e Veçantë në Marku 2:6.

12:31 “Do ta duash të afërmin” Ky është citim nga Lev. 19:18 në Septuagintë. Jezusi e lidhi të vërtetën teologjike me kërkesat praktike dhe etike (shih Zak. 7-8). Është e pamundur ta duash Perëndinë dhe të urresh ata që janë krijuar në shëmbëllimin e tij (shih 1 Gjonit 2:9-11; 3:15; 4:20).

Është e pamundur ta duash të afërmin (pra, vëllain ose motrën e besëlidhjes) si veten nëse nuk do vetveten. Ekziston një dashurie e përshtatshme për veten, që bazohet në dashurinë e madhe të Perëndisë për njerëzimin. Ne jemi krijesa e tij, të modeluar në shëmbëllimin e tij (shih Zan. 1:26, 27). Duhet të gëzohemi në dhuntitë tona dhe ta pranojmë formën tonë fizike, mendore dhe psikologjike (shih Psa. 139). Të kritikosh veten do të thotë të kritikosh Bërësin! Ai mund ta transformojë natyrën tonë të rënë në pasqyrimin e lavdisë së vet (pra, në ngjashmërinë me Krishtin).

Krishterimi kërkon përkushtim personal besimi ndaj Perëndisë përmes Krishtit. Ai fillon si vendim i vullnetshëm i individit që të pendohet dhe të besojë. Nga ana tjetër, kjo gjë çon në një përjetim familjar. Pra, ne kemi marrë dhunti për të mirën e përbashkët (shih 1 Kor. 12:7). Jemi pjesë e trupit të Krishtit. Mënyra si i trajtojmë të tjerët zbulon përkushtimin tonë të vërtetë ndaj Krishtit. Bashkësia e Perëndisë me njerëzimin e krijuar në shëmbëllimin dhe ngjashmërinë e Perëndisë kërkon reagimin e duhur ndaj Perëndisë dhe ndaj njerëzve (veçanërisht ndaj atyre që janë pjesë e familjes së besimit).

▣ **“Nuk ka urdhërim tjetër më të madh se këto”** Kjo thënie është shumë e rëndë për besimtarët legalistë (pra, të dobtit; shih Rom. 14:1-15:13). Nuk ka rregulla për dashurinë e plotë për Perëndinë dhe për vëllezërit/motrat e besëlidhjes (madje, dhe për të humburit). Rregullat rrjedhin nga zemra dhe mendja e ndryshuar; nuk prodhojnë automatikisht perëndishmëri!

12:32-33 “ai... atë” Këta përemra bëjnë fjalë për JHVH. Për shkak të Eks. 20:7, shumica e judenjve e kishin të vështirë ta shqiptonin emrin e Perëndisë së besëlidhjes.

▣ **“nuk ka tjetër veç tij”** Kjo frazë nuk e mohon ekzistencën e qenieve të tjera shpirtërore, si engjëjt. Fjalë për fjalë do të thotë se askush nuk ka qenë përpara, ose përkras, JHVH-së. Ai është në një kategori unike (shih Eks. 8:10; 9:14; LiP. 4:35, 39). Ky skrib po shpreh natyrën unike të JHVH-së!

12:33 “ta duash... është shumë më e lartë se çdo ofrim i djegur” Ky skrib e kuptonte mirë marrëdhënien e besimit me ritualet (shih 1 Sam. 15:22; Isa. 1:11-14; Os. 6:6; Amosi 5:21-24; Mikea 6:6-8). Kjo nuk e zhvlerësonte ritualin e tempullit, por pohonte se motivi i saktë dhe besimi janë thelbësorë (këtu shohim bashkimin e mësimëve përfundimtare me ato profetike).

12:34 “Nuk je larg nga mbretëria e Perëndisë” Me pak fjalë, me këtë thënie Jezusi po pohonte natyrën qendrore të besimit pozitiv dhe të atypëratyshëm në Jezusin. Mbretëria ishte e disponueshme për ta (pra, nëpërmjet besimit në Jezusin), jo diçka që do të ndodhte vetëm në të ardhmen. Ndonëse ky burrë e kuptonte teologjinë e DHV, nuk do të ishte në marrëdhënien e drejtë me Perëndinë pa e vendosur besimin në Krishtin. Teologjia e saktë nuk na garanton shpëtimin! Njohuria e Biblës nuk na siguron shpëtimin! Kryerja e ritualeve dhe liturgjive fetare nuk na e garanton shpëtimin! Këtë e bën vetëm besimi në Krishtin!

TEKSTI I NASB (I PËRDITËSUAR): MARKU 12:35-37

³⁵Dhe Jezusi filloi të thoshte teksa po jepte mësim në tempull: “Si thonë skribët se Krishti është biri i Davidit? ³⁶Davidi vetë tha në Frymën e Shenjtë: ‘Zoti i tha zotit tim: ‘Ulu në të djathtën time derisa të t’i vendos poshtë këmbëve armiqtë e tu’. ³⁷Davidi vetë e quan ‘Zot’; atëherë, në ç’kuptim është Krishti bir i tij?’” Dhe turma e madhe e dëgjonte me kënaqësi.

12:35 “Si” Ky kapitull përmend një sërë pyetjesh:

1. nga Sinedri (Marku 11:27-12:12)
2. nga farisenjtë dhe herodianët (Marku 12:13-17)
3. nga saducenjtë (Marku 12:18-27)
4. nga një skrib (Marku 12:28-34)
5. nga Jezusi (Marku 11:29-33, 35-37)

Tani Jezusi po u bën një pyetje, si te Marku 11:29-30. Kjo metodë pyetje-përgjigje ishte karakteristike për judaizmin rabinik.

▣ **“Krishti është biri i Davidit”** Lexo Mat. 12:23 e më tej; 21:15; 2 Sam. 7:11-16, dhe krahasoje me Psa. 110:1. Jezusi po përpiqte t’u hapte sytë krerëve fetare. Ai donte t’ia dinte për ta, prandaj dhe përdori këtë lloj arsytimi dhe shtjellimi. Ata kishin shumë dritë, por i kishte verbuar tradita.

12:36 “Davidi vetë tha në Frymën e Shenjtë” Kjo pohon frymëzimin e Psalmi 110 nga Fryma e Shenjtë. Bibla është e vërtetë hyjnore (pra, nga Fryma), ndonëse e shkruar në gjuhën dhe kulturën e autorëve të vet.

▣ **“Zoti i tha zotit tim”** Ky është citim nga Psa. 110:1 në përkthimin e Septuagintës. Në hebraisht, fjala e parë “Zot” (e përkthyer në Biblat anglisht me shkronja të mëdha të shtypit, LORD) është mënyra sesi në e përkthejmë fjalën JHVH. Kjo ndodhi për shkak se hebrenjtë bënë çmos që të mos e përdornin emrin e Perëndisë së besëlidhjes. Prandaj, kur lexonin Biblën me zë dhe vinin te fjala JHVH, e zëvendësonin me fjalën hebraisht *Adon*, që do të thotë “zot”, “bashkëshort”, “pronar”, ose “zotëri”. Në greqisht, kjo përkthehet me fjalën *kurios*. Ky dallim nuk shfaqet në tekstin hebraisht, ku *kurios* është përkthimi i dy fjalëve: JHVH dhe *adon*.

TEMË E VEÇANTË: EMRAT E PERËNDISË (SPECIAL TOPIC: THE NAMES FOR DEITY)

A. *El* (BDB 42, KB 48)

1. Kuptimi fillestar i këtij termi të përgjithshëm e të lashtë për Perëndinë është i paqartë, ndonëse shumë studiues besojnë se vjen nga rrënja akadiane “jam i fortë”, ose “jam i fuqishëm” (shih Zan. 17:1; Num. 23:19; LiP. 7:21; Psa. 50:1).
2. Në panteonin kanaanit, perëndia i lartë është *El* (tekstet e Ras Shamras).
3. Në Bibël, zakonisht, *El* shoqërohet me terma të tjerë. Këto kombinime bëhen një mënyrë për të karakterizuar Perëndinë.
 - a. *El-Eljon* (Perëndia Shumë i Lartë, BDB 42 & 751 II), Zan. 14:18-22; LiP. 32:8; Isa. 14:14
 - b. *El-Roi* (“Perëndia që sheh”, ose “Perëndia që zbulon veten”, BDB 42 & 909), Zan. 16:13
 - c. *El-Shaddai* (“Perëndia i Gjithëfuqishëm”, ose “Perëndia i Gjithëmëshirshëm”, ose “Perëndia i malit”, BDB 42 & 994), Zan. 17:1; 35:11; 43:14; 49:25; Eks. 6:3
 - d. *El-Olam* (Perëndia i Përjetshëm, BDB 42 & 761), Zan. 21:33. Ky term lidhet nga ana teologjike me premtimin e Perëndisë për Davidin, 2 Sam. 7:13, 16
 - e. *El-Berit* (“Perëndia i Besëlidhjes”, BDB 42 & 136), Gjyq. 9:46
4. *El* barazohet me
 - a. JHVH, në Psa. 85:8; Isa. 42:5
 - b. *Elohim* në Zan. 46:3; Jobi 5:8, “Unë jam *El*, *Elohim* i atit tuaj”
 - c. *Shaddai*, në Zan. 49:25
 - d. “xhelozinë”, në Eks. 34:14; LiP. 4:24; 5:9; 6:15
 - e. “mëshirën” në LiP. 4:31; Neh. 9:31;
 - f. “i madh dhe i mahnitshëm” në LiP. 7:21; 10:17; Neh. 1:5; 9:31; Dan. 9:4
 - g. “njohurinë”, në 1 Sam. 2:3
 - h. “streha ime e fuqishme”, në 2 Sam. 22:33
 - i. “hakmarrësi im”, në 2 Sam. 22:49
 - j. “i shenjtë”, në Isa. 5:16
 - k. “fuqi”, në Isa. 10:21
 - l. “shpëtimi im”, në Isa. 12:2
 - m. “i madh dhe i fuqishëm”, në Jer. 32:19
 - n. “shpagim”, në Jer. 51:56
5. Një kombinim i të gjithë emrave kryesore të Perëndisë në DhV gjendet në Jozueu 22:22 (*El*, *Elohim*, *JHVH*, të përsëritur)

B. *Eljon* (BDB 751, KB 832)

1. Kuptimi bazë i kësaj fjale është “i lartë”, “i lartësuar”, ose “i ngritur lart” (shih Zan. 40:17; 1 Mbret. 9:8; 2 Mbret. 18:17; Neh. 3:25; Jer. 20:2; 36:10; Psa. 18:13).
2. Përdoret në kuptim paralel me disa emra/tituj të tjerë të Perëndisë.

- a. *Elohim* - Ps. 47:1-2; 73:11; 107:11
 - b. *JHVH* – Zan. 14:22; 2 Sam. 22:14
 - c. *El-Shaddai* – Psa. 91:1, 9
 - d. *El* – Num. 24:16
 - e. *Elah* – përdoret shpesh te Danieli 2-6 dhe Esdra 4-7, lidhet me *illair* (aramaisht, “Perëndia i Lartë”), te Dan. 3:26; 4:2; 5:18, 21
3. Përdoret shpesh nga johebrenjtë.
- a. Melkicedeku, Zan. 14:18-22
 - b. Balaami, Num. 24:16
 - c. Moisiu, që u flet kombeve te LiP. 32:8
 - d. Ungjilli i Lukës në DhR, që u shkruhet johebrenjve, përdor ekuivalentin grek *Hupsistos* (shih 1:32, 35, 76; 6:35; 8:28; Veprat 7:48; 16:17)
- C. *Elohim* (SHUMËS), *Eloah* (NJËJËS), që përdoren kryesisht në poezi (BDB 43, KB 52)
1. Ky term nuk gjendet jashtë Dhiatës së Vjetër.
 2. Kjo fjalë mund të nënkuptojë Perëndinë e Izraelit ose perënditë e kombeve (shih Eks. 12. 12; 20:3). Familja e Abrahamit ishte politeiste (shih Joz. 242).
 3. Mund t’u referohet gjyqtarëve të Izraelit (shih Eks. 216; Psa. 82:6).
 4. Termi *elohim* përdoret edhe për qenie të tjera shpirtërore (engjëjt, demonët), si te LiP. 32:8 (LXX) Psa. 8:5; Jobi 1:6; 38:7.
 5. Në Bibël, ky është emri/titulli i parë i Hyjnisë (shih Zan. 1:1). Është i vetmi që përdoret deri te Zan. 2:4, ku kombinohet me JHVH. Në thelb, nga ana teologjike, nënkupton Perëndinë si krijues, ruajtës dhe sigures i gjithë jetës në këtë planet (shih Psalmi 104).
Është sinonim me *El* (shih LiP. 32:15-19). Mund të jetë edhe term paralel me JHVH, pasi Psalmi 14 (*Elohim*) është plotësisht njësoj si Psalmi 53 (JHVH), me përjashtim të ndryshimit të emrave hyjonrë.
 6. Ndonëse SHUMËSI mund të përdoret edhe për perënditë e tjera, shpesh, ky term nënkupton Perëndinë e Izraelit, por zakonisht ajo që tregon kuptimin monoteist është FOLJA në NJËJËS.
 7. Është e çuditshme që një emër i zakonshëm i Perëndisë monoteiste të Izraelit është në SHUMËS! Ndonëse nuk ka siguri, këto janë teoritë.
 - a. Hebraishtja ka shumë SHUMËSA, që shpesh përdoren për theksim. E lidhur ngushtë me këtë është një veçori e mëvonshme gramatikore e hebraishtes, që quhet “shumësi i madhështisë”, ku SHUMËSI përdoret për të përforcuar një koncept.
 - b. Kjo mund t’i referohet këshillit të engjëjve, me të cilët Perëndia takohet në qiell dhe të cilët bëjnë vullnetin e tij (shih 1 Mbret. 22:19-23; Jobi 1:6; Psa. 82:1; 89:5, 7).
 - c. Madje, është e mundur që kjo të reflektojë zbulësën në DhR e të një Perëndie në tre persona. Te Zan. 1:1, Perëndia krijon; Zan. 1:2, Fryma rri mbi ujërat, dhe, nga DhR, Jezusi është vepruesi i krijimit të Atit Perëndi (shih Gjoni 1:3, 1 Rom. 11:36; 1 Kor. 8:6; Kol. 1:15; Heb. 1:2; 2:10).
- D. JHVH (BDB 217, KB 394)
1. Ky është emri që reflekton Hyjninë si Perëndia që bën besëlidhje; Perëndia si shpëtimtar, shpengues! Njerëzit i thejnë besëlidhjet, kurse Perëndia është besnik ndaj fjalës, premtimit, besëlidhjes së vet (shih Psalmi 103).
Ky emër përmendet për herë të parë në kombinim me *Elohim* në Zan. 2:4. Te Zan. 1-2 nuk gjenden dy rrëfime të krijimit, por dy theksime të tij:
 - a. Perëndia si krijuesi i universit (fizik) dhe
 - b. Perëndia si krijuesi i veçantë i njerëzimit. Zanafilla 2:4-3:24 nis zbulësën e veçantë për pozicionin dhe synimin e privilegjuar të njerëzimit, si dhe për problemin e mëkatit dhe rebelimit që shoqërojnë këtë pozitë unike.
 2. Në Zan. 4:26, thuhet se “*njerëzit* filluan t’i bënin thirrje emrit të ZOTIT” (JHVH). Mirëpo Eks. 6:3 nënkupton se populli i hershëm i besëlidhjes (patriarkët dhe familjet e tyre) e njihnin Perëndinë vetëm si *El-Shaddai*. Emri JHVH shpjegohet vetëm një herë në Eks. 3:13-16, sidomos në v. 14. Megjithatë, shkrimet e Moisiut shpesh i interpretojnë fjalët me lojëra të njohura fjalësh, jo me etimologji (shih Zan. 17:5; 27:36; 29:13-35). Ka patur disa teori për kuptimin e këtij emri (marrë nga IDB, vëll. 2 f. 409-11).

- a. nga një rrënjë fjale arabisht, “tregoj dashuri të zjarrtë”
- b. nga një rrënjë fjale arabisht, “fryj” (JHVH si Perëndia i furtunës)
- c. nga një rrënjë fjale ugarite (kanaanite), “flas”
- d. nga një mbishkrim fenikas, një PJESORE SHKAKORE që do të thotë “Ai që mban”, ose “Ai që themelon”
- e. nga forma *Kal* në hebraisht, “Ai që është”, ose “Ai që është i pranishëm” (në kuptimin e ardhshëm, “Ai që do të jetë”)
- f. nga forma *Hifil* në hebraisht, “Ai që bën të jetë”
- g. nga rrënja e fjalës hebraisht “jetoj” (p.sh. Zan. 3:20), që do të thotë “Ai që është i vetmi që jeton dhe që jeton gjithmonë”
- h. nga konteksti i Eks. 3:13-16, një lojë fjalësh me formën E PAKRYER të përdorur në një kuptim TË KRYER, “Unë do të vazhdoj të jem ai që isha”, ose “do të vazhdoj të jem ai që kam qenë gjithmonë” (shih J. Eash Eatts, *A Survey of Syntax in the Old Testament*, f. 67). Emri i plotë JHVH shpesh shprehet në formë të shkurtuar, ose, mundësisht, në një formë fillestare.

(1) *Jah* (p.sh. Halelu – jah, BDB 219, shih Eks. 15:2; 17:16; Psa. 89:8; 104:35)

(2) *Jahu* (fundit i emrave me “jah”, p.sh., Isa-jah)

(3) *Jo* (emrat që fillojnë me “Jo”, p.sh., Jozueu ose Joeli)

3. Në judaizmin e mëvonshëm, ky emër i besëlidhjes u bë kaq i shenjtë (tetragramatoni), sa që judenjtë druheshin ta përdornin se mos shkelnin urdhrin e Eks. 20:7; LiP. 5:11; 6:13. Kështu, ata e zëvendësuan me termin hebraisht “pronar”, “zotëri”, “bashkëshort”, “zot” – *adon* ose *adonai* (zoti im). Kur vinin te fjala JHVH në leximin e pasazheve të DhV, ata shqiptonin “zot”. Ja pse JHVH shkruhet me të mëdha ZOT në përkthimet në anglisht.
4. Si në rastin e *El-it*, edhe JHVH shpesh kombinohet me terma të tjerë për të theksuar disa karakteristika të Perëndisë së Besëlidhjes me Izraelin. Ndonëse ka shumë terma të mundshëm për këto kombinime, ja disa prej tyre.
 - a. *JHVH – Jire* (JHVH do të sigurojë, BDB 217 & 906), Zan. 22:14
 - b. *JHVH – Rofekha* (JHVH është shëruesi yt, BDB 217 & 950, PJESORJA *Kal*), Eks. 15:26
 - c. *JHVH – Nissi* (JHVH është flamuri im, BDB 217 & 651), Eks. 17:15
 - d. *JHVH – Mekaddishkem* (JHVH, Ai që të shenjtëron, BDB 217 & 872, PJESORE *Piel*), Eks. 31:13
 - e. *JHVH – Shalom* (JHVH është Paqe, BDB 217 & 1022), Gjyq. 6:24
 - f. *JHVH – Sabaoth* (JHVH i ushtrive, BDB 217 & 878), 1 Sam. 1:3, 11; 4:4; 15:2; shpesh në Profetët
 - g. *JHVH – Ro’i* (JHVH është bariu im, BDB 217 & 944, PJESORE *Kal*), Psa. 23:1
 - h. *JHVH – Cidkenu* (JHVH është drejtësia jonë, BDB 217 & 841), Jer. 23:6
 - i. *JHVH – Shamma* (JHVH është aty, BDB 217 & 1027), Ezek. 48:35

■ **“Ulu në të djathtën time”** “Time” bëhet fjalë për JHVH. Kjo frazë antropomorfike (pra, të folurit për ushqimin me fjalë njerëzore) synonte të tregonte vendin e pushtetit, autoritetit dhe epërsisë së Mesisë. Kjo nënkupton se Mbreti i universit e ndante fronin me dikë tjetër (pra, me Mesinë e tij, shih Marku 14:62).

■ **“derisa të t’i vendos poshtë këmbëve armiqtë e tu”** Kjo vijon citimin e Psa. 110:1. Kjo frazë tregon fitoren e JHVH për hir të Mesisë së tij (shih Psalmi 2). Kjo e vërtetë zbulohet më tej në 1 Kor. 15:24-27, madje, zbatohet përfundimisht në mbretërinë e përjetshme të Atit në 1 Kor. 15:28!

Citimi që i bën Marku (dhe Mat. 22:44) Psalmi 110:1 devijon nga teksti hebraisht mazoretik dhe nga Septuaginta (njësoj si citimi që i bën Markut LiP. 6:4-6 në Marku 12:29-30). Teksti mazoretik dhe LXX shkruajnë: “derisa të t’i vë armiqtë si stol të këmbëve të tua” (shih Luka 20:43; Veprat 2:34-35). Disa kopjues (pra, dorëshkrimet Sinaitikus, A, L dhe përkthimet Vullgata dhe Peshita) e ndryshuan citimin e Markut për t’ia përshtatur citimit nga DHV.

12:37 Ky është thelbi i çështjes. Tregon se (1) krerët fetarë nuk i kuptonin Shkrimet (pra, ishin shpirtërisht të verbër ndaj tyre), majde as për Mesinë, ose (2) Krishti, ndonëse bir i Davidit, ishte shpirtërisht më i lartë se

Davidi dhe, madje, kishte origjinë hyjnore. Ata ishin përpjekur t'ia hidhnin Jezusit me pyejet e tyre kurse, tni, ai u përgjigjet menë pyetje që i bën të heshtin.

Mendoj se alternativa 2 është përgjigjja e duhur teologjike. JHVH i DHV e zgjodhi vijën e prejardhjes së Mesisë veçmas përpjekjeve njerëzore ose traditave kulturore (pra, të gjithë etërit u martuan me gra jopjellore dhe djali i madh kurrë nuk u bë i zgjedhuri për vazhdimësinë e vijës familjare të Mesisë)! Ky është një pohim i fshehur, por i fuqishëm, se Mesia do të jetë më i madh se Davidi (pra, “zotëria” ose “i zoti” i Davidit), gjë që sigurisht nënkupton një veprim hyjnor, madje një person hyjnor.

■ **“Dhe turma e madhe e dëgjonte me kënaqësi”** Turmat e mëdha janë tipar i përsëritur në ungjillin e Markut. Populli i vendit, që shpesh tallej dhe anashkalohej nga elita fetare (pra Marku 12:38-40), këanqej kur shihte Jezusin që i zinte mat fetaristët arrogantë duke përdorur metodat e tyre.

TEKSTI I NASB (I PËRDITËSUAR): MARKU 12:38-40

³⁸Në mësimin e tij, po thoshte: “Ruhuni nga skribët, të cilëve u pëlqen të ecin lart e poshtë me rroba të gjata dhe iu pëlqejnë përshëndetjet plot nderim në tregje ³⁹dhe vendet kryesore në sinagoga, si dhe vendet e nderit në gosti, ⁴⁰që gllabërojnë shtëpitë e vejushave dhe, për hir të dukjes, ofrojnë lutje të gjata; këta do të marrin dënim më të madh”.

12:38 “skribët, të cilëve u pëlqen” Lidhja kohore mes Markut 12:25-27 dhe 12:38-40 është e paqartë. Me sa duket, Jezusi po i drejtohej të njëjtës kategori drejtuesish (pra, skribëve), por është e paqartë nëse bëhet fjalë për skribët e 35-37, apo skribë të tjerë, që mburreshin me fenë e tyre në publik. Me siguri, fjalët e Jezusit vlejné edhe për saducenjtë dhe farisenjtë që mburreshin publikisht nga ana fetare me qëllim që t'i respektonte populli.

■ **“të cilëve u pëlqen të ecin lart e poshtë me rroba të gjata”** Bëhet fjalë për shallin e veçantë dhe të bardhë prej stofi, *tallith*, që kishte xhufka të mëdha ngjyrë blu, të cilat i vishnin skribët. Talmudi mëson se besimtari duhet të qëndronte në këmbë në prani të rabinit. Këtyre u pëlqente ky trajtim i veçantë (pra, shallët e veçanta të lutjes, përshëndetjet gjithë respekt, vendet më të mira për adhurim dhe vendet e nderuara në gosti). Ata kishin gjithçka, por u mungonte Krishti!

12:40 “që gllabërojnë shtëpitë e vejushave” Kjo mund të jetë gjuhë metaforike që nënkupton (1) barrën e lëmshës që këta krerë i kërkonin gjithë popullit, ose (2) praktikën e bindjes së vejushave që t'ia falnin trashëgiminë e tyre (pra, mënyrën e mbijetesës) tempullit. Në këtë mënyrë, këtu bëhet fjalë për teknikat financuese të krerëve fetarë.

■ **“për hir të dukjes, ofrojnë lutje të gjata”** Ata luteshin që t'i shihnin të tjerët, jo që t'i dëgjonte Perëndia. Feja e tyre ishte sa për sy e faqe (shih Isa. 29:13; Mat. 7:21-23; Kol. 2:16-23), por nuk e kuptonin dhuratën më të madhe të Perëndisë!

■ **“këta do të marrin dënim më të madh”** Besimi i tyre fetar ishte dukje e jashtme, jo besim i brendshëm veprues, që bazohet në dashuri dhe shërbesë (shih Marku 12:28-34). Kjo frazë mund të reflektojë (1) shkallë të ndryshme ndëshkimi (shih Mat. 10:15; 11:22, 24; 18:6; 25:21, 23; Luka 12:47-48; 20:47; Jakobi 3:1), ose (2) është teprim metaforik (pra, hiperbolë).

TEMË E VEÇANTË: SHKALLËT E SHPËRBLIMEVE DHE NDËSHKIMEVE (SPECIAL TOPIC: DEGREES OF REWARDS AND PUNISHMENT)

- A. Përgjigjja e duhur ose e gabuar ndaj Perëndisë bazohet në nivelin e njohurisë që ka individ. Sa më pak njohuri të ketë, aq më pak i përgjegjshëm është. Por edhe e kundërta është e vërtetë (shih Luka 12:45).
- B. Njohuria e Perëndisë vjen thelbësisht në dy mënyra:
 - 1. krijimi (shih Psalmi 19; Romakëve 1-2)
 - 2. Shkrimi (shih Psalmi 19; 119; Jezusi, siç na zbulohet në DHR)

C. Të dhënat nga DHV

1. shpërblimet
 - a. Zan. 15:1 (zakonisht, shoqërohet me shpërblimet tokësore: toka dhe fëmijë djem)
 - b. Lev. 26:1-13; LiP. 28:1-14, 58-68 (bindja ndaj besëlidhjes sjell bekim)
 - c. Dan. 12:3
2. Ndëshkimet: Lev. 26:14-39; LiP. 27:15-26; 28:15-37 (mosbindja ndaj besëlidhjes sjell mallkim)
3. Modeli i DHV për shpërblimin për drejtësinë personale ndaj besëlidhjes modifikohet për shkak të mëkatit njerëzor. Ky modifikim shihet te Jobi dhe Psalmi 73 (pra, “dy udhët”, shih LiP. 30:15, 19; Psami 1). DHR e përforcon fokusin nga vepra te mendimi (shih Predikimin në Mal, Mateu 5-7).

D. Të dhënat nga DHR

1. shpërblimet (përtej shpëtimit)
 - a. Marku 9:41
 - b. Mat. 5:12,46; 6:1-4,5-6,6-18; 10:41-42; 16:27; 25:14-23
 - c. Luka 6:23, 35; 19:11-19, 25-26
2. ndëshkimet
 - a. Marku 12:38-40
 - b. Luka 10:12; 12:47-48; 19:20-24; 20:47
 - c. Mateu 5:22, 29, 30; 7:19; 10:15, 28; 11:22-24; 13:49-50; 18:6; 25:14-30
 - d. Jakobi 3:1

E. Për mua, e vetmja analogji e kuptueshme vjen nga opera. Unë nuk shkoj nëpër shfaqje operistike, kështu që nuk i kuptoj. Sa më shumë ta kuptoja vështirësinë dhe kompleksitetin e kompozimit, muzikës dhe kërcimit, aq më shumë do ta vlerësoja një shfaqje të tillë. Unë mendoj se Perëndia do të na e mbushë kupën plot në qiell, por mendoj se shërbesa jonë tokësore është ajo që na përcakton madhësinë e kupës.

Prandaj, njohuria dhe reagimi ndaj kësaj njohurie çon në shpërblime dhe ndëshkime (shih Mat. 16:7; Luka 12:48; 1 Kor. 3:8, 14; 9:17, 18; Gal. 6:7; 2 Tim. 4:14). Ekziston një parim shpirtëror: korrin atë që mbjellim! Disa mbjellin më tepër, kështu që korrin më tepër (shih Mat. 13:8, 23).

F. “Kurora e drejtësisë” është e jona në veprën e përfunduar të Jezu Krishtit (shih 2 Tim. 4:8), por vini re se “kurora e jetës” lidhet me qëndrueshmërinë në prova (shih Jak. 1:12; Zbu. 2:10; 3:10-11). “Kurora e lavdisë” për drejtuesit e krishterë lidhet me stilin e tyre të jetesës (shih 1 Pje. 5:1-4). Pali e di se ka një kurorë të paprishshme, por ushtorn vetëkontroll të rreptë ndaj vetes (shih 1 Kor. 9:24-27).

Misteri i jetës së krishterë është se ungjilli është plotësisht falas për shkak të veprës së përfunduar të Krishtit, por, ashtu siç duhet t’i përgjigjemi ofertës së Perëndisë në Krishtin, duhet t’i përgjigjemi edhe fuqizimit të Perëndisë për të bërë një jetë të krishterë. Jeta e krishterë është e mbinatyrshe, njësoj si shpëtimi, por duhet ta pranojmë dhe ta mbajmë fort. Paradoksi “falas, por të kushton gjithçka” është misteri i shpërblimeve dhe mbjellje/korrjes.

Ne nuk shpëtohem nga veprat e mira, por për të kryer vepra të mira (shih Efe. 2:8-10). Veprat e mira janë provë se jemi takuar me Jezusin (shih Mateu 7). Merita njerëzore në fushën e shpëtimit çon në shkatërrim, ndërsa jetesa e perëndishme shpërblehet.

TEKSTI I NASB (I PËRDITËSUAR): MARKU 12:41-44

⁴¹Dhe u ul përballë arkës së thesarit dhe nisi të vëzhgoje sesi njerëzit hidhnin para në arkën e thesarit; dhe shumë të pasur po hidhnin shuma të mëdha. ⁴²Një vejushë e varfër erdhi dhe hodhi dy monedha të vogla bakri, që vlejnë një qindarkë. ⁴³Si i thirri dishepujt te vetja, iu tha: “Me të vërtetë ju them: kjo vejushë e varfër hodhi më shumë se gjithë dhuruesit e tjerë në arkën e thesarit; ⁴⁴sepse të

gjithë hodhën aty nga teprica e tyre, kurse ajo, nga varfëria, hodhi gjithçka që zotëronte, gjithçka që kishte për të jetuar”.

12:41 “arkës së thesarit” Mishnah (dhe libri *Temple*, i Alfred Edersheim, f. 48-49) thotë se, në Oborrin e Grave, ndodheshin trembëdhjetë arka në formë trumpetash, secila të shënuarap ër një qëllim të caktuar bamirës. Nuk është gjetur asnjë e dhënë fizike për këto, as ndonjë mbështetje tjetër letrare përveç Mishnës për ekzistencën e tyre.

12:42 “dy monedha të vogla bakri” Fjalë për fjalë, “lepton” (monedhë e hollë), që vlente sa 1/24 ose 1/96 e dinarit. Ishte monedha më pak e vlefshme judaike prej bakri.

▣ **“që vlejné një qindarkë”** Kjo është fjala latinisht *quadrans*, që ishte sa një *lepton*, monedha më e vogël romake prej bakri (1/4 e një *asarioni*, që ishte sa 1/16 e dinarit). Marku, ndoshta, u shkrua për Romakët.

**TEMË E VEÇANTË: MONEDHAT QË PËRDORESHIN NË PALESTINË NË KOHËN E JEZUSIT
(SPECIAL TOPIC: COINS IN USE IN PALESTINE IN JESUS' DAY)**

- I. Monedha bakri
 - A. *kherma* – vlerë e ulët (shih Gjoni 2:15)
 - B. *khalkos* – vlerë e ulët (shih Mat. 10:9; Marku 12:41)
 - C. *assarion* – monedhë bakri romake, që vlente rreth 1/16 e një *dēnarius* (shih Mat. 10:29)
 - D. *kodrantēs* – monedhë bakri romake, që vlente rreth 1/64 e një *dēnarius* (shih Mat. 5:26)
 - E. *lepton* – monedhë bakri judaike, që vlente rreth 1/128 e një *dēnarius* (shih Marku 12:42; Luka 21:2)
 - F. *kuadrans/qindarkë* – monedhë bakri romake me vlerë të ulët

- II. Monedha argjendi
 - A. *arguros* (“monedhë argjendi”) – shumë më e vlefshme se monedhat prej bakri ose bronzi (shih Mat. 10:9; 26:15)
 - B. *dēnarius* – monedhë argjendi romake, e barasvlershme me një *dēnarius* (shih Mat. 18:28; Marku 6:37)
 - C. *drakhme* – monedhë argjendi greke, e barazvlefshme në vlerë me një *denarius* (Luka 15:9)
 - D. *di-drakhmon* – dy *drakhma*, e barabartë me gjysmë shekeli judaik (shih Mat. 17:24)
 - E. *statēr* – monedhë argjendi, e vlefshme rreth katër *dēnarii* (shih Mat. 17:27)

- III. Monedha floriri – *khrusos* (“monedha floriri”) – monedhat më të vlefshme (shih Mat. 10:9)

- IV. Terma të përgjithshëm për peshën e metaleve
 - A. *mnaa* - latinisht *mina*, një peshë metal e barabartë me 100 *dēnarii* (shih Luka 19:13)
 - B. *talanton* – njësi peshe greke (shih Mat. 18:24; 25:15, 16, 20, 24, 25, 28)
 1. e argjendtë, vlente 6,000 *dēnarii*
 2. e florinjte, vlente 180,000 *dēnarii*
 - C. *shekel* – peshë argjendi judaike në DhV (shih Zan. 23:15; 37:28; Eks. 21:32)
 1. *pīm* – 2/3 e shekelit
 2. *beka* – 1/2 e shekelit
 3. *gerah* – 1/20 e shekelitNjësi më të mëdha
 1. *maneh* – 50 shekel
 2. *kikkar* – 3,000 shekel

12:43 “Me të vërtetë” Fjalë për fjalë, “amen”. Shih Temën e Veçantë në Marku 3:28.

12:44 Besimi i plotë i kësaj gruaje përdoret si kontrast me krenarinë dhe cektësinë fetare të skribëve. Ata i plaçkisnin pasuritë e vejushave. Kurse kjo vejushë ia jep gjithë pasurinë e vet Perëndisë dhe, në këtë mënyrë, mbështetet me besim në të, që ai t'ia përmbushë të gjitha nevojat. Kur njeriu jep, Perëndia i sheh zemrën, jo sasinë e parave (shih 2 Kor. 8-9). Por vini re, gjithashtu, se kjo sasi parash ishte gjithë sa kishte ajo. Dhënia, ashtu si veprat dhe fjalët, zbulon zemrën! Shih Temën e Veçantë: Pasuria, në Marku 10:23.

PYETJE PËR DISKUTIM

Ky është një komentari studimor udhëzues, që do të thotë se ti je vetë përgjegjës për interpretimin e Biblës. Secili prej nesh duhet të ecë sipas dritës që ka. Ti, Bibla dhe Fryma e Shenjtë keni përparësi në interpretim. Nuk duhet t'ia dorëzosh këtë të drejtë komentuesit.

Këto pyetje për diskutim t'i kam dhënë për të të ndihmuar që të analizosh çështjet kryesore të kësaj pjese të librit. Ato synojnë të të nxisin mendimin, jo të kenë natyrë shteruese.

1. Rendit atë që përfaqëson secila nga gjërat e mëposhtme në shëmbëlltyrë (12:1-12)
 - a. Pronari i vreshtit _____
 - b. Vreshti _____
 - c. Vreshtarët _____
 - d. Sklleverit _____
 - e. Biri _____
2. Pse është kaq me vend citimi i pjesshëm i Psalmit 118 këtu (pra, te Marku 12:10)?
3. Cila është domethënia e shëmbëlltyrës (shih Marku 12:1-12) për kombin jude (Mat. 21:43-44)? Po kështu, shqyrto Rom. 9-11 për një thënie të drejtpeshuar.
4. Përmblihdh të vërtetat qendrore të thënieve të Jezusit.
 - a. Në lidhje me autoritetet civile (Marku 12:13-17)
 - b. Në lidhje me ringjalljet (Marku 12:18-27)
 - c. Në lidhje me ligjin (Marku 12:28-34)
 - d. Në lidhje me titullin "Biri i Davidit" (Marku 12:35-40)
 - e. Në lidhje me dhënien dhe përkushtimin (Marku 12:41-44)
5. A ka gradë të ndryshe ndëshkimi (shih Marku 12:40)?

MARKU 13

NDARJET NË PARAGRAFË TË PËRKTHIMEVE MODERNE

UBS ⁴	NKJV	NRSV	TEV	NJB
Profetizimi i shkatërrimit të tempullit 13:1-2	Jezusi parathotë shkatërrimin e tempullit 13:1-2	Profetizimi i shkatërrimit të tempullit 13:1-2	Jezusi flet për shkatërrimin e tempullit 13:1-2	Ligjërimi eskatologjik: hyrje 13:1-2
Fillimi i vuajtjeve 13:3-13	Shenjat e kohës dhe fundi i epokës 13:3-13	Për fundin e epokës 13:3-13	Shqetësimet dhe përndjekjet 13:3-8 13:9-13	Fillimi i trishtimeve 13:3-4 13:5-8 13:9-10 13:11-13
Mundimi i madh 13:14-23	Mundimi i madh 13:14-23	13:14-23	Tmerri i madh 13:14-20 13:21-23	Mundimi i madh i Jerusalemit 13:14-20 13:21-23
Ardhja e Birit të Njeriut 13:24-27	Ardhja e Birit të Njeriut 13:24-27	13:24-27	Ardhja e Birit të Njeriut 13:24-27	Ardhja e Birit të Njeriut 13:24-27
Mësimi nga fiku 13:28-31	Shëmbëlltyra e fikut 13:28-31	13:28-31	Mësimi nga fiku 13:28-31	Koha e kësaj ardhjeje 13:28-31
Ora dhe dita e panjohur 13:32-37	Askush s'e di ditën ose orën 13:32-37	13:32-37	Askush s'e di ditën ose orën 13:32-37	13:32 Rrini zgjuar 13:33-37

CIKLI TRE I LEXIMIT (shih f. v)

NDJEKJA E SYNIMIT TË AUTORIT FILLESTAR NË NIVELIN E PARAGRAFËVE

Ky është një komentari studimor udhëzues, që do të thotë se ti je vetë përgjegjës për interpretimin e Biblës. Secili prej nesh duhet të ecë sipas dritës që ka. Ti, Bibla dhe Fryma e Shenjtë keni përparësi në interpretim. Nuk duhet t'ia dorëzosh këtë të drejtë komentuesit.

Lexo gjithë kapitullin njëherësh. Identifiko temat. Krahaso ndarjet e tua tematike me pesë përkthimet moderne. Ndarja në paragrafë nuk është e frymëzuar, por është çelësi për të ndjekur synimin e autorit fillestar, gjë që është thelbi i interpretimit. Secili paragraf ka vetëm një temë të vetme.

1. Paragrafi i parë
2. Paragrafi i dytë
3. Paragrafi i tretë
4. Etj.

MËSIMET KONTEKSTUALE:

- A. Pasazhet eskatologjike të Dhiatës së Re reflektojnë të dhënat profetike të Dhiatës së Vjetër, që e shihnin kohën e fundit nëpërmjet ngjarjeve të momentit. Këtë model e ndoqi dhe Jezusi. Profetët e DHV, Mikea dhe Jeremia e parathanë shkatërrimin e Jerusalemit dhe tempullit si shenjë e gjykimit të

Perëndisë kundër Izraelit mosbesues. Perëndia do t'i thërriste johebrenjtë për ta gjykuar popullin e tij dhe për ta pushtuar vendin. Tani, në DHR, populli i Perëndisë ende vperon me mosbesim. E hedhin poshtë Mesinë e tij. Ata do të shkatërrohen, bashkë me qytetin dhe tempullin e tyre (pra, më 70 pas K. nga Titi). Toka e tyre e premtuar, tani, u jepet të tjerëve (shih Marku 12:1-12; veçanërisht Marku 13:9, pra, me sa duket, besimtarëve johebrenj. Misioni johebre shprehet në Marku 13:9-13).

- B. Mateu 24, Marku 13 dhe Luka 21 janë shumë të vështirë për t'u interpretuar për shkak se trajtojnë disa pyetje njëherësh:
1. Kur do të shkatërrohet tempulli?
 2. Cila do të jetë shenja e kthimit të Mesisë?
 3. Kur do të përfundojë kjo epokë?
- C. Zhanri i eskatologjisë në DHR është zakonisht kombinim i gjuhës apokaliptike me atë profetike, që është qëllimisht e vagullt dhe tejet simbolike.
- D. Një sërë pasazhesh në DHR (shih Mat. 24; Marku 13; Luka 17 dhe 21; 1 dhe 2 Thes; dhe Zbu.) trajtojnë Ardhjen e Dytë. Këto pasazhe theksojnë
1. se koha e saktë e kësaj ngjarjeje nuk dihet, por kjo ngjarje është e sigurt
 2. se brezi i fundit do ta tijë kohën e përgjithshme, por jo kohën specifike, të ngjarjeve
 3. se do të ndodhë papritmas
 4. se çdo brez besimtarësh duhet të lutet, të jetë gati dhe të jetë besnik për detyrat e caktuara
- E. Fokusi kryesor i këtij kapitulli janë këshillat praktike (19 urdhërore), jo përcaktimi i kohës së saktë apo i vijimësisë kronologjike të ngjarjeve të Ardhjes së Dytë.
- F. Dy frazat kyçe janë (1) “kini kujdes” (Marku 13:5, 9, 23, 33) dhe (2) “ende jo” (Marku 13:7, 10). Këto dy këshilla qëndrore, “jini gati” dhe “prisni me durim” balancohen nga paradoksi tjetër, “tashmë” dhe “ende jo”.

TEMË E VEÇANTË: PARASHIKIMET E DHIA TËS SË VJETËR PËR TË ARDHMEN KUNDREJT PARASHIKIMEVE TË DHIA TËS SË RE (“HYRJE E RËNDËSISHME” PËR ZBULESËN) (SPECIAL TOPIC: OLD TESTAMENT PREDICTIONS VS. NEW TESTAMENT PREDICTIONS)

Gjatë viteve që kam studiuar eskatologjinë, kam mësuar se shumica e të krishterëve nuk kanë, ose nuk duan, një kronologji të zhvilluar dhe të sistematizuar të kohëve të fundit. Por ka dhe disa të krishterë që fokusohen ose përqendrohen te kjo doktrinë e krishtërit për arsye teologjike, psikologjike ose denominacionale. Këta të krishterë fiksohen te mënyra sesi do të përfundojë gjithçka dhe, në njëfarë mënyre, humbasin natyrën urgjente të ungjillit! Besimtarët nuk mund të ndikojnë te plani eskatologjik (i kohëve të fundit) i Perëndisë, por mund të marrin pjesë në urdhërimin e ungjillit (shih Mat. 28:19-20; Luka 24:46-47; Veprat 1:8). Shumica e besimtarëve besojnë te Ardhja e Dytë e Krishtit dhe te kulminimi i premtimeve të Perëndisë në kohët e fundit. Problemet interpretuese, që dalin nga mënyra sesi e kuptojmë këtë pikë kulmore kohore, vijnë nga një sërë paradoksesh biblike.

1. tensioni mes modeleve profetike të Besëlidhjes së Vjetër dhe modeleve apostolike të Besëlidhjes së Re
2. tensioni mes monoteizmit të Biblës (një Perëndi për të gjithë) dhe zgjedhjes së Izraelit (si popull i veçantë)
3. tensioni mes aspektit të kushtëzuar të besëlidhjeve dhe premtimeve biblike (“nëse... atëherë”) dhe besnikërisë së pakushtëzuar të Perëndisë ndaj shpengimit të njerëzimit të rënë
4. tensioni mes gjinive letrare të Lindjes së Afërt dhe modeleve moderne letrare perëndimore
5. tensioni mes Mbretërisë së Perëndisë si e tashme, por edhe e ardhme.
6. tensioni mes besimit në kthimin e Krishtit nga çasti në çast dhe besimit se disa ngjarje duhet të ndodhin paraprakisht.

Le t'i diskutojmë me radhë këto tensione.

TENSIONI I PARË (kategoritë raciale, kombëtare dhe gjeografike të DHV përkundrejt ekzistencës së gjithë besimtarëve në gjithë botën)

Profetët e DHV parathënë rikthimin e mbretërisë judaike në Palestinë, me qendër në Jerusalem, ku të gjitha kombet e tokës do të mblidhen për të lavdëruar dhe për t'i shërbyer një mbreti davidik, por as Jezusi dhe as apostujt e DHR nuk përqendrohen te kjo axhendë. A nuk është e frymëzuar DHV (shih Mat. 5:17-19)? Mos, ndoshta, autorët e DHR kanë lënë pa përmendur ngjarje të rëndësishme të kohëve të fundit?

Ka një sërë burimesh informacioni për fundin e botës.

1. Profetët e DHV (Isaia, Mikea, Malakia)
2. Shkruesit apokaliptikë të DHV (shih Ezek. 37-39; Danieli 7-12; Zakaria)
3. Shkruesit apokaliptikë judenj jokanonikë të kohës ndërthjatore (si *I Enokut*, që aludohet te Juda)
4. Vetë Jezusi (shih Mat. 24; Marku 13; Luka 21)
5. Shkrimet e Palit (shih 1 Kor. 15; 2 Kor. 5; 1 Thes. 4-5; 2 Thes. 2)
6. Shkrimet e Gjonit (1 Gjonit dhe Zbulesa)

A mësojnë të gjithë këta qartazi një plan të qartë të kohëve të fundit (ngjarje, kronologji, persona)?

Nëse jo, pse? A nuk janë të gjithë të frymëzuar (me përjashtim të shkrimeve judaike ndërthjatore)?

Fryma ua zbuloi të vërtetat shkruesve të DHV me fjalë dhe kategori që ata ishin në gjendje t'i kuptonin. Sidoqoftë, nëpërmjet zbulesës së përshkallëzuar, Fryma i ka zgjeruar këto koncepte eskatologjike të DHV duke iu dhënë një gamë universale ("misteri i Krishtit", shih Efe. 2:11-3:13). Ja disa shembuj me vend:

1. Qyteti i Jerusalemit në DHV përdoret si metaforë për popullin e Perëndisë (Sioni), por në DHR projektohet si term që shpreh pranimin nga Perëndia të të gjithë njerëzve që pendohen dhe besojnë ("Jerusalemi i ri", Zbulesa 21-22). Zgjerimi teologjik i një qyteti të vërtetë dhe fizik për të nënkuptuar popullin e ri të Perëndisë (besimtarët judenj dhe johebrenj) parathuhet në premtimin e Perëndisë për ta shpenguar njerëzimin e rënë në Zan. 3:15, përpara se të kishte judenj apo një kryeqytet jude. Edhe thirrja e Abrahamit (shih Zan. 12:1-3) i përfshinte johebrenjtë (shih Zan. 12:3; Eks. 19:5). Shih Temën e Veçantë: Plani i përjetshëm shpengues i JHVH.
2. Në DHV, armiqtë e popullit të Perëndisë janë kombet përreth të Lindjes së Afërt, kurse në DHR armiqtë janë gjithë njerëzit mosbesues, kundër Perëndisë dhe të frymëzuar nga Satani. Beteja është zhvendosur nga konflikti gjeografik dhe rajonal në një konflikt të përbotshëm kozmik (shih Kolosianëve).
3. Premtimi i tokës së Izraelit, që ishte tejet i rëndësishëm në DHV (premtimet patriarkale të Zanafillës, shih Zan. 12:7; 13:15; 15:7, 15, 16; 7:8), tani përfshin gjithë tokën. Jeruslemi i ri zbret në tokën e rikrijuar, jo vetëm në Lindjen e Afërt (shih Zbu. 21-22).
4. Disa shembuj të tjerë të koncepteve profetike të DHV që tani janë zgjeruar:
 - a. Fara e Abrahamit tani është e rrethprerë shpirtërisht (shih Rom. 2:28-29)
 - b. Populli i besëlidhjes tani përfshin johebrenjtë (shih Os. 1:10; 2:23, cituar në Rom. 9:24-26; dhe Lev. 26:12; Eks. 29:45, cituar në 2 Kor. 6:16-18 dhe Eks. 19:5; LiP. 14:2, cituar në Titit 2:14)
 - c. Tempulli tani është Jezusi (shih Mat. 26:61; 27:40; Gjoni 2:19-21) dhe, përmes tij, kisha lokale (shih 1 Kor. 3:16) ose besimtari si individ (shih 1 Kor. 6:19)
 - d. Edhe Izraeli, si dhe frazat që e përshkruajnë atë në DHV, tani nënkupton gjithë popullin e Perëndisë (pra, "Izraeli", shih Rom. 9:6; Gal. 6:16; ose "mbretëri priftërinjsh", shih 1 Pje. 2:5, 9-10; Zbu. 1:6)

Modeli profetik tani është përmbushur, zgjeruar dhe është bërë më përfshirës. Jezusi dhe shkruesit apostolikë nuk e paraqesin fundin e kohës njësoj si profetët e DHV (shih Martin Wyngaarden, *The Future of the Kingdom in Prophecy and Fulfillment*). Interpretuesit modernë që përpiqen ta bëjnë modelin e DHV të fjalëpërfjalshëm ose të detyrueshëm e deformojnë librin e Zbulesës duke e kthyer në një libër shumë judaik dhe fusin kuptime të paqena në frazat e shkurtra ose të paqarta të Jezusit dhe Palit! Shkruesit e DHR nuk i mohojnë profetët e DHV, por tregojnë domethënien e tyre absolute dhe universale. Eskatologjia e Jezusit ose e Palit nuk është një sistem i organizuar dhe logjik. Synimi i tyre ishte, pikësepari, shpengues ose pastoral.

Megjithatë, edhe brenda DHR ekziston njëfarë tensioni. Nuk ka sistematizim të qartë të ngjarjeve eskatologjike. Në shumë mënyra, Zbulesa çuditërisht përdor aludime nga DHV, jo mësimet e Jezusit, për të përshkruar fundin (shih Mat. 24; Marku 13)! Zbulesa ndjek gjininë letrare të nisur nga Ezekieli, Danieli dhe Zakaria, por që u zhvillua më tepër gjatë periudhës ndërthjatore (literatura apokaliptike judaike). Ndoshta, në këtë mënyrë, Gjoni lidhi Besëlidhjen e Vjetër me atë të Re. Kjo tregon modelin e lashtë të rebelimit njerëzor dhe përkushtimin e Perëndisë për shpengimin e njerëzimit! Por duhet thënë se, ndonëse Zbulesa përdor

terminologji, personazhe dhe ngjarje të DHV, i interpreton ata në dritën e Romës së shekullit të parë (shih Zbulesa 17).

TENSIONI I DYTË (monoteizmi kundrejt popullit të zgjedhur)

Theksi biblik vihet te një Perëndi personal, shpirtëror dhe krijues-shpengues (shih Eks. 8:10; Isa. 44:24; 45:5-7, 14, 18, 21-22; 46:9; Jer. 10:6-7). Tipari unik i DHV për kohën e vet ishte monoteizmi (shih Tema e Veçantë: Monoteizmi). Të gjitha kombet përreth ishin politeistë. Natyra unik e Perëndisë ishte thelbi i zbulesës së DHV (shih LiP. 6:4). Krijimi është skenë për miqësinë mes Perëndisë dhe njerëzimit, që është krijuar në shëmbëllimin dhe ngjashmërinë e tij (shih Zan. 1:26-27). Megjithatë, njerëzimi u rebelua, mëkatoi kundër dashurisë, udhëheqjes dhe qëllimit të Perëndisë (shih Zan. 3). Dashuria dhe synimi i Perëndisë ishin kaq të sigurt dhe kaq të patundur sa që ai premtoi se do ta shpengonte njerëzimin e rënë (shih Zan. 3:15)!

Tensioni shfaqet kur Perëndia zgjedh të përdorë një njeri, një familje, një komb të vetëm për të ungjillizuar gjithë njerëzimin. Zgjedhja e Abrahamit nga Perëndia (shih Zan. 12; 15; 17; 18) dhe e judenjve si komb priftërinjsh (shih Esk. 19:4-6) ngjalli krenari në vend që të nxiste ndjesinë e shërbesës; shkaktoi përjashtim, jo përfshirje. Thirrja hyjnore e Abrahamit përfshinte si synim bekimin e gjithë njerëzimit (shih Zan. 12:3). Duhet mbajtur parasysh dhe duhet theksuar fakti se zgjedhja në DHV ishte për shërbesë, jo për shpëtim. Nuk ishte gjithë Izraeli në rregull me Perëndinë, dhe as nuk shpëtoheshin izraelitët përjetësisht thjesht për shkak se kishin lindur të tillë (shih Gjoni 8:31-59; Mat. 3:9); shpëtimi ishte me anë të besimit dhe bindjes personale (shih Zan. 15:6; cituar në Rom. 4:3, 9, 22; Gal. 3:6). Izraeli e humbi misionin e vet (tani, kisha është mbretëri priftërinjsh, shih Zbu. 1:6; 1 Pje. 2:5, 9) dhe e ktheu urdhrin hyjnor në privilegj, dhe shërbesën në pozitë të veçantë! Perëndia zgjodhi njërin për t'i zgjedhur të gjithë!

TENSIONI I TRETË (besëlidhjet e kushtëzuara kundrejt besëlidhjeve të pakushtëzuara)

Ekziston një tension, ose paradoks, teologjik mes besëlidhjeve të kushtëzuara dhe atyre të pakushtëzuara. Është sigurisht e vërtetë se synimi/plani shpengues i Perëndisë është i pakushtëzuar (shih Zan. 15:12-21). Gjithsesi, reagimi i kërkuar njerëzor është gjithmonë i kushtëzuar!

Modeli “nëse... atëherë” shfaqet si në DHV, ashtu dhe në DHR. Perëndia është besnik; njerëzimi është jobesnik. Ky tension ka shkaktuar shumë pësjtjellim. Interpretuesit janë prirur të fokusohen te vetëm një nga këto dy “brirët e dilemës”: ose të besnikëria e Perëndisë, ose të përpjekja njerëzore; ose të sovraniteti i Perëndisë, ose te vullneti i lirë i njeriut. Të dyja janë biblike dhe të nevojshme. Shih Temën e Veçantë: Zgjedhja/Paracaktimi dhe Nevoja për një Drejtpeshim Teologjik.

Kjo lidhet me eskatologjinë, me premtimet e Perëndisë për Izraelin në DHV. Nëse Perëndia premtonte diçka, kryhet patjetër! Perëndia detyrohet nga premtimet e tij; në këtë mes bëhet fjalë për reputacionin e tij (shih Ezek. 36:22-38). Besëlidhjet e pakushtëzuara dhe ato të kushtëzuara piqen në Krishtin (shih Isa 53), jo në Izraelin! Besnikëria absolute e Perëndisë ka të bëjë me shpengimin e gjithë atyre që pendohen dhe besojnë, jo me faktin se kë ke nënë/baba! Çelësi i gjithë besëlidhjeve dhe premtimeve të Perëndisë është Krishti, jo Izraeli. Nëse në Bibël ka një parantezë teologjik, kjo parantezë është Izraeli, jo kisha (shih Veprat 7 dhe Galatasve 3).

Misioni botëror i shpalljes së ungjillit i ka kaluar kishës (shih Mat. 28:19-20; Luka 24:47; Veprat 1:8). Kjo besëlidhje mbetet e kushtëzuar! Kjo nuk do të thotë se Perëndia i ka hedhur plotësisht poshtë judenjtë (shih Romakëve 9-11). Për Izraelin besimtar mund të ketë një vend dhe synim hyjnor në kohën e fundit (shih Zak. 12:10).

TENSIONI I KATËRT (modelet letrare të Lindjes së Afërt kundrejt modeleve perëndimore).

Gjinia letrare është element kritik për interpretimin e saktë të Biblës (shih Fee dhe Stuart, *How to Read the Bible for All Its Earth*). Kisha u zhvillua në një mjedis kulturor perëndimor (grek). Literatura lindore është shumë më e figurshme, metaforike dhe simbolike se modelet letrare të kulturës perëndimore moderne (shih Temën e Veçantë: Literatura lindore (paradokset biblike)). Ajo përqendrohet në njerëzit, takimet dhe ngjarjet, më shumë sesa në të vërtetat doktrinale koncize. Të krishterët kanë qenë fajtorë për përdorimin e historisë dhe modeleve të tyre letrare për të interpretuar profecinë biblike (në DHV apo DHR). Çdo brez dhe grupim gjeografik ka përdorur kulturën, historinë dhe interpretimin e vet të fjalëpërfjalshëm për të interpretuar Zbulesën. Dhe të gjithë kanë qenë gabim! Është arrogante të mendosh se kultura perëndimore moderne është fokusi i profecisë biblike!

Gjinia letrare në të cilën zgjedh të shkruajë autori i parë i frymëzuar është një kontratë letrare me lexuesin (Bruce Corley). Libri i Zbulesës nuk është narrativë historike. Ai është kombinim i literaturës së

letrave (kapitujt 1-3), profecisë dhe, kryesisht, asaj apokaliptike. Është gabim ta detyrosh Biblën të thotë me tepër nga ç'ka dashur të thotë autori original, ashtu siç është gabim ta bësh Biblën të thotë më pak nga ç'ka dashur të thotë autori! Arroganca dhe dogmatizmi i interpretuesve janë edhe më të pavenda me një libër si Zbulesa.

Kisha nuk ka rënë kurrë dakord për interpretimin e saktë të Zbulesës. Preokupimi im është të dëgjoj dhe të trajtoj gjithë Biblën, jo vetëm disa pjesë të përzgjedhura. Mendësia lindore e Biblës e paraqet të vërtetën në dyshe të mbushura me tension. Pirja jonë perëndimore drejt së vërtetave dogmatike nuk është e pavlerë, por është e padrejtpeshuar! Mendoj se është e mundur që një pjesë të vështirësisë për interpretimin e Zbulesës ta heqim duke vërejtur qëllimin e tij gjithnjë në ndryshim për brezat e ndryshëm të besimtarëve. Shumica e interpretuesve mendojnë se Zbulesa duhet interpretuar në dritën e kohës dhe gjinisë letrare të vet. Qasja historike ndaj Zbulesës duhet të trajtojë atë që duhet të kenë kuptuar lexuesit e parë. Në shumë mënyra, interpretuesit modernë e kanë humbur kuptimin e shumë prej simboleve të këtij libri. Thelbi qendror i Zbulesës ishte të inkurajonte besimtarët e përndjekur. Ai tregoi se Perëndia e kishte historinë nën kontroll (siç thoshin dhe profetët e DHV); pohoi faktin se historia po lëviz drejt një fundi të paracaktuar: gjykim ose bekim (si në profetët e DHV). Pohoi, me terminologji apokaliptike judaike të shekullit të parë, dashurinë, praninë, fuqinë dhe sovranitetin e Perëndisë!

Zbulesa funksionon në të njëjtat mënyra teologjike për çdo brez besimtarësh. Pasqyron betejën kozmike mes së mirës dhe së keqes. Ndoshta, ne s'i kuptojmë më disa detaje të shekullit të parë, por kuptojmë të vërtetat e fuqishme dhe ngushëlluese. Kur interpretuesit perëndimorë modernë përpiqen t'i fusin me detyrim detajet e Zbulesës brenda kuadrin të historisë së kohës së tyre, vijon modeli i interpretimeve të rreme!

Ka mundësi që detajet e Zbulesës të bëhen sërish tejet të fjalëpërfjalshme (siç ndodh në DHV me lindjen, jetën dhe vdekjen e Krishtit) për brezin e fundit të besimtarëve, të cilët do të përballen me mësymjen e një udhëheqësi dhe kulture anti-Perëndi (shih 2 Thesalonikasve 2). Askush s'mund t'i kuptojë këto përmbushje të fjalëpërfjalshme të Zbulesës pa u bërë historikisht të qarta dhe fjalët e Jezusit (shih Matu 24; Marku 13; Luka 21) dhe të Palit (shih 1 Korintasve 15; 1 Thesalonikasve 4-5; dhe 2 Thesalonikasve 2). Hamendësimet, vramendjet dhe dogmatizmi janë të pavenda. Literatura apokaliptike lejon njëfarë elasticiteti. Lavdi Perëndisë për metaforat dhe simbolet që e tejkalojnë narrativën historike! Perëndia e ka në dorë historinë; ai mbretëron; madje, do të vijë sërish!

Shumica e komentareve modernë as nuk e kapin fare thelbin e kësaj gjinie letrare! Interpretuesit perëndimorë modernë, shpesh përpiqen të formojnë një sistem të qartë dhe logjike teologjike, në vend që të jenë të ndershmë me gjininë e paqartë, simbolike dhe dramatike të literaturës apokaliptike judaike. Kjo e vërtetë është shprehur bukur nga Ralph P. Martin në artikullin e tij, "Approaches to New Testament Exegesis", në librin *New Testament Interpretation*, redaktuar nga I. Howard Marshall:

"Nëse nuk kuptojmë cilësinë dramatike të saj veprë dhe nuk kemi parasysh mënyrën sesi e përdor ajo gjuhën, pra, si mjet për të shprehur të vërteta fetare, kemi për të gabuar rëndë në përpjekjen për të kuptuar Apokalipsin; madje, do të përpiqemi gabimisht që t'i interpretojmë vegimet e tij si të ishte një libër proze të fjalëpërfjalshme që përpiqet të përshkruajë ngjarje të datueshme dhe empirike në histori. Kjo mënyrë interpretimi ka për t'u përballur me gjithfarëlloj problemesh interpretimi. Ç'është më e rëndësishme, ky interpretim çon në shtrembërimin e kuptimit thelbësor të apokaliptikës dhe, në këtë mënyrë, s'arrin të rrokë vlerën madhështore të kësaj pjese të Dhiatës së Re si shprehje dramatike (me terminologji mitopoetike) e sovranitetit të Perëndisë në Krishtin dhe paradoksin e sundimit të tij, që e përziën forcën me dashurinë (shih Zbu. 5:5, 6; Luani është Qengji)" (f. 235).

W. Randolph Tate, në librin e tij, *Biblical Interpretations*, shkruan:

"Asnjë gjini tjetër e Biblës nuk është lexuar me kaq zell dhe me rezultate kaq të trishtueshme sa apokalipsi, sidomos librat e Danielit dhe Zbulesës. Kjo gjini letrare ka vuajtur nga një histori shkatërrimtare keqinterpretimi për shkak të një keqkuptimi themelor të formave, strukturës dhe synimit të saj letrar. Për shkak të fakti se pohon që do të na zbulojë atë që do të ndodhë pas pak, apokalipsi është parë si hartë itinerari e së ardhmes, ose si planimetri e së ardhmes. E meta tragjike e kësaj pikëpamjeje është koncepti i saj se kuadri i referencës së librit në fjalë është epoka e lexuesit, jo ajo e autorit. Kjo qasje e gabuar ndaj apokalipsit (sidomos ndaj Zbulesës) e trajton veprën si të ishte një kriptogram me anë të së cilit ngjarjet e kohës sonë mund të përdoren për të interpretuar simbolizmin e

tekstit. Pikësëpari, interpretuesi duhet të kuptojë se apokaliptika i përçon mesazhet e veta nëpërmjet simbolizmit. Interpretimi i simbolit në mënyrë të fjalëpërfjalshme, kur ai është metaforik, është thjesht keqinterpretim. Çështja nuk është nëse ngjarjet e apokaliptikës janë historike ose jo. Ngjarjet mund të jenë historike; mund të kenë ndodhur, ose mund të ndodhin, por autori i paraqet ngjarjet dhe e përçon kuptimin nëpërmjet metaforave dhe arketipeve” (f. 137).

Nga *Dictionary of Biblical Imagery*, redaktuar nga Ryken, Wilhost dhe Longman III:

“Lexuesit e sotëm, shpesh, pëshqjellohen dhe acarohen nga kjo gjini letrare. Simbolika e papritur dhe përjetimet e jashtëbotshme na duken të çuditshme dhe pa lidhje me pjesën më të madhe të Shkrimit. Leximi i kësaj literature në mënyrë të fjalëpërfjalshme i detyron shumë lexues që të rreken të përcaktojnë “çfarë do të ndodhë dhe kur”; në këtë mënyrë, ata e humbasin synimin e mesazhit apokaliptik” (f. 35).

TENSIONI I PESTË (Mbretëria e Perëndisë si e tashme, por edhe e ardhme)

Mbretëria e Perëndisë është edhe e tashme, edhe e ardhme. Ky paradoks teologjik përqendrohet sidomos në pikën e eskatologjisë. Nëse presim përmbushjen e fjalëpërfjalshme të të gjitha profecive të DHV për Izraelin, atëherë Mbretëria përbën kryesisht rikthimin e Izraelit në një vend gjeografik dhe në një pozitë të rëndësishme teologjike! Kjo do të kërkonte që kisha të rrëmbëhej fshehtaz në kapitullin 5, dhe pastaj kapitujt e tjerë të Zbulesës do të flisnin vetëm për Izraelin (por vini re Zbu. 22:16).

Nga ana tjetër, nëse fokusi është te mbretëria e inauguruar nga Mesia i premtuar në DHV, atëherë mbretëria është e pranishme që në ardhjen e parë të Krishtit, dhe pastaj fokusi është mishërimi, jeta, mësimet, vdekja dhe ringjallja e Krishtit. Në këtë mënyrë theksi teologjik është te shpëtimi i tanishëm. Mbretëria ka ardhur, DHV është përmbushur në ofertën e shpëtimit që Krishti u ka dhënë të gjithë njerëzve, dhe jo në mbretërimin e tij mijëvjeçar mbi disa njerëz në veçanti!

Është, pa dyshim, e vërtetë se Bibla flet për të dyja ardhjet e Krishtit, por ku duhet ta vendosim theksin? Unë mendoj se shumica e profecive të DHV përqendrohen në ardhjen e parë të Mesisë, në themelimin e mbretërisë mesianike (shih Danieli 2). Në shumë mënyra, kjo ngjason me mbretërimin e përjetshëm të Perëndisë (shih Danieli 7). Në DHV, fokusi është te mbretërimi i përjetshëm i Perëndisë, mirëpo mekanizmi për shfaqjen e atij mbretërimi është shërbesa e Mesisë (shih 1 Kor. 15:25-27). Nuk është çështja se cila prej këtyre dy aspekteve është e vërtetë; të dyja janë të vërteta, por ku duhet vënë theksi? Duhet tëhën se disa interpretues përqendrohen kaq shumë te mbretërimi mijëvjeçar i Mesisë (shih Mësimet Kontekstuale të Zbulesës 20), sa që nuk e rrokin përqendrimin e Biblës te mbretërimi i përjetshëm i Atit. Mbretërimi i Krishtit është ngjarje e përkohshme. Meqë dy ardhjet e Krishtit nuk ishin të qarta në DHV, as mbretërimi i përjetshëm i Mesisë nuk është i tillë!

Çelësi për të kuptuar predikimet dhe mësimet e Jezusit është mbretëria e Perëndisë. Ajo është e tanishme (në shpëtim dhe shërbesë), por edhe e ardhshme (në bindje dhe fuqi). Nëse Zbulesa përqendrohet te mbretërimi mijëvjeçar mesianik (shih Zbulesa 20), flet për diçka paraprake, jo përfundimtare (shih Zbulesa 21-22). DHV nuk na thotë se është e nevojshme të ketë një mbretërim të përkohshëm; madje, mbretërimi mesianik në Danieli 7 është i përjetshëm, jo mijëvjeçar.

TENSIONI I GJASHTË (kthimi i papritur i Krishtit kundrejt *Parousia*-s së vonuar)

Shumicës së besimtarëve iu është mësuar se Jezusi po vjen shpejt, papritur dhe papandehur (shih Mat. 10:23; 24:27,34,44; Marku 9:1; 13:30; Zbu. 1:1,3; 2:16; 3:11; 22:7,10,12,20; shih Temën e Veçantë: Kthimi Shpejt). Por çdo brez besimtarësh në pritje deri tani e ka patur gabim! Shpejtësia (ardhja nga çasti në çast) e kthimit të Jezusit është një shpresë e fuqishme premtimi për çdo brez, por si realitet do të vlejë vetëm për njërin prej tyre (dhe ai do të jetë brez i përndjekur). Besimtarët duhet të jetojnë sikur Jezusi vjen nesër, por duhet të planifikojnë dhe të zbatojnë Porosinë e Madhe (shih Mat. 28:19-20) për sa kohë ai s’vjen.

Disa pasazhe në ungjijtë dhe në 1 e 2 Thesalonikasve bazohen në vonimin e Ardhjes së Dytë (*Parousia*). Ja disa ngjarje historike që duhet të ndodhin më parë:

1. ungjillizimi i mbarë botës (shih Mat. 24:14; Marku 13:10)
2. zbulesa e “njeriut të Mëkatit” (shih Mat. 24:15; 2 Thesalonikasve 2; Zbulesa 13)
3. përndjekja e madhe (shih Mat. 24:21, 24; Zbulesa 13)

Vagullia biblike është e qëllimshme (shih Mat. 24:42-51; Marku 13:32-36)! Jeto çdo ditë sikur ta kesh ditën e

fundit, por planifiko dhe trajnohu për shërbesë të ardhshme!

KONSEKUENCA DHE EKUILIBRI

Duhet pranuar se të gjitha shkollat e ndryshme të interpretimit eskatologjik modern përmbajnë disa gjysmë të vërteta. Ato shpjegojnë dhe interpretojnë mirë disa pasazhe biblike. Problemi qëndron te konsekuenca dhe ekuilibri. Shpesh, shohim një grup supozimesh paraprake që e përdorin tekstin biblik për të mbushur një skelet teologjik të paracaktuar. Por Bibla nuk na zbulon një eskatologji logjike, kronologjike apo sistematike. Ajo është si albumi i familjes. Fotot janë të vërteta, por jo gjithmonë në rendin e duhur, në kontekstin e duhur, apo në radhë logjike. Disa nga foto të albumit janë hequr dhe brezat e mëvonshëm të faimljes nuk e dinë me saktësi sesi ti vendosin sërish në vend. Çelësi për interpretimin e saktë të Zbulesës është synimi i autorit origjinal, që na zbulohet në gjininë letrare që zgjodhi ai. Shumica e interpretuesve përpiqen që, në interpretimin e Zbulesës, të përdorin mjete dhe procedura ekzegjetike që ata i kanë mbartur nga gjini të tjera letrare të DHR. Përqendrohen në DHV, në vend që të lejojnë që mësimet e Jezusit dhe Palit ta përcaktojnë strukturën teologjike, dhe ta lejojnë Zbulesën që të veprojë si ilustrim i këtyre mësimëve.

Duhet të rrëfej se komentimit të Zbulesës i qasem me njëfarë frike dhe dridhjeje, jo për shkak të mallkimit të Zbu. 22:18-19, por për shkak të polemikës së fortë që ka shkaktuar interpretimi i këtij libri, madje vazhdon të shkaktojë në popullin e Perëndisë. E dua me shpirt zbulesën e Perëndisë. Ajo është e vërtetë edhe nëse gjithë njerëzit janë gënjeshtarë (shih Rom. 3:4)! Të lutem, përdore këtë komentari si diçka që të nxit të mendosh, jo si mendim përfundimtar, si shenjë rrugore, por jo si hartë itinrari, si një “po sikur”, por jo si “kështu thotë Zoti”. Unë kam arritur të përballem me mangësitë, paragjykimet dhe axhendën time teologjike. Kam vërejtur dhe ato të interpretuesve të tjerë. Duket pothuajse sikur njerëzit gjejnë në Zbulesë pikërisht atë që prisnin të gjenin. Kjo gjini letrare mund të abuzohet lehtësisht! Megjithatë, ajo nuk është kot në Bibël. Vendosja e Zbulesës si “fjala” përmbyllëse nuk është rastësi. Ajo ka një mesazh prej Perëndisë për fëmijët e tij në çdo brez. Perëndia dëshiron që të kuptojmë! Le të bashkojmë duart, jo të formojmë kampe lufte; le të pranojmë atë që është e qartë dhe qendrore, jo gjithçka që mund të ishte ose të jetë. Perëndia na ndihmoftë të gjithëve!

TEMË E VEÇANTË: LITERATURA APOKALIPTIKE (nga Hyrja e librit të Zbulesës) (SPECIAL TOPIC: APOCALYPTIC LITERATURE [from Intro. to Revelation])

Zbulesa është një gjini letrare unike për mendimin judaik: gjinia apokaliptike. Shpesh, përdorej në periudha të mbushura me tension për të shprehur bindjen se historinë e kishte në dorë Perëndia dhe se ai do të sillte çlirim për popullin e vet. Kjo lloj literature karakterizohet nga

1. një bindje e fortë për sovranitetin universal të Perëndisë (monoteizmi dhe determinizmi)
2. beteja mes së mirës dhe së ligës, e kësaj epoke dhe epokës që po vjen (dualizmi)
3. përdorimi i fjalëve të fshehta e të koduara (zakonisht nga DHV ose nga literatura apokaliptike judaike ndërthjatore)
4. përdorimi i ngjyrave, numrave, kafshëve, ndonjëherë dhe kafshëve/njerëzve
5. përdorimi i ndërmjetësimit engjëllor nëpërmjet vegimeve dhe ëndrrave, por zakonisht përmes ndërmjetësimit engjëllor
6. përqendrohet pikësëpari në kohët e fundit (epoka e re)
7. përdorimi i një grupi të ngulët simbolesh, dhe jo i realitetit, për të përçuar mesazhin për kohët e fundit
8. Disa shembuj të kësaj gjini janë
 - a. Dhiata e Vjetër
 - (1) Isaia 24-27, 56-66
 - (2) Ezekieli 37-48
 - (3) Danieli 7-12
 - (4) Joeli 2:28-3:21
 - (5) Zakaria 1-6, 12-14
 - b. Dhiata e Re
 - (1) Mateu 24, Marku 13, Luka 21 dhe 1 Korintasve 15 (në disa mënyra)
 - (2) 2 Thesalonikasve 2 (në disa mënyra)

- (3) Zbulesa (kapitujt 4-22)
- c. Literatura jokanonike (marrë nga D. S. Russell, *The Method and Message of Jewish Apocalyptic*, f. 37-38)
- (1) *1 Enokut, 2 Enokut (Sekretet e Enokut)*
 - (2) *Libri i jubileve*
 - (3) *Orakujt sibilinë III, IV, V*
 - (4) *Testamenti i dymbëdhjetë patriarkëve*
 - (5) *Psalmet e Solomonit*
 - (6) *Ngritja e Moisiut*
 - (7) *Martirizimi i Isaisë*
 - (8) *Apokalipsi i Moisiut (Jeta e Adamit dhe Evës)*
 - (9) *Apokalipsi i Abrahamit*
 - (10) *Testamenti i Abrahamit*
 - (11) *2 Ezra (IV Ezra)*
 - (12) *Baruku II, III*

9. Kjo gjini shfaq një sens dualiteti. E sheh realitetin si një sërë dualizmash, kontrastesh, ose tensionesh (shumë e përdorur në shkrimet e Gjonit) midis:
- a. qiellit dhe tokës
 - b. epokës së ligësisë (njerëzve dhe engjëjve të ligj) dhe epokës së re të drejtësisë (njerëzit dhe engjëjt e perëndishëm)
 - c. ekzistencës së tanishme dhe ekzistencës së ardhme

Të gjitha kato po lëvizin drejt përmbushjes, që do të kryhet nga Perëndia. Kjo botë nuk është ajo që kishte patur ndërmend Perëndia, por ai po vazhdon të punojë dhe të kryejë vullnetin e vet për rimëkëmbjen e miqësisë së ngushtë që nisi dikur në Kopshtin e Edenit. Ardhja e Krishtit ishte pika e nisjes së përmbushjes së planit të Perëndisë, por dy ardhjet e tij kanë shkaktuar dualizmat e tanishëm.

PËRVIJIMI I MUNDSHËM NË LIDHJE ME PYETJET E DISHEPUJVE (marrë nga F. F. Bruce, *Answers to Questions*, f. 57)

- A. Paralajmërimi që mos mashtrohemi (Marku 13:5-8)
- B. Profecitë e përndjekjes (Marku 13:9-13)
- C. Shkatërrimi i Jerusalemit (Marku 13:14-23)
- D. Kthimi i Krishtit (Marku 13:24-27)
- E. Thirrjet që dishepujt të ruhen në situatën e atëhershme, që çoi në shkatërrimin e Jerusalemit (Marku 13:28-31; pra, ai brez, Marku 13:34)
- F. Thirrjet që të ruhen për ardhjen e Zotit (Marku 13:32-37; askush nuk e di veç Atit. Marku 13:36)
- G. F. F. Bruce mendon se Marku 13 është paralel me gjashtë vulat e para të Zbulesës 6 (shih f. 57 dhe 138)

STUDIMI I FJALËVE DHE FRAZAVE

TEKSTI I NASB (I PËRDITËSUAR): MARKU 13:1-2

¹Teksa po dilte nga tempulli, njëri nga dishepujt i tha: “Mësues, ja ç’gurë të mahnitshëm dhe ç’godina të mrekullueshme!” ²Dhe Jezusi i tha: “A i shikon këto godina të mëdha? Asnjë gur nuk do të mbetet mbi tjetrin, pa u rrënuar”.

13:1 “tempulli” Kjo ishte fjala (*hieron*) për gjithë zonën e tempullit. Jezusi kishte dhënë mësim aty që nga ngjarjet e Markut 11 (shih Mat. 26:55). Këto ndërtesa ishin shndërruar në shpresën e madhe judaike, si simbol i dashurisë unike të Perëndisë për Izraelin (shih Jer. 7; Gjoni 8:31-59).

■ **“njëri nga dishepujt”** Ky mund të ketë qenë Pjetri (shih Marku 13:3). Gjon Marku, ndoshta, po na jep kujtesën e fjalëve të Jezusit nga Pjetri. Ky është sesioni më i gjatë mësimdhënës në ungjillin e Markut.

■ **“gurë të mahnitshëm”** Fjalë për fjalë, “gurë të stërmëdhenj”. Jozefusi na thotë se Herodi i Madh përdori gurë të stërmëdhenj gëlqerorë, ose *mezzeh*, që ndodheshin në atë zonë. Ishin 25 x 8 x 12 kubitë (shih *Lashtësitë* 15.11.3). Gurë me madhësi dhe prej materialesh të ngjashme duken ende në murin vajtues në Jerusalem.

■ **“godina të mrekuallueshme”** Fjalë për fjalë, “ndërtesa të stërmëdha”. Ishin prej gurësh të bardhë dhe të lëmuar gëlqerorë dhe të lyer me flori. Kjo ndërtesë e stërmadhe dhe e shtrenjtë ishte ndërtuar për t’i qetësuar judenjtë, që ishin të acaruar nga fakti se kishin si mbret një idumeas. Ky rimodelim dhe zgjerim kishte nisur më 20/19 para K., dhe përfundoi rreth 63/64 pas K. (shih *Lashtësitë* e Jozefusit 15.11.1-7; *Luftrat* 5.5.1-6).

13:2 “Asnjë gur nuk do të mbetet mbi tjetrin” Kjo frazë ka forma mohore me një folje në formën lidhore. Nuk ka mohim më të fortë gramatikore se ky në gjuhën greke! Kjo tregon shkatërrim të plotë. Kjo gjë duhet t’i ketë shtangur dishepujt! Jozefusi na thotë se, në 70 pas K., romakët e shkatërruan këtë vend kaq plotësisht sa që mund të shije dhe tokën si fushë (shih Mik. 3:12; Jer. 26:18).

Për këtë frazë ka disa variante tekstuale në dorëshkrimet greke. Njëri ndjek formën e Mat. 24:2, që gjendet në dorëshkrimet e lashta uncialë greke Sinaitikus, B, L dhe W. I dyti ndjek formën e Lukës 21:6, që gjendet në dorëshkrimet A dhe në Vullgatë. UBS4 ndjek Mat. 24:2, që shton ndajfoljen “këtu”, ose “në këtë vend”.

TEKSTI I NASB (I PËRDITËSUAR): MARKU 13:3-8

³Ndërsa Jezusi ishte ulur në malin e Ullinjve përballë tempullit, Pjetri, Jakobi, Gjoni dhe Andrea po e pyesnin veçmas: ⁴“Na thuaj, kur do të ndodhin këto gjëra, dhe cila do të jetë shenja kur të gjitha këto gjëra do të përmbushen?” ⁵Dhe Jezusi filloi t’u thoshte: “Kujdesuni që askush të mos ju mashtrrojë. ⁶Shumë do të vijnë në emrin tim, duke thënë: ‘Unë jam ai!’ dhe do të mashtrojnë shumë vetë. ⁷Kur të dëgjoni për luftra dhe për zhurmë luftrash, mos u frikësoni; këto gjëra duhet të ndodhin; por ky nuk do të jetë ende fundi. ⁸Sepse një komb do të ngrihet kundër tjetrit, dhe një mbretëri kundër tjetrës; do të ketë tërmete në vende të ndryshme; do të ketë dhe zi buke. Këto gjëra janë thjesht fillimi i dhimbjeve të lindjes”.

13:3 “ulur në malin e Ullinjve” Kjo kreshtë 4 kilometërshe në lindje kishte pamje (ishte rreth 90-120 m më e lartë) nga Jerusalemi dhe zona e tempullit.

■ **“Pjetri, Jakobi, Gjoni dhe Andrea”** Vetëm ungjilli i Markut e përmend këtë hollësi. Kjo është ndoshta një nga kujtimet okulare të Pjetrit.

13:4 “kur do të ndodhin këto gjëra, dhe cila do të jetë shenja kur të gjitha këto gjëra do të përmbushen” Mateu 24:3 përmend pyetjet e zgjeruara. Kishte disa ngjarje për të cilat këta dishepuj donin të dinin: (1) koha e shkatërrimit të tempullit; (2) koha e Ardhjes së Dytë; dhe (3) koha e fundit të epokës. Dishepujt, ndoshta, mendonin se të tria do të ndodhnin në të njëjtën kohë. Vini re se Jezusi e shkrin të tashmen me eskatologjiken, njësoj si profetët e DHV.

TEMË E VEÇANTË: PËRGJIGJET PËR DY PYETJET E DISHEPUJVE NË LIDHJE ME KTHIMIN E KRISHTIT NË MATEU 24:3 (nga F. F. Bruce në *Answers to Questions*, f. 57)

- A. Paralajmërim për t’u ruajtur nga mashtrimi (prej profetësh të rremë ose prej fatkeqësish të mëdha) që të mendojmë se ky është fundi
1. Mat. 24:4-8
 2. Marku 13:5-8
 3. Luka 21:8-11
- B. Parashikimi i përndjekjeve dhe premtimi për ndihmë
1. Mat. 24:9-14
 2. Marku 13:9-13
 3. Luka 21:12-19

- C. Përgjigje për pyetjen e parë në lidhje me shkatërrimin e Jerusalemit dhe shpërndarjen e banorëve të tij
1. Mat. 24:15-28
 2. Marku 13:14-23
 3. Luka 21:20-24
- D. Përgjigje për pyetjen e dytë, që përshkruan ardhjen e Krishtit
1. Mat. 24:29-31
 2. Marku 13:24-27
 3. Luka 21:20-24
- E. Nxitje për vigjilencë në situatën që do të çojë deri në rënien e Jerusalemit
1. Mat. 24:32-35
 2. Marku 13:28-31
 3. Luka 21:29-33
- F. Nxitje për vigjilencë për ardhjen e Krishtit
1. Mat. 24:36-44
 2. Marku 13:32-37
 3. Luka 21:34-36

13:5-13 “Kujdesuni që askush të mos ju mashtrojë” “Kujdesuni” është urdhërore e tashme veprorë. Jezusi i urdhëron që të jenë vazhdimisht vigjilentë. Në disa mënyra, këto tradita judaike për Mesinë i kishin bërë dishepujt t’i besonin këtij lloj sistemi mendimi. Këto vargje përmendin shenja të rreme, ose shenja pararendëse, që janë të pranishme në çdo epokë. Kjo thënie përsëritet shpesh (shih Marku 13:5, 9, 23, 33). Do të vijnë shumë vetë që do të përpiqen t’i mashtrojnë dishepujt për këto çështje.

Çdo brez i krishterësh është përpjekur që ta detyrojë historinë e vet të momentit të përputhet me profecinë biblike. Deri tani, e kanë patur të gjithë gabim! Një pjesë e problemit është se besimtarët duhet të jetojnë duke pritur nga çasti në çast Ardhen e Dytë, mirëpo profecitë janë shkruar të gjitha për brezin e fundit të besimtarëve të përndjekur, pikërisht atë të kohës së fundit. Gëzohuni që nuk i dini këto!

13:6 “Shumë do të vijnë në emrin tim” Bëhet fjalë për Mesitë e rremë (shih Mat. 24:11, 23-24). Madje, ka dhe një referencë në librin e Jozefusit, *Luftrat e judenjve*, 6.54, që thotë se romakët e shkatërruan Jerusalemin nga fanatizmi i profetëve të rremë, të cilët e mashtruan popullin me premtimet e rreme se JHVH do të ndërhynte për ta shpëtuar Jerusalemin në bazë të profecive të Isaisë (shih Isa. 37), por, sigurisht, pa përmendur profecitë e përsëritura të Jeremisë për rënien e Jerusalemit jobesnik.

▣ **“duke thënë: “Unë jam ai”** Fjalë për fjalë, “unë jam”. Ishte përcaktim mesianik, që përdorte titullin e Perëndisë së besëlidhjes në DHV, JHVH, që vinte nga folja hebraisht “jam” (shih Eks. 3:12, 14; Gjoni 4:26; 8:24, 58; 13:19; 18:5). Shih Temën e Veçantë në Marku 12:36.

▣ **“dhe do të mashtrojnë shumë vetë”** Këto lloj paralajmërimesh dhe terminologjish janë të zakonshme për literaturën apokaliptike. Kjo tregon fuqinë bindëse të mesive të rremë, si dhe boshllëkun shpirtëror të njerëzimit të rënë (shih Mat. 24:11, 23-26). Po kështu, kjo tregon naivitetin e besimtarëve të rinj dhe/ose besimtarëve mishorë (shih 1 Kor. 3:1-3; Heb. 5:11-14).

13:7 “mos u frikësoni” Kjo është urdhërore e tashme e pjesëz mohore që, zakonisht, nënkupton ndalimin e një veprimi në kryerje e sipër.

▣ **“këto gjëra duhet të ndodhin; por ky nuk do të jetë ende fundi”** Luftrat dhe tërmetet nuk janë shenja të fundit, por pararendëse/shenja të pranishme në çdo epokë (shih Marku 13:8, 10; Mat. 24:6-8). Këto ngjarje të dhunshme natyrore nuk janë shenja të Ardhes së Dytë, por të jetës në një botë të rënë (shih John L. Bray, *Matthew 24 Fulfilled*, f. 25, 28, që paraqet më së miri interpretimin preterist).

13:8 “do të ketë dhe zi buke” Disa dorëshkrime greke shtojnë dhe frazën “dhe trazira” (shih dorëshkrimet A, W dhe NKJV). Ka dhe disa variante të tjera, por shumica e përkthimeve anglisht thonë “dhe zi buke”, që gjendet në Mat. 24:7 dhe në dorëshkrimet Sinaitikus, B dhe L (dhe dorëshkrimi D në një formë disi të ndryshuar). Pasazhi paralel në Luka 21:11 rendit një sërë gjërash të tjera. UBS4 i jep leximit më të shkurtër vlerësimin “B” (pothuajse i sigurt).

■ **“dhimbjeve të lindjes”** Shprehja e plotë është “dhimbjet e lindjes” së epokës së re (shih Isa. 13:8; 26:17; Jer. 30:6-7; Mikea 4:9-10; Mat. 24:8; Marku 13:8; Veprat 2:24; 1 Thes. 5:3). Kjo reflekton besimin e judenjve në shtimin e ligësisë përpara epokës së re të drejtësisë (shih Marku 13:19-20 dhe *Libri i Jubileve* 23:18, bashkë me *Apokalipsin e Barukut* 27-29). Judenjtë besonin në dy epoka: epoka e tanishme e ligë, e karakterizuar nga mëkati dhe rebelimi kundër Perëndisë, dhe “epoka e ardhshme”. Epoka e Re do të inaugurohej me ardhjen e Mesisë (shih Psalmi 2). Kjo do të ishte një kohë drejtësie dhe besnikërie ndaj Perëndisë. Ndonëse pikëpamja judaike ishte pjesërisht e vërtetë, nuk merrte parasysh dy ardhjet e Mesisë. Ne jetojmë në mbivendosjen e dy epokave: kjo është “tashmë” dhe “ende jo” e mbretërisë së Perëndisë!

TEMË E VEÇANTË: KJO EPOKË DHE EPOKA E ARDHSHME (SPECIAL TOPIC: THIS AGE AND THE AGE TO COME)

Profetët e DhV e shihnin të ardhmen si zgjatim të së tashmes. Për ta, e ardhmja do të shënojë rimëkëmbjen e Izraelit gjeografik. Sidoqoftë, edhe ata e shihnin si ditë të re (shih Isa. 65:17; 66:22). Me refuzimin e vazhdueshëm kokëfortë të JHVH-së nga pasardhësit e Abrahamit (edhe pas robërisë), në letërsinë apokaliptike ndërthjatore të judenjve u zhvillua një paradigmë e re (p.sh., 1 Enoku, 4 Esdra, 2 Baruku). Këto shkrime filluan të bënin dallimin mes dy epokave: epoka e ligë e tanishme, e dominuar nga Satani, dhe epoka e ardhshme e drejtësisë, e dominuar nga Fryma dhe e inauguruar nga Mesia (shpesh, si luftëtar dinamik).

Në këtë zonë të teologjisë (eskatologjia) ekziston një zhvillim i dukshëm. Teologët e quajnë këtë “zbulesë e shkallëzuar”. DhR e pohon këtë realitet të ri kozmik të dy epokave (pra, një dualizëm kohor).

<u>Jezusi</u>	<u>Pali</u>	<u>Hebrenjve</u>
Mateu 12:32	Romakëve 12:2	1:2
Mateu 13:22, 39	1 Kor. 1:20; 2:6, 8; 3:18	6:5
Marku 10:30	2 Kor. 4:4	11:3
Luka 16:8	Galatasve 1:4	
Luka 18:30	Efe. 1:21; 2:1, 7; 6:12	
Luka 20:34-35	1 Timoteut 6:17	
	2 Timoteu 4:10	
	Titit 2:12	

Në teologjinë e Dhiatës së Re, këto dy epoka judaike janë mbivendosur për shkak të parashikimeve të papritura dhe të anashkaluara për dy ardhjet e Mesisë. Mishërimi i Jezusit përmbushi profecitë e DhV për inaugurimin e epokës së re (Dan. 2:44-45). Mirëpo DhV parapa edhe ardhjen e tij si Gjykatës dhe Fitimtar, por herën e parë ai erdhi si Shërbëtori i Përvuajtur (shih Isaia 53; Zak. 12:10), i përulur dhe i butë (shih Zak. 9:9). Ai do të kthehet me fuqi, pikërisht siç e paratha dhe DhV (shih Zbulesa 19). Kjo përmbushje me dy faza bëri që Mbretëria të jetë e tashme (e inauguruar), por edhe e ardhshme (e papërmbushur plotësisht). Ky është tensioni i DhR: tashmë, por ende jo!

TEKSTI I NASB (I PËRDITËSUAR): MARKU 13:9-13

⁹“Por ruhuni; sepse do t’ju dorëzojnë në gjykata dhe do të rriheni me kamxhik në sinagoga, dhe do të qëndroni përpara guvernatorëve dhe mbretërve për hirin tim, si dëshmi për ta. ¹⁰Ungjilli duhet t’u predikohet më parë të gjitha kombeve. ¹¹Kur t’ju arrestojnë dhe t’ju dorëzojnë, mos u shqetësoni më parë se çfarë do të thoni, por thoni çfarëdo t’ju jepet në atë orë; sepse nuk do të jeni ju që flisni, por Fryma e Shenjtë. ¹²Vëllai do ta tradhtojë të vëllanë për vdekje, dhe babai fëmijën e vet; dhe fëmijët do të ngrihen kundër prindërve dhe do t’i bëjnë të vdesin. ¹³Do të urreheni nga të gjithë për shkak të emrit

tim, por ai që duron deri në fund do të shpëtohet”.

13:9-13 Ky material nuk gjendet në Mateu 24, por shfaqet në Mat. 10:17-22. Kjo tregon se Jezusi duhet t’i ketë përsëritur këto të vërteta në raste të ndryshme, ose se Mateu dhe Marku e kanë strukturuar të njëjtin material në mënyrë tematike.

13:9 “ruhuni” Kjo është urdhërore e tashme veprore (e njëjta formë si te Marku 13:5 dhe 23). Kemi një element përgjegjësie personale në përgatitjen për përndjekjen e ngjarjeve të kohës së fundit.

▣ **“gjkata... sinagoga... përpara guvernatorëve dhe mbretërve”** “Gjykatat dhe sinagogat”, një frazë që nuk gjendet në Mat. 24:9, tregon përndjekjen qeveritare dhe fetare të të krishterëve nga judenjtë dhe johebrenjtë (shih 1 Pje. 4:12-16).

▣ **“gjkata”** Kjo është forma shumë e fjalës “sinedër”. Bën fjalë për gjykatat e sinagogave lokale (shih 2 Kor. 11:24).

▣ **“do të rriheni me kamxhik”** Fjalë për fjalë, “rripeni” (shih 2 Kor. 11:24). Judenjtë i godisnin 39 herë me kamxhik shkelësit—trembëdhjetë herë nga përpara dhe 26 herë në shpinë, në përputhje me LiP. 25:1-3.

13:9, 12 “për hirin tim” A do të përndiqen besimtarët, jo për shkak të ligësisë ose krimeve të tyre civile, apo thjesht se janë të krishterë (shih Mat. 5:10-16; 1 Pje. 4:12-16)?

13:10 “Ungjilli duhet t’u predikohet më parë të gjitha kombeve” Fjala “duhet” në greqisht është *dei*, që nënkupton domosdoshmëri. Jezusi (ose Pjetri ose Marku, pasi ishin të gjithë të frymëzuar) po përpicoj t’u tregonte dishepujve (1) misionin e tyre ndër johebrenjtë (shih Zan. 12:3; 1 Mbre. 8:60; Isa. 42:6; 49:6; 51:4; 52:10; 60:1-3; Mat. 24:14; 28:19-20; Veprat 1:8; Rom. 11:25-27) dhe (2) se do të kishte një periudhë të gjatë kohore mes shkatërrimit të Jerusalemit dhe Ardhjes së Dytë (shih 2 Thesalonikasve 2; 2 Pjetrit 2). Duhet ta ruajmë tensionin mes kthimit në çdo çast të Zotit tonë dhe së vërtetës së Ardhjes së Dytë: e atypëratyshme, e vonuar, ose e panjohur.

13:11 Fryma do të jetë gjithmonë me besimtarët! Fryma do t’i fuqizojë besimtarët gjatë përndjekjeve (shih Veprat 4)! Ai identifikohet shpesh me Jezusin, siç tregon dhe vargu paralel në Luka 21:15. Ky premtim nuk e zëvendëson përgatitjen personale për predikime dhe mësimdhënie; prandaj, nuk është zëvendësim për të mos bërë përgatitjen e duhur studimore të Biblës. Ky është hir i veçantë që u lejon besimtarët të dëshmojnë besimin në Krishtin në kohë përndjekjeje (shih Mat. 10:19-20; Luka 12:11-12; 21:14-15).

▣ **“në atë orë”** Shih Temën e Veçantë: Ora në Marku 14:35.

13:12 “vëllai... të vëllanë” Familja ishte thelbi i jetës judaike, por familjet do të përçahen për shkak të Krishtit (shih Mat. 10:21, 35-37). Edhe kjo është tematikë e përsëritur në shkrimet apokaliptike (shih *Jubiletë* 23:19 dhe 2 *Barukut* 70:3).

13:13 “por ai që duron deri në fund do të shpëtohet” Kjo është doktrina e qëndresës (shih Mat. 10:22). Ajo duhet ruajtur në tension dialektik me doktrinën e sigurisë (shih Zbu. 2:7, 11, 17, 26; 3:5, 12, 21; 21:7). Shih Temën e Veçantë: Nevoja për qëndresë në Marku 4:17.

TEKSTI I NASB (I PËRDITËSUAR): MARKU 13:14-23

¹⁴Por kur ta shihni neverinë e shkatërrimit që qëndron aty ku s’duhet të jetë (le ta kuptojë lexuesi), atëherë ata që janë në Jude duhet të arratisen nëpër male. ¹⁵Ai që është në çatinë e shtëpisë të mos zbresë, as të hyjë të marrë diçka nga shtëpia; ¹⁶dhe ai që është në fushë s’duhet të kthehet për të marrë rrobën e vetë. ¹⁷Por mjerë ato që janë shtatzëna dhe ato me fëmijë në gjë në ato ditë! ¹⁸Por lutuni që kjo të mos ndodhë në dimër. ¹⁹Sepse ato ditë do të jenë një kohë mundimi, aq i madh sa nuk ka ndodhur që nga fillimi i krijimit që kreu Perëndia deri tani, madje s’do të ketë më kurrë si ai. ²⁰Nëse Zoti s’do t’i shkurtonte ato ditë, asnjë jetë nuk do të shpëtohej, por për hir të të zgjedhurve që ka

zgjedhur ai, i ka shkurtuar ato ditë. ²¹Dhe, atëherë, nëse dikush ju thotë: ‘Ja ku është Krishti’; ose ‘Ja, ai është këtu’; mos e besoni; ²²sepse do të ngrihen krishtër të rremë dhe profetë të rremë, dhe do të shfaqin shenja dhe mrekulli me qëllim që të mashtrojnë, po të ishte e mundur, dhe të zgjedhurit. ²³Por kini kujdes; ja, unë jua kam thënë gjithçka që më parë”.

13:14

NASB, NKJV “neveria e shkatërrimit”
NRSV “përdhosja shkatërruese”
TEV “Tmerri i Madh”
NJB “neveria shkatërrimtare”

TEMË E VEÇANTË: NEVERIA E SHKATËRRIMIT (SPECIAL TOPIC: THE ABOMINATION OF DESOLATION)

M. R. Vincent e përshkruan më së miri fjalën “neveria”: “Fjala prej së njëjtës rrënjë, *bdelussomai*, do të thotë ‘më përzihet, ose më pështiroset ushqimi’, pra, përdoret për neverinë në përgjithësi. Në kuptimin moral, nënkupton një objekt neverie morale ose fetare (shih 2 Kro. 15:8; Jer. 13:27; Ezek. 11:21; Dan. 9:27; 11:31). Përdoret si sinonim i idhujtarisë në 1 Mbre. 11:17; LiP. 7:26; 2 Mbre. 23:13. Nënkupton gjithçka që shfaq tëhuajtje nga Perëndia, si ngrënia e kafshëve të papastra (Lev. 11:11; LiP. 14:3) dhe, përgjithësi, çdo formë paganizmi. Ky kuptim moral duhet theksuar në përdorimin që i bën Dhiata e Re kësaj fjale (shih Luka 16:15; Zbu. 14:4, 5; 21:27). Kjo fjalë nuk nënkupton thjesht neveri fizike ose estetike. Këtu, mund të bëhet fjalë për pushtimin e mjedisit të tempullit nga romakët idhujtarë, të udhëhequr nga Titi, bashkë me flamurët dhe simbolet e tyre pagane. Jozefusi thotë se, pas djegies së tempullit, romakët sollën flamurët e tyre dhe i vendosën mbi portën lindore dhe aty ofruan fljime ndaj tyre dhe, me brohori, e shpallën Titin perandor” (*Word Studies in the New Testament*, f. 74-75).

Fjala hebraisht “neveri” (BDB 1055, KB 1640) do të thotë “përdhosje”. Kjo frazë përdoret te Dan. 9:27; 11:31; dhe 12:11.

1. Në radhë të parë, bënte fjalë për Antiokun IV Epifan, i cili vendosir në tempullin e Jerusalemit (më 167 para K.) një altar për Zeusin dhe mbi të fljoi një derr (shih Dan. 8:9-14; 1 Mak. 1:54, 59; 2 Mak. 6:1-2).
2. Në Dan. 7:7-8, bën fjalë për Antikrishtin e kohëve të fundit (shih 2 Thes. 2:4).
3. Në Mat. 24:15; Marku 13:14; Luka 21:20, bën fjalë për ardhjen e ushtrisë romake të gjeneralit (më vonë perandorit) Titi më 70 pas K., të cilët, para flamujve të ushtrisë romake (që i kishin ngulur përbri portës lindore ngjitur me tempullin), bënë fli të kushtuara perëndive pagane. Nuk bën fjalë për rrethimin e vetë Jerusalemit, sepse në atë çast do të ishte tepër vonë që besimtarët të merrnin arratinë prej Jerusalemit.

Ky shembull tregon sesi një frazë mund të përdoret në disa kuptime të ndryshme, por që kanë lidhje me njëra-tjetrën. Quhet “profeci me përmbushje të shumëfishtë”. Është e pamundur ta interpretosh pa u përmbushur më parë ngjarjet në fjalë; vetëm kur kthen kokën pas arrin ta kuptosh tipologjinë e kësaj profecie.

NASB “që qëndron aty ku s’duhet të jetë”
NKJV “që qëndron aty ku s’duhet”
NRSV, NJB “që është vendosur aty ku s’duhet”
TEV “që qëndron në vendin ku s’duhet të ishte”

Kjo pjesore, “duke qëndruar” (në greqisht), është e kryer veprorë kallëzore në gjininë mashkullore në librin *The Analytical Greek New Testament*, i Barbara dhe Timothy Friberg, f. 154 (shih TEV), kurse në *The Analytical Lexicon to the Greek New Testament*, i William D. Mounce, f. 219 (shih NASB, NRSV, NJB) gjendet në formën e kryer veprorë kallëzore asnjane. Nëse është asnjane, atëherë bën fjalë për (1) “neverinë” (*bdelugma*), ose (2) për ushtrinë e Titit (*strateuma*). Mateu 24:15 shton “duke qëndruar në Vendin e Shenjtë” (pra, në Vendin e Shenjtë të tempullit), që nënkupton gjininë mashkullore dhe bën fjalë për gjeneralin romak. Edhe kjo do të bënte fjalë për Titin, i cili i ngrii flamujt romakë (që përfaqësonin perënditë e tyre) në tempullin e Jerusalemit.

■ **“(le ta kuptojë lexuesi)”** Kjo do të thotë “mendoj me kujdes” ose “shqyrtoj mirë” (shih 2 Tim. 2:7). Është koment i autorit të ungjillit. Me sa duket, synohej të nxiste diskutime të mëtejshme (pra, për Neverinë e Shkatërrimit në Dan. 9:27; 11:31; 12:11) për këtë temë nga personi që lexonte këtë pasazh me zë të lartë në një grup studimi në kontekstin e adhurimit, pak a shumë si në grupet e shkollës të së dielës sot.

■ **“ata që janë në Jude duhet të arratisen nëpër male”** Euzebi, historian i kishës në shekullin e katërt, thotë se të krishterët lanë Jerusalemin dhe shkuan në Pella, rreth 32 km në juglindje të Detit të Galilesë, pak përpara se ushtria romake ta rrethonte qytetin më 70 pas K. (shih *Hist. Eccl.* 3:5:2-3).

13:15 “Ai që është në çatinë e shtëpisë” Shtëpitë kishin çati të sheshta. Përdorehin për festa shoqërore në muajt e nxehtë. Thuhet se mund ta përshkoje gjithë Jerusalemin duke ecur mbi çatitë e shtëpive. Me sa duket, disa shtëpi ishin ndërtuar ngjitur me murin e qytetit. Kur të krishterët panë ushtrinë, e kuptuan se arratisja ishte e domosdoshme.

13:16 “rrobën” Bëhet fjalë për rrobën e jashtme, që përdorej dhe si mbulesë për të fjetur. Burrat që punonin në fushë nuk e merrnin me vetë këtë rrobë.

13:17 “mjerë” Kjo fjalë përdorej në DHV para profecive të gjykimit. Ishte si një lloj vajtimi ose kujë për funeral. Gjykimi i Jerusalemit nga Perëndia do të prekte edhe besimtarët, edhe jo besimtarët (siç do të ndodhë edhe në Mundimin e Madh).

■ **“ato që janë shtatzëna”** Qartazi, bëhet fjalë vetëm për shkatërrimin e Jerusalemit. Graë shtatzëna duhet ta kenë patur të vështirë që të arratiseshin me shpejtësi duke kaluar murin. Kjo s’ka të bëjë fare me Ardhjen e Dytë! Pyetjet e këtyre dishepujve për Jezusin lidhen me tri çështje të veçuara: shkatërrimi i Jerusalemit, Ardhja e Dytë e Jezusit, dhe fundi i epokës. Problemi është se këto pyetje trajtohen të gjitha në të njëjtën kohë. Nuk ndahen lehtë me vargje sipas tematikës.

13:18 “në dimër” Udhëtimi i shpejtë do të kishte qenë i vështirë në dimër për shtatzënat dhe fëmijët e vegjël.

13:19 Kjo mund të shihet si (1) shkallë e rëndë e përndjekjes së besimtarëve dhe gjykimit hyjnor të jobesimtarëve në kohët e fundit, ose (2) si hiperbolë orientale. Është e vështirë të dish se cilat referenca janë të fjalëpërfjalshme ose të figurshme (shih Joeli 2:28-32 dhe përdorimin që i bën Pjetri këtij pasazhi në Veprat 2, ku nuk merret në mënyrë të fjalëpërfjalshme). DHR është libër lindor. Shkruarit e saj ishin shumë më të mësuar se perëndimorët e sotëm për të përdorur teprimet dhe figurat letrare. Çështja nuk është nëse duhet ta marrim zbuluesin seriozisht ose jo. Kjo ka të bëjë me çështjen hermeneutike të qëllimit të autorit të frymëzuar fillestar. Ta marrësh DHR në mënyrë të fjalëpërfjalshme çdo herë dhe në çdo pikë nuk përbën konservatizëm biblik, por interpretim të gabuar.

Ky varg mund të jetë aludim për Dan. 12:1, por me një frazë të shtuar. Të zgjedhurit janë ata që i kanë emrat në librin e jetës (pra, judenjtë besimtarë, mbetja e vërtetë, johebrenjtë besimtarë, misteri i Perëndisë që ishte fshehur, por tani është zbuluar; Efe. 2:11-3:13)!

■ **“që nga fillimi i krijimit”** Shih Temën e Veçantë në Marku 10:6.

13:20 Pyetja interpretuese është se për çfarë ngjarje bëhet fjalë këtu: (1) shkatërrimi i Jerusalemit; (2) Ardhja e Krishtit; apo (3) fundi i epokës? Këto tri ngjarje diskutohen në mënyra të mbivendosura. Nuk ka asnjë ndarje të qartë dhe të saktë vargjesh. Unë mendoj se bën fjalë për Ardhjen e Dytë dhe për fundin e epokës, jo për shkatërrimin e Jerusalemit, pasi të krishterët u larguan prej tij përpara se të shkatërrohej.

■ **“Nëse... s’do”** Kjo është fjali e rrallë kushtore e rendit të dytë, që quhet “në kundërshtim me faktet”. Shpreh një premisë të gabuar që e bën të pasaktë përfundimin. Fjalë për fjalë, kjo nënkupton: “nëse Zoti s’do t’i kishte shkurtuar ato ditë (që, në fakt, i shkurttoi), askush nuk do të shpëtohej (por tani do të shpëtohen)”.

■ **“Zoti”** Duhet të bëhet fjalë për JHVH, jo për Jezusin. JHVH është Ai që zgjedh (shih Efe. 1:4).

■ **“shpëtohej”** Kjo fjalë përdoret në kuptimin e DHV: pra si çlirim fizik (shih Jakobi 5:15), jo si shpëtim shpirtëror.

■ **“por për hir të të zgjedhuve që ka zgjedhur”** Shih Temën e Veçantë më poshtë.

TEMË E VEÇANTË: ZGJEDHJA/PARACAKTIMI DHE NEVOJA PËR NJË DREJTPESHIM TEOLOGJIK (SPECIAL TOPIC: ELECTION/PREDESTINATION AND THE NEED FOR A THEOLOGICAL BALANCE)

Zgjedhja është doktrinë e mahnitshme. Megjithatë, ajo nuk përbën thirrje për parapëlqime, por thirrje për të qenë kanal, instrument ose mjet për shpengimin e të tjerëve! Në Dhiatën e Vjetër, kjo fjalë përdoret pikësepari për shërbesë; në Dhiatën e Re, përdoret kryesisht për shpëtimin, i cili rezulton në shërbesë. Bibla nuk e pajton kurrë kontradiktën në dukje midis sovranitetit të Perëndisë dhe vullnetit të lirë njerëzor, por i pohon të dyja! Një shembull i mirë i tensionit biblik është Romakëve 9, që flet për zgjedhjen sovranë të Perëndisë, dhe Romakëve 10, që flet për përgjigjen e domosdoshme nga ana e njerëzimit (shih 10:11, 13).

Çelësi për të kuptuar këtë tension teologjik mund të jetë Efe. 1:4. Jezusi është njeriu i zgjedhur i Perëndisë dhe të gjithë janë mundësisht të zgjedhur në të (Karl Barth). Jezusi është “po”-ja e Perëndisë për nevojën e njerëzimit të rënë (Karl Barth). Po kështu, Efesianëve 1:4 na ndihmon në sqarimin e kësaj çështjeje kur pohon se synimi i paracaktimit nuk është qielli, por shenjtëria (ngjashmëria me Krishtin). Shpesh, ne joshemi nga dobitë e ungjillit dhe ia anashkalojmë përgjegjësitë! Thirrja (zgjedhja) e Perëndisë është, jo vetëm për përjetësinë, por edhe për kohën!

Doktrinat vijnë në marrëdhënie me të vërtetën tjetër, jo si të vërtetën e vetme dhe të shkëputura. Një analogji e mirë do të ishte yësia përkundrejt një ylli të vetëm. Perëndia e paraqet të vërtetën me gjini letrare lindore, jo perëndimore. Nuk duhet ta largojmë tensionin që shkaktohet nga dyshet dialektike (paradoksale) të së vërtetave doktrinar:

1. Paracaktimi kundrejt vullnetit të lirë njerëzor
2. Siguria e besimtarëve përkundrejt nevojës për qëndresë
3. Mëkatit fillestar përkundër mëkatit të vullnetshëm
4. Mungesa e mëkatit (“përsosmëria”) kundrejt mëkatimit më pak
5. Shfajësimi dhe shenjtërimi i atypëratyshëm fillestar dhe shenjtërimi i përshkallëzuar
6. Liria e krishterë përkundrejt përgjegjësisë së krishterë
7. Transcendenca e Perëndisë kundrejt imanencës së Perëndisë
8. Perëndia si i panjohshëm në mënyrë absolute përkundrejt Perëndisë si i njohshëm në Shkrimet
9. Mbretëria e Perëndisë si e tashme përkundrejt përmbushjes së ardhshme
10. Pendimi si dhuratë e Perëndisë kundrejt pendimit si reagim i domosdoshëm njerëzor ndaj besëlidhjes
11. Jezusi si hyjnor kundrejt Jezusit si njerëzor
12. Jezusi është i barabartë me Atin kundrejt Jezusit si i nënshtruar ndaj Atit

Koncepti teologjik i “besëlidhjes” bashkon sovranitetin e Perëndisë (i cili është gjithmonë ai që merr nismën dhe përcakton rendin e gjërave) me reagimin e detyrueshëm fillestar dhe të vazhdueshëm me besim dhe pendim nga ana e njerëzimit (shih Marku 1:15; Veprat 3:16, 19; 20:21). Ruhë që të mos e përdorësh vargje “provë” për njërën anë të këtij paradoksi duke zhvlerësuar anën tjetër të tij! Ki kujdes që të mos pohosh vetëm doktrinën, ose sistemin tënd të parapëlqyer teologjik!

■ **“t’i shkurtonte ato ditë”** Kjo frazë nënkupton se Perëndia i pandryshueshëm (shih Psa. 102:26-27; Mal. 3:6) mund t’i ndryshojë planet e tij! Karakteri dhe qëllimet e tij shpenguese nuk ndryshojnë kurrë, por lutjet e popullit të tij ndikojnë tek ai dhe, shpesh, ia ndryshojnë planet. Ky është mister! Por ky është thelbi i lutjes ndërmjetësuese.

TEMË E VEÇANTË: LUTJA NDËRMJETËSUESE (SPECIAL TOPIC: INTERCESSORY PRAYER)

- I. Hyrje
 - A. Lutja është e rëndësishme për shkak të shembullit të Jezusit.

1. Lutja personale (Marku 1:35; Luka 3:21; 6:12; 9:29; 22:31-46)
 2. Pastrimi i Tempullit (Mat. 21:13; Marku 11:17; Luka 19:46)
 3. Lutja model (Mat. 6:5-13; Luka 11:2-4)
- B. Lutja është vënia në veprim konkret e besimit tonë në Perëndinë personal dhe të dashur i cili është i pranishëm, i gatshëm dhe ia aftë të veprorë për hirin tonë dhe të tjerëve, përmes lutjeve tona.
- C. Perëndia e ka kufizuar personalisht veten për të vepruar në bazë të lutjeve të fëmijëve të tij në shumë zona (shih Jakobi 4:2)
- D. Synimi kryesor i lutjes është bashkësia dhe koha jonë me Perëndinë trium.
- E. Gama e lutjes është gjithçka ose kushdo që preokupon besimtarët. Ne mund të lutemi një herë (me besim), ose në mënyrë të përsëritur, sa herë që na kthehet në mendje preokupimi në fjalë.
- F. Lutja mund të përfshijë një sërë elementesh
1. lavdërimi dhe adhurimi i Perëndisë trium
 2. falënderimi i Perëndisë për praninë, miqësinë dhe furnizimin e tij
 3. rrëfimi i mëkatit tonë, si të kaluar ashtu dhe të tashëm
 4. lutje për nevojat ose dëshirat tona të perceptuara
 5. ndërmjetësim, kur sjellim para Atit nevojat e të tjerëve
- G. Lutja ndërmjetësuese është mister. Perëndia i do shumë më tepër se ne personat për të cilët lutemi, mirëpo, shpesh, lutjet tona shkaktojnë një ndryshim, përgjigje, ose nevojë, jo vetëm në ne, por edhe në ta.

II. Materiali biblik

A. Dhiata e Vjetër

1. Disa shembuj të lutjes ndërmjetësuese:
 - a. Abrahami përgjërohet për Sodomën (Zan. 18:22 e më tej)
 - b. Lutjet e Moisiut për Izraelin
 - (1) Eksodi 5:22-23
 - (2) Eksodi 32:9-14, 31-35
 - (3) Eksodi 33:12-16
 - (4) Eksodi 34:9
 - (5) Ligji i Përtërirë 9:18, 25-29
 - c. Samueli lutet për Izraelin:
 - (1) 1 Samuelit 7:5-6, 8-9
 - (2) 1 Samuelit 12:16-23
 - (3) 1 Samuelit 15:11
 - d. Davidi lutet për fëmijën e vet, 2 Samueli 12:16-18
2. Perëndia kërkon ndërmjetësues, Isaia 59:16
3. Mëkati i njohur dhe i parrëfyer, ose qëndrimi i papënduar, ndikon në lutjet tona
 - a. Psalmi 66:18
 - b. Fjalët e Urta 28:9
 - c. Isaia 59:1-2; 64:7

B. Dhiata e Re

1. Shërbesa ndërmjetësuese e Birit dhe Frymës
 - a. Jezusi
 - (1) Romakëve 8:34
 - (2) Hebrenjve 7:25
 - (3) 1 Gjonit 2:1
 - b. Fryma e Shenjtë, Romakëve 8:26-27
2. Shërbesa ndërmjetësuese e Palit
 - a. Lutet për judenjtë
 - (1) Romakëve 9:1 e më tej
 - (2) Romakëve 10:1
 - b. Lutet për kishat
 - (1) Romakëve 1:9
 - (2) Efesianëve 1:16
 - (3) Filipianëve 1:3-4, 9

- (4) Kolosianëve 1:3, 9
- (5) 1 Thesalonikasve 1:2-3
- (6) 2 Thesalonikasve 1:11
- (7) 2 Timoteut 1:3
- (8) Filemonit, v. 4
- c. Pali u kërkoi kishave të luten për të
 - (1) Romakëve 15:30
 - (2) 2 Korintasve 1:11
 - (3) Efesianëve 6:19
 - (4) Kolosianëve 4:3
 - (5) 1 Thesalonikasve 5:25
 - (6) 2 Thesalonikasve 3:1
- 3. Shërbesa ndërmjetësuese e kishës
 - a. Lutuni për njëri-tjetrin
 - (1) Efesianëve 6:18
 - (2) 1 Timoteut 2:1
 - (3) Jakobit 5:16
 - b. Kërkohen lutje për grupe të veçanta
 - (1) Armiqtë tanë, Mat. 5:44
 - (2) Punëtorët e krishterë, Hebrenjve 13:18
 - (3) Sundimtarët, 1 Timoteut 2:2
 - (4) Të sëmurët, Jakobit, 5:13-16
 - (5) Ata që rrëshqasin në besim, 1 Gjonit 5:16
- III. Kushtet për lutjen që merr përgjigje
 - A. Marrëdhënia jonë me Krishtin dhe me Frymën
 - 1. Qëndroni në të, Gjoni 15:7
 - 2. Në emër të tij, Gjoni 14:13, 14; 15:16; 16:23-24
 - 3. Në Frymën, Efesianëve 6:18; Juda 20
 - 4. Sipas vullnetit të Perëndisë, Mateu 6:10; 1 Gjonit 3:22; 5:14-15
 - B. Motivet
 - 1. Pa u lëkundur, Mateu 21:22; Jakobi 1:6-7
 - 2. Përulësi dhe pendim, Luka 18:9-14
 - 3. Kur kërkohet gabim, Jakobi 4:3
 - 4. Egoizmi, Jakobi 4:2-3
 - C. Aspekte të tjera
 - 1. Qëndresa
 - a. Luka 18:1-8
 - b. Kolosianëve 4:2
 - 2. Kërkoni vazhdimisht
 - a. Mateu 7:7-8
 - b. Luka 11:5-13
 - c. Jakobi 1:5
 - 3. Mosmarrëveshjet në familje, 1 Pjetrit 3:7
 - 4. Të mos keni asnjë mëkat të ditur
 - a. Psalmi 66:18
 - b. Fjalët e Urta 28:9
 - c. Isaia 59:1-2
 - d. Isaia 64:7
- IV. Përmbyllje teologjike
 - A. Sa privilegj, mundësi, detyrë dhe përgjegjësi e jashtëzakonshme!
 - B. Jezusi është shembulli ynë. Fryma është udhërrëfyeni ynë. Ati po na pret me shumë përmallim.
 - C. Kjo mund të të ndryshojë ty, familjen, miqtë dhe botën.

TEMË E VEÇANTË: DYZET E DY MUAJT (nga Danieli) (SPECIAL TOPIC: FORTY-TWO MONTHS [Daniel])

Fraza “dyzet e dy muajt” karakterizon në mënyrë profetike një periudhë përndjekjeje. Përdhosja e oborrit të jashtëm është proverb për dominimin e popullit të Perëndisë nga jobesimtarët në periudha të ndryshme të historisë: Antioku Epifan, romakëve më 70 pas K., dhe Antikrishti i kohëve të fundit.

Dyzet e dy muajt, ose një shifër që iu korrespondon, përmenden disa herë në Bibël. Origjina duket se është libri i Danielit.

1. Danieli 7:25; 12:7 përmend “një kohë, kohë, dhe gjysmë kohe” ose 1277 ditë (nëse “koha” është baraz me një vit), shih Zbu. 12:14
2. Danieli 8:14 përmend 2300 mbrëmje dhe mëngjese
3. Danieli 12:11 përmend 1290 ditë
4. Danieli 12:12 përmend 1335 ditë. Fraza të ngjashme gjenden edhe te Zbu. 11:3; 12:6 (1260 ditë) dhe 11:2; 13:5 (42 muajt).

Një tjetër mënyrë si ta shohim këtë frazë enigmatike është duke e konsideruar si sekuencë: një, dy, por jo një e tretë; pra, një kohë e kufizuar hyjnore, gjatë së cilës mbretëritë pagane përndjekin popullin e Perëndisë. Në librin e Danielit, Perëndia ka kontrollin e plotë të historisë (shih Dan. 7:4, 6, 11, 12, 18, 22, 25, 26, 27)!

Kur merren parasysh të gjitha këto përmendje, larmia e tyre duket se nxjerr në pah natyrën simbolike të shifrave (shih Temën e Veçantë: Numrat simbolikë në Bibël), ndërsa afria e tyre me periudhën dyzetedymujore duket se tregon që bëhet fjalë për një numër që simbolizon një periudhë përndjekjeje. Meqë tre e gjysëm është gjysma e shtatës, duket se bëhet fjalë për një periudhë të plotë përndjekjeje që ndërpritet (shih Mat. 24:22; Marku 13:20; Luka 21:24). Përndjekja, si dhe gjykimi, kufizohet nga dashuria e Perëndisë.

13:21 “nëse” Kjo është fjali kushtore e rendit të tretë, që nënkupton veprim të mundshëm.

■ **“mos e besoni”** Kjo është urdhërore e tashme veprare me një pjesëz mohore, që zakonisht nënkupton ndalin e një veprimi në kryerje e sipër, por në këtë kontekst nuk mund ta ketë këtë domethënie normale.

Të krishterët duhet të jenë të zgjuar si gjarpërinjtë dhe të butë si pëllumbat (shih Mat. 10:16). Të krishterët naivë, mendjelehtë dhe foshnja janë diçka tepër e zakonshme. Duhet t’i sprovovjmë frymërat (shih 1 Gjonit 4:1) për të parë nëse janë vërtet zëdhënës të Perëndisë. Trishtohem shumë kur dëgjojë për besimtarë që mblidhen turma te ndonjë pemë, portë, apo vend i shenjtë për të parë Jezusin. Ky kontekst është tepër i qartë! Kur të vijë Jezusi, të gjithë do ta shohin dhe do ta njohin (shih Mat. 24:27).

Konteksti i atypëratyshëm i Markut 13:14-23 bën fjalë për ata që do të arratiseshin nga Jerusalemi, që të mos ndalonin nga dikush që pretendonte se ishte Krishti dhe ishte shfaqur në filan qytet, apo në filan vend.

13:22 “do të shfaqin shenja dhe mrekulli” Këta krishterë të rremë do të kryejnë mrekulli. Ruhuni që të mos e barazoni gjithmonë “mrekullinë” me Perëndinë (shih Eks. 7:11-12:22; LiP. 13:1 e më tej; Mat. 24:24; 2 Thes. 2:9-12; Zbu. 13:13-14). Besimtarët e rremë mund të bëjnë mrekulli (shih Mat. 7:21-23).

■ **“po të ishte e mundur”** Unë mendoj se kushtëzimi i Markut 13:22 mund të ketë lidhjet kontekstualisht me kushtëzimin e Markut 13:20 (pra, kushtore e rendit të dytë) pasi të zgjedhurit (shih Marku 13:20 dhe 22) nuk mund të mashtrohen!

13:23 Kjo ishte një nga mënyrat (që reflektojnë profecitë e JHVH në DHV) sesi Jezusi u provoi ndjekësve të vet faktin se kishte nën kontroll historinë dhe shpengimin duke parashikuar ngjarjet e ardhshme. JHVH dhe Krishti i tij kanë nën kontroll kohën dhe historinë! Edhe kohët e vështira janë pjesë e planit të tij të plotë shpengues.

TEKSTI I NASB (I PËRDITËSUAR): MARKU 13:24-27

²⁴“Por në ato ditë, pas atij mundimi, dielli do të errësohet dhe hëna nuk do ta japë dritën e vet, ²⁵dhe yjet do të bien nga qielli, ndërsa pushtetet që janë në qiejt do të tronditen. ²⁶Atëherë do ta shohin Birin e Njeriut tek vjen në re me pushtet dhe lavdi të madhe. ²⁷Dhe, pastaj, ai do të dërgojë engjëjt dhe do t’i mbledhë së bashku të zgjedhurit nga të katërta erërat, nga skaji më i largët i tokës deri në skajin më të largët të qiellit”.

13:24 “Por” Kjo është lidhëz e fortë kundërshtuese, që tregon ndërprerje konteksti. Po zbulohet një segment i ri kohor.

13:24 “dielli do të errësohet” Kjo është gjuha apokaliptike e DHV për fundin e kohës (shih Ezek. 32:7-8; Joeli 2:10; 3:15; 28:3-4; Amosi 8:9; shih dhe 2 Ezra 5:5; Ngjitja e Moisiut 10:5; dhe 1 Enokut 80:4-7). Kjo është një seri me citime nga DHV:

1. v. 24 është nga Isa. 13:10
2. v. 25 është nga Isa. 34:3
3. v. 26 është nga Dan. 7:13

Gjithsesi, kjo mund të tregojë dhe ndryshime rrënjësore në natyrë me afrimin e Krijuesit (shih 2 Pje. 3:7, 10, 11, 12; Rom. 8:18-22). Shpesh, këto ngjarje kozmike apokaliptike përdoren për të përshkruar rënien e qeverive.

13:25 Ky është citim nga Isa. 34:4. Reflekton besimin se yjet janë forca qiellore (shih Gjyq. 5:20; Jobi 38:7). Në literaturën apokaliptike, shpesh, yjet e rënë bëjnë fjalë për engjëjt (shih Zbu. 8:10; 9:1; 12:4). Në Bibël, engjëjt janë shërbëtorë të Perëndisë, kurse në idhujtarinë mesopotamase ata janë perëndi që kontrollojnë fatin e njerëzve (pra, dymbëdhjetë shenjat e Zodiakut, ose lëvizjet e planeteve).

13:26 “Birin e Njeriut tek vjen në re” Natyra njerëzore dhe hyjnore e Jezusit theksohet nga termi “Biri i Njeriut”, siç përdoret dhe në Psa. 8:4; në kuptimin normal idiomatik judaik, ka kuptimin qenie njerëzore, si tek Ezek. 2:1; ndërsa në kuptimin hyjnor gjendet në Dan. 7:13 (shih Marku 8:38; 13:26; 14:62; në të gjitha këto vargjet aludohet për Dan. 7:13). Fakti se ky “Bir i Njeriut” vjen mbi retë e qiellit tregon se ai është hyjnor (shih Psa. 68:4; 104:3). Retë janë transportuesit dhe mbulesa e JHVH (Reja e Lavdisë *Shekina* gjatë periudhës së endjes në shkretëtirë sipas Eksodit dhe Numrave. Jezusi largohet me një re [shih Veprat 1:9] dhe do të kthehet në re [shih 1 Thes. 4:17]).

**TEMË E VEÇANTË: ARDHJA NË RE (disa fjalë hebraisht, por kryesisht *anan*, BDB 777, KB 857)
(SPECIAL TOPIC: COMING IN THE CLOUDS)**

Kjo ardhje në re është shenjë shumë domethënëse eskatologjike. Në DHV përdoret në tri mënyra të ndryshme.

1. për të treguar praninë fizike të Perëndisë, renë e lavdisë *Shekina* (shih Eks. 13:21; 14:19,20,24; 16:10; 19:9; Num. 11:25; Neh. 9:19)
2. për të mbuluar natyrën e tij të shenjtë që njeriu të mos e shihte dhe të vdiste (shih Eks. 33:20; Isa. 6:5)
3. për të mbartur Perëndinë (shih Psa. 18:9; 104:3; Isa. 19:1; Nah. 1:3; Veprat 1:9; 1 Thes. 4:17)

Në Danieli 7:13, retë përdoren për të transportuar Mesinë njerëzor dhe hyjnor (shih Temën e Veçantë: Mesia). Kjo profeci e Danielit aludohet mbi 30 herë në DHR. Po kjo lidhje e Mesisë me retë e qiellit vihet në dukje edhe tek Mat. 24:30; 26:64; Marku 13:26; 14:62; Luka 21:27; Veprat 1:9, 11; 1 Thes. 4:17; Zbu. 1:7.

■ **“pushtet dhe lavdi të madhe”** Kjo tregon kontrastin e fortë mes ardhjes së tij të parë (shih Zak. 9:9; Isa. 53) dhe Ardhjes së Dytë (shih Zbu. 19). Paraleli i kësaj gjendet, me fjalë të tjera, në Mat. 24:30.

13:27 “engjëjt” Në 2 Thes. 1:7, engjëjt quhen engjëjt e Jezusit. Zakonisht, quhen engjëjt e JHVH (shih Juda 14).

■ **“do t’i mbledhë së bashku të zgjedhurit”** Kjo është gjuhë profetike nga DHV (shih LiP. 30:35; Isa. 43:6; dhe Psa. 50:5). Rendi i saktë i këtyre ngjarjeve të kohëve të fundit është i paqartë. Pali na mësoi se, kur vdes, besimtari është tashmë me Krishtin (shih 2 Kor. 5:6, 8). 1 Thes. 4:13-18 na mëson se, me sa duket, diçka nga trupi ynë fizik, që mbetet këtu, do të bashkohet me shpirtin në ardhjen e Zotit. Kjo nënkupton një gjendje të patrupëzuar mes vdekjes dhe ditës së ringjalljes. Ka shumë gjëra që Bibla nuk na i tregon në lidhje me ngjarjet e kohëve të fundit dhe jetën pas vdekjes.

■ **“nga të katërta erat, nga skaji më i largët i tokës deri në skajin më të largët të qiellit”** Kjo nënkupton se Jezusi do të ketë ndjekës nga gjithë bota! Po kështu, nënkupton se do të duhet një kohë e gjatë që ungjilli të

përhapat. Numri katër në Bibël simbolizon botën. Bën fjalë për katër skajet e botës (Isa. 11:12), katër erërat e qiellit (Dan. 7:2; Zak. 2:6) dhe katër skajet e qiellit (Jer. 49:36). Të zgjedhurit do të mblidhen nga çdo vend ku janë shpërndarë.

TEMË E VEÇANTË: NUMRAT SIMBOLIKË NË BIBËL (SPECIAL TOPIC: SYMBOLIC NUMBERS IN SCRIPTURE)

- A. Disa numra funksiononin edhe si shifra, edhe si simbole.
1. Një – Perëndia (p.sh. LiP. 6:4; Efe. 4:4-6)
 2. Katër – gjithë toka (pra, katër cepat, katër erërat; p.sh., Isa. 11:12; Jer. 49:36; Dan. 7:2; 11:4; Zak. 2:6; Mat. 24:31; Marku 13:27; Zbu. 7:1)
 3. Gjashtë – mospërsosmëria njerëzore (një më pak se 7; p.sh., Zbu. 13:18)
 4. Shtatë – përsosmëria hyjnore (shtatë ditët e krijimit). Vini re përdorimet simbolike që i bëhen këtij numri në Zbulesë:
 - a. Shtatë shandanët: Zbu. 1:12, 20; 2:1
 - b. Shtatë yjet: Zbu. 1:16, 20; 2:1
 - c. Shtatë kishat: Zbu. 1:20
 - d. Shtatë shpirtrat e Perëndisë: Zbu. 3:1; 4:5; 5:6
 - e. Shtatë llambat: Zbu. 4:5
 - f. Shtatë vulat: Zbu. 5:1, 5
 - g. Shtatë brirët dhe shtatë sytë: Zbu. 5:6
 - h. Shtatë engjëjt: Zbu. 8:2, 6; 15:1, 6, 7, 8; 16:1; 17:1
 - i. Shtatë trumbetat: Zbu. 8:2, 6
 - j. Shtatë bubullimat: Zbu. 10:3, 4
 - k. Shtatë mijë: Zbu. 11:13
 - l. Shtatë kokat: Zbu. 13:1; 17:3, 7, 9
 - m. Shtatë murtajat: Zbu. 15:1, 6, 8; 21:9
 - n. Shtatë kupat: Zbu. 15:7; 21:9
 - o. Shtatë mbretërit: Zbu. 17:10
 5. Dhjetë – plotësia
 - a. Përdorimi në ungujtë:
 - (1) Mat. 20:24; 25:1, 28
 - (2) Marku 10:41
 - (3) Luka 14:31; 15:8; 17:12,17; 19:13,16,17,24,25
 - b. Përdorimi në librin e Zbulesës:
 - (1) Zbu. 2:10; dhjetë ditë e mundimit
 - (2) Zbu. 12:3; 17:3, 7, 12, 16; dhjetë brirët
 - (3) Zbu. 13:1; dhjetë kurorat
 - c. Shumëfishat e numrit 10 në Zbulesë:
 - (1) 144,000 = 12x12x1000; shih Zbu. 7:4; 14:1, 3
 - (2) 1,000 = 10x10x10; Zbu. 20:2, 3, 6
 6. Dymbëdhjetë – organizimi njerëzor:
 - a. Dymbëdhjetë bijtë e Jakobit (pra, dymbëdhjetë fiset e Izraelit, Zan. 35:22; 49:28)
 - b. Dymbëdhjetë shtyllat; Eks. 24:4
 - c. Dymbëdhjetë gurët e çmuar në gjoksoren e Kryepriftit; Eks. 28:21; 39:14
 - d. Dymbëdhjetë bukët për tryezën e Shenjtërores (simbol se Perëndia siguron për dymbëdhjetë fiset); Lev. 24:5; Eks. 25:30
 - e. Dymbëdhjetë gjurmuesit; LiP. 1:23;
 - f. Dymbëdhjetë mbartësit e gurëve; Joz. 4:2, 3, 4, 8, 9, 20
 - g. Dymbëdhjetë apostujt; Mat. 10:1
 - h. Përdorimi në Zbulesë:
 - (1) Dymbëdhjetë mijë të vulosur; Zbu. 7:5-8
 - (2) Dymbëdhjetë yjet; Zbu. 12:1
 - (3) Dymbëdhjetë portat, dymbëdhjetë engjëjt, dymbëdhjetë fiset; Zbu. 21:12

- (4) Dymbëdhjetë gurët e themelit, emrat e 12 apostujve; Zbu. 21:14
 (5) Jerusalemi i Ri ishte dymbëdhjetë mijë stade në të gjitha anët; Zbu. 21:16
 (6) Dymbëdhjetë portat e bëra me dymbëdhjetë gurë të çmuar; Zbu. 21:21
 (7) Pema e jetës me dymbëdhjetë lloj frytësh; Zbu. 22:2
7. Dyzet – numri për kohën:
- Nganjëherë i fjalëpërfjalshëm (eksodi dhe endja në shkretëtirë; p.sh., Eks. 16:35); LiP. 2:7; 8:2
 - Mund të jetë i fjalëpërfjalshëm ose simbolik:
 - Përmbytja; Zan. 7:4, 17; 8:6
 - Moisiu në malin Sinai; Eks. 24:18; 34:28; LiP. 9:9, 11, 18, 25
 - Periudhat e jetës së Moisiut:
 - 40 vjet në Egjipt
 - 40 vjet në shkretëtirë
 - 40 vjet në krye të Izraelit
 - Jezusi agjëroi dyzet ditë; Mat. 4:2; Marku 1:13; Luka 4:2
 - Vini re (me anë të një Përkuesi Biblik) numrin e herëve që kjo shifër shfaqet për të përcaktuar kohën në Bibël!
8. Shtatëdhjetë – numri i plotë për njerëzit
- Izraeli; Eks. 1:5
 - Shtatëdhjetë pleqtë; Eks. 24:1, 9
 - Eskatologjik; Dan. 9:2, 24
 - Ekipi misionar; Luka 10:1, 17
 - Falja (70x7), Mat. 18:22
- B. Referenca të dobishme
- John J. Davis, *Biblical Numerology*
 - D. Brent Sandy, *Plowshares and Pruning Hooks*

TEKSTI I NASB (I PËRDITËSUAR): MARKU 13:28-32

²⁸“Tani, mësoni shëmbëlltyrën nga fiku: kur dega e tij është tashmë e butë dhe lëshon gjethe, e dini se vera është afër. ²⁹Po kështu, edhe ju, kur t’i shihni këto gjëra të ndodhin, kuptoni se ai është afër, madje te dera. ³⁰Me të vërtetë ju them: ky brez nuk do të kalojë para se të ndodhin të gjitha këto gjëra. ³¹Qielli dhe toka do të kalojnë, por fjalët e mia nuk do të kalojnë. ³²Por, sa për atë ditë ose orë, askush nuk e di, as engjëjt në qiell, as Biri, por vetëm Ati”.

13:28 “fiku” Në këtë shëmbëlltyrë, pema e fikut, me sa duket, nuk është simbol i Izraelit si komb, si te Marku 11:12-14, por është metaforë e dallimit të stinës së duhur nga besimtarët në lidhje me kthimin e Zotit (ndonëse koha specifike nuk dihet). Pema e fikut lulëzonte vonë. Sinjalizonte ardhjen e verës, jo pranverës.

13:29 “kuptoni” Kjo është, ose dëftore e tashme veprorë, ose urdhërore e tashme veprorë. Brezi i fundit do t’i kuptojë plotësisht këto pasazhe profetike. Problemi i kishës është se çdo brez besimtarësh është përpjekur t’i detyrojë profecitë ti përputhen historisë dhe kulturës së kohës së tyre. Deri tani, çdo brez e ka patur gabim. Kisha e humbet besueshmërinë nga gjithë këto parashikime të rreme!

▣ **“ai”** Teksti greqisht nuk ka asnjë peremër. Folja “është” mund të jetë mashkullorë ose asnjësorë. Për shkak të Markut 13:14, asnjësja përshtatet më mirë. Nëse është kështu, bëhet fjalë për shkatërrimin e Jerusalemit.

13:30 Kjo është një formë gramatikore e dyfishtë mohore, pra mohore e fortë. Mund të bëjë fjalë për

- shkatërrimin e Jerusalemit
- shndërrimin në mal (shih Marku 9:1)
- shenjat e Ardhjes së Dytë

Problemi është se Jezusi i shkrin të tria këto pyetje që ia bënë dishepujt (shih Mat. 24:3) në një kontekst të vetëm, pa bërë asnjë ndarje të qartë mes ngjarjeve.

13:31 “Qielli dhe toka do të kalojnë” Kjo e vërtetë madhështore mbulohet me terminologji apokaliptike nga DhV (shih 2 Pje. 3:7, 10). Fjala e Perëndisë nuk do të kalojë kurrë, por krjimi fizik, që është prekur nga mëkati njerëzor, do të pastrohet. Ky është motiv i përsëritur në Shkrim (shih Joz. 21:45; 23:14-15; 1 Mbre. 8:56; Isa. 40:6-8; 55:8-11; Mat. 5:17-20).

13:32 “atë ditë” Ky është shkurtim i frazës së DhV “Dita e Zotit” (shumë e përdorur te Amosi dhe Joeli). Bën fjalë për Ardhjen e Dytë, ose për ditën e gjykimit (pra, i kohshëm = shkatërrimi i Jerusalemit, ose eskatologjik = gjykimi i fundit).

■ **“ose orë”** Shih Temën e Veçantë: Ora, në Marku 14:35.

■ **“askush nuk e di... por vetëm Ati”** Bëhet fjalë për Ardhjen e Dytë dhe për Epokën e Re, jo për shkatërrimin e Jerusalemit. Jezusi iu drejtua veçanërisht atij brezi në Marku 13:30. Ky është varg i fortë që duhet t’i bëjë të krishterët që të mos japin data të veçanta për Ardhjen e Dytë.

TEMË E VEÇANTË: ATI (SPECIAL TOPIC: FATHER)

DhV prezanton metaforën e ngushtë familjare të Perëndisë si Atë:

1. kombi i Izraelit përshkruhet shpesh si “biri” i JHVH (shih Os. 11:1; Mal. 3:17)
2. edhe më herët, në Ligjin e Përtërirë, përdoret analogjia e Perëndisë si Atë (1:31)
3. në LiP. 32, Izraeli quhet “fëmijët e tij”, ndërsa Perëndia quhet “ati juaj”
4. kjo analogji shprehet te Psa. 103:13 dhe zhvillohet në Psa. 68:5 (ati i jetimëve)
5. ishte i zakonshëm në profetët (shih Isa. 1:2; 63:8; Izraeli si bir, Perëndia si Atë, 63:16; 64:8; Jer. 3:4, 19; 31:9).

Jezusi fliste aramaisht, që do të thotë se shumë prej pasazheve ku shfaqet “Ati” në greqisht, si *Pater*, mund të reflektojnë aramaishten *Abba* (shih Marku 14:36). Ky term familjar, “Babi”, ose “Baba” pasqyron marrëdhënien e ngushtë të Jezusit me Atin. Fakti se ai ua zbuloi këtë ndjekësve të vetë nxiti edhe marrëdhënien tonë të ngushtë me atin. Termi “Atë” përdoret rrallë në DhV për JHVH, por Jezusi e përdor shpesh dhe gjerësisht. Kjo është një zbuluesë madhore e marrëdhënies së re të besimtarëve me Perëndinë përmes Krishtit (shih Mateu 6:9).

■ **“as engjëjt në qiell”** Engjëjt shihen si kureshtarë për të mësuar si do të veprojnë Perëndia me njerëzimin (shih 1 Kor. 4:9; Efe. 2:7; 3:10; 1 Pje. 3:12). Ndonëse janë të pranishëm me Perëndinë, nuk ia kuptojnë plotësisht planet. Në Krishtin, këto qëllime të përjetshme dalin në pah!

■ **“as Biri”** Kjo mungesë informacioni tregon qartë natyrën e vërtetë njerëzore të Jezusit. Ndonëse ishte plotësisht Perëndi dhe plotësisht njeri, Jezusi i la atributet e veta hyjnore në qiell kur u mishërua (shih Fil. 2:7). Ky kufizim ishte në veprim vetëm deri në kohën e ngritjes në qiell.

Përdorimi i fjalës “Bir” nga Jezusi për të përshkruar veten zbulon mendimin e tij për veten (pra, JHVH është Ai; Jezusi është Biri i zgjedhur mesianik). Ky është përdorimi rrallë i fjalës “Bir në kuptimin “Biri i Atit” (pra, Perëndisë). Shpesh, Jezusi e quante veten “Biri i Njeriut”, por dëgjuesit e vetë duhet ta kenë marrë këtë frazë në kuptimin “qenie njerëzore”; ata e kuptonin ndryshe vetëm nëse ia njihnin përdorimin e specializuar te Dan. 7:13. Por Judaizmi nuk e theksonte këtë pasazh nga DhV, dhe as këtë titull.

Fraza “as Biri” nuk përfshihet në Mat. 24:36, dhe as në disa dorëshkrime të lashta uncialë greke si Sinaitikus (dora e dytë), K, L dhe W. Në shumicën e përkthimeve përmendet për shkak se shfaqet dhe në dorëshkrimet Sinaitikus, B dhe D, në Diatesaron, si dhe në tekstet greqisht që njihen Ireneu, Origeni, Gojarti dhe dorëshkrimi i lashtë latinisht i përdorur nga Jeronimi. Ky mund të ketë qenë një nga pasazhet e modifikuara nga kopjuesit ortodoksë për të theksuar hyjninë e Krishtit përkundër mësuesve të rremë (shih Bart D. Ehrman, *The Orthodox Corruption of Scripture*, Oxford University Press, 1993, f. 91-92).

TEKSTI I NASB (I PËRDITËSUAR): MARKU 13:33-37

³³“Kini kujdes, rrini zgjuar; sepse nuk e dini se kur do të vijë koha e caktuar. ³⁴Është si njeriu që shkoi në një udhëtim, i cili, teksa largohej nga shtëpia dhe u dha përgjegjësi skllëvërve të vet, duke i cakuar secilit detyrën e vet, urdhëroi gjithashtu portierin që të rrinte zgjuar. ³⁵Prandaj, rrini zgjuar—sepse nuk e dini se kur vjen i zoti i shtëpisë, në darkë, në mesnatë, apo kur këndon gjeli në mëngjes—³⁶se mos vjen papritmas dhe ju gjen në gjumë. ³⁷Atë që jua them juve, ua them të gjithëve: ‘Rrini zgjuar!’”

13:33 “Kini kujdes, rrini zgjuar” Këto janë urdhërore të tashme veprare (shih Marku 13:5, 9, 23). Besimtarët duhet të jetojnë me shpresën e vazhdueshme të Ardhjes së Dytë. Në Marku 13:33-37 ka dy fjalë të ndryshme greqisht që përkthehen “jini vigjilentë”:

1. *blepo* (vargu 33, shih Gal. 6:1)
2. *gregoreo* (vargjet 34, 35, 37, shh Efe. 6:18)

Në librin e Louw dhe Nida, *Greek-English Lexicon of the New Testament Based on Semantic Domains*, vëll. 1, f. 333, këto fjalë kanë një mbivendosje kuptimore “qëndro zgjuar”, ose “qëndro vigjilent” për #1 dhe “ji i vetëdijshëm për” “ruhu nga” Për #2.

Ndonëse realiteti i Ardhjes së Dytë do të përjetohet vetëm nga një brez, secili brez jeton me shpresën e vazhdueshme të kthimit nga çasti në çast të Zotit. Kjo shpjegon pse apostujt dhe kisha e hershme mendonin se kthimi i Jezusit ishte i atypëratyshëm. Vonesa prej 2000 vitesh është e habitshme, por Perëndia është i duruar dhe dëshiron që askush të mos humbasë (shih 1 Tim. 2:4; 2 Pje. 3:9). Ai vonohet në mënyrë që kisha të përmbushë Porosinë e Madhe (shih Mat. 28:19-20; Luka 24:46-47; Veprat 1:8) dhe që të grumbullohet numri i plotë i judenjve dhe johebrenjve besimtarë (shih Rom. 11). Kthimi i Jezusit është i mrekullueshëm për besimtarët, por do të sjellë pasojë shkatërrimtare dhe të përrjetshme për jobesimtarët.

■ **“dhe lutuni”** Këto fjalë janë të pranishme në shumë dorëshkrime të lashta uncial greke, përfshi Sinaitikus, A, C, K, L, W, X, por mungojnë në B dhe D. Mund të kenë qenë në origjinal (shih NKJV). Mirëpo UBS4 i jep leximit më të shkurtër vlerësimin “B” (pothuajse e sigurt).

■ **“koha e caktuar”** Ky nuk është termi për kohën kronologjike *kronos*, që nuk përdoret në Marku, por është termi për një kohë të caktuar dhe të veçantë (*kairos*, shih Marku 1:15). Bën fjalë për një ngjarje eskatologjike madhore. Pyetja është se për ç’ngjarje bëhet fjalë: (1) shkatërrimi i Jerusalemit; (2) shfaqja e Birit të Njeriut; ose (3) fillimi i Epokës së Re? Numri një ndodhi në 70 pas K. Numri dy, në një farë kuptimi, ka ndodhur tashmë (pra, mishërimi dhe jeta e Jezusit), por në një kuptim tjetër, është në të ardhmen (pra, përmbushja e Mbretërisë së Perëndisë në Ardhjen e Dytë të Jezusit). Numri tre, ashtu si numri dy, ka ndodhur tashmë në njëfarë kuptimi. Besimtarët jetojnë në momentin “tashmë, por ende jo” të Epokës së Re, Mbretërisë së Perëndisë (shih Fee dhe Stuart, *How to Read the Bible for All Its Worth*, f. 131-134).

13:34 “si njeriu që shkoi në një udhëtim” Kjo është terminologji normale për shumë mësim shëmbëlltore të Jezusit (shih Marku 12:1; Mat. 21:33; 25:14; Luka 15:13; 19:12; 20:9). Pyetja ka të bëjë me faktorin kohor (shih Marku 13:35-37). Nëse u jepet kohë e mjaftueshme, del në pah natyra e vërtetë e njerëzve. Kthimi i vonuar bën të shfaqet vetvetiu besnikëria dhe përparësitë e vërteta të njerëzve. Ungjilli i Mateut i zgjeron këto fjalë në Mat. 24:42-51.

■ **“duke i caktuar secilit detyrën e vet”** Ndoshta, bëhet fjalë për dhuntitë e Frymës, të renditura në Rom. 12:1; 1 Kor. 12; dhe Efe. 4. Të krishterët do të gjykohen (shih 2 Kor. 5:10), por për çfarë? Sigurisht jo për mëkatet, pasi gjaku i Jezusit i fal të gjitha mëkatet (shih Heb. 9). Ndoshta, të krishterët do të japin llogari Perëndisë për administrimin e ungjillit dhe për përdorimin e dhuntive të tyre shpirtërore.

13:35

NASB “në darkë, në mesnatë, apo kur këndon gjeli në mëngjes”

NKJV “në darkë, në mesnatë, kur këndon gjeli, ose në mëngjes”

NRSV “në darkë, ose në mesnatë, ose kur këndon gjeli, ose në agim”

TEV “në darkë, ose në mesnatë, ose përpara agimit, ose kur lind dielli”

NJB “në darkë, mesnatë, kur këndon gjeli, ose në agim”

Kjo terminologji pasqyron katër rojet romake të natës nga tre orë secila:

1. darka: 6-9 pasdite
2. mesnatë: 9 - mesnatë
3. këndimi i gjelit: mesnatë- 3 e mëngjesit
4. agimi: 3 – 6 e mëngjesit

13:37 Shih shënimin në Marku 13:33.

PYETJE PËR DISKUTIM

Ky është një komentuar studimor udhëzues, që do të thotë se ti je vetë përgjegjës për interpretimin e Biblës. Secili prej nesh duhet të ecë sipas dritës që ka. Ti, Bibla dhe Fryma e Shenjtë keni përparësi në interpretim. Nuk duhet t'ia dorëzosh këtë të drejtë komentuesit.

Këto pyetje për diskutim t'i kam dhënë për të të ndihmuar që të analizosh çështjet kryesore të kësaj pjese të librit. Ato synojnë të të nxisin mendimin, jo të kenë natyrë shteruese.

1. Cili është qëllimi bazë i këtij kapitulli?
2. A përshkruajnë fundin e kohës vargjet 4-7?
3. Si lidhet profecia e Danielit në kapitujt 7-12 me Ardhjen e Dytë?
4. Pse përdor Jezusi gjuhë apokaliptike si në vargun 24?
5. A mund ta dinë besimtarët kur do të kthehet Zoti?
6. A është Ardhja e Dytë e atypëratyshme, e vonuar, apo e paqartë nga ana kohore?
7. Si mund të mos e dinte Jezusin kohën e kthimit të vet?
8. A e pret kthimin e Jezusit gjatë jetës sate?

MARKU 14

NDARJET NË PARAGRAFË TË PËRKTHIMEVE MODERNE

UBS ⁴	NKJV	NRSV	TEV	NJB
Komploti për të vvarë Jezusin	Komploti për të vvarë Jezusin	Vdekja e Jezusit (14:1-15:47)	Komploti kundër Jezusit	Konspiracioni kundër Jezusit
14:1-2	14:1-2	14:1-2	14:1-2	14:1-2
Vajosja në Betani	Vajosja në Betani		Jezusi vajoset në Betani	Vajosja në Betani
14:3-9	14:3-9	14:3-9	14:3-5 14:6-9	14:3-9
Pranimi i Judës që të tradhtojë Jezusin	Juda pranon të tradhtojë Jezusin		Juda bie dakord të tradhtojë Jezusin	Juda tradhton Jezusin
14:10-11	14:10-11	14:10-11	14:10-11	14:10-11
Pashka me dishepujt	Jezusi kremton Pashkën me dishepujt	Darka e fundit	Jezusi ha darkën e Pashkës me dishepujt	Përgatitjet për darkën e Pashkës
14:12-21	14:12-21	14:12-16 14:17-21	14:12 14:13-15 14:16 14:17-18 14:19 14:20-21	14:12-16 Parashikimi i tradhtisë së Judës 14:17-21
Caktimi i Darkës së Zotit	Jezusi cakton Darkën e Zotit		Darka e Zotit	Vendosja e Eukaristit
14:22-26	14:22-26	14:22-25 Gjeteamani 14:26-31	14:22 14:23-25 14:26	14:22-25 Parashikimi i mohimit të Pjetrit 14:26-31
Profetizimi i mohimit të Pjetrit	Jezusi parathotë mohimin e Pjetrit		Jezusi parathotë mohimin e Pjetrit	
14:27-31	14:27-31		14:27-28 14:29 14:30 14:31a 14:31b	
Lutja në Gjeteaman	Lutja në Gjeteaman		Jezusi lutet në Gjeteaman	Gjeteamani
14:32-42	14:32-42	14:32-42	14:32-34 14:35-36 14:37-38 14:39-40 14:41-42	14:32-42
Tradhtimi dhe arrestimi i Jezusit	Tradhtimi dhe arrestimi në Gjeteaman		Arrestimi i Jezusit	Arrestimi
14:43-50	14:43-50	14:43-50	14:43-44	14:43-52

			14:45-49	
I riu që iku me vrap	I riu ikën me vrap i zhveshur		14:50	
14:51-52	14:51-52	14:51-52	14:51-52	
Jezusi përpara Këshillit	Jezusi përballë me Sinedrin	Jezusi përpara Kajafës	Jezusi përpara Këshillit	Jezusi përpara Sinedrit
14:53-65	14:53-65	14:53-65	14:53-56	14:53-54 14:55-64
			14:57-59	
			14:60	
			14:61	
			14:62	
			14:63-64a	
			14:64b	
			14:65	14:65
Mohimi i Jezusit nga Pjetri	Pjetri mohon Jezusin dhe qan		Pjetri mohon Jezusin	Mohimi i Pjetrit
14:66-72	14:66-72	14:66-72	14:66-67	14:66-72
			14:68	
			14:69-70a	
			14:70b	
			14:71	
			14:72	

CIKLI TRE I LEXIMIT (shih f. v)

NDJEKJA E SYNIMIT TË AUTORIT FILLESTAR NË NIVELIN E PARAGRAFËVE

Ky është një komentuar studimor udhëzues, që do të thotë se ti je vetë përgjegjës për interpretimin e Biblës. Secili prej nesh duhet të ecë sipas dritës që ka. Ti, Bibla dhe Fryma e Shenjtë keni përparësi në interpretim. Nuk duhet t'ia dorëzosh këtë të drejtë komentuesit.

Lexo gjithë kapitullin njëherësh. Identifiko temat. Krahaso ndarjet e tua tematike me pesë përkthimet moderne. Ndarja në paragrafë nuk është e frymëzuar, por është çelësi për të ndjekur synimin e autorit fillestar, gjë që është thelbi i interpretimit. Secili paragraf ka vetëm një temë të vetme.

1. Paragrafi i parë
2. Paragrafi i dytë
3. Paragrafi i tretë
4. Etj.

PASAZHET PARALELE NË UNGJIJTË SINOPTIKË:

- A. Komploti për të vvarë Jezusin në Marku 14:1-2 gjendet dhe në Mat. 16:1-5 dhe Luka 22:1-2.
- B. Vajosja në Betani në Marku 14:3-9 gjendet dhe në Mat. 16:6-13 dhe Gjoni 12:2-8 (ndoshta, ka një tjetër vajosje në Galile në Luka 7:36-39).
- C. Marrëveshja e Judës që të tradhtojë Jezusin në Marku 14:10-11 gjendet dhe në Mat. 26:14-16 dhe Luka 22:3-6.
- D. Pashka me dishepujt në Marku 14:12-21 gjendet dhe në Mat. 26:17-25 dhe Luka 22:21-23, dhe Gjoni 13:21-30.

- E. Caktimi i Darkës së Zotit në Marku 14:22-26 gjendet dhe në Mat. 26:26-29 dhe Luka 22:17-20 (shih 1 Kor. 11:23-26).
- F. Mohimi i Pjetrit, që parathuhet në Marku 14:27-31, gjendet dhe në Mat. 26:31-35.
- G. Lutja e Jezusit në Gjetseman në Marku 14:32-42 gjendet dhe në Mat. 26:36-46, Luka 22:39-40, dhe Gjoni 18:1.
- H. Tradhtimi dhe arrestimi i Jezusit në Marku 14:43-50 gjendet dhe në Mat. 26:47-56; Luka 22:47-53, dhe Gjoni 18:2-12.
- I. Jezusi përpara Sinedrit në Marku 14:53-65 gjendet dhe në Mat. 26:57-68 dhe Gjoni 18:12, 19-24.
- J. Mohimi i Jezusit nga Pjetri në Marku 14:66-72 gjendet dhe në Mat. 26:69-75; Luka 22:54-62; dhe Gjoni 18:15-18, 25-27.

STUDIMI I FJALËVE DHE FRAZAVE

TEKSTI I NASB (I PËRDITËSUAR): MARKU 14:1-2

¹Pashka dhe festa e Bukëve të Ndorme ishte pas dy ditësh; dhe krerët e priftërinjve dhe skribët po kërkonin sesi ta kapnin me mashtrim dhe ta vrisnin; ²sepse thoshnin: “Jo gjatë festës, përndryshe mund të ketë revoltë nga populli”.

14:1 “Pashka dhe festa e Bukëve të Ndorme” Në fillim, këto ishin festa të veçanta që përkujtonin të njëjtën ngjarje: goditjen e fundit hyjnore, që e detyroi faraonin t’i lejonte hebrenjtë të largoheshin nga Egjipti. Kërkesat për darkën e Pashkës gjende në Eks. 12:1-14, 21-28, 43-51. Procedurat për festën shtatëditëshe të Bukëve të Ndorme gjenden në Eks. 12:8, 15-20 (shih Num. 28:16-25; LiP. 16:1-8 dhe *Lashtësitë* e Jozefusit, 3.10.5).

■ **“pas dy ditësh”** Për shkak se këto dy festa u bashkuan, judenjtë nganjëherë e përmendnin gjithë këtë periudhë me termin “Pashkë”. Prandaj, është e përtutur se ç’do të thotë “dy ditësh”: (1) dy ditë pas festës së ditës së tetë, apo (2) dy ditë para vetë Pashkës.

Gjoni 12:1-8 thotë se kjo ndodhi në një ditë tjetër; vargjet 3 e më tej ndoshta janë kujtim. Kronologjia e ditëve të fundit të jetës së Jezusit jepet ndryshe nga katër shkruarit e ungjijve. Për mendimin tim, kisha e hershme i kuptonte dallimet mes katër ungjijve, por nuk u përpoq që t’i pajtonte. Dallimet shkaktohen nga (1) natyra okulare e shkrimeve të tyre dhe (2) qëllimet teologjike/ungjillizuese të secilit ungjilltar. Secili prej tyre kishte lirinë (nën frymëzim) që të përzgjidhte, përshtaste dhe rendiste mësimet dhe veprimet e Jezusit për t’ua përputhur synimeve dhe grupeve të synuara (shih Gordon Fee dhe Doug Stuart, *Si ta lexojmë Biblën për gjithë vlerën që ka*, f. 126-129).

■ **“krerët e priftërinjve dhe skribët”** Mateu shton dhe “pleqtë”, duke nënkuptuar kështu gjithë përbërjen e Sinedrit. Shih Temën e Veçantë në Marku 12:13.

■ **“sesi ta kapnin me mashtrim dhe ta vrisnin”** Kjo s’ishte aspak diçka e re (shih Marku 3:6; 11:18), por fati i Jezusit në duart e farisenjve dhe saducenjve u vulos nga veprimet e tij kur pranoi brohoritjet e turmës gjatë Hyrjes Ngadhënjimtare në Jerusalem dhe kur dëboi tregtarët nga Oborri i Johebrenjve.

14:2 “mund të ketë revoltë nga populli” Jezusi ishte shumë popullor në Galileë. Gjatë Pashkës, Jerusalemi shtohet tre herë sa popullsia e vet normale për shkak të shtegtarëve që vinin nga gjithë zona e Mesdheut; shumë prej tyre vinin nga Galileë. “Revolta” e mundshme përmendet dhe te Mat. 26:5 dhe 27:24.

TEKSTI I NASB (I PËRDITËSUAR): MARKU 14:3-9

³Ndërsa ishte në Betani në shtëpinë e Simon lebrozit dhe ishte mbështetur në tryezë, erdhi një grua me një enë alabastri me parfum shumë të shtrenjtë nardi të kulluar; dhe e theu enën e ia derdhi

mbi kokë. ⁴Por disa i thoshin me zemërim njëri-tjetrit: “Pse u çua dëm gjithë ky parfum? ⁵Sepse ky parfum mund të ishte shitur për mbi treqind dinarë, dhe paratë t’u jepeshin të varfërve”. Dhe po e qortonin gruan. ⁶Por Jezusi u tha: “Lereni të qetë; pse i bini në qafë? Ajo ka bërë një vepër të mirë për mua. ⁷Sepse të varfrit do t’i keni gjithmonë mes jush dhe mund t’u bëni të mirë sa herë që të dëshironi; por mua nuk do të më keni gjithmonë. ⁸Ajo ka bërë atë që munda; e ka vajosur trupin tim paraprakisht për varrimin. ⁹Me të vërtetë ju them: kudo që të predikohet ungjilli në mbarë botën, edhe ajo që ka bërë kjo grua do të përmendet në përkujtim të saj”.

14:3 “Betani” Qyteti në kreshtën e njohur si mali i Ullinjve, jo larg nga Jerusalemi, ishte vend i njohur për shtegtarët, që flinin aty gjatë tri festave të detyrueshme vjetore. Secila familje judaike që jetonte pranë Jerusalemit kishte detyrimin kulturor që t’ua hapte shtëpinë shtegtarëve.

■ **“Simon lebrozit”** Në DHV, lebroza ishte shenjë e pakënaqësisë së Perëndisë. Kishte pasoja të tmerrshme shoqërore. Ky njeri, me sa duket, ishte shëruar, ndoshta nga Jezusi. Lebroza në botën e lashtë nënkuptonte një sërë sëmundjesh të ndryshme të lëkurës (shih Levitiku 13-14), jo vetëm lebrozën e sotme.

Pasazhi paralel në Gjoni 12:2-8 lë të kuptohet se kjo ishte shtëpia e Lazarit dhe se ajo gruaja ishte Maria, motra e tij. Mos, ndoshta, Simoni ishte babai i tyre, të cilin Jezusi mund ta kishte shëruar më parë?

■ **“mbështetur në tryezë”** Ata nuk përdornin karrige, por mbështeteshin në tre tryeza të ulta në formën e potkoit; bërrylin e majtë e mbështesnin përtokë me këmbët e shtrirë pas.

■ **“erdhi një grua”** Luka 7:36-50 përmend një ngjarje shume të ngjashme vajosjeje në të njëjtin vend, por në këtë rast nga një grua mëkatore. Gjoni 12:3 thotë se kjo grua quhej Mari, motra e Lazarit, kurse Marku nuk jep asnjë emër. Marku, që e shkroi i pari ungjillin, ndoshta druhej ta identifikonte atë grua si ndjekëse të Jezusit, ndërsa Gjoni, që shkroi shumë më vonë, u ndie i lirë që ta përmendte (shih Lenski, *St. Mark’s Gospel*).

Ky është, pa diskutim, një veprim i mahnitshëm dashurie, që simbolizonte faktin se së shpejti do të ndodhte varrosja e Jezusit.

NASB “një enë alabastrit”
NKJV “qafore alabastrit”
NRS, TEV, “qyp alabastrit”
NJB

Kjo ishte një enë prej guri të bardhë opak, e taposur, që vinte nga Alabastron, një qytet në Egjipt. Pasi hapaj tapa, nuk taposej dot më. Gjoni 12:3 na thotë se përmbante gjysmë litri. Ndoshta, gruaja e kishte patur si pajë dasme. Qartazi, ky ishte veprim i nxitur nga dashuria dhe përkushtimi i jashtëzakonshëm.

14:3

NASB “parfum shumë të shtrenjtë nardi të kulluar”
NKJV “vaj shumë të shtrenjtë spikenardi”
NRSV “vaj shumë të shtrenjtë nardi”
TEV “parfum shumë të shtrenjtë, i bërë prej nardi të kulluar”
NJB “parfum shumë të shtrenjtë, nard i kulluar”

Nardi bëhej nga rrënja e një bime prej Himalajave. Kishte aromë shumë të fortë. Fjala “i kulluar” vjen nga *pistikos*, që nënkupton cilësi të besueshme (pra “i vërtetë”, ose “i papërzier”, shih Gjoni 12:3).

Fjala “nard” mund të vijë nga latinishtja (shih A. T. Robertson, *Word Pictures in the New Testament*, vëll. 1, f. 380). Ungjilli i Markut ka më shumë fjalë dhe fraza latinisht se çdo ungjill tjetër. Me sa duket, synonte lexuesit romakë.

■ **“mbi kokë”** Ungjilli i Gjonit na thotë se ajo ia derdhi nardin te këmbët (shih Gjoni 12:3). Ndoshta, janë të dyja të vërteta, pasi një gjysmë litri parfum do të kishte qenë i tepër për kokën e tij, dhe mund t’ia ketë vajosur lehtësisht gjithë trupin.

Ndoshta, vajosja në kokë mund t'u ketë sjellë në mendje këtyre judenjve vajosjen e mbretit (shih 1 Sam. 10:1; 2 Mbre. 9:3, 6; nënkuptohet dhe në 1 Sam. 16:13). Ky mund të ketë qenë simbol mbretëror mesianik, si dhe profeci/procedurë varrimi (shih Marku 15:46; 16:1; Luka 23:56; Gjoni 19:39-40).

14:4 “disa” Gjoni 12:4-5 e identifikon këtë person me emrin Juda Iskariot. Me sa duket, dishepujt e Jezusit po debatonin për këtë gjë me njëri-tjetrin (shih Marku 9:10; 10:26; 11:31; 12:7; 16:3).

▣ **“i thoshin me zemërim njëri-tjetrit”** Kjo është formë perifrastike e pakryer. Dishepujt po flisnin me njëri-tjetrin dhe po shprehnin keqardhje për teprimin e gruas. Ishin të pezmatuar, madje të zemëruar. Kjo fjalë përdoret dhe për sjelljen e Jezusit në Marku 10:14 kur dishepujt larguan fëmijët.

▣ **“mund të ishte shitur për mbi treqind dinarë”** Shuma e sotme monetare nuk na vjen në ndihmë për shkak se paraja ka ndryshuar vlerë që atëherë. Një dinar ishte sa rroga ditore e një ushtari ose mëditësi; prandaj, ky parfum vllente sa rroga e një viti.

14:5 “paratë t'u jepeshin të varfërve” Dhënia e parave të varfërve gjatë Pashkës ishte kërkesë e rëndësishme fetare e rabinëve (shih Gjoni 13:29). Quhej lëmoshë.

TEMË E VEÇANTË: LËMOSHA (SPECIAL TOPIC: ALMSGIVING)

- I. Termi në vetvete
 - A. Ky term u zhvillua brenda judaizmit.
 - B. Bën fjalë për të ndihmuar të varfrit dhe/ose nevojtarët.
 - C. Në shqip, fjala “lëmoshë” vjen nga një deformim i fjalës greke *eleimosini*.
- II. Koncepti në Dhiatën e Vjetër
 - A. Koncepti i ndihmës së të varfërve shprehet herët në Torah
 1. konteksti tipik, LiP. 15:7-11
 2. “mbledhja e kallinjve”; një pjesë e të korrave iu lihej të varfërve (Lev. 19:9; 22:23; LiP. 24:20)
 3. “viti i shabatit”, që u lejonte të varfërve të hanin prodhimet e vitit të shtatë, kur toka nuk punohej (Eks. 23:10-11; Lev. 25:2-7).
 - B. Ky koncept u zhvillua më tej në literaturën e urtësisë (shembuj të përzgjedhur)
 1. Jobi 5:8-16; 29:12-17 (të ligjtë përshkruhet në 24:1-12)
 2. Psalmet, 11:7
 3. Fjalët e Urta 11:4; 14:21, 31; 16:6; 21:3, 13
- III. Zhvillimi në judaizëm
 - A. Vëllimi i parë i Mishnës flet për mënyrën si duhen trajtuar të varfrit, nevojtarët dhe levitët lokalë.
 - B. Citime të përzgjedhura
 1. *Ekleziasti* (i njohur edhe si Urtësia e Ben Sirakut) 3:30: “ashtu si uji shuan zjarrin e tërbuar, kështu dhe lëmosha shlyen mëkatën” (NRSV)
 2. *Tobiti* 4:6-11: “sepse ata që veprojnë në përputhje me të vërtetën do të begatohen në çdo gjë që bëjnë. Gjithë atyre që kryejnë drejtësinë jepu lëmoshë nga pasuria jote, dhe mos lejoj që syri yt ta shohë me keqardhje dhuratën kur e jep. Mos e kthe kokën nga ana tjetër para të varfrit, dhe as Perëndia nuk do ta kthejë kurrë fytyrën nga ana tjetër para teje. Nëse ke shumë pasuri, jepe dhuratën në përpjesëtim me to; nëse ke pak, mos ki frikë të japësh sipas asaj pak që ke. Kështu, ke për të grumbulluar një thesar të madh për vete ditën e nevojës. Sepse lëmosha të çliron nga vdekja dhe të mbron që të mos kridhesh në Errësirë. Me të vërtetë, për gjithë ata që e japin, lëmosha është ofertë e shkëlqyer në prani të Shumë të Lartit”. (NRSV)
 3. *Tobiti* 12:8-9: “Lutja dhe agjërimi janë të mira, por më e mirë se të dyja është lëmosha me drejtësi. Pak me drejtësi është më mirë se pasuria me keqbërje. Më mirë të japësh

lëmshë sesa të grumbullosh flori. Sepse lëmshë të shpëton nga vdekja dhe të pastron nga çdo mëkat. Ata që japin lëmshë do të shijojnë një jetë të plotë”. (NRSV)

- C. Citimi i fundit nga Tobiti 12:8-9 tregon zhvillimin e problemit. Veprimet/meritat njerëzore shiheshin si mekanizëm për të siguruar falje dhe begati.

Ky koncept zhvillohet më tej në Septuagintë, ku fjala greke “lëmshë” (*eleimosini*) bëhet sinonim i “drejtësisë” (*dikaosune*). Të dyja përdoren për të përkthyer ndonjëherë fjalën hebraisht “drejtësi” (BDB 842, dashuria dhe besnikëria e besëlidhjes së Perëndisë, shih LiP. 6:25; 24:13; Isa. 1:27; 28:17; 59:16; Dan. 4:27).

- D. Veprimet e mëshirshme njerëzore u bënë synim në vetvete për të arritur begati personale gjatë jetës dhe shpëtimin pas vdekjes. Kjo vepër (dhe jo motivi pas këtij veprimi) mori vlerë të madhe teologjike. Perëndia sheh zemrën, pastaj gjykon veprimin e dorës. Ky ishte mësimi i rabinëve, por, në njëfarë mënyre, humbi dhe u shndërrua në veprim vetëdrejtësie (shih Mikea 6:8).

IV. Reagimi i Dhiatës së Re

- A. Kjo fjalë gjendet në

1. Mat. 6:1-4
2. Luka 11:41; 12:33
3. Veprat 3:2-3, 10; 10:2, 4, 31; 24:17

- B. Jezusi trajton konceptin tradicional të drejtësisë si (shih 2 Klementit 16:4)

1. Lëmshë
2. Agjërim
3. Lutje

- C. Në Predikimin në Mal (shih Mat. 5-7), Jezusi i jep një riorientim rrënjësor pikëpamjes tradicionale për drejtësinë (pra, besimit në veprimet njerëzore). “Besëlidhja e re” e Jer. 31:31-34 bëhet standardi i ri për të patur marrëdhënien e drejtë me Perëndinë (shih Rom. 3:19-31). Perëndia të jep zemër, mendje dhe shpirt të ri. Fokusi i Jezusit është te arritjet hyjnore, jo arritje njerëzore (shih Ezek. 36:26-27).

14:6 “Ierëni të qetë” Kjo është urdhërore aoriste veprorë. Jezusi e mbron këtë veprim plot dashuri dhe hir. Ai e pa si veprim profetik përgatitjeje për vdekjen dhe varrosjen që do t’i ndodhte së shpejti (shih Marku 14:*)).

14:7 “Sepse të varfrit do t’i keni gjithmonë mes jush” Kjo nuk është thënie përçmuese për të varfrit (shih LiP. 15:4, 11), por thekson natyrën unike të Jezusit dhe kohën e veçantë të tij në tokë.

14:8 “e ka vajosur trupin tim paraprakisht” Mos, ndoshta, ajo kuptoi atë që dishepujt e tij s’e kishi nkuptuar ende? Ky lloj parfumi përdorej dhe për përgatitjen e kufomës për varrim (shih Gjoni 19:40).

14:9 “Me të vërtetë” Fjalë për fjalë, “amen”. Shih Temën e Veçantë në Marku 3:28.

■ **“kudo që të predikohet ungjilli”** Ungjilli është mesazhi që Jezusi jepte në lidhje me Perëndinë, njerëzimin, mëkatin, veten e tij, shpëtimin dhe jetën e përtejme. Jezusi ua zbuloi këto të vërteta shkruarve të frymëzuar të DHR nëpërmjet ndërmjetësisë së Frymës. Ato janë zbulesa, jo zbulim njerëzor. Kjo vjen, pikësepari, nga zbulesa e një personi dhe nga marrëdhëniet me atë person, jo thjesht një kredo apo një sistem doktrinash për atë person. Këtu bëhet fjalë për marrëdhënien personale me Krishtin me anë të besimit kur kupton se kush është ai dhe pse erdhi, gjë që çon në jetesën si Krishti në dritën e kësaj marrëdhënieje të re me Perëndinë; kjo nënkupton një botëkuptim krejtësisht të ri.

■ **“në mbarë botën”** Jezusi priste që ungjilli të përshkonte gjithë globin (shih Marku 13:27; si dhe Mat. 28:19-20; Luka 24:46-47; Veprat 1:8).

■ **“edhe ajo që ka bërë kjo grua do të përmendet në përkujtim të saj”** Jezusi nuk i harron veprat e mirësisë dhe përkushtimit. Kjo vepër shënohet në Shkrimet, por shumë të tjera ruhen në zemrën e Perëndisë dhe do të zbulohen në atë ditë madhështore (shih Gal. 6:7-9; 1 Tim. 5:25; Zbu. 14:13; si dhe 2:1, 19; 3:8).

TEKSTI I NASB (I PËRDITËSUAR): MARKU 14:10-11

¹⁰Atëherë Juda Iskarioti, që ishte një nga të dymbëdhjetët, shkoi te krerët e priftërinjve që ta tradhëtonte Jezusin te ta. ¹¹Ata u gëzuan kur e dëgjuan këtë dhe i premtuan para. Dhe ai filloi të përpiqej si ta tradhëtonte në kohën e përshtatshme.

14:10 “Juda Iskarioti, që ishte një nga të dymbëdhjetët” Ka disa teori në lidhje me termin Iskariot (kjo fjalë shqiptohet ndryshe në dorëshkrimet e ndryshme greke). Mund të bëjë fjalë për këto alternativa:

1. një burrë nga Keriothi, qytet i Judës
2. një burrë nga Kartami, qytet në Galile
3. çanta që përdorej për të mbajtur paratë
4. fjalë habrisht “mbys”
5. fjala greqisht që përdorej për thikën e vrasësve

Nëse është e vërtetë alternativa #1, Juda ishte i vetmi judeas ndër të dymbëdhjetët. Nëse janë të vërteta #4 ose #5, ai ishte zelot si Simoni.

Kohët e fundit është botuar një libër interesant, por tejet hamendësues (që e zhvlerëson ungjillin e Gjonit), i cili e interpreton Judën në mënyrë pozitive. Ky libër ka titullin *Judas, Betrayer or Friend of Jesus? (Juda: tradhtar apo mik i Jezusit?)*, nga William Klassen, Fortress Press, 1996.

■ **“që ishte një nga të dymbëdhjetët”** Ai ishte anëtar i grupit të dishepujve që Jezusi e kishte zgjedhur vetë. Ishte pjesë e udhëtimeve misionare dhe i pranishëm në mësimet, mrekullitë dhe Darkën e Fundit të Jezusit.

Kjo frazë ka një shqesë “njëri”. Janë dhënë disa mendime për kuptimin e kësaj: (1) Juda ishte drejtuesi i grupit të apostujve. Ai mbante paratë e grupit dhe zuri vendin e nderit në Darkën e Fundit; ose (2) bën fjalë për murmuritjet në Marku 14:4.

■ **“shkoi te krerët e priftërinjve”** Luka 22:4 shton dhe fjalën “policia e tempullit”. Juda i pyeti sa do t’i jepnin (shih Mat. 26:15). Ky ishte sa çmimi i skllavit që goditej nga lopa (shih Eks. 21:32; Zak. 11:12).

Mateu 26:16 na thotë se ishin “tridhjetë monedha argjendi”. Kjo përmbushi profecinë e Zak. 11:12-13 (shih Mat. 27:9-10). Jezusi ishte “Bariu” i hedhur poshtë. Shkruesit e ungjijve i citojnë kapitujt 9-14 të Zakarisë si burim profetik, ose si tipologji, për shërbesën e Jezusit.

1. Mat. 21:4-5 citon Zak. 9:9
2. Mat. 24:3 citon Zak. 12:10
3. Mat. 26:15 citon Zak. 11:12-13
4. Mat. 26:31 citon Zak. 13:7
5. Mat 27:9-10 citon Zak. 11:12-13

■ **“tradhëtonte”** Kjo është fjala greke “dorëzoi” (*paradidomi*). Bibla anglisht e përkthejnë gjithmonë “tradhtoj”, por ky nuk është kuptim i sigurt. Mund të ketë dhe kuptimin pozitiv “besoj në duart e dikujt” (shih Mat. 11:27), ose “përtërij”, ose “urdhëroj” (Veprat 14:26; 15:40), si dhe kuptimin negativ “dorëzoi dikë te autoritetet”, ose “dorëzoi dikë në duart e Satanit” (shih 1 Kor. 5:5; 1 Tim. 1:20), ose kur Perëndia e dorëzon dikë në idhujtarinë e vet (shih Veprat 7:42). Është e qartë se kutimin e kësaj foljeje të zakonshme duhet ta përcaktojë konteksti. Tradhtia përshtatet me veprimin e Judës.

14:11 “ata u gëzuan” Nuk na thuhet se ishin të habitur. Motivimi i Judës ka qenë gjithmonë burim hamdnësimesh. Këta krerë fetarë duhet ta kenë parë largimin e Judës nga grupi i apostujve si përligjeje për planin e tyre vrasar!

■ **“në kohën e përshtatshme”** Luka 22:6 shton “veçmas turmës”. Ata i druheshin popullaritetit të Jezusit në shtegtarët galileas që ishin në Jerusalem për festën (shih Marku 11:18; 12:12; Mat. 26:5; 27:24).

TEKSTI I NASB (I PËRDITËSUAR): MARKU 14:12-16

¹²Ditën e parë të Bukëve të Ndorme, kur po flijohej qengji i Pashkës, dishepujt i thanë: “Ku dëshiron që të shkojmë dhe të të përgatisim ngrënien e Pashkës?” ¹³Dhe ai dërgoi dy nga dishepujt dhe u

tha: “Shkoni në qytet, dhe do t’ju takojë një njeri që mban një kanë me ujë; ndiqeni; ¹⁴dhe, kudo të hyjë ai, thuajini të zotit të shtëpisë: ‘Mësuesi thotë: “Ku është dhoma ime e miqve, që të ha Pashkën me dishepujt e mi?”’ ¹⁵Dhe ai vetë do t’ju tregojë një dhomë të madhe sipër, e mobiluar dhe gati; përgatitni darkën për ne aty”. ¹⁶Dishepujt ikën dhe shkuan në qytet, dhe i gjetën pikërisht ashtu siç u kishte thënë ai; dhe përgatitën Pashkën.

14:12 “Ditën e parë të Bukëve të Ndorme” Ka një problem të madh se në ç’ditë e hëngrën Darkën e Fundit Zoti me dishepujt: 13 apo 14 Nisan? Gjoni lë të kuptosh datën 13 (shih Marku 18:29; 19:14, 31, 32), ndërsa ungjijtë sinoptikë thonë 14. Ndoshta, dallimi lidhet me

1. përdorimin e kalendarit romak kundrejt kalendarit hënor judaik
2. mënyrat e ndryshme si nisej dita: në darkë për judenjtë, por në mëngjes për romakët
3. të dhënat se komuniteti i Detit të Vdekur, që ndiqte kalendarin hënor, e festonte Pashkën një ditë më herët si simbol se ata e refuzonin udhëheqjen priftërore të Jerusalemit

Katër ungjijtë janë dëshmi okulare të shkruara për qëllime teologjike dhe ungjillizuese. Autorët e tyre kishin të drejtën që, nën frymëzim, të përzgjidhnin, përshtasni dhe rendisnin jetën dhe fjalët e Jezusit. Kjo është arsyeja e shumicës së të ashtuquajturave vështirësi në rrëfimet e Ungjijve (shih Fee dhe Stuart, *How to Read the Bible for All Its Worth*, f. 126-129). Vetë fakti se ungjijtë ndryshon disa nga njëri-tjetri është shenjë se janë të besueshëm nga ana historike. Kisha e hershme i pranoi të katërta versionet pa u përpjekur që t’i unifikonte (me përjashtim të Diatesaronit të Tatianit në fund të shekullit të dytë).

Nga ana hermeneutike, ungjijtë duhen interpretuar në dritën e kontekstit të tyre (pra, synimit të secilit autor) dhe nuk duhen krahasuar me ungjijtë e tjerë thjesht për të marrë më tepër të dhëna historike.

14:13 “dy nga dishepujt” Luka 22:8 thotë se këta ishin Pjetri dhe Gjoni. Nga burimet rabinike dimë se vetëm dy vetë nga çdo familje lejoheshin në tempull për të ofruar qengjin me ndihmën e priftit.

■ **“dhe do t’ju takojë një njeri që mban një kanë me ujë”** Në atë kulturë, ishte tejet e pazakontë që burri të mbante ujë, sidomos ta mbante në kanë. Nëse nevojiteshin burra për të mbartur sasi të mëdha uji përdornin lëkurë delesh ose dhish, jo qypa balte. Kjo është tjetër dëshmi okulare e Pjetrit.

14:14 “thuajini të zotit të shtëpisë” Shumë besojnë se kjo ishte shtëpia e Gjon Markut (që i futi shënimet e predikimeve të Pjetrit në Romë në ungjillin e Markut), vendi i mundshëm i Darkës së Fundit dhe i shfaqjeve të Jezusit pas ringjalljes. Gjon Marku ishte kushëriri i Barnabës dhe pjesëmarrës në pjesën e parë të udhëtimit të parë misionar të Barnabës dhe Saulit (pra, Palit). Ishte dhe shoqëruar i Pjetrit dhe, me sa duket, autori i ungjillit të parë; përdori kujtimet ose predikimet e Pjetrit. Kjo duket si ngjarje e rregulluar që më parë, jo profeci.

14:15 Ky ishte dhe vendi ku ndodhën shfaqjet e Jezusit pas ringjalljes (shih Veprat 1:12). Kjo dhomë u shndërrua në selinë e dishepujve në Jerusalem.

TEKSTI I NASB (I PËRDITËSUAR): MARKU 14:17-21

¹⁷Kur erdhi darka, ai ishte me të dymbëdhjetët. ¹⁸Teksa ishin mbështetur në tryezë dhe po hanin, Jezusi tha: “Me të vërtetë ju them se njëri prej jush do të më tradhtojë—ai që po ha me mua”. ¹⁹Ata filluan të trishtoheshin dhe i thanë një nga një: “Sigurisht që jo unë, apo jo?” ²⁰Dhe ai u tha: “Është njëri nga të dymbëdhjetët, ai që po ngjyen me mua në tas. ²¹Sepse Biri i Njeriut duhet të shkojë ashtu siç është shkruar për të; por mjerë ai njeri nga i cili tradhtohet Biri i Njeriut! Do të kishte qenë më mirë për të që të mos kishte lindur”.

14:17 “Kur erdhi darka” Dita e judenjve niste në muzg (shih Zan. 1:5, 8, 13, 19, 23, 31). Kjo ishte darka e Pashkës pasi, zakonisht, vaktet e darkës për judenjtë haheshin pasdite vonë. Vetëm darka e Pashkës hahej pas orës 6 të darkës.

14:18 “mbështetur” Në fillim, Pashka hahej në këmbë për shkak të Eks. 12:11. Judenjtë e shekullit të parë nuk përdornin karrige, një zakon që e kishin marrë nga persët (shih Esteri 1:6; 7:8). Ata hanin të mbështetur në mbështetëse të ulta, zakonisht tre të tilla, rreth një tryeze në formën e potkoit (në këtë mënyrë, shërbëtorët e kishin

të lehtë t'u servirnin ushqimet), të mbështetur në jastëkë me bërrylin e majtë, ndërsa këmbët i mbanin të shtrira pas.

▣ **“Me të vërtetë”** Fjalë për fjalë, “amen”. Shih Temën e Veçantë në Marku 3:28.

▣ **“se njëri prej jush do të më tradhtojë—ai që po ha me mua”** Ky është aludim për Psa. 41:9. Kjo ishte mënyrë kulturore për të theksuar fajin e Judës (shih Gjoni 13:18). Ngrënia së bashku në një tryezë ishte simbol i rëndësishëm miqësie dhe përkushtimi në atë kontekst kulturor. Tradhtimi i dikujt me të cilin kishe ngrënë ishte e tmerrshme për lindorët.

14:19 “një nga një: ‘Sigurisht jo unë’” Secili dishepull mendonte se mund të ishte tradhtar. Kjo tregon se, në këtë pikë kohore. Askush prej tyre nuk dyshonte te Juda. Secili ishte vetë i pasigurt për qëndrimin ndaj Jezusit.

14:20 “që po ngjyen me mua në tas” Kjo ishte një pjatë e veçantë me salcë frutash ngjyrë gri, që i ngjante llaçit. Juda ishte ulur ngjitur me Jezusin në vendin e nderit! Edhe në këtë orë të vonët, Jezusi po përpiquej që t'i jepte shpirtërisht dorën Judës.

14:21 “por mjerë ai njeri nga i cili do të tradhtohet Biri i Njeriut! Do të kishte qenë më mirë për të që të mos kishte lindur” Gjoni 13:27 e më tej nënkupton se Juda u largua pas kupës së tretë të bekimit përpara themelimit të Darkës së Zotit. Juda është enigmatik. Motivet pse e trahdtoi Jezusin nuk na zbulohen askund. Disa e shohin si patriot fisnik jude (pra, si zelot), që po përpiquej ta detyronte Jezusin të vepronte ushtarakisht kundër Romës. Të tjerë e shohin si jude të përkushtuar, që ishte i zemëruar ngaqë Jezusi refuzoi traditat gojore dhe ngaqë shoqërohej me të përjashtuarit dhe mëktarët e shoqësi judaike. Ungjilli i Gjonit e pasqyron si vjedhës që nga fillimi, si dikush që nxitej nga dashuria për paranë. Mirëpo veprimet e Judës pas arrestimit të Jezusit nuk përkojnë me këtë karakterizim. Cilido të ketë qenë motivi ose arsyeja e tij e vërtetë, cilado të ketë qenë përfshirja e Satanit, apo çfarëdo paranjohurie të ketë qenë e përfshirë në profecinë parashikuese, Juda është përgjegjës për veprimat e veta, njësoj si të gjithë ne (shih Gal. 6:7).

TEKSTI I NASB (I PËRDITËSUAR): MARKU 14:22-25

²²Ndërsa po hanin, mori ca bukë, dhe pasi e bekoj, e theu, ua dha atyre dhe tha: “Merreni; ky është trupi im”. ²³Dhe, pasi mori një kupë, falënderoi, ua dha dhe të gjithë pinë prej saj. ²⁴Dhe u tha: “Ky është gjaku im i besëlidhjes, që derdhet për shumë vetë. ²⁵Me të vërtetë ju them: nuk do të pi më kurrë prej frytit të hardhisë deri ditën kur do ta pi të ri në mbretërinë e Perëndisë”.

14:22 “mori ca bukë” Vini re se ky nuk ishte qengji i Pashkës (as bimët e hidhura), por buka pa maja (*azumos*, shih Marku 14:1). Fjala greqisht këtu është *artos*, që zakonisht përdorej për të nënkuptuar bukën normale (shih Marku 3:20; 6:8, 16, 36, 37; 7:2, 5, 27; 8:4, 14, 16, 17). Por përdoret dhe për bukën pa maja në pasazhet paralele Mat. 26:26; Luka 22:19. Ndoshta, qengji përmbante ngjyrimet tepër të forta nacionaliste. Me gjithë lidhjet historike mes Pashkës dhe Darkës së Fundit, këtu bëhet një dallim i qëllimshëm teologjik.

Nëse këtu kemi një tipologji të vazhdueshme mes Eksodit dhe Jezusit (dhe kështu duket se është), atëherë buka shfaq një marrëdhënie të veçantë me “manën” (shih Eks. 16), që JHVH ua dha izraelitëve gjatë endjes në shkretëtirë. Ajo përbënte ushqimin jetëdhënës dhe të përditshëm për popullin e Perëndisë. Tani, JHVH po jep bukën “e vërtetë” të qiellit, po jep ushqimin “e vërtetë” jetëdhënës, po dërgon drejtuesin “e përsosur” dhe po inauguron Pashkën e re nga mëkati dhe vdekja. Autorët e DHR e përdornin shpesh tipologjinë kristologjike kur e paraqisnin Jezusin të paraprophetizuar në DHV.

Vera në DHV njihet si gjaku i hardhisë dhe, shpesh, përdorej në kuptimin gjyqësor (p.sh., rrushtë e zeërimit). Tani, ajo është flijimi që sjell jetë të përjetshme. Kjo metaforë shihet qartë në Gjoni 6.

▣ **“pasi e bekoj”** Kjo ishte procedura standarde për darkën e Pashkës. Me shumë gjasa, simbolizmi i bukës së thyer dhe verës ndodhi në atë pikë të ritualit që quhet “kupa e tretë e bekimit” (shih 1 Kor. 10:16).

TEMË E VEÇANTË: PASHKA (RENDI I SHËRBESËS) (SPECIAL TOPIC: PASSOVER [ORDER OF SERVICE])

- A. Lutja
- B. Kupa e verës
- C. I zoti i shtëpisë lan duart dhe ua kalon legenin të gjithëve
- D. Ngjyerja e bukës në një salcë me bimë të hidhura
- E. Qengji dhe vakti kryesor
- F. Lutja dhe ngjyerja e dytë e bukës në salcën me bimë të hidhura
- G. Kupa e dytë e verës me një kohë “pyetje-përgjigje” për fëmijët (shih Eks. 12:26-27)
- H. Këndimi i Psalmeve “Halel” 113-114 dhe lutja
- I. Kryesuesi i ceremonisë ngjyen nga një kafshatë për secilin pjesëmarrës pasi lan duart
- J. Të gjithë hanë derisa ngopen; e përfundojnë me një copë mishi nga qengji
- K. Kupa e tretë e verës pas larjes së duarve
- L. Këndimi i Psalmeve “Halel” 115-118
- M. Kupa e katërt e verës, që nënkuptonte ardhjen e Mbretërisë

Shumë besojnë se inaugurimi i Darkës së Zotit ndodhi në pikën “K”.

■ **“Merreni; ky është trupi im”** Gjoni 6:22 e më tej dhe 1 Kor. 10:16 tregojnë simbolikat e forta teologjike të këtij rituali. Fjalët e Jezusit për trupin dhe gjakun e vet duhet t’i kenë tronditur dishepujt e tij judenj. Kanibalizmi dhe pirja e gjakut ishin shkelje të Lev. 11. Këto thënie janë qartazi simbolike, por gjithsesi të papritura.

Jezusi po simbolizon kryqëzimin duke thyer bukën. Ashtu si ngjyra e verës ishte e ngjashme me gjakun, kështu dhe ngjyra e bukës ishte e ngjashme me trupin e njeriut. Jezusi ishte Buka e vërtetë e Jetës (pra, mana; shih Gjoni 6:31-33, 51), Pashka e vërtetë, Eksodi i ri!

TEMË E VEÇANTË: DARKA E ZOTIT NË GJONI 6 (SPECIAL TOPIC: THE LORD’S SUPPER IN JOHN 6)

- A. Ungjilli i Gjonit nuk e përmend Darkën e Zotit në vetvete, ndonëse kapitujt 13-17 përmbajnë dialogun dhe lutjen e kryer në Dhomën e Sipërme. Kjo mospërmendje mund të jetë e qëllimshme. Kisha e fundshekullit të parë filloi ta shihte pagëzimin dhe Darkën e Zotit në kuptimin sakramental, madje si kanal të hirit. Gjoni ndoshta po reagonte ndaj këtij këndvështrimi sakramental që po zhvillohej, ndaj nuk e përmend pagëzimin e Jezusit apo Darkën e Zotit.
- B. Gjoni 6 është në kontekstin e ushqyerjes së pesë mijë vetave. Mirëpo shumë e përdorin për të mbështetur pikëpamjen sakramentale të Eukaristisë. Ky është dhe burimi i doktrinës katolike të transsubstancimit (Gjoni 6:53-56).

Pyetja se ç’lidhja ka kapitulli 6 me Eukaristinë tregon dhe natyrën dualiste të ungjijve. Qartazi, ungjijtë flasin për fjalët dhe jetën e Jezusit, mirëpo u shkruan dekada më vonë dhe shprehën besimin e komuniteteve të autorëve të tyre. Kështu, ka tre nivele synimi autorial:

- 1. Fryma
- 2. Jezusi dhe dëgjuesit e parë
- 3. Shkruesit e ungjijve dhe lexuesit e tyre

Si t’i interpretojmë atëherë? Metoda e vetme e verifikueshme duhet të jetë qasja kontekstuale, gramatikore dhe leksikore, e informuar nga konteksti historik.

- C. Duhet të mos harrojmë se dëgjuesit e parë ishin judenj dhe sfondi i tyre kulturor ishte pritishtëria rabinike e Mesisë si një super-Moisi (shih Gjoni 6:30-31), sidomos në lidhje me përjetimet e Eksodit, si për shembull furnizimi me “mana”. Rabinët përdornin si varg provë Psa. 72:16. Thënie e pazakonta të Jezusit (shih Gjoni 6:60-62, 66) synonin të hidhnin poshtë pritishtëritë e rreme që kishte turma për Mesinë (shih Gjoni 6:14-15).
- D. Etërit e hershëm të kishës nuk ishin të gjithë dakord se ky pasazh bën fjalë për Darkën e Zotit. Klementi i Aleksandrisë, Origeni dhe Euzebi nuk e përmendin kurrë Darkën e Zotit në diskutimet e tyre për këtë pasazh.
- E. Metaforat e këtij pasazhi janë shumë të ngjashme me fjalët që Jezusi përdori me “gruan te pusi” në

Gjoni 4. Uji dhe buka tokësore përdoren si metafora për jetën e përjetshme dhe për realitetet shpirtërore.

F. Ky shumëfishim i bukës është e vetmja mrekulli e regjistruar në të katërt ungjijtë!

14:23 “falënderoi” Fjala greqisht për “faleminderit” është *eukaristi*, nga e cila vjen dhe termi anglisht për Darkën e Zotit: Eukaristia.

14:24 “Ky është gjaku im i besëlidhjes” Ngjyra e verës i ngjante ngjyrës së gjakut njerëzor. Kjo frazë ka tre origjina të mundshme nga DHV.

1. Eks. 24:6-8, inaugurimi i Librit të Besëlidhjes me anë të gjakut të besëlidhjes
2. Jer. 31:31-34, i vetmi pasazh në DHV që përmend “besëlidhjen e re”
3. Zak. 9:11, që gjendet në njësinë letrare 9-14, burimi i shumë profecive (pra, tipologjive kristologjike) për jetën e Jezusit

Ka dy variante në traditën e dorëshkrimeve greqisht.

1. “besëlidhja”, që ndjek Mat. 26:28, që gjendet në dorëshkrimet greke Sinaitikus, B, C, D2 dhe L (si dhe D* dhe W me disa ndryshime të vogla). UBS4 i jep leximit të shkurtër vlerësimin “A” (i sigurt).
2. “besëlidhja e re”, që ndjek Luka 22:20 dhe 1 Kor. 11:25, dhe gjendet në dorëshkrimet A dhe E, si dhe në përkthimet e Vulgatës, Siriake, Kopte dhe Armene (shih NKJV). Ndoshta, kjo ishte shtesë për t’i lidhur fjalët e Jezusit me besëlidhjen “e re” të Jer. 31:31-34.

Në gjithë këtë debat një gjë është e qartë: vdekja e Jezusit ishte jetike për rikthimin e njerëzimit të rënë në bashkësi me Atin (shih Marku 10:45). Jezusi erdhi (1) për të na zbuluar Atin; (2) për të na dhënë një shembull për të ndjekur; dhe (3) për të vdekur në vendin tonë për mëkatet tona. Nuk ka asnjë mënyrë tjetër shpengimi (shih Gjoni 10, 14). Ky ishte aspekti thelbësor i planit të përjetshëm të Perëndisë (shih Veprat 2:23; 3:18; 4:28; 13:29).

TEMË E VEÇANTË: BESËLIDHJA (SPECIAL TOPIC: COVENANT)

Fjala e DHV, *berith* (BDB 136), besëlidhje, s’përcaktohet dot lehtë. Nuk ekziston asnjë FOLJE që i përkon këtij emri në hebraisht. Çdo përpjekje për t’i dhënë një përcaktim etimologjik ka dalë jobindëse. Gjithsesi, rëndësia e qartë qendrore e këtij koncepti i ka detyruar studiuesit të shqyrtojnë përdorimin e kësaj fjale në përpjekje për t’i përcaktuar kuptimin funksional.

Besëlidhja është mjeti me të cilin Perëndia i vetëm dhe i vërtetë përcakton marrëdhënien e tij me krijesat njerëzore. Koncepti i besëlidhjes, traktatit, ose marrëveshjes, është thelbësor për të kuptuar zbuluesin biblike. Tensioni mes sovranitetit të Perëndisë dhe vullnetit të lirë njerëzor shihet qartë në konceptin e besëlidhjes. Disa besëlidhje bazohen kryekëput në karakterin dhe veprimet e Perëndisë

1. Vetë krijimi (shih Zan. 1-2)
2. Thirrja e Abrahamit (shih Zan. 12)
3. Besëlidhja me Abrahamin (shih Zan. 15)
4. Ruajtja e Noeut dhe premtimi për të (shih Zan. 6-9)

Sidoqoftë, nga vetë natyra, besëlidhja kërkon një përgjigje

1. Me anë të besimit, Adami duhet t’i bindet Perëndisë dhe të mos hajë nga pema në mes të Edenit
2. Me anë të besimit, Abrahami duhet të lërë familjen, të ndjekë Perëndinë dhe të besojë në brezat e ardhshëm
3. Me anë të besimit, Noeu duhet të ndërtojë një barkë të stërmadhe lar nga uji dhe të mbledhë kafshët
4. Me anë të besimit, Moisiu i nxori izraelitët nga Egjipti deri në malin Sinai dhe mori udhëzime të qarta për jetën fetare dhe shoqërore, bashkë me premtimet e bekimit dhe mallkimit (shih LiP. 27-28)

I njëjti tension, që bën fjalë për marrëdhënien e Perëndisë me njerëzimin, përfshihet edhe në konceptin e “besëlidhjes së re”. Ky tension mund të shihet qartë kur krahason Ezek. 18 me Ezek. 36:27-37 (veprimi i JHVH). A bazohet kjo besëlidhje në veprimet e hirshme të Perëndisë, apo në reagimin e detyrueshëm njerëzor? Kjo është çështja kyçe në Besëlidhjen e Vjetër dhe atë të Re. Synimet e të dyjave janë të njëjta:

1. ripërtëritja e bashkësisë me JHVH-në humbet në Zan. 3; dhe
2. formimi i njerëzve të drejtë që pasqyrojnë karakterin e Perëndisë.

Besëlidhja e re e Jer. 31:31-34 e zgjidh tensionin duke larguar veprimin njerëzor si mjet për të arritur

pranimin nga Perëndia. Ligji i Perëndisë bëhet dëshirë e brendshme, jo kod i jashtëm ligji. Synimi për formimin e një populli të perëndishëm dhe të drejtë mbetet i njëjti, por metodologjia ndryshon. Njerëzimi i rënë e ka provuar vetën të paaftë për të qenë pasqyrimi i përsosur i shëmbëllimit të Perëndisë. Problemi s' ishte te besëlidhja e Perëndisë, por te mëkati dhe dobësia e njeriut (shih Rom. 7; Gal. 3).

I njëjti tension mes besëlidhjeve të pakushtëzuara dhe atyre të kushtëzuara në DHV mbetet edhe në DHR. Shpëtimi është kryekëput falas për shkak të veprës së përfunduar të Jezus Krishtit, por kërkon pendim dhe besim (si në fillim, ashtu dhe në vijimësi). Bëhet fjalë, si për një deklaratë ligjore, ashtu dhe për një thirrje për të qenë si Krishti, një shpallje e pranimit nga Perëndia, por edhe një urdhër për shenjtëri! Besimtarët nuk shpëtohen nga veprat e tyre, por gjithsesi shpëtohen për të treguar bindje (shih Efe. 2:8-10). Jeta e perëndishme bëhet prova e shpëtimit, jo mjete i tij. Sidoqoftë, jeta e përjetshme ka disa tipare të vrojtueshme! Ky tension shihet qartë në letrën e Hebrenjve.

■ **“që derdhet për shumë vetë”** Vdekja e Jezusit, e simbolizuar nga derdhja e gjakut të tij, ishte fljijim për mëkatin (shih Marku 10:45; Mat. 26:28; 1 Kor. 15:3; 2 Kor. 5:21; Heb. 9:11-15). Fjala “shumë” nuk i referohet një grupi të kufizuar, por është metaforë hebraike (ose semite) për “gjithë ata që përgjigjen me besim”. Kjo mund të shihet në paralelizmin e Rom. 5:18 me 5:19, si dhe në Isa. 53:6, ku “të gjithë” paralelizohet nga 53:11-12, “shumë”. Shih shënimin në Marku 10:45.

TEMË E VEÇANTË: “DERDHET” (DHR) (SPECIAL TOPIC: POURED OUT [NT])

Fjala *heo* në greqishten klasike do të thotë “derdh” (zakonisht, në kuptimin e fjalëpërfjalshëm). Forma e përforcuar, *ekheo*, e zëvendësoi më vonë dhe zhvilloi dy ngjyime kuptimore.

1. derdhja e gjakut të pafajshëm (Zan 9:6; 37:22; LiP. 19:10; Mat. 23:35; Veprat 22:20; Rom. 3:15)
2. dhënia e flisë (Gjyq. 6:20; 1 Sam. 7:6; 2 Sam. 23:16; Mat. 26:28; Marku 14:24; Luka 22:20)

Në Jezusin këto dy kuptime u bashkuan në Kalvari (shih Colin Brown, red., *The New International Dictionary of New Testament Theology*, vëll. 2, f. 853-855).

Bibla e përdor këtë FOLJE edhe në lidhje me

1. derdhjen e Frymës së Shenjtë (shih Joeli 2:28-29; Ezek. 39:29; Zak. 12:10; Veprat 2:17-18, 33; 10:45; Titit 3:6)
2. dashurinë e Perëndisë (shih Rom. 5:5; vini re paralelizmin teologjik në Gal. 4:6)
3. zemërimin e Perëndisë (shih Zbulesa 16; aty, kjo FOLJE përdoret tetë herë)

14:25 “nuk do të pi më kurrë” Liturgjia e Pashkës përdorte katër kupa bekimi. Rabinët e kishin përcaktuar këtë procedurë në bazë të Eks. 6:6-7. Kupa e tretë simbolizonte shpengimin. Kjo është kupa që përbën bazën e Darkës së Zotit. Jezusi nuk pranoi ta pinte kupën e katërt të bekimit për shkak se ajo simbolizonte përmbushjen. Jezusi e lidhi këtë me gostinë mesianike në kohët e fundit (shih Isa. 25:6; 55; Mat. 8:11; Luka 13:29; 14:15, 24; 22:30; Zbu. 19:9, 17).

■ **“deri ditën”** Qartazi, bëhet fjalë për kthimin e ardhshëm të Jezusit në lavdi dhe pushtet, që ishte shumë e ndryshme nga situata e atëhershme, kur ai përballëj me turpin, dhimbjen, refuzimin dhe vdekjen! Dy ardhjet e Jezusit bëjnë dallimin mes detyrave të tij si shpengues (pra, shlyerja zëvendësuese) dhe si fitimtar/gjykatës. Kjo ardhje e dyfishtë i gjeti të papërgatitur judenjtë. Ndoshta, ishte vetë Jezusi, në rrugën e Emeut, që u tregoi dishepujve domethënien e plotë të pasazheve kyçe nga DHV (shih Zan. 3:15; Psa. 22; Isa. 53; dhe Zak. 9-14).

■ **“mbretërinë e Perëndisë”** Shih Temën e Veçantë në Marku 1:15c.

TEKSTI I NASB (I PËRDITËSUAR): MARKU 14:26

²⁶Pasi kënduan një himn, dolën për te mali i Ullinjve.

14:26 “kënduan një himn” Kjo folje greke është burimi i fjalës anglisht “hymn”. Ndoshta, ishte pjesë Psalmeve Halel (pra, Psa. 113-118; Mat. 26:30), që ishte pjesa e fundit e ritualit të Pashkës. Këto psalme ishin shprehje

gëzimi dhe mirënjohjeje për shpengimin e JHVH-së. Ato recitoheshin ose këndoheshin të plota, ose pjesërisht, në të gjitha festat kryesore, përveç Ditës së Shlyerjes. Psalmet 113-114 këndohen nga fillimi i vaktit të Pashkës ndërsa 115-118 nga fundi i vaktit.

■ **“mali i Ullinjve”** Jezusi dhe dishepujt duhet ta kenë përdorur vazhdimisht si vend kampimi ose vend lutjeje gjatë periudhës së Pashkës (pra, për tetë ditë).

TEKSTI I NASB (I PËRDITËSUAR): MARKU 14:27-31

²⁷Dhe Jezusi u tha: **“Ju të gjithë do të rrëzoheni, sepse është shkruar: ‘do ta godas bariun dhe delet do të shpërndahen’.** ²⁸Por, pasi të jem ngritur, do të shkoj para jush në Galile”. ²⁹Por Pjetri i tha: **“Edhe sikur të gjithë të rrëzohen, unë, jo”.** ³⁰Dhe Jezusi i tha: **“Me të vërtetë po të them, se pikërisht këtë natë, përpara se gjeli të këndoje dy herë, ti vetë do të më mohosh tri herë”.** ³¹Por Pjetri vazhdoi t’i thoshte me këmbëngulje: **“Edhe sikur të më duhet të vdes me ty, nuk do të të mohoj!”** Dhe të gjithë po thoshin të njëjtën gjë.

14:27

NASB, NJB **“Ju të gjithë do të rrëzoheni”**
NKJV **“Të gjithë ju do të pengoheni”**
NRSV **“Të gjithë ju do të bëheni dezertorë”**
TEV **“Të gjithë ju do të largoheni me vrap”**

Kjo është dëftore e ardhme pësore. Është tjetër provë se Jezusi njeh dhe kontrollon ngjarjet e ardhshme. Ideja pësore rroket më së miri nga përkthimi i ASV, “të gjithë ju do të fyheni” (pra, *skandalizo*, që përdorej për shkopinj të që përdorëshin si karrem). Ka dhe një të ardhme të dytë pësore, “do të shpërndaheni”, nga Zak. 13:7. E njëjta terminologji për mosbesimin (pra, “rrëzohem”) përdorej edhe për të tjerët që refuzonin Krishtin (shih Mat. 11:6; 13:21, 57; 24:10; 26:31). Besimi i dishepujve do të dështonte! Mohimet e Pjetrit ishin thjesht shembull i frikës së gjithë të tjerëve.

■ **“është shkruar”** Fjalë për fjalë, “ka qenë shkruar”, që është dëftore e kryer pësore. Ishte fraza karakteristike (pra, habraike) që i referohej DHV së frymëzuar.

■ **“do ta godas”** Ky është citim nga Zak. 13:7. Ishte plani i Atit që Jezusi ta jepte jetën si fljirim për mëkatën (shih Isa. 53:4,6,10; Marku 10:45; Luka 22:22; Veprat 2:23; 3:18; 4:28; 13:29; 2 Kor. 5:21).

14:28 Jezusi ua tha disa herë dishepujve se do t’i takonte në një mal në Galile (shih Mat. 26:32; 28:7, 10, 16). Ky takim i veçantë ishte rasti për t’u dhënë Porosinë e Madhe (shih Mat. 28:16-20), që ishte ndoshta shfaqja pas ringjalljes që përmendet në 1 Kor. 15:6. Nuk bëhet fjalë për ngritjen e Jezusit në qiell, që ndodhi në malin e Ullinjve dyzet ditë pas ringjalljes (shih Veprat 1:12).

Ky ishte profetizim i ringjalljes së tij, por ata nuk ia dallonin domethënien. Kjo frazë është rast i shkëlqyer për të treguar se, shpesh, DHR ua atribuon veprën e shpengimit të tre personave të Trinisë.

1. Perëndia Atë ringjalli Jezusin (shih Veprat 2:24; 3:15; 4:10; 5:30; 10:40; 13:30,33,34,37; 17:31; Rom. 6:4,9; 10:9; 1 Kor. 6:14; 2 Kor. 4:14; Gal. 1:1; Efe. 1:20; Kol. 2:12; 1 Thes. 1:10).
2. Perëndia Bir u ringjall vetë (shih Gjoni 2:19-22; 10:17-18)
3. Perëndia Frymë ringjalli Jezusin (shih Rom. 8:11). I njëjti theks trium mund të shihet dhe në Marku 14:9-10. Shih Temën e Veçantë: Trinia në Marku 1:11.

14:29 “Edhe sikur” Fjalë për fjalë “edhe nëse” (shih NKJV dhe NJB). Është fjali kushtore e rendit të parë, që merret si e vërtetë nga pikëvështrimi i autorit ose për qëllimet e tij letrare. Pjetri arrinte ta përfytyronte që të tjerët mund t’ia mbathnin, por ai vetë jo!

■ **“unë jo”** Këtu kemi lidhëzën e fortë kundërshtore, *alla* (por). Pjetri po thoshte prerazi se nuk do ta braktiste kurrë Jezusin (shih Luka 22:33; Gjoni 13:37-38). Ai po shpallte publikisht një betim që nuk mund dhe nuk do ta përmbushte dot! Dëshirën e kishte më të fortë se aftësinë!

14:30 “pikërisht këtë natë, përpara se gjeli të këndojë dy herë, ti vetë do të më mohosh tri herë” “Ti vetë” është e theksuar! Kjo është dëftore e ardhme mesore. Rrëfimi i Lukës është më i gjatë (shih Marku 22:31-34). Hollësia se gjeli do të këndojë dy herë është dëshmi okulare e Pjetri. Shënohet vetëm në ungjillin e Markut.

14:31

NASB “vazhdoi t’i thoshte me këmbëngulje”

NKJV “foli edhe më me zjarrmi”

NRSV “tha me zjarrmi”

TEV “u përgjigj edhe më fort”

NJB “e përsëriti edhe më me zell”

Kjo fjalë (*perisseia*), që nënkupton tepri ose shkallë të skajshme, përdoret shpesh në forma të ndryshme në DHR (shih Mat. 5:20; 27:23; Veprat 26:11; Fil. 1:9; 1 Thes. 4:1). Forma e përforcuar, me parashtesën parafoljore *ek*, gjendet vetëm në Marku. Ndoshta, e përdorte vetë Pjetri! Atij i kujtohej sa fort e kishte mohuar mundësinë e braktisjes së Jezusit!

▣ **“Edhe sikur”** Kjo është fjali kushtore e rendit të tretë, që nënkupton veprim të mundshëm. Fjalë për fjalë: “edhe sikur të duhet të ndodhë”.

▣ **“nuk do të të mohoj”** Pjetri ndihej vërtet ashtu. Me gjithë zemër dhe vullnet, ai ishte i vendosur që të qëndronte përkrah Jezusit! Ashtu si mëkatet dhe falja e mëvonshme e Davidit shërbejnë që t’i inkurajojnë besimtarët e mëvonshëm, kështu duhet të ndodhë edhe me përbetimet dhe dështimet e Pjetrit. Njerëzit e mëkatshëm dhe të dobët duan të bëjnë gjënë e duhur (shih Rom. 7), por e kuptojnë se janë të paafte që t’ia dalin! Jezusi e fal dështimin, por jo mosbesimin e papenduar.

TEKSTI I NASB (I PËRDITËSUAR): MARKU 14:32-42

³²Erdhën në një vend që quhej Gjetseman; dhe ai u tha dishepujve: “Uluni këtu derisa të jem lutur”. ³³Dhe mori me vete Pjetrin, Jakobin dhe Gjonin, dhe filloi të ndihej shumë i shqetësuar dhe i trazuar. ³⁴Dhe u tha atyre: “Shpirti im është thellësisht i trishtuar deri në vdekje; qëndroni këtu dhe rrini zgjuar”. ³⁵Dhe shkoi pak më tutje tyre, ra përtokë dhe nisi të lutej që, nëse ishte e mundur, kjo orë të kalonte prej tij. ³⁶Dhe po thoshte: “Abba! Atë! Të gjitha gjërat janë të mundshme për ty; largoje këtë kupë prej meje; megjithatë, jo siç dua unë, por siç do ti”. ³⁷Dhe erdhi e i gjeti në gjumë, dhe i tha Pjetrit: “Simon, në gjumë je? As një orë nuk rrije dot zgjuar?” ³⁸Vazhdoni të rrini zgjuar dhe të luteni që të mos bini në tundim; shpirti është i gatshëm, por mishi është i dobët”. ³⁹Sërish u largua dhe u lut, duke thënë të njëjtat fjalë. ⁴⁰Dhe, sërish, erdhi e i gjeti në gjumë, sepse i kishin sytë shumë të rënduar; dhe nuk e dinin si t’i përgjigjeshin. ⁴¹Dhe erdhi për herë të tretë dhe u tha: “Ende po flini dhe po pushoni? Mjafton; ora ka ardhur; ja, Biri i Njeriut po tradhtohet në duart e mëkatarëve. ⁴²Ngrihuni, le të ikim; ja, ai që më tradhton është afër!”

14:32 “Gjetseman” “Gjetseman” do të thotë “shtypëse ulliri” në hebraisht. Me sa duket, ishte një kopsht privat jashtë kufijve të qytetit të Jerusalemit në malin e Ullinjve. Ishte e paligjshme të kishe kopshtije brenda qytetit pasi plehu që nevojitej për bimët do ta bënte qytetin të papastër ceremonialisht. Me sa duket, Jezusi vinte shumë shpesh në këtë kopsht. Madje, ka mundësi që, gjatë javës së Mundimit, ta ketë patur aty kampin me dishepujt e tij. Juda e njihte mirë si vend.

▣ **“Uluni këtu derisa të jem lutur”** Në pasazhet paralele të Mat. 26:41 dhe Luka 22:40, Jezusi iu kërkon të lutet që të mos bien në tundim.

14:33 “Mori me vete Pjetrin, Jakobin dhe Gjonin” Ky ishte rrethi i ngushtë i udhëheqjes brenda dishepujve. Ata ishin të pranishëm me Jezusin në disa raste të veçanta, kurse dishepujt e tjerë, jo. Me sa duket, kjo çoi dhe në trajnim të veçantë, por edhe në xhelozitë nga ana e dishepujve të tjerë. Saktësisht pse Jezusi e kishte këtë rreth të ngushtë është e paqartë. Lista e të Dymbëdhjetëve jepet gjithmonë në katër grupe treshe. Grupet nuk ndryshojnë kurrë. Ka gjasa që grupet të kenë formuar një axhendë me rotacion, në mënyrë që dishepujt të shkonin periodikisht në shtëpi për të parë si e kishin familjen. Shih Temën e Veçantë në Marku 3:16.

NASB “filloi të ndihej shumë i shqetësuar dhe i trazuar”
NKJV “nisi të shqetësohej dhe të ndiente ankth të thellë”
NRSV “nisi të shqetësohej dhe të kishte ankth”
TEV “E mbërtheu shqetësimi dhe ankthi”
NJB “nisi të ndiente tmerr dhe ankth”

Jezusi ishte në gjendje të thellë ankthi! Këto janë fjalë të forta në greqisht. Si lexues të sotëm, jemi në vend shumë të shenjtë këtu në kopsht, kur shohim Birin e Perëndisë në çastin e tij më të dobët nga ana njerëzore. Jezusi duhet t’ua ketë treguar këtë ndodhi dishepujve pas ringjalljes. Me sa duket, qëllimi ishte që t’i ndihmonte ata që përballen me tundime dhe ata që përpiqen të kuptojnë agoninë dhe çmimin e përjetimit të Kalvarit nga ana e Jezusit.

▣ **“Shpirti im është thellësisht i trishtuar deri në vdekje”** Kjo është një thënie jashtëzakonisht e qartë, që për habi shpreh shqetësim, frikë dhe trishtim nga ana e Jezusit. Ndonëse vetë pasazhi nuk na e jep arsyen, duket se Jezusi i druhej ndërprerjes së marrëdhënies së ngushtë që kishte patur gjithmonë me Atin. Kjo karakterizohet nga fjalët e Jezusit në Marku 15:34. Kjo është një nga çastet më njerëzore që na lejohej të dëshmojmë në lidhje me betejën e besimit të Jezusit.

Kjo ishte shprehje e Dhiatës së Vjetër (shih Psa. 42:5), që shprehet intensitetin e jashtëzakonshëm që nevojitej për shpengimin e njerëzimit mëkatar. Gjithë Psalmi 42 reflekton përvojën e refuzimit dhe vdekjes së Jezusit, njësoj si te Psalmi 22. Një pjesë e kësaj beteje mund të shihet në pasazhin paralel të Lukës 22:43-44 (ndonëse UBS4 e vlerëson heqjen e këtyre vargjeve si “A” [e sigurt]), që tregon se një engjëll erdhi t’i shërbente atij dhe se Jezusi djersiti pika të mëdha gjaku. Fitorja mbi të ligun u fitua këtu, në kopsht. Dinakëria e tundimit të Satanit në Matu 4 dhe komenteve gjoja të dobishme, por realisht tejet shkatërruese, në Mat. 16:22, zbulohen plotësisht në këtë pasazh.

▣ **“qëndroni këtu dhe rrini zgjuar”** Kjo është urdhërore aoriste veprorë, e ndjekur nga një urdhërore e tashme veprorë. Ata ishin me detyrë si roje, që të vigjëlonin kur të vinte Juda dhe turma, por i zuri gjumi!

14:35 “ra përtokë dhe nisi të lutej” Këto janë dy folje të pakryera. Zakonisht, kjo kohë nënkupton veprimin e vazhduar në kohën e shkuar, por është e qartë se nuk mund të kenë këtë kuptim këtu. Përdorimi tjetër tipik i kësaj kohe foljore në greqisht ishte fillimi i një veprimi në të shkuarën. Lutja i shtrirë përtokë tregon ndjenja të forta.

14:35 “nëse ishte e mundur” Kjo është kushtore e rendit të parë, që merret si e vërtetë nga pikëvështrimi i autorit. Jezusi e dinte se JHVH ishte në gjendje të bënte gjithçka (shih Marku 14:36, “të gjitha gjërat janë të mundshme për ty!”).

▣ **“orë”**

TEMË E VEÇANTË: ORA (SPECIAL TOPIC: THE HOUR)

Termi “orë” përdoret në disa mënyra të ndryshme në ungjijtë, si

1. referencë kohore (shih Mat. 8:13; Luka 7:21; Gjoni 11:9)
2. metaforë për një periudhë sprove dhe sprovimi (shih Mat. 10:19; Marku 13:11; Luka 12:12)
3. metaforë për fillimin e shërbesës së Jezusit (shih Gjoni 2:4; 4:23)
4. metaforë për ditën e gjykimit (pra, Ardhja e Dytë, Mat. 24:36,44; 25:13; Marku 13:32; Gjoni 5:25,28)
5. metaforë për mundimin e Krishtit (shih Mat. 26:45; Marku 14:35,41; Gjoni 7:30; 8:20; 12:23,27; 13:1; 16:32; 17:1)

▣ **“kjo orë të kalonte prej tij”** Kjo është lidhore aoriste veprorë. Jezusi po thotë se JHVH është në gjendje të bëjë gjithçka dhe Jezusi po shpreson që t’i kursehet kryqi (shih Marku 14:36). Ky ishte pikërisht tundimi i Satanit në shkretëtirë, shih James Stewart, *The Life and Teaching of Jesus Christ*, f. 39-46). Nga Mat. 26:39, 42 dhe 44, dhe Marku 14:39, 41, mësojmë se Jezusi e bëri këtë lutje tri herë, që ishte mënyra judaike për të theksuar diçka.

14:36 “Abba” Kjo është fjalë aramaisht, që përdoret nga fëmijët kur iu drejtoheshin baballarëve në shtëpi: babi, ba, etj. Jezusi kishte marrëdhënie të ngushtë me JHVH (shih Heb. 1:2; 3:6; 5:8; 7:28). Vdekja e tij na e siguron dhe neve këtë marrëdhënie të ngushtë.

Ky kontekst është e vetmja herë që përdoret fjala aramaisht *Abba* (pra, në tekstin greqisht) nga Jezusi. Jezusi zbulon betejën e ashpër me të cilën përballë në këtë çast tundimi njerëzor (pra, përshkruan ndjenjat e tij të forta; ra përtokë; u lut tri herë). Këtu, ai luajti kartën e fundit, shansin e fundit për t’ia ndryshuar Atit mendjen për Kalvarin. E thërret JHVH-në me këtë fjalë tejet të ngushtë familjare! Por, megjithatë, çdo lutje e përmyll me fjalët “jo vullneti im, por yti”. Perëndia atë e tregon dashurinë e vet për njerëzimin e rënë duke mos iu përgjigjur vullnetit të shprehur të Jezusit. Ishte e domosdoshme të kryhej fljimi absolut për mëkatën, por nuk ishte diçka e lehtë dhe pa kosto të lartë, emocionale apo fizike, si për Jezusin ashtu dhe për Atin!

Jezusi na njeh, sepse i njeh të gjitha tundimet e njerëzimit (por pa mëkatuar). Frika, tmerri, dekurajimi dhe zhgënjimi **nuk** janë mëkate! Fitorja u korr në Gjeteaman.

■ **“Atë”** Ungjilli i Markut, shpesh, përdor fjalë dhe fraza aramaisht (shih Marku 3:17; 5:41; 7:34; 14:36; 15:34). Aramaishtja ishte gjuha e folur e Jezusit dhe dishepujve. Marku i përkthen të gjitha këto, gjë që tregon se nuk po shkruante për lexuesit judenj, por për ata johebrenj, ndoshta për romakët, për shkak të të gjitha fjalëve dhe frazave latine që gjenden në Marku. Shih Temën e Veçantë: Ati në Marku 13:32.

■ **“këtë kupë”** Kjo ishte metaforë e DHV për fatin e njeriut (shih Psa. 16:5; 23:5; Jer. 51:2; Mat. 20:22). Zakonisht, përdoret në kuptimin gjykues (pra, negativ) (shih Psa. 11:6; 75:8; Isa. 51:17, 22; Jer. 25:15-16, 27-28; 49:12; Vaj. 4:21; Ezek. 23:31-33; Hab. 2:16). Shpesh, kjo fjalë shoqërohet me dehjen, që është një tjetër metaforë e DHV për gjykimin (shih Jobi 21:20; Isa. 29:9; 63:6; Jer. 25:15-16, 27-28). Jezusi dëshiron ta shmangë! Frika nuk është mëkat. Ai u përball me frikën me besim; kështu duhet të bëjmë ne!

■ **“megjithatë, jo siç dua unë, por siç do ti”** Përemrat “unë” dhe “ti” janë në pozicionin e theksuar në greqisht. Ky ishte nënshtrimi i vazhdueshëm i Jezusit ndaj vullnetit të Atit. Në këtë kontekst, natyra e vërtetë njerëzore dhe besimi i vërtetë shkëlqejnë fort! Ndonëse natyra e tij njerëzore bërtet të çlirohet, zemra e tij është e vendosur të përmbushë vullnetin e Atit me anë të shlyerjes zëvendësuese (shih Marku 10:45; Mat. 26:39).

14:37, 40 “i gjeti në gjumë” Këta dishepuj kishin fjetur edhe gjatë Shndërrimit në mal (shih Mat. 26:43; Luka 9:32). Ata nuk ishin të ligj apo të pamend, por ishin njerëzorë! Përpara se të tregohemi të nxituar dhe t’i dënojmë dishepujt, le të vërejmë se, në Luka 22:45, fraza “ishin të përgjumur nga trishtimi” përshkruan faktin se ata ishin të paafte ta përballonin dhimbjen e profetizimit të Jezusit për vdekjen e tij dhe për shpërndarjen tyre të mëvonshme. Ndonëse Jezusi kishte dëshirë të fortë për të patur mbështetje dhe ndërmjetësim njerëzor në këtë kohë krize maksimale në jetën e tij, i duhej që këtë çast ta përballonte i vetëm; dhe u përball me të për gjithë besimtarët!

14:37 “Simon” Kjo është e vetmja herë që Jezusi e quan “Simon” që kur i kishte dhënë emër tjetër në Marku 3:16. Shkëmbi (pra, Pjetri) s’ishite aspak i patundur, i sigurt dhe i besueshëm. Pjetrit duhet t’i jetë kujtuar me dhimbje të madhe ky rikthim te emri i vjetër. Jam i sigurt se e mori mesazhin!

14:38 “Vazhdoni të rrii zgjuar dhe të luteni” Kjo është urdhërore e tashme veprare dhe urdhërore e tashme mesore (deponente). Konteksti i mëposhtëm na zbulon armikun.

■ **“që të mos bini në tundim”** Ka patur disa teori se për çfarë bën fjalë “tundimi” në këtë kontekst:

1. profecia e Jezusit në Marku 14:27
2. për faktin se dishepujt po flinin në vend që të luteshin, Marku 14:37, 40
3. për braktisjen e Jezusit nga dishepujt në Marku 14:56
4. për mohimin e Pjetrit në Marku 14:69-75
5. për sprovat nga qeveritarët ose sprovat fetare (shih Mat. 5:10-12; Gjoni 9:22; 16:2)

Termi “tundim” (*peirasmos*) kishte ngjyrimin kuptimor: “tundoj, ose përpiqem me synim që ta shkatërroj filanin” (shih Mat. 6:13; Luka 11:4 Jakobi 1:13). Shpesh, ai kontrastohet me një tjetër fjalë greke për sprovimin (*dokimazo*), që kishte ngjyrimin kuptimor: “sprovaj ose tundoj me qëllim që ta forcoj filanin”. Megjithatë, këto

ngjyrimet nuk janë gjithmonë të pranishme në çdo kontekst. Teologjikisht, mund të thuhet se Perëndia nuk i sprovon ose tundon fëmijët e vet që t'i shkatërrojë, por u siguron mundësi për rritje shpirtërore përmes sprovave (shih Zan. 22:1; Eks. 16:4; 20:20; LiP. 8:2, 16; Mat. 4; Luka 4; Heb. 5:8). Megjithatë, ai na siguron gjithmonë një rrugëdalje (shih 1 Kor. 10:13). Shih Temën e Veçantë: Fjalët greke për sprovimin në Marku 1:13.

■ **“shpirti është i gatshëm, por mishi është i dobët”** Ky mund të jetë koment për fjalët e Pjetrit dhe dishepujve të tjerë në Marku 14:29, 31. Jezusi e kupton plotësisht këtë tension (shih Marku 14:36). Përdorimi i fjalës “shpirt” në lidhje me shpirtin e njeriut bën fjalë për jetën tonë të brendshme dhe me mendimet tona (shih Psa. 51:10, 12, 17).

Në shkrimet e Palit, “shpirti” shpesh kontrastohet me “mishin” (shih Rom. 8:1-11).

14:40 “nuk e dinin si t’i përgjigjeshin” S’kishin arsye të shpjegueshme (shih Marku 9:6) përveç dobësisë së mishit (shih Luka 9:32).

14:41 “Ende po flini dhe po pushoni” Është e vështirë ta interpretosh këtë idiomë greke. A është pyetje? Është ironi? Apo është pohim? Ndonëse kuptimi është i paqartë, kuptohet se Jezusi e ka korrur fitoren dhe tani qëndron drejt, i gatshëm të përballet me sprovat e natës, rrahjet në mëngjes dhe kryqëzimin.

■ **“Mjafton”** Kjo fjalë shkaktoi disa ndryshime nga kopjuesit në traditën e dorëshkrimeve greke. Mos, ndoshta, kjo frazë bën fjalë për gjumin e dishepujve? Mund të përkthehet (1) “mjafton”; (2) “është përfunduar”; ose (3) “ka marrë fund” (shih NJB “ka marrë fund gjithçka”). Në papiruset e greqishtes koine, që janë gjetur në Egjipt, kjo fjalë përdorej kur diçka paguhej plotësisht (shih Moulton dhe Milligan, *The Vocabulary of the Greek New Testament*, f. 57-58). Kështu, kjo mund të jetë paralele me Gjonin 19:30, “ka përfunduar”, ose “është paguar plotësisht”. Ndoshta, bën fjalë për Judën dhe për tradhtinë e tij, që duhet ta ketë trishtuar së tepërmi Jezusin. Jezusi e korri fitoren shpirtërore në Gjetseman!

14:41c-42 Këto thënie të palidhura me njëra-tjetrën theksohen nga fakti se nuk përmbajnë lidhëza (janë *asyndeton*) mes tyre. Ngjarjet po shpaloseshin pikërisht siç e kishte parashikuar Jezusi. Ora kishte ardhur.

■ **“ora ka ardhur”** Shih Temën e Veçantë në Marku 14:35.

■ **“tradhtohet”** Kjo fjalë (*paradidomi*), normalisht, ka kuptimin “dorëzohem në duart e” (shih Marku 9:31), por lidhja e saj me Judën bën që shumica e përkthimeve anglisht ta përkthejnë me kuptimin e përforcuar “tradhtoj”. Shih shënimin e plotë në Marku 14:10d.

TEKSTI I NASB (I PËRDITËSUAR): MARKU 14:43-50

⁴³Menjëherë, ndërsa Jezusi ende po fliste, Juda, një nga të dymbëdhjetët, erdhi i shoqëruar nga një turmë me shpata dhe shkopinj, të cilët kishin ardhur nga krerët e priftërinjve, skribët dhe pleqtë. ⁴⁴Ai që po e tradhtonte Jezusin u kishte dhënë një sinjal duke u thënë: “Këdo që të uth, ai është; kapeni dhe largojeni me roje”. ⁴⁵Pasi erdhi, Juda menjëherë shkoi tek ai dhe i tha: “Rabin!” dhe e uthi. ⁴⁶Ata vunë duart mbi të dhe e kapën. ⁴⁷Por njëri prej atyre që rrinte përbri nxori shpatën, goditi skllavin e kryepriftit dhe ia preu veshin. ⁴⁸Dhe Jezusi i tha: “Keni dalë me shpata dhe shkopinj që të më arrestoni, si të isha kusar? ⁴⁹Çdo ditë isha me ju në tempull duke dhënë mësim, dhe ju s’më kapët; por kjo ka ndodhur që të përmbushen Shkrimet”. ⁵⁰Dhe të gjithë ata e lanë dhe ia mbathën.

14:43 “Menjëherë” Shih shënimin në Marku 1:10.

■ **“një turmë”** Gjoni 18:3, 12, thotë se ishte e pranishme një kohortë romake. Luka 22:52 thotë se në turmë ishin përfaqësues të Sinedrit, gjë që nënkupton policinë e tempullit. Arsyeja pse kishte kaq shumë ushtarë ishte se ishte sezoni i Pashkës dhe autoritetet i druheshin ndonjë revolte (shih Marku 14:2; Mat. 26:5; 27:24).

■ **“shpata dhe shkopinj”** Kjo fjalë, “shpata”, nënkuptonte shpatën e shkurtër që e mbanin ushtarët romakë në brez. “Shkopinjte” bën fjalë në mënyrë të veçantë për armët e policisë së tempullit.

▣ **“krerët e priftërinjve, skribët dhe pleqtë”** Bëhet fjalë për Sinedrin. Shih Temën e Veçantë në Marku 12:13.

14:44 “kapeni” Kjo është urdhërore aoriste veprore.

NASB, NRSV

TEV “largojeni me roje”

NKJV “largojeni të sigurt”

NJB “kujdesuni që ta ruajnë mirë kur ta largoni”

Kjo është fjala greke *sfallomai* (“rrezohem, ose pengohem”) me alfa mohuese, pra, që e mohon veprimin. Kjo fjalë është metaforë për “jam i sigurt, i patundur, i qëndrueshëm”. Juda kishte frikë se os Jezusi bënte diçka për t’i shpëtuar arrestimit. Kjo zbulon frikën e Judës. Ai kishte parë mrekullitë e Jezusit dhe ia njihte fuqinë.

14:45 “i tha, ‘Rabin!’ dhe e puthi” Puthja në faqe ose në ballë ishte përshëndetja normale në këtë kulturë (sidomos mes rabinëve). Lexo komentet e Jezusit për veprimet e Judës në Mat. 26:50; Luka 22:48. Kjo shenjë tregon se bëhej fjalë për ushtarë romakë, pasi policia e tempullit do ta kishte njohur Jezusin.

14:47 “Por njëri prej atyre që rrinte përbri nxori shpatën” Nga pasazhi paralel në Gjoni 18:10 dhe Luka 22:50-51, e dimë se ky ishte Pjetri, ndërsa shërbëtori që u plagos quhej Malkus. Jezusi i kishte nxitur më parë dishepujt që të blinin shpata (shih Luka 22:36-38), por, me sa duket, ata e kishin keqkuptuar mendimin e vërtetë të Jezusit në lidhje me këtë çështje. Në mbrojtje të Pjetrit, duhet pranuar se ai ishte plotësisht i gatshëm që të vdiste për Zotin e tij në atë çast. Ndonëse përballë një numri tepër të madh ushtarësh, ai nxori njërin nga dy shpatat. Por, sërish, personaliteti i tij karakterizohej nga vendimet e pavenda dhe të nxituara.

▣ **“skllavin e kryepriftit”** Gjoni 18:10 e quan Malkus.

▣ **“skllavinia preu veshin”** Në Luka 22:51, Jezusi ia vendosi prapë veshin në vend!

14:48

NASB, NKJV “kusar”

NRSV, NJB “bandit”

TEV “kriminel”

Ata po e trajtojnë Jezusin si kriminel, jo si blasfemues. Po i bënë Jezusit atë që duhet t’ia kishin bërë Barabës (për të cilin përdoret e njëjta fjalë, shih Gjoni 18:40).

14:49 “Çdo ditë isha me ju në tempull duke dhënë mësim” Kjo u drejtohej anëtarëve të Sinedrit, ose policisë së tempullit. Jezusi ua nxjerr në shesh planin e fshehtë.

▣ **“por kjo ka ndodhur që të përmbushen Shkrimet”** Në Marku 14:50, “gjithë dishepujt e braktisën” (shih Marku 14:27, që citon Zak. 13:7 dhe Mat. 26:31). Nuk e dimë sesi përputhet me këtë profeci Gjoni 18:15-16. Me sa duket, Gjoni e shoqëroi Jezusin në të gjitha gjyqet dhe ishte i pranishëm në kryqëzim (shih Gjoni 19:26-27).

TEKSTI I NASB (I PËRDITËSUAR): MARKU 14:51-52

⁵¹Një djalë po e ndiqte, i mbështjellë vetëm me një çarçaf mbi trupin e tij të zhveshur; dhe ata e kapën. ⁵²Por ai e la çarçafin dhe u arratis lakuriq.

14:51-52 “djalosh... i mbështjellë vetëm me një çarçaf mbi trupin e tij të zhveshur” Tradita e kishës thotë se ky ishte Gjon Marku, shkruesi i këtij ungjilli. Ai ishte shoqëruar i hershëm misionar i xhaxhait të vet, Barnabës (shih Veprat 12:25), dhe i Saulit (Palit) të Tarsit. Tradita kishtare shprehet qartë se ai ishte kopjues i kujtimeve të Pjetrit për jetën e Jezusit (ndaj shkroi ungjillin e Markut). Po kështu, sipas traditës, Darka e Zotit u mbajt në shtëpinë e tij (shih Veprat 12:12).

Është e paqartë pse ishte veshur kështu. Ndoshta po flinte dhe dikush i tha se Jezusin po e arrestonin, ose ndoshta, ngaqë përpiqej t’u qëndronte pranë Jezusit dhe dishepujve, po flinte diku aty afër në kopsht.

TEKSTI I NASB (I PËRDITËSUAR): MARKU 14:53-65

⁵³Ata e çuan Jezusin te kryepriifti; dhe të gjithë krerët e priftërinjve, pleqtë dhe skribët u mblodhën së bashku. ⁵⁴Pjetri e kishte ndjekur nga larg, deri në oborin e kryepriiftit; dhe ishte ulur me oficerët dhe po ngrohej te zjarri. ⁵⁵Ndërkaq, krerët e priftërinjve dhe gjithë Këshilli po përpiqeshin të gjenin dëshmi kundër Jezusit për ta dënuar me vdekje, por nuk po gjenin asgjë. ⁵⁶Sepse shumë po jepnin dëshmi të rreme kundër tij, por dëshmia e tyre nuk përputhej. ⁵⁷Disa u ngritën dhe nisën të jepnin dëshmi të rreme kundër tij, duke thënë, ⁵⁸“E dëgjua kur tha: “Do ta shkatërroj këtë tempull të bërë me duar dhe, brenda tri ditësh, do të ngre një tjetër që s’është bërë me duar”. ⁵⁹Por edhe në këtë aspekt, dëshmia e tyre nuk përputhej. ⁶⁰Kryepriifti u ngrit, doli përpara dhe e mori në pyetje Jezusin, duke thënë: “Nuk po përgjigjesh? Për çfarë po dëshmojnë kundër teje këta burra?” ⁶¹Por ai qëndroi i heshtur dhe nuk u përgjigj. Sërish, kryepriifti po e pyeste dhe po i thoshte: “A je ti Krishti, Biri i të Bekuarit?” ⁶²Dhe Jezusi i tha: “Jam; dhe ke për ta parë Birin e Njeriut të ulur në të djathtë të Pushtetit, duke ardhur me retë e qiellit”. ⁶³Kryepriifti shqeu rrobat dhe tha: “Ç’nevojë të mëtejshme kemi për dëshmitarë? ⁶⁴Ju e keni dëgjuar blasfeminë; si ju duket?” Dhe të gjithë ata e dënuan sikur meritonte vdekjen. ⁶⁵Disa nisën ta pështynin, t’ia lidhnin sytë, ta rrihnin me grushta dhe t’i thoshin: “Profetizo!” Dhe oficerët e godisnin me shpulla në fytyrë.

14:53 “Ata e çuan Jezusin te kryepriifti” Gjoni 18:13a përmend Anën, por kryepriifti ishte Kajafa në vitet 18-36 pas K. (shih Mat. 26:57). Ungjijtë sinoptikë nuk e përmendin marrjen në pyetje nga Ana. Ai ishte kryepriifti i mëparshëm dhe ishte personi që kishte vërtet pushtetin e këtij ofiqi (shih Gjoni 18:13b).

▣ **“gjithë krerët e priftërinjve, pleqtë dhe skribët”** Kjo frazë përdoret për të përcaktuar këshillin e madh, Sinedrin (shih Marku 14:55). Shih Temën e Veçantë në Marku 12:13.

14:54 Ky varg përcakton skenën për mohimet e Pjetrit në oborin e kryepriiftit. Pjetri nuk mund të rrinte larg, por as nuk pranonte/mundej të identifikojë me Jezusin. Çfarë ironie!

NASB “ishte ulur me oficerët”

NKJV “ishte ulur me shërbëtorët”

NRSV “ishte ulur me rojet”

TEV “ishte ulur me rojet”

NJB “ishte ulur me ndihmësit”

Kjo është pjesore perifrastike e pakryer mesore (deponente). Duket se nënkupton që Pjetri u përpoq të sillej si një nga shërbëtorët/ndihmësit. Donte të përzihej me grupin, por drita në fytyrën e tij dhe theksi galileas e tradhtuan. Pjetrit i kujtohet mirë ajo natë!

14:55 Ky nuk ishte gjyq i ligjshëm; ishte i rremë (shih A. N. Sherwin-White, *Roman Society and Roman Law in the New Testament*, f. 24-47).

14:56 “Sepse shumë po jepnin dëshmi të rreme kundër tij” Koha e pakryer (në këtë varg, dy herë, dhe në Marku 14:57 dhe 59) tregon përpjekjen e përsëritur për këto dëshmi të rreme, por asnjëherë nuk përkuan me njëra-tjetrën. Kjo ishte paradë e gënjeshtarëve të dobët!

▣ **“dëshmia e tyre nuk përputhej”** Në DHV, duhej dëshmia e dy dëshmitarëve që të dënohej dikush (shih LiP. 17:6; 19:15). Po kështu, në DHV, nëse dikush jepte dëshmi të rreme, duhet të dënohej me ndëshkimin e të akuzuarit.

14:58 “Do ta shkatërroj këtë tempull” Ky varg është shembull i qartë i përdorimit të metaforave nga Jezusi për të përshkruar ngjarjet e ardhshme. Fjala “tempull” nënkupton dy gjëra dhe dy korniza kohore.

1. Trupi i Jezusit (shih Gjoni 2:19-22) i kryqëzuar, por i ringjallur pas tre ditësh (pra, shenja e Jonës, shih Mat. 12:39-40; Luka 11:29-32). Kjo do të ndodhte brenda disa orësh.

2. Tempulli i Herodit në Jerusalem do të shkatërrohej nga romakët më 70 pas K. dhe nuk do të rindërtohej më. Ky ishte gjykim i ardhshëm brenda 40 vitesh, por reflekton një gjykim eskatologjik (pra, 2 Thes. 2; dhe Zbulesa).

Është e lehtë të kuptohet sesi mbretëria kohore, por edhe eskatologjike, e Jezusit si dhe etika e saj mund të keqkuptohej nga fetaristët dogmatikë dhe legalistë të atëhershëm dhe të tanishëm.

☐ **“brenda tri ditësh”** Kjo referencë kohore (shih Marku 8:31; 9:31; 10:34) lidhet me profecinë e DHV në 1 Kor. 15:3-4. Koha “treditëshe” lidhet, si me “tempullin e ri”, ashtu dhe me trupin e ri të ringjalljes. Jezusi i shkrin qëllimisht të dyja me njëra-tjetrën. Tempulli i epokës së re është besimtari, si individualisht, ashtu dhe kolektivisht (shih 1 Kor. 3:16; 6:19).

☐ **“do të ngre një tjetër që s’është bërë me duar”** Kjo është profeci e mahnitshme e vdekjes dhe ringjalljes së Jezusit. Ashtu si tempulli kishte rol qendror në adhurim në DHV, tani këtë vlerë do ta ketë vetë Jezusi. Ai është guri i qoshes i hedhur poshtë! Është fokusi i ri i adhurimit!

Ai ka pushtetin që ta lërë jetën e vet dhe ta rifitojë sërish (shih Gjoni 10:11, 15, 17, 18). Ai është në kontroll të plotë të jetës, vdekjes dhe ringjalljes së vet.

14:60 “Kryeprifti u ngrit, doli përpara dhe e mori në pyetje” Kryeprifti po përpiquej ta bënte Jezusin që të vetinkrimohej. Kjo ishte e paligjshme sipas ligjit jude; po kaq i paligjshëm ishte gjyqi natën, si dhe gjykimi dhe dënimi të nesërmen.

14:61 “ai qëndroi i heshtur” Kjo mund të jetë përmbushje e Isa. 53:7 (shih Mat. 26:63; 27:12-14; Marku 15:5; Luka 23:9; Gjoni 19:9).

☐ **“Sërish, kryeprifti po e pyeste”** Mat. 26:63 shton se e detyroi të betohej.

☐ **“Krishti”** Ky është përkthimi greqisht i fjalës hebraisht “Mesia”, që kishte kuptimin “i vajosuri”. Në DHV, profetët, priftërinjtë dhe mbretërit vajoseshin si simbol i veçantë i zgjedhjes dhe pajisjes nga Perëndia për një detyrë të caktuar. Kjo fjalë, më vonë, përdorej për Birin e veçantë dhe mbretëror të Davidit (shih 2 Sam. 7), i cili do ta shpëngonte dhe rimëkëmbte Izraelin.

☐ **“Biri i të Bekuarit”** “I Bekuari” është titull i zakonshëm judaik (pra, perifrazim) për Perëndinë. Judenjtë nuk prisnin që Mesia të ishte Perëndia i mishëruar, por njeri me dhunti dhe i fuqizuar, njësoj si Gjykatësit. Por Jezusi e përdori këtë marrëdhënie familjare për të pohuar barazinë e tij të plotë me Atin (shih Gjoni 5:18; 10:30, 33; shih dhe 1:1).

14:62 “Jam” Ndoshta, ky ishte aludim për emrin në DHV për Perëndinë e Besëlidhjes, JHVH, që vinte nga folja hebraisht “jam” (shih Eks. 3:14; LiP. 32:39; Isa. 41:4; 43:10; 46:4; Gjoni 4:26; 8:24, 28, 58; 13:19; 18:5). Shih Temën e Veçantë: Emrat e Perëndisë në Marku 12:36. Kjo përgjigje shumë e drejtpërdrejtë ngjason me Lukën 22:70. Mateu shënon një përgjigje shumë më kriptike (shih Mat. 26:64).

Ungjilli i Markut e përshkruan mendimin e Jezusit për veten që nga fillimi si Biri dhe Mesia i Perëndisë (shih Marku 1:1). Edhe demonët e pranonin si të tillë dhe e thoshin gojarisht (shih Marku 1:24, 34; 3:11), por dishepujt ishin të ngadaltë për të kuptuar (shih Marku 8:29) personalitetin dhe veprën e Jezusit. Ata e shihnin ende me sy judenjsh të shekullit të parë (njësoj si kryeprifti).

☐ **“Birin e Njeriut të ulur në të djathtë të Pushtetit”** Ky është aludim për Psa. 110:1. Ishte metaforë antropomorfike për pozitën e autoritetit. Termi “pushtet” është mënyrë perifrazuese për të nënkuptuar JHVH-në. Jezusi (pra, Biri i Njeriut, shih Marku 14:21, 41, 62) po thotë me fjalë eskatologjike që ata mund t’i kuptonin se ai ishte Mesia i JHVH. Ndonëse Psa. 110:4 ka dhe një ngjyrim kuptimor priftëror, ka dhe kuptim mbretëror (shih Heb. 1:3).

Duhet përsëritur se mënyra si e kuptonte kryeprifti pyetjen në Marku 14:61 ndryshonte nga botëkuptimi i Jezusit (e njëjta gjë vlen dhe për pyetjen e Pilatit në Marku 15). Kryeprifti e mori si kërcënim ndaj pushtetit dhe autoritetit të vet, si dhe kërcënim ndaj pushtetit dhe autoritetit të Romës. Konceptin e DHV për Mesinë si mbret luftëtar e kishin dhe apostujt (shih Marku 10:37).

Mirëpo Jezusi e shihte mbretërinë e vet si të ardhshme dhe shpirtërore (shih Gjoni 18:36). Prandaj dhe citon këto pasazhe eskatologjike nga Psalmi 110 dhe Danieli 7.

Pa dyshim, ka një paradoks në lidhje me dy ardhjet, njëra si shërbëtor i përlurur dhe i përvuajtur dhe tjetra si mbret dhe gjykatës i përlëvdur. DHV i paraqet të dyja, por judenjtë fokusoheshin vetëm tek e dyta. Ky është dhe tensioni teologjik i mbretërisë së Perëndisë: i inauguruar, por jo i përbushur! Ne e kemi shumë të vështirë ta përfytyrojmë sa të vështirë e kishin judenjtë e kohës së Jezusit që t'ia kuptonin mesazhin.

■ **“duke ardhur me retë e qiellit”** Ky është citim nga Dan. 7:13. Është një frazë që e pohonte natyrën hyjnore të Jezusit me fjalë të qarta nga DHV. Askush nuk vinte me retë e qiellit përveç JHVH, por tani këtë gjë e bënte dhe “Biri” i tij (shih Marku 13:26; Veprat 1:9; Zbu. 1:7).

14:63 “shqeu rrobat” Kjo ishte shenjë e një shpirti thellësisht të trazuar, që e shkaktonte (gjoja) blasfemia. Ndëshkimi për blasfeminë (sipas Lev. 24:15) ishte vdekja e gurë. Jezusi meritonte të vdiste në bazë të LiP. 13:1-3 dhe 18:22 nëse nuk ishte Mesia, ai që duhet të vinte, Biri i Perëndisë, Shpëtimtari i botës. Nuk ka terren të ndërmjetëm këtu. Ose Jezusi është ai që pretendon, ose është blasfemues që meriton vdekjen (shih Josh McDowell, *Evidence that Demands a Verdict*).

14:64 “blasfeminë” Gënjeshtrat për JHVH-në meritonin dënimin me vdekje me gurë (shih Lev. 24:14-16).

14:65 “ta pështynin” Ky ishte simbol refuzimi në DHV (shih Num. 12:14; LiP. 25:9; Jobi 17:6; 30:10; Isa. 50:6). Jezusin e pështynë anëtarët e Sinedrit dhe ushtarët romakë (shih Marku 15:19).

■ **“t’ia lidhnin sytë, ta rrihnin me grushta dhe t’i thoshin: ‘Profetizo!’”** Ata ia lidhën sytë, e goditën dhe e pyetën: “Kush të goditi?” Po talleshin me pretendimin e tij se ishte profet i Perëndisë. Rabinët e kohës së Jezusit mendonin se Isa. 11:3 thoshte që Mesia ishte në gjendje ta gjykonte njeriun, jo vetëm me anë të shikimit, por edhe me anë të nuhatjes. Ndoshta këtë gjë kishte parasysh dhe ky incident, i cili ka sigurisht lidhje me Isa. 52:14. Rabinët e interpretonin këtë varg duke thënë se Mesia do të kishte lebrozë, por unë mendoj se këtu bëhet fjalë për rrahjet e rënda nga këto grupet e ndryshme të ushtarëve.

Disa dorëshkrime greke e zgjerojnë këtë pasazh të Markut për t’ia përshtatur Mat. 26:68 dhe Lukës 22:64.

NASB “ta rrihnin me shpulla”

NKJV “e rrihnin me shuplaka”

NRSV “ta godisnin”

TEV “e godisnin”

NJB “ta godisnin”

Kjo ndodhi e rrahjes së Jezusit përdor fjalët greqisht *kolafizo*, që do të thotë “godas me grusht”, dhe *rapizo*, që do të thotë “godas me shpullë” (shih Mat. 26:67). Shpulla me dorë të hapur është simbol oriental përçmimi (shih Mat. 5:39; Gjoni 18:22; 19:3). Këto fjalë përdoren dhe për “rrahjen me shkopinj” në Veprat 16:27.

Si Sinedri, ashtu dhe ushtarët romakët, e poshtëruan Jezusin dhe e keqtrajtuan fizikisht (shih Isa. 52:14; 53:4).

TEKSTI I NASB (I PËRDITËSUAR): MARKU 14:66-72

⁶⁶Ndërsa Pjetri po rrinte poshtë në oborr, një nga shërbëtorët e kryepfritit erdhi ⁶⁷dhe, kur e pa Pjetrin tek ngrohej e vështoi dhe i tha: “Edhe ti ishe me Jezus Nazareasin”. ⁶⁸Por ai e mohoi dhe i tha: “As nuk e njoh, as nuk e kuptoj se çfarë po thua”. Dhe doli në hyrje të oborrit; dhe këndoi një gjel. ⁶⁹Shërbëtorja e pa dhe filloi sërish t’u thoshte atyre që ishin aty: “Ky është njëri prej tyre!” ⁷⁰Por ai sërish e mohoi. Dhe, pas pak, ata që ishin aty po i thoshin sërish Pjetrit: “Pa dyshim që je njëri prej tyre, sepse dhe ti galileas je”. ⁷¹Por ai filloi të mallkonte dhe të betohej: “Nuk e njoh këtë njeri për të cilin po flisni!” ⁷²Menjëherë, këndoi për herë të dytë një gjel. Dhe Pjetrit iu kujtua sesi Jezusi i kishte thënë: “Përpara se gjeli të kdnëojë dy herë, do të më mohosh tri herë”. Dhe filloi të qajë.

14:66 “një nga shërbëtorët e kryepfritit erdhi” Gjoni 18:17 thotë se ajo ishte portierja. Mateu, si zakonisht, përmend dy persona, ndërsa Marku përmend vetëm një shërbëtorë (shih Mat. 26:69-71). Këtë histori Gjon Markut

duhet t'i ketë treguar Pjetri vetë, ose ndoshta e përdori në një nga predikimet e tij në Romë dhe Gjon Marku e dëgjoi.

14:67 “kur e pa Pjetrin” Ishte hënë e plotë (në Pashkë). Ajo arrinte ta shquante mirë Pjetrin për shkak të dritës së zjarrit (Marku 14:54, 67; Gjoni 18:18, 25) dhe dritës së hënës.

▣ **“Jezus Nazareasin”** Judenjtë e rritur në Galile (shih Mat. 26:69) kishin një theks të veçantë. Kjo e lidhte Jezusin me dishepujt e vet (shih Marku 14:70). Shih Temën e Veçantë në Marku 10:47.

14:68 “As nuk e njoh, as nuk e kuptoj se çfarë po thua” Rendi i saktë i këtyre tre akuzave ndryshon nga njëri ungjill në tjetrin. Fakti se Pjetri e mohoi Jezusin tri herë, duke e theksuar gjithnjë e më fort, është i përbashkët për të gjithë ungjijtë.

▣ **“Dhe doli në hyrje të oborrit”** Me sa duket, Pjetri u përpoq të largohej. Dorëshkrimet e lashta uncialë greke janë të ndara gjysmë për gjysmë në lidhje me faktin nëse fraza “dhe këndoi një gjel” duhet përfshirë ose jo në Marku 14:68 (dorëshkrimet A, C, D, si dhe Vulgata, përkthimet Peshita e përfshijnë, ndërsa Sinaitikus, B, L dhe W nuk e përmbajnë). Qartazi, ajo shpjegon frazën “një gjel këndoi për herë të dytë” në Marku 14:72. Disa përkthime moderne (shih NASB, NIV) nuk e përmbajnë, por disa e përfshijnë me një shënim në fund të faqes (shih NKJV, NRSV, TEV, NJB). UBS4 nuk e përcakton dot cili është origjinali.

14:70 “pas pak” Luka 22:59 thotë “pas rreth një ore”.

▣ **“galileas”** Ose dialekti, ose veshja, bëri që Pjetri të dallohej nga ishte.

14:71 “filloi të mallkonte dhe të betohej” Fjala “mallkoj” (*anathematizo*) në fillim përdorej për diçka që i përkushtohej Perëndisë (*anathema*), por më vonë nënkuptonte mallkimin (shih Veprat 23:12, 14, 21). Ishte mënyrë për të pohuar vërtetësinë e një thënieje duke thirrur gjykimin e Perëndisë mbi veten nëse gënjeje. Në mënyrën kulturore më të fortë të mundshme (pra, me anë të besimit dhe zotimit), Pjetri gënjeu përpara Perëndisë! Juda nuk bëri asgjë më të keqe se Pjetri! Pjetri e mohoi publikisht Zotin e vet në mënyrë të përsëritur, të prerë dhe përbetuese (shih Mat. 26:34, 74).

TEMË E VEÇANTË: MALLKIMI (*anathema*) (SPECIAL TOPIC: CURSE [*anathema*])

I. DHV

Në hebraisht përdoren një sërë fjalësh me kuptimin “mallkim”. *Herem* (BDB 356, Kb 353) përdorej për diçka që i jepej Perëndisë (p.sh., LXX e përkthen si *anathema*, BAGD 54, Lev. 27:28). Zakonisht, kjo kërkonte që objekti në fjalë të shkatërrohej pasi ishte tepër i shenjtë për përdorim nga njerëzit (shih LiP. 7:26; Joz. 6:17-18; 17:12). Ishte një term që përdorej në konceptin e “luftës së shenjtë”. Perëndia i tha Jozueut të shkatërronte kanaanitët. Jeriko ishte mundësia e parë, pra “fryti i parë” i këtij shkatërimi/pastrimi.

II. DHR

Në DHR, *anathema* dhe format që rrjedhin prej saj përdoren në disa kuptime të ndryshme:

- A. Si dhuratë ose ofertë për Perëndinë (shih Luka 21:5)
- B. Si betim vdekjeje (shih Veprat 23:14)
- C. Për të mallkuar dhe për t'u betuar (shih Marku 14:71)
- D. Një formulë mallkimi që lidhej me Jezusin (shih 1 Kor. 12:3)
- E. Kur jep dikë ose diçka për gjykim ose për shkatërrim nga Perëndia (shih Rom. 9:3; 1 Kor. 16:22; Gal. 1:8-9)

Pika D është shumë polemike. Përfshij më poshtë shënimet e mia për 1 Kor. 12:3:

“I mallkuar qoftë Jezusi” është thënie tronditëse. Si mund ta thotë këtë dikush (përveç judenjve tradicionalë) që thotë se flet në emër të Perëndisë? Vetë kjo fjalë (pra, *anathema*) ka një sfond nga DHV (pra, në hebraisht, *herem*). Kishte të bënte me konceptin e Luftës së Shenjtë, ku një qytet i kushtohej Perëndisë dhe, si rrjedhojë, bëhej i shenjtë. Kjo donte të thoshte se gjithçka në të që

merrte frymë, njeri apo kafshë, duhet të vdiste (shih Joz. 6:17; 7:12). Teoritë sesi ky term përdorej në Korint janë si më poshtë:

1. Kjo fjalë ka kontekst judaik, që lidhet me zotimet në sinagogë (shih Veprat 26:11; pra, formulat e mëvonshme të mallkimit rabinik, që përdorshin për t'i dëbuar të krishterët nga sinagoga). Që të qëndroje anëtar i sinagogës duhet të hidhje poshtë ose të mallkoje Jezusin e Nazaretit.
2. Kjo fjalë ka kontekst romak, që lidhet me adhurimin e perandorit, pasi vetëm Cezari mund të quhej “Zot”.
3. Ka kontekst të adhurimit pagan, ku në emër të perëndive shqiptoheshin mallkime ndaj njerëzve të caktuar. Pra, kjo mund të përkthehet edhe kështu: “Jezusi mallkoftë [filanin]” (shih 1 Kor. 16:22).
4. Dikush e lidhi këtë frazë me konceptin teologjik të Jezusit si mbartës i mallkimit të DHV për hirin tonë (shih LiP. 21:23; Gal. 3:13).
5. Disa studime të kohëve të fundit për Korintin (shih shënimin #1, f. 164, në librin e Bruce Winter, *After Paul Left Corinth*) dokumentojnë disa pllaka me mallkime që janë gjendur në akropolin e lashtë të Korintit. Studiuesit biblikë kanë menduar se në frazën “Jezusi është i mallkuar” duhet futur folja lidhëse “është”, por të dhënat arkeologjike në Korint tregojnë qartë se këto mallkime të periudhës romake të shekullit të parë nuk e përmbajnë këtë folje (njësoj si dhe në mallkimet e LXX te LiP. 22:15-20), njësoj si te 1 Kor. 12:3. Gjithashtu, ka të dhëna të tjera arkeologjike se të krishterët në shekullin e parë në Korintin romak përdornin formula mallkimi në procedura varrimi (në periudhën bizantine këto janë gjetur në varre të krishtera (J. H. Kent, *The Inscriptions*, 1926-50. Princeton: American School of Classical Studies, 1966, vëll. 8:3, nr. 644).

Disa segmente të kishës në Korint iu ishin kthyer mallkimeve pagane kundër anëtarëve të tjerë të kishës, ndonëse mallkimin e bënin në emër të Jezusit. Problemi këtu s'ishte vetëm metoda, por dhe qëllimi i tyre gjithë urrejtje. Ky është një tjetër shembull i tensionit brenda kësaj kisha. Pali dëshiron që ata ta ndërtojnë kishën; kurse ata duan që ta mallkojnë një pjesë të kishës!

■ **“Nuk e njoh këtë njeri”** Ndoshta, fraza “ky njeri” është shprehje semite përcmuese, si mënyrë për t'iu referuar Jezusit.

14:72 “këndoi për herë të dytë një gjel” Pjetrit iu kujtuan fjalët e Jezusit (shih Luka 22:31-32). Luka 22:61 thotë se Jezusi e vështroi. Me sa duket, Jezusin po e kalonin nga njëra anë e pallatit të kryepfritit ku banonte Ana, tek ajo pjesë e pallatit që i përkiste Kajafës.

Fraza “për herë të dytë” nuk gjendet në disa dorëshkrie greke. Problemi me të cilën përballeshin kopjuesit ishte se tre ungjijtë e tjerë (Mateu, Luka dhe Gjoni) përmendin këndimin e vetëm një gjeli, ndërsa Marku me sa duket përmban dy (shih dorëshkrimet A, B, C², D dhe W) kështu që disa dorëshkrime e heqin këtë frazë (shih dorëshkrimet Sinaitikus, C dhe L).

■ **“Dhe filloi të qajë”** Pjetri po përmbushte profecinë me mohimet e tij dhe po u jepte shpresë gjithë besimtarëve që e kanë mohuar Jezusin me gjuhën, me jetën dhe me përparësitë e tyre. Ka shpresë për çdokënd që kthehet sërish te Jezusi me besim (shih Gjoni 21).

PYETJE PËR DISKUTIM

Ky është një komentuar studimor udhëzues, që do të thotë se ti je vetë përgjegjës për interpretimin e Biblës. Secili prej nesh duhet të ecë sipas dritës që ka. Ti, Bibla dhe Fryma e Shenjtë keni përparësi në interpretim. Nuk duhet t'ia dorëzosh këtë të drejtë komentuesit.

Këto pyetje për diskutim t'i kam dhënë për të të ndihmuar që të analizosh çështjet kryesore të kësaj pjese të librit. Ato synojnë të të nxisin mendimin, jo të kenë natyrë shteruese.

1. A ka mospërputhje mes Markut dhe Gjoni për ditën kur ndodhi Darka e Zotit?

2. Pse e teproi kaq shumë Maria me parfumin e shtrenjtë? Pse e lejoi Jezusi?
3. A na mëson Marku 14:7 se Jezusi nuk donte t'ia dinte për të varfrit?
4. Pse përpiqeshin krerët fetarë që ta vrisnin Jezusin?
5. Po Juda? Si mund t'i shpjegojmë veprimet e tij?
6. Ç'lidhje ka Darka e Zotit me Pashkën? Cila është domethënia e Darkës së Zotit?
7. Pse është kaq paradoksal Gjetsemani (pra, Jezusi dëshiron që t'i kalojë kupa, por dëshiron dhe vullnetin e Perëndisë)?
8. Pse u zemërua kaq shumë kryepriifti kur Jezusi citoi Psa. 110 dhe Dan. 7:13?

MARKU 15

NDARJET NË PARAGRAFË TË PËRKTHIMEVE MODERNE

UBS ⁴	NKJV	NRSV	TEV	NJB
Jezusi para Pilatit 15:1-5	Jezusi përballë Pilatit 15:1-5	Jezusi përpara Pilatit 15:1-5	Jezusi përpara Pilatit 15:1-2a 15:2b 15:3-4 15:5	Jezusi përpara Pilatit 15:1 15:2-5
Jezusi dënohet me vdekje 15:6-15	Jezusi zë vendin e Barabës 15:6-15	15:6-15	Jezusi dënohet me vdekje 15:6-10 15:11-12 15:13 15:14a 15:14b 15:15	15:6-15
Ushtarët tallen me Jezusin 15:16-20	Ushtarët tallen me Jezusin 15:16-20	Kryqëzimi 15:16-20	Ushtarët tallen me Jezusin 15:16-20	Jezusi kurorëzohet me gjemba 15:16-20a
Kryqëzimi i Jezusit 15:21-32	Mbreti në kryq 15:21-32	15:21-24 15:25-32	Jezusi kryqëzohet 15:21-28 15:29-30 15:31-32a 15:32b	Udha e kryqit 15:20b-22 Kryqëzimi 15:23-28 Jezusi i kryqëzuar tallet 15:29-32
Vdekja e Jezusit 15:33-41	Jezusi vdes në kryq 15:33-41	15:33-41	Vdekja e Jezusit 15:33-34 15:35-36 15:37 15:38-39 15:40-41	Vdekja e Jezusit 15:33-39 Gratë në Kalvar 15:40-41
Varrimi i Jezusit 15:42-47	Jezusi varroset në varrin e Jozefit 15:42-47	15:42-47	Varrimi i Jezusit 15:42-47	Varrimi 15:42-47

CIKLI TRE I LEXIMIT (shih f. v)

NDJEKJA E SYNIMIT TË AUTORIT FILLESTAR NË NIVELIN E PARAGRAFËVE

Ky është një komentari studimor udhëzues, që do të thotë se ti je vetë përgjegjës për interpretimin e Biblës. Secili prej nesh duhet të ecë sipas dritës që ka. Ti, Bibla dhe Fryma e Shenjtë keni përparësi në interpretim. Nuk duhet t'ia dorëzosh këtë të drejtë komentuesit.

Lexo gjithë kapitullin njëherësh. Identifiko temat. Krahaso ndarjet e tua tematike me pesë përkthimet moderne. Ndarja në paragrafë nuk është e frymëzuar, por është çelësi për të ndjekur synimin e autorit fillestar, gjë që është thelbi i interpretimit. Secili paragraf ka vetëm një temë të vetme.

1. Paragrafi i parë
2. Paragrafi i dytë
3. Paragrafi i tretë
4. Etj.

STUDIMI I FJALËVE DHE FRAZAVE

TEKSTI I NASB (I PËRDITËSUAR): MARKU 15:1-5

¹Herët në mëngjes, krerët e priftërinjve, me pleqtë, skribët dhe gjithë Këshillin, mbajtën menjëherë një takim; dhe si e lidhën Jezusin e nxorën dhe ia dorëzuan Pilatit. ²Pilati e pyeti: “Ti je mbreti i judenjve?” Dhe ai iu përgjigj: “Siç thua ti është”. ³Krerët e priftërinjve filluan ta akuzonin ashpër. ⁴Atëherë Pilati e pyeti sërish duke i thënë: “Nuk përgjigjesh? E shikon sa akuza po sjellin kundër teje?” Por Jezusi nuk i dha asnjë përgjigje tjetër; kështu që Pilati u mahnit.

15:1 “Herët në mëngjes” Marku, ashtu si gjithë shkrimet e judenjve, nuk fokusohet në kohë të veçanta. Ndoshta, judenjtë e kohës së Jezusit e ndanin natën dhe ditën në dymbëdhjetë orë secila (shih Gjoni 11:9), me tre segmente katër orëshe. Dita njëzetekatërorëshe vjen nga Babilonia. Grekët dhe judenjtë e huazuan prej babilonasve. Ora me diell ndahej në dymbëdhjetë segmente.

Në kapitullin 15, Marku përmban një sërë periudhash kohore:

1. lindja e diellit Marku 15:1 (rreth 6 e mëngjesit, në varësi të kohës gjatë vitit)
2. ora e tretë, Marku 15:25 (rreth 9 e mëngjesit)
3. ora e gjashtë, Marku 15:33 (rreth mesditës)
4. ora e nëntë, Marku 15:34 (rreth 3 e pasdites)
5. darka, Marku 15:42 (perëndimi i diellit, rreth 6 e pasdites)

Luka 22:66-71 jep hollësitë e këtij takimi. Ky takim i herët u mbajt me qëllim që t’i jepej njëfarë vlere ligjore gjyqit të paligjshëm të natës (shih A. N. Sherwin-White, *Roman Society and Roman Law in the New Testament*, f. 24-47). Kronologjia e gjyqit të Jezusit përpara Pilatit dhe e kryqëzimit të tij është:

	<u>Mateu</u>	<u>Marku</u>	<u>Luka</u>	<u>Gjoni</u>
Vendimi i Pilatit				ora e 6-të 19:14
Kryqëzimi		Ora e 3-të 15:25		
Rënia e errësirës	ora e 6-9 27:45	ora e 6-9 15:33	ora e 6-9 23:44	
Jezusi bërtet	ora e 9-të 27:46	ora e 9-të 15:34		

Kur krahasohen këto përcaktime kohore, shfaqen dy mundësi interpretuese: (1) janë të njëjta. Gjoni përdori kohën romake, duke e llogaritur nga mesnata (shih Gleason L. Archer, *Encyclopedia of Bible Difficulties*, f. 364), ndërsa ungjijtë sinoptikë përdorën kohën judaike, duke e llogaritur nga 6 e mëngjesit. (2) Gjoni flet për një kohë të mëvonshme për kryqëzimin e Jezusit, që përbën një tjetër shembull të dallimeve mes ungjijve sinoptikë dhe Gjoni. Megjithatë, nga Gjoni 1:39 dhe 4:6, duket se Gjoni nganjëherë përdor kohën judaike, dhe herë të tjera kohën romake (shih M. R. Vincent, *Word Studies*, vëll. 1, f. 403).

Përcaktimet kohore mund të jenë simbolike në të gjitha ungjijtë pasi flasin për (1) kohën e flijimeve të përditshme (pra, të vazhdueshme) në tempull (9 e mëngjesit dhe 3 e pasdites, Veprat 2:15; 3:1) dhe (2) pak para mesditës ishte koha tradicionale për therjen e Qengjit të Pashkës, më 14 Nisan. Bibla, si libër i lashtë lindor, nuk përqendrohet në kronologjinë e saktë, ndryshe nga rrëfimet historike moderne në perëndim.

▣ **“krerët e priftërinjve, me pleqtë, skribët dhe gjithë Këshillin”** Shih Temën e Veçantë: Sinedri, në Marku 12:13.

▣ **“menjëherë”** Ungjilli i Markut karakterizohet nga veprimi (“pastaj”, “dhe”, “menjëherë”). Jezusi zbulohet pikësëpari përmes veprimeve të tij. Ritmi i rrëfimit lëviz përpara përmes këtyre fjalëve vepruese. Shih shënimin në Marku 1:10.

▣ **“si e lidhën Jezusin”** Kjo mund të ketë qenë procedurë normale për kriminelët, ose, në mënyrë të pavetëdijshme, kjo zbulonte frikën që kishin ata nga Jezusi. Shumë kishin frikë se ai ishte magjistar ose shtrigan, dhe se fuqinë e kishte të duart.

▣ **“ia dorëzuan Pilatit”** Se ku saktësisht ishte ky vend është e paqartë. Shumica e studiuesve mendojnë se Pilati banonte në pallatin e Herodit kur ishte në Jerusalem. Rezidencën normale e kishte në Cezarenë e bregdetit, ku përdorte një tjetër pallat të Herodit si pretorium. Të tjerë mendojnë se ai qëndronte në shtabin e ushtrisë, që ishte fortësia Antonia, ngjitur me tempullin. Koha kur ndodhi kjo ishte në agim, sipas zakoneve romake të gjyqit herët në mëngjes (ndoshta, për shkak të nxehtësisë). Pilati e sundoi Palestinën si përfaqësues i perandorit romak nga 25/26-36/37 pas K., dhe më pas perandori e hoqi prej andej për shkak të akuzave të përsëritura të Vitelit, legatit të Sirisë.

TEMË E VEÇANTË: PONC PILATI (SPECIAL TOPIC: PONTIUS PILATE)

- I. Njeriu
 - A. Vendi dhe data e lindjes e panjohur
 - B. Nga një rend kalorësiak (klasa e sipërme e mesme e shoqërisë romake)
 - C. I martuar, por s’dihet të ketë patur fëmijë
 - D. Postet e mëparshme administrative (duhet të ketë pasur disa të tilla) nuk dihen
- II. Personaliteti i tij
 - A. Dy pikëpamje të ndryshme
 1. Filoja (*Legatio and Gaium*, 299-305) dhe Jozefusi (*Antik*. 18.3.1 dhe *Luftërat judaike* 2.9.2-4) e pasqyrojnë si diktator mizor dhe të pamëshirshëm.
 2. DhR (ungjijtë, Veprat) paraqesin një guvernator romak të dobët dhe lehtësisht të manipulueshëm
 - B. Paul Barnett, *Jesus and the Rise of Early Christianity (Jezusi dhe ngritja e krishterimit të hershëm)*, f. 143-148, jep një shpjegim të besueshëm të këtyre dy pikëpamjeve.
 1. Pilati u caktua guvernator më 26 pas K. nën Tiberin, i cili ishte pro judenjve (shih Filo, *Legatio and Gaium*, 160-161), me këshillë të Sejanit, kryekëshilltarit antijude të Tiberit.
 2. Tiberi pësoi një humbje pushteti politik ndaj L. Aelius Sejanit, prefektit të tij pretorin, i cili u bë pushteti i vërtetë politik pas fronit dhe që i urrente judenjtë (Filo, *Legatio and Gaium*, 159-160).
 3. Pilati ishte i mbrojtur nga Sejanit dhe përpiquej t’i linte përshtypje
 - a. duke sjellë flamuj romakë në Jerusalem (26 pas K.), gjë që guvernatorët e tjerë nuk e kishin bërë. Këto simbole të perëndive romake i tërbuan judenjtë (shih Jozefusi, *Ant.* 18.3.1; *Luftërat e judenjve* 2.9.2-3).
 - b. duke shtypur monedha (29-31 pas K.) ku ishin skalitur pamje të adhurimit romak. Jozefusi thotë se ai po përpiquej qëllimisht që të përmbyste ligjet dhe zakonet e judenjve (shih Jozefusi, *Ant.* 18.4.1-2).
 - c. duke marrë para nga thesari i tempullit për të ndërtuar një akuedukt në Jerusalem (shih Jozefusi, *Ant.* 18.3.2; *Luftërat e judenjve* 2.9.3).
 - d. duke vrarë disa galileas ndërsa ofronin flijime për Pashkën në Jerusalem.
 - e. duke sjellë mburoja romake në Jerusalem më 31 pas K. I biri i Herodit të Madh iu përgjërta që t’i largonte, por nuk pranoi, kështu që ata i shkruan Tiberit, i cili urdhëroi që mburojat ta ktheheshin në Cezare në anë të detit (shih Filo, *Legatio and Gaium*, 299-305).

- f. duke urdhëruar therjen e shumë samaritanëve në malin Gerizim (36/37 pas K.), teksa po kërkonin për sende të shenjta të fesë së tyre, që ishin humbur. Kjo bëri që eprori vendas i Pilatit (Viteli, prefekti i Sirisë) ta hiqte nga posti dhe ta dërgonte në Romë (shih Jozefusi, *Ant.* 18.4.1-2).
- 4. Sejanit u ekzekutua më 31 pas K. dhe Tiberi rifitoi pushtetin e plotë politik; prandaj, #a, b, c dhe d ka mundësi që të jenë bërë nga Pilati për të fituar besimin e Sejanit; #e dhe f mund të kenë qenë përpjekje për të fituar besimin e Tiberit, por ndoshta mund t'i jenë kthyer kundër.
- 5. Është e qartë se, me rikthimin e perandorit pro-jude, plus një letër zyrtare drejtuar guvernatorëve nga Tiberi që të tregoheshin të njerëzishëm me judenjtë (shih Filo, *Legatio and Gaium*, 160-161), udhëheqësit e judenjve në Jerusalem përfituan nga cenueshmëria politike e Pilatit para Tiberit dhe e manipuluan që të kryqëzonte Jezusin. Kjo teori e Barnett i bashkon dy pikëpamjet për Pilatin në mënyrë të besueshme.

III. Fundi i tij

- A. E thirrën dhe mbërriti në Romë pak pas vdekjes së Tiberit (37 pas K.).
- B. Nuk i dhanë post tjetër.
- C. Jeta e tij pas kësaj është e panjohur. Ka shumë teori të mëvonshme, por asnjë fakt të sigurt.

15:2 “Pilati e pyeti” Në ç’gjuhë? Mundësia që Pilati të ketë folur aramaisht është më e vogël sesa mundësia që Jezusi të ketë folur greqishten *koine*. Për një diskutim të dobishëm, shih:

1. “A fliste greqisht Jezusi”, nga Joseph A. Fitzmeyer, kapitulli 21, f. 253-264, në *Approaches to the Bible: the Best of Bible Review*
2. “Gjuhët e Dhiatës së Re”, nga J. Hoëard Greenlee në *Expositor’s Bible Commentary*. Vëll. 1, f. 410-411

■ **“Ti je mbreti i judenjve?”** “Ti” është në pozicion të theksuar dhe ironik. Luka 23:1-2 rendit akuzat e Sinedrit. Gjoni 19:8-19 shton shumë hollësi për bisedën mes Jezusit dhe Pilatit. Pilati nuk donte t’ia dinte për aspektin fetar të akuzës, por aspektin politik të saj.

NASB, NKJV “Siç thua ti është”

NRSV, TEV “Ti po thua”

NJB “Është siç e thua ti”

Fjalë për fjalë, “ti thua që Unë Jam”, që mund të jetë shprehje hebraike pohuese (shih Mat. 26:25, 64; Luka 22:70; 23:3), ose është mënyrë kriptike përgjigjeje, që nënkupton: “Kështu thua ti, por po nënkupton se unë jam një lloj i ndryshëm gjëje”. Duket se ky ka qenë një konsultim privat (shih Gjoni 18:33-38) brenda pretoriumit. Jezusit duhet t’ua ketë treguar më vonë dishepujve, ose vetë Gjoni ishte i pranishëm. Judenjtë nuk mund të kenë hyrë aty brenda sepse kjo do t’i bënte ceremonialisht të papastër për të ngrënë Pashkën.

Ndodhia e marrjes së Jezusit në pyetje nga Herodi nuk përmendet në ungjillin e Markut, por gjendet në Luka 23:6-12.

15:3

NASB “filluan ta akuzonin ashpër”

NKJV, NRSV “e akuzuan për shumë gjëra”

TEV “po e akuzonin Jezusin për shumë gjëra”

NJB “sollën shumë akuza kundër tij”

Kjo është në kohën e pakryer, që do të thotë se po e akuzonin vazhdimisht. Kjo duhet të ketë ndodhur pasi Pilati foli vetëm për vetëm me Jezusin (shih Marku 15:4). Një listë e disa prej akuzave të tyre gjendet në Luka 23:1.

15:5 “Jezusi nuk i dha asnjë përgjigje tjetër” Kjo mund të jetë përmbushje e Isa. 53:7 (shih Marku 14:61; Mat. 26:63; 27:12; Gjoni 19:9).

▣ **“kështu që Pilati u mahnit”** Pse u mahnit Pilati?

1. Jezusi foli vetëm për vetëm me të, por nuk pranonte t'i fliste në prani të akuzuesve.
2. Kryepriifti solli shumë akuza kundër tij, dhe ishin shumë të ashpra.
3. Jezusi nuk veproi si shumica e të burgosurve, të cilët mbroheshin me mish e me shpirt.

TEKSTI I NASB (I PËRDITËSUAR): MARKU 15:6-15

⁶Në festë, ai e kishte zakon t'u lironte një të burgosur, këdo që t'ia kërkonin. ⁷Burri i quajtur Baraba ishte burgosur me kryengritësit që kishin kryer vrasje gjatë kryengritjes. ⁸Turma u ngrit dhe filloi t'i kërkonte Pilatit që të bënte siç e kishte zakon për ta. ⁹Pilati iu përgjigj dhe u tha: “A doni që t'ju liroj mbretin e judenjve?” ¹⁰Sepse ishte në dijëni që krerët e priftërinjve e kishin dorëzuar për shkak të zilisë. ¹¹Por krerët e priftërinjve e nxitën turmën që t'i kërkonte të lironte Barabën për ta. ¹²Pilati u përgjigj sërish dhe u tha: “Atëherë, çfarë të bëj me atë që e quani mbreti i judenjve?” ¹³Ata ia kthyen me të bërtitur: “Kryqëzoje!” ¹⁴Por Pilati u tha: “Pse, ç'të keqe ka bërë?” Por ata bërtisnin dhe më tej: “Kryqëzojeni!” ¹⁵Duke dashur të kënaqte turmën, Pilati u liroi Barabën dhe, pasi urdhëroi ta rrihnin Jezusin me kamxhik, e dorëzoi për ta kryqëzuar.

15:6 “festë” Bëhet fjalë për Pashkën. Studiuesit kanë debatuar shpesh për kohëzgjatjen e shërbesës publike të Jezusit. E vetmja arsye pse tradita kishtarë flet për një shërbesë publike trevjeçare është për shkak të tre pashkëve të përmendura në ungjillin e Gjonit. Mirëpo, në Gjoni, përmendet dhe një “festë”, si këtu, që nënkupton dhe një Pashkë tjetër. Mendoj se Jezusi mund të ketë patur një shërbesë publike 4-, ose ndoshta dhe 5- ose 6-vjeçare. Është e qartë se shkruesit e ungjijve nuk ishin të preokupuar për kronologjinë në vetvete, por për teologjinë. Ungjijtë nuk janë histori perëndimore, por rrëfime teologjike lindore. Nuk janë, as biografi, as autobiografi. Ato janë gjini letrare më vete. Shkruesit e ungjijve, nën frymëzim, kishin lirinë që të përzgjidhnin, përshtasin dhe ririndisnin fjalët dhe veprimet e Jezusit për t'ia paraqitur audiencës së tyre. Nuk besoj se kishin lirinë që të vendosnin në gojën e tij fjalë të paqena; megjithatë, materialet e dëshmitarëve okularë, të shkruara pas shumë kohësh, si dhe qëllimet teologjike dhe audiencat e ndryshme të ungjilltarëve, përbën arsyen pse ndrshojnë katër ungjijtë nga njëri-tjetri.

▣ **“ai e kishte zakon t'u lironte një të burgosur, këdo që t'ia kërkonin”** Kjo duket se ishte bërë traditë romake e përvitshme në Palestinën e kohës së Jezusit. Mbështetje historike për këtë gjendet vetëm te Jozefusi, *Lashtësitë e Judenjve* 20:9:3. Pilati po përpigj ta bënte turmën të kishte keqardhje për Jezusin, që ta lironte (shih Marku 15:14; Luka 23:14-16; Gjoni 18:38-39; 19:4).

15:7 “Baraba” Ky emër ishte kombinimi i fjalëve Bar=“biri i” dhe Abbas=“atit”. Ungjilli jokanonik i Hebrenjve e quan Bar Rabbas, “biri i rabinit”. Disa dorëshkrime greke të Mat. 27:16-17 e quajnë “Jezus Baraba”, që është përpjekje për ironi, për shkak se të dy quheshin “Jezus”, i cili ishte vërtet “Biri i Atit”.

▣ **“me kryengritësit”** Burri që turma donte të lirohej ishte pikërisht ai lloj njeriu për të cilin po e akuzonin Jezusin. Çfarë ironie!

15:8 “Turma” Disa mendojnë se miqtë e Barabës po e prisnin këtë mundësi të përvitshme. Të tjerët mendojnë se turma përbëhej, jo nga shtegtarët, por nga dëshmitarë të rremë dhe nga njerëz të tjerë të përfshirë në gjyqet e natës. Këta s'kishin asgjë të përbashkët përveç faktit se donin të lirohej Baraba, por për arsye shumë të ndryshme.

Qyteti ishte plot me shtegtarë, shumë nga Galilea, por ata s'mund të ishin zgjuar kaq herët, thjesht që të shkonin te gjykata e Pilatit.

NASB, NJB	“u ngrit”
NKJV	“po bërtiste me zë të lartë”
NRSV	“erdhi”
TEV	“u mblodh”

Fjalët greke “ngjitem” (*anabaino*) dhe “bërtas” (*anaboao*) shkruhen dhe shqiptohen në mënyrë të ngjashme, që do të thotë se ngatërroheshin lehtë nga metoda e lashtë e bërjeve të kopjeve të DHR, ku një kopjues lexonte tekstin me zë të lartë, ndërsa disa të tjerë bënin kopje. Tradita e dorëshkrimeve greke është e ndarë:

1. “u ngjit” pjesore aoriste veprare në dorëshkrimet Sinaitikus (dora e parë), B dhe Vulgata.
2. “bërtiti” pjesore aoriste veprare në dorëshkrimet Sinaitikus (dora e dytë), A, C, W dhe Peshita.

“Bërtiti” nuk gjendet në asnjë pjesë tjetër të Markut, kurse “u ngji” gjendet nëntë herë dhe përdoret për:

1. gjërat që rriten (4:7)
2. hipjen në anije (6:51)
3. ngjitjen (15:8)

Ndoshta, NASB dhe NJB kanë të drejtë.

15:9 Ashtu si Luka (pra, në ungjillin e Lukës dhe në Veprat), edhe Marku shkruan për të treguar se krishterimi nuk ëprbënte kërcënim për autoritetet romake.

15:10 “për shkak të zilisë” Pilati ia kuptonte qëllimet Sinedrit (shih Mat. 27:18), por nuk pranoi të vepronte me drejtësi!

Xhelozia ishte, pa dyshim, motiv i mundshëm i krerëve judenj, por unë habitem që Pilati nuk i kuptonte po aq qartë dhe motivet e tyre teologjike dhe politike (shih Luka 23:2). Po kështu, ka mundësi që Pilati të ketë dëgjuar për Jezusin përmes spiunëve ose informuesve të vet (ose, madje, dhe përmes gruas së vet, shih Mat. 27:19).

15:12 “atë që e quani mbreti i judenjve” Gjoni 19:15 thotë se kjo turmë judenjsh (pra, kryengritës dhe krerë judenj) po thoshin: “Ne s’kemi asnjë mbret tjetër veç Cezarit”. Çfarë ironie!

15:13

NASB, NRSV,

TEV, NJB “Ata ia kthyen me të bërtitur”

NKJV “Ata bërtitën sërish”

Fjala greke *palin* përkthehet “sërish” nga përkthimet moderne. “Sërish” dhe “ia kthej” janë mundësi standarde përkthimi te Baruer, Arndt, Gingrich dhe Danker, *A Greek-English Lexicon of the New Testament*, f. 606. Konteksti këtu kërkon “ia kthyen”.

15:14 “ç’të keqe ka bërë” Ungjilli i Gjoni e paralelizon këtë thënie të Pilatit tri herë në Marku 18:38; 19:4, 6. Pilati po përpiqej të ngjallte keqardhje për Jezusin që ta çlironte (shih Gjoni 18:38; 19:6, 12), por kjo turmë e anshme nuk pranonte!

15:15

NASB, NRSV “Duke dashur të kënaqte turmën”

NKJV “Duke dashur të kënaqte turmën”

TEV “donte t’i bënte qejfin turmës”

NJB “i ankthshëm që të kënaqte turmën”

Për Pilatin, rendi ishte më i rëndësishëm se drejtësia. Këta drejtues judenj ia dolën që ta trembnin Pilatin (shih Gjoni 19:12). Pilati ishte akuzuar për shumë gjëra tek autoritetet siriane dhe romake. Nuk i duheshin akuza të tjera. Ata e dinin këtë dhe e përdorën!

Disa gjuhëtarë të sotëm vërejnë se foljet greke *hikanon poiesai* janë idiomë latine (shih Bauer, Arndt dhe Gingrich, f. 374; Moulton dhe Milligan, f. 302; C. F. D. Moule, *An Idiom Book of the New Testament Greek*, f. 192). Kjo është domethënëse, pasi Marku ka shumë fjalë, fraza dhe idioma latine, ndoshta për shkak se u shkrua si dëshmi për romakët.

■ **“ta rrihnin Jezusin me kamxhik”** Kjo është përbushje e Isa. 53:5. Rrahja me kamxhik ishte procedurë paraprake dhe standarde romake për ata që kryqëzoheshin. Ishte rrahje e tmerrshme. Të dënuarin e përkulnin dhe ia lidhnin duart te një hu i ulët. Pastaj, dy ushtarë, nga një në secilën anë, e godisnin me kamxhikë të bërë prej nëntë rripa lëkure; në majë të çdo rripi ishin ngjitur sende të rënda. Shpesh, të burgosurit vdisnin nga rrahja.

TEKSTI I NASB (I PËRDITËSUAR): MARKU 15:16-20

¹⁶Ushtarët e futën Jezusin në pallat (pra, në Pretorium), dhe thirrën gjithë kohortën romake. ¹⁷E veshën me të purpurta dhe, pasi thurën një kurorë me gjemba, ia vunë në kokë ¹⁸dhe filluan ta përshëndesnin: “Nderime, mbret i judenjve!” ¹⁹E godisnin vazhdimisht në kokë me kallam dhe e pështynin, gjunjëzoheshin dhe përkuleshin para tij. ²⁰Pasi e tallën, ia hoqën robën e purpurt dhe ia veshën rrobat e tij. Dhe e nxorën jashtë për ta kryqëzuar.

15:16 “Ushtarët e futën” Këta ushtarët romakë (shih Mat. 27:27) i urrenin judenjtë për shkak të qëndrimit përjashtues që mbanin ndaj johebrenjve, dhe inatin e judenjve ia nxorën Jezusit. Luka 23:11 nënkupton se dhe ushtarët e Herod Tetrarkut e tallnin si mbret.

NASB “në pallat (pra, në Pretorium)

NKJV “në pallatin e quajtur Pretorium”

NRSV “në oborrit e pallatit (pra, në selinë e guvernatorit)”

TEV “brenda oborrit të pallatit të guvernatorit”

NJB “në pjesën e brendshme të pallatit, pra, në Pretorium”

Bëhej fjalë për rezidencën e zyrtarëve romakë kur rrinin në Jerusalem. Kjo mund të ketë qenë fortesa Antonia, që ishte përbri tempullit, ose, me më shumë gjasë, pallati i Herodit të Madh në Jerusalem.

NASB “gjithë kohortën romake”

NKJV “gjithë garnizonin”

NRSV, NJB “gjithë kohortën”

TEV “pjesën tjetër të kompanisë”

Fjala greke *speiran* (pra, kohorta), në fillim, nënkuptonte diçka që mpleksur së bashku, si, për shembull, një fill ose një litar. Më vonë, përdorej në mënyrë të figurshme për një grup burrash që punonin së bashku për një qëllim. Kohorta është një tjetër fjalë latine. Përdorej për një të dhjetën e legjionit, normalisht 600 burra. Por mund të përbëhej edhe nga një numër shumë më i vogël burrash (shih Gjoni 18:3). Ushtria romake strukturohej sipas (1) legjioneve, 6000; (2) kohortave, 600; (3) maniplave, 200; dhe (4) qindësheve, 100.

15:17 “e veshën me të purpurta” Mateu 27:28 thotë “rrobë të kuqe flakë”, që i përkiste oficerit të kavalerisë romake. E purpurta ishte simbol i mbretërisë. Në fillim, manteli i oficerit romak duhet të ketë qenë i kuq flakë, por me kalimin e kohës u zëvendësua në një hije të purpurt. Ata po e tallnin Jezusin si gjoja mbretin e judenjve (shih Marku 15:18-20; Gjoni 19:2).

Luka 23:11 thotë se edhe ushtarët judenj të Herod Tetrarkut, ose Herod Antipës, e tallën Jezusin si mbret/Mesi duke i vënë mbi supet një mantel mbreti.

■ **“një kurorë me gjemba”** Tradicionalisht, kjo është menduar si mënyrë torture, pasi gjembat i nguleshin në vetulla Jezusit. Mirëpo ka shumë mundësi që kjo të ketë qenë një kurorë e bërë me gjethe palme, që ishte një mënyrë tjetër për ta tallur Jezusin si mbret (shih Mat. 27:27-31; Marku 15:15-20). Fjala greke “kurorë” (*stefanos*) përdorej për kurorën prej dafinash të fituesit të lojërave atletike, ose kurorën me dafina që e vishte perandori.

15:19 Ky varg përshkruan talljen e ushtarëve romakë.

1. “Nderime”, një përshëndetje e specializuar për udhëheqësin (Marku 15:18)

2. “e godisnin në kokë me kallam”; ndoshta, në fillim, kallamin ia vunë në dorë Jezusit si skeptër të rremë

3. “e pështynin”, shenjë kulturore përçmimi, ose imitimi i një puthjeje (pra, një lloj përshëndetjeje)

4. “gjunjëzoheshin dhe përkuleshin para tij”, një tjetër simbol tallës i pozitës mbretërore të Jezusit

Numrat dy deri në katër janë në kohën e pakryer, që nënkuptojnë veprim të përsëritur në të shkuarën. Shumë prej ushtarëve i bënin vazhdimisht këto veprime, ose, ndoshta, çdo ushtar i pranishëm i bënte.

15:20 “e nxorën jashtë” Si gjithë të burgosurit e dënuar, Jezusi duhet ta mbartte traun e kryqit të vet deri në vendin e kryqëzimit jashtë mureve të qytetit. Ata ndiqnin udhën e gjatë nëpër rrugët e Jerusalemit që të gjithë ta shihnin drejtësinë romake dhe t’i druhashin.

Kjo çuarje e kriminelëve jashtë mureve të Jerusalemit për t’u vrarë mund të jetë bërë nga respekti për ligjin judaik (shih Lev. 24:14 dhe Num. 15:35-36). Romakët nuk donin revoltë gjatë këtyre ditëve të festës, kur rrugët ishin të mbushura me judenj.

■ **“për ta kryqëzuar”** Kryqëzimin e shpikën fenikasit. Aleksandri i Madh kryqëzoi 2,000 vetë pas rënies së Tirit. Romakët e përsosën këtë teknikë; bënë që kriminelët e dënuar të vuanin për disa ditë para se të vdisnin. Kjo torturë mizore synonte të parandalonte krimet. Nuk lejohej të kryhej për qytetarët romakë.

TEKSTI I NASB (I PËRDITËSUAR): MARKU 15:21

²¹Ata detyruan një kalimtar që vinte nga fshati, Simonin e Kirenës (babai i Aleksandrit dhe Rufusit), që ta mbartte kryqin e Jezusit.

15:21 “detyruan” Kjo është fjalë e huazuar nga persishtja, që përdorej për konfiskimin zyrtar të pronës ose rekrutimin e detyruar të punëtorëve në shërbim të qeverisë.

NASB “një kalimtar që vinte nga fshati”

NKJV “teksta po dilte nga fshati”

NRSV “një kalimtar, që po hynte nga fshati”

TEV “që po hynte në qytet nga fshati”

NJB “një kalimtar... që po vinte nga fshati”

A nënkupton kjo një person që tani jetonte në Palestinë, apo një vizitor për Pashkët? Unë mendoj se bëhet fjalë për një shtegtar, që rrinte përkohësisht në periferinë e Jerusalemit dhe thjesht rastisi të kalonte aty pari në atë kohë. Gjithsesi, në Jerusalem jetonin shumë njerëz nga Kirenaika (pra, nga Afrika Veriore). Madje, kishte një sinagogë të veçantë për ta (shih Veprat 6:9). Përmenden fëmijët e tij; me sa duket, ata njiheshin në kishën e hershme (jo në Jerusalem, por në Romë).

■ **“Simonin e Kirenës”** Kirenaika ishte provincë e Afrikës së Veriut. Kirena ishte kryeqyteti i saj. Megjithatë, emri Simon ishte emër jude. Nga Veprat mësojmë se nga kjo zonë kishte shumë judenj (shih Veprat 2:10; 6:9; 11:20; 13:1). Identiteti i tij racor është i paqartë. Aty kishte dhe judenj zezakë nga koha e Solomonit dhe mbretëreshës së Shebës (pra, nga Etiopia).

■ **“babai i Aleksandrit dhe Rufusit”** Me sa duket, ky përshkrim i hollësishëm nënkupton se Simoni dhe/ose fëmijët e tij ishin bërë të mirënjohur në kishën e hershme. Meqë Marku u shkrua për romakët, ndoshta Rufusi te Rom. 16:13 është i njëjti person.

■ **“kryqin”** Romakët përdornin forma të ndryshme kryqi: T, X, t, ose një skelë me një sërë trarësh vertikalë. Të gjitha këto forma janë gjetur nga gërmimet arkeologjike si të përdorura në Palestinën e shekullit të parë.

TEKSTI I NASB (I PËRDITËSUAR): MARKU 15:22-26

²²Pastaj, e sollën në vendin e Golgotës, që përkthehet, Vendi i Kafkës. ²³U përpoqën t’i jepnin verë të përzier me mirë; por ai nuk e piu. ²⁴Dhe e kryqëzuan dhe ndanë rrobat e tij me njëri-tjetrin, duke hedhur short për to për të vendosur se çfarë do të merrte secili. ²⁵Ishte ora e tretë kur e kryqëzuan. ²⁶Mbishkrimi i akuzës kundër tij lexonte: “MBRETI I JUDENJVE”.

15:22 “Golgotës” Kjo ishte fjalë aramaike. Fjala “kalvar” është latinisht, që do të thotë “kafkë”. Këto fjalë nuk nënkuptojnë gjithë kafkën, por vetëm ballin e saj. Kjo vendndodhje është e paqartë, por ishte jashtë mureve të vjetra të Jerusalemit ndoshta në një kodër të ulët dhe të zhveshur përbri një rruge kryesore që të çonte në qytetin e shenjtë (shih Lev. 24:14; Num. 15:35-36; Gjoni 19:20).

15:23 “U përpoqën t’i jepnin verë të përzier me mirë” Kjo është në kohën e pakryer, që do të thotë se u përpoqën disa herë. Tradita talmudike thotë se gratë e Jerusalemit e bënë këtë gjë si shërbesë ndaj të burgosurve të dënuar. Në thelb, ishte një drogë e fortë që qetësonte trurin dhe mpinte mendjen.

▣ **“por ai nuk e piu”** Arsyeja nuk dihet.

15:24 “e kryqëzuan” Romakët nuk i ngulnin gozhdët në pëllëmbët e duarve por në kyçet e duarve, ndërsa trupin i të dënuarit mbahej kryesisht me litarë rreth sjetullave. Këmbët i rrinin disi të përthyera, dhe shputat i gozhdoheshin te një kuti e vogël trekëndore. Kjo bëhej që ta detyronte të dënuarin të ngrihej vazhdimisht lart me qëllim që të merrte fryë. Kishte dhe një copë të vogël druri, që quhej samar, në të cilin mund të ulej i dënuari dhe ta mbështeste për pak kohë peshën e trupit. Shumica e të kryqëzuarve vdisnin nga asfiksioni. I dënuari qëndronte pezull mbi tokë aq lart sa këmbët t’i rrinin rreth 30 centimetra mbi tokë.

▣ **“ndanë rrobat e tij me njëri-tjetrin”** Ushtarët romakë që kryqëzonin të dënuarit i mbanin zotërimet e tyre si pjesë të pagesës.

▣ **“duke hedhur short”** Kjo ishte parathënë në Psa. 22:18. Ky psalm përshkruan kryqëzimin e Jezusit (tipologji kristologjike). Jezusi citon rreshtin e parë të këtij Psalmi në Marku 15:34. Po kështu, Psa. 22:7-8 parathotë dhe komentet e atyre që kalonin aty pari dhe talleshin me Jezusin (shih Marku 15:29).

15:25 “ora e tretë” Në Gjoni 19:14 thuhet “ora e gjashtë). Ungjijtë sinoptikë përdorin vazhdimisht orën judaike, ndërsa Gjoni, shpesh (por jo gjithmonë) përdorte orën romake.

▣ **“e kryqëzuan”** Shkruesit e ungjillit nuk luajnë me ndjenjat tona; nuk përshkruajnë hapat mizore fizike që ndiqeshin për kryqëzimin. Çështja teologjike nuk është mënyra (ndonëse Lip. 21:23 është e rëndësishme; shih Gal. 3:13) si vdiq ai, por kush është ai dhe përse vdiq!

15:26

NASB, NRSV,

NJB,

NKJV

TEV

“Mbishkrimi... lexonte”

“Mbishkrimi... i shkruar më sipër”

“Lajmërimi i akuzës kundër tij thoshte”

Informacioni që ky mbishkrim ishte në tri gjuhë vjen nga Gjoni 19:20. Ndërsa informacioni se ai ishte ngulur mbi kokën e Jezusit vjen nga Mat. 22:37.

KJV dhe NKJV e përkthejnë Markun 15:26 në një mënyrë që nënkupton se teksti thotë qartazi “sipër”, por fjala “mbishkrim” përsëritet te folja, që do të thotë “gdhend, mbishkruaj, shkruaj mbi diçka”, por jo “sipër”.

▣ **“i akuzës lexonte”** Kjo shenjë e vogël quhej *titulus* nga romakët. Zakonisht, shkruhej me shkronja të zeza mbi një sfond të bardhë. Akuza zyrtare (1) mbahej përpara të dënuarit, ose (2) varej rreth qafës së tij. Në vendin e kryqëzimit, ia vunë mbi kokë Jezusit në kryq (shih Mat. 27:37). Shih *Manners and Customs of the Bible*, nga James M. Freeman, f. 395-6.

▣ **“MBRETI I JUDENJVE”** Është interesante kur vërejmë larminë mes ungjijve për fjalët e sakta të akuzës së vendosur mbi kryet e Jezusit në kryq.

1. Mat. 27:37 – “Ky është Jezusi, mbreti i judenjve”

2. Marku 15:26 – “mbreti i judenjve”

3. Luka 23:38 – “Ky është mbreti i judenjve”

4. Gjoni 19:19 – “Jezus Nazareasi, mbreti i judenjve”

Secili ndryshon por, në thelb, janë njësoj. Kjo vlen për shumicën e hollësive historike në ungjijtë. Secili shkrues i vendosi kujtimet (ose burimet) e veta në mënyra disi të ndryshme, por gjithsesi të gjitha janë dëshmi okulare.

Pilati donte t’i acaronte krerët e judenjve duke vendosur në kryqin e Jezusit vetë titullin të cilit ata i druheshin më tepër (shih Marku 15:21-22).

TEKSTI I NASB (I PËRDITËSUAR): MARKU 15:27-32

²⁷Bashkë me të kryqëzuar dhe dy kusarë, njërin në të majtë dhe tjetrin në të djathtë të tij. ²⁸[Dhe u përmbush Shkrimi që thotë, “Dhe ai u numërua me shkelësit.”] ²⁹Ata që kalonin aty pari hidhnin sharje kundër tij, tundnin kokën dhe thoshin: “Ha! Ti je ai që do të shkatërrojë tempullin dhe do ta rindërtojë në tri ditë. ³⁰Shpëto veten dhe zbrit nga kryqi!” ³¹Në të njëjtën mënyrë, edhe krerët e priftërinjve, bashkë me skribët, po e tallnin Jezusin me njëri-tjetrin dhe thoshin: “Ai shpëtoi të tjerët; por veten nuk e shpëton dot”. ³²“Le të zbresë tani nga kryqi ky Krishti, mbreti i Izraelit, që ta shohim dhe të besojmë!” Edhe ata që ishin kryqëzuar me të po e fyenin.

15:27 “me të... dy kusarë” Kjo fjalë ka kuptimin “plaçkitës” ose “kryengritës”. Kjo është përmbushje e veçantë of Isa. 53:12.

Psalmi 22 dhe Isa. 52:13-53:12 janë specifike në disa hollësi, por jo në gjithçka! Leximi i këtyre lloj profecish mesianike është shuëm i vështirë për shkak se vetëm disa hollësi vlejné për situatën e Jezusit. Disa të tjera duhet të kenë qenë (1) simbolike; (2) poetike; ose (3) lidheshin vetëm me situatën historike fillestare. Vetëm përmes frymëzimit të autorëve të DHR bën sens kjo lloj tipologjie kristologjike. Besimtarët e sotëm udhëhiqen nga Fryma kur lexojnë Biblën (pra, përndritja), por nuk bien dakord për hollësitë, gjë që tregon se frymëzimi është më i lartë se përndritja.

Tiplogjia është abuzuar kaq shumë nga shkrimtarët pas DHR sa që unë s’e pranoj këtë lloj interpretimi biblik, përveçse nëse e gjej në autorët e DHR. Ne nuk mund t’i riprodhojmë procedurat hermeneutike të shkruesve të frymëzuar të Biblës. Për të kuptuar, duhet të mbështetemi në ato që thanë në kohën e tyre ata autorë origjinalë dhe të frymëzuar (shih Artikullin Hyrës, “Leximi i duhur biblik”). Pastaj, ato të vërteta duhet t’i zbatojmë në situatën tonë kulturore.

15:28 Ky varg mungon në dorëshkrimet e lashta uncialë greke Sinaitikus, A, B, C dhe D. Mungon në përkthimet e NRSV, TEV, NJB dhe NIV. Me sa duket, një kopjues i lashtë e shtoi si shënim në anë të faqes në bazë të Lukës 22:37. Nuk është pjesë e tekstit origjinal të Markut. Është jashtë karakterit të Markut që, kur u shkruan johebrenjve, të përfshijë një citim nga DHV (shih Marku 15:28 si aludim i Isa. 53:12). UBS4 i jep mospërfshirjes së këtij vargu vlerësimin “A” (i sigurt).

15:29 “Ata që kalonin aty pari hidhnin sharje kundër tij” Ndoshta, në përputhje me qëllimin dhe procedurën e kryqëzimit romak, vendi i ekzekutimit gjendej në një rrugë kryesore që hynte në Jerusalem. Këta kalimtarë mund të kenë qenë përmbushje e profecisë së Psa. 22:6-8, 12-13, 16-17.

▣ **“Ha! Ti je ai që do të shkatërrojë tempullin”** Këta tallës mund të kenë qenë ata akuzues të rremë që ishin të pranishëm në gjyqin e natës së Sinedrit (shih Marku 14:58).

15:30 Ky koment është tallje e vazhdueshme (shih Marku 15:31-32) e fuqive të Jezusit. Ata ende donin një shenjë të mrekullueshme, edhe në këtë moment të vonët. Pretendonin se do të besonin në të (shih Marku 15:32).

15:31 “Ai shpëtoi të tjerët” Fjala “shpëtoi” përdoret në kuptimin e DHV, pra, për çlirimin fizik. Këta drejtues nuk i mohonin dot mrekullitë e Jezusit, por ia atribuonin Satanit (shih Marku 3:22). Populli i Jerusalemit ishte shumë i vetëdijshëm se Jezusi e kishte ringjallur Lazarit (shih Gjoni 11).

15:32 “Krishti, mbreti i Izraelit” Kjo është tallje e krerëve të priftërinjve me titullin e Pilatit, “mbreti i judenjve”, që ishte gozhdur mbi kokën e Jezusit. Kjo është sarkazëm, jo miratim!

Dhe ajo përputhet me talljen që parathuhet në Psa. 22:6-8, 12-13, 16.

▣ **“Edhe ata që ishin kryqëzuar me të po e fyenin”** Vetëm në Luka 23:35-43 përmendet rrëfimi i kriminelit të penduar.

TEKSTI I NASB (I PËRDITËSUAR): MARKU 15:33-39

³³Kur erdhi ora e gjashtë, errësira ra mbi gjithë vendin deri në orën e nëntë. ³⁴Në orën e nëntë, Jezusi bërtiti me zë të lartë: “Eloi, Eloi, lama sabaktani?”, që përkthehet: “Perëndia im, Perëndia im, pse më ke braktisur?” ³⁵Kur disa nga ata që po rrinin aty e dëgjuan, filluan të thoshin: “Ja, po i thërret

Elisë”. ³⁶Dikush vrapoi dhe mbushi një sfungjer me verë të thartuar, e vendosi në një kallam dhe ia dha ta pinte, duke thënë: “Le të shohim nëse do të vijë Elija që ta zbresë”. ³⁷Dhe Jezusi lëshoi një bërtitje të fortë dhe dha shpirt. ³⁸Dhe perdja e tempullit u ça më dysh, nga maja në fund. ³⁹Kur centurioni, që po qëndronte përpara tij, pa mënyrën sesi dha shpirt, tha: “Me të vërtetë, ky njeri ishte Biri i Perëndisë!”

15:33 “ora e gjashtë” Nëse përdoret ora judaike, i bie të ketë qenë 12 e drekës. Shih shënimin në Marku 15:1.

■ **“errësira ra mbi gjithë vendin”** Kjo është një nga shenjat e gjykimit në DHV, ose në kuptimin e besëlidhjes (p.sh., një nga murtagjat e Egjiptit, shih Eks. 10:21; LiP. 28:28-29), ose në kuptimin apokaliptik (shih Joeli 2:2; Amosi 8:9-10; Sof. 1:15). Kjo simbolizonte faktin se Perëndia Atë e largoi praninë e vet nga Biri i tij, i cili po mbartte mëkatën e gjithë njerëzimit. Kësaj i frikësohej Jezusi më shumë se gjithçkaje në Gjetseman (e simbolizuar nga: “Perëndia im! Perëndia im! Pse më ke braktisur?” në Marku 15:34). Jezusi u bë ofertë për mëkatën dhe mbarti mëkatën e gjithë botës (shih 2 Kor. 5:21). Ai përjetoi ndarjen personale nga Ati. Errësira ishte simbol fizik i momentit kur Ati Perëndi i ktheu shpinën Birit të vet.

15:34 “Në orën e nëntë” Nëse përdoret koha judaike, ishte ora 3 e pasdites.

■ **“Perëndia im, Perëndia im, pse më ke braktisur”** Ky është citim i Psa. 22:1. Meqë pergamenat judaike nuk kishin ndarje në kapituj dhe vargje (këto iu shtuan Biblës në mesjetë). Me sa duket, duke cituar vargun e parë, Jezusi donte të theksonte gjithë Psalmin.

Mendimi i studiuesve ndahet në lidhje me mënyrën si duhet përkthyer kjo frazë:

1. Septuaginta e përkthen: “O Perëndi, Perëndia im, më ndihmo” (që ndodh në Psalmet)
2. Peshita (e përkthyer nga George M. Lamsa) thotë:
 - a. Psa. 22:1: “Perëndia im, Perëndia im, pse më ke lejuar të jetoj?”
 - b. Marku 15:34: “Perëndia im, Perëndia im, për këtë më kurseve!”
3. Shoqëria Botuese Judaice e Amerikës e përkthen Psa. 22:1 kështu: “Perëndia im, Perëndia im, pse më ke braktisur?”
4. Kodiku i Bezës (shekulli i pestë) thotë: “Perëndia im, Perëndia im, pse më ke fyer?” Për një diskutim të plotë të problemeve gnostiek që lidhen me këtë varg, shih Bart D. Erhman, *The Orthodox Corruption of Scripture: The Effect of Early Christological Controversies on the Text of the New Testament*, f. 143-145.

Jezusi po përjetonte masën e plotë dhe të fundit të mëkatit njerëzor: ndarjen nga bashkësia me Atin (shih Isa. 54:2). Njerëzit janë krijuar për bashkësi me Perëndinë; pa të, nuk do të mund të jemi kurrë të plotë!

15:34, 35 “po i thërret Elisë” Jezusi dhe apostujt (si dhe gjithë judenjtë në Palestinën e shekullit të parë) flisnin aramaisht. Marku, që u shkruan romakëve, i përkthen gjithmonë këto fraza aramaisht, që Pjetrit i kujtohen shumë mirë. Në aramaisht, Elia është Elia. Kjo frazë aramaisht regjistrohët dhe në Mat. 27:46. Kjo është fjalia më e habitshme që Jezusi bërtiti në kryq. U ndie i tëhuajtur nga Ati. Tradicionalisht, Elia ishte profeti që do të vinte në kohë të vështira dhe përpara Mesisë (shih Mal. 3:1-6; 4:4-6), prandaj, kalimtarët mendonin se Jezusi po lutej që Elia të vinte dhe ta ndihmonte.

Një nga autorët e mi të preferuar është F. F. Bruce. Në librin e tij *Answers to Questions*, f. 65, ai përmend një artikull në *Palestine Exploration Quarterly*, janar-prill 1951, nga Alfred Guillaume, ku vëren se prapashtesa “ime” gjendet në Pergamenat e Detit të Vdekur si *ija*. Kur Jezusi tha, “Perëndia im”, forma duhet të ketë qenë *Elia*, që kishte shqiptim shumë të ngjashëm me emrin e Elisë. Kjo mund të shpjegojë pse ata që rrinin pranë kryqit i keqkuptuan fjalët e Jezusit.

15:36 “me verë të thartuar” Kjo ishte vera e lirë që pinte popullata dhe ushtarët. Ndoshta, lidhet me Psa. 22:15. Jezusi ishte kaq i etur sa që i duhej një gllënjë që ta ndihmonte të thoshte fjalët e fundit nga kryqi (shih Gjoni 19:28-30).

■ **“e vendosi në një kallam”** Kallami u përdor që t’ia vinte sfungjerin te goja. T’i jepje për të pirë njeriut të kryqëzuar nuk ishte vepër dhembshurie, por një mënyrë për t’ia zgjatur jetën dhe agoninë.

■ **“Le të shohim nëse do të vijë Elija që ta zbresë”** Kjo nuk ishte nga dhembshuria e tyre, por nga dëshira për të parë një shenjë (shih Mat. 27:47-48).

15:37 “një bërtitje të fortë” Gjoni 19:30 na thotë se Jezusi tha: “U bë!” Kjo fjalë gjendet në shumë dokumente tregtie në papiruset e greqishtes koine nga Egjipti. Me sa duket, ishte term tregtar që donte të thoshte: “u pagua plotësisht” (shih Isaia 53).

15:38 “perdja e tempullit u çua më dysh, nga maja në fund” Në faktoren e brendshme të tempullit kishte dy perde, njëri në Vendin e Shenjtë, dhe tjetri përpara Shenjtërores së Shenjtërove. Nëse ajo që u çua ishte perdja e dytë, askush s’mund ta ketë parë përveç priftërinjve, përveçse nëse perdja e parë hapej shpesh dhe lidhej anash. Këto perde përshkruhen në Eks. 26:31-37. Në kohën e Jezusit, në tempullin e riparuar të Herodit, kjo perde ishte 60 x 30 inç, dhe rreth 4 inç e trashë! Nëse ajo që u çua ishte perdja e jashtme, duhet ta kenë parë të gjithë adhuruesit në oborret e ndryshme e të jashtme të tempullit. Ndoshta, kjo tregonte se tani, nëpërmjet vdekjes së Krishtit, Perëndia na ka rihapur udhën për të patur bashkësi të ngushtë me të (shih Zan. 3:15; Eks. 26:31-35). Në Mat. 27:51-53, shënohen mrekulli të tjera si shenja miratuese.

15:39 “centurioni” Ky ishte rangi i një oficeri romak të nivelit të ulët. Fjalë për fjalë, do të thotë “drejtues i qindshes”. Këta burra ishin shtylla e ushtrisë romake. Edhe Korneli, në Veprat 10, ishte centurion. Marku u shkrua për të ungjillizuar romakët!

■ **“Me të vërtetë, ky njeri ishte Biri i Perëndisë”** Fjalë për fjalë, “ky njeri ishte bir i Perëndisë”. Megjithatë, mungesa e një shquese nuk nënkupton automatikisht se fjala është e pacaktuar (shih Mat. 4:3, 6; 14:33; 27:43; dhe Luka 4:3, 9). Ky ishte ushtar romak me përvojë. Kishte parë shumë burra të vdisnin (shih Mat. 27:54). Ky mund të jetë “pasazhi qendror” i Markut pasi ky ungjill u shkrua posaçërisht për romakët. Përmban shumë fjalë latinisht dhe shumë pak citime nga DHV. Po kështu, zakonet judaike dhe frazat aramaike përkthehen dhe shpjegohen. Ky centurio romak po rrëfente besimin në një kryengritës të kryqëzuar jude!

Ndoshta, është kuptimplotë nga ana teologjike që kalimtarët, krerët e priftërinjve, madje dhe të dënuarit e tjerë tallen me Jezusin kurse centurioni romak përgjigjet me miratim dhe mahnitje!

TEKSTI I NASB (I PËRDITËSUAR): MARKU 15:40-41

⁴⁰Ishin dhe disa gra që vështronin nga larg, mes të cilave ishte Marie Magdalena, dhe Maria nëna e Jakobit të vogël dhe Joseut, si dhe Salomeja. ⁴¹Kur Jezusi ishte në Galile, ato e ndiqnin dhe i shërbenin; kishte dhe shumë gra të tjera që erdhën me të nga Jerusalemi.

15:40 “Ishin dhe disa gra që vështronin nga larg” Grupi apostolik shërbehej financiarisht nga disa gra (pra, me gatim, larje rrobash, etj.; shih Marku 15:41; Mat. 27:55; Luka 8:3).

TEMË E VEÇANTË: GRATË NË BIBËL (SPECIAL TOPIC: WOMEN IN THE BIBLE)

- I. Dhiata e Vjetër
 - A. Nga ana kulturore, gratë konsideroheshin prona
 - 1. përfshiheshin në listën e pronave (Eks. 20:17)
 - 2. trajtimi i skllaveve (Eks. 21:7-11)
 - 3. betimet e grave ishin të anulueshme nga meshkuj të përgjegjshëm nga ana sociale (Numrat 30)
 - 4. gratë si plaçka lufte (Ligji i Përtërirë 20:10-14; 21:10-14)
 - B. Praktikisht, ekzistonte një reciprocitet
 - 1. meshkujt dhe femrat të krijuara në shëmbëllimin e Perëndisë (Zan. 1:26-27)
 - 2. nderoni babanë dhe nënën (Eks. 20:12 [LiP. 5:16])
 - 3. kini nderim për babanë dhe nënën (Levitiku 19:3; 20:9)
 - 4. burrat dhe gratë mund të ishin naziritë (Num. 6:1-2)
 - 5. bijat kishin të drejtë trashëgimie (Num. 27:1-11)
 - 6. pjesë e popullit të besëlidhjes (Ligji i Përtërirë 29:10-12)

7. zbato mësimin e babait dhe nënës (Fja. 1:8; 6:20)
 8. bijtë dhe bijat e Hemanit (familje levite) drejtonin muzikën në tempull (1 Kron. 25:5-6)
 9. bijtë dhe bijat do të profetizojnë në epokën e re (Joeli 2:28-29)
- C. Gratë ishin në role udhëheqjeje
1. motra e Moisiut, Miriami, quhej profeteshë (Eks. 15:20-21, shih dhe Mikea 6:4)
 2. gratë që kishin dhunti nga Perëndia për të endur materiale për tabernakullin (Eks. 35:25-26)
 3. një grua, Debora, që ishte edhe profeteshë (shih Gjyq. 4:4), u priu gjithë fiseve (Gjyq. 4:4-5; 5:7)
 4. Hulda ishte profeteshë, të cilës mbreti Josia i bëri thirrje të lexonte dhe të interpretonte “Librin” e sapogjetur “të Ligjit” (2 Mbret. 22:14; 2 Kro. 34:22-27)
 5. mbretëresha Ester, një grua e perëndishme, shpëtoi judenjtë në Persi
- II. Dhiata e Re
- A. Nga ana kulturore, si në judaizëm ashtu dhe në botën romake, gratë ishin qytetare të dorës së dytë, me pak të drejta apo privilegje (me përjashtim të Maqedonisë).
- B. Gratë në role udhëheqjeje
1. Elizabeta dhe Maria, gra të perëndishme në dispozicion të Perëndisë (Luka 1-2)
 2. Ana, gruaja e perëndishme që shërbente në tempull (Luka 2:36)
 3. Lidia, besimtare dhe drejtuese e një kishe shtëpiake (Veprat 16:14, 40)
 4. Katër bijat e virgjra të Filipit ishin profeteshë (Veprat 21:8-9)
 5. Febja, dhjake e kishës në Kenkrea (Rom. 16:1)
 6. Priska (Prishila), bashkëpunëtorja e Palit dhe mësuesja e Apollos (Veprat 18:26; Rom. 16:3)
 7. Maria, Trifena, Trifoza, Persisi, Julia, motra e Nereut, një sërë grash bashkëpunëtoreshë të Palit (Rom. 16:6-16)
 8. Junia (KJV), ndoshta një grua apostull (Rom. 16:7)
 9. Evodia dhe Sintika, bashkëpunëtoreshë të Palit (Fil. 4:2-3)
- III. Si t’i drejtpeshojë shembujt e ndryshëm biblikë besimtarë të kohës së sotme?
- A. Si të përcaktojmë të vërtetat historike ose kulturore, që vlejné vetëm për kontekstin fillestar, dhe të vërtetat e përgjithshme që vlejné për të gjitha kishat, për të gjithë besimtarët e të gjitha kohëve?
1. Duhet të marrim shumë seriozisht synimin e autorit të frymëzuar fillestar. Bibla është Fjala e Perëndisë dhe i vetmi burim për besimin dhe praktikën.
 2. Duhet të ballafaqohemi me pasazhet e frymëzuara që, dukshëm, janë të kushtëzuara nga ana historike.
 - a. Kulti (pra, rituali dhe liturgjia) e Izraelit (shih Veprat 15; Gal. 3)
 - b. Judaizmi i shekullit të parë
 - c. Thëniet e kushtëzuara historikisht të Palit në 1 Korintasve
 - (1) sistemi ligjor i Romës pagane (1 Kor. 6)
 - (2) qëndrimi në skllavëri (1 Kor. 7:20-24)
 - (3) beqaria (1 Kor. 7:1-35)
 - (4) virgjëreshat (1 Kor. 7:36-38)
 - (5) ushqimi që u flijohet idhujve (1 Kor. 8; 10:23-33)
 - (6) veprime të padenja në Darkën e Zotit (1 Kor. 11)
 3. Perëndia e zbuloi plotësisht dhe qartazi veten në një kulturë të veçantë dhe në një kohë të veçantë. Ne duhet të marrim seriozisht zbuluesën, por jo çdo aspekt të përshtatjes së saj historike. Fjala e Perëndisë u shkrua me fjalë njerëzore dhe iu drejtua një kulture të caktuar në një kohë të caktuar.
- B. Interpretimi biblik duhet të kërkojë synimin e autorit fillestar. Çfarë po i thoshte ai ditës së vet? Kjo është themelore dhe kyçe për interpretimin e sakte. Por, më tej, këtë duhet ta zbatojmë në kohën tonë. Tani, këtu qëndron problemi me gratë në udhëheqje (problemi i vërtetë interpretues mund të jetë përcaktimi i termit. A kishte shërbesa të tjera përveç pastorëve që konsideroheshin udhëheqje? A shiheshin si drejtuese dhjaket ose profeteshat? Është shumë e qartë se Pali, në 1 Kor. 14:34-35 dhe 1 Tim. 2:9-15, po pohon se gratë nuk duhet të marrin

drejtimin në adhurimin publik! Por si ta zbatoj këtë në kohën time? Nuk dua që kultura e Palit, apo e imja, t'i mbyllë gojën Fjalës dhe vullnetit të Perëndisë. Ndoshta, koha e Palit ishte tepër kufizuese, por ndoshta koha ime mund të jetë tepër e hapur. S'ndihem fare rehat të them se fjalët dhe mësimet e Palit janë të vërteta të kushtëzuara, situatore, lokale të shekullit të parë. Kush jam unë që t'i lejoj mendjes ose kulturës sime të mohojnë një autor të frymëzuar?!

Nga ana tjetër, si t'ia bëj kur gjej shembuj biblike për gratë drejtuese (edhe në shkrimet e Palit, shih Romakëve 16)? Një shembull i qartë i kësaj është diskutimi që i bën Pali adhurimit publik në 1 Korintasve 11-14. Në 11:5, ai duket se lejon predikimin dhe lutjen e grave në adhurimin publik, por me koka të mbuluara, ndërsa në 14:34-35 kërkon që ato të qëndrojnë në heshtje! Kishte dhjake (shih Rom. 16:1) dhe profetesa (shih Veprat 21:9). Është pikërisht kjo larmi që më jep lirinë t'i identifikoj komentet e Palit (në lidhje me kufizimet për femrat) si tipare që vlenin vetëm për Korintin dhe Efesin e shekullit të parë. Në të dyja ato vende kishte probleme me femrat që ushtronin lirinë e tyre të sapogjetur (shih Bruce Winter, *After Paul Left Corinth [Pasi Pali la Korintin]*), gjë që mund të ketë shkaktuar vështirësi për kishën që të ungjillizonte shoqërinë për Krishtin. Liria e tyre duhej kufizuar në mënyrë që ungjilli të ishte më i efektshëm.

Koha ime është plotësisht e kundërt me atë të Palit. Në kohën time, ungjilli mund të kufizohet nëse grave të trajnuara, që dinë të flasin, nuk u lejohej të ndajnë ungjillin ose të drejtojnë! Cili është synimi absolut i adhurimit publik? A nuk është ungjillizimi dhe dishepullizimi? A mund të nderohet dhe kënaqet Perëndia nga gratë drejtuese? Bibla në tërësi duket se thotë "po"!

Unë dua t'i nënshtrohem Palit; teologjia ime është kryesisht paliane. Nuk dua që të ndikohem ose manipulohem nga feminizmi modern! Megjithatë, mendoj se kisha ka qenë e ngadaltë për të reaguar ndaj të vërtetave të qarta biblike, si papranueshmëria e skllavërisë, racizmit, fanatizmit dhe seksizmit. Po kështu, ajo ka reaguar shumë me vonesë ndaj abuzimit të femrave në botën e sotme. Perëndia, në Krishtin, e çliroi skllavin dhe femrën. Unë nuk guxoj që të lejoj një pasazh të kufizuar nga ana kulturore që t'i fusë sërish nën pranga.

Dhe një pikë e fundit: si interpretues, unë e di se Korinti ishte një kishë shumë problematike. Dhuntitë karizmatike vlerësoheshin dhe përdorshin për t'u mburrur. Në këtë gjë mund të jenë përfshirë dhe femrat. Po kështu, besoj se Efesi po ndikohej nga mësuesit e rremë, të cilët po përfitonin nga gratë dhe po i përdornin si folëse zëvendësuese në kishat shtëpiake të Efesit.

C. Sugjerime për lexime të mëtejshëm

How to Read the Bible For All Its Worth [Si të lexosh Biblën për gjithë vlerën që ka], Gordon Fee dhe Doug Stuart (f. 61-77)

Gospel and Spirit: Issues in New Testament Hermeneutics [Ungjilli dhe Fryma: Çështje në hermeneutikën e Dhiatës së Re], Gordon Fee

Hard Sayings of the Bible [Thënie të vështira në Bibël], Walter C. Kaiser, Peter H. Davids, F. F. Bruce, dhe Manfred T. Branch (f. 613-616; 665-667)

■ **“Marie Magdalena”** Magdala ishte një qytet i vogël në bregun e Detit të Galileesë, 4.5 kilometra në veri të Tiberiadës. Maria e ndoqi Jezusin nga Galilea pasi ai e çliroi nga disa demonë (shih Luka 8:2). Ajo është etiketuar padrejtësisht si prostitutë, ndonëse nuk ka asnjë të dhënë në DHR për këtë. Shih Temën e Veçantë në Marku 16:1.

■ **“Maria, nëna e Jakobit të vogël dhe Joseut”** Në Mat. 27:56 ajo quhet “nëna e Jakobit dhe Jozefit”. Në Mat. 28:1, quhet “Maria tjetër”. Pyetja e vërtetë është: me kë ishte martuar ajo? Në Gjoni 19:25, ndoshta ajo ishte martuar me Klopën, por biri i saj Jakobi, thuhet se ishte “biri i Alfeut” (shih Mat. 10:3; Marku 3:18; Luka 6:15). Shih Temën e Veçantë në Marku 16:1.

■ **“Salomeja”** Kjo ishte nëna e Jakobit dhe Gjonit, që ishin pjesë e rrethit të brendshëm të dishepujve të Jezusit, si dhe gruaja e Zebedeut (shih Mat. 27:56; Marku 15:40; 16:1-2). Shih Temën e Veçantë: Gratë që ndiqnin Jezusin në Marku 16:1.

TEKSTI I NASB (I PËRDITËSUAR): MARKU 15:42-47

⁴²Kur ra nata, për shkak se ishte dita e përgatitjes, pra dita para shabatit, ⁴³erdhi Jozefi i Arimatesë, një anëtar i spikatorit i Këshillit, i cili po e priste vetë mbretërinë e Perëndisë; dhe ai mori guximin dhe hyri përpara Pilatit dhe i kërkoi trupin e Jezusit. ⁴⁴Pilati pyeti nëse kishte vdekur tashmë, dhe si thirri centurionin, e pyeti nëse kishte vdekur tashmë. ⁴⁵Dhe, si u sigurua për këtë nga centurioni, ia dha trupin e Jezusit Jozefit. ⁴⁶Jozefi solli çarçaf, e zbriti nga kryqi, e mbështolli me çarçaf dhe e shtriu në një varr që ishte gërmuar në shkëmb; dhe rrotulloi një gur te hyrja e varrit. ⁴⁷Marie Magdalena dhe Maria, nëna e Joses, po vështronin për të parë se ku e vunë Jezusin.

15:42 “Kur ra nata” Marku është i vetmi ungjill që e përmend këtë. Eksodi 12:6 thotë “netë” si të kishte dy të tilla: (1) 3:00-6:00 e pasdites dhe (2) 6:00 e darkës e më vonë. Konteksti nënkupton se duhet të ketë qenë pas orë 3:00 pasdite (koha e flijimit të darkës), por përpara 6:00 e darkës (fillimi i shabatit të Pashkës).

▣ **“dita e përgatitjes”** Bëhet fjalë për ditën kur duhej bërë gjithçka gati për shabatin e lartë e të shenjtë të javës së Pashkës (pra, Pashka dhe Bukët e Ndorme ishin festë tetëditëshe, prandaj, kishte dy shabate), jo për vetë vaktin e Pashkës.

15:43 “Jozefi i Arimatesë” Me sa duket, ishte dishepull i fshehtë, bashkë me Nikodemin (shih Mat. 27:57; Gjoni 12:42). Mirëpo, pas vdekjes së Jezusit, ai shkoi publikisht që t’ia kërkonte Pilatit trupin e Jezusit (shih Gjoni 19:38). Ishte e rrezikshme të identifikohesh si miku i një kryengritësi të kryqëzuar.

Si jude ortodokës në kohën e tij, Jozefi duhet ta ketë bërë veten ceremonialisht të papastër për të kremtuar shabatin e Pashkës për shkak se

1. shkoi në shtëpinë e një pagani
2. preku një kufomë

Megjithatë, ai ndoshta po përpiquej të largonte mallkimin e LiP. 21:22-23. Zakonisht, romakët i linin trupat e të kryqëzuarve të pavarrosur në vendin ku vdisnin, por meqë judenjtë ishin shumë pedantë për trupat e pavarrosur romakët i lejonin që t’i varrosnin të vdekur, ndonëse, zakonisht, jo aty për aty.

Fjala “Arimatea” do të thotë “lartësi” dhe, me sa duket, ishte një tjetër emër i qytetit të Ramës, që ishte 7.5 km në verilindje të Jerusalemit.

▣ **“anëtar i spikatorit i Këshillit”** Jozefi ishte anëtar i Sinedrit, njësoj si Nikodemi. Shih Temën e Veçantë: Sinedri në Marku 12:13.

▣ **“po e priste vetë mbretërinë e Perëndisë”** Jozefi ishte njeri fetar (shih Mat. 27:58). Mbretëria e Perëndisë ishte një shpresë e përhapur judaike ndër farisenjtë dhe ndër popullin e zakonshëm. Jezusi predikoi shpeh për këtë temë. Ishte tema e predikimit të tij të parë dhe të fundit, si dhe fokusi i shëmbëlltyrave të tij. Shih Temën e Veçantë në Marku 1:15.

Në ç’kuptim po e priste Jozefi mbretërinë është e paqartë. Si mund të ishte dishepull dhe të mos e dinte që mbretëria pati ardhur? Ndoshta, ai ende po priste një mbretëri tokësore (si dishepujt, shih Vepra 1:6).

▣ **“hyri përpara Pilatit dhe i kërkoi trupin e Jezusit”** Kjo do ta ketë bërë ceremonialisht të papasër për të marrë pjesë në shabatin e lartë të javës së Pashkës. Po kështu, kjo duhet ta ketë identifikuar me Jezusin, një kryengritës i kryqëzuar. Ky ishte një akt i guximshëm dhe vendimtar.

▣ **“i kërkoi trupin”** Zakonisht, romakët i linin kufomat të kalbeshin në kryq, si parandalues për revolta. Këta trupa ishin pronë e Romës. Zakonisht, nuk iu ktheheshin familjeve për t’i varrosur si duhet, gjë që ishte tejet e rëndësishme për judenjtë. Kjo ishte kërkesë e veçantë dhe e pazakontë. Pilati ia pranoi kërkesën për shkak të ndjeshmërisë judaike për faktin se kufomat e ndosnin ceremonialisht vendin, sidomos gjatë kohës së Pashkës.

15:44 “Pilati pyeti nëse kishte vdekur tashmë” Kryqëzimi të sillte vdekje shumë të ngadaltë dhe të dhimbshme. Shpesh, duheshin ditë që të vdiste i kryqëzuar. Usharët romakë i jepnin herë pas here viktimës ujë ose verë, jo nga mëshira, por që t’ia vononin vdekjen. Mirëpo, kësaj here të dënuarit duhet të vdisnin shpejt për shkak se po vinte shabati i Pashkës, kështu që ushtarët ua thyen këmbët dy kriminelëve (shih Gjoni 19:31 e më tej). Këtë e bën me qëllim që të mos mbështeteshin mbi këmbë për të marrë frymë. Kjo do t’i bënte të vdisnin shpejt. Mirëpo

Jezusi kishte vdekur tashmë, kështu që nuk ia thyen këmbët. Kjo përmbushi profecinë (shih Gjoni 19:36, që citon Eks. 12:46. Shih komentin hermeneutik në Marku 15:27).

“Nëse” nuk tregon se kemi të bëjmë me fjali kushtore, por përbën pyetje të tërthortë. Pilati u mahnit që Jezusi vdiq kaq shpejt, prandaj ua bërë këtë pyetje ndihmësve të vet.

15:46 “trupin” Fjala në greqisht nuk është *soma*, por *ptoma*, që do të thotë “kufomë”. Jezusi kishte vdekur!

15:46 “Jozefi solli çarçaf, e zbriti nga kryqi, e mbështolli me çarçaf” Aty ishte dhe Nikodemi (shih Gjoni 19:39-40). Ia përgatitën shpejt e shpejt trupin Jezusit (për shkak të afrimit të shabatit në orën 6 të darkës) sipas traditës judaike. Judenjtë nuk e praktikonin balsamosjen si egjiptianët, por kishin një procedurë të caktuar, ku kufomën e mbështillnin me rripa çarçafi dhe erëza.

▣ **“e shtriu në një varr që ishte gërmuar në shkëmb”** Kjo përmbushi profecinë e veçantë të Isa. 53:9. Mat. 27:57-60 na thotë se ky ishte varri personal i Jozefit.

▣ **“i gërmuar në shkëmb”** Jezusi nuk u varros në tokë, por në kriptën e familjes së Jozefit. Ajo ishte gërmuar në një faqe shkëmbore dhe duhet të ketë patur disa pllaka të ndryshme ku vendoseshin trupat e të vdekurve. Kishte shumë varre të tilla në zonën e Jerusalemit.

▣ **“gur”** Kjo pllakë e madhe dhe e rrumbullaktë guri kishte formën e gurit të mullirit. Këto varre plaçkiteshin shpesh, kështu që i vulosnin me një gur të rëndë. Madhësia e gurit tregonte se ishte varri i një të pasuri.

15:47 “po vështronin për të parë se ku e vunë Jezusin” Kjo fjalë do të thotë “shoh me kërshtëri dhe vëmendje”. Ato donin të siguroheshin që Jezusi do të përgatitej siç duhet për varrim. Sidoqoftë, kjo siguroi dhe dy dëshimtarët e nevojshëm (shih LiP. 17:6; 19:15) për të vërtetuar dëshminë nga ana ligjore. Jezusi kishte vdekur dhe ato nuk shkuan në varrin e gabuar!

PYETJE PËR DISKUTIM

Ky është një komentari studimor udhëzues, që do të thotë se ti je vetë përgjegjës për interpretimin e Biblës. Secili prej nesh duhet të ecë sipas dritës që ka. Ti, Bibla dhe Fryma e Shenjtë keni përparësi në interpretim. Nuk duhet t’ia dorëzosh këtë të drejtë komentuesit.

Këto pyetje për diskutim t’i kam dhënë për të të ndihmuar që të analizosh çështjet kryesore të kësaj pjese të librit. Ato synojnë të të nxisin mendimin, jo të kenë natyrë shteruese.

1. Kush e arrestoi Jezusin? (pra, flisni për përbërjen e turmës)
2. Pse ishte i parregullt gjykimi i Jezusit, edhe sipas standardeve judaike?
3. Sa shërbëtoresh ishin në vargjet 66-69: një apo dy?
4. Pse ishte kaq i nervozuar Pjetri në oborr?
5. Lexo rrëfimet e gjykimeve të Jezusit në të katërt ungjijtë dhe përpilo listën tënde kronologjike.
6. Nëse është e mundur, përshtroaj motivin e Pilatit në gjithë këtë histori.
7. Si mund ta shpjegojmë sjelljen e turmës?
8. Pse u tallën me Jezusin ushtarët? Sa grupe të ndryshëm u tallën me të?
9. Rendit mënyrat e ndryshme si u tallën me Jezusin.
10. Ku e kryqëzuan Jezusin?
11. Pse u ndie i braktisur nga Ati Jezusi (shih Marku 15:34)?
12. Pse është Marku 15:39 një nga vargjet kyçe në ungjillin e Markut?
13. Pse donte Jozefi që ta varroste shpejt Jezusin?

MARKU 16

NDARJET NË PARAGRAFË TË PËRKTHIMEVE MODERNE

UBS ⁴	NKJV	NRSV	TEV	NJB
Ringjallja	Ai është ngritur	Pashka e parë	Ringjallja	Varri bosh. Mesazhi i engjëjve.
16:1-8	16:1-8	16:1-8	16:1-5 16:6-7 16:8	16:1-2 16:3-8

CIKLI TRE I LEXIMIT (shih f. v)

NDJEKJA E SYNIMIT TË AUTORIT FILLESTAR NË NIVELIN E PARAGRAFËVE

Ky është një komentuar studimor udhëzues, që do të thotë se ti je vetë përgjegjës për interpretimin e Biblës. Secili prej nesh duhet të ecë sipas dritës që ka. Ti, Bibla dhe Fryma e Shenjtë keni përparësi në interpretim. Nuk duhet t'ia dorëzosh këtë të drejtë komentuesit.

Lexo gjithë kapitullin njëherësh. Identifiko temat. Krahaso ndarjet e tua tematike me pesë përkthimet moderne. Ndarja në paragrafë nuk është e frymëzuar, por është çelësi për të ndjekur synimin e autorit fillestar, gjë që është thelbi i interpretimit. Secili paragraf ka vetëm një temë të vetme.

1. Paragrafi i parë
2. Paragrafi i dytë
3. Paragrafi i tretë
4. Etj.

KANONICITETI I VARGJEVE 9-20

- A. Unë nuk mendoj se vargjet 9-20 janë origjinale në ungjillin e Markut. Nuk janë të frymëzuara dhe nuk duhen përfshirë në Dhiatën e Re.
- B. Gjithçka pas vargut 8 mungon në dorëshkrimet e lashta uncialë greke të
 1. Sinaitikut, i njohur me shkronjën e parë të alfabetit hebre, א. Ky dorëshkrim përfshin gjithë DHR dhe vjen nga shekulli i katërt. Gjetet në manastirin e shën Katerinës në Xhebul Musa, vendi tradicional i malit Sinai.
 2. Vatikanusit, i njohur me shkronjën greke B. Ky dorëshkrim përfshin gjithë DHR përveç Zbulesës, dhe vjen nga shekulli i katërt.
Në kohën tonë, u gjet në bibliotekën e Vatikanit në Romë.
- C. Dëshmitari i tretë uncial për Dhiatën e Re greqisht, kodiku Aleksandrinus, njihet me shkronjën greqisht A. Ky dorëshkrim përfshin gjithë DHR dhe vjen nga shekulli i pestë. Është nga Aleksandria, Egjipt. Nuk e përfshin fundin e Markut (ai që gjendet në Tekstus Receptus dhe KJV). Ky fund i gjatë shfaqet për herë të parë në librin e Ireneut (120-202 pas K.) *Kundër Herezive* III:10:5; dhe në Diatesaronin e Ticianit (110-172 pas K), një harmoni e katër ungjijve. Megjithatë, Klementi i Aleksandrisë dhe Origeni i Aleksandrisë nuk i citojnë kurrë këto vargje, dhe as aludojnë për to. Kjo tregon se ky fund nuk ishte origjinal as në kodikun e Aleksandrinusit që vjen nga i njëjti qytet. Këto vargje u përfshinë në dorëshkrimin C, që vjen po ashtu nga Aleksandria diku në shekullin e pestë.
- D. Euzebi (275-340 pas K.), një historian i kishës së hershme i shekullit të katërt, tha se “kopjet më të sakta” përfundojnë në Marku 16:8.

- E. Jeronimi (347-420 pas K.), përkthyesi i Vulgatës latine, tha se pothuajse të gjitha dorëshkrimet greke nuk e përmbajnë fundin pas vargut 8.
- F. Vargjet 9-20 përmbajnë 14-17 fjalë që nuk përdoren më parë (ose përdoren ndryshe) te Marku. Kemi dhe një ndryshim të theksuar stili dhe sintakse. Po kështu, shenjat e qarta jobiblike të Markut 16:18 tregojnë natyrën jo të frymëzuar të këtyre vargjeve shtesë.
- G. Dorëshkrimet nga Egjipti (ato kopte) kanë katër funde të ndryshme pas vargut 8. Disa dorëshkrime greke përfshijnë fundin e gjatë (pra, Marku 16:9-20) dhe, pastaj, fundin e shkurtër, ose përmbajnë fundin e shkurtër dhe pastaj të gjatën, ose një nga fundet e tjera si kombinim.
1. Ja, një fund i shkurtër nga një dorëshkrim kopt: “Dhe të gjitha ato që ai urdhëroi Pjetrin dhe ata që ishin të tijtë, ata i përfunduan së treguari dhe, pas kësaj, Jezusi iu shfaq atyre; dhe që nga lindja e diellit e deri në perëndi, ai i dërgoi për të predikuar shpëtimin e përjetshëm me anë të ungjillit të shenjtë, i cili është i paprishshëm”.
 2. Ja një tjetër fund i shkurtër. “Por ata ia treguan shkurtimisht Pjetrit dhe atyre që ishin me të gjithçka që iu ishte thënë. Dhe, pas kësaj, vetë Jezusi dërgoi me anë të tyre, nga lindja në perëndim, shpalljen e shenjtë dhe të paprishshme të shpëtimit të përjetshëm”. Ky quhet “fundi i shkurtër” dhe gjendet në dorëshkrimin e vjetër latinisht K.
- H. Problemi kryesor është se ungjilli i Markut duket se përfundon tepër papritur në vargun 8. Ka shumë teori për këtë, por askush nuk e di me siguri përse Marku përfundon kaq papritmas me një fjali frike.
- I. Një shpjegim i mirë i këtij problemi tekstual gjendet në librin e Bruce M. Metzger, *A Textual Commentary on the Greek New Testament*, botuar nga United Bible Societies, f. 122-126, ose në librin e Robert G. Bratcher dhe Eugene Nida, *A Translator's Handbook on the Gospel of Mark*, botuar nga United Bible Societies, f. 517-522.
- J. Për një diskutim të shkurtër të kritikës së tekstit, shih Shtojcën Dy në fund të këtij komentari.

STUDIMI I FJALËVE DHE FRAZAVE

TEKSTI I NASB (I PËRDITËSUAR): MARKU 16:1-8

¹Kur përfundoi shabati, Marie Magdalena, dhe Maria nëna e Jakobit, si dhe Salomeja, sollën erëza që të vinin dhe ta vajosnin. ²Shumë herët, ditën e parë të javës, erdhën te varri pasi doli dielli. ³Ato po i thoshin njëra-tjetrës: “Kush do të na e rrotullojë gurin nga hyrja e varrit?” ⁴Kur ngritën sytë lart panë se guri ishte lëvizur nga vendi, ndonëse ishte i stërmadh. ⁵Si hynë në varr, panë një të ri që ishte ulur në të djathtë, i veshur me një rrobë të bardhë; dhe u habitën. ⁶Dhe ai u tha: “Mos u habitni; ju po kërkonte Jezus Nazareasin, që është kryqëzuar. Ai është ringjallur; nuk është këtu; ja, ky është vendi ku e kishin vendosur. ⁷Por shkoni, thajuni dishepujve dhe Pjetrit: ‘Ai po shkon përpara jush në Galile; aty do ta shihni, ashtu siç ju kishte thënë’”. ⁸Ato dolën dhe ikën me vrap nga varri, sepse i kishin mbërthyer frika dhe habia; dhe nuk i thanë asgjë kurrkujt, sepse kishin frikë.

16:1 “Kur përfundoi shabati” Izraelitët e lashtë e nisnin ditën në muzg (pra, në darkë), sipas Zan. 1:5, 8, 13, 19, 23, 31. Ndërsa romakët (dhe grekët) përdornin një metodë babilonase, që e ndante natën dhe ditën në dymbëdhjetë pjesë. Këto pjesë nuk kishin gjatësi të barabartë, për shkak të ndryshimeve stinore, dhe sjellin kohëzgjatje të ndryshme drite/errësire. Marku 15 përdor disa lloje të ndryshme matjeje kohore (p.sh., ora e tretë, Marku 16:25; ora e gjashtë, Marku 16:33; ora e nëntë, Marku 16:34).

Kjo frazë duket se përdor metodën e lashtë izraelite të kohës dhe, si rrjedhojë, shabati i bie të ketë qenë nga ora 6 e darkës së të premtës deri në orën 6 pasdite të së shtunës.

■ **“Marie Magdalena dhe Maria nëna e Jakobit, si dhe Salomeja”** Shih Temën e Veçanët në vijim.

TEMË E VEÇANTË: GRATË QË NDIQNIN JEZUSIN (SPECIAL TOPIC: THE WOMEN WHO FOLLOWED JESUS)

- A. Përmendja e parë e grave ndjekëse të Jezusit, që ndihmonin atë dhe grupin e apostujve, është Luka 8:1-3.
1. Maria, që quhej Magdalena (v. 2)
 - a. Mat. 27:56, 61; 28:1
 - b. Marku 15:40, 47; 16:1, 9
 - c. Luka 8:2; 24:10
 - d. Gjoni 19:25; 20:1, 11, 16, 18
 2. Joana, gruaja e Kuzës (shërbëtori i Herodit, v. 3), renditet edhe te Luka 24:10
 3. Suzana (v. 3)
 4. “dhe shumë të tjera që kontribuonin për mbështetjen e tyre nga pasuria e tyre personale” (v. 3)
- B. Një grup grash përmenden si të pranishme në kryqëzim
1. Lista e Mateut
 - a. Marie Magdalena (27:56)
 - b. Maria, nëna e Jakobit dhe Jozefit (27:56)
 - c. Nëna e bijve të Zebedeut (27:56)
 2. Lista e Markut
 - a. Marie Magdalena (15:40)
 - b. Maria, nëna e Jakobit të vogël dhe Jozeut (15:40)
 - c. Salomeja (15:40)
 3. Luka thotë vetëm “gratë që e shoqëronin nga Galileja” (23:49)
 4. Lista e Gjunit
 - a. Maria, nëna e Jezusit (19:25)
 - b. Motra e nënës së tij (19:25)
 - c. Maria e Kleopës [*tou Cleopas*, që mund të ketë kuptimin “gruaja e Kleopës”, ose “bija e Kleopës”] (19:25)
 - d. Marie Magdalena (19:25)
- C. Përmendet një grup grash që vëzhguan vendin e varrimit të Jezusit
1. Lista e Mateut
 - a. Marie Magdalena (27:61)
 - b. Maria tjetër (27:61)
 2. Lista e Markut
 - a. Marie Magdalena (15:47)
 - b. Maria, nëna e Jozes (15:47)
 3. Luka thotë vetëm “gratë që kishin ardhur me të nga Galileja” (23:55)
 4. Gjoni nuk thotë asgjë për gratë që panë varrin
- D. Një grup grash erdhën te varri të dielën herët në mëngjes
1. Lista e Mateut
 - a. Marie Magdalena (28:1)
 - b. Maria tjetër (28:1)
 2. Lista e Markut
 - a. Marie Magdalena (16:1)
 - b. Maria, nëna e Jakobit (16:1)
 - c. Salomeja (16:1)
 3. Lista e Lukës
 - a. “ato erdhën te varri” (24:1-5, 24)
 - (1) Marie Magdalena (24:10)
 - (2) Joana (24:10)
 - (3) Maria, nëna e Jakobit (24:10)
 4. Jakobi rendit vetëm Marie Magdalenën (20:1, 11)
- E. Gratë përmenden si të pranishme në dhomën e sipërme (Veprat 1:14)
1. “gratë” (1:14)

2. Maria, nëna e Jezusit (1:14)
- F. Marrëdhënia e saktë midis grave të ndryshme në këto lista të ndryshme është e paqartë. Qartazi, Marie Magdalena luan rol kryesor. Një artikull i mirë për “gratë” në jetën dhe shërbesën e Jezusit gjendet te *Dictionary of Jesus and the Gospels [Fjalor i Jezusit dhe i ungjijve]*, botuar nga IVP, f. 880-886.

▣ **“sollën erëza... ta vajosnin”** Ndonëse këto gra e kishin parë Jozefin dhe Nikodemin kur përgatitën dhe vendosën trupin e Jezusit në varr, me sa duket, për shkak të kufizimeve kohore (pra, mes orës 3-6 pasdite), ndoshta lanë pa kryer ndonjë pjesë të ritualit normale të varrimit judaik (ndoshta, s’ia vunë qirinjtë aromatikë, apo ndonjë lloj tjetër erëze), dhe këto gra donin që ta përfundonin plotësisht ritualin tradicional.

TEMË E VEÇANTË: ERËZAT E VARRIMIT (SPECIAL TOPIC: BURIAL SPICES)

- A. Mira, një rrëshirë aromatike nga pemë arabike (BDB 600, KB 629; shih UBS, *Fauna and Flora in the Bible*, f. 147-148)
 1. Kjo erëz përmendet dymbëdhjetë herë në DhV, kryesisht në letërsinë e urtësisë, si parfum
 2. Ishte një nga dhuratat që i sollën dijetarët foshnjës Jezus (shih Mat. 2:11)
 3. Simbolizmi i saj është goditës
 - a. përdorej në “vajin e shenjtë vajosës” (Eks. 30:23-25)
 - b. përdorej si dhuratë për mbretin (Mat. 2:11)
 - c. u përdor për të vajosur Jezusin kur e varrosën (shih Gjoni 19:39 dhe, simbolikisht, Gjoni 11:2). Kjo ishte sipas zakonisht jude të përshkruar në Talmud (p.sh., Berakhoth 53a)
 - d. përdorej nga gratë e Jerusalemit në një pije, që u jepej të dënuarve të rrahur me kamxhik dhe të nisur drejt vendit të kryqëzimit (Marku 15:23) për t’ua lehtësuar dhimbjet
- B. Aloet, një lloj druri aromatik (BDB 14 III, KB 19)
 1. lidhej me një parfum erëmirë (shih Num. 24:6; Psa. 45:8; Fja. 7:17; Kënga e Këngëve 4:14; shih UBS, *Fauna and Flora in the Bible*, f. 90-91)
 2. i përzier me mirë, përdorej nga egjiptianët si pjesë e procesit balsamosës
 3. Nikodemi solli një sasi të madhe të kësaj për varrimin e Jezusit dhe e vajosi Jezusin me të (shih Gjoni 19:39). Kjo ishte sipas zakonisht jude në Talmud (p.sh., Betsah 6a). Shih Temën e Veçantë: Ritet e Varrimit

16:2 “Shumë herët, ditën e parë të javës... pasi doli dielli” Të gjithë ungjijtë japin një periudhë kohore disi të ndryshme.

1. Mateu 28:1 thotë “në agim”
2. Luka 24:1 thotë “herët në agim”
3. Gjoni 20:1 thotë “ndërsa ishte ende errësirë”

Me sa duket, këto gra kishin dalë nga shtëpia ndërsa ishte ende errët, por kur mbërritën (ndoshta, iu desh të blinin dhe erëzat) në varr kishte zbardhur dit.

16:3 “Ato po i thoshin njëra-tjetrës” Kjo është në kohën e pakryer. Ato ishin vazhdimisht të shqetësuar dhe pyesnin vazhdimisht njëra-tjetrën teksa ecnin për te varri.

▣ **“Kush do ta na e rrotullojë gurin”** Kishin bërë tashmë goxha rrugë dhe kishin marrë erëzat me vete, kur iu kujtua guri i madh që kishte mbyllur varrin. Marku nuk na thotë asgjë për rojat dhe për vulën e Mat. 27:62-66.

Ky gur ishte i rrumbullakët dhe i ishte dhënë një formë e duhur për t’u futur në një kanal të pjerrët, i gërmuar në pjesën e përparme të gojës së dhomës në shkëmb. Ishte relativisht e lehtë që ta rrotulloje gurin për ta mbyllur varrin, por tejet e vështirë që ta largoje nga hyrja e varrit.

16:4 “Kur ngritën sytë lart” Me sa duket, ishin të dëshpëruara dhe po i mbanin sytë përtokë ngaqë vajtonin.

▣ **“guri ishte lëvizur nga vendi”** Nga Mat. 28:2, duket se guri ishte flakur tej nga vendi për shkak të një tërmeti (i shkaktuar nga një engjëll, shih Luka 24:4; Gjoni 20:12) dhe po dergjej përtokë.

■ **“ndonëse ishte i stërmadh”** Plaçkitja e varreve ishte diçka e zakonshme për shkak të vlerës së erëzave dhe objekteve të tjera të varrimit. Vendi dhe lloji i dhomës së varrit, si dhe madhësia e gurit, do të tregonin se ishte varri i një të pasuri (shih Isa. 53:9).

16:5 “Si hynë në varr” Gjoni 20:11 thotë se Maria hyri brenda varrit për të parë, kurse Luka 24:3 thotë se, të paktën në një moment të caktuar, brenda hynë gratë.

■ **“panë një të ri që ishte ulur në të djathtë”** Normalisht, Mateu përmend dy persona—dy demoniakë gerasenas, dy të verbër në Jeriko etj.,--por këtu është Luka dhe Gjoni që flasin për dy engjëj, ndërsa Marku dhe Mateu përmendin vetëm një.

Në Bibël, engjëjt zakonisht përshkruhen si meshkuj, përveçse te Zakaria 5:9-10.

■ **“i veshur me një rrobë të bardhë”** Një përshkrim më i plotë i veshjes së tij gjendet në Mat. 28:8 (shih Luka 24:4 thotë “një veshje vezulluese”).

16:6 “Mos u habitni” Kjo është urdhërore e tashme me pjesore mohore, që zakonisht nënkupton ndalimin e një veprimi që është në kryerje e sipër. Njerëzit gjithmonë mahnitën ose tmerrohen nga shfaqjet fizike të botës shpirtërore.

■ **“Jezus Nazareasin”** Shih shënimin e plotë në Makru 14:67.

■ **“që është kryqëzuar”** Kjo është pjesore e kryer pësore (shih Mat. 28:5). Ajo ka një nyje shquese dhe mund të jetë një titull: “I Kryqëzuar” (shih 1 Kor. 1:23; 2:2; Gal. 3:1). Kur ta shohim Jezusin, do t’ia shohim ende shenjat e kryqëzimit, sepse ato janë kthyer në medalje nderi dhe lavdie (shih 1 Kor. 15:4 dhe Zbu. 5:12). Jezusi është i vetmi Person i Trinisë që ka trup fizik.

■ **“Ai është ringjallur”** Ringjallja është shtylla qendrore e besimit të krishterë (shih 1 Kor. 15). Kjo tregon miratimin e Perëndisë për jetën dhe flijimin e Jezusit. Kjo është tematikë e përsëritur te Pjetri (shih Veprat 2:24-28,32, 3:15,26; 4:10; 5:30; 10:40; 1 Pje. 1:13, 3:18,21, dhe te Pali, Veprat 13:30,33,34,37; 17:31; Rom. 4:24, 8:11; 10:9; 2 Kor. 4:14). Ky është konfirmim i faktit se Ati e pranoi vdekjen zëvendësuese të Birit (shih 1 Kor. 15). Teologjikisht, të tre personat e Trinisë ishin veprues në ringjalljen e Krishtit: Ati (Veprat 2:24; 3:15; 4:10; 5:30; 10:40; 13:30, 33, 34; 17:31); Fryma (Rom. 8:11); dhe Biri (Gjoni 2:19-22; 10:17-18). Shih Temën e Veçantë: Ringjallja, në Marku 8:31.

■ **“ja, ky është vendi ku e kishin vendosur”** Bëhet fjalë për një nga vendet e sheshta në shkëmb brenda varrit të Jozefit. Gjoni 20:6-7 e përshkruan këtë vend varrimi bashkë me mënyrën si ishin vendosur rrobat e varrimit.

16:7 “Por shkoni, thuajuni dishepujve dhe Pjetrit” Pse përmendet në veçanti Pjetri? Sa i dashur dhe zemërbutë që është Zoti ynë (përmes engjëllit), që përmendi në veçanti Pjetrin, i cili e kishte braktisur dhe ndihej i lënduar! Pjetrit i kujtohet kjo!

■ **“Ai po shkon përpara jush në Galile”** Jezusi kishte paracaktuar një takim me dishepujt e vet në Galile pas ringjalljes. Dishepujt nuk i kuptonin rrjedhojat teologjike të kësaj ngjarjeje (shih Marku 14:28; Mat. 28:32; 28:7, 10; Gjoni 21; 1 Kor. 15:6). Unë mendoj se ky ishte vendi dhe koha kur u dha Porosia e Madhe.

16:8 “sepse i kishin mbërthyer frika dhe habia” Mateu 28:8 shton “me gëzim të madh”.

■ **“nuk i thanë asgjë kurrkujt”** A ishte kjo vetëm për momentin, apo thjesht nuk iu bindën mesazhit të engjëllit në Marku 16:7? Gjoni 20:1-10 na tregon se Maria e Magdalës u tregoi dishepujve për varrin bosh, por nuk përmend mesazhin e engjëllit.

■ **“sepse kishin frikë”** Ky ungjill përfundon kaq prerazi dhe me një shprehje kaq negative saqë, me sa duket, kopjuesit e lashtë u përpoqën t’i shtonin një lloj përmbylljeje.

16:9-20 Unë iu përkushtohem shkrimeve të frymëzuara apostolike si fjala e vërtetë e Perëndisë, si burimi i vetëm i besimit dhe praktikës. Gjithsesi, këto vargje nuk janë të frymëzuara, madje ndoshta janë dhe disi heretike (pirja e helmit, mbajtja e gjarpërinjve). Unë nuk pranoj të komentoj për to! Për një diskutim të plotë të këtij problemi tekstual, shih Bruce M. Metzger, *A Textual Commentary on the Greek New Testament*, f. 122-126.

PYETJE PËR DISKUTIM

Ky është një komentuar studimor udhëzues, që do të thotë se ti je vetë përgjegjës për interpretimin e Biblës. Secili prej nesh duhet të ecë sipas dritës që ka. Ti, Bibla dhe Fryma e Shenjtë keni përparësi në interpretim. Nuk duhet t'ia dorëzosh këtë të drejtë komentuesit.

Këto pyetje për diskutim t'i kam dhënë për të të ndihmuar që të analizosh çështjet kryesore të kësaj pjese të librit. Ato synojnë të të nxisin mendimin, jo të kenë natyrë shteruese.

1. Pse ekzistojnë këto dallime mes këtyre katër ungjijve?
2. Pse përfundon ungjilli i Markut në mënyrë kaq negative?
3. Pse është ringjallja shtylla qendrore e besimit të krishterë?

HYRJE PËR 1 PJETRIN

AUTORËSIA

- A. Të dhënat e brendshme për autorësinë e apostullit Pjetër
1. e shprehur qartë te 1 Pje. 1:1
 2. aludime për fjalët dhe përjetimet e jetës së Jezusit me të Dymbëdhjetët
 - a. shembuj të marrë nga E. G. Selwyn, *The First Epistle of St. Peter*, 1946
 - (1) 1 Pje. 1:3 – Gjoni 21:27
 - (2) 1 Pje. 1:7-9 – Luka 22:31; Marku 8:29
 - (3) 1 Pje. 1:10-12 – Luka 24:25 e më tej; Veprat 15:14 e më tej
 - (4) 1 Pje. 3:15 – Marku 14:29, 71
 - (5) 1 Pje. 5:2 – Gjoni 21:15 e më tej
 - b. shembuj të marrë nga Alan Stibbs, *The First General Epistle of Peter*, 1971
 - (1) 1 Pje. 1:16 – Mat. 5:48
 - (2) 1 Pje. 1:17 – Mat. 22:16
 - (3) 1 Pje. 1:18 – Marku 10:45
 - (4) 1 Pje. 1:22 – Gjoni 15:12
 - (5) 1 Pje. 2:4 – Mat. 21:42 e më tej
 - (6) 1 Pje. 2:19 – Luka 6:32; Mat. 5:39
 - (7) 1 Pje. 3:9 – Mat. 5:39
 - (8) 1 Pje. 3:14 – Mat. 5:10
 - (9) 1 Pje. 3:16 – Mat. 5:44; Luka 6:28
 - (10) 1 Pje. 3:20 – Mat. 24:37-38
 - (11) 1 Pje. 4:11 – Mat. 5:16
 - (12) 1 Pje. 4:13 – Mat. 5:10 e më tej
 - (13) 1 Pje. 4:18 – Mat. 24:22
 - (14) 1 Pje. 5:3 – Mat. 20:25
 - (15) 1 Pje. 5:7 – Mat. 6:25 e më tej
 3. fjalë dhe fraza të ngjashme me predikimet e Pjetrit në Veprat
 - a. 1 Pje. 1:20 – Veprat 2:23
 - b. 1 Pje. 2:7-8 – Veprat 4:10-11
 - c. 1 Pje. 2:24 – Veprat 5:30; 10:39 (sidomos përdorimi i fjalës greke *ksilon* për kryqin)
 - d. 1 Pje. 4:5 – Veprat 10:45
 4. krahasime me misionarë të tjerë të shekullit të parë
 - a. Silvani (Sila) – 1 Pje. 5:12
 - b. Marku (Gjon Marku) – 1 Pje. 5:13.
- B. Të dhënat e jashtme për autorësinë e apostullit Pjetër
1. e pranuar herët dhe gjerësisht nga kisha e hershme
 - a. fraza të ngjashme, ndoshta citime, nga Klementi i Romës në *Letrën drejtuar korintasve* (rreth 95 pas K.)
 - b. fraza të ngjashme, ndoshta citime, në *Letrën e Barnabës* (130 pas K.)
 - c. aludim nga Papia, peshkopi i Hieropolit (140 pas K.) në një citim nga libri i Euzebit *Historia e Kishës*
 - d. cituar nga Polikarpi në *Letrën drejtuar filipianëve* 8:1, por ai nuk e përmend 1 Pjetrin me emër (Polikarpi vdiq më 155 pas K.)
 - e. cituar nga Ireneu (140-203 pas K.)
 - f. cituar nga Origeni (185-253 pas K.). Origeni besonte se 1 Pje. 5:13, ku Pjetri e thërret Markun “biri im”, nënkupton se ai shkroi ungjillin e Pjetrit.
 - g. cituar nga Tertuliani (150-222 pas K.)
- C. Arsye për vënien në dyshim të autorësisë së apostullit Pjetër

1. nuk renditet në Fragmentin Muratorian, një listë me libra kanonikë e përpiluar në Romë mes viteve 180-200 pas K.
2. greqishtja e letrës është e mirë, madje greqishte *koine* elegante, që është e habitshme për një peshkatar galileas (të paarsimuar) (*agrammatos*, shih Veprat 4:13)
3. ngjason së tepërmi me shkrimet e Palit në Romakëve dhe Efesianëve
4. përskrimi i përndjekjes të 1 Pjetrit përputhet më mirë me një datë më të vonët
 - a. Domiciani (81-96 pas K.)
 - b. Trajani (98-117 pas K.)

D. Përgjigje të mundshme për preokupimet e studiuesve të sotëm

1. Fragmenti Muratorian është i dëmtuar dhe mungon me të paktën një rresht (shih B. F. Westcott, *A General Survey of the History of the Canon of the New Testament*, bot. 6, f. 289).
2. Pjetri nuk ishte i paarsimuar (shih Veprat 4:13), por thjesht i paedukuar në një shkollë të pranuar rabinike. Me sa dihet, shumica e judenjve në Galile ishin dygjuhësh që nga lindja. Problemi tjetër madhor në këtë diskutim është përdorimi i një letërshkruesi nga Pjetri. Fjalët e 1 Pje. 5:12 nënkuptojnë se ai mund të ketë përdorur Silvanin (Silën).
3. Si Pjetri, ashtu dhe Pali, citonin shpesh materiale liturgjike ose edukative (dokumente katekizmi) që njiheshin në kishën e hershme. Po kështu, patën kontakt me njëri-tjetrin gjatë viteve (shih Veprat, Galatasve dhe 2 Pje. 3:15-16).

Për mua, arsyeja më e mundshme për ngjashmërinë mes shkrimeve të Pjetrit dhe Palit është fakti se Pjetri mund të ketë përdorur si letërshkrues Silën (Silvanin), shoqëruesin misionar të Palit.

4. 1 Pjetrit nuk reflekton medoemos një përndjekje në mbarë perandorinë romake. Fakti se Pjetri do që besimtarët t'i nënshtrohen qeverisë (1 Pje. 2:13-17) do të ishte diçka e pazakontë në kohën e përndjekjes zyrtare të të krishterëve në mbarë perandorinë.

Sëmundja mendore në rritje (pra, pretendimet megalomaniake) e Neronit (54-68 pas K.) nxiti kultet lokale të perandorit, sidomos në Azinë e Vogël, gjë që nxiti dhe përndjekjet lokale. 1 Pjetrit përputhet më mirë me kohën e Neronit sesa me atë të Domicianit (81-96 pas K.) apo të Trajanit (98-117 pas K.). Madje, ka mundësi që një pjesë e përndjekjeve të ketë ardhur nga grupimet judaike, jo vetëm nga zyrtarët e qeverisjes lokale apo kultet perandorake.

E. 1 Pjetri vetë nuk përmban asgjë që të kërkojë një periudhë ose autor të mëvonshëm.

DATA

- A. Data lidhet qartazi me autorësinë e letrës.
- B. Tradita i lidh vdekjet e Pjetrit dhe Palit në Romë me kohën e Neronit, ndoshta rreth 65 pas K. Nëse është kështu, 1 Pjetri duhet të jetë shkruar rreth vitit 63-64 pas K.
- C. Një datim i mesit të shekullit të parë është i mundshëm nëse 1 Pjetri aludohet nga Klementi i Romës (shih 95 pas K.).
- D. A. T. Robertson beson se Pjetri vdiq më 67-68 pas K. dhe se e shkroi 1 Pjetrit më 65-66 pas K. Unë mendoj se ai vdiq më 64-65 pas K. dhe se letrën e shkroi pak para vdekjes.

MARRËSIT E LETRËS

- A. Siç ndodh rëndom në letrat e shekullit të parë, marrësit përmenden në 1 Pje. 1:1 si “ata që banojnë si të huaj të shpërndarë në mbarë Pontin, Galatinë, Kapadokinë, Azinë dhe Bitininë”. Këto provinca romake (nëse supozojmë se Galatia është Galatia etnike e veriut) ndodhen në Turqinë e sotme veriore. Këto zona, me sa duket, ishin vende të paungjillizuara nga Pali (shih Veprat 16:6) apo nga Pjetri (shih 1 Pje. 1:12). Ndoshta, këto kisha u mbollën nga judenjtë e krishterë që ishin kthyer në shtëpi pas Rrëshajëve (shih Veprat 2:9-11).

- B. Ndonëse këto kisha, në fillim, mund të jenë mbjellë nga besimtarë judenj, në kohën e letrës së Pjetrit ishin kthyer në kisha kryesisht me johebrenj
1. më parë nuk e njihnin Perëndinë (1:14)
 2. mënyra të kota jetese, të trashëguara nga paraardhësit (1 Pje. 1:18)
 3. tani janë populli i Perëndisë (1 Pje. 2:9-10, lojë fjalësh me Osea 1:9-10; 2:23)
 4. ishin ndër johebrenjtë (1 Pje. 2:12)
 5. listat me veset e johebrenjve (1 Pje. 4:3-4)
- C. Kjo letër përmban dhe elemente judaike
1. përdorimi i fjalëve “të huaj” dhe “diasporë” nënkupton një kontekst judaik (shih Gjoni 7:35; Veprat 7:6)
 2. përdorimi i Shkrimeve të DHV
 - a. Eksodi 19 (shih 1 Pje. 2:5, 9)
 - b. Isaia 53 (shih 1 Pje. 1:19; 2:22, 24, 25)
 Megjithatë, këto shembuj nuk reflektojnë medoemos një kishë judaike, por
 1. transferimin e titujve të DHV nga Izraeli te kisha (p.sh., “mbretëri priftërinjsh”)
 - a. 1 Pje. 2:5
 - b. 1 Pje. 2:9
 2. një dokument trajnimi për kishën (pra, materiale katekizmi për besimtarët e rinj), që përdorte pasazhe mesianike nga DHV
 - a. 1 Pje. 1:19 – Isaia 53:7 (pra, Qengji)
 - b. 1 Pje. 2:22 – Isaia 53:5
 - c. 1 Pje. 2:24 – Isaia 53:4, 5, 11, 12
 - d. 1 Pje. 2:25 – Isaia 53:6
- D. Ndonëse Pjetri ishte thirrur në veçanti për t’u shërbyer judenjve (shih Gal. 2:8), ai, ashtu si dhe Pali, punonte, edhe me judenjtë, edhe me johebrenjtë (shih Veprat 10). Kthimi në besim i Kornelit i tregoi Pjetrit natyrën rrënjësisht përfshirëse të ungjillit! 1 Pjetrit e reflekton këtë botëkuptim të ri.

QËLLIMI

- A. 1 Pjetrit ka edhe një aspekt doktrinor, edhe një aspekt praktik. Megjithatë, ndërsa Pali i ndante letrat e veta në një pjesë fillimi doktrimore dhe një pjesë përmblyllëse zbatuese, Pjetri i bashkon këto të dyja. Libri i tij është shumë më i vështirë që ta përvijosh. Në shumë mënyra, i ngjan më tepër një predikimi se një letre.
- B. Çështja kryesore që diskutohet është vuajtja dhe përndjekja. Kjo bëhet në dy mënyra.
1. Jezusi paraqitet si shembulli absolut i vuajtjes dhe refuzimit (shih 1 Pje. 1:11; 2:21, 23; 3:18; 4:1, 13; 5:1).
 2. Ndjekësit e Jezusit thirren ta imitojnë modelin dhe sjelljen e Jezusit (shih 1 Pje. 1:6-7; 2:19; 3:13-17; 4:1, 12-19; 5:9-10).
- C. Në dritën e vuajtjes dhe përndjekjeve, që ishin kaq të përhapura në vitet e hershme të krishterimit, nuk është e habitshme që Ardhja e Dytë përmendet kaq shpesh. Ky libër, ashtu si dhe shumica e shkrimeve të DHR është eskatologjik fund e krye.

GJINIA LETRARE

- A. Ky libër përmban një hapje dhe përmblyllje tipike për letrat greko-romake të shekullit të parë
1. 1 Pje. 1:1-2
 - a. Autori
 - b. Marrësit
 - c. Lutja

2. 1 Pje. 5:12-14
 - a. Përshëndetjet përmbyllëse
 - (1) nga kush
 - (2) për kë
 - b. Lutja
- B. Trupi kryesor i letrës i ngjan më tepër një predikimi sesa një letre. Disa mendojnë se, në fillim, ishte
 1. një predikim
 2. një liturgji pagëzimore
 3. pjesë të kombinuara të një materiali katekizmi nga kisha e hershme
- C. Letra duket se përmbillet në 1 Pje. 4:11 me një doksologji, por asnjë dorëshkrim grek nuk përfundon në këtë pikë. Ka gjasa që 1 Pje. 4:12-5:11 të jetë një përmbledhje e qëllimshme e gjithë letrës.
- D. Unë, personalisht, besoj se 1 Pjetrit funksionon si letër qarkore për kishat që nuk i kishte mbjellë personalisht Pjetri; i ngjan Kolosianëve të Palit (që iu dërgua kishave në Kolos, Laodicea dhe Hierapolis, shih Kol. 4:13), por shërben dhe si inkurajim i përgjithshëm për besimtarët që t'u ruhen problemeve të ardhshme, njësoj si letrat e Galatasve dhe Efesianëve të Palit.

Kjo gjini e letrave qarkore shpjegon mungesën e një hyrjeje dhe përmbylljeje personale të kësaj letre. Po kështu, shpjegon mungesën e shembujve të shkoqur të përndjekjes.

KANONIZIMI

- A. Unë përmend dhe kategorinë e kanonizimit të 1 Pjetrit për shkak se kjo çështje është tejet e polemizuar në rastin e 2 Pjetrit.
- B. 1 Pjetrit renditet nga Euzebi në *Historinë e Kishës* 3:3:25 si pjesë e “librave të padiskutueshëm”. Në kishën e hershme, ajo nuk u dyshua kurrë si letër e vërtetë e apostullit Pjetër.
- C. Çështja e kanonizimit koklavitet për shkak të numrit të shkrimeve të rreme që i atribuohen Pjetrit. Kisha e hershme nuk i pranoi kurrë këto letra, por pranoi vetëm 1 Pjetrin dhe letrën e debatuar të 2 Pjetrit si të shkruara vërtet nga apostulli Pjetër.
 1. *Veprat e Pjetrit*
 2. *Veprat e Pjetrit dhe Andreas*
 3. *Veprat e Pjetrit dhe Palit*
 4. *Mundimi i Pjetrit dhe Palit*
 5. *Veprat e Pjetrit dhe të Dymbëdhjetëve*
 6. *Apokalipsi i Pjetrit*
 7. *Ungjilli i Pjetrit*
 8. *Mundimi i Pjetrit*
 9. *Predikimi i Pjetrit*
 10. *Veprat Sllavonike të Pjetrit*

(Për një diskutim të secilës prej këtyre shkrimeve pseudonimike, shih *Zondervan Pictorial Encyclopedia of the Bible*, vëll. 4; f. 721-723, 732-733, 740). Asnjëra prej këtyre shkrimeve, që gjoja i shkroi Pjetrit, nuk u konsiderua ndonjëherë seriozisht si pjesë e kanonit të DHR. Kjo, në vetvete, është tregues i fortë i përfshirjes së 1 dhe 2 Pjetrit në DHR.

CIKLI NJË I LEXIMIT (nga “Udhëzues për leximin e mirë biblik”)

Ky është një komentari studimor udhëzues, që do të thotë se ti je vetë përgjegjës për interpretimin e Biblës. Secili prej nesh duhet të ecë sipas dritës që ka. Ti, Bibla dhe Fryma e Shenjtë keni përparësi në interpretim. Nuk duhet t'ia dorëzosh këtë të drejtë komentuesit.

Lexo gjithë librin biblik njëherësh. Shprehe idenë qendrore të librit me fjalët e tua.

1. Ideja e gjithë librit.
2. Lloji i letërsisë (gjinia letrare)

CIKLI DY I LEXIMIT (nga “Udhëzues për leximin e mirë biblik”)

Ky është një komentuar studimor udhëzues, që do të thotë se ti je vetë përgjegjës për interpretimin e Biblës. Secili prej nesh duhet të ecë sipas dritës që ka. Ti, Bibla dhe Fryma e Shenjtë keni përparësi në interpretim. Nuk duhet t’ia dorëzosh këtë të drejtë komentuesit.

Lexo gjithë librin biblik njëherësh për herë të dytë. Përvijoj temat kryesore dhe shprehe temën me një fjali.

1. Tema e njësisë së parë letrare.
2. Tema e njësisë së dytë letrare.
3. Tema e njësisë së tretë letrare.
4. Tema e njësisë së katërt letrare
5. Etj.

1 PJETRIT 1:1-2:3

NDARJET NË PARAGRAFË TË PËRKTHIMEVE MODERNE*

UBS ⁴	NKJV	NRSV	TEV	NJB
Përshëndetja	Përshëndetje shtegtarëve të zgjedhur	Përshëndetjet	Hyrje	Adresa dhe përshëndetjet
1:1-2	1:1-2	1:1-2	1:1a 1:1b-2a 1:2b	1:1-2
Shpresa e gjallë	Trashëgimia qiellore	Gëzohuni në shpëtimin	Shpresa e gjallë	Hyrja dhe trashëgimia e të krishterëve
1:3-9	1:3-12	1:3-9	1:3-5 1:6-9	1:3-5 Besnikëria ndaj Krishtit dhe dashuria e Krishtit 1:6-9 Shpresa e profetëve
1:10-12		1:10-12	1:10-12	1:10-12
Thirrje për jetë të shenjtë	Jeta përpara Perëndisë, Atit tonë	Thirrje për shenjtëri (1:13-2:10)	Thirrje për jetë të shenjtë	Kërkesat e jetës së re dhe shenjtëria e të sapopagëzuarve
1:13-16	1:13-21	1:13-16	1:13-16	1:13-21
1:17-21	Fjala e qëndrueshme	1:17-21	1:17-21	Rilindja me anë të Fjalës
1:22-25	1:22-2:3	1:22-2:3	1:22-25	1:22-2:3

CIKLI TRE I LEXIMIT (shih f. v)

NDJEKJA E SYNIMIT TË AUTORIT FILLESTAR NË NIVELIN E PARAGRAFËVE

Ky është një komentuar studimor udhëzues, që do të thotë se ti je vetë përgjegjës për interpretimin e Biblës. Secili prej nesh duhet të ecë sipas dritës që ka. Ti, Bibla dhe Fryma e Shenjtë keni përparësi në interpretim. Nuk duhet t'ia dorëzosh këtë të drejtë komentuesit.

Lexo gjithë kapitullin njëherësh. Identifiko temat. Krahaso ndarjet e tua tematike me pesë përkthimet moderne. Ndarja në paragrafë nuk është e frymëzuar, por është çelësi për të ndjekur synimin e autorit fillestar, gjë që është thelbi i interpretimit. Secili paragraf ka vetëm një temë të vetme.

1. Paragrafi i parë
2. Paragrafi i dytë

* Ndonëse nuk janë të frymëzuara, ndarjet në paragrafë janë kyçe për të kuptuar dhe ndjekur synimin e autorit fillestar. Secili përkthim modern i ka ndarë dhe përmbledhur paragrafët. Secili paragraf ka një temë, të vërtetë, ose mendim qendror. Secili version e përmbledh atë temë në mënyrën e vet të veçantë. Kur të lexosh tekstin, pyet veten se cili përkthim i përshtatet logjikës tënde për temën dhe për ndarjet në vargje.

Në çdo kapitull, së pari duhet të lexojmë Biblën dhe të përpiqemi të identifikojmë temat e saj (paragrafët), pastaj ta krahasojmë njohurinë tonë me versionet moderne. Biblën mund ta kuptojmë vërtet vetëm pasi kuptojmë synimin e autorit fillestar duke dalluar logjikën dhe prezantimin e tij. Vetëm autori fillestar është i frymëzuar; lexuesit nuk kanë të drejtë t'ia ndryshojnë ose modifikojnë mesazhin. Lexuesit e Biblës kanë vërtet përgjegjësinë që ta zbatojnë të vërtetën e frymëzuar në kohën dhe jetën e tyre.

Vini re se të gjithë termat teknike dhe shkurtime shpjegohen plotësisht në këto dokumente: Përcaktime të termave gramatikore greqisht, Kritika e tekstit, dhe Fjalorth.

3. Paragrafi i tretë
4. Etj.

STUDIMI I FJALËVE DHE FRAZAVE

TEKSTI I NASB (I PËRDITËSUAR): 1 PJETRIT 1:1-2

¹Pjetri, apostull i Jezu Krishtit, atyre që banojnë si të huaj, të shpërndarë në mbarë Pontin, Galatinë, Kapadokinë, Azinë dhe Bitininë, të cilët janë zgjedhur ²sipas paranjohjes së Perëndisë Atë, me anë të veprës shenjtëruese të Frymës, për t’iu bindur Jezu Krishtit dhe për t’u spërkatur me gjakun e tij: hiri dhe paqja qofshin tuajat me mbushulli.

1:1 “Pjetri” Pjetri ishte, qartazi, zëdhënësi i dymbëdhejtë apostujve. Ishte pjesë e rrethit të ngushtë (Pjetri, Jakobi dhe Gjoni). Dëshmia okulare e Pjetrit për jetën dhe mësimet e Jezusit (shih 1 Pje. 5:1) është shkruar në ungjillin e Markut (ndoshta, ungjilli i parë që u shkrua: ndoshta, u shkrua nga Marku në bazë të predikimeve të Pjetrit në Romë).

Marrëdhënia e veçantë e Jezusit me Pjetrin dokumentohet edhe te Mateu 16 dhe Gjoni 21. Megjithatë, kjo marrëdhënie e veçantë nuk u pranua si shenjë kryesimi. Pjetri si kreu (Papa) i krishtërimin perëndimor është një zhvillim historik (si dhe pikëpamja katolike për Marinë), jo një mësim i qartë biblik. 1 Pjetrit na hap një dritare për të kuptuar zemrën pastorale dhe jetën e vështirë të këtij udhëheqësi të mahnitshëm.

Fjala *petros* në greqisht do të thotë “gur i shkëputur”, në dallim nga *petra* (femërore) “shkëmb themeli” (shih Mat. 16:18); në aramaisht, të dyja përktheheshin *Kefas*; çdo dallim i mundshëm mes këtyre dy fjalëve greke mungonte në fjalët që Jezusi i tha Pjetrit (sepse i foli në aramaisht)!

■ **“apostull”** Në judaizmin rabinik, kjo fjalë përdorej me kuptimin “një i dërguar me autoritet”. Pjetri renditet gjithmonë i pari. Jezusi zgjodhi dymbëdhejtë prej dishepujve të tij që të ishin me të në një kuptim të veçantë dhe i quajti “apostuj” (shih Luka 6:13). Shpesh, kjo fjalë përdoret dhe për Jezusin, si i dërguari nga Ati (shih Matt. 10:40; Marku 9:37; Luka 9:48; Gjoni 4:34; 5:24,30,36,37,38; 6:29,38,39,40,57; 7:29; 8:42; 10:36; 11:42; 17:3,8,18,21,23,25; 20:21). Të dymbëdhejtët renditen në Mat. 10:1-4; Marku 3:13-19; Luka 6:12-16; Veprat 1:12-13.

■ **“Jezu”** Në hebraisht, ky emër ka kuptimin “JHVH shpëton”, ose “JHVH sjell shpëtim”. Ky emër iu zbulua prindërve të Jezusit nga një engjëll (shih Mat. 1:21). “Jezus” vjen nga fjala hebraisht për shpëtimin, *hosea*, që i bashkëngjitet emrit të besëlidhjes së Perëndisë: JHVH. Është i njëjti emër si Jozueu.

■ **“Krishtit”** Ky është ekuivalenti greqisht i fjalës hebraisht *mesia*, që do të thotë “i vajosur”. Nënkupton “dikë që është thirrur dhe pajisur nga Perëndia për një detyrë të caktuar”. Në DHV vajoseshin tre grupe drejtuesish: priftërinjtë, mbretërit dhe profetët. Jezusi i përmbush të tria këto ofiqe të vajosura (shih Heb. 1:2-3). Shih Temën e Veçantë: Vajosja në Bibël (BDB 630) në Marku 6:13.

NASB “atyre që banojnë si të huaj”

NKJV “shtegtarëve të diasporës”

NRSV “robërisë së Shpërndarjes”

TEV “popullit të zgjedhur të Perëndisë, që jetojnë si refugjatë”

NJB “atyre që jetojnë si të huaj”

Kjo letër qarkore iu dërgua bashkësive me shumicë johebrenjsh (1 Pje. 1:14, 18; 2:9-10, 12; 4:3-4). Shpesh, Pjetri përdor terminologjinë e DHV për të përshkruar kishën e DHR (shih 1 Pje. 2:5, 9).

■ **“të shpërndarë në mbarë”** Fjalë për fjalë do të thotë “diasporë”, që ka kuptimin “mbjell”. Kjo fjalë, zakonisht, përdoret nga judenjtë e Palestinës për të nënkuptuar judenjtë që jetonin jashtë Palestinës (shih Gjoni 7:35). Pjetri e përdor për kishat e përbëra nga besimtarë johebrenj dhe judenj në Azinë e Vogël veriore. Këta besimtarë, tani, janë qytetarë të qiellit (shih Fil. 3:20; Heb. 11:8-10, 13-16), por për gjithë pjesën e mbetur të jetës së tyre tokësore, ata jetojnë si të huaj dhe të robëruar.

■ **“Pontin, Galatinë, Kapadokinë, Azinë dhe Bitininë”** Ponti nuk ishte provincë romake. Kjo listë përmend kryesisht disa grupe racore. Duket se reflekton rrugën e mbartësit të kësaj letre, që niste në Sinope në Detin e Zi dhe lëvizte në krahun e akrepave të orës deri në kthim në Bitini. Disa nga këto grupe përmenden si të pranishëm në ditën e Rrëshajëve (shih Veprat 2:9-11).

1:2 “të cilët janë zgjedhur sipas paranjohjes së Perëndisë Atë” Këtu theksohet fort sovraniteti i Perëndisë (që karakterizon 1 Pjetrin), që shpesh në DHV përdoret për të treguar faktin se Izraelin e zgjodhi JHVH (shih LIP. 4:37; 7:6-7; 14:2; Isa. 65:9). Në DHV, zgjedhja kishte të bënte me shërbesën; mirëpo, në DHR, kjo fjalë lidhet me shpëtimin shpirtëror.

Paranjohja (emri [*prognosis*] vetëm këtu dhe në Veprat 2:23; folja [*proginosko*] përdoret teologjikisht në Rom. 8:29; 11:2) nuk lidhet me përpjekjet ose meritën njerëzore (shih Efe. 2:8-9; 2 Tim. 1:9; Titit 3:5). Perëndia është sovran dhe gjithë historia është e tashme për të. Vetëm njerëzit e përjetojnë kohën si të shkuar, të tashme dhe të ardhme. Mos harroni se Pjetri, zëdhënasi i grupit të apostujve dhe mohuesi i Zotit, është ai që i shkroi këto fjalë. Pjetri u zgjodh për shkak të karakterit të Perëndisë, jo për shkak të karakterit të vet! Hiri i Perëndisë nuk ka të bëjë me paranjohjen, përndryshe shpëtimi do të bazohej në një veprim të ardhshëm njerëzor.

Trinia shihet aktive këtu: Ati (1 Pje. 1:3-50, Biri (1 Pje. 1:6-9) dhe Fryma e Shenjtë (1 Pje. 1:10-12). Fjala “Trini” nuk është term biblik, por Perëndia trium përmendet shpesh në kontekste të unifikuara. Shih Temën e Veçantë: Trinia në Marku 1:11.

TEMË E VEÇANTË: ZGJEDHJA/PARACAKTIMI DHE NEVOJA PËR NJË DREJTPESHIM TEOLOGJIK (SPECIAL TOPIC: ELECTION/PREDESTINATION AND THE NEED FOR A THEOLOGICAL BALANCE)

Zgjedhja është doktrinë e mahnitshme. Megjithatë, ajo nuk përbën thirrje për parapëlqime, por thirrje për të qenë kanal, instrument ose mjet për shpengimin e të tjerëve! Në Dhiatën e Vjetër, kjo fjalë përdorej pikësisht për shërbesë; në Dhiatën e Re, përdoret kryesisht për shpëtimin, i cili rezulton në shërbesë. Bibla nuk e pajton kurrë kontradiktën në dukje midis sovranitetit të Perëndisë dhe vullnetit të lirë njerëzor, por i pohon të dyja! Një shembull i mirë i tensionit biblik është Romakëve 9, që flet për zgjedhjen sovranë të Perëndisë, dhe Romakëve 10, që flet për përgjigjen e domosdoshme nga ana e njerëzimit (shih Rom. 10:11, 13).

Çelësi për të kuptuar këtë tension teologjik mund të jetë Efe. 1:4. Jezusi është njeriu i zgjedhur i Perëndisë dhe të gjithë janë mundësisht të zgjedhur në të (Karl Barth). Jezusi është “po”-ja e Perëndisë për nevojën e njerëzimit të rënë (Karl Barth). Po kështu, Efesianëve 1:4 na ndihmon në sqarimin e kësaj çështjeje kur pohon se synimi i paracaktimit nuk është qielli, por shenjtëria (ngjashmëria me Krishtin). Shpesh, ne joshemi nga dobitë e ungjillit dhe ia anashkalojmë përgjegjësitë! Thirrja (zgjedhja) e Perëndisë është, jo vetëm për përjetësinë, por edhe për kohën!

Doktrinat vijnë në marrëdhënie me të vërteta të tjera, jo si të vërteta të vetme dhe të shkëputura. Një analogji e mirë do të ishte yjësia përkundrejt një ylli të vetëm. Perëndia e paraqet të vërtetën me gjini letrare lindore, jo perëndimore. Nuk duhet ta largojmë tensionin që shkaktohet nga dyshet dialektike (paradoksale) të së vërtetave doktrinale (Perëndia si transcendent kundrejt Perëndisë si imanent; siguria përkundrejt nevojës për qëndrueshmëri; Jezusi si i barabartë me Atin kundrejt Jezusit si i nënshtruar ndaj Atit; liria e krishterë kundrejt përgjegjësisë së krishterë ndaj partnerit të besëlidhjes; etj.)

Koncepti teologjik i “besëlidhjes” bashkon sovranitetin e Perëndisë (i cili është gjithmonë ai që merr nismën dhe përcakton rendin e gjërave) me reagimin e detyrueshëm fillestar dhe të vazhdueshëm me besim dhe pendim nga ana e njerëzimit (shih Marku 1:15; Veprat 3:16, 19; 20:21). Ruhë që të mos e përdorësh vargje “provë” për njërën anë të këtij paradoksi duke zhvlerësuar anën tjetër të tij! Ki kujdes që të mos pohosh vetëm doktrinën ose sistemin tënd të parapëlqyer teologjik!

Shih këto Tema të Veçanta:

1. Zgjedhja/Paracaktimi dhe nevoja për drejtpeshim teologjik
2. Paracaktimi (kalvinizmi) kundrejt vullnetit të lirë njerëzor (arminianizmi)
3. Besëlidhja
4. Literatura lindore (paradokset biblike)

■ **“me anë të veprës shenjtëruese të Frymës”** “Shenjtëroj” vjen nga e njëjta rrënjë greqisht si dhe fjalët “shenjtor”, “i shenjtë”; në aramaisht, kjo rrënjë do të thotë “i veçuar për një detyrë të veçantë”. Besimtarët janë “të thirrurit, të veçuarit, dhe të caktuarit për një detyrë” (shih 2 Thes. 2:13, që është dhe pasazh për Trininë).

Kjo shpallje hyrëse për funksionet shpenguese të të tre personave të Trinisë në lidhje me problemin e mëkatit të njerëzimit të rënë është kyçe për të kuptuar ungujillin e Pjetrit.

1. Ati – zgjedhi
2. Fryma – shenjtëroi
3. Biri – dha jetën e vet

Meqë kjo frazë gjendet edhe në 2 Thes. 2:13 dhe në 1 Pje. 1:2, është interesante të hamendësojmë se mos ndoshta Silvani (shih 1 Pje. 5:12, ku quhet dhe Sila) mund të ketë qenë letërshkruesi që Pjetri përdori për të shkruar 1 Pjetrin, si dhe letërshkruesi që Pali përdori për të shkruar 1 dhe 2 Thesalonikasve (shih 1 Thes. 1:1; 2 Thes. 1:1). Ka një sërë shenjash të tilla gjatë gjithë 1 Pjetrit. Shih Temën e Veçantë: Personaliteti i Frymës në Marku 3:29. Kjo demonstroi dhe lirinë e kompozimit (pra, të fjalëve dhe frazave) që u jepej letërshkruese për frazimet e zakonshme liturgjike që përdorshin nga komuniteti i kishës së hershme.

■ **“për t’iu bindur Jezu Krishtit”** Bibla e paraqet marrëdhënien e njerëzimit me Perëndinë me fjalë të besëlidhjes. Perëndia merr gjithmonë nismën dhe përcakton planin, por njerëzimi duhet t’i përgjigjet me pendim, besim, bindje, shërbim dhe këmbëngulje. Ne jemi shpëtuar për të shërbyer! Bindja është kyçe (shih Luka 6:46; Efe. 2:10). Shih Temën e Veçantë: Besëlidhja në Marku 14:24.

■ **“dhe për t’u spërkatur me gjakun e tij”** Kjo është metaforë e DHV për

1. pastrimin dhe faljen (shih Lev. 14:1-7)
2. inaugurimin e librit të Besëlidhjes (shih Eks. 24:3-8)
3. vendosjen në një pozicion të ri (shih Eks. 29:20-22)

Flijimi i Jezusit (shih Isaia 53; Marku 10:45; 2 Kor. 5:21) u lejoi ndjekësve të tij që të pranohen, pastrohen, falen dhe që të marrin një marrëdhënie të re me Perëndinë (shih Heb. 10:22; 12:24). Besimtarët janë popull i blerë me gjak (i shpenguar) dhe i spërkatur me gjak (i shenjtëruar).

■ **“Hiri dhe paqja qofshin tuajat në masën më të plotë”** Kjo është e ngjashme me 2 Pje. 2:1 dhe Judën 2. Edhe Pali përdorte një hyrje të ngjashme në letrat e veta. Pjetri mund t’i ketë njohur letrat e Palit, sidomos Romakëve dhe Efesianëve, ose ndoshta të dy bashkë u bazuan në një traditë të përbashkët katekizmore (pra, materiale të përcaktuara edukimi për besimtarët e rinj) të shekullit të parë. Mos harroni se Sila mund të ketë shërbyer si letërshkrues për Pjetrin (shih 1 Pje. 5:12) dhe për Palin (shih 1 dhe 2 Thes. 1:1). Sila zëvendësoi dhe Gjon Markun, i cili ndoshta mësonte besimtarët e rinj. Nëse ka qenë kështu, edhe Sila duhet të ketë qenë i përfshirë në edukimin katekizmor dhe, si i tillë, e njihnte materialin e shkruar të kishës së hershme për besimtarët e rinj.

“Hiri dhe paqja” është një përshëndetje hyrëse unike për të krishterët, si dhe një pohim teologjik i përparësisë së karakterit të hirshëm të Perëndisë dhe veprave shpenguese që përgatitën terrenin për paqen e njerëzimit, një paqe e shkaktuar nga veprimet e Perëndisë triun (shih 1 Pje. 1:2). Paqja jonë është e mundshme vetëm për shkak të karakterit të Perëndisë dhe asaj që ka kryer ai.

Është disi e tepruar të themi se kjo hyrje e zakonshme letrë e krishterizuar është provë se Pjetri u shkroi edhe johebrenjve besimtarë (hiri, që është formë e krishterizuar e përshëndetjes greke, *haren*) dhe judenjve (paqe, që është përkthim i përshëndetjes tipike judaike *shalom*).

■ **“qofshin tuajat me mbushulli”** Kjo është shprehje e zakonshme hebraike në lutjet judaike (shih 1 Pje. 1:2; Juda 2).

TEKSTI I NASB (I PËRDITËSUAR): 1 PJETRIT 1:3-9

³I bekuar qoftë Perëndia dhe Ati i Zotit tonë Jezu Krisht, i cili, sipas mëshirës së tij të madhe, ka bërë që të lindemi sërish në një shpresë të gjallë përmes ringjalljes së Jezu Krishtit nga vdekja, ⁴që të marrim një trashëgimi që është e paprishshme, e panjollësuar dhe që nuk do të venitet, e rezervuar në qiell për ju, ⁵që jeni të mbrojtur nga fuqia e Perëndisë nëpërmjet besimit për një shpëtim të gatshëm për t’u zbuluar në kohën e fundit. ⁶Në këtë ju gëzoheni së tepërmi, ndonëse tani, për pak kohë, nëse është e nevojshme, jeni shqetësuar nga sprova të ndryshme, ⁷në mënyrë që prova e besimit tuaj, që është më i vyer se ari që priset, ndonëse i sprovuar me zjarr, të dalë në fund për përlëvdim, lavdi dhe nder në

zbulësën e Jezu Krishtit; dhe ndonëse nuk e keni parë atë, ju e doni,⁸ dhe ndonëse nuk e shihni tani, por besoni në të, ju gëzoheni së tepërmi me një gëzim të pashprehshëm dhe gjithë lavdi,⁹ duke marrë rrjedhjen e besimit tuaj: shpëtimin e shpirtit tuaj.

1:3 “I bekuar” Kjo fjalë (*evlogjitos*) nuk është si ajo e përdorur në Mateu 5 (*makarios*). Përdoret vetëm për Perëndinë në DHR. Nga kjo fjalë kemi marrë dhe fjalën “eulogji”. Kjo është e ngjashme me lavdërimin e Trinisë në Efe. 1:3-14; 1 Pje. 1:3-5 lidhet me Atin, 1 Pje. 1:6-9 me Birin, dhe 1 Pje. 1:10-12 me Frymën.

▣ **“Perëndia dhe Ati i”** Toma Akuina përpiqet ta provojë ekzistencën e Perëndisë duke u fokusuar në

1. modelimin
2. domosdoshmërinë logjike të një shkaku të parë, ose lëvizësi të parë.
3. shkakun dhe pasojën

Megjithatë, këto trajtojnë domosdoshmëritë filozofike dhe logjike njerëzore. Bibla na e zbulon Perëndinë me kategori personale që s’janë të disponueshme për arsyen ose hulumtimin njerëzor. Vetëm zbulesa na e zbulon Perëndinë si Atin e Zotit tonë Jezu Krisht. Shih Temën e Veçantë: Ati, në Marku 13:22.

▣ **“Zotit”** Fjala greqisht “Zot” (*kurios*) mund të përdoret në kuptimin e përgjithshëm, ose në një kuptim të zhvilluar teologjik. Pra, mund të ketë kuptimin “zotëri”, “padron”, “zot”, “bashkëshort”, ose “njeriu-Perëndi i plotë” (shih Gjoni 9:36, 38). Përdorimi i kësaj fjale në DHV (hebraisht, *adon*) erdhi nga ngurrimi i judenjve për të shqiptuar emrin e Perëndisë së besëlidhjes, JHVH, nga folja hebraisht “jam” (shih Eks. 3:14). Shih Temën e Veçantë: Emrat e Perëndisë në Marku 12:26. Ata kishin frikë mos shkelnin Urdhërimin: “Nuk do ta marrësh emrin e Zotit, Perëndisë tënd më kot” (shih Eks. 20:7; LiP. 5:11). Prandaj, judenjtë mendonin se, nëse nuk e shqiptonin si emër, nuk do ta përmendnin më kot. Kështu, kur lexonin Shkrimet, këtë fjalë e zëvendësonin me fjalën hebraisht *adon*, që kishte kuptim të ngjashëm me fjalën greke *kurios* (Zot). Autorët e DHR e përdornin këtë term për të përshkruar hyjninë e plotë të Krishtit. Frazja “Jezusi është Zot” ishte ndoshta rrëfimi publik i besimit dhe formulë pagëzimore e kishës së hershme (shih Rom. 10:9-13; 1 Kor. 12:3; Fil. 2:11).

▣ **“i cili, sipas mëshirës së tij të madhe”** Ky pasazh, që lartëson karakterin e Perëndisë Atë (1 Pje. 1:3-5) ndoshta reflekton një himn, poezi, ose liturgji katekizmore të hershme. Personazhi kryesor i Biblës është Perëndia! Vetëm qëllimi, karakteri dhe veprimet e tij janë shpresa e vetme e njerëzimit të rënë për të gjetur praninë të Perëndia dhe për të bërë qëndresë në besim (shih Efe. 2:4; Titit 3:5).

▣ **“ka bërë”** Kjo lloj fraze përdoret për të theksuar sovranitetin e Perëndisë si e vetmja e vërtetë biblike në lidhje me shpëtimin (shih Veprat 11:18; Jakobi 1:18; Efe. 1:4), por kjo është vetëm gjysma e konceptit të besëlidhjes. Shih Temën e Veçantë në Marku 14:24.

▣ **“të lindemi sërish”** Kjo është e njëjta rrënjë (*anagennao*, shih 1 Pje. 1:23) si te Gjoni 3:3 (*gennaio*). Është pjesore aoriste veprare, që bën fjalë për një veprim tendimtar. DHR përdor dhe metafora të tjera për të përshkruar shpëtimin: (1) “të ngjallur” (shih Kol. 2:13; Efe. 2:4-5); (2) “krijimi i ri” (shih 2 Kor. 5:17; Gal. 6:15); dhe (3) “pjesëmarrës në natyrën hyjnore” (shih 2 Pje. 1:4). Pali parapëlqen metaforën familjare “birësim”, ndërsa Gjoni dhe Pjetri parapëlqejnë metaforën familjare “lindja e re/rilindja”.

“Rilindja”, ose “lindja nga lart” është theksim biblik i nevojës për një fillim tërësisht të ri, për një familje tërësisht të re (shih Rom. 5:12-21). Krishterimi nuk është reformim, as moral i ri; ai është marrëdhënie e re me Perëndinë. Kjo marrëdhënie e re është bërë e mundshme për shkak të

1. mëshirës dhe hirit të Atit
2. vdekjes flijuese të Birit dhe ringjalljes së tij nga vdekja
3. veprës së Frymës (shih 1 Pje. 1:2)

Ky vullnet dhe veprim hyjnor u jep besimtarëve një jetë të re, një shpresë të gjallë dhe një trashëgimi të sigurt.

▣ **“në një shpresë të gjallë”** Mbiemri “të gjallë” është theksim i përsëritur te 1 Pjetrit (shih 1 Pje. 1:3, 23; 2:4, 5, 24; 4:5, 6). Gjithçka që Perëndia dëshiron dhe bën është “e gjallë” dhe mbetet (pra, lojë fjalësh me JHVH).

■ **“përmes ringjalljes së Jezu Krishtit”** Jezusi është vepruesi i Atit dhe mjeti i shpengimit (ashtu siç është vepruesi i Atit në krijim si dhe në gjykim). Ringjallja e Jezusit është e vërtetë qëndrore e ungjillit (shih Rom. 1:4; 1 Kor. 15). Ringjallja është aspekti i mesazhit të krishterë që grekët nuk mund ta praninin (shih Veprat 17:16-34).

1:4 “që të marrim një trashëgimi që është” Në DHV, çdo fis veç Levit mori një trashëgimi toke. Levitet, si fisi i priftërinjve, shërbëtorëve të tempullit dhe mësuesve lokale, konsideroheshin se kishin vetë JHVH-në si trashëgimi (shih Psa. 16:5; 73:23-26; 119:57; 142:5; Vaj. 3:24). Shkruesit e DHR, shpesh, i merrnin të drejtat dhe privilegjet e levitëve dhe ua zbatonin gjithë besimtarëve. Me këtë mënyrë, ata po theksonin se ndjekësit e Jezusit ishin populli i vërtetë i Perëndisë dhe se, tani, të gjithë besimtarët janë thirrur që t’i shërbejnë si priftërinj Perëndisë (shih 1 Pje. 2:5, 9; Zbu. 1:6), diçka që DHV ia zbatonte gjithë Izraelit (shih Eks. 19:4-6). DHR nuk thekson individin si prift me privilegje të veçanta, por thekson të vërtetën se gjithë besimtarët janë priftërinj, gjë që kërkon një qëndrim kolektiv prej shërbëtorit (shih 1 Kor. 12:7). Populli i Perëndisë në DHR ka marrë rolin që, në DHV, i jepej ungjillizimit të botës (shih Zan. 12:3; Eks. 19:5b; Mat. 28:18-20; Veprat 1:8).

Ky është koncepti i Jezusit si zotëruesi i krijimit, për shkak se ai ishte vepruesi i krijimit në emër të Atit (shih Gjoni 1:3, 10; 1 Kor. 8:6; Kol. 1:16; Heb. 1:2-3). Ne jemi bashkëtrashëgimtarë për shkak se ai është trashëgimtari (shih Rom. 8:17; Gal. 4:7; Kol. 3:24).

TEMË E VEÇANTË: TRASHËGIMIA E BESIMTARËVE (nga 1 Pjetrit 1) (SPECIAL TOPIC: BELIEVERS’ INHERITANCE [from 1 Peter 1])

Në DHV, çdo fis përveç Levit mori trashëgimi nga një pjesë të tokës në Izrael (shih Jozueu 14-22). Si fis priftërinjsh, shërbëtorësh të tempullit dhe mësues lokalë, levitet konsideroheshin se kishin si trashëgimi vetë JHVH-në (shih Psa. 16:5; 73:23-26; 119:57; 142:5; Vaj. 3:24). Shkruesit e DHV, shpesh, të drejtat e privilegjet e levitëve ua zbatuan të gjithë besimtarëve. Në këtë mënyrë, ata po thoshin se ndjekësit e Jezusit janë populli i vërtetë i Perëndisë dhe se, tani, të gjithë besimtarët janë të thirrur që të shërbejnë si priftërinj për Perëndinë (shih 1 Pje. 2:5, 9; Zbu. 1:6), ashtu siç pohon dhe DHV për gjithë Izraelin (shih Eks. 19:4-6). DHR nuk thekson individin si prift me privilegje të caktuara, por i mëshon të vërtetës se të gjithë besimtarët janë priftërinj, gjë që kërkon një qëndrim kolektiv prej shërbëtorit (shih 1 Kor. 12:7). Popullit të Perëndisë në DHR i është dhënë detyra e DHV për ungjillizimin e gjithë botës (shih Zan. 12:3; Eks. 19:5b; Mat. 28:18-20; Luka 24:46-47; Veprat 1:8; shih Temën e Veçantë: Plani i përjetshëm shpengues i JHVH).

Ky është koncepti i Jezusit si zotërues i krijimit, pasi ai ishte Personi që Ati përdori për të krijuar gjithçka (shih Gjoni 1:3, 10; 1 Kor. 8:6; Kol. 1:16; Heb. 1:2-3). Ne jemi bashkëtrashëgimtarë për shkak se ai është Trashëgimtari (shih Rom. 8:17; Gal. 4:7; Kol. 3:24). Shkrimet flasin për faktin se besimtarët trashëgojnë (shih Veprat 20:32; 26:18; Efe. 1:4; Kol. 1:12; 3:24) shumë gjëra për shkak të marrëdhënies familjare me Jezusin, i cili është Trashëgimtari i gjithçkaje (shih Heb. 1:2). Prandaj, ata janë bashkëtrashëgimtarë (shih Rom. 8:17; Gal. 4:7) të

1. mbretërisë (shih Mat. 25:34; 1 Kor. 6:9-10; 15:50; Efe. 5:5)
2. jetës së përjetshme (shih Mat. 19:29; Heb. 9:15)
3. premtimeve të Perëndisë (shih Heb. 6:12)
4. mbrojtjes që iu bën Perëndia premtimeve të tij (shih 1 Pje. 1:4-5)

■ **“e paprishshme, e panjollësuar dhe që nuk do të venitet”** Në 1 Pje. 1:4 përdoren tri fraza përshkruese për të sqaruar trashëgiminë e besimtarit; kjo bëhet duke përdorur aludime historike nga DHV për Tokën e Premtuar. Gjeografikisht, Palestina ndodhej në urën e vetme tokësore mes perandorive të Mesopotamisë dhe Egjiptit. Kjo çoi në shumë pushtime dhe manovrime politike. Trashëgimia e besimtarit nuk ndikohet nga konfliktet tokësore.

1. është “e paprishshme”, ose “e sigurt nga pushtimet”
2. është “e panjollësuar”, ose “e pavjetërueshme”
3. nuk do të “venitet”; nuk ka kufij kohorë për zotërimin e saj

■ **“e rezervuar në qiell për ju”** Kjo është pjesore e kryer pjesore që do të thotë se Perëndia e ka ruajtur dhe vazhdon ta ruajë trashëgiminë e besimtarëve. Ky është term ushtarak për një fortesë të ruajtur me roje ose garnizon (shih Fil. 4:7).

Fjala “qiell” është në shumës. Kjo reflekton shumësin hebraisht. Hebraishtja e lashtë kishte shumë emra shumës që përdorshin në këtë formë për t’i theksuar (p.sh., përdorimi i mëvonshëm rabinik i shumësit mbretëror,

që përdorej për Perëndinë). Rabinët debatonin për faktin nëse kishte tre nivele qielli (shih LiP. 10:14; 1 Mbre. 8:27; Neh. 9:6; 2 Kor. 12:2), apo shtatë qiej, pasi shtata ishte numri i përsosur (shih Zan. 2:1-3).

1:5 “që jeni të mbrojtur nga fuqia e Perëndisë” Kjo është pjesore e tashme pësore. Ashtu si ruhet trashëgimia jonë (jeta shpirtërore), kështu ruhet dhe individ i krishterë (jeta fizike). Personaliteti dhe premtimet e Perëndisë mbulojnë çdo aspekt të jetës sonë. Kjo ishte një fjalë tejet e nevojshme dhe e dobishme inkurajimi në një kohë përndjekjeje, vuajtjeje dhe mësimi të rremë (shih 2 Pjetrit). Me këtë nuk po themi se besimtarët nuk do të vriten apo torturohen; po themi vetëm se Perëndia do të jetë me ta dhe se, në fund, ata janë fitimtarë nëpërmjet tij. Kjo është teologjikisht e ngjashme me mesazhin e librit të Zbulesës.

■ **“nëpërmjet besimit”** Vini re paradoksin e besëlidhjes. Perëndia po i ruan ata dhe trashëgiminë e tyre, por gjithsesi besimtarët duhet të qëndrojnë në besim. Ky është tensioni mes këtyre dysheve dialektike biblike (pra, sovraniteti i Perëndisë dhe vullneti i lirë njerëzor), që ka shkaktuar zhvillimin e sistemeve teologjike që theksojnë vetëm njërin anë të paradoksit. Të dyja palët janë biblike; të dyja palët janë të domosdoshme! Perëndia ka marrëdhënie me njerëzit nëpërmjet besëlidhjeve të pakushtëzuara (ku gjithçka e siguron Perëndia) dhe të kushtëzuara (ku njeriu i përgjigjet Perëndisë).

■ **“një shpëtim të gatshëm për t’u zbuluar”** Bibla i përdor të gjitha kohët e foljeve greke për të përshkruar shpëtimin. Ne nuk do të shpëtohem plotësisht derisa të vijë Dita e Ringjalljes (shih 1 Gjonit 3:2). Shpesh, ky quhet përlëvdimi ynë (shih Rom. 8:29-30). Shih Temën e Veçantë më poshtë.

TEMË E VEÇANTË: SHPËTIMI (KOHËT E FOLJEVE GREQISHT) (SPECIAL TOPIC: SALVATION [GREEK VERB TENSES])

Shpëtimi nuk është produkt, por marrëdhënie. Nuk përfundon kur njeriu beson në Krishtin; sapo ka filluar! Nuk është policë sigurimi kundër zjarrit, as biletë për në qiell, por një jetë ku njeriu sa vjen e bëhet si Krishti. Në Amerikë ekziston një proverb që thotë se, sa më tepër të jetojë çifti së bashku, aq më tepër i ngjasin njëri-tjetrit. Ky është synimi i shpëtimit!

SHPËTIMI SI VEPRIM I PLOTËSUAR (AORIST)

- Veprat 15:11
- Romakëve 8:24
- 2 Timoteut 1:9
- Titit 3:5
- Romakëve 13:11 (kombinon AORISTIN me një orientim TË ARDHSHËM)

SHPËTIMI SI GJENDJE EKZISTENCE (E KRYERA)

- Efesianët 2:5, 8

SHPËTIMI SI PROCES I VAZHDUAR (E TASHMJA)

- 1 Korintasve 1:18; 15:2
- 2 Korintasve 2:15
- 1 Pjetrit 3:21

SHPËTIMI SI PËRMBUSHJE E ARDHSHME (KOHË E ARDHME në FOLJE, ose konteksti)

- Romakëve 5:9, 10; 10:9, 13
- 1 Korintasve 3:15; 5:5
- Filipianëve 1:28
- 1 Thesalonikasve 5:8-9
- Hebrenjve 1:14; 9:28
- 1 Pjetrit 1:5, 9

Si rrjedhojë, shpëtimi fillon me një vendim fillestar besimi (shih Gjoni 1:12; 3:16; Rom. 10:9-13), por kjo duhet të rezultojë në një proces besimi në stilin e jetesës (shih Rom. 8:29; Gal. 2:19-20; Efe. 1:4; 2:10), që, një ditë, do të përmbushet me shikim (shih 1 Gjonit 3:2). Kjo gjendje përfundimtar quhet përlëvdim. Kjo mund të ilustruhet si

4. Shpëtimi fillestar – shfajësimi (shpëtuar nga ndëshkimi i mëkatit)
5. Shpëtimi përparues – shenjtërimi (shpëtuar nga fuqia e mëkatit)

▣ **“në kohën e fundit”** Ky është koncepti i mëvonshëm judaik për dy epokat, por nga Dhiata e Re kuptojmë se këto dy epoka mbivendosen. Ditët e fundit filluan në mishërimin e Jezusit në Betlehem dhe do të përfundojnë në Ardhjen e Dytë. Ne kemi dy mijë vjet që ndodhemi në kohët e fundit. Shih Temën e Veçantë: Kjo Epokë dhe Epoka e Ardhsme, në Marku 13:8.

1:6

NASB “Në këtë ju gëzoheni së tepërmi”

NKJV “Në këtë ju gëzoheni”

NRSV

(shënim) “Gëzohuni në këtë”

TEV “Gëzohuni për këtë”

NJB “Ky është gëzim i madh për ju”

Kjo është dëftore e tashme mesore (A. T. Robertson) ose urdhërore (Barbara dhe Timothy Friberg). Besimtarët vazhdojnë të gëzohen për shkak të marrëdhënies së sigurt që kanë me Perëndinë (shih 1 Pje. 1:3-5) edhe në mes të kësaj bote të rënë (shih Jakobi 1:2-4; 1 Thes. 5:16; Rom. 5:3; 8:18).

▣ **“ndonëse tani, për pak kohë”** Sprovat dhe përndjekjet e së tashmes nuk krahasohen dot me përjetësinë me Zotin tonë (shih Rom. 8:18).

▣ **“nëse është e nevojshme, jeni shqetësuar nga sprovat të ndryshme”** Kjo është fjala greke *dei*, që do të thotë “e kërkuar, ose e nevojshme”, e cila lidhet me një fjali kushtore. Një folje e supozuar “jam” e bën këtë një fjali kushtore perifrastike të rendit të parë, që merret si e vërtetë. Pjetri e merr si fakt të kryer se jeta e perëndishme çon në përndjekje. Ai e përsërit shpesh këtë motiv përndjekjeje (shih 1 Pje. 1:6-7; 2:19; 3:14-17; 4:1, 12-14, 19; 5:9).

▣ **“jeni shqetësuar”** Kjo është pjesore aoriste pësore. Vepruesi i pashprehur i diatezës pësore është i ligu; Perëndia përdor dhe ligësinë për qëllimet e tij të mira. Madje dhe vetë Jezusi u përsos nga gjërat që pësoi (shih Heb. 5:8-9). Vuajtja i shërben një qëllimi të nevojshëm në jetën e besimit! Dilema teologjike është se vuajtja ka tri burime të mundshme:

1. i ligu
2. bota e rënë
3. Perëndia
 - a. për ndëshkimin e përkohshëm të mëkatit
 - b. për pjekurinë

Problemi është se unë nuk e di asnjëherë për cilin bëhet fjalë! Kështu që zgjedh të besoj se, kur kjo gjë ndodh, po kur kjo të ndodhë me siguri, Perëndia do ta përdorë për qëllimet e veta. Libri im i preferuar në këtë pikë është ai i Hannah Whithall Smith, *The Christian's Secret of a Happy Life*.

▣ **“nga sprovat të ndryshme”** Ky mbiemër greqisht do të thotë “i larmishëm, ose shumëngjyrësh” (shih Jakobi 1:2). Ka shumë lloje të ndryshme sprovash, tundimesh dhe përndjekjesh. Në 1 Pje. 4:10, kjo fjalë përdoret për të përshkruar hirin e larmishëm të Perëndisë. Ne nuk sprovohemi ose tundohemi kurrë përtej furnizimit të tij (shih 1 Kor. 10:13).

1:7 “në mënyrë që prova e besimit tuaj” Kjo është fjali *hina* ose qëllimore. Vuajtja e forcon vërtet besimin. Gjatë gjithë Biblës, Perëndia i sprovon fëmijët e tij (shih Zan. 22:1; Eks. 15:22-25; 16:4; LiP. 8:2,16; 13:3; Gjq. 2:22; 2 Kro. 32:31; Mat. 4:1; Luka 4:1-2; Rom. 5:2-4; Heb. 5:8-9; Jakobi 1:2-4).

Ky varg ka emrin *dokimon* dhe pjesoren *dokimazo*; të dyja kanë ngjyrimin kuptimor të sprovimit me qëllim forcimin dhe, si rrjedhojë, miratimin. Shih Temën e Veçantë për Fjalët Greke për “Sprovën” dhe Ngjyrimet e Tyre Kuptimore, në Marku 1:13b.

▣ **“që është më i vyer se ari që priset”** Në këtë jetë, dhurata më e madhe që mund t’i japim Perëndisë është besimi ynë (shih Gjoni 20:27; 2 Kor. 4:17). Në përjetësi, besimi do të shndërrohet në shikim. Perëndia nderohet

dhe kënaqet kur, me anë të besimit, ne durojmë sprovat që na shkaktohen nga besimi ynë në të (shih 1 Pje. 4:12-16). Rritja shpirtërore vjen vetëm nëpërmjet besimit të sprovuar (shih Rom. 5:2-5; Heb. 12:11; Jakobi 1:2-4).

■ **“zbulesën e Jezu Krishtit”** Po kjo fjalë (*apokalupsis*) përdoret si titull për librin e fundit të DHR: Zbulesën. Do të thotë “zbuloj”, “zbuloj plotësisht”, ose “bëj të njohur”. Këtu, bëhet fjalë për Ardhjen e Dytë, një motiv i zakonshëm në shkrimet e Pjetrit (shih 1 Pje. 1:7, 13; 2:12; 4:13; 5:4).

1:8 “dhe ndonëse nuk e keni parë atë” Edhe në mes të vuajtjes, besimtarët duhet të besojnë në të. Jezusi u lut për ata që besojnë në të, por që nuk e kanë parë kurrë (Gjoni 17:20; 20:29).

■ **“por besoni në të”** Sfondi etimologjik i kësaj fjale na ndihmon që t’ia përcaktojmë kuptimin për kohën e vet. Mos harroni se autorët e DHR ishin mendimtarë hebrej që shkruan në greqishten *koine*. Në hebraisht, në fillim kishte kuptimin e një personi që qëndronte drejt (i mbante këmbët e pozicionuara që të mos e shtynin dhe të rrëzohesh). Më vonë, përdorej metaforikisht për dikë që ishte i besueshëm, besnik, ose i besueshëm. Fjala e barazvlefshme në greqisht (*pistis* ose *pisteuo*) përkthehet me fjalët “besim”, “besoj”, ose “siguri besimi”. Besimi biblik nuk është në radhë të parë diçka që ne bëjmë, por dikë tek i cili besojmë. Fokusi është te besnikëria e Perëndisë, jo e jona. Njerëzimi i rënë beson në besnikërinë e Perëndisë, në vërtetësinë e tij, në të Dashurin e tij dhe në furnizimin e tij. Fokusi nuk është te bollëku apo forca e besimit njerëzor, por te objekti i atij besimi (shih 1 Pje. 1:8, 21; 2:6-7). Shih Temën e Veçantë në Marku 1:15.

■ **“gëzoheni së tepërmi me një gëzim të pashprehshëm”** Fjalët “gëzoheni së tepërmi” u përdorën më herët në 1 Pje. 1:6. Bëhet fjalë për një gëzim të thellë që, zakonisht, shoqërohet me shprehje fizike si bërtitjet, kërcimi, etj. (shih Luka 1:44, 47; 10:21; Gjoni 5:35; 8:56). Ky gëzim, për të cilin flet Pjetri, gjendet edhe në mes të vuajtjeve (shih 1 Pje. 4:13; Rom. 5:3; 1 Thes. 5:17). Ky gëzim është një nga bekimet e papritura të Frymës në kohë sprovash dhe përndjekjesh.

■ **“gjithë lavdi”** Kjo është pjesore e kryer pësore. Me anë të besimit (ende jo me anë të shikimit), besimtarët shpërthejnë në një gëzim të pashprehshëm dhe gjithë lavdi! Ky gëzim dhe kjo lavdi nuk mund të fshihen. Janë si shatërvan i madh që prodhohet nga Fryma (shih Gjoni 4:14; 7:38). Kjo është dëshmi për fuqinë e ungjillit për gjithë ata që vijnë në kontakt me besimtarët e ungjillit që janë nën trysni. Shih Temën e Veçantë: Lavdi (Doksa) në Marku 10:37.

1:9 “duke marrë rrjedhjen e besimit tuaj” Kjo është pjesore e tashme mesore. Nënkupton se gëzimi ynë nuk është vetëm diçka që do të përmbushet në të ardhmen, por edhe një realitet i tanishëm në mes të vuajtjeve, për shkak të veprimeve të Perëndisë triun për hirin tonë (shih 1 Pje. 1:2).

■ **“shpëtimin e shpirtave tuaj”** Bëhet fjalë për përlëvdimin tonë. Shpëtimi shihet në DHR si një vendim i marrë (në kohën aoriste, shih Rom. 8:24), por edhe si proces i vazhdueshëm (koha e tashme, shih 1 Kor. 1:18; 15:2; 1 Thes. 4:14) me përmbushje në të ardhmen (pra, koha e ardhme, shih Rom. 5:9, 10; 10:9). Shih Temën e Veçantë në 1 Pjetrit 1:5. Ky aspekt i ardhshëm, shpesh, quhet “përlëvdim” (shih Rom. 8:29-30). Një ditë, besimtarët do ta shohin Jezusin ashtu siç është dhe do të ndryshohen sipas ngjashmërisë së tij (shih 1 Gjonit 3:2).

Fjala greke *psukhe* (shpirt) përdoret shpesh në shkrimet e Pjetrit (shih 1 Pje. 1:9, 22; 2:11, 25; 3:20; 4:19; 2 Pje. 2:8, 14). Përdoret si fjalë hebraike që nënkupton gjithë njeriun si individ. Njerëzit nuk janë qenie me dy ose tre pjesë, por janë një unitet i vetëm (shih Zan. 2:7). Është e vërtetë se, si njerëz, ne kemi lidhje me këtë planet, por jemi krijuar në shëmbëllimin dhe ngjashmërinë e Perëndisë dhe, si të tillë, kemi lidhje dhe me botën shpirtërore. Jemi qytetarë të dy botëve.

Është e pavend që ta ndërtohet teologjinë sistematike mbi 1 Thes. 5:23 dhe Heb. 4:12 dhe, nga kjo, të përpiqesh t’i lidhësh të gjitha pasazhet biblike brenda këtyre tre kategorive (trupit, shpirti dhe fryma). Ato thjesht bëjnë fjalë për gjithë individin dhe për fuqinë depërtuese të fjalës së Perëndisë. Ruhuni kur dikush pretendon se çelësi i gjithë Biblës gjendet në dy pasazhe të paqarta, të nxjerra nga konteksti dhe të shndërruara në një kornizë teologjike përmes së cilës shihet gjithë Shkrimi (Uoçman Ni). Nëse çelësi i Biblës do të ishte ky, Fryma do ta kishte vendosur në një kontekst të qartë mësimor dhe do ta kishte përsëritur shpesh. Bibla nuk është libër me gjëgjëza apo me enigma për të stimuluar trurin! Perëndia dëshiron të komunikojë me ne, dhe të vërtetat madhore gjenden në kontekste të qarta mësimore.

MËSIMET KONTEKSTUALE NGA VARGJET 1:10-21

- A. 1 Pje. 1:10-12 flet për njohurinë që kishin profetët e DHV për shpëtimin e DHR në Krishtin.
- B. “Fryma”, përmes profetëve, u zbulon tri gjëra besimtarëve në 1 Pje. 1:11-12.
1. Vuajtjet e Mesisë (Zan. 3:15; Psalmi 22; Isa. 52:13-53:12)
 2. Lavdinë që do të vijojë (Isaia 56-66)
 3. Profetët po flisnin jo vetëm për ditën e tyre por dhe për më vonë (p.sh., Isaia, Ezekieli, Danieli, Mikea, Zakaria)
- C. Në 1 Pje. 1:13-17, Pjetri u kërkon besimtarëve të bëjnë gjashtë gjëra për t’u mbrojtur
1. Përgatisni mendjen, 1 Pje. 1:13
 2. Qëndroni të esëllt në frymë, 1 Pje. 1:13
 3. Nguliteni shpresën në hirin e kohës së fundit, 1 Pje. 1:13
 4. Mos u përshtasni me kohën e tanishëm, 1 Pje. 1:14
 5. Jetoni në mënyrë të shenjtë, 1 Pje. 1:15
 6. Jetoni duke respektuar Perëndinë, 1 Pje. 1:17
 7. Duajeni me zjarr njëri-tjetrin (i shtati u shtua nga 1 Pje. 1:22)

STUDIMI I FJALËVE DHE FRAZAVE

TEKSTI I NASB (I PËRDITËSUAR): 1 PJETRIT 1:10-12

¹⁰Sa për këtë shpëtim, profetët që profetizuan për hirin që do t’ju vinte juve bënë kërkime dhe hetime të hollësishme, ¹¹duke u përpjekur të dinin cilin person ose cilën kohë po u tregonte brenda tyre Fryma e Krishtit teksa parathoshte vuajtjet e Krishtit dhe lavditë që do të vijonin. ¹²Atyre iu zbulua se nuk po i shërbenin vetes, por juve, në këto gjëra, që tani ju janë shpallur përmes atyre që jua predikuan ungjillin me anë të Frymës së Shenjtë të dërguar nga qielli—gjëra që engjëjt dëshirojnë t’i shohin.

1:10 “Sa për këtë shpëtim” Kjo ka qenë tema që nga (1) 1 Pje. 1:2, që përshkruan veprën e Perëndisë trium në shpëtim; (2) 1 Pje. 1:3-5, që përshkruan faktin se Perëndia e ruan dhe e mbron këtë shpëtim; dhe (3) 1 Pje. 1:6-9, që përshkruan vuajtjen e këtyre besimtarëve për shkak të këtij shpëtimi.

▣ **“profetët”** Bëhet fjalë për profetët e DHV (shih 1 Pje. 1:12). Në mendimin rabinik, të gjithë shkruesit e frymëzuar konsideroheshin profetë. Moisiu quhet profet (shih LiP. 18:18), dhe ato që ne i quajmë libra historikë (pra, nga Jozueu te Mbretërit) judenjtë i quanin “profeët e mëparshëm”.

▣ **“për hirin që do t’u vinte juve”** Kjo frazë nënkupton se profetët e DHV e njihnin disi besëlidhjen e re. Ky është dhe kuptimi i thënies së Jezusit për Abrahamin në Gjoni 8:56 (shih 2 Ezra 3:14). Ky aludim gjendet dhe në Heb. 11:13b. Është e vështirë të dish me saktësi sa gjëra dinin profetët e DHV për ungjillin. Përshkrimi që i bën Jeremia Besëlidhjes së Re në Jer. 31:31-34 (si dhe Ezek. 36:22-38) tregon për një pranim që do të bazohej në dashurinë dhe veprimet e Perëndisë, jo në veprat njerëzore. Mateu 13:17 thotë se shumë profetë të DHV donin të shihnin dhe të dëgjonin ato që po thoshte dhe bënte Jezusi.

Edhe profecia e Isaisë për lindjen e virgjër (shih 1 Pje. 7:14), kur interpretohet në kontekst, bën fjalë për një lindje të natyrshme brenda një periudhe kohore të mbinatyrshme (shih 1 Pje. 7:15-16), jo vetëm për një lindje të ardhshme të Mesisë. Por Mateu dhe Luka arrijnë të shohin domethënien e plotë të profecisë së Isaisë. Kjo vlen dhe për profecitë e tjera të veçanta të Osesë (shih Osea 11:1) dhe Zakarisë (shih Zak. 9:9; 11:13; 12:10). Ata që na e zbulojnë plotësisht Jezusin nga DHV (në bazë të tipologjisë kristologjike) janë judenjtë e DHR dhe apostujt. Këto mund t’i kenë mësuar nga vetë Jezusi, siç i mësoi ai dy dishepujt në rrugën për në Emaus (shih Luka 24:13-35, sidomos 1 Pje. 1:27).

▣ **“bënë kërkime dhe hetime të hollësishme”** Këto duket se janë sinonime (shih *Greek-English Lexicon of the New Testament: Based on Semantic Domains*, vëll. 1, f. 331).

1:11

NASB “duke u përpjekur të dinin cilin person ose cilën kohë”

NKJV “duke hetuar çfarë, ose ç’lloj kohe”

NRSV “duke hetuar për personin ose kohën”

TEV (shënim) “u përpoqën të gjenin se kur do të ishte koha dhe sesi do të vinte ajo”

NJB “duke hetuar për kohën dhe rrethanat”

Kjo nënkupton edhe një person, edhe një periudhë kohore. Ata prisnin një Mesi davidik, që do të hynte vrulltas në histori në kohën e caktuar nga Perëndia. Si ne, dhe ata “shihnin errët përmes një pasqyre” (shih 1 Kor. 13:9-13).

■ **“brenda tyre Fryma e Krishtit”** Fryma dhe Mesia lidhen së bashku në DHV (shih Isa. 11:1-2; 48:16; 61:1). Vini re se Fryma e Shenjtë quhet “Fryma e Krishtit” (shih Rom. 8:9; Gal. 4:6). Po kështu vini re aspektin brendabanues të Frymës, qoftë dhe në DHV. Detyrat e Jezusit mbivendosen me ato të Frymës. Shihni sesi shprehet kjo e vërtetë në 2 Pje. 1:21.

TEMË E VEÇANTË: JEZUSI DHE FRYMA (SPECIAL TOPIC: JESUS AND THE SPIRIT)

Ekziston një rrjedhshmëri mes veprës së Frymës dhe asaj të Birit. G. Campbell Morgan tha se emri më i mirë për Frymën është “Jezusi tjetër” (sidoqoftë, ata janë persona të veçantë e të përvetshëm). Më poshtë vijon skica e krahasimit të veprës dhe titujve të Frymës dhe të Birit.

1. Fryma quhet “Fryma e Jezusit”, ose me shprehje të ngjashme (shih Rom. 8:9; 2 Kor. 3:17; Gal. 4:6; 1 Pjet. 1:11).
2. Të dy thirren me të njëjtat fjalë
 - a. “e vërteta”
 - 1) Jezusi (Gjoni 14:6)
 - 2) Fryma (Gjoni 14:17; 16:13)
 - b. “avokati”
 - 1) Jezusi (1 Gjonit 2:1)
 - 2) Fryma (Gjoni 14:16, 26; 15:26; 16:7)
 - c. “I Shenjtë”
 - 1) Jezusi (Marku 1:24; Luka 1:35; Veprat 3:14; 4:27, 30)
 - 2) Fryma (Luka 1:35; 4:34)
3. Të dy brendabanojnë besimtarët
 - a. Jezusi (Mat. 28:20; Gjoni 14:20,23; 15:4-5; Rom. 8:10; 2 Kor. 13:5; Gal. 2:20; Efe. 3:17; Kol. 1:27)
 - b. Fryma (Gjoni 14:16-17; Rom. 8:9,11; 1 Kor. 3:16; 6:19; 2 Tim. 1:14)
 - c. Ati (Gjoni 14:23; 2 Kor. 6:16)
4. Detyra e Frymës është të dëshmojë për Jezusin (shih Gjoni 15:29; 16:13-15)

■ **“parathoshte vuajtjet e Krishtit”** Kjo ishte ajo që i habiti judenjtë (shih 1 Kor. 1:23). Shërbëtori i Përvuajtur u bë shtyllë qendrore e predikimeve të hershme të Pjetrit dhe Palit në Veprat; këtë ne e quajmë *kerigmë* (pra, ajo që u shpall, shih Veprat 2:23, 24; 3:18; 4:11; 10:39; 17:3; 26:23). Pikërisht kjo ishte ajo që Jezusi u përpoq t’u thoshte të Dymbëdhjetëve gjatë kohës që kaloi me ta (shih Mat. 16:21; 20:17-19; Marku 8:31; Luka 9:22), por ata nuk e kuptonin (shih Marku 9:31-32; 10:32-34; Luka 9:44-45; 18:31-34).

Edhe në DHV jepen aludime për vuajtjet e Mesisë (shih Zan. 3:15; Psalmi 22; Isaia 53), por izraelitët e DHV po prisnin një Mesi që do të vinte si hero pushtues për të gjykuar gjithë njerëzimin dhe për t’i kthyer Izraelit pozitën e epërsisë dhe pushtetit. Ata s’i kuptuan dy ardhjet e Mesisë, të cilat na zbulohen në jetën dhe mësimet e Jezusit (pra, si Shpëtimtar dhe pastaj si Gjykatës).

Më poshtë vijon një tabelë interesante e *kerigmës*, që gjendet në librin e H. Wayne House, *Chronological and Background Charts of the New Testament* (f. 120).

TEMË E VEÇANTË: *KERIGMA* E KISHËS SË HERSHME (SPECIAL TOPIC: THE *KERYGMA* OF THE EARLY CHURCH)

Ka shumë mendime për krishterimin. Koha jonë është kohë e pluralizmit fetar, njësoj si në shekullin e parë. Personalisht, unë i përfshij dhe i pranoj të gjitha grupet që pretendojnë se e njohin dhe besojnë në Jezun Krishtin. Të gjithë kemi mosmarrëveshjet tona për gjëra të ndryshme, por, në thelb, krishterimi ka të bëjë vetëm me Jezusin. Sidoqoftë, ka grupe që pretendojnë se janë të krishtera, por në fakt janë thjesht kopje “false”, ose “të vonët në fushën e betejës”. Si t’i dalloj sektet nga e vërteta?

Po, ja ka dy mënyra:

- A. Një libër i dobishëm për të mësuar çfarë besojnë grupet moderne të kulteve (nga vetë librat e tyre) është *The Kingdom of the Cults*, nga Walter Martin.
- B. Predikimet e kishës së hershme, veçanërisht ato të apostujve Pjetër dhe Pal në librin e Veprave, na japin skicën bazë të mënyrës sesi autorët e frymëzuar të shekullit të parë ua paraqesnin krishterimin grupeve të ndryshme. Kjo “shpallje”, ose ky “predikim” i hershëm (Veprat përbën një përmbledhje të tij) njihet me fjalën greke *kerigma*. Më poshtë janë të vërtetat bazë të ungjillit për Jezusin në Veprat:
 1. përmbush shumë profeci nga DHV – Veprat 2:17-21,30-31,34; 3:18-19,24; 10:43; 13:17-23,27; 33:33-37,40-41; 26: 6-7,22-23
 2. i dërguar nga JHVH sipas premtimit – Veprat 2:23; 3:26
 3. kreu mrekulli për ta vërtetuar mesazhin e vet dhe për të zbuluar mëshirën e Perëndisë – Veprat 2:22; 3:16; 10:38
 4. u dorëzua dhe u mohua – Veprat 3:13-14; 4:11
 5. u kryqëzua – Veprat 2:23; 3:14-15; 4:10; 10:39; 13:28; 26:23
 6. u ringjall – Veprat 2:24,31-32; 3:15,26; 4:10; 10:40; 13:30; 17:31; 26:23
 7. u lartësua në të djathtë të Perëndisë – Veprat 2:33-36; 3:13, 21
 8. do të kthehet sërish – Veprat 3:20-21
 9. i caktuar Gjykatës – Veprat 10:42; 17:31
 10. dërgoi Frymën e Shenjtë – Veprat 2:17-18, 33, 38-39; 10:44-47
 11. Shpëtimtar i gjithë atyre që besojnë – Veprat 13:38-39
 12. Askush tjetër s’është Shpëtimtar – Veprat 4:12; 10:34-36

Ja disa mënyra si të reagojmë ndaj këtyre shtyllave apostolike të së vërtetës:

1. Pendohu – Veprat 2:38; 3:19; 17:30; 26:20
2. Beso – Veprat 2:21; 10:43; 13:38-39
3. Pagëzohu – Veprat 2:38; 10:47-48
4. Merr Frymën – Veprat 2:38; 10:47
5. Të gjithë mund të vijnë – Veprat 2:39; 3:25; 26:23

Kjo skemë shërbeu si shpallja thelbësore e kishës së hershme, ndonëse autorë të ndryshëm të Dhiatës së Re mund ta lënë pa përmendur një pjesë, ose të thekojnë disa pjesë të tjera në shkrimet e tyre. Gjithë ungjilli i Markut ndjek me kujdes aspektin pjetrin të *kerigmës*. Nga tradita, Marku shihet si strukturues i predikimeve të Pjetrit, të bëra në Romë, në formën e një ungjilli me shkrim. Si Mateu ashtu dhe Luka ndjekin strukturën bazë të Markut.

■ “dhe lavditë që do të vijonin” Kjo aludohet në Isa. 53:10-12.

1:12 “nuk po i shërbenin vetes, por juve” Ka disa vende në shkriet e Palit, ky ai thotë të njëjtën të vërtetë (shih Rom. 4:23-24; 15:4; 1 Kor. 9:9-10; 10:6, 11). Në thelb, kjo teologji zbulohet dhe në 2 Tim. 3:15-17. Veprimet e Perëndisë (zbulues) dhe shkrimi e interpretimi i tyre (frymëzimi) vlejnë për gjithë besimtarët e ardhshëm (përndritja).

Nëse Pjetri po i shkruante një grupi kryesisht prej besimtarësh johebrenj, kjo frazë përmban dhe pohimin e shtuar teologjik të përfshirjes së johebrenjve, gjë që ishte gjithmonë pjesë e planit të Perëndisë (shih Zan. 3:15; Romakëve 9-11; Efe. 2:11-3:13).

TEMË E VEÇANTË: PIKËPAMJET E PALIT PËR LIGJIN E MOISIUT (SPECIAL TOPIC: PAUL'S VIEWS OF THE MOSAIC LAW)

Ligji është i mirë dhe vjen nga Perëndia (shih Rom. 7:12, 16).

- A. Ai nuk është rruga për te drejtësia dhe pranimit nga Perëndia (madje, mund të jetë mallkim, shih Galatasve 3).
- B. Ai është ende vullneti i Perëndisë për besimtarët, sepse është vetëzbuluesia e Perëndia (Pali e citon shpesh DhV për të qortuar dhe/ose inkurajuar besimtarët).
- C. Besimtarët informohen nga DhV (shih Rom. 4:23-24; 15:4; 1 Kor. 10:6, 11), por nuk shpëtohen nga DhV (shih Veprat 15; Romakëve 4; Galatasve 3; Hebrenjve)
- D. Ai funksionon në besëlidhjen e re:
 - 1. për të treguar mëkatshmërinë (shih Gal. 3:15-29)
 - 2. për të udhëzuar njerëzimin e shpenguar në shoqëri
 - 3. për të informuar vendimet etike të të krishterëve

Është pikërisht ky spektër teologjik nga mallkimi dhe kalimtarja te bekimi dhe vazhdimësia që shkakton problemin për të kuptuar pikëpamjen e Palit për Ligjin e Moisiut. Në *A Man in Christ*, James Steeart tregon mendimin dhe shkrimin paradoksal të Palit:

“Normalisht, ne do të prisnim që një njeri, që i ka vënë qëllim vetes të ndërtojë një sistem mendimi dhe doktrine, do të nguliste sa më ngurtësisht të mundte kuptimet e termave që përdorte. Do të prisnim që ai të synonte saktësi në frazeologjinë e ideve të tij kryesore. Do të prisnim që një fjalë e caktuar, e përdorur një herë nga shkrimtari në një kuptim të caktuar, të kishte kurdoherë po atë kuptim. Por do të zhgënjehesh po e kërkoje këtë nga Pali. Një pjesë e mirë e frazeologjisë së tij është e rrjedhshme, jo e ngurtë... ‘Ligji është i shenjtë’, shkruan ai, ‘dhe unë gëzohem në ligjin e Perëndisë sipas njeriut të brendshëm’ (shih Rom. 7:12, 22), por është pa dyshim një tjetër aspekt i *nomos* që e bën Palin të thotë gjatë: ‘Krishti më ka shpenguar nga mallkimi i ligjit’ (shih Gal. 3:13)” (f. 26).

■ **“përmes atyre që jua predikuan ungjillin”** Kjo duket se nënkupton që këto kisha nuk i kishte mbjellë të gjitha Pjetri. Ndoshta ishin mbjellë nga judenj besimtarë që ishin kthyer nga Rrëshajët (shih Veprat 2), ose nga predikimi i Palit ose ungjilltarëve të tjerë.

■ **“me anë të Frymës së Shenjtë të dërguar nga qielli”** Fryma e Shenjtë përmendet në disa vende kyçe në 1 Pjetrit (shih 1 Pje. 1:2, 11; 4:14). Kjo frazë ishte shprehje hebraike që thoshte se epoka e re e drejtësisë, që ishte nga Perëndia, e sjellë nga Fryma, kishte ardhur plotësisht (shih Veprat 2).

■ **“gjëra që engjëjt dëshirojnë t’i shohin”** Fjalë për fjalë, “kërrusen për të parë”, si te Gjoni 20:5, 11. Në Jakobi 1:25 përkthehet: “këqyr ngultas”. Bëhet fjalë edhe për engjëjt e mirë, edhe ata të këqinj (shih Efe. 3:10; 1 Kor. 4:9).

Në judaizmin rabinik engjëjt shiheshin si ndërmjetës mes JHVH-së dhe Moisiut në malin Sinai (shih Veprat 7:53; Gal. 3:19; Heb. 2:2). Po kështu, përshkruhen si xhelozë për dashurinë dhe vëmendjen që Perëndia u kushton njerëzve. Në Heb. 1:14, engjëjt përshkruhen si shërbëtorë të “atyre që do të trashëgojnë shpëtimin”. Madje, Pali thotë se besimtarët do të gjykojnë engjëjt (shih 1 Kor. 6:3).

Perëndia ua zbuloi në mënyrë unike veten engjëjve nëpërmjet marrëdhënies së tij me njerëzimin e rënë (shih 1 Kor. 4:9; Efe. 2:7; 3:10).

TEKSTI I NASB (I PËRDITËSUAR): 1 PJETRIT 1:13-16

¹³Prandaj, përgatisni mendjen për veprim, jini të esëllt në frymë, nguliteni shpresën plotësisht në hirin që do të vijë te ju në zbulesën e Jezu Krishtit. ¹⁴Si fëmijë të bindur, mos iu përshtatni epsheve të mëparshme që ishin tuajat në padijen tuaj, ¹⁵por, si i Shenjti që ju thirri, jini dhe ju vetë të shenjtë në gjithë sjelljen tuaj; ¹⁶pasi është shkruar: “Jini të shenjtë, sepse unë jam i shenjtë”.

1:13 “Prandaj” Kjo (*dio*, shih 2 Pje. 1:10, 12; 3:14) tregon se nxitjet e mëposhtme janë rezultat i diskutimit të mëparshëm.

NASB “përgatisni mendjen për veprim”
NKJV “ngjishni ijët e mendjes suaj”
NRSV “përgatitni mendjen për veprim”
TEV “kijeni mendjen gati për veprim”
NJB “mendjen tuaj... gati për veprim”

Kjo është pjesore aoriste mesore e përdorur si urdhërore. Forma e saj tregon se kërkohet një veprim vendimtar si rrjedhojë e një zgjedhjeje personale. Është shprehje hebraike, që do të thotë fjalë për fjalë: “ngjishni ijët e mendjes suaj”. Në Lindjen e Afërt në lashtësi, burrat dhe gratë vishnin rrobe të gjata. Për t’i lejuar njerëzit që të vraponin, këto rrobe futeshin mes këmbëve dhe kapeshin përpara e lidheshin te beli; kështu, ktheheshin në pantallona. Nxitje të ngjashme për përgatitje për veprimtari mendore gjenden dhe te Rom. 12:2 ose Efe. 4:17, 23.

▣ **“jini të esëllt në frymë”** Kjo është pjesore e tashme veprare me një sërë urdhëroresh dhe pjesorësh të përdorura me forcë urdhërore. Nuk është thirrje për të mos pirë alkool, por është metaforë për kthjelltësi dhe qartësi mendore (shih 1 Pje. 4:7; 5:8; 1 Thes. 5:6, 8; 2 Tim. 4:5).

▣ **“nguliteni shpresën plotësisht”** Kjo është urdhërore aoriste veprare, që nënkupton marrjen e një vendimi vendimtar për të besuar plotësisht në kthimin e Krishtit. “Shpresa”, në DHR, shpesh bën fjalë për Ardhjen e Dytë (shih Titit 2:13). Shpresa jonë është e bazuar në karakterin dhe veprimet e patundura dhe të sigurta të Perëndisë triumf (shih 1 Pje. 1:2, 3-5).

▣ **“në hirin që do të vijë te ju në zbulesën e Jezus Krishtit”** Ky është i njëjti hir për të cilin kishin bërë hetime të hollësishme dhe profetët e DHV (shih 1 Pje. 1:10). Kjo tregon qartazi se shpresa e besimtarëve është në karakterin dhe veprimet e Perëndisë triumf (shih 1 Pje. 1:2, 3-5) dhe se hiri i tij do të shfaqet plotësisht në kthimin e Jezusit (shih 1 Gjonit 3:2). Shpëtimi përshkruhet me të gjitha kohët e foljeve në greqisht. Shih Temën e Veçantë në 1 Pjetrit 1:5.

1:14 “fëmijë të bindur” Kjo është shprehje hebraike që nënkupton marrëdhënien tonë familjare me Perëndinë Atë dhe me Birin Jezus (shprehje mohore gjenden në Efe. 2:2; 5:6). Besimtarët janë bashkëtrashëgimtarë përmes tij (shih Rom. 8:15-17). Ç’është më e mahnitshmja, mëkatarët bëhen pjesë e familjes së Perëndisë me anë të ftesës së tij dhe flijimit të Jezusit.

NASB, NRSV “mos iu përshtatni”
NKJV “mos e përshtatni veten”
TEV “mos lejoni që jeta juaj të formësohet”
NJB “mos lejoni që të formësoheni”

Kjo është pjesore e tashme mesore ose pësore, e përdorur si urdhërore. Siç ndodh shpesh në DHR, besimtarët përshkruhen sikur mbi ta vepron Perëndia ose Fryma (në diatezën pësore), por ekziston dhe mundësia gramatikore që besimtarëve po u bëhet thirrje qartazi që ta jetësojnë marrëdhënien e tyre të re me Perëndinë përmes fuqisë së Frymës (diateza mesore).

Ashtu si shpëtimi është besëlidhje e kushtëzuar, e nisur nga Perëndia, por që kërkon një përgjigje të detyrueshme nga njeriu, kështu ndodh dhe me jetën e krishterë. Jeta e përvetshme ka karakteristika të vëzhgueshme (shih 1 Pje. 1:15). Një pjesë e mirë e terminologjisë së Pjetrit vjen nga letrat e Palit (këtu nga Rom. 12:2).

▣ **“epsheve të mëparshme që ishin tuajat në padijen tuaj”** Bëhet fjalë për të shkuarën e shturur dhe të paperëndishme pagane të besimtarëve johebrenj (shih 1 Pje. 4:2-3; Efe. 4:17-19).

1:15

NASB “por, si i Shenjti që ju thirri”
NKJV “por, ashtu si ai që ju thirri është i shenjtë”
NRSV “përkundrazi, ashtu si ai që ju thirri është i shenjtë”
TEV “përkundrazi... ashtu si Perëndi që ju thirri është i shenjtë”

NJB “sipas modelit të të Shenjtit që na thërret”

Këtu theksohet karakteri dhe zgjedhja sovraane e Perëndisë (shih 1 Pje. 2:9; 5:10). Askush nuk vjen te Perëndia përveçse nëse e tërheq Fryma (shih Gjoni 6:44, 65). Kjo është një tjetër mënyrë teologjike për të hedhur poshtë pranimin nga Perëndia me anë të përpjekjeve njerëzore (shih Efe. 2:8-9). Titulli i predikimit që kam bërë unë për këtë pasazh ishte: “Të shenjtët e të Shenjtit”.

■ **“jini dhe ju vetë të shenjtë”** Kjo është urdhërore aoriste pësore (deponente). Besimtarëve u bëhet thirrje për shenjtëri. Vullneti i Perëndisë ka qenë gjithmonë që fëmijët e tij të reflektojnë karakterin e tij (shih Titit 2:14). Synimi i krishterimit nuk është vetëm qielli pasi vdesim, por ngjashmëria me Krishtin tani (shih Rom. 8:29-30; 2 Kor. 3:18; 7:1; Gal. 4:19; Efe. 1:4; 2:10; 4:13; 1 Thes. 3:13; 4:3, 7; 5:23). Detyra e Jezusit nuk është vetëm heqja e mëkatit, por rimëkëmbja e shëmbëllimit të Perëndisë në njerëzimin e rënë. Duhet ta shohim gjithmonë me dyshim atë siguri shpëtimi që nuk shfaq ngjashmëri me Krishtin! Ungjilli është (1) një person që duhet pranuar; (2) një e vërtetë për atë person që duhet besuar; dhe (3) një jetë që imiton atë person (shih Efe. 4:1; 5:1-2, 15; 1 Gjonit 1:7; 2:4-6). Mos harroni fjalët tronditëse të Jezusit në Mat. 5:20 dhe 48! Gjithmonë ruhuni nga ai krishterim që ka qëndrimin “po unë, ç’fitim kam nga kjo gjë?”. Ne jemi shpëtuar për të shërbyer. Jemi thirrur prerazi për shenjtëri. Perëndia pastë mëshirë për atë kishë perëndimore që është mbërthyer nga predikimi i (1) begatisë; (2) materializmit; dhe (3) shëndetit/pasurisë!

TEMË E VEÇANTË: SHENJTËRIA/SHENJTËRIMI NË DHIATËN E RE (SPECIAL TOPIC: NEW TESTAMENT HOLINESS/SANCTIFICATION)

DHR pohon se, kur mëkatarët kthehen te Jezusi me pendim dhe besim, shfajësohen aty për aty dhe shenjtërohen. Ky është pozicioni i tyre i ri në Krishtin. Drejtësia e tij u është llogaritur atyre (shih Romakëve 4). Ata shpallen të drejtë dhe të shenjtë (akt ligjor i Perëndisë).

Por, gjithashtu, DHR u bën thirrje besimtarëve për shenjtëri, ose shenjtërim. Ky është edhe pozicioni teologjik në bazë të veprës së përfunduar të Jezu Krishtit, edhe thirrje për të qenë si Krishti në qëndrim dhe në veprime në jetën e përditshme. Ashtu si shpëtimi është dhuratë falas dhe stil jetese që të kushton gjithçka, kështu ndodh dhe me shenjtërimin.

Përgjigjja fillestare

Veprat 26:18
Romakëve 15:16
1 Korintasve 1:2-3; 6:11
2 Thesalonikasve 2:13
Hebrenjve 2:11; 10:10, 14; 13:12
2 Pjetrit 1:2

Ngjashmëria gjithnjë e më madhe me Krishtin

Romakëve 6:19
2 Korintasve 7:1
Efesianëve 1:4; 2:10
1 Thesalonikasve 3:13; 4:3-4, 7; 5:2
1 Timoteut 2:15
2 Timoteut 2:21
Hebrenjve 12:14
1 Pjetrit 1:15-16

■ **“në gjithë sjelljen tuaj”** Vini re theksin te “gjithë”. Sfida nuk është drejtësia selektive, por te shenjtëria në gjithë qenien tënde (shih 1 Gjonit 3:3).

1:16 “pasi është shkruar: “Jini të shenjtë, sepse unë jam i shenjtë” “Shkruar” është dëftore e kryer pësore; kjo ishte një shprehje për Biblën, të cilën Jezusi e përdorte shpesh, kurse Pjetri këtu e përdor vetëm një herë. Është një citim nga Lev. 11:44-45; 19:2; 20:7, 26. Nuk është urdhërim i ri, por urdhërim i përsëritur (sih Mat. 5:48). Shenjtëria, në kuptimin e DHV, nuk ishte mungesë mëkati, por zbatim i kërkesave të besëlidhjes së Perëndisë (shih Eks. 19:6; 22:31; LiP. 14:2, 21; 26:19). Edhe DHV përmban kërkesa besëlidhjeje, të cilat çojnë në ngjashmëri me Krishtin (shih Rom. 8:28-29; 2 Kor. 3:18; 7:1; Gal. 4:19; Efe. 1:4; 4:13; 1 Thes. 3:13; 4:3, 7; 5:23). Shih Temën e Veçantë më poshtë.

TEMË E VEÇANTË: I SHENJTË (SPECIAL TOPIC: HOLY)

- I. Dhiata e Vjetër (ilustruar kryesisht nga Isaia)
- A. Etimologjia e fjalës *kadosh* (BDB 872) është e paqartë; ka gjasa të jetë kanaanite. Ka mundësi që një pjesë e rrënjës së saj (pra, *kd*) të ketë kuptimin “ndaj”. Ky është burimi i përcaktimit popullor “i ndarë (nga kultura kanaanite, shih LiP. 7:6; 14:2, 21; 26:19) për përdorim nga Perëndia”.
- B. Ajo lidhet me praninë e Perëndisë në objekte, vende, kohë dhe persona të ndryshëm. Nuk përdoret te Zanafilla, por bëhet e zakonshme te Eksodi, Levitiku dhe Numrat.
- C. Në literaturën profetike (sidomos te Isaia dhe Osea), elementi personal, që më parë ishte i pranishëm por jo i theksuar, tani del në pamje të parë. Bëhet mënyrë për të përcaktuar thelbin e Perëndisë (shih Isa. 6:3). Perëndia është i shenjtë. Emri i tij, që përfaqëson karakterin e tij, është i shenjtë. Populli i tij, që duhet t’ia zbulojë kësaj bote nevojtare karakterin e tij, është i shenjtë (nëse i bindet besëlidhjes me besim).
1. MBIEMËR, BDB 872 *kadosh*, “i shenjtë”, i përdorur për
 - a. Perëndinë, Isa. 5:16; 6:3 (tri herë); shih Temën e Veçantë: I Shenjti
 - b. Emri i tij, Isa. 40:25; 49:7; 57:15
 - c. Vendbanimi i tij, Isa. 57:15
 - d. Shabati i tij, Isa. 58:13
 2. FOLJE, BDB 872 *kdsh*, “veçoj”, “shenjtëroj”
 - a. Karakteri i Perëndisë, Isa. 5:16; 29:23
 - b. Perëndia Isa. 8:13; 65:5
 - c. Engjëjt e Perëndisë, Isa. 13:3
 - d. Emri i Perëndisë, 29:23
 - e. Festival, Isa. 30:29
 - f. Njerëz të shenjtëruar, Isa. 66:17
 3. EMËR, BDB 871 *kdsh*, “veçim”, “shenjtëri”
 - a. Farë e shenjtë, Isa. 6:13
 - b. Mal i shenjtë, Isa. 11:9; 27:13; 56:7 57:13; 65:11, 25; 66:20
 - c. I veçuar, Isa. 23:18
 - d. Udhë e shenjtërisë, Isa. 35:8
 - e. Shenjtërorja, Isa. 43:28; 62:9; 64:11
 - f. Qytet i shenjtë, Isa. 48:2; 52:1
 - g. I Shenjti, Isa. 49:7 (shih Temën e Veçantë: I Shenjti)
 - h. Krah i shenjtë, Isa. 52:10
 - i. Ditë e shenjtë, Isa. 58:13
 - j. Popull i shenjtë, Isa. 62:12
 - k. Fryma e Shenjtë, 63:10,11
 - l. Froni i Perëndisë, Isa. 63:15
 - m. Vendi i shenjtë, Isa. 63:18
 - n. Qytete të shenjta, Isa. 64:10
- D. Mëshira dhe dashuria e Perëndisë janë të pandashme nga konceptet teologjike të besëlidhjeve, drejtësisë dhe karakterit thelbësor. Këtu qëndron tensioni brenda Perëndisë kundrejt njerëzimit të pashenjtë, të rënë dhe rebel. Është një artikull shumë interesant për marrëdhënien e Perëndisë si “i mëshirshëm” me Perëndinë si “i shenjtë”, te Robert B. Girdlestone, *Synonyms of the Old Testament (Sinonime të Dhiatës së Vjetër)*, f. 112-113.
- II. Dhiata e Re
- A. Shkrimtarët e DhR (përveç Lukës) janë mendimtarë hebrenj, por janë të ndikuar nga greqishtja *koine* (pra, Septuaginta). Ajo që kontrollonte fjalorin e tyre nuk ishte feja, mendimi, apo literatura klasike greke, por përkthimi grek i DhV.
- B. Jezusi është i shenjtë ngaqë është nga Perëndia dhe si Perëndia (shih Luka 1:35; 4:34; Veprat 3:14; 4:27, 30). Ai është i Shenjti dhe i Drejti (shih Veprat 3:14; 22:14). Jezusi është i shenjtë ngaqë është i pamëkat (shih Gjoni 8:46; 2 Kor. 5:21; Heb. 4:15; 7:26; 1 Pje. 1:19; 2:22; 1 Gjonit 3:5).

Për shkak se Perëndia është i shenjtë, fëmijët e tij duhet të jenë të shenjtë (shih Lev. 11:44-45; 19:2; 20:7, 26; Mat. 5:48; 1 Pje. 1:16). Për shkak se Jezusi është i shenjtë, edhe ndjekësit e tij duhet të jenë të shenjtë (shih Rom. 8:28-29; 2 Kor. 3:18; Gal. 4:19; Efe. 1:4; 1 Thes. 3:13; 4:3; 1 Pje. 1:15). Të krishterët shpëtohen për të shërbyer në ngjashmëri me Krishtin (shenjtëria).

TEKSTI I NASB (I PËRDITËSUAR): 1 PJETRIT 1:17-21

¹⁷Nëse thërrisni si Atë atij që, me paanësi, gjykon sipas veprës së secilit, silluni me frikë gjatë kohës së qëndrimit tuaj në tokë; ¹⁸duke ditur se nuk u shpenguat me gjëra të prishshme, si argjendi apo ari, nga mënyra juaj e kotë e jetës, e trashëguar nga paraardhësit tuaj, ¹⁹por me gjak të çmuar, si ai i një qengji të patëmetë dhe të panjollë, me gjakun e Krishtit. ²⁰Sepse ai ishte i paranjohur përpara themelimit të botës, por është shfaqur këto kohët e fundit për hirin tuaj që, përmes tij, të jeni besimtarë në Perëndinë, ²¹i cili e ringjalli nga vdekja dhe i dha lavdi, që besimi dhe shpresa juaj të jenë në Perëndinë.

1:17 “Nëse” Kjo është fjali kushtore e rendit të parë, që supozohet si e vërtetë nga pikëvështrimi i autorit, ose për qëllimet e tij letrare.

■ **“thërrisni si Atë”** Kjo është dëftore e tashme mesore (shih Os. 11:1-3; Jer. 3:19), që nënkupton se besimtarët do të vazhdojnë ta thërrasin JHVH-në me fjalë familjare (shih Rom. 8:15; Gal. 4:6), ashtu si i mësoi Jezusi (shih Mat. 6:9). Shih Temën e Veçantë: Ati, në Marku 13:32.

■ **“atë që me paanësi gjykon”** Perëndia do t’u kërkojë llogari jo vetëm atyre që nuk e kanë njohur kurrë, por edhe atyre që pretendojnë se e njohin (shih 1 Pje. 4:5, 17-18; Rom. 14:12; 2 Kor. 5:10). Atyre që u jepet shumë, shumë do t’u kërkohej (shih Luka 12:48)!

Nëse e thërrasin Atë, atëherë duhet edhe t’i ngjasim si bij të tij, siç bën dhe Biri i tij i madh! Ati ynë, i shenjtë, është gjykatës i paanshëm (shih LiP. 10:17; 2 Kro. 19:7; Veprat 10:34; Rom. 2:11; Gal. 2:6; Efe. 6:9; Kol. 3:25; 1 Pje. 1:17).

Qeniet njerëzore e kanë një zgjedhje (shih LiP. 30:15-20; Joz. 24:15; Ezek. 18:30-32) për mënyrën si duhet të kenë marrëdhënie me Perëndinë. Ai mund të jetë një Atë i dashur nëse ata besojnë në Krishtin (shih Gjoni 1:12; Rom. 10:9-13), ose mund të jetë një gjykatës i shenjtë nëse mbështeten vetëm në meritat ose përpjekjet e tyre në lidhje me ritet, rregullat dhe procedurat fetare (shih Mat. 25:31-46; Kol. 2:20-23). Çfarë dëshiron: mëshirë, apo drejtësi?

Fjala “i paanshëm” reflekton një shprehje të DHV, “ngre fytyrën”. Gjykatësit nuk duhet të ndikoheshin nga njohja me të akuzuarin, por nga veprimet e tij.

■ **“sipas veprës së secilit”** Ky është univers moral. Perëndia është Gjykatësi. Njerëzit do t’i japin llogari atij për dhuratën e jetës (shih Mat. 25:31-46; 2 Kor. 5:10; Zbu. 20:11-15). Të gjithë ne jemi administratorë dhe do të korrim atë që mbjellim (shih Jobi 34:11; Psa. 28:4; 62:12; Fja. 12:14; 24:12; Isa. 3:10-11; Jer. 17:10; Os. 4:9; Mat. 16:27; 25:31-46; Rom. 2:6; 1 Kor. 3:8; Gal. 6:7; Kol. 3:25; Zbu. 2:23; 20:12-13; 22:12).

■ **“silluni me frikë”** Ekziston një respekt i duhur që e kemi për detyrë t’ia shfaqim Perëndisë së shenjtë (shih 2 Kor. 5:21). Ky respekt kërkon që fëmijët e tij të bëjnë jetë të perëndishme, duke ditur se do t’i japin llogari Perëndisë për dhuratën e jetës dhe për ungjillin.

■ **“gjatë kohës së qëndrimit tuaj në tokë”** I përshkruan besimtarët si shtegtarë në një vend të huaj (shih 1 Pje. 1:1; 2:11; Heb. 11:9-10). Kjo botë nuk është shtëpia jonë!

1:18 “duke ditur” Njohuria jonë për veprën e Krishtit për hirin tonë na bën që të jetojmë një jetë me bindje si Krishti.

Ka patur hamendësime mes komentuesve nëse Pjetri përdor kredo, himne, apo liturgji adhurimi të kishës së hershme në letrën e parë. 1 Pjetrit 1:18-21 dhe 2:21-25 tregojnë shenja formash poetike. Edhe Pali përdor nga këto materiale kredore, himnore dhe liturgjike, ose, ndoshta, dhe literaturë katekizmore të shndërruar në poezi për të ndihmuar kujtesën (shih Efe. 5:19; Fil. 2:6-11; Kol. 1:15-16; 3:15-20; 1 Tim. 3:16; 2 Tim. 2:11-13).

■ **“u shpenguat”** Fjala “i shpenguar” reflekton një term të DHV që ka kuptimin “shpengoj” dikë nga varfëria ose skllavëria. Ka dy fjalë hebraisht (peng, shpengoj). Një prej tyre ka ngjyrimin kuptimor shtesë: “shpengohem nga një i afërm” (*go’el*, shpenguesi farefisnor, shih Ruthi 4:1, 3, 6, 8, 14). Jezusi është i afërmi ynë, i cili na ka shpenguar me faljen e tij duke dhënë jetën e vet (shih Isa. 53; Marku 10:45; 2 Kor. 5:21). Shih Temën e Veçantë: Peng/Shpengoj në Marku 10:45.

NASB, NJB “nga mënyra juaj e kotë e jetës”
NKJV “nga sjellja juaj e pakuptimtë”
NRSV “nga mënyrat e kota”
TEV “nga mënyra e pavlerë e jetesës”

Ka dy mënyra si mund të interpretohet kjo frazë.

1. Bën fjalë për traditat e DHV (shih Isa. 29:13; Mat. 15:1-20; Marku 7:1-23) dhe reflekton fjalën hebraisht “e kotë”, “boshe”, ose “mjegull” (shih Jer. 2:5; Zak. 10:2). Fraza tjetër aludon për sistemin e flijimeve në DHV. Nëse është kështu, Pjetri po u flet judenjve besimtarë.
2. Bën fjalë për 1 Pje. 1:14 dhe për përvojën e shthurur pagane në të shkuarën e besimtarëve johebrenj. Për ta kuptuar në përgjithësi këtë fjalë, shih Veprat 14:15; 1 Kor. 15:17; Titit 3:9 dhe Jakobi 1:26.

1:19 “me gjakun e çmuar, si ai i një qengji” Kjo frazë aludon për sistemin e flijimeve të Izraelit (shih Lev. 1-7). Perëndia e ka lejuar me hir njerëzimin mëkatar që t’i afrohet me anë të flijimeve. Mëkati merr një jetë. Jeta është në gjak (shih Lev. 18:11, 14). Perëndia ka lejuar që jeta njerëzore të zëvendësohet me një jetë kafshe. Gjon Pagëzori e quajti Jezusin “Qengjin e Perëndisë që largon mëkatin e botës” (shih Gjoni 1:29). Vdekja e profetizuar e Jezusit (shih Isa. 53:7-8) largoi mëkatin e gjithë botës (shih Gjoni 3:16, 17; 4:42; 1 Gjonit 2:2; 4:14).

■ **“të patëmetë dhe të panjollë”** Këto janë metafora nga flijimet e DHV për kafshët e pranueshme për flijim (shih Lev. 22:19-20), kurse këtu bëjnë fjalë për natyrën e pamëkatë të Jezusit (shih Gjoni 8:46; 14:30; Luka 23:41; 2 Kor. 5:21; Heb. 4:15; 7:26-27; 1 Pje. 2:22, 3:18; 1 Gjonit 3:5). Ai ishte flijim i pranueshëm dhe i shenjtë.

1:20 “Sepse ai ishte i paranjohur” Kjo është pjesore e kryer pësore. Vepra shpenguese e Perëndisë përshkruhet me këtë fjalë në 1 Pje. 1:2. Vdekja e Krishtit nuk ishte diçka pa paramendim (shih Zan. 3:15; Psa. 22; Isa. 53; Marku 10:45; Veprat 2:23; 3:18; 4:28; 13:29). Jezusi erdhi për të vdekur!

■ **“përpara themelimit të botës”** Kjo frazë përdoret disa herë në DHR. Bën fjalë për veprimtarinë e Perëndisë para krijimit për shpengimin e njerëzimit (shih Mat. 25:34; Gjoni 17:24; Efe. 1:4; 1 Pje. 1:19-20; Zbu. 13:8). Kjo nënkupton dhe paraekzistencën e Jezusit (shih Gjoni 1:1-2; 8:57-58; 2 Kor. 8:9; Fil. 2:6-7; Kol. 1:17; Zbu. 13:8).

■ **“por është shfaqur”** Kjo është pjesore aoriste pësore, që do të thotë: “Perëndia ka bërë që ai të zbulohet qartë” (shih Heb. 9:26; 1 Gjonit 1:2; 3:5, 8).

■ **“këto kohët e fundit”** Bëhet fjalë për mishërimin e Jezusit në Betlehem. Ai ekzistonte si Hyjni nga përjetësia, por u zbulua qartë në formë njerëzore në Betlehem sipas profecive (shih Mik. 5:2). Ditët e fundit nisën me lindjen e Jezusit, pasi ai inauguroi Mbretërinë. Ato do të përmbushen në Ardhjen e tij të Dytë. Shih Temën e Veçantë: Kjo Epokë dhe Epoka e Ardhme në 1 Pjetrit 1:5.

■ **“që, përmes tij, jeni besimtarë në Perëndinë”** Fjalë për fjalë, “ata... që besojnë”. Mbiemri *pistos* përdoret si emër këtu (“besimtarët”).

Sfondi etimologjik i fjalës “besoj” (hebraisht *emeth*, greqisht, *pistis*) na ndihmon që t’ia përcaktojmë kuptimin në kohën e Pjetrit. Në hebraisht, në fillim nënkuptonte një njeri me qëndrim të drejtë. Më vonë, përdorej metaforikisht për dikë që ishte i besueshëm dhe besnik. Fjala greqisht përkthehet në gjuhën tonë me fjalët “besim”, “besoj”, ose “kam besim në dikë”. Besimi biblik nuk është pikësepri diçka që bëjmë, por një person tek i cili besojmë. Fokusi është te besnikëria e Perëndisë, jo e jona. Njerëzimi i rënë beson në besnikërinë e Perëndisë, në besueshmërinë e tij, në të Dashurin e tij. Fokusi ynë nuk është te bollëku apo fortësia e besimit njerëzor, por tek objekti i atij besimi.

1:21 “i cili e ringjalli nga vdekja” Kjo tregon miratimin e Perëndisë për jetën dhe vdekjen e Jezusit. Kjo është tematikë e përsëritur te Pjetri (shih Vep. 2:24-28,32, 3:15,26; 4:10; 5:30; 10:40; 1 Pje. 1:13, 3:18,21, dhe te Pali, Veprat 13:30,,33,34,37; 17:31; Rom. 4:24, 8:11; 10:9; 2 Kor. 4:14). Ky ishte vërtetimi se Ati e pranoi vdekjen zëvendësuese të Birit (shih 1 Kor. 15). Teologjikisht, të tre personat e Trinisë u përfshinë në ringjalljen e Krishtit.

1. Ati (Veprat 2:24; 3:15; 4:10; 5:30; 10:40; 13:30, 33, 34; 17:31)
2. Fryma (Rom. 8:11)
3. Biri (Gjoni 2:19-22; 10:17-18)

☐ **“dhe i dha lavdi”** Në këtë kontekst, pranimi dhe miratimi i Atit për fjalët dhe veprat e Birit shprehen në dy ngjarje të mëdha.

1. Ringjallja e Jezusit nga vdekja
2. Ngjitja e Jezusit në të djathtë të Atit

Shih Temën e Veçantë: Lavdi (*Doksa*) në Marku 10:37b.

TEKSTI I NASB (I PËRDITËSUAR): 1 PJETRIT 1:22-25

²²Meqë, në bindje ndaj së vërtetës, e keni pastruar shpirtin për një dashuri të sinqertë për vëllezërit, duajeni me zjarr njëri-tjetrin nga zemra, ²³sepse ju jeni rilindur, jo nga një farë e prishshme, por e paprishshme, pra, përmes fjalës së gjallë dhe të qëndrueshme të Perëndisë. ²⁴Sepse: “çdo mish është si bari, dhe gjithë lavdia e tij si lulja e barit. Bari thahet dhe lulja bie, ²⁵por fjala e Zotit mbetet përjetë”. Dhe kjo është fjala që ju predikua juve.

1:22 “në bindje” Bindja është motiv i përsëritur në kapitullin një (shih 1 Pje. 1:2, 14, 22). Bën fjalë për pranimin e ungjillit (pra, e vërteta, shih Gjoni 17:17; 2 Thes. 2:12) dhe për ecjen në të. Mos harroni se ungjilli është (1) një person; (2) e vërteta për atë person; dhe (3) jeta si ai person. Jezusi e shprehu rëndësinë e bindjes shumë qartë në Luka 6:46. Bindja është prova se ne jemi takuar vërtet me të dhe jemi ndryshuar prej tij. Jeta e përjetshme ka tipare të vrojtueshme.

☐ **“ndaj së vërtetës”** Fjalë për fjalë, “me anë të bindjes të së vërtetës”, që është konstrukt gjinor kundrinor. E vërteta është tipar i Perëndisë, por edhe i fëmijëve të tij. Shih Temën e Veçantë: E Vërteta, në 2 Pje. 1:12.

☐ **“e keni pastruar shpirtin”** Kjo është pjesore e kryer veprorë. Bindja ndaj së vërtetës çon në pastrim personal (shih Jakobi 4:8; 1 Gjonit 3:3). Ky pastrim shpirtëror nuk e fiton dashurinë dhe pranimin e Perëndisë, por e reflekton këtë dashuri dhe pranim. Ky proces pastrues nis në çastin e shpëtimit dhe vazhdon gjatë gjithë jetës (pjesore e kryer veprorë). Kjo çon në një dashuri të sinqertë për vëllezërit (shih 1 Gjonit 4:7-21). Krishterimi është edhe (1) një përgjigje individuale me besim ndaj ofertës së shpëtimit të Perëndisë përmes Krishtit, edhe (2) një përjetim kolektiv shërbese ndaj trupit të Krishtit (shih 1 Kor. 12:7). Besimtarët e shprehin dashurinë për Perëndinë duke dashur fëmijët e tij (shih Rom. 14:1-15:13). Shih shënimin më të plotë për “shpirtrat” në 1 Pje. 1:9.

☐ **“dashuri të sinqertë për vëllezërit... duajeni me zjarr njëri-tjetrin”** Përdorimi i fjalës “dashuri” në këtë frazë është një fjalë e përbërë greke, *filadelfia* (dashuria vëllazërore). Fjala “duajeni” është forma urdhërore aoriste veprorë e foljes *agapao*. Këto fjalë (*fileo* dhe *agapao*) përdoren në mënyrë të përkëmbyeshme në DHR (shih Gjoni 5:20 dhe krahasojeni me 3:25; po kështu Gjoni 16:27 dhe 17:23). Në disa pasazhe, si Gjoni 21:15-17, këto folje mund të përçojnë aspekte të ndryshme të dashurisë. Kisha e hershme mori një emër relativisht të papërdorur (*agape*) dhe filloi ta përdorte për të shprehur dashurinë vetëdhënëse dhe unike të Perëndisë në Krishtin.

1:23 “sepse ju jeni rilindur” Kjo është pjesore e kryer pjesore. Zhvillon mendimin teologjik të 1 Pje. 1:3. Kjo është një metafore familjare, e përdorur për t’i përshkruar të krishterët si anëtarë të rinj të familjes së Perëndisë nëpërmjet besimit në Krishtin (shih Gjoni 1:12-13). Kjo ngjan nga ana kuptimore me shprehjen e Gjonit “i lindur nga lart” në Gjoni 3:3.

Vini re të vërtetën e mahnitshme që përçon kjo folje.

1. koha e kryer = shpëtimi ynë nisi në të shkuarën dhe vazhdon në një gjendje të tanishme ekzistence
2. diateza pjesore = nuk e shpëtuam ne veten, por ky ishte veprim i jashtëm nga Perëndia triumfues

3. E njëjta formë foljore (një fjalë e ndryshme greqisht) gjendet dhe në Efe. 2:5, 8, që është një varg i mahnitshëm për sigurinë e shpëtimit të besimtarit.

▣ **“jo nga një farë e prishshme”** Fara është metaforë biblike për (1) shumimin (rabinët e përdornin për spermën), ose (2) për pasardhjen fizike (shih Zan. 12:1-3 për pasardhësit e Abrahamit). Kjo është ajo që jep jetë.

▣ **“përmes fjalës së gjallë dhe të qëndrueshme të Perëndisë”** Predikimi i ungjillit personifikohet si mjete me anë të së cilit Ati sjell në jetë besimtarët (shih Jakobi 1:18). Ky predikim apostolik i së vërtetës së ungjillit përshkruhet si diçka e gjallë dhe e qëndrueshme (shih Heb. 4:12); të dyja janë aspekte të JHVH-së!

1:24 Vargjet 24-25a janë citim nga Septuaginta e Isaisë 40:6-8 (shih Jobi 14:1-2; Psa. 90:5-6; 103:15-17), që thekson brishtësinë dhe natyrën e fundme të jetës njerëzore (shih Jakobi 1:10-11) në dallim nga natyra e përjetshme e Fjalës së Perëndisë (shih Jak. 1:21). Në kontekstin origjinal, këto vargje bënin fjalë për Izraelin, por tani bëjnë fjalë për kishën (shih 1 Pje. 2:5, 9). Transferimi i tyre është diçka karakteristike për 1 Pjetrin.

1:25 “fjala e Zotit” Ka dy fjalë greke që, zakonisht, përkthehen “fjalë” ose “mesazh”. Në greqishten *koine*, *logos* (shih Gjoni 1:1; 1 Pje. 1:23) dhe *rema* (pra, citimi nga DHV në Septuagint të 1 Pje. 1:25a, e aluduar dhe në 1 Pje. 1:25b) zakonisht janë sinonimike. Sinoniminë e përcakton konteksti, jo fjalori. Perëndia na e ka zbuluar veten (pra, me anë të zbulesës)!

TEKSTI I NASB (I PËRDITËSUAR): 1 PJETRIT 2:1-3

¹Prandaj, duke lënë mënjanë çdo keqdashje dhe çdo mashtrim, hipokrizi, smirë dhe çdo shpifje, ²si foshnja të sapolindura kërkoni me ngulm qumështin e pastër të fjalës, në mënyrë që, me anë të saj, të rriteni në lidhje me shpëtimin, ³nëse e keni shijuar mirësinë e Zotit.

2:1 “Prandaj” Kjo tregon se diskutimi i mëposhtëm bazohet në ato që sapo u thanë.

▣ **“duke lënë mënjanë”** Kjo është pjesore aoriste mesore, që fjalë për fjalë do të thotë “zhvesh”. Zhveshja e rrobave është metaforë e zakonshme biblike për të përshkruar jetën shpirtërore (shih Jobi 29:14; Psalmi 109; Psalmi 29; Isa. 61:10; Rom. 13:12; Efe. 4:22, 25, 31; Kol. 3:8; Heb. 12:1).

Vini re diatezën mesore, që thekson veprimin e kryefjalës. Besimtarët duhet ta zhveshin një herë e përgjithmonë (koha aoriste si veprim i kryer) gjithë ligësinë. Kjo është e mundur vetëm për shkak të prezantimit të mëparshëm teologjik të veprës së Perëndisë triun (shih 1 Pje. 1:2). Njerëzimi i rënë nuk është i aftë që t’ia kthejë shpinën mëkatit dhe ligësisë me forcat e veta, por Perëndia, në Krishtin dhe nëpërmjet Frymës, i ka aftësuar besimtarët që të kthehen plotësisht te Perëndia (shih Rom. 6). Tragjedia është se besimtarët vazhdojnë ta anashkalojnë këtë fuqi që ua ka dhënë Perëndia dhe zgjedhin të kthehen te ligësia (shih Rom. 7).

▣ **“çdo keqdashje”** Bëhet fjalë për “keqdashjen aktive” (shih Rom. 1:29; 1 Kor. 5:8; 14:20; Efe. 4:31; Kol. 3:8; Titit 3:3; 1 Pje. 2:16). Listat e veseve ishin të njohura në botën romake (p.sh., te stoikët), por edhe në DHR (shih Marku 7:21-27; Rom. 1:29-31; 13:13; 1 Kor. 5:10; 6:9-10; 2 Kor. 12:2; Gal. 5:19-20; Efe. 4:31; Kol. 3:8; 1 Tim. 1:9-10; 2 Pje. 2:10-14; Zbu. 21:8, 22:15).

▣ **“çdo mashtrim”** Kjo fjalë përdoret për “karremin e peshikimit”. Përshkruan përpjekjen për ta futur tjetrin në kurth me anë të mashtrimit (shih 1 Kor. 12:16; 1 Thes. 2:3; 1 Pje. 2:1, 22; 3:10).

▣ **“hipokrizi”** Fjalë për fjalë, “gjykoj nën [diçka]”. Është fjalë teatrale; përdoret për aktorët, të cilët flisnin pas një maske (pra, nën një maskë).

▣ **“smirë”** Kjo është xhelozia e shkaktuar nga dëshira për të patur diçka që e zotëron tjetri (shih Mat. 27:18; Marku 15:10; Rom. 1:29; Fil. 1:15; 1 Tim. 6:4; Titit 3:3; Jakobi 4:5).

▣ **“shpifje”** Bën fjalë për të folurit keq për dikë tjetër, në mënyrë që t’u nxjerrësh namin e keq (shih Rom. 1:30; 2 Kor. 12:20; 1 Pje. 2:1, 12; 3:16). Ky veprim përdoret në DHV dhe DHR për të përshkruar Satanin. Nga fakti që përmendet, është e qartë se ky ishte problem edhe në këto kisha që po përjetonin këtë përndjekje të madhe.

2:2 “si foshnja të sapolindura” Ndoshta, ka lidhje me këshillën e Jezusit për dishepujt: ata duhet të kenë besim si fëmijët e vegjël (shih Mat. 18:3 e më tej). Bën fjalë dhe për metaforën e mëparshme familjare të rilindjes (shih 1 Pje. 1:3, 23; Gjoni 3:3).

Në 1 Pjetrit 2, Pjetri përdor disa metafora për të përshkruar besimtarët.

1. foshnja të sapolindura, 1 Pje. 2:1
2. gurë të gjallë, që ndërtojnë një shtëpi shpirtërore, 1 Pje. 2:5
3. priftëri, 1 Pje. 2:5, 9
4. popull, 1 Pje. 2:9-10
5. të huaj dhe shtegtarë, 1 Pje. 2:11
6. dele, 1 Pje. 2:25

☐ **“kërkoni me ngulm”** Kjo është urdhërore aoriste veprore. Nënkupton një dëshirë të fortë (shih Fil. 1:8; 2:26). Rritja dhe pjekuria shpirtërore nuk janë diçka automatike në jetën e të krishterit. Thelbi i këtij urdhërimit shihet në Psa. 42:1-4 dhe në Mat. 5:6.

☐ **“e pastër”** Kjo fjalë është marrë nga industria e verës në shekullin e parë. Është fjala *dolon* (mashtim, shih 1 Pje. 1:1) me parashtesën mohore alfa. Shpesh, vera përzihej me ujë, sidomos vera e vjetër. Shpesh, tregtarët përpiqeshin të shisnin verë me ujë, ose të holluar. Prandaj, kjo fjalë përdorej metaforikisht për diçka që ishte “e papërzier”, ose “e vërtetë”.

Në përputhje me metaforën kontekstuale të së krishterëve si foshnja të sapolindura, këtu bëhet fjalë për ushqimin e domosdoshëm të bebeve: qumështi. Këta njerëz ishin shpëtuar nga fjala e Perëndisë (shih 1 Pje. 1:23); tani, duhet të rriteshin me fjalën e Perëndisë. Ky ishte rezultati i pritjes së rilindjes. Sa tragjedi që shumë besimtarë të krishterë mbeten foshnja!

☐ **“qumështin”** Tertuliani u jepte besimtarëve të rinj qumësht dhe mjaltë pas pagëzimit si simbol i jetës së tyre të re në Krishtin, pikërisht në bazë të këtij vargu biblik. Ne kemi nevojë për të vërtetën e Perëndisë, e cila na zbulohet vazhdimisht në Krishtin dhe në predikimin e apostujve (shih Heb. 5:12).

NASB, NKJV “të fjalës”
NRSV, TEV, “shpirtëror”
NJB

Kjo është fjala filozofike *logikos*, si në Rom. 12:1. Mund të nënkuptojë arsyetimin mendor (shih NASB, NKJV), ose mund të përdoret metaforikisht për diçka shpirtërore (shih NRSV, TEV, NJB). Qartazi, lidhet me nevojën e besimtarëve të rinj për predikimin dhe mësimdhënien e apostujve (shih 1 Pje. 1:23-25). Besimtarët duhet ta lexojnë dhe ta njohin mirë Biblën.

☐ **“të rriteni në lidhje me shpëtimin”** Kjo është lidhore aoriste pësore. Predikimi apostolik personifikohet si vepruesi i diatezës pësore, që i bën besimtarët të rriten. Në DHR, shpëtimi shihet si

1. vendim në të kaluarën (koha aoriste)
2. proces i vazhduar (koha e tashme)
3. ngjarje e shkuar që kulminon në një gjendje të tanishme (koha e kryer)
4. përmbushje e ardhshme (koha e ardhme)

Ky kontekst thotë se rritja shpirtërore me anë të së vërtetës së zbuluar të Perëndisë (shih 1 Pje. 1:23, 25; 2:2) është jetike për jetën e krishterë të përmbushur. Shih Temën e Veçantë në 1 Pje. 1:5.

2:3 “nëse e keni shijuar mirësinë e Zotit” Kjo është fjali kushtore e rendit të parë, që merret si e vërtetë. Besimtarët që kanë përjetuar hirin e Perëndisë duhet ta dëshirojnë të vërtetën e Perëndisë dhe të rriten në të vërtetën e tij për të patur një shpëtim të plotë. Vargu 3 është aludim për Psa. 34:8. Ky psalm flet për JHVH-në, por këtu bëhet fjalë për Jezusin. Libri i Shoqërive të Bashkuara të Biblës, *Handbook on the First Letter of Peter*, thotë se ndoshta bëhet fjalë për kungimin e parë të besimtarit (f. 53).

1. lojë fjalësh me termat mirësi (*khrestos*) dhe Krisht (*Khristos*)
2. Psalmi 34 përdorej nga kisha e hershme gjatë shërbesave të kungimit

3. “shijoj” (koha e kryer) bën fjalë për kungimin e parë (ndoshta, pas pagëzimit)

PYETJE PËR DISKUTIM

Ky është një komentari studimor udhëzues, që do të thotë se ti je vetë përgjegjës për interpretimin e Biblës. Secili prej nesh duhet të ecë sipas dritës që ka. Ti, Bibla dhe Fryma e Shenjtë keni përparësi në interpretim. Nuk duhet t'ia dorëzosh këtë të drejtë komentuesit.

Këto pyetje për diskutim t'i kam dhënë për të të ndihmuar që të analizosh çështjet kryesore të kësaj pjese të librit. Ato synojnë të të nxisin mendimin, jo të kenë natyrë shteruese.

1. Kujt po u shkruan Pjetri: judenjve, johebrenjve, apo të dyve?
2. Cila është e vërteta qendrore e lutjes së Pjetrit në 1 Pje. 1:3-9?
3. Pse vuajnë të krishterët?
4. Pse thuhet që shpëtimi ynë është ende në të ardhmen?
5. Çfarë donin profetët e DHV që të dinin me zjarrmi sipas 1 Pje. 1:10-12?
6. Rendit porositë e 1 Pje. 1:13-22.
7. Çfarë u nevojitet më tepër besimtarëve të rinj?

1 PJETRIT 2:4-25

NDARJET NË PARAGRAFË TË PËRKTHIMEVE MODERNE

UBS ⁴	NKJV	NRSV	TEV	NJB
Guri i gjallë dhe kombi i shenjtë	Fjala e qëndrueshme (1:22-2:3)	Thirrje për shenjtëri (1:23-2:10)	Guri i gjallë dhe kombi i shenjtë	Rilindja me anë të Fjalës (1:22-2:3)
2:1-8	Guri i zgjedhur dhe populli i zgjedhur i tij 2:4-10	2:4-8	2:1-8	Priftëria e re 2:4-8
2:9-10		2:9-10	2:9-10	2:9-10
Jetoni si shërbëtorë të Perëndisë	Jeta përpara botës	Detyrimet e të krishterëve (2:11-4:11)	Sklevërit e Perëndisë	Detyrimet e të krishterëve: kundrejt jobesimtarëve
2:11-12	2:11-12 Nënshtrimi ndaj qeverisë	2:11-12	2:11-12	2:11-12 Detyrimet e të krishterëve: kundrejt autoritetit civil
2:13-17	2:13-17	2:13-17	2:13-17	2:13-17
Shembulli i vuajtjes së Krishtit	Nënshtrimi ndaj zotërinjve		Shembulli i vuajtjes së Krishtit	Detyrimet e të krishterëve: ndaj zotërinjve
2:18-25	2:18-25	2:18-25	2:18-25	2:18-20 2:21-25

CIKLI TRE I LEXIMIT (shih f. v)

NDJEKJA E SYNIMIT TË AUTORIT FILLESTAR NË NIVELIN E PARAGRAFËVE

Ky është një komentuar studimor udhëzues, që do të thotë se ti je vetë përgjegjës për interpretimin e Biblës. Secili prej nesh duhet të ecë sipas dritës që ka. Ti, Bibla dhe Fryma e Shenjtë keni përparësi në interpretim. Nuk duhet t'ia dorëzosh këtë të drejtë komentuesit.

Lexo gjithë kapitullin njëherësh. Identifiko temat. Krahaso ndarjet e tua tematike me pesë përkthimet moderne. Ndarja në paragrafë nuk është e frymëzuar, por është çelësi për të ndjekur synimin e autorit fillestar, gjë që është thelbi i interpretimit. Secili paragraf ka vetëm një temë të vetme.

1. Paragrafi i parë
2. Paragrafi i dytë
3. Paragrafi i tretë
4. Etj.

STUDIMI I FJALËVE DHE FRAZAVE

TEKSTI I NASB (I PËRDITËSUAR): 1 PJETRIT 2:4-8

⁴Dhe, duke ardhur tek ai si te një gur i gjallë që është refuzuar nga njerëzit, por është i zgjedhur dhe i çmuar në sytë e Perëndisë, ⁵edhe ju, si gurë të gjallë, po ndërtoheni si shtëpi shpirtërore për një priftëri të shenjtë, për të ofruar flijime shpirtërore të pranueshme nga Perëndia përmes Jezu Krishtit. ⁶Sepse kjo gjendet në Shkrim: “Ja, unë vendos në Sion një gur të zgjedhur, një gur qoshe të çmuar, dhe ai që beson në të nuk do të zhgënjehet”. ⁷Pra, kjo vlerë e çmuar është për ju që besoni; por për ata që

nuk besojnë, “Guri që ndërtuesit hodhën poshtë, ky vetë u bë guri i qoshes”,⁸ dhe, “një gur pengese dhe shkëmb skandali”; sepse ata pengohen ngaqë janë të pabindur ndaj fjalës, dhe për këtë fund janë caktuar.

2:4 “Dhe, duke ardhur tek ai” Kjo është pjesore e tashme mesore (deponente). NKJV, NRSV dhe TEV e përkthejnë si urdhërore. Vini re ardhjen e vazhdueshme dhe elementin personal “tek ai”. Ungjilli është, në radhë të parë, një person që duhet mirëpritur, besuar dhe imituar. Kjo fjalë mund të ketë ngjyrimin kuptimor të afrimit të Perëndia si prift ose adhurues (shih Heb. 4:16; 7:25; 10:1, 22; 11:6). Pjetri e ndryshon metaforën e vet nga qumështi (1 Pje. 2:2-3) në metaforat e ndërtimit në 1 Pje. 2:4-8 (besimtarët si gurë të gjallë dhe Jezusi si guri i qoshes). Ndoshta, ky është aludim i vazhdueshëm nga Psa. 34:4 (Septuaginta).

■ **“si te një gur i gjallë”** Në DHV, shpesh, qëndrueshmëria, forca dhe këmbëngulja e Perëndisë përshkruhen duke përdorur analogjinë e shkëmbit si titull (shih LiP. 32:4,15,18,30; Ps. 18:2,31,46; 28:1; 31:3; 42:9; 71:3).

Metafora e Jezusit si gur gjendet në

1. Një gur të refuzuar (Psa. 118:22)
2. Një gur ndërtimi (Psa. 118:22; Isa. 28:16)
3. Një gur pengese (Isa. 8:14-15)
4. Një gur fitimtar dhe pushtues (mbretëri), (Dan. 2:45)

Jezusi i përdori këto pasazhe për të përshkruar veten (shih Mat. 21:40; Marku 12:10; Luka 20:17).

■ **“që është refuzuar nga njerëzit”** Kjo është pjesore e kryer pësore. Ky mund të jetë aludim për 1 Pje. 2:7, që vjen nga Septuaginta e Psa. 118:22. Guri hidhet poshtë nga “ndërtuesit”; ndoshta, bëhet fjalë për krerët judenj, por te Pjetri zgjerohet për të përfshirë gjithë njerëzit mosbesues. Kjo fjalë, që vjen nga *apo* dhe *dokimazo*, do të thotë ta vësh dikë ose diçka në sprovë për të parë nëse është i vërtetë apo kallp. Judenjtë vazhduan ta refuzonin Jezusin si Mesi dhe ky refuzim u shndërruar në një gjendje verbërie shpirtërore (shih Marku 8:31; Mat. 6:23).

■ **“por është i zgjedhur dhe i çmuar në sytë e Perëndisë”** Kjo është në kontrast të drejtpërdrejtë me frazën e mëparshme. Fjala “i zgjedhur” do të thotë fjalë për fjalë “i zgjedhur në kuptimin e paracaktimit” (shih 1 Pje. 1:2, 20). Mesia i refuzuar (i kryqëzuar, ose i papranuar) ka qenë gjithmonë plani i vetëm i Perëndisë për shpengimin (shih Luka 22:22; Veprat 2:23; 3:18; 4:28; 13:29; Efe. 1:11).

2:5 “si gurë të gjallë” DHR përdor një sërë metaforash kolektive për të përshkruar kishën.

1. Vresht (Gjoni 15:5)
2. Tufë (Gjoni 10:16)
3. Nuse (pra, familje, shih Efe. 5:27; Zbu. 19:7; 21:9)
4. Trup (Efe. 1:22-23; 1 Kor. 12)
5. Familje (Rom. 8:15-17; 1 Tim. 3:15)
6. Qytet (Heb. 11:10, 16; 12:22; 13:14; Zbu. 2:2, 10)
7. Këtu, tempull (shih 1 Kor. 3:9, 16; 6:19)

■ **“po ndërtoheni si shtëpi shpirtërore”** Kjo mund të jetë dëftore e tashme pësore, ndonëse, nga forma, mund të jetë dhe urdhërore e tashme pësore. Është e njëjta folje e përdorur në Mat. 16:18 për të përshkruar faktin se kisha është ndërtuar mbi shkëmbin e besimit personal (pra, Pjetri është shembull në këtë drejtim). Gjithë konteksti po vazhdon të zhvillojë metaforën e 1 Pje. 2:4. Jezusi është Tempulli i ri (shih Gjoni 2:18-22). Besimtarët në Krishtin janë priftëria e vërtetë. Judenjtë mosbesues janë penguar (shih 1 Pje. 2:7-8) pikërisht te gurët mbi të cilët JHVH ndërtoi tempullin e tij shpirtëror—(1) Jezusi dhe (2) kisha (shih 1 Tim. 3:15). Vetëm ata që kanë besim në Krishtin mund të funksionojnë në tempullin shpirtëror të Perëndisë, duke ofruar flijime të pranuar shpirtërisht (pra, jetën e tyre të shenjtë dhe vetëmohuese, shih 1 Pje. 1:14-16; Rom. 12:1-2).

TEMË E VEÇANTË: NDËRTOJ (SPECIAL TOPIC: EDIFY)

Kjo fjalë, *oikodomeō*, dhe format e tjera të saj përdoren shpesh nga Pali. Fjalë për fjalë, do të thotë “ndërtoj një shtëpi” (shih Mat. 7:24), por më vonë filloi të përdorej në mënyrë metaforike për:

1. trupin e Krishtit, kishën (1 Kor. 3:9; Efe. 2:21; 4:16)
2. ndërtimin
 - a. e vëllezërve të dobët (Rom. 15:1)
 - b. e të afërmeve (Rom. 15:2)
 - c. e njëri-tjetrit (Efe. 4:29; 1 Thes. 5:11)
 - d. e shenjtorëve për shërbesë (Efe. 4:11)
3. ne e ndërtojmë njëri-tjetrin me anë të
 - a. dashurisë (1 Kor. 8:1; Efe. 4:16)
 - b. kufizimit të lirisë personale (1 Kor. 10:23-24)
 - c. shmangies së hamendësimeve (1 Tim. 1:4)
 - d. kufizimit të folësve në shërbesat e adhurimit (këngëtarëve, mësuesve, profetëve, atyre që flasin në gjuhë, dhe interpretuesve); 1 Kor. 14:3-4, 12
4. të gjitha gjërat duhet të ndërtojnë
 - a. autoriteti i Palit (2 Kor. 10:8; 12:19; 13:10)
 - b. pohimet përmbledhëse në Rom 14:19 dhe 1 Kor. 14:26

■ **“për një priftëri të shenjtë”** Pjetri po përdor emrat e popullit të Perëndisë në DHV, Izraelit, për të përshkruar kishën (shih Eks. 19:5; 1 Pje. 2:9-10; Zbu. 1:6). Në DHV, JHVH premtoi se, përmes pasardhjes së Evës, do ta shpengonte gjithë njerëzimin (shih Zan. 3:15). JHVH thirri Abramin (shih Zan. 12:1-3) për të thirrur një mbretëri priftërinjsh (shih Eks. 19:5-6) që të ungjillizonte gjithë botën (shih Zan. 12:3 dhe Eks. 19:5). Izraeli dështoi në këtë detyrë (shih Ezek. 36:27-38). Prandaj, Perëndia caktoi një popull të ri besimi (shih Jer. 31:31-34; Ezek. 36:22-38) për të ungjillizuar botën (shih Mat. 28:19-20; Luka 24:47; Veprat 1:8; 1 Pje. 2:9).

Martin Luteri e përdori autoritetin e Biblës dhe të vërtetën paliane të shfajësimit me anë të hirit nëpërmjet besimit për të hedhur poshtë traditat e kishës katolike. Ai shpiku frazën “priftëria e besimtarit” (njëjës). Individualizmi perëndimor e ka marrë këtë parrullë dhe e ka kthyer në justifikim për liri personale në besim dhe stil jetese. Por ky koncept është kolektiv, jo individual (pra, vini re përemrat shumë në 1 Pje. 2:5, 7, 9). Fokusi i tij është shpallja e ungjillit, jo liria personale. Besimtarëve u është dhënë detyra ungjillizuese mbarëbotërore, që e kishte patur Izraeli (shih Rom. 15:16; Heb. 13:15-16). Është e vërtetë që priftëria nënkupton se tani kemi hyrje të drejtpërdrejtë te Perëndia përmes Krishtit, por nuk është ky synimi i kësaj metafore. Prifti qëndron midis popullit nevojtar dhe Perëndisë së shenjtë. Ai mbron, jo pozicionin e vet, por nevojat e popullit. DHR flet për priftërinë e besimtarëve (shumës, kolektive); ata duhet ta sjellin botën e humbur në besim te Krishti.

TEMË E VEÇANTË: KRISHTERIMI ËSHTË KOLEKTIV (SPECIAL TOPIC: CHRISTIANITY IS CORPORATE)

- A. Metaforat e Palit dhe Pjetrit në shumë për popullin e Perëndisë
 1. trupi (shih 1 Kor. 12:12-20)
 2. fusha (shih 1 Kor. 3:9)
 3. ndërtesa (shih 1 Pje. 2:4-5)
- B. Termi “shenjtor” është gjithmonë në SHUMËS (përveç Fil. 4:21; por edhe aty edhe në sensin kolektiv)
- C. Theksi që Martin Luteri dhe Reformacioni vinin te “priftëria e besimtarit” (pra, aftësia e shpirtit) është supozim biblik. Në të vërtetë, Bibla flet për “priftërinë e besimtarëve” (shih Eks. 19:6; 1 Pje. 2:5, 9; Zbu. 1:6).
- D. Secili besimtar ka dhunti për të mirën e përbashkët (shih 1 Kor. 12:7)
- E. Vetëm në bashkëpunim me njëri-tjetrin mund të jetë i frytshëm populli i Perëndisë. Shërbesa është kolektive (shih Efe. 4:11-12).

■ **“për të ofruar flijime shpirtërore”** Pas shkatërrimit të tempullit më 70 pas K., judentjë theksuan pasazhet e DHV që flisnin për flijimet pa kafshë (shih Psa. 50:14; 51:27; 69:30-31; 107:22; 141:2; Os. 14:2). Hebrejve 13:5 reflekton pikërisht këtë lloj flijimi të krishterë. Në kontekst, bëhet fjalë për faktin se besimtarët duhet të jetojnë një jetë të shenjtë dhe vetëmohuese (sidomos në 1 Pje. 2:14-16; Heb. 13:15-16).

2:6 “një gur të zgjedhur, një gur qoshe të çmuar” Ky është citim nga Isa. 28:16. Ky koncept i Mesisë si gur ose si shkëmb përsëritet në DHV (shih Psa. 118:22; Dan. 2:34-35; Isa. 8:14; 28:16). Këto pasazhe të DHV citohen shpesh në DHR (shih Mat. 21:42; Marku 12:10; Luka 20:17; 1 Kor. 10:4; Efe. 2:22; 1 Pje. 2:6-8) për të folur për Jezusin si i Premtuari i Perëndisë. Edhe Pjetri e përdori në predikimin e vet në Veprat 4:11. Shih shënimin në 1 Pje. 2:4b. Shih Temën e Veçantë: Guri i Qoshes në Marku 12:10.

NASB “ai që beson në të nuk do të zhgënjehet”

NKJV “ai që beson në të nuk do të turpërohet kurrsesi”

NRSV “kushdo që beson në të nuk do të turpërohet”

TEV “kushdo që beson në të nuk do të zhgënjehet”

NJB “askush që mbështetet në këtë nuk do të turpërohet”

Kjo frazë vjen nga LXX e Isa. 28:16. Vini re se ftesa është e hapur për të gjithë (shih Gjoni 1:12; 3:16; Rom. 10:9-13; 1 Tim. 2:4; 2 Pje. 3:9). Kjo është mohore e dyfishtë, “kurrë, kurrë, s’do të zhgënjehet”, ose “turpërohet”. Për “besoj” shih Temën e Veçantë në Marku 1:15.

F. F. Bruce, *Answers to Questions* (f. 158), vë në dukje dallimin mes tekstit të Septuagintës dhe tekstit hebraisht masoretik.

1. LXX – “nuk do të zhgënjehet” (NASB), ose “nuk do të turpërohet” (NJB) është folja *jebosh*

2. MT – “nuk do të trazohet” (NASB, shënim anash faqes), “nxitohet” është folja *jahish*

Në faqen 157, Bruce komenton se autorët e DHR ndoshta citonin versionin më në përdorim në kishën e hershme, përveçse nëse kishin arsye të veçantë teologjike për t’u larguar prej tij dhe për të përdorur një tjetër. Thelbi i këtij pasazhi është çelësi për konceptin e frymëzimit, jo lufta për secilën fjalë. Njerëzve u është dhënë një zbuluesë e besueshme!

2:7 “ndërtuesit” Targumët judaikë (përkthime aramaisht me komentar) e përdorin këtë term si titull për skribët. Ky citim vjen nga Psa. 118:22. Jezusi e përdor këtë citim nga DHV në shëmbëlltyrën e vreshtarëve të këqinj në Mat. 21:42. Kjo shëmbëlltyrë përshkruan krerët judenj të kohës së Jezusit. Është e paqartë nëse fjalët e forta gjykuese të Jezusit kishin të bënin me (1) refuzimin nga ana e tij të konceptit të udhëheqjes judaike jo-Aronike (pra, atë të Anës dhe Kajafës), të cilët e blenin këtë pozicion nga Roma, ose (2) me refuzimin nga ana e tij të gjithë popullit jude (pra, Izraelit) që nuk pranonte të besonte në të (shih Rom. 9-11).

2:8 “një gur pengese dhe shkëmb skandali” Ky është citim nga Isa. 8:14. Citohet edhe në Rom. 9:32, ku bëhet fjalë për Jezusin. Guri i veçantë është refuzuar dhe bëhet objekti i shkatërrimit!

■ **“janë të pabindur”** Kjo është pjesore e tashme veprare. Ata (jobesimtarët e kohës së Pjetrit, si judenj ashtu dhe johebrej) vazhdojnë të jenë të pabindur për shkak se refuzojnë Jezusin si Mesia i Përvuajtur. Ata kanë refuzuar, edhe predikimin e Jezusit, edhe atë të apostujve të tij (shih 1 Pje. 1:24, 25). Ata kanë refuzuar fjalën e përjetshme (pra, ungjillin, shih 1 Pje. 1:22-2:2).

NASB “dhe për këtë fund janë caktuar”

NKJV “për të cilën gjë dhe janë caktuar”

NRSV “ashtu siç ishin caktuar që të bënin”

TEV “i tillë ishte vullneti i Perëndisë për ta”

Kalvinistët e përdorin këtë varg dhe Rom. 9:22; 1 Thes. 5:9 për të thënë se Perëndia i zgjodhi disa për shpëtim dhe disa të tjerë për dënim. Mirëpo, vargje të tilla si Gjoni 3:16; 1 Tim. 2:4; 2 Pje. 3:9 tregojnë se kjo s’mund të jetë e vërtetë. Zgjedhja e Perëndisë është kryesisht për shenjtëri (shih Efe. 1:4; 2:10) dhe për ngjashmëri me Krishtin (shih Rom. 8:29).

Ky varg më kujton Isa. 6:9-13. Populli i besëlidhjes së Perëndisë kishte dritën e nevojshme për t’iu përgjigjur siç duhet atij, por nuk e bëri. Ky refuzim i vazhdueshëm bëri që t’i ngurtësohej zemra dhe të mos i përgjigjej dot. Vetëm gjykimi ishte i mundur. Peërndia i kohës dhe historisë e di çfarë do të bëjnë njerëzit, por ua lejon që ta bëjnë dhe, pastaj, i pranon pasojat e zgjedhjeve të tyre të përkohshme/të përrjetshme.

Këta besimtarë judenj duhet ta kenë patur shumë të vështirë që ta kuptonin refuzimin e Jezusit nga judenj. Si mund të ndodhte kjo? Këta besimtarë të hershëm nisën të lexonin Shkrimet për të gjetur arsyet për këtë mosbesim të habitshëm.

1. Isaia 6:9-10; 8:14-15; 43:8
2. Jeremia 5:21; 7
3. Mat. 21:33-44; Marku 12:1-12
4. Luka 2:34; 20:9-18
5. Romakëve 9-11
6. 1 Kor. 1:23

Citimi i mëposhtëm vjen nga F. F. Bruce, *Answers to Questions*, f. 196-197, për “zgjedhjen” kundrejt “përzgjedhjes”.

“A janë ‘zgjedhja për shpëtim’ dhe ‘zgjedhja për dënim’ terma të lidhur me njëri-tjetrin?”

Në disa sisteme teologjike, ato janë të lidhura vërtet; por është e rëndësishme që të gjitha sistemet teologjike t’i testojmë me anë të Shkrimit, dhe të mos harrojmë se, kur mësimi i Shkrimit sistematizohet, zakonisht diçka lihet jashtë në këtë proces. Fjala “zgjedhje” është bërë kaq e përfshirë në debate teologjike sa që kuptimi i mësimit biblik për këtë temë mund të kuptohet më mirë nëse përdorim një fjalë joteologjike si “përzgjedhja” në vendin e saj. Krishti përzgjedhi dymbëdhjetë burra për të qenë apostuj (Luka 6:13); përzgjedhi dhe Saulin e Tarsit si “enë të zgjedhur” (Veprat 9:15); por përzgjedhja e këtyre burrave nga ana e Jezusit për një qëllim të veçantë nuk i përçmon aspak të tjerët që nuk janë përzgjedhur për këtë gjë. Perëndia e përzgjedhi Izraelin nga kombet (Veprat 13:17)—për dobinë e madhe të kombeve të tjera, jo në dëm të tyre. Kur bëhet fjalë për zgjedhjen e popullit të Perëndisë në këtë epokë, nuk theksohet “zgjedhja e tyre për shpëtim”, por më tepër zgjedhja e tyre për shenjtëri. Për shembull, kështu ndodh në Efe. 1:4 dhe 1 Pje. 1:1 e më tej; dhe, në mënyrë të ngjashme, në Rom. 8:29, qëllimi për të cilin Perëndia i paracaktoi ata që i kishte paranojohur ishte që ata t’i “përshtateshin shëmbëllimit të Birit të tij”. Në asnjërën prej këtyre pasazheve nuk nënkuptohet se “zgjedhja për dënim” është biblike. Duhet t’i ruhem përgjithësimi nga vargje të veçanta si ai i Rom. 9:22 (“enë zemërimi të bëra për shkatërrim”) dhe 1 Pje. 2:8 (“ata pengohen ngaqë nuk i binden fjalës, dhe për këtë ishin caktuar”). Analogjia e përgjithshme e mësimit biblik për këtë temë tregon se disa janë zgjedhur ose përzgjedhur nga Perëndia—jo me qëllim që të tjerët, jashtë këtij grupi, të lihen në dënim, por me qëllim që të tjerët, përmes tyre, të bekohen.

TEKSTI I NASB (I PËRDITËSUAR): 1 PJETRIT 2:9-10

⁹Por ju jeni fis i zgjedhur, priftëri mbretërore, komb i shenjtë, popull për zotërimin e vetë Perëndisë, në mënyrë që të shpallni virtytet e shkëlqyera të atij që ju ka thirrur nga errësira në dritën e tij të mrekullueshme; ¹⁰sepse ju, dikur, nuk ishit popull, por tani jeni populli i Perëndisë; nuk kishit marrë mëshirë, por tani keni marrë mëshirë.

2:9 “Por ju” Vini re shumësin “ju” dhe kontrastin. Autori përdor një aludim të përbërë nga Eks. 19:6 dhe 19:5.

■ **“fis i zgjedhur”** Ky titull përshkruhet gjendet dhe në LiP. 7:6; 10:15; Isa. 43:20-21. Të zgjedhur për shërbesë! Ky është titull i DHV për shërbëtorët e zgjedhur.

■ **“priftëri mbretërore”** Ky titull gjendet në Eks. 19:6; Isa. 61:6; 66:21. Ashtu si Izraeli u zgjedh për t’ia përçuar botës njohurinë e JHVH-së, tani kishës i bëhet thirrje që të informojë mëkatarët dhe nevojtarët për JHVH-në dhe t’i sjellë tek ai.

■ **“komb i shenjtë”** Ky titull gjendet dhe në Eks. 19:6; LiP. 7:6; 14:2, 21; 26:19. Izraeli u thirr që të ishte në mënyrë unike i shenjtë dhe, kështu, t’i zbulonte botës së rënë Perëndinë e shenjtë (shih Mat. 5:48; 1 Pje. 1:15-16).

■ **“popull për zotërimin e vetë Perëndisë”** Ky titull përshkruet gjendet dhe në Eks. 19:5; LiP. 4:20; 7:6; 14:2; 26:18; Mal. 3:17. Ky pasazh flet për kishën si Izraeli shpirtëror (shih Gal. 6:16). Këta tituj të DHV për popullin e Perëndisë tani në DHR i zbatohen Trupit të Krishtit (shih Rom. 2:28-29; Gal. 3:29; 6:16; Efe. 2:11-3:13; Zbu. 1:6). Në disa mënyra, kisha e ka zëvendësuar Izraelin, për shembull, si në rastin e urdhërimit për misionin botëror (shih Mat. 28:19-20; Luka 24:47; Veprat 1:8).

■ **“në mënyrë që të shpallni virtytet e shkëlqyera të atij”** Qëllimi i popullit të Perëndisë është të dëshmojnë për madhësitë e Perëndisë, të vetmit krijues/shpengues të vërtetë! Ata janë zgjedhur dhe pajisur që të jetësojnë ungjillin dhe të flasin për të.

■ **“që ju ka thirrur nga errësira në dritën e tij të mrekullueshme”** Errësira dhe drita janë metafora biblike për mëkat, rebelimin dhe ligësinë kundrejt shpësës, së vërtetës, shërimit dhe mirësisë (shih Gjoni 1:4-5; 3:19-21; 8:12; 12:35-36,46; Acts 26:18; 2 Cor. 4:6; 1 John 1:5; 2:8-9,11). Ashtu si fraza e mëparshme mund të jetë aludim për Isa. 42:12, edhe kjo frazë mund të aludojë për Isa. 42:16.

2:10 “sepse ju, dikur, nuk ishit popull” Kjo shërben si hyrje për një citim nga Os. 1:10 dhe 2:23. Termi ky, është *lo ammi* (emri i njërit prej fëmijëve të Oseas) që, në fillim, i referohej Izraelit si një popull jo i Perëndisë për shkak të idhujtarisë dhe stilit të jetesës që thyente besëlidhjen. Izraelitët (1) besonin në aleancat politike, jo në Perëndinë, dhe (2) adhuronin Ba’alin duke përdorur emrin e JHVH-së.

■ **“por tani jeni populli i Perëndisë”** Edhe ky është citim nga Os. 2:23. Ky pasazh, në kontekstin e vet të DHV, thotë se, ndonëse Izraeli kishte mëkatuar dhe ishte larguar nga Perëndia i besëlidhjes, ai ishte gati që t’ua rikthente statusin e tyre të besëlidhjes (shihni metaforën e martesës). I njëjti Perëndi i dashur dhe zemërmadh tani ka hapur krahët për të pranuar johebrenjtë rebelë.

■ **“nuk kishit marrë mëshirë”** Profeti Osea kishte tre fëmijë, të cilëve u dha emra profetikë:

1. një djalë i quajtur *Jezreel*, që do të thotë “Perëndia bën të frytshëm”
2. një vajzë e quajtur *Lo-Ruhamah*, që do të thotë “pa mëshirë”
3. një djalë i quajtur *Lo-Ammi*, që do të thotë “jo populli im”

Ashtu si pjesa e parë e 1 Pje. 2:10 përdor emrin e fëmijës së tretë, pjesa e fundit e 1 Pje. 2:10 përdor emrin e fëmijës së dytë (shih Os. 1:6; 2:20, 23). Perëndia i pranon plotësisht mëkatarët për shkak se ka dhembshuri për ta.

Format gramatikore që gjenden në 1 Pje. 2:10 janë të dobishme për të shprehur thelbin teologjik të Pjetrit. Ekzistonte një kundërshtim i shprehur nga ana e johebrenjve, i shkaktuar nga veprimi i Satanit (pjesore e kryer pjesore), por Perëndia i besëlidhjes ka ndërhyrë në mënyrë vendimare në histori me anë të Mesisë së tij dhe ka sjellë një ditë të re mundësie për përfshirje në besëlidhje (pra pjesorja aoriste pjesore). Kjo e vërtetë është e ngjashme me misterin e planit të Perëndisë, që dikur ishte i fshehur, kurse tani është zbuluar (shih Efe. 2:11-3:13).

TEKSTI I NASB (I PËRDITËSUAR): 1 PJETRIT 2:11-12

¹¹Të dashur, ju nxis si të huaj dhe shtegtarë, që të hiqni dorë nga epsheet e mishit, të cilat luftojnë kundër shpirtit. ¹²Mbani një sjellje të shkëlqyer ndër johebrenjtë, në mënyrë që, pikërisht në ato që ju akuzojnë si keqbërës, të përlëvdojnë Perëndinë në ditën e vizitimit për shkak të veprave tuaja të mira, kur t’i vëzhgojnë.

2:11 “të huaj” Kjo fjalë e DHV nënkupton jobanorët me të drejta të kufizuara, që jetojnë në një vend që s’është vendlindja e tyre si Abrahami (shih Zan. 23:4; Psa. 39:12; Heb. 11:13; 1 Pje. 2:11). Këtu, përdoret metaforikisht për besimtarët që jetojnë në sistemin e kësaj bote të rënë.

■ **“shtegtarë”** Kjo fjalë nënkupton një qëndrim të shkurtër (shih 1 Pje. 1:1, 17). Aludon për faktin se besimtarët janë qytetarë të një sfere qiellore, jo vetëm qytetarë të këtij realiteti fizik të kufizuar nga koha dhe hapësira. Ne jemi krijesa mishi dhe shpirti (shih Zan. 1:26-27).

■ **“hiqni dorë”** Fjalë për fjalë, “vazhdoni t’i ruheni diçkaje” (pra, paskajore e tashme mesore). Besimtarët duhet të vazhdojnë të luftojnë kundër mëkatit dhe tundimit (shih Romakëve 7). Beteja me ligësinë nuk përfundon në çastin e shpëtimit (shih Efe. 6:10-20). Në shumë mënyra, madje forcohet pas kësaj. Kur njeriu beson dhe pranon

Krishtin, brendabanohet nga Fryma (shih Rom. 8:9) dhe i jepet një natyrë hyjnore (shih 2 Pje. 1:4). Megjithatë, kjo nuk do të thotë se natyra e tij e vjetër mëkatore zhduket. Ajo thjesht del jashtë funksioni nga vepra e përfunduar e Krishtit në vendin tonë (shih Romakëve 6, shih Temën e Veçantë: Anullim).

Rabinët thonë se, në zemrën e çdo njeriu, ka një qen të zi dhe një qenë të bardhë. Qeni që ushqen njeriu bëhet më i madhi. Besimtarët përballen vazhdimisht me zgjedhjen e kërimit të së mirës, banimit në drejtësi, ecjes në dritë, dhe zgjedhjen e riaktivizimit të natyrës së vjetër mëkatore! Besimtarët janë qytetarë të dy mbretërive (natyra e rënë mëkatore dhe Fryma, shih Rom. 8:5-17); dy epokave (pra, epoka e tanishme e ligë dhe epoka e drejtësisë, shih Titit 2:11-14; cila prej tyre ushtron ndikimin më të madh te ty?

■ **“nga epshet e mishit”** Trupi vetë nuk është i lig (mendimi grek), por është fushëbeteja e tundimeve egoiste dhe atyre satanike (shih Romakëve 6-8; Gal. 5:16-24).

■ **“të cilat luftojnë kundër shpirtit”** Kjo është dëftore e tashme mesore. Kjo luftë përshkruhet në Jakobi 4:1-4.

2:12 “Mbani një sjellje të shkëlqyer ndër johebrenjtë” Kjo është pjesore e tashme veprare, e përdorur si urdhërore. Jobsimtarët po na vëzhgojnë! Mënyra si besimtarët jetojnë dhe reagojnë ndaj betejave të përditshme të jetës shërbejnë si dëshmitarë për të gjithë ata që i njohin. Shpesh, jeta jonë flet me zë më të lartë se fjalët!

■ **“ju akuzojnë si keqbërës”** Të krishterët e hershëm akuzoheshin për

1. kanibalizëm (për shkak të terminologjisë së Darkës së Zotit)
2. incest (për shkak se donin njëri-tjetrin)
3. ateizëm (për shkak se Perëndia i tyre ishte i padukshëm)
4. tradhti të lartë (për shkak se nuk shkonin ushtarë, ose nuk betoheshin para Cezarit)
5. shturje (ndoshta, për shkak të puthjes së shenjtë)

Këto shpifje për Udhën (shih 1 Pje. 24:14; Veprat 28:22) duket se u zhvilluan në provincat lindore, që ishin pro-perandorit, ose në perandorinë romake (p.sh., në Azinë e Vogël).

■ **“të përlejnë Perëndinë...për shkak të veprave tuaja të mira”** Mënyra si jetojmë si të krishterë reflekton Perëndinë që pretendojmë se njohim dhe i shërbejmë (shih 1 Pje. 2:15; 3:16; Mat. 5:16; Fil. 2:15; Titit 2:7-8). Mënyra lidhore këtu paraqet një mundësi. Lavdia e Perëndisë është thirrja jonë më e lartë dhe detyra jonë ungjillizuese (shih 1 Pje. 4:11, 16).

■ **“në ditën e vizitimit”** Bëhet fjalë për çdo kohë kur Perëndia afrohet, qoftë për bekim, qoftë për gjykim (shih Isa. 10:3; Jer. 8:12; 10:15; 11:23; 23:12; 46:21; 48:44; 50:27; 51:18; Os. 9:7; Mik. 7:4). Mund të jetë vizitim brenda kohës, ose eskatologjik (shih Luka 19:44). Disa e shohin këtë si të lidhur me sprovimin e besimtarëve, por në këtë kontekst duket se bën fjalë për çdo mundësi kur i pashpëtuari dëgjon dhe i përgjigjet Jezusit si Shpëtimtar përpara se të përballet me të si Gjykatës.

NJË PËRVIJIM I SHKURTËR I Pjesës PRAKTIKE TË 1 PJETRIT

- A. Nënshtrimi ndaj qeverisë dhe komunitetit (1 Pje. 2:13-17)
- B. Nënshtrimi ndaj zotërinjve tokësorë (1 Pje. 2:18-25)
- C. Nënshtrimi në familjen e krishterë (1 Pje. 3:1-7)
- D. Nënshtrimi në mes të përndjekjes (1 Pje. 3:8-22)

TEKSTI I NASB (I PËRDITËSUAR): 1 PJETRIT 2:13-17

¹³Nënshtroni, për hir të Zotit, çdo institucioni njerëzor, qoftë një mbreti si atij në autoritet, ¹⁴qoftë guvernatorëve, si të dërguar prej tij për ndëshkimin e keqbërësve dhe për lavdërimin e atyre që bëjnë të mirën. ¹⁵Sepse i tillë është vullneti i Perëndisë që, duke bërë të drejtën, t'ia mbyllni gojën padijes së të pamendëve. ¹⁶Veproni si njerëz të lirë, dhe mos e përdorni lirinë si mbulesë për ligësinë, por përdoreni si skllëvër të Perëndisë. ¹⁷Nderoni gjithë njerëzit, duajeni vëllazërinë, druani Perëndinë, nderoni mbretin.

2:13 “Nënshtrojuni” Kjo është urdhërore aoriste pësore, por NASB dhe NKJV e përkthejnë si mesore (shih 1 Pje. 2:18). Nënkupton, nënshtrojuni “veten tuaj”, ndonëse kjo e fundit nuk gjendet në tekstin greqisht. Kjo nënkupton se ata duhet të bëjnë një zgjedhje vendimtare që të nënshtrohen (shih 1 Pje. 2:18; 3:1). Ky është term ushtarak, që përdorej për zinxhirin e komandës. Fjalë për fjalë, do të thotë: “vendose veten nën autoritet”. Ky është motiv i përsëritur te Pjetri (shih 1 Pje. 2:13, 18; 3:1, 5, 22; 5:5). Nënshtrimi nuk nënkupton pabarazi, sepse vetë Jezusi përshkruhet me këtë fjalë. Ky është qëndrim shërbimi nën autoritet. Në Efe. 5:21 nënshtrimi është një nga pesë karakteristikat e jetës së mbushur me Frymë (nënshtrimi reciprok ndaj njëri-tjetrit në Krishtin).

TEMË E VEÇANTË: NËNSHTRIM (*hupotassō*) (SPECIAL TOPIC: SUBMISSION [*hupotassō*])

Septuaginta e përdor këtë term për të përkthyer dhjetë fjalë të ndryshme hebraisht. Kuptimi thelbësor i kësaj fjale në hebraisht ishte “urdhëroj” ose “e drejta për të urdhëruar”. Kjo shihet në Septuagint (LXX).

1. Perëndia urdhëron (shih Lev. 10:1; Jona 2:1; 4:6-8)
2. Moisiu urdhëron (shih Eks. 36:6; LiP. 27:1)
3. Mbretërit urdhërojnë (shih 2 Kro. 31:13)

Në DHR ky kuptim vazhdon, si te Veprat 10:48, ku apostulli bën thirrje për “nënshtrim”. Megjithatë, DHR zhvillon dhe disa ngjyime të reja.

1. Zhvillohet një aspekt vullnetar (shpesh në DIATEZËN MESORE)
2. Ky veprim vetëkufizues mund të shihet në faktin se Jezusi iu nënshtroi
 - a. Atit (1 Kor. 15:25)
 - b. Prindërve të tij tokësorë (shih Luka 2:51)
3. Besimtarët iu nënshtrohen disa aspekteve të kulturës në mënyrë që ungjilli të mos marrë emrin e keq
 - a. Besimtarët e tjerë (shih Efe. 5:21)
 - b. Gratë besimtare (shih Kol. 3:18; Efe. 5:22-24; Titit 2:5; 1 Pje. 3:1)
 - c. Besimtarët iu nënshtrohen qeverive pagane (shih Rom. 13:1-7; 1 Pje. 2:13)

Besimtarët veprojnë ngaqë shtyhen nga dashuria për Perëndinë, për Krishtin, për Mbretërinë dhe për dobinë e të tjerëve.

Ashtu si me fjalën *agapao* (dua), edhe këtë fjalë (nënshtroj) kisha e mbushi me kuptim të ri në bazë të nevojave të Mbretërisë dhe nevojave të së tjerëve. Kjo fjalë shfaq një fisnikëri të re altruizmi, jo në bazë të urdhrave, por të një marrëdhënieje të re me Perëndinë dhe Mesinë e tij vetëflijues. Besimtarët binden dhe nënshtrohen për të mirën e të gjithëve dhe për bekimin e familjes së Perëndisë.

■ **“për hir të Zotit”** Ky është motivi për të gjitha veprimet tona (shih 1 Pje. 4:11; 1 Kor. 10:31; Kol. 3:17; Efe. 6:5).

■ **“çdo institucioni njerëzor”** Për “institucionin” shih Temën e Veçantë në Marku 10:6. Nga ajo që vijon, kjo është thirrje që t’i nënshtrohemi autoritetit qeveritar ose civil, njësoj si te Rom. 13:1-7 dhe Titit 3:1. Kjo është edhe më domethënëse në dritën e përndjekjes qeveritare me të cilën përballëshin këta besimtarë. Është e paqartë nëse përndjekja vinte nga judenjtë, paganët, qeverisja lokale, apo nga gjithë perandoria. Dëshmia jonë më e fortë për fuqinë e ungjillit ndodh në kohë përndjekjeje. Qëndrimi, fjalët dhe veprimet tona kur trajtohem padrejtësisht bëjnë që jobesimtarët ta vënë re këtë gjë.

TEMË E VEÇANTË: QEVERIA NJERËZORE (SPECIAL TOPIC: HUMAN GOVERNMENT)

I. HYRJE

- A. Përcaktim – Qeveria është organizimi i njerëzimit për të përmbushur dhe siguruar nevojat e perceptuara (p.sh., Zanafilla 4 dhe 11). Njerëzit janë qenie shoqërore (edhe përpara Rënies [shih Zan. 2:18]). Familjet, fiset dhe kombet na japin komunitet.
- B. Qëllimi – Vullneti i Perëndisë është që rendi është i preferueshëm ndaj anarkisë.
 1. Legjislacioni i Moisiut, veçanërisht Dekalogu, është vullneti i Perëndisë për njerëzimin në

shoqëri. Ai ekuilibron adhurimin dhe jetën.

2. Në Shkrim nuk përkrahet asnjë formë ose strukturë qeverisjeje, ndonëse teokracia e Izraelit të lashtë është forma paraprirëse e qiellit. As demokracia, as kapitalizmi, nuk janë e vërteta biblike. Të krishterët duhet të veprojnë siç duhet në çfarëdo sistemi qeverisës që të gjenden. Qëllimi i të krishterit është ungjillizimi dhe shërbesa, jo revolucioni. Të gjitha qeveritë janë kalimtare!

C. Origjina e qeverisjes njerëzore

1. Katolicizmi është shprehur se qeveria njerëzore është nevojë e qenësishme, madje dhe përpara Rënies. Aristoteli duket se ishte i pari që e siguroi këtë premisë. Ai thotë: “njeriu është kafshë politike”; me këtë nënkupton se qeveria “ekziston për përkrahjen e jetës së duhur”.
2. Protestantizmi, veçanërisht Martin Luteri, ka pohuar se qeveria njerëzore është e qenësishme pas Rënies. Ai e quan “dora e majtë e mbretërisë së Perëndisë”. Luteri thotë se “mënyra e Perëndisë për të bërë zap njerëzit e këqij është duke i mbajtur nën kontroll”.
3. Karl Marksi ka thënë se qeveria është mjet me anë të së cilit një elitë pakicë mban nën kontroll masat. Për të, qeveria dhe feja luajnë rol të ngjashëm.

II. MATERIALI BIBLIK

A. Dhiata e Vjetër

1. Izraeli është modeli që do të përdoret në qiell. Në Izraelin e lashtë, Mbret ishte JHVH. Teokracia është termi që përdoret për të përshkruar sundimin e drejtpërdrejtë të Perëndisë (shih 1 Sam. 8:4-9).
2. Sovraniteti i Perëndisë në qeverisjen njerëzore mund të shihet qartë në faktin se ai cakton.
 - a. të gjithë mbretërit (Dan. 2:21; 4:17, 24-25)
 - b. mbretërimin mesianik (Dan. 2:44-45)
 - c. Nebukadnecarin (neo-Babilonia) (Jer. 27:6; Dan. 5:28)
 - d. Kirin II (Persi) (2 Kro. 36:22; Esdra 1:1; Isa. 44:28; 45:1)
3. Populli i Perëndisë duhet të jetë i nënshtruar dhe respektues edhe ndaj qeverive pushtuese dhe zaptuese:
 - a. Danieli 1-4, Nebukadnecari (neo-Babilonia)
 - b. Danieli 5, Belshacari (neo-Babilonia)
 - c. Danieli 6, Dari (Persia)
 - d. Esdra dhe Nehemia (Persia)
4. Judea e mëkëmbur duhet të lutej për Kirin dhe për mbretërimin e pasardhësve të tij
 - a. Esdra 6:10; 7:23
 - b. Judenjtë duhet të luteshin për autoritetet civile, Mishnah, Avot. 3:2

B. Dhiata e Re

1. Jezusi tregonte respekt për qeveritë njerëzore
 - a. Mateu 17:24-27; ai pagoi taksën e tempullit (autoritetet fetare dhe civile duhet të ishin një; shih 1 Pje. 2:17)
 - b. Mateu 22:15-22; Marku 12:13-17; Luka 20:20-26; ai përkrahu dhënien e taksës romake dhe, në këtë mënyrë, edhe autoritetin civil romak
 - c. Gjoni 19:11; Perëndia lejon autoritetin civil
2. Fjalët e Palit në lidhje me qeveritë njerëzore
 - a. Romakëve 13:1-5; besimtarët duhet t’u nënshtrohen autoriteteve civile, pasi janë caktuar nga Perëndia
 - b. Romakëve 13:6-7; besimtarët duhet të paguajnë taksat dhe të nderojnë autoritetet civile
 - c. 1 Timoteut 2:1-3; besimtarët duhet të luten për autoritetet civile
 - d. Titit 3:1; besimtarët duhet t’u nënshtrohen autoriteteve civile
3. Fjalët e Pjetrit në lidhje me qeveritë njerëzore
 - a. Veprat 4:1-31; 5:29; Pjetri dhe Gjoni përpara Sinedrit (kjo tregon precedentin biblik për mosbindjen civile).
 - b. 1 Pjetrit 2:13-17; besimtarët duhet t’u nënshtrohen autoriteteve civile për të mirën e shoqërisë dhe ungjillizimit
4. Fjalët e Gjonit në lidhje me qeveritë njerëzore
 - a. Zbulesa 17; lavirja e Babilonisë simbolizon qeverisjen njerëzore, e cila organizohet

dhe funksionon veçmas Perëndisë

b. Zbulesa 18; lavirja e Babilonisë shkatërrohet

III. PËRMBYLLJE

- A. Qeverisja njerëzore (në këtë botë të rënë) caktohet nga Perëndia. Kjo nuk është “e drejta hyjnore mbretërve”, por detyra hyjnore e qeverisjes. Asnjë formë nuk përkrahet mbi të tjerat.
- B. Detyra fetare e besimtarëve është t’i binden autoritetit civil dhe të lutet për të.
- C. Detyra e besimtarëve është ta mbështesin qeverinë njerëzore me anë të taksave, duke shfaqur qëndrimin e duhur plot respekt.
- D. Qeveria njerëzore ekziston me qëllim që të ruajë rendin. Ata janë shërbëtorë të Perëndisë për këtë detyrë.
- E. Qeveria njerëzore nuk është absolute. Ajo është e kufizuar në autoritetin e vet. Besimtarët duhet të veprojnë për hir të ndërgjegjes duke refuzuar autoritetin civil kur ai i tejkalon caqet që i ka caktuar Perëndia. Siç pohoi Augustini në *Qytetin e Perëndisë*, ne jemi qytetarë të dy mbretërve, asaj të përkohshme dhe asaj hyjnore (shih Fil. 3:20). Ne kemi përgjegjësi ndaj të dyjave, por absolutja është mbretëria e Perëndisë! Jepet një fokus individual dhe kolektiv në lidhje me përgjegjësinë tonë ndaj Perëndisë.
- F. Ne duhet t’i inkurajojmë besimtarët e sistemeve demokratike që të marrin pjesë aktive në procesin e qeverisjes dhe që të zbatojnë, aty ku është e mundur, mësimet e Shkrimit.
- G. Ndryshimi shoqëror duhet paraprirë nga kthimi individual në besim. Nuk ekziston asnjë shpresë e qëndrueshme dhe e vërtetë eskatologjike në qeverinë njerëzore. Të gjitha qeveritë e njerëzve, ndonëse të caktuara dhe të përdorura nga Perëndia, janë shprehje të mëkatshme të organizimit njerëzor që funksionon veçmas Perëndisë. Ky koncept shprehet në përdorimin që i bën Gjoni fjalës “botë” (shih 1 Gjonit 2:15-17).

■ **“si atij në autoritet”** Ky term, në greqishten klasike, kishte kuptimin “themeluesi njerëzor i një qyteti”; mirëpo, në DHR përdoret gjithmonë për autoritetin e Perëndisë (shih Mat. 22:21; Rom. 13:1-7; 1 Tim. 2:1-7; Titit 3:1-8), që shpesh u jepet organizatave njerëzore. Perëndia preferon rendin ndaj anarkisë.

2:14 “qoftë guvernatorëve, si të dërguar prej tij” Kjo është pjesore e tashme pësore. Perëndia është në kontroll të gjithçkaje. Ky pasazh nuk mëson “të drejtën hyjnore të mbretërve”, por pohon se Perëndia e mbështet ligjin dhe rendin (pra, shoqërinë e qëndrueshmë), jo anarkinë.

Përemri “tij” mund të bëjë fjalë për (1) Perëndinë, ose (2) guvernatorin.

■ **“për ndëshkimin e keqbërësve”** Qeveria ka autoritetin e dhënë nga Perëndia që të ruajë rendin dhe të përmbajë e ndëshkojë mungesën e rendit. Një formë e këtij autoriteti është dënimi me vdekje (shih Rom. 13:4; Veprat 25:11).

2:15 “Sepse i tillë është vullneti i Perëndisë” Shih Temën e Veçantë më poshtë.

TEMË E VEÇANTË: VULLNETI (*thelēma*) I PERËNDISË (SPECIAL TOPIC: THE WILL [*thelēma*] OF GOD)

Vullneti i Perëndisë përfshin disa kategori.

UNGJILLI I GJONIT

- Jezusi erdhi për të bërë vullnetin e Atit (4:34; 5:30; 6:38)
- për të ngritur ditën e fundit të gjithë ata që Ati i dha Birit (shih 6:39)
- që të gjithë të besojnë në Birin (shih 6:29, 40)
- përgjigje ndaj lutjeve që lidhen me kryerjen e vullnetit të Perëndisë (shih 9:31 dhe 1 Gjonit 5:14)

UNGJILTË SINOPTIKË

- kryerja e vullnetit të Perëndisë ka rëndësi jetike (shih Mat. 7:21)

- kryerja e vullnetit të Perëndisë e bën besimtarin vëlla ose motër me Jezusin (shih Mat. 12:50; Marku 3:35)
- nuk është vullneti i Perëndisë që njerëzit të humbasin (shih Mat. 18:14; 1 Tim. 2:4; 2 Pjet. 3:9)
- Kalvari ishte vullneti i Atit për Jezusin (shih Mat. 26:42; Luka 22:42)

LETRAT E PALIT

- pjekuria dhe shërbesa e gjithë besimtarëve (shih Rom. 12:1-2)
- besimtarët çlirohen nga kjo epokë e ligë (shih Gal. 1:4)
- vullneti i Perëndisë ishte plani i tij shpengues (shih Efe. 1:5, 9, 11)
- besimtarët përjetojnë dhe jetojnë jetën e mbushur me Frymën (shih Efe. 5:17-18)
- besimtarët mbushen me njohurinë e Perëndisë (shih Kol. 1:9)
- besimtarët përsosen dhe përmbushen (shih Kol. 4:12)
- besimtarët shenjtërohen (shih 1 Thes. 4:3)
- besimtarët japin falënderim për të gjitha gjërat (shih 1 Thes. 5:18)

LETRAT E PJETRIT

- besimtarët bëjnë gjënë e duhur (pra, u nënshtrohen autoriteteve qeverisëse) dhe, në këtë mënyrë, u mbyllin gojën njerëzve të marrë, duke siguruar një mundësi për ungjillizim (shih 1 Pjet. 2:15)
- besimtarët vuajnë (shih 1 Pjet. 3:17; 4:19)
- besimtarët nuk bëjnë jetë egoiste (shih 1 Pjet. 4:2)

LETRAT E GJONIT

- besimtarët mbeten përjetë (shih 1 Gjonit 2:17)
- besimtarët kanë rol kyç në përgjigjen e lutjeve (shih 1 Gjonit 5:14)

▣ **“t’ia mbyllni gojën”** Fjalë për fjalë, “vendosi mamuze” (shih Marku 1:25; 4:39).

▣ **“padijes”** Bëhet fjalë për njeriun të cilit i mungon mprehtësia shpirtërore (shih 1 Kor. 15:34).

▣ **“të pamendëve”** Ky term renditet në serinë e mëkateve në Marku 7:22. Përshkruan mësuesit jobesimtarë judenj në Rom. 3:20, por përdoret për të përshkruar besimtarët në Efe. 5:17. Prandaj, nënkupton një gjendje mendore përtace që prek edhe të shpëtuarit, edhe të pashpëtuarit. Këtu, bën fjalë për paganët e painformuar, të cilët po akuzojnë besimtarët për gjëra që s’janë të vërteta (shih 1 Pje. 2:12).

2:16 “Veproni si njerëz të lirë” Kjo është urdhërore e nënkuptuar (shih NASB, TEV, NIV). Është në kontrast me paganët, të cilët janë skllëvër ndaj mëkatit. Besimtarët kanë mundësi zgjedhjeje. Jezusi i ka çliruar nga zotërimi i mëkatit (shih Romakëve 6), por shpesh ata e përdorin lirinë e tyre të re për të zgjedhur sërish mëkatin.

▣ **“mos e përdorni lirinë si mbulesë për ligësinë”** Fjalë për fjalë, “duke patur” (pjesore e tashme veprare) e mohuar, e përdorur si urdhërore. Tepër shpesh, ne e kthejmë lirinë në shturje (shih 1 Kor. 8:9; Gal. 5:13) në vend që ta kthejmë në dëshmi të gjallë flijuese (shih Rom. 14:1-15:13). Liria sjell gjithmonë përgjegjësi, por kujdes nga legalizmi ose ritualizmi (shih 1 Kor. 8-10; Kol. 2:16-23)! Besimtarët tani janë të lirë nga mëkati për t’i shërbyer Perëndisë (shih Rom. 6) dhe njëri-tjetrit (shih 1 Kor. 9:19-23).

▣ **“por përdoreni si skllëvër të Perëndisë”** Besimtarët janë çliruar nga mëkati dhe, tani, janë të lirë për t’i shërbyer Perëndisë (shih Rom. 6:22).

2:17 “Nderoni gjithë njerëzit” Kjo është urdhërore aoriste veprate, e para nga katër urdhërimet e forta përmbledhëse në 1 Pje. 2:17. Kjo kërkon që të pranojmë vlerën e gjithë njerëzve në sytë e Perëndisë (shih Zan. 1:26-27; Gjoni 3:16) dhe të jetojmë në mënyrë që t’i bindim ata të besojnë në Krishtin (shih Mat. 28:18-20; Luka 24:47; Veprat 1:8).

■ **“duajeni vëllazërinë”** Kjo është urdhërore e tashme veprare. Të krishterët duhet ta duan vazhdimisht njëri-tjetrin (shih 1 Pje. 1:22; Gjoni 13:34; 15:12, 17; Rom. 12:10; 1 Thes. 4:9; Heb. 13:1; 1 Gjonit 2:7-8; 3:11, 23; 4:1, 11; 2 Gjonit 5). Dashuria është prova e vërtetë se e njohim Perëndinë, kemi besuar në Krishtin, dhe se udhëhiqemi nga Fryma. Dashuria është tipari familjar i Perëndisë. Besimtarët duhet t’i duan gjithë njerëzit për hir të ungjillit dhe t’i duan të krishterët e tjerë, për shkak se janë pjesë e familjes së Perëndisë.

■ **“druani Perëndinë”** Kjo është urdhërore e tashme mesore (deponente) (shih Jobi 28:28; Psa. 111:10; Fja. 1:7; 15:33). Dhe fjalën “fobi” e marrim pikërisht nga kjo fjalë greqisht. Ajo përdoret në kuptimin e nderimit dhe respektit. Të gjitha veprimet e besimtarëve duhet të rrjedhin nga marrëdhënia e tyre me Perëndinë dhe në lidhje me të!

■ **“nderoni mbretin”** Këto dy urdhërore të tashme mund të jenë aludim i Fja. 24:21. Mos harroni se, në kohën e Pjetrit, perandori ishte Neroni (shih 1 Pje. 2:13)!

TEKSTI I NASB (I PËRDITËSUAR): 1 PJETRIT 2:18-25

¹⁸Shërbëtorë, nënshtrojuni zotërinjve tuaj me çdo respekt, jo vetëm atyre që janë të mirë dhe zemërbutë, por edhe atyre që janë të paarsyeshëm. ¹⁹Sepse kjo gjen pëlqim, nëse, për hir të ndërgjegjes ndaj Perëndisë, dikush duron nën trishtime kur vuan padrejtësisht. ²⁰Sepse, ç’lavdërim ka nëse, kur ti mëkaton dhe trajtohesh rëndë, e duron me durim? Por, nëse bën atë që është e drejtë dhe vuan për të, e duron me durim, kjo gjen pëlqim te Perëndia. ²¹Sepse për këtë qëllim jeni thirrur, pasi edhe Krishti vuajti për ju, duke ju lënë një shembull për ju, që të ndiqni hapat e tij, ²²i cili nuk kreu asnjë mëkat, dhe as nuk u gjet asnjë mashtrim në gojën e tij; ²³dhe, kur e fyenin, nuk e kthente fyerjen; kur vuante, nuk shqiptoi asnjë kërcënim, por vazhdoi t’ia besonte veten atij që gjykon drejtësisht; ²⁴dhe ai vetë i mbarti mëkatet tona në trupin e vet në kryq, në mënyrë që të vdesim ndaj mëkatit dhe të jetojmë ndaj drejtësisë; sepse nga plagët e tij jeni shëruar. ²⁵Sepse ju endeshit vazhdimisht si delet, por tani jeni kthyer te Bariu dhe Rojtari i shpirtave tuaj.

2:18 “Shërbëtorë, nënshtrojuni zotërinjve tuaj” Kjo pjesore e tashme mesore përdoret si urdhërore (shih shënimin dhe Temën e Veçantë në 1 Pje. 2:13). Skllëvërit besimtarë i respektojnë zotërinjtë e tyre tokësore për shkak se respektojnë Perëndinë! Kjo, madje, përfshin dhe ata zotërinj jobesimtarë që janë të padrejtë, mizorë, ose ata skllavopronarë të krishterë që veprojnë padrejtësisht. Në kohën tonë, një zbatim i kësaj këshille do të ishte marrëdhënia e punëdhënësve të krishterë me të punësuarit e krishterë. Kjo është e ngjashme me mësimet e Palit në Efe. 6:5-9. Vini re #3 në Temën e Veçantë më poshtë.

Ky është vendi i duhur për të diskutuar për aspektin kulturor të interpretimit biblik. Nëse ungjilli do ta kishte sfiduar (1) kulturën patriarkale greko-romake të shekullit të parë, ose (2) kulturën e skllavërisë, atëherë ungjilli do të ishte refuzuar dhe shkatërruar nga shoqëria e shekullit të parë. Duke predikuar ungjillin, të dyja këto pengesa ranë me kalimin e kohës! Bibla duhet interpretuar gjithmonë në kontekstin e vet historik dhe, pastaj të vërtetat e frymëzuara mund të zbatohen për kohën dhe kulturën tonë me të njëjtën fuqi dhe ndikim. Kjo nuk do të thotë që të përpiqemi ta riprodhojmë klaturën e shekullit të parë si vullnetin e Perëndisë për çdo shoqëri dhe në çdo kohë. Synimi është predikimi i të vërtetës së përyetshme të ungjillit, i cili do të ndikojë tek individit dhe, në fund, të vetë shoqëria.

TEMË E VEÇANTË: POROSITË E PALIT PËR SKLLEVËRIT (SPECIAL TOPIC: PAUL’S ADMONITIONS TO SLAVES)

1. Ji i kënaqur, por nëse të del mundësia për të fituar lirinë, shfrytëzoje (1 Kor. 7:21-24).
2. Në Krishtin nuk ka skllav apo të lirë (Gal. 3:28; Kol. 3:11; shih 1 Kor. 12:13).
3. Puno si për Zotin; ai do të ta shpërblejë (Efe. 6:5-9; Kol. 3:22-25; shih 1 Pje. 2:18-20).
4. Në Krishtin skllëvërit bëhen vëllazër (1 Tim. 6:2; Filemoni 1:16-17).
5. Skllëvërit e perëndishëm e nderojnë Perëndinë (1 Tim. 6:1; Titit 2:9).

Porositë e Palit për skllavopronarët:

Skllëvërit dhe skllavopronarët e krishterë kanë të njëjtin Zotëri; prandaj, duhet ta trajtojnë njëri-tjetrin

me respekt (Efe. 6:9; Kol. 4:1).

Skllavëria është një nga elementet kulturore (si kultura patriarkale) që ishte shtyllë e botës së shekullit të parë. DHR nuk e sfidon këtë aspekt. Megjithatë, të vërtetat e ungjillit, me kalimin e kohës sollën ndryshime në këtë aspekt kulturor.

2:19

NASB “Sepse kjo gjen pëlqim”

NKJV “Sepse kjo është e lavdërueshme”

NRSV “Sepse kjo është lëvdim për ju”

TEV “Perëndia do t’ju bekojë për këtë”

NJB “Shihni, ka meritë”

Bëhet fjalë për faktin se Perëndia e miraton nënshtrimin edhe në mes të përndjekjes, pasi kjo vuajtje lidhet me bindjen tonë të krishterë dhe me besimin tonë në Krishtin (shih 1 Pje. 3:14, 17; 4:13-14, 16). “Pëlqimi” është fjala greke *kharis* (hir), që përdoret në kuptimin e vet joteologjik.

▣ **“nëse”** Kjo është fjali kushtore e rendit të parë, pra, supozohet si e vërtetë nga pikëvështrimi i autorit, ose për qëllimet e tij letrare. Skllavërit e krishterë po vuanin nën zotërinj mizorë për hir të Krishtit.

▣ **“ndërgjegjes”** Shih shënimin në 1 Pjetrit 3:16.

2:20 “Sepse, ç’lavdërim ka” Kjo është një fjalë për nderin, që lidhet me reputacionin personal (shih Luka 6:32-34). Vjen nga fjala greke *kaleo*, që do të thotë “thërras”. Prandaj, bën fjalë për thirrje nderimi, lavdërimi, ose lavdie për dikë.

▣ **“nëse”** Në këtë varg ka dy fjali kushtore të rendit të parë, që supozohen si të vërteta. Fjali e parë kushtore përdoret në kuptimin mohor, ndërsa e dyta në kuptimin pohor. Perëndia është i kënaqur kur besimtarët vuajnë padrejtësisht por, me durim, për shkak se janë besimtarë (shih 1 Pje. 1:29; 3:24, 27; 4:12-16; Mat. 5:10-16).

2:21 “Sepse për këtë qëllim jeni thirrur” Kjo është dëftore aoriste pësore. Në kontekst, kjo frazë do të thotë se besimtarët janë thirrur për të imituar jetën e Jezusit, gjë që i sjell lavdi Perëndisë dhe shpëtim njerëzimit. Kjo është thirrje për nënshtrim për gjithë besimtarët, gjë që do të sjellë pjekuri shpirtërore dhe dëshmi të fuqishme për ungjillin.

Është thënie e papritur që besimtarët janë thirrur nga Perëndia për të vuajtur, sidomos për kulturën perëndimore që e mendon krishterimin në këtë mënyrë: (1) “ç’fitoj unë nga kjo?” ose, (2) një ungjill shëndeti, pasurie dhe prosperiteti. Përndjekja e besimtarëve është mundësi reale në këtë botë të rënë (shih Veprat 14:22; Rom. 5:3-4; 8:17; Fil. 1:29; 1 Thess. 3:3-4; 2 Tim. 3:12; Jak. 1:2-4; 1 Pje. 3:14; 4:12-19).

▣ **“edhe Krishti vuajti”** Vuajtja e Mesisë ishte habi për judenjtë, të cilët prisnin një Mesi pushtues dhe triumfues. Por për këtë gjë ka shenja të qarta në DHV (shih Zan. 3:15; Psa. 22; Isa. 53). Vetë Jezusi ua tregoi (1) apostujve të vet (shih Mat. 16:21; 17:12, 22-23; 20:18-19) dhe (2) kishës së hershme këto pasazhe profetike (shih Luka 24:25-27).

Vuajtja dhe vdekja e tij ishin pjesë e qenësishme e predikimit apostolik të kishës së hershme në Veprat (që quhej *kerigma*). Shih Veprat 2:23; 3:13-14, 18; 17:3; 26:23). Shih Temën e Veçantë në 1 Pje. 1:11.

Me vuajtjen e tij lidhen një sërë të vërtetash kyçe teologjike.

1. Krishti është shembulli ynë (1 Pje. 2:21)
2. Krishti mbajti mëkatet tona në kryq (1 Pje. 2:24)
3. Vepra e Krishtit na bëri të vdisnim ndaj mëkatit dhe të jetonim për Perëndinë (1 Pje. 2:24)
4. Krishti është Bari dhe Rojtari i shpirtave tanë (1 Pje. 2:25)

Fjala “vuajti” (*epathen*) gjendet në dorëshkrimet P72, A, B dhe C, por disa dorëshkrime të tjera të lashta, si P81, dhe Sinaitikus, lexojnë “vdiq” (*apethanen*). UBS4 i jep leximit të parë vlerësimin “A” (i sigurt), pasi mendohet që “vdiq” është shtuar nga disa kopjues nga 1 Pje. 3:18.

▣ **“një shembull”** DHR jep tri arsye pse erdhi Krishti:

1. Për të qenë shlyerja zëvendësuese e Perëndisë. Ai, Qengji i pafajshëm dhe i panjollë (shih 1 Pje. 2:22) i Perëndisë (shih Gjoni 1:29), ofroi veten për hirin tonë (shih 1 Pje. 2:24).
2. Për të qenë zbulesa e plotë e Atit (shih Gjoni 1:1-14; 14:8-9).
3. Për të qenë shembull për besimtarët (shih 1 Pje. 2:21), që ata ta imitojnë. Ai është izraeliti ideal, njeriu i përsosur, ajo që njerëzimi duhet të kishte qenë, mund të jetë dhe, një ditë, do të jetë me siguri.

2:22 “i cili nuk kreu asnjë mëkat” Ky është citim nga Isa. 53:9. Ky koncept shprehet dhe në Gjoni 8:46, 14:30; Luka 23:41; 2 Kor. 5:21; Heb. 4:15, 7:26-27; 1 Pje. 1:19; 2:22; 3:18, 1 Gjonit 3:5. Ai ishte në gjendje të vdiste në emrin tonë për shkak se nuk kishte nevojë të vdiste për mëkatet e veta!

☐ **“as nuk u gjet asnjë mashtrim në tojën e tij”** Jezusi ishte izraeliti ideal (shih Isa. 53:9 dhe Sof. 3:13).

2:23 “kur e fyenin, nuk e kthente fyerjen” Këtu ka një seri me tre dëftore të pakryera veprare, që nënkupton veprim të përsëritur në të shkuarën. E para është aludim i Isa. 53:7. Jezusi e përmbushi këtë profeci në gjyqet përpara Kajafës, kryepriut Ana, Pilatit dhe Herodit.

☐ **“kur vuante nuk shqiptoi asnjë kërcënim”** Ai foli, por ama foli me falje për gjithë ata që u përfshinë në vdekjen e tij (shih Luka 23:34).

☐ **“por vazhdoi t’ia besonte veten atij që gjykon drejtësisht”** Ky besim ishte qëndrimi i përditshëm në jetën e Jezusit. Kjo shihet fuqishëm në Luka 22:42 dhe 23:46.

2:24 “ai vetë i mbarti mëkatet tona” Qartazi kjo vjen nga Isa. 53:4, 11, 12. Fjala “mbarti” përdoret për flinë në Lev. 14:20 dhe Jakobi 2:21. Ky është thelbi i shlyerjes zëvendësuese (shih Marku 10:45; Rom. 5:6, 8, 10; 2 Kor. 5:21).

☐ **“në trupin e vet në kryq”** Ndonëse 1 Pjetri nuk i kundërvihet asnjë elementi gnostik në veçanti (filozofisë së hershme greko-të krishterë që thoshte se Jezusi nuk ishte vërtet njerëzor, shih Kol; 1 Tim.; 1 Gjonit), ky pasazh është një tjetër pohim i fuqishëm i natyrës së vërtetë njerëzore dhe vdekjes fizike të Jezusit të Nazaretit (shih Kol. 1:22).

Fraza “në kryq” mund të ketë lidhje me LiP. 21:23, ku kushdo që gozhdohej në dru (pra, në pemë), në vend që të varrosej si duhet, ishte i mallkuar nga Perëndia. Në kohën e Jezusit, rabinët e kishin interpretuar këtë sikur përfshinte dhe kryqëzimin romak. Jezusi u akuzua për blasfemi që, sipas ligjit të Moisiut, meritonte dënimin me vdekje me gurë. Po atëherë, pse krerët judenj donin që ai të kryqëzohej, gjë që kërkonte miratimin romak dhe ndotjen ceremoniale të tyre para Pashkës? Disa kanë thënë se judenjtë e bënë këtë për shkak se nuk kishin autoritet, sipas ligjit romak, që të dënonin njerëz me vdekje. Po atëherë, si e vranë Stefanin në Veprat 7?

Unë mendoj se ata donin që Jezusi të kryqëzohej me qëllim që të thoshin se ky pretendues mesianik ishte i mallkuar nga Perëndia! Por pikërisht kjo gjë ndodhi. Jezusi u bë mallkim për ne (shih Gal. 3:13). Vetë DHV ishte bërë mallkim (shih Kol. 2:14). Aty thuhet se shpirti që mëkaton duhet të vdesë (shih 2 Mbre. 14:6; Ezek. 18:4, 2). Por të gjithë njerëzit kanë mëkatuar (shih Rom. 3:9-18, 23; Gal. 3:22). Prandaj, të gjithë meritojnë të vdesin dhe janë nën dënimin me vdekje. Jezusi, Qengji i pamëkat i Perëndisë (Gjoni 1:29), mbarti mëkatet e gjithë botës së rënë (shih Rom. 5:12-21).

☐ **“që të vdesim ndaj mëkatit dhe të jetojmë ndaj drejtësisë”** Kjo është fjali qëllimore (*hina*). Ky është qëllimi i krishterimit (shih Rom. 6:20; Gal. 2:20): ripërtëritja e shëmbëllimit të Perëndisë në njerëzit, që do ta rikthejë marrëdhënien e tyre të ngushtë me Perëndinë.

☐ **“nga plagët e tij jeni shëruar”** Kjo është dëftore aoriste pësore. Në Isa. 53:4-6, bëhet fjalë për shërimin tonë shpirtëror, jo atë fizik. Nuk e mohoj se shërimi fizik është një veprim i vazhdueshëm i Perëndisë sonë të hirshëm, por e mohoj faktin se ky ishte një aspekt i premtuar i shlyerjes që kreu Krishti. Në DHV, mëkati karakterizohej si sëmundje fizike (shih Isa. 1:5-6; Psa. 103:3). Kjo është metaforë për faljen e mëkatit, jo një premtim që, nëse besimtarët kanë besim, Perëndia do t’ua shërojë çdo problem fizik.

Për një diskutim të dobishëm të Isa. 53:4, si dhe për përdorimin e saj në Mat. 8:17, shih F. F. Bruce’s *Answers to Questions*, f. 44-45.

2:25 “Sepse ju endeshit vazhdimisht” Ky është aludim i Isa. 53:6. Është formë perifrastike e pakryer pësore, që bën fjalë për një veprim të përsëritur në të shkuarën, ose për fillimin e një veprimi. A bën fjalë kjo për

1. judenjtë e DHV (shih Rom. 3:9-18, që është një seri citimesh nga DHV)
2. gjithë njerëzimin
3. besimtarët johebrenj, që po binin pre e përndjekjes (pra, ndoshta, po mohonin Jezusin nën sprovë)
4. besimtarët, judenj dhe johebrenj, që po e humbnin betejën e përditshme kundër natyrës mëkatare?

■ **“por tani jeni kthyer”** Kjo është dëftore aoriste pësore, që nënkupton një kthim vendimtar me anë të veprimit të Perëndisë, Krishtit, ose Frymës (shih TEV: “ju jeni kthyer”). Shumica e versioneve anglisht të Biblës e përkthejnë si formë mesore (NASB, NRSV, NJB, NIV). Në DHV, “kthimi” ose “rikthimi” (*shub*) shpesh përdoret për pendimin dhe kthimin e popullit të Perëndisë të Perëndia.

■ **“Bariu”** Ky titull përdoret për Perëndinë (shih Psa. 23:1; Ezek. 34), dhe këtu, përdoret për Jezusin, si te Gjoni 10:1-18 dhe Heb. 13:20. Nënkupton përkujdesjen zemërbutë, të mençur dhe të vazhdueshme të Jezusit. Ky titull, madje, ndoshta reflekton diskutimin e Pjetrit me Jezusin në Gjoni 21 (shih 1 Pje. 5:1-3).

NASB, NRSV,

NJB

“Rojtari”

NKJV

“Mbikëqyrësi”

TEV

“Ruajtësi”

Këtu, termi *episkopos* përdoret për Jezusin, por zakonisht përdoret për drejtuesit e kishave lokale. Kjo fjalë përkthehet “peshkop”, ose “mbikëqyrës”, dhe ka një sfond historik në qytet/shtetin grek, ndërsa termi sinonimik “plak” (*presbuteros*) ka sfond fisnor hebraik. Këto fjalë, zakonisht, përdoren në mënyrë sinonimike për rolin e pastorit në DHR (shih Veprat 20:17, 28; Titit 1:5, 7).

PYETJE PËR DISKUTIM

Ky është një komentari studimor udhëzues, që do të thotë se ti je vetë përgjegjës për interpretimin e Biblës. Secili prej nesh duhet të ecë sipas dritës që ka. Ti, Bibla dhe Fryma e Shenjtë keni përparësi në interpretim. Nuk duhet t’ia dorëzosh këtë të drejtë komentuesit.

Këto pyetje për diskutim t’i kam dhënë për të të ndihmuar që të analizosh çështjet kryesore të kësaj pjese të librit. Ato synojnë të të nxisin mendimin, jo të kenë natyrë shteruese.

1. A ia nisin të gjithë të krishterët si të krishterë foshnja? Pse?
2. Pse përdor Pjetri kaq shumë tituj të DHV për të përshkruar besimtarët e DHR?
3. Cila është domethënia e faktit se besimtarët quhen “gurë”?
4. Pse është kaq i rëndësishëm stili ynë i jetesës?
5. Pse duhet që ne, si të krishterë, t’i bindemi autoritetit qeveritar?
6. Pse nuk e sulmoi krishterimi skllavërinë?
7. Cila ishte këshilla e Pjetrit për ata që ndodhen në situata të padrejta?
8. Cila është domethënia e vdekjes së Krishtit?

1 PJETRIT 3

NDARJET NË PARAGRAFË TË PËRKTHEMEVE MODERNE

UBS ⁴	NKJV	NRSV	TEV	NJB
Gratë dhe burrat	Nënshtrimi ndaj burrave	Detyrimet e të krishterëve (2:11-4:11)	Gratë dhe burrat	Detyrimet e të krishterëve: në martesë
3:1-6	3:1-6 Një fjalë për burrat	3:1-6	3:1-6	3:1-6
3:7	3:7	3:7	3:7	3:7
Vuajtja për hir të drejtësisë	Të thirrur për bekim		Vuajtja për drejtësinë	Detyrimet e të krishterëve: t'i doni vëllezërit
3:8-12	3:8-12 Vuajtja për drejtësi ose për keqbërje	3:8-12	3:8-12	3:8-12 Detyrimet e të krishterëve: në përndjekje
3:13-22	3:13-17 Vuajtja e Krishtit dhe vuajtjet tona 3:18-4:6	3:13-22	3:13-22	3:13-17 Ringjallja dhe zbritja në ferr 3:18-22

CIKLI TRE I LEXIMIT (shih f. v)

NDJEKJA E SYNIMIT TË AUTORIT FILLESTAR NË NIVELIN E PARAGRAFËVE

Ky është një komentuar studimor udhëzues, që do të thotë se ti je vetë përgjegjës për interpretimin e Biblës. Secili prej nesh duhet të ecë sipas dritës që ka. Ti, Bibla dhe Fryma e Shenjtë keni përparësi në interpretim. Nuk duhet t'ia dorëzosh këtë të drejtë komentuesit.

Lexo gjithë kapitullin njëherësh. Identifiko temat. Krahaso ndarjet e tua tematike me pesë përkthimet moderne. Ndarja në paragrafë nuk është e frymëzuar, por është çelësi për të ndjekur synimin e autorit fillestar, gjë që është thelbi i interpretimit. Secili paragraf ka vetëm një temë të vetme.

1. Paragrafi i parë
2. Paragrafi i dytë
3. Paragrafi i tretë
4. Etj.

STUDIMI I FJALËVE DHE FRAZAVE

TEKSTI I NASB (I PËRDITËSUAR): 1 PJETRIT 3:1-6

¹Në të njëjtën mënyrë, ju gra, nënshtroni burrave tuaj në mënyrë që, edhe nëse dikush prej tyre s'është i bindur ndaj fjalës, të fitohet pa asnjë fjalë nga sjellja e gruas së tij, ²kur të vërejë sjelljen tuaj të dëlirë dhe plot respekt. ³Zbukurimi juaj të mos jetë thjesht gërshetimi i jashtëm i flokëve, apo vënia e bizhuterive prej ari, apo veshja e fustaneve; ⁴por le të jetë personi i fshehur i zemrës, me cilësinë e përpisshme të një fryme të butë dhe të qetë, që është e vyer në sytë e Perëndisë. ⁵Sepse, në këtë mënyrë, në kohët e shkuara, e kishin zakon të zbukuroheshin dhe gratë e shenjta, të cilat shpresonin në Perëndinë, duke qenë të nënshtruara ndaj burrave të tyre; ⁶ashtu si Sara i bindej Abrahamit, duke e quajtur zot; dhe ju jeni bërë bija të saj nëse bëni atë që është e drejtë pa u trembur nga asnjë frikë.

3:1 “Në të njëjtën mënyrë” Kjo na kthen te këshilla e Pjetrit për qytetarët e krishterë (shih 1 Pje. 2:13) dhe për skllëvërit e krishterë (shih 1 Pje. 2:18).

▣ **“ju gra, nënshtrorë”** Kjo është pjesore e tashme mesore, si te 2:18. Është një term ushtarak, që ka kuptimin “vendos veten nën autoritet” (shih Efe. 5:21-33; Kol. 3:18-19; Titit 2:4-5). Gjithë ky kapitull lidhet me diskutimin e Pjetrit për “nënshtrimin” e besimtarëve ndaj qeverisë (2:13-17) dhe skllëvërve besimtarë ndaj të zotëve (2:18-20). Nënshtrimi nuk është fjalë negative; përshkruan vetë Jezusin. Ai iu nënshtrua prindërve të vet tokësore. Iu nënshtrua dhe Atit të tij qiellor.

▣ **“në mënyrë që”** Kjo është fjali qëllimore (*hina*), që shpreh qëllimin teologjik të nënshtrimit të gruas. Kjo bëhet gjithmonë për ungjillizim! Besimtarët duhet ta modelojnë përditë në sjellje e tye Mbretërinë e Perëndisë (shih Predikimin në Mal, Mateu 5-7).

▣ **“nëse”** Kjo është fjali kushtore e rendit të parë, që supozohet si e vërtetë nga pikëvështrimi i autorit ose për qëllimet e tij letrare. Ky kontekst po diskuton për burrat besimtarë. Në shekullin e parë, mbizotëronin familjet e përziera për shkak se njëri nga partnerët ishte bërë besimtar. Ky nuk është pasazh për t’u përdorur si provë që mund të martohemi me një jobesimtar!

▣ **“dikush prej tyre s’është i bindur”** Kjo është dëftore e tashme veprare, që nënkupton veprim të vazhduar. Besimi biblik është përjetim i vazhdueshëm; i tillë është dhe mosbesimi!

▣ **“ndaj fjalës”** Në 1 Pjetrit, “fjala” (pra, *logos*) është metaforë për predikimin apostolik të ungjillit. Besimtarët lindin sërish me anë të fjalës (shih 1 Pje. 1:23). Ata duhet të dëshirojnë qumështin shpirtëror ose të sinqertë të fjalës (pra, *logikos*, shih 1 Pje. 2:2).

▣ **“fitohet”** Kjo është dëftore e ardhme pësore. Kjo fjalë do të thotë “përfitoj”. Përdoret për shpëtimin në 1 Kor. 9:19-22. Qëllimi i natyrshëm i gruas besimtare është shpëtimi i familjes së saj. Ky duhet të jetë synimi i gjithë besimtarëve.

▣ **“pa asnjë fjalë”** Jeta e saj e besimit do të flasë më fort dhe më qartë se fjalët! Megjithatë, në njëfarë pike, edhe fjalët janë të nevojshme për komunikimin e mesazhit të ungjillit!

▣ **“nga sjellja”** Shpesh, stili ynë i jetesës bërtet më fort se fjalët.

3:2 “vërejë” Kjo fjalë përdoret për dëshmitarët okularë. Pjetri e përdori tri herë në letrat e tij (shih 1 Pje. 2:12; 3:2; 2 Pje. 1:16). Jeta e besimtarëve është e ekspozuar ndaj të tjerëve. Ndonëse është klishe, është e vërtetë të themi se jeta e besimtarit është e vetmja Bibël që do të lexojnë ndonjëherë disa njerëz. Jeta e besimtarit është i vetmi Jezus që disa njerëz do të njohin ndonjëherë. Sa përgjegjësi madhështore!

NASB “sjelljen tuaj të dëlirë dhe plot respekt”

NKJV “sjelljen tuaj të dëlirë, e shoqëruar me frikë”

NRSV “pastërtinë dhe nderimin e jetës suaj”

TEV “sjellja juaj është e pastër dhe e nderuar”

NJB “nderimi dhe pastërtia e mënyrës suaj të jetesës”

Pjetri e ka përdorur fjalën “frikë”, e kuptuar si “respekt” më herët, në 1 Pje. 1:17 dhe 2:18 (shih Veprat 9:3; 10:2; Rom. 3:18; 13:7; Efe. 5:33; Zbu. 11:18). Besimtarët bëjnë jetë joegoiste, të perëndishme dhe të pranueshme nga kultura, me qëllim që të dëshmojnë për Mbretërinë dhe të ungjillizojnë.

Fjala “e dëlirë” (*agnos*) përkthehet në mënyra të ndryshme (e patër, e dëlirë, modeste, e pafajshme, e panjollë). Përdoret për gratë në 2 Kor. 11:2; Titit 2:5 dhe këtu.

3:3 “Zbukurimi juaj të mos jetë thjesht... i jashtëm” Këtu theksohen cilësitë e brendshme të besimtarit; nuk është ndalim i çdo zbukurimi kulturor. Zbukurimi i jashtëm kulturor mund të kthehet në problem nëse bëhet

qëllimi absolut e krenar dhe karakterizon një zemër të ligë (shih Isa.3:18-24). Mënyra si vishet njeriu është dritare për zemrën e vet (shih 1 Pje. 3:4).

Fjala “zbukurim” është përdorim unik i fjalës *kosmos* (forma foljore gjendet në 1 Pje. 3:5). Nga kjo fjalë marrim dhe termin “kozmetike”.

■ **“gërshtimi... i flokëve, apo vënia e bizhuterive prej ari apo veshja e fustaneve”** Të gjitha këto lidhen me modat e shtrenjta dhe të ndërlukuara të flokëve dhe veshjes së grave në botën greko-romake të shekullit të parë. Besimtarët nuk duhet ta dëshirojnë apo ta imitojnë këtë epsh për pranim shoqëror dhe rang shoqëror në bazë të zbulimeve të jashtme. Kjo nuk nënkupton se duhet të vishen me rreca, por se besimtarët duhet të vishen në mënyra që janë shoqërisht të pranueshme për kulturën dhe kohën e tyre të caktuar, veçse nuk duhet të tërheqin vëmendje të panevojshme ndaj vetes.

3:4 “personi i fshehur i zemrës” Bëhet fjalë për njeriun e ri pas shpëtimit. Besëlidhja e Re na ka dhënë një zemër dhe një frymë të re (shih Ezek. 36:22-38). Për fjalën “zemër”, shih Temën e Veçantë në Marku 2:6.

■ **“cilësinë e paprishshme”** Pjetri e ka përdorur këtë term për (1) trashëgiminë e paprishshme të Perëndisë, të cilën ai po e ruan për besimtarët në qiell (shih 1:4) dhe (2) për besimtarët e lindur sërish nga një farë e paprishshme (1:23).

Pali përdor të njëjtin term për trupin tonë të ringjalljes në 1 Kor. 15, dhe për kurorën e paprishshme të besimtarëve në 1 Kor. 9:25.

■ **“fryme të butë dhe të qetë”** Fjala e parë, *praus* (i butë, zemërbutë), përkthyer Jezusin në Mat. 11:29 dhe 21:5 dhe duhet t’i karakterizojë besimtarët në Lumturitë (shih Mat. 5:5). Përdoret dhe për 1 Pje. 3:15 për të karakterizuar dëshminë e besimtarit.

Fjala e dytë, *hēsukhios* ose *hēsukhia*, përdoret disa herë në shkrimet e Palit për t’i përkthyer besimtarët si të qetë, të paqshëm, ose në qetësi (shih 1 Thes. 4:11; 2 Thes. 3:12; 1 Tim. 2:2, 11, 12).

Ekziston një kontrast i nënkuptuar mes stileve të ndryshueshme të botës (shih 1 Pje. 3:3) dhe karakterit të qëndrueshëm të jetës së shpenguar (shih 1 Pje. 3:4).

3:5 “duke qenë të nënshtruara” Ky është motivi i përgjithshëm i gjithë këtij konteksti (besimtarët i nënshtrohen autoritetit civil, 1 Pje. 2:13-17; skllëvërit besimtarë u nënshtrohen të zotërve, 1 Pje. 2:18-20; Krishti i nënshtrohet planit të Atit, 1 Pje. 2:21-25; gratë besimtare u nënshtrohen burrave, 1 Pje. 3:1-6). Nënshtrimi është riorientim i vëzhgueshëm që nga Rënia e Zanafillës 3. Besimtarët nuk jetojnë më për vete, por për Perëndinë.

3:6 “Sara...duke e quajtur zot” Ky është shembull në DHV (shih Zan. 18:12) i nënshtrimit të një gruaje të perëndishme.

■ **“ju jeni bërë bija të saj”** Shpesh, shenjtorët e Dhiatës së Vjetër përdoren për të inkurajuar besimtarët (shih Heb. 11). Ata përdoren edhe për të treguar se besimtarët pranohen plotësisht nga Perëndia me anë të besimit në Krishtin (shih Rom. 2:28-29; 4:11; Gal. 3:7, 9). Ne i përkasim familjes së besimit të Abrahamit dhe Sarës. Jemi populli i ri i Perëndisë, Izraeli i ri i besimit (shih Gal. 6:16; 1 Pje 2:5, 9).

■ **“nëse bëni atë që është e drejtë”** Shih shënimin në 1 Pje. 2:14. Elementi kushtëzues (“nëse”) shprehet në përkthimet anglisht të Biblës (NASB, NKJV, TEV), por jo në tekstin greqisht, ku është i nënkuptuar. Jeta e besimit ka tipare të vëzhgueshme.

■ **“pa u trembur nga asnjë frikë”** Kjo është një tjetër karakteristikë e jetës së besimit (shih 1 Pje. 3:6, 14). Ky mund të jetë aludim nga Fja. 3:25 dhe nga e vërteta e Psa. 23:4; 27:1; dhe 91:5.

TEKSTI I NASB (I PËRDITËSUAR): 1 PJETRIT 3:7

⁷Edhe ju, burra, në të njëjtën mënyrë, jetoni me gratë tuaja me urtësi, si me dikë më të dobët, pasi ajo është grua; dhe tregojini nder si bashkëtrashëgimtare e hirit të jetës, në mënyrë që lutjet tuaja të mos pengohen.

3:7 “ju, burra” Kjo pjesë për burrat besimtarë është shumë më e shkurtër se ajo që iu drejtua grave besimtaërve; megjithatë, ajo reflekton një drejtpeshim rrënjësisht pozitiv për kohën e Pjetrit, si dhe për atë të Palit (shih Efe. 5:21-31).

■ **“me urtësi”** Mund të bëhet fjalë për (1) të vërtetat e Shkrimit (shih Zan. 1:26-27; 2:18-25; Gal. 3:28) ose (2) për faktin se burri duhet të ketë parasysh strukturën unike fizike të femrës (shih shënimin më poshtë).

■ **“si me dikë më të dobët”** Ose, “si me enën më të dobët” Pra, fizikisht (shih Jobi 4:19; 10:9; 33:6; 2 Kor. 4:7), jo shpirtërisht apo intelektualisht (shih Gal. 3:28). Disa komentues e lidhin me statusin shoqëror. E njëjta “enë” mund të jetë përdorur dhe në 1 Thes. 4:4 për të nënkuptuar gruan (ose është idiomë që përshkruan shpirtin e përvetshëm brenda një trupi fizik të bërë prej balte, shih Zan. 2:7; 3:19).

■ **“tregojini nder si bashkëtrashëgimtare e hirit të jetës”** Kjo reflekton barazinë shpirtërore (pra bashkëtrashëgimtare, shih 1 Pje. 1:4-5) e burrave me gratë (shih Zan. 1:27; 2:18; Gal. 3:28). Në disa mënyra, edhe tani shpëtimi i largon pasojat e Rënies (shih Zan. 3:16) dhe rikthen reciprocitetin mes burrave dhe grave të Zanafillës 1-2.

■ **“në mënyrë që lutjet tuaja të mos pengohen”** Mënyra si çiftet besimtare e trajtojnë njëri-tjetrin ndikon në marrëdhënien e tyre me Perëndinë (shih 1 Kor. 7:5).

TEKSTI I NASB (I PËRDITËSUAR): 1 PJETRIT 3:8-12

⁸Për ta përmbledhur, jini të gjithë në harmoni, të dhembshur, vëllazërorë, zemërdhembshur dhe të përlurur në frymë; ⁹duke mos e kthyer të keqen me të keqe ose fyerjen me fyerje, por duke dhënë bekim; sepse jeni thirrur pikërisht me qëllim që të trashëgoni një bekim. ¹⁰Sepse, “Kush dëshiron jetën, të dojë dhe të shohë ditë të mira, duhet ta ruajë gjuhën e vet nga e keqja dhe buzët e veta nga të folurit me mashtrim. ¹¹Ai duhet t’i kthejë shpinën së keqes dhe të bëjë të mirën; duhet të kërkojë paqen dhe ta ndjekë. ¹²Sepse sytë e Zotit janë mbi të drejtët dhe veshët e tij e dëgjojnë lutjen e tyre; por fytyra e Zotit është kundër atyre që bëjnë të keqen”.

3:8

NASB “Për ta përmbledhur”
NKJV, NRSV,
NJB, “Së fundi”
TEV “Për ta përmbledhur”

Kjo është shprehje greke (“tani, në fund”), që do të thotë “si përmbledhje”, jo e gjithë letrës, por e këtij konteksti që flet për nënshtrimin (shih 1 Pje. 2:13-17, 18-25; 3:1-7, 8-22).

■ **“jini të gjithë”** Kjo i drejtohet gjithë komunitetit të besimit. Nuk ka asnjë folje në këtë listë cilësish për të cilat na nxit Pjetri.

NASB “në harmoni”
NKJV “të një mendjeje”
NRSV “unitet fryme”
TEV “të njëjtin qëndrim”
NJB “duhet të bini të gjithë dakord me njëri-tjetrin”

Fjalë për fjalë, kjo është fjalë e përbërë prej *homos* (e njëjtë) dhe *fren* (mendje ose mendim). Ky koncept inkurajohet dhe në Gjoni 17:20-23; Rom. 12:16; Fil. 1:27 dhe 2:2.

NASB, NJB “të dhembshur”
NKJV “duke patur dhembshuri për njëri-tjetrin”
NRSV “dhembshuri”
TEV “të keni të njëjtat ndjenja”

Kjo është fjalë e përbërë prej *sun* (me) dhe *paskho* (vuaj). Fjalën “simpati” e marrim pikërisht prej kësaj fjale të përbërë greqisht. Në kohë përndjekjeje dhe sprovash, kjo është po aq e rëndësishme sa dhe cilësitë e tjera të përmendura në 1 Pje. 3:8.

NASB “vëllazërorë”
NKJV “doni si vëllezër”
NRSV “dashurinë për njëri-tjetrin”
TEV “ta doni njëri-tjetrin”
NJB “t’i doni vëllezërit”

Kjo është fjalë e përbërë prej *filos* (dashuri) dhe *adelphos* (vëlla). Sigurisht, ky është përdorimi përgjithësues i termit “vëlla”. Ndoshta, një mënyra më e mirë për ta shprehur këtë është: “tregoni dashuri familjare për gjithë besimtarët” (shih Rom. 12:10; 1 Thes. 4:9). Kjo reflekton urdhrin e Jezusit në Gjoni 13:34; 1 Gjonit 3:23; 4:7-8, 11-12, 19-21. Në greqishten *koine*, fjalët *filos* dhe *agape* janë zakonisht sinonime (krahasoje me Gjonin 3:35 dhe 5:20).

NASB “zemërdhembshur”
NKJV “zemërbutë”
NRSV “një zemër të butë”
TEV “jini të sjellshëm”
NJB “kini dhembshuri”

Kjo është fjalë e përbërë nga *eu* (i mirë) dhe *splagkhnon* (të përbrendshmet, zorrët). Të lashtët besonin se të përbrendshmet e poshtme (shih Veprat 1:18) ishin vatra e ndjenjave (shih Luka 1:28; 2 Kor. 6:12; Fil. 1:8). Kjo fjalë e përbërë u bën thirrje besimtarëve të kenë “ndjenja të mira” kundrejt njëri-tjetrit (shih Efe. 4:32).

NASB “të përlulur në frymë”
NKJV “të sjellshëm”
NRSV “një mendje e përlulur”
TEV “të përlulur”
NJB “të përlulur”

Kjo është fjalë e përbërë nga *tapeinos* (i përlulur) dhe *fren* (mendje). Përdoret në Veprat 20:19; Efe. 4:2 dhe Fil. 2:3. Është një virtut unik për të krishterët. Nënkupton të kundërtën e arrogancës dhe krenarisë egocentrike.

3:9 “duke mos e kthyer të keqen me të keqe” Kjo është pjesore e tashme veprare, e përdorur si urdhërore. Bën fjalë për faljen e vërtetë (shih Fja. 17:13; 20:22; Rom. 12:17; 1 Thes. 5:15). Mos harroni se 1 Pjetrit u shkrua për besimtarët e përndjekur dhe të përvuajtur, por ata duhet të reagojnë siç reagoi Krishti ndaj trajtimit të padrejtë.

▣ **“fyerjen me fyerje”** Kjo reflekton jetën e Jezusit (shih 1 Pje. 2:23).

▣ **“por duke dhënë bekim”** Kjo është një tjetër pjesore e tashme veprare e përdorur si urdhërore. Fjalë për fjalë, do të thotë “flas mirë për dikë” ose “i thurr lavde dikujt” (shih Mat. 5:10, 12, 44; 6:14-15; Luka 6:28; Rom. 12:14; 1 Kor. 4:12).

3:9 “sepse jeni thirrur pikërisht me qëllim” Kjo është pikërisht e njëjta e vërtetë që u shpreh në 1 Pje. 2:21. Vuajtja, siç ishte dhe shembulli i Krishtit, është mjeti i pjekurisë për besimtarin (shih Heb. 5:8) dhe mjeti i tij i dëshmisë (shih 1 Pje. 3:15).

▣ **“që të trashëgoni një bekim”** Kjo reflekton fjalët e Jezusit në at. 5:44 dhe Luka 6:28. Trashëgimia e besimtarit ka qenë një motiv i përsëritur në këtë letër (shih 1 Pje. 1:4-5; 3:7, 9). Ne jemi anëtarë të familjes së Perëndisë dhe bashkëtrashëgimtarë të Jezusit (shih Rom. 8:17).

3:10-12 Ky është citim nga Psalmi 34, i marrë nga teksti hebraisht, jo nga Septuaginta. Ky Psalm aludohet dhe në

- 1 Pje. 2:3 – Psa. 34:8 (shih Heb. 6:5)
- 1 Pje. 2:22 – Psa. 34:13
- 1 Pje. 3:10- Psa. 34:12-13
- 1 Pje. 3:11 – Psa. 34:14 (shih Rom. 14:19; Heb. 12:14)
- 1 Pje. 3:12 – Psa. 34:15-16

▣ Vini re tre këshilla.

1. duhet ta ruajë gjuhën nga e keqja (1 Pje. 3:10, shih Temën e Veçantë: Gjuha Njerëzore, në Marku 7:20)
2. duhet t'i kthejë shpinën së keqes (1 Pje. 3:11)
3. duhet të kërkojë paqen dhe ta ndjekë (1 Pje. 3:11)

Kjo tregon aspektin njerëzor të reagimit të besimtarit ndaj besëlidhjes. Arsyet për veprimet e besimtarëve jepen në 1 Pje. 3:12:

1. Zoti u kushton vëmendje personale të drejtëve
2. Zoti i dëgjon të drejtët
3. Zoti është personalisht kundër të ligjve

Gjatë gjithë Psalmeve, “Zoti” në fillim bënte fjalë për JHVH-në, Perëndinë e besëlidhjes së Izraelit, por në këtë kontekst bën fjalë për Jezusin, sjellësin e besëlidhjes së re (si në 1:25 dhe 2:3). Kjo është teknikë e zakonshme e autorëve të DHR për të pohuar natyrën hyjnore të Jezusit.

TEKSTI I NASB (I PËRDITËSUAR): 1 PJETRIT 3:13-22

¹³Kush do t’ju bëjë keq nëse dilni të zellshëm për atë që është e mirë? ¹⁴Por edhe nëse duhet të vuani për hir të drejtësisë, jeni të bekuar. Dhe mos druani frikësimin e tyre, as mos u shqetësoni, ¹⁵por shenjtëroni Krishtin si Zot në zemrën tuaj, duke qenë gjithmonë gati për t’u mbrojtur para kujt do që ju kërkon të jepni shpjegime për shpresën që keni në ju, por me butësi dhe nderim; ¹⁶dhe mbani një ndërgjegje të mirë në mënyrë që, pikërisht në atë gjë që shpifin për ju, të turpërohen ata që fyejnë sjelljen tuaj të mirë në Krishtin. ¹⁷Sepse është më mirë, nëse i tillë është vullneti i Perëndisë, që të vuani për shkak se bëni të drejtën sesa për shkak se bëni të gabuarën. ¹⁸Sepse edhe Krishti vdiq për mëkatet një herë e përgjithmonë, i drejti për të padrejtët, në mënyrë që të na sjellë te Perëndia, pasi u vra në mish, por u ngjall në frymë; ¹⁹në të cilën dhe shkoi dhe u predikoi frymërave që tani janë në burg, ²⁰të cilët ishin dikur të pabindur, kur durimi i Perëndisë po priste në ditët e Noeut, gjatë ndërtimit të arkës, në të cilën pak vetë, pra, tetë persona, u shpëtuan përmes ujit. ²¹Në përputhje me këtë, tani ju shpëton pagëzimi—jo pastrimi i pluhurit nga mishi, por kërkesa para Perëndisë për një ndërgjegje të mirë—nëpërmjet ringjalljes së Jezu Krishtit, ²²i cili tani është në të djathtë të Perëndisë, i ngritur në qiell, pasi iu nënshtruan engjëjt, autoritetet dhe pushtetet.

3:13 “Kush do t’ju bëjë keq” Mund të jetë aludim për Psa. 118:6, pasi ky psalm citohet dhe në 1 Pje. 2:7 dhe 9. E njëjta e vërtetë shprehet dhe në Rom. 8:31-34.

Besimtarët duhet t’i kujtojnë vazhdimisht vetes se kjo botë nuk është shtëpia e tyre, dhe se fizikja nuk është realiteti më i lartë! Ne jemi shtegtarë këtu, thjesht kalimtarë. S’duhet të kemi frikë (shih 1 Pje. 3:14).

Është ironik fakti se ata që mbrohen nga Zot, shpesh, janë pikërisht ata që përndiqen. Të njohësh, të duash dhe t’i shërbesh Perëndisë nuk të ruan nga dhimbja, trajtimi i padrejtë, apo dhe vdekja. Mund të duket sikur ligësia ka fituar, por prit; edhe në mes të vuajtjes, besimtari është i bekuar (shih Mat. 5:10-12; Veprat 5:41).

▣ **“nëse dilni të zellshëm për atë që është e mirë?”** Kjo është fjali kushtore e rendit të tretë, që nënkupton veprim të mundshëm. Ata po vuanin pikërisht për shkak se ishin të krishterë (shih 1 Pje. 3:14; 2:19; 3:16; 4:16). Gjithsesi vini re anën kushtore (mënyrën lidhore): “të zellshëm për atë që është e mirë”!

3:14 “Por edhe nëse duhet të vuani” Kjo është një fjali e rrallë kushtore e rendit të katërt (gjendja më e largët nga realiteti), që nënkupton veprim të mundshëm, por jo të sigurt (shih 2 Tim. 3:12). Jo çdo besimtar, në çdo vend, po vuante. Vuajtja nuk ishte (dhe nuk është) kurrë përjetimi i çdo të krishteri, por çdo i krishterë duhet të jetë gati (shih 1 Pje. 4:12-16; Gjoni 15:20; Veprat 14:22; Zbu. 8:17)!

■ “drejtësisë” Në këtë kontekst, bën fjalë për jetesën e perëndishme, ose për dëshminë tonë gojore për ungjillin. Shih Temën e Veçantë më poshtë.

TEMË E VEÇANTË: DREJTËSIA (SPECIAL TOPIC: RIGHTEOUSNESS)

“Drejtësia” është temë kaq kyçe sa studiuesi i Biblës duhet të bëjë një studim të hollësishëm personal të këtij koncepti.

Në DhV, karakteri i Perëndisë përshkruhet si “i drejtë” (BDB 842; KB 1003; emër mashkullor, BDB 841, KB 1004; emër femëror, BDB 842, KB 1006). Vetë kjo fjalë mesopotamase vjen nga një kallam lumi, që përdorej si vegël ndërtimi për të gjykuar drejtësinë horizontale të mureve dhe gardheve. Perëndia e zgjodhi këtë term për ta përdorur në mënyrë metaforike për natyrën e vet. Ai është shkopi i drejtë (vizorja) me të cilin maten të gjitha gjërat. Ky koncept pohon edhe drejtësinë e Perëndisë, edhe të drejtën e tij për të gjykuar.

Njeriu u krijua në shëmbëllimin e Perëndisë (shih Zan. 1:26-27; 5:1, 3; 9:6). Njerëzimi u krijua për miqësi me Perëndinë (p.sh., Zan. 3:8). Gjithë krijimi është skenë ose sfond për ndërveprimin e Perëndisë me njerëzimin. Perëndia donte që krijesa e tij më e lartë, njeriu, ta njihte, ta donte, t’i shërbente dhe të ishte si ai! Besnikëria e njerëzimit u vu në sprovë (shih Zanafilla 3) dhe çifti i parë dështoi. Kjo çoi në prishjen e marrëdhënies së Perëndisë me njerëzimin (shih Zanafilla 3; Rom. 5:12-21).

Perëndia premtoi se do ta ndreqte dhe rimëkëmbte këtë bashkësi (shih Zan. 3:15; shih Temën e Veçantë: Plani i Përrjetshëm Shpengues i JHVH). Ai e bën këtë me vullnetin e vet dhe me anë të Birit të vet. Njerëzit janë të paaftë për ta ndrequr këtë çarje (shih Rom. 1:18-3:20; Zbulesa 5).

Pas Rënies, hapi i parë i Perëndisë drejt ripërtëritjes së miqësisë është koncepti i besëlidhjes, i bazuar në ftesën e tij dhe në përgjigjen e njerëzimit me pendim, besim dhe bindje (shih Jer. 31:31-34; Ezek. 36:22-38). Për shkak të Rënies, njerëzit s’janë të aftë që të kryejnë veprimin e duhur (shih Rom. 3:21-31; Galatasve 3).

Vetë Perëndisë iu desh të merrte nismën për të rimëkëmbur njerëzit që thyen besëlidhjen. Ai e bëri këtë

1. duke e shpallur njerëzimin të drejtë përmes veprës së Krishtit (pra, drejtësia ligjore).
2. duke i dhënë lirisht njerëzimit një drejtësi me anë të veprës së Krishtit (pra, drejtësia e llogaritur).
3. duke siguruar Frymën brendabanues, i cili prodhon drejtësi (pra, ngjashmëria me Krishtin, rikthimi i shëmbëllimit të Perëndisë) në njerëzimin.
4. duke rikthyer bashkësinë e Kopshtit të Edenit (krahaso Zanafillën 1-2 me Zbulesën 21-22)

Gjithsesi, Perëndia kërkon një përgjigje ndaj besëlidhjes. Ai vendos (pra, jep lirisht; Rom. 5:8; 6:23) dhe siguron, por njerëzit duhet të përgjigjen dhe të vazhdojnë të përgjigjen me

1. pendim
2. besim
3. bindje në stilin e jetesës
4. qëndresë

Prandaj, drejtësia është një veprim reciprok i besëlidhjes mes Perëndisë dhe krijesës së tij më të larët. Ajo bazohet në karakterin e Perëndisë, veprën e Krishtit dhe aftësimin e Frymës, dhe çdo individ duhet t’i përgjigjet siç duhet, personalisht dhe vazhdimisht. Ky koncept quhet “shfajësim me anë të besimit” (shih Efe. 2:8-9). Ky koncept zbulohet në ungjijtë, por jo me këto fjalë. Në fillim, u përcaktua nga Pali, i cili e përdor termin greqisht “drejtësi” në forma të ndryshme mbi 100 herë.

Pali, si rabin i trajnuar, termin *dikaïosunē* e përdor në kuptimin e saj hebraik *SDQ*, të përdorur edhe nga Septuaginta, dhe jo nga literatura greke. Në shkrimet greke, kjo fjalë përdorej për dikë që përputhej me pritshmëritë e Hyjnisë dhe shoqërisë (p.sh., Noeu dhe Jobi). Në kuptimin e saj hebraik, kjo fjalë strukturohej gjithmonë në kuadër të besëlidhjes (shih Temën e Veçantë: Besëlidhja). JHVH është Perëndi i drejtë, etik dhe moral. Ai do që populli i tij të reflektojë karakterin e tij. Njerëzimi i shpenguar bëhet krijesë e re (shih 2 Kor. 5:17; Gal. 6:15). Kjo risi çon në një stil të re jetese me perëndishmëri (shih Mateu 5-7; Gal. 5:22-24; Jakobi; 1 Gjonit). Meqë Izraeli ishte teokraci, nuk kishte dallim të qartë mes laikes (rregullave shoqërore) dhe së shenjtës (vullnetit të Perëndisë). Ky dallim shprehet duke i përkthyer fjalët hebraisht dhe greqisht në anglisht si “justice” (drejtësia që lidhet me shoqërinë) dhe “righteousness” (drejtësia që lidhet me fenë).

Ungjilli (lajmi i mirë) i Jezusit është se njerëzimi i rënë është rikthyer në bashkësi me Perëndinë. Kjo është arritur përmes dashurisë, mëshirës dhe hirit të Atit; jetës, vdekjes dhe ringjalljes së Birit; dhe nxitjes e afrimit që na ka bërë Fryma me ungjillin. Shfajësimi është akt falas i Perëndisë, por duhet të çojë në perëndishmëri (pozicioni i Augustinit, i cili reflekton edhe theksin e reformacionit të natyra falas e ungjillit, por

edhe theksin katolik për jetën e ndryshuar plot dashuri dhe besnikëri). Për reformatoret, termi “drejtësi e Perëndisë” është GJINORE KUNDRINORE (pra, akti që e bën njerëzimin e mëkatshëm të pranueshëm nga Perëndia [shenjtërimi pozicional]), ndërsa për katolikët është GJINORE KRYEFJALORE, që nënkupton procesin ku njeriu bëhet gjithnjë e më tepër si Perëndia [shenjtërimi përparues dhe i përjetuar]. Në të vërtetë, ajo është patjetër të dyja bashkë!).

Për mendimin tim, e gjithë Bibla, nga Zanafilla 4 deri te Zbulesa 20, tregon sesi Perëndia rimëkëmb miqësinë e Edenit. Bibla ia nis me miqësinë e Perëndisë me njerëzimin në një kontekst tokësor (shih Zanafilla 1-2) dhe e përfundon me të njëjtin kontekst (shih Zbulesa 21-22). Shëmbëllimi dhe qëllimi i Perëndisë do të rimëkëmbet!

Për të dokumentuar diskutimet e mësipërme, vini re pasazhet e mëposhtme, të përzgjedhura nga DhR, që ilustrojnë grupin e fjalëve greke.

1. Perëndia është i drejtë (shpesh lidhet me Perëndinë si Gjykatës)
 - a. Romakëve 3:26
 - b. 2 Thesalonikasve 1:5-6
 - c. 2 Timoteut 4:8
 - d. Zbulesa 16:5
2. Jezusi është i drejtë
 - a. Veprat 3:14; 7:52; 22:14 (titulli i Mesisë)
 - b. Mateu 27:19
 - c. 1 Gjonit 2:1, 29; 3:7
3. Vullneti i Perëndisë për krijimin e vet është drejtësia
 - a. Levitiku 19:2
 - b. Mateu 5:48 (shih 5:17-20)
4. Mënyra e Perëndisë për të siguruar dhe prodhuar drejtësinë
 - a. Romakëve 3:21-31
 - b. Romakëve 4
 - c. Romakëve 5:6-11
 - d. Galatasve 3:6-14
5. Jepet nga Perëndia
 - a. Romakëve 3:24; 6:23
 - b. 1 Korintasve 1:30
 - c. Efesianëve 2:8-9
6. Merret me anë të besimit
 - a. Romakëve 1:17; 3:22, 26; 4:3, 5, 13; 9:30; 10:4, 6, 10
 - b. 2 Korintasve 5:7, 21
7. Përmes veprave të Birit
 - a. Romakëve 5:21
 - b. 2 Korintasve 5:21
 - c. Filipianëve 2:6-11
8. Vullneti i Perëndisë është që ndjekësit e tij të jenë të drejtë
 - a. Mateu 5:3-48; 7:24-27
 - b. Romakëve 2:13; 5:1-5; 6:1-23
 - c. Efesianëve 1:4; 2:10
 - d. 1 Timoteut 6:11
 - e. 2 Timoteut 2:22; 3:16
 - f. 1 Gjonit 3:7
 - g. 1 Pjetrit 2:24
9. Perëndia do ta gjykojë botën me drejtësi
 - a. Veprat 17:31
 - b. 2 Timoteut 4:8

Drejtësia është karakteristikë e Perëndisë, dhe i jepet lirisht njerëzimit të mëkatshëm me anë të Krishtit.

Ajo është

1. vendim i Perëndisë
2. dhuratë e Perëndisë

3. akt i Krishtit
4. jetë për t'u jetuar

Por ajo është edhe proces i të bërit i drejtë; ky proces duhet ndjekur me forcë dhe këmbëngulje dhe do të përmbushet një ditë, në Ardhjen e Dytë. Bashkësia me Perëndinë rikthehet në çastin e shpëtimit, por përparon gjatë gjithë jetës dhe bëhet takim ballë përballë në çastin e vdekjes (shih 1 Gjonit 3:2), ose në *Parousia*!

Ja një citim i duhur për ta përmyllur këtë diskutim. Është marrë nga *Dictionary of Paul and His Letters* [Fjalori i Palit dhe letrave të tij], nga IVP:

“Kalvini, shumë më tepër se Luteri, thekson aspektin e marrëdhënies të drejtësisë së Perëndisë. Pikëpamja e Luterit për drejtësinë e Perëndisë duket se përmban aspektin e deklarimit të pafajësisë. Kalvini thekson natyrën e mrekullueshme të komunikimit ose përcimit të drejtësisë së Perëndisë te ne” (f. 834).

Për mua, marrëdhënia e besimtarit me Perëndinë ka tre aspekte.

1. ungjilli është person (theksi i kishës lindore dhe Kalvinit)
2. ungjilli është e vërtetë (theksi i Augustinit dhe Luterit)
3. ungjilli është jetë e ndryshuar (theksi katolik)

Këto janë të tria të vërteta dhe duhen mbajtur të bashkuara për të patur një krishterim të shëndetshëm, të shëndoshë dhe biblik. Nëse ndonjëra prej tyre mbitheksoset ose nënvlerësohet, shfaqen probleme.

Duhet ta mirëpresim Jezusin!

Duhet t'i besojmë ungjillit!

Duhet të ndjekim ngjashmërinë me Krishtin!

▣ **“jeni të bekuar”** Ky është term ndryshe nga ai i përdorur në 1 Pje. 3:9. Ky është termi i përdorur në Lumturitë e Predikimit të Jezusit në Mal (shih Mat. 5:10-12). Besimtarët lidhen me profetët e DHV si drita dhe zbulesa e Perëndisë për këtë botë të humbur. Me anë të dëshmisë sonë, edhe në mes të përndjekjes, jobesimtari mund të kthehet dhe të lavdërojë Perëndinë (shih 1 Pje. 3:1, 8-9).

▣ **“Dhe mos druani frikësimin e tyre”** Ky është aludim për Isa. 8:12-13 (shih konceptin e ngjashëm në Isa. 50:9; 54:17; Rom. 8:31-38). Fjalë për fjalë, “mos u frikësoni nga frika e tyre”. Kjo frazë mund të kuptohet në dy mënyra: (1) frika e Perëndisë, që ndienin përndjekësit, ose (2) frika që ata u shkaktonin të tjerëve. Mungesa e frikës është tipar i fëmijës së Perëndisë (shih 1 Pje. 3:6).

3:15 “por shenjtëroni” Kjo është urdhërore aoriste veprare, që nënkupton një akt të kaluar dhe vendimtar ku dikush veçohet për t'u përdorur nga Perëndia (ndoshta, kjo reflekton dhe Isa. 8:14, që shkruan “shenjtërore”). Besimtarët duhet të shenjtërojnë Krishtin në zemër, ashtu si Krishti shenjtëroi veten për ta (shih Gjoni 17:19).

Vini re se, në 1 Thes. 5:23, ai që shenjtëron besimtarët është Perëndia. Tani, besimtarëve u bëhet thirrje të shenjtërojnë veten. Ky është paradoksi i besëlidhjes së besimit biblik (shih Ezek. 18:31 dhe 36:26-27). Perëndia është sovran, por njerëzit janë të lirë dhe duhet ta ushtrojnë atë liri në vullnetin e Perëndisë. Po si ta shenjtërojmë Krishtin?

1. me dashurinë tonë për njëri-tjetrin (shih 1 Pje. 3:8-9)
2. me jetën tonë (shih 1 Pje. 3:13-14)
3. me dëshminë tonë gojore (shih 1 Pje. 3:15)

▣ **“Krishtin si Zot”** Versioni i Mbretit Xhejms e përkthen “Zotin Perëndi”, që reflekton Isa. 8:12-13, ku shkruhet “Zoti i ushtrive”, ndërsa 1 Pje. 3:14 është pasazh mesianik. Megjithatë, dorëshkrimet e lashta greke P72, Sinaitiku, A, B dhe C shkruajnë “Krishtin si Zot”, që përputhet më mirë me kontekstin.

▣ **“në zemrën tuaj”** “Zemër” është shprehje e DHV, që nënkupton gjithë individin. Shih Temën e Veçantë: Zemra, në Marku 2:6.

▣ **“duke qenë gjithmonë gati për t'u mbrojtur”** Kjo është fjala greke *apologia*, që është fjalë e përbërë, e krijuar nga *apo* (prej) dhe *logos* (fjalë). Bën fjalë për mbrojtjen ligjore në një kontekst gjykatë (shih Veprat 19:33;

22:1; 25:16; 26:1, 2, 24). Shpesh, ky varg është përdorur për të inkurajuar besimtarët që të bëhen dëshmitarë ungjillizues (gjë që është sigurisht e nevojshme), por, në këtë kontekst, ndoshta bëhet fjalë për gjyqet ose proceset hetimore zyrtare. Vini re se është e rëndësishme që gjithë besimtarët të kenë gati një prezantim të përgatitur dhe logjik të besimit në Krishtin, qoftë në gjykatore, qoftë kur flasin me fqinjët. Çdo besimtar duhet të jetë gati të bëhet dëshmitar me gojë!

▣ **“për shpresën që keni në ju”** Këtu, shpresa është fjalë kolektive për ungjillin dhe përmbushjen e tij të ardhshme. Besimtarët jetojnë tani në mënyrë të perëndishme për shkak të sigurisë që kanë në premtimet dhe kthimin e Krishtit.

TEMË E VEÇANTË: SHPRESA (elpis, sipas Palit) (SPECIAL TOPIC: HOPE [elpis, in Paul])

Pali e përdori shpesh këtë term në disa kuptime të ndryshme, por të lidhura me njëra-tjetrën. Shpesh, ky koncept lidhet me përmbushjen e besimit të besimtarit (p.sh., 1 Tim. 1:1). Mund të shprehet si lavdi, jetë e përjetshme, shpëtim përfundimtar, Ardhja e Dytë, etj. Përmbushja është e sigurt, por elementi kohor është në të ardhmen dhe i panjohur. Shpesh, shpresa shoqërohet me “besimin” dhe “dashurinë” (1 Kor. 13:13; 1 Thes. 1:3; 2 Thes. 2:16). Një listë e pjesshme e përdorimit të kësaj fjale nga Pali është më poshtë:

1. Ardhja e Dytë (Gal. 5:5; Efe. 1:18; 4:4; Titit 2:13)
2. Jezusi është shpresa jonë (1 Tim. 1:1); Perëndia është shpresa jonë (1 Tim. 5:5; 1 Pje. 3:5)
3. Besimtari do të dalë para Perëndisë (Kol. 1:22-23; 1 Thes. 2:19)
4. Shpresa ruhet në qiell (Kol. 1:5)
5. Beso në ungjillin (Kol. 1:23; 1 Thes. 2:19)
6. Shpëtimi përfundimtar (Kol. 1:5; 1 Thes. 4:13; 5:8)
7. Lavdia e Perëndisë (Rom. 5:2; 2 Kor. 3:12; Kol. 1:27)
8. Shpëtimi i johebrenjve me anë të Krishtit (Kol. 1:27)
9. Siguria e shpëtimit (1 Thes. 5:8)
10. Jeta e përjetshme (Titit 1:2; 3:7)
11. Rezultatet e pjekurisë së krishterë (Rom. 5:2-5)
12. Shpengimi i gjithë krijimit (Rom. 8:20-22)
13. Përmbushja e birësimit (Rom. 8:23-25)
14. Titull i Perëndisë (Rom. 15:13)
15. Dëshira e Palit për besimtarët (2 Kor. 1:7)
16. DHV si udhërrëfyes për besimtarët e DHR (Rom. 15:4)

▣ **“me butësi dhe nderim”** Termi i parë përdoret për gratë në 1 Pje. 3:4, ku përshkruan qëndrimin që kënaq Perëndinë. Kjo është e vërtetë jo vetëm në marrëdhëniet ndërpersonale në familje, por edhe në marrëdhënien e besimtarit me të tjerët, edhe me ata që nxisin përndjekjen kundër tij (shih 2 Tim. 2:25).

Termi i dytë përdoret shpesh në 1 Pjetrit dhe reflekton një kohë përndjekjeje dhe frikësimi (shih 1 Pje. 1:17; 2:17, 18; 3:2, 15). Ne duhet ta respektojmë Perëndinë dhe, për shkak të kësaj, duhet të nderojmë edhe zotërinjtë, burrat dhe përndjekësit jobesimtarë, duke dëshmuar për fuqinë dhe mbretërinë e tij.

3:16 Ka njëfarë pështjellimi se ku fillon 1 Pje. 3:16. NASB dhe NKJV e fillojnë këtu, ndërsa UBS4, NRSV, TEV dhe NJB e nisin një frazë më herët.

▣ **“mbani një ndërgjegje të mirë”** Kjo është pjesore e tashme veprare, e përdorur si urdhërore. Fjala greke “ndërgjegje” nuk ka një fjalë të barazvlefshme në DHV, përveçse nëse e marrim fjalën “gjoks” në hebraisht në kuptimin e “njohurisë së vetes dhe motiveve të saj”. Në fillim, fjala greke për vetëdijen kishte të bënte me të pesta shqisat. Më vonë u përdor për shqisat e brendshme (shih Rom. 2:15). Pali e përdori këtë term dy herë në gjyqet e tij në Veprat (shih Veprat 23:1; dhe 24:16). Bën fjalë për vetëdijen e tij se nuk kishte shkelur me dijeni asnjë detyrë të pritshme në lidhje me Perëndinë (shih 1 Kor. 4:4).

Ndërgjegjja nënkupton njohja e motiveve dhe veprimeve të besimtarit në bazë të

1. një botëkuptimi biblik
2. një Fryme brendabanues

3. një njohurie të Fjalës së Perëndisë
4. pranimit personal të ungjillit

Pjetri e ka përdorur tri herë këtë shprehje, 1 Pje. 2:19; 3:16 dhe 21. Pikërisht kjo është ajo që legalizmi fetar nuk mund të na e sigurojë; por ungjilli na e siguron.

▣ **“në mënyrë që, pikërisht në atë gjë që shpifin për ju, të turpërohen ata që fyejnë sjelljen tuaj të mirë në Krishtin”** Shih shënimet në 1 Pje. 2:12 dhe 2:15.

3:17 “nëse i tillë është vullneti i Perëndisë” Kjo është fjali e rrallë kushtore e rendit të katërt, njësoj si në 1 Pje. 3:14. Pjetri e ka shprehur vazhdimisht mundësinë, por jo sigurinë, e vuajtjes dhe përndjekjes (shih 1 Pje. 1:6; 2:15; 3:17; 4:14).

3:18-22 Richard N. Longenecker, *Biblical Exegesis in the Apostolic Period*, f. 69, 172, shprehet se këto vargje janë marrë nga një himn pagëzimi. Grant Osborne, *The Hermeneutical Spiral*, mendon se vetëm 1 Pje. 3:18 është poetik (asnjë nga përkthimet e përdorura në këtë komentari nuk e paraqet si poezi). Nëse është himnik ose poetike, ky pasazh nuk duhet “detyruar” të na japë doktrinë!

3:18 “Sepse edhe Krishti vdiq për mëkatet” Kjo frazë përdoret në Septuagintë në kuptimin “ofertë për mëkatin” (shih Lev. 5:7; 6:30; Isaia 53; 2 Kor. 5:21). Kjo frazë bën fjalë për vdekjen zëvendësuese të Jezusit, njësoj si 2:22-24.

Kjo frazë ka dy pjesë, të cilat përmbajnë variante në greqisht.

1. “Krishti vdiq” (shih NASB, TEV, NJB). Kjo gjendet në dorëshkrimet greke P72, Sinaitiku, A, B dhe C. Unciale të tjera të lashta greke shkruajnë “vuajti” (NKJV, NRSV; dorëshkrimet B, K dhe P). “Vuajti” përputhet më mirë me kontekstin dhe fjalorin e Pjetrit (ai e përdor foljen “vuajti” 11 herë), por po të ishte origjinale, pse do ta ndryshonte ndonjë kopjues në “vdiq”?
2. “për mëkatet”. Ka mbi shtatë variante të kësaj pjesë të vargut. Shumica e tyre përfshijnë fjalët “për ne” ose “për hirin tonë”. Problemi është se përdoret parafjala greke *peri* në lidhje me mëkatin, dhe jo parafjala më e pritur *huper*.

▣ **“një herë e përgjithmonë”** Kjo është tematika e librit të Hebrenjve (shih Rom. 6:10; Heb. 7:17; 9:12, 18, 26, 28; 10:10. Krishti është flijimi i përsosur, i efektshëm, dhe unik për mëkatin!

▣ **“i drejti për të padrejtët”** Ndoshta, është aludim i Isa. 53:11-12 (shih NRSV). “I drejti” mund të jetë titull për Jezusin në kishën e hershme (shih Veprat 3:14; 7:52; 1 Gjonit 2:1, 29; 3:7). Thekson jetën e tij të pamëkatë (shih 1 Pje. 1:19; 2:22), që e dha për hir të mëkatarëve (shih 1 Pje. 2:24).

▣ **“në mënyrë që”** Kjo është fjali qëllimore (*hina*).

▣ **“që të na sjellë te Perëndia”** Bëhet fjalë për “aksesin” ose “prezantimin” me hyjninë (shih Rom. 5:2; Efe. 2:18; 3:12). Vdekja e Jezusit rimëkëmb marrëdhënien me Perëndinë, që humbi nga Rënia. Shëmbëllimi i Perëndisë në njerëzimin rimëkëmbet përmes Krishtit. Besimtarët kanë mundësinë që të kenë marrëdhënie të ngushtë me Perëndinë, njësoj si ajo që pati Adami dhe Eva me Perëndinë përpara Rënies (Zanafilla 3).

▣ **“pasi u vra në mish, por u ngjall në frymë”** Ekziston një kontrast (paralelizëm) mes trupit fizik të Jezusit (shih 1 Pje. 4:1) dhe jetës së tij shpirtërore (shih 1 Pje. 4:6; 1 Kor. 15:45). Kjo e vërtetë mund të reflektohet dhe në kredon ose himnin e hershëm, i shkruar në 1 Tim. 3:16.

Të dyja këto fraza janë pjesore aoriste pësore, që nënkuptojnë një ngjarje historike (kryqëzimin dhe ringjalljen, shih Rom. 1:3-4) të kryer nga një veprues i jashtëm (pra nga Ati ose Fryma e Shenjtë). Është e vështirë që të përcaktojmë në këtë pasazh nëse fjala “frymë” duhet shkruar me F të madhe (pra, Fryma e Shenjtë), apo të vogël (pra, fryma njerëzore e Jezusit). Unë preferoj të dytën (njësoj si A. T. Robertson), por F. F. Bruce preferon të parën.

▣ **“u predikoi”** Kjo është fjala greke *kērussō*, që do të thotë “shpall, ose lajëroj publikisht”. Në pasazhin tjetër që lidhet me të, 4:6, folja është *euangelizō*, që përdoret vetëm për predikimin e ungjillit. Është e paqartë nëse, në këtë

kontekst, duhet bërë dallimi mes këtyre dy termave (shih Marku 5:20; Luka 9:60, ku *kērussō* përdoret për shpalljen e ungjillit). Unë mendoj se janë sinonime.

▣ **“frymërave”** Ka dy teori për këtë: (1) të vdekurit (4:6; Heb. 12:23), ose (2) engjëjt e këqinj (Zan. 6; 2 Pje. 2:4-5; Juda 6; *1 Enokut*). Njerëzit nuk përmenden me termin “frymëra” në DHR pa cilësues të tjerë (shih F. F. Bruce, *Answers to Questions*, f. 128).

▣ **“tani... në burg”** Ky varg përmban disa elemente që duhen lidhur së bashku në njëfarë mënyre për të përcaktuar ku e ka fjalën Pjetri:

1. Jezusi ishte “në frymë” (1 Pje. 3:18)
2. Jezusi u predikoi frymërave që ishin të burgosur (1 Pje. 3:19)
3. këto frymëra ishin të pabindura në kohën e Noeut (1 Pje. 3:20).

Kur krahasohen të gjitha këto elemente, të vetmet mundësi tekstuale duket se mbeten një mesazh për engjëllit e rënë të Zan. 6, ose njerëzit e kohës së Noes që u mbytën. Koha e Noes përmendet dhe në 2 Pje. 2:4-5, së bashku me Sodomën dhe Gomorrën (shih 2 Pje. 2:6). Edhe te Juda, engjëjt rebelë (shih Juda 6) dhe Sodomi e Gomorra (Juda 7) lidhen së bashku.

Është e paqartë nga konteksti më i gjerë përse Pjetri e përmend këtë temë, përveçse nëse ai po e përdor përmbytjen si analogji për pagëzimin (pra, shpëtimi përmes ujit, shih 1 Pje. 3:20).

Dy nga pikat kryesore të debatueshme për interpretimin e këtij pasazhi janë (1) koha kur dhe (2) cila është përmbajtja e predikimit të Krishtit?

1. Krishti paraekzistues, i predikuar përmes Noeut (shih 1 Pje. 1:11, ku Fryma e Krishtit predikon përmes shkruarve të DHV) për njerëzit e kohës së tij, që tani janë të burgosur (Augustini)
2. Krishti, përmes vdekjes dhe ringjalljes së vet, u predikoi njerëzve të burgosur të kohës së Noeut
 - a. Duke i dënuar
 - b. Duke i shpëtuar (Klementi i Aleksandrisë)
 - c. Gjëra të mira për Noeun dhe familjen e tij (në parajsë) përpara tyre (në *Tartar*)
3. Përmes vdekjes dhe ringjalljes së vet, Krishti u predikoi
 - a. engjëjve që morën gra njerëzore dhe lindën fëmijë me ta (shih Zan. 6:1-2)
 - b. pasardhësve gjysmë-engjëj dhe gjysmënjerëz të Zan. 6:4 (shih Temën e Veçantë të Zanafilla 6 në internet në www.freebiblecommentary.org). Përmbajtja e mesazhit ishte gjykimi i tyre dhe fitorja e tij. *1 Enokut* thotë se këta gjysmë-engjëj/gjysmënjerëz janë demonët e DHR.
4. Krishti, si Mesia triumfues, u ngjiti përmes qiejve (pra, niveleve engjëllore të gnostikëve, ose shtatë qiejve të rabinëve; shih 1 Pje. 3:22; Efe. 4:9). *2 Enokut* 7:1-5 thotë se engjëjt e rënë janë të burgosur në qiellin e dytë. Me anë të këtij akti, ai shpalli fitoren e vet mbi sferat engjëllore (pra, kundër çdo kundërshtari shpirtëror, shih *Jerome Bible Commentary*, f. 367). Mua kjo mundësi më duket si më e përshtatshme me kontekstin.

TEMË E VEÇANTË: KU JANË TË VDEKURIT? (SPECIAL TOPIC: WHERE ARE THE DEAD?)

I. Dhiata e Vjetër

A. Të gjithë njerëzit shkojnë në *Sheol* (etimologjia e paqartë, BDB 1066), që nënkupton vdekjen ose varrin, kryesisht në letërsinë e urtësisë dhe në librin e Isaisë. Në DhV, kjo ishte një ekzistencë e errët, e vetëdijshme, por pa gëzim (shih Jobi 10:21-22; 38:17).

B. Karakteri i *Sheolit*

1. shoqërohet me gjykimin (zjarrin) e Perëndisë, LiP. 32:22
2. burg me porta (Jobi 38:17; Psa. 9:13; 107:18)
3. tokë pa kthim (Jobi 7:9; titull akadian për vdekjen)
4. tokë/sferë e errët (Jobi 10:21-22; 17:13; 18:18)
5. vend heshtjeje (Psa. 28:1; 31:17; 94:17; 115:17; Isa. 47:5)
6. shoqërohet me ndëshkimin edhe përpara Ditës së Gjykimit, Psa. 18:4-5
7. shoqërohet me *abaddon*-in (shkatërrimin), ku është i pranishëm dhe Perëndia, Jobi 26:6; Psa. 139:8; Amosi 9:2
8. shoqërohet me “Gropën” (varrin), Psa. 16:10; 88:3-4; Isa. 14:15; Ezek. 31:15-17
9. të ligjtë zbresin të gjallë në *Sheol*, Num. 16:30, 33; Jobi 7:9; Psa. 55:15

10. shpesh, personifikohet si kafshë me gojë të madhe, Num. 16:30; Fja. 1:12; Isa. 5:14; Hab. 2:5
11. njerëzit aty thirren *Refa'im* (pra, shpirtrat e të vdekurve), Jobi 26:5; Fja. 2:18; 21:16; 26:14; Isa. 14:9-11
12. megjithatë, JHVH është i pranishëm edhe aty (Jobi 26:6; Psa. 139:8; Fja. 15:11)

II. Dhiata e Re

A. Fjala hebraisht *Sheol* përkthehet në greqisht si *Hades* (bota e padukshme)

B. Karakterizimi i *Hadesit*

1. i referohet vdekjes, Mat. 16:18
2. lidhet me vdekjen, Zbu. 1:18; 6:8; 20:13-14
3. shpesh nënkupton vendin e ndëshkimit të përhershëm (*Gehenna*), Mat. 11:23 (citim i DhV); Luka 10:15; 16:23-24
4. shpesh nënkupton varrin, Luka 16:23

C. Ndoshta i ndarë (rabinët)

1. pjesa e të drejtëve quhet parajsë (në fakt, ky është një tjetër emër i qiellit, shih 2 Kor. 12:4; Zbu. 2:7), Luka 23:43
2. pjesa e të ligjve quhet *Tartar*, 2 Pjetrit 2:4, ku është vendi që mbahen engjëjt e ligj (shih Zan. 6; 1 Enokut). Shoqërohet me "Humnerën", Luka 8:31; Rom. 10:7; Zbu. 9:1-2, 11; 11:7; 17:18; 20:1, 3

D. *Gehenna*

1. Reflekton frazën e DhV, "lugina e bijve të Hinomit" (në jug të Jerusalemit). Ishte vendi ku perëndia fenikas i zjarrit, *Moleku* (BDB 574), adhurohej me fljime foshnjash (shih 2 Mbret. 16:3; 21:6; 2 Kro. 28:3; 33:6), gjë që ndalohej nga Lev. 18:21; 20:2-5.
2. Jeremia e ndryshoi, nga vend adhurimi pagan, në një vend të ndëshkimit të JHVH-së (shih Jer. 7:32; 19:6-7). Kështu, ky u bë vendi i gjykimit të flaktë e të përjetshëm në 1 Enokut 90:26-27 dhe Sib. 1:103.
3. Judenjtë e kohës së Jezusit ndienin kaq shumë neveri prej pjesëmarrjes së paraardhësve të tyre në adhurimin pagan me fljime foshnjash, sa që këtë zonë e shndërruan në vendgrumbullimi plehrash për Jerusalemin. Shumë prej metaforave të Jezusit për gjykimin e përjetshëm vinin nga ky vendgrumbullim (zjarri, tymi, krimbat, era e qelbur, shih Marku 9:44, 46). Fjala *Gehenna* përdoret vetëm nga Jezusi (përveçse te Jakobi 3:6).
4. Përdorimi i *Gehenna*-s nga Jezusi
 - a. zjarr, Mat. 5:22; 18:9; Marku 9:43
 - b. i përhershëm, Marku 9:48 (Mat. 25:46)
 - c. vend shkatërrimi (i trupit dhe shpirtit), Mat. 10:28
 - d. paralel me *Sheolin*, Mat. 5:29-30; 18:9
 - e. karakterizon të ligjtë si "bij të ferrit", Mat. 23:15
 - f. rezultat i dënimit të gjyqit hyjnor, Mat. 23:33; Luka 12:5
 - g. koncepti i *Gehenna*-s është paralel me vdekjen e dytë (shih Zbu. 2:11; 20:6, 14), ose me liqenin e zjarrtë (shih Mat. 13:42, 50; Zbu. 19:20; 20:10, 14-15; 21:8). Ka gjasa që liqeni i zjarrtë të bëhet vendbanimi i përhershëm i njerëzve (nga *Sheoli*) dhe i engjëjve të ligj (nga *Tartari*, 2 Pjet. 2:4; Juda v. 6, ose humnera, shih Luka 8:31; Zbu. 9:1-11; 20:1, 3).

h. nuk u krijua për njerëzit, por për Satanin dhe për engjëjt e tij, Mat. 25:41

E. Ka gjasa që, për shkak të mbivendosjes së *Sheolit* me *Hadesin* dhe *Gehenna*-n,

1. në fillim, të gjithë njerëzit shkonin në *Sheol/Hades*
2. përvoja e tyre atje (e mirë/e keqe) përkeqësohet pas Ditës së Gjykimit, por vendi i të ligjve mbetet i njëjtë (ja pse KJV e përktheu fjalën *hades* (varr) si *gehanna* (ferr))
3. I vetmi pasazh në DhR që përmend torturën përpara Gjykimit është shëmbëlltyra e Lukës 16:19-31 (Lazari dhe i Pasuri). *Sheoli* përkthehet edhe si vend ndëshkimi tani (shih LiP. 32:22; Psa. 18:1-5). Megjithatë, s'mund të krijojmë një doktrinë në bazë të një shëmbëlltyre.

III. Gjendja e ndërmjetme midis vdekjes dhe ringjalljes

- A. DhR nuk mëson “pavdekshmërinë e shpirtit”, që është një prej disa pikëpamjeve të lashta për jetën pas vdekjes.
1. shpirti njerëzor ekziston përpara jetës së vet fizike
 2. shpirti njerëzor është i përgjeshëm përpara dhe pas vdekjes fizike
 3. shpesh, trupi fizik shihet si burg, ndërsa vdekja si çlirim për t’u kthyer në gjendjen paraekzistuese
- B. DhR aludon për një gjendje të patrupëzuar midis vdekjes dhe ringjalljes
1. Jezusi flet për ndarjen e shpirtit dhe trupit, Mat. 10:28
 2. Abrahami mund të ketë një trup tani, Marku 12:26-27; Luka 16:23
 3. Moisiu dhe Elija kanë një trup fizik në çastin e shndërrimit në mal, Matu 17
 4. Pali pohon se, në Ardhjen e Dytë, shpirtat me Krishtin do të marrin të parët trupa të rinj, 1 Thes. 4:13-18
 5. Pali pohon se besimtarët do të marrin trupa të rinj shpirtërorë në Ditën e Ringjalljes, 1 Kor. 15:23, 52
 6. Pali pohon se besimtarët nuk shkojnë në *Hades*, por, pas vdekjes, janë me Jezusin, 2 Kor. 5:6, 8; Fil. 1:23. Jezusi mposhti vdekjen dhe i mori të drejtët në qiell me të (1 Pjet. 3:18-22).

IV. Qielli

- A. Kjo fjalë përdoret në tre kuptime në Bibël.
1. atmosfera mbi tokë, Zan. 1:1, 8; Isa. 42:5; 45:18
 2. qiejt me yje, Zan. 1:14; LiP. 10:14; Psa. 148:4; Heb. 4:14; 7:26
 3. vendi i fronit të Perëndisë, LiP. 10:14; 1 Mbret. 8:27; Psa. 148:4; Efe. 4:10; Heb. 9:24 (qielli i tretë, 2 Kor. 12:2)
- B. Bibla nuk na zbulon shumë gjëra për jetën pas vdekjes, ndoshta për shkak se njerëzit e rënë nuk kanë kapacitetin që të kuptojnë (shih 1 Kor. 2:9).
- C. Qielli është edhe vend (shih Gjoni 14:2-3), edhe person (shih 2 Kor. 5:6 8). Qielli mund të jetë Kopshti i ripërtërirë i Edenit (Zanafilla 1-2; Zbulesa 21-22). Toka do të pastrohet dhe rimëkëmbët (shih Veprat 3:21; Rom. 8:21; 2 Pjet. 3:10). Shëmbëllimi i Perëndisë (Zan. 1:26-27) ripërtërihet në Krishtin. Tani, bashkësia e ngushtë e Kopshtit të Edenit bëhet sërish e mundshme.

Gjithsesi, kjo mund të jetë metaforike (qielli si qytet i stërmadh në formë kubi, i Zbu. 21:9-27), dhe jo e fjalëpërfjalshme. 1 Korintasve 15 përshkruan dallimin mes trupit fizik dhe trupit shpirtëror si dallimi mes farës dhe bimës së rritur. Sërish, 1 Kor. 2:9 (citim i Isa. 64:4 dhe 65:17) është një shpresë dhe premtim madhështor! Unë e di se, kur të shohim atë, do të jemi si ai (shih 1 Gjonit 3:2).

V. Burime të dobishme

- A. William Hendriksen, *The Bible on the Life Hereafter* [Bibla për jetën pas vdekjes]
B. Maurice Rawlings, *Beyond Death's Door* [Përtej derës së vdekjes]

3:20 “kur durimi i Perëndisë po priste” Kjo është formë e përbërë e *mēkos* (i largët, i distancuar) dhe *thumos* (zemërim). Folja është dëftore e pakryer mesore (deponente), që nënkupton se vetë Perëndia vazhdonte të priste pareshtur. Durimi i Perëndisë, i cili është i ngadaltë në hakmarrje, dhe ka durim plot dashuri, e karakterizon marrëdhënien e tij me njerëzit rebelë (shih 1 Pje. 3:20; Eks. 34:6; Neh. 9:16-23; Ps. 103:8-14; Joeli 2:13; Mikea 6:18-20; 2 Pje. 3:15; Rom. 2:4; 9:22). Ky karakter i perëndishëm shfaqet edhe në fëmijët e tij (shih 2 Kor. 6:6; Gal. 5:22; Efe. 4:2; Kol. 1:11; 3:12; 1 Tim. 1:16; 2 Tim. 3:10; 4:2).

Në shkrimet e Pjetrit, Perëndia paraqitet si person që pret me durim dhe e mban gjykimin në mënyrë që njerëzit të shpëtohen.

1. Ai priti në ditët e Noeut, 1 Pje. 3:20
2. E vonoi Ardhjen e Dytë, 2 Pje. 3:9

Perëndia do që të gjithë njerëzit të shpëtohen (shih 2 Pje. 3:9, 15)!

■ **“të cilët ishin dikur të pabindur... Noeut”** Kjo duket se bën fjalë për engjëjt e Zanafillës 6 (shih 2 Pje. 2:4-5; Juda 6), ose për njerëzit mosbesues në kohën e Noeut.

■ **“u shpëtuan përmes ujit”** Kontekstualisht, duket se Pjetri po e përmend rrëfimin historik të Noeut dhe përmbytyes si mënyrë për të folur për “shpëtimin” (çlirimi fizik i DHV kundrejt shpëtimit shpirtëror në DHR) përmes ujit (pra, përmbytyja e DHV [Zan. 6-9] kundrejt pagëzimit të krishterë). Nëse sfondi i kësaj është *1 Enokut*, atëherë Noeu dhe familja e tij (pra, gjithë njerëzimi) u shpëtuan përmes ujërave të përmbytyes nga raca e ligë dhe e përzier e njerëzve dhe engjëjve.

3:21

NASB “Në përputhje me këtë”

NKJV “ekziston dhe një kundërtip”

NRSV “gjë që parafigurohet”

TEV “gjë që ishte simbol, që tregonte për”

NJB “Në përputhje me këtë”

Kjo është fjala greke *antitupon*, që është fjalë e përbërë prej *anti* (pra, kundër, ose në përputhje me) dhe *tupos* (shëmbëllturyrë ose kopje). Ky është i vetmi shembull i këtij mbiemri në DHR, por si emër shfaqet në Heb. 9:24. Kjo frazë tregon natyrën simbolike dhe tipologjike të referencës së Pjetrit.

■ **“pagëzimi”** Pagëzimi ishte mundësia e kishës së hershme për rrëfimin publik të individit. Nuk ishte/është mekanizmi për shpëtim, por përbën një rast që besimtari të shpallë gojarisht besimin. Mos harroni se kisha e hershme nuk kishte godina, por takohej nëpër shtëpi, ose, shpesh, në vende të fshehta për shkak të përndjekjes.

Shumë komentues kanë argumentuar se 1 Pjetrit është predikim për pagëzime. Ndonëse kjo është e mundur, nuk është e vetmja mundësi. Është e vërtetë se, shpesh, Pjetri e përdor pagëzimin si akt kyç besimi (shih Veprat 2:38, 41; 10:17). Mirëpo nuk ishte/është ngjarje sakramentale, por një ngjarje besimi, që simbolizon vdekjen, varrosjen dhe ringjalljen; në pagëzim, besimtari identifikohet me përvojën e vetë Krishtit (shih Rom. 6:7-9; Kol. 2:12). Ky akt është simbolik, jo sakramental; akti i pagëzimit është rasti për të rrëfyer shpëtimin, jo mekanizëm i shpëtimit.

■ **“ju shpëton”** Në DHV kjo fjalë përdoret kryesisht për çlirimin fizik, kurse në DHR përdoret kryesisht për çlirimin shpirtëror. Në këtë kontekst përndjekjeje, qartazi i ka të dyja këto ngjyime kuptimore.

■ **“por kërkesa para Perëndisë për një ndërgjegje të mirë”** Kjo tregon se nuk është riti i pagëzimit ai që e shpëton besimtarin, por qëndrimi i tij ndaj Perëndisë (shih 1 Pje. 3:16). Megjithatë, do të shtoja se pagëzimi nuk është fakultativ, por është (1) një shembull që na e la Jezusi (shih Mat. 3:13-17; Marku 1:9-11; Luka 3:21-22; Gjoni 1:31-34) dhe (2) një urdhërim i Jezusit (shih Mat. 28:19) për gjithë besimtarët. Në DHR nuk flitet aspak për besimtarë të papagëzuar. Në DHR, pagëzimi ishte i pandashëm nga rrëfimi i besimit në Krishtin.

Shih shënimin për “ndërgjegjen” në 1 Pje. 3:16.

■ **“nëpërmjet ringjalljes së Jezu Krishtit”** Kjo tregon se thelbi i shpëtimit gjendet në ringjalljen e Jezusit (shih Rom. 1:4-5), jo në pagëzim. Kjo vijë mendimi shihet qartë në Rom. 6:3-4. Pagëzimi është analogji, nëpërmjet zhytjes, që simbolizon vdekjen, varrosjen dhe ringjalljen. Në të vërtetë, rëndësi ka zemra e kandidatit që pagëzohet, jo mënyra e pagëzimit.

3:22 “i cili... është në të djathtë të Perëndisë” Kjo është metaforë antropomorfe e autoritetit, pushtetit dhe prestigjit të Jezusit (shih 1 Gjonit 2:1). Kjo simbolikë është marrë nga Psa. 110:1.

Bibla e përdor gjuhën njerëzore për të përshkruar persona, vende dhe ngjarje të mbinatyrshme. Qartazi, kjo gjuhë është analoge, simbolike dhe metaforike. Bibla është në gjendje të komunikojë realitetin, por brenda kufijve të (1) perceptimit tonë të rënë njerëzor dhe (2) veçantisë së tij fizike, kohore dhe kulturore. Kjo gjuhë është e mjaftueshme, por jo absolute.

■ **“iu nënshtruan engjëjt, autoritetet dhe pushtetet”** Duket se bëhet fjalë për rangjet engjëllore (shih Rom. 8:38-39; 1 Kor. 15:24; Efe. 1:20-21; 6:12; Kol. 2:15; *1 Enokut*). Kjo tregon autoritetin e plotë dhe pushtetin e Krishtit mbi sferën shpirtërore.

Ndonëse 1 Pjetrit nuk e adreson drejtpërdrejt gnosticizmin, është e qartë nga shkrime të tjera të DHR (Kol., Efe., 1 Tim., Titit, dhe 1 Gjonit) se konteksti kulturor i botës greko-romake të shekullit të parë u ndikua nga kjo mënyrë mendimi filozofiko-teologjike. Në gnosticizmin e shekullit të dytë (tekstet e Nag Hammadit) fjala greke *pleroma* (plotësi), e përdorur shpesh nga Pali, nënkupton “plotësinë e Perëndisë”, nivelet engjëllore (*aeon-at*, ndoshta shtatë qiejt judaïke) midis perëndisë së lartë dhe të mirë dhe perëndive më të ulëta. Jezusi është çelësi për të shkuar në qiell, jo fjalëkalimet apo njohuria e fshehtë, që gjoja lidhej me këto qenie të ndërmjetme engjëllore/demoniake.

Edhe nëse *aeon-at* gnostike nuk janë fokusi i këtij pasazhi, duket se engjëjt janë fokusi i tij gjithsesi! Kjo nënkupton se “frymërat në burg” janë engjëjt e pabindur, të cilët morën gra njerëzore dhe lindën fëmijë (shih Zan. 6:1-4).

TEMË E VEÇANTË: GNOSTICIZMI [nga fjala greke *gnosis*, që do të thotë njohuri, shih 1 Tim. 6:20] (SPECIAL TOPIC: GNOSTICISM)

- I. Konteksti i shekullit të parë
Bota romake e shekullit të parë ishte një kohë eklektizmi mes feve lindore dhe atyre perëndimore. Perënditë e panteoneve greke dhe romake kishin fituar emër të keq. Fetë e mistershme ishin shumë popullore për shkak se theksonin marrëdhënien personale me hyjninë si dhe një njohuri të fshehtë. Filozofia sekulare greke ishte popullore dhe po shkrihej me botëkuptime të tjera. Në këtë botë feje eklektike erdhi dhe ekskluziviteti i besimit të krishterë (Jezusi është e vetmja udhë për te Perëndia, shih Gjoni 14:6). Cilido qoftë sfondi i saktë i kësaj herezie, ajo ishte një përpjekje për ta bërë natyrën përjashtuese të krishterimit (pra, Gjoni 14:6; 1 Gjonit 5:12) të pranueshme dhe të pëlqyeshme nga ana mendore për dëgjuesit greko-romakë në përgjithësi. Ka gjasa që mendimi gnostik të ketë dalë prej sekteve të skajshme judaïke (një shembull: sekti i Pergamenave të Detit të Vdekur). Kjo ndoshta shpjegon dhe disa prej elementeve judaïke të librave të DHV që trajtojnë gnosticizmin.
- II. Disa nga parimet bazë të kësaj herezie sipas të dhënave të brendshme të 1 Gjonit.
 - A. Mohimi i mishërimit të Jezu Krishtit
 - B. Mohimi i rolit qendror të Jezu Krishtit në shpëtim
 - C. Mungesa e një stili të përshtatshëm jetese si të krishterë
 - D. Theksimi i njohurisë (shpesh, e fshehtë)
 - E. Prirja drejt ekskluzivimit dhe elitizmit
- III. Shenjat e gnosticizmit në shekullin e parë
 - A. Mësimet bazë të proto-gnosticizmit të shekullit të parë duket se ishin theksimi i dualizmit ontologjik (të përjetshëm) mes shpirtit dhe materies. Shpirti (perëndia i lartë) konsiderohej i mirë, ndërsa materia ishte qenësisht e keqe. Kjo dikotomi i ngjan
 1. Platonizmit: idealja kundër fizikes
 2. Qiellorja përkundër tokësore
 3. E padukshmja përkundër të dukshmes. Kishte dhe një mbitheksim të rëndësisë së njohurisë së fshehtë (fjalët kyçe ose kodet sekrete i lejonin shpirtit të kalonte përmes sferave engjëllore [*aeona*] deri te perëndia i lartë), që ishte e domosdoshme për shpëtim.
 4. Ndoshta ka ndikime nga zoroastrianizmi
 - B. Nga sfondi i 1 Gjonit mund të dallojmë dy forma të proto-gnosticizmit
 1. Gnosticizmi docetik, që mohonte natyrën e vërtetë njerëzore të Jezusit për shkak se materia është e keqe
 2. Gnosticizmi i Kerintit, që e identifikonte Krishtin me një nga *aeon-at* ose nivelet e shumta engjëllore midis perëndisë së lartë dhe materies së ligë. Ky “Shpirt Krishti” banoi në njeriun Jezus që nga çasti i pagëzimit dhe e braktisi para kryqëzimit.
 3. Nga këto dy grupe, disa praktikonin asketizmin (nëse trupi do diçka, ajo është gjë e ligë),

ndërsa disa të tjerë, antinomianizmin (nëse trupi do diçka, jepja).

- C. Nuk ka të dhëna me shkrim për ndonjë sistem të zhvilluar të gnosticizmit në shekullin e parë. Vetëm nga mesi i shekullit të dytë ekzistojnë të dhëna të dokumentuara (shih Tekstet e Nag Hamadit). Për informacione të mëtejshme për “gnosticizmin”, shih
1. *The Gnostic Religion* nga Hans Jonas, botuar nga Beacon Press
 2. *The Gnostic Gospels* nga Elaine Pagels, botuar nga Random House
 3. *The Nag Hammadi Gnostic Texts and the Bible* nga Andreë Helmbold

IV. Herezia sot

- A. Fryma e kësaj herezie është e pranishme dhe sot, kur njerëzit përpiqen ta kombinojnë të vërtetën e krishterë me sisteme të tjera mendimi.
- B. Fryma e kësaj herezie është e pranishme dhe sot, kur njerëzit theksojnë doktrinën “e saktë” në veçim nga marrëdhënia personale dhe besimi si stil jetese.
- C. Fryma e kësaj herezie është e pranishme dhe sot, kur njerëzit e kthejnë krishterimin në një grupi elitare dhe përjashtues nga ana intelektuale.
- D. Fryma e kësaj herezie është e pranishme dhe sot, kur njerëzit fetarë bien pre e asketizmit ose antinomianizmit si mënyra më e mirë për të gjetur hir te Perëndia.

PYETJE PËR DISKUTIM

Ky është një komentari studimor udhëzues, që do të thotë se ti je vetë përgjegjës për interpretimin e Biblës. Secili prej nesh duhet të ecë sipas dritës që ka. Ti, Bibla dhe Fryma e Shenjtë keni përparësi në interpretim. Nuk duhet t’ia dorëzosh këtë të drejtë komentuesit.

Këto pyetje për diskutim t’i kam dhënë për të të ndihmuar që të analizosh çështjet kryesore të kësaj pjese të librit. Ato synojnë të të nxisin mendimin, jo të kenë natyrë shteruese.

1. A ishin maskilistë shkruarit e DHR?
2. Si duhet të vishen gratë? (Kërkoni videon time #1337 me titull “Një teologji e veshjes së krishterë”)
3. Si mund të ndikojnë marrëdhëniet familjare në lutjet tona?
4. Rendit karakteristikat që duhet të na udhëheqin në marrëdhëniet shoqërore.
5. Pse vuajnë të krishterët?
6. A duhet të jetë çdo i krishterë dëshmitar me gojë i ungjillit?
7. Kush janë frymërat në burg?
8. A na shpëton pagëzimi (Kërkoni videon time #1962 me titull “Rilindja pagëzimore”)

1 PJETRIT 4

NDARJET NË PARAGRAFË TË PËRKTHEMEVE MODERNE

UBS ⁴	NKJV	NRSV	TEV	NJB
Administratorë të mirë të hirit të Perëndisë	Vuajtjet e Krishtit dhe tonat (3:18-4:6)	Detyrimet e të krishterëve (2:11-4:11)	Jetë të ndryshuara	Ndarja nga mëkati
4:1-6		4:1-6	4:1-6	4:1-6
	Shërbimi për lavdi të Perëndisë		Administrues të mirë të dhuntive të Perëndisë	Zbulesa e Krishtit është afër
4:7-11	4:7-11	4:7-11	4:7-11	4:7-11
Vuajtja si i krishterë	Vuajtja për lavdi të Perëndisë	Përmbledhje	Vuajtja si i krishterë	Vuajtja për Krishtin
4:12-19	4:12-19	4:12-19	4:12-19	4:12-19

CIKLI TRE I LEXIMIT (shih f. v)

NDJEKJA E SYNIMIT TË AUTORIT FILLESTAR NË NIVELIN E PARAGRAFËVE

Ky është një komentuar studimor udhëzues, që do të thotë se ti je vetë përgjegjës për interpretimin e Biblës. Secili prej nesh duhet të ecë sipas dritës që ka. Ti, Bibla dhe Fryma e Shenjtë keni përparësi në interpretim. Nuk duhet t'ia dorëzosh këtë të drejtë komentuesit.

Lexo gjithë kapitullin njëherësh. Identifiko temat. Krahaso ndarjet e tua tematike me pesë përkthimet moderne. Ndarja në paragrafë nuk është e frymëzuar, por është çelësi për të ndjekur synimin e autorit fillestar, gjë që është thelbi i interpretimit. Secili paragraf ka vetëm një temë të vetme.

1. Paragrafi i parë
2. Paragrafi i dytë
3. Paragrafi i tretë
4. Etj.

STUDIMI I FJALËVE DHE FRAZAVE

TEKSTI I NASB (I PËRDITËSUAR): 1 PJETRIT 4:1-6

¹Prandaj, meqë Krishti ka vuajtur në mish, armatosuni me të njëjtin qëllim, sepse ai që ka vuajtur në mish ka pushuar nga mëkati, ²në mënyrë që ta jetojë pjesën tjetër të kohës në mish, jo më për epshet e njerëzve, por për vullnetin e Perëndisë. ³Sepse koha që tashmë ka kaluar ju mjafton që të keni kryer dëshirën e johebrenjve, kur ndoqët rrugën e shturjes, epsheve, dehjes, teprimeve, gostive me pije dhe idhujtarive të neveritshme. ⁴Në të gjitha këto, ata habiten që nuk vraponi me ta drejt të njëjtave teprime shturjeje, dhe flasin keq për ju; ⁵por do t'i japin llogari atij që është gati të gjykojë të gjallët dhe të vdekurit. ⁶Sepse pikërisht për këtë qëllim ungjilli u është predikuar dhe atyre që kanë vdekur, që ndonëse të gjykoohen në mish si njerëz, të jetojnë në frymë sipas vullnetit të Perëndisë.

4:1 “Prandaj” Kjo lidh diskutimin e mëparshëm me atë që vijon.

■ **“Krishti ka vuajtur në mish”** Kjo lidhet me 3:18. Mishi bën fjalë për jetën fizike të Jezusit. Ai ishte vërtet njëri prej nesh (pra, njeri). Vdiq në vendin tonë (shih 1 Pje. 4:18; Isaia 53; Marku 10:45; 2 Kor. 5:21). 1 Pjetri thekson vuajtjen e Krishtit (shih 1 Pje. 2:21, 23; 3:18; 4:1) dhe realitetin e vuajtjes së ndjekësve të tij për shkak se ndjekin Krishtin (shih 1 Pje. 2:19-20; 3:14, 17; 4:15, 19; 5:10).

Natyra zëvendësuese e vuajtjes së Krishtit, e përmendur në 1 Pje. 3:18 dhe 2:21, theksohet nga disa dorëshkrime greke, që shtojnë “vuajti për ju” (kodiku Siatikus) ose “për ne” (pra, Sinaitikus [dora e tretë], A, K dhe P).

I njëjti lloj përemri që specifikon këtë shtesë mund të shihet dhe në 1 Pje. 4:3. Disa kopjues të kishës së hershme u përpoqën që t’i qartësonin tekstet.

▣ **“armatosuni me të njëjtin qëlim”** Qëndrimi i Jezusit ndaj vuajtjes, përfshi dhe vuajtjen si i pafajshëm, është normativ për të perëndishmit në këtë botë të rënë (shih Gjoni 15:20; Rom. 8:17; Fil. 1:29; 2 Tim. 3:12; 1 Pje. 4:12-19).

▣ **“sepse ai që ka vuajtur në mish ka pushuar nga mëkati”** Kjo frazë mund të interpretohet në disa mënyra, në varësi të formës gramatikore. Krishti është shembulli ynë për vuajtjen si i pafajshëm, madje në mënyrë zëvendësuese (pjesore aoriste veprare). Tani, besimtarët janë të përfshirë në vuajte për shkak të identifikimit të tyre me të.

Folja kryesore mund të jetë, ose mesore (A. T. Robertson, *Word Pictures of the New Testament*, f. 121), ose pësore (Moulton, *Analytical Greek Lexicon* dhe Barbara e Tim Friberg, *Analytical Greek New Testament*). Nëse është mesore, Pjetri po inkurajon besimtarët të përfshihen pozitivisht që të mos mëkatojnë si ndjekës të shembullit të Krishtit. Nëse është pësore, po thekson faktin shpirtëror të çlirimit të besimtarit nga fuqia e mëkatis.

Vdekja e anulon marrëdhënien e njeriut me mëkatin. Kjo mund të lidhet me konceptet teologjike të Rom. 6. Vdekja ndaj jetës së vjetër ngjall shërbesën ndaj Perëndisë (shih Rom. 6:2, 6, 7), ose pagëzimi simbolizon risinë e jetës së re (shih Rom. 6:4; Kol. 2:12).

Gjithë ideja është se besimtarët ndjekin jo vetëm shembullin e vuajtjes së Krishtit, por edhe shembullin e fitores së tij mbi mëkatin. Ne jemi krijesa të reja në Krishtin! Duhet të jetojmë si të tilla. Ngjashmëria me Krishtin është vullneti i Perëndisë (shih Rom. 8:28-29; 2 Kor. 3:18; 7:1; Gal. 4:19; Efe. 1:4; 4:13; 1 Thes. 3:13; 4:3,7; 5:23; 1 Pje. 1:15). Kjo reflekton faktin se shëmbëllimi i Perëndisë, i humbur pas Rënies (shih Zanafilla 3), tani rikthehet plotësisht në Krishtin. Të krishterët kanë sërish një zgjedhje për mënyrën si të jetojnë. Nuk janë më skllëvër të mëkatis! Le të ecin në të!

4:2 “në mënyrë që ta jetojë pjesën tjetër të kohës në mish, jo më për epshet e njerëzve” Kjo reflekton të njëjtën të vërtetë teologjike si Romakëve 6. Besimtarët kanë vdekur ndaj mëkatis dhe, tani, janë të gjallë për shërbesën ndaj Perëndisë (shih Rom. 6:20). Shpëtimi është jetë e re, krijim i ri. Ka një sërë tiparesh të vëzhgueshme.

▣ **“por për vullnetin e Peërndisë”** Shih Temën e Veçantë: Vullneti i Perëndisë në 1 Pjetrit 2:15.

4:3 Ky varg është dënim i jetës së mëparshme të lexuesve në paganizëm. Ky është një nga vargjet që i bën komentuesit të shprehur se kishat të cilave po u shkruan Pjetri janë kryesisht bashkësi me johebrenj. Shoqëria pagane ishte shumë imorale, madje dhe në ritualet e vet të adhurimit. Krishterimi duhet të bëjë një ndryshim thellësisht të ndryshëm dhe dramatik në stilin e jetesës së individit. Shpesh, ky ndryshim shënon fillimin e përndjekjes nga paganët. Mëkati dëshiron shoqëri.

Pas fjalës “Sepse”, disa dorëshkrime greke shtojnë “ju”, ndërsa disa të tjera “ne”. Këto janë të dyja shtesa kopjuesish që përpiqen të qartësojnë fjalinë e autorit.

TEMË E VEÇANTË: VESET DHE VIRTYTET NË DHR (SPECIAL TOPIC: VICES AND VIRTUES IN THE NT)

Listat e veseve dhe virtyteve përmenden shpesh në DHR. Shpesh, ato reflektojnë listat rabinike dhe kulturore (stoike). Listat e DHR, me karakteristika të kundërta, mund të shihen në:

	Veset	Virtytet
1. Pali	Rom. 1:28-32 Rom. 13:13 1 Kor. 5:9-11	--- Rom. 12:9-21 ---

	1 Kor. 6:10	1 Kor. 6:6-9
	2 Kor. 12:20	2 Kor. 6:4-10
	Gal. 5:19-21	Gal. 5:22-23
	Efe. 4:25-32	---
	Efe. 5:3-5	---
	---	Fil. 4:8-9
	Kol. 3:5,8	Kol. 3:12-14
	1 Tim. 1:9-10	---
	1 Tim. 6:4-5	---
	2 Tim. 2:22a, 23	2 Tim. 2:22b,24
	Titit 1:7, 3:3	Titit 1:8-9; 3:1-2
2. Jakobi	Jakobi 3:15-16	Jakobi 3:17-18
3. Pjetri	1 Pje. 4:3	1 Pje. 4:7-11
	2 Pje. 1:9	2 Pje. 1:5-8
4. Gjoni	Zbu. 21:8; 22:15	---

☐ **“kur ndoqët rrugën e”** Kjo është pjesore e kryer mesore. Jobsimtarët e kanë përcaktuar qëllimisht dhe pakthyeshmërisht rrugën e tyre drejt vetes dhe mëkatit.

NASB “shthurjes”
NKJV, NRSV “imoralitetit”
TEV “turpit”
NJB “sjelljes në mënyrë të shthurur”

Kjo fjalë nënkupton mungesën e plotë të vetëkontrollit, shkeljen e vendosur të normave shoqërore, sidomos në fushën seksuale (shih Marku 7:22; Rom. 13:13; 2 Kor. 12:21; Gal. 5:19; Efe. 4:19; 1 Pje. 4:3; 2 Pje. 2:7,18; Juda 6).

☐ **“epsheve”** Kjo fjalë nënkupton dëshirimin e fortë të diçkaje ose të dikujt. Kjo dëshirë e fortë mund të jetë pozitive (shih Luka 22:15; 1 Tim. 2:1; 1 Pje. 1:12), por zakonisht është negative (shih 1 Pje. 1:14; 2:11; 4:2, 3; 2 Pje. 1:4; 2:10, 18; 3:3; Marku 4:19).

☐ **“dehjes”** Kjo është fjalë e përbërë (dhe gjendet vetëm këtu në DHR) nga “vera” (*oinos*) dhe “nxjerr filluska” (*flu*). Bota e lashtë e pinte rregullisht verën; edhe Jezusi (shih Mat. 11:18-19) e kisha e hershme. Ajo që dënohet është teprimi (shih Fja. 23:29-35; Rom. 13:13; Gal. 5:21).

TEMË E VEÇANTË: QËNDRIMET BIBLIKE NDAJ ALKOOLIT DHE ALKOOLIZMIT (SPECIAL TOPIC: BIBLICAL ATTITUDES TOWARD ALCOHOL AND ALCOHOLISM)

I. Termat biblikë

A. Dhiata e Vjetër

1. *Jajin* – ky është term i përgjithshëm për verën (BDB 406, KB 409), që përdoret 141 herë. Etimologjia e tij është e paqartë pasi nuk vjen nga një rrënjë hebraisht. Gjithmonë ka kuptimin “lëng fryti i fermentuar”, zakonisht nga rrushi. Disa pasazhe tipike janë Zan. 9:21; Eks. 29:40; Num. 15:5, 10.
2. *Tirosh* – Kjo është “verë e re” (BDB 440, KB 1727). Për shkak të kushteve klimatike të Lindjes së Afërt, fermentimi fillonte që gjashtë orë pas nxjerrjes së lëngut. Ky term i referohet verës në procesin e fermentimit. Për disa pasazhe tipike, shih LiP. 12:17; 18:4; Isa. 62:8-9; Os. 4:11.
3. *Asis* – Qartazi, këtu bëhet fjalë për pije alkoolike (“verë e ëmbël”, BDB 779, KB 860, p.sh., Joeli 1:5; Isa. 49:26).
4. *Sekar* – ky term do të thotë “pije e fortë” (BDB 1016, KB 1500). Rrënja hebraisht përdoret

në termin “i dehur” ose “pijanec”. Atij i shtohet diçka për ta bërë më dehës. Është fjalë paralele me *jajin* (shih Fja. 20:1; 31:6; Isa. 28:7).

B. Dhiata e Re

1. *Oinos* – fjala greqisht që është e barasvlershme me *jajin*
2. *Neos oinos* (verë e re) – fjala greqisht e barasvlershme me *tiros* (shih Marku 2:22).
3. *Gleukos oinos* (verë e ëmbël, *asis*) – verë në fazat e para të fermentimit (shih Veprat 2:13).

II. Përdorimi biblik

A. Dhiata e Vjetër

1. Vera është dhuratë nga Perëndia (Zan. 27:28; Psa. 104:14-15; Pred. 9:7; Os. 2:8-9; Joeli 2:19, 24; Amosi 9:13; Zak. 10:7).
2. Vera është pjesë e ofrimit flijues (Eks. 29:40; Lev. 23:13; Num. 15:7, 10; 28:14; LiP. 14:26; Gjyq. 9:13).
3. Vera përdoret si ilaç (2 Sam. 16:2; Fja. 31:6-7).
4. Vera mund të jetë problem i vërtetë (Noeu – Zan. 9:21; Loti – Zan. 19:33, 35; Samsoni – Gjyq. 16; Nabali – 1 Sam. 25:36; Uriahu – 2 Sam. 11:13; Amoni – 2 Sam. 13:28; Elahu – 1 Mbret. 16:9; Benhadadi – 1 Mbret. 20:12; Sundimtarët – Amosi 6:6; dhe Zonjat – Amosi 4).
5. Me verën mund të abuzohet (Fja. 20:1; 23:29-35; 31:4-5; Isa. 5:11, 22; 19:14; 28:7-8; Osea 4:11).
6. Vera iu ndalohej grupeve të caktuara (priftërinjve në detyrë, Lev. 10:9; Ezek. 44:21; nazaritëve, Num. 6; dhe sundimtarëve, Fja. 31:4-5; Isa. 56:11-12; Osea 7:5).
7. Vera përdoret në kontekstin eskatologjik (Amosi 9:13; Joeli 3:18; Zak. 9:17).

B. Periudha ndërhytore

1. Vera, me masë, është shumë e dobishme (*Ekleziasti* 31:27-30).
2. Rabinët thonë: “Vera është ilaçi më i shkëlqyer; aty ku vera mungon, atëherë nevojiten ilaçet” (BB 58b).

C. Dhiata e Re

1. Jezusi shndërroi një sasi të madhe uji në verë (Gjoni 2:1-11).
2. Jezusi piu verë (Mat. 11:18-19; Luka 7:33-34; 22:17 e më tej).
3. Pjetri u akuzua për dehje me “verë të re” në ditën e Rrëshajave (Veprat 2:13).
4. Vera mund të përdoret si ilaç (Marku 15:23; Luka 10:34; 1 Tim. 5:23).
5. Drejtuesit nuk duhet të jenë abuzues me verë. Kjo nuk do të thotë se duhet të mos pinë fare alkool (2 Tim. 3:3, 8; Titi 1:7; 2:3; 1 Pje. 4:3).
6. Vera përdoret në kontekste eskatologjike (Mateu 22:1 e më tej; Zbu. 19:9).
7. Dehja shihet me sy të keq (Mat. 24:49; Luka 12:45; 21:34; 1 Kor. 5:11-13; 6:10; Gal. 5:21; 1 Pje. 4:3; Rom. 13:13-14).

III. Mësime teologjike

A. Tensioni dialektik

1. Vera është dhuratë nga Perëndia.
2. Dehja përbën problem të madh.
3. Në disa kultura, besimtarët duhet t’i kufizojnë liritë e tyre për hir të ungjillit (Mat. 15:1-20; Marku 7:1-23; 1 Korintasve 8-10; Romakëve 14).

B. Prirja për t’i kaluar caqet e dhëna

1. Perëndia është burimi i të gjitha gjërave të mira.
 - a. Ushqimi – Marku 7:19; Luka 11:44; 1 Kor. 10:25-26
 - b. Të gjitha gjërat e pastra – Rom. 14:14, 20; 1 Tim. 4:4
 - c. Të gjitha gjërat e lejueshme – 1 Kor. 6:12; 10:23
 - d. Të gjitha gjërat e pastra – Titit 1:15
2. Njerëzimi i rënë ka abuzuar me të gjitha dhuratat e Perëndisë duke i çuar përtej kufijve të caktuar nga Perëndia.

C. Abuzimi është faji ynë, jo i gjërave. Nuk ka asgjë të keqe në krijimin fizik (shih Marku 7:18-23; Rom. 14:14, 20; 1 Kor. 10:25-26; 1 Tim. 4:4; Titi 1:15).

IV. Kultura dhe fermentimi judaik në shekullin e parë

A. Fermentimi fillon shumë herët, rreth 6 orë pasi është shtypur rrushi.

- B. Tradita judaike thotë se, kur në sipërfaqe shfaqet një shkumë e lehtë (shenjë e fermentimit), ajo duhet t'i nënshtrohet të dhjetave të verës (*Maaseroth* 1:7). Quhet “verë e re” ose “verë e ëmbël”.
 - C. Fermentimi i parë i fortë përfundonte pas një jave.
 - D. Fermentimi dytësor kërkonte rreth 40 ditë. Në këtë fazë, konsiderohej “verë e vjetruar” dhe mund të ofrohej në altar (*Edhujjoth*, 6:1).
 - E. Vera që kishte pushuar mbi llumin e vet (vera e vjetër) konsiderohej e mirë, por duhej kulluar mirë përpara përdorimi.
 - F. Vera konsiderohej e vjetruar sa duhet zakonisht pas një viti fermentimi. Tre vite ishte periudha më e gjatë kohore që vera mund të magazinohet e sigurt. Ajo quhej “verë e vjetër” dhe duhej holluar me ujë.
 - G. Vetëm në 100 e fundit është arritur të vonohet periudha e fermentimit, për shkak të mjedisit steril dhe kimikateve të shtuara. Bota e lashtë nuk e ndalonte dot procesin e natyrshëm të fermentimit.
- V. Pohime përmbyllëse
- A. Sigurohu që përvoja, teologjia dhe interpretimi yt biblik të mos nënvlerësojë Jezusin dhe kulturën judaike/të krishterë të shekullit të parë! Është e qartë se ata nuk ishin njerëz që s'pinin fare alkool.
 - B. Nuk po mbroj përdorimin shoqëror të alkoolit. Megjithatë, shumë vetë e kanë ekzagjeruar pozicionin e Biblës për këtë temë dhe, tani, pretendojnë drejtësi më të lartë për shkak të anshmërisë së tyre kulturore/denominacionale.
 - C. Për mendimin tim, Romakëve 14 dhe 1 Korintasve 8-10 na sigurojnë mësimet dhe udhëzimet të bazuara në dashurinë dhe respektin për bashkëbesimtarët dhe për përhapjen e ungjillit në kulturën tonë, dhe jo liri vetjake apo kritika plot gjykim. Nëse Bibla është i vetmi burim për besimin dhe praktikën, atëherë, ndoshta të gjithë ne duhet ta mendojmë nga e para këtë çështje.
 - D. Nëse themi se mospirja absolute e alkoolit është vullneti i Perëndisë, çfarë po themi për Jezusin, si dhe për ato kultura që përdorin rregullisht verë (p.sh., Evropa, Izraeli, Argjentina)?

NASB “teprimeve”
 NKJV “teprimeve”
 NRSV “teprimeve”
 TEV “orgjive”

Kjo fjalë, *kōmos*, ka lidhje me fjalën greqisht “fshat”, *kōmē*. Nënkupton një gosti të madhe e festive për gjithë komunitetin, ku ka teprime në të ngrënë e në të pirë, si dhe kryhen akte të papërmbajtura seksuale (shih Rom. 13:13; Gal. 5:21).

■ **“gostive me pije”** Kjo fjalë lidhet me atë të mëparshme. NJB i kombinon në një: “kur bënit gosti të çmendura dhe orgji plot dehje”.

NASB, NKJV **“idhujtarive të neveritshme”**
 NRSV **“idhujtarisë së paligjshme”**
 TEV **“adhurimit të neveritshëm të idhujve”**
 NJB **“duke adhuruar në mënyrë përdhosëse perënditë e rreme”**

Kjo listë mëkatesh lidhet me ritualet e adhurimit pagan që, shpesh, përfshinin dehjen, të ngrënin e tepruar dhe shturje seksuale të llojeve më të ndyra të mundshme. Kjo ngjante me adhurimin e pjellorisë kanaanite, që dënohet kaq fort në DHV.

4:4 Ky varg lidhet me 2:12, 15; 3:16. Të krishterët keqkuptoheshin dhe sulmoheshin për shkak se (1) jeta dhe përparësitë e tyre ndryshonin kaq dukshëm dhe rrënjësisht nga të tjerët sa që familja, miqtë dhe fqinjët e tyre e vinin re, dhe (2) për shkak se disa fjalë dhe praktika të krishtera keqinterpretoheshin (p.sh., festat e dashurisë konsideroheshin incest, Darka e Zotit konsiderohej kanibalizëm, etj.).

4:5 “do t’i japin llogari atij që është gati të gjykojë” Gjykimi është i sigurt (shih Mat. 12:36; Heb. 9:27; 10:27; 2 Pje. 2:4, 9; 3:7). Ai që gjykon është

1. Perëndia (shih Rom. 2:2-3; 14:10,12; 1 Pje. 1:17; 2:23; Zbu. 20:11-15)
2. Krishti (shih Gjoni 9:39; Mat. 16:27; 25:31-46; Veprat 10:42; 17:31; 2 Kor. 5:10; 2 Tim. 4:1)
3. Ati përmes Birit (shih Gjoni 5:22-27; Veprat 17:31; Rom. 2:16).

Gjykimi është temë e pakëndshme, por e përsëritur në Bibël. Bazohet në disa të vërteta biblike të patundura:

1. Ky është një univers moral, i krijuar nga një Perëndi etik (korrim atë që mbjellim, shih Gal. 6:7).
2. Njerëzimi është i rënë; ne kemi bërë kryengritje kundër Zotit.
3. Kjo nuk është bota siç e kishte synuar Perëndia.
4. Të gjitha krijesat e vetëdijshme (engjëjt dhe njerëzit) do të japin llogari para Krijuesit të tyre për dhuratën e jetës. Ne jemi administratorë të saj.
5. Përjetësia do të përcaktohet në mënyrë të pakthyeshme nga veprimet dhe zgjedhjet tona në këtë jetë.

■ **“të gjallët dhe të vdekurit”** Kjo nënkupton gjithë njerëzit, si të gjallët ashtu dhe ata që kanë vdekur (shih Fil. 2:10; Zbu. 2:13).

4:6 “Sepse pikërisht për këtë qëllim ungjilli u është predikuar dhe atyre që kanë vdekur” Ka disa teori në lidhje me këtë frazë:

1. ka lidhje me 3:18-20 (pra, “frymërat në burg”)
2. bën fjalë për gjithë njerëzit pasi të gjithë njerëzit, besimtarë ose jo, vdesin fizikisht për shkak të mëkatit (paralel me 1 Pje. 4:5)
3. bën fjalë për ata që i besuan ungjillit por, qysh atëherë, kanë vdekur (të dyja janë aoriste pësore)
4. bën fjalë për të vdekurit shpirtërisht (pra, të humburit) sipas Augustinit, Bedes, Erazmit dhe Luterit (shih Luka 15:24, 32; Efe. 2:1, 5; 5:14; Kol. 2:13)

Kjo teori e fundit hamendëson se disa (pra, ata që nuk e kanë dëgjuar kurrë ungjillin) do të kenë mundësinë që ta pranojnë Krishtin pas vdekjes. Kjo teori është tërheqëse për arsyen njerëzore, por tërësisht e huaj për pjesën tjetër të Shkrimit (shih Heb. 9:27). Ajo mohon urgjencën dhe domosdoshmërinë e ungjillizimit dhe misionit tani! Unë mendoj se me kontekstin përputhen më mirë mundësitë 1 ose 3.

■ **“ndonëse të gjykohe në mish si njerëz, të jetojnë në frymë”** Kjo shprehje është shumë e ngjashme me përshkrimin e Jezusit në 1 Pje. 3:18. Pohon realitetin e jetës së përtejme. Bibla është e qartë për ringjalljen e të shpëtuarve dhe të humburve (shih Dan. 12:2; Mat. 25:46; Gjoni 5:28-29; Veprat 24:15).

TEKSTI I NASB (I PËRDITËSUAR): 1 PJETRIT 4:7-11

⁷Fundi i gjithçkaje është afër; prandaj, jini të përkorë në gjykim dhe të esëllt në frymë me qëllim që të luteni. ⁸Mbi të gjitha, qëndroni të zjarrtë në dashurinë për njëri-tjetrin, sepse dashuria mbulon një shumicë mëkatesh. ⁹Jini mikpritës me njëri-tjetrin pa u ankuar. ¹⁰Ashtu si secili ka marrë nga një dhunti të veçantë, ta përdorë për t’i shërbyer njëri-tjetrit si kujdestarë të mirë të hirit të shumëfishtë të Perëndisë. ¹¹Kushdo që flet, ta bëjë si ai që flet fjalët e Perëndisë; kushdo që shërben, ta bëjë si ai që shërben me anë të forcës që siguron Perëndia; në mënyrë që në të gjitha gjërat Perëndia të përlevdohet përmes Jezu Krishtit, të cilit i përket lavdia dhe pushteti në jetë të jetëve. Amen.

4:7 “Fundi i gjithçkaje është afër” Kjo është dëftore e kryer veprorë. Ardhja e Dytë është motiv i përsëritur në 1 Pjetrit (shih 1 Pje. 1:5, 6; 4:13, 17; 5:1, 10). Toka fizike do të shkatërrohet/pastrohet me zjarr pastrues (shih 2 Pje. 3:10). Ideja se Parousia mund të ndodhë nga momenti në moment shihet edhe te Jezusi (shih Marku 1:15; Luka 21:32); Pali (shih Rom. 13:11); Jakobi (shih Jakobi 5:8); dhe Gjoni (shih Zbu. 1:1, 3; 3:11; 22:6, 7, 10, 12, 20).

Kthimi nga momenti në moment i Jezusit ka qenë temë e shumë predikimeve gjatë dy mijë viteve të fundit dhe do të vazhdojë të jetë e tillë derisa ai të kthehet. Mos, ndoshta, kjo nënkupton (1) se ai nuk do të vijë, apo (2) se DHR e ka gabim kur flet për kthimin e tij shpejt? Jezusi nuk e dinte kohën e kthimit të vet (shih Mat. 24:36). Kjo na habit, dhe është pjesë e misterit të mishërimit.

Kthimi i shpejtë i Jezusit duket se është pikëvështrimi i autorëve të DHR. Çfarë ka ndodhur? Së pari, le të mos harrojmë se koha është e rëndësishme vetëm për ata që jetojnë brenda saj. Perëndia nuk është i ngadaltë, madje Perëndia është mbi kohën. Afërsia e kthimit të Jezusit ka qenë inkurajim dhe motivues për jetesën e shenjtë

në çdo brez besimtarësh. Mirëpo, teologjikisht, 2 Thesalonikasve flet për një kthim të vonuar (pra, s' do të ndodhë para se "të zbulohet njeriu i paligjshmërisë"). Ardhja e Dytë është motiv i përsëritur, por është një realitet që do të ndodhë vetëm për një brez besimtarësh (shih 2 Pje. 3).

NASB "jini të përkorë në gjykim dhe të esëllt në frymë"

NKJV "jini seriozë dhe vigjilentë"

NRSV "jini seriozë dhe disiplinoni veten"

TEV "duhet të keni vetëkontroll dhe të jeni zgjuar"

NJB "prandaj, mbajeni mendjen të qetë dhe të kthjellët"

Ky është fillimi i një sërë urdhëroresh ose pjesoresh të përdorura si urdhërore, që theksojnë jetesën e perëndishme (shih 1 Pje. 4:6c). Këto dy terma nënkuptojnë vigjilencën mendore, sidomos në zonën e lutjes. Fjala e parë është *sōfroneō*. Ajo (dhe forma të ngjashme me të) nënkupton mendimin e qetë, të shëndoshë, të qëndrueshëm dhe energjik (përdoret shpesh në letrat pastorale të Palit; shih 1 Tim. 2:9, 15; 3:2; 2 Tim. 1:7; Titit 1:8; 2:2, 4, 5, 6, 12). Fjala e dytë është *nēfō* (dhe format e lidhura me të), që ka lidhje me dehjen, por përdoret figurshëm për mendimin logjik, të kontrolluar dhe të shëndoshë, ndoshta dhe vetëkontrollin (shih 1 Thes. 5:6, 8; 1 Tim. 3:11; Titit 2:2; dhe 1 Pje. 1:13; 5:8).

Megjithatë, vini re se Pjetri nuk përmend asnjë ngjarje të kohëve të fundit, që lidhet me kthimin e Krishtit. Ai përdor realitetin e kthimit të Krishtit për t'i nxitur besimtarët për jetesë të perëndishme. Këto të dyja janë urdhërore aoriste. Ndoshta, kjo lidhet me përjetimin e Pjetrit në Gjetseman (shih Mat. 26:40-41). Mundësia e atypëratyshme e Parousia-s është inkurajim i vërtetë për jetesën si Krishti në çdo epokë, sidomos në mes të përndjekjeve të forta.

■ **"me qëllim që të luteni"** Lutja është armë e fuqishme në kohë përndjekjeje dhe tundimesh (shih Efe. 6:18-19), jo vetëm për të mbrojtur veten, por edhe të tjerët (shih 1 Thes. 5:17, 25; Jakobi 5:16). Ndërsa 1 Pje. 4:3 përshkruan sjelljen e pahijshme të paganëve mosbesues, 1 Pje. 4:7-11 përshkruan sjelljen që duhet të kenë besimtarët.

4:8

NASB, NRSV,

NJB "Mbi të gjitha"

NKJV "Mbi të gjitha"

TEV "Mbi gjithçka"

Kjo është shprehje greqisht, që tregon përparësi (shih Jakobi 5:12). Përparësia është dashuria (shih 1 Pje. 1:22; 3:8; Gjoni 13:34; 15:12,17; 1 Kor. 13; 1 Gjonit 2:7-8; 3:11,23; 4:7-21).

■ **"qëndroni të zjarrtë në dashurinë"** Kjo është pjesore e tashme veprorë, e përdorur si urdhërore. Kjo kërkon dashuri të vazhdueshme për besimtarët e tjerë, gjë që është një motiv që 1 Pjetrit e ka prezantuar më herët (shih 1 Pje. 1:22; 3:8).

■ **"për njëri-tjetrin"** Vini re përdorimin e trefishtë të "njëri-tjetrit" (shih 1 Pje. 4:8, 9 dhe 10). Krishterimi është kolektiv. Ne i jepemi njëri-tjetrit (shih 1 Kor. 12:7).

■ **"dashuria mbulon një shumicë mëkatesh"** Ka disa teori për këtë frazë.

1. është citim nga DHV, nga Fja. 10:12 (nga teksti masoret, jo nga LXX), ku dashuria nuk kujton të këqijat që i bëhen
2. ka lidhje me Jakobin 5:20, ku dashuria ndihmon bashkëbesimtarin që t'i zbrapsë pasojat shpirtërore të shkarjes nga besimi
3. ka lidhje me Mat. 6:14-15 dhe Markun 11:25, ku falja e të tjerëve shërben si provë se ne vetë jemi të falur (Origeni dhe Tertuliani)
4. lidhet me 1 Kor. 13:7; aftësia e dashurisë që të mos shohë dobësitë e qarta të bashkëbesimtarëve të krishterëve nën përndjekje

4:9 “Jini mikpritës me njëri-tjetrin” Është fjalë e përbërë nga *fileo* (dua) dhe *ksenos* (i huaj). Kjo dashuri për të huajt ishte veçanërisht e nevojshme për të krishterët shëtitës, në një kohë kur hanet ishin vende të tmerrshme ligësie (shih Mat. 25:35; e më tej; Rom. 12:13; 1 Tim. 3:2; Titit 1:8; Heb. 13:2; 2 Gjonit 5-8). Teksti greqisht nuk përmban asnjë folje në këtë frazë. Për shkak të numrit të madh të urdhërore, edhe kjo është ndoshta një urdhër i vazhdueshëm.

▣ **“pa u ankuar”** Qëndrimi i besimtarëve është kyç. Besimtarët e kuptojnë se nuk janë pronare të asgjëje por janë kujdestarë të gjithçkaje. Ky qëndrim “me derën hapur” ishte i nevojshëm, jo vetëm për misionarët shëtitës, por edhe për besimtarët lokalë, të cilët humbnin punën ose shtëpinë për shkak të përndjekjeve. Ky urdhërim, ashtu si të tjerët, tregon natyrën kolektive të besimit të krishterë.

4:10 “Ashtu si secili ka marrë nga një dhunti të veçantë” Kjo është dëftore aoriste veprorë, që nënkupton një veprim të plotësuar në të shkuarën. Fjala dhuratë/dhunti (*kharisma*) vjen nga fjala rrënjë “hiri” (*kharis*). Këto dhunti janë të pamerituara, pra dhurata të pamerituara dashurie për hir të shërbesës. Çdo besimtar ka një dhunti shpirtërore, që ia ka dhënë Perëndia kur u shpëtua, me qëllim që të shërbejë në dhe për kishën (shih Rom. 12:6-8; 1 Kor. 12:7, 11, 18; Efe. 4:7). Këto dhunti mund të jenë talente të natyrshme, por nëse janë të tilla, marrin energji të mbinatyrshme për lavdi të Krishtit!

Aspekti praktik i kësaj të vërtete të DHR është se çdo besimtar është shërbëstar me kohë të plotë, i thirrur dhe i dhuntishëm i Krishtit (shih Efe. 4:12). Prandaj, çdo besimtar është kyç për veprimin e efektshëm të kishës lokale. Ky është korrigjimi biblik për modelin e klerit/laicitetit në kishë, që është kaq i përhapur në kishën moderne, por edhe kaq jofunksional. Bota nuk do të fitohet dhe dishepullizohet kurrë vetëm nga stafi i paguar, apo i shuguruar!

▣ **“për t’i shërbyer njëri-tjetrit”** Kjo është pjesore e tashme veprorë, e përdorur si urdhërore. Vjen nga fjala greke “shërbëtor” (*diakonos*). Më vonë, u bë titull për dhjakët (shih Fil. 1:1). Në krishterim, drejtuesit janë shërbëtorë, jo shefa. Dhuntitë shpirtërore janë për të tjerët, jo për veten (shih 1 Kor. 12:7). Dhuntitë shpirtërore nuk janë “medalje merite”, por “peshqirë shërbese”.

▣ **“si kujdestarë të mirë”** Fjalë për fjalë, “administratorë shtëpie”. Kisha është shtëpia e Perëndisë (shih 1 Pje. 4:17). Besimtarët do t’i japin llogari Perëndisë në Krishtin për kujdestarinë e dhuntive të tyre shpirtërore (shih 1 Kor. 3:10-17; 2 Kor. 5:10).

▣ **“hirit të shumëfishtë të Perëndisë”** Fjala “i shumëfishtë” shfaqet dy herë në 1 Pjetrit, me kuptimin “i larmishëm”, ashtu si drita kur kalon nëpër një prizëm. Ky pasazh drejtpeshon 1 Pje. 1:6. Për çdo sprovë (shih Jakobi 1:2) ka nga një hir të barazvlefshëm të Perëndisë, dhe Perëndia ka zgjedhur ta bëjë të disponueshëm nëpërmjet besimtarëve të tjerë. Asnjë besimtar nuk është ishull.

4:11 “Kushdo... kushdo” Këto janë dy fjali kushtore të rendit të parë. Shërbëtorët e dhuntishëm të Perëndisë duhet të flasin dhe të shërbejnë përmes fuqisë së tij. Nëse flasim, duhet të themi fjalët e tij. Nëse shërbejmë, duhet ta bëjmë me forcën e tij.

▣ **“që siguron Perëndia”** Kjo është dëftore e tashme veprorë e një fjale që përdoret për dikë që mbështeste financiarisht një “kor” (*koregeo*, që është fjalë e përbërë, *koros* dhe *hegeomai*). Perëndia vazhdon t’i furnizojë me bollëk të dhuntishmit e tij (shih 2 Kor. 9:10, e njëjta fjalë me parashtesën *epi* shfaqet në 2 Pje. 1:5, 11).

Është interesante se Pali duket se ia atribuon dhuntitë shpirtërore Frymës (shih Rom. 12), ose Krishtit (shih Efe. 4:11), kurse Pjetri ia atribuon Perëndisë Atë. Ky është një tjetër shembull se të tre personat e Trinitës janë të përfshirë në veprimtaritë e mbretërisë (shih 1 Kor. 12:4-6).

▣ **“në mënyrë që në të gjitha gjërat Perëndia të përlehtëpohet përmes Jezu Krishtit”** Kjo është fjali qëllimore (*hina*). Dhuntitë shpirtërore duhet të përlehtëpohet Perëndinë, jo vepruesin njerëzor. Dhuntishmëria jonë dëfton drejt tij (shih Mat. 5:16; 1 Kor. 10:31; 1 Pje. 2:12).

▣ **“të cilit i përket lavdia dhe pushteti në jetë të jetëve”** Kjo bën fjalë për Jezusin në këtë kontekst (shih 2 Tim. 4:18; 2 Pje. 3:18; Zbu. 1:6). Në Zbu. 5:13 përdoret edhe për Atin, edhe për Birin. Zakonisht, kjo fjalë përdoret për

Atin (shih 1 Pje. 5:11; Rom. 11:36; 16:27; Efe. 3:21; Fil. 4:20; 1 Tim. 1:17; 1 Pje. 5:11; Juda 25; Zbu. 7:12). Për shënimin për “lavdinë”, shih 1:21.

▣ Doksologjitë përdoren shpesh në DHR. Autorët e DHR, shpesh, shpërthejnë në lavdërim për Perëndinë (shih Rom. 11:33-36; Efe. 3:20-21; 1 Pje. 5:11).

▣ “Amen” Shih Temën e Veçantë: Amen, në Marku 3:28.

TEKSTI I NASB (I PËRDITËSUAR): 1 PJETRIT 4:12-19

¹²Të dashur, mos u habitni nga sprova e zjarrit ndër ju, që vjen mbi ju për t’ju provuar, sikur ju ka ndodhur diçka e çuditshme; ¹³por, për shkak se merrni pjesë në vuajtjet e Krishtit, vazhdoni të gëzoheni, në mënyrë që edhe në zbuluesën e lavdisë së tij të gëzoheni me ngazëllim. ¹⁴Nëse ju shajnë për emrin e Krishtit, jeni të bekuar, sepse Fryma i lavdisë dhe Perëndisë prehet mbi ju. ¹⁵Sigurohuni që askush prej jush të mos vuajë si vrasës, ose vjedhës, ose keqbërës, ose si njeri që përzihet në punën e tjetrit; ¹⁶por nëse dikush vuan si i krishterë, s’duhet të ketë turp, por duhet ta përlëvdojë Perëndinë në këtë emër. ¹⁷Sepse është koha që gjykimi të nisë nga shtëpia e Perëndisë; dhe, nëse fillon së pari nga ne, cili do të jetë rezultati për ata që nuk i binden ungjillit të Perëndisë? ¹⁸Dhe, nëse i drejti shpëtohet me vështirësi, çfarë do të bëhet me të paperëndishmin dhe mëkatarin? ¹⁹Prandaj, edhe ata që vuajnë sipas vullnetit të Perëndisë duhet t’ua besojnë shpirtin e tyre Krijuesit besnik duke bërë të drejtën.

4:12 “Të dashur” Kjo ishte mënyra sesi Ati fliste për të Birin (në pagëzimin e Jezusit, shih Mat. 3:17; citim nga Isa. 42:1; 12:18; në transformimin e Jezusit në mal, 17:5). Ky titull, më vonë, iu transferua ndjekësve të tij (shih 1 Pje. 2:11; 4:12; 2 Pje. 1:17; 3:1, 8, 15, 15, 17; dhe përdoret në mënyrë të përsëritur në shkrimet e Palit).

▣ “mos u habitni” Kjo është urdhërore e tashme pësore, me një pjesëz mohore, që zakonisht nënkupton ndalimin e një veprimi në kryerje e sipër. Këta besimtarë ishin të habitur nga përndjekjet.

▣ “nga sprova e zjarrit” Kjo është metaforë për sprovat dhe përndjekjet (jo për problemet e zakonshme të jetës së përditshme; shih 1 Pje. 4:14, 18; por për mënyrën sesi e përdorim jetën tonë kulturore si dëshmi). Ka shumë pasazhe biblike që thonë se përndjekja dhe vuajtja janë normale për ata që ndjekin Krishtin (shih Mat. 5:10-12; Gjoni 15:18-21; 16:1-3; 17:14; Veprat 14:22; Rom. 5:3-4; 8:17; 2 Kor. 4:16-18; 6:3-10; 11:23-30; Fil. 1:29; 1 Thess. 3:3; 2 Tim. 3:12; Jakobi 1:2-4; 1 Pje. 4:12-16). Këto janë mjeti i Atit për të prodhuar në ne ngjashmërinë me Krishtin (shih Heb. 5:8).

▣ “që vjen mbi ju” Kjo nuk është në kohën e ardhme, por është pjesore e tashme. Kjo gjë ishte një realitet i papritur dhe i tanishëm!

▣ “për t’ju provuar” Kjo është fjala greke *peirazo*; shih Temën e Veçantë në Marku 1:13, #2, c.

▣ “sikur ju ka ndodhur diçka e çuditshme” Kjo frazë ka një folje të përbërë (pjesore e tashme veprare) me parafjalën *sun*, që do të thotë “pjesëmarrje me”. Këta besimtarë po kalonin përndjekje. Ata duhet të dinin

1. se kjo nuk ishte e pazakontë për besimtarët
2. se nuk ishte rezultat i mëkatit (shih LiP. 27-28)
3. se ishte qëllimi i vullnetit të Perëndisë

TEMË E VEÇANTË: PSE VUAJNË TË KRISHTERËT? (SPECIAL TOPIC: WHY DO CHRISTIANS SUFFER?)

1. Për shkak të mëkatit personal (gjykimi i përkohshëm). Kjo nuk do të thotë se të gjitha problemet dhe rrethanat negative janë rezultat i mëkatit (shih Jobi; Psalmi 73; Luka 14:1-5; Nehemia 9; Gjoni 9; Veprat 5:1-11; 1 Kor. 11:29-30; Gal. 6:7).
2. Për të zhvilluar ngjashmërinë me Krishtin (Heb. 5:8). Edhe Jezusi, nga ana njerëzore, u desh të piquej; kjo vlen dhe për ndjekësit e tij (shih Rom. 5:3-4, 8:28-29; 2 Kor. 12:7-10; Fil. 3:10; Heb.

12:5-12; Jak. 1:2-4; 1 Pje. 1:7)

3. Për të zhvilluar një dëshmi të fuqishme dhe të efektshme (shih Mat. 5:10-12; Gjoni 15:18-22; 1 Pje. 2:18-21; 3:13-17).
4. Si shenjë e dhimbjeve të lindjes së Epokës së Re (shih Mat. 24:6; Marku 13:8).

Dy libra që më kanë ndihmuar të kuptoj padrejtësinë dhe ligësinë e kësaj bote të rënë janë: Hannah Whithall Smith, *The Christian's Secret of a Happy Life* dhe John W. Wenham, *The Goodness of God*.

Besimtarët duhet të mos harrojnë se problemet dhe vuajtjet nuk janë domosdoshmërisht shenjë e zemërimit apo kundërshtimit të Peërndisë. Edhe besimtarëve besnikë iu ndodhin gjëra të këqija në këtë botë të rënë (shih 1 Pje. 4:12-19). Premtimi i Perëndisë dhe vdekja vetëmohuese e Krishtit janë shenja të dashurisë së Perëndisë (shih Rom. 5:8). Shkrimi duhet të ketë përparësi ndaj rrethanave të përkohshme!

4:13 “merrni pjesë” Shih Temën e Veçantë më poshtë.

TEMË E VEÇANTË: KOINŌNIA (SPECIAL TOPIC: KOINŌNIA)

Termi “bashkësi” (*koinōnia*) do të thotë

1. shoqërim i ngushtë me një person
 - a. me Birin (shih 1 Gjoni 1:6; 1 Kor. 1:9)
 - b. me Frymën (shih 2 Kor. 13:14; Fil. 2:1)
 - c. me Atin dhe me Birin (shih 1 Gjoni 1:3)
 - d. me vëllezërit/motrat e tjerë të besëlidhjes (shih 1 Gjoni 1:7; Veprat 2:42; Gal. 2:9; Filemoni 17)
 - e. jo me ligësinë (shih 2 Kor. 6:14)
2. shoqërim i ngushtë me gjëra ose grupe
 - a. me ungjillin (shih Fil. 1:5; Filemoni 6)
 - b. me gjakun e Krishtit (shih 1 Kor. 10:16)
 - c. jo me errësirën (shih 2 Kor. 6:14)
 - d. e vuajtjet (shih Fil. 3:10; 4:14; 1 Pje. 4:13)
3. dhuratë ose kontribut, që jepet në mënyrë bujare (shih Rom. 12:13; 15:26; 2 Kor. 8:4; 9:13; Fil. 4:15; Heb. 13:16)
4. Dhurata e hirit të Perëndisë përmes Krishtit, e cila rimëkëmb bashkësinë e njerëzimit me të dhe me vëllezërit e motrat e tij

Kjo thekson marrëdhënien horizontale (njeri me njeri) që shkaktohet nga marrëdhënia vertikale (njeriu me Krijuesin). Ajo thekson dhe nevojën për komunitetin e krishterë, si dhe gëzimin e këtij komuniteti (shih Heb. 10:25)

■ **“vazhdoni të gëzoheni”** Kjo është urdhërore e tashme veprore. Është e mahnitshme sesi vuajtja për Krishtin lidhet me gëzimin. Kjo tregon botëkuptimin radikalisht të ri që besimtarët marrin me anë të besimit kur e vendosin besimin e tyre absolut në Krishtin. Vetë Jezusi e shprehu i pari këtë të vërtetë në Mat. 5:10-12. Pali shpreh të njëjtën të vërtetë në Rom. 5:2, 3.

■ **“në mënyrë që edhe në zbulesën e lavdisë së tij”** Bën fjalë për kthimin e lavdishëm të Krishtit për të marrë të vetët (shih Gjoni 14:1-3).

4:14 “Nëse” Kjo është fjali kushtore e rendit të parë, që merret si e vërtetë dhe e përmbushur sipas pikëvështrimit të autorit, ose për synimet e tij letrare.

■ **“shajnë”** Fjala “shaj” ose “fyej” vjen, po ashtu, nga Mat. 5:11. Pjetrit duhet t’i jetë kujtuar Jezusi kur foli pikërisht për këtë temë.

■ **“emrin e Krishtit”** “Në emër të...” është një shprehje e DHV që i referohet personit. Thirrja në emër të Zotit (shih Joeli 2:32; Veprat 2:21; shih Rom. 10:9-13) do të thotë t’i besosh Jezusit si Shpëtimtar. Lutja në emër të Zotit (shih Gjoni 14:13; 15:16; 16:23-24) do të thotë të lutesh në personin dhe karakterin e tij.

■ **“jeni të bekuar”** Kjo është fjala greke *makarios*, e përdorur nga Jezusi në Lumturitë (shih Mat. 5:3-9). Ky varg reflekton Mat. 5:10-12. E njëjta e vërtetë (dhe e njëjta fjalë) gjendet dhe në 1 Pje. 3:14. Materialistët perëndimorë habiten shumë nga fakti se vuajtja dhe përndjekja mund të sjellin gëzim dhe bekim.

■ **“Fryma i lavdisë dhe i Perëndisë prehet mbi ju”** Ky është aludim për (1) një përjetim të ngjashëm me pagëzimin e Krishtit (shih Mat. 3:16; Gjoni 1:32), ose (2) për mënyrën sesi Fryma e fuqizoi Mesinë (shih Isa. 11:2; 42:2; 59:21; 61:1). Përjetimi i vuajtjes së Jezusit, tani, është i yni (shih Rom. 8:17). Prania e Frymës nuk sjell shëndet, pasuri dhe prosperitet, por përndjekje (shih Gjoni 15:18; 17:14). Jezusi premtoi praninë e Frymës dhe ndihmë në kohë përndjekjeje (shih Mat. 10:16-23; sidomos 1 Pje. 4:20).

Ka disa variante (katër të tilla) të kësaj fraze në dorëshkrimet greqisht. UBS4 i jep të parit, që përdoret në NASB, vlerësimin “A” (i sigurt).

Tekstus Receptus shton një frazë në këtë pikë, që reflektohet në versionet KJV dhe NKJV: “Nga ta, ai blasfemohet, por nga ana juaj, ai përlëvdohet”. Kjo frazë shfaqet në forma të ndryshme vetëm në disa dorëshkrime të mëvonshme unciale (p.sh., K, nga shekulli i nëntë; L, nga shekulli i tetë; dhe P, nga shekulli i gjashtë), dhe ndoshta nuk shtë origjinale. UBS4 i jep mospërfshirjes së kësaj fraze vlerësimin “e sigurt”.

4:15 “askush prej jush të mos vuajë si vrasës” Kjo është urdhërore e tashme veprare me pjesëz mohore, që zakonisht nënkupton ndalimin e një veprimi në kryerje e sipër.

■ **“njeri që përzihet në punën e tjetrit”** Kjo fjalë përdoret vetëm këtu në gjithë literaturën greke. Përbëhet nga dy fjalë, “i përkas tjetrit” (*allogrios*), dhe “shqyrtoj”, ose “inspektoj”, (*epikospos*). Pra, bëhet fjalë për dikë që fut hundët në punët e të tjerëve.

4:16 “nëse” Kjo është një tjetër fjali kushtore e rendit të parë, që merret si e vërtetë. Të krishterët po vuajnë thjesht për shkak se janë të krishterë.

■ **“i krishterë”** Në fillim, ishte fjalë talljeje (shih Veprat 11:26; 26:28). Përdoret vetëm tri herë në DHR. Do të thotë “krisht i vogël/krishtuc” (pra, *Khristianos*). U bë përcaktimi kryesor për besimtarët nga mesi i shekullit të parë (shih Taciti, *Ann.* 15:44).

■ **“s’duhet të ketë turp”** Kjo është urdhërore e tashme pësore me pjesëz mohore që, zakonisht, nënkupton ndalimin e një veprimi në kryerje e sipër. Ndoshta, është kujtim i Pjetrit për gjyqet e Jezusit natën, kur Pjetri u turpërua (shih Mat. 26:69-75; Marku 14:66-72; Luka 22:56-62; Gjoji 18:16-18, 25-27).

4:17” Sepse është koha që gjykimi të nisë” Ndoshta, është aludim për Mal. 3:1-6, ku gjykimi fillon kur Mesia vjen papritur e papandehur te populli i vet (atij që i është dhënë shumë, shumë do t’i kërkohet, shih Jer. 25:29). Nëse ka mëkatarë qëllimisht të papandehur ndër popullin e Perëndisë (dhe patjetër që ka të tillë), ata do të gjykoen të parët. Shpresa e tyre e vetme është karakteri i pandryshueshëm i JHVH (shih Mal. 1:6).

Kjo frazë mund të jetë dhe shprehje judaike, që tregon faktin se Ardhja e Dytë e Krishtit si Gjykatës është afër. Judenjtë e DHV (dhe apostujt e DHR) parashikuan një përmbyllje katastrofike të historisë njerëzore, që shpeh quhet “dhimbjet e lindjes së epokës së re”, që u shpreh qartazi dhe nga vetë Jezusi në Marku 13:8.

■ **“shtëpia e Perëndisë”** Ka dy metafora ndërtimi që 1 Pjetrit i lidh me kishën: (1) kisha si tempull i ndërtuar nga gurë të gjallë (shih 1 Pje 2:4-10) dhe (2) kisha si shtëpia e Perëndisë (metaforë kolektive e popullit, ose e një shtëpie të madhe familjare, shih 1 Pje. 4:17; 1 Tim. 3:15; Heb. 3:6).

■ **“nëse”** Kjo është një tjetër fjali kushtore e rendit të parë, si dhe 1 Pje. 4:16 dhe 18.

4:18 “nëse i drejti shpëtohet me vështirësi” Ky është aludim me Fja. 11:31 në Septuagintë (“nëse i drejti mezi shpëtohet, ku do të përfundojë i pashenjtë dhe mëkatarin?”).

4:19 “ata që vuajnë sipas vullnetit të Perëndisë” Nëse, në këtë botë, ai që vuan është “i drejti” (fjalja kushtore e rendit të parë, 1 Pje. 4:18), çfarë do të ndodhë me të padrejtin në ditën e gjykimit të Perëndisë? Zoti është me të shpëtuarit (shih 1 Pje. 3:12, 14), por është kundër jobesimarit rebel dhe përndjekësit (shih 1 Pje. 3:12).

■ **“duhet t’ua besojnë shpirtin e tyre”** Kjo është urdhërore e tashme mesore, që nënkupton se ata vetë duhet të vazhdojnë t’ia besojnë veten Perëndisë. Pali ia besoi ungjillin Timoteut (shih 1 Tim. 1:18). Madje, Pali ua besoi ungjillin besimtarëve që t’ua transmetonin të tjerëve (shih 2 Tim. 2:2). Kjo është fjala nga banka; quhet “depozitë”. Jezusi e përdori këtë term në kohën e vdekjes së tij në kryq. Ai ia besoi shpirtin e vet Atit (shih Luka 23:46).

■ **“Krijuesit besnik”** Perëndia është besnik! Ky është pohimi bazë i Biblës (shih Num. 23:19; LiP. 7:9; Isa. 40:8; 49:7; 55:11; 1 Kor. 1:9; 10:23; 2 Kor. 1:18; 1 Thes. 5:24; 2 Thes. 3:3; 2 Tim. 2:13 dhe 1 Pje. 1:19). Shpresa e sigurt e çdo besimtari është pikërisht karakteri i pandryshueshëm i Perëndisë (shih Mal. 3:6). Perëndia do ta bëjë atë që ka premtuar!

■ **“duke bërë të drejtën”** Kjo fjalë greqisht do të thotë “bëj mirë”, ose “bëj gjënë e duhur”. Ky është motiv i përsëritur në 1 Pjetrit (shih 1 Pje. 2:14, 15, 20; 3:6, 17; 4:19). Kjo letër mbizotërohet nga këshilla për të jetuar drejt dhe për të qenë gati për të vuajtur. Shih Temën e Veçantë: Pse vuajnë të krishterët? Në 1 Pje. 4:14.

PYETJE PËR DISKUTIM

Ky është një komentuar studimor udhëzues, që do të thotë se ti je vetë përgjegjës për interpretimin e Biblës. Secili prej nesh duhet të ecë sipas dritës që ka. Ti, Bibla dhe Fryma e Shenjtë keni përparësi në interpretim. Nuk duhet t’ia dorëzosh këtë të drejtë komentuesit.

Këto pyetje për diskutim t’i kam dhënë për të të ndihmuar që të analizosh çështjet kryesore të kësaj pjese të librit. Ato synojnë të të nxisin mendimin, jo të kenë natyrë shteruese.

1. Rendit gjërat që duhet të bëjnë besimtarët për shkak të faktit se Ardhja e Dytë mund të ndodhë nga çasti në çast.
2. A prisnin shkruesit e DHR që ardhja e Zotit do të ndodhte shpejt, apo shumë më vonë?
3. Pse i mbulon dashuria mëkatet? Mëkatet e kujt?
4. A ka çdo i krishterë nga një dhunti? Nëse po, pse?
5. A është normale, apo anormale, përndjekja për besimtarët?
6. Cili është qëllimi i vuajtjeve dhe sprovave të pafajshme në jetën e besimtarëve?
7. Si duhet të reagojë i krishteri ndaj përndjekjes së pafajshme?
8. A do të gjykohen të krishterët? Si? Pse? Kur? Ku?

1 PJETRIT 5

NDARJET NË PARAGRAFË TË PËRKTHIMEVE MODERNE

UBS ⁴	NKJV	NRSV	TEV	NJB
Mësimi i tufës së Perëndisë	Kullotni tufën	Nxitje dhe përshëndetje përmbyllëse	Tufa e Perëndisë	Udhëzime: për pleqtë
5:1-4	5:1-4	5:1-5	5:1-4	5:1-4
	Nështroruni Perëndisë, kundërshtoni djallin			Udhëzime: për besimtarët
5:5	5:5-11		5:5-7	5:5-11
5:6-7		5:6-11		
5:8-11			5:8-11	
Përshëndetjet përmbyllëse	Lamtumirë dhe paqe		Përshëndetjet përmbyllëse	Fjalët e fundit; përshëndetjet
5:12-14	5:12-14	5:12-14a	5:12	5:12
			5:13-14a	5:13
		5:14b	5:14b	5:14

CIKLI TRE I LEXIMIT (shih f. v)

NDJEKJA E SYNIMIT TË AUTORIT FILLESTAR NË NIVELIN E PARAGRAFËVE

Ky është një komentar studimor udhëzues, që do të thotë se ti je vetë përgjegjës për interpretimin e Biblës. Secili prej nesh duhet të ecë sipas dritës që ka. Ti, Bibla dhe Fryma e Shenjtë keni përparësi në interpretim. Nuk duhet t'ia dorëzosh këtë të drejtë komentuesit.

Lexo gjithë kapitullin njëherësh. Identifiko temat. Krahaso ndarjet e tua tematike me pesë përkthimet moderne. Ndarja në paragrafë nuk është e frymëzuar, por është çelësi për të ndjekur synimin e autorit fillestar, gjë që është thelbi i interpretimit. Secili paragraf ka vetëm një temë të vetme.

1. Paragrafi i parë
2. Paragrafi i dytë
3. Paragrafi i tretë
4. Etj.

STUDIMI I FJALËVE DHE FRAZAVE

TEKSTI I NASB (I PËRDITËSUAR): 1 PJETRIT 5:1-5

¹Prandaj, unë nxis pleqtë ndër ju, si bashkëplak dhe dëshmitar i vuajtjeve të Krishtit, dhe gjithashtu si pjesëmarrës i lavdisë që do të zbulohet, ²kulloso tufën e Perëndisë ndër ju, duke e mbikëqyrur, jo me detyrim, por me dëshirë, sipas vullnetit të Perëndisë; dhe jo për fitim të ndyrë por me zell; ³dhe jo si zotërues mbi ata që ju janë caktuar si pjesë, por duke provuar se jeni shembuj për tufën. ⁴Dhe, kur të shfaqet Kryebariu, do të merrni kurorën e pavyshkur të lavdisë. ⁵Edhe ju, të rinjtë, nështroruni pleqve tuaj; dhe të gjithë ju vishuni me përlësi ndaj njëri-tjetrit, sepse Perëndia u kundërvihet krenarëve, por u jep hir të përlulurve.

5:1 “pleqtë... bashkëplak” Ka një lojë fjalësh me termin plak (*presbuteros*) në 1 Pje. 5:1 dhe 5. Kjo fjalë, me sa duket, përdorej si titull drejtues (shih 1 Pje. 5:1), por edhe për si përcaktim moshe (shih 1 Pje. 5:5). Përdorimi i kësaj fjale është i habitshëm, duke patur parasysh përcaktimin fisnor judaik të udhëheqjes, ndërsa “peshkop” ose “mbikëqyrës” (*episkopos*) ishin përcaktim udhëheqjeje që vinte nga qytet-shteti grek. 1 Pjetri përdor terma judaikë për t’iu drejtuar besimtarëve johebrenj.

Pjetri e quajti veten “bashkëplak”, fjala *presbuteros* plus parafjalën *sun*, që do të thotë “bashkëpjesëmarrës në”. Pjetri nuk i bën thirrje autoritetit të vet apostolik (shih 2 Gjonit 1, ku një tjetër apostull e quan veten “plak”), por këshillon (pra, “nxit”, dëftore e tashme veprore) drejtuesit lokalë që të veprojnë dhe të jetojnë si duhet në dritën e

1. shembullit të Krishtit
2. afërsisë së kthimit të tij

Kishat e hershme nuk kishin pozicione të paguara drejtuesish, por i njihnin dhuntitë e shërbesës dhe udhëheqjes brenda secilës kisha lokale. Kjo njohje e dhuntive duhej drejtpeshuar me nderimin kulturor të “urtësisë që vjen nga mosha”, sidomos ndër komunitetet me besimtarë judenj. Prandaj, Pjetri u drejtohet të dy llojeve të udhëheqjes.

Gjithashtu, vini re se “pleqtë” është shumës. Mund të bëjë fjalë (1) për një numër drejtuesish të kishave shtëpiake (shih Veprat 20:17), ose (2) për dhuntitë e ndryshme shpirtërore brenda një grupi drejtuesish (shih Efe. 4:11), që tregon qartë se shërbesa u përket gjithë besimtarëve. Kjo është paralele me konceptin e “një mbretërie priftërinjsh” (shih 1 Pje. 2:5, 9).

■ **“dëshmitar i vuajtjeve të Krishtit”** Kjo tregon se Pjetrit i kujtohet si dëshmitar okular jeta e Jezusit (shih Veprat 3:15; 10:39). Ndoshta, reflekton dhe çastin kur Pjetri kujton fjalët e Jezusit në Veprat 1:8. Fjala “vuajtje” bën fjalë për kryqëzimin. Pjetri e përdor shpesh fjalën “vuajtje” (shih 1 Pje. 1:11; 2:19,20,21,23; 3:14,17,18; 4:1[dy herë],13,15,19; 5:1,10). Ky diskutim për vuajtjet e Jezusit si shpengues dhe si shembull për t’u imituar nga besimtarët përbën një motiv kryesor në 1 Pjetrit.

■ **“gjithashtu si pjesëmarrës i lavdisë që do të zbulohet”** Kjo është jo vetëm një përmendje e Kthimit të Dytë (shih 1 Pje. 1:5, 7; 4:13; 5:4) por ndoshta dhe një kujtim okular i Shpërfytyrimit (shih Mat. 17; Marku 9:2-8; 2 Pje. 1:16-18). Shih Temën e Veçantë: Lavdi, në Marku 10:37.

5:2 “kullosni tufën e Perëndisë” Kjo është urdhërore aoriste veprore. “Kullosni” (pra, Bari) është metaforë nga DHV për Perëndinë (shih Psa. 23:1; 100:3). U bë titull për drejtuesit (shih Ezek. 34:7-10). Delet kanë nevojë vazhdimisht për përkujdesje, mbrojtje dhe vëmendje. Jezusi quhet “Bari i Mirë” në Gjoni 10 dhe i thotë Pjetrit të jetë pastor i deleve të tij në Gjoni 21.

Në DHR, ka disa tituj për drejtuesit e kishës lokale.

1. pleqtë
2. mbikëqyrësit ose peshkopët
3. barinj të ose pastorët

Këto duket se përdoren në mënyrë të përkëmbeshme (shih Veprat 20:17, 28 dhe Titit 1:5, 7).

NASB “duke e mbikëqyrur”

NKJV “duke shërbyer si mbikëqyrës”

NRSV “duke e ushtruar mbikëqyrjen”

TEV - nuk e ka -

NJB - nuk e ka -

Një sërë dorëshkrimesh të lashta greke (pra, P72, Sinaitikus (dora e dytë), A, P dhe Vulgata) përfshijnë formën foljore (pjesore e tashme veprore) të “mbikëqyrësit”, e përdorur në lidhje me punën e pleqve. Disa dorëshkrime të lashta nuk e përmbajnë pjesoren (pra, Sinaitikus (dora e parë), dhe B). Është e paqartë nëse kjo mospërmendje ishte e qëllimshme, ngaqë disa kopjues mund të mos jenë ndier rehat që t’i përzierin ofiqet ose rolet e plakut dhe mbikëqyrësit.

5:2-3 Kjo nis një seri (shih 1 Pje. 5:2-3) kualifikimesh kontrastuese për drejtuesit e kishës.

Pozitive

1. me dëshirë
2. me zell
3. si shembull

Negative

- jo me detyrim
- jo për fitim të ndyrë
- jo si zotërues

Nuk e dimë sesa e reflektojnë këto kontraste gjendjen reale të udhëheqësve të disa prej kishave shtëpiake në lidhje me mësuesit e rremë (shih 2 Pjetrit).

▣ **“sipas vullnetit të Perëndisë”** Kjo frazë është e pranishme në shumë dorëshkrime të lashta greke (pra, P72, Sinaitikus [dora e dytë], A dhe P), por mungon në dorëshkrimet B, K dhe L. Është e pranishme në shumicën e përkthimeve anglisht, por mungon në KJV. Pjetri e përdor shpesh këtë frazë në 1 Pjetrit (shih 1 Pje. 2:15; 3:17; 4:2, 3, 19). Prandaj, ka mundësi të ketë qenë origjinale.

▣ **“shembuj”** Shih Temën e Veçantë më poshtë.

5:4 “Kryebariu” Terminologjia e Pjetrit për Krishtin si Bari (shih 1 Pje. 2:25) mund të ketë ardhur nga biseda e tij me Zotin e ringjallur, që përmendet në Gjoni 21:15-17. Këtu, Pjetri e quan Krishtin me fjalën e përbërë *arkhi* dhe *poimen*, duke nënkuptuar bariun e lartë ose të parë (shih Gjoni 10:1-18). Në Heb. 13:20, Krishti përshkruhet si “Bariu i madh”. Të gjithë drejtuesit e tjerë (“pleqtë”, ose “mbikëqyrësit”) janë nënbarinj. Ka gjasa që Pjetri po aludon për Isa. 63:11, ku Moisiu quhet “bari”.

▣ **“shfaqet”** Kjo është një tjetër referencë e Ardhjes së Dytë (shih 1 Pje. 5:1; 1:5, 7; 4:13).

▣ **“kurorën e pavyshkur të lavdisë”** Në kontekst (shih 1 Pje. 5:1-5), bëhet fjalë për “nënbarinjët”. Pjetri e përzien metaforën atletike (shih 1 Kor. 9:23) me një metaforë lulësh. Kjo kurorë e pavyshkur lavdie mund të bëjë fjalë për trashëgiminë e besimtarit, të cilën ai ruan Perëndia (1 Pje. 1:4). Kjo është paralele me

1. “kurorën e drejtësisë” së Palit, në 2 Tim. 4:8
2. “kurora e jetës” e Jakobit në Jakobi 1:12
3. “kurora e jetës” e Jezusit, në Zbu. 2:10; 3:11

Ajo është simbol i fitores së besimtarit në betejën kundër mëkatit, vetes, si dhe simbol i vuajtjes besnik dhe të durueshme të besimtarit për hir të Krishtit.

5:5 “ju, të rinjtë” Në shoqërinë judaike, mashkulli konsiderohej i ri deri në 40 vjeç. Brenda komunitetit besimtar nuk duhet të kishte dallim moshe, ose luftë mes moshave, por respekt reciprok (pra, “në mënyrë të ngjashme” e 1 Pje. 5:5).

▣ **“nënshtrijuni pleqve tuaj”** Kjo është urdhërore aoriste pësore, që përshkruan një mënyrë të qëndrueshme jetese. Konteksti nënkupton se “pleqtë” e 1 Pje. 5:1 janë të njëjtë me “pleqtë” e 1 Pje. 5:5. Megjithatë, fjala “të rinjtë” ndoshta reflekton një dallim moshe (shih 1 Tim. 5:1, që i referohet një personi më të vjetër, ndërsa 1 Tim. 5:17 i referohet një drejtuesi kisha). Shih Temën e Veçantë: Nënshtrimi, në 1 Pje. 2:13.

▣ **“dhe të gjithë ju”** Pjetri po kalon nga këshillat për drejtuesit e kishës dhe burrave të tjerë të bashkësisë tek gjithë anëtarët e kishës (shih Efe. 5:21). Është kyçe që besimtarët ta kuptojnë përgjegjësinë e tyre personale për paqe dhe unitet në bashkësi (shih Efe. 4:2-3).

▣ **“vishuni”** Kjo është urdhërore aoriste mesore. Veshja dhe zheshja e rrobave është shprehje biblike për stilin etik të jetesës së besimtarëve (shih Jobi 29:14; Psa. 109:29; Isa. 61:10; Efe. 4:22, 24, 25, 31). Ata duhet të veshin tiparet e Perëndisë dhe të zhvishen nga fryma konkurruese.

Fjala greke “vesh” është fjalë për fjalë “ngjish”. Ka gjasa që Pjetri po reflekton për veprimet e Jezusit në dhomën e sipërme, e shkruar në Gjoni 13:2-11 (Jezusi ngjishet me përparësen e skllavit dhe u lan këmbët dishepujve). Pjetri e kishte parë me sy përlulësinë e vërtetë dhe, tani, u bën thirrje besimtarëve që të imitojnë Krishtin (shih Fil. 2:8; Jakobi 4:10).

▣ **“përlulësi”** Kjo është fjalë e përbërë nga “përlulësia” dhe “mendja”. Shih shënimin në 1 Pje. 3:8.

▣ **“ndaj njëri-tjetrit”** Këtu theksohet komuniteti (shih 1 Pje. 3:9; Efe. 5:21). Besimtarët jepen (dhe marrin) dhunti, shih 1 Kor. 12:7) për njëri-tjetrin. Ne qëndrojmë, ose rrëzohemi, së bashku!

■ **“sepse Perëndia u kundërvihet krenarëve, por u jep hir të përlururve”** Ky është citim nga Fja. 3:34 (shih Jakobi 4:6). Fjala “hir” përdoret në kuptimin e DHV si “pëlqim”.

TEKSTI I NASB (I PËRDITËSUAR): 1 PJETRIT 5:6-11

⁶Prandaj përujeni veten nën dorën e fuqishme të Perëndisë, që ai t’ju lartësojë në kohën e duhur, ⁷duke e hedhur gjithë ankthin tuaj mbi të, sepse ai kujdeset për ju. ⁸Jini të kthjellët në frymë, jini vigjilentë. Armiku juaj, djalli, sillet vërdallë si luan që vrumbullon, duke kërkuar dikë që ta përpijë. ⁹Por kundërvihuni atij, të patundur në besim, duke ditur se të njëjtat përjetime vuajtjeje po i kalojnë dhe vëllezërit tuaj në botë. ¹⁰Pasi të keni vuajtur për njëfarë kohe, Perëndia i gjithë hirit, i cili ju thirri në lavdinë e tij të përjetshme në Krishtin, vetë ai do t’ju përsosë, miratojë, forcojë dhe do t’ju themelojë. ¹¹Atij i goftë pushteti në jetë të jetëve. Amen.

5:6 “përujeni veten” Kjo është urdhërore aoriste pësore. Kjo është karakteristikë e Jezusit (shih Mat. 11:29), që bëhet standard për ndjekësit e tij (shih Jakobi 4:10).

■ **“që ai t’ju lartësojë”** Kjo reflekton fjalët e Jezusit në Mat. 23:12 dhe këshillën e Jakobit në Jakobi 4:6. JHVH përshtet vazhdimisht si kunërshtues i krenarëve dhe lartësues i të përlururve (shih Jobi 5:11; Psa. 138:6; Fja. 3:34; Ezek. 17:24; 21:26).

NASB “në kohën e duhur”
NKJV, NRSV,
NJB “në kohën e duhur”
TEV “në kohën e tij”

Në kontekst, kjo u shërben dy qëllimeve teologjike: (1) në këtë çast, këta lexues po përndiqen, nuk po lartësohen, dhe (2) koha e lartësimit është në Ardhjen e Dytë. Vigjilenca, përlësia dhe mungesa e ankthit janë kyçe në mes të përndjekjes së frymëzuar nga Satani.

5:7 “duke hedhur gjithë ankthin tuaj mbi të” Kjo është pjesore aoriste veprorë, e përdorur si urdhërore, dhe mund të jetë aludim për Psa. 55:22 në Septuagintë. Kjo shprehje do të thotë që njeriu duhet t’i vendosë mendërisht shqetësimet e veta mbi Krishtin (shih Mat. 6:25). Ai i mbart për ne ato shqetësime edhe në mes të përndjekjeve dhe vuajtjes. Ai mbart mëkatën tonë dhe, tani mbart shqetësimin dhe frikën tonë!

Besimtarët mund ta bëjnë këtë për shkak se e dinë që ai do t’ia dijë për ta. Këtë e dimë nga:

1. vdekja e tij (shih 1 Pje. 2:22-24; 3:18)
2. ndërhyrja e tij (shih 1 Gjonit 2:1-2)
3. baritimi i tij (shih 1 Pje. 2:25; 5:4)

5:8 “Jini të kthjellët në frymë, jini vigjilentë” Këto janë urdhërore aoriste veprorë. Besimtarët duhet të bëjnë një zgjedhje vendimtare për të qenë vigjilentë nga ana mendore (shih Mat. 24:42; 25:13; 26:41; Marku 13:35,37; 14:38; Veprat 20:31; 1 Kor. 16:13; Col. 4:2; 1 Thes. 5:6,10; Zbu. 3:2-3; 16:15). Pjetri i ka theksuar këto (p.sh., i kthjellët dhe vigjilent) që më parë (shih 1 Pje. 1:13; 4:7). Vigjilenca dhe mendimi i duhur mund ta mposhtin ankthin dhe tundimin.

■ **“Armiku juaj, djalli”** Fjala “armiku” reflekton titullin hebraisht të Satanit (i përdorur 36 herë në DHR), që do të thotë “kundërshtar”. Titulli “djall” (i përdorur 37 herë në DHR) është fjalë e përbërë greke, “hedh nga ana tjetër”, që do të thotë “hedh shpifje”. Shih Temën e Veçantë më poshtë.

TEMË E VEÇANTË: LIGËSIA SI PERSON (SPECIAL TOPIC: PERSONAL EVIL)

I. SATANI ËSHTË TEMË SHUMË E VËSHTIRË

Kjo është një temë shumë e vështirë për një sërë arsyesh.

- A. DhV nuk zbulon një kryearmik ndaj së vërtetës, por një shërbëtor të JHVH-së, i cili i ofron njerëzimit një alternativë dhe e akuzon njerëzimin për padrejtësi (A. B. Davidson, *Old*

Testament Theology, f. 300-306).

- B. Koncepti i një kryearmiku personal të Perëndisë u zhvillua në literaturën ndërthjatore (jokanonike) nga ndikimi i fesë persiane (*zoroasrianizmi*). Nga ana e vet, ajo ndikoi së tepërmi në judaizmin rabinik (pra, gjatë mërgimit të Izraelit në Babiloni dhe Persi).
- C. DhR i zhvillon temat e DhV nëpërmjet kategorive çuditërisht të prera, por dhe të përzgjedhura.

Nëse studimin e ligësisë e shohim nga pikëvështrimi i teologjisë biblike (ku secili libër, ose autor, ose gjini letrare, studiohet dhe përvijohet veçmas), atëherë zbulohen pikëpamje shumë të ndryshme për ligësinë.

Nga ana tjetër, nëse ligësinë e studiojmë nga një qasje jobiblike ose jashtëbiblike e feve botërore ose e feve lindore, atëherë një pjesë e mirë e zhvillimit të DhR gjen pararendës në dualizmin persian dhe në spiritizmin greko-romak.

Nëse je i përkushtuar në mënyrë paraprake ndaj autoritetit hyjnor të Shkrimit (si unë!), atëherë zhvillimi në DhR duhet parë si zbuluesë e përshkallëzuar. Të krishterët duhet të ruhen që të mos lejojnë idetë popullore judaike apo letërsinë evropiane (p.sh., Danten dhe Miltonin) që të qartësojnë më tej këtë koncept. Pa dyshim që ka mister dhe vagulli në këtë zonë të zbuluesës. Perëndia ka zgjedhur të mos na zbulojë të gjitha aspektet e ligësisë, origjinën (Shih Temën e Veçantë: Luciferi) dhe synimin e saj, por na ka zbuluar mposhtjen e saj!

II. SATANI NË DHIATËN E VJETËR

Në DhV, termi Satan (BDB 966, KB 1317), ose “akuzues”, duket se përdoret për tre grupe të ndryshme.

- A. akuzues njerëzorë (1 Sam. 29:4; 2 Sam. 19:22; 1 Mbret. 11:14,23,25; Ps. 109:6)
- B. akuzues engjëj (Num. 22:22-23; Zak. 3:1)
 - 1. Engjëlli i Zotit – Num. 22:22-23
 - 2. Satani – 1 Kro. 21:1; Jobi 1-2; Zak. 3:1
- C. akuzues demonë (ndoshta, Satani) (1 Kro. 21:1; Zak. 13:2)

Vetëm më vonë, në periudhën ndërthjatore, identifikohet me Satanin gjarpri i Zanafillës 3 (shih Libri i Urtësisë 2:23-24; 2 Enokut 31:3); madje, kalon edhe më shumë kohë para se ky të bëhet mendim rabinik (shih *Sot* 9b dhe *Sanh.* 29a). “Bijtë e Perëndisë” në Zanafilla 6 bëhen engjëjt e ligj në 1 Enokut 54:6. Ata bëhen fillesa e ligësisë në teologjinë rabinike. Këtë po e përmend, jo për të pohuar saktësinë e saj teologjike, por për të treguar zhvillimin e saj. Në DhR, këto veprimtari të DhV i atribuohen ligësisë së personifikuar engjëllorë (pra, Satanit) në 2 Kor. 11:3; Zbu. 12:9.

Origjina e ligësisë së personifikuar është e vështirë ose e pamundur (në varësi të pikëvështrimit) të përcaktohet nga DhV. Një arsye për këtë është monoteizmi i fortë i Izraelit (shih LiP. 6:4-6; 1 Mbret. 22:20-22; Pred. 7:14; Isa. 45:7; Amosi 3:6). Çdo shkakësi i atribuohet JHVH-së për të demonstruar natyrën unike dhe epërsinë e tij (shih Isa. 43:11; 44:6, 8, 24; 45:5-6, 14, 18, 21, 22).

Burime të mundshme informacioni janë (1) Jobi 1-2, ku Satani është një nga “bjtë e Perëndisë” (pra, engjëjt), ose (2) Isaia 14; Ezekieli 28, ku mbretërit krenarë të lindjes së afërt (Babilonisë dhe Tirit) përdoren për të ilustruar krenarinë e Satanit (shih 1 Tim. 3:6). Unë s’jam shumë i bindur për këtë qasje. Ezekieli përdor metafora të kopshtit të Edenit, jo vetëm për mbretin e Tirit si Satan (shih Ezek. 28:12-16), por edhe për mbretin e Egjiptit si Pema e Njohjes së të Mirës dhe të Keqes (Ezekieli 31). Nga ana tjetër, Isaia 14, sidomos v. 12-14, duket se përshkruan një rebelim engjëllor për shkak të krenarisë. Nëse Perëndia ka dashur të na zbulojë natyrën dhe origjinën e saktë të Satanit, kjo është një mënyrë dhe vend tejet i paqartë për këtë synim (shih Temën e Veçantë: Luciferi). Duhet t’i ruhemi prirjes së teologjisë sistematike që të marrë pjesë të vogla dhe të vagullta nga dhiata, autorë, libra dhe gjini të ndryshme e t’i kombinojë si copëza të një enigme hyjnore.

III. SATANI NË DHIATËN E RE

Alfred Edersheim (*The Life and Times of Jesus the Messiah [Jeta dhe kohët e Jezus Mesisë]*, vëll. 2, shtojcat XIII [f. 748-763] dhe XVI [f. 770-776]) thotë se judaizmi rabinik është ndikuar së tepërmi nga dualizmi dhe hamendësimi demoniak pers. Rabinët nuk janë burim i mirë për të vërtetën në këtë pikë. Jezusi ndryshon tërësisht nga mësimet e sinagogës. Unë mendoj se koncepti rabinik për ndërmytesimin (shih Veprat 7:53) dhe kundërshtimin engjëllor në dhënien e ligjit që iu bë Moisiut në malin Sinai i hapi derën konceptit të armikut kryeengjëllor të JHVH-së dhe njerëzimit. Në dualizmin persian (zoroastrian) ka dy perëndi të larta:

- 1. *Ahura Mazda*, më vonë i quajtur *Ohrmazd*, i cili ishte perëndia krijues, perëndia e mirë
- 2. *Angra Mainju*, më vonë i quajtur *Ahriman*, perëndia shkatërrues, perëndia e lig.

Ata luftojnë për epërsi, ku toka është fushëbeteja. Ky dualizëm u zhvillua në judaizëm në një dualizëm të kufizuar mes JHVH-së dhe Satanit.

Pa dyshim, në DhR shohim përparimin e zbulësës në lidhje me zhvillimin e konceptit të ligësisë, por jo aq me hollësi sa ç' shpallin rabinët. Një shembull i mirë i këtij dallimi është "lufta në qiell". Rënia e Satanit është domosdoshmëri logjike, por detajet nuk jepen (shih Temën e Veçantë: Rënia e Satanit dhe engjëjve të tij). Edhe ajo që jepet mbulohet me gjininë apokaliptike (shih Zbu. 12:4, 7, 12-13). Ndonëse Satani është mposhtur dhe është dëbuar në tokë, ai ende funksionon si shërbyes i JHVH-së (shih Mat. 4:1; Luka 22:31-32; 1 Kor. 5:5; 1 Tim. 1:20).

Duhet t'i vëmë fre kureshtjes në këtë pikë. Ekziston një forcë personale tundimi dhe ligësie, por gjithsesi ekziston vetëm një Perëndi dhe njerëzimi është përgjegjës për veprimet e veta. Ekziston një betejë shpirtërore, si përpara ashtu dhe pas shpëtimit. Fitorja mund të vijë dhe të qëndrojë vetëm në Perëndinë Triun dhe përmes tij. Ligësia është mposhtur dhe do të asgjësohet (shih Zbu. 20:10)!

■ **“sillet vërdallë si luan që vrumbullon”** Kjo metaforë që e krahason Satanin me një kafshë vjen nga DHV.

1. simbol i një armiku të fuqishëm (shih Psa. 7:2; 10:2; 17:12; 22:13,21; 2 Tim. 4:17).
2. një nga mënyrat e Perëndisë për të gjykuar popullin e vet (shih 2 Mbre. 17:25; Isa. 15:9; Jer. 50:17)

■ **“duke kërkuar dikë që ta përpijë”** Zbulohet synimi përfundimtar i Satanit: shkatërrim dhe vdekje. Ai është armiku i gjithçkaje të mirë, të perëndishme dhe të vërtetë.

5:9 “kundërvihuni atij” Kjo është një tjetër urdhërore aoriste veprare. Në Jezusin, besimtarët kanë fuqinë që t'i kundërvihen ligësisë dhe të ligut! Në Jakobi 4:7, e njëjta këshillë lidhet me Satanin që largohet me vrap, por këtu lidhet me vuajtjen dhe përndjekjen e vazhdueshme. Fitorja mbi djallin nuk nënkupton mungesën e vuajtjes!

■ **“të patundur në besim”** Besimtarët duhet të vazhdojnë në besim (shih Kol. 2:5). Begatia dhe shëndeti nuk janë gjithmonë shenja të bekimeve të Perëndisë (shih Jobi; Psa. 73). Besimtarët duhet ta ushtrojnë besimin në çdo lloj rrethane. Vazhdimësia është kyçe (shih Veprat 14:22; Rom. 8:17).

TEMË E VEÇANTË: QËNDRESA (SPECIAL TOPIC: PERSEVERANCE)

Doktrinat biblike që lidhen me jetën e krishterë janë të vështira të shpjegohen, pasi paraqiten në dyshe dialektike, që janë tipike për botën lindore (Shih Temën e Veçantë: Literatura Lindore [paradokset biblike]). Këto dyshe duken kontradiktore, por janë të dyja biblike. Të krishterët perëndimorë janë prirur që të zgjedhin njëren të vërtetë dhe të anashkalojnë ose zhvlerësojnë të vërtetën e kundërt. Disa Shembu.

- A. A është besimi një vendim fillestar për të besuar në Krishtin, apo një përkushtim dishepullizimi gjithë jetën?
- B. A është shpëtimi një zgjedhje që bën Perëndia sovran me anë të hirit, apo është një përgjigje e njerëzimit me besim dhe me pendim ndaj ofertës hyjnore?
- C. Pasi merret shpëtimi, a është i pamundur të humbet, apo ekziston nevoja për zell të vazhdueshëm? Çështja e qëndresës ka qenë polemike gjatë gjithë historisë së kishës. Problemi fillon me disa pasazhe në DhR që duket sikur janë në kundërshti me njëra-tjetrën:
 1. pasazhet për sigurinë e shpëtimit
 - a. thëniet e Jezusit në ungjillin e Gjonit (Gjoni 6:37; 10:28-29)
 - b. thëniet e Palit (Rom. 8:35-39; Efe. 1:13; 2:5,8-9; Fil. 1:6; 2:13; 2 Thes. 3:3; 2 Tim. 1:12; 4:18)
 - c. thëniet e Pjetrit (1 Pjet. 1:4-5)
 2. pasazhet për nevojën për qëndresë
 - a. thëniet e Jezusit në ungjijtë sinoptikë (Mat. 10:22; 13:1-9,24-30; 24:13; Marku 13:13)
 - b. thëniet e Jezusit në ungjillin e Gjonit (Gjoni 8:31; 15:4-10)
 - c. thëniet e Palit (Rom. 11:22; 1 Kor. 15:2; 2 Kor. 13:5; Gal. 1:6; 3:4; 5:4; 6:9; Fil. 2:12; 3:18-20; Kol. 1:23; 2 Tim. 3:2)
 - d. thëniet e autorit të Hebrenjve (2:1; 3:6, 14; 4:14; 6:11)
 - e. thëniet e Gjonit (1 Gjoni 2:6; 2 Gjoni 9; Zbu. 2:7, 17, 26; 3:5, 12, 21; 21:7)

Shpëtimi biblik rrjedh nga dashuria, mëshira dhe hiri i Perëndisë Triun dhe sovran. Asnjë njeri nuk

mund të shpëtohet pa nismën e Frymës (shih Gjoni 6:44, 65). Perëndia vjen në fillim dhe përcakton rendin, por kërkon që njerëzit të përgjigjen me besim dhe pendim, si në fillim, ashtu dhe në vazhdim. Perëndia punon me njerëzimin në një marrëdhënie besëlidhjeje. Ka edhe privilegje, edhe përgjegjësi!

Shpëtimi u ofrohet gjithë njerëzve. Vdekja e Jezusit i dha fund problemit të mëkatit në krijimin e rënë. Perëndia ka siguruar një rrugë dhe kërkon që gjithë ata që janë krijuar në shëmbëllimin e tij t'i përgjigjen dashurisë dhe asaj që na ka siguruar ai në Jezusin.

Nëse dëshiron të lexosh më tepër për këtë temë nga një pikëvështrim jokalvinist, shih

1. Dale Moody, *The Word of Truth [Fjala e së vërtetës]*, Eerdmans, 1981 (f. 348-365)
2. Howard Marshall, *Kept by the Power of God [I ruajtur me anë të fuqisë së Perëndisë]*, Bethany Fellowship, 1969
3. Robert Shank, *Life in the Son [Jeta në Birin]*, Westcott, 1961

Bibla trajton dy probleme të ndryshme në këtë pikë: (1) të mos e marrim sigurinë e shpëtimit si leje për të bërë jetë të pafrytshme dhe egoiste; dhe (2) të inkurajojë ata që kanë vështirësi në shërbesë apo me mëkatit personal. Problemi është se grupet e gabuara po marrin mesazhin e gabuar dhe po ndërtojnë sisteme teologjike mbi pasazhe të kufizuara biblike. Disa të krishterë kanë nevojë të dëshpëruar për mesazhin e sigurisë së shpëtimit, ndërsa disa të tjerë kanë nevojë për paralajmërime të rrepta! Në cilin grup bën pjesë ti?

Ekziston një polemikë teologjike historike mes Augustinit dhe Pelagiusit dhe mes Kalvinit dhe Arminiusit (semi-pelagian). Çështja ka të bëjë me shpëtimin: nëse njeriu është i shpëtuar vërtet, a duhet të tregojë qëndrueshmëri në besim dhe frytshmëri?

Kalvinistët bazohen te ato pasazhe biblike që pohojnë sovranitetin e Perëndisë dhe fuqinë e tij për ta ruajtur besimtarin (Gjoni 10:27-30; Rom. 8:31-39; 1 Gjonit 5:13, 18; 1 Pje. 1:3-5), si dhe në KOHËT E FOLJEVE si Pjesoret e Kryera Pësore të Efe. 2:5, 8.

Arminianët bazohen në ato pasazhe biblike që i paralajmërojnë besimtarët të “mbahen fort”, “të qëndrojnë”, ose “të vazhdojnë (Mat. 10:22; 24:9-13; Marku 13:13; Gjoni 15:4-6; 1 Kor. 15:2; Gal. 6:9; Zbu. 2:7,11,17,26; 3:5,12,21; 21:7). Unë vetë nuk besoj se Hebrenjve 6 dhe 10 vlejnë në këtë debat, por shumë arminianë i përdorin si paralajmërim kundër femohimit. Shëmbëlltyra e Mbjellësit në Mateu 13 dhe Marku 4 trajton çështjen e besimit në dukje, si dhe Gjoni 8:31-59. Ndërsa kalvinistët citojnë FOLJET E KRYERA që përdoren për të përshkruar shpëtimin, arminianët citojnë pasazhet në KOHËN E TASHME si 1 Kor. 1:18; 15:2; 2 Kor. 2:15.

Ky është shembull i përsosur për të treguar sesi sistemet teologjike abuzojnë me metodën e interpretimit që bazohet te “pasazhet-provë”. Zakonisht, ata përdorin një parim kryesor, ose një pasazh kryesor, për të ndërtuar një kornizë teologjike nëpërmjet së cilës shihen të gjitha pasazhet e tjera. Ruhuni nga kornizat që vijnë nga çdo lloj burimi. Ato vijnë nga logjika perëndimore, jo nga zbulesa. Bibla është libër lindor. Ajo e paraqet të vërtetën në grupe dyshe të mbushura me tension dhe, në dukje, paradoksale. Të krishterët duhet t'i pranojnë të dyja dhe të jetojnë brenda tensionit. DHR paraqet, edhe sigurinë e besimtarit, edhe kërkesën për besim dhe perëndishmëri të vazhdueshme. Krishterimi është një përgjigje fillestare e pendimit dhe besimit, e ndjekur nga një përgjigje e vazhdueshme besimi dhe pendimi. Shpëtimi nuk është produkt (biletë për në qiell, apo siguracion kundër zjarrit), por është marrëdhënie. Është vendim dhe dishepullizim. Ai përshkruhet në DHR në të gjitha KOHËT E FOLJES:

- (1) AORISTE (veprim i kryer): Veprat 15:11; Rom. 8:24; 2 Tim. 1:9; Titi 3:5
- (2) E KRYER (veprim i kryer me rezultate të vazhduara): Efe. 2:5, 8
- (3) E TASHME (veprim i vazhduar): 1 Kor. 1:18; 15:2; 2 Kor. 2:15
- (4) E ARDHME (ngjarje të ardhme, ose ngjarje të sigurta); Rom. 5:8,10; 10:9; 1 Kor. 3:15; Fil. 1:28; 1 Thes. 5:8-9; Heb. 1:14; 9:28

■ **“duke ditur se të njëjtat përjetime vuajtjeje po i kalojnë dhe vëllezërit tuaj në botë”** Pjetri përdor përvojën e përbashkët të besimtarëve të shpërndarë në mbarë perandorinë romake si inkurajim për këta besimtarë të përndjekur. Përvoja e tyre nuk është e pazakontë, por normative.

5:10 “Pasi të keni vuajtur për njëfarë kohe” Kjo bën fjalë për këtë jetë (shih 1 Pje. 1:6).

■ **“Perëndia i gjithë hirit”** Shpresa e gjithë besimtarëve është karakteri i qëndrueshëm dhe i pandryshueshëm i Perëndisë së dashur, të hirshëm dhe të mëshirshëm. Ndonëse jetojmë në një botë të rënë, plot me ligësi dhe rebelim, kur besojmë në Perëndinë asgjë nuk mund të na ndajë prej tij (shih Rom. 8:31-39).

NIDOTTE, vëll. 2, f. 78-79, përmban një listë të shkëlqyer të frazës gjinore që përdorej për të përshkruar Perëndinë.

1. Perëndia i paqes – Rom. 15:33; 16:20; 1 Kor. 14:33; 1 Thes. 5:23; Fil. 4:9; Heb. 13:20
2. Perëndia i mëshirës – Luka 1:78
3. Perëndia i çdo ngushëllimi – Rom. 12:1; 2 Kor. 1:3
4. Perëndia i çdo hiri – 1 Pje. 5:10, 12
5. Perëndia i dashurisë – 2 Kor. 13:11
6. Jo Perëndi ngushëllimi – 1 Kor. 14:33

■ **“i cili ju thirri në lavdinë e tij të përjetshme në Krishtin”** Ky është një tjetër theksim i identifikimit tonë me Krishtin. Tani, ne identifikohemi me të në vdekjen e tij (shih Rom. 6:4) dhe në vuajtjen e tij (shih Rom. 8:17), por edhe në ringjalljen dhe lavdinë e tij (shih 2 Kor. 4:17; 2 Tim. 2:10). Kjo lavdi e përjetshme do të përjetohet vetëm pas vdekjes fizike, ose në Ardhjen e Dytë!

■ **“vetë ai do t’ju përsosë, miratojë, forcojë dhe do t’ju themelojë”** Synimi i Perëndisë për gjithë besimtarët është ngjashmëria me Krishtin përmes vuajtjeve dhe vështirësive (shih 1 Pje. 4:13; Rom. 8:17; 2 Kor. 1:5,7; Fil. 3:19; 2 Tim. 2:12; Heb. 2:10; 5:8). Mirëpo është ai vetë që na siguron gjithçka të nevojshme. Sërish, këtu shohim konceptin paradoksal të besëlidhjes. Perëndia bën pjesën e vet, por edhe ne duhet të bëjmë tonën!

5:11 “Atij i qoftë pushteti në jetë të jetëve” Kjo rishpreh 4:11, por këtu nuk na jepet asnjë folje. Shumë nga tematikat e 1 Pjetrit (si te 1 Gjoni) janë si motive në tapiceri, ose melodi në muzikë, që përsëriten me njëfarë variacioni. Perëndia është në kontroll të gjithçkaje (shih Rom. 11:36).

TEKSTI I NASB (I PËRDITËSUAR): 1 PJETRIT 5:12-14a

¹²Përmes Silvanit, vëllait tonë besnik (sepse të tillë e konsideroj), ju kam shkruar shkurtimisht, duke ju nxitur dhe dëshmuar se ky është hiri i vërtetë i Perëndisë. Qëndroni të patundur në të! ¹³Ajo që është në Babiloni, e zgjedhur së bashku me ju, ju dërgon përshëndetje, si dhe biri im, Marku. ¹⁴Përsëndeteni njëri-tjetrin me një puthje dashurie.

5:12 “Përmes Silvanit” Ky është Sila i Veprave 15:40. Bashkë me Gjon Markun, Sila ishte burimi prej ku Pjetri huazoi nga teologjia dhe shkrimet e Palit. Shkrimet e Pjetrit ngjasojnë në shumë mënyra me ato të Palit. Ka patur shumë hmondësime në lidhje me marrëdhënien e kësaj fraze me autorësinë e 1 Pjetrit. Unë mendoj se nuk ka dyshim që Pjetri përdori një letërshtues, por a ishte ky Silvani? Një artikull interesant në *Journal of the Evangelical Theological Society*, vëll. 43, nr. 3, f. 417-432, me titull: “Silvanus Was Not Peter’s Secretary”, i E. Randolph Richards, më ka bindur se kjo frazë ndoshta nënkupton se Silvani ua çoi letrën lexuesve të Pjetrit, por jo domosdoshmërisht se ai e shkroi letrën për Pjetrin.

TEMË E VEÇANTË: SILA/SILVANI (SPECIAL TOPIC: SILAS/SILVANUS)

Silva, ose Silvani, ishte njeriu që Pali zgjodhi ta shoqëronte në udhëtimin e dytë misionar (shih Veprat 15:40-18:5) pasi Barnaba dhe Gjon Marku u kthyen në Qipro (për shkak të debatit për Markun; Veprat 15:36-39).

- A. Ai përmendet për herë të parë në Bibël te Veprat 15:22, ku quhet i pari ndër vëllezërit e kishës së Jerusalemit.
- B. Ishte edhe profet (Veprat 15:32).
- C. Ishte qytetar romak si Pali (Veprat 16:37).
- D. Ai dhe Juda Barsaba u dërguan në Antioki nga kisha e Jerusalemit për të inspektuar situatën (Veprat 15:22, 30-35).
- E. Pali e përmend në 2 Kor. 1:19 si bashkëpredikues ungjilli.
- F. Më vonë, përmendet me Pjetrin në shkrimin e letrës së 1 Pjetrit (shih 1 Pje. 5:12; ndoshta, kjo është arsyeja pse Pjetri “tingëllon” kaq shumë si Pali).
- G. Edhe Pali, edhe Pjetri, e quajnë Silvan, ndërsa Luka e quan Sila (forma aramaike e emrit “Saul”). Ka gjasa që Sila të ketë qenë emri i tij jude, ndërsa Silvan emri i tij latin (shih F. F. Bruce, *Paul: Apostle of the Heart Set Free*, f. 213).

■ **“hiri i vërtetë i Perëndisë”** Rreth kohës së shkrimeve të Pjetrit, u zhvilluan dhe pikëpamje të tjera për Jezusin. Pjetri thotë se ka vetëm një hir—ungjilli. Pjetri e ka theksuar shpesh hirin e Perëndisë në 1 Pjetrit (shih 1 Pje. 1:10, 13; 2:3; 3:7; 4:10; 5:5, 10, 12). Ungjilli i Jezu Krishtit reflekton vërtet zemrën e JHVH-së. Këtu, quhet “i vërtetë” për shkak se është përjetuar në jetën e këtyre besimtarëve të përvuajtur!

■ **“Qëndroni të patundur në të”** Kjo është urdhërore aoriste veprorë. Ishte e rëndësishme në kohë përndjekjesh. “Qëndrimi” këtu ka të bëjë me “të patundur në besim” në 1 Pje. 5:9. Ky është një qëndrim drejt Perëndisë dhe Krishtit dhe larg mëkatit, vetes dhe Satanit. Është fjalë ushtarake në Efe. 6:11, 13, 14. Pali e përdor në disa mënyra të ndryshme.

1. përmbledhje ungjilli, në 1 Kor. 15:1
2. shpjegim i “shfajësimit me anë të besimit”, në Rom. 5:2
3. këshilla që johebrenjtë të ruajnë besimin, në Rom. 11:20
4. paralajmërim kundër arrogancës shpirtërore, në 1 Kor. 10:12

Besimtarët kanë përgjegjësinë e besëlidhjes që të qëndrojnë të patundur! Shih Temën e Veçantë, Qëndresa, në 1 Pje. 5:9.

5:13 “Ajo” Kishat, shpesh, personifikohen si femra (shih 2 Gjonit), ndoshta për shkak të konceptit në DHV të JHVH-së si burrë dhe Izraelit si grua (shih Os. 1-3). Kisha është nusja e Krishtit (shih Efe. 5:21-31).

■ **“Babiloni”** Ndoshta, është referencë e fshehtë për Romën (shih Zbu. 14:8; 17:5; 18:2, 10; *Orakujt sibilinë* 5:143, 152; *Baruku* 9:1). Në kohën e Pjetrit, Roma ishte simbol i fuqive botërore të DHV (p.sh., Asiria, Babilonia, Persia). Ajo ishte simbol i një sistemi botëror të pushtetshëm, arrogant dhe idhujtar, që ishte larg Perëndisë (shih Efe. 2:2a).

Pjetri po shkruan nga vetë limeri i luanit. Kisha e Perëndisë ishte themeluar në territorin e armikut.

■ **“Marku”** Bëhet fjalë për Gjon Markun. Kisha e hershme mbledh në shtëpinë e familjes së tij në Jerusalemin (shih Veprat 12:12). Ky ishte dhe vendi i tre shfaqjeve të Zotit pas ringjalljes dhe i ardhjes së Frymës.

Gjon Marku e shoqëroi Palin dhe kushëririn e vet Barnabën (shih Kol. 4:10) në udhëtimin e parë misionar (shih Veprat 12:25-13:13). Për njëfarë arsye, ai e braktisi ekipin dhe u kthye në shtëpi (shih Veprat 15:38). Barnaba donte ta përfshinte në udhëtimin e dytë misionar, por Pali nuk pranoi (shih Veprat 15:36-41). Kjo bëri që Pali dhe Barnaba të ndaheshin. Barnaba e mori me vete Gjon Markun në Qipro (shih Veprat 15:39). Më vonë, kur Pali ishte në burg, e përmend Gjon Markun në mënyrë pozitive (shih Kol. 4:10), ndërsa më vonë, gjatë burgosjes së dytë në Romë, pak para vdekjes, Pali e përmend sërish Gjon Markun (shih 2 Tim. 4:11).

Me sa duket, Gjon Marku u bë pjesë e ekipit misionar të Pjetrit (shih 1 Pje. 5:13). *Historia e Kishës* (3:39:12) e Euzebit na jep një rrëfim interesant të marrëdhënies së Gjon Markut me Pjetrin.

“Në librin e vet, Papia na jep disa thënie të Zotit, të marra nga Aristioni, ose të nxëna drejtpërdrejt nga plakun Gjon. Pasi ua kam sjell këto në vëmendje studiuesve, tani duhet t’i shoqëroj thëniet që kam cituar tashmë prej tij me disa të dhëna që ai jep për Markun, shkruesin e ungjillit:

“Plaku thoshte dhe këtë: ‘Marku, që kishte qenë interpretues i Pjetrit, shkroi me kujdes, por jo në mënyrë të renditur, gjithçka që i kujtohej nga thëniet dhe veprat e Zotit. Sepse ai nuk e kishte dëgjuar Zotin, as nuk kishte qenë një ndër ndjekësit e tij, por më vonë, siç thashë, kishte qenë ndjekës i Pjetrit. Pjetrit e kishte zakon t’i përshtaste mësimet sipas rastit, pa bërë një renditje sistematike të thënieve të Zotit, kështu që Marku pati shumë të drejtë kur shkroi disa gjëra, ashtu siç i kujtoheshin. Sepse ai kishte vetëm një qëllim: të mos linte pa përmendur asgjë që kishte dëgjuar, dhe të mos e shprehte gabim’ (f. 152).

Në këtë citim Papia flet për “plakun Gjon”; në *Kundër Herezive* 5:33:4, Ireneu thotë: “Dhe këto gjëra i dëshmoi me shkrim dhe Papia, dëgjuesi i Gjonit dhe shoku i Polikarpit”. Kjo nënkupton se Papia i dëgjoi nga apostulli Gjon. Gjon Marku i rishprehur kujtimet dhe predikimet e Pjetrit për Jezusin në ungjillin e vet.

5:14 “me një puthje dashurie” Kjo ishte përshëndetja tipike kulturore ndër anëtarët e një familjeje. Në fillim, u huazua nga gjithë familja e Perëndisë (shih Rom. 16:16; 1 Kor. 16:20; 2 Kor. 13:12; 1 Thes. 5:6). Nga shekulli i katërt pas Krishtit, kjo puthje bëhej vetëm midis anëtarëve të së njëjtës gjini për shkak të abuzimeve brenda kishës

dhe keqkuptimeve jashtë saj. Ky akt ritual bashkësie ishte pjesë e rregullt e Darkës së Zotit, ose Festës së Dashurisë.

TEKSTI I NASB (I PËRDITËSUAR): 1 PJETRIT 5:14b

^{14b}Paqja qoftë me ju të gjithë që jeni në Krishtin.

5:14b Vetëm ata që janë në Krishtin kanë paqe (shih Luka 2:14). Ata që kanë paqen e Krishtit, zakonisht nuk e kanë paqen e botës (shih Mat. 10:34; Luka 12:49-53; Gjoni 14:27).

PYETJE PËR DISKUTIM

Ky është një komentuar studimor udhëzues, që do të thotë se ti je vetë përgjegjës për interpretimin e Biblës. Secili prej nesh duhet të ecë sipas dritës që ka. Ti, Bibla dhe Fryma e Shenjtë keni përparësi në interpretim. Nuk duhet t'ia dorëzosh këtë të drejtë komentuesit.

Këto pyetje për diskutim t'i kam dhënë për të të ndihmuar që të analizosh çështjet kryesore të kësaj pjese të librit. Ato synojnë të të nxisin mendimin, jo të kenë natyrë shteruese.

1. Rendit dhe shpjego fjalët e DHR që përdoren për drejtuesin e kishave lokale, që mblihdeshin nëpër shtëpi.
2. Rendit katër këshillat për pastorët në 1 Pje. 5:2-3.
3. Rendit aludimet për kontaktin personal të Pjetrit me Jezusin, që përmenden në këtë kapitull.
4. Ç'lidhje ka vuajtja me pjekurinë e krishterë? Po me Djallin?

HYRJE PËR 2 PJETRIN

THËNIE HYRËSE

- A. Qëllimi ose synimi i kësaj hyrjeje nuk është të diskutojë në hollësi problemet që lidhen me autorësinë e 2 Pjetrit. Unë, personalisht, kam arritur në përfundimin se nuk ka asnjë arsye të fortë për ta mohuar autorësinë e Pjetrit. Tri burime kanë qenë të dobishme për procesin e vendimmarrjes sime në këtë çështje.
1. Artikulli i Bruce M. Metzger, “Literary Forgeries and Canonical Pseudepigrapha” në *The Journal of the Society of Biblical Literature*, 1972, f. 3-24.
 2. Artikulli i Michael J. Kruger, “The Authenticity of 2 Peter”, në *The Journal of the Evangelical Theological Society*, vëll. 42, nr. 4, f. 645-671.
 3. Libri i E. M. B. Green, *2 Peter Reconsidered*, Tyndale Press, 1961.
- B. Kur mendoj për mundësinë se 2 Pjetri nuk u shkrua nga Pjetri, shumë gjëra më shkojnë në mendje.
1. Fakti se kush e shkroi 2 Pjetrin nuk ma ndryshon mendimin se është i frymëzuar dhe i besueshëm. Autorësia prek hermeneutikën, jo frymëzimin; frymëzimi është presupozim besimi dhe proces i dokumentuar historik.
 2. Pse të shqetësohem nga pseudonimiteti? Me sa duket, bota greko-romake e shekullit të parë ishte mësuar me pseudonimitetin (shih artikullin e Metzger).
 3. A jam ngurrues që ta lejoj pseudonimitetin në këtë letër për shkak të preferencave të mia, apo jam në gjendje t’i vlerësoj ndershmërisht të dhënat historike dhe tekstuale? Mos, ndoshta, tradita më ka predispozuar që të arrij në një përfundim të caktuar?
 4. Kisha e hershme e vuri në dyshim autorësinë e Pjetrit, por jo mesazhin e kësaj letre (përveç kishës siriane). Ky është një mesazh ortodoks, në unitet teologjik me librat e tjerë të DHR; ka shumë ngjashmëri me predikimet e Pjetrit në Veprat.
- C. Euzebi përdori tri kategori për të përshkruar shkrimet e krishtera:
1. të pranuar
 2. të debatuar
 3. të rreme

Ai e përfshiu 2 Pjetrin bashkë me Jakobin, Judën, 2 Gjonin dhe 3 Gjonin në kategorinë e dytë (të debatuar). Euzebi e pranoi 1 Pjetrin, kishte dyshim për 2 Pjetrin, por hodhi poshtë si të rreme shkrimet e tjera të supozuara të Pjetrit: (1) *Veprat e Pjetrit*; (2) *Ungjillin e Pjetrit*; (3) *Predikimin e Pjetrit*; dhe (4) *Apokalipsin e Pjetrit*.

AUTORËSIA

- A. Ky është një nga librat më të debatuar të DHR për sa i përket autorësisë tradicionale.
- B. Arsyet për këto dyshime janë të brendshme (stili dhe përmbajtja) dhe të jashtme (pranimi i vonët nga kisha)

PROBLEME TË BRENDSHME

1. Stili
 - a. Stili ndryshon shumë nga 1 Pjetrit. Këtë e kuptoi dhe Origeni me Jeronimin.
 - (1) Origeni e pranoi se disa e hidhnin poshtë autorësinë e Pjetrit, por ai e citoi gjashtë herë 2 Pjetrin në shkrimet e tij.
 - (2) Jeronimi ia atribuoi këtë letër përdorimit të një letërshkruesi nga Pjetri. Po kështu, ai pranon se, në kohën e tij, disa e refuzonin autorësinë e Pjetrit.
 - (3) Euzebi e përmend këtë shqetësim në *Hist. Kish.* 3:3:1; “por të ashtuquajturën letër të dytë ne nuk e kemi pranuar si kanonike; gjithsesi, ka provuar se është e dobishme për shumë vetë dhe është studiuar me Shkrimet e tjera”.
 - b. Stili i 2 Pjetrit është shumë i veçantë. Në *The Epistles of James, Peter and Jude*, në Anchor Bible, f. 146-147, B. Reicke e quan “azianizëm”.

“Quhej stili ‘aziatik’ për shkak se përfaqësuesit e tij kryesorë vijnë nga Azia e Vogël, dhe karakterizohen nga një mënyrë e tepruar, fjalëshumtë, dhe pompoze shprehjeje që prirë drejt risisë dhe të çuditshmes; ishte e pakujshme, duke shkëlqyer ideat klasike të thjeshtësisë.... Kjo letër, pa dyshim, u shkrua në përputhje me rregullat e shkollës aziatike, që ishte ende e rëndësishme gjatë shekullit të parë të krishterimit”.

- c. Ka gjasa që Pjetri të jetë përpjekur të shkruajë në një gjuhë (pra, në greqishten *koine*), në të cilën nuk ishte plotësisht i rrjedhshëm. Gjuha e tij amtare ishte aramaishtja.
2. Gjinia letrare
 - a. A është kjo një letër tipike e shekullit të parë?
 - (1) Ka një hyrje dhe përmbyllje tipike
 - (2) Megjithatë, duket se është letër ciklike për disa kisha, si Galatasve, Efesianëve, Jakobi dhe 1 Gjonit
 - b. Mund të jetë një gjini e specializuar judaike, e quajtur “testament”, që karakterizohet nga
 - (1) Ligjërime lamtumire
 - a) Ligji i Përtërirë 31-33
 - b) Jozueu 24
 - c) *Testamenti i Dymbëdhjetë Patriarkëve*
 - d) Gjoni 13-17
 - e) Veprat 20:17-28
 - (2) Parashikim i vdekjes së afërt të shkruarit (shih 2 Timoteut)
 - (3) Këshillë për dëgjuesit që të vazhdojnë në traditën e tij
3. Marrëdhënia mes 2 Pjetrit 2 dhe Judës
 - a. Qartazi, ka ndodhur një huazim letrar mes të dyve.
 - b. Aludimi për burime jokanonike ka bërë që shumë ta hedhin poshtë, edhe Judën, edhe 2 Pjetrin; mirëpo, edhe 1 Pjetri aludon për *1 Enokun*, kurse Pali citon dhe poetë grekë.
4. Vetë libri pretendon se u shkrua nga apostulli Pjetër
 - a. Ai përmendet me emër në 2 Pje. 1:1. Ai quhet Simeon Pjetër. Pjetri është emri që ia dha Jezusi (shih Mat. 16). Simeoni (jo Simoni) është emër i rrallë dhe i pazakontë. Nëse dikush do të përpiquej të shkruante në emër të Pjetrit, përzgjedhja e këtij shqiptimi semit është shumë e habitshme, madje kundërproduktive për pseudonimitetin.
 - b. Ai pretendon se ishte dëshmitar okular i Shpërfytyrimit në Mal (shih Mat. 17:1-8; Marku 9:2-8; Luka 9:28-36) në 2 Pje. 1:16-18.
 - c. Ai pretendon se ka shkruar dhe një letër të parë (shih 2 Pje. 3:1), që nënkupton 1 Pjetrin.
5. Ortodoksia
 - a. Nuk ka asgjë në këtë letër që të kundërshtojë ndonjë mësim apostolik të DHR.
 - b. Ka disa elemente unike (p.sh., që bota do të shkatërrohet me zjarr, dhe që letrat e Palit shihen si Shkrim), por asgjë gnostike, ose adopsioniste, ose qartazi heretike.

PROBLEME TË JASHTME

1. Euzebi i rendit shkrimet e krishtera të shekujve të parë dhe të dytë në tre kategori:
 - a. të pranuar
 - b. të debatuar
 - c. të rreme
 2 Pjetri, bashkë me Hebrenjve Jakobin, 2 dhe 3 Gjonin, renditen në kategorinë e debatuar.
2. 2 Pjetrit nuk shfaqet në kanonin e Markionit (154 pas K.), por Markioni refuzoi dhe shumë libra të tjerë të DHR.
3. 2 Pjetrit nuk shfaqet në Fragmentin Muratorian (rreth 180-200 pas K.), por kjo listë duket se ishte e dëmtuar; po kështu, ajo nuk përmend as Hebrenjve, Jakobin dhe 1 Pjetrin.
4. U refuzua nga kisha lindore (siriane)
 - a. Nuk gjendet në Peshita (gjysma e parë e shekullit të pestë)
 - b. U përfshi në Filokseniana (507 pas K.) në Irak, dhe në versionin Harklean (616 pas K.) në Afrikën e veriut
 - c. Krizostomi dhe Teodori i Mopsuestias (pra, drejtuesit e kishës antiokene të interpretimit) i refuzuan të gjitha letrat e përgjithshme.

5. 2 Pjetrit duke se citohet në “Ungjillin e së Vërtetës” dhe “Apokrifonin e Gjonit”, që gjenden në tekstet gnostike të Nag Hammadit (shih *The Nag Hammadi Gnostic Sects and the Bible*, nga Andrew K. Helmbold, f. 91). Këto shkrime në gjuhën kopte janë përkthime të teksteve të mëparshme greqisht. Nëse 2 Pjetrit aludohet aty, atëherë është e pamundur që të jetë shkruar në shekullin e dytë.
 6. Përfshihet në P72 e datuar nga UBS4 (f. 8) si në shekullin e tretë ose të katërt.
 7. Aludohet ose citohet nga Klementi i Romës (95 pas K.)
 - a. *1 Klementi* (9:2 – 2 Pjetrit 1:17)
 - b. *1 Klementi* (23:3 – 2 Pjetrit 3:4)
 - c. *1 Klementi* (35:5 – 2 Pjetrit 2:2)
 8. Ndoshta, aludohet në *Dialogun me Trifon* (82:1 – 2 Pje. 2:1), e shkruar nga Justin Martiri (115-165 pas K.). Këto janë të vetmet dy vende në shkrimet e lashta të krishtera, ku përdoret fjala greke *pseudoprofetai*.
 9. Ireneu (130-200 pas K.) ndoshta aludon për 2 Pjetrit (citohet nga Euzebi në *Hist. Kish.* 5:32:2 – 2 Pje. 3:8; dhe 3:1:1 – 2 Pje. 1:15).
 10. Klementi i Aleksandrisë (150-215 pas K.) shkroi komentarin e parë (ndonëse tani ka humbur) për 2 Pjetrit.
 11. Përmendet në letrën e Pashkës së Athanasit (367 pas K.), që është një listë e librave kanonikë të kohës.
 12. U pranua si kanonike nga këshillat e kishës së hershme në Laodice (372 pas K.) dhe Kartagjenë (397 pas K.).
 13. Është interesante se shkrimet e tjera të supozuara të Pjetrit (pra, *Veprat e Pjetrit*, *Veprat e Andreas dhe Pjetrit*, *Veprat e Pjetrit dhe Palit*, *Mundimi i Pjetrit dhe Palit*, *Veprat e Pjetrit dhe Dymbëdhjetë Apostujve*, *Apokalipsi i Pjetrit*, dhe *Predikimi i Pjetrit*) u refuzuan pa përjashtim nga kishat e hershme si të reme (pra, jo të frymëzuara).
- C. Richard N. Longenecker, *Biblical Exegesis in the Apostolic Period* (f. 174), komenton se 2 Pjetri mund të jetë shkruar na vetë Pjetri pa përdorimin e një letërshkruesi (pra, Silës në 1 Pjetrit 5:12 dhe Gjon Markut për ungjillin). Si provë, ai thotë se 1 Pjetrit përdor vetëm Septuagintën për citimet nga DHV, ndërsa 2 Pjetrit (shih 2 Pje. 2:22) përdor Tekstin Masoret të Fja. 26:11, gjë që tregon një sfond hebraik.

DATA

- A. Kjo varet nga autorësia.
- B. Nëse jemi të bindur për autorësinë e Pjetrit, atëherë u shkrua përpara vdekjes së tij (shih 2 Pje. 1:14).
- C. Tradita e kishës thotë se apostulli Pjetër vdiq në Romë kur Cezar ishte Neroni. Neroni urdhëroi përndjekjen e të krishterëve rreth 64 pas K. Ai vrau veten më 68 pas K.
- D. Nëse letrën e shkroi një ndjekës i Pjetrit në emër të apostullit, atëherë bëhet e mundshme një datim i vonët deri në 130-150 pas K., për shkak se 2 Pjetrit citohet në *Apokalipsin e Pjetrit* si dhe në *Ungjillin e së Vërtetës* dhe në *Apokrifonin e Gjonit*.
- E. Arkeologu i shquar amerikan W. F. Albright thotë se u shkrua përpara vitit 80 pas K. për shkak të ngjashmërive që ka më Pergamenat e Detit të Vdekur.

MARRËSIT E LETRËS

- A. Nëse 1 Pjetrit përmendet në 2 Pjetrit 3:1, atëherë marrësit e letrës ishin të njëjtit njerëz (pra, jetonin në Turqinë veriore).

- B. 2 Pjetrit mund të jetë dëshmi për të inkurajuar gjithë besimtarët që të bëjnë qëndresë nën sprovë, t'i kundërshtojnë mësuesit e rremë dhe të jetojnë besnikërisht në traditën e ungjillit duke pritur Ardhjen e Dytë.

ARSYEJA E SHKRIMIT

- A. Ndërsa 1 Pjetrit flet për përndjekjen dhe vuajtjen, 2 Pjetrit flet për mësuesit e rremë.
- B. Natyra e saktë e mësimit të rremë nuk është e qartë, por ndoshta kishte lidhje me gnosticizmin antinomian (shih 2 Pje. 2:1-22; 3 :15-18). Ky libër përdor një fjalor teknik, i përdorur nga proto-gnosticizmi dhe nga fetë e misterit. Ndoshta, kjo ishte teknikë e qëllimshme apologjetike për të sulmuar teologjinë e tyre.
- C. Ky libër, ashtu si 2 Thesalonikasve trajton temën e Ardhjes së Dytë, që ndonëse e vonuar, është e sigurt; atëherë, fëmijët e Perëndisë do të përlëvdohen dhe jobesimtarët do të gjykohen (shih 2 Pje. 3:3-4). Është interesante se 1 Pjetrit, në mënyrë karakteristike, përdor fjalën *apokalupsis* për t'iu referuar kthimit të Jezusit, ndërsa 2 Pjetrit përdor fjalën *parousia*. Ndoshta, kjo reflekton përdorimin e letërshkruesve të ndryshëm (kështu mendon Jeronimi).

CIKLI NJË I LEXIMIT (nga “Udhëzues për leximin e mirë biblik”)

Ky është një komentari studimor udhëzues, që do të thotë se ti je vetë përgjegjës për interpretimin e Biblës. Secili prej nesh duhet të ecë sipas dritës që ka. Ti, Bibla dhe Fryma e Shenjtë keni përparësi në interpretim. Nuk duhet t'ia dorëzosh këtë të drejtë komentuesit.

Lexo gjithë librin biblik njëherësh. Shprehe idenë qendrore të librit me fjalët e tua.

1. Ideja e gjithë librit.
2. Lloji i letërsisë (gjinia letrare)

CIKLI DY I LEXIMIT (nga “Udhëzues për leximin e mirë biblik”)

Ky është një komentari studimor udhëzues, që do të thotë se ti je vetë përgjegjës për interpretimin e Biblës. Secili prej nesh duhet të ecë sipas dritës që ka. Ti, Bibla dhe Fryma e Shenjtë keni përparësi në interpretim. Nuk duhet t'ia dorëzosh këtë të drejtë komentuesit.

Lexo gjithë librin biblik njëherësh për herë të dytë. Përvijoj temat kryesore dhe shprehe temën me një fjali.

1. Tema e njësisë së parë letrare.
2. Tema e njësisë së dytë letrare.
3. Tema e njësisë së tretë letrare.
4. Tema e njësisë së katërt letrare
5. Etj.

2 PJETRIT 1

NDARJET NË PARAGRAFË TË PËRKTHIMEVE MODERNE*

UBS ⁴	NKJV	NRSV	TEV	NJB
Përshëndetje	Përshëndetja e besimtarëve	Përshendetje	Hyrje	Përshëndetje
1:1-2	1:1-4	1:1-2	1:1 1:2	1:1-2
Thirrja dhe zgjedhja e të krishterëve		Nxitje për shenjtëri	Thirrja dhe zgjedhja e Perëndisë	Bujaria e Perëndisë
1:3-11		1:3-11	1:3-9	1:3-11
	Rritja e frytshme në besim			
	1:5-11			
	Vdekja e afërt e Pjetrit			Dëshmia apostolike
1:12-15	1:12-15	1:12-15	1:12-15	1:12-15
Lavdia e Krishtit dhe fjala profetike	Fjala e besueshme profetike		Dëshmitarët okularë të lavdisë së Krishtit	
1:16-21	1:16-21	1:16-18	1:16-18	1:16-18
				Vlera e profecisë
		1:19-21	1:19-21	1:19-21

CIKLI TRE I LEXIMIT (shih f. v)

NDJEKJA E SYNIMIT TË AUTORIT FILLESTAR NË NIVELIN E PARAGRAFËVE

Ky është një komentuar studimor udhëzues, që do të thotë se ti je vetë përgjegjës për interpretimin e Biblës. Secili prej nesh duhet të ecë sipas dritës që ka. Ti, Bibla dhe Fryma e Shenjtë keni përparësi në interpretim. Nuk duhet t'ia dorëzosh këtë të drejtë komentuesit.

Lexo gjithë kapitullin njëherësh. Identifiko temat. Krahaso ndarjet e tua tematike me pesë përkthimet moderne. Ndarja në paragrafë nuk është e frymëzuar, por është çelësi për të ndjekur synimin e autorit fillestar, gjë që është thelbi i interpretimit. Secili paragraf ka vetëm një temë të vetme.

1. Paragrafi i parë
2. Paragrafi i dytë
3. Paragrafi i tretë
4. Etj.

* Ndonëse nuk janë të frymëzuara, ndarjet në paragrafë janë kyçe për të kuptuar dhe ndjekur synimin e autorit fillestar. Secili përkthim modern i ka ndarë dhe përmbledhur paragrafët. Secili paragraf ka një temë, të vërtetë, ose mendim qendror. Secili version e përmbledh atë temë në mënyrën e vet të veçantë. Kur të lexosh tekstin, pyet veten se cili përkthim i përshtatet logjikës tënde për temën dhe për ndarjet në vargje.

Në çdo kapitull, së pari duhet të lexojmë Biblën dhe të përpiqemi të identifikojmë temat e saj (paragrafët), pastaj ta krahasojmë njohurinë tonë me versionet moderne. Biblën mund ta kuptojmë vërtet vetëm pasi kuptojmë synimin e autorit fillestar duke dalluar logjikën dhe prezantimin e tij. Vetëm autori fillestar është i frymëzuar; lexuesit nuk kanë të drejtë t'ia ndryshojnë ose modifikojnë mesazhin. Lexuesit e Biblës kanë vërtet përgjegjësinë që ta zbatojnë të vërtetën e frymëzuar në kohën dhe jetën e tyre.

Vini re se të gjithë termat teknike dhe shkurtime shpjegohen plotësisht në këto dokumente: Përcaktime të termave gramatikore greqisht, Kritika e tekstit, dhe Fjalorth.

MËSIMET KONTEKSTUALE NGA VARGJET 1-11

- A. Vargjet 1-11 janë një fjali në greqisht, që kombinon të dyja aspektet e besëlidhjes: një hir falas sovran dhe jeta që duhet t'i ngjajë Krishtit.
- B. Përvijimi duket se është ky:
1. hyrje tradicionale (2 Pje. 1:1-2)
 - a. prej kujt
 - b. për kë
 - c. përshëndetje
 2. vargjet 3-4 – pjesa e Perëndisë
 3. vargjet 5-7 – pjesa e besimtarit
 4. vargjet 8-9 – aspektet pozitive dhe negative të besnikërisë
 5. vargjet 10-11 – siguria përmes perëndishmërisë në stilin e jetesës

STUDIMI I FJALËVE DHE FRAZAVE

TEKSTI I NASB (I PËRDITËSUAR): 2 PJETRIT 1:1-11

¹Simon Pjetri, skllav dhe apostull i Jezu Krishtit, atyre që kanë marrë një besim të të njëjtit lloj si yni, me anë të drejtësisë së Perëndisë dhe Shpëtimtarit tonë, Jezu Krishtit; ²Hiri dhe paqja u shumofshin në ju në njohurinë e Perëndisë dhe të Jezusit, Zotit tonë; ³duke parë se fuqia e tij hyjnore na ka falur gjithçka në lidhje me jetën dhe perëndishmërinë, përmes njohurisë së vërtetë të atij, i cili na thirri me anë të lavdisë dhe virtytit të vet. ⁴Sepse me anë të tyre ai na ka falur premtimet e tij të vjera dhe të mahnitshme, në mënyrë që, me anë të tyre, ju të bëheni pjesëmarrës të natyrës hyjnore, duke i shpëtuar shprishjes që tani është në botë me anë të epshit. ⁵Pikërisht për të njëjtën arsye, duke ushtruar çdo zell, në besimin tuaj shtoni viryutin moral, dhe në viryutin tuaj moral, njohurinë, ⁶dhe në njohurinë tuaj, vetëkontrollin, dhe në vetëkontrollin tuaj, qëndresën, dhe në qëndresën tuaj, perëndishmërinë, ⁷dhe në perëndishmërinë tuaj, mirëdashjen vëllazërore, dhe në mirëdashjen tuaj vëllazërore dashurinë. ⁸Sepse nëse këto cilësi janë tuajat dhe po shtohen, nuk ju bëjnë, as të padobishëm, as të pafryt, në njohurinë e vërtetë të Zotit tonë Jezu Krisht. ⁹Sepse atij që i mungojnë këto cilësi është i verbër dhe dritëshkurtër, pasi ka harruar pastrimin nga mëkatet e mëparshme. ¹⁰Prandaj, vëllazër, jini edhe më të zellshëm për ta bërë të sigurt thirrjen dhe zgjedhjen tuaj prej tij; sepse, për sa kohë që i praktikoni këto gjëra, nuk do të pengoheni kurrë; ¹¹sepse në këtë mënyrë do t'ju sigurohet begatisht hyrja në mbretërinë e përjetshme të Zotit dhe Shpëtimtarit tonë Jezu Krisht.

1:1 “Simon” Fjalë për fjalë, “Simeon” (shih Bruce Metzger, *A Textual Commentary on the Greek New Testament*, f. 699). Ky është emri hebre i Pjetrit dhe emri i një prej dymbëdhjetë fiseve të Izraelit. E njëjta formë shfaqet dhe në Veprat 15:14. Nëse kjo letër do të ishte pseudonimike, autori me siguri që do të kishte zgjedhur shqiptimin normal të këtij emri: “Simon”.

■ **“Pjetri”** Fjalë për fjalë, *Petros*, që në greqisht do të thotë “gur i madh, ose shkëmb”. Ishte emri që ia dha Pjetri Simonit në Mat. 16:18 dhe në Gjoni 1:42. Në këtë pasazh, te Gjoni përmendet emri aramaik *Kefa*. Në bisedat e përditshme, Jezusi fliste aramaisht, jo hebraisht apo greqisht. Shpesh, Pali e përdor shpesh emrin *Kefa* (shih 1 Kor. 1:12; 3:22; 9:5; 15:5; Gal. 1:18; 2:9, 11, 14).

Ka patur shumë debate mes studiuesve katolike dhe protestantë për domethënien e këtij ndryshimi emri (që ka domethënien e DHV për ndryshimin e emri të Abramit, Jakobit, etj.). Në Mat. 16:18, shkëmbi Pjetër thuhet se është themeli i kishës. Protestanët i kanë mëshuar gjithmonë nga ana teologjike konceptit se fjala “Pjetër” është mashkullore (pra, *Petros*), kurse “shkëmb” është femërore (pra, *Petra*); në këtë mënyrë, rrëfimi i besimit të Pjetrit, dhe jo vetë Pjetri, është shkëmbi ku mbështetet kisha. Sidoqoftë, ky dallim në gramatikën greqisht nuk kishte vlerë në aramaisht, ku në të dyja vendet do të përdorej fjala *Kefa*.

Si teolog, nuk dua ta mohoj udhëheqjen e qartë të Pjetrit, por e kuptoj gjithashtu se apostujt e tjerë nuk ia pranorin këtë përparësi (shih Marku 9:34; Luka 9:46; 22:24-27; Mat. 20:20-24). Ndonëse Jezusi nuk fliste përditë në greqisht, teksti i frymëzuar është shkruar në greqisht; prandaj, dallimi gramatikore duhet marrë si i frymëzuar.

■ **“skllav”** Kjo është fjala greke *doulos*, që do të thotë skllav ose shërbëtor. Kjo vjen ose nga sfondi i nderuar i DHV i termit “shërbëtor i Zotit” (si Moisiu, Jozueu, Davidi dhe Isaia), ose nga fokusi i DHR te përlulësi në lidhje me Jezusin si Zot (shih Mat. 10:24-25).

■ **“apostull”** Qartazi, kjo është mënyra letrare sesi autori i 2 Pjetrit pohon identitetin e vet si dëshmitar okular, ndjekës dhe dishepull i zgjedhur i Jezusit.

Fjala “apostull” vjen nga fjala greke “dërgoj” (*apostellō*). Jezusi zgjodhi dymbëdhjetë nga dishepujt e vet që të ishin me të në mënyrë të veçantë dhe i quajti “apostuj” (shih Luka 6:13). Shpesh, kjo fjalë përdorej shpesh për Jezusin si i dërguar nga Ati (shih Mat. 10:40; 15:24; Marku 9:37; Luka 9:48; Gjoni 4:34; 5:24, 30, 36, 37, 38, 40, 57; 7:29; 8:42; 10:36; 11:42; 17:3, 8, 18, 21, 23, 25; 20:21). Në burimet judaike përdorej për dikë që dërgohej si përfaqësues zyrtar i tjetrit, i ngjashëm me termin “ambasador” (shih 2 Kor. 5:20). Pjetri po pohon autoritetin që ia ka dhënë Krishti!

Më vonë, u përdor në mënyrë më të zgjeruar përtej “të dymbëdhjetëve” (shih Veprat 14:4, 14, Barnaba; Rom. 16:7, Androniku dhe Junia; 1 Kor. 4:6, 9; 12:28-29; 15:7, Apollo; Fil. 2:25, Epafroditi; 1 Thes. 2:6, Silvani dhe Timoteu). Detyra e tyre e saktë nuk është e qartë, por përfshin shpalljen e ungjillit dhe udhëheqjen prej shërbëtorit të kishës. Madje, ka mundësi që Rom. 16:7 (KJV “Junia”) përmend një apostulle femër!

■ **“Jezu Krishtit”** Shih shënimet në 1 Pjetrit 1:1.

NASB, NRSV,

NJB “atyre që kanë marrë një besim”

NKJV “atyre qëk anë marrë një besim të vyer”

TEV “atyre... që iu është dhënë një besim”

Kjo është një pjesore aoriste veprare nga fjala “*laghanō*”, që bënte fjalë për hedhjen e shortit

1. si në bixhoz (shih Gjoni 19:24)
2. në kuptimin e detyrës ose detyrimit (shih Luka 1:9)
3. si mënyrë për të treguar zgjedhjen hyjnore (shih Veprat 1:17)

Mund të ketë thjesht kuptimin “përftoj”, ose “marr”, por mund të ketë dhe ngjyrimin e shtuar të përdorimit në LXX: “me anë të vullnetit të Perëndisë”. I njëjti motiv gjendet në 2 Pje. 1:3 dhe 4 “dha/fali” (dy herë) dhe “thirri”; shih dhe shënimin 2 Pje. 1:10, “thirrja dhe zgjedhja juaj prej tij”.

Kjo dykuptimësi është e njëjta gjë si dhe paradoksi i shpëtimit. A është shpëtimi me anë të zgjedhjes së Perëndisë, apo është zgjedhja e atij që e pranon? Përgjigjja është: sigurisht që po! Bibla është shumë e qartë se kjo është bota e Perëndisë. Ai është i përfshirë në të gjitha aspektet. Ai ka zgjedhur të komunikojë me krijimin e vetëdijshëm me anë të besëlidhjes. Ai e nis kontaktin. Ai e cakton axhendën, por ka kërkuar që ne t’i përgjigjemi (pra, fillimisht dhe vazhdimisht).

Këta lexues morën një besim që ishte vullneti i Perëndisë për ta (dhe për të gjithë).

Fjala “besim” vjen nga fjala greke *pistis*, që në shqip përkthehet “besim”, “besoj”. Në fillim, në hebraisht, ky koncept bënte fjalë për një qëndrim të drejtë në këmbë, por më vonë përdorej për dikë që ishte besnik, i besueshëm dhe i qëndrueshëm. Në Bibël, nuk bëhet fjalë për besimin e besimtarit, por për besnikërinë e Perëndisë; jo për besimin e besimtarit, por për besueshmërinë e Perëndisë. Shih Temën e Veçantë në Marku 1:15.

NASB “të të njëjtit lloj si yni”

NKJV “po aq i vyer”

NRSV, TEV,

NJB “po aq i çmuar”

Kjo është fjala e përbërë greke *isotimos*, nga *isos* (pra, i barabartë, i ngjashëm, ose i përkon) dhe *time* (pra, çmim, vlerë, me ngjyrimin kuptimor “i vyer” ose “i kushtueshëm”). Besimi që na jep Perëndia ka vlerë të paçmuar (shih 1 Pje. 1:7), dhe të gjithë besimtarët marrin pjesë në të njëjtin lloj besimi. Nuk ka një besim për apostujt dhe një tjetër për judenjtë e johebrenjtë, apo një tjetër për besimtarët e tjerë (shih 1 Kor. 12:13; Gal. 3:28; Kol. 3:11). Ka dhunti të ndryshme, por vetëm një besim (shih Efe. 4:5).

■ **“drejtësisë”** Bëhet fjalë, jo për drejtësinë që na është llogaritur ne (shih Rom. 4), por për drejtësinë e Krishtit (shih Veprat 3:14; 7:52; 22:14; 1 Gjonit 2:1, 29; 3:7). Shih Temën e Veçantë: Drejtësia, në 1 Pje .3:14. Ky është vendi më i qartë në DHR ku fjala *Theos* i atribuohet Jezusit.

Kjo fjalë greke (që reflekton rrënjën hebraike דָּרַךְ, BDB 841) përdoret disa herë në 1 Pjetrit.

1. i drejtë (*dikaïos*) – 2:8, njeri i drejtë
2. i drejtë, drejtësi (*diknïosunē*)
 - 1:1 – drejtësia e Jezusit
 - 2:5 – drejtësia e Noeut (shih Zan. 7:1)
 - 2:21 – udha e drejtësisë
 - 3:13 – qiejt e rinj dhe toka e re, ku banon drejtësia
3. i drejtë (*dikaïon*)
 - 1:13 – i drejtë, i duhur
 - 2:7 – Loti i drejtë
 - 2:8 – njeriu i drejtë

Jezusi është i drejtë; besimtarët janë të drejtë në të; prandaj, duhet të jetojnë në drejtësi, që reflekton epokën e re!

■ **“Perëndisë dhe Shpëtimtarit tonë, Jezu Krishtit”** Kjo frazë i referohet vetëm Jezusit.

1. nyja shquese është vetëm para emrit të parë (rregulli Granville Sharp)
2. forma gramatikore e të katërt termave kyçe, “Perëndi”, “Shpëtimtar”, “Jezus” dhe “Krisht” (njëjës mashkullore gjinorë)
3. forma e përsëritur gramatikore (përveç “Zot” në vend të “Perëndisë”) në 2 Pje. 1:11; 2:20 dhe 3:18
4. Libri i A. T. Robertson, *Word Pictures in the New Testament*, vëll. 6, f. 148, na kujton se, te 2 Pjetrit, *gnōsis* dhe *epignōsis* përdoren gjithmonë për Jezusin
5. Ka pasazhe të tjera në DHR ku pohohet natyra hyjnore e Jezusit (shih Gjoni 1:1; 8:57-58; 20:28; Rom. 9:5; Fil. 2:6-11; 2 Thes. 1:12; Titit 2:13; Heb. 1:8; dhe 1 Gjonit 5:20), që është tronditëse në dritën e monoteizmit të DHV

Në DHV, fjala “Shpëtimtar” zakonisht përdoret për JHVH, por ndonjëherë përdoret për Mesinë. Në DHR, zakonisht përdoret për Perëndinë Atë. Në Titi, kjo frazë përdoret tri herë për Atin (shih Titit 1:3; 2:10; 3:4), por, në të njëjtat kontekste, përdoret dhe për Jezusin (shih Titit 1:4; 2:13; 3:6). Në 2 Pjetrit, përdoret vetëm për Jezusin, madje përmendet shpesh (shih 2 Pje. 1:1, 11; 2:20; 3:2, 18).

1:2 “Hiri dhe paqja u shumofshin në ju” Kjo është e ngjashme me 1 Pje. 1:2. Shpesh, Pali përdor frazën “hir dhe paqe”, por e vijon me “nga Perëndia, Ati ynë” dhe, shpesh shton “dhe nga Zoti Jezu Krisht”.

Hiri reflekton të vërtetën se shpëtimi dhe bashkësia e njerëzimit mëkatar rrjedh nga karakteri dhe furnizimi i Perëndisë. Kjo marrëdhënie e re (pra, e rimëkëmbur) me Perëndinë çon në paqe. Njerëzit janë krijuar për bashkësi me Perëndinë, në shëmbëllimin e të cilit janë krijuar, dhe për bashkësi me njëri-tjetrin. Hiri gjithmonë i paraprin paqes! Kjo folje është dëshirore aoriste pësore. Është lutje. Pjetri dëshiron që Perëndia të na japë edhe hir, edhe paqe.

■ **“në njohurinë e Perëndisë”** Hiri dhe paqja jepen nga Perëndia (pra, në diatezën pësore) nëpërmjet një njohurie të përjetuar (*epignōsis*) të tij dhe të Birit të tij.

Njohuria është motiv i përsëritur në 2 Pjetrit, ndoshta për shkak të mësuesve të remë (pra, gnostikëve), si te Kolosianëve dhe 1 Gjonit.

1. <i>epignosis</i> (njohuri e plotë); 2 Pje. 1:2 2 Pje. 1:3 2 Pje. 1:8 2 Pje. 2:20	<i>epignōskō</i> (njoh plotësisht) 2 Pje. 2:21 (dy herë)
2. <i>gnosis</i> (njohuri) 2 Pje. 1:5 2 Pje. 1:6	<i>ginōskō</i> (njoh) 2 Pje. 1:20 2 Pje. 3:3

Mësuesit e rremë të kapitullit dy duket se kishin karakteristikat e asaj, që më vonë, u quajt “gnosticizëm antinomian”. Ky sistem i zhvilluar herezie filozofike/teologjike u zhvillua në shekullin e dytë, por rrënjët i kishte në shekullin e parë. Karakterizohej nga natyra përjashtuese, e bazuar në njohurinë e fshehtë. Shpëtimi lidhej me këtë njohuri, jo me etikën. Shih Temën e Veçantë në 1 Pje. 3:22.

■ **“e Perëndisë dhe të Jezusit Zotit tonë”** Te 2 Pje. 1:1, dhashë pikat e mëposhtme gramatikore në lidhje me një frazë të ngjashme, e cila bënte fjalë vetëm për Jezusin.

1. një nyjë shquese
2. të gjitha format janë gjinore

Të njëjtat elemente gramatikore gjenden edhe në këtë frazë, që gjë duhet t’i shtojë njëfarë skepticizmi idesë nëse 2 Pje. 1:1 bën fjalë vetëm për Jezusin, apo edhe për Atin dhe për Birin. Megjithatë, ky dallim përfshin një variant të komplikuar në dorëshkrimet greqisht. Gramatika e 2 Pje. 1:1 nuk ka asnjë variant në dorëshkrimet greqisht. Për një listë të plotë të varianteve shih shënimin e botimit të katërt të Dhiatës së Re Greqisht të United Bible Societies, f. 799, dhe Bart Ehrman, *The Orthodox Corruption of Scripture*. f. 85.

1:3-7 Kjo është një fjali e gjatë në greqisht.

1:3 “duke parë” NASB (e përditësuar) është tejet idiomatike në këtë pikë. Pjesorja “duke parë” nuk gjendet në tekstin greqisht.

■ **“e tij”** Ky përemër bën fjalë, ose për Perëndinë Atë, ose për Perëndinë Bir. Të gjithë përemrat në këto vargje të para janë të paqartë. Kjo është tipike për Pjerin. Ka gjasa që kjo paqartësi të jetë e qëllimshme (pra, kuptim i dyfishtë, si në shkrimet e Gjonit). Jezusi identifikohet si “Perëndi” në 2 Pje. 1:1; edhe Ati, edhe Biri, lidhen gramatikisht në 2 Pje. 1:2; dhe mbiemri “hyjnore” në 2 Pje. 1:3 bën fjalë për të dy.

■ **“na ka falur”** Kjo është pjesore e kryer mesore (deponente). Kjo formë e fjalës greke (*dōreomai* nga *didōmi*) përdoret vetëm nga Marku (shih Marku 15:45) dhe Pjetri (shih 1 Pje. 1:3, 4), gjë që ndoshta tregon marrëdhënien letrare mes ungjillit të Markut dhe 1 Pjetrit.

■ **“gjithçka në lidhje me jetën”** Në thelb, vargu 3 është kundërshtim i ndarjes teologjike që mësuesit e rremë gnostikë bënin midis shpëtimit përmes njohurisë së fshehtë dhe jetesës së perëndishme të përditshme. Perëndia na siguron jetën e përjetshme (pra, *zoe*) dhe ngjashmërinë e përditshme me Krishtin (pra, *eusebeia*). Njohuria e vërtetë është besimi në Jezu Krishtin, gjë që ndikon në jetesën e përditshme. Besimtarët kanë gjithçka që u nevojitet shpirtërisht në Krishtin! Nuk ka nevojë që të kërkojmë një përjetim më të thellë të së vërtetës!

■ **“perëndishmërinë”** Kjo fjalë e përbërë (pra, *eusebeia*) vjen nga “mirë” dhe “adhurim”. Ka ngjyrimin kuptimor të jetesës së përditshme që është e pranueshme nga Perëndia. Pjetri e thekson vazhdimisht nevojën për perëndishmëri për shkak të anashkalimit që i bënin mësuesit e rremë etikës dhe moralit personal (shih 2 Pje. 1:3, 6, 7; 2:9; 3:11). Shih shënimin e plotë në 2 Pje. 1:6.

NASB “njohurisë së vërtetë”
NKJV, NRSV,
NJB “njohurisë”
TEV “njohurisë sonë”

Kjo është një tjetër shpullë ndaj theksit që mësuesit e rremë i vinin njohurisë së fshehtë (shih 2 Pje. 2:20-21). Ungjilli, siç u predikua nga apostujt, është njohuria e vërtetë dhe Jezusi është e vërteta (shih Gjoni 14:6). Kjo është forma e përforuar, *epignōsis*, që ka ngjyrimin kuptimor të njohurisë së përjetuar (shih 2 Pje. 1:2, 3, 8; 2:20). Ungjilli është person dhe duhet përjetuar, jo thjesht të përcaktohet teologjikisht.

■ **“atij, i cili na thirri”** Kjo folje përdoret disa herë në Pjetri (1 Pje. 1:15; 2:9, 21; 3:9; 5:10; 2 Pje. 1:3). Bën gjithmonë fjalë për një thirrje nga Perëndia. Asnjë person nuk vjen te Perëndia po nuk e tërhoqi Fryma (shih Gjoni 6:44, 65; Efe. 1:4-5).

■ **“me anë të lavdisë dhe virtytit të vet”** Ka nja variant në dorëshkrimet greke në këtë pikë.

1. Dorëshkrimet P72, B K, L dhe shumica e dorëshkrimeve minuskule shkruajnë *dia* (përmes) lavdisë dhe virtytit (shih NKJV).
2. Dorëshkrimet Sinaitikus, A, C, P dhe shumica e përkthimeve të lashta shkruajnë *lavdia* dhe virtyti *idia* (i vetë atij) (shih NASB, NRSV, TEV, NJB).

Pyetja eksegetike është: “A thirren besimtarët (1) me anë të cilësive të hyjnisë (pra, Atit ose Birit), ose (2) që të marrin pjesë në këto cilësi?” Komiteti i UBS4 i jep vlerësimin “B” (pothuajse e sigurt) mundësisë 1.

1:4 “Sepse me anë të tyre ai na ka faluar” Kjo është dëftore e kryer mesore (deponente), që përputhet me pjesoren në 2 Pje. 1:3. Fuqia hyjnore e Perëndisë u ka dhënë (dhe vazhdon t’u japë) besimtarëve gjithçka që u nevojitet, si në fillim (shfajësimi), ashtu dhe vazhdimisht (shenjtërimi) me anë të premtimeve të tij.

NASB “premtimet e tij të vyera dhe të mahnitshme”

NKJV “premtimet e tij tejet madhështore dhe të vyera”

NRSV “premtimet e vyera dhe shumë madhështore”

TEV “dhuratat shumë madhështore dhe të vyera që premtoi ai”

NJB “premtimet më madhështore dhe të vyera”

Këto fjalë përshkruese duhet të bëjnë fjalë për ungjillin, me anë të së cilit besimtarët bëhen pjesëmarrës të natyrës hyjnore (pra, me anë të Frymës së Shenjtë brendabanues). Shpresa e njerëzimit të rënë është karakteri i patundur dhe i hirshëm i Perëndisë, i shprehur përmes premtimeve të tij (pra, në DHV, dhe veçanërisht në Krishtin, Heb. 6:17-18). Rendi i këtyre dy fjalëve luhetet në dorëshkrimet greke.

Fjala “të vyera” përdoret në 1 Pje. 1:19 për gjakun flijues të Krishtit. Kjo fjalë përbën rrënjën e emrit “Timote”.

■ **“pjesëmarrës të natyrës hyjnore”** Bëhet fjalë për (1) Frymën e Shenjtë brendabanues (shih 2 Pje. 1:3), që vjen në shpëtim, ose (2) është një tjetër mënyrë për të nënkuptuar rilindjen (shih 1 Pje. 1:3, 23). Kjo ndryshon shumë nga koncepti filozofik grek (ndonëse si terminologji vjen nga stoikët) i shkëndijës hyjnore në gjithë njerëzit që nga krijimi. Kjo nuk do të thotë se jemi perëndi, apo se do të jemi ndonjëherë të tillë, por synimi hyjnor është që të jemi si Jezusi (shih Rom. 8:29; Efe. 1:4; Gjoni 3:2). Besimtarët duhet të modelojnë karakteristikat familjare të Perëndisë (pra, shëmbëllimin e Perëndisë). Fjala “hyjnor” që përdoret, si në 2 Pje. 1:3 dhe 4, është *theios*, që do të thotë “i perëndishëm” ose “si perëndia”.

■ **“duke i shpëtuar”** Kjo fjalë shfaqet vetëm në 2 Pjetrit në DHR (shih 2 Pje. 1:4; 2:18, 20). Kjo është pjesore aoriste veprorë, që nënkupton një veprim të përmbushur (pra, shpëtimin, koha e pranimit të ungjillit, shih 2 Pje. 1:1).

■ **“shprishjes që tani është në botë me anë të epshit”** Çështja te 2 Pjetrit është se mësuesit e rremë po përkrahnin një njohuri të veçantë e të fshehtë (pra, gnosticizmi), por përçmonin jetesën e përditshme e të perëndishme (shih 1 Pje. 1:14; 2:11; 4:3; 2 Pje. 2:10, 18). Kapitulli një i përgjigjet këtij gabimi në 2 Pje. 1:3-11!

Jeta e besimtarëve është provë (jo bazë) për kthimin e tyre të vërtetë në besim (shih Jakobi dhe 1 Gjonit). Kush s’ka fryt, s’ka rrënjë (shih Marku 4:1-20).

1:5 “Pikërisht për të njëjtën arsye” Bëhet fjalë për reagimin e besimtarëve ndaj dhuntive dhe premtimeve të Perëndisë në 2 Pje. 1:3-4 (shih Fil. 2:12-13). Shih Temën e Veçantë: Veset dhe Virtytet në 1 Pje. 4:3.

NASB “duke ushtruar çdo zell... shtoni”

NKJV “duke i dhënë çdo zell, shtoni”

NRSV “duhet të bëni çdo përpjekje që ta mbështesni”

TEV “bëni të pamundurën që t’i shtoni”

NJB “bëni maksimumin që ta mbështesni”

Fjalë për fjalë, do të thotë “duke sjellë çdo zell, shtoni...” Kjo është pjesore aoriste veprore, e përdorur si urdhërore; folja tjetër është urdhërore aoriste veprore. Perëndia na ka siguruar në mënyrë të mahnitshme shpëtimin (shih 2 Pje. 1:3-4); tani, besimtarët duhet të ecin në të (shih 2 Pje. 1:5-7). Ungjilli është absolutisht falas nga (1) vullneti i Perëndisë; (2) vepra e përfunduar e Krishtit; dhe (3) tërheqja e Frymës; por, pasi ungjilli pranohet duhet të bëhet dishepullizim i përditshëm, që na kushton gjithçka. Ky është paradoksi i ungjillit. Është dhuratë (shih Gjoni 4:10; Rom. 3:24; 6:23; Efe. 2:8; Heb. 6:4), por edhe besëlidhje me privilegje dhe përgjegjësi. Ungjilli i vërtetë të prek mendjen, zemrën dhe dorën!

■ **“besimin”** Kjo fjalë ka një sërë ngjyrimesh të veçanta kuptimore.

1. sfondi i saj në DHV do të thotë “besnikëri” ose “besueshmëri”
2. pranimi ose marrja nga ana jonë e ofertës falas të faljes së Perëndisë në Krishtin
3. jetesa besnike dhe e perëndishme
4. ndjesia kolektive e besimit të krishterë ose e së vërtetës për Jezusin (shih Veprat 6:7 dhe Juda, 3 20)

Në këtë kontekst (shih 2 Pje. 1:1) bën fjalë për pranimin e Krishtit si Shpëtimtar. Tani, besimtarët duhet të rriten dhe të zhvillohen.

Kjo rritje e pritur e të krishterit shprehet dhe në Rom. 5:3-4; Jakobi 1:3-4.

TEMË E VEÇANTË: RITJIA E KRISHTERË (tiparet) (SPECIAL TOPIC: CHRISTIAN GROWTH [characteristics])

Romakëve 5:3-4

Mundimet prodhojnë
* këmbëngulje
* karakter të sprovuar
* shpresë (shih v. 2)

Galatasve 5:22-23

Fryti i Frymës
* dashuri
* gëzim
* paqe
* durim
* mirëdashje
* mirësi
* besnikëri
* butësi
* vetëkontroll

Jakobi 1:3-4

Sprovimi prodhon
* qëndresë
* pjekuri
1. patundshmëri
2. plotësi

2 Pjetrit 1:5-7

Shfaqni zell
* moral të lartë
* njohuri
* vetëkontroll
* këmbëngulje
* perëndishmëri
* mirësi vëllazërore
(*filadelfia*)
* dashuri të krishterë
(*agapë*)

■ **“virtytin tuaj moral”** Kjo cilësi u përdor për Krishtin (ose Perëndinë Atë) në 2 Pje. 1:3. Është një nga frytet e Frymës (shih Gal. 5:22-23). Është antonim i “teprimit” (shih 2 Pje. 2:3, 14). Shih Temën e Veçantë: Veset dhe Virtytet në DHR në 1 Pje. 4:2.

■ **“njohurinë”** Njohuria (*gnōsis*) e ungjillit, që çon në ngjashmëri me Krishtin, është diçka e mrekullueshme. Mësuesit e rremë po përkrahnin një njohuri të rreme që çon në shturje.

■ **“vetëkontrollin”** Ky virtyt përshkruan dikë që është i aftë ta mbajë nën kontroll tërheqjen egocentrike të natyrës së rënë mëkatore (shih Veprat 24:25; Gal. 5:23; Titit 1:8). Në disa kontekste (p.sh., 1 Kor. 7:9) aludon për aktivitetin e palejueshëm seksual dhe, për shkak të prirjeve antinomiane të mësuesve të rremë, mund ta përfshijë dhe këtu këtë ngjyrim kuptimor.

■ **“qëndresën”** Kjo fjalë nënkupton qëndresën aktive, të vullnetshme dhe të patundur. Është tipar i perëndishëm i durimit në lidhje me njerëzit dhe rrethanat (shih Rom. 5:3-4; Jakobi 1:3).

■ **“perëndishmërinë”** Kjo është një fjalë kaq e rëndësishme në letrat pastorale si dhe në 2 Pjetrit (shih shënimin në 2 Pje. 1:3), sa që dua të citoj nga komentari im, vëllimi 9, për 1 Timoteun 4:7:

“Ky është term kyç në letrat pastorale. Bën fjalë për rrjedhojat doktrinale dhe në jetën e përditshme të ungjillit (shih 1 Tim. 3:16). Përshkruan, jo të veçantën, por të pritshmen. Është një fjalë e

përbërë nga “e mirë” (*eu*) dhe “adhurim” (*sebomai*). Adhurimi i vërtetë është jeta përditshme me anë të mendimit të duhur (shih 1 Tim. 4:16a). Vini re sa herë përdoret kjo fjalë në letrat pastorale:

1. emër (*eusebeia*), 1 Tim. 2:2; 3:16; 4:7 8; 6:3, 5, 6, 11; 2 Tim. 3:5; Titit 1:1
2. ndajfolje (*eusebēs*), 1 Tim. 5:4
3. Termi i ngjashëm *theosebeia*, 1 Tim. 2:10
4. Termi i mohuar (alfa mohore, pra, *asebeia*), 2 Tim. 2:16; Titit 2:12” (f. 53)

1:7

NASB, NKJV “mirëdashjen vëllazërore... dashurinë”

NRSV “mirëdashjen reciproke me dashuri”

TEV “dashamirësinë dhe dashurinë e krishterë”

NJB “mirësinë për vëllezërit me dashuri”

Kjo është fjala e përbërë greqisht *fileo* (pra, dua) dhe *adelphos* (pra, vëlla). Përdoret dhe në 1 Pje. 1:22. Në këtë kontekst, bën fjalë për vëllezërit dhe motrat e besëlidhjes.

Shpesh, thuhet se *fileo* bën fjalë për një dashuri më të ulët se *agapeo* (shih 2 Pje. 1:7), por, në greqishten koine këto fjalë janë sinonimike (shih Gjoni 5:20, që e përdor fjalën *fileo* për dashurinë e Atit për Jezusin). Megjithatë, këtu dhe në Gjoni 21 mund të ketë një dallim të qëllimshëm.

1:8 “Sepse nëse” Kjo nuk është forma e zakonshme e një fjalie kushtore në greqisht (p.sh., NJB: megjithatë, në *Word Pictures in the New Testament*, A. T. Robertson e identifikon këtë frazë si dy pjesore të tashme veprare rrethanore [kushtore], shih vëll. 6, f. 151), por përbën të dhënat e shprehura të nevojshme për sigurinë e shpëtimit, që bazohet në një jetë të ndryshuar (dhe në ndryshim e sipër) pendimi, besimi, bindjeje, shërbese dhe qëndrese. Jeta e përjetshme (pra, natyra hyjnore) ka disa karakteristika të vëzhgueshme.

1. besimtarët shfaqin cilësi të krishtera, 2 Pje. 1:5-7
2. besimtarët i kanë këto cilësi dhe po i shtojnë (të dyja janë pjesore të tashme veprare), 2 Pje. 1:8
3. besimtarët janë të dobishëm dhe të frytshëm për Perëndinë, 2 Pje. 1:8
4. besimtarët e jetojnë në praktikë njohurinë e vërtetë të Perëndisë (pra, ngjashmërinë me Krishtin, shih 2 Pje. 1:8).

■ **“as të padobishëm, as të pafryt”** Tragjikisht, kjo është tepër shpesh gjendja shpirtërore e besimtarëve.

1. të padobishëm ose joproduktivë – Jakobi 2:20
2. të pafrytshëm – Mat. 7:16-19; 13:22; Marku 4:19; Kol. 1:10; Titit 3:14
3. Pali e përdor këtë fjalë në paralajmërimin: “mso merrni pjesë në veprat e pafrytshme të errësirës”

Kujdes nga mungesa e fryteve, ose nga frytet e këqija! Jeta e përjetshme ka tipare të vëzhgueshme. Kush s’ka fryte, s’ka rrënjë!

1:9 Ndërsa 2 Pje. 1:8 përshkruan të krishterin e vërtetë, 2 Pje. 1:9 përshkruan besimtarët që po ndikohen nga dikotomia e gabuar e mësuesve të rremë njohuri—jetë, teologji—etikë, ortodoksi—ortopraksi!

■ **“dritëshkurtër”** Fjalë për fjalë, do të thotë “pulis sytë”, “mbyll njërin sy”, “picërroj sytë”. Metaforikisht, përdoret për dikë që përpqej të shihte qartë, por e kishte të pamundur, ndoshta ngaqë ia kthente qëllimisht shpinën dritës (shih *The Vocabulary of the Greek Testament: Illustrated from the Papyri and Other Non-Literary Sources*, nga James Hope Moulton dhe George Milligan, f. 420).

NASB “pasi ka harruar pastrimin nga mëkatet e mëparshme”

NKJV “ka harruar që ishte pastruar nga mëkatet e vjetra”

NRSV “harron pastrimin nga mëkatet e shkuara”

TEV “keni harruar që jeni pastruar nga mëkatet e shkuara”

NJB “duke harruar sesi i ishin pastruar mëkatet e të shkuarës”

Kjo nënkupton se këta ishin besimtarë, por ishin joshur nga mësuesit e rremë që të ndiqnin mënyrën e paperëndishme pagane të jeteës (shih 2 Pjetrit 2). Çfarë tragjedi!

1. Kjo mënyrë jetese nuk sjell gëzim, paqe, apo siguri

2. Kjo mënyrë jetese pengon ungjillizimin
3. Kjo mënyrë jetese shkatërron shërbesën e frytshme
4. Kjo mënyrë jetese sjell vdekje të parakohshme

Në këtë frazë, Pjetri po flet për pastrimin nga mëkati, që ndodh përmes vdekjes zëvendësuese të Krishtit në vendin tonë (shih 1 Pje. 1:18; 2:24; 3:18).

1:10 “jini edhe më të zellshëm” Kjo është urdhërore aoriste veprare. Kjo fjalë (shih 2 Pje. 1:15; 3:14) mund të ketë kuptimin:

1. bëj diçka shpejt (shih Titit 3:12)
2. bëj të pamundurën (shih Efe. 4:3)
3. jam i zellshëm (shih Veprat 20:16; Gal. 2:10)

Alternativa #3 duket më e sakta (shih NRSV).

NASB “për ta bërë të sigurt”

NKJV “për ta bërë... të sigurt”

NRSV “për të vërtetuar”

TEV “për ta bërë... të qëndrueshëm”

NJB “kurrë mos lejoni... të lëkundenit”

Kjo fjalë përdoret në tre mënyra.

1. e sigurt për shkak se është vërtetuar plotësisht (shih Rom. 4:16)
2. e besueshme (shih 2 Pje. 2:19 dhe Heb. 3:14; 6:19)
3. e verifikueshme (e përdorur në papiruset në greqishten koine në Egjipt për garancitë ligjore, si vleftësimi i një testamenti)

Të krishterët mund të kenë sigurinë e shpëtimit (shih Fil. 2:12-13; 1 Gjonit 5:13). Shih Temën e Veçantë më poshtë.

TEMË E VEÇANTË: SIGURIA E SHPËTIMIT (SPECIAL TOPIC: ASSURANCE)

- A. A mund ta dinë të krishterët se janë të shpëtuar (shih 1 Gjonit 5:13)? 1 Gjonit ka tre prova ose dëshmi.
 1. Doktrinë (besimi) (shih v. 1,5,10; 2:18-25; 4:1-6,14-16; 5:11-12)
 2. Të stilit të jetesës (bindja) (shih 2-3; 2:3-6; 3:1-10; 5:18)
 3. Shoqërore (dashuria) (v. 2-3; 2:7-11; 3:11-18; 4:7-12, 16-21)
- B. Siguria e shpëtimit është bërë çështje denominacionale
 1. Gjon Kalvini e bazonte sigurinë e shpëtimit në zgjedhjen e Perëndisë. Ai thoshte se nuk mund të jemi kurrë të sigurt në këtë jetë.
 2. Gjon Uezli e bazonte sigurinë në përjetimin fetar. Ai besonte se ne kemi aftësinë të jetojmë pa kryer mëkate të njohura.
 3. Katolikët romakë dhe denominacioni “Kisha e Krishtit” e bazojnë sigurinë e shpëtimit në kishën e autoritetshme. Grupi të cilit i përket njeriu është çelësi për të patur siguri shpëtimi.
 4. Shumica e ungjillorëve e bazojnë sigurinë në premtimet e Biblës, që lidhet me frytin e Frymës (shih Gal. 5:22-23) në jetën e besimtarit (pra, ngjashmërinë e përditshme me Krishtin).
- C. Unë mendoj se siguria parësore e njerëzimit të rënë lidhet me karakterin e Perëndisë triumfues
 1. dashuria e Perëndisë Atë
 - a. Gjoni 3:16; 10:28-29
 - b. Romakëve 8:31-39
 - c. Efesianëve 2:5, 8-9
 - d. Filipianëve 1:6
 - e. 1 Pjetrit 1:3-5
 - f. Gjoni 4:7-21
 2. veprimet e Perëndisë Bir
 - a. vdekja për hirin tonë
 - 1) Veprat 2:23

- 2) Romakëve 5:6-11
- 3) 2 Korintasve 5:21
- 4) 1 Gjonit 2:2; 4:9-10
- b. lutja kryepriftërore (Gjoni 17:12)
- c. ndërmjetësimi i vazhdueshëm
 - 1) Romakëve 8:34
 - 2) Hebrenjve 7:25
 - 3) 1 Gjonit 2:1
3. shërbesa e Perëndisë Frymë
 - a. thirrja (Gjoni 6:44, 65)
 - b. vulosja
 - 1) 2 Korintasve 1:22; 5:5
 - 2) Efesianëve 1:13-14; 4:3
 - c. dhënia e sigurisë
 - 1) Romakëve 8:16-17
 - 2) 1 Gjonit 5:7-13
- D. Por njerëzit duhet t'i përgjigjen ofertës së besëlidhjes së Perëndisë (qoftë në fillim, ashtu dhe në vazhdimësi)
 1. besimtarët duhet t'i kthejnë shpinën mëkatit (pendimi) dhe të kthehen te Perëndia përmes Jezusit (besimi)
 - a. Marku 1:15
 - b. Veprat 3:16, 19; 20:21
 2. besimtarët duhet të marrin ofertën e Perëndisë në Krishtin (shih Temën e Veçantë: Ç' do të thotë "pranoj", "besoj", "rrëfej", "i bëj thirrje"?)
 - a. Gjoni 1:12; 3:16
 - b. Romakëve 5:1 (dhe, në mënyrë të ngjashme, 10:9-13)
 - c. Efesianëve 2:5, 8-9
 3. besimtarët duhet të vazhdojnë në besim
 - a. Marku 13:13
 - b. 1 Korintasve 15:2
 - c. Galatasve 6:9
 - d. Hebrenjve 3:14
 - e. 2 Pjetrit 1:10
 - f. Juda 20-21
 - g. Zbulesa 2:2-3, 7, 10, 17, 19, 25-26; 3:5, 10, 11, 21
- E. Siguria e shpëtimit është e vështirë sepse
 1. shpesh, besimtarët kërkojnë disa përjetime që nuk premtohen në Bibël
 2. shpesh, besimtarët nuk e kuptojnë plotësisht ungjillin
 3. shpesh, besimtarët vazhdojnë të mëkatojnë me dashje (shih 1 Kor. 3:10-15; 9:27; 1 Tim. 1:19-20; 2 Tim. 4:10; 2 Pje. 1:8-11)
 4. disa lloje personaliteti (pra, perfeksionistët) s'e pranojnë dot kurrë pranimin dhe dashurinë e pakushtëzuar të Perëndisë
 5. në Bibël ka shembuj rrëfimesh të rreme besimi (shih Mat. 13:3-23; 7:21-23; Marku 4:14-20; 2 Pje. 2:19-20; 1 Gjonit 2:18-19; shih Temën e Veçantë: Femohimi)

Shih Temën e Veçantë: Siguria e krishterë, për një përvijim të ndryshëm të kësaj doktrine.

■ **“thirrjen... prej tij”** “Tij” nuk është në tekstin greqisht, por nënkuptohet nga 2 Pje. 1:3. Shpresa më e lartë e besimtarëve është në karakterin e Atit, veprën e Birit dhe tërheqjen e Frymës. Sidoqoftë, këto vërtetohen në besimtarin si individ në jetën e tij të besimit, perëndishmërisë, etj. (shih 2 Pje. 1:5-7; Fil. 2:12-13). Perëndia lidhet me njerëzimin me anë të një marrëdhënie besëlidhjeje. Ai e përcakton axhendën. Ai e nis takimin. Ai na tërheq te vetja, por ne duhet që, fillimisht dhe vazhdimisht, t'i përgjigjemi me pendim, besim, shërbesë, bindje dhe qëndresë. Ungjilli është një person që duhet mirëpritur, një e vërtetë që duhet besuar, dhe një jetë që duhet jetuar! Nëse njëra prej tyre lihet jashtë, shpëtimi i pjekur biblik bëhet i pamundur.

TEMË E VEÇANTË: I THIRRUR (SPECIAL TOPIC: CALLED)

Perëndia është gjithmonë ai që merr nismën në thirrjen, zgjedhjen dhe tërheqjen e besimtarëve të vetja (shih Gjoni 6:44, 65; 15:16; 1 Kor. 1:1-2; Efe. 1:4-5, 11). Fjala “thirrje” përdoret në një sërë kuptimesh teologjike.

- A. Në DHV, “thirrja e emrit” është gjithmonë në kontekstin e adhurimit (Zan. 4:26; 12:8, 21:33; 26:25; Eks. 34:5)
- B. Mëkatarët thirren për shpëtim me anë të hirit të Perëndisë (shih Eks. 34:6-7) përmes punës së përfunduar të Krishtit dhe përmes bindjes së Frymës (pra, *kletos*, shih Rom. 1:6-7; 9:24, që është e ngjashme teologjikisht me 1 Kor. 1:1-2 dhe 2 Tim. 1:9; 2 Pje. 1:10).
- C. Mëkatarët i bëjnë thirrje emrit të Zotit që të shpëtohen (pra, *epikaleo*, shih Veprat 2:21; 22:16; Rom. 10:9-13). Kjo thënie është shprehje judaike për adhurimin.
- D. Besimtarët i bëjnë thirrje Emrit të tij në kohë krize dhe nevojë (shih Veprat 7:59).
- E. Besimtarëve iu bëhet thirrje që të jetojnë si Krishti (pra, *klesis*, shih 1 Kor. 1:26; 7:20; Efe. 4:1; Fil. 3:14; 2 Thes. 1:11; 2 Tim. 1:9).
- F. Besimtarët thirren për detyra shërbese (shih Veprat 13:2; 1 Kor. 12:4-7; Efe. 4:1).

■ **“dhe zgjedhjen tuaj”** Emri përdoret *eklogē* gjithmonë për zgjedhjen që bën Perëndia.

1. Jakobi/Izraeli – Rom. 9:11
2. Mbetja besnike – Rom. 11:5, 28
3. Besimtarët e DHR – Rom. 11:7
4. Kisha – 1 Thes. 1:4; 2 Pje. 1:10

Shih Temën e Veçantë në Marku 13:20 dhe 1 Pjetrit 1:2.

■ **“për sa kohë që i praktikoni këto gjëra, nuk do të pengoheni kurrë”** “Këto gjëra” bën fjalë për 2 Pje. 1:3-7. Jeta e përvetshme ka tipare të vëzhgueshme.

Gramatika (pra, forma mohore e dyfishtë) dhe fjala *pote* (pra, “në çdo kohë”, ose “kurdoherë”) u jep siguri të madhe besimtarëve të vuajtur në mes të vuajtjeve dhe përndjekjes (1 Pjetrit) dhe kundër mësimëve të rreme (2 Pjetrit).

Në *Word Pictures in the New Testament*, vëll. 6, f. 153, A. T. Robertson e identifikon foljen “praktikoj” (pra, *poieō*) si pjesore të tashme veprorë rrethore [kushtore], si te 2 Pje. 1:8. NASB, NKJV, NRSV dhe TEV përfshijnë dhe pjesëzën kushtore anglisht “if” [nëse] në përkthimet e tyre (si 2 Pje. 1:8).

■ **“nuk do të pengoheni kurrë”** Kjo është një strukturë gramatikore (mohore e dyfishtë dhe mënyra lidhore), që është mënyra më e fortë për të mohuar një thënie. E njëjta e vërtetë shprehet në Juda 24.

Megjithatë, ashtu si Hebrenjve (shih Heb. 2:1-4; 3:7-4:11; 5:11-6:12; 10:9-39; 12:14-29), edhe 2 Pjetrit përmban disa paralajmërime tronditëse (shih 2 Pje. 2:1 20-22; 3:17). Shpëtimi është i sigurt (shih 1 Pje. 1:4-6), por duhet ruajtur.

TEMË E VEÇANTË: FEMOHIMI (AFISTĒMI) (SPECIAL TOPIC: APOSTASY [APHISTĒMI])

Ky term greqisht, *afistēmi*, ka fushë të gjerë semantike. Gjithsesi, termi anglisht “apostasy” [shqip, “femohim”] rrjedh nga ky term dhe e paragjykon përdorimin e tij në mendjen e lexuesve anglishtfolës. Si gjithmonë, konteksti është ka vlerë kyçe, dhe jo ndonjë përcaktim paraprak.

Kjo është një fjalë e përbërë nga parafjala *apo*, që do të thotë “prej” ose “larg nga” dhe *histēmi*, “ulem”, “qëndroj”, ose “ngulis”. Vini re përdorimet e mëposhtme (joteologjike):

1. heq fizikisht
 - a. nga tempulli, Luka 2:37
 - b. nga një shtëpi, Marku 13:34
 - c. nga një njeri, Marku 12:12; 14:50; Veprat 5:38
 - d. nga të gjitha gjërat, Mat. 19:27, 29
2. heq politikisht, Veprat 5:37
3. heq nga ana e marrëdhënies, Veprat 5:38; 15:38; 19:9; 22:29

4. heq ligjërisht (divorcoj), LiP. 24:1, 3 (LXX) dhe DhR, Mat. 5:31; 19:7; Marku 10:4; 1 Kor. 7:11
5. largoj një borxh, Mat. 18:27
6. tregoj moskokëçarje duke u larguar, Mat. 4:20; Gjoni 4:28; 16:32
7. tregoj preokupim duke mos u larguar, Gjoni 8:29; 14:18
8. lejoj ose jap leje, Mat. 13:30; 19:14; Marku 14:6; Luka 13:8

Në kuptimin teologjik, edhe FOLJA ka përdorim të gjerë:

1. anuloj, fal, largoj fajin e mëkatit, Eks. 32:32 (LXX); Num. 14:19; Jobi 42:10 dhe DhR, Mat. 6:12, 14-15; Marku 11:25-26
2. i qëndroj larg mëkatit, 2 Tim. 2:19
3. neglizhoj duke u larguar prej
 - a. Ligjit, Mat. 23:23; Veprat 21:21
 - b. Besimit, Ezek. 20:8 (LXX); Luka 8:13; 2 Thes. 2:3; 1 Tim. 4:1; Heb. 3:12

Besimtarët e sotëm bëjnë shumë pyetje teologjike që shkrimtarëve të DhR as nuk u kanë shkuar kurrë në mendje. Një prej këtyre lidhet me prirjen moderne për ta ndarë besimin nga besnikëria.

Ka persona në Bibël që përfshihen në popullin e Perëndisë dhe ndodh diçka.

I. Dhiata e Vjetër

- A. Ata që dëgjuan lajmin e dymbëdhjetë (dhjetë) spiunëve, Numrat 14 (shih Heb. 3:16-19)
- B. Korahu, Numrat 16
- C. Bijtë e Elit, 1 Samuelit 2, 4
- D. Sauli, 1 Samueli 11-31
- E. Profetët e rremë (shembuj)
 1. LiP. 13:1-5; 18:19-22 (mënyrat si të njihet profeti i rremë)
 2. Jeremia 28
 3. Ezekieli 13:1-7
- F. Profeteshat e rreme
 1. Ezekieli 13:17
 2. Nehemia 6:14
- G. Drejtuesit e ligj të Izraelit (shembuj)
 1. Jeremia 5:30-31; 8:1-2; 23:1-4
 2. Ezekieli 22:23-31
 3. Mikea 3:5-12

II. Dhiata e Re

- A. Fjalë për fjalë, ky term greqisht do të thotë “femohim”. Dhiata e Vjetër dhe ajo e Re konfirmojnë shtimin e ligësisë dhe mësimin të rremë përpara Ardhjes së Dytë (shih Mat. 24:24; Marku 13:22; Veprat 20:29,30; 2 Thes. 2:9-12; 2 Tim. 4:4). Kjo fjalë, ndoshta, reflekton fjalët e Jezusit në Shëmbëlltyrën e Farës, që gjendet në Mateu 13; Marku 4; dhe Luka 8. Qartazi, këta mësues të rremë nuk ishin të krishterë, por vinin nga brenda (shih Veprat 20:29-30; 1 Gjonit 2:19); megjithatë, ata janë në gjendje të joshin dhe të bëjnë për vete besimtarët e papjekur (shih Heb. 3:12).

Pyetja teologjike është kjo: a kishin qenë ndonjëherë besimtarë këta mësues të rremë? Është e vështirë t’i përgjigjemi, pasi në kishat lokale kishte mësues të rremë (shih 1 Gjonit 2:18-19). Shpesh, traditat tona teologjike ose denominacionale i përgjigjen kësaj pyetjeje pa i referuar pasazheve të veçanta biblike (përveç metodës së “pasazhit-provë”, pra, e citimit të një vargu jashtë konteksti gjoja për të provuar anshmërinë tënde).

B. Besim në dukje

1. Juda, Gjoni 17:12
2. Simon Magjistari, Veprat 8
3. Ata që përmenden te Mat. 7:13-23
4. Ata që përmenden te Mateu 13; Marku 4; Luka 8
5. Judenjtë e Gjonit 8:31-59
6. Aleksandri dhe Himeneu, 1 Tim. 1:19-20
7. Ata të 1 Tim. 6:21
8. Himeneu dhe Fileti, 2 Tim. 2:16-18

9. Dema, 2 Tim. 4:10
 10. Mësuesit e rremë, 2 Pjetri 2:19-22; Juda v. 12-19
 11. Antikrishtët, 1 Gjonit 2:18-19
- C. Besim pa fryt
1. 1 Korintasve 3:10-15
 2. 2 Pjetrit 1:8-11

Ne rrallëherë mendojmë për këto pasazhe për shkak se teologjia jonë sistematike (kalvinizëm, arminianizëm, etj.) na dikton përgjigjen e detyruar. Ju lutem, mos më paragjykoni pse po e shtroj këtë temë. Preokupimi im është procedura e saktë hermeneutike. Duhet t'i lejojmë Biblës të na flasë dhe s' duhet të përpiqemi ta fusim Biblën brenda një teologjie të paracaktuar. Shpesh, kjo është e dhimbshme dhe tronditëse për shkak se një pjesë e mirë e teologjisë sonë është denominacionale, kulturore, ose sociale (prindi, miku, pastori), jo biblike. Disa që janë në Popullin e Perëndisë dalin se nuk janë pjesë e Popullit të Perëndisë (p.sh., Rom. 9:6).

1:11 “mbretërinë e përjetshme” Bëhet fjalë për mbretërimin e përjetshëm të JHVH-së dhe Mesisë së tij (shih Isa. 9:7; Dan. 7:14, 27; Luka 1:33; 1 Tim. 6:16; Zbu. 11:15; 22:5). Nuk bëhet fjalë për mbretërinë mijëvjeçare; madje asnjë pasazh tjetër në DHR (përveç Zbu. 20) nuk flet për këtë mbretëri, ndonëse disa shohin një aludim të fshehtë të saj në 1 Kor. 15:25-28. Unë nuk e shoh një aludim të tillë.

■ **“Zotit dhe Shpëtimtarit”** E njëjta frazë përdorej dhe për perandorin romak. Është një titull i rrallë, i përdorur shpesh në këtë letër (shih 2 Pje. 1:11; 2:20; 3:2, 18).

■ **“do t’ju sigurohet begatisht hyrja”** Kjo është dëftore e ardhme pësore. Forma urdhërore u përdor në 2 Pje. 1:5. Perëndia do t’i përmbushë të gjitha nevojat e besimtarëve (shih 2 Pje. 1:3). Besimtarët urdhërohen që të reagojnë si duhet në dritën e furnizimit të Perëndisë (shih 2 Pje. 1:4). Përgjigjja e tyre nuk iu siguronte pranimin nga Perëndia, por ishte provë se ata ishin pranuar tashmë prej tij.

TEKSTI I NASB (I PËRDITËSUAR): 2 PJETRIT 1:12-15

¹²Prandaj, do të jem gjithmonë gati t’ju kujtoj këto gjëra ndonëse ju i dini tashmë dhe jeni të themeluar në të vërtetën që është e pranishme ndër ju. ¹³Më duket e drejtë, për sa kohë që jam në këtë banesë tokësore, që t’ju mbaj zgjuar me anë të kujtesës, ¹⁴duke ditur se lënia e kësaj banese tokësore nga ana ime është e afërt, siç ma ka bërë të qartë dhe Zoti ynë Jezu Krisht. ¹⁵Dhe, gjithashtu do të jem i zellshëm që, në çdo kohë pas largimit tim, të jeni në gjendje t’i kujtoni këto gjëra.

1:12 “Prandaj” Në bazë të të vërtetave të ungjillit në 2 Pjetrit 1.

■ **“do të jem gjithmonë gati t’ju kujtoj këto gjëra”** Kjo është temë e përsëritur (shih 2 Pje. 1:12-13, 15; 3:1-2; Fil. 3:1; Juda 5, 17). Këto të vërteta të ungjillit duhen përsëritur vazhdimisht për njohurinë e besimtarëve të rinj dhe për përforcimin e besimtarëve të pjekur.

Vargjet 12-15, shpesh, identifikohen si një gjini letrare e quajtur “dëshmi”. Zakonisht, ajo përbënte fjalët e fundit të dikujt përpara vdekjes (shih Joz. 23-24; 1 Sam. 12; 2 Tim. 4:6-8; 2 Pje. 1:12-15).

■ **“jeni të themeluar”** Kjo është pjesore e kryer pësore. Mund të bëjë fjalë për (1) predikimin e ungjillit, ose (2) shfaqjet e mrekullueshme. Vini re fuqinë e Perëndisë (diateza pësore) që i jep stabilitet besimtarit (shih 1 Pje. 5:10). Por besimtarët duhet ta ruajnë këtë qëndrim (shih 2 Pje. 3:17; 1 Pje. 5:9).

■ **“në të vërtetën”** Fjalët “e vërtetë/i vërtetë/i besueshëm” janë koncepte kaq të rëndësishme biblike sa që dua të ndaj me ju dy tema të veçanta të nxjerra nga komentari im për shkrimet e Gjonit (vëllimi 4).

TEMË E VEÇANTË: “E VËRTETA” (SI KONCEPT) NË SHKRIMET E GJONIT (SPECIAL TOPIC: “TRUTH” [THE CONCEPT] IN JOHN’S WRITINGS)

Në njëfarë kuptimi, Gjoni kombinon sfondin hebraik me sfondin greke në rastin e *alētheia*, “e vërteta”, siç bëri dhe me *logos* (shih 1:1-14). Hebraishtja (shih Temën e Veçantë: Besoj, Besim dhe Besueshmëri në DHV) nënkupton diçka që është e vërtetë, ose e besueshme (shpesh, shoqërohet në Septuagintë me *pisteuō*). Në greqisht, kjo fjalë lidhet me realitetin e Platonit përkundër jorealitetit, qiellores përkundër tokësore. Kjo përputhet me dualizmin e Gjoni. Perëndia e ka zbuluar qartë veten (etimologjia e *alētheia* është “nxjerr në dritë, zbuloj, demonstroj qartazi”) në Birin e vet. Kjo shprehet në disa mënyra.

1. EMRI, *alētheia*, e vërteta
 - a. Jezusi është plot hir e të vërtetë (shih 1:14, 17 – terma të besëlidhjes në DhV)
 - b. Jezusi është fokusi i dëshmisë së Gjoni Pagëzorit (shih 1:32-34; 18:37 – profeti i fundit i DhV)
 - c. Jezusi thotë të vërtetën (shih 8:40, 44, 45, 46 – zbulues është e shprehshme dhe personale)
 - d. Jezusi është udha, e vërteta dhe jeta (shih 14:6)
 - e. Jezusi i shenjtëron në të vërtetën (shih 17:17)
 - f. Jezusi (*Logos*, 1:1-3) është e vërteta (shih 17:17)
 2. MBIEMRI, *alēthēs*, e vërtetë, e besueshme
 - a. Dëshmia e Jezusit (shih 5:31-32; 7:18; 8:13-14)
 - b. Gjikimi i Jezusit (shih 8:16)
 3. MBIEMRI, *alēthinos*, e vërtetë
 - a. Jezusi është drita e vërtetë (shih 1:9)
 - b. Jezusi është buka e vërtetë (shih 6:32)
 - c. Jezusi është hardhia e vërtetë (shih 15:1)
 - d. Jezusi është dëshmia e vërtetë (shih 19:35)
 4. NDAJFOLJA, *alēthōs*, vërtet
 - a. Dëshmia e samaritanëve për Jezusin si Shpëtimtar i botës (shih 4:42)
 - b. Jezusi është vërtet ushqim dhe pije, në dallim nga mana e kohës së Moisiut (shih 6:55)
- Termi “e vërtetë” dhe fjalët që rrjedhin prej saj shprehin dhe dëshminë e të tjerëve për Jezusin, *alēthēs*
- a. Dëshmia e Gjoni Pagëzorit është e vërtetë (shih 10:41)
 - b. Dëshmia e Gjoni (autorit të ungjillit) është e vërtetë (shih 19:35; 21:24)
 - c. Jezusi shihet si profeti i vërtetë (shih 6:14; 7:40)

Për një diskutim të mirë të së vërtetës në DhV dhe në DhR, shih George E. Ladd, *A Theology of the New Testament*, f. 263-269.

TEMË E VEÇANTË: “I VËRTETË” NË SHKRIMET E GJONIT (SPECIAL TOPIC: “TRUE” [THE TERM] IN JOHN’S WRITINGS)

1. Perëndia Atë
 - b. Perëndia është i vërtetë/i besueshëm (shih Gjoni 3:33; 7:18,28; 8:26; 17:3; Rom. 3:4; 1 Thes. 1:9; 1 Gjoni 5:20; Zbu. 6:10)
 - c. Rrugët e Perëndisë janë të vërteta (shih Zbu. 15:3)
 - d. Gjykimet e Perëndisë janë të vërteta (shih Zbu. 16:7; 19:2)
 - e. Thëniet e Perëndisë janë të vërteta (shih Zbu. 19:11)
2. Perëndia Bir
 - a. Biri është i vërtetë/e vërteta
 - 1) drita e vërtetë (shih Gjoni 1:9; 1 Gjoni 2:8)
 - 2) hardhia e vërtetë (shih Gjoni 15:1)
 - 3) plot me hir dhe të vërtetë (shih Gjoni 1:14, 17)
 - 4) ai është e vërteta (shih Gjoni 14:6; 8:32)
 - 5) ai është i vërtetë (shih Zbu. 3:7, 14; 19:11)
 - b. Dëshmia e Birit është e vërtetë (shih Gjoni 18:37)
3. Mund të ketë kuptim krahasues
 - a. Ligji i Moisiut në dallim nga hiri dhe e vërteta e Jezusit (shih Gjoni 1:17)

- b. Tabernakulli në shkretëtirë në dallim nga tabernakulli qiellor (shih Heb. 8:2; 9:1)
4. Siç ndodh shpesh te Gjoni, kjo fjalë ka një sërë ngjyimesh kuptimore (hebraike dhe greke). Gjoni i përdor të gjitha për të përshkruar Atin dhe Birin si persona, si folës, dhe si mesazhin e tyre, i cili u duhet transmetuar ndjekësve të tyre (shih Gjoni 4:23; 19:35; Heb 10:22; Zbu. 22:6).
 5. Për Gjonin, këto dy mbiemra përshkruajnë Atin si të vetmin hyjni të besueshëm (shih 5:44; 1 Gjoni 5:20) dhe Jezusin si zbuluesin e tij të vërtetë dhe të plotë duke pasur si synim faktet shpenguese, jo thjesht ato njohëse!

NASB “që është e pranishme ndër ju”

NKJV “në të vërtetë e pranishme”

NRSV “që ka ardhur te ju”

TEV “që keni marrë”

NJB (kjo frazë s’përmendet”

Fjalë për fjalë kjo frazë është “në të vërtetë e tanishme”. Si është e pranishme “e vërteta”? E vërteta është edhe (1) besnikëria e karakterit dhe fjalës të Perëndisë, edhe (2) një përshkrim i Jezusit dhe një mënyrë për t’iu referuar mesazhit të ungjillit (pra Fjalës së Gjallë dhe Fjalës së Shkruar).

Fjala “e pranishme” është *parousē*, që përdoret për ta përshkruar Ardhjen e Dytë të Krishtit si “prani” të tij (shih 2 Pje. 1:16; 3:4, 12).

1:13 “banesë tokësore” Edhe Pali e përdor këtë frazë në 2 Kor. 5:1-10 për t’iu referuar trupit të vet fizik. Vargjet 14 dhe 15 tregojnë qartazi se Pjetri priste që të martirizohej së shpejti.

1:14 “Zoti ynë Jezu Krisht” Ky titull duhet të ketë nënkuptuar disa të vërteta teologjike për lexuesit judeo-kristianë të shekullit të parë.

■ **“Zoti”** Fjala greke *Zot* (*kurios*) mund të përdoret në mënyrë të përgjithshme, ose në një kuptim të zhvilluar teologjik. Mund të ketë kuptimin “zotëri”, (shih Gjoni 4:11), “pronar”, “bashkëshort”, ose “Perëndia-njeri i plotë” (shih Gjoni 9:36, 38). Përdorimi i kësaj fjale në DHV (hebraisht, *adon*) erdhi nga ngurrimi i judenjve për të shqiptuar emrin e Perëndisë së besëlidhjes, JHVH, nga fjala hebraisht “jam” (shih Eks. 3:14). Shih Temën e Veçantë: Emrat e Perëndisë në Marku 12:36. Ata kishin frikë mos thyenin urdhërimin që thoshte: “Nuk do ta marrësh emrin e Zotit, Perëndisë tënd, më kot” (shih Eks. 20:7; LiP. 5:11). Prandaj, ata mendonin se, po ta shqiptonin, mund ta merrnin më kot. Kështu, e zëvendësuan me fjalën hebraisht *adon*, që kishte një kuptim të ngjashëm me fjalën greke *kurios* (Zot). Autorët e DHR e përdornin këtë term për të përshkruar natyrën e plotë hyjnore të Krishtit. Frazja “Jezusi është Zot” ishte shpallje publike besimi dhe formulë pagëzimi në kishën e hershme (shih Rom. 10:9-13; 1 Kor. 12:3; Fil. 2:11).

■ **“Jezu”** Kjo fjalë hebraisht do të thotë “JHVH shpëton”, ose “JHVH sjell shpëtim”. Iu zbulua prindërve të Jezusit nga një engjëll (shih Mat. 1:21). “Jezus” vjen nga fjala hebraisht “shpëtim” *hosea*, me një prapashtesë që nënkupton emrin e Perëndisë së besëlidhjes, JHVH. Është e njëjta fjalë si emri hebraisht Jozue.

■ **“Krisht”** Ky është ekuivalenti grek i fjalës hebraisht *mesia*, që donte të thoshte “i vajosuri”. Nënkupton “dikë që është thirrur dhe pajisur nga Perëndia për një detyrë të caktuar”. Në DHV vajoseshin tre grupe drejtuesish: priftërinjtë, mbretërit dhe profetët. Jezusi i përmbush të tria këto ofiqe të vajosura (shih Heb. 1:2-3).

■ **“ma ka bërë të qartë”** Kjo mund të bëjë fjalë për vdekjen e Pjetrit (shih Gjoni 13:36), ose për mënyrën e vdekjes së tij, që Zoti ia kishte zbuluar Pjetrit në Gjoni 21:18-19.

1:15 “pas largimit tim” Kjo është fjala “eksod” (shih Luka 9:31), e përdorur në kuptimin e vdekjes (pra, është eufemizëm), ose për kthimin në qiell.

■ **“të jeni në gjendje t’i kujtoni këto gjëra”** Mund të bëhet fjalë për letrën e 1 Pjetrit, 2 Pjetrit, ose për ungjillin e Markut (sipas Ireneut). Pjetri e kuptonte se Fryma do t’ia përdorte shkrimet e tij pas vdekjes. Duhet ta ketë kuptuar se Fryma po fliste përmes tij në mënyrë që të krishterët ta lexonin dhe ta përdornin pas vdekjes!

TEKSTI I NASB (I PËRDITËSUAR): 2 PJETRIT 1:16-18

¹⁶Sepse ne nuk ndoqëm përralla të sajuara me mjeshtëri kur jua bëmë të ditur fuqinë dhe ardhjen e Zotit tonë Jezu Krisht, por ishim dëshmitarë okularë të madhësisë së tij. ¹⁷Sepse, kur ai mori nder dhe lavdi nga Perëndia Atë, këto fjalë të tilla u thanë për të nga Lavdia e Madhërisme: “Ky është Biri im i dashur, ne të cilin jam i kënaqur”, ¹⁸dhe vetë ne e dëgjuam këtë thënie të bërë nga qielli kur ishim me të në malin e shenjtë.

1:16

NASB “përralla të sajuara me mjeshtëri”

NKJV “fabula të shpikura me dinakëri”

NRSV “mite të shpikura me mjeshtëri”

TEV “histori të shpikura”

NJB “mite të shpikura me mjeshtëri”

Kjo është pjesore e kryer pësore, që nënkupton një gjendje të vazhdueshme mashtrimi (koha e kryer), i shkaktuar nga një veprues i paidentifikuar dhe i jashtëm (diateza pësore), që mund të kenë qenë vetë mësuesit e rremë, ose i ligu. Fjalën “mit” e marrim pikërisht nga kjo fjalë greqisht, që gjendet vetëm në

1. 1 Tim. 1:4; 4:7
2. 2 Tim. 4:4
3. Titit 3:9, 14
4. 2 Pje. 1:16

Meqë këta mësues të rremë (nga përshkrimi i 2 Pjetrit 2) ishin proto-gnostikë me disa prirje judaike (pra, #2), këto mite mund të bëjnë fjalë për

1. nivelet engjëlllore midis perëndisë së shenjtë dhe qenieve më të ulëta shpirtërore (aeonat) dhe emrat e tyre të fshehtë
2. gjenealogjitë e Mesisë si njeriu qiellor, i veçuar nga Krishti i vërtetë njerëor
3. ndarja e qëllimshme teologjike e shpëtimit nga etika/morali

Për një diskutim të dobishëm të mënyrave të ndryshme si përdoret emri “mit”, shih G. B. Caird, *The Language and Imagery of the Bible*, kapitujt 12-13, f. 201-243.

■ “ardhjen e Zotit tonë” Kjo është një tematikë qëndrore e kësaj letre. Fjala *parousia*, e përcaktuar si “ardhje” ose “pranim” (e njëjta rrënjë si te 2 Pje. 1:12), përdoret në papiruset (në greqishten koine) për vizitën mbretërore të një mbreti. Emri *parousia*, zakonisht, bën fjalë për Ardhjen e Dytë (shih 2 Pje. 3:4, 12), por mund të bëjë fjalë dhe për Mishërimin. Edhe këtu mund të ketë këtë kuptim për shkak të aludimit kontekstual të Shpërfytyrimit në frazën vijuese.

TEMË E VEÇANTË: TERMA PËR ARDHJEN E DYTË (SPECIAL TOPIC: TERMS FOR THE SECOND COMING)

Ka një sërë fjalësh dhe frazash që bëjnë fjalë për kthimin e Jezusit.

1. *Parousia* (shih Jakobi 5:7), që do të thotë “prani”, bënte fjalë për vizitën e mbretit (shih Mat. 24:3,27,37,39; 1 Kor. 15:23; 1 Thes. 2:19; 3:13; 4:15; 5:23; 2 Thes. 2:1,8; Jakobi 5:7,8; 2 Pje. 1:16; 3:4,12; 1 Gjonit 2:28)
2. *Epifaneia*, “shfaqja sy për sy” (1 Tim. 6:14; 2 Tim. 1:10; 4:1, 8; Titit 2:13)
3. *Apokalupsis*, “heqje veli”, ose “zbulesë” (1 Kor. 1:7; 2 Thes. 1:7; 1 Pje. 1:5, 13; 4:13; 5:1).
4. “Dita e Zotit” dhe variantet e kësaj fraze (shih Temën e Veçantë: Dita e Zotit)

DhR në tërësi u shkrua brenda botëkuptimit të DhV, që pohonte

1. një epokë e tanishme, e ligë dhe rebele
2. një epokë e re e ardhshme drejtësie
3. një epokë që do të vijë me anë të Frymës nëpërmjet veprës së Mesisë (të Vajosurit).

Supozimi teologjik i zbulesës përparuese është i nevojshëm për shkak se autorët e DhR e modifikojnë disi pritshmërinë e Izraelit. Në vend të një ardhjeje ushtarake dhe nacionaliste (izraelite) të Mesisë, ka dy

ardhje. Ardhja e parë është mishërimi i hyjnisë në ngjizjen dhe lindjen e Jezusit të Nazaretit. Ai erdhi si “shërbëtor i përvuajtur” jo ushtarak, jo gjyqësor, i Isa. 53; po kështu, ai erdhi si kalorësi i përulur mbi kërricin e një gomari (jo një kali lufte apo mushke mbretërore) i Zak. 9:9. Ardhja e parë inauguroi Epokën e Re Mesianike, mbretërinë e Perëndisë në tokë (shih Temën e Veçantë: Mbretëria e Perëndisë). Në një kuptim, mbretëria është këtu, por, sigurisht, në një kuptim tjetër, është ende larg. Pikërisht ky tension midis dy ardhjeve të Mesisë, në njëfarë kuptimi, është mbivendosja e dy epokave judaike që ishin të paparë, ose të paktën të paqarta, në DhR (shih Temën e Veçantë: Kjo Epokë dhe Epoka e Ardhme). Në të vërtetë, kjo ardhje e dyfishtë thekson përkushtimin e JHVH-së për të shpenguar gjithë njerëzimin (shih Zan. 3:15; 12:3; Eks. 19:5 dhe predikimin e profetëve, veçanërisht Isaisë dhe Jonës; shih Temën e Veçantë: Plani i Përjetshëm Shpengues i JHVH).

Kisha nuk po pret përmbushjen e profecisë së DhV, sepse shumica e profecive kanë të bëjnë me ardhjen e parë (shih *Si ta lexosh Biblën për gjithë vlerën që ka*, f. 165-166). Ajo që presin besimtarët është ardhja e lavdishme e të ringjallurit Mbret mbi Mbretër dhe Zot mbi Zotër, përmbushja e pritur historike e epokës së re të drejtësisë në tokë, ashtu si dhe në qiell (shih Mat. 6:10). Përshkrimet simbolike të DhV nuk ishin të pasakta, por të paplota. Ai do të vijë sërish, ashtu siç parathanë profetët me fuqinë dhe autoritetin e JHVH-së (shih Temën e Veçantë: Pse duken kaq të ndryshme premtimet e besëlidhjes së DHV nga premtimet e besëlidhjes së DHR?).

Ardhja e Dytë nuk është term biblik, por ky koncept është botëkuptimi dhe korniza e gjithë DhR. Perëndia do ta vërë gjithçka në vendin e vet. Bashkësia mes Perëndisë dhe njerëzimit të krijuar në shëmbëllimin e tij do të ripërtërihet (shih Zbulesa 21-22). Ligësia do të gjykohej dhe shfaroset (shih Zbu. 20:11-15). Synimet e Perëndisë nuk mund (dhe nuk do të) dështojnë!

■ **“ne ishim dëshmitarë okularë të madhësisë së tij”** Kjo pohon autorësinë e Pjetrit, pasi ai ishte dëshmitar okular i jetës tokësore të Jezusit. Në mënyrë të veçantë këtu bëhet fjalë për Shpërfytyrimin (shih 2 Pje. 1:18; dhe Marku 9:2-8). Kjo frazë përdoret dhe për ata që hynin në fetë e mistereve duke përjetuar njëjtësinë me perëndinë e sektit. Pjetri, si dhe Pali, shpesh përdorte frazat e kundërshtarëve si mjet për t’i kundërshtuar, ose për t’u dhënë kuptimin e saktë.

Jezusi përshkruhet me fjalën “madhështi”. Në vargun tjetër (shih 2 Pje. 1:17), Perëndia Atë identifikohet me të njëjtën fjalë: “Lavdi Madhështore”. Thelbi i hyjnisë brenda Jezusit iu zbulua rrethit të ngushtë të dishepujve (pra, Pjetrit, Jakobit dhe Gjonit) në mal.

1:17 “nder dhe lavdi” Ndoshta bëhet fjalë për “Lavdinë *Shekina*” (kështu e quajnë rabinët renë në Eksod dhe në Numrat), reja prej së cilës fliste Perëndia (shih Marku 9:2-8). Shih Temën e Veçantë: Lavdi (*Doksa*) në 1 Pjetrit 1:21.

■ **“Atë”** Shih Temën e Veçantë në Marku 13:32.

■ **“fjalë”** Rabinët e quajnë këtë *Bath Kol* (pra, një zë nga qielli), që ishte konfirmim i vullnetit të Perëndisë gjatë kohës prej Malakisë e deri te Gjon Pagëzori, kur nuk kishte më zë profetik. Ati e miratoi Jezusin, si në pagëzim, ashtu dhe në Shpërfytyrimin në Mal (shih Marku 1:11; Mat. 17:5-6).

■ **“Biri im i dashur”** Ky është titull mesianik nga Psa. 2:7.

■ **“në të cilin jam i kënaqur”** Ky është aludim i Isa. 42:1 (shih Mat. 3:17; 17:5). Duke lidhur Psalmin 2 me Isainë 42, Pjetri thekson, si aspektet mbretërore, ashtu dhe ato të shërbëtorit të përvuajtur, të Mesisë. Këto dy aspekte përcaktojnë dhe dy ardhjet e tij: Mishërimi = Shërbëtori i Përvuajtur; Ardhja e Dytë – Mbret dhe Gjykatës!

TEKSTI I NASB (I PËRDITËSUAR): 2 PJETRIT 1:19-21

¹⁹Kështu, e kemi fjalën profetike edhe më të sigurt, së cilës bëni mirë t’i kushtoni vëmendje si një llambë që shkëlqen në një vend të errët, derisa dita të agojë dhe ylli i mëngjesit të lindë në zemrat tuaja.

²⁰Por dini këtë, para së gjithash, se asnjë profeci e Shkrimit nuk është çështje interpretimi personal,

²¹sepse asnjë profeci nuk u bë asnjëherë nga një akt i vullnetit njerëzor, por burrat e shtyrë nga Fryma e

1:19 “fjalën profetike” Bëhet fjalë, ose (10 për tekstet e DHV (pra, 2 Pje. 1:17), ose (2) për dëshminë apostolike në DHR (shih 2 Pje. 1:12; 1 Gjonit 1:1-5).

■ **“edhe më të sigurt”** Zbulesa e Perëndisë në DHV vërtetohet nga zbulesa në DHR. Pa dyshim, DHV është kyçe për të kuptuar plotësisht DHR (shih Marku 1:1-3).

Gjithë ky paragraf lidhet me Ardhjen e Dytë të vonuar, të cilën disa kishin filluar ta vinin në dyshim. Pjetri dëshiron që t'i sigurojë lexuesit me anë të

1. përjetimit që pati vetë ai për epokën e re (pra, Shpërfytyrimi i Jezusit)
2. përmbushjes së profecisë në jetën, mësimet, vdekjen dhe ringjalljen e Jezusit

Dita e re ka mbërritur dhe do të përmbushet (pra, ashtu si llamba ndriçon, apo si Afërdita që lind). Shih F. F. Bruce, *Answers to Questions*, f. 130.

■ **“një llambë që shkëlqen në një vend të errët”** Ky është aludim për Psa. 119:105 dhe, ndoshta, për Fja. 6:23. Perëndia i ka siguruar njerëzimit të rënë gjithë informacionin e nevojshëm për t'iu përgjigjur atij me besim (pra, zbulesa, frymëzimi dhe përndritja). Vetëzbulesa e Perëndisë përmes DHV dhe, në mënyrën më të lartë, përmes Krishtit, që është e shkruar dhe e shpjeguar nga autorët e DHR, është plotësisht e mjaftueshme (ndonëse jo shteruese). Kjo zbulesë (DHV dhe DHR) është si drita që ndriçon në errësirën e mëkatit dhe rebelimit njerëzor dhe engjëllor. Por, një ditë, drita shumë më e shkëlqyer (pra, takimi ballë për ballë me Krishtin) do të ndriçojë zemrën dhe mendjen e çdo besimtari. Synimi i zbulesës nuk është informacioni, por shpëtimi (pra, bashkësia e rimëkëmbur dhe e ngushtë me Perëndinë).

Mësuesit e rremë pretendonin se kishin një zbulesë të veçantë nga perëndia i tyre, por Pjetri pohon se Jezusi është vetëzbulesa e plotë dhe e kompletuar e Perëndisë.

■ **“ylli i mëngjesit”** Fjalë për fjalë, “mbartësi i dritës”, ose “ylli i ditës” (shih Zbu. 2:28; 22:16). Nga kjo fjalë greke kemi marrë dhe fjalën “fosfor”. Ky aspekt i shkëlqimit të dritës ka një sërë ngjyrimesh kuptimore nga DHV.

1. Lidhet me fjalën hebraisht *helel*, që përkthehet “ylli i mëngjesit” (në latinisht “Lucifer”, shih Isa. 14:12), që zakonisht bën fjalë për planetin e Afërditës.
2. Lidhet me Mesian e ardhshëm në Num. 24:17 (pra, “një yll do të dalë nga Jakobi”) dhe Mal. 4:2 (pra, “dielli i drejtësisë do të lindë”).
3. Lidhet me shenjtorët e ringjallur në Dan. 12:3 (pra, “do të shkëlqejë fort si shkëlqimi i kupës qiellore”).
4. Lidhet me Mesinë mbretëror dhe të ringjallur në Zbu. 22:16 (pra, “pasardhja e Davidit, dielli i shkëlqyer i mëngjesit”).

■ **“të lindë në zemrat tuaja”** Në kontekst, bën fjalë për përballjen ekzistenciale me Perëndinë që ndodh nga vetëzbulesa e tij në Shkrim (DHV), në Jezusin (mishërimi) dhe në shkrimet e apostujve (DHR). Në një çast të caktuar, njerëzit e rënë kanë një çast “eureka”, ku kuptojnë situatën. E vërteta e Perëndisë shpërthen brenda vetëdijes sonë. Ky proces syhapjeje dhe bindjeje udhëhiqet nga Fryma e Shenjtë (shih Gjoni 6:44, 65).

Krishterimi nis si takimi dhe reagimi me besim i individit ndaj Perëndisë në Krishtin. Kjo çon në një përjetim kolektiv të dashurisë dhe shërbesës familjare (shih 1 Kor. 12:7). Shih Temën e Veçantë: Zemra, në Marku 2:6.

1:20 “Shkrimet” Kjo është një nga ato vargjet e shumta të DHR që flasin për vetëzbulesën e Perëndisë në DHV dhe në DHR (pra, në Shkrimet).

1. Mateu 5:17-19
2. 1 Korintasve 2:9-13
3. 1 Thesalonikasve 2:13
4. 2 Timoteut 3:16
5. 1 Pjetrit 1:23-25
6. 2 Pjetrit 1:20-21
7. 2 Pjetrit 3:15-16

Thelbi i gjithë këtyre vargjeve është se Shkrimi vjen nga Perëndia dhe është i Perëndisë; nuk ka origjinë njerëzore. Perëndia i frymëzoi shkruarit (shih 2 Pje. 1:20-21) dhe shkrimet e tyre (shih 2 Tim. 3:16).

■ **“çështje interpretimi personal”** Kjo frazë sigurisht që shpjegon tensionin që po shkaktonin mësuesit e rremë nëpër kisha. Ka gjasa që ata po citonin Shkrimet dhe, pastaj, po iu jepnin interpretimin e tyre mashtures (gjë që ndodh rëndom dhe sot).

Në kontekst, është e vështirë të dimë nëse kjo frazë ka parasysh (1) shkruarit e DHV, apo (2) mësuesit e rremë të kohës së Pjetrit. Nëse mundësia e parë është e vërtetë, kjo frazë bën fjalë për konceptin teologjik të frymëzimit (shih 2 Tim. 3:16). Vargu vijues duket se e përkrah këtë interpretim. Nëse është e vërtetë mundësia e dytë, vargu bën fjalë për konceptin teologjik të përndritjes (pra, se Fryma i udhëheq besimtarët kur interpretojnë Biblën).

Duhet thënë se koncepti ungjillor i “priftërisë së besimtarit”, zakonisht, kuptohet kështu: Fryma na jep aftësinë që ta interpretojmë vetë Biblën. Mirëpo, biblikisht, kjo frazë bën fjalë për kishën si vepruese e përmbushjes së Porosisë së Madhe: shih 1 Pje. 2:5, 9; Zbu. 1:6. Vini re se, në DHV (pra, Eks. 19:6) dhe në DHR, fraza “priftëri e besimtarëve” është shumës (pra, kolektive), jo individuale.

1:21 “burrat e shtyrë nga Fryma e Shenjtë” Fjalë për fjalë, “transportuar”, që është pjesore e tashme pësore. Kjo ia shton theksin të vërtetës se Bibla është mesazhi i Perëndisë, jo i njeriut! Është e vërtetë se Bibla u shkrua me fjalë njerëzore, por njerëzit që e shkruan u udhëhoqën nga Fryma. Bibla nuk është e vërtetë shteruese, pasi asnjë njeri nuk mund ta kuptojë atë nivel realiteti, por është e vërtetë besnike dhe e mjaftueshme për Perëndinë, mëkatën, shpëtimin, jetesën e perëndishme dhe përjetësinë.

Metoda e saktë e frymëzimit ndryshon.

1. Theofanitë
2. Urimi dhe Thumimi/shorti
3. Ëndrrat
4. Vegimet
5. Gjendjet ekstatike
6. Engjëjt
7. Aktet simbolike
8. Ngjarjet e veçanta dhe interpretimet e tyre

Pyetjet që mbeten janë këto: (1) Perëndia jepte përmbajtjen dhe autori njerëzor jepte formën, apo (2) të dyja këto i jepte Perëndia?

PYETJE PËR DISKUTIM

Ky është një komentuar studimor udhëzues, që do të thotë se ti je vetë përgjegjës për interpretimin e Biblës. Secili prej nesh duhet të ecë sipas dritës që ka. Ti, Bibla dhe Fryma e Shenjtë keni përparësi në interpretim. Nuk duhet t’ia dorëzosh këtë të drejtë komentuesit.

Këto pyetje për diskutim t’i kam dhënë për të të ndihmuar që të analizosh çështjet kryesore të kësaj pjese të librit. Ato synojnë të të nxisin mendimin, jo të kenë natyrë shteruese.

1. A është jeta e krishterë kryesisht vepër e Perëndisë, apo e jona?
2. Çfarë pjese luajnë njerëzit në marrëdhënien me Perëndinë?
3. A mund të ndahet jetesa e krishterë nga shpëtimi?
4. A është i kushtëzuar shpëtimi?
5. Çfarë mësimi të rremë po kundërshtonte Pjetri në këtë letër?
6. Cila është domethënia e fjalëve të Atit në 2 Pje. 1:19?
7. Çfarë thonë vargjet 20-21 për Biblën?

2 PJETRIT 2

NDARJET NË PARAGRAFË TË PËRKTHIMEVE MODERNE

UBS ⁴	NKJV	NRSV	TEV	NJB
Profetët dhe mësuesit e rremë	Doktrinat shkatërruese	Sulmi ndaj mësuesve të rremë	Mësuesit e rremë	Mësuesit e rremë
2:1-3	2:1-3 Fati përfundimtar i mësuesve të rremë	2:1-3	2:1-3	2:1-3 Mësimet nga e shkuara
2:4-10a	2:4-11	2:4-10a	2:4-10a	2:4-10a Ndëshkimi i ardhshëm
2:10b-16	Sthurja e mësuesve të rremë 2:12-17	2:10b-16	2:10b-16	2:10b-12 2:13-16
2:17-22	Mashtrimet e mësuesve të rremë 2:18-22	2:17-22	2:17-22	2:17-22

CIKLI TRE I LEXIMIT (shih f. v)

NDJEKJA E SYNIMIT TË AUTORIT FILLESTAR NË NIVELIN E PARAGRAFËVE

Ky është një komentuar studimor udhëzues, që do të thotë se ti je vetë përgjegjës për interpretimin e Biblës. Secili prej nesh duhet të ecë sipas dritës që ka. Ti, Bibla dhe Fryma e Shenjtë keni përparësi në interpretim. Nuk duhet t'ia dorëzosh këtë të drejtë komentuesit.

Lexo gjithë kapitullin njëherësh. Identifiko temat. Krahaso ndarjet e tua tematike me pesë përkthimet moderne. Ndarja në paragrafë nuk është e frymëzuar, por është çelësi për të ndjekur synimin e autorit fillestar, gjë që është thelbi i interpretimit. Secili paragraf ka vetëm një temë të vetme.

1. Paragrafi i parë
2. Paragrafi i dytë
3. Paragrafi i tretë
4. Etj.

MËSIMET KONTEKSTUALE NGA 2 PJETRIT 2:1-22

- A. Kjo pjesë paralelizon librin e Judës. Këtu kemi huazim letrar, por s'është e qartë kush huazoi nga tjetri. Ndoshta, Juda po aludon për profecinë e Pjetrit për shkak se, pas vdekjes, ajo është përmushur (NET Bible).
- B. Këta mësues të rremë duket se ishin antinomianë, proto-gnostikë me një angjelologji tejet të zhvilluar (që, ndoshta, reflekton ndikimin pers; shih 1 Tim. 6:3-5). Të gjitha rrëfimet e DHV që përmenden përfshijnë, në mënyra të ndryshme, engjëjt.
- C. Pjetri përfiton nga njohuria e përbashkët në kohën e tij (rrëfimet e DHV; *1 Enokut*; burimet pagane).
- D. Bibla është tejet e vagullt për origjinën, rënien dhe veprimtaritë e botës engjëllore. Mos lejo që kureshtja jote të shkojë përtej informacionit që na ka dhënë Perëndia (pra, mos u bë si romanet e sotme).

- E. Kemi një listë të zgjeruar të tipareve të mësuesve të rremë
1. prezantojnë fshehtazi herezi shkatërruese (2 Pje. 2:1)
 2. mohojnë Zotërinë (2 Pje. 2:1)
 3. ndjekin epshet (2 Pje. 2:2)
 4. janë lakmitarë (2 Pje. 2:3)
 5. përçmojnë autoritetin (2 Pje. 2:10)
 6. veprojnë si shtazë (2 Pje. 2:12)
 7. kërkojnë kënaqësinë (2 Pje. 2:13)
 8. minojnë festat e dashurisë të të krishterëve (2 Pje. 2:13)
 9. i bëjnë besimtarët e dobët të mëkatojnë (2 Pje. 2:14)
 10. premtojnë liri, por vetë janë skllëvër (2 Pje. 2:19).

STUDIMI I FJALËVE DHE FRAZAVE

TEKSTI I NASB (I PËRDITËSUAR): 2 PJETRIT 2:1-3

¹Por u ngritën dhe profetë të rremë mes popullit, ashtu si do të ketë dhe mësues të rremë mes jush, të cilët do të fusin fshehurazi herezi shkatërrimtare, duke mohuar dhe Zotërinë që i bleu, duke sjellë mbi vete shkatërrim të shpejtë. ²Shumë do të ndjekin epshet e tyre, dhe për shkak të tyre udha e së vërtetës do të shahet; ³dhe, në lakminë e tyre, do t'ju shfrytëzojnë me fjalë të rreme; gjykimi i tyre prej qyshkur nuk është përtac, dhe shkatërrimi i tyre nuk është në gjumë.

2:1 “profetë të rremë” Profetët e vërtetë diskutohen në 2 Pje. 1:19-21. DHV i përmend shpesh profetët e rremë (shih LiP. 13:1-5, 18:19-22; 1 Mbre. 18:19, 22:6 e më tej; Jer. 5:3, 23:9-18); kjo ndodh dhe në DHR (shih Mat. 7:15; 24:11,24; Marku 13:22; Luka 6:26; Veprat 13:6; 2 Pje. 2:1; 1 Gjonit 4:1; Zbu. 16:13; 19:20; 20:10). Shih Temën e Veçantë: Femohimi (*Afistemi*) në 2 Pjetrit 1:10.

▣ **“u ngritën... mes popullit”** Bëhet fjalë për popullin e Perëndisë në DHV. Vini re paralelizmin mes dy fjalive të para (përsëritet “mes”). Vini re se profetët e rremë dolën nga mesi i popullit të Perëndisë, jo nga jashtë.

▣ **“mësues të rremë”** Shenjat në 2 Pjetrit 2 tregojnë se këta ishin proto-agnostikë. Shih Temën e Veçantë: Gnostikët në 1 Pje. 3:22.

▣ **“fusin fshehurazi”** Kjo fjalë e përbërë nga *para* dhe *eisagō* ka ngjyrimin kuptimor (përvidhem përbri”) (shih Gal. 2:4 dhe Juda, vargu 4).

▣ **“herezi shkatërrimtare”** Fjala “herezi” (ndasi) përdoret në tri mënyra në DHR.

1. sekt ose grup fetar (shih Vepat 24:14; 26:5)
2. ndarje brenda krishterimit (shih 1 Kor. 11:19)
3. mësim që janë kundër ortodoksisë

Zakonisht, ato janë përzierje e së vërtetës me gabiin. Shpesh, zmadhojnë një të vërtetë duke përjashtuar disa të vërteta të tjera biblike, ose shtrembërojnë kristologjinë. Herezia vjen gjithmonë nga brenda bashkësisë së krishterë (shih Mat. 7:15-23; 24:24; 1 Tim. 4:1-5; 1 Gjonit 2:18-25). Një përshkrim i veprimeve të tyre mund të shihet në (1) Mësimet Kontekstuale, pika E., dhe (2) në Gal. 5:19.

▣ **“duke mohuar dhe Zotërinë”** Kjo është pjesore e tashme mesore (deponente), që nënkupton refuzimin e vazhdueshëm personal të Krishtit nga mësuesit e rremë. Kjo tregon mohimin e Krishtit (1) me anë të teologjisë, ose (2) mënyrës së jetesës (shih Juda 4). Kjo është e para e katër frazave përshkruese (2 Pje. 2:1-3) të mësuesve të rremë, që mohojnë Zotërinë me anë të

1. veprimeve dhe bindjeve të tyre
2. sjelljes së tyre të shthurur
3. lakmisë së tyre
4. vetëmashtrimit të tyre

Titulli “zotëri” është fjala *despotēs*, që do të thotë “padron”, ose “zotëri”. Përdoret për skllavopronarët (shih 1 Tim. 6:1, 2; Titit 2:9; 1 Pje. 2:18).

Është interesante të vërejmë se fjala “zotëri”, zakonisht, përdoret për Perëndinë Atë (shih Luka 2:29; Veprat 4:24 [që citon nga LXX e Eks. 20:11; ose Psa. 146:6]). Megjithatë, përdoret dhe për Krishtin (shih 2 Tim. 2:21; Juda 4; Zbu. 6:10). Ky është një tjetër titull i Atit që i transferohet Birit për të theksuar natyrën e tij hyjnore.

■ **“që i bleu”** Kjo është pjesore aoriste veprare. Ashtu si 2 Pje. 2:20-22, kjo duket se nënkupton që ata dikur ishin të shpëtuar, por tani jo! Kjo është referencë për (1) shpëtimin që JHVH i bëri popullit të vet në DHV, ose (2) për veprën shpenguese të Krishtit në DHR (shih Marku 10:45; Veprat 20:28; 1 Kor. 6:20; Efe. 1:7; 1 Tim. 2:6; Heb. 2:9; 1 Pje. 1:19; 1 Gjonit 2:2; Zbu. 5:9). Në DHV, blerja e dikujt nga skllavëria (pra, shpengimi) nënkupton çlirimin fizik. Zakonisht, në DHV, kjo fjalë përdoret për shpëtimin. Në DHV, shitja e dikujt në duart e armiqve nënkuptonte gjykim.

NJB ka përkthimin interesant: “i cili iu bleu lirinë”. Me sa duket, këta përkthyes mendojnë se ky kontekst (2 Pje. 2:2-3) bën fjalë për besimtarë që po jetojnë jetë të paperëndishme dhe po turpërojnë Krishtin dhe krishterimin. Pra, kjo bën fjalë për besimtarë që vdesin shpejt për shkak të jetës së tyre të paperëndishme dhe ndikimit të tyre shkatërrimtar.

■ **“duke sjellë mbi vete shkatërrim të shpejtë”** Asnjë besimtar i shekullit të parë nuk do ta kishte bërë këtë pyetje, por besimtarët e sotëm mendojnë shumë për të, veçanërisht në lidhje me faktin sesi grupimi i tyre e shikon sigurinë e besimit! Disa e lidhin këtë frazë me “JHVH-në” ose me “popullin”, që do të lidhej në këtë rast me Eksodin (pra, me endjen në shkretëtirë).

Pyetja e vërtetë është: “A ishin të shpëtuar vërtet heretikët?” Unë besoj se doktrinat biblike na jepen në dyshe dialektike ose paradoksale, diçka karakteristike për literaturën lindore. Lexuesit dhe interpretuesit e sotëm perëndimore priren që t’u japin vargjeve vlerë doktrinale, madje i nxjerrin nga konteksti. Unë, pa dyshim, që besoj në sigurinë e besimtarit, por jam gjithnjë e më i pasigurt për doktrinën “pasi shpëtohesh, je gjithmonë i shpëtuar”, për shkak të pasazheve si ky. Siguria e shpëtimit tregohet (nuk bazohet) nga jetesa e perëndishme (shih Jakobi dhe 1 Gjonit). Besimtarët përpiqen dhe mëkatojnë, por vazhdojnë të besojnë në Krishtin dhe t’i përgjigjen (nganjëherë ngadalë) ndreqjes së Frymës së Shenjtë.

Megjithatë, Shëmbëlltyra e Mbjellësit (shih Mateu 13) dhe fetaristët aktivë, por të humbur, të Mat. 7:15-27, më japin siguri se ekzistojnë dhe rrëfime të rreme besimi (shih 2 Pje. 2:20-22; 1 Gjonit 2:18-19).

Mësuesit e rremë kanë shkaktuar dhe ende shkaktajnë trazirë të madhe në kishë. Në 1 Gjonit na jepen disa teste për besimtarët e vërtetë.

1. gatishmëri për të rrëfyer mëkatën (1 Gjonit 1:5; 2:22)
2. bindja si still jetese (1 Gjonit 2:3-6)
3. dashuria si stil jetese (1 Gjonit 2:7-11)
4. fitore mbi ligësinë (1 Gjonit 2:12-14)
5. braktisje e botës (1 Gjonit 2:15-17)
6. qëndresë (1 Gjonit 2:19)
7. doktrinë (1 Gjonit 2:20-24)

Pjetri rendit dhe veprimet e papërshtatshme të këtyre mësuesve të rremë (shih Mësimet Kontekstuale, E). Nëse është e vërtetë se ungjilli është (1) një person; (2) një mesazh për atë person; dhe (3) një mënyrë jetese që imiton atë person, atëherë këta mësues të rremë i kishin shkelur të tria këto pika. A mundet dikush që “të blihet” nga Jezusi dhe, pastaj, ta mohojë Jezusin? Ky është problemi. Shpëtimi është falas dhe vlen për të gjithë që janë gati të përgjigjen me pendim, besim, bindje dhe qëndresë. Por pjekuria është dishepullizim që kushton gjithçka. Duhet t’i mbajmë fort të dyja këto të vërteta biblike. Doktrina na jepet në dyshe të mbushura me tension, pasi krishterimi nuk është vetëm teologji biblike (shih Rom. 6), por edhe betejë e përditshme (shih Romakëve 7) për perëndishmëri. Shpëtimi është marrëdhënie, jo vendim i izoluar!

2:2 “Shumë do të ndjekin” Sa e madhe tragjedia e mashtrimit të të tjerëve (shih Mat. 18:6-7)! Pjetri e përdor shpesh këtë fjalë të përbërë (shih 2 Pje. 1:16; 2:2, 15, 21; Mat. 18:6)

NASB “epshet e tyre”
NKJV “udhët e tyre shkatërrimtare”
NRSV “udhët e tyre të shthurura”
TEV “udhët e tyre imorale”
NJB “sjelljen e tyre të shthurur”

Fjala *aselgeia* mund të përkthehet “shthurje”, “lapërdharë”, ose “epsh”, që nënkupton aktivitet të shthurur seksual (shih 2 Pje. 2:2, 7, 18; 1 Pje. 4:3; Juda 4). Shpesh, kjo përfshihej në listat e mëkateve të shoqërisë pagane (shih Rom. 13:13; 1 Kor. 12:21; Gal. 5:19).

■ **“për shkak të tyre udha e së vërtetës do të shahet”** Mënyra si jetojnë besimtarët ka vlerë jetike. Ata duhet të pasqyrojnë tiparet familjare të Perëndisë (pra, besimi në Jezusin ia kthen njerëzimit shëmbëllimin e Perëndisë; shih 1 Tim. 6:1; Titit 2:5).

■ **“udha e së vërtetës”** “Udha” ishte emri i hershëm që u përdor për të kristherët (shih Veprat 9:2; 18:25-26; 19:9, 23; 22:4; 24:14, 22). Ajo reflekton konceptin e DHV për besimin biblik si një shteg të shenjuar qartë, të cilin duhet ta ndjekim (shih Psa. 119:105; Fja. 6:23). Kjo frazë i referohet mesazhit të ungjillit. Qartazi, stili i perëndishëm i jetesës është aspekt integral i shpëtimit (Efe. 1:4; 2:10).

■ **“do të shahet”** Paganët i keqkuptonin besimtarët dhe i akuzonin për praktika imorale. Jeta e këtyre mësuesve të rremë i shtonte më tej këto keqinterpretime.

2:3 “në lakminë e tyre” Kjo fjalë ka ngjyime negative kuptimore si në Septuagintë, ashtu dhe në DHR. Mësuesit e rremë karakterizoheshin nga dëshira për të patur gjithnjë e më tepër pa asnjë çmim (shih 2 Pje. 2:14; Mikea 3:11; 1 Tim. 6:5; Titit 1:11; Juda 16). Kjo fjalë përdoret shpesh në DHR (shih Marku 7:22; Luka 12:15; Rom. 1:29; 2 Kor. 9:5; Efe. 5:3; Kol. 3:5; 1 Thes. 2:5; 2 Pje. 2:3,14), pasi karakterizon natyrën egoiste të njerëzimit të rënë. Mund të bëjë fjalë për lakminë financiare, lakminë seksuale, ose vendet e nderit (pra, mësuesit brenda kishave).

■ **“do t’ju shfrytëzojnë”** Versioni i Mbretit Xhejms e përkthen: “do t’ju tregojnë si mall”. Nga kjo fjalë greke marrim dhe termin “emporium”.

NASB “me fjalë të rreme”
NKJV, NRSV “fjalë mashtruese”
NJB “përralla të pavërteta”

Ky mbiemër tregon diçka të modeluar, ose të trilluar (shih Rom. 9:20). Fjalën “plastike” e marrim pikërisht nga kjo fjalë greke. Mësuesit e rremë shkaktonin probleme brenda komunitetit besimtar, si dhe në shoqëri. Jeta e tyre e turpëronte ungjillin dhe mashtrimet e tyre e deformonin mesazhin e ungjillit.

■ **“gjkimi i tyre”** Gjithmonë ka patur mësues të rremë në mes të popullit të Perëndisë. Ata dënoheshin në DHV (shih LiP. 13:1-5, 6-11, 12-18). Gjykimi i tyre i tanishëm, si dhe ai eskatologjik, është i sigurt dhe nuk do të vonohet (shih Gal. 6:7). Në këtë varg, “gjkimi” dhe “shkatërrimi” personifikohen.

Ky është parim shpirtëror. Perëndia është etiko-moral; i tillë është dhe krijimi i tij. Njerëzit ndahen nga standardi i Perëndisë. Kështu, korrim atë që mbjellim. Kjo është e vërtetë, edhe për besimtarët (por nuk e humbasin shpëtimin nga kjo gjë), edhe jobesimtarët (shih Jobi 34:11; Ps. 28:4; 62:12; Fja. 24:12; Pred. 12:14; Jer. 17:10; 32:19; Mat. 16:27; 25:31-46; Rom. 2:6; 14:12; 1 Kor. 3:8; Gal. 6:7-10; 2 Tim. 4:14; 1 Pje. 1:17; Zbu. 2:23; 20:12; 22:12).

TEKSTI I NASB (I PËRDITËSUAR): 2 PJETRIT 2:4-10a

⁴Sepse, nëse Perëndia nuk kurseu engjëjt kur mëkatuan, por i flaku në ferr dhe i dorëzoi në gropat e errësirës, të ruajtur për gjykim; ⁵dhe nuk e kurseu botën e lashtë, por e ruajti Noeun, një predikues drejtësie, me shtatë të tjerë, kur solli një përmbytje mbi botën e të paperëndishmëve; ⁶dhe, nëse i dënoi qytetet e Sodomit dhe Gomorrës me shkatërrim duke i kthyer në hi, pasi i bëri shembull për

ata që do të bënin më vonë jetë të paperëndishme;⁷ dhe nëse e liroi të drejtin Lot, i cili ishte i shtypur nga sjellja e shthurur e njerëzve të çoroditur⁸ (sepse, nga ajo që ai njeri i drejtë shihte dhe dëgjonte ndërsa jetonte mes tyre, bënte që shpirti i tij i drejtë të torturohej përditë nga veprat e tyre të poshtra),⁹ atëherë Zoti e di sesi t'i çlirojë të perëndishmit nga tundimit, dhe të ruajë të paperëndishmit nën ndëshkim për ditën e gjykimit,¹⁰ sidomos ata që kënaqin mishin në dëshirat e tij të shprishura dhe përcmojnë autoritetin.

2:4 “nëse” Kjo është fjali kushtore e rendit të parë, që zakonisht merret si e vërtetë nga pikëvështrimi i autorit, ose për qëllimet e tij letrare. Kjo fillon një fjali të gjatë që vazhdon deri në vargun 10a. Ka gjasa që ky model kushtor duhet përsëritur gjatë gjithë kësaj fjalie të gjatë dhe të koklavitur në greqisht. NRSV përdor “nëse” në 2 Pje. 2:4, 5, 6, 7; NIV përdor “nëse” në 2 Pje. 2:4, 5, 6, 7, 9, por në tekstin greqisht shfaqet vetëm në 2 Pje. 2:4. Ky kontekst përvijon një sërë gjykimesh të DHV në lidhje me engjëjt.

▣ **“engjëjt kur mëkatuan”** Kjo është paralel me vargun e Judës 6. Më poshtë janë disa shënime nga komentari im për Jakobin dhe Judën (vëll. 11).

Shënim nga Komentari për Judën

Juda 6: “Dhe engjëjt që nuk ruajtën vendin e tyre, por braktisën vendbanimin që u takonte, ai i ka ruajtur në pranga të përjetshme nën errësirë për gjykimin e ditës së madhe” Sodomi dhe Gomorra, njësoj si këta engjëj, u zhytën në shthurje të rëndë dhe shkuan pas mishit të huaj. Të dy përdoren si shembuj të atyre që do të ndëshkohen me zjarrin e përjetshëm.

Juda 6 “dhe engjëjt” Ky varg shton engjëjt në listën e atyre që, në fillim adhuruan JHVH-në, por pastaj u rebeluan kundër tij dhe, kështu, u shkatërruan ose u gjykuan. Por cilët engjëj? Na jepen disa të dhëna që përshkruajnë këtë grup të caktuar engjëjsh:

1. nuk e ruajtën vendin e tyre
2. e braktisën vendbanimin që u takonte
3. do të ruhen me pranga të përjetshme nën errësirë për ditën e gjykimit
4. “mëkatuan” (2 Pje. 2:4)
5. “i vendosi në Tartar” (2 Pje. 2:4)
6. “i hodhi në gropa të errësirës, të ruajtur për gjykim” (2 Pje. 2:4)

Cilët engjëj në DHV u rebeluan dhe mëkatuan?

1. engjëjt si pushtetet pas adhurimit pagan
2. qeniet më të ulëta engjëjlore, që thirren me emra të veçantë demoniakë në DHV. Shembuj: Lilith (shih Isa. 34:14), Azazel (shih Lev. 16:8), dhe demonët-dhi (shih Lev. 17:7)
3. “bijtë e Perëndisë” në Zan. 6 (diskutohen shpesh në shkrimet apokaliptike ndërthjatore, *1 Enokut* 86-88; 10; *2 Enokut* 7, 18; *2 Barukut* 56; *Jubiletë* 5)
4. engjëjt e përdorur si shembull nga një shkrim apokaliptik ndërthjator judaik (për shkak të përdorimit që i bëu Juda librave të tjerë të këtij lloji në Juda 9, 14)

NASB “që nuk ruajtën vendin e tyre”

NKJV “që nuk ruajtën vendin që u takonte”

NRSV “që nuk ruajtën pozicionin e tyre”

TEV “që nuk qëndruan brenda caqeve të autoritetit që u takonte”

NJB “që nuk ruajtën autoritetin që kishin”

Ka një lojë fjalësh me kohën e foljes “ruaj” në 2 Pje. 2:6. Engjëjt nuk e ruajtën vendin e tyre (pjesore aoriste veprare), kështu që Perëndia i ka ruajtur në një vend burgimi deri në ditën e gjykimit (dëftore e kryer veprare). Ata engjëj që shkelën vullnetin e Perëndisë do të përballen, edhe me gjykim të përkohshëm, edhe me gjykim eskatologjik, njësoj si rebelët e Izraelit gjatë periudhës së endjes në shkretëtirë, ose si banorët e Sodomit dhe Gomorrës.

Fjala “vend” është *archē* në greqisht, që do të thotë “fillimi” ose “origjina” e diçkaje.

1. fillimi i rendit të krijuar (shih Gjoni 1:1; 1 Gjonit 1:1)
2. fillimi i ungjillit (shih Marku 1:1; Fil. 4:15)
3. dëshmitarët e parë okularë (shih Luka 1:2)
4. shenjat e fillimit (mrekullitë, shih Gjoni 2:11)
5. parimet e fillimit (shih Heb. 5:12)
6. siguria e fillimit (shih Heb. 3:14)

Më vonë, u përdor për “sundimin” ose “autoritetin”

1. për zyrtarët qeverisës njerëzorë
 - a. Luka 12:11
 - b. Luka 20:20
 - c. Romakëve 13:3; Titit 3:1
2. Për autoritetet engjëjlore
 - a. Romakëve 8:38
 - b. 1 Kor. 15:24
 - c. Efe. 1:21; 3:10; 6:10
 - d. Kol. 1:16; 2:10, 15

Këta mësues të rremë përçmojnë çdo autoritet, tokësor apo qiellor qoftë. Ata janë libërtinë antinomianë. Vetën dhe dëshirat e tyre i vendosin përpara Perëndisë engjëjve, autoriteteve civile dhe drejtuesve të kishës.

NASB “por braktisën vendbanimin që u takonte”

NKJV “por e lanë mjedisin e tyre”

NRSV “por e lanë banesën që u takonte”

TEV “por e braktisën vendbanimin e tyre”

NJB “por e lanë sferën që u ishte caktuar”

Këta engjëj e lanë vendin e tyre qiellor dhe shkuan në një tjetër (në tokë). Kjo përputhet mjaft mirë me interpretimin engjëjlor të Zan. 6:1-4. Ky akt përbën refuzimin e qëllimshëm të vullnetit dhe autoritetit të Perëndisë.

■ **“në pranga të përjetshme”** Prangat përdoren për engjëjt në *1 Enokut* dhe Satani lidhet me një “zinxhir të madh” në Zbu. 20:1-2. Fjala “të përjetshme” mund të ketë kuptimin “të fuqishme”, “të mjaftueshme”, “të sigurta”, jo fjalë për fjalë të përjetshme, pasi këta engjëj do të mbahen aty vetëm deri në Ditën e Gjykimit, kur do të përdoren mjete të tjera burgosjeje (shih Zbu. 20:10, 14-15). Ideja është se disa engjëj tani janë të burgosur, në mënyrë që veprimtaria e tyre e ligë të mbahet nën kontroll.

■ **“nën errësirë”** Fjala *Tartar* (nuk përdoret nga Juda, por është e pranishme në 2 Pje. 2:4 dhe *1 Enokut* 20:2) përdoret në mitologjinë greke për të nënkuptuar vendin e burgosjes së titanëve, që ishin gjigandë gjysmënjerëzorë, gjysmëhyjnorë. Kjo përputhet me interpretimin engjëjlor të Zan. 6. *1 Enokut* e përshkruan vendbanimin e ri të këtyre engjëjve rebelë (shih *1 Enokut* 10:5, 12) si vend i përjetshëm errësire. Sa ndryshon kjo nga shkëlqimi qiellor (lavdia)! Rabinët e ndanin *Sheolin* në “parajsë” (për të drejtët) dhe *Tartar* (për të ligjtë). Fjala “humnerë” (shih Luka 8:3; Zbu. 9:1; 11:7; 20:3) është sinonimike me metaforët e errësirës, që përdoren në vargun 13b.

■ **“ditës së madhe”** Kjo është një mënyrë tjetër sesi quhet Dita e Gjykimit, dita kur Perëndia do t’i kërkojë llogari çdo krijesë të vetëdijshme për dhuratën e tij të jetës (shih Fil. 2:10-11; Isa. 45:23; Rom. 14:10-12).

TEMË E VEÇANTË: “Bijtë e Perëndisë” në Zanafilla 6 (SPECIAL TOPIC: “The Sons of God” in Genesis 6)

- A. Ekziston një polemikë e fortë në lidhje me identifikimin e frazës “bjtë e Perëndisë.” Ka pasur tre interpretime kryesore:
1. kjo frazë bën fjalë për pasardhjen e perëndishme të Setit (shih Zan 5)
 2. kjo frazë bën fjalë për një grup qeniesh engjëjlore
 3. kjo frazë bën fjalë për mbretërit ose tiranët e pasardhjes së Kainit (shih Zan. 4)

- B. Të dhënat që kjo frazë bën fjalë për pasardhjen e Setit
1. konteksti i atypëratyshëm letrar i Zan. 4 dhe 5 flet për zhvillimin e pasardhësve rebelë të Kainit dhe e pasardhësve të zgjedhur të Setit. Prandaj, të dhënat e kontekstit duket se përkrahin pasardhësit e perëndishëm të Setit
 2. rabinët janë ndarë në lidhje me mënyrën si e kuptojnë këtë pasazh. Disa thonë se bën fjalë për Setin (por shumica e tyre, për engjëjt).
 3. Frazja shumë “bijtë e Perëndisë,” ndonëse në pjesën dërrmuese përdoret për qeniet engjëjllore, rrallë përdoret edhe për njerëzit
 - a. LiP. 14:1 – “bijtë e JHVH, Perëndisë suaj”
 - b. LiP. 32:5 – “bijtë e tij”
 - c. Eks. 22:8-9; 21:6 (ndoshta, gjykatës levitikë, shih Psa. 82:1)
 - d. Psa. 73:15 – “fëmijët e tu”
 - e. Osea 1:10 – “bijtë e Perëndisë së gjallë”
- C. Të dhënat se kjo frazë bën fjalë për qenie engjëjllore
1. Kjo ka qenë mënyra më tradicionale si është kuptuar ky pasazh. Konteksti më i gjerë i Zanafillës ndoshta e përkrah këtë pikëpamje si një tjetër shembull i ligësisë së mbinatyrshme që përpiqet të pengojë vullnetin e Perëndisë për njerëzimin (rabinët thonë se kjo ndodhi për shkak të smirës).
 2. Frazja në shumës (“bijtë e Perëndisë”) përdoret në shumicën dërrmuese në DHV për engjëjt
 - a. Jobi 1:6
 - b. Jobi 2:1
 - c. Jobi 38:7
 - d. Psalmi 29:1
 - e. Psalmi 89:6, 7
 3. Libri ndërdhjetor i 1 Enokut dhe ai i Jubileve (shih Jobi 5:1), që ishte shumë popullor mes besimtarëve në periudhën e DHR, së bashku me *Apokrifën e Zanafillës* nga Pergamenat e Detit të Vdekur, i interpreton këta si engjëj kryengritës (shih 1 Enokut 12:4; 19:1; 21:1-10).
 4. Konteksti i atypëratyshëm i Zanafillës 6 duket se nënkupton se, nga kjo përzierje e papranueshme e rendit të krijimit lindën “të fuqishmit e lashtësisë, burra të shquar”.
 5. *1 Enokut*, madje, thotë se Përmbytja e Noeut ndodhi për të shkatërruar lidhjen engjëj/njerëz që ishte veprim armiqësor ndaj JHVH-së dhe planit të tij për krijimin (shih *1 Enokut* 7:1 e më tej; 15:1 e më tej; 86:1 e më tej).
- D. Të dhënat se kjo frazë bën fjalë për mbretërit ose tiranët e pasardhjes së Kainit
1. ka një sërë përkthimesh të lashta që mbështesin këtë pikëpamje
 - a. Targumi i Onkelos (shekulli i dytë pas K.) e përkthen frazën “bijtë e Perëndisë” si “bijtë e fisnikëve”
 - b. Simakusi (shekulli i dytë pas K.), në përkthimin e tij greqisht të DHV, e përktheu frazën “bijtë e Perëndisë” si “bijtë e mbretërve”
 - c. fjala “*elohim*” përdoret edhe për krerët e Izraelit (shih Eks. 21:6; 22:8; Psa. 82:1, 6); vini re si e përkthen edhe NIV dhe NET
 - d. *Nefilim* (NIDOTTE, vëll. 3, f. 130, #5) lidhet me termin *gibborim* në Zan. 6:4; *gibborim* vjen nga fjala *gibbor*, që do të thotë “njeri i fuqishëm dhe trim; forcë; pasuri ose fuqi”
 2. ky interpretim dhe provat për të janë marrë nga *Hard Saying of the Bible [Thënie të vështira të Biblës]*, f. 106-108.
- E. Të dhënat historike për mbrojtësit e të dyja këtyre pozicioneve
1. kjo frazë bën fjalë për setitët
 - a. Kirili i Aleksandrisë
 - b. Theodreti
 - c. Augustini
 - d. Jeronimi
 - e. Kalvini
 - f. Kyle

- g. Gleason Archer
- h. Watts
- 2. kjo frazë bën fjalë për engjëjt
 - a. shkruarit e Septuagintës
 - b. Filoja i Aleksandrisë
 - c. Jozefusi (*Lashtësitë* 1:3:1)
 - d. Justin Martiri
 - e. Ireneu
 - f. Klementi i Aleksandrisë
 - g. Tertuliani
 - h. Origeni
 - i. Luteri
 - j. Esvaldi
 - k. Delitzsch
 - l. Hengstenberg
 - m. Olford
 - n. Westermann
 - o. Wenham
 - p. Bibla NET

F. Ç’lidhje kanë “nefilimët” e Zan. 6:4 me “bijtë e Perëndisë” dhe “bijat e njerëzve” te Zan. 6:1-2? Vini re këto teori:

1. Ata ishin gjigantët që lindën nga bashkimi i engjëjve me gratë e njerëzve (shih Urtësinë e Ben Siras 16:7).
2. Nuk kanë aspak lidhje me njëri-tjetrin. Ata përmenden thjesht se ishin në tokë në kohën e këtyre ngjarjeve (Zan. 6:1-2) si dhe më vonë.
3. R. K. Harrison, në *Introduction to the Old Testament [Hyrje në Dhiatën e Vjetër]*, f. 557, thotë në mënyrë kriptike si më poshtë: “nuk arrin të cekë aspak mësimet e vyera antropologjike që flasin për ndërlidhjen e *Homo sapiensit* me speciet para-adamike që përmban ky pasazh, dhe që janë të vlefshme për ata studiues që janë të pajisur me njohurinë e mjaftueshme për të ndjekur këtë pistë”.

Për mendimin tim, kjo nënkupton se Harrison i sheh këto dy grupe si përfaqësues të grupimeve të ndryshme të humanoidëve. Kjo duket se aludon për një krijim të mëvonshëm e të veçantë të Adamit dhe Evës, por edhe zhvillimin evolucionar të *Homo erectusit*.

G. Këtu, e do vendi që të zbuloj dhe mënyrën si e kuptoj unë këtë tekst polemik. Së pari, më lejoni që t’ju kujtoj të gjithëve se ky pasazh i Zanafillës është i shkurtër dhe i paqartë. Dëgjuesit e parë të Moisiut duhet të kenë patur njohuri të tjera shtesë nga ana historike, ose Moisiu ndoshta përdori një traditë gojore ose të shkruar nga periudha patriarkale, të cilën as ai vetë s’e kuptonte plotësisht. Kjo çështje nuk përbën një temë teologjike kyçe. Shpesh, ne jemi kureshtarë për gjëra që Shkrimi na i jep vetëm në mënyrë të tërthortë dhe që janë të paqarta. Do të ishte vërtet fatkeqë që të ndërtonim një teologji të hollësishme nga kjo apo nga fragmente të ngjashme biblike. Nëse ky informacion do të na nevojitej, Perëndia do të na e kishte dhënë në formë më të qartë e të plotë. Unë, personalisht, besoj se bëhet fjalë për një lidhje engjëjsh me njerëzit, për këto arsye:

1. Përdorimi i vazhdueshëm, ndonëse jo plotësisht i tillë, i frazës “bijtë e Perëndisë” për të nënkuptuar engjëjt në DHV
2. Septuaginta (në Aleksandrinë e fundshekullit të parë para K) e përkthen “bijtë e Perëndisë” si “engjëjt e Perëndisë”
3. Libri pseudografik apokaliptik i *1 Enokut* (ndoshta, i shkruar rreth 200 para K.) e thotë shkoqur se bën fjalë për engjëjt (shih kap. 6-7; vëre dhe Jubiletë 4:19)
4. 2 Pje. 2 dhe Juda flasin për engjëjt që mëkatuan dhe nuk qëndruan në vendin që u takonte (vini re, gjithashtu, *1 Enokut* 10:4, 12)

E di se një pjesë e këtij interpretimi duket se bie ndesh me Mat. 22:30, por këta engjëj s’janë as në qiell, as në tokë, por në një burg të veçantë (*Tartari*).

5. Mendoj se një arsye pse shumë prej ngjarjeve të Zan. 1-11 gjenden edhe në kultura të tjera (pra, në rrëfime të ngjashme për krijimin, në rrëfime të ngjashme për përmytjen, apo për engjëjt që flenë me femra njerëzore) ndodh për shkak se të gjithë njerëzit dikur ishin bashkë dhe kishin njëfarë njohurie për JHVH-në gjatë kësaj periudhe; gjithsesi, pas shpërndarjes që ndodhi në kullën e Babelit, kjo njohuri u shprish dhe iu përshtat modelit politeist.

Një shembull i kësaj është mitologjia greke, ku gjigantët gjysmënjëzërorë/gjysmëmbinjëzërorë, të quajtur titanët, burgosen në *Tartar*; dhe pikërisht ky emër përdoret veç një herë në Bibël (shih 2 Pje. 2) si vendi ku mbahen engjëjt që nuk qëndruan në vendin që u takonte. Sipas teologjisë rabinike, Hadesi ndahet në një pjesë për të drejtët (parajsa) dhe një pjesë për të ligjtë (*Tartari*).

NASB, NKJV,
NRSV, TEV,
NIV “Ferr”
NJB “bota e nëndheshme”
Weymouth “Tartar”

Shih shënimin më lart për “nën errësirë” në shënimet e Judës 6.

■ **“gropat e errësirës”** Fjala *sirois* gjendet në dorëshkrimet e lashta uncialë greke Sinaitikus A, B dhe C. Versioni i Mbretit Xhejms e përkthen “zinxhirë” (*seirais*), që është e ngjashme me kuptimin e fjalës “pranga” (*demois*) në Juda 6, që gjendet në dorëshkrimin e lashtë në papirus, P72 (shih dhe *1 Enokut* 10:12).

2:5 “dhe nuk e kurseu botën e lashtë” Bëhet fjalë për gjykimin e Perëndisë mbi ligësinë e njerëzimit (shih Zan. 6:5, 11-12, 13; 8:21b). Ky gjykim me anë të ujit përshkruhet në Zan. 6-9. E njëjta ngjarje përmendet dhe në 1 Pje. 3:18-22.

■ **“Noeun”** Një burrë dhe familja e tij “gjetën hir në sytë e Zotit” (pra, Noeu; shih Zan. 6:8-9, 18). Kjo ngjarje përshkruhet dhe nga Jozefusi në *Lashtësitë e judenjve* 1.3.1; *1 Klementi* 7.6, 9.4; dhe *Orakujt sibilinë* 1.128).

■ **“një predikues drejtësie”** DHV nuk e përmend predikimin e Noeut, por tradita rabinike e përmend (shih *Jubiletë* 7:20-29; *Orakujt sibilinë* 1.128-129).

■ **“përmytje”** Nga kjo fjalë greke vjen dhe fjala “kataklizmë”. Sipas *1 Enokut*, ky ishte gjykimi i Perëndisë kundër racës së përzier që lindi nga marrëdhëniet seksuale e engjëjve me femra njerëzore në Zan. 6:1-4.

2:6 “Sodomit dhe Gomorrës” Shkatërrimi i këtyre qyteteve të liga përshkruhet në Zan. 19:24-28. Engjëjt ishin mënyra si shpëtoi Loti dhe familja e tij dhe, si rrjedhojë, ata u përfshinë në shkatërrimin e këtyre qyteteve të pllajës.

Kjo është paralele me Judën 7. Me sa duket, Noeu është shembull i gjykimit me ujë, kurse Sodomi dhe Gomorra janë shembull i gjykimit me zjarr.

Unë kam përfshirë shënimet e mëposhtme nga komentari im për Judën 7.

Shënime nga Komentari për Judën

Juda 7 “Sodomi dhe Gomorra” Ky është shembulli i tretë i rebelimit, që përfshinte veprimtaritë seksuale jashtë planit të martesës që na ka zbuluar Perëndia:

1. adhurimi i pjellorisë kanaanite në Shittim (shih Numrat 25)
2. përpjekja nga engjëjt që të përzienin rendet e krijimit (shih Zan. 6:1-4; 2 Pje. 2:4)
3. veprimtaria seksuale e Sodomit dhe Gomorrës ndaj engjëjve (shih Zan. 19; 2 Pje. 2:6)

■ **“dhe qytetet rreth tyre”** Këto qytete renditen me emër në LiP. 29:23.

■ **“në të njëjtën mënyrë”** Kjo është në kallëzore, gjë që e lidh gramatikisht me engjëjt (shih Juda 6), jo me “qytetet përreth”. Është hamendësuar se Juda i përdori këto ilustrime nga DHV për shkak se, ashtu si engjëjt morën gra në Zanafilla 6, kështu dhe këtu burrat u përpoqën të merrnin engjëj (shih Zan. 18:22; 19:1). Nëse është kështu, ky do të ishte një tjetër shembull i përpjekjes për t’i përzier rendet e krijimit. Mirëpo, mua më duket se banorët e Sodomit nuk e dinin se ata ishin engjëj, por mendonin se ishin burra (shih Zan. 18:22).

■ **“në shthurje të rëndë dhe shkuan pas mishit të huaj”** Bëhet fjalë për “lloj të ndryshëm (*heteros*) mishi”. Duket se kjo lidhet edhe me (1) engjëjt dhe gratë sipas Jozefusit në *Lashtësitë e judenjve* 1:3:1; edhe me (2) homoseksualitetin (shih Rom. 1:26-27), që ishte tejet i përhapur në zonën e Sodomit.

■ **“vihen përpara si shembull ndëshkimi në zjarrin e përjetshëm”** Juda i përdor këto shembuj të DHV si paralajmërim të qartë për lexuesit. Kujdes nga shfrytëzimi seksual i të tjerëve.

DHR flet qartë për ndëshkimin e përjetshëm (shih Mat. 25:41, 46; 2 Thes. 2:8-9; Zbu. 19:20; 20:11, 14-15; 21:28; dhe *I Enokut* 54:1). Kjo temë është e vështirë për t’u diskutuar, pasi Bibla nuk na jep shumë të dhëna për qiellin dhe ferrin. Ajo e pranon realitetin e tyre, por nuk na jep të dhëna të veçanta; zakonisht i përshkruan me gjuhë metaforike. Jezusi përdor si term “luginën e bijve të Hinomit”, që ishte në jug të Jerusalemit dhe përdorej nga izraelitët nën Manasehun për adhurimin e Moleku, perëndia kanaanit i zjarrit, që kërkonte flijimi fëmijësh. Nga turpi dhe pendimi për pjesëmarrjen e tyre në këto rite pjellorie, judenjtë e kthyen këtë vend në një pikë ku grumbulloheshin plehurat e Jerusalemit. Metaforat e Jezusit për zjarrin, tymin dhe krimbat vijnë nga ky vend: Gehena.

Ky vend torture nuk u krijua për njerëzimin, por për engjëjt rebelë (shih Mat. 25:41). Ligësia, në të gjitha nivelet e veta, do të hiqet qafe dhe do të ndahet nga krijimi i Perëndisë. Ferri është mënyra si e përshkruan Bibla këtë ndarje të pakthyeshme.

Përpara se ta lë këtë temë, më lejoni të shpreh dhimbjen me të cilën i qasem asaj. Kjo është e vetmja vuajtje në Bibël që nuk ka shpengim. Ky nuk është vullneti i Perëndisë për askënd. Ferri është rezultati i një rebelimi të qëllimshëm dhe të vazhdueshëm, si engjëllor, ashtu dhe njerëzor. Është një plagë e hapur dhe e përgjakur në zemrën e Perëndisë, që nuk do të shërohet kurrë! Gatishmëria e Perëndisë për t’u lejuar krijesave të tij që të kenë vullnet të lirë çon në humbje të dhimbshme dhe të përjetshme.

The Jerome Biblical Commentary, vëll. II, f. 379, përmend faktin se përshkrimi që i bën Juda ndëshkimit të këtyre engjëjve është shumë i ngjashëm me *I Enokun* 10:4-6, 11, 13; 12:4; 15:3; 19:1. Kjo duket se vërteton familjaritetin e Judës me këtë vepër apokaliptike judaike ndërhyjatore.

2:7-8 “të drejtin Lot” Ky mund të jetë aludim për (1) librin jashtëkanonik judaik të *Urtësisë së Solomonit* 10:6, ose (2) për një traditë rabinike. Loti hidhërohej shpirtërisht nga veprimet e të ligjve të kohës së tij (disa tradita rabinike reflektohen dhe në 2 Pje. 2:8 dhe *I Klem.* 11:1), ashtu si lexuesit e 2 Pjetrit hidhëroheshin nga mësuesit e rremë dhe imoralë.

Gjithë kjo pjesë është një formë tipologjie e DHV. Gjërat që kanë ndodhur në historinë e Izraelit po përsëriteshin në kohën e Pjetrit.

2:9 Ky është përfundimi i një fjalie të zgjatur, që nisi në 2 Pje. 2:4. Perëndia do t’i shpëtojë të vetët (pra, Noeun, 2 Pje. 2:5; dhe Lotin, 2 Pje. 2:7) dhe do t’u kërkojë llogari të padrejtëve për veprat e tyre (pra, engjëj dhe njerëz bashkë).

2:10 “ata që kënaqin mishin në dëshirat e tij të shprishura” Bëhet fjalë për instinktet njerëzore, që na i ka dhënë Perëndia por me disa kufizime (pra, seksualiteti njerëzor, por brenda martesës). Njerëzimi i rënë i çon dhuntitë e Perëndisë përtej kufijve hyjnorë për qëllime egoiste dhe egocentrike (dua të fitoj sa më tepër pa asnjë çmim).

■ **“dhe përçmojnë autoritetin”** Kjo është paralel me Judën 8 në disa mënyra.

2 Pjetrit 2:10

1. kënaqin mishin
2. përçmojnë autoritetin
3. fyejnë madhësitë engjëllore

Juda 8

1. ndotin mishin
2. refuzojnë autoritetin
3. fyejnë madhësitë engjëllore

Qartazi, Juda u referohet engjëjve me këtë frazë, por 2 Pjetrit ndoshta e lidh atë me 2 Pje. 2:4 dhe me refuzimin e Krishtit. Më poshtë, kam përfshirë shënimet e mia për Judën 8.

Shënime nga Komentari për Judën

Juda 8 “Megjithatë, në të njëjtën mënyrë” Mësuesit e rremë të kohës së Judës kishin ngjashmëri me rebelët e së shkuarës. Natyra e saktë e ngjashmërisë së tyre nuk na jepet qartë.

■ **“këta”** Me këtë mënyrë, Juda iu referohet mësuesve të rremë, që kishin pushtuar kishën (shih Juda 8, 10, 12, 14, 16, 19).

■ **“duke ëndërruar gjithashtu”** Kjo fjalë përdoret për profetët e rremë të DHV (shih LiP. 13:1-5; Jer. 23:25-32), ata që pretendonin se merrnin zbulesa të veçanta nga Perëndia (shih Kol. 2:18).

■ **“ndotin mishin”** Ky është përdorimi metaforik i fjalës “njollo”. Qartazi, mësimit dhe/ose mënyra e tyre e jetesës kishte një aspekt imoral. Të gjitha këto shembuj të DHV përfshinin njëfarëlloj mëkati seksual (shih 2 Tim. 3:1 e më tej; 2 Pje. 2).

■ **“refuzojnë autoritetin dhe fyejnë madhësitë engjëllore”** “Këta” kanë tre tipare.

1. “ndotin mishin”
2. “refuzojnë autoritetin” (NASB, NKJV, NRSV)
“përçmojnë autoritetin e Perëndisë” (TEV)
“përçmojnë Autoritetin” (NJB)
3. “fyejnë madhësitë engjëllore” (NASB)
“flasin keq për autoritetet” (NKJV)
“shajnë të lavdishmit” (NRSV)
“fyejnë qeniet e lavdishme lart” (TEV)
“fyejnë dhe Lavditë” (NJB)

Është e qartë se tipari i parë ka të bëjë me mëkatet seksuale; por ç’ mund të themi për të dytin dhe të tretin?

Përcaktimi i dytë, “refuzojnë autoritetin”, është interpretuar në të paktën dy mënyra.

1. fjala greke për “autoritetin” është *kuriotēa*, që lidhet me fjalën “Zot” (*kurios*); prandaj, disa e lidhin këtë refuzim (ndonëse foljet janë të ndryshme) me mohimin e Jezusit në Juda 4 (“Zotëria dhe Zoti ynë i vetëm, Jezu Krishti”)
2. fjala greke për “autoritetin” është *kuriotēta*, që lidhet me *kuriotēs*, e përdorur në 2 Pje. 2:10 (shih Efe. 1:21; Kol. 1:16) për t’iu referuar engjëjve.

Ky kontekst duket se bën fjalë për engjëjt, kështu që #2 përputhet më mirë.

Përcaktimi i tretë përdor fjalën e DHV “lavdi” (*kabod*), që përdoret për Perëndinë (shih Juda 24, 25; 2 Pje. 1:3, 17; 3:18) dhe për gjithçka që lidhet me Perëndinë, sidomos në qiell ose në jetën e ardhshme. Në këtë rast, Juda po bazohet te zgjerimi ndërthjator i këtij koncepti të DHV dhe po iu referohet qenieve engjëllorë, qenieve me pushtet dhe autoritet.

Kjo mund të bëjë dhe fjalë për refuzimin e ligjit të DHV, pasi judenjtë besonin se engjëjt kishin shërbyer si ndërmjetës për JHVH-në, kur ai ia dha ligjin Moisiut në malin Sinai (shih Veprat 7:35).

Ideja e kontekstit është mënyra e turpshme e jetesës së “këtyrë” mësuesve të rremë në zonën e moralit dhe autoritetit. Lista e tipareve të mësuesve të rremë, që nisi në Juda 1-4, vazhdon këtu: (1) përçmojnë autoritetin, 2 Pje. 2:10; (2) si shtazë, 2 Pje. 2:12; (3) kërkuesit e kënaqësisë, 2 Pje. 2:13; (4) prishin festat e dashurisë, Juda 13; (5) bëjnë që vëllezërit e dobët të mëkatojnë, Juda 14; dhe (6) premtojnë liri, por vetë janë skllëvër, Juda 19.

TEKSTI I NASB (I PËRDITËSUAR): 2 PJETRIT 2:10b-16

^{10b}Të pacipë, arrogantë, ata nuk dridhen kur fyejnë madhësitë engjëjlore, ¹¹ndërsa engjëjt, që janë më të mëdhenj në fuqi dhe forcë, nuk sjellin gjykim fyes kundër tyre para Zotit. ¹²Por këta, si shtazë të paarsyeshme, duke fyer aty ku nuk kanë njohuri, do të shkatërrohen në shkatërrimin e atyre krijesave, ¹³duke pësuar të keqen si shpërblim që bënë të keqen. Ata e konsiderojnë kënaqësi të bëjnë qejf ditën. Janë njolla dhe fëlliqësi, kënaqen në mashtrimet e tyre, ndërsa bëjnë gosti me ju, ¹⁴i kanë sytë plot me kurorëshkelje që nuk pushojnë kurrë së mëkatuari, joshin shpirtrat e paqëndrueshëm, kanë zemër të stërvitur në lakmi, fëmijë të mallkuar; ¹⁵pasi lanë rrugën e drejtë, dolën nga udha, pasi ndoqën rrugën e Balaamit, birit të Beorit, i cili e donte rrugën e padrejtësisë; ¹⁶por mori një qortim për shkeljen e vet, sepse një gomar pa gojë, që i foli me zë njeriu, ia përmbajti marrëzinë profetit.

2:10b “Të pacipë” (shih Marku 12:34; 15:43)

▣ “arrogantë” (shih Titit 1:7)

▣ “nuk dridhen” (shih Mat. 28:4; Luka 8:47; Veprat 7:32; 1 Kor. 2:3).

Tre fjalët e mëparshme përshkruajnë mungesën e respektit që kishin mësuesit e rremë për fuqitë dhe autoritetet shpirtërore. Ndoshta, kjo ka të bëjë me teologjinë e detajuar gnostike të niveleve engjëjlore (*aeonat*) dhe me emrat e fshehtë të këtyre engjëjve, që gjoja ishin të nevojshëm për të kaluar përmes sferës së tyre në rrugën drejt bashkësisë me perëndinë e lartë dhe të mirë.

NASB “madhësitë engjëjlore”

NKJV “flasin keq për autoritetet”

NRSV “fyejnë të lavdishmit”

TEV “pa respekt për qenien e lavdishme lart”

NJB “duke fyer të lavdishmin”

Shih shënimin në pjesën e mëparshme nga Juda për fjalën “lavditë” (*doksai*).

2:11 “nuk sjellin gjykim fyes kundër tyre para Zotit” Jo është paralele me Judën 9, që mund të jetë citim nga *Ngjitja në qiell e Moisiut*. Lidhet me një incident mes Mikaelit (pra, Kryeengjëllit dhe rojtarit të Izraelit) dhe Satanit për trupin e Moisiut (shih LiP. 34:6).

Në këtë frazë ka një variant në dorëshkrimet greke.

1. para Zotit (*para* me rasën vendore, Sinaitiku, B, C, K, P; shih NASB, NKJV, TEV, NJB)
2. nga Zoti (*para* me rasën rrjedhore, P72; shih NRSV)

2:12 Ky varg është paralel me Judën 10. Juda 9 përshkruan takimin e Mikaelit me Satanin. Ky varg në 2 Pjetrit dhe në Juda 10 përshkruan sesi reagojnë mësuesit e rremë ndaj autoritetit dhe pushtetit engjëjlor:

1. ata veprojnë si kafshë të paarsyeshme
2. janë krijesa me instinkte shtazore

Ajo që dinë (dhe mënrya si veprojnë) do t'i shkatërrojnë.

▣ “shkatërrohen... shkatërrimin” Shih Temën e Veçantë më poshtë.

TEMË E VEÇANTË: SHKATËRROJ, RRËNOJ, SHPRISH (*ftheirō*) (SPECIAL TOPIC: DESTROY, RUIN, CORRUPT [*ftheirō*])

Kuptimi bazë i fjalës *ftheirō* është “shkatërroj, rrënoj, shprish, ose prish”. Mund të përdoret në këto kuptime:

1. Rrënim financiar (ndoshta, 2 Kor. 7:2)
2. Shkatërrim fizik (shih 1 Kor. 3:17a)
3. Shprishje morale (shih Rom. 1:23; 8:21; 1 Kor. 15:33,42,50; Gal. 6:8; Zbu. 19:2)

4. Joshje seksuale (shih 2 Kor. 11:3)
5. Shkatërrim i përjetshëm (shih 2 Pje. 2:12, 19)
6. Traditat njerëzore që janë në shprishje e sipër (shih Kol. 2:22)

Shpesh, kjo fjalë përdoret në të njëjtin kontekst si e kundërta e saj (shih Rom. 1:23; 1 Kor. 9:25; 15:50, 53). Vini re kontrastet paralele mes trupit tonë fizik e tokësor dhe trupit tonë të përjetshëm qiellor.

1. i prishshëm kundrejt i paprishshëm, 1 Kor. 15:42, 50
2. turpërimi përkundrejt lavdërimit, 1 Kor. 15:43
3. dobësia kundrejt fuqisë, 1 Kor. 15:43
4. trupi natyror kundrejt trupit shpirtëror, 1 Kor. 15:44
5. Adami i parë kundrejt Adamit të fundit, 1 Kor. 15:45
6. Shëmbëllimi i tokësore kundrejt shëmbëllimit të qiellores, 1 Kor. 15:49

2:13 “duke pësuar të keqen si shpërblim që bënë të keqen” Ky është një fjaliformim i pazakontë, që është (1) idiomë, ose (2) lojë fjalësh (pra, *adikoumenoi*, që do të thotë “pësoj të keqen” dhe *adikias*, që përkthehet “e së keqes”).

☐ **“të bëjnë qejf ditën”** Ata mburren me veprimet e tyre, që t’i shohin të gjithë. Kjo frazë dhe fraza e fundit e 2 Pje. 2:12 thonë të njëjtën gjë.

NASB “njolla dhe fëlliqësi”

NKJV “pika dhe fëlliqësi”

NRSV “njolla dhe fëlliqësi”

TEV “turp dhe turpërim”

NJB “njolla të shpifura”

Fjala e parë *spilas* (dhe format e saj) ka dy kuptime të veçanta: (1) në fillim bënte fjalë për rreziqet e padukshme, fjalë për fjalë, shkëmbinjtë e fshehur ose të cekët të ujit (shih Juda 12) dhe (2) njolla ose pika (shih Efe. 5:27; Jakobi 3:6; 2 Pje. 2:13; Juda 23).

Fala e dytë është disi sinonime. Përdoret metaforikisht për “njollat”. Të dyja i përshkruajnë mësuesit e rremë si gjahtarë seksualë të besimtarëve në festat e krishtera të dashurisë (vakti i Darkës së Zotit).

NASB “ndërsa bëjnë gosti me ju”

NKJV, NRSV “ndërsa festojnë me ju”

TEV “marrin pjesë në darkat tuaja”

NJB “edhe kur janë në të njëjtën tryezë me ju”

Kjo është paralele me Judën 12. Vakti që përmendet quhej “Festa e Dashurisë” (shih 1 Kor. 11:17-22), që ishte një eukaristi e përbashkët e komunitetit besimtar.

2:14 “sytë plot me kurorëshkelje” Ata e shihnin çdo femër në tryezën e Krishtit si objekt seksual. Këta mësues të rremë ishin shfrytëues seksualë (shih 2 Pje. 2:2, 10, 14, 18). Rabinët thonë se sytë janë dritarja e shpirtit. Mëkati fillon në jetën e mendimeve. Sytë e këtyre mësuesve të rremë s’rrinin kurrë në qetësi!

☐ **“joshin shpirtrat e paqëndrueshëm”** Ata vënë në kurth dhe mbërthejnë besimtarët e dobët ose të rinj (shih Mat. 18:6; 2 Tim. 3:6).

☐ **“kanë zemër të stërvitur në lakmi”** Në greqisht, kjo është pjesore e kryer pjesore. Fjalën “gjimnaz” e marrim pikërisht nga kjo fjalë (“stërvitur”). Ata stërviten rregullisht që të fitojnë sa më shumë për vete me çdo çmim! Shih Temën e Veçantë: Zemra, në Marku 2:6.

NASB “fëmijë të mallkuar”

NKJV “dhe janë fëmijë të mallkuar”

NRSV “Fëmijë të mallkuar”

TEV “Ata janë nën mallkimin e Perëndisë”

NJB “Ata janë nën mallkim”

Kjo është shprehje hebraike (shih Efe. 2:3). Ata demonstronë tiparet dhe karakterin e pandryshueshëm të atit të tyre, Djallit. E kundërta pozitive e kësaj shprehjeje është “fëmijë të bindur” të 1 Pje. 1:14!

2:15 “pasi janë rrugën e drejtë” Kjo reflekton shprehjen hebraisht për “mëkatën” (shih NRSV, TEV, NJB).

Drejhtësia përshkruhet si shteg, ose si rrugë. Të perëndishmit duhet ta ndiqnin këtë shteg (shih Psa. 119:105; Fja. 6:23). Çdo shmangie nga udha ishte mëkat.

▣ **“dolën nga udha”** Fjala “dolën” na ka dhënë fjalën “planet”, që do të thotë “vërdallosës”. Kjo është paralele me Judën 13.

▣ **“rrugën e Balaamit”** Ky incident i DHV përmendet dhe në Juda 11. Rrëfëhet në Num. 22-25; 31:8, 16. Ashtu si Balaami dëshironte para, edhe këta mësues të rremë donin të njëjtën gjë (pra, kishin lakmi; 2 Pje. 2:14).

NASB, NKJV,

TEV “Beorit”

NRSV, NJB “Bosorit”

Leximi i parë është nga Septuaginta i Numrave 22 dhe është leximi i dorëshkrimit B. Leximi i dytë gjendet në dorëshkrimet P72, Sinaitikus (dora e dytë), A (dora e tretë), C; UBS4 i jep vlerësimin “A” (i sigurt). Megjithatë, nuk ka asnjë shembull të këtij emri gjetiu.

2:16 “një gomar pa gojë, që i foli me zë njeriu” Kjo bën fjalë për Num. 22:24 dhe 31, një tjetër ngjarje ku u përfshi një engjell.

TEKSTI I NASB (I PËRDITËSUAR): 2 PJETRIT 2:17-22

¹⁷Këta janë burime pa ujë dhe mjegulla që shtyhen nga furtuna, për të cilët është rezervuar errësira e thellë. ¹⁸Sepse, duke folur fjalë arrogante boshe, ata joshin me anë të dëshirave mishore, me anë të shthurjes, ata që mezi shpëtojnë nga ata që jetojnë në gabim, ¹⁹duke u premtuar liri, ndërsa ata vetë janë skllëvër të shprishjes; sepse njeriu bëhet skllav i atij që e mposht. ²⁰Sepse nëse, pasi u kanë shpëtuar ndotjeve të botës me anë të njohurisë së Zotit dhe Shpëtimtarit Jezu Krisht, ata ngatërrohen sërish në to dhe mposhten, gjendja e tyre e fundit është bërë më e keqe sesa e mëparshmja. ²¹Sepse do të kishte qenë më mirë po të mos e kishin njohur udhën e drejtësisë sesa, pasi e njohën, t’i kthejnë shpinën urdhërimit të shenjtë që iu dorëzua atyre. ²²Atyre iu ka ndodhur sipas fjalës së urtë e të vërtetë: “Qeni u kthye te të vjellat e veta”, dhe “Dosa, pasi lahet, kthehet të zhgërryhet në baltë”.

2:17 “burime pa ujë dhe mjegulla” Vargu paralel i kësaj është Juda 12. Ata kishin premtimin e bekimit, por jepnin vetëm vdekje.

▣ **“për të cilët është rezervuar errësira e thellë”** Fjalë për fjalë, “errësira e thellë e territ” (shih 2 Pje. 2:4; Juda 6, 13). Folja është dëftore e kryer pësore; nënkupton gjykimin dhe ndarjen e përhershme nga Perëndia.

Edhe ky varg gjendet në Juda 13. Është metaforë e ndëshkimit të përjetshëm, që përdor errësirën për ta përçuar si ide (shih Mat. 8:12; 22:13; 25:30; dhe 1 Enokut 10:4-5; 63:6).

2:18

NASB “duke folur fjalë arrogante boshe”

NKJV “flasin fjalë të mëdha dhe të fryra boshe”

NRSV “flasin budallallëqe bombastike”

TEV “bëjnë pohime krenare dhe të marra”

NJB “fjalë të fryra, por boshe”

Kjo është paralele me 2 Pje. 2:17 dhe Juda 12-13, 16. Ata duken si shpirtërorë dhe të vërtetë, por kjo është fasadë, mashtrim.

NASB “joshin me anë të dëshirave mishore”

NKJV “joshin përmes epsheve të mishit, me anë të shthurjes”

NRSV “me dëshira të shthurura të mishit, ata joshin”

TEV “përdorin epsheve të shthurura të trupit si kurth”

NJB “tundojnë... duke luajtur me dëshirat e çrregullta të natyrës së tyre njerëzore dhe me shthurje”

Sërish, bëhet fjalë për aspektet seksuale të mësuesve të rremë. Ata ishin në gabim, jo vetëm teologjikisht, por edhe moralisht.

NASB “ata që mezi shpëtojnë”

NKJV “ata që kanë shpëtuar vërtet”

NRSV “të cilët mezi kanë shpëtuar”

TEV “ata që sa po fillojnë të shpëtojnë”

NJB “njerëzit që mezi kanë shpëtuar”

Në këtë frazë ka një variant në dorëshkrimet greke.

1. *oligōs*, do të thotë “pothuajse” (shih dorëshkrimet P72, Sinaitikus (dora e dytë), A, B dhe përkthimet e Vulgatës, siriake dhe kopte)
2. *ontōs*, që do të thotë “vërtetë” ose “në fakt” (shih dorëshkrimet Sinaitikus (dora e parë), C dhe përkthimet armene dhe slavonike).

Çështja teologjike është kjo: a ishin këta besimtarë që po mashtroheshin (shih NKJV, NRSV, NIV), apo ishin njerëz që pothuajse po bëheshin besimtarë (shih NASB, NRSV [shënimi në fund të faqes], TEV)? Konteksti i 2 Pje. 2:20-21 të lë të nënkuptosh me siguri se ishin besimtarë (kjo është fjali kushtore e rendit të parë).

2:19 “duke u premtuar liri” Këta mësues të rremë po premtinin lirinë në dy kuptime: (1) lirinë teologjike, e bazuar në njohurinë e fshehtë të sferave engjëllore dhe (2) lirinë nga caqet morale, e bazuar në një shpëtim që kishte të bënte vetëm me arritjet mendore (pra, gnostiëkt libertinë ose antinomianë).

Pali i nxiste besimtarët që të mos e përdornin lirinë si leje për të kryer mëkat (shih Gal. 2:16); të njëjtën gjë bëri dhe Pjetri (shih 1 Pje. 2:16). Liria ka qenë gjithmonë fryti i ndaluar. Vetëkontrolli është shenjë e pjekurisë shpirtërore (shih Gal. 5:23). Këtu s’bëhet fjalë për konceptin stoik të vetëkontrollit, por për konceptin e krishterë: besimtarët i dorëzohen Frymës brendabanues dhe i përshtaten zbulesës së Perëndisë (DHR). Pyetja e vërtetë, pra, është kjo: kush (ose çfarë) na e kontrollon dhe/ose karakterizon jetën?

■ **“shprishjes”** Shih Temën e Veçantë në 2 Pje. 2:12.

2:20 “nëse” Kjo është fjali kushtore e rendit të parë, që supozohet si e vërtetë nga pikëvështrimi i autorit, ose për qëllimet e tij letrare. Kjo nënkupton se viktimat e 2 Pje. 2:18 ishin besimtarë.

■ **“u kanë shpëtuar ndotjeve të botës”** Kjo është pjesore aoriste veprare, që nënkupton veprim të përmbushur (pra, rrëfimi i tyre i besimit në Krishtin). Ungjilli i ka çliruar nga fuqia e natyrës së rënë (shih Rom. 6).

■ **“me anë të njohurisë së Zotit”** Kjo është fjala *epignōskō*, që ka ngjyrimin kuptimor të njohurisë së plotë të përjetuar (shih 2 Pje. 1:2). Mjeti i shpëtimit të tyre ishte ungjilli, i cili është një person, e vërteta rreth atij personi dhe mënyra e jetesës si ai person. Mësuesit e rremë i kishin shkelur të tria!

■ **“ngatërrohen sërish në to dhe mposhten”** Forma e parë foljore është pjesore aoriste pësore, ndërsa e dyta është dëftore e tashme pësore. Vini re diatezën pësore, që nënkupton veprues të jashtëm (pra, mësuesit e rremë, ose i ligu). Konteksti këtu e përcakton ngatërrimin si epsh, ose dëshira mishore. Për një diskutim të dobishëm të këtij vargu, shih *Hard Sayings of the Bible*, f. 729-730. Jam plotësisht dakord me vlerësimin e këtij libri.

■ **“gjendja e tyre e fundit është bërë më e keqe sesa e mëparshmja”** Mund të bëhet fjalë për (1) besimtarët e rinj (2 Pje. 2:14b, 18b, 21), ose (2) mësuesit e rremë (2 Pje. 2:17, 18a). Kjo paqartësi vlen dhe për 2 Pje. 2:19.

2:21 Si mund të keqësohej gjendja e tyre? (1) Ata ishin “imunizuar” kundër besimit të vërtetë. Ata janë si te Heb. 2:1-4; 6:4-6 dhe 10:26-31 (pra, jobesimtarët që rrinë në praninë e dritës madhështore); (2) Mund të bëhet fjalë për humbjen e dëshmisë së besimtarëve të rinj ose të dobët për shkak të mënyrës së jetesës, jo për shpëtimin e tyre personal. Ekziston një luftë e fortë mes natyrës së vjetër dhe asaj të re (shih Romakëve 7), si përpara shpëtimit, ashtu dhe më pas.

■ **“udhën e drejtësisë”** Bëhet fjalë për ungjillin; e ngjashme me shprehjen “urdhërimi i shenjtë” në 2 Pje. 2:21, dhe me “njohurinë e Zotit” në 2 Pje. 2:20 (shih 2 Pje. 3:2).

2:22 “fjalës së urtë e të vërtetë” Fjala e urtë për qenin është marrë nga teskti masoret, jo nga Septuaginta, i Fja. 26:11. Fjala e urtë për dosën është marrë nga libri aramaik i urtësisë së Ahikanit (8:18), që njihej mirë nga judenjët gjatë robërimit në Asiri. Ahikani përmendet në librin jude të *Tobitit* si njeri i mençur nga një prej dhjetë fiseve veriore të robëruara të Izraelit. Tradita judaike thotë se ai u ngrit në nivelin e zyrtarit të lartë të qeverisë (si Danieli) gjatë mbretërimeve të Senakeribit dhe Esarhadonit. Këta mësues të rremë dukeshin si besimtarë (pra, si të mençur), por veprimet e tyre tregonin se ky ishte ndryshim sipërfaqësor dhe jo pendim i vërtetë (shih Mateu 7 dhe 13).

PYETJE PËR DISKUTIM

Ky është një komentuar studimor udhëzues, që do të thotë se ti je vetë përgjegjës për interpretimin e Biblës. Secili prej nesh duhet të ecë sipas dritës që ka. Ti, Bibla dhe Fryma e Shenjtë keni përparësi në interpretim. Nuk duhet t’ia dorëzosh këtë të drejtë komentuesit.

Këto pyetje për diskutim t’i kam dhënë për të të ndihmuar që të analizosh çështjet kryesore të kësaj pjese të librit. Ato synojnë të të nxisin mendimin, jo të kenë natyrë shteruese.

1. A ishin mësuesit e rremë të krishterë të vërtetë? (2 Pje. 2:1)
2. A ishin të krishterë ndjekësit e tyre?
3. Rendit tiparet e këtyre mësuesve të rremë.
4. Pse flitet kaq shumë për engjëjt në këtë kapitull?
5. Cila është domethënia e vargjeve 20-22?

2 PJETRIT 3

NDARJET NË PARAGRAFË TË PËRKTHEMEVE MODERNE

UBS ⁴	NKJV	NRSV	TEV	NJB
Premtimi i ardhjes së Zotit 3:1-7	Premtimi i Perëndisë nuk vonon 3:1-9	Dita e Zotit 3:1-7	Premtimi i ardhjes së Zotit 3:1-7	Dita e Zotit: profetët dhe apostujt 3:1-2 Dita e Zotit: mësuësit e rremë 3:3-7
3:8-13	Dita e Zotit 3:10-13 Jini të patundur	3:8-10 3:11-13	3:8-9 3:10-13	3:8-10 Thirrje e re për shenjtëri; doksologjia 3:11-18
3:14-18	3:14-18	3:14-18	3:14-16 3:17-18	

CIKLI TRE I LEXIMIT (shih f. v)

NDJEKJA E SYNIMIT TË AUTORIT FILLESTAR NË NIVELIN E PARAGRAFËVE

Ky është një komentuar studimor udhëzues, që do të thotë se ti je vetë përgjegjës për interpretimin e Biblës. Secili prej nesh duhet të ecë sipas dritës që ka. Ti, Bibla dhe Fryma e Shenjtë keni përparësi në interpretim. Nuk duhet t'ia dorëzosh këtë të drejtë komentuesit.

Lexo gjithë kapitullin njëherësh. Identifiko temat. Krahaso ndarjet e tua tematike me pesë përkthimet moderne. Ndarja në paragrafë nuk është e frymëzuar, por është çelësi për të ndjekur synimin e autorit fillestar, gjë që është thelbi i interpretimit. Secili paragraf ka vetëm një temë të vetme.

1. Paragrafi i parë
2. Paragrafi i dytë
3. Paragrafi i tretë
4. Etj.

STUDIMI I FJALËVE DHE FRAZAVE

TEKSTI I NASB (I PËRDITËSUAR): 2 PJETRIT 3:1-7

¹Të dashur kjo është letra e dytë që po ju shkruaj, ku po jua zgjoj mendjen tuaj të singertë me anë të kujtesës, ²që t'i kujtoni fjalët e thëna më parë nga profetët e shenjtë dhe urdhërimin e Zotit dhe Shpëtimtarit, të thënë nga apostujt tuaj. ³Dini këtë, para së gjithash, se, në ditët e fundit, do të vijnë tallës me talljen e tyre, duke ndjekur epshet e tyre, ⁴dhe duke thënë: “Ku është premtimi i ardhjes së tij? Sepse, që kur etërit fjetën, gjithçka vazhdon siç ka qenë nga fillimi i krijimit”. ⁵Sepse, kur e thonë këtë, iu shpëton nga mendja se me anë të fjalës së Perëndisë qiejt ekzistonin kohë më parë dhe se toka u formua nga uji dhe nëpërmjet ujit, ⁶përmes së cilit bota e asaj kohe u shatërrua, pasi u përmyt me ujë. ⁷Por, me anë të fjalës së tij, qiejt dhe toka e tanishme po ruhen për zjarrin, i mbajtur për ditën e gjykimit dhe shkatërrimit të të paperëndishmëve.

3:1 “Të dashur” Në fillim, kjo fjalë u përdor nga Perëndia Atë për Birin në pagëzim (shih Mat. 3:17) dhe në Shpërfytyrimin në Mal (shih Mat. 17:5 dhe 2 Pje. 1:17). Më vonë u bë titull për popullin e Perëndisë (shih Rom. 1:7). Përdoret vetëm një herë nga 1 Pjetrit (shih 1 Pje. 2:11; 4:12), por përdoret gjerësisht në 2 Pjetrit 3 (shih 2 Pje. 3:1, 8, 14, 15-17). Është shumë e përhapur dhe te 1 dhe 3 Gjonit.

■ **“letra e dytë”** Me sa duket, bëhet fjalë për letrën e 1 Pjetrit, nëse besojmë se Pjetri është burimi pas 1 dhe 2 Pjetrit, siç mendoj dhe unë.

NASB **“mendjen tuaj të sinqertë”**

NKJV **“mendjen tuaj të pastër”**

NRSV **“synimin tuaj të sinqertë”**

TEV **“mendimet tuaja të pastra”**

NJB **“mendimin e pamjegulluar”**

Kjo fjalë mund të ketë kuptimin “i pastër”, në kuptimin e sinqeritetit dhe drejtësisë morale (shih Fil. 1:10). Mësuesit e rremë nuk ishin të pastër në asnjë kuptim. Ata ishin egoistë imoralë dhe manipulues.

■ **“me anë të kujtesës”** Këto ishin pothuajse fjalët e njëjta të 2 Pje. 1:13-14 (shih Juda 17). Në Bibël, njerëzve u bëhet gjithmonë thirrje që ta kujtojnë Perëndinë, Fjalën dhe veprimet e tij. Kurse Perëndia nxitet që t’i harrojë mëkatet e tyre (shih Jer. 31:34; Isa. 43:25; metaforike në Ps. 103:3; Isa. 1:18; 38:17; 44:22; Mikea 7:18).

3:2 “t’i kujtoni fjalët” Kjo është pjesore aoriste pësore. Thekson fort njohjen (1) e DHV (shih 2 Pje. 1:21); (2) fjalët e Jezusit (shih 2 Pje. 2:21); dhe (3) zbatimin e tyre apostolik (shih 2 Pje. 1:1). Është paralele me Judën 17.

Njohja/kujtesa synonte që t’ia përforconte besimtarit besimin në Ardhjen e Dytë dhe jetesën si Krishti!

■ **“e thëna më parë nga profetët e shenjtë”** Kjo është pjesore e kryer pësore, që nënkupton zbulesën e përhershme (koha e kryer, shih Mat. 5:17-19; 1 Pje. 1:25), e dhënë nga Fryma (diateza pësore, shih 2 Pje. 1:20-21).

Bën fjalë për gjithë DHV. Judenjtë besonin se gjithë Shkrimi ishte shkruar nga profetë. Prandaj dhe Moisiu quhet profet në LiP. 18:15; po kështu, librat nga Jozueu te Mbretërit quhen “profetët e hershëm”.

■ **“urdhërimin e Zotit dhe Shpëtimtarit”** Kjo është një shprehje që bën fjalë për ungjillin (“urdhërimi i shenjtë”, shih 2 Pje. 2:21; “urdhërimi”, 1 Tim. 6:14). Lidhet me shprehjen “ligji i Krishtit” (shih Gal. 6:2).

■ **“apostujt tuaj”** Ashtu si profeti dha besëlidhjen e parë, apostujt japin të dytën!

3:3 “Dini këtë, para së gjithash” E njëjta frazë përdoret dhe në 2 Pje. 1:20. Pjetri e përdor këtë shprehje letrare për të shënuar pikat e tij kryesore.

■ **“në ditët e fundit”** Kjo frazë e DHV shënon periudhën kohore pak përpara pikës kulmore të historisë njerëzore. Pjetri është disi i vagullt se për ç’periudhë kohore bëhet fjalë. Në 2 Pjetrit 2, ai thotë se mësimi i rremë “po vjen”, mirëpo ato mësimet ishin të pranishme që në kohën e tij. Kjo është teologjikisht e ngjashme me “antikrishti... antikrishtët” e Gjonit në 1 Gjonit 2:18. Këta mësues të rremë dhe tallës do të karakterizojnë çdo periudhë të ardhshme të historisë së kishës, duke filluar që nga shekulli i parë. Shih Temën e Veçantë në Marku 13:8.

■ **“do të vijnë tallës me talljen e tyre”** Kjo është paralele me Judën 18. Format emërore dhe mjetore të të njëjtit emër përdoren për theksim. Këta mësues të rremë po talleshin, dhe do të vazhdojnë të tallen, me premtimet biblike për kthimin e Krishtit (shih 2 Pje. 3:4).

■ **“duke ndjekur epshet e tyre”** Mësuesit e rremë janë të dukshëm për shkak të fjalëve dhe veprave (shih Mat. 7:15-20; dhe 2 Tim. 3:2-5). Kjo është paralele me Judën 18.

3:4 “Ku është premtimi i ardhjes së tij” Mund të bëhet fjalë për (1) Ditën e ardhjes së JHVH-së në DHV, ose (2) Ardhjen e Dytë të Krishtit në DHR.

NASB, NKJV **“etërit”**

NRSV, TEV **“paraardhësit tanë”**

NJB **“Etërit tanë”**

Periudha e DHV përmendet në 2 Pje. 3:2, kështu që “Etërit” duhet të bëjnë fjalë për patriarkët, ose drejtuesit fisnorë të DHV. Kjo konfirmohet nga 2 Pje. 3:4-6, që bën fjalë për krijimin.

Konteksti qartaiz bën fjalë për vizitën e Perëndisë me gjykim (shih 2 Pjetrit 2). DHV thotë se njerëzit, një ditë, do t’i japin llogari Perëndisë për kujdestarinë e dhuratës së jetës (p.sh., Mat. 25:31-46; 20:11-15). Këta tallës, jo vetëm që e përçmonin mishërimin e Jezusit, por edhe talleshin me kthimin e tij si Gjykatës.

■ **“fjetën”** Ky është eufemizëm i DHV për vdekjen, që vazhdohet në DHR (shih Mat. 27:53; Marku 5:39; Gjoni 11:11; 1 Kor. 11:30; 15:51; Efe. 5:14; 1 Thes. 4:14).

■ **“gjithçka vazhdon siç ka qenë nga fillimi i krijimit”** Historia njerëzore, ndonëse minimale në kohë në krahasim me historinë gjeologjike, u jep njerëzve idenë e rregullsisë. Ky është presupozimi i shkencës së sotme (pra, uniformitarianizmi): procesi natyror dhe rregullsia e ligjeve natyrore ishte e njëjta gjë më parë dhe do të jetë njësoj në të ardhmen. Bibla thotë se fillimi e ka patur një fillim dhe do ta ketë një fund. Perëndia e krijoi me një qëllim. Ai qëllim ishte bashkësia me krijesat e bëra në shëmbëllimin e tij, të cilat reflektojnë karakterin e tij. Bota është përgjegjëse para Perëndisë etik dhe moral. Megjithatë, iluzioni i kohës së pafundme dhe rregullsisë së natyrës i kishte bërë mësuesit e rremë që t’i refuzonin zbuluesin e Shkrimit, fjalët e Jezusit dhe shpalljen apostolike. Historia njerëzore dhe jetëgjatësia e individit janë aq të gjata sa iu japin njerëzve perceptimin e rremë të bindjes se “nesër do të jetë si sot”!

3:5

NASB “iu shpëton nga mendja”
NKJV “harrojnë qëllimisht”
NRSV, NJB “anashkalojnë me dashje”
TEV “anashkalojnë qëllimisht”

Kjo fjalë ka ngjyrimin kuptimor të harresës ose fshehjes së diçkaje; prandaj, ky term përmban konceptin e qëllimshmërisë (shih 2 Pje. 1:9 3:5, 8). Këta mësue të rremë “harronin volitshëm” ose “zgjidhnin të anashkalonin” ndërhyrjen e Perëndisë në krijimin e vet, si dhe qëllimin e tij të shprehur të llogaridhënies (pra, gjykimit) së gjithë krijimit.

■ **“me anë të fjalës së tij”** Do të thotë se krijimi u bë me anë të fjalës së folur (shih Zan. 1:3, 6, 8, 14, 20, 24). Në teologji njihet me termin latin “fiat”, që do të thotë “me anë të fjalës së folur”. Shih John L. Walter, *The Lost World of Genesis One*, ku ai shprehet se Zanafilla 1 nuk është krijimi i lëndës, por i një universi funksionues. Mësuesit e rremë gnostikë e mohonin se Perëndia i shenjtë mund të formonte (aq më pak të krijonte) lëndën e mëkatshme dhe bashkekzistuese.

NASB, TEV “toka u formua nga uji dhe nëpërmjet ujit”
NKJV “toka dilte nga uji dhe ishet në ujë”
NRSV “dhe toka u formua nga uji dhe me anë të ujit”
NJB “toka u formua nga fjala e Perëndisë nga uji dhe midis ujërave”

Uji është element i rëndësishëm në Zan. 1:2 (“thellësia” dhe “ujërat”). Nuk përmendet sikur u krijua me anë të fjalës. Parafjala greke “përmes” (*dia*) ujit mund të ketë kupimin “midis”, “i rrethuar nga”, “në mes të”, “nga veprimi i”, ose “i mbajtur nga” (shih Psa. 24:2; 136:6). Kjo frazë mund të jetë dhe aludim për Zan. 1:2; 1:6, ose 1:9.

3:6 “bota... u shkatërrua” Bëhet fjalë për përmytjen e Noeut (shih Zan. 6-80). Unë kam përfshirë këtu një shënim të shkurtër nga komentari im për Zan. 1-11.

ZANAFILLA

“Ka patur një hamendësim se fjala “përmbytje” mund të ketë lidhje me fjalën asiriane “shkatërroj”. A ishte përmbytja e kohë së Noeut mbarëbotërore, apo ndodhi vetëm në Lindjen e Afërt në lashtësi? Fjala “tokë”, shpesh, përkthehet “vend/tokë” në kuptimin lokal. Nëse njerëzit s’do të ishin shpërndarë në gjithë pjesët e tokës, gjë që sigurisht nënkuptohet nga ngjarja e kullë së Babelit në 2 Pjetrit 10-11, atëherë një përmbytje lokale do të kishte qenë e mjaftueshme. Libri më i mirë që kam lexuar me të dhëna logjike për një përmbytje lokale është ai i Bernard Ramm: *The Christian View of Science and Scripture* [Pikëpamja e krishterë për shkencën dhe Shkrimin]” (f. 62).

3:7

NASB “me anë të fjalës së tij”
NKJV, NRSV “nga e njëjta fjalë”
TEV “nga i njëjti urdhër”
NJB “është e njëjta Fjalë”

Ashtu si Perëndia e bëri krijimin me anë të fjalës së folur dhe mbretëron me anë të fjalës (pra, Krishti, shih Gjoni 1:1), edhe ne u rilindëm nga Fjala e gjallë dhe e qëndrueshme e Perëndisë (1 Pje. 1:23). Edhe pastrimin, ai do ta bëjë me anë të fjalës së folur (pra, gjykimi i përmbytjes, gjykimi me zjarr). Metafora e Jezusit në Zbu. 19:15, pra, se do të kthehet me një shpatë me dy tehe në gojë është një tjetër mënyrë për të shprehur të njëjtën të vërtetë.

■ **“qiejt dhe toka e tanishme po ruhen për zjarrin”** Kjo është pjesore perifrastike e kryer pësore, që bën fjalë për diçka që ka ndodhur tashmë. Këtu, përdoret në kuptimin profetik të sigurisë së një ngjarjeje të ardhshme në bazë të besnikërisë së fjalës së Perëndisë. I gjithë ky kontekst thekson fuqinë dhe epërsinë e fjalës së Perëndisë (shih 2 Pje. 1:19; 3:5, 7; 1 Pje. 1:23; 2:8; 3:1).

Ky gjykim me anë të zjarrit mund të vijë nga DHV në dy kuptime: (1) Psalmet flasin për një zjarr që i paraprin Zotit (shih Psa. 18:8; 50:3; 97:3), ose (2) gjykimet e JHVH-së gjatë endjes në shkretëtirë (shih Lev. 10:2; Num. 11:1-3; 16:35; 26:10), ose gjykimet e tij eskatologjike me zjarr (shih Dan. 7:10; Isa. 30:27, 30, 33).

Shpesh, zjarri e shoqëron praninë e JHVH-së në DHV. Kjo mund të shoqërohet me (1) Perëndinë si veprues i njohursië dhe zbulesës (dritës); (2) Perëndinë si veprues pastrues; ose (3) Perëndinë si gjykatës (pra, veprues shkatërrues).

TEMË E VEÇANTË: ZJARRI (SPECIAL TOPIC: FIRE [BDB 77, KB 92])

Në Shkrim, zjarri ka edhe ngjyime pozitive, edhe negative.

A. Pozitive

1. ngroh (shih Isa. 44:15; Gjoni 18:18)
2. ndriçon (Isa. 50:11; Mat. 25:1-13)
3. pjek (shih Eks. 12:8; Isa. 44:15-16; Gjoni 21:9)
4. pastron (shih Num. 31:22-23; Fja. 17:3; Isa. 1:25; 6:6-8; Jer. 6:29; Mal. 3:2-3)
5. shenjtëria e Perëndisë (shih Zan. 15:17; Eks. 3:2; 19:18; Ezek. 1:27; Heb. 12:29)
6. udhëheqja e Perëndisë (shih Eks. 13:21; Num. 14:14; 1 Mbret. 18:24)
7. fuqizimi i Perëndisë (shih Veprat 2:3)
8. mbrojtja e Perëndisë (shih Zak. 2:5)

B. Negative

1. djeg (shih Joz. 6:24; 8:8; 11:11; Mat. 22:7)
2. shkatërron (shih Zan. 19:24; Lev. 10:1-2)
3. zemërim (shih Num. 21:28; Isa. 10:16; Zak. 12:6)
4. ndëshkim (shih Zan. 38:24; Lev. 20:14; 21:9; Joz. 7:15)
5. shenjë e rremë eskatologjike (shih Zbu. 13:13)

C. Zemërimi i Perëndisë kundër mëkatit shprehet me metafora zjarri

1. zemërimi i tij djeg (shih Os. 8:5; Sof. 3:8)
 2. ai derdh zjarr (shih Nah. 1:6)
 3. zjarri i përjetshëm (shih Jer. 15:14; 17:4)
 4. gjykimi eskatologjik (shih Mat. 3:10; 13:40; Gjoni 15:6; 2 Thes. 1:7; 2 Pjet. 3:7-10; Zbu. 8:7; 16:8)
- D. Shpesh, zjarri shfaqet në epifani
1. Zan. 15:17
 2. Eks. 3:2
 3. Eks. 19:18
 4. Psa. 18:7-15; 29:7
 5. Ezek. 1:4, 27; 10:2
 6. Heb. 1:7; 12:29
- E. Ashtu si shumë metafora të tjera në Bibël (si majaja, luani), zjarri mund të jetë bekim ose mallkim, në varësi të kontekstit.

■ **“i mbajtur për ditën e gjykimit... të të paperëndishmëve”** Kjo është pjesore e tashme pësore. Si 2 Pjetrit 2, ashtu dhe Juda, theksojnë se engjëjt e ligj dhe njerëzit e ligj po ruhen për një ditë llogaridhënieje. Të gjitha krijesat e vetëdijshme (shih Fil. 2:9-11), një ditë, do të japin llogari si kujdestarë të dhuratës së jetës (shih Gal. 6:7).

Kjo ditë eskatologjike është kohë gjykimi për të paperëndishmit, por edhe kohë shpërblimi madhështor për besimtarët. Kisha e përndjekur duhet të mos harrojë se, një ditë, Perëndia do ta vendosë gjithçka në vendin e vet!

■ **“shkatërrimit”** Fjalën “Apollion” e kemi marrë pikërisht nga kjo fjalë greke (shih Zbu. 9:11).

TEKSTI I NASB (I PËRDITËSUAR): 2 PJETRIT 3:8-10

⁸Por, të dashur, mos e lejoni këtë fakt që t’ju dalë nga mendja: se me Zotin, një ditë është si një mijë vjet, dhe një mijë vjet, si një ditë. ⁹Zoti nuk është i ngadaltë për premtimin e vet, siç e llogarisin disa ngadalësinë, por është i duruar me ju, pasi nuk dëshiron që të humbasë askush, por që të gjithë të vijnë në pendim. ¹⁰Por dita e Zotit do të vijë si vjedhës, kur qiejt do të kalojnë me oshëtimë dhe elementet do të shkatërrohen me nxehtësi të tmerrshme, dhe toka dhe veprat e saj do të shkrumbohen.

3:8

NASB “mos e lejoni këtë fakt që t’ju dalë nga mendja”

NKJV “mos e harroni këtë gjë”

NRSV “mos e anashkaloni këtë fakt”

TEV “mos e harroni këtë gjë”

NJB “ka një gjë... që s’duhet ta harroni kurrë”

Kjo është urdhërore e tashme me pjesëz mohore, që zakonisht nënkupton “ndalimin e një veprimi në kryerje e sipër”. Për shkak të përndjekjes (shih 1 Pje.) dhe të mësuesve të rremë (shih 2 Pje.), besimtarët po fillonin të vinin në pikëpyetje vërtetësinë e ngjarjeve eskatologjike biblike.

■ **“një ditë është si një mijë vjet”** Ky është aludim për Psa. 90:4. Pohon të vërtetën se koha nuk ka rëndësi për Perëndinë e përjetshëm. Vetëm krijesat e tij e përjetojnë të shkuarën, të tashmen dhe të ardhmen. Ne jemi të kufizuar nga koha, të vetëdijshëm për kohën. Besimtarët duhet të mbahen fort pas së vërtetës se, atë që premtton Perëndia, edhe do ta bëjë (shih 1 Mbre. 8:24, 26, 56). Ne kemi besim në karakterin, premtimet, fjalën dhe Birin e tij! Koha s’ka rëndësi, ndonëse Perëndia e përdor kohën për shpalosjen e qëllimeve të tij.

Brezi i parë i besimtarëve priste që Jezusi të kthehej shpejt (shih Marku 13:30). Kjo është një arsye pse ata nuk i shkruan fjalët dhe veprat e Jezusit (ungjijtë) për shumë vjet. Por, me zgjatjen e vonesës së kthimit të Jezusit,

1. dëshmitarët okularë filluan të vdisnin
2. mësuesit e rremë hapën sekte të tyre

3. disa filluan të pyesnin pse po vonohej Jezusi

Si Pali (shih 2 Thesalonikasve 2), ashtu dhe Pjetri (shih 2 Pjetrit 3), e trajtojnë këtë temë të vonesës së Ardhjes së Dytë. Edhe në mësimet e Jezusit ka një tension mes kthimit të atypëratyshëm (shih Mat. 10:23; 24:27, 34, 44; Marku 9:1; 13:30) dhe “disa ngjarjeve që duhet të ndodhin më parë”:

1. ungjillizimi i mbarë botës, shih Mat. 24:15; Marku 13:10
2. zbuluesia e “njeriut të mëkatit”, shih Mat. 24:15; 2 Thesalonikasve 2; Zbuluesia 13
3. përndjekja e madhe, shih Mat. 24:21, 24; Zbuluesia 13

Në mënyrë unike, Pjetri e lidh këtë vonesë me dhembshurinë e Perëndisë për të humburit! Perëndia po e vonon kthimin e Krishtit në mënyrë që gjithnjë e më tepër njerëz të pendohen dhe të kthehen tek ai përmes Krishtit. Jeta e perëndishme e besimtarëve duhet t’i drejtojë jobesimtarët te Perëndia!

3:9 “Zoti nuk është i ngadaltë” Ky përdorim i fjalës “Zot” i referohet JHVH-së. Plani shpalosës i Perëndisë (shih Hab. 2:3) për krijimin dhe shpengimin u duket shumë i ngadaltë njerëzve. Elementi kohor na lejon që të ushtrojmë besim brenda kohës. Kjo periudhë e jetës sonë është e vetmja kohë që besimtarët mund ta jetojnë me besim, që i pëlqen Perëndisë. Durimi dhe jeta jonë e perëndishme janë shprehje dhe dëshmi të përkushtimit tonë me besim në të.

■ **“por është i duruar me ju”** Një nga karakteristikat e Perëndisë është durimi i tij i madh ndaj mëkatarëve dhe shenjtorëve. Mirëpo të dyja këto grupe përfitojnë prej durimit të tij. Durimi i tij ka një synim: rikthimi i shëmbëllimit hyjnor të humbur pas Rënies.

■ **“nuk dëshiron që të humbasë askush”** Kjo është pjesore e tashme mesore (deponente). Perëndia dëshiron që gjithë njerëzit të shpëtojnë (shih Ezek. 18:23,32; 33:11; Gjoni 3:16; 4:42; Veprat 17:30; Rom. 11:32; 1 Tim. 2:4,6; 4:10; Titit 2:11; Heb. 2:9; 1 Gjonit 2:2). Për shkak se të gjithë njerëzit janë bërë në shëmbëllimin e tij për bashkësi personale me të, ai e dërgoi Birin e vet që të vdiste në mënyrë që të gjithë të mund t’i përgjigjen me besim (shih Rom. 5:12-21). Ky është drejtpeshim i rëndësishëm ndaj atyre sistemeve teologjike që e zmadhojnë rolin e Perëndisë në shpëtim, por e minimizojnë përgjigjen e domosdoshme të njerëzimit ndaj besëlidhjes. Më poshtë, kam përfshirë shënimet e mia për 1 Tim. 2:4 (vëll. 9, f. 25) në lidhje me këtë temë.

Shënime nga komentari im për 1 Timoteut 2:4

2:4 “i cili dëshiron që të gjithë njerëzit të shpëtohen” Besimtarët duhet të lutën për gjithë njerëzit, pasi Perëndia dëshiron që të gjithë të shpëtohen. Kjo ishte thënie tronditëse për mësuesit e rremë ekskluzivistë, qofshin ata gnostikë apo judenj ose (si, ndoshta, në rastin e letrave pastorale) të dyja bashkë. Kjo është e vërtetë madhështore për dashurinë e Perëndisë për gjithë njerëzimin (shih 1 Tim. 4:10; Ezek. 18:23,32; 33:11; Gjoni 3:16; Veprat 17:30; Rom. 11:22; 1 Tim. 2:4,6; 4:10; Titit 2:11; Heb. 2:9; 2 Pje. 3:9; 1 Gjonit 2:2). Ky varg tregon mungesën e drejtpeshimit të atij paracaktimi dogmatik, superlapsarian dhe të dyfishtë, i cili thekson sovranitetin e Perëndisë duke përjashtuar çdo përgjigje të nevojshme nga njeriu. Të vërtetat e shprehura të kalvinizmit “pesëpikësh”, sidomos “hiri i parëzistueshëm” dhe “shlyerja e kufizuar” e shkelin aspektin e besëlidhjes së besimit biblik. Është e pasaktë që ta reduktosh Perëndinë në një kukull të vullnetit të lirë njerëzor, por është po aq e pavend që ta reduktosh njerëzimin në një kukull të vullnetit hyjnor. Në sovranitetin e vet, Perëndia ka zgjedhur që të ketë marrëdhënie me njerëzimin e rënë me anë të besëlidhjes. Ai është gjithmonë personi që nis dhe strukturon besëlidhjen (shih Gjoni 6:44, 65), por gjithashtu ka urdhëruar që njerëzit duhet të reagojnë dhe të vazhdojnë t’i përgjigjen me pendim dhe besim (shih Marku 1:15; Veprat 3:16, 19; 20:21), si dhe me bindje dhe qëndresë!

Shpesh, diskutimi teologjik i sovranitetit (paracaktimit) të Perëndisë dhe vullnetit të lirë njerëzor përfundon në një garë për të siguruar “pasazhe provë”. Bibla na e zbulon qartë sovranitetin e JHVH-së. Megjithatë, ajo na zbulon edhe faktin se krijesës më të lartë të tij, njerëzimit, i bërë në shëmbëllimin e tij, i është dhënë cilësia e mahnitshme personale që të bëjë vendimmarrje morale. Njerëzit duhet të bashkëpunojnë me Perëndinë në çdo aspekt të jetës.

Fjala “shumë” është përdorur për të thënë se Perëndia ka zgjedhur disa (të zgjedhurit), por jo gjithë njerëzit; se Jezusi vdiq për disa, jo për të gjithë. Një lexim i kujdesshëm i pasazheve të mëposhtme tregon se këto përdoren në mënyrë paralele!

Isaia 53

1. “të gjithë” (Isa. 53:6)
2. “shumë” (Isa. 53:11-12)

Romakëve 5

1. “të gjithë” (Rom. 5:18)
2. “shumë” (Rom. 5:19)

TEMË E VEÇANTË: PLANI I PËRJETSHËM SHPENGUES I JHVH (SPECIAL TOPIC: YHWH'S ETERNAL REDEMPTIVE PLAN)

Të dashur lexues, duhet t'ju rrëfej se jam i anshëm në këtë pikë. Teologjia ime sistematike nuk është kalvinizmi ose dispensacionalizmi, por besimi ungjillor i Porosisë së Madhe (shih Mat. 28:18-20; Luka 24:46-47; Veprat 1:8). Unë besoj se Perëndia ka një plan të përjetshëm për shpengimin e gjithë njerëzimit (p.sh., Zan. 3:15; 12:3; Eks. 19:5-6; Jer. 31:31-34; Ezekieli 18; 36:22-39; Veprat 2:23; 3:18; 4:28; 13:29; Rom. 3:9-18, 19-20, 21-31), për gjithë ata që janë krijuar në shëmbëllimin dhe ngjashmërinë e tij (shih Zan. 1:26-27). Besëlidhjet janë bashkuar në Krishtin (shih Gal. 3:28-29; Kol. 3:11). Jezusi është misteri i Perëndisë, dikur i fshehur por tani i zbuluar (shih Efe. 2:11-3:13)! Çelësi për të kuptuar Biblën nuk është Izraeli, por ungjilli i DHR.

Këto koncepte paraprake ma përcaktojnë gjithë interpretimin që i bëj Shkrimit. I lexoj të gjitha pasazhet përmes këtyre koncepteve! Padyshim që kjo quhet anësi (të gjithë interpretuesit e kanë një të tillë!), por ama është anësi e informuar nga Bibla.

Fokusi i Zanafillës 1-2 është krijimi nga JHVH i një vendi ku ai dhe krijesa e tij më e lartë, njerëzimi, mund të kenë miqësi me njëri-tjetrin (shih Zan. 1:26, 27; 3:8). Krijimi fizik është skena ku zhvillohet ky plan hyjnor ndërpersonal.

1. Shën Augustini e karakterizonte si një boshllëk me formë hyjnore brenda çdo njeriu; ky boshllëk mund të mbushet vetëm nga Perëndia.
2. C. S. Ljui e quanet këtë planet “planeti i prekur”, (pra, i përgatitur nga Perëndia për njerëzit).

DHV përmban shumë shenja të këtij plani hyjnor.

1. Zanafilla 3:15 është premtimi i parë; sipas tij, JHVH Perëndia nuk do ta braktisë njerëzimin në lëmshin e tmerrshëm të mëkatit dhe kryengritjes. Këtu nuk bëhet fjalë për Izraelin, pasi në atë kohë s'kishte Izrael, as popull të besëlidhjes; kjo ndodhi vetëm pas thirrjes së Abrahamit në Zanafilla 12.
2. Zanafilla 12:1-3 përbën thirrjen e parë të Abrahamit nga JHVH, ku atij iu zbulua se do të bëhet babai i popullit të besëlidhjes, Izraelit. Por edhe në këtë thirrje të parë, Perëndia e kishte vështrimin te gjithë bota. Vini re Zan. 12:3!
3. Në Eksodi 20 (Ligji i Përtërirë 5), JHVH ia dha ligjin e vet Moisiut për ta udhëhequr popullin e tij të veçantë. Vini re se, në Eks. 19:5-6, JHVH i zbulon Moisiut marrëdhënien unike që do të ketë Izraeli. Por vini re, gjithashtu, se ashtu si Abrahami, edhe Izraeli u zgjodh për të bekuar botën (shih Eks. 19:5, “sepse gjithë toka është e imja”). Izraeli duhet të shërbente si mekanizëm me anë të së cilit kombet do të njihnin JHVH-në dhe do të besonin në të. Izraeli dështoi në mënyrë tragjike (shih Ezek. 36:22-38).
4. Në 1 Mbretërve 8, Solomoni e përkushton tempullin që të gjithë të vijnë te JHVH (shih 1 Mbre. 8:43, 60).
5. Në Psalmet – 22:27-28; 66:4; 86:9 (Zbu. 15:4)
6. Nëpërmjet profetëve, JHVH vazhdoi të zbulonte planet e tij shpenguese për gjithë botën.
 - a. Isaia – 2:2-4; 12:4-5; 25:6-9; 42:6,10-12; 45:22; 49:5-6; 51:4-5; 56:6-8; 60:1-3; 66:18,23
 - b. Jeremia – 3:17; 4:2; 16:19
 - c. Mikea 4:1-3
 - d. Malakia 1:11

Ky theksim i përbotshëm bëhet i mundshëm nga shfaqja e “besëlidhjes së re” (shih Jer. 31:31-34; Ezek. 36:22-38), që përqendrohet në mëshirën e JHVH, jo në përpjekjet e njerëzve të rënë. Ajo do të sjellë “një zemër të re”, “një mendje të re” dhe “një shpirt të ri”. Bindja është thelbësore, por është diçka e brendshme, jo thjesht një kod i jashtëm (shih Rom. 3:21-31).

DHR e thekson qartë planin e përbotshëm shpengues në disa mënyra.

1. Porosia e Madhe – Mat. 28:18-20; Luka 24:46-47; Veprat 1:8
2. Plani i përjetshëm (pra, i paracaktuar) i Perëndisë – Luka 22:22; Veprat 2:23; 3:18; 4:28; 13:29
3. Perëndia dëshiron që gjithë njerëzit të shpëtohen; Gjoni 3:16; 4:42; Veprat 10:34-35; 1 Tim. 2:4-6; Titit 2:11; 2 Pje. 3:9; 1 Gjonit 2:2; 4:14
4. Krishti bashkon DHV me DHR – Gal. 3:28-29; Efe. 2:11-3:13; Kol. 3:11. Të gjitha pengesat dhe dallimet njerëzore

DHR përqendrohet në Jezusin, jo në Izraelin. Rol qëndror luan ungjilli, jo kombësia apo zona gjeografike. Izraeli është zbuluesi e parë, por Jezusi është zbuluesi përfundimtar (shih Mat. 5:17-48).

Shpresoj që do të merrni pak kohë për të lexuar Temën e Veçantë: Pse duken premtimet e besëlidhjes së DHV kaq të ndryshme nga premtimet e besëlidhjes së DHR? Këtë mund ta gjeni falas në internet në www.freebiblecommentary.org.

■ **“të gjithë të vijnë në pendim”** Vini re theksimin e fjalës “të gjithë”, jo thjesht “disa” (pra, të zgjedhurit). Çdo njeri është potencialisht i zgjedhur në Krishtin. Shih Temën e Veçantë: Pendimi në Dhiatën e Vjetër, në Marku 1:4.

3:10 “dita e Zotit do të vijë si vjedhës” Kjo frazë “dita e Zotit” është frazë e DHV për fundin e kohës. Shpesh, vjedhësit përdoren si metaforë për vizitën e papritur (shih Mat. 24:43-44; Luka 12|39; 1 Thes. 5:2; Zbu. 3:3; 16:15) të Perëndisë (pra, Dita e Gjykimit/Ardhja e Dytë/Dita e Ringjalljes).

■ **“qiejt do të kalojnë”** Ky është motiv i përsëritur (pra, krijimi fizik do të përfundojë, por fjala e Perëndisë, jo; shih Marku 13:31; Mat. 5:18; 24:35), i cili përshkruan përkohshmërinë dhe natyrën e fundme të krijesës fizike (shih Zbu. 21:1).

NASB, NJB “me oshëtimë”
NKJV “me zhurmë të madhe”
NRSV “me zhurmë të lartë”
TEV “me zhurmë të stërmadhe”

Kjo fjalë ka ngjyrimin kuptimor të një zhurme të lartë e të shpejtë të diçkaje që lëviz vërtik në ajër. Përmeshja dhe pastrimi i epokës së re do të vijë me një tingull dhe flakë si ato të inaugurimit të epokës së re në ditën e Rrëshajëve (shih Veprat 2:2-3).

■ **“elementet”** Shumica e fjalëve zhvillohet nga një kuptim i fjalëpërfjalshëm fizik në një kuptim metaforik. Kjo fjalë (*stoiheia*), në fillim, bënte fjalë për diçka në radhë, në rresht. Më vonë, mori një sërë ngjyrimesh kuptimore:

1. Elementet bazë fizike prej së cilave është ndërtuar bota (ajri, uji, toka dhe zjarri; shih 2 Pje. 3:10, 12).
2. Mësimet bazë të një teme të caktuar (shih Heb. 5:12; 6:1; për judaizmin).
3. Fuqitë engjëllore pas trupave qiellorë (shih *1 Enokut* 52:8-9; etërit e kishës së hershme; Kol. 2:8 20; 1 Kor. 15:24), ose nivelet engjëllore (*aeon*-at) e mësuesve të rremë gnostikë (shih Kol. 2:10, 15; Efe. 3:10).
4. Engjëjt armiq të njerëzimit, të cilët u përpoqën ta ndalonin Moisiun që të merrte ligjin (shih Veprat 7:38; Heb. 2:2).
5. Ndoshta, strukturat jofrymore të botës sonë të rënë, që i lejojnë njerëzimit të rënë të duket i pavarur nga Perëndia (arsimi, qeverisja, mjekësia, feja, etj.; shih Gal. 4:3, 8-9 dhe Hendrik Berkhof, *Christ and the Powers*, nga Herald Press, f. 32).

■ **“me nxehtësi të tmerrshme”** Kjo është pjesore e tashme pësore, që nënkupton se Perëndia është vepruesi i papërmendur. Ky është term mjekësor që tregon temperaturë të lartë.

NASB “toka dhe veprat e saj do të shkrumbohen”
NKJV “toka dhe veprat që janë në të do të shkrumbohen”
NRSV “toka dhe gjithçka që bëhet në të do të zbulohet”
TEV “toka me gjithçka në të do të zhduket”

NJB “toka, dhe gjithçka që përmban, do të shkumbohet”

Ka shumë variante në dorëshkrimet greke në këtë frazë.

1. “do të zbulohet” (shih dorëshkrimet Sinaitikus, B, K, P)
2. “do të dalë e shkatërruar” (shih dorëshkrimi P72)
3. “do të shkumbohet” (shih dorëshkrimi A)
4. “do të fshihet” (shih dorëshkrimi C)

Nuk ka asnjë siguri për fjalën në tekstin origjinal greqisht; s’ekziston asnjë mundësi e fortë për përkthimin e kësaj fraze.

TEKSTI I NASB (I PËRDITËSUAR): 2 PJETRIT 3:11-13

¹¹Meqë të gjitha këto gjëra do të shkatërrohen në këtë mënyrë, ç’lloj njerëzish duhet të jeni ju, me sjellje të shenjtë dhe perëndishmëri, ¹²duke pritur dhe përshpejtuar ardhjen e ditës së Perëndisë, për shkak të së cilës qiejt do të shkatërrohen me djegie, dhe elementet do të shkrihen me nxehtësi të tmerrshme! ¹³Por sipas premtimit të tij, ne po presim qiej të rinj dhe një tokë të re, ku banon drejtësia.

3:11 “ç’lloj njerëzish duhet të jeni ju” Mësuesit e rremë e zhvlerësonin moralin dhe perëndishmërinë si mënyrë jetese, kështu që Pjetri vazhdon t’i ngrejë lart këto vlera.

■ **“me sjellje të shentjë dhe perëndishmëri”** Fjala “perëndishmëri” është koncept i rëndësishëm në 2 Pjetrit, njësoj si në letrat pastorale. Unë po riprodhoj shënimet e mia nga 1 Tim. 4:7 (shih vëll. 9, f. 53). 2 Pjetrit përdor emrin në 2 Pje. 1:3, 6, 7 dhe 3:11, dhe ndajfoljen në 2 Pje. 2:9.

Shënime nga komentari im për 1 Timoteun

■ **“perëndishmëri”** Kjo është fjalë kyçe në letrat pastorale. Bën fjalë për rrjedhojat doktrinale të ungjillit, si dhe rrjedhojat e tij në mënyrën e jetesës së përditshme (shih 1 Tim. 3:16). Përshkruan, jo të veçantën, por të pritshmen. Është një fjalë e përbërë nga “i mirë” (*eu*) dhe “adhurim” (*sebomai*). Adhurimi i vërtetë është jeta e përditshme me anë të mendimit të duhur (shih 1 Tim. 4:16a). Vini re sa herë përdoret kjo fjalë në letrat pastorale:

1. Emër (*eusebeia*), 1 Tim. 2:2; 3:16; 4:7,8; 6:3,5,6,11; 2 Tim. 3:5; Titit 1:1
2. Ndajfolje (*eusebēs*), 2 Tim. 3:12; Titit 2:12
3. Folje (*eusebeō*), 1 Tim. 5:4
4. Fjala e lidhur me të, *theosebeia*, 1 Tim. 2:10
5. Fjala e mohuar (alfa mohore, *asebeia*), 2 Tim. 2:16; Titit 2:12

3:12

NASB, NKJV “duke pritur dhe përshpejtuar ardhjen e ditës së Perëndisë”

NRSV “duke pritur dhe përshpejtur ardhjen e ditës së Perëndisë”

TEV “ndërsa prisni Ditën e Perëndisë dhe bëni të pamundurën që të ndodhë shpejt”

NJB “ndërsa prisni të vijë Dita e Perëndisë, dhe përpiqeni ta shpejtoni ardhjen e saj”

Të dyja këto janë pjesore të tashme veprore, që përshkruajnë dy aspekte të lidhura me Ardhjen e Dytë, që këtu në mënyrë unike quhet “dita e Perëndisë”. Në thelb, fjala e parë do të thotë “pres me zell” (shih Veprat 3:5; 10:24), ose “pres me frikë” (shih Luka 21:26; Veprat 27:33; 28:6). Përdoret tri herë në 2 Pjetrit 3:12, 13, dhe 14. Besimtarët presin me shpresë, ndërsa jobesimtarët i druhen kësaj dite llogaridhënieje.

Fjala e dytë ka dy kuptime që lidhen me strukturën gramatikore ku gjendet:

1. Nëse është folje kalimtare (pra, e kalon veprimin te një kundrinor i drejtë), do të thotë “nxis”, “jam i zellshëm për” (shih shënimet në NRSV, ASV, NEB, NIV, Peshita, dhe New Century Version, e ngjashme në kuptim me shprehjen *maranatha* të kishës së hershme).
2. Nëse është formë gramatikore jokalimtare (pra, përshkruan një gjendje ekzistence, ose fokusohet te kryesi i veprimit), do të thotë “përshpejtoj” (shih Luka 19:5; Veprat 22:18). Teologjia se veprimet e besimtarët mund ta përshpejtojnë kthimin e Zotit gjendet në Mat. 6:10 (lutja) dhe Veprat 3:19-20

(rilindja); Romakëve 9-11 (numri i plotë i johebrenjve dhe judenjve shpëtohet). Në këtë kontekst, mënyra e perëndishme e jetesës së besimtarëve inkurajohet nga një shpresë eskatologjike që mund të përmbushet nga çasti në çast.

Kjo është shprehje e vështirë për mendësinë tonë të sotme, që e zhvlerëson paradoksin. Perëndia është sovran dhe e ka caktuar datën për kthimin e Krishtit, por veprimet e besimtarëve (pra, lutja, dëshmia, perëndishmëria) mund ta ndryshojnë këtë datë (pra, më shpejt, ose më vonë). Ky është aspekti i besëlidhjes të së vërtetës biblike, që është shumë përshtjelluese për njerëzit e sotëm në perëndim. Perëndia ndikohet nga fëmijët e tij (si negativisht, ashtu dhe pozitivisht)! Megjithatë, pikërisht kjo e vërtetë është arsyeja sesi vepron lutja ndërmjetësuese.

■ **“për shkak të së cilës qiejt do të shkatërrohen me djegie, dhe elementet do të shkrihen me nxehtësi të tmerrshme”** Pyetja interpretuese është: “A janë këto aludime të fjalëpërfjalshme apo apokaliptike?” Këto thënie të ngjashme me ato të DHV kanë shumë gjëra të përbashkëta me Isa. 10:10-13; 34:4; 51:6; Joeli 2:28-32; Mik. 1:4. Ky kontekst e ka përmendur disa herë këtë sferë fizike të kohës dhe hapësirës, që përfundon me nxehtësi. Ky pastrim përgatit skenën shpirtërore për qiejt dhe tokën e re. A do të jenë këto qiej dhe kjo tokë e re fizike (kthim në Eden), apo shpirtërore (shih 1 Kor. 15:35-58)? Është e vështirë t’i përshkruash realitetet absolute dhe shpirtërore me fjalë tokësore dhe njerëzore. Realiteti nuk ndikohet nga gjinia letrare!

3:13 “Por sipas premtimit të tij” (shih Isa. 65:17-25; 66:22-24)

■ **“qiej të rinj dhe një tokë të re”** (shih Isa. 11:6-9; 65:17; 66:22; Zbu. 21:1-27)

■ **“ku banon drejtësia”** Perëndia dëshiron një skenë dhe një popull që i përputhet karakterit të tij (shih Isa. 45:24-25). Perëndia i shenjtë kërkon një popull të shenjtë (shih Isa. 60:12; Mat. 5:48). Ky është krijimi i ri, për shkak se i kundërvihet krijimit të rënë (shih Zan. 3).

TEKSTI I NASB (I PËRDITËSUAR): 2 PJETRIT 3:14-18

¹⁴Prandaj, të dashur, meqë po prisni këto gjëra, jini të zellshëm që të gjendeni prej tij në paqe, të panjollë dhe pa të metë, ¹⁵dhe konsiderojeni durimin e Zotit tonë si shpëtim; ashtu si dhe vëllai ynë i dashur Pali, sipas urtësisë që iu dha, ju shkroi, ¹⁶ashtu si bën në të gjitha letrat e tij, duke folur në to për këto gjëra, në të cilat ka disa gjëra të vështira për t’u kuptuar, të cilat të pamësuarit dhe të paqëndrueshmit i shtrembërojnë, siç bëjnë dhe me Shkrimet e tjera, për shkatërrimin e tyre. ¹⁷Prandaj, ju, të dashur, duke e ditur këtë që më parë, ruhuni që të mos ju bëjë për vete gabimi i njerëzve batakçinj dhe të mos bini nga qëndrueshmëria juaj, ¹⁸por rrituni në hirin dhe njohurinë e Zotit dhe Shpëtimtarit tonë, Jezu Krishtit. Atij i qoftë lavdia, tani dhe në jetë të jetëve. Amen.

3:14 “jini të zellshëm që të gjendeni prej tij në paqe” Kjo është urdhërore aoriste veprare, që thekson diçka urgjente. Besimtarët kanë përgjegjësinë që të bëjnë jetë të perëndishme. Besëlidhja kërkon një reagim të duhur ndaj dashurisë së Perëndisë.

Forma e dytë foljore është paskajore aoriste pësore. Me sa duket, bën fjalë për “ditën e Zotit” në 2 Pje. 3:12. Jezusi e përdor shpesh shembullin e besimtarëve si kujdestarë që u jepet përgjegjësia e pronës së zotërisë së tyre. Ata duhet të jenë gati në çdo kohë për kthimin e tij dhe, në atë kohë, do t’i japin llogari për kujdestarinë e tyre (shih Marku 13:33-37; Luka 18:8).

Paqja është e mundur vetëm nëse (1) individi i është përgjigjur ofertës së ungjillit; (2) e kupton mesazhin e ungjillit; dhe (3) e jeton përditë ungjillin. Mësuesit e rremë dhe ndjekësit e tyre dështojnë në të tria këto pika dhe nuk kanë paqe!

■ **“të panjollë dhe pa të metë”** Kjo frazë përdoret në 1 Pje. 1:19 për t’iu referuar Krishtit (shih Gjoni 8:46; 14:30; Luka 23:41; 2 Kor. 5:21; Heb. 4:15; 7:26-27; 1 Pje. 2:22; 3:18; 1 Gjonit 2:2; 4:14). Është metaforë e DHV, që përshkruan pastërtinë e kafshëve të flijimit (shih Lev. 22:19-20). Ne duhet të jetojmë në dritën e (1) shembullit të Krishtit, (2) urdhërimeve të Krishtit, dhe (3) ardhjes së Krishtit!

3:15

NASB, NRSV “konsiderojeni durimin e Zotit tonë si shpëtim”

NKJV “dhe llogarisni se durimi i Zotit tonë është shpëtim”

Për kë bën fjalë kjo: (1) të krishterët, që janë të shpëtuar tashmë, apo (2) mësuesit e paperëndishëm dhe rebelë, si dhe ndjekësit e tyre? Qartazi, po përmend sërish durimin e Perëndisë të 2 Pje. 3:9. Disa përfitojnë nga mëshira e Perëndisë që të mëkatojnë dhe të jetojnë jetë egoiste. Të tjerë e përqafojnë faljen e Perëndisë dhe imitojnë karakterin e tij.

■ **“ashtu si dhe vëllai ynë i dashur Pali”** Kjo frazë tregon qartë se nuk kishte asnjë tension mes Palit dhe Pjetrit. Secili prej tyre e kuptonte thirrjen dhe dhuntinë e tjetrit (shih Gal. 2:7-10). Incidenti i shënuar në Gal. 2:11-21 nuk shkaktoi përçarje të pakthyeshme.

■ **“ju shkroi”** Është e paqartë se për cilat letra të Palit bëhet fjalë. Nëse marrësit (në Azinë e Vogël) janë të njëjtët si ata të 1 Pjetrit, dhe Pali ua shkroi letrën e Galatasve një grupi verior të kishave në Azinë e Vogël, atëherë Galatasve u shkrua herët për të njëjtën zonë si dhe 2 Pjetrit, dhe mundësia më e fortë është letra e Galatasve. Por, në të vërtetë, nuk dimë gjë.

Mundësia e dytë është se, meqë tema e përgjithshme e këtij kapitulli është Ardhja e Dytë, atëherë, ndoshta, letrat e hershme të Palit drejtuar Thesalonikasve janë ato që përmenden këtu. Mundësia e tretë është se disa mendojnë që një pjesë Romakëve funksiononte në fillim si letër qarkore. Për mendimin tim, Galatasve ose Romakëve, që janë letrat më teologjike të Palit në lidhje me shpëtimin, janë ndoshta hamendësimi më i mirë.

3:16 “si bën në të gjitha letrat e tij” Një pjesë e mirë e kritikave që thonë se 2 Pjetrit nuk u shkrua nga apostulli Pjetër lidhen me këtë përmendje të letrave të Palit. Është e vërtetë se të gjitha letrat e Palit u mbledhën së bashku dhe u qarkulluan nën titullin “Apostulli”, por kjo ndodhi shumë më pas vdekjes së Pjetrit në Neronin (64-68 pas K.). Megjithatë, ky varg nuk na tregon për sa letra të Palit e ka fjalën Pjetri dhe as nuk e përmend qarkullimin e gjithë letrave të Palit së bashku.

■ **“duke folur në to për këto gjëra, në të cilat ka disa gjëra të vështira për t’u kuptuar”** Cilat gjëra? (1) Zbulesa (shih 2 Pje. 3:2); (2) ditët e fundit (2 Pje. 3:3-4a); (3) krijimi (2 Pje. 3:4b-5); (4) përmbytja e Noeut (2 Pje. 3:6); (5) dita e gjykimit (2 Pje. 3:7, 10); (6) koha e Perëndisë (2 Pje. 3:9); (7) Ardhja e Dytë (2 Pje. 3:12); (8) epoka e re e drejtësisë (2 Pje. 3:12-13); (9) shpëtimi personal (2 Pje. 3:14a, 15a); (1) jeta e perëndishme (2 Pje. 3:11, 14b); ose (11) diçka në kapitullin një ose dy?

Për çfarëdo të bëhej fjalë, mësuesit e rremë e keqkuptonin dhe e shtrembëronin për dëmin e vetë atyre. Në këtë kuptim, ka gjasa që bëhet fjalë për theksimin që i bënte Pali shpëtimit si dhuratë falas nga Perëndia, pa veprat njerëzore të drejtësisë (pra, shfajësimi me anë të besimi). Ndoshta, Jakobi (shih Jakobi 2:14-26) korrigjon një tjetër keqkuptim të predikimit të Palit.

■ **“të cilat të pamësuarit dhe të paqëndrueshmit i shtrembërojnë, siç bëjnë dhe me Shkrimet e tjera”** Është e dobishme për mua të kuptoj se edhe apostujt, që ecën personalisht me Jezusin për vite me radhë nuk e kuptonin gjithmonë atë (shih Marku 9:32; Luka 2:50; 9:45; 18:34; Gjoni 2:22; 10:6; 12:16; 16:18). Madje, apostujt nuk kuptonin as gjithë shkrimet e apostujve të tjerë. Neve na bëhet thirrje të jemi dëshmitarë besnikë dhe vëllezër të perëndishëm të besëlidhjes! Askush prej nesh nuk i kupton të gjitha gjërat.

Në DHR, fjala “Shkrime” përdoret gjithmonë për DHV. DHR nuk u përfundua dhe u përpilua para fundit të shekullit të parë. Shumica e pasazheve të njohura për frymëzimin dhe besueshmërinë e Shkrimeve bëjnë fjalë për DHV (shih Mat. 5:17-19; 1 Kor. 2:9-13; 1 Thes. 2:13; 2 Tim. 3:16; 1 Pje. 1:23-25; 2 Pje. 1:20-21).

Ky është një nga vargjet e paktë ku shkrimet e DHR barazohen me Shkrimet e DHV. Me këtë frazë, Pjetri pranon frymëzimin e Palit dhe autoritetin e shkrimeve të tij.

■ **“për shkatërrimin e tyre”** Bibla është vetëzbulesa e Perëndisë për botën e humbur dhe nevojtarë. Njerëzit mëkatarë (pra, mësuesit e rremë) e shtrembërojnë për rrezikun e tyre. Gjykimi po vjen: Jezusi është e vetmja shpresë. Çdo njeri do të qëndrojë përpara Perëndisë një ditë!

3:17 “duke e ditur këtë që më parë” Mësuesit e rremë janë gjithmonë të pranishëm! Lexuesit shqetësoheshin për përdorimin që iu bënin mësuesit e rremë Shkrimeve (pra, DHV) dhe shkrimeve apostolike (shih 2 Pje. 3:2). Ka disa mënyra biblike për ta dalluar mësuesin e rremë:

1. shenja dhe mrekulli, por në emër të një perëndie tjetër (LiP. 13:1-5)
2. parashikim të saktë të së ardhmes, por në emër të një perëndie tjetër (LiP. 18:18-22)
3. mënyra e jetesës (Mat. 7; Jakobi; 1 Gjonit; dhe 2 Pjetrit)
4. mrekullitë nuk janë automatikisht shenja të Perëndisë (Mat. 24:24)
5. mesazhi duhet të ketë në qendër Krishtin (1 Gjonit 4:1-6)
6. keqinterpretimi i zbulesës së Perëndisë (2 Pje. 3:2)

▣ **“ruhuni”** Kjo është urdhërore e tashme mesore. Është fjalë ushtarake, si te 1 Pje. 1:4. Besimtarët kanë përgjegjësinë personale që të kontrollojnë dhe vlerësojnë vazhdimisht ato që thonë të tjerët për Perëndinë/Krishtin. Ka mashtrues, si brenda, ashtu dhe jashtë bashkësisë (shih Efe. 4:14; 6:11-12). Mos jini naivë nga ana shpirtërore!

▣ **“që të mos ju bëjë për vete”** Kjo është pjesore aoriste pësore. Është e kundërta e fjalës “besim” në DHV, që nënkuptonte të qenit i patundur (pra, i palëkundur dhe i paqëndrueshëm). E njëjta fjalë përkthyer dhe veprimet e vetë Pjetrit në Gal. 2:13.

3:18 “por rrituni në hirin dhe njohurinë e Zotit dhe Shpëtimtarit tonë” Kjo është urdhërore e tashme veprorë. Ka qenë temë qendrore e kësaj letrë. Besimtarët i ruhen gabimit duke u rritur në njohurinë e unguillit dhe duke e jetuar në praktikë unguillin. Kjo është paralele me Judën 20.

▣ **“Atij i qoftë lavdia”** Kjo frazë përdoret në shumicën e rasteve për Perëndinë Atë (shih shënimin në 1 Pje. 4:11, shih Juda; 2 Pje. 3:24-25), dhe ndonjëherë përdoret për Krishin (shih 2 Tim. 4:18; 2 Pje. 3:18; Zbu. 1:6).

Në DHV, fjala hebraisht që përdoret me shumë për “lavdinë” (*kbd*), në fillim, ishte fjalë tregtare, që bënte fjalë për një palë peshore dhe donte të thoshte “e rëndë”. Ajo që ishte e rëndë ishte e vyer ose kishte vlerë të qenësishme. Shpesh, shtohet dhe koncepti i shkëlqimit për të shprehur madhësitë e Perëndisë (shih Eks. 19:16-18; 24:17; Isa. 60:12). Vetëm ai ka vlerë dhe duhet nderuar. Perëndia është tepër i shkëlqyer që ta shohë njerëzimi i rënë (shih Eks. 33:17-23; Isa. 6:5). Perëndia mund të njihet vërtet vetëm nëpërmjet Krishtit (shih Jer. 1:14; Mat. 17:2; Heb. 1:3; Jakobi 2:1).

Fjala “lavdi” është disi e vagullt.

1. mund të jetë paralele me shprehjen “drejtësia e Perëndisë”
2. mund të bëjë fjalë për shenjtërinë ose përsosmërinë e Perëndisë
3. mund të bëjë fjalë për shëmbëllimin e Perëndisë në të cilin u krijua njerëzimi (shih Zan. 1:26-27; 5:1; 9:6), por që më vonë u njollosoi nga rebelimi (shih Zan. 3:1-22)

Në fillim, u përdor për praninë e JHVH-së mes popullit të tij në Eks. 16:7, 10; Lev. 9:23; Num. 14:10.

NASB, NRSV “tani dhe në jetë të jetëve”

NKJV “tani dhe përjetë”

TEV “tani e në jetë të jetëve”

NJB “në kohë dhe në përjetësi”

Fjalë për fjalë “si tani, ashtu dhe në ditën e epokës”. Kjo është formë unike e një përmbylljeje tipike, disi paralele me Judën 1:25. Judenjtë e shihnin historinë të ndarë në dy epoka: epoka e ligë dhe epoka e ardhshme e drejtësisë. Kjo epokë e ardhshme është sinonimike me mbretërinë e përjetshme. Shih Temën e Veçantë në Marku 13:8.

▣ **“Amen”** Kjo fjalë mungon në dorëshkrimin e lashtë uncial greke B (pra, Vatikanus), por është e pranishme në P72, Sinaitikus, A dhe C. Shih Temën e Veçantë në Marku 3:28.

PYETJE PËR DISKUTIM

Ky është një komentari studimor udhëzues, që do të thotë se ti je vetë përgjegjës për interpretimin e Biblës. Secili prej nesh duhet të ecë sipas dritës që ka. Ti, Bibla dhe Fryma e Shenjtë keni përparësi në interpretim. Nuk duhet t'ia dorëzosh këtë të drejtë komentuesit.

Këto pyetje për diskutim t'i kam dhënë për të të ndihmuar që të analizosh çështjet kryesore të kësaj pjese të librit. Ato synojnë të të nxisin mendimin, jo të kenë natyrë shteruese.

1. Pse e mohonin gnostikët Ardhjen e Dytë?
2. Cili është mesazhi kryesor i DHR në lidhje me Ardhjen e Dytë?
3. Pse i përmend Pjetri shkrimet e Palit?

PËRCAKTIVE TË SHKURTRA TË TERMAVE GRAMATIKORE GREQISHT

Grequishtja *koine*, shpesh e quajtur grequishtja heleniste, ishte gjuha e përbashkët e botës mesdhetare, duke filluar që nga pushtimi i Aleksandrit të Madh (336-323 para K.) dhe duke zgjatur rreth tetëqind vjet (300 para K. – 500 pas K.). Ajo nuk ishte thjesht greqishte klasike e thjeshtëzuar, por, në shumë mënyra, ishte një formë më e re e greqishtes, e cila u bë gjuha e dytë e Lindjes së mesme dhe botës mesdhetare në lashtësi.

Grequishtja e Dhiatës së Re ishte unike në shumë mënyra pasi përdoruesit e saj, përjashtoj Lukën dhe autorin e Hebrejve, ndoshta përdornin aramaishten si gjuhë të parë. Si rrjedhojë, shkrimet e tyre u ndikuan nga idiomat dhe format strukturore të aramaishtes. Po kështu, ata lexonin dhe citonin Septuagintën (përkthimin greqisht të DhV), e cila ishte shkruar gjithashtu në greqishten *koine*. Mirëpo edhe Septuaginta ishte shkruar nga studiues judenj, gjuha amtare e të cilëve nuk ishte greqisht.

Kjo na shërben si kujtesë se nuk mund ta futim forcërisht Dhiatën e Re brenda një strukture të ngushtë gramatikore. Ajo është unike, por, megjithatë, ka shumë të përbashkëta me (1) Septuagintën; (2) shkrimet judaike si ato të Jozefit; dhe (3) papiruset e gjetura në Egjipt. Po atëherë, si duhet t'i qasemi analizës gramatikore të Dhiatës së Re?

Tiparet gramatikore të greqishtes *koine* dhe greqishtes *koine* të Dhiatës së Re janë të paqëndrueshme. Në shumë mënyra, bëhet fjalë për një periudhë thjeshtëzimi të gramatikës. Si udhërrëfyes kryesor do të kemi kontekstin. Fjalët kanë kuptim vetëm në një kontekst më të gjerë, prandaj, struktura gramatikore mund të kuptohet vetëm në dritën e (1) stilit individual të autorit; dhe (2) kontekstit të veçantë. Asnjë përcaktim përfundimtar i formave dhe strukturave greke nuk është i mundshëm.

Grequishtja *koine* ishte kryesisht një gjuhë foljore. Shpesh, çelësi drejt interpretimit është lloji dhe forma e trajtave FOLJORE. Në shumicën e rasteve, FOLJA shfaqet e para, duke treguar epërsinë e saj. Në analizën e FOLJES greke, duhen vërejtur tre pjesë informacioni: (1) theksimi bazë i KOHËS, DIATEZËS dhe MËNYRËS (eptimi, ose morfologjia); (2) kuptimi bazë i FOLJES (leksikografia); dhe (3) rrjedha e kontekstit (sintaksa).

I. KOHA

- A. Koha ose aspekti ka të bëjë me marrëdhënien e FOLJEVE me veprimin e përfunduar ose të papërfunduar. Shpesh, ai quhet “I KRYER”, ose “I PAKRYER”.
1. KOHËT E KRYERA përqendrohen te kryerja e një veprimi. Asnjë informacion i mëtejshëm nuk jepet përveç faktit se diçka ka ndodhur! Nuk trajtohet fillimi, vazhdimi, apo kulmimi i veprimit.
 2. KOHËT E PAKRYERA përqendrohen te procesi i vazhduar i një veprimi. Mund të përshkruhet në kuadër të veprimit linear, veprimit durativ, veprimit progresiv, etj.
- B. Kohët mund të kategorizohen sipas mënyrës sesi autori sheh përparimin e veprimit
1. Ndodhi = AORIST
 2. Ndodhi, dhe rezultatet vazhdojnë = E KRYER
 3. Po ndodhte në të kaluarën dhe rezultatet po vazhdonin, por jo tani = E KRYER E TEJSHKUAR
 4. Po ndodh = E TASHME
 5. Po ndodhte = E PAKRYER
 6. Do të ndodhë = E ARDHME
- Një shembull konkret sesi ndihmojnë këto KOHË në interpretim do të ishte fjala “shpëtoj”. Ajo përdoret në disa kontekste të ndryshme për të treguar, si procesin, ashtu dhe kulmimin e tij:
1. AORISTI = “shpëtoi” (shih Rom. 8:24)
 2. E KRYER = “jemi shpëtuar dhe rezultati vazhdon” (shih Efe. 2:5, 8)
 3. E TASHME = “po shpëtohem” (shih 1 Kor. 1:18; 15:2)
 4. E ARDHME = “do të shpëtohem” (shih Rom. 5:9; 10: 9)
- C. Kur përqendrohet te KOHËT E FOLJES, interpretuesi kërkon arsyen pse autori fillestar zgjodhi të shprehej në një KOHË të caktuar. Koha standarde, “pa lajlelule”, ishte AORISTI. Kjo ishte forma e rregullt FOLJORE “e paspecifikuar”, “e paklasifikuar”, ose “e pashënuar”. Ajo mund të përdoret në një larmi të madhe mënyrash, të cilat duhet t'i qartësojë konteksti. Kjo kohë thjesht pohon se diçka ka

ndodhur. Aspekti i kohës së shkuar përdoret vetëm në MËNYRËN DËFTORE. Nëse përdoret një KOHË tjetër, po theksohej diçka më e veçantë. Por çfarë?

1. KOHA E KRYER. Bën fjalë për një veprim të përfunduar, por me rezultate që vazhdojnë. Në disa mënyra, ky ishte një kombinim i KOHËS AORISTE me atë TË TASHME. Zakonisht, fokusi është te rezultatet e vazhdueshme, ose te plotësimi i një veprimi (shembull: Efe. 2:5 dhe 8: “ju jeni shpëtuar dhe po vazhdoni të shpëtoheni”).
2. KOHA E KRYER E TEJSHKUAR. Kjo ishte si E KRYERA, përveçse këtu rezultatet e vazhduara kanë përfunduar. Për shembull: Gjoni 18:16, “Pjetri kishte qëndruar përjashta te porta”.
3. KOHA E TASHME. Flet për një veprim të papërfunduar ose të pakryer. Zakonisht, fokusi është te vazhdimi i ngjarjes. Shembull: 1 Gjoni 3:6 dhe 9, “Kushdo që banon në të nuk vazhdon të mëkatojë”. “Kushdo që është lindur nga Perëndia nuk vazhdon të kryejë mëkat”.
4. KOHA E PAKRYER. Në këtë kohë, marrëdhënia me KOHËN E TASHME është e ngjashme me marrëdhënien mes TË KRYERËS dhe TË KRYERËS SË TEJSHKUAR. E PAKRYERA flet për një veprim të paplotë që po ndodhte por që, tani, ka përfunduar, ose për fillimin e një veprimi në të shkuarën. Shembull: Mateu 3:5, “atëherë gjithë Jerusalemi po vazhdonte të shkonte tek ai”, ose, “atëherë, gjithë Jerusalemi filloi të shkonte tek ai”.
5. KOHA E ARDHME. Bën fjalë për një veprim që, zakonisht, vendoset në një kornizë kohore në të ardhmen. Fokusohej te mundësia e një ndodhie, sesa te një ndodhi aktuale. Shpesh, flet për sigurinë e ngjarjes. Shembull: Mat. 5:4-9, “Të bekuar janë... Ata do të...”.

II. DIATEZA

- A. DIATEZA përshkruan marrëdhënien mes veprimit të FOLJES dhe KRYEFJALËS së saj.
- B. DIATEZA VEPRORE ishte mënyra normale, e pritshme dhe e patheksuar për të pohuar se kryefjala po kryente veprimin e FOLJES.
- C. DIATEZA PËSORE do të thotë se kryefjala po merrte veprimin e FOLJES të kryer nga një veprues i jashtëm. Vepruesi i jashtëm që kryente veprimin tregohet në Dhr greqisht me anë të këtyre PARAFJALËVE dhe rasave:
 1. Një veprues personal i drejtpërdrejtë, nga *hupo* me RASËN RRJEDHORE (shih Mat. 1:22; Veprat 22:30).
 2. Një veprues personal i ndërmjetëm, nga *dia* me RASËN RRJEDHORE (shih Mat. 1:22).
 3. Një veprues jopersonal, zakonisht nga *en* me RASËN MJETORE.
 4. Nganjëherë, një veprues personal ose jopersonal, vetëm me anë të RASËS MJETORE.
- D. DIATEZA MESORE tregon se kryefjala prodhon veprimin e FOLJES dhe, gjithashtu, është e përfshirë drejtpërdrejt në veprimin e FOLJES. Shpesh, ajo quhet diateza e interesit të shtuar vetjak. Ky konstrukt theksonte në njëfarë mënyre kryefjalën e fjalisë ose periudhës. Ky konstrukt nuk gjendet në anglisht. Ka një mundësi të gjerë kuptimesh dhe përkthimesh në greqisht. Disa shembuj të kësaj forme janë:
 1. VETVETORE – veprimi i drejtpërdrejtë i kryefjalës mbi veten. Shembull: Mat. 27:5: “vari veten”.
 2. INTENSIVE – kryefjala e kryen veprimin për vete. Shembull: 2 Kor. 11:14: “vetë Satani e maskon veten si engjëll drite”.
 3. E NDËRSJELLË – veprim i ndërsjellë i dy vepruese. Shembull: Mat. 26:4: “ata këshillonin njëri-tjetrin”.

III. MËNYRA (ose “MODALITETI”)

- A. Greqishtja *koine* ka katër MËNYRA. Ato tregojnë marrëdhënien e FOLJES me realitetin, të paktën në mendjen e autorit. MËNYRAT ndahen në dy kategori të përgjithshme: ajo që tregonte realitetin (DËFTORE) dhe ajo që tregonte mundësinë (LIDHORE, URDHËRORE dhe DËSHIRORE).

- B. MËNYRA DËFTORE ishte forma normale për të shprehur një veprim që kishte ndodhur ose që po ndodhte, të paktën në mendjen e autorit. Ishte e vetmja mënyrë greqisht që shprehte një kohë të përcaktuar, ndonëse edhe këtu ky aspekt ishte dytësor.
- C. MËNYRA LIDHORE shprehte veprim të ardhshëm të mundshëm. Diçka nuk kishte ndodhur ende, por kishte mundësi që të ndodhte. Kishte shumë të përbashkëta me DËFTOREN E ARDHME. Dallimi ishte se LIDHORJA shpreh njëfarë mase dyshimi. Shpesh, në anglisht, shprehet me termat “mund të”, “do të”, “mund”.
- D. MËNYRA DËSHIRORE shprehte një dëshire që ishte teorikisht e mundshme. Konsiderohej si një hap më larg realitetit nga LIDHORJA. DËSHIRORJA shprehte mundësi në disa kushte të caktuara. DËSHIRORJA është e rrallë në Dhiatën e Re. Përdorimi i saj më i shpeshtë është në frazën e famshme të Palit, “Kurrë mos qoftë!” (KJV, “Mos e dhëntë Zoti”), e përdorur pesëmbëdhjetë herë (shih Rom. 3:4, 6, 31; 6:2, 15; 7:7, 13; 9:14; 11:1, 11; 1 Kor. 6:15; Gal. 2:17; 3:21; 6:14). Shembuj të tjerë gjenden te Luka 1:38; 20:16; Veprat 8:20; dhe 1 Thes. 3:11.
- E. MËNYRA URDHËRORE theksonte një urdhër që ishte i mundshëm, por theksin e vinte te synimi i folësit. Ajo theksonte vetëm një mundësi dëshirore dhe kushtëzohej nga zgjedhjet e tjetrit. URDHËRORJA përdorej në mënyrë të veçantë në lutjet dhe në kërkesat e vetës së tretë. Këto urdhra gjenden vetëm në KOHËN E TASHME dhe atë AORISTE në DhR.
- F. Disa gramatika kategorizojnë edhe PJESORET si një tjetër lloj MËNYRE. Ato janë shumë të zakonshme në DhR greqisht, dhe zakonisht përcaktohen si MBIEMRA FOLJORË. Ato përkthehen në lidhje me FOLJEN kryesoren me të cilën kanë të bëjnë. Ekzistonte një larmi e madhe mundësish për përkthimin e PJESOREVE. Gjëja më e mirë është të konsultosh disa përkthime të Biblës në anglisht. *The Bible in Twenty Six Translations (Bibla në 26 përkthime)*, e botuar nga Baker, është shumë e dobishme në këtë pikë.
- G. DËFTORJA AORISTE VEPRORE ishte mënyra normale, ose “e paklasifikuar”, për të shënuar një veprim. Çdo KOHË, DIATEZË, ose MËNYRË tjetër kishte një domethënie të veçantë interpretuese që dëshironte të komunikonte autori fillestar.
- IV. Për ata që nuk e njohin greqishtes, ndihmat e mëposhtme studimore do t’u sigurojnë informacionet e nevojshme:
- A. Friberg, Barbara dhe Timothy. *Analytical Greek New Testament (Dhiata e Re analitike në greqisht)*. Grand Rapids: Baker, 1988.
- B. Marshall, Alfred. *Interlinear Greek-English New Testament (Dhiata e Re ndërlineare greqisht-anglisht)*. Grand Rapids: Zondervan, 1976.
- C. Mounce, William D. *The Analytical Lexicon to the Greek New Testament (Leksiku analitik i Dhiatës së Re greqisht)*. Grand Rapids: Zondervan, 1993.
- D. Summers, Ray. *Essentials of New Testament Greek (Elementet bazë të greqishtes së Dhiatës së Re)*. Nashville: Broadman, 1950.
- E. Kurse greqishteje *koine* me korrespondence, të akredituar nga ana akademike, janë të disponueshme përmes Institutit Biblik Moody në Çikago, Illinois

V. EMRAT

- A. Nga ana sintaksore, EMRAT klasifikohen sipas RASËS. RASA ishte forma e eptuar e EMRIT, që tregonte marrëdhënien e tij me FOLJEN dhe me pjesë të tjera të fjalisë. Në greqishten *koine*, shumë prej funksioneve të RASËS tregoheshin nga PARAFJALËT. Meqë forma e RASËS ishte në gjendje të identifikonte një sërë marrëdhëniesh të ndryshme, u zhvilluan PARAFJALËT për t'u dhënë një ndarje më të qartë këtyre funksioneve të mundshme.
- B. RASAT greke kategorizoheshin në tetë mënyrat e mëposhtme:
1. RASA EMËRORE përdorej për të emërtuar dhe, zakonisht, ishte KRYEFJALA e fjalisë ose periudhës. Po kështu, përdorej edhe për EMRAT KALLZUESORË dhe MBIEMRAT me FOLJET lidhëse “jam” ose “bëhem”.
 2. RASA GJINORE përdorej për përshkrim dhe, zakonisht, i caktonte një cilësi ose sasi fjalës me të cilën lidhej. I përgjigjej pyetjes, “Çfarë lloji?” Shpesh, shprehet me përdorimin e PARAFJALËS “i/e [dikujt]”.
 3. RASA RRJEDHORE përdoret të njëjtën formë të eptuar si GJINORJA, por përdoret për të përshkruar ndarje. Zakonisht, shënonte ndarje nga një pikë në kohë, hapësirë, burim, origjinë ose shkallë. Shpesh, shprehej me përdorimin e PARAFJALËS “nga/prej”.
 4. RASA DHANORE përdorej për të përshkruar interes vetjak. Mund të shënonte një aspekt pozitiv, ose negativ. Shpesh, ajo ishte KUNDRINORI I ZHDREJTË. Shpesh, në anglisht shprehet me PARAFJALËN “to”.
 5. RASA VENDORE kishte të njëjtën formë të eptuar si DHANORJA, por përshkruante pozicionin ose vendndodhjen në hapësirë, kohë, ose kufij logjikë. Shpesh, shprehet me PARAFJALËT “në, mbi, mes, gjatë, me anë të, përbri”.
 6. RASA MJETORE kishte të njëjtën formë të eptuar si DHANORJA dhe VENDORJA. Shprehte mjete ose shoqërime. Shpesh, shprehet me PARAFJALËT “nga” ose “me”.
 7. RASA KALLËZORE përdorej për të përshkruar përfundimin e një veprimi. Shprehte kufizim. Kryesisht, përdorej për KUNDRINORIN E DREJTË. I përgjigjej pyetjes, “Sa larg?”, ose “Deri në çfarë mase?”
 8. RASA THIRRORE përdorej për thirrjen e drejtpërdrejtë.

VI. LIDHËZAT DHE LIDHËSET

- A. Greqishtja është gjuhë shumë precize, për shkak se ka një numër shumë të madh fjalësh lidhëse. Ato lidhin mendimet (PERIUDHAT, FJALITË dhe PARAGRAFËT). Janë kaq të zakonshme saqë, shpesh, mungesa (asindetit) e tyre ka rëndësi nga ana ekzegjetike. Në fakt, këto LIDHËZA dhe LIDHËSE tregojnë drejtimin e mendimit të autorit. Shpesh, kanë rol kyç në përcaktimin e saktë të asaj që po përpiqet të përçojë ai.
- B. Ja një listë me disa prej LIDHËZAVE dhe LIDHËSEVE, si dhe kuptimet e tyre (ky informacion është qëmtuar kryesisht nga libri i H. E. Dana dhe Julius K. Mantey, *A Manual Grammar of the Greek New Testament [Gramatikë praktike e Dhiatës së Re greqisht]*).
1. Fjalët lidhëse kohore
 - a. *epei, epeidē, hopote, hōs, hote, hotan* (LIDH.) – “kur”
 - b. *heōs* – “ndërsa”
 - c. *hotan, epan* (LIDH.) – “kurdo”
 - d. *heōs, achri, mechri* (LIDH.) – “derisa”
 - e. *prin* (PASK.) – “përpara”
 - f. *hōs* – “që kur”, “kur”, “ndërsa”
 2. LIDHËZA logjike
 - a. Qëllim
 - (1) *hina* (LIDH.), *hopōs* (LIDH.), *hōs* – “me qëllim që”, “që”
 - (2) *hōste* (PASKAJORE KALLËZORE NYJORE) – “që”

- (3) *pros* (PASKAJORE KALLËZORE NYJORE) ose *eis* (PASKAJORE KALLËZORE NYJORE) – “që”
- b. Rezultat
- (1) *hōste* (PASKAJORE, kjo është më e përhapura) – “me qëllim që”, “kështu”
 - (2) *hina* (LIDH.) – “në mënyrë që”
 - (3) *ara* – “kështu”
- c. Shkakore, ose arsye
- (1) *gar* (shkak/efekt, ose arsye/përfundim) – “sepse,” “pasi”
 - (2) *dioti, hoti* – “sepse”
 - (3) *epei, epeidē, hōs* – “meqë”
 - (4) *dia* (me kallëzore) dhe (me pask. nyjore) – “për shkak”
- d. Rrjedhimore
- (1) *ara, poinun, hōste* – “prandaj”
 - (2) *dio* (LIDHËZA më e fortë rrjedhimore) – “për shkak të kësaj”, “si rrjedhojë”, “prandaj”
 - (3) *oun* – “prandaj”, “kështu”, “atëherë”, “rrjedhimisht”
 - (4) *toinoun* – “në këtë mënyrë”
- e. Kundërshtore, ose kontrast
- (1) *alla* (KUNDËRSHTORE e fortë) – “por”, “përveç”
 - (2) *de* – “por”, “megjithatë”, “gjithsesi”, “nga ana tjetër”
 - (3) *kai* – “por”
 - (4) *mentoi, oun* – “sidoqoftë”
 - (5) *plēn* – “gjithsesi” (kryesisht te Luka)
 - (6) *oun* – “megjithatë”
- f. Krahasim
- (1) *hōs, kathōs* (prezanton FJALITË KRAHASUESE)
 - (2) *kata* (në fjalë të përbëra, *katho, kathoti, kathōsper, kathaper*)
 - (3) *hosos* (te Hebrejve)
 - (4) *ē* – “sesa”
- g. Vazhduese, ose seri
- (1) *de* - “dhe”, “tani”
 - (2) *kai* – “dhe”
 - (3) *te* – “dhe”
 - (4) *hina, oun* – “që”
 - (5) *oun* – “atëherë” (te Gjoni)
3. Përdorimet theksuese
- a. *alla* – “sigurisht”, “po”, “madje”
 - b. *ara* – “me të vërtetë”, “sigurisht”, “vërtet”
 - c. *gar* – “por me të vërtetë”, “sigurisht”, “vërtet”
 - d. *de* – “me të vërtetë”
 - e. *ean* – “madje”
 - f. *kai* – “madje”, “me të vërtetë”, “vërtet”
 - g. *mentoi* – “me të vërtetë”
 - h. *oun* – “vërtetë”, “patjetër”

VII. PERIUDHA KUSHTORE

- A. PERIUDHA KUSHTORE është ajo që përmban një ose më tepër fjali të varura kushtore. Kjo strukturë gramatikore i vjen në ndihmë interpretimit për shkak se jep kushtet, arsyet, ose shkaqet pse ndodh ose pse nuk ndodh veprimi i FOLJES kryesore. Ka katër lloje PERIUDHASH KUSHTORE. Ato variojnë nga ajo që supozohet si e vërtetë nga pikëvështrimi i autorit (ose për synimet e tij) tek ajo që është vetëm dëshirë.
- B. PERIUDHA KUSHTORE E KLASIT TË PARË shprehte veprim ose qenie që supozohej si e vërtetë nga pikëvështrimi i shkrimtarit (ose për synimet e tij), ndonëse shprehej me “nëse”. Në një sërë kontekstesh, mund të përkthehet “meqë” (shih Mat. 4:3; Rom. 8:31). Sidoqoftë, me këtë nuk nënkuptojmë se të gjitha

KLASET E PARË përrputhen me realitetin. Shpesh, ato përdoren për të vërtetuar një argument ose për të theksuar një ide të gabuar (shih Mat. 12:27).

- C. PERIUDHA KUSHTORE E KLASIT TË DYTË shpesh quhet “kundër fakteve”. Ajo shpreh diçka që ishte e pavërtetë ndaj realitetit, në mënyrë që të argumentonte diçka. Shembuj:
1. “Po të ishte vërtet profet, dhe nuk është i tillë, do të dinte se kush dhe ç’karakter është kjo gruaja që po varet tek ai, por ja që nuk e di” (Luka 7:39)
 2. “Po t’i kishit besuar vërtet Moisiut, por ju nuk i besoni, do të besonit edhe në mua, por ja që nuk po e bëni” (Gjoni 5:46)
 3. “Po të përpiquesha ende që të kënaqja njerëzit, gjë që nuk po e bëj, nuk do të isha aspak skllav i Krishtit, por ja që jam i tillë” (Gal. 1:10).
- D. KLASI I TRETË bën fjalë për një veprim të mundshëm në të ardhmen. Shpesh, supozon probabilitetin e veprimit. Zakonisht, nënkupton kushtëzim nga rrethanat. Veprimi i FOLJES kryesore varet nga veprimi në fjalinë e varur që fillon me “nëse”. Shembuj nga 1 Gjoni: 1:6-10; 2:4, 6, 9, 15, 20, 21, 24, 29; 3:21; 4:20; 5:14, 16.
- E. KLASI I KATËRT është më i largëti për sa i përket mundësisë. Është i rrallë në DhR. Në të vërtetë, nuk ekziston asnjë PERIUDHË e plotë KUSHTORE E KLASIT TË KATËRT, ku të dyja pjesët e kushtit të përrputhen me këtë përcaktim. Një shembull i KLASIT TË KATËRT të pjesshëm në fjalinë hapëse është 1 Pje. 3:14. Një shembull i KLASIT TË KATËRT të pjesshëm në fjalinë përmbyllëse është Veprat 8:31.

VIII. NDALIMET

- A. URDHËRORJA E TASHME me PJESËZËN MË shpesh (por jo ekskluzivisht) thekson ndalimin e një veprimi që është tashmë në kryerje e sipër. Disa shembuj: “mos mblidhni më pasuri në tokë...” (Mat. 6:19); “mos u shqetësoni më për jetën tuaj...” (Mat. 6:25); “mos i ofroni më mëkatit gjymtyrët e trupit tuaj si mjete keqbërje...” (Rom. 6:13); “duhet të ndalni së fyeri Frymën e Shenjtë të Perëndisë...” (Efe. 4:30); dhe “ndalni së u dehuri me verë...” (5:18).
- B. LIDHORJA AORISTE me PJESËZËN MË ka këtë theks: “as mos fillo apo nis të bësh një veprim”. Disa shembuj: “As mos fillo të mendosh se...” (Mat. 5:17); “kurrë mos fillo të shqetësohesh...” (Mat. 6:31); “kurrë s’duhet të kesh turp...” (2 Tim. 1:8).
- C. MOHORJA E DYFISHTË me MËNYRËN LIDHORE përbën një mohim shumë të theksuar. “Kurrën e kurrës”, ose “në asnjë lloj rrethane”. Disa shembuj: “Ai nuk do të përjetojë kurrën e kurrës vdekje” (Gjoni 8:51); “Unë, kurrën e kurrës, nuk...” (1 Kor. 8:13).

IX. NYJA SHQUESE

- A. Në greqishten *koine*, NYJA SHQUESE kishte një përdorim të ngjashëm me një shquese “*the*” në anglisht. Funkzioni bazë i saj ishte të shërbente si “dëftues”, si mënyrë për të tërhequr vëmendjen ndaj një fjale, emri, ose fraze. Përdorimi i saj ndryshon nga njëri autor në tjetrin në Dhiatën e Re. NYJA SHQUESE mund të funksionojë edhe si
1. mjet ballafaques, si PËREMËR dëftor;
 2. shenjë për t’iu referuar një teme ose personi të prezantuar më herët;
 3. mënyrë për të identifikuar KRYEFJALËN në fjali me një FOLJE lidhëse. Shembuj: “Perëndia është Frymë” (Gjoni 4:24); “Perëndia është dritë” (1 Gjoni 1:5); “Perëndia është dashuri” (4:8, 16).
- B. Greqishtja *koine* nuk kishte NYJË JOSHQUESE si në anglisht, “a” ose “an”. Mungesa e NYJËS SHQUESE mund të nënkuptonte

1. Një përqendrim të karakteristikat ose cilësitë e diçkaje
2. Një fokus në kategorinë e diçkaje

C. Autorët e DhR ndryshonin së tepërmi nga njëri-tjetri për mënyrën si e përdornin NYJËN.

X. MËNYRA PËR TË TREGUAR THEKSIMIN NË DHIATËN E RE GREQISHT

- A. Teknikat për të treguar theksimin ndryshojnë nga njëri autor në tjetrin në Dhiatën e Re. Shkrimtarët më të njëtrajtshëm dhe më formalë ishin Luka dhe autori i Hebrenjve.
- B. Më herët, pohuam se DËFTORJA AORISTE VEPRORE ishte standarde dhe e paklasifikuar për theksim, por çdo KOHË, DIATEZË, ose MËNYRË tjetër kishte domethënie nga ana interpretuese. Me këtë nuk po themi se DËFTORJA AORISTE VEPRORE nuk përdorej shpesh në një kuptim gramatikor domethënës. (Shembull: Rom. 6:10 [dy herë]).
- C. Rendi i fjalëve në greqishten *koine*
1. Greqishtja *koine* ishte një gjuhë e eptuar që, në dallim nga anglishtja, nuk varej nga rendi i fjalëve. Si rrjedhojë, autori mund ta ndryshojë rendin e prishëm dhe normal të fjalëve për të treguar
 - a. atë që autori donte t'i theksonte lexuesit
 - b. atë që autori mendonte se do të ishte e papritur për lexuesin
 - c. atë që autori e kishte shumë për zemër
 2. Rendi normal i fjalëve në greqisht është ende një çështje e pazgjidhur. Megjithatë, rendi i supozuar normal është ky:
 - a. për FOLJET lidhëse
 - (1) FOLJE
 - (2) KRYEFJALË
 - (3) PLOTËS
 - b. për FOLJET KALIMTARE
 - (1) FOLJE
 - (2) KRYEFJALË
 - (3) KUNDRINOR
 - (4) KUNDRINOR I ZHDREJTË
 - (5) FRAZË PARAFJALORE
 - c. për FRAZAT EMËRORE
 - (1) EMËR
 - (2) PËRCAKTOR
 - (3) FRAZË PARAFJALORE
 3. Rendi i fjalëve mund të jetë një pikë jashtëzakonisht e rëndësishme ekzegjetike. Shembuj:
 - a. “dorën e djathtë na dhanë mua dhe Barnabës për miqësi”. Fraza “dora e djathtë e miqësisë” ndahet dhe është vendosur në krye për të treguar domethënien e vet (Gal. 2:9).
 - b. “me Krishtin” vendoset në fillim. Vdekja e tij ishte qendrore (Gal. 2:20).
 - c. “ishte pjesë-pjesë dhe në shumë mënyra të ndryshme” (Heb. 1:1) vendoset në fillim. Kontrasti që po jepet është mënyra sesi Perëndia e zbuloi veten, jo fakti i zbulës.
- D. Zakonisht, njëfarë shkalle theksimi tregohet nga
1. Përsëritja e PËREMËRIT që ishte tashmë i pranishëm në formën e eptuar të FOLJES. Shembull: “unë, vetë, do të jem patjetër me ju...” (Mat. 28:20).
 2. Mungesa e një LIDHËZE të pritshme, ose ndonjë tjetër mjeti lidhës mes fjalëve, frazave, fjalive, ose periudhave. Kjo gjë quhet asindet (“jo e lidhur”). Mjeti lidhës pritej, prandaj mungesa e tij tërhiqte vëmendje. Shembuj:
 - a. “Lum”-et në Mal, Mat. 5:3 e më tej (e theksoi listën)
 - b. Gjoni 14:1 (temë e re)
 - c. Romakëve 9:1 (pjesë e re)
 - d. 2 Kor. 12:20 (thekson listën)

3. Përsëritja e fjalëve ose frazave të pranishme në një kontekst të dhënë. Shembuj: “për lëvdimin e lavdisë së tij” (Efe. 1:6, 12 & 14). Kjo frazë përdoret për të treguar veprën e secilit person të Trinisë.
4. Përdorimi i një idiome ose loje fjalësh (tingujsh) mes termave
 - a. eufemizmat – zëvendësim fjalësh për disa tema tabu, si “gjumi” për vdekjen (Gjoni 11:11-14), ose “këmbët” për gjenitalet mashkullore (Ruthi 3:7-8; 1 Sam. 24:3).
 - b. perifrazimet – zëvendësim fjalësh për emrin e Perëndisë, si “Mbretëria e qiejve” (Mat. 3:21), ose “një zë nga qielli” (Mat. 3:17).
 - c. FIGURAT LETRARE
 - (1) ekzagjerime të pamundura (Mat. 3:9; 5:29-30; 19:24)
 - (2) pohime disi të tepruara (Mat. 3:5; Veprat 2:36)
 - (3) personifikime (1 Kor. 15:55)
 - (4) ironi (Gal. 5:12)
 - (5) pasazhe poetike (Fil. 2:6-11)
 - (6) lojë tingujsh mes fjalëve
 - (a) “kisha”
 - i. “kisha” (Efe. 3:21)
 - ii. “thirrja” (Efe. 4:1, 4)
 - iii. “i thirrur” (Efe. 4:1, 4)
 - (b) “i lirë”
 - i. “grua e lirë” (Gal. 4:31)
 - ii. “liri” (Gal. 5:1)
 - iii. “i lirë” (Gal. 5:1)
 - d. gjuha idiomatike – terminologji që, zakonisht, është e veçantë për kulturat dhe gjuhët e ndryshme:
 - (1) përdorimi figurativ i fjalës “ushqim” (Gjoni 4:31-34)
 - (2) përdorimi figurativ i fjalës “tempull” (Gjoni 2:19; Mat. 26:61)
 - (3) idioma hebraike për termin dhembshuri, “urrej” (Zan. 29:31; LiP. 21:15; Luka 14:36; Gjoni 12:25; Rom. 9:13)
 - (4) “Të gjithë” përkundër “shumë”-ve. Krahaso Isa. 53:6 (“të gjithë”) me 53:11 & 12 (“shumë”). Këta terma janë sinonimikë, siç e tregojnë dhe Rom. 5:18 dhe 19.
5. Përdorimi i një fraze të plotë gjuhësore, në vend të një fjale të vetme. Shembull: “Zoti Jezu Krisht”.
6. Përdorimi i veçantë të *autos*
 - a. kur ka NYJË (pozicioni atributiv), përkthehej “i njëjti”.
 - b. kur s’ka NYJË (pozicioni kallëzuesor), përkthehej si PËREMËR VETVETOR INTENSIV – “veten e tij”, “veten e saj”.

E. Studiuesi i Biblës që nuk di greqisht mund ta identifikojë theksimin në mënyra të ndryshme:

1. Përdorimi i një leksiku analitik dhe i një teksti ndërlinear greqisht/anglisht.
2. Krahasimi i përkthimeve në gjuhën angleze, sidomos ato përkthime që kanë teori të ndryshme përkthimi. Shembull: krahasimi i një përkthimi “fjalë për fjalë” (KJV, NKJV, ASV, NASB, RSV, NRSV) me një përkthim të “ekuivalencës dinamike” (Williams, NIV, NEB, REB, JB, NJB, TEV). Ndihmë e dobishme këtu do të ishte *The Bible in Twenty-Six Translations*, përkthyer nga Baker.
3. Përdorimi i *The Emphasized Bible (Bibla e theksuar)*, nga Joseph Bryant Rotherham (Kregel, 1994).
4. Përdorimi i një përkthimi shumë të fjalëpërfjalshëm
 - a. *The American Standard Version* i vitit 1901
 - b. *Young’s Literal Translation of the Bible*, nga Robert Young (Guardian Press, 1976).

Studimi i gramatikës është i mërztitshëm, por i domosdoshëm për interpretimin e saktë. Këto përcaktime të shkurtra, komente dhe shembuj synojnë të inkurajojnë dhe të pajisin personat që nuk dinë greqisht që të përdorin shënimet gramatikore të dhëna në këtë vëllim. Pa dyshim, këto përcaktime janë të mbithjeshtëzuara. Ato nuk duhen përdorur në mënyrë dogmatike dhe të pandryshueshme, por si trampolina drejt të kuptuarit më të mirë të sintaksës së Dhiatës së Re. Shpresoj se këto përcaktime do t’u mundësojnë lexuesve edhe që të kuptojnë komentet e ndihmave të tjera studimore, si komentaret teknikë për Dhiatën e Re.

Duhet të jemi në gjendje që interpretimin tonë ta verifikojmë në bazë të informacionit që gjendet në tekstin e Biblës. Gramatika është një nga pjesët më të dobishme të këtij informacioni; elementet e tjera përfshijnë sfondin historik, kontekstin letrar, përdorimin bashkëkohor të fjalëve, dhe pasazhet paralele.

KRITIKA E TEKSTIT

Kjo temë do të trajtohet në mënyrë të tillë që të shpjegojmë shënimet tekstuale që gjenden në këtë komentari. Do të përdorim përvijimin e mëposhtëm:

- I. Burimet tekstuale të Biblës anglisht
 - A. Dhiata e Vjetër
 - B. Dhiata e Re
- II. Shpjegim i shkurtër i problemeve dhe teorive të “kritikës së ulët”, e quajtur edhe ‘kritika e tekstit’.
- III. Burime të sugjeruara për lexim të mëtejshëm

I. Burimet tekstuale të Biblës anglisht

A. Dhiata e Vjetër

1. Teksti Masoretik (MT) – teksti bashkëtingëllor hebraisht u përcaktua nga rabini Akiva më 100 pas K. Pikat e zanoreve, thekset, shënimet anësore, pikësimi dhe pikat e aparatusit filluan të shtoheshin në shekullin në shekullin e gjashtë pas K. dhe u përfunduan në shekullin e nëntë pas K. Kjo u bë nga një familje studiuesish judenj të njohur si Masoretët. Forma tekstuale që përdorën ata ishte e njëjta që përdoret në Mishnah, Talmud, Targumet, Peshita dhe Vulgatë.
2. Septuaginta (LXX) – Tradita thotë se Septuaginta u prodhua nga 70 studiues judenj në 70 ditë për bibliotekën e Aleksandrisë, me sponsorizimin e mbretit Ptoleme II (285-246 pas K.). Me gjasë, përkthimi u kërkua nga një udhëheqës jude që jetonte në Aleksandri. Kjo traditë vjen nga “Letra e Aristee”. Shpesh, LXX bazohet në një traditë tekstuale hebraisht që ndryshon nga teksti i rabinit Akiva (MT).
3. Pergamenat e Detit të Vdekur (DSS) – Pergamenat e Detit të Vdekur u shkruan në periudhën romake para Krishtit (200 para K. deri më 70 pas K.) nga një sekt separatisësh judenj të quajtur “esenë”. Dorëshkrimet hebraisht, të gjetura në vendndodhje të ndryshme përreth Detit të Vdekur, tregojnë një familje tekstuale hebraisht disi të ndryshme nga ajo e MT dhe LXX.
4. Disa shembuj të veçantë për mënyrën sesi krahasimi i këtyre teksteve ka ndihmuar interpretuesit që të kuptojnë Dhiatën e Vjetër
 - a. LXX ka ndihmuar përkthyesit dhe studiuesit që të kuptojnë MT-në
 - (1) LXX, në Isa. 52:14: “ashtu si shumë do të mahnitën me të”.
 - (2) MTT, në Isa. 52:14: “ashtu si shumë u habitën me ty”.
 - (3) Në Isa. 52:15 konfirmohet dallimi përemëror i LXX
 - (a) LXX, “kështu dhe shumë kombe do të mrekullohen prej tij”
 - (b) MT, “kështu ai spërkat shumë kombe”
 - b. DSS kanë ndihmuar përkthyesit dhe studiuesit që të kuptojnë MT-në
 - (1) DSS, në Isa. 21:8: “atëherë vrojtuesi bërtiti, ‘Mbi një kullë roje po qëndroj’...”
 - (2) MT, në Isa. 21:8: “dhe unë bërtita, një luan! Zoti im, unë do të qëndroj gjithmonë në kullën e rojës ditën...”
 - c. Si LXX, ashtu dhe DSS, kanë ndihmuar për qartësimin e Isa. 53:11
 - (1) LXX & DSS, “pas mundimit të shpirtit të tij, ai do të shohë dritë dhe do të kënaqet”
 - (2) MT, “ai do të shohë... e mundimit të shpirtit të tij, do të kënaqet”

B. Dhiata e Re

1. Kanë mbijetuar mbi 5,300 dorëshkrime të gjithë Dhiatës së Re, ose të pjesëve të saj. Rreth 85 janë shkruar në papirus ndërsa 268 prej tyre janë shkruar vetëm me shkronja të mëdha (unciale). Më vonë, rreth shekullit të nëntë pas K., u zhvillua një shkrim i lidhur (minuskul). Dorëshkrimet greqisht, në formë të shkruar, numërojnë rreth 2,700. Po kështu, kemi dhe rreth 2,100 kopje me lista pasazhesh biblike që përdorëshin në adhurim, të cilat i quajmë leksionarë.
2. Rreth 85 dorëshkrime greqisht, që përmbajnë pjesë të Dhiatës së Re të shkruara në papirus, gjenden në muze. Disa datojnë nga shekulli i dytë pas K., por shumica janë nga shekujt e tretë dhe të katërt pas K. Asnjë prej këtyre MSS nuk e përmban gjithë Dhiatën e Re. Thjesht fakti se ato janë kopjet më të lashta të Dhiatës së Re nuk do të thotë automatikisht se kanë më pak variante. Shumë prej tyre u

kopjuan me shpejtësi për përdorim lokal. Nuk u ushtrua kujdes në këtë proces. Si rrjedhojë, ato përmbajnë shumë variante.

3. Kodiku Sinaitikus, i njohur me shkronjën hebraisht **א** (*alef*), ose (01), i gjetur në manastirin e shën Katerinës në malin Sinai nga Tischendorf. Daton nga shekulli i katërt pas K. dhe përmban, si LXX-në e DhV, ashtu dhe Dh.R. greqisht. Është i llojit të “tekstit aleksandrian”.
4. Kodiku Aleksandrinus, i njohur si “A”, ose (02), një dorëshkrim greqisht i shekullit të pestë, i cili u gjet në Aleksandri të Egjiptit.
5. Kodiku Vatikanus, i njohur si “B”, ose (03), i gjetur në bibliotekën e Vatikanit në Romë dhe daton nga mesi i shekullit të katërt pas K. Përmban si LXX-në e Dhiatës së Vjetër, ashtu dhe Dhiatën e Re greqisht. Është i llojit të “tekstit aleksandrian”.
6. Kodiku Ephraemi, i njohur si “C”, ose (04), një dorëshkrim greqisht i shekullit të pestë, i cili është shkatërruar pjesërisht.
7. Kodiku Bezae, i njohur si “D”, ose (05), një dorëshkrim greqisht i shekullit të pestë ose të gjashtë. Është përfaqësues kryesor i atij që quhet “tekst perëndimor”. Përmban shumë shtesa dhe është dëshmitari kryesor në greqisht për përkthimin e King James Version.
8. Dorëshkrimet e DhR mund të grupohen në tre, ndoshta dhe katër, familje që ndajnë disa karakteristika.
 - a. Teksti aleksandrian nga Egjipti
 - (1) P⁷⁵, P⁶⁶ (rreth 200 pas K.), që përmbajnë ungjijtë
 - (2) P⁴⁶ (rreth 225 pas K.), që përmban letrat e Palit
 - (3) P⁷² (rreth 225-250 pas K.), që përmban Pjetrin dhe Judën
 - (4) Kodiku B, i quajtur Vatikanus (rreth 325 pas K.), që përfshin gjithë DhV dhe DhR
 - (5) Origeni citon nga ky lloj teksti
 - (6) Dorëshkrime të tjera që shfaqin këtë lloj teksti janë **א**, C, L, W, 33
 - b. Teksti perëndimor nga Afrika veriore
 - (1) Citime nga etërit e kishës në Afrikën veriore, Tertuliani, Qipriani dhe përkthimi i “Vjetër Latin”
 - (2) Citime nga Ireneu
 - (3) Citime nga Tatiani dhe përkthimi “i Vjetër Siriak”
 - (4) Kodiku D, “Beza”, ndjek këtë lloj teksti
 - c. Teksti bizantin i lindjes, nga Kostandinopoja
 - (1) Ky lloj teksti reflektohet në mbi 80% të 5,300 dorëshkrimeve
 - (2) Citohet nga etërit e kishës në Antioki të Sirisë, Kapadokianët, Gojarti dhe Theodoret
 - (3) Kodiku A, vetëm në ungjijtë
 - (4) Kodiku E (shekulli i tetë) për gjithë DhR
 - d. Lloji i katërt i mundshëm është ai “cezareas”, nga Palestina
 - (1) Kryesisht, shihet vetëm te Marku
 - (2) Disa dëshmitarë të tij janë P⁴⁵ dhe W

II. Problemet dhe teoritë e “kritikës së ulët”, ose “kritikës së tekstit”.

A. Si u shfaqën variantet

1. të paqëllimshëm ose aksidentalë (shumica dërrmuese e tyre)
 - a. shkarje syri në kopjimin me dorë, ky syri lexon rastin e dytë të dy fjalëve të ngjashme dhe, në këtë mënyrë, lë pa shkruar të gjitha fjalët e ndërmjetme (homoioteleuton)
 - (1) shkarje syri, duke lënë pa shkruar një shkronjë, fjalë, ose frazë, që duhej shkruar dy herë (haplografi)
 - (2) shkarje mendjeje, duke përsëritur një frazë ose rresht të tekstit greqisht (ditografi)
 - b. shkarje veshi, që ndodhte në kopjimin me diktim gojor, ku ndodh një keqshqiptim (itacizëm). Shpesh, keqshqiptimi nënkupton ose shqipton një fjalë tjetër greqisht, që tingëllon në mënyrë të ngjashme.
 - c. teksti më i hershëm greqisht nuk kishte ndarje në kapituj apo vargje, pak ose aspak pikëzim dhe asnjë ndarje mes fjalëve. Është e mundur që t'i ndash shkronjat në vende të ndryshme, duke formuar fjalë të ndryshme.

2. të qëllimshëm
 - a. bëheshin ndryshime për të përmirësuar formën gramatikore të tekstit të kopjuar
 - b. bëheshin ndryshime duke kombinuar dy ose më tepër variante të ndryshme në një tekst të gjatë e të kombinuar (bashkëshkrimje)
 - c. bëheshin ndryshime për të korrigjuar ndonjë problem të perceptuar në tekst (shih 1 Kor. 11:27 dhe 1 Gjonit 5:7-8)
 - d. disa informacione shtesë në lidhje me sfondin historik ose interpretimin e duhur të tekstit vendoseshin në anë të faqes nga njëri kopjues, ndërsa një kopjues i dytë i fuste në tekst (shih Gjoni 5:4)
- B. Parimet bazë të kritikës së tekstit (udhërrëfytes logjike për përcaktimin e leximit origjinal të një teksti kur ekzistojnë forma variante)
1. Teksti më i vështirë, ose më i pazakontë nga ana gramatikore, ka gjasa të jetë origjinali
 2. Teksti më i shkurtër ka gjasa të jetë origjinali
 3. Tekstit më të vjetër i jepet më tepër peshë për shkak të afërsisë së tij historike me origjinalin, në rast se gjithçka tjetër është në ekuilibër
 4. MSS që janë të larmishme nga ana gjeografike zakonisht kanë leximin origjinal
 5. Duhet preferuar tekstet më të dobët nga ana doktrinale, sidomos ato që lidhen me diskutimet kryesore teologjike të periudhës së ndryshimeve në dorëshkrime, si Trinia në 1 Gjonit 5:7-8.
 6. Teksti që arrin të shpjegojë më mirë origjinën e varianteve të tjerë
 7. Dy citime që ndihmojnë për të treguar ekuilibrin për këto variante shqetësuese
 - a. Libri i J. Harold Greenlee, *Introduction to New Testament Textual Criticism*, f. 68:
 “Asnjë doktrinë e krishterë nuk varet nga një tekst i debatueshëm; dhe studiuesi i DhR duhet të ketë kujdes që të mos dëshirojë që teksti i tij të jetë më ortodoks, ose më i fortë nga ana doktrinale, sesa vetë origjinali i frymëzuar”.
 - b. W. A. Criswell i tha Greg Garrisonit të *The Birmingham News* se ai (Criswell) nuk besonte se çdo fjalë në Bibël është e frymëzuar, “të paktën jo çdo fjalë që i është dhënë publikut të sotëm nga shekuj përkthyesish”. Criswell tha: “unë jam besimtar i fortë në kritikë e tekstit. Si i tillë, unë mendoj se gjysma e fundit e kapitullit 16 të Markut është herezi: nuk është e frymëzuar, por thjesht e shpikur... Kur e krahason me dorëshkrimet më të lashta, nuk ekziston diçka e tillë si përmbyllja e librit të Markut. Dikush e shtoi...”
 Patriarku i atyre të SBC-së që besojnë në pagabueshmërinë e Biblës pohoi gjithashtu se “ndërhyrja” është e dukshme edhe në Gjoni 5, në rrëfimin e Jezusit te pellgu i Betezdës. Po kështu, ai diskuton për dy rrëfimet e ndryshme të vetëvrasjes së Judës (shih Mat. 27 dhe Veprat 1): “Këtu kemi thjesht një pikëpamje të ndryshme të vetëvrasjes”, tha Criswell. “Nëse është në Bibël, ka një shpjegim për këtë. Dhe dy rrëfimet e vetëvrasjes së Judës janë në Bibël”. Criswell shtoi: “Kritika e tekstit është një shkencë e mrekullueshme në vetvete. Nuk është kalimtare, nuk është e pacipë. Ajo është dinamike dhe qendrore...”

III. Problemet në dorëshkrime (kritika e tekstit)

A. Burime të sugjeruara për lexim të mëtejshëm

1. *Biblical Criticism: Historical, Literary and Textual (Kritika e Biblës: historike, letrare dhe tekstuale)*, nga R. H. Harrison
2. *The Text of the New Testament: Its Transmission, Corruption, and Restoration (Teksti i Dhiatës së Re: transmetimi, shprishja dhe ndreqja e tij)*, nga Bruce M. Metzger
3. *Introduction to New Testament Textual Criticism (Hyrje në kritikën e tekstit të Dhiatës së Re)*, nga J. H. Greenlee

SHPALLJE DOKTRINORE

S'është se dua t'ia di për shpalljet doktrimore apo kredot. Parapëlqej të pohoj vetë Biblën. Gjithsesi, e kuptoj se një shpallje besimi do t'u sigurojë atyre që s'më njohin një mënyrë për të vlerësuar këndvështrimin tim doktrinor. Në kohën tonë, të mbushur me kaq shumë gabime dhe mashtrime teologjike, ofroj shkurtimisht më poshtë përmbledhjen e teologjisë sime.

1. Bibla, si Dhiata e Vjetër ashtu dhe e Reja, është Fjala e frymëzuar, e pagabueshme, e autoritetshme dhe e përjetshme e Perëndisë. Ajo është vetëzbuluesja e Perëndisë, e shkruar nga njerëzit nën drejtimin e mbinatyrshëm hyjnor. Ajo është burimi ynë i vetëm i së vërtetës së qartë për Perëndinë dhe për synimet e tij. Po kështu, ajo është burimi i vetëm i besimit dhe praktikës për kishën e tij.

2. Ekziston vetëm një Perëndi i përjetshëm, krijues dhe shpengues. Ai është krijuesi i të gjitha gjërave, të dukshme dhe të padukshme. Ai e ka zbuluar veten si Perëndi i dashur dhe i dhembshur, ndonëse është edhe i paanshëm e i drejtë. Ai e ka zbuluar veten në tre persona të veçantë: Ati, Biri dhe Fryma; vërtet të veçantë por, megjithatë, të njëjtë për nga substanca.

3. Perëndia është aktivisht në kontroll të botës së vet. Ekziston një plan i përjetshëm për krijimin e tij, që është i pandryshueshëm, por edhe një plan i fokusuar tek individë, që lejon vullnetin e lirë njerëzor. Asgjë nuk ndodh pa njohurinë dhe lejen e Perëndisë, por, megjithatë, ai lejon zgjedhje individuale ndër engjëjt dhe njerëzit. Jezusi është Njeriu i Zgjedhur i Atit dhe të gjithë janë potencialisht të zgjedhur në të. Paranjohja e ngjarjeve nga ana e Perëndisë nuk i ul njerëzit në nivelin e një skenari të parashkruar dhe të paracaktuar. Të gjithë jemi përgjegjës për mendimet dhe veprat tona.

4. Njerëzimi, ndonëse i krijuar në shëmbëllimin e Perëndisë dhe i lirë nga mëkati, zgjodhi të ngrinte krye kundër Perëndisë. Ndonëse u tunduan nga një veprues i mbinatyrshëm, Adami dhe Eva ishin përgjegjës për egoizmin e tyre rebel. Kryengritja e tyre ka prekur njerëzimin dhe krijimin. Të gjithë kemi nevojë për mëshirën dhe hirin e Perëndisë, si për gjendjen tonë kolektive në Adamin, ashtu dhe për kryengritjen tonë të vullnetshme si individë.

5. Perëndia i ka siguruar njerëzimit të rënë një mënyrë faljeje dhe rimëkëmbjeje. Jezu Krishti, biri i pashoq i Perëndisë, u bë njeri, bëri një jetë të pamëkatë dhe, me anë të vdekjes së vet zëvendësuese, pagoi dënimin për mëkatin e njerëzimit. Ai është e vetmja rrugë për rimëkëmbjen dhe bashkësinë me Perëndinë. Nuk ka mënyrë tjetër shpëtimi përveçse përmes besimit në veprën e përfunduar të tij.

6. Secili prej nesh duhet të pranojë personalisht ofertën e faljes së Perëndisë dhe rimëkëmbjes në Jezusin. Kjo arrihet me anë të besimit të vullnetshëm në premtimet e Perëndisë përmes Jezusit, duke i kthyer vullnetshëm shpinën mëkateve të njohura.

7. Të gjithë ne falemi dhe rimëkëmbemi plotësisht në bazë të besimit në Krishtin dhe pendimit nga mëkati. Sidoqoftë, provat për këtë marrëdhënie të re shihen në jetën e ndryshuar dhe në ndryshim e sipër të besimtarit. Synimi i Perëndisë për njerëzimin nuk është vetëm qielli dikur në të ardhmen, por ngjashmëria me Krishtin tani. Ata që janë vërtet të shpenguar, ndonëse mëkatojnë ndonjëherë, do të vazhdojnë me besim dhe pendim gjatë gjithë jetës.

8. Fryma e Shenjtë është "Jezusi tjetër". Ai është i pranishëm në botë për të drejtuar të humburit të Krishti dhe për të zhvilluar ngjashmërinë me Krishtin të të shpëtuarit. Dhuntitë e Frymës jepen kur shpëtohem. Ato janë jeta dhe shërbesa e Jezusit, të ndara brenda trupit të tij, kishës. Dhuntitë, të cilat në thelb janë qëndrimet dhe motivet e Jezusit, duhen motivuar me anë të frytit të Frymës. Fryma është po aq veprues në kohën tonë sa dhe në kohët biblike.

9. Ati e ka bërë Jezu Krishtin e ringjallur Gjykatës të të gjitha gjërave. Ai do të kthehet në tokë për të gjykuar gjithë njerëzimin. Ata që kanë besuar në Jezusin, emrat e të cilëve janë në librin e jetës së Qengjit, do të marrin trupa të përlëvdur dhe të përjetshëm kur të kthehet ai. Ata do të jenë përjetësisht me të. Ndërsa ata që s'kanë pranuar t'i përgjigjen së vërtetës së Perëndisë do të ndahen përjetësisht nga gëzimet e bashkësisë me Perëndinë Triun. Ata do të dënohen së bashku me Djallin dhe engjëjt e tij.

Sigurisht, kjo nuk është as e plotë, as tërësore, por shpresoj se do t'ju japë sadopak ngjyrimin teologjik të zemrës sime. Mua më pëlqen shprehja:

“Në thelbësoret – unitet; në jothelbësoret – liri; në gjithçka – dashuri”.